Hemodializa është një procedurë terapeutike, që përdor qarkullimin ekstrakorporal të gjakut të pacientit për të përmirësuar azoteminë, anomalitë e lëngjeve, elektrolitëve dhe acido - bazës karakteristike të sindromës uremike. Hemodializa përdoret kryesisht për trajtimin e insuficiencës renale akute dhe kronike, që është refraktare ndaj terapisë mjekësore konvencionale. Aplikimet shtesë përfshijnë dehjet akute (p. sh. , helmimi me etilen glikol) dhe kondicionimin para operacionit të marrësve të transplantit të veshkave. Hemodializa është një procedurë teknikisht kërkuese, që kërkon një grup të gjerë pajisjesh të sofistikuara të shpërndarjes dhe staf të trajnuar dhe të dedikuar posaçërisht për të kryer, monitoruar dhe garantuar integritetin dhe sigurinë e procedurës në pacientët me sëmundje kritike.
Qëllimi I studimit ka të bëjë me vlerësimin e disa faktorëve prioritar në vlerësimin e cilësisë së jetë, si dhe të dhënave antropometrike të pacientëve të hemodializës, që ndikojnë në mënyrë më të drejtpërdrejtë në të.
Metodologjia: Studimi ynë është i tipit transversal deskriptiv. Në këtë studim u përfshi një kampion prej 100 individësh, që u përzgjodh në sektorin e Hemodializës, në Spitalin Hygeia. Mbledhja e të dhënave u mundësua nëpërmjet ekzaminimit fizik, si dhe një pyetësori të strukturuar të vetë–administrueshëm.
Rezultate: Sipas studimit rezultoi se në kampionin e përzgjedhur sipas ndarjes në kategori kemi që 40% e pacientëve në hemodializë e vlerësojne cilësinë e jetës se tyre në nivel mesatar, kurse vetëm 10% theksuan se cilësia e jetës është në nivel shumë të ulët; ndërkohë 70% e pacientëve me insuficiencë renale ndjekin programin e dializës 3 herë në javë, 65% respektojnë kohëzgjatjen e dializës 3 orë e 30 min, po ashtu 65% deklaruan se kanë përdorur medikamente gjatë gjithë kohës së hemodializës. Në aspektin e menaxhimit të perdorimit të lëngjeve, 77% e intervistuesve kishin njohuri mbi rëndësinë e kufizimit të lëngjeve për shkak të mbingarkesës së veshkave jofunksionale; kurse vetëm 59% prej tyre theksuan se shërbimi infermieror i ka këshilluar për kufizimin e lëngjeve dhe në drejtim të dietës 65% prej tyre e deklaruan se veshka kërkon respektimin e një diete rigoroze.
Konkluzione: Kualiteti i jetës së pacientëve në hemodializë është vleresuar në nivel mesatar, por që refleton nevojën për ndjekje dhe vleresim të vazhdueshëm. Punonjësit e kujdesit shëndetësorë duhet të kryejnë promocion shëndetësor në lidhje me stilin e jetesës së shëndetshme dhe promovimin e një diete të ekulibruar sipas grupeve dhe kategorive të rriskut.

Fjalë kyçe: Insufiçenca renale, dializa, vlerësimi i kualitetit të jetës, regjimi dietetik, efektet psikosociale.

KRIJIMI I TIPIT TË HUNDËS - TEKNIKAT MODERNE.
Adem Kllokoqi

Abstrakt
Rinoplastika është një procedurë kirurgjikale që kombinon artin dhe shkencën për të krijuar një hundë funksionalisht të shëndetshme dhe estetikisht harmonike. Ky proces kërkon një analizë të detajuar të strukturës anatomike të pacientit, një qasje të personalizuar dhe përdorimin e teknikave më të përparuara për të arritur rezultate optimale.
Struktura Kockore dhe Kërcore: Hunda ka një bazë skeletore të përbërë nga kockat nazale dhe një strukturë fleksibile kërcore që formon dorsumin dhe majën e hundës.
Parimet Estetike: Këndet nazale të mesme përfshijnë këndin nazofrontal (115 - 1309), këndin nazolabial. këndi (90 - 110 për burrat, 95 - 115" për gratë), dhe këndi kolumel - lobular, i cili ndikon në ekuilibrin estetik të tipit nazal.
Analiza e Projeksionit dhe Rrotullimit: Matjet e avancuara përdoren për të përcaktuar nëse një hundë është e nënprojektuar, e mbiprojektuar ose e rrotulluar në një mënyrë të çrregullt.
Rinoplastika e Hapur: Ofron një pamje të qartë të strukturave nazale, duke lejuar manipulim më të saktë të kërcit dhe indeve të buta.
Rinoplastika e Mbyllur: Një teknikë më pak invazive, ku të gjitha prerjet bëhen brenda hundës, duke zvogëluar shenjat pas operacionit.
Rikonstruksionet autologe: Përdorimi i kërcit nga septumi, veshi ose kocka e hundës për të ndërtuar dhe stabilizuar hundën.
Rikonstruksionet e tipit të hundës: Rikonstruksionet me Kapak: Shtohen në majë për rafinim estetik. Rikonstruksionet Mburojëse: Ndihmojnë në projeksionin dhe përkufizimin e majës. Rikonstruksionet Kolumellare Strut: Forcojnë dhe stabilizojnë kolumelën. Rikonstruksionet Laterale Krurale Strut: Rregullojnë projeksionin lateral dhe stabilizojnë strukturën e hundës. Rikonstruksionet me Shtyllë: Përdoren për të parandaluar shembjen e valvulës nazale. Implantet Sintetike: Përdoren në raste të zgjedhura për të përmirësuar strukturën e hundës, por përdorimi i materialeve autologe preferohet për shkak të biokompatibilitetit më të mirë.
Rinoplastika me Ultratinguj (Piezo): Teknologji që lejon prerjen e kontrolluar të kockave pa dëmtuar indet e buta, duke zvogëluar
hematomat dhe ënjtjen.
Rinoplastika Jo - kirurgjikale: Përdorimi i flluskave (acid hialuronik) për të korrigjuar deformimet e vogla pa ndërhyrje kirurgjikale.

Fjalë kyçe: rinoplastikë, rikonstruksion, kirurgji, ultratinguj.

DYSBIOZA, ULJA E CITRATEVE URINARE DHE RRITJA E ACIDEVE YNDYRORE TË LIRA SI TREGUES TË HERSHËM TË ÇRREGULLIMEVE IMUNOMETABOLIKE.
Adilta Bejko

Abstrakt
Hyrje: Mikrobiota intestinale përfaqëson një komponent thelbësor të boshtit zorrë–metabolizëm–imunitet, duke luajtur një rol kritik në ruajtjen e homeostazës metabolike dhe imunitare sistemike. Modifikimet në ekuilibrin mikrobial intestinal (dysbioza) mund të ndikojnë ndjeshëm në metabolizmin qelizor dhe përgjigjet imune përmes ndërmjetësimit të metabolitëve bioaktivë. Ndërkohë, ndryshimet në profilin metabolik urinar, veçanërisht ulja e përqendrimeve të citrateve dhe rritja e acideve yndyrore të lira (FFA) mund të shërbejnë si biomarkues të hershëm të çrregullimeve imunometabolike subklinike, përpara shfaqjes së manifestimeve klinike të qarta.
Përshkrimi i rastit: Paraqitet një pacient mashkull 50 - vjeç, i cili gjatë një kontrolli rutinë laboratorik u identifikua me hipocitraturi të theksuar, rritje të moderuar të përqendrimeve të acideve yndyrore të lira urinare, si dhe ulje të diversitetit mikrobial intestinal, të dokumentuar përmes analizës së disbiozës fekale me metodologji molekulare. Pacienti ishte asimptomatik, pa anamnezë për patologji kronike ose medikamente të rregullta, ndërkohë që parametrat standart biokimik serik dhe urinar ishin brenda intervaleve referencë.
Diskutime: Këto gjetje laboratorike sugjerojnë një model të hershëm të disfunksionit imunometabolik, i cili potencialisht lidhet me ndryshime në ciklin e Krebsit dhe shfrytëzimin e substrateve energjetike. Uljet e citrateve

urinare mund të pasqyrojnë disfunksionin në metabolizmin mitokondrial ose hipocitratemi të lidhur me acidozë subklinike. Kritja e FFA mund të jetë tregues i ndryshimeve në metabolizmin lipidik dhe inflamacionit latent. Dysbioza intestinale luan një rol modulues, duke ndikuar në metabolitët sistemikë përmes boshtit zorrë–metabolizëm–imunitet.
Përfundime: Kombinimi i profilit urinar metabolik me vlerësimin e mikrobiotës intestinale mund të shërbejë si një mjet i vlefshëm për identifikimin e hershëm të çrregullimeve imunometabolike, duke lejuar ndërhyrje të personalizuara përpara zhvillimit të sëmundjeve kronike.

Fjalë kyçe: dysbioza, mikrobiota intestinale, citrate urinare, pacient.

RËNDËSIA E HULUMTIMIT TË KONCEPTEVE MË TË FUNDIT MBI ALTERACIONET E PROFILIT LIPIDIK.

Admir Nake

Abstrakt
Hyrje: Profili lipidik është i njohur për një lidhje dikotomike mes vlerave të larta të kolesterolemisë, LDL - kolesterolemisë, triglicerideve, vlerave të ulëta të HDL - kolesterolemisë dhe rrezikut aterosklerotik. Sot këndvështrimi ka përmasa të reja. Evolucioni i koncepteve (paradigm shift) lidhur me aterosklerozën, faktorët lipidikë dhe jolipidikë ka qenë i jashtëzakonshëm dhe një shembull spektakolar i rëndësisë së këndvështrimeve sa më të larmishme e dinamike, si frymëmarrje e kërkimit shkencor në antitezë me përfundimet e ngurta dhe absolutiste. Theksimi i evolucionit të disa qasjeve lidhur me profilin lipidik është në fokusin e këtij studimi. Vlen të përmendet relativizimi i rolit të vetëm të kolesterolit dhe fokusimi te roli i LDL - kolesterolemisë dhe PCSK9, relativizimi i rolit mbrojtës të HDL - kolesterolemisë së lartë dhe forma U - shape e saj lidhur me sëmundshmërinë. Roli i apolipoproteinave dhe patologjitë me bazë gjenetike me ndikim në profilin lipidik (p. sh. : sëmundja Tangier), kriteret Frederiksen të dislipidemive, matja e Lp(a) njëherë në jetë janë qasje relativisht të reja të qëndrimit mjekësor ndaj dislipidemive, jo vetëm lidhur me eventet aterosklerotike dhe ato kardiovaskulare, por edhe në patologji të tjera.
Përfundime: Evolucioni i vazhdueshëm dhe i thelluar ndaj profilit lipidik sjell edhe qëndrime të reja mjekësore parandaluese, kapje të hershme dhe terapi në nivel individi, nënpopullate dhe popullate, dhe për rrjedhojë i jep atribute të reja "evidence - based medicine", mjekësisë së personalizuar dhe politikave gjithnjë e më inovative të shëndetit publik.

Fjalë kyçe: forma U - shape, profil lipidik, ateroskleroza, sëmundja Tangier, qasje të reja.

RETINOPATIA E PREMATURITETIT NË SHQIPËRI: PERSPEKTIVA KLINIKE, ETIKE DHE DEONTOLOGJIKE.

PhD - C Eglantina Bulica[1], Assoc. Prof Vilma Mema[2], Assoc. Prof Alketa Tandili[2], Assoc. Prof Admir Sinamati[3]
[1]Okuliste, Poliklinikë e Specialiteteve, Nr. 1, Tiranë, Shqipëri
[2]Qendra Spitalore"Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri
[3]Universiteti i Mjekësisë së Tiranës, Shqipëri

Abstrakt
Hyrja: Retinopatia e prematuritetit (ROP) është një çrregullim vazoproliferativ i retinës që prek foshnjat e parakohshme dhe përbën një nga shkaqet kryesore të verbërisë së parandalueshme në fëmijëri në mbarë botën. Në Shqipëri, sfidat në menaxhimin e ROP përkeqësohen nga infrastruktura e kufizuar, mungesa e programeve të strukturuara të depistimit dhe informacion jo i mjaftueshëm i personelit mjekësor në mbarë vendin si edhe prindërve dhe familjeve.
Qëllimi: Të shqyrtohen sfidat klinike, etike dhe deontologjike në diagnostikimin dhe menaxhimin e ROP në Shqipëri dhe të theksohen strategjitë për përmirësimin e rezultateve të pacientëve.
Materiale dhe Metoda: U krye një analizë narrative e praktikave klinike aktuale, burimeve diagnostike dhe terapeutike, si dhe kornizave etike në kujdesin neonatal shqiptar. U vu theksi në boshllëqet që lidhen me

zbulimin e hershëm, disponueshmërinë e personelit dhe pajisjeve të specializuara, si dhe në zbatimin e terapive standarde, përfshirë fotokoagulimin me lazer dhe injeksionet intravitreale me anti - VEGF.
Rezultate: Diagnoza e vonuar, mungesa e okulistëve pediatrikë të trajnuar, akses i kufizuar në mjete diagnostike dhe terapeutike, si dhe ndjekja e parregullt përbëjnë sfidat kryesore klinike. Sfidat etike lidhen me dhënien e pëlqimit të pacientit (prinderve), pasigurinë mbi efektet afatgjata të terapive të reja, aksesin e barabartë në trajtim dhe mbështetjen psikosociale për familjet. Çështjet deontologjike përfshijnë përgjegjësinë profesionale, transparencën në komunikim, respektin për dinjitetin e pacientit, bashkëpunimin ndërdisiplinor dhe përgjegjësinë institucionale.
Përfundime: ROP në Shqipëri përbën një sfidë shumëdimensionale që kërkon përgjigje të koordinuar klinike, etike dhe institucionale. Krijimi i protokolleve kombëtare të depistimit, forcimi i trajnimit të specialistëve, garantimi i aksesit të barabartë në terapi dhe zbatimi i udhëzimeve të strukturuara etike janë thelbësore për parandalimin e verbërisë së lidhur me ROP dhe për optimizimin e kujdesit ndaj foshnjave të parakohshme.

Fjalë kyçe: Retinopatia e prematuritetit (ROP), foshnja të parakohshme, programe depistimi, menaxhim klinik, sfida etike, përgjegjësi deontologjike, Shqipëri.

REHABILITIMI MJEKËSOR TEK SINDROMA E DHIMBJES KOMPLEKSE REGJIONALE, RISHIKIM LITERATURE.

Dr. Admirim Dinarama, Dr. Agron Qoqaj, Prof. Asc. Teuta Osmani Vllasolli

Abstrakt
Hyrje: CRPS, e njohur si sindroma e dhimbjes komplekse regjionale, është një shqetësim mjaft i madh për njerëzit në të gjithë botën, të cilët kërkojnë shërimin, për shkak të dhimbjeve të vazhdueshme dhe të padurueshme që i jep sëmundja. Bashkësi të ndryshme mjekësh, japin diagnoza dhe formula të ndryshme të zgjidhjes, të cilat do t'ia bënin pacientit dhimbjen më të lehtë. Ata studiojnë këtë sëmundje tek gjinitë dhe moshat e ndryshme, ku shihet që moshat e vjetra janë më të prekur, kryesisht për faktin që kanë neglizhuar mjekimin e tyre në moshë më të re.
Qëllimi: Ky punim ka për qëllim të paraqes rehabilitimin mjekësor, gjegjësisht agjentët fizik më adekuat në trajtimin e sëmundjes së CRPS, të bazuar në literaturën bashkëkohore botërore. Njëkohësisht të paraqes metodat e diagnostikimit dhe trajtimin medikamentoz.
Metodologjia: Punimi është hulumtim i tipit kontroll i randomizuar me komponenta deskriptive dhe analitike, që bën krahasimin e efikasitetit të llojeve të ndryshme të agjentëve fizikë te sindroma e dhimbjes komplekse regjionale, duke u bazuar në punime të botuara në revista të ndryshme për hulumtime mjekësore: BJA Education, Medicina Univeritaria, Medscape, Pubmed, National library of Medicine. Janë shfrytëzuar web faqe si: Google, Elsevier.
Rezultate: Prej agjentëve fizikë, në trajtimin e CRPS, më efikas u tregua TENS. Po ashtu, ushtrimet para pasqyrës (biofadback), u tregua efikase në trajtimin e dhimbjes në nyjen humeroskapulare tek pacientët me ICV. Gjithashtu, mjekimi medikamentoz dha rezultat më të mirë me barna anti inflamatore jo steroide, antiepileptikë si amitriptilina dhe gabapentina.
Përfundime: Sëmundja CRPS, është një sëmundje simptomat e të cilës shkaktojnë tek pacienti dhimbje të vazhdueshme. Për rehabilitimin e kësaj sëmundje, janë përdorur agjentë fizikë dhe mjekim medikamentoz. Prej agjentëve fizikë, më të suksesshëm kanë qenë TENS, TENS me rreze infra të kuqe, ushtrimet para pasqyrës. Prej mjekimit medikamentoz rezultate kanë treguar anti inflamatorët jo steroid, antiepileptikët, antidepresantët si dhe kortikosteroidet.

Fjalë kyçe: CRPS, rehabilitimi, agjentët fizik, mjekimi medikamentoz.

APENDISITI AKUT: EPIDEMIOLOGJIA, KLINIKA, QËNDRIMET TERAPEUTIKE. TË DHËNA PËR PERIUDHËN KOHORE 2020 – 2023.

Adnand Demrozi, Asc. Prof. Dritan Alushani
Shërbimi i Kirurgjisë Infantile - QSUT

Abstrakt

Hyrje: Apendisiti është proces inflamator akut i apendiksit që shkaktohet nga obstruksioni i apendiksit nga inflamacioni i murit, nga një fekalit si dhe nga një hiperplazi limfoide. Në Shqipëri incidenca vjetore është nga 1 - 6 për 10. 000 lindje në moshat nën 4 vjeç dhe 19 - 28 për 10. 000 lindje për fëmijët nën 14 vjeç. Qëndrimi terapeutik klasik është ai kirurgjikal (apendektomia) por 5 vitet e fundit po insistohet aplikimi i trajtimit konservativ.

Qëllimi: Pasqyrim i sëmundshmërisë duke prezantuar rezultatet epidemilogjike, klinike si dhe rezultatet e 2 qëndrimeve terapeutike.

Metodologjia: Është studim deskriptiv, cros - seksional dhe retrospektiv, i realizuar në një mostër prej 9879 pacientë të hospitalizuar pranë Shërbimit të Kirurgjisë Infantile QSUT gjatë viteve 2020–2023. U studiuan duke përdorur Epi Info dhe SPPS ver. 11, incidenca e sëmundjes, sëmundshmëria sipas gjinisë dhe shpërndarja gjeografike. Gjithashtu u studiuan aspekte klinike të sëmundjes si dhe u krahasua efektshmëria e trajtimit konservativ kundrejt atij kirurgjikal (ditëqëndimi u përdor si indikator).

Rezultate dhe diskutime: Apendisiti u vu re më shumë në meshkuj (62. 5 % e pacientëve ishin meshkuj, ose thënë ndryshe raporti M / F = 1. 7 / 1). Mosha më e prekur rezultoi ajo nga 5 - 12 vjeç (72% e pacientëve). 32% e pacientëve u trajtuan me terapi konservative. Nga këta vetëm 2 pacientë u rikthyen për të kryer apendektomi. Ditëqëndrimi mesatar për pacientët e trajtuar me terapi konservative ishte mesatarisht 3 ditë, ndërkohë që për pacientët e trajtuar në mënyrë kirurgjikale ishte 5 ditë.

Konkluzione: Apendisiti akut shfaqet më shpesh në meshkuj me predominim të grupmoshës 5 deri 12 vjeç. Trajtimi i apendisitit akut është kryesisht kirurgji që kryhet pranë Kirurgjisë Infantile QSUT. Mesatarja e ditëve të qëndrimit në spital ishte 5 ditë për pacientët me apendektomi, dhe 3 ditë ata me trajtim konservativ.

Fjalë kyçe: Apendisiti akut, proces inflamator, fekalit, epidemiologjia.

SFIDAT QË LIDHEN ME TRAJTIMIN E HEPATITIT B: REZISTENCA ANTIVIRALE, EFEKTET ANËSORE, IMUNODEFICIENCA DHE QASJA NDAJ TRAJTIMIT.

Adriana Babameto[1], Erald Vasili[2], Klerida Shehu[3], Dorina Osmanaj[4]
[1]*Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Shërbimi i Gastro - Hepatologjisë*
[2]*Spitali GVM, Departamenti Imazherisë*
[3]*Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike*
[4]*Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Shërbimii i Toksikologjisë dhe Adiktologjisë I*

Abstrakt

Hepatiti B është një problem i rëndësishëm global shëndetësor, dhe ndërsa ekzistojnë trajtime efektive dhe janë zbatuar një numër politikash të shëndetit publik në shkallë të gjerë, ka disa sfida që lidhen me menaxhimin e tij. Një pjesë e konsiderueshme e personave të infektuar nuk janë identifikuar, vlerësimet aktuale sugjerojnë se vetëm 10. 5% e individëve të infektuar janë diagnostikuar dhe vetëm 5% e atyre që kanë të drejtë për trajtim për infeksionin kronik të HBV po marrin trajtim. Një rishikim i madh sistemik zbuloi se 10% e njerëzve (26 milionë) me infeksion të HBV mund të kenë nevojë për trajtim urgjent për shkak të cirrozës dhe 12% - 25% e pacientëve do të ishin gjithashtu të kualifikuar për trajtim sipas udhëzimeve të ndryshme ndërkombëtare.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) vendosi një objektiv ambicioz për të eliminuar hepatitin viral deri në vitin 2030, por mbeten sfida të rëndësishme. Këto përfshijnë: pabarazitë në aksesin në kujdesin shëndetësor, arritjen e popullatave në rrezik dhe sigurimin e aksesit në shqyrtim dhe trajtim efektiv. Stigma rreth hepatitit viral vazhdon dhe duhet të adresohet. Qëllimi i OBSH - së për eliminimin global deri në vitin 2030 është një qëllim i denjë, por mbetet ambicioz dhe pandemia e koronavirusit 2019 padyshim ka penguar progresin.

Sfidat që përfshijnë aspekte mjekësore, sociale dhe ekonomike dhe që pengojnë rezultatet optimale të trajtimit dhe përpjekjet globale për të eliminuar sëmundjen janë: diagnoza e vonuar dhe nën - diagnoza, qasja në trajtim, trajtimi dhe respektimi afatgjatë i terapisë, zhvillimi i rezistencës ndaj ilaçeve, hezitimi ndaj vaksinave, bashkë

- infeksioni me viruse të tjera, përparimi dhe monitorimi i sëmundjes së mëlçisë, stigma dhe barrierat sociale, mutacionet virale dhe dështimet e trajtimit.
Kapërcimi i sfidave që lidhen me aksesin në trajtimin e hepatitit B kërkon një qasje shumëplanëshe që adreson barrierat financiare, gjeografike, arsimore dhe kulturore.

Fjalë kyçe: Hepatiti B, rezistenca antivirale, OBSH, imunodeficenca.

OSTEOPOROZA TE PACIENTËT ME ARTRIT REUMATOID: NJË STUDIM (CROSS - SECTIONAL) PRERJE NË KOHË.

Prof. Asoc. Adriatik Gabrani[1, 2], Prof. Teuta Backa (Çiço)[1, 2], Prof. Asoc. Adrian Hoxha[2]
[1]*Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza, Shërbimi i Reumatologjisë,*
[2]*Universiteti Mjekësisë Tiranë*

Abstrakt
Hyrje: Pacientët me Artrit Reumatoid kërkojne një kujdes të veçante dhe në ndjekje dinamike të tyre pasi inflamacioni, përdorimi i IPP - ve, steroideve, inaktiviteti për shkak të dobësisë dhe pamundësisë, dieta por dhe faktorë të tjerë i predispozojne këta pacientë për të zhvilluar probleme të densitetit kockor. Përpjekjet konsistojnë në njohjen si dhe minimizimin e rrisqeve për këta pacientë
Qëllimi i studimit: Osteoporoza është vërejtur shpesh te pacientët tanë me artrit reumatoid. Ky studim u realizua me qëllim vlerësimin e faktorëve që lidhen me osteoporozën te pacientët me artrit reumatoid.
Metodologjia: Studim prerje në kohë, i kryer në shërbimin e Reumatologjise në QSUNT.
42 pacientë me artrit reumatoid (mosha mesatare 51. 2 vjeç). Dendësia minerale e kockave (DMK) dhe përbërja trupore u matën me testin DEXA. Pacientet u ndanë në tre grupe sipas DMK - së: grupi 1, DMK normale (n = 12); grupi 2, osteopeni (n = 19); dhe grupi 3, osteoporozë (n = 11). U kryen teste për të krahasuar ndryshimet në mesatare dhe korrelacionet, me përshtatje për moshën, kohëzgjatjen e sëmundjes dhe përdorimin total të kortikosteroideve. Marrëdhëniet midis faktorëve klinikë, pikëve të aktivitetit fizik, marrjes ushqimore, përbërjes trupore dhe parametrave biokimikë u analizuan duke përdorur modele të regresionit linear.
Rezultate: Densiteti kockor në matjet e kryera, ishte më i ulët në krahasim me popullatën e shëndoshë apo me sëmundshmëri të tjera jo reumatizmale. U gjetën lidhje midis DMK - së dhe moshës, kohëzgjatjes së sëmundjes, përqendrimit të hormonit paratiroid dhe marrjes së yndyrnave. Modeli i regresionit linear tregoi se të qenit më e vjetër, me më shumë vite sëmundje dhe me peshë më të ulët lidhej në mënyrë negative me DMK - në [Total femur = 0. 552 + 0. 06 (peshë) + 0. 019 (aktivitet fizik total) – 0. 05 (moshë) – 0. 003 (kohëzgjatje e sëmundjes); R^2 = 48. 1; P < 0. 001].
Konkluzione: Ky studim tregon se densiteti i masës kockore te pacientët me artrit reumatoid ndikohet nga medikamentet, faktorët ushqimorë, gjinia, mosha dhe kohëzgjatja e sëmundjes.
Rekomandime: Ndjekja e kujdesshme në dinamikë si nga ana ekzaminimeve me testin DEXA, por dhe terapive mbështetëse per mineralizimin e kockave, ne pacientet që janë diagnostikuar me Artrit Reumatoid, është thelbësor për të garantuar një qasje pozitive të mbrojtjes së këtyre pacientëve, të cilët janë më të riskuar.

Fjalë kyçe: Osteoporoza, Artrit Reumatoid, inflamacion, testi DEXA.

MENAXHIMI I KËNAQËSISË NË PUNË I BURIMEVE NJERËZORE NË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE JO - PUBLIKE NË TIRANË.

Prof. Asoc. Adriatik Gabrani[1, 2], Prof. Asoc. Adrian Hoxha[2], Prof. Asoc. Valbona Duraj[1, 2], Dr. Arjola Gabrani[3]
[1]*Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza*
[2]*Universiteti i Mjekësisë Tiranë*

Abstrakt
Hyrje: Kënaqësia në ambientin e punës dhe proceset e saj sikurse dhe politikat e duhura të pagës dhe shpërblimeve të veçuara ose të ndërthurura, janë dy faktorë shumë të rëndësishëm për motivimin dhe rritjen e performancës së stafeve mjekësore.

Qëllimi i studimit: Shqyrtimi i marrëdhënieve komplekse midis motivimit të brendshëm dhe të jashtëm, kënaqësisë nga paga dhe kënaqësisë nga puna të mjekeve te rinj në institucione shëndetësore private që përdorin një plan pagese bazuar mbi performancën.
Metodologjia: Ky dokument bazohet në një studim të rastit ne dy institucione shëndetësore, duke përdorur një pyetësor, pyetje të hapura dhe ndërveprim me punonjësit dhe menaxherët.
Rezultate: Të anketuarit ishin ne raport gjinie 58% femra dhe 42% meshkuj. Rezultatet ofrojnë mbështetje për natyrën plotësuese të motivimit të brendshëm dhe të jashtëm respektivisht 76% dhe 88%, me një ndryshim në vlerësim ndërmjet dy gjinive. Motivimi i brendshëm ishte pozitivisht i lidhur me kënaqësinë nga paga dhe i jashtëm me kënaqësinë nga puna. Të dhënat cilësore tregojnë se sasia e shpërblimeve është e rëndësishme, dhe ata që perceptonin se paga nuk ishte e drejtë zakonisht bënin krahasime me të tjerë ose ndiheshin se paga nuk reflektonte përpjekjet e tyre. Gjithashtu, u gjet se shumica e punonjësve perceptonin që objektivat ishin të qarta.
Kufizimet / implikimet e kërkimit: Dominimi i motivimit të jashtëm pa përfshirjen e faktorëve të sjelljes, socialë dhe psikologjikë vihet në dyshim. Kërkimi nuk gjeti mbështetje për "zvogëlimin e motivimit të brendshëm", por gjeti disa prova për "përforcimin e motivimit të brendshëm", ku motivimi i brendshëm përmirësohet, duke dëmtuar motivimin e jashtëm.
Konkluzione: Gjetjet theksojnë se menaxherët duhet të përmirësojnë si motivimin e brendshëm ashtu dhe të jashtëm, dhe politika pagash dhe kompensimi për doktorët e rinj për të rritur kënaqësinë nga puna. Perceptimet për vlerën e pagesës mund të ndryshojnë në varësi të niveleve të motivimit, moshës dhe gjinisë.
Rekomandime: Studime te mëtejshme duhet të shqyrtojnë problematikat qe lidhen me kënaqësinë dhe motivimin e doktorëve te rinj.

Fjalë kyçe: Kënaqësia në ambientin e punës, motivim i brendëshem, studim, stafe mjekësore.

KONVULSIONET TEK FËMIJËT.

Afërdita Tako, Aida Bushati, Armand Shehu, Xheni Doka, Sindi Dizdari, Rovena Aliaj

Abstrakt
Konvulsionet janë shkarkesa elektrike jonormale, të përsëritura, të njëkohshme nga një grup neuronesh kortikale. Epilepsia është dy ose më shumë kriza konvulsive të pa provokuara. Konvulsionet klasifikohen sipas etiologjisë ILAE 2017: strukturore, infeksioze, gjenetike, metabolike, imune dhe të panjohura; sipas tipologjisë së krizave: fokale, të gjeneralizuara, fokale sekondarisht të gjeneralizuara dhe epilepsi sindromike.
Rezultate: Ndryshime të përsëritura sensore, motore, autonome dhe të sjelljes.
Paraqitja klinike varet nga lokalizimi dhe përhapja e pjesës së korteksit të përfshirë.
Diagnoza: EEG, MRI, CT, hemogramë, analiza imune, analiza gjenetike.
Diagnoza diferenciale bëhet me shfaqjet anoksike ishemike, migrena, çrregullimet e gjumit, çrregullimet e lëvizjeve, çrregullimet psikologjike.
Trajtimi: Antiepileptikë (AED) në varësi të tipologjisë së konvulsioneve.

Fjalë kyçe: Konvulsione, fëmijë, EEG, MRI, AED.

SHIGA - LIKE TOXIN: MEKANIZMAT PATOGJENETIKË DHE RËNDËSIA E IDENTIFIKIMIT LABORATORIK.

Dr. Afërdita Kuqi - Hyseni[1], Mrs. Ardita Beqiraj[2]
[1]Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës - Departamenti i Mikrobiologjisë, Prishtinë, Kosovë,
[2]Spitali i përgjithshëm i Pejës.

Abstrakt
Hyrje: Escherichia coli prodhuese e Shiga - like toxin (STEC) është një patogjen i rëndësishëm enterik, që shkakton diarre hemorragjike dhe komplikime serioze si sindroma hemolitike - uremike (SHU). Diagnostikimi i hershëm laboratorik është thelbësor për parandalimin e komplikimeve dhe menaxhimin e rasteve klinike.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të theksohet rëndësia e identifikimit laboratorik të Escherichia coli prodhuese të Shiga - like toxin (STEC), si dhe të paraqiten implikimet klinike dhe komplikimet e mundshme, me fokus të veçantë në rolin e diagnostikimit të hershëm për parandalimin e sindromës hemolitike - uremike.
Materiale dhe metoda: Hulumtim i realizuar në periudhën maj–shtator 2025, 71 mostra të punuara në Laboratorin e Mikrobiologjisë në IKSHPK. Mostrat janë testuar me metodën multiplex PCR - Biofire dhe janë krahasuar me metoda konvencionale. Llojet e mostrave të testuara janë: feçe, strisho anorektale, sjellë nga Klinika e Pediatrisë në Kosovë.
Rezultate: Panel gastrointestinal – gjithsej 71 mostra, prej tyre 35. 2% kanë rezultuar negative, 64. 8% pozitive. Patogjenët e detektuar janë: ETEC 4. 2%, EPEC 14. 1%, EAEC 9. 9%, Cryptosporidium 8. 5%, Norovirus 18. 3%, Rotavirus 9. 9%, Sapovirus 7. 0%, Astrovirus 5. 6%, Clostridium difficile toxin A+B 12. 7%, Salmonella 7. 0%, Campylobacter 2. 8% dhe Shiga - like **toxin - producing E. coli (STEC) stx1 / stx2 – 11. 3%.**
Konkluzione: Infeksionet e shkaktuara nga Escherichia coli prodhuese e Shiga - like toxin përbëjnë një sfidë të rëndësishme klinike dhe mikrobiologjike. Diagnostikimi i hershëm laboratorik nga mostrat e feçeve mbetet metoda më e besueshme për identifikimin e patogjenit dhe për parandalimin e komplikimeve të rënda, si sindroma hemolitike - uremike. Ndërthurja e teknikave tradicionale dhe atyre molekulare ofron një qasje më të saktë në diagnostikim, ndërsa bashkëpunimi mes laboratorit dhe klinicistëve është thelbësor për menaxhimin efektiv të rasteve dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

Fjalë kyçe: Shiga - like toxin (Stx), Escherichia coli prodhuese e toksinës Shiga (STEC), diarre hemorragjike, sindroma hemolitike - uremike (SHU).

MENAXHIMI I DHIMBJES TE PACIENTËT ME TRAUMA NË KUJDESIN PARASPITALOR: SFIDAT DHE STRATEGJITË.

Afrodita Sejda

Abstrakt
Hyrje: Dhimbja është një nga simptomat më të zakonshme dhe më shqetësuese tek pacientët me trauma. Në kujdesin paraspitalor, menaxhimi efektiv i dhimbjes jo vetëm që përmirëson komoditetin e pacientit, por gjithashtu redukton stresin fiziologjik dhe ndërlikimet sekondare. Megjithë rëndësinë e saj, dhimbja shpesh nënvlerësohet dhe trajtohet në mënyrë jo të mjaftueshme në terren.
Objektivi: Të shqyrtohen qasjet aktuale, sfidat dhe mundësitë në menaxhimin e dhimbjes akute tek pacientët me trauma në kujdesin emergjent paraspitalor.
Materiale dhe metoda: U krye një rishikim narrativ i literaturës dhe praktikës klinike, me fokus tek ndërhyrjet farmakologjike dhe jo - farmakologjike, barrierat për një analgjezi adekuate dhe roli i vlerësimit të strukturuar të dhimbjes.
Rezultate: Evidencat tregojnë se opioidët, ketamina dhe oksidi i azotit janë opsione efektive farmakologjike, ndërsa imobilizimi, vendosja e shinatave dhe mbështetja psikologjike ofrojnë lehtësim jo - farmakologjik. Barrierat kryesore përfshijnë presionin kohor, frikën nga efektet anësore dhe mungesën e trajnimit ose resurseve.

Fjalë kyçe: Menaxhim i dhimbjes, trauma paraspitalore, pacientë.

FARMAKOGENETIKA DHE MJEKËSIA E PERSONALIZUAR: NGA QASJA "NJË MASË PËR TË GJITHË" TEK KUJDESI SHËNDETËSOR I INTEGRUAR.

Dr. Agim Koçiraj, Prof Asc. Kleva Shpati
Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University

Abstrakt
Hyrje: Mjekësia tradicionale e modelit "një masë për të gjithë", ndonëse historikisht efektive në krijimin e trajtimeve të standardizuara, po bëhet gjithnjë e më e pamjaftueshme për të adresuar kompleksitetin dhe ndryshueshmërinë e nevojave moderne shëndetësore. Rritja e barrës së sëmundjeve kronike dhe përparimet e shpejta në gjenomikë, shëndetësinë digjitale dhe kujdesin e përqendruar te pacienti, kanë nxitur kalimin drejt qasjeve më të personalizuara dhe të integruara.

Qëllimi dhe objektiva: Qëllimi i këtij shqyrtimi është të eksplorojë tranzicionin nga mjekësia e standardizuar drejt kujdesit shëndetësor të personalizuar dhe të integruar. Objektivat specifike përfshijnë shqyrtimin e evolucionit konceptual të mjekësisë së personalizuar, vlerësimin e përparimeve në gjenomikë dhe shëndetësi digjitale, analizimin e modeleve të kujdesit të integruar dhe identifikimin e pengesave dhe implikimeve politike për zbatimin.
Materiale dhe metoda: U krye një shqyrtim narrativ duke përdorur literaturë të rishikuar nga kolegët, kuadro ndërkombëtare dhe dokumente politike të publikuara midis viteve 2000 dhe 2025. Burimet përfshinë baza të dhënash si PubMed, Scopus dhe Web of Science, si dhe raporte nga OBSH, OECD dhe Komisioni Evropian.
Rezultate: Gjetjet tregojnë se gjenomika dhe farmakogjenetika po transformojnë diagnostikën dhe terapinë, ndërsa shëndetësia digjitale dhe inteligjenca artificiale po mundësojnë analiza parashikuese dhe telemjekësi. Modelet e kujdesit të integruar, të mbështetura në kujdesin parësor shëndetësor, bashkëpunimin multidisiplinar dhe platformat digjitale të ndërveprueshme, po pilotohen globalisht, duke treguar përmirësime në efikasitet dhe rezultatet e pacientëve. Megjithatë, pengesa të rëndësishme mbeten, përfshirë numrin e kufizuar të biomarkerëve, kostot e larta, mungesën e përgatitjes së fuqisë punëtore dhe sfidat etike të lidhura me qeverisjen e të dhënave dhe barazinë.
Përfundime: Konvergjenca e kujdesit shëndetësor të personalizuar dhe të integruar përfaqëson një mundësi transformuese për sistemet moderne shëndetësore. Suksesi varet nga integrimi i qasjeve të personalizuara brenda nivelit të sistemit për të siguruar barazi, qëndrueshmëri dhe përqendrim te pacienti.
Rekomandime: Vendimmarrësit politikë duhet të prioritarizojnë modelet e financimit që mbështesin aksesin universal, të investojnë në zhvillimin e kapaciteteve të fuqisë punëtore dhe të forcojnë infrastrukturën digjitale. Kornizat e bazuara në barazi duhet të garantojnë që përfitimet e personalizimit të mos kufizohen vetëm në kontekste me të ardhura të larta. Kërkimet e ardhshme duhet të përqendrohen në shkencën e zbatimit dhe bashkëpunimin ndërkufitar për të përshpejtuar adoptimin.

Fjalë kyçe: mjekësi e personalizuar; kujdes i integruar; sisteme shëndetësore; gjenomikë; shëndetësi digjitale.

TIROIDITI HASHIMOTO (TIROIDITI LIMFOCITIK KRONIK).

Agnesa Behrami

Abstrakt
Hyrje: Tiroiditi Hashimoto është shkaku më i shpeshtë i hipotiroidizmit primar dhe përfaqëson një çrregullim autoimun kronik të gjëndrës tiroide. Ai karakterizohet nga infiltrimi limfocitar i parenkimës tiroide dhe prodhimi i autoantitrupave ndaj peroksidazës tiroide (anti - TPO) dhe tiroglobulinës (anti - Tg), të cilët shkaktojnë shkatërrim progresiv të gjëndrës. Patogjeneza është multifaktoriale, duke përfshirë predispozitën gjenetike (p. sh. , HLA - DR3, HLA - DR5) si dhe faktorë mjedisorë si teprica e jodit, infeksionet virale dhe stresi. Diagnostikimi bazohet në kombinimin e kritereve klinike, biokimike dhe imazherike. Analizat laboratorike zakonisht tregojnë rritje të TSH dhe ulje të FT4 në hipotiroidizmin manifest, ndërsa anti - TPO është markuesi më i ndjeshëm dhe specific. Ekografia tiroide shpesh paraqet gjëndër hipoekoike, heterogjene dhe me inflamacion difuz, duke ndihmuar në diferencimin nga patologjitë strukturore të tjera. Bashkëshoqërimi i hipotiroidizmit biokimik me autoantitrupat pozitivë përbën kriterin më të saktë diagnostik. Trajtimi është zëvendësues dhe konsiston në përdorimin e levotiroksinës natriumi (T4 sintetik), e cila normalizon funksionin tiroide dhe balancën metabolike. Doza përcaktohet individualisht sipas nivelit të TSH dhe profilit klinik, ndërsa monitorimi periodik është i domosdoshëm për të ruajtur eutiroidizmin. Evidencat e fundit sugjerojnë se suplementimi me selen dhe vitaminë D mund të reduktojë titrat e autoantitrupave, megjithëse rezultatet mbeten të paqarta.
Konkluzione: Tiroiditi Hashimoto është një sëmundje autoimune komplekse që kërkon një qasje të integruar diagnostikuese. Terapia zëvendësuese me levotiroksinë mbetet standardi i artë i trajtimit, ndërsa ndërhyrjet imunomoduluese vazhdojnë të jenë objekt studimi.

Fjalë kyçe: Tiroiditi Hashimoto, hipotiroidizmit primar, çrregullim autoimun kronik, sëmundje autoimune, HLA - DR3, HLA - DR5.

KOMPLIKIMET POSTOPERATIVE PAS HISTEREKTOMISË.

Dr. Agnesa Zekaj

Abstrakt

Hyrje: Histerektomia është një procedurë kirurgjikale që përfshin heqjen e mitrës. Indikacionet për histerektomi përfshijnë komplikacionet serioze gjatë lindjes, hemorragjitë e pakontrollueshme, prolapsin e mitrës, endometriozën, kancerin invaziv të mitrës, qafës së mitrës, tubave të Fallopit ose vezoreve. Komplikimet më të zakonshme të histerektomisë përfshijnë infeksione, tromboemboli venoze, probleme genitourinare, dëmtime të traktit gastrointestinal, dëmtime nervore dhe dehiscencë vaginale.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është rishikimi i literaturës dhe publikimeve të fundit shkencore në lëminë e gjinekologjisë, obstetrikes, onkologjise dhe kirurgjisë për të kuptuar incidencën, indikacionet, kundërindikacionet dhe komplikimet postoperative pas histerektomisë.

Metodologjia: Ky punim hyn në radhën e grupit të hulumtimeve: Rishikim literature. Të dhënat e mbledhura dhe të përdorura në këtë punim i takojnë literaturës akademike, publikimeve dhe rishikimeve të gjetura në databazat e: Google Scholar, PubMed, Research Gate, Amboss, etj.

Rezultate dhe diskutime: Nga publikimet e rishikuara është vërejtur që Histerektomia është procedura gjinekologjike më e zakonshme. Komplikimet më të zakonshme të histerektomisë mund të kategorizohen në disa lloje, tromboemboli venoze, dëmtime të traktit genitourinar (GU) dhe gastrointestinal (GI), gjakderdhje, dëmtime nervore dhe vaginal cuff dehiscence. Komplikimet infektive janë më të shpeshtat, duke ndodhur në 10. 5% të histerektomive abdominale, 13. 0% të histerektomive vaginale dhe 9. 0% të histerektomive laparaskopike. Tromboembolia venoze, edhe pse më pak e zakonshme, ka një shkallë diagnostikimi klinik rreth 1%, por mund të zbulohet në një normë deri në 12% duke përdorur metoda laboratorike më të ndjeshme. Dëmtimi i traktit GU infektive ndodh në rreth 1–2% të të gjitha operacioneve gjinekologjike të mëdha, me 75% të këtyre dëmtimeve që ndodhin gjatë histerektomisë. Dëmtimet e traktit GI janë më të rralla, me një frekuencë që varion nga 0. 1–1%. Komplikimet nga gjakderdhja janë gjithashtu të rralla, me humbje të vlerësuar të gjakut që varion mesatarisht nga 238–660. 5 mL për histerektominë abdominale, 156–568 mL për histerektominë laparaskopike dhe 215–287 mL për histerektominë vaginale.

Fjalë kyçe: Histerektomia, komplikimet postoperative, gjakderdhja, kanceri.

RIKUPERIMI I AFTËSIVE GJUHËSORE DHE MOTORIKE TEK INDIVID ADULT PAS INSULTIT CEREBRAL.

Msc. Aida Ajdini

Logopede – OJQ "Handimak" – Tetovë, Maqedonia e Veriut

Edukatore speciale, koordinatore për asistencë personale, themeluese dhe trajner në Olimpiadën Speciale - Tetovë

Abstrakt

Insulti cerebral (i njohur edhe si goditje në tru apo stroke) është një gjendje urgjente mjekësore që ndodh kur furnizimi me gjak në një pjesë të trurit ndërpritet ose zvogëlohet ndjeshëm. Pa furnizim të mjaftueshëm me oksigjen dhe lëndë ushqyese, qelizat nervore në atë pjesë të trurit fillojnë të vdesin brenda pak minutash. Është një çrregullim motorik i të folurit, që ndodh kur truri ka vështirësi të planifikojë dhe programojë lëvizjet e sakta të muskujve për të prodhuar tingujt, rrokjet dhe fjalët. Muskujt vetë janë të shëndetshëm (nuk ka paralizë si te disartria), por "komanda" nga truri nuk është e saktë.

Qëllimi: Ndikimi i ushtrimeve – trajtimit logopedik në përmirësimin e të folurit gjegjësisht të artikulimit të saktë të fjalëve, renditjes së fjalëve në fjali, leximit dhe shënimit të saktë, përmirësimi i memorizimit, përmirësimi apo rikthimi i koordinimit muskulor oral dhe koordinimit dorë – sy.

Metoda: Metoda e përdorur është metoda analitike (e analizës) së vlersimeve të mëparëshme dhe vlerësimeve aktuale të rastit, dhe metoda komparative (e krahasimit) të aftësive të poseduara para insultit cerebral dhe atyre të fituara (aktualisht) pas insultit cerebral.

Konkluzione: Dëmtimi i sistemit nervor bën që muskujt që prodhojnë të folurin të paralizohen ose dobësohen dhe meqë dëmtimi mund ta bëjë të vështirë kontrollin e gjuhës. Rekomandohet terapia e të folurit nga patolog të të folurit që të mund t'ju ndihmojë të komunikoni në mënyrë më efektive. Ku përmes: ushtrimeve për të forcuar muskujt oral dhe nofullës, nxitjes për të shprehur zë, tingull apo fjalë, korrigjimin e formimit të tingujve

të caktuar për të folur më qartë, aftësi për të mbajtur në mend dhe përgjigjur pyetjeve, bisedave (përpunimin dhe shprehjen) e informacioneve, ushtrimet respiratore (frymëmarrjes), ushtrimeve dhe masazhës rehabilitatuese për motoriken globale: të mbajturit, të kapurit e objekteve të imta dhe e objekteve pak më të rënda, koordinimi në kohë dhe hapësirë, motorikën fine (të imët) mbajtja e lapsit, zhvendosja e objekteve të ndryshme, kapja – mbajtja – radhitja sipas rendit të caktuar të objekteve të imta. Janë arritur dhe përvetësuar aftësitë, shprehitë e rutinës, të shprehurit, shkrimi, kuptimi, koordinimi në kohë dhe hapësirë rikthimi i memorizimit të kujtimeve të mëparëshme dhe momenteve të reja që krijohen, memorizimi dhe të shprehurit i gjësendeve që aktualisht në të tashmen ndodhin.

Fjalë kyç: çrregullim gjuhësor, apraxia e të folurit (apraxia verbale), insultus cerebri, rehabilitim, muskujt oral, respiracion.

MENAXHIMI I EPILEPSISË TE GRATË NË GRAVIDANCE: PASOJAT PËR GRAVIDANCEN DHE USHQYERJEN ME GJI.

QUKA[1, 2], I. Zekja [1, 2], S. Grabova [1, 2], J. Kruja[1, 2]
[1]*Departamenti i Neuroshkencave, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë*
[2]*Shërbimi i Neurologjisë, QSUNT.*

Abstrakt
Hyrje: Epilepsia është një çrregullim neurologjik i zakonshëm që prek gratë në moshën e lindjes. Ndërveprimi midis epilepsisë, shtatzënisë dhe ushqyerjes me gji paraqet sfida unike që kërkojnë menaxhim të kujdesshëm për të siguruar shëndetin e nënës dhe fëmijës.
Objektiva: Të eksplorojmë efektet e epilepsisë në gravidancë, ndikimin e ilaçeve antiepileptike (AED) në zhvillimin e fetusit, opsionet më të fundit të trajtimit dhe konsideratat për ushqyerjen me gji te gratë me epilepsi.
Metoda: U krye një rishikim i gjithanshëm i literaturës aktuale, duke u fokusuar në studime që adresojnë: Rreziqet për nënën dhe fetusit që lidhen me epilepsinë dhe AED gjatë shtatzënisë.
Udhëzimet për menaxhimin e epilepsisë te gratë shtatzëna dhe ato që ushqejnë me gji. Efektet e ushqyerjes me gji në kontrollin e krizave te nëna dhe shëndetin e foshnjës. Avancimet e fundit në opsionet e trajtimit për menaxhimin e epilepsisë në këtë popullatë.
Rezultate: Në gravidance femrat me epilepsi kanë një rrezik më të lartë të komplikacioneve si lindja e parakohshme, pesha e ulët e lindjes dhe vonesat në zhvillim te fëmijët. Efektet teratogjene të disa AED, veçanërisht gjatë tremujorit të parë, janë të rëndësishme. Përdorimi i monoterapisë dhe zgjedhja e AED - ve më të sigurta janë thelbësore për minimizimin e rreziqeve. Opsionet më të fundit të trajtimit përfshijnë AED të rinj si Lamotrigina dhe Levetiracetami, të cilat kanë një profil më të favorshëm të sigurisë gjatë shtatzënisë. Ushqyerja me gji inkurajohet përgjithësisht, pasi shumica e AED - ve janë të përputhshme me ushqyerjen me gji. Kontrolli i krizave te nëna duhet të jetë prioritet, por terapite duhet te individualizohen rast pas rasti.
Konkluzione: Menaxhimi efektiv i epilepsisë te gratë në periudhën e gravidances dhe periudhen puerperale kërkon një perqasje të balancuar duke marre parasysh rreziqet dhe përfitimet e trajtimit gjatë shtatzënisë dhe ushqyerjes me gji. Rekomandohet monitorimi i rregullt dhe kujdesi multidisiplinar që përfshin obstetër, neurologë dhe pediatër. Edukimi i nënave është shumë i nevojshëm për të siguruar një kompliancë të mirë me mjekimin.

Fjalë kyçe: epilepsi gjatë shtatzënisë, ilaçe antiepileptike (AED), teratogjeneza, ushqyerja me gji, menaxhim multidisiplinar, kontrolli i krizave.

TENDENCAT E KANCERIT NË SHQIPËRI DHE RËNDËSIA E REDUKTIMIT TË RISKUT NGA FAKTORËT MJEDISOR.

Alba Agaraj[1], Adrian Hoxha[2], Bukurie Hyseni[3]
[1]*Specialiste në Shëndet Publik pranë Regjistrave Spitalor, QSUNT, Tirane*
[2]*Profesor pranë Universitetit të Mjekësisë, Tiranë*
[3]*Specialiste në Shëndet Publik pranë DQOSHKSH, Tiranë*

Abstrakt
Studimet e ndryshme kanë konfirmuar se vdekshmëria nga tumoret është gjeografikisht e shoqëruar me ndotjen e ambjentit, pavarsisht nga stili i jetës së shëndëtshme të individit. Individët me predispozita të ndryshme gjenetike, që banojnë në zona të ndryshme, kanë probabilitet të ndryshëm për tu prekur nga kanceri. Ka një lidhje të ngushtë midis ndotjes ambientale, stilit të jetesës dhe shumë lloje tumoresh.
Rritja e vazhdueshme urbanistike, rritja e industrializimit, rritja e nevojës së përdorimit të mjeteve të trasportit, betonizimi në masë i zonave të gjelbërta, është duke modifikuar jetën tonë nëpërmjet ndryshimit të ambientit. Këto modifikime ndikojnë në të gjitha format e jetës, përfshirë edhe njeriun. Përllogariten çdo vit në botë, mbi 20 milion raste të reja tumoresh me rreth 13 milion raste vdekjesh që i atribuohen ambjenteve jo të shëndëtshme. Sipas të dhënave të OMS, kemi rreth 4, 2 milion raste vdekjesh të lidhura drejtepërdrejtë me ndotjen atmosferike. Trendi i rritjes së rasteve me kancer në fëmijë, që në vitin e parë të lindjes, si dhe në mosha gjithnjë e më të reja përbën një sinjal alarmi të rëndësishëm. Në botë, sot, më shumë se 400. 000 fëmijë nën moshën 20 vjeç diagnostikohen me kancer. Dy janë shkaqet e mundshme: ekspozimi direkt i embrionit / fetus ndaj faktorëve të jashtëm kancerogen fizik, biologjik e kimik nëpërmjet rrugës trans - placentare si dhe mundësia transmetimit nga prindi mbartës, që trasmeton të gjitha ndryshimet epigjenetike te fëmija. Në fakt, sot, secili prej nesh, mund të zgjedhë të parandaloj afërsisht 40% të tumoreve nëpërmjët vaksinimeve dhe terapive me antibiotik dhe jo vetëm. Por të gjitha strategjitë për luftën kundër kancerit të fokusuara në zgjedhjet personale për ndryshimin e stilit të jetesës dhe diagnostifikimi i hershëm, nuk duken të mjaftueshme për të ndryshuar këtë pandemi tumorale. Faktorë ambeintal onkogjen si edhe shumë substanca kimike që gjenden në mjedis, kanë efekt kancerogjenë dhe ndikojnë në shfaqjen e tumoreve. Këto faktore përfshijnë ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës, ekspozimin ndaj rrezeve ultraviolet dhe ndotjen elektromagnetike. Ambienti në të cilin jetojmë ndikon dukshëm në probabilitetin për tu sëmurur. E rëndësishme është të intensifikohet fokusi në parandalimin e kancerit nëpërmjet uljes së ekspozimit ndaj faktorëve të rrezikut mjedisor. Rritja e ndërgjegjësimit publik dhe përmiresimi i politikave mjedisore janë hapesira ku duhet punuar seriozisht për të ulur barrën e kancerit.

Fjalë kyçe: faktorët mjedisor, risku, pandemi e tumoreve malinje, ndotje ambientale, barra e kancerit, parandalim, ndërgjegjësim.

BLLOKU I DEGËS SË MAJTË SI FAKTOR RREZIKU PËR INSUFIÇIENCËN KARDIAKE.

Albana Banushi[1, 2], Vilma Paparisto[1], Ilva Miza[1]
[1]*Shërbimi Kardiologji, QSUT "Nënë Tereza"*
[2]*UM, Tiranë*

Abstrakt
Prevalenca e bllokut të degës së majtë (BDM) në popullatën e përgjithshme është 0. 06 - 0. 1%. BDM është më i shpeshtë në pacientët me insufiçencë kardiake (IK) dhe shoqërohet me mortalitet dhe morbiditet më të madh. Prevalenca rritet nga <1% në moshën nën 50 vjeç në 6% në moshën deri 80 vjeç. Ka nje relacion kompleks midis BDM dhe IK; pacientët me kardiomiopati joishemike (KMPjI) kanë prevalencë të lartë të BDM që shkon rreth 31%, ndërsa 21% e pacientëve me BDM kanë KMPjI. Shoqata Europiane e Kardiologjise (ESC) në vitin 2021 rishikoi kriteret e BDM.
Udhërrëfyesit aktualë rekomandojnë terapinë e resinkronizimit (CRT) pas tre muajve nën terapi optimale medikamentoze për pacientët me BDM dhe funksion sistolik të ulur (FE <35%). Nisur nga të dhënat e studimeve të randomizuara këta pacientë përfitojnë maksimalisht krahasuar me pacientët që nuk kanë të pranishëm BDM. Pyetja shtrohet nëse BDM i pranishëm në individët asimptomatikë me strukturë zemre normale shoqërohet me rrezik të lartë për IK, rënie të funksionit të VM apo vdekje? Studime të ndryshme tregojne një lidhje të BDM në pacientët pa IK me rrezikun e zhvillimit të mëvonshëm të IK dhe vdekjes në këta pacientë për shkaqe kardiovaskulare. Megjithatë mbetet jo e qartë nëse BDM reflekton progresionin e një patologjie të

padiagnostikuar apo është në vetvete një faktor rreziku. Meqenëse nuk ka rekomandime aktuale për testime të mëtejshme ose trajtim të pacientëve me BDM asimptomatik, përmirësimi i të kuptuarit tonë të këtyre shoqërimeve mund të ndihmojë në identifikimin e individëve me rrezik të lartë për IK dhe përcaktimit të strategjive për ndërhyrje efektive.

Fjalë kyçe: blloku i degës së majtë, faktor rreziku, insufiçiencën kardiake, kardiomiopati joishemike.

AGJENTËT UTEROTONIKË NË LINDJEN ME OPERACION ÇEZARIAN: PËRDORIMI KLINIK, KONSIDERATAT ANESTETIKE DHE TERAPITË NË ZHVILLIM.

Albana Cane
Departamenti i Anesteziologjisë dhe Kujdesit Intensiv, Spitali Hygeia, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Sfondi: Hemorragjia postpartum vazhdon të jetë një ndër shkaqet kryesore të morbiditetit dhe mortalitetit matern në nivel global, veçanërisht pas lindjes me operacion çezarian. Agjentët uterotonikë janë thelbësorë për parandalimin e hemorragjisë së tepërt, duke nxitur kontraksione efektive të mitrës. Oksitocina është agjenti i zgjedhur si trajtim fillestar; megjithatë, në varësi të kontekstit klinik dhe disponueshmërisë së burimeve, përdoren edhe alternativa të tjera.
Qëllimi: Ky rishikim synon të përmbledhë të dhënat mbi farmakologjinë, përdorimin klinik dhe konsideratat anestetike të agjentëve uterotonikë më të përdorur gjatë lindjes me prerje çezariane, duke përfshirë edhe një përmbledhje të shkurtër mbi substanca të reja që janë ende në faza kërkimore.
Metodologjia: U krye një rishikim mbi udhëzimet bashkëkohore dhe literaturën e fundit shkencore, me fokus te oksitocina, karbetocina, metilergometrina, misoprostoli dhe agjentë uterotonikë të rinj në zhvillim. U analizuan aspektet e efikasitetit, dozimit, efekteve anësore, kundërindikacioneve dhe përdorimit praktik në praktikën klinike.
Rezultate: Oksitocina mbetet baza e trajtimit uterotonik, por administrimi i saj i shpejtë intravenoz mund të shkaktojë hipotension dhe takikardi, veçanërisht në prani të anestezisë regjionale. Karbetocina siguron kontraktilitet të qëndrueshëm të mitrës me më pak efekte kardiovaskulare. Metilergometrina është një uterotonik potent, por është e kundërindikuar te pacientet me hipertension ose patologji kardiovaskulare për shkak të efekteve të saj vazokonstriktore. Misoprostoli, për shkak të stabilitetit në temperatura të larta dhe mundësisë së administrimit jo invaziv, është veçanërisht i përshtatshëm në mjedise me burime të kufizuara, megjithëse efektet anësore si hipertermia dhe shqetësimet gastrointestinale janë të zakonshme.
Agjentët e rinj, si karbetocina termostabile dhe oksitocina në formë inhalatore, po tregojnë potencial për përmirësimin e aksesit dhe përdorimit të uterotonikëve, veçanërisht në vendet ku zinxhiri i ftohtë apo aplikimi i preparateve intravenoze është i kufizuar. Megjithatë, këto produkte ende nuk janë të miratuara gjerësisht në vendet me të ardhura të larta.
Përfundime: Menaxhimi i suksesshëm i hemorragjisë postpartum gjatë lindjes çezariane kërkon përzgjedhje të kujdesshme të agjentëve uterotonikë, në bazë të karakteristikave të pacientes dhe burimeve në dispozicion. Edhe pse oksitocina mbetet zgjedhja standarde, opsionet alternative ofrojnë avantazhe në situata të caktuara. Agjentët në zhvillim mund të zgjerojnë mundësitë terapeutike në të ardhmen, por nevojiten më shumë studime dhe miratime rregullatore.
Anestezistët dhe ekipet obstetrikale duhet të jenë të përditësuar mbi këto zhvillime për të përmirësuar rezultatet obstetrikale.

Fjalë kyçe: Agjentë uterotonikë, oksitocinë, karbetocinë, metilergometrinë, misoprostol, lindje çezariane, hemorragji postpartum, anestezi.

GJETJE PËR TUBERKULOZIN (TB) NË TË SËMURËT ME KANCER POSTCOVID 19.

Prof. Asoc. Albana Fico[1], Dr. Shk. Rovena Daja[2], Msc. Mirela Rexhepi[3], Dr. Gerta Elezaj[1]
[1]*Fakulteti i Mjekësisë, UMT*
[2]*Instituti i Shëndetit Publik (ISHP)*
[3]*QSUT "Nënë Tereza"*

Abstrakt
Historikisht TB mbetet vrasësi më i madh i njerëzimit dhe sëmundja infektive më ngjitëse, njëherazi dhe një nga shkaqet më të shpeshta të vdekjes në tërësi. Ndërkohë TB në vitet e fundit (dekadën e fundit), ka rregjistruar një ulje me 1 / 3 të rasteve të reja në botë, megjithatë pesha globale e kësaj sëmundjeje është më shumë se 10 milion raste të reja në vit.
Krahasuar me 2019, gjetja e rasteve të reja në 2020 globalisht është reduktuar me 18%.
Bashkëjetesa e sëmundjes tumorale me TB gjendet rallë. Pacientët me kancer përbëjnë një subgrup shumë vulnerabël edhe përgjatë pandemisë COVID 19. Vonesa në trajtim me protokollet antitumorale, për arësye të krizës së COVID 19, prodhon shanse të shtuara për t'u infektuar nga shkaktari i TB dhe për të zhvilluar sëmundjen respektive. Studimi më domethënës është ai që konsideroi lidhjen ose bashkëegzistencën (profil klinikopatologjik) e TB dhe carcinomës tek pacientët gjatë pandemisë COVID 19. Bashkëgjentja e TB me karcinomën është përshkruar fillimisht 200 vjet më parë nga Bayle, që konsideroi "cavitation cancereuse" si një variant të TB. Kjo bashkëegzistencë mes TB dhe karcinomës është vërejtur në organe (kryesisht mushkëritë) dhe më pas lëkurë dhe larings. Më rallë janë identifikuar në kolon, stomak, në limfonodujt peripankreatike, gji dhe në mukozën bukale.
Rasti i Indisë si vendi i dytë me popullatën më të madhe në botë dhe me përhapje endemike të TB, ka një rrezik të shtuar për format latent dhe active të TB. Nga ana tjetër situata e një imuniteti të kompromentuar prodhon "flare up" të TB. Është vënë re që ka një rritje të papritur të rasteve me koegzistencë të TB dhe karcinomës.
Eksperienca e kësaj pandemie tregoi mangësitë e sistemeve shëndetësore, por nga ana tjetër shërbeu për të nxjerrë mësime për të përmirësuar edhe trajtimin e sëmundjes tumorale.

Fjalë kyce: Sëmundja tumorale, tuberkulozi, COVID 19, pandemi.

STUDIM RETROSPEKTIV MBI KANCERIN PULMONAR - FAKTORËT KLINIKË, HISTOPATOLOGJIA DHE MENAXHIMI TERAPEUTIK.

Kristi Krimce[1], Ina Pojani[1], Suada Velo[1], Armanda Ashiku[1], Doris Orgocka[1], Albana Fico[2]
[1]*Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi"*
[2]*Fakulteti i Mjekësisë, UMT*

Abstrakt:
Hyrje: Kanceri i pulmonit përfaqëson një nga patologjitë më të shpeshta malinje dhe një nga shkaqet kryesore të vdekshmërisë globale. Në Shqipëri, incidenca e tij mbetet e lartë, kryesisht e lidhur me duhanpirjen afatgjatë dhe diagnostikimin e vonuar. Analiza e faktorëve klinikë, sëmundjeve bashkëshoqëruese, karakteristikave histopatologjike dhe modaliteteve terapeutike është thelbësore për përmirësimin e menaxhimit dhe prognozës së këtyre pacientëve.
Metodologjia: U realizua një studim retrospektiv mbi 20 pacientë të diagnostikuar me kancer pulmonar gjatë një periudhe tre mujore në shërbimin e pneumologjisë. U analizuan mosha, gjinia, statusi i duhanpirjes, sëmundjet bashkëshoqëruese, lloji histopatologjik sipas biopsisë, stadifikimi sipas sistemit TNM, modalitetet terapeutike dhe vlerësimi funksional sipas indeksit Karnofsky.
Rezultate: Mosha dhe gjinia: Mosha mesatare ishte 67 vjeç (52–82 vjeç). Meshkujt përbënin 75% të rasteve, ndërsa femrat 25%. Duhanpirja: 70% kishin histori duhanpirjeje mbi 20 vite, duke theksuar rolin determinant të këtij faktori risku. Sëmundje bashkëshoqëruese: Hipertensioni arterial u evidentua në 60% të rasteve; gjithashtu u regjistruan fibrilacion atrial, diabet mellitus, sëmundje koronare, tuberkuloz dhe epilepsi. Histopatologjia: Adenokarcinoma pulmonare ishte tipi më i shpeshtë (40%), pasuar nga karcinoma skuamocelulare (35%) dhe karcinoma me qeliza të vogla (25%). Stadifikimi: Shumica u diagnostikuan në stadet e avancuara (T3–T4, N2–N3, M1), duke reflektuar prezantimin e vonuar klinik. Trajtimi: Kimioterapia ishte modaliteti kryesor (80% e rasteve), shpesh e kombinuar me radioterapi ose imunoterapi. Vetëm një rast i diagnostikuar herët iu nënshtrua

ndërhyrjes kirurgjikale. Performanca funksionale: Indeksi Karnofsky varionte nga 60% në 100%, me shumicën e pacientëve në intervalin 70–80%.
Përfundime: Studimi nxjerr në pah se pacientët më të prekur janë meshkuj të moshuar, me histori të gjatë duhanpirjeje dhe me sëmundje bashkëshoqëruese kardiovaskulare. Shumica diagnostikohen në stad të avancuar, duke e kufizuar menaxhimin terapeutik kryesisht në trajtime sistemike. Rezultatet sugjerojnë domosdoshmërinë e aplikimit të programeve të skriningut, diagnostikimit të hershëm dhe qasjeve multidisiplinare për të përmirësuar mbijetesën dhe cilësinë e jetës së pacientëve.

Fjalë kyçe: Kanceri pulmonar, mosha, duhanpirja, kimioterapia, komplikacionet.

VLERËSIMI I SITUATËS SË PACIENTËVE ME MULTIMORBIDITET NË SHËRBIMIN PARËSOR.

Dr. Albana Poloska[1], Dr. Risida Gjonej[2]
[1, 2]*Fakulteti Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti Mjekësisë, Tiranë*

Abstrakt
Hyrje: OBSH e ka përcaktuar multimorbiditetin si prania e dy ose më shumë gjendjeve mjekësore kronike në një individ. Multimorbiditeti mund të paraqitet si një bashkim i sëmundjeve afatgjata që ndajnë faktorët e përbashkët të rrezikut (p. sh. sëmundjet kronike pulmonare dhe sëmundjet kardiovaskulare si rezultat i pirjes së duhanit) ose kur një gjendje çon në një tjetër si një ndërlikim (p. sh. diabeti dhe sëmundjet kardiovaskulare). Ato shoqërohen me ulje të cilësisë së jetës dhe rritje të përdorimit të kujdesit shëndetësor dhe kostos. Gjithashtu një rritje të barrës totale të sëmundjeve dhe një sfidë për personelin dhe shëndetin publik në planifikimin e kujdesit me cilësi të mirë. **Qëllimi:** Vlerësimi i situatës së multimorbiditetit në shërbimin parësor duke u bazuar në të dhënat sociodemografike të pacientëve dhe krahasimi i tyre në cdo 3 mujor.
Metodologjia: Studimi jonë është një studim retrospektiv me dy komponente: deskriptiv dhe analizues në bazë të të dhënave të mbledhura në vitin 2024, Pol nr 4 Tiranë.
Rezultate: Paraqitet nje trend ne rritje e SJT dhe pacientëve me multimorbiditet. Predominojnë moshat > 65 vjec me 41. 85%. Mosha mesatare eshte 60 ± 5 vite. % më të lartë e zë statusi i pensionistit me 55. 29%. Në sëmundjet më të shpeshta rezultuan HTA, DM me një tëndencë më të madhe te femrat në cdo tremujor. Mbi 50 % e pacientëve kanë dy ose më shumë diagnoza të SJT.
Konkluzione: Për të menaxhuar në mënyrë të sigurt njerëzit me multimorbiditet, ekipet e kujdesit parësor duhet të trajnohen, dhe ndiqet edukim ne vazhdim. Kujdesi duhet të jetë proaktiv dhe parashikues, për një qasje gjatë gjithë jetës duke përfshirë kujdesin parandalues për ata në rrezik për multimorbiditet. Sistemet e kujdesit parësor duhet të integrohen më mirë me sistemet shëndetësore, arsimore dhe të kujdesit social. Kujdesi parësor duhet të jetë komunitar duke u përballur dhe lidhur drejtpërdrejt me komunitetin lokal, duke kontribuar kështu tek individi, familja dhe komuniteti.

Fjalë kyce: multimorbiditet, kujdesit shëndetësor, shërbimi parësor, pacient, moshta e treta.

EPERSIA E RM SË GJIRIT NDAJ METODAVE TRADICIONALE TË DIAGNOSTIKIMIT TË PATOLOGJIVE TË GJIRIT.

Dr. Sc. Albana Shahini
Radiologe - Spitali Katolik

Abstrakt
Hyrje: Zbatimi i protokolleve diagnostike dhe ndjekja në dinamike të pacientëve me patologji të gjirit, është një detyrim profesional për të ndihmuar në mbijetimin dhe shërimin si dhe jetëgjatësinë post trajtimit të tyre. Ulja e moshës në patologjitë malinje të gjirit te gratë dhe vajzat e reja është kthyer në një sfidë për diagnostikimin e tyre. Fakti se moshat e reja për shak dhe të statusit hormonal të tyre nuk përfitojnë nga mamaografia nxit nevojën për teknika të reja diagnostikimi.
Qëllimi: Përzgjedhja e saktë e modaliteteve imazherike në pacientët e rinj dhe në ato me gji të dendur, seleksionimi i tyre sipas faktorëve të riskut, densitetit të gjirit, historive të mëparshme të rrezatimit në nivel të

kraharorit dhe faktorëve të tjerë gjenetike bën që rezultati diagnostik dhe si pasojë menaxhimi i saktë i pacientëve të japë një rezultante sa më të mirë për ecurinë afatgjate të pacientit.
Metodologjia: Kryerja e rezonancës magnetike për vlerësimin e patologjive të gjirit tashmë te vajzat e reja dhe ato me gji të dendur ka hapur rrugë të reja diagnostike si për kancerat duktale invasive por dhe ata lobulare. Mungesa e një sistemi mbarëkombëtar screening - u në Shqipëri e limiton mundësinë e mbledhjes së shumë të dhënave, duke e kufizuar problematikën në një numër të vogël pacientësh. Por ajo që vihet re është se, në ato paciente të cilët kryejnë në mënyrë të rregullt ekzaminime të gjirit, kryesisht echo / mamografi, në retrospektivë evidentohet prezenca e tumoreve në ekzaminimet paraardhëse kur krahasohen me ato ekzistente, në një pjesë jo të vogël. Në qendra të mëdha, në studime me numër të madh pacientësh në screening, ky numër varion në 1 / 3 e ekzaminimeve të mamografisë, që mbahet si ekzaminimi standard i screening - ut. Lezimi i dyfishtë dhe kombinimi me rezonancën magnetike dhe tomosintezën tenton të ulë ndjeshëm këto misdiagnostikime dhe të rrisë numrin e kancerave sa më të vegjël me limfonodula negative.
Rezultate: Nga rastet që u morën në studim dhe që u kombinuan të dhënat e ekografisë / mamografisë me MRI me kontrast IV, ekografisë me tomosintezën dhe ekografisë me MRI e tomosintezë, u vu re një rritje e ndjeshme e sensitivitetit diagnostik nga kombinimi i modaliteteve. Sensitiviteti i MRI - së kundrejt mamografisë është 70% në rastet e kombinimit, përkundrejt 35% raste të zbuluara në mamografi. Kombinimi i ekografisë me tomosintezën u vu re që e rrit me 26% saktësinë diagnostike në rastet e marra në studim.
Konkluzione: Mbledhja modeste e të dhënave hedh dritë mbi limitacionet e teknikave imazherike kur përdoren të izoluara, dhe rritjen e sensitivitetit dhe specificitetit kur ato kombinohen me njëra - tjetrën. Implementimi i teknikave të reja imazherike si tomosinteza dhe MRI apo mamografia me kontrast IV synojnë të selektojnë grupet e pacientëve që përfitojnë nga secila teknikë dhe grupet e riskut të pacientëve, duke bërë që në një pjesë të tyre modalitetet imazherike të jenë të ndryshme nga popullata e gjerë dhe intervali i kontrolleve të jetë më i shkurtër, për të synuar uljen e rasteve të kancerave të intervalit, që janë sot një nga sfidat e radiologjisë në botë.

Fjalë kyçe: gjiri, RM, diagnostikim, ekografi.

USHQYESHMËRIA, RREGULLAT E MOSMARRJES ASGJË NGA GOJA PARA OPERACIONIT, PRAKTIKA JONË.

Dr. Albanë Sherifi

Abstrakt
Hyrje: Praktika tradicionale e "mos marrjes asgje nga goja "para ndërhyrjeve kirurgjikaleve synonte të ulte riskun e aspirimit, por evidencat e reja tregojnë se uria e zgjatur dëmton metabolizmin, rrit rezistencën ndaj insulinës dhe ngadalëson shërimin.
Metodologjia: Studimi në vazhdim është studim retrospektiv kohort. Punimi është bazuar në të dhënat e pacientëve paraoperacioneve të hospitalizuar dhe të evidentuar në protokollet e klinikave kirurgji dhe klinikës orl për hulumtimin retrospektiv dhe prospektiv.
Rezultate: Kequshqyreja para operacionit rrit ndjeshëm kompikacionet, infeksionet dhe vdekshmërinë. Marrja e lëngjeve të qarta deri në 2 orë dhe karbohidrateve deri 3 orë para anestezisë përmirëson rikuperimin metabolik. Ushqyerja e hershme enterale pas operacionit është opsioni i preferuar, parenteralja rezervohet për raste të veçanta. Mbështetja ushqimore individuale përmirëson shërimin, ul qëndrimin spitalor dhe redukton koston e trajtimit.
Përfundime: Rregulli klasik "NPO nga mesnata " është i tejkaluar. Optimizimi ushqimor para dhe pas operaconit duhet të jetë pjesë standarde e kujdesit kirurgjikal për të reduktuar komplikacionet dhe për të rritur shanset e rikuperimit të suksesshëm.

Fjalë kyçe: ushqyeshmeria peri - operative, NPO, kirurgjia, rikuperimi.

TRAJTIMET TERAPEUTIKE TË OBEZITETIT DHE INSUFICIENCA KARDIAKE: NJË PËRMBLEDHJE NARRATIVE E REZULTATEVE KLINIKE.

Alberta Humolli[1], Krenar Xhafa[1]
[1]*Universiteti i Ljubljanës, Fakulteti i Mjekësisë, Ljubljana, Slloveni*

Abstrakt
Bashkë ekzistenca e obezitetit dhe insuficiencës kardiake ndikon në mënyrë të theksuar në funksionin kardiovaskular, cilësinë e jetës dhe rezultatet klinike. Megjithëse lidhja ndërmjet këtyre dy gjendjeve është mirë e dokumentuar, menaxhimi i peshës mbetet ende një komponent i nënvlerësuar i kujdesit tek pacientët me insuficiencë kardiake. Ky rishikim narrativ përmbledh të dhënat nga 14 studime origjinale të publikuara gjatë periudhës 2013–2025, të cilat përfshinin pacientë me diagnozë të konfirmuar të obezitetit dhe insuficiencës kardiake, duke raportuar mbi mortalitetin, shkallën e hospitalizimeve, kapacitetin fizik, biomarkerët dhe cilësinë e jetës. Kirurgjia bariatrike tregoi përfitimet më konsistente, duke reduktuar mortalitetin nga të gjitha shkaqet me 45–77% dhe duke përmirësuar njëkohësisht strukturën dhe funksionin kardiak. Farmakoterapitë, përfshirë semaglutide dhe tirzepatide, u shoqëruan me efekte pozitive mbi simptomat, tolerancën ushtrimore, biomarkerët dhe barrën terapeutike. Ndërhyrjet në stilin e jetesës dhe masat dietike rezultuan në përmirësime të kufizuara dhe heterogjene, ndërsa suplementet si koenzima Q10, acide yndyrore omega - 3 dhe L - karnitina treguan efekte të paqëndrueshme, shpesh të kufizuara vetëm brenda grupeve. Në përfundim, qasjet për reduktimin e peshës, veçanërisht kirurgjia bariatrike dhe farmakoterapia e bazuar në agonistët e receptorit GLP - 1, ofrojnë evidencë solide mbi përmirësimin e rezultateve klinike tek pacientët me insuficiencë kardiake të lidhur me obezitetin. Implementimi i strategjive të individualizuara dhe të bazuara në evidencë mbetet thelbësor për optimizimin e kujdesit dhe prognozës në këtë popullatë.

Fjalë kyçe: Insuficienca kardiake, obeziteti, kirurgjia bariatrike, agonistët e receptorit GLP - 1, semaglutide, tirzepatide, humbja e peshës, dieta, aktiviteti fizik.

LIMFOMA PRIMARE E PANKREASIT: NJË RAPORT RASTI DHE RISHIKIM I LITERATURËS.

Albina Ndoja[2, 3], Leart Berdica[1, 2, 3], Erion Sukaj[2, 3], Teona Bushati[1, 2, 3]
[1]*Universiteti i Mjekësisë, Tiranë – Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Patologjisë dhe Mjekësisë Ligjore*
[2]*Western Balkans University*
[3]*Cambridge Clinical Laboratories*

Abstrakt
Hyrje: Limfoma primare e pankreasit (LPP) është një formë e rrallë e limfomës jo - Hodgkin, që origjinon në pankreas dhe përbën më pak se 0. 5% të të gjitha neoplazmave pankreatike. Për shkak të rrallësisë dhe simptomave klinike jo specifike, LPP shpesh ngatërrohet me adenokarcinomën pankreatike. Njohja e saktë është thelbësore, pasi trajtimi dhe prognoza ndryshojnë ndjeshëm midis këtyre dy patologjive.
Paraqitja e rastit: Paraqitet rasti i një pacienti mashkull 72 - vjeçar, i cili shfaqi shqetësime në pjesën e sipërme të barkut, verdhëz të lehtë dhe humbje peshe për rreth dy muaj. Imazheria zbuloi një masë homogjene me përmasa të mëdha në kokën e pankreasit, pa zgjerim të dukshëm të kanalit pankreatik.
Biopsia e kryer nën udhëzim të ultratingullit endoskopik tregoi infiltrime difuze të qelizave limfoide atipike me bërthama vezikulare dhe nukleole të theksuara. Imunohistokimia rezultoi pozitive për CD20, BCL2 dhe MUM1, në përputhje me limfomën difuze me qeliza të mëdha B (nënlloji jo i qendrës germinale). Lezioni ishte i kufizuar në pankreas dhe në nyjet limfatike rajonale, duke plotësuar kriteret diagnostike për limfomë primare pankreatike.
Përfundime: Limfoma primare e pankreasit duhet të merret në konsideratë në diagnozën diferenciale të masave pankreatike, veçanërisht kur karakteristikat radiologjike nuk përputhen me adenokarcinomën. Vlerësimi i hershëm histopatologjik dhe imunohistokimik është vendimtar për diagnozën e saktë, duke mundësuar menaxhim adekuat me kimioterapi dhe prognozë më të favorshme krahasuar me karcinomën pankreatike.

Fjalë kyçe: Limfoma, pankreas, pacientë.

KUJDESI INFERMIEROR GJATË FERTILIZIMIT IN VITRO (IVF).

MSc. Albina Bani
Mami pranë Spitalit Hygeia, Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Infertiliteti përkufizohet si pamundësia për të arritur një shtatzëni të paktën prej 12 muajsh marrëdhënie seksuale të rregullta dhe të pambrojtura. Teknologjitë e riprodhimit të asistuar (ART) përfshijnë të gjitha trajtimet ose procedurat që përfshijnë manipulimin in vitro të vezëve dhe spermës njerëzore, ose të embrioneve, me qëllim arritjen e një shtatzënie. Këto teknika përfaqësojnë trajtimet më të avancuara dhe komplekse të infertilitetit

Fertilizimi in vitro (IVF) përfshin disa hapa, përfshirë stimulimin e kontrolluar të vezoreve, marrjen kirurgjikale të vezëve, fertilizimin në laborator dhe transferimin e embrioneve në mitër. Rasti i parë i lindjes së suksesshme pas IVF u raportua në vitin 1978. Fillimisht, IVF përdorej vetëm për gratë me bllokim të plotë të tubave fallopiane, por sot përdoret edhe për parandalimin e sëmundjeve të caktuara gjenetike. Edhe pse IVF konsiderohet një procedurë mjekësore, infermieret dhe mamitë luajnë një rol qendror dhe të pazëvendësueshëm. Infermierja specialiste është e përfshirë në kujdesin e pacientit gjatë gjithë ciklit të IVF, duke siguruar vazhdimësi kujdesi, rritje të besimit dhe ulje të stresit tek çiftet. Ato veprojnë si udhërrëfyes, mbështetëse dhe trajnere emocionale gjatë gjithë procesit. Në këtë punim theksohet rëndësia e rolit të infermieres gjatë IVF dhe paraqitet përvoja jonë në Departamentin e Fertilitetit të Spitalit Hygeia, i cili menaxhon mbi 200 raste IVF çdo vit. Në këtë punim theksohet rëndësia e rolit të infermieres gjatë IVF dhe paraqitet përvoja jonë në Departamentin e Fertilitetit të Spitalit Hygeia, i cili menaxhon mbi 300 raste IVF çdo vit.

Fjalë kyçe: kujdes infermieror, fertilizim, in vitro.

ZËRI I FËMIJËRISË TRAUMATIKE: SI SHFAQET NË PERSONALITETIN BORDERLINE?!

Albjona Demushi
Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë Tiranë.

Abstrakt

Hyrje: Çrregullimi Borderline i Personalitetit (BPD) përbën një nga çrregullimet më komplekse dhe sfiduese në psikiatri, i karakterizuar nga paqëndrueshmëri emocionale, impulsivitet dhe marrëdhënie ndërpersonale të vështira. Studimet bashkëkohore sugjerojnë një lidhje të fortë midis përjetimeve traumatike në fëmijëri dhe zhvillimit të BPD - së. Trauma e hershme ndikon në ndërtimin e strukturës emocionale dhe neurobiologjike të individit, duke lënë "zërin" e saj në funksionimin psikik të moshës madhore.

Qëllimi: Të eksplorohet mënyra se si trauma e përjetuar në fëmijëri ndikon në formimin e simptomave emocionale, njohëse dhe sjellore tek individët me BPD, duke përfshirë edhe aspektet neurobiologjike që ndërmjetësojnë këtë marrëdhënie.

Metodologjia: Studimi bazohet në analizë bibliografike të literaturës bashkëkohore dhe në prezantimin e një rasti klinik tipik të një pacienteje me histori të abuzimit fizik, emocional dhe seksual në fëmijëri, e diagnostikuar me BPD sipas kritereve DSM - 5. Janë vlerësuar aspektet psiko - patologjike, biologjike dhe psikosociale që ndërlidhen me çrregullimin.

Rezultate: Për lidhjen traumë–BPD rezultoi rreth 70–80% e individëve me BPD raportojnë trauma të rënda në fëmijëri. Manifestimet klinike më të shpeshta përfshijnë: frikë e thellë nga braktisja, ndjesi kronike boshllëku, vetëdëmtim dhe marrëdhënie kaotike. Për ndryshimet neurobiologjike rezultoi se kryesoret ishin hiperaktiviteti i amigdalës, atrofia e hipokampusit dhe hipofunksionimi i korteksit prefrontal, të cilat ndikojnë në rregullimin emocional dhe kontrollin e impulseve. Mënyrat e trajtimit më të shpeshta që përdoren në praktikën klinike janë Terapia Dialektike e Sjelljes (DBT) dhe terapia e bazuar në trauma, të cilat rezultojnë më efektive në menaxhimin e simptomave dhe reduktimin e rrezikut për vetëdëmtim.

Përfundime: Traumat e fëmijërisë luajnë rol themelor në zhvillimin dhe ruajtjen e simptomave të BPD - së. Ndryshimet neurobiologjike dhe emocionale të shkaktuara nga trauma reflektohen në funksionimin afatgjatë të individit. Qasja terapeutike duhet të fokusohet në ndërhyrjen e hershme, procesimin e traumës dhe zhvillimin e aftësive të rregullimit emocional. Përfshirja e mbështetjes familjare dhe sociale përmirëson ndjeshëm rezultatet e trajtimit.

Fjalë kyçe: Çrregullimi Borderline i Personalitetit, trauma e fëmijërisë, amigdala, hipokampusi, psikoterapia dialektike, rregullimi emocional.

NJË RAST ME KANCER INOPERABËL TË PENISIT SI PASOJË E NJË INFEKSIONI NGA HPV.

Alert Xhaja[1], Entela Shkodrani[1], Eglantina Sinani[1], Bilbil Hoxha[2], Aspasia Mishtaku[1]
[1]*Klinika e Dermatologjisë QSU Nënë Tereza*
[2]*Klinika e Urologjisë QSU Nënë Tereza*

Abstrakt
Hyrje: Kanceri i penisit është konsideruar prej vitesh si një formë e rrallë e tumoreve malinje që mund të shkaktojë paaftësi të rëndësishme te pacienti. Histologjikisht në 95% të rasteve është karçinomë skuamoqelizore dhe afërsisht gjysma e këtyre rasteve janë të lidhura me infeksion nga HPV.
Prezantimi i rastit: Ne paraqesim rastin e një pacienti 62 vjeç që hospitalizohet në klinikën e dermatologjisë në QSUT me diagnozën e suspektuar pemphigoid buloz. Në momentin e shtrimit pacienti paraqiste elemente vezikulo - buloz në trung dhe më pak në anësitë e poshtme. Gjatë vizitës u vu re limfoadenopati e dhimbshme inguinale bilaterale. Më pas gjatë një vizite më të detajuar u vu re një tumefaksion që kishte përfshirë gjithë penisin. Në eko vihen re limfonodula jo reaktive me përmasa të mëdha që shtrihen nga rajoni inguinal deri në artikulacionet e gjunjëve. Pacienti referoi se rreth 20 vite më parë i ishin shfaqur formacione verrukoze vegjetante në penis dhe me kalimin e viteve i ishin shndërruar në formacion tumoroz. Pacientit iu mor material për biopsi në lëkurë dhe në penis, që rezultuan respektivisht pemphigoid buloz e karçinomë skuamoqelizore. Gjithashtu testi për HPV rezultoi pozitiv.
Diskutime: Megjithëse mekanizmi i shndërrimit të një infeksioni nga HPV në karçinomë të penisit nuk është plotësisht i qartë, shumë studime kanë treguar se ndikimi i HPV është shumë i madh. Ne mund të konfirmojmë se në rastin tone, neglizhenca në mjekimin e kondilomës çoi në shndërrimin në karçinomë. Në literaturë raportohen mbi 15 raste në 10 vitet e fundit.
Konkluzione: Infeksionet nga HPV te meshkujt për shkak se nuk kanë simptoma nuk merren shumë seriozisht. Në të ardhmen prania e këtyre tumoreve mund të rritet si pasojë dhe e shpërndarjes së gjerë të infeksioneve në popullatë, prandaj profesionistët shëndetësorë duhet të edukojnë pacientët dhe t'i paraqesin infeksionet nga HPV si lezione premalinje dhe që duhen mjekuar dhe ndjekur me kujdes deri në shërimin e plotë.

Fjalë kyçe: Kanceri i penisit, HPV, infeksion, karçinomë skuamoqelizore.

ROLI I ARTERIES RADIALE NË KIRURGJINË MODERNE TË REVASCULARIZIMIT KORONAR.

Alessia Mehmeti[1], Ermal Likaj[1]
[1]*Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Shërbimi i Kardiokirurgjisë*

Abstrakt
Që prej ndërhyrjes së parë të suksesshme të Favaloro - s në vitin 1967, kirurgjia e revascularizimit koronar (CABG) ka pësuar një evolucion të thellë. Anastomoza e arteries mamare të majtë (LITA) me arterien deshendente anteriore (LAD) mbetet gur themeli i ndërhyrjes, megjithatë konfigurimi tradicional "mamare–venë–safene" nuk përfaqëson më standardin bashkëkohor të trajtimit kirurgjikal. Njohja e jetëgjatësisë së kufizuar të grafteve të venës safene (SVG), me norma okluzioni që arrijnë deri në 40–50% brenda dhjetë viteve, ka orientuar qasjen kirurgjikale drejt përdorimit të grafteve arteriale të shumëfishtë (multiple arterial grafting, MAG). Ndër këto, arteria radiale (RA) është konfirmuar si një alternativë e sigurt dhe me jetëgjatësi të faktuar, duke ofruar rezultate të favorshme në patencën afatgjatë dhe në ecurinë klinike, krahasuar me graftet venozë.
Megjithatë, pavarësisht provave të forta, arteria radiale mbetet nënshfrytëzuar në praktikën kirurgjikale bashkëkohore. Ajo përdoret në më pak se 10% të procedurave CABG në Amerikën e Veriut, kryesisht për shkak të mungesës së njohurive teknike, perceptimit të rrezikut të spazmës dhe mungesës së programeve të strukturuara të trajnimit.
Ky artikull është pjesë e një projekti kërkimor në zhvillim nga autorët, që synon të vlerësojë patencën afatgjatë të arteries radiale pas përdorimit të saj në CABG, me fokus në identifikimin e faktorëve klinikë, anatomikë dhe

teknikë që ndikojnë në qëndrueshmërinë e graftit. Artikulli sintetizon evidencën më të fundit dhe udhëzimet kirurgjikale mbi përdorimin e arteries radiale në kirurgjinë koronare, duke u mbështetur në tekstin "Technical Aspects of Modern Coronary Artery Bypass Surgery" dhe në të dhëna nga studime të kontrolluara të rastësishme, meta - analiza dhe regjistra të publikuar gjatë viteve 1999–2024. Theksi vendoset mbi bazën fiziologjike të përdorimit të arteries radiale, përzgjedhjen e kujdesshme të pacientëve, teknikat e marrjes së arteries, konfigurimin e graftit dhe rezultatet krahasuese me arterien mamare të majtë dhe graftet venozë safenë. Kur anastomozohet me arterie me përqindje të lartë ngushtimi, arteria radiale arrin norma patence prej 85–95% në dhjetë vjet, në krahasim me 45–60% për graftet venozë. Optimizimi i rezultateve kërkon përzgjedhje të saktë të pacientëve, teknikë atraumatike gjatë marrjes së arteries dhe profilaksi farmakologjike kundër spazmës. Të dy konfigurimet, si ato të "qepura" në aortë dhe ato kompozite në formë Y / T, japin rezultate të shkëlqyera kur shmangen flukset konkurrente.
Si përfundim, përdorimi i arteries radiale përbën një element thelbësor të revaskularizimit modern me shumë arterie. Kur aplikohet me teknikë të përpiktë dhe zgjedhje të kujdesshme të targetit, ajo siguron përfitime të qëndrueshme në mbijetesë dhe jetëgjatësinë e graftit, pa shtuar rrezikun perioperativ. Evidenca e qëndrueshme që mbështet avantazhet e saj afatgjata nënvizon domosdoshmërinë e adoptimit më të gjerë të arteries radiale në praktikën e CABG, të nxitur përmes trajnimit të dedikuar kirurgjikal dhe mbështetjes institucionale.

Fjalë kyçe: kirurgjia e revascularizimit, arteries radiale, CABG, MAG.

RËNDËSIA E KOHËS SË NDËRHYRJES KIRURGJIKALE NË TRAJTIMIN E FRAKTURAVE SUPRAKONDILARE TË HUMERUSIT TEK FËMIJËT.

Alfred Cake[1], Aldo Shpuza[1,2], Roxhers Mucaj[1], Ledian Fezollari[1]
[1]Spitali Universitar i Traumës, Tiranë
[2]Departamenti i Shëndetit Publik, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Frakturat suprakondilare të humerusit (SCHF) janë ndër frakturat më të zakonshme në moshën pediatrike, duke përbërë deri në 3% të të gjitha frakturave dhe 60% të frakturave të bërrylit tek fëmijët nën 8 vjeç. Për shkak të afërsisë anatomike me enët e gjakut dhe nervat, këto dëmtime kërkojnë trajtim të kujdesshëm dhe të koordinuar për të shmangur komplikacionet neurovaskulare. Koha e ndërhyrjes kirurgjikale është konsideruar një faktor kyç që ndikon në suksesin e trajtimit. Ky studim synon të vlerësojë lidhjen midis vonesës kirurgjikale dhe mënyrës së trajtimit e komplikacioneve post–operative në praktikën klinikë të Spitalit Universitar të Traumës.
Metodologji dhe rezultate: Ky studim retrospektiv përfshiu 90 pacientë nën moshën 12 vjeç me fraktura suprakondilare të humerusit, të trajtuar në periudhën janar 2021 – nëntor 2022. Janë analizuar të dhënat demografike, koha e ndërhyrjes kirurgjikale dhe mënyra e trajtimit: reponim i hapur dhe fiksim intern me shtiza Kirschner (40%), reponim i mbyllur dhe longete gipsi (36%) dhe reponim i mbyllur me fiksim perkutan (24%). Koha mesatare e ndërhyrjes ishte 1. 6 ditë (0–13). Analiza e regresit tregoi lidhje statistikisht të rëndësishme midis kohës së ndërhyrjes dhe komplikacioneve post–operative (p=0. 00). Pacientët me vonesë më të madhe kishin probabilitet më të lartë për ndërhyrje të hapur dhe komplikacione të mëvonshme.
Diskutim dhe përfundime: Rezultatet e këtij studimi janë në përputhje me literaturën ndërkombëtare, e cila nënvizon rëndësinë e ndërhyrjes së hershme në frakturat suprakondilare për të reduktuar komplikacionet dhe për të siguruar rezultate funksionale më të mira. Koha e ndërhyrjes kirurgjikale mbi 24 orë është shoqëruar me rritje të mundësisë për reponim të hapur dhe dëmtime neurovaskulare. Në praktikën klinike shqiptare, vonesat shpesh lidhen me faktorë logjistikë dhe mungesë të kushteve operative emergjente. Kjo tregon nevojën për përmirësim të kapaciteteve kirurgjikale në trajtimin urgjent të frakturave pediatrike. Në përfundim, rekomandohet që ndërhyrja kirurgjikale për frakturat suprakondilare të humerusit tek fëmijët të kryhet sa më herët që të jetë e mundur, brenda 24 orëve nga trauma, për të ulur komplikacionet dhe përmirësuar rezultatet klinike.

Fjalë kyçe: fraktura suprakondilare, fëmijë, koha kirurgjikale, komplikacione, trajtim ortopedik.

KANCERI I PROSTATËS.
Ali Krasniqi

Abstrakt
Kanceri i prostatës është një nga llojet e kancereve më të zakonshem te meshkujt, që prek gjëndrën e prostatës. Kjo sëmundje ka një përhapje të lartë dhe është një ndër shkaqet kryesore të vdekjes tek meshkujt e moshës së mesme dhe të vjetër. Shpesh, kanceri i prostatës rritet ngadalë dhe mund të mbetet asimptomatik për një periudhë të gjatë kohore, duke e bërë diagnostikimin e hershëm mjaft sfidues.
Objektiva: Objektivi i këtij studimi është të shqyrtojë faktorët e rrezikut, metodat e diagnostikimit, mundësitë e trajtimit dhe prognozën e kancerit të prostatës, si dhe të vlerësojë rëndësinë e ekzaminimeve të rregullta për identifikimin e kësaj sëmundjeje në fazat e hershme.
Metodologjia: Ky studim u realizua përmes një shqyrtimi të literaturës ekzistuese mbi kancerin e prostatës dhe përmes analizës së të dhënave të pacientëve të diagnostikuar me këtë sëmundje. U përdorën burime të besueshme shkencore dhe mjekësore, si dhe raporte klinike që shqyrtojnë trajtimin dhe menaxhimin e kancerit të prostatës në nivele të ndryshme. Për më tepër, u përdorën statistika dhe studime retrospektive për të analizuar faktorët e rrezikut dhe efektivitetin e trajtimeve të ndryshme.
Rezultate: Rezultatet treguan se moshat mbi 50 vjeç, historia familjare e kancerit të prostatës, dhe faktorët gjenetikë janë disa nga faktorët më të rëndësishëm të rrezikut për zhvillimin e sëmundjes. Diagnostikimi kryhet përmes analizës së PSA dhe biopsisë së prostatës. Mjetet moderne të trajtimit, përfshirë kirurgjinë, radioterapinë dhe terapinë hormonale, kanë treguar efikasitet të lartë, veçanërisht kur sëmundja diagnostikohet në stadet e hershme. Trajtimi i kancerit të prostatës ka ndihmuar në uljen e vdekshmërisë, megjithatë, ka ende debate në lidhje me vlerën e ekzaminimeve të rregullta për burra pa simptoma, për shkak të mundësisë së diagnostikimit të tepërt.
Përfundime: Kanceri i prostatës mbetet një sfidë të madhe në mjekësinë moderne për shkak të shpërndarjes së gjerë dhe pasojave që ai ka në jetën e pacientëve. Ndërhyrjet e hershme dhe trajtimet adekuate kanë mundësinë të përmirësojnë ndjeshëm cilësinë e jetës dhe të zvogëlojnë vdekshmërinë. Megjithatë, është e nevojshme të vazhdohet me kërkime dhe të zhvillohen protokolle të reja për diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjes, duke u fokusuar në individualizimin e trajtimit për çdo pacient.

Fjalë kyçe: Kanceri i prostatës, PSA, biopsia, faktorët e rrezikut, trajtimi, kirurgjia, radioterapia, trajtimi hormonal, diagnostikimi i hershëm, vdekshmëria.

RETINOPATIA DIABETIKE – NJË PËRMBLEDHJE MBI PATOGJENEZËN, GJETJET KLINIKE DHE KLASIFIKIMET BASHKËKOHORE.
Ali Tonuzi

Abstrakt
Hyrje: Retinopatia diabetike (RD) përbën një nga komplikacionet mikrovaskulare më të shpeshta të diabetit mellitus dhe është shkaku kryesor i verbërisë tek popullata në moshë pune.
Qëllimi: Qëllimi i këtij review është të analizojë mekanizmat patogjenetikë, ndryshimet patofiziologjike, gjetjet klinike dhe sistemet kryesore të klasifikimit të kësaj sëmundjeje, duke përfshirë klasifikimet sipas Kansk - it dhe ETDRS.
Metoda: U realizua një rishikim narrativ i literaturës bashkëkohore në bazat e të dhënave PubMed, Scopus dhe Google Scholar, duke u fokusuar në artikujt më të fundit që trajtojnë aspektet molekulare, klinike dhe diagnostike të RD - së. U përfshinë studime eksperimentale, klinike dhe përmbledhje sistematike mbi progresionin dhe menaxhimin e saj.
Gjetjet klinike: Retinopatia diabetike rezulton nga dëmtimi kronik i qelizave endoteliale vaskulare për shkak të hiperglicemisë së zgjatur, stresit oksidativ dhe aktivizimit të rrugëve biokimike si ajo e poliolit dhe proteinave të avancuara të glikacionit (AGEs). Këto ndryshime çojnë në rritje të permeabilitetit kapilar, mikroaneurizma, hemorragji retinale dhe neovaskularizim. Sipas Kansk - it, RD ndahet në forma jo - proliferative dhe proliferative, ndërsa sistemi ETDRS ofron një ndarje më të hollësishme bazuar në ashpërsinë e lezioneve vaskulare dhe praninë e edemës makulare. Retinopatia diabetike e avancuar karakterizohet nga neovaskularizim i disk - ut optik, hemorragji vitreale dhe traksione fibrotike që mund të çojnë në shkolitje të retinës.

Përfundime: Njohja e mekanizmave patogjenetikë dhe përdorimi i klasifikimeve të standardizuara janë thelbësore për diagnostikimin e hershëm dhe trajtimin adekuat të RD - së. Kombinimi i monitorimit sistematik oftalmologjik me ndërhyrjet mjekësore si anti - VEGF, trajtimi me lazer dhe menaxhimi i rreptë i diabetit përbën qasjen më efikase për të parandaluar humbjen e shikimit.

Fjalë kyçe: retinopatia diabetike, patogjeneza, ETDRS, Kanski, neovaskularizimi, diabet mellitus, anti - VEGF, verbëri parandaluese.

STRATEGJITË E MENAXHIMIT DHE TRAJTIMIT NË ROP TE PREMATURËT: ROLI KRITIK I OKSIGJENO - TERAPISË DHE NDËRHYRJET KIRURGJIKALE.

Prof. Asc. Ali Tonuzi, Dr. Migena Beqiri

Abstrakt

Hyrja: Retinopatia e prematuritetit (ROP) është një çrregullim vazoproliferativ i retinës që prek foshnjat e lindura premature, si pasojë e zhvillimit të paplotë të vaskularizimit retinal. Zhvillimi i saj ndikohet ndjeshëm nga luhatjet postnatale të oksigjenit. Kuptimi i lidhjes ndërmjet oksigjenoterapisë dhe përparimit të sëmundjes është thelbësor për përmirësimin e parandalimit dhe trajtimit të saj.

Qëllimi: Të përmblidhen të dhënat aktuale mbi menaxhimin dhe trajtimin e ROP - it, duke theksuar rolin e oksigjenoterapisë dhe ndërhyrjeve kirurgjikale në kontrollin e sëmundjes dhe ruajtjen e funksionit vizual.

Materiale dhe metoda: U krye një rishikim i literaturës, përfshirë studime klinike dhe analiza sistematike që vlerësojnë ndikimin e rregullimit të oksigjenit, fotokoagulimit me lazer, terapisë intravitreale anti - VEGF dhe ndërhyrjeve vitreoretinale te foshnjat e lindura premature me ROP.

Rezultate: Parandalimi fillon me reduktimin e incidencës së prematuritetit dhe ruajtjen e oksigjenimit postnatal të qëndrueshëm. Ekspozimi i tepruar ndaj oksigjenit në fazën e hershme postnatale (faza 1 e ROP) pengon zhvillimin normal të enëve të retinës, ndërsa hipoksia e mëvonshme (faza 2) nxit neovaskularizimin patologjik. Rregullimi i kujdesshëm i niveleve të saturimit të oksigjenit, më të ulëta në fazën e parë dhe më të larta në fazën e dytë mund të zvogëlojë ashpërsinë e sëmundjes. Fotokoagulimi me lazer mbetet standardi i artë për trajtimin e ROP - it të tipit 1, ndërsa krioterapia përdoret në mungesë të lazerit. Terapia intravitreale anti - VEGF (bevacizumab, ranibizumab) është efektive për format posteriore ose agresive të ROP - it dhe për foshnjat që nuk mund të përballojnë anestezinë, megjithatë kërkon ndjekje të zgjatur për shkak të rrezikut të rikthimit të vonshëm. Në fazat e avancuara (stadiumi 4–5 i ROP - it), ndërhyrja kirurgjikale, si vitrektomia me ruajtje të kristalint ose scleral buckle, mund të jetë e nevojshme për të lehtësuar tërheqjet vitreoretinale dhe për të ruajtur integritetin anatomik të retinës, duke ofruar rezultate më të mira kur kryhet në fazat e hershme.

Përfundime: Menaxhimi optimal i ROP - it kërkon një qasje multidisiplinare që kombinon oksigjenoterapinë e kontrolluar, ndërhyrjet farmakologjike dhe me lazer në kohën e duhur, si dhe trajtime kirurgjikale kur është e nevojshme. Rregullimi i saktë i oksigjenit gjatë gjithë periudhës neonatale mbetet thelbësor për parandalimin e progresionit të sëmundjes. Nevojiten studime të mëtejshme për të përcaktuar kufijtë optimalë të saturimit të oksigjenit dhe për të vlerësuar sigurinë afatgjatë sistemike të agjentëve anti - VEGF dhe efektet e ndërhyrjeve kirurgjikale.

Fjalë kyçe: retinopatia e prematuritetit, oksigjenoterapi, fotokoagulim me lazer, terapi anti - VEGF, kirurgji vitreoretinale, kujdes neonatal, prematuritet.

LINDJA PREMATURE DHE TRENDI I SAJ GJATË DHE PAS COVID - IT NË VENDIN TONË.

Prof. Asoc. Alketa Hoxha Qosja
Shefe e Departamentit të Neonatologjisë, QSUOGJ "Koço Gliozheni", Tiranë
Lektore në Departamentin e Pediatrisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë në Tiranë.

Abstrakt

Hyrje: Lindja e parakohshme është shkaku kryesor i vdekshmërisë neonatale dhe lidhet me pasoja afatgjata fizike, neurozhvillimore dhe socio - ekonomike. Komplikacionet nga lindja e parakohshme mbetën shkaku kryesor i vdekshmërisë tek fëmijët nën 5 vjeç në nivel global në vitin 2022, duke përbërë rreth 1 milion vdekje

neonatale, të ngjashme me shifrat e një dekade më parë. Kuptimi i trendeve të lindjeve të parakohshme (<37 javë gestacionale) është thelbësor për hartimin e strategjive të shëndetit perinatal. Fatkeqësisht, Shqipëria mungon në të dhëna kombëtare të qëndrueshme pas vitit 2015; megjithatë, modelet globale (OBSH / UNICEF) ofrojnë vlerësime të trendeve deri në vitin 2020.
Qëllimi: Të përshkruhet trendi i vlerësuar i normave të lindjeve të parakohshme në Shqipëri gjatë periudhës 2015–2020 bazuar në modelimin global, dhe të diskutohen implikimet për periudhën 2021–2024 në mungesë të të dhënave empirike të përditësuara.
Metodologjia: Ne mbështetemi në vlerësimet e modeluara të OBSH - së nga Global Health Observatory për normat e lindjeve të parakohshme. Ky model projekton normat kombëtare edhe kur mungojnë të dhëna të drejtpërdrejta.
Rezultate: Gjetjet kryesore për trendin 2015–2020: Për shumicën e vendeve evropiane, përfshirë Shqipërinë, normat e parakohshmërisë kanë qenë të qëndrueshme gjatë dekadës 2010–2020, pa ndonjë ulje statistikisht domethënëse. Globalisht, shkalla vjetore e reduktimit ishte vetëm −0. 14% / vit (2010–2020), që nënkupton ndryshim minimal nga viti në vit. Duke qenë se Shqipëria ndjek modelin rajonal evropian (zakonisht <8–9% e lindjeve), është e arsyeshme të konkludohet se trendi 2015–2020 ka qenë i qëndrueshëm, me luhatje të vogla ndërvite. 2015–2024: boshllëqet dhe interpretimi: Pas vitit 2020, nuk ka publikime zyrtare të hapura që ofrojnë seri vjetore për parakohshmërinë në Shqipëri deri në 2024 / 2025. Në mungesë të tyre, vlerësimi epidemiologjik bazohet në faktin se asnjë rajon nuk ka shënuar ulje të qëndrueshme në dekadën e fundit dhe se faktorët e rrezikut (mosha në rritje e nënës, shtatzënitë e shumëfishta / IVF, obeziteti / hipertensioni) nuk kanë ndryshuar në mënyrë të dukshme për të pritur një ulje të theksuar të parakohshmërisë në vend. Prandaj, trendi për periudhën 2021–2024 ka të ngjarë të mbetet afërsisht i qëndrueshëm, por kjo duhet të verifikohet përmes të dhënave administrative kombëtare (regjistrat e maternitetit / INSTAT / ISHP).
Konkluzione: Duke pasur parasysh ndryshimet minimale gjatë dekadës së mëparshme, është e arsyeshme të mendohet se trendi ka mbetur kryesisht i qëndrueshëm, përveç rasteve kur kanë ndodhur ndryshime të konsiderueshme politike ose demografike.

Fjalë kyçe: Lindja e parakohshme, Shqipëri, trendet 2015–2025, shëndeti perinatal.

FAKTORËT E RISKUT PËR ROP NË PERIUDHËN NEONATALE.

Prof. Asoc. Alketa Hoxha (Qosja)
Shefe e Shërbimit të Neonatologjisë
Pedagoge pranë Departamentit të Pediatrisë, FM / UMT

Abstrakt
Hyrje: Retinopatia e prematurit (ROP) është një pathollogji që mund të ndodhë tek foshnjat që lindin premature, ekstremisht premature dhe me peshë të vogël në lindje, por jo vetëm dhe mund të shkaktojë verbëri. E përshkruar për herë të parë në vitet 1940 si Fibroplazi Retrolentale, ROP - i është një situatë që tregon papjekuri të sistemit vaskular të retinës. Gjasat e zhvillimit të ROP - it lidhen me fazën e zhvillimit vaskular, e cila nga ana tjetër lidhet me moshën postmenstruale të foshnjës. Pa masa terapeutike efektive, skriningu nuk konsiderohej përparësi në Mbretërinë e Bashkuar deri në zhvillimin e një klasifikimi të pranuar ndërkombëtarisht të ROP - it në vitin 1984 dhe demonstrimin e efikasitetit të trajtimit për kete pathollogji. Një nga faktorët kryesorë të riskut për ROP është mosha e barrës, sa më premature të jetë foshnja në lindje aq më i riskuar është për zhvillimin e kësaj pathollogjie. Kështu në një studim të kryer nga Blencowe në vitin 2010, u vlerësuan globalisht 184, 700 foshnja premature që zhvilluan ROP nga grada 1 - 4, nga të cilat 20, 000 foshnja u verbuan ose u dëmtuan rëndë nga shikimi për shkak të kësaj pathollogjie dhe 12, 300 të tjerë zhvilluan dëmtime të lehta / të moderuara të shikimit. Një faktor tjeter risku është akcesi ne ekzaminim dhe trajtim sa me te hereshem dhe adekuat. Keshtu nga foshnjat me shikim të dëmtuar, nga ROP, 65% lindën në rajone me të ardhura mesatare. Shumë foshnja që lindin ekstremisht premature do të zhvillojnë një shkallë të caktuar të retinopatisë së parakohshme (ROP), por që në shumicën e rasteve nuk përparojnë, duke u zgjidhur spontanisht pa trajtim. Megjithatë, një pjesë e vogël zhvillon ROP potencialisht të rëndë e cila mund të zbulohet vetëm me anë të ekzaminimit të retinës. Nëse nuk trajtohet, sëmundja e rëndë mund të rezultojë në dëmtim serioz të shikimit dhe si pasojë të gjitha foshnjat në rrezik të ROP që kërcënon shikimin duhet të ekzaminohen dhe trajtohen në kohë.
Për foshnjat e lindura para moshës gestacionale 31+0 javë, ekzaminimi i parë ROP duhet të kryhet midis moshës postmenstruale 31+0 dhe 31+6 javë, ose në moshën postnatale 4 javë të plota (28–34 ditë). Për foshnjat e lindura

nga GA 31+0 javë (pavarësisht nga pesha e lindjes), ekzaminimi i parë ROP duhet të kryhet midis PMA 36+0 dhe 36+6 javë ose në PNA 4 javë të plota (28–34 ditë). Një faktor tjetër risku që i shtohet prematuritetit është dhe ekspozimi ndaj oksigjenit, terapi që është jetëshpëtues nga njëra anë por që shkakton këtë komplikacion nga ana tjetër. Disa foshnje me ROP janë raste të lehta dhe përmirësohen pa trajtim. Por disa foshnje kanë nevojë për trajtim për të mbrojtur shikimin e tyre dhe për të parandaluar verbërinë.
ROP është një nga shkaqet e pakta të aftësisë së kufizuar të shikimit në fëmijëri që është kryesisht e parandalueshme. Në vendin tonë është përmirësuar ndjeshëm jetueshmëria e foshnjave prematore dhe ekstremisht prematore dhe kjo sjell si nevojë diagnostikimin e hershëm dhe trajtimin e ROP.

Fjalë kyçe: shikim, ROP, prematur, RTIN.

PËRDITËSIME NË KRITERET DIAGNOSTIKE TË RETINOPATISË NË LINDJET PREMATURE (ROP).

Alketa Tandili Assoc. Prof [1], Dr. Shk. Rezart Ajazi, Holgena Cepani, Telma Aliaj, Adela Jahollari, Rigers Ajazi, Vilma Mema Assoc. Prof[1], Eglantina Bulica Phd - C[2], Ilir Arapi Assoc. Prof[1], Spiro Dama PhD[3], Amarilda Hysenshahaj Msc[4]
[1]Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri
[2]Okuliste, Poliklinika e Specialiteteve, Nr. 1, Tiranë, Shqipëri
[3]Neonatolog, Spitali Obstetrik Gjinekologjik "Mbreterësha Geraldinë", Tiranë, Shqipëri
[4]Staticiene, Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Qëllimi: Kjo përmbledhje synon të përshkruajë evolucionin dhe përditësimet e fundit në kriteret diagnostike të retinopatisë së prematuritetit (ROP), duke theksuar ndryshimet kryesore të prezantuara në Klasifikimin Ndërkombëtar të Retinopatisë së Prematuritetit – versioni i tretë (ICROP3) dhe ndikimin e tyre klinik.
Metodologjia: U krye një përmbledhje narrative e literaturës për periudhën 2010–2025. U përfshinë studime dhe deklarata konsensusi që trajtonin përkufizimet diagnostike, parametrat e stadifikimit dhe përditësimet në klasifikim. Të dhënat u analizuan për të krahasuar kriteret e mëparshme diagnostike me kriteret e ICROP3, të publikuara në vitin 2021.
Rezultatet: Diagnoza e ROP bazohet në vlerësimin e zhvillimit vaskular retinal në raport me moshën gestacionale, peshën në lindje dhe ekspozimin postnatal ndaj oksigjenit. Foshnjat e lindura para javës së 32 - të ose me peshë nën 1500 g kanë rrezikun më të lartë. ROP ndodh kur enët e pamaturuara të retinës nuk arrijnë zonën e *ora serrata*, duke shkaktuar neovaskularizim jonormal. ICROP3 përcakton pesë faza: Faza 1, vijë ndarëse; Faza 2, rritje (ridge); Faza 3, proliferim fibro - vaskular jashtë retinës; Faza 4, shkëputje e pjesshme e retinës; dhe Faza 5, shkëputje totale me prognozë të dobët. Retina ndahet në tre zona të përqendruara në diskut optik: Zona I (poli posterior, thelbësore për shikimin), Zona II (zgjatet deri në *ora serrata* nazale) dhe Zona III (segmenti temporal). Klasifikimi sipas fazës, zonës dhe pranisë së "plus disease" përcakton urgjencën e trajtimit. ROP e lehtë në zonat periferike shpesh regredon spontanisht, ndërsa rastet në Zonën I ose Faza 3 me *plus disease* kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme për të parandaluar shkëputjen e retinës dhe verbërinë.
Përfundime: Klasifikimi ICROP3 ofron përkufizime më të qarta dhe integron vlerësimet me bazë imazherike, duke rritur saktësinë dhe konsistencën diagnostike. Zbatimi i këtyre kritereve të përditësuara në skriningun neonatal mundëson zbulim më të hershëm të ROP që rrezikon shikimin, zvogëlon ndryshueshmërinë ndërmjet vëzhguesve dhe mbështet trajtimin në kohë për të parandaluar humbjen e parikthyeshme të shikimit tek foshnjat e lindura para kohe.

Fjalë kyçe: Retinopatia e prematuritetit, ICROP3, faza e ROP, plus disease.

SFIDAT DIAGNOSTIKE TË LEUKOPENISË: ROLI I MORFOLOGJISË NË DIAGNOZËN DIFERENCIALE MIDIS ORIGJINËS HEMATOLOGJIKE DHE JO - HEMATOLOGJIKE.

Prof. Dr. Alma Barbullushi
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, UMT

Abstrakt

Hyrje: Leukopenia përfaqëson një ulje të numrit total të leukociteve në gjakun periferik, zakonisht nën 4. 0×10^9 / L, dhe shpesh është një manifestim i hershëm i një game të gjerë patologjish, si hematologjike ashtu edhe jo - hematologjike. Klasifikimi i saktë etiologjik i leukopenisë është thelbësor për vendosjen e diagnozës, menaxhimin klinik dhe trajtim të përshtatshëm të pacientit. Leukopenitë me origjinë hematologjike përfshijnë patologji që prekin drejtpërdrejt palcën e kockave, si leuçemitë, sindromat mielodisplastike, aplazia medulare dhe mielofibroza, të cilat ndikojnë në prodhimin dhe maturimin normal të qelizave të bardha. Në të kundërt, leukopenitë jo - hematologjike janë shpesh sekondare ndaj infeksioneve virale, sëmundjeve autoimune, deficitit të mikronutrientëve ose efekteve toksike të barnave. Është e rëndësishme të theksohet se leukopenia është një shenjë laboratorike dhe jo një diagnozë më vete. Për përcaktimin e shkakut dhe natyrës së dëmtimit, nëse ai është qendror (palca e kockave) apo periferik (shkatërrim apo sekuestrim qelizash), ekzaminimi morfologjik mikroskopik mbetet një instrument diagnostik i pazëvendësueshëm. Ky ekzaminim ofron informacion të drejtpërdrejtë mbi morfologjinë e qelizave të bardha, ndihmon në diferencimin midis hipoprodhimit medular dhe shkatërrimit periferik, lejon identifikimin e qelizave jonormale (si blaste, displazi, vakuolizime, granula anormale, etj.), që orientojnë menjëherë drejt patologjive hematologjike.

Konkluzion: Leukopenia është një tregues laboratorik me shumëshkaqe që kërkon analizë të kujdesshme etiologjike. Morfologjia mikroskopike mbetet thelbësore për të dalluar origjinën hematologjike nga ajo jo - hematologjike. Vetëm integrimi i të dhënave klinike, laboratorike, dhe morfologjike mundëson një diagnozë të saktë, trajtim të duhur dhe parandalim të komplikacioneve, duke e bërë morfologjinë një hallkë thelbësore në mirëmenaxhimin e pacientëve me leukopeni.

Fjalë kyçe: leukopenia, leukocite, gjak periferik etj.

SEPSISI SHKAQET, SIMPTOMAT, TRAJTIMI.

A. Cani[1] A. Hatibi[1], F. Kokiçi[1], E. Shima[1], A. Vyshka[1], A. Gjoka[1], L. Agolli[2]
[1]*QSR "Shefqet Ndroqi" Anestezist - Reanimator*
[2]*QSR "Shefqet Ndroqi" Pneumolog*

Abstrakt

Hyrje: Sepsis është një sindromë që karakterizohet nga shenja klinike dhe simptoma për shkak të infeksionit, me një shkallë të lartë të vdekshmërisë, veçanërisht nëse nuk mjekohet menjëherë. Qëllimi për trajtimin e sepsisit përfshin: diagnostikimin e shpejtë; ndërhyrjen e menjëhershme, për të parandaluar alterimet e hemodinamikës, dhënien e antibiotikëve, trajtimin e pasojave të sepsisit (saturimet e ulëta të oksigjenit, acidemise të rritur në gjak, alterimet të koagulimit të gjakut); dhe rehabilitimin e funksioneve jetësore (tensioni arterial, debiti urinar, funksioni kardiak).

Prezantim i rastit: F. F 58 vjec**.** Diagnoza e shtrimit**:** Pneumoni bilaterale masive, insuficiencë respiratore tip I, Sëmundjet shoqëruese**:** status post perforacio ventriculi, operuar para 10 vitesh, HTA, DM tip2**,** duhanpirës - exfumator, alkolist. Anamneza: 2 jave para ardhjes në spital me temperaturë 37 - 39° C me djersë, kollë të thatë, dispne, lodhje, dobësi trupore. 3 ditët e fundit me temperaturë deri 40°C, vështirësi të theksuar në fryëmarrje edhe në qetësi. Predominon dhimbja epigastrike. Nga urgjenca shtrohet në pavion me parametrat e mëposhtëm në shtrim: Koshient, dispne, polipne, Fr=28 / min; SaO_2= 71% me 15l - O_2 / min; Fc=120 / min (RS); TA=70 / 40mmHg. Transferohet në reanimacion ku intubohet në kushtet e urgjencës dhe vendoset me keto parametra: FiO_2=100% IPPV Vt=600ml; Fr=16 / min; PEEP=6cmH_20; Pmax=40cmH_2O; Insp. Time=1, 2sek; Të Dhënat laboratorike flasin për leukocitozë të shprehur, insuficiencë renale, dhe rritje të PCR. Gasanaliza (Astrupograma) flet për alterime të vlerave të PaO2, si dhe komponentëve metabolikë. Egzaminimet e tjera si: Rtg pulmoni p - a bilateral si dhe Ct Scan toraksi evidentojnë errësime infiltrative bilaterale. Kryhen të gjitha konsultat e kërkuara si: Kardiologu, Echo kardiake, kardiomiopati ischemike, IK NYHA IV (Probabël alkoolike). Gastrohepatologu, kryen echon abdominale, hepar steatozik, kalkula në kolecistë pa likid peritoneal et pleural. Terapi gastroprotektore, kërkon analizat përkatëse (Albuminemi, Prot tot, Niv, Prot. etj.)

Endokrinologu: DM tipI, Insulinoterapi sipas vlerave të glicemive.
Terapia: Antibiotikoterapi me spektër të gjerë, kortizonikë, antacid, antikoagulantë kardiotonikë, inotrope, oksigjenoterapi, insulinoterapi, likide e simptomatikë të tjerë. Pacienti mbahet në ventilim mekanik për 10 ditë.
Përfundim: Ky studim tregon se shoku septik është një gjendje kërcënuese për jetën, veçanërisht tek pacientët me sëmundje kronike. Trajtimi i duhur, i shpejtë dhe gjithëpërfshirës, si dhe përcaktimi i burimit të infeksionit, janë thelbësore në menaxhimin e shokut septik.

Fjalë kyçe: sepsis, shoku septic, antibiotikoterapia, ards, hypoperfusion, emergjencë.

MIELOFIBROZA, RASTET E REZISTENCËS DHE MEKANIZMI I MUNDSHËM NËN TRAJTIMIN ME RUXOLITINIB.
Cili. A, Perolla. A, Calliku. E, Pulluqi. P, Ivanaj. A

Abstrakt
Ndërsa transplantimi alogjenik me qeliza mëmë hematopoietike mbetet terapia e vetme kurative për pacientët me mielofibrozë. Kjo terapi është e kufizuar si nga morbiditeti dhe vdekshmëria e lartë e shoqëruar me procedurën, ashtu edhe nga fakti se vetëm një pakicë pacientësh janë të përshtatshëm për shkak të moshës ose sëmundjeve bashkeshoqeruese. Ruxolitinibi, një frenues JAK1 / JAK2, është terapia standarde e linjës së parë për mielofibrozën me rrezik të ndërmjetëm dhe të lartë, duke ofruar lehtësim të simptomave dhe zvogëlim të vëllimit të lienit, por pa një përfitim të qartë mbijetese. Dështimi i ruxolitinib mbetet një sfidë e rëndësishme klinike, me mekanizmat e rezistencës që nuk janë sqaruar plotësisht. Për më tepër, shumë agjentë të tjerë janë në zhvillim në sprova klinike, si monoterapi ose në kombinim me ruxolitinib. Ky rishikim ofron një përditësim mbi përdorimin e frenuesve të JAK1 / JAK2 dhe agjentëve të rinj, me fokus në opsionet e trajtimit për pacientët rezistentë ose refraktarë ndaj ruxolitinib.

Fjalë kyçe: mielofibrozë, frenues të JAK, ruksolitinib, rezistent / refraktar.

RITMI I RRITJES NË PESHË TEK BEBET PREMATURË TË LINDUR MË PAK SE 1500 G.
Dr. Alma Hysa

Abstrakt
Hyrje: Të porsalindurit prematurë me peshë më të vogël se 1500 gr, përfaqësojnë nje grup me rrezik të lartë për morbiditet dhe mortalitet. Rritja e shpejtë dhe e qëndrueshme në peshë është një nga faktorët më të rëndësishëm për prognozën e tyre.
Objektiva: Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i ritmit të rritjes në peshë tek të porsalindurit prematurë me peshë më pak se 1500gr nëpërmjet ushqyerjes enterale dhe a është kjo e mjaftueshme. Dhe faktorët që ndikojnë në këtë proçes gjatë qëndrimit në spital.
Metodologjia: Ky studim përfshin një analizë retrospektive të të dhënave klinike të të porsalindurve prematurë me VLBW (<1500g) të shtruar në repartin e terapisë intensive neonatale në Maternitetin Koço Gliozheni për periudhën Janar 2024 - Dhjetor 2024. Janë vlerësuar parametra si: pesha e lindjes, gjinia, mosha e barrës, ditëqëndrimi në spital, mënyra e ventilimit, lloji i ushqyerjes enterale (qumësht nënë, artificial apo qumësht hiperkalorik - Infantrini).
Rezultate: Studimi përfshin 27 foshnja preterm <1500gr. Pesha mesatare e lindjes së tyre ishte 1253 gr, mosha mesatare e barrës 30. 3 javë, ndërsa vlera mesatare e Apgarit ishte 5. 7. Shpërndarja sipas gjinisë tregoi dominancë të femrave (77. 8%) ndaj meshkujve (22. 2%). U vlerësua mënyra e ushqyerjes enterale ku 92. 6% e bebeve janë ushqyer me metodë të kombinuar (QN, QA, QI), 7. 4% të ushqyer vetëm me QA. U vu re që përdorimi i qumështit artificial hiperkalorik(Infantrini) është i lidhur me një shtim më të shpejtë në peshë krahasuar me grupin e ushqyer pa të. Nga 27 te porsalindur QI është përdorur në 15 raste(55%).
Përfundime: Foshnjat me peshë nën 1500g paraqesin një ritëm të ngadaltë por progresiv të rritjes në peshë. Mungesa e ushqyerjes parenterale kufizon shtimin e shpejtë në peshë në periudhën e hershme postnatale. Aplikimi i protokolleve të përbashkëta të ushqyerjes enterale dhe parenterale mund të përmirësojë ndjeshëm rezultatet neonatale.

Fjalë kyçe: Preterm, VLBW, ushqyerje.

ADRESIMI I SFIDAVE NË KUJDESIN PËR PACIENTIN KARDIORENAL.

Alma Idrizi, Eriola Bolleke Likaj, Matilda Imeraj, Kristi Saliaj, Enxhi Rusta
Shërbimi Nefrologji - Dializë - Transplant, UHC "Nëne Terza", Tiranë.

Abstrakt
Hyrje: Frenuesit e sistemit reninë - angiotensinë - aldosteron (RAASi) dhe antagonistët e receptorëve mineralokortikoidë (MRA) janë ilaçe kyçe në menaxhimin e pacientëve me sëmundje kardiovaskulare (SKV), veçanërisht atyre me hipertension, diabet, sëmundje kronike të veshkave dhe insuficiencë kardiake (IK), duke pasur parasysh efektivitetin e tyre të demonstruar në uljen e rrezikut. Pavarësisht ndikimit të tyre pozitiv në ecurinë e sëmundjes, pacientët nën trajtim me RAASi dhe MRA janë veçanërisht të ekspozuar ndaj hiperkalemisë. Afërsisht 50% të këtyre individëve përjetojnë dy ose më shumë episode te hiperkalemisë çdo vit. Praktika e zakonshme e uljes së dozës ose ndërprerjes së trajtimit me RAASi dhe MRA në kushtet e hiperkalemisë rezulton të jetë jo optimal në këta pacientë, me një ndikim të mundshëm në rrezikun e vdekshmërisë dhe morbiditetit të tyre.
Diskutime: Linjat udhërrëfyese reçente të shoqatave ndërkombëtare kardiovaskulare dhe renale po theksojnë gjithnjë e më shumë nevojën për strategji alternative për të menaxhuar rrezikun e hiperkalemisë, duke lejuar vazhdimin e terapive RAASi dhe MRA. Ekzistojnë disa mundësi terapeutike efektive dhe të sigurta për trajtimin e hiperkalemisë në grupe të ndryshme pacientësh.
Komente dhe Përfundime: Diagnoza e hershme dhe zbulimi i shkaqeve themelore janë thelbësore për menaxhimin e duhur të pacientit. Duke pasur parasysh mekanizmat e ndryshëm që kontribuojnë në hiperkalemi, një qasje multidisiplinare është e nevojshme për të optimizuar menaxhimin e pacientit dhe për të zvogëluar rrezikun që shoqërohet me këtë gjendje.

Fjalë kyçe: sëmundje kardiovaskulare, diabet, sëmundje kronike e veshkave, hiperkalemi.

NDJEKJA E NEONATIT TË NËNËS ME ANTIGEN AUSTRALIA POZITIVE (HBsAg+).

Alma Nurçe[1], Xhensila Prendushi[1] Vjollca Hajro[2], Emirvina Koliçi[1], Altina Xhaferi[1], Gentjana Gora[3], Rozeta Shahinaj[3], Daniela Tasha[1], Enkeleida Kamberi[4]
[1]Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
[2] Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit, Universiteti i Sporteve të Tiranës
[3] SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë" Tiranë
[4] SUOGJ "Koço Gliozheni" Tiranë.

Abstrakt
Hyrje: Hepatiti B është një sëmundje infektive e heparit. Shumica e infeksioneve të HBV ndodhin në periudhën perinatale dhe në fëmijërinë e hershme. Fetusi dhe i porsalinduri mund të infektohen në mitër, gjatë lindjes ose pas lindjes. Transmetimi perinatal mund të parandalohet duke u kontrolluar për HBsAg gjatë çdo shtatzënie.
Qëllimi: Për të vlerësuar ndjekjen e të porsalindurit të një nëne me antigjen australian pozitiv (HBsAg+).
Materiale dhe metoda: U kryen kërkime në literaturën e 15 viteve të fundit në PubMed dhe Cochrane, si dhe rekomandime nga AAP, ACMG, ACOG dhe CDC. Bazat e të dhënave u kontrolluan duke përdorur titujt dhe fjalët kyçe përkatëse të temës. U përzgjodh vetëm literatura në gjuhën angleze. Praktika e ndjekur në SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë".
Rezultate: Infeksionet kronike mund të çojnë në cirrozë, kancer të heparit dhe vdekje të parakohshme. Zakonisht, të porsalindurit janë asimptomatikë, por 90% e tyre që janë të infektuar me HBV do të zhvillojnë infeksion kronik dhe 25% do të vdesin para kohe nga kanceri hepatik ose cirroza. 30 - 85% e foshnjave të nënave HBsAg - pozitive mund të infektohen me HBV nëse nuk aplikohet profilaksia. Kur HBV jepet brenda 24 orëve nga lindja, është 75% deri në 95% efektive në parandalimin e transmetimit perinatal të hepatitit B. Kur vaksina e hepatitit B (HBV) jepet brenda 24 orëve nga lindja, është 75% deri në 95% efektive në parandalimin e transmetimit perinatal të hepatitit B. Kur vaksina e hepatitit B (HBV) dhe imunoglobulina e hepatitit B (HBIG)

jepen brenda 12 orëve nga lindja, dhe seria e imunizimit ndaj hepatitit B të foshnjës përfundon e plotë, shkalla e infeksionit perinatal varion nga 0. 7% në 1. 1%.
Konkluzione: Të gjitha foshnjat e ekspozuara perinatalisht ndaj HBV duhet të menaxhohen nga programet perinatalë të parandalimit të hepatitit B (PHBPP). Foshnjat e lindura nga nëna HBsAg+ duhet të marrë HBIG dhe një dozë të vaksinës së hepatitit B me një antigjen të vetëm ≤12 orë para lindjes, e ndjekur nga një seri e plotë e vaksinës së hepatitit B.

Fjalë kyçe: Antigjeni Australian, virusi i hepatitit B, i porsalindur, vaksina, imunoglobulinë.

LEUKOENCEFALOPATI MULTIFOKALE PROGRESIVE NË NJË PACIENT ME HIV / AIDS.

Alma Sallahu, Esmeralda Meta, Najada Como, Arjan Harxhi, Pellumb Pipero, Pavllo Djamandi
Departamenti i Sëmundjeve Infektive, Fakulteti i Mjekësisë, QSUT

Abstrakt
Hyrje: Leukoencefalopatia multifokale progresive (PML) është një sëmundje e rrallë demielinizuese e sistemit nervor qendror, e shkaktuar nga virusi JC. Ajo shfaqet zakonisht tek pacientët me imunosupresion të thellë, si tek individët me HIV / AIDS në stad të avancuar, dhe vlerësohet se prek deri në 5% të pacientëve me AIDS. Ecuria shpesh është progresive dhe prognoza mbetet e rëndë pavarësisht trajtimit.
Materiali dhe metodat: Qëllimi i këtij materiali është përshkrimi i një rasti të pacientit me HIV / AIDS në stadin C3 të komplikuar me PML. Janë analizuar të dhënat klinike, laboratorike, imazherike dhe terapitë e aplikuara, duke u fokusuar në ecurinë klinike dhe përgjigjen ndaj trajtimit.
Rasti klinik: Pacienti, mashkull 31 vjeç, u paraqit fillimisht në pavionin e neurologjisë me vështirësi në të folur, çrregullim të ekuilibrit, dobësi trupore, erupsione papulare në lëkurë dhe humbje peshe. Në ekzaminimin neurologjik u evidentuan dizartri, nistagmus horizontal bilateral dhe ataksi trunkale / pedunkulare.
Ai u transferua më pas në pavionin e infektivit pas diagnostikimit me HIV / AIDS, stad C3. Analizat laboratorike treguan CD4+ 162 qeliza / mm³ (14%) dhe HIV RNA 2. 9 × 10⁴ kopje / ml. MRI e trurit evidentoi lezione me hipersinjal bilateral në pedunkujt cerebelarë dhe pons, tipike për PML. Pacienti kishte gjithashtu infeksione oportuniste, sindromë wasting, dermatit dhe kandidiazë orale.
Pas transferimit në pavionin e infektivit, pacienti u trajtua me terapi antiretrovirale (DTG / TDF / 3TC), antibiotikë, antifungikë dhe kortikosteroide, por pavarësisht trajtimit dhe hospitalizimeve të përsëritura, shfaqi përkeqësim progresiv neurologjik me humbje të funksioneve motorike, duke përfunduar me exitus letalis.
Konkluzioni: Ky rast nënvizon rëndësinë e diagnostikimit të hershëm të HIV dhe fillimit të menjëhershëm të trajtimit antiretroviral për të parandaluar komplikacionet neurologjike të rënda. Tek pacientët me imunosupresion të thellë dhe infeksione oportuniste, PML mund të ketë ecuri shumë të rënduar, duke theksuar nevojën për monitorim të vazhdueshëm dhe menaxhim multidisiplinar.

Fjalë kyçe: HIV / AIDS, PML, CD4, infeksione oportuniste.

RAPORTIM RASTI: DIAGNOZA DHE HEQJA BRONKOSKOPIKE E GURIT ENDOBRONKIAL NË NJË PACIENTE ME TUBERKULOZ ENDOBRONKIAL AKTIV.

Alma Teferici Dr, Ilir Peposhi Dr. Shk, Marsel Broqi Dr
Qendra Spitalore Rajonale e Tiranes, "Shefqet Ndroqi"
Sherbimi Radilogjise, Qendra Spitalore Rajonale e Tiranes, "Shefqet Ndroqi"

Abstrakt
Hyrje: Bronkolitiaza, e njohur si prania e materialit të kalcifikuar apo osifikuar endobronkial, perfaqëson një sekelë jo të shpeshtë, por klinikisht mjaft sinjifikante, të inflamacioneve kronike granulomatoze, kryesisht tuberkulare. Paraqitja klinike varion nga gjetja rastësore asimptomatike, tek infeksionet rekurente, pneumonitë post stenotike dhe hemoptizia. Shpesh, imazhi radiologjik i ngjashëm me atë të proceseve neoplazike me shtrirje endobronkiale, krijon paqartësi diagnostike, gjë që kërkon vlerësim të drejtpërdrejtë endoskopik.
Kemi paraqitur rastin e një pacienteje 65 vjece, hospitalizuar fillimisht nën dyshimin radiologjik për neoplazi pulmonare, tek e cila, nëpërmjet bronkoskopisë, u evidentua një mase ekzofite endobronkiale në pjesën distale

të bronkut primar sinister, me nekrozë tepër të shprehur e cila stenozonte plotësisht lobarin superior. Pacientes iu mor biopsi endobronkiale dhe pas debalkimit dhe heqjes së zonës nekrotike në hyrje të lingules vihet re fragment i kalcifikuar endobronkial i përputhshëm me bronkolitiazën. Biopsia dhe ekzaminimi imunohistokimik konfirmuan inflamacionin tuberkular si etiologjinë bazë. Pacientes i fillohet terapia me antibacilare më pas, heqja me bronkoskop flexible i gurit të kalcifikuar endobronkial.
Ky rast nënvizon vlerën e bronkoskopisë në diagnozën e tuberkulozit endobronkial dhe bronkolitiazës, në sajë të marrjes së materialit endobronkial për ekzaminim histologjik dhe menaxhimin e bronkolitiazës. Diagnostikimi i hershëm mund të parandalojë diagnozën e gabuar, komplikacionet, fillimin e terapisë adekuate. Heqja me bronkoskopinë flexible apo rigide e gurëve endobronkialë është procedurë efikase dhe e sigurtë. Kur kjo procedurë dështon trajtimi mëtejshëm mbetet kirurgjia.

Fjalë kyçe: tuberkuloz endobronkial aktiv, bronkolitiaza, bronkoskopia flexible, bronkoliths.

STEATOZA METABOLIKE HEPATIKE (NAFLD).

Dr. Shk. MD Altin Goxharaj[1], Maksim Logli[2]
[1]*Mjek laboratori, lektor panë deparamentit të Infermierisë, UGj "Eqrem Cabej"*
[2]*Mjek Imazherist*

Abstrakt
Hyrje; Steatoza hepatike jo - alkolike (NAFLD). Sëmundja Steatotike e Mëlçisë e lidhur me Disfunksionin Metabolik (më parë sëmundje e mëlçisë yndyrore joalkoolike), karakterizohet nga akumulimi i lartë i yndyrës në mëlçinë e individëve që konsumojnë pak ose aspak alkool.
NAFLD është një sëmundje shumë e përhapur e mëlçisë në mbarë botën dhe prek afërsisht 25 - 30% të popullsisë, me prevalencë më të madhe në vendet me shkallë të lartë të obezitetit, diabetit mellitus tip 2 dhe sindromës metabolike, ku është përbërësi i mëlçisë.
NAFLD përfshin akumulimin e yndyrës në hepatocite, por jo inflamacion.
Metodologjia: Pranë shërbimit tonë u paraqitën 50 raste nga të cilat meshkuj 37 raste (74%) dhe 13 femra (26 %) me moshë mesatare 48. 2 (28 - 68). U përcaktuan transaminanzat ALT, AST, GGT, ALP dhe u vlersuan me imazheri, ultrasound.
Konkluzione: - 86% e pacienteve kane rritje te ALT, AST, GGT
- 62% e tyre kane pozitivitet ne ultrasound (ECHO)

Fjalë kyce: NAFL, ultrasound, NAFLD.

SHKAQET DHE MENAXHIMI I KOMPLIKIMEVE TË FISTULAVE ARTERIOVENOZE PËR HEMODIALIZË.

Dr. Altin Jakupi

Abstrakt
Hyrje: Fistula arteriovenoze (FAV) autologe mbetet standardi i artë për qasjen vaskulare te pacientët me insuficiencë kronike të veshkave që trajtohen me hemodializë, për shkak të jetëgjatësisë më të madhe dhe rrezikut më të ulët për infeksione në krahasim me graftet apo kateterët. Megjithatë, përdorimi i FAV shoqërohet me një gamë komplikimesh që ndikojnë ndjeshëm në cilësinë e dializës dhe jetën e pacientit.
Qëllimi: Ky punim synon të ofrojë një rishikim gjithëpërfshirës të shkaqeve dhe menaxhimit të komplikimeve të FAV, duke përfshirë trombozën, stenozën, infeksionet, aneurizmat dhe sindromën e "vjedhjes", si dhe masat përkatëse parandaluese.
Metodologjia: Analiza është kryer nëpërmjet rishikimit të literaturës shkencore ndërkombëtare nga burime të besueshme si PubMed, Google Scholar, ScienceDirect, SpringerLink, si dhe udhëzimeve klinike të KDOQI dhe NKF. Gjithashtu është bërë shqyrtim i praktikave në vend, rajon dhe më gjerë.
Rezultate: Rezultatet tregojnë se planifikimi i hershëm, monitorimi i vazhdueshëm, zbatimi i protokolleve të standardizuara, rritja e bashkëpunimit ndërdisiplinor, investimi në teknologji dhe trajnime, si dhe edukimi i pacientëve, janë elemente kyçe në parandalimin e komplikimeve.

Perfundime: Punimi përfundon me rekomandime praktike për përmirësimin e menaxhimit të FAV dhe përputhjen me standardet bashkëkohore të kujdesit në dializë.

Fjalë kyçe: fistula arteriovenoze; hemodializë; qasje vaskulare; shkaqet; komplikime vaskulare; edukim; menaxhim klinik.

KANULIMI I ARTERISË SUBCLAVIANE PËRKUNDREJT ARTERIES INOMINATE SI AKSES PËR BYPASS - IN KARDIOPULMONAR NË RIPARIMIN E DISEKACIONIT AKUT TË AORTËS TË TIPIT A.

Altin Veshti

Abstrakt

Hyrje: Disekacioni akut i aortës të tipit A (DAATA) paraqet një urgjencë kardio - kirurgjikale me rrezik të lartë për jetë. Vendimi për zgjedhjen optimale të aksesit për kanulim gjatë bypass - it kardiopulmonar (CPB) është kyç për suksesin e ndërhyrjes kirurgjikale. Kanulimi i arterisë subklaviane së majtë dhe ai i arteries inominate janë dy nga opsionet më të përdorura, secila me avantazhet dhe kufizimet e veta.

Objektivi: Krahasimi i sigurisë, efikasitetit hemodinamik dhe rezultateve klinike midis kanulimit të arterisë subklaviane përkundrejt arteries inominate si akses për CPB në pacientët me DAATA gjatë ndërhyrjes kirurgjikale emergjente.

Materiale dhe metoda: Është kryer një analizë retrospektive e pacientëve të operuar për disekacion akut të aortës të tipit A në periudhën 2020–2024. Pacientët janë ndarë në dy grupe sipas llojit të kanulimit arterial: grupi i kanulimit subklavian (KS) dhe grupi i kanulimit inominate (KI). Janë krahasuar parametrat intraoperativë, kohëzgjatja e CPB, kohëzgjatja e arrestimit cirkulator, incidenca e komplikacioneve neurologjike, si dhe mortaliteti post - operativ.

Rezultate: Kanulimi i arterisë subklaviane rezultoi në perfuzion më të qëndrueshëm cerebrale, reduktim të rrezikut për embolizëm retrograd dhe incidencë më të ulët të komplikacioneve neurologjike (7. 5% KS vs 13. 2% KI, $p < 0.05$). Ndërsa kanulimi i arteries inominate u shoqërua me kohë më të shkurtër të instalimit të CPB dhe ishte teknikisht më i lehtë në disa raste të emergjencës së avancuar. Nuk u vu re diferencë statistikisht domethënëse në mortalitetin intra - hospitalor midis dy grupeve.

Konkluzione: Kanulimi i arterisë subklaviane ofron përparësi të rëndësishme në mbrojtjen cerebrale dhe uljen e komplikacioneve neurologjike në pacientët me disekacion akut të aortës të tipit A. Megjithatë, zgjedhja e aksesit duhet të individualizohet në bazë të anatomisë pacientit dhe urgjencës kirurgjikale. Nevojiten studime prospektive me kampione më të mëdha për të standardizuar protokollet e kanulimit në këtë grup pacientësh kritikë.

Fjalë kyçe: Disekacion i aortës tipi A, kanulim subklavian, arteria inominate, bypass kardiopulmonar, perfuzion cerebral, kirurgjia aortike emergjente.

TRAJTIMI KIRURGJIKAL MINI - INVAZIV I DEFEKTEVE TË LINDURA TË ZEMRËS.

Altin Veshti, Anxhela Laze.

Abstrakt

Defektet kongjenitale të zemrës përbëjnë grupin më të shpeshtë të malformacioneve kardiake tek njeriu dhe përfshijnë anomali strukturore si defekti septal atrial (ASD), defekti septal ventrikular (VSD), tetralogjia e Fallot - it, duktusi arterioz patent (DAP) dhe transpozicioni i enëve të mëdha (TGA). Trajtimi kirurgjikal mbetet mënyra kryesore e korrigjimit të tyre, ndërsa në vitet e fundit është vënë në fokus përdorimi i teknikave mini - invazive, të cilat ofrojnë rezultate të ngjashme hemodinamike me kirurgjinë tradicionale, por me trauma të reduktuar dhe përfitime estetike e psikologjike më të mëdha. Ky studim retrospektiv, i zhvilluar në QSUT gjatë periudhës mars 2019 – maj 2025, përfshiu 56 pacientë me ASD (tipi ostium secundum), të cilët u trajtuan përmes mini - torakotomisë anteriore të djathtë (n=40) dhe sternotomisë mediane (n=16). U analizuan parametrat klinikë, kohëzgjatja e klampimit aortik, ditët e qëndrimit spitalor, komplikacionet post - operatore dhe kënaqësia estetike e pacientëve. Rezultatet treguan se mini - torakotomia ofronte rikuperim më të shpejtë (6 ± 1 ditë),

komplikacione më të pakta dhe kënaqësi estetike dhe psikologjike më të lartë, ndërsa koha e klampimit aortik ishte e krahasueshme me atë të sternotomisë (p>0. 05). Sternotomia lidhej me incidencë më të lartë infeksionesh, instabilitet skeletik dhe pakënaqësi estetike (87. 5%). Në përfundim, kirurgjia mini - invazive për trajtimin e defekteve kongjenitale si ASD përfaqëson një alternativë moderne, të sigurt dhe efektive, duke siguruar rezultate të shkëlqyera klinike, rikuperim të përshpejtuar dhe përfitime të rëndësishme psikologjike dhe estetike për pacientët.

Fjalë kyçe: sternotomia, klampim, ASD, defekte kongjenitale, tetralogji Fallot.

EKZAMINIMI FIZIK PARA EKOGRAFISË: E NEVOJSHME APO NJË RELIKE E SË KALUARËS?

Altina Xhaferi, Enida Xhaferi
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë

Abstrakt
Qëllimi: Të hetohet se sa shpesh mjekët kryejnë ekzaminimin fizik para se të referojnë pacientët për ekografi diagnostikuese, dhe nëse mosrealizimi i tij ndikon në cilësinë e arsyetimit klinik ose rendimentin diagnostik.
Metoda: Në këtë studim prospektiv, pacientët që i nënshtrohen ekografisë diagnostikuese në një qendër të kujdesit shëndetësor (dhjetor 2024 - prill 2025) dhe u pyetën nëse mjeku i tyre referues kishte kryer një ekzaminim fizik. U mbajtën të dhëna për demografinë e pacientit, specialitetin referues, profesionistin e kujdesit shëndetësor, indikacionin e ekografisë dhe rajonin anatomik. Cilësia e arsyetimit klinik (0–100%) u përcaktua si përputhja midis gjetjeve klinikisht të dyshuara dhe ekografisë. Rezultatet e ekografisë u klasifikuan si pozitive, negative ose të papërcaktuara.
U përdor regrasioni shumëvariabël për të analizuar lidhjet me mosrealizimin e ekzaminimit fizik.
Rezultate: U përfshinë 302 pacientë (mosha mesatare: 56 vjeç; 48% meshkuj). Ekzaminimi fizik u la jashtë në 168 raste (55. 6%). Lëshimi ishte më pak i mundshëm në referimet nga specialitetet kirurgjikale (raporti i probabilitetit (OR) prej 0. 490, P = 0. 032), mjekësia familjare (OR prej 0. 253, P = 0. 016) dhe specialistët (OR 0. 303, P < 0. 001), si dhe në rastet e ankesave të reja (OR prej 0. 226, P < 0. 001) dhe ekografia e kokës dhe qafës (OR prej 0. 261, P < 0. 001). Anashkalimi i vizitës ishte i lidhur pak me rezultate më të ulëta të arsyetimit klinik në analizën univariate (P = 0. 050), por jo pas përshtatjes. Nga të gjitha ekzaminimet, 51% ishin pozitive. Mungesa e ekzaminimit fizik tregoi një tendencë drejt një rendimenti më të ulët diagnostikues (P = 0. 059), por nuk ishte i rëndësishëm.
Përfundime: Ekzaminimi fizik fillimisht lidhej me arsyetim klinik dhe rendiment diagnostikues të reduktuar. Megjithatë, deri më sot, asnjë studim nuk ka hetuar ndikimin e moskryerjes së ekzaminimit fizik para imazherisë diagnostike në rezultatet e imazherisë.

Fjalë kyçe: ekzaminim fizik, ekografi, pacientë etj.

GJENET NËN PRESION: NJË SHQYRTIM I HIPERTENSIONIT HEREDITAR.

Imeraj A. , Strakosha A. , Metasana A. , Myrta E

Abstrakt
Hyrje: Format hereditare të hipertensionit përbëjnë një grup interesant dhe me rëndësi klinike, ku mutacionet në një gjen të vetëm shkaktojnë çrregullime në rregullimin e presionit të gjakut. Ndryshe nga hipertensioni esencial multifaktorial dhe i zakonshëm, këto kushte monogjenike shfaqen shpesh në moshë të re dhe manifestohen me modele biokimike dhe klinike të veçanta. Megjithëse të rralla, njohja e tyre është thelbësore, pasi shumë prej tyre janë shumë të trajtueshme kur identifikohet mekanizmi themelor. Përparimet në testimin gjenetik kanë përshpejtuar dhe përmirësuar saktësinë e diagnostikimit, duke hapur rrugën për menaxhim të personalizuar. Nga format më të njohura trashëgimore është sindroma Liddle, e shkaktuar nga mutacione që aktivizojnë në mënyrë të përhershme kanalet epiteliale të natriumit, duke çuar në mbajtje të natriumit, zgjerim volumetrik dhe hipertension me nivel të ulët të reninës dhe aldosteronit. Në mënyrë të ngjashme, "teprica e dukshme e mineralokortikoideve" (apparent mineralocorticoid excess) shkaktohet nga një defekt në gjenin HSD11B2, që parandalon inaktivizimin normal të kortizolit, duke i lejuar atij të stimulojë receptorët mineralokortikoidë dhe të imitojë efektin e tepruar

të aldosteronit. Një grup tjetër i rëndësishëm përfshin sindromat familjare të hiperaldosteronizmit (tipet I–IV). Në këto çrregullime, mutacionet gjenetike shkaktojnë prodhim autonom të aldosteronit; tipi I, i njohur si hiperaldosteronizmi i remediueshëm me glukokortikoide, përgjigjet ndaj dozave të vogla të kortikosteroideve që frenojnë sintezën e aldosteronit të nxitur nga ACTH. Pseudohipoaldosteronizmi tipi 2, i njohur edhe si sindroma Gordon, karakterizohet nga mutacione në WNK1, WNK4, KLHL3 ose CUL3. Pacientët shfaqin hipertension, hiperkalemi dhe acidozë metabolike, të cilat përgjigjen në mënyrë dramatike ndaj diuretikëve tiazidikë. Përtej këtyre formave klasike të hipertensionit renal - tubular, disa sindroma gjenetike multisistemike mund të shkaktojnë gjithashtu hipertension sekondar. Neurofibromatoza e tipit 1, për shkak të mutacioneve në NF1, mund të shkaktojë stenozë të arteries renale ose anomali të tjera vaskulare, ndërsa Sindroma Williams, e lidhur me delecione në gjenin ELN, çon në arteriopati nga mungesa e elastinës dhe stenozë supravalvulare të aortës.

Përfundime: Edhe pse në mënyrë individuale janë të rralla, format trashëgimore të hipertensionit kanë rëndësi të madhe klinike, pasi ato tregojnë qartë sesi defektet molekulare përkthehen në strategji specifike terapeutike. Njohja e këtyre modeleve mundëson ndërhyrje të personalizuarasi përdorimi i amiloridit në sindromën Liddle, tiazideve në sindromën Gordon, apo glukokortikoideve në hiperaldosteronizmin familjar duke ndihmuar në parandalimin e dëmtimeve afatgjata kardiovaskulare dhe renale. Në këtë mënyrë, skriningu gjenetik dhe diagnostikimi i hershëm luajnë një rol kyç në mjekësinë precize moderne për trajtimin e hipertensionit.

Fjalë kyçe: Hipertensioni trashëgues, sindroma Liddle, hiperaldosteronizmi familjar, mutacione gjenetike, mjekësia precize, diagnostikim gjenetik.

IMIQUIMOD, NJË MODULATOR TOPICAL I PËRGJIGJES IMMUNE NË SËMUNDJE DERMATOLOGJIKE.

Amarda Cenko[1], Ermira Vasili[2], Fabian Cenko[3], Entela Shkodrani[2], Rea Cenko[3]
[1]*Departament of Dermatology, Catholic Hospital Our Lady of Good Counsel, Tirana, Albania*
[2]*Departament of Dermatology, "Mother Teresa" Univerisity Hospital Center, Tirana, Albania*
[3]*Departament Medical Sciences, Catholic University Our Lady of Good Counsel, Tirana, Albania*
[4]*Catholic University, Our Lady of Good Counsel Tirana, Albania*

Abstrakt

Hyrje: Imiquimodi është një agjent imunomodulator topikal që i përket klasës së imidazokinolinave. Ai përdoret gjerësisht në dermatologji për trajtimin e disa gjendjeve të lëkurës me origjinë virale, prekanceroze dhe neoplazike sipërfaqësore.

Qëllime: Të përmblidhet mekanizmi i veprimit, indikacionet, siguria e perdorimit dhe roli terapeutik i imiquimodit në trajtimin e keratozave aktinike, karcinomës bazocelulare sipërfaqësore, kondilomave akuminate dhe disa përdorimeve të tjera jashtë protokolleve në dermatologji.

Metoda: U krye një rishikim i literaturës së fundit lidhur me farmakodinamikën e imiquimodit, studimet klinike dhe ato vëzhguese në fushën e dermatologjisë, me fokus në dozën, frekuencën, kohëzgjatjen e trajtimit, efektet anësore dhe kriteret për përzgjedhjen e pacientëve.

Rezultate: Imiquimodi aktivizon receptorin Toll - like 7 (TLR7) në qelizat dendritike, monocitet dhe makrofagët e lëkurës, duke stimuluar prodhimin e citokinave proinflamatore (IFN - α, IL - 12, TNF - α) dhe një përgjigje qelizore të ndërmjetësuar nga limfocitet Th1. Indikacionet e miratuara ne semundje dermatologjike përfshijnë keratozat aktinike, karcinomën bazocelulare sipërfaqësore dhe verrucat anogjenitale (kondilomat akuminate). Përdorimi jashtë protokollit ka treguar efektivitet në molluscum contagiosum, verruca vulgaris rezistente, lentigo maligna dhe sëmundjen e Bowen (karcinoma skuamoze in situ). Reaksioni inflamator lokal (eritemë, djegie, edemë) është i shpeshtë dhe zakonisht lidhet me efektivitetin terapeutik, ndërsa efektet sistemike janë të rralla. Imiquimodi nuk duhet të aplikohet mbi lëkurë të ulceruar ose të dëmtuar, dhe duhet të përdoret me kujdes tek pacientët me sëmundje autoimune ose nën terapi imunosupresive.

Përfundime: Imiquimodi përfaqëson një alternativë terapeutike jo - invazive, të ndërmjetësuar nga sistemi imunitar, për trajtimin e një game të gjerë dermatozash, veçanërisht në rastet kur kërkohen qasje më pak invasive ose kirurgjikale. Reagimi inflamator që ai shkakton është pjesë thelbësore e mekanizmit të tij terapeutik, dhe jo thjesht një efekt anësor.

Fjalë kyçe: Vitamina D, Ekspozimi ndaj rrezeve të diellit, pamjaftueshmëri.

HPV - JA DHE PARANDALIMI I HPV - SË TEK MESHKUJT.

Gica Amarda[1], Nelaj Ergita[2], Cabiri Zamira[1], Mehilli Brunilda[1]
[1]*Universiteti i Elbasanit, Elbasan.*
[2]*Universiteti i Mjekësisë, Tirana.*

Abstrakt
Në vitet e fundit, komuniteti shëndetësor ka njohur ndikimin e rëndësishëm që HPV mund të ketë në shëndetin e meshkujve. Studimet kanë zbuluar se ky virus mund të shkaktojë tumore malinje të traktit anogenital dhe të sipërm aero - digjestiv, si dhe lezionet e tyre pararendëse tek meshkujt. Gjatë pesë dekadave të fundit, barra e kancerit të lidhur me HPV është zhvendosur dhe meshkujt tani preken po aq sa femrat, duke përbërë një pjesë të konsiderueshme të rasteve të reja të kancerit.
Ky rishikim përqendrohet në HPV dhe kancerin e lidhur me HPV - nw tek meshkujt, konkretisht kancerin anal, penil dhe të kokës dhe qafës, së bashku me strategjitë e parandalimit dhe vaksinimit. Ka ende shumë për të mësuar rreth infeksionit HPV tek meshkujt, veçanërisht në lidhje me kohëzgjatjen dhe transmetimin e tij. Prevalenca e infeksionit HPV ndryshon ndjeshëm midis grupeve të popullsisë dhe rajoneve gjeografike. Meshkujt veprojnë si bartës të virusit dhe vektorë dhe ky është një komponent i rëndësishëm i zinxhirit epidemiologjik për HPV.
Parandalimi dhe trajtimi i gjendjeve të lidhura me HPV - në mbeten fusha thelbësore të kërkimit mjekësor, pasi aktualisht nuk ka trajtime të standardizuara në dispozicion. Janë rekomanduar disa veprime parandaluese për të ulur rrezikun e kontraktimit të sëmundjes, të tilla si përdorimi i prezervativëve, ulja e numrit të partnerëve seksualë dhe ndërprerja e pirjes së duhanit. Diagnostikimi i hershëm i kancereve të lidhura me HPV - në tek burrat është gjithashtu një sfidë e rëndësishme. Parandalimi dhe trajtimi i HPV - së tek burrat duhet të studiohet më plotësisht në kërkimet e ardhshme.

Fjalë kyçe: HPV, kanceri i lidhur me HPV, meshkujt.

PËRMBLEDHJE E PROCESIT TË MBLEDHJES SË TË DHËNAVE FILLESTARE PËR ZHVILLIMIN E REGJISTRIT KOMBËTAR PËR RETINOPATINË E PREMATURITETIT.

Amarilda Hysenshahaj[3], Vilma Mema[1], Spiro Damo[1], Alketa Tandili[1] [2], Eglantina Bulica[1]
[1]*Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"*
[2]*Universiteti i Mjekësisë, Shqipëri, Tiranë*
[3]*Instituti i Shëndetit Publik*

Abstrakt
Hyrje: Në Shqipëri, përparimet në kujdesin neonatal kanë përmirësuar ndjeshëm mbijetesën e foshnjave të lindura para kohe, por kjo është shoqëruar me një rrezik të shtuar për retinopatinë e prematuritetit (ROP), një nga shkaqet kryesore të verbërisë në fëmijëri që mund të parandalohet. Të dhënat e kufizuara në nivel kombëtar theksojnë nevojën për një regjistër gjithëpërfshirës që mbështet monitorimin sistematik, diagnozën e hershme dhe parandalimin e dëmtimit të shikimit.
Qëllimi: Të përshkruhet procesi i mbledhjes së të dhënave fillestare për krijimin e Regjistrit Kombëtar të Retinopatisë së Prematuritetit (ROP) në Shqipëri.
Materiale dhe metoda: U zhvillua një bazë të dhënash dixhitale për rastet e reja të identifikuara me ROP, duke përdorur një formular raportimi individual të plotësuar për çdo rast të zbuluar në maternitetet dhe repartet neonatale. Formulari përmban të dhëna demografike dhe klinike për foshnjat e lindura para kohe me peshë nën 1500 g dhe të lindura para javës së 32 - të të shtatzënisë, si dhe rezultatet e ekzaminimeve të regjistruara në diagrame të standardizuara. Të dhënat digjitalizohen përmes platformës **NexusHealth,** duke mundësuar regjistrimin në kohë reale, ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme dhe kategorizimin e rrezikut për çdo foshnjë. Ky sistem lejon monitorim të vazhdueshëm të gjendjes shëndetësore të foshnjave dhe lehtëson kujdesin e koordinuar mes shërbimeve neonatale dhe atyre të oftalmologjisë.
Rezultatet: Gjatë vitit të parë të skriningut, u ekzaminuan 135 foshnja të lindura para kohe (mosha mesatare gestacionale 29 javë) dhe 46% e tyre u diagnostikuan me ROP. Këto të dhëna tregojnë një ngarkesë të konsiderueshme të sëmundjes dhe nënvizojnë rëndësinë e monitorimit sistematik dhe trajtimit në kohë.
Përfundime: Krijimi i një Regjistri Kombëtar për ROP është një hap kyç drejt forcimit të mbikëqyrjes së shëndetit të syrit neonatal në Shqipëri. Ai mundëson mbledhje të standardizuar të të dhënave, mbështet

ndërhyrjen e hershme dhe ofron një bazë provash për politika që synojnë reduktimin e verbërisë së parandalueshme në fëmijëri.

Fjalë kyçe: regjistri kombëtar, ROP, prematuritet etj.

KOMPLIKACIONET KARDIOVASKULARE TË DIABETIT NË KORRELACION ME HEMOGLOBINËN E GLUKOZUAR: NJË RISHIKIM SISTEMATIK I LITERATURËS SHKENCORE.

MD Ambra Kanani[1], PhD. Eva Duraku[2], MD Fjola Kore, MD Desara Kanani
[1]*QSSH Levan Fier*
[2]*Kardiologe Spitali Katolik "Zoja e Keshillit të Mirë"*

Abstrakt
Hyrje: Diabeti Mellitus i Tipit 2 (T2DM) përfaqëson një faktor madhor rreziku për sëmundjet kardiovaskulare (CVD). Emoglobina e glukozuar (HbA1c) është një tregues i rëndësishëm i kontrollit glicemik afatgjatë dhe lidhet ngushtë me komplikacionet makro dhe mikrovasculare.
Qëllimi: Kjo punë synon të përcaktojë lidhjen ndërmjet niveleve tè ndryshme të HbA1c dhe rrezikut të komplikacioneve kardiovaskulare, mortalitetit për çdo shkak dhe iktusit, si tek pacientët me diabet, ashtu edhe tek popullata jo diabetike.
Metodologjia: U realizua një rishikim sistematik i literaturës përfshirë studime kohortë, prospektive, retrospektive dhe të rast - kontrollit, me një periudhë ndjekjeje ≥3 vjet. Totali i pacientëve të analizuar ishte rreth 251. 798, nga të cilët 174. 360 me diabet dhe 77. 438 pa diabet.
Rezultate: Tek pacientët me T2DM, shumica e studimeve treguan një lidhje në formë "U" midis HbA1c dhe vdekshmërisë kardiovaskulare, ku nivelet shumë të ulëta ose shumë të larta ishin të lidhura me rrezik më të lartë, ndërsa nivelet mesatare (rreth 7%) shoqëroheshin me rezultate më të favorshme. Në popullatën jo diabetike, edhe rritje të lehta të HbA1c (5–6. 4%) u lidhën me një rrezik të shtuar për CVD dhe mortalitet.
Përfundime: Mbajtja e HbA1c në intervale të moderuara (rreth 7%) ul rrezikun e komplikacioneve kardiovaskulare, duke shmangur rreziqet e hipoglicemisë dhe hiperglicemisë. Monitorimi i kujdesshëm i HbA1c, përfshirë edhe tek individët me prediabet, është thelbësor për parandalimin e komplikacioneve kardiovaskulare. Personalizimi i objektivave terapeutike dhe kontrolli paralel i faktorëve të tjerë të rrezikut kardiovaskular përfaqëson strategjinë më efikase për përmirësimin e prognozës.

Fjalë kyçe: Komplikacione kardiovaskulare, diabet, HbA1c.

SËMUNDJA ME NDRYSHIME MINIMALE DHE SINDROMA METABOLIKE: SFIDAT E TRAJTIMIT.

Ambra Metasana

Abstrakt
Hyrje: Minimal Change Disease (MCD) është një çrregullim glomerular i karakterizuar nga dëmtimi i podociteve që çon në proteinuri selektive, zakonisht pa ndryshime të dukshme nën mikroskopinë e dritës. Tek të rriturit, MCD mund të bashkëshoqërohet me sindromën metabolike që përfshin obezitetin, rezistencën ndaj insulinës, dislipideminë, steatozën hepatike dhe rritjen e enzimave hepatike duke e komplikuar diagnostikimin dhe trajtimin. Qasja terapeutike kërkon një ekuilibër të kujdesshëm që synon remisionin e plotë renal, duke minimizuar përkeqësimin / impaktin metabolik.
Paraqitja e rastit: Një mashkull 23 - vjeçar u paraqit me proteinuri me vlera nefrotike (4. 3–5. 5 g / 24 h), sëmundje renale kronike stad i 3 - të, hipertension, dislipidemi, hiperuricemi, steatozë hepatike dhe rritje të enzimave hepatike. Historia e jetës evidentoi konsum të tepruar të pijeve të ëmbla dhe dietë të varfër. Biopsia fillestare sugjeroi glomerulonefrit mezangiokapilar, por rivlerësimi konfirmoi MCD në mungesë të depozitave imune. Menaxhimi përfshiu kortikosteroide në dozë të reduktuar (metilprednizolon 0, 5 mg / kg / ditë) të kombinuara me rituksimab (1 g në ditët 1 dhe 14), si dhe frenues të SGLT2 dhe inhibitorë të ACE - së (ACEi) për mbrojtje renale, fenofibrat për dislipideminë dhe modifikim intensiv të stilit të jetesës. Brenda dy muajsh,

proteinuria u ul në 2. 7 g / 24 h, pesha trupore u reduktua me 9 kg dhe parametrat metabolikë u përmirësuan pjesërisht, ndërsa vlera e eGFR mbeti e qëndrueshme.
Përfundime: Ky rast nënvizon sfidat diagnostike të MCD në kontekstin e sindromës metabolike dhe rëndësinë e një qasjeje multidisiplinare. Rituksimabi mundësoi përdorimin e kortikosteroideve në dozë të reduktuar, duke arritur një remision të pjesshëm, ndërsa frenues të SGLT2 / inhibitorë të ACE - së (ACEi) siguruan efekte renoprotektive dhe fenofibrati adresoi komponentët metabolikë. Dozimi shtesë i rituksimabit mbetet i diskutueshëm; evidenca aktuale favorizon ripërsëritjen e trajtimit në rast relapsi ose persistencë të sëmundjes. Rezultatet afatgjata varen nga modifikimi agresiv i riskut metabolik përmes terapisë farmakologjike, ndërhyrjeve në stilin e jetesës dhe bashkëpunimit të koordinuar nefrologji–hepatologji.

Fjalë kyçe: Minimal Change Disease, çrregullim glomerular, sindromë metabolike, SGLT2.

TENOSINOVITI I DORËS: SHKAQET DHE KOMPLIKACIONET.

Anastasio Kolaci, Artur Zoto, Ervin Rapushi, Teuta Backa, Stela Janko, Florid Zenelaj, Silda Caushaj
Shërbimi Reumatologjisë, QSUNT

Abstrakt
Hyrje: Tenosinoviti përfaqëson një gjendje klinike të zakonshme të karakterizuar nga inflamacion i sinoviumit që mbështjell mbështjellësin e tendinit. Edhe pse tenosinovitet mund të vërehen në çdo tendin në trup, ekstremitete të tilla si dora dhe këmba mbeten vendet me prirje të lartë për këtë gjendje. Shkaku mbizotërues i kësaj prirjeje qëndron në organizimin e ndërlikuara të tendinit në këto ekstremitete që lejojnë veprime motorike fine. Ky prezantim shqyrton shkaqet e zakonshme dhe ndërlikimet që lidhen me këtë gjendje që haset në praktikën tonë të përditshme klinike. Tenosinoviti i dorës mund të jetë për shkak të arsyeve infektive ose jo - infektive, të tilla si arsye idiopatike, të mbipërdorimit dhe autoimune. Edhe pse tenosinoviti infektiv zakonisht është për shkak të lëndimeve traumatike, ekzistojnë arsye sistemike. Në mënyrë të ngjashme, midis shkaqeve jo - infektive, përveç shkaqeve autoimune dhe të mbipërdorimit, tenosinoviti idiopatik gjithashtu kontribuon në etiologjinë e tij. Komplikimet e zakonshme që hasen me këtë gjendje varen nga shkaku, ku tenosinoviti infektiv mund të rezultojë në ngurtësi, anhesion, deformim dhe përhapje të mëtejshme të infeksionit në strukturat më të thella, dhe tenosinoviti jo - infektiv rezulton në tenosinovit stenozues që paraqitet me kontraktura, të cilat kërkojnë trajtim kirurgjikal.

Fjalë kyçe: tenosinovit, shkaqe, komplikacione etj.

NJË RAST PEDIATRIK ME CHOLESTEATOMA SEKONDARE / KOMPLIKIM OTITIT KRONIK SUPURATIV.

And Elshani[1], Xhevdet Latifi[2]
[1]*Departamenti i Mjekësisë së Përgjithshme, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, Kosovë*
[2]*Specialist në Departamentin e Otorinolaringologjisë, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, Kosovë*

Abstrakt
Hyrje: Kolesteatoma pediatrike është një rritje beninje e epitelit që zgjerohet dhe shkatërron strukturat kockore (ossikuj, mastoid). Te fëmijët, ajo shpesh shfaqet në formë kongenitale, agresive dhe me rrezik të lartë për rezidual ose recidivë. Stadimi (si ai i Potsic) ndihmon në përcaktimin e qasjes kirurgjikale dhe parashikimin e rreziqeve. Ndjekja me MRI DWI për ≥5 vjet pas operacionit është rekomanduar për detektimin e rezidualit dhe recidivës.
Qëllimi: Të raportojmë një rast pediatrik me cholesteatoma sekondare / komplikim otitit kronik supurativ, të operuar me qasje retroaurikulare plus mastoidektomi dhe timpanoplastikë tip III, duke fokusuar në strategji kirurgjikale, rezultat audiologjik dhe plan ndjekjeje të gjatë.
Metodologjia: Pacienti: E. Sh. , djalë, lindur më 29. 06. 2020, rezident në Shtime. Historia e paraqitjes: Pranimi në spital më 22. 08. 2025 për otit media chronica suppurativa poliposa me cholesteatoma lateral sinistra.
Intervenimi kirurgjik:

- Qasje retroaurikulare – qasje mastoidale. U sekuestruan polipe dhe kolesteatoma nga anulus postero-superior dhe atik.
- Zinxhiri ossikular ishte i dëmtuar: incusi dhe pjesë e malleusit janë hequr; stapesi ruajtur dhe funksional.
- U krye antrotomi dhe mastoidectomi – të mbushura me kolesteatoma – me marrje materiale për histopatologji.
- Rekonstruksion i atikut dhe defektit me fascie dhe kërc; vendosje grafti.
- Llapa e lëkurës mbyllur dhe tamponuar; pacienti ekstubohet pa ndërlikime.

Postop: Fashimi, pastrim plage çdo dy ditë; terapia me NaCl, Ceftriaxon, Vitamina C, Voltaren; pushim mjekësor 3 javor.
Analizat laboratorike: Urea, kreatininë, CRP, glikemi, koagulim – normale; trombocitet, limfocitet, monocitet – të ngritura; hematokriti normal; neutrofilet të ulta; pjesë tjetër normale.
Diskutim: Rasti reprezenton tipin e stadit të avancuar (sipas Potsic III) për shkak të përhapjes në mastoid dhe dëmtimit ossikular—i tillë kërkon qasje me mastoidektomi në vend që një qasje minimalisht invazive. Literatura tregon se rreziku i rezidualit dhe recidivitetit janë më të lartë te rastet me stad të avancuar dhe për këtë arsye kërkohet resekcion i plotë. Ndjekja me MRI DWI për ≥5 vjet pas operacionit është e domosdoshme për të kapur rezidivat e fshehtë dhe recidiva të vonë. Zgjedhja e tympanoplastikës tip III për të rikuperuar zinxhirin ossikular është standarde dhe u mundëson mirëmbajtje funksionale në të ardhmen.
Përfundime: Rasti i E. Sh. demonstron se, në kolesteatomë pediatrike me përhapje dhe dëmtime ossikulare, një qasje retroaurikulare me mastoidectomi dhe tympanoplastikë tip III është e justifikueshme. Ndjekja e kujdesshme me MRI DWI për një periudhë prej të paktën 5 vjetësh është esenciale për të minimizuar rezikun e rezidualit dhe recidivës. Stadimi i saktë dhe planifikimi individual kirurgjikal janë kyç në përmirësimin e rezultateve.

Fjalë kyçe: Kolesteatoma pediatrike, otit media kronik supurativ, mastoidektomi, tympanoplastikë tip III, ossikuj, mastoid, MRI DWI

ÇRREGULLIMI I METABOLIZMIT TË LIPIDEVE TE DIABETI MELLITUS TIP 2.

Anda Macula

Abstrakt
Hyrje: Diabeti mellitus tip 2 (DMT2) është një çrregullim kompleks metabolik që ndikon jo vetëm në metabolizmin e glukozës, por edhe në metabolizmin e lipideve. Rezistenca ndaj insulinës në indin dhjamor dhe në mëlçi shkakton ndryshime të rëndësishme në sintezën, transportin dhe degradimin e lipideve, duke çuar në zhvillimin e dislipidemisë diabetike – një faktor kryesor rreziku për sëmundjet kardiovaskulare.
Qëllimi: Të vlerësohet lidhja ndërmjet diabetit mellitus tip 2 dhe çrregullimeve të metabolizmit të lipideve, si dhe rëndësia klinike e diagnostikimit dhe menaxhimit të hershëm të këtyre ndryshimeve metabolike.
Materiale dhe metoda: U shqyrtuan të dhënat nga literatura bashkëkohore ndërkombëtare (artikuj shkencorë, meta - analiza dhe udhëzime klinike të ADA dhe ESC për periudhën 2019–2023), me fokus në ndryshimet e profilit lipidik, mekanizmat patofiziologjikë dhe qasjet terapeutike në pacientët me DMT2.
Rezultate: Pacientët me diabet tip 2 shfaqin shpesh hipertrigliceridemi, ulje të HDL - kolesterolit dhe rritje të fraksionit të vogël dhe të dendur të LDL - kolesterolit. Këto ndryshime burojnë nga rritja e lipolizës dhe prodhimi i shtuar hepatik i lipoproteinave me densitet shumë të ulët (VLDL), si pasojë e veprimit të reduktuar të insulinës. Ndërhyrjet e kombinuara – kontrolli glikemik, aktiviteti fizik, modifikimi i dietës dhe përdorimi i barnave hipolipemike (si statinat dhe fibratet) – kanë treguar përmirësim të ndjeshëm të profilit lipidik dhe ulje të rrezikut kardiovaskular.
Përfundime: Dislipidemia diabetike është një komponent thelbësor i diabetit mellitus tip 2 dhe ndikon drejtpërdrejt në prognozën afatgjatë të pacientëve. Njohja e hershme dhe trajtimi i synuar i çrregullimeve të metabolizmit të lipideve përbëjnë një hap kyç për parandalimin e komplikimeve aterosklerotike dhe përmirësimin e cilësisë së jetës te pacientët me DMT2.

Fjalë kyçe: Diabeti mellitus tip 2, dislipidemi, metabolizëm lipidik, insulinë, rrezik kardiovaskular.

SINDROMA NEFROTIKE KORTIKO - REZISTENTE.
Anda Sylqa

Abstrakt
Sindroma nefrotike është një çrregullim i veshkave në njësitë glomerulare, që mund të shkaktohet nga sëmundje të shumta renale apo ekstrarenale dhe që mund të prekë të gjitha moshat, duke përfshirë moshat e reja. Sindroma nefrotike karakterizohet nga një pasqyrë klinike me simptoma të veçanta, ku numërohen: edema apo ënjtja, proteinuria apo niveli i rritur i proteinave që eliminohen nga trupi përmes urinës, hipoalbuminemia apo niveli i ulur i albuminave në gjak si dhe hiperlipidemia apo rritja e lipideve, e sidomos kolesterolit, në gjak. Duke u bazuar në udhërrëfyesit më të ri të sëmundjeve dhe çrregullimeve të veshkave, pacientët që përdorin terapi për sindromë nefrotike mund të klasifikohet në disa grupe, ku i përmendim: pacientët me sindromë nefrotike që përjetojnë remision apo shërim të plotë, ata me sindromë nefrotike me përgjigjje apo rezistencë fillestare ndaj trajtimit (SSNS apo SRNS), ata me relapse apo përsëritje të shpeshta të simptomave të sindromës nefrotike edhe pas trajtimit (FRNS) si dhe ata që janë të varur nga barnat kortikosteroide (SDNS). Sindroma nefrotike rezistente ndaj trajtimit fillestar me kortikosteroide apo sindroma kortiko - rezistente (SRNS) është nënlloj i sindromës nefrotike, e cila paraqet një sfidë për nefrologët pediatrikë. Shpeshtësia e rasteve me SRNS dallon nga shteti në shtet. Trajtimi i SRNS kërkon përdorim të barnave të cilat e dobësojnë imunitetin e pacientit pediatrik dhe të cilat vazhdimisht duhet të monitorohen, vazhdohen, ndalohen apo kombinohen, varësisht nga efekti në pacientin. Qëllimi i trajtimit të pacientëve me sindromë nefrotike kortiko - rezistente është gjithnjë parimisht shërimi apo remisioni i plotë i pacientit dhe parandalimi i zhvillimit të sëmundjes së avancuar renale. Në grupin e medikamenteve që përdoren te SRNS, krahas kortikosteroideve, numërohen edhe: inhibitorët e kalcineurinës, mikofenolat mofetili, ciklofosfamidi, levamisoli, rituksimabi, medikamente të tjera më të reja si dhe masa jo - medikamentoze terapeutike. Nga të gjitha barnat e përmendura, inhibitorët e kalcineurinës oralë si monoterapi janë më të suksesshëm në indukimin e remisionit të plotë gjatë vitit të parë pas fillimit të sëmundjes. Prognoza te fëmijët me SRNS varet nga shkaqet, gjenetike apo jo - gjenetike, histologjia renale, përgjigjja ndaj imunosupresivëve dhe nga kohëzgjatja e monitorimit të terapisë.

Fjalë kyçe: sindroma nefrotike, veshka, SSND, SRNS.

TRAJTIMI KIRURGJIKAL I KANCERIT TË TIROIDES.
Andi Isufi

Abstrakt
Hyrje: Kanceri i tiroides përfaqëson neoplazinë më të shpeshtë të sistemit endokrin, që origjinon nga qelizat folikulare ose parafolikulare të gjëndrës tiroide. Incidenca e tij është në rritje për shkak të përdorimit të gjerë të imazherisë me rezolucion të lartë. Shumica e rasteve përbëhen nga kanceret e diferencuara të tiroides (papilare dhe folikulare), ndërsa format medulare, anaplastike, limfomat dhe sarkomat janë më të rralla.
Qëllimi: Ky studim synon të analizojë patofiziologjinë, prezantimin klinik, diagnostikimin dhe trajtimin kirurgjikal bashkëkohor të kancerit të tiroides, duke theksuar parimet që udhëheqin zgjedhjen e llojit dhe shtrirjes së ndërhyrjes kirurgjikale.
Materiale dhe metoda: Është realizuar një analizë retrospektive dhe përmbledhëse e literaturës mbi llojet histopatologjike, indikacionet kirurgjikale, teknikat operatore dhe menaxhimin postoperator. Të dhënat përfshijnë shpërndarjen demografike, karakteristikat tumorale dhe rezultatet kirurgjikale të pacientëve të trajtuar në Shërbimin e Kirurgjisë së Përgjithshme.
Rezultate: Karcinomat e diferencuara të tiroides përbënin shumicën e rasteve, me prevalencë më të lartë te femrat. Tiroidektomia totale u aplikua si procedurë standarde për tumoret >2 cm ose me faktorë risku të mesëm dhe të lartë, ndërsa hemitiroidektomia u përdor në lezionet unifokale të vogla. Diseksioni limfatik cervikal u realizua në prani të metastazave klinike ose radiologjike. Ndjekja pas operacionit përfshiu terapi suprimuese me levotiroksinë dhe, sipas rastit, ablacione me jod radioaktiv. Prognoza e karcinomave të diferencuara ishte e favorshme, ndërsa karcinoma anaplastike mbetet me mbijetesë të ulët.
Përfundime: Kirurgjia mbetet shtylla kryesore e trajtimit të kancerit të tiroides. Zgjedhja e ndërhyrjes duhet të individualizohet sipas tipit histologjik, përmasave dhe stadit të tumorit, në kuadër të një qasjeje multidisiplinare. Përparimet teknike dhe terapitë ndihmëse kanë përmirësuar ndjeshëm rezultatet dhe mbijetesën e pacientëve.

Fjalë kyçe: Kanceri i tiroides, tiroidektomia, karcinoma papilare, karcinoma medulare, karcinoma anaplastike, trajtim kirurgjikal.

EVOLUCIONI I DIAGNOSTIKËS MIKROBIOLOGJIKE NË EPOKËN E IA - SË DHE REZISTENCËS ANTIMIKROBIKE.

Andi Koraqi[1], Denada Lacej[2, 3]
[1]Universiteti i Mjekësisë, Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Laboratorëve, Shërbimi i Mikrobiologjisë, Tiranë, Shqipëri
[2]Instituti i Shëndetit Publik, Departamenti i Laboratorëve, Tiranë, Shqipëri
[3]Universiteti i Mjekësisë, Fakulteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Hyrje: Diagnoza mikrobiologjike po kalon një periudhë ndryshimesh transformuese, e nxitur nga një presion i dyfishtë: rritja e rezistencës mikrobike ndaj medikamenteve antimikrobike dhe përparimet teknologjike të përshpejtuara nga inteligjenca artificiale (IA). Paralelisht me zhvillimet e vrullshme teknologjike të nxitura nga IA - ja, AMR e shfaqur si një krizë globale e shëndetit publik përforcon nevojën për një diagnostikim të shpejtë dhe të saktë në mënyrë që të përcaktohet një terapi antimikrobike adekuate dhe të reduktohet përdorimi i panevojshëm i antibiotikëve.
Qëllimi: Ky prezantim eksploron zhvillimin historik të metodave diagnostikuese mikrobiologjike–nga kultura tradicionale dhe mikroskopia deri te teknikat molekulare të përmirësuara nga IA - ja. Ai thekson se si IA po integrohet në procedurat e përditshme të punës në laborator për të rritur shpejtësinë, saktësinë dhe shkallëzueshmërinë e identifikimit të mikroorganizmave patogjenë dhe profilizimit të rezistencës.
Rezultate: Është e rëndësishme të theksohet dhe evidentohet roli i AI - së në survejancën e AMR - së duke dhënë informacione të vlefshme në kohë reale dhe modelim parashikues, duke mbështetur dhe sugjeruar iniciativa si në kujdesin individual të pacientit ashtu edhe më të gjera në fushën e shëndetit publik.
Përfundime: Së fundmi evidentohen sfidat praktike të zbatimit të IA - së në mikrobiologjinë klinike, duke reflektuar mbi drejtimet e ardhshme të diagnostikimit në një botë që po formësohet gjithnjë e më shumë nga teknologjitë digjitale të shëndetit dhe kërcënimet antimikrobike.

Fjalë kyçe: diagnozë mikrobiologjike, inteligjencë artificiale, rezistencë antimikrobike, AMR, diagnostikim i shpejtë, teknologji digjitale.

ANTIKOAGULIMI NË NDËRHYRJET KIRURGJIKALE ESTETIKE, PERSPEKTIVA ANESTEZIOLOGJIKE: NJË RISHIKIM I LITERATURËS.

Dr. Andriada Meta,
Mjeke Anesteziste - reanimatore, Spitali Hygeia Tiranë.

Abstrakt
Hyrje: Menaxhimi i antikoagulimit tek pacientët që i nënshtrohen ndërhyrjeve kirurgjikale mbetet një nga çështjet më të debatuara dhe klinikisht më të rëndësishme në mjekësinë perioperative. Pacientët që kryejnë ndërhyrje kirurgjikale estetike përbëjnë një grup gjithnjë e më të larmishëm si në llojin e procedurave, ashtu edhe në moshë dhe sëmundje shoqëruese. Përfshirja e pacientëve me komorbiditete të tilla si sëmundjet kardiovaskulare, metabolike apo tromboembolike, shpesh shoqërohet me përdorim të terapisë antikoagulante kronike, duke e bërë menaxhimin perioperativ veçanërisht sfidues për anestezistin.
Qëllimi: Ky prezantim synon të theksojë rëndësinë e individualizimit të strategjive të menaxhimit të antikoagulimit tek pacientët që i nënshtrohen ndërhyrjeve estetike, veçanërisht ata me rrezik të lartë tromboembolik ose që trajtohen me terapi antikoagulante afatgjatë. Gjithashtu, nënvizon nevojën për rishikim të vazhdueshëm dhe përditësim të udhëzimeve më të fundit të profilaksisë antitrombotike në praktikën anestezjologjike.
Materiale dhe metoda: Ky punim bazohet në analizën e udhëzimeve dhe publikimeve të fundit që trajtojnë menaxhimin perioperativ të agjentëve antikoagulantë dhe antiagregantë tek pacientët që i nënshtrohen ndërhyrjeve estetike. Vëmendje e veçantë i është kushtuar përcaktimit të kohës optimale të ndërprerjes dhe

rifillimit të terapisë antikoagulante, si dhe identifikimit të strategjive më të përshtatshme për pacientët me rrezik të lartë, nga perspektiva e anestezistit.
Rezultate: Të dhënat aktuale tregojnë se rreziku për ngjarje tromboembolike nuk mund të eliminohet plotësisht në asnjë ndërhyrje kirurgjikale. Kirurgjia estetike, megjithëse është elektive, mbart një potencial të konsiderueshëm për komplikacione trombotike dhe hemorragjike, sidomos tek pacientët me patologji kardiovaskulare apo metabolike. Vlerësimi i kujdesshëm para operacionit, menaxhimi i individualizuar i antikoagulimit dhe zbatimi i protokolleve të përditësuara nga ana e anestezistit janë elemente kyçe për rritjen e sigurisë së pacientit.
Përfundime: Rreziku tromboembolik është i pranishëm në çdo ndërhyrje kirurgjikale, përfshirë edhe ato estetike. Këto procedura nuk duhet të nënvlerësohen në aspektin e rrezikut perioperativ. Janë të nevojshme studime të mëtejshme për përcaktimin e strategjive më efektive antitrombotike. Terapia më e mirë është ajo e përshtatur sipas karakteristikave dhe profilit individual të pacientit, me anestezistin që luan rolin qendror në koordinimin e menaxhimit perioperativ të antikoagulimit.

Fjalë kyçe: kirurgjia estetike, antikoagulimi, profilaksia trombotike, rreziku tromboembolik, anesteziologjia, menaxhimi perioperativ.

STUDIM MBI PËRDORIMIN E LËNDËVE NARKOTIKE NGA TË MITURIT NË SHQIPËRI.

Andrin Tahiri, Tedi Rrudha, Migena Albrahimi

Abstrakt
Hyrje: Përdorimi i substancave tek fëmijët është një shqetësim në rritje i shëndetit publik në nivel global, me implikime të rëndësishme sociale dhe shëndetësore. Adoleshenca është një fazë vendimtare zhvillimore e karakterizuar nga vulnerabiliteti i shtuar ndaj ndikimeve të jashtme, duke përfshirë eksperimentimin me substanca psikoaktive. Ekspozimi i hershëm ndaj narkotikëve rrit rrezikun e varësisë dhe komplikimeve shëndetësore afatgjata, duke e bërë atë një çështje prioritare për sistemet e kujdesit shëndetësor, edukatorët dhe politikëbërësit. Mungesa e programeve efektive parandaluese dhe aksesi i kufizuar në shërbimet e shëndetit mendor e ndërlikon më tej situatën. Për më tepër, prania e fortë e rrjeteve të trafikut të paligjshëm të drogës në rajon rrit disponueshmërinë dhe aksesin e lëndëve narkotike edhe për të miturit gjithashtu. Pavarësisht shqetësimit në rritje për përdorimin e substancave nga adoleshentët në Shqipëri, të dhënat mbi prevalencën, modelet dhe faktorët themelorë që nxisin përdorimin e drogës tek të miturit mbeten të kufizuara.
Qëllimi: Në këtë kontekst, qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë prevalencën e përdorimit të substancave të paligjshme tek të miturit në Shqipëri, të cilët kërkuan ndihmë të specializuar pranë Qëndrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" në Tiranë, si dhe të identifikojë faktorët kryesorë të lidhur me këtë sjellje. Objektivi është të ofrojë njohuri të bazuara në fakte lidhur me karakteristikat demografike të të miturve të prekur nga abuzimi me drogën në Shqipëri.
Metodologjia: Në aspektin metodologjik ky është një studim retrospektiv vëzhgues i bazuar në të dhëna të mbledhura nga Shërbimi i Toksikologjisë Klinike në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" në Tiranë. Shërbimi i Toksikologjisë Klinike është shërbimi i vetëm kombëtar në nivel terciar që ofron diagnostikim, parandalim dhe trajtim për abuzimin, intoksikimin, mbidozën dhe varësinë nga substancat psikoaktive për individë nga e gjithë Shqipëria. Studimi përfshiu të gjithë të miturit (nën 18 vjeç) që janë paraqitur në Shërbimin e Toksikologjisë Klinike të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" midis 1 janarit 2020 dhe 31 dhjetorit 2024 për shkak të intoksikimit akut ose kronik, mbidozës, abstinencës ose varësisë nga substancat psikoaktive, dhe nevojës urgjente për të trajtuar këto gjendje. Kriteret e përfshirjes ishin: 1) intoksikim, mbidozë, abstinencë ose abuzim i konfirmuar ose i dyshuar që ka kërkuar trajtim të specializuar toksikologjik, 2) të dhëna të plota klinike të disponueshme. Kriteret e përjashtimit: 1) të dhëna të paplota klinike, 2) raste të pa lidhura me përdorimin e substancave psikoaktive (p. sh. , helmime aksidentale nga substanca jo - psikoaktive.
Diskutime: Ky studim nxjerr në pah një çështje të rëndësishme për shëndetin publik në Shqipëri: përdorimi i substancave narkotike tek të miturit. Gjetjet e këtij studimi tregojnë qartë se përdorimi i substancave psikoaktive tek të miturit mbetet një problem serioz dhe në rritje, i cili kërkon trajtim dhe masa parandaluese të mirëkoordinuara. Nga 1032 pacientë të trajtuar në Shërbimin e Toksikologjisë Klinike në QSUT "Nënë Tereza" për shkak të intoksikimit nga substancat psikoaktive, 27 pacientë (2. 6%) ishin nën moshën 18 vjeç, duke dëshmuar se edhe në një vend relativisht të vogël si Shqipëria, përdorimi i drogës tek të miturit është një problem i pranishëm dhe alarmues. Studimi tregon qartë se përdorimi i substancave tek të miturit në Shqipëri është një

problem serioz dhe në rritje. Ndërhyrjet e hershme, trajtimi i specializuar dhe programet parandaluese të bazuara në komunitet dhe në shkolla janë të nevojshme për të adresuar këtë çështje në mënyrë efektive. Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet sektorit të shëndetit, arsimit dhe strukturave të zbatimit të ligjit është i domosdoshëm për të reduktuar përdorimin e substancave dhe për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien e të miturve në Shqipëri.

Fjalë kyçe: Shqipëri, minoren, droga ileagle, intoksikim, varësi.

SINDROMA SJOGREN ME PËRFSHIRJE SISTEMIKE NË NJË PACIENTE 63 - VJEÇARE: RAST KLINIK.

Anife Lika MD, Prof. Asc. Dorina Ruci

Abstrakt

Sindroma Sjogren (SS) është një sëmundje autoimune sistemike që karakterizohet nga infiltrimi limfocitar i gjëndrave ekzokrine, kryesisht lakrimale dhe salivare, duke shkaktuar simptomat tipike të "sicca syndrome". Manifestimet ekstra - glandulare janë të zakonshme dhe përfshijnë organet vitale si: pulmonet, veshkat, sistemin nervor periferik dhe sistemin muskuloskeletik. Komplikacionet neurologjike periferike raportohen në rreth 20–30% të pacientëve me SS, më shpesh në formën e neuropative aksonale sensore, ndërsa aksonopatia motore e izoluar mbetet më e rrallë. Përveç kësaj, osteoporoza është një ndërlikim i njohur në SS, e lidhur me inflamacionin kronik, mungesën e aktivitetit fizik dhe përdorimin e terapisë me kortikosteroide. Diagnoza e SS në rastet sistemike kërkon kombinimin e të dhënave klinike, serologjike dhe biopsisë së gjëndrave salivare labiale si test referues.

Pacientja R. Sh. , 63 vjeç, me histori për hipertension arterial të diagnostikuar në Janar 2024, u paraqit në klinikë me tumefaksione në regjionet submandibulare bilaterale dhe temperaturë deri në 39°C. Pas një qasjeje diagnostike multidisiplinare, pacientja u diagnostikua me Sindromë Sjogren me përfshirje sistemike. Ky rast klinik ilustron një formë sistemike të Sindromës Sjogren me manifestime dominuese ekstra - glandulare, duke përfshirë limfadenopatinë, manifestimet neurologjike periferike dhe osteoporozën.

Fjalë kyçe: inflamacion, sistemike, Sjogren, ekstraglandulare.

MIOMEKTOMIA GJATË OPERACIONIT ÇEZARIAN: SFIDA NDAJ STIGMËS SË RREZIKUT HEMORRAGJIK – RAPORTIM RASTI.

Anika Dokle

Abstrakt

Hyrje: Kryerja e miomektomisë gjatë operacionit çezarian shpesh është shmangur për shkak të frikës nga hemorragjia masive intraoperatore dhe rrezikut për histerektomi peripartum. Megjithatë, evidencat e viteve të fundit tregojnë se, me menaxhim të kujdesshëm të hemostazës dhe përvojë të mjaftueshme kirurgjikale, procedura mund të realizohet në mënyrë të sigurt. Ky raport paraqet një rast të suksesshëm të miomektomisë gjatë operacionit çezarian, duke ilustruar zbatueshmërinë dhe përfitimet e saj në praktikën obstetrike.

Paraqitja e rastit: Një grua shqiptare 33 - vjeçare iu nënshtrua një operacioni çezarian urgjent në Tiranë për shkak të bradikardisë së rëndë fetale. Pacientja kishte një shtatzëni të arritur përmes fertilizimit in vitro (IVF) dhe u paraqit në lindje aktive me dilatacion cervikal prej 5 cm. Pas lindjes së foshnjës, u identifikua një miomë intersticiale fundike me diametër rreth 8 cm. U krye miomektomi menjëherë pas nxjerrjes së placentës, si pjesë e menaxhimit kirurgjikal. Hemostaza u arrit në mënyrë të plotë me administrimin e Oksitocinës, Misoprostolit dhe Acidit Traneksamik. U vendos dren kirurgjikal profilaktik. Ecuria postoperatore ishte pa komplikacione; nuk u evidentuan episode hemorragjie apo infeksioni, dhe pacientja doli nga spitali në gjendje të përgjithshme të mirë.

Përfundime: Ky rast mbështet literaturën që sugjeron se miomektomia gjatë operacionit çezarian, kur kryhet në kushte të kontrolluara kirurgjikale dhe me strategji adekuate të hemostazës, mund të jetë ndërhyrje e sigurt dhe e justifikuar. Në raste të përzgjedhura, ajo mundëson ruajtjen e mitrës dhe redukton rrezikun e komplikacioneve obstetrikale në shtatzënitë e ardhshme. Nevojiten studime të mëtejshme për të përcaktuar udhëzime të standardizuara dhe për të nxitur pranimin më të gjerë të kësaj praktike në obstetrikë.

Fjalë kyçe: obstetrikë, miomektomi, operacion çezarian, hemorragjia, histerektomi.

NUTRICIONI TE FËMIJËT ME KANCER.

Prof. Dr. Anila Godo[1], Prof. Dr. Ersilia Buonomo[2], Prof. As. Dr. Fabian Cenko[1]
[1]UniZKM, SKZKM, Tiranë, Shqipëri
[2]Università "Tor Vergata", Romë, Itali

Abstrakt
Hyrje: Onkologjia pediatrike mbetet në qendër të vëmendjes shkencore në mbarë botën. Ndërsa biologjia molekulare dhe imunogjenetika synojnë terapi precize dhe të personalizuara, terapitë mbështetëse mbeten një fushë e rëndësishme, që lehtëson zbatimin e suksesshëm dhe të sigurt të strategjive kimioterapeutike dhe radioterapeutike. Në këtë kontekst, nutricioni adekuat, i përshtatur sipas patologjisë dhe nevojave të pacientit, mbetet një sfidë që duhet trajtuar me kujdes.
Qëllimi: Të tërheqë vëmendjen dhe të ofrojë informacion të përditësuar mbi pasojat afatshkurtra dhe afatgjata të kancerit dhe terapisë së lidhur mbi statusin nutricional të fëmijës; të paraqesë rekomandimet më të fundit dhe më të besueshme lidhur me nutricionin e duhur në faza dhe kushte specifike gjatë trajtimit të neoplazisë dhe komplikacioneve të mundshme. Bazuar në trendet aktuale, prezantojmë qasje profilaktike lidhur me marrëdhëniet nutricion - kancer.
Metodologjia: Për realizimin e qëllimit, kemi hulumtuar, analizuar dhe përzgjedhur informacionin më të fundit nga literatura shkencore, nga burime shumë të besueshme, lidhur me nutricionin në neoplazitë pediatrike.
Rezultate: Fëmijët që nënshtrohen terapisë për kancer janë në rrezik të lartë për zhvillimin e deficiteve nutricionale, si në periudhën e hershme ashtu edhe në atë afatgjatë. Duke analizuar të dhënat e mbledhura dhe duke i krahasuar ato me eksperiencën tonë të gjatë klinike, kemi mundur të përpilojmë një përmbledhje të strategjive nutrive, preventive dhe terapeutike.
Rekomandime: Nutricionisti duhet të jetë pjesë thelbësore e ekipit multidisiplinar që ndjek fëmijën me kancer. Ne rekomandojmë që nutricioni i këtyre pacientëve të bazohet në rekomandimet përkatëse, si një element i rëndësishëm për rritjen e shanseve të mbijetesës. Ruajtja e indeksit të masës trupore (BMI) brenda normave normale. Aktiviteti fizik i përshtatshëm. Evitimi i dietave "alternative". Dieta e balancuar parandaluese sipas udhëzimeve të WCRF (World Cancer Research Fund), në mungesë të humbjes së peshës, vështirësive në ushqyerje apo çrregullimeve gastrointestinale. Marrja adekuate e lëngjeve. Në rast shtimi peshe, përfshirja e ushqimeve të pasura me fibra. Në rast problemeve gastrointestinale, shmangia e ushqimeve me fibra. Në prani të mukozitit oral, ushqimet duhet të jenë të buta, të ftohta dhe jo irrituese, etj.

Fjalë kyçe: Fëmijët, nutricioni në kancer, onkologji.

LODHJA KRONIKE NË PRAKTIKËN E PËRDITSHME – NJË QASJE DIAGNOSTIKE PËR MJEKUN E KUJDESIT PARËSOR.

Anila Heta

Abstrakt
Hyrje: Lodhja kronike është një ndër ankesat më të zakonshme që hasin mjekët e kujdesit parësor, duke përbërë deri në 10–20% të konsultave ambulatore. Pavarësisht prevalencës së lartë, ajo mbetet një sfidë diagnostike për shkak të natyrës së saj jo specifike dhe listës së gjatë të shkaktarëve të mundshëm, përfshirë sëmundjet kronike, çrregullimet psikologjike, faktorët socialë dhe lodhjen funksionale.
Qëllimi: Të paraqitet një qasje sistematike dhe praktike për diagnostikimin e lodhjes kronike në kujdesin parësor, me synimin për të ndihmuar mjekët në diferencimin e shkaqeve organike nga ato funksionale dhe për të përmirësuar vendimmarrjen klinike në praktikën e përditshme.
Metodologjia: Është kryer një rishikim i literaturës bashkëkohore mbi lodhjen kronike, duke u fokusuar në udhëzimet klinike, algoritmat diagnostikë dhe përvojën praktike në kujdesin parësor.

Rezultate: Nga shqyrtimi i rasteve dhe literaturës rezulton se një numër i madh pacientësh me lodhje kronike nuk marrin diagnozë të qartë për shkak të mungesës së një strukture të qartë vlerësimi në kujdesin parësor. Algoritmi i propozuar ndihmon në përmirësimin e procesit diagnostik dhe redukton referimet e panevojshme.
Përfundime: Lodhja kronike mbetet një sfidë për mjekët e kujdesit parësor për shkak të natyrës multifaktoriale dhe jo specifike të saj. Përdorimi i një qasjeje të strukturuar dhe algoritmike mund të ndihmojë në identifikimin më të saktë të shkakut themelor dhe në përmirësimin e kujdesit ndaj pacientit. Edukimi i vazhdueshëm dhe ndarja e praktikave të mira mes mjekëve është thelbësore për përballimin efektiv të këtij problemi klinik të zakonshëm.

Fjalë kyce: lodhje kronike, kujdes parësor, qasje diagnostike, algoritme klinike.

TROMBOZA E VENËS PORTA (PVT), NJË RISHIKIM I LITERATURËS MBI PREZANTIMIN KLINIK DHE FAKTORËT E RISKUT.

Anila Kristo[1], Jonila Çela[2]
[1]*Departamenti i Morfologjisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësië, Tiranë*
[2]*Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Elbasan*

Abstrakt
Tromboza e venës porta (PVT) i referohet formimit të trombit në venën porta dhe degët e saj, por që mund të prekë edhe venat tributare si venat mezenterike dhe lienale. Bazuar në kohën e formimit të trombit PVT konsiderohet si recente kur tromboza akute gjykohet të jetë prezente prej më pak se 6 muaj, me dilatim të venës porta në vendin e okluzionit dhe mungesë ose prezencë e pakët e qarkullimit kolateral dhe PVT kronike kur tromboza është prezente për më shumë se 6 muaj shoqëruar me kavernomë portale. Në formën kronike klinika lidhet kryesisht me shenjat e hipertensionit portal dhe komplikacioneve të tij si hemorragji variçeale, ascit etj. PVT akute mund të jetë asimptomatike por në shumicën e rasteve mund të shoqerohet me shenja jospecifike si dhimbje abdominale dhe nëse tromboza prek edhe venën mesenterica superior mund të çojë drejt iskemisë intestinale me shenja të ileusit. Ndër faktorët më të shpeshtë predispozues për PVT janë sëmundjet kronike hepatike si cirroza hepatike ku hipertensioni portal i avancuar, reduktimi i fluksit të gjakut në PV dhe dëmtimi endotelial favorizojnë PVT. Faktorë risku për PVT në cirrozë janë severiteti i sëmundjes, mutacione gjenetike trombofilike, endotoksemia / inflamacioni, hepatocarcinoma (HCC) dhe ndër hyrje jatrogjene. Pacientët pa probleme hepatike paraqesin gjëndje protrombotike të fitura apo të trashëguara që mund të jenë sistemike si sëmundjet mieloproliferative, trombofili të trashëguara (defiçencat e Protein C, S dhe Antithrombinës, mutacionet e faktorit V Leiden etj), trombofili të fituara si sindroma antifosfolipid, faktorë të tjerë risku sistemike si sëmundja inflamatore e zorrës, sëmundje autoimmune dhe vaskuliti, shtatzania, ose faktorë lokalë si inflamacion / infeksion abdominal, tumore malinje hepato - biliare, pankreatike ose kirurgji abdominale dhe trauma. Në momentin e diagnozës së PVT pacientët mund kenë prezencë të më tepër se një faktori risku. Dyshimi klinik i hershëm i kombinuar me imazherinë e përshtatshme është thelbësor për diagnozën në kohë. Trajtimi i PVT në pacientë pa cirrozë bazohet në antikoagulimin dhe menaxhimin e faktorëve predispozues. Në pacientët me cirrozë hepatike trajtimi konsiderohet rast - pas - rasti bazuar në rrezikun për hemorragji dhe prezencën e komplikacioneve. Njohja e faktorëve të riskut lejon strategji parandaluese dhe trajtuese, duke pakësuar komplikacionet si iskemia intestinale, hipertensioni portal dhe përkeqësimi i funksionit të mëlçisë.

Fjalë kyçe: Tromboza e venës porta, klinika, faktorë risku.

BARRIERAT E DEPISTIMIT TË ORGANIZUAR TË KANCERIT TË QAFËS SË MITRËS NË MITRËS NË SHQIPËRI.

Anila Xhani[1], Kozeta Filipi[2]
[1]*Qendra Spitalore Universitare, "Mbretëresha Geraldine", Tiranë, Shqipëri*
[2] *Instituti i Shëndetit Publik të Shqipërisë, Tiranë, Shqipëri*

Abstrakt

Hyrje: Depistimi i organizuar i qafës së mitrës është jetik për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës. Megjithatë, shumë programe ekzistuese të depistimit dështojnë të arrijnë potencialin e tyre të plotë, siç demonstrohet nga treguesit kryesorë të performancës. Ka barriera që pengojnë zbatimin dhe zvogëlojnë efektivitetin e programeve. Ky studim eksploron pengesat e depistimit të kancerit të qafës së mitrës në Shqipëri duke synuar të vendos strategji te sakte për të përmirësuar barazinë dhe te ardhmen e kujdesit shëndetësor për gratë.

Metoda: Vlerësimi i barrierave ndoqi kornizën EU - TOPIA, të hartuar për të identifikuar pengesat për depistimin efektiv të kancerit të gjirit, qafës së mitrës dhe zorrës së trashë. Kjo qasje mbështetet në një proces përsëritës të kryer nga përfaqësuesit e vendit përgjegjës për depistimin dhe studiuesit ekspert në planifikimin dhe vlerësimin e programeve të depistimit. Ai përfshin tre hapa: a. përshkrim gjithëpërfshirës të aktiviteteve të depistimit; b. identifikimin e barrierave kryesore nëpërmjet publikimeve te meparshme dhe c. vlerësim gjithëpërfshirës të barrierave kryesore të identifikuara.

Rezultate: Vlerësimi i pengesave zbuloi sfida të përbashkëta në depistimin e kancerit të qafës së mitrës në Shqipëri. Shqipëria përballet me vështirësi në sistemet e saj të ftesave, shtrirje të kufizuara të aktiviteteve dhe shkallë të ulëta pjesëmarrjeje. Mungojnë sisteme të të dhënave plotësisht të integruara në nivel kombëtar, duke penguar monitorimin e programit dhe shperndarjen e të dhënave. Kufizimet financiare dhe kufizimet e burimeve ndikojnë negativisht në qëndrueshmërinë dhe cilësinë e programit, duke ulur ndërgjegjësimin dhe aksesin publik. Përveç kësaj, Shqipëria nuk ka strategji gjithëpërfshirëse dhe të azhornuara afatgjata për të mbështetur përpjekjet e parandalimit dhe zbulimit të hershëm.

Përfundime: Studimi ynë nënvizon rëndësinë e adresimit të barrierave organizative në depistimin e kancerit të qafës së mitrës për të përmirësuar efektivitetin dhe aksesin e programit. Përshtatja e
praktikave të depistimit me standardet e BE - së dhe OBSH - së është thelbësore për Shqipërinë, si anëtare të ardhshme të BE - së. Mësimet nga praktikat më të mira ndërkombëtare, të tilla si integrimi i sistemeve të IT - së, përdorimi i strategjive të shtrirjes shumëkanalëshe dhe miratimi i politikave afatgjata të mbështetura ligjërisht, ofrojnë rrugë të zbatueshme për përmirësim. Politikëbërësit duhet të kene perparesi financimin e qëndrueshëm, sistemet e centralizuara dhe qasjet inovative për të kapërcyer sfidat strukturore.

Fjalë kyçe: kanceri i qafës së mitrës, depistimi i organizuar i kancerit, Evropa Juglindore, barrierat e depistimit.

PROCESI I SHKATËRRIMIT TË GAMETËVE DHE EMBRIONEVE DHE ÇËSHTJET ETIKE NË VENDET E BALLKANIT.

Anisa Mukaj

Abstrakt

Hyrje: Ky punim trajton procesin e shkatërrimit të gametëve dhe embrioneve në kontekstin e teknikave të riprodhimit të asistuar (ART), duke analizuar sfidat ligjore, etike dhe kulturore që lidhen me këtë temë në vendet e Ballkanit. Shkatërrimi i materialit gjenetik kryhet për arsye si përfundimi i planifikimit familjar, skadimi i afatit të ruajtjes, mungesa e viabilitetit, apo tërheqja e pëlqimit nga pacientët. Metodat më të zakonshme përfshijnë incenerimin, trajtimin kimik dhe sterilizimin para hedhjes, të gjitha të mbështetura në kërkesa ligjore për dokumentim dhe pëlqim të informuar. Në rajonin e Ballkanit, qasjet janë të ndryshme: vendet si Greqia kanë korniza më liberale dhe të rregulluara, ndërsa të tjera si Serbia, Shqipëria dhe Bosnja ballafaqohen me boshllëqe ligjore, ndikim të theksuar të fesë dhe mungesë ndërgjegjësimi publik. Ndër sfidat kryesore përfshihen: paqartësia në legjislacion, rezistenca kulturore dhe fetare, si dhe mungesa e edukimit publik mbi riprodhimin e asistuar. Risi në Shqipëri është propozimi i një ligji të ri "Për shëndetin seksual dhe riprodhues", i cili synon të rregullojë më qartë çështje si riprodhimi in vitro, shtatzënia surrogate dhe aborti. Drafti parashikon që embrionet dhe vezët e pafekonduara mund të ruhen deri në moshën 53 - vjeçare të gruas, pas së cilës ato duhet të shkatërrohen nëse nuk dhurohen megjithatë, mungojnë ende udhëzime të detajuara procedurale për këtë proces.

Punimi përfundon me rekomandime për Shqipërinë: harmonizim me standardet e BE - së (direktiva 2004 / 23 / EC), vendosje kufijsh të qartë kohorë për ruajtjen, rritje të transparencës në dokumentim dhe edukim publik mbi aspektet etike të përdorimit të materialit gjenetik.

Fjalë kyçe: material gjenetik, gametë, embrion, ruajtje, shkatërrim etj.

LIMFADENITI CERVIKAL I ABSCEDUAR TE FËMIJËT.

Prof. Gjeorgjina Kuli Lito, Prof. Ermira Kola, Dr Anisa Potka, Dr Diana Shtembari, Dr Vladimir Hoxha

Abstrakt

Hyrje: Limfadeniti cervikal i absceduar te fëmijët përfshin një nyje limfatike të infektuar dhe edematoze në qafë që formon një absces. Shumica e rasteve akute të limfadenitit purulent shkaktohen nga Staphylococcus aureus ose nga Streptococcus pyogenes por gjithashtu edhe nga infeksione virale ose, rrallë, nga tumore malinje. Terapia empirike me antibiotikë është shpesh e suksesshme në fazat e hershme të procesit të sëmundjes, por rritja e prevalencës së S. aureus rezistent ndaj meticilinës në veçanti ka bërë të nevojshme një ndryshim në zgjedhjen e antibiotikëve. Mosreagimi ndaj antibiotikëve empirik duhet të shkaktojë një rivlerësim diagnostik për të përcaktuar nevojën për ndërhyrje kirurgjikale ose mundësinë e diagnozave alternative mikrobiologjike.

Prezantim rasti: Fëmijë 3 muajsh paraqitet në urgjencën pediatrike me epikrizë nga Spitali Rajonal Korçë, me diagnozën Lezion cervikal dexter për determinim, suspect formacion kistik, gjendje septike. Bebi që prej lindjes ka patur një masë në anën e djathtë të qafës që sa vinte dhe zmadhohej. Ka kryer ekografi cervikale dhe vjen nga Spitali i Korçës me temperaturë të lartë deri 39. Analizat Lab: Wbc = 38. 6K / uL, Rbc = 3. 7x10^6 / uL, hgb = 9. 3g / dL Hct = 29. 6% neutrofile = 19. 6K / ul, limfocite = 16K / ul, monocite 2. 9K / uL, Plt = 803K / uL, PCR = 13. 26mg / dL, Esr = 24mm / hour, Bilanci Biokimik në normë. Eko cervikale: Limfonodula cervikale të rritura bilaterale dhe një lezion solid dextra me aspekt solid dhe hipovaskular Ro - grafi Toraksi: Theksim i lehtë hilar bilateral Shtrohet në Terapi intensive ku i nënshtrohet një sërë ekzaminimesh laboratorike specifike dhe imazherike. Fillohet terapia me antibiotikë: Cefepime dhe Vankomicinë. Gjendja përmirësohet dhe fëmija transferohet në pavionin e Infektivit për trajtim dhe ndjekje të mëtejshme.

Konkluzione: Ky prezantim synon të rrisë ndërgjegjësimin rreth limfadenitit cervikal si një agjent i mundshëm shkaktar në limfadenitin suppurativ cervikal. Njohja e hershme dhe ndërhyrja në kohë mund të shmangë diagnozën e gabuar duke përmirësuar rezultatet e trajtimit.

Fjalë kyçe: limfadeniti suppurativ cervikal, fëmijë i shëndetshëm, diagnozë e saktë, gjendje septike.

SINUSITI KRONIK ME POLIPOZË NASALE, NJË TERAPI E RE MJEKIMI, RAST KLINIK.

Dr. Anjeza Kuçi
ENT, Poliklinika Nr. 3, Tiranë

Abstrakt

Përkufizim: Tocilizumabi dhe barnat biologjike janë medikamente që i përkasin një klase si interleukinat 6 në formën e anti IL 6R antikorpe monoklonale të humanizuara, që kanë treguar efekt në pacientët me kriza persistente të asthmës, rezistente ndaj terapisë me steroide, ashtu si edhe në artritin reumatoid juvenil, artritin idiopatik juvenil, ose artritin me qeliza gjigande etj. Sinusiti kronik me polyposis nasi, sidomos në rastet e shoqëruara me asthma bronkiale, futet në grupin e patologjive që, megjithë trajtimin me FESS dhe vazhdimin e terapisë për asthmën, ka mundësi ripërsëritjeje më të madhe se në rastet e tjera.

Qëllimi: Të njihet roli i barnave biologjike jo vetëm në trajtimin e sëmundjeve autoimune apo asthma bronkiale, por edhe në rastet e sinusitis cronica me polyposis nasi.

Rast klinik: Ndaj kortizonikëve, paciente A. L. , 52 vjeç, e cila vjen për vizitë për një otitis media me effusion në status post gjendje virale dhe merr terapi. Gjatë anamnezës me pacienten zbuloj se ajo vuante njëkohësisht me asthma bronkiale dhe prej 5 vitesh trajtohet me Tocilizumab sipas një skeme mjekimi të përcaktuar nga mjeku alergolog dhe se njëkohësisht me asthmën, gjatë një vizite në një spital në Turqi, kishte bërë edhe një CT - scan të sinuseve paranazale ku i ishte indikuar edhe FESS, po para 5 vitesh, dhe nuk e kishte kryer për arsye ekonomike. Ndërkohë, si rezultat i rezistencës, ishte futur në skemë mjekimi me barnat biologjike me

Tocilizumab prej 5 vitesh dhe ndërkohë edhe shenjat e patologjisë ORL ishin qetësuar. I kërkoj pacientes që të ribëjmë një CT - scan të sinuseve paranazale, e cila na rezulton normale. Pacientja vazhdon ende trajtimin me Tocilizumab dhe ka rezultuar efektiv pasi krizat i janë qetësuar.
Konkluzione: Megjithëse në hapat e parë dhe në studimet e para se si barnat biologjike mund të ndikojnë në rastet e sinusiteve kronike me polyposis nasi, përveç patologjive të tjera, në një rast klinik të zbuluar rastësisht për një periudhë 5 - vjeçare pacientja është pa simptoma nga të dyja patologjitë. Ndoshta në një të ardhme do të përpilohen protokolle mjekimi dhe skema afatgjata se si barnat biologjike mund të përdoren edhe për sinusitet kronike me polyposis nasi.

Fjalë kyçe: sinusiti kronik, mjekim, polyposis nasi.

ROLI I MRI NË DIAGNOSTIKIMIN DHE MENAXHIMIN E TUMOREVE CEREBRALE: ANALIZË E PACIENTËVE NË QKUK, 2020–2024.
Dr. Antigone Kabashi - Sadikaj

Abstrakt
Hyrje: Tumoret e sistemit nervor qendror (SNQ) paraqesin një sfidë të konsiderueshme diagnostike dhe terapeutike për shkak të diversitetit histologjik dhe lokalizimit kompleks. Diagnostikimi i hershëm dhe stadifikimi i saktë janë vendimtar për zgjedhjen e trajtimit dhe parashikimin e prognozës. Rezonanca Magnetike (RM) ka një rol të pazëvendësueshëm në identifikimin, karakterizimin dhe monitorimin e tumoreve cerebrale.
Qëllimi: Ky studim ka për qëllim të vlerësojë rolin e RM në diagnostikimin, stadifikimin dhe menaxhimin e tumoreve të trurit tek pacientët e diagnostikuar për herë të parë në Klinikën e Radiologjisë - QKUK, gjatë periudhës 2020–2024.
Metoda: Hulumtimi është retrospektiv dhe përfshin 294 pacientë. Ekzaminimet u realizuan me RM 1. 5 T Siemens Symphoni, duke përdorur protokolle standarde për vlerësimin e strukturave cerebrale. Në disa raste, janë përdorur edhe Angio - RM dhe RM venografi TOF 3D për studimin e qarkullimit vaskular para ndërhyrjes neurokirurgjikale. Të dhënat u analizuan statistikisht duke përdorur numra absolutë, përqindje, testin chi - katërkëndor dhe analiza të trendit linear të sëmundjes.
Rezultate: Nga pacientët e studiuar, 61. 6% kishin tumore malinje dhe 38. 4% beninje. Tumoret më të shpeshtë ishin meningeomat (32. 7%), glioblastomat (18. 5%) dhe medulloblastomat (15. 0%). Lloji i tumorit korrelacionoi me moshën; tumoret malinje ishin më të zakonshme tek pacientët e rinj (P=0. 023). Shumica e tumoreve (88. 1%) ishin solitare. Nuk u vërejt dallim statistikisht i rëndësishëm midis gjinisë dhe natyrës së tumorit.
Përfundime: RM është metoda e zgjedhur për diagnostikimin dhe stadifikimin e tumoreve të trurit, duke mundësuar planifikim të saktë neurokirurgjik dhe vlerësim të prognozës. Diagnostikimi i hershëm, bashkëpunimi multidisiplinar dhe përdorimi i protokolleve standarde janë faktorë kyç për optimizimin e trajtimit dhe rritjen e jetëgjatësisë së pacientëve me tumore cerebrale.

Fjalë kyçe: tumoret e trurit, rezonanca magnetike, diagnostikimi, stadifikimi, QKUK.

RËNDËSIA E PËRDORIMIT TË UJIT XHELATINOZ NË PACIENTËT POST STROKE ME PREZENCË DISFAGIE.
Phd. Cand. Antigoni Bullari[1], Prof. Dr. Ilirjana Zekja[2], Bsc. Ansa Terolli[3]
[1]*Logopediste,*
[2]*Neurologe*
[3]*Studente*

Abstrakt
Hyrje: Disfagia është paraqitja klinike e ndërprerjes së aktivitetit të sinkronizuar të mekanizmit normal të gëlltitjes. Ndodh si pasojë e një numër të madh shkaqesh duke përfshirë sëmundjet neurologjike, miopatike, metabolike, inflamatore / autoimune, infektive, strukturore, iatrogjene dhe psikiatrike. Disfagia është tepër e zakonshme tek ishemitë dhe aktualisht konsiderohet si një simptomë alarmi që kërkon vëmendje të

menjëhershme pasi shoqërohet me rritje të vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë për shkak të kequshqyerjes, dehidratimit dhe komplikimeve respiratore. Në Shqipëri ishemia ka një incidence prej 1000 goditje në vit pas Covid - it, 60% e të cilave shfaqin një lloj demtimi fizik ose kognitiv edhe pas hospitalizimit. Disfagia ka një incidence të lartë tek pacientët ishemik sipas statistikave Europiane, nga 29 në 67%, por ulet rreth 20 - 25% 6 muaj pas eventit ishemik. Vështirësia për të gëlltitur pilula ose konsistenca të ndryshme ushqimore, dalja e salivës, humbja e ushqimit nga goja, refluksi ose futja e ushqimit në 'xhepa' në faqe janë shenja të shpeshta të vërejtura në praktikën klinike. Menaxhimi i disfagisë orofaringeale bazohet kryesisht në modifikimin e viskozitetit të lëngjeve dhe konsistencës së ngurtë me qëllim ruajtjen e ushqyerjes orale, duke shmangur gëlltitjen e pasigurt. Shtimi i pluhurave trashësuese në ujë ose përdorimi i ujit xhelatinoz të gatshëm është praktika më e zakonshme tek pacientët që vuajnë nga disfagia.
Qëllimi: Rëndësia e e përdorimit të ujit xhelatinoz në pacientët post stroke me prezencë disfagie
Metodologjia: Rishikim literature, janë marr në shqyrtim 6 studime mjekësore që tregojnë për rëndësinë e përdorimit të ujit xhelatinoz në pacientë me disfagi.
Limitimet e studimit: Ka nevojë për më shumë studime për të përmirësuar rehabilitimin e çrregullimeve të gëlltitjes në pacientët post stroke, duke qenë se në literaturë nuk ka shumë evidenca shkencore.
Konkluzionet: Përdorimi i ujit në konsistencë xhelatinoze mund të jetë pjesë e strategjisë terapeutike për të përmirësuar sigurinë e pacientit, si dhe për të kontribuar në ruajtjen e marrjes adekuate të lëngjeve duke parandaluar dehidratimin dhe duke punuar në mënyrë të sigurt për rikthimin e ushqyerjes fiziologjike.

Fjalë kyçe: terapi, logopedi, rehabilitim logopedik, stroke, AVC, disfagi, uje xhelatinoz.

ROLI I D - DIMERIT NË PATOLOGJITE INFLAMATORE REUMATIZMALE.
Dr. Antuela Sulaj, Dr. Marina Parllaku

Abstrakt
Hyrje: D - dimeri është një fragment proteinik, i cili e ka origjinen nga degradimi i fibrinës, që gjenerohet gjatë procesit të fibrinolizës dhe shërben si një tregues i rëndësishëm për aktivizimin e sistemit koagulues. Në vitet e fundit, është vërejtur një interes për rolin e D - dimerit në patologjitë inflamatore reumatizmale, si artriti reumatoid, lupus eritematoz sistemik dhe vaskulitet. Këto sëmundje karakterizohen nga inflamacioni kronik sistemik, i cili mund të shkaktojë aktivizimin e sistemit të koagulimit dhe të rrisë nivelet e D - dimerit, edhe në mungesë të një tromboze akute.
Qëllimi: Analizimi nivelit të D - dimerit në pacientët me patologji inflamatore reumatizmale dhe përdorimi D - dimerit si mjet ndihmës diagnostik apo prognostik në praktikën klinike reumatologjike.
Matja laboratorike: D - dimeri u mat në plazëm duke përdorur metodën imunoturbidimetrike. Së bashku me D - dimerin, u matën edhe dy parametra inflamatore si: CRP dhe ESR. Vlerat normale në njerëz të rritur jane < 500 ng / ml.
Rezultate: Rezultatet treguan se D - dimeri ishte dukshëm më i lartë te pacientët me sëmundje reumatizmale inflamatore dhe u vu re një korrelacion pozitiv midis D - dimerit, CRP dhe ESR, duke sugjeruar lidhje të ngushtë midis aktivizimit inflamator dhe sistemit të koagulimit.
Rritja e D - dimerit në këto kushte jo vetëm që reflekton inflamacionin sistemik, por gjithashtu mund të lidhet me rrezikun e komplikacioneve tromboembolike dhe dëmtimit endotelial. Kjo e bën atë një tregues potencial për monitorimin e aktivitetit të sëmundjes dhe për vlerësimin e rrezikut vaskular te pacientët me sëmundje reumatizmale.
Përfundime: D - Dimeri mund të shërbejë si një tregues shtesë i aktivitetit inflamator në pacientët me patologji reumatizmale. D - Dimeri ndihmon në vlerësimin e rrezikut për komplikacione trombotike në pacientet me patologji inflamatore reumatizmale. Matja e D - dimerit duhet të merret parasysh në ndjekjen klinike të pacientëve me patologji inflamatore reumatizmale.

Fjalë kyçe: D - dimer, patologji inflamatore, sëmundje reumatizmale, aktivitet i sëmundjes, sistem koagulues, markues inflamator, CRP, ESR, rrezik tromboembolik.

DETERMINANTËT E CILËSISË SË IMAZHIT NË ANGIO - CT KORONAR: FAKTORËT TEKNIKË DHE INDIVIDUAL TË PACIENTIT.

Anxhela Bici[1]
[1]*Master Shkencor, Teknik Imazherie, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësise, Tiranë.*

Abstrakt
Hyrje: Tomografia e kompjuterizuar për vizualizimin e arterieve koronare (CCTA) përfaqëson një modalitet superior radiologjik jo - invaziv për vlerësimin morfologjik dhe funksional të pemës arteriale koronare. Megjithëse teknologjia e skanimit është fundamentale, cilësia përfundimtare e imazhit nuk është vetëm funksion i aparaturës, por rezultat i një ndërveprimi kompleks midis parametrave teknikë të skanimit dhe faktorëve fiziologjikë të pacientit. Në këtë ndërveprim sensibël, tekniku radiolog luan një rol qendror në konfigurimin dhe zbatimin e protokolleve optimale për të arritur rezolucionin diagnostik optimal paralelisht me sigurinë e pacientit.
Qëllimi i studimit: Ky studim synon të analizojë ndikimin e faktorëve teknikë dhe individual të pacientit në cilësinë e imazheve CCTA, duke u fokusuar në përcaktimin e komponentëve që kompromet ojnë ose përmirësojnë vlefshmërinë diagnostike të skanimit, në kushte reale klinike.
Metodologjia: Studimi është i tipit kros seksional, me një shtrirje kohore janar – mars 2025 dhe kampion studimi prej 50 pacientësh (29 meshkuj dhe 21 femra), me moshë mesatare 59 vjeç, nga të cilët 34% geriatrikë. Të 50 subjektet iu nënshtruan një skanimi CT koronar me një aparturë CT S128 deketor, single source. U vlerësuan parametrat teknikë të skanimit (kVp, EKG - gating, FOV, algoritmi i rindërtimit, protokollet e kontrastit, metoda e monitorimit të bolusit) si dhe karakteristika fiziologjike të pacientëve (BMI, ritmi kardiak, mbajtja e frymës, kalcifikimet arteriale, prania e stenteve / implanteve). Cilësia e imazhit u kategorizua sipas një shkalle standarde 4 - pikëshe Likert.
Rezultate: Faktorët që kontribuan ndjeshëm në përmirësimin e cilësisë së imazhit ishin: përdorimi i rekonstruksionit iterativ (IR), tension i reduktuar (100 kVp) në pacientë të selektuar, dhe gating prospektiv në subjekte me ritëm të qëndrueshëm kardiak. Cilësia më e dobët e imazhit u shënua te pacientët me aritmi, frekuencë >75 bpm, BMI >30, dhe kapacitet të dobët të mbajtjes së frymës.
Konkluzione: Gjetjet e këtij studimi nënvizojnë se cilësia e imazhit në CCTA nuk është një vlerë e qëndrueshme, por një balancë dinamike midis faktorëve të kontrollueshëm teknikë dhe atyre biologjikë. Roli i teknikut të imazherisë është thelbësor jo vetëm për zbatimin rigoroz të protokolleve, por edhe për adaptimin në kohë reale të parametrave sipas nevojave individuale të pacientit.

Fjalë kyce: CT koronare, cilësia e imazhit, faktorë teknikë, faktorë individual të pacientit, artefakte.

SFIDAT DIAGNOSTIKE NË SARKOIDOZËN PULMONARE: BIOPSI VS TË DHËNAT KLINIKO - RADIOLOGJIKE.

Anxhela Karati MD, Ornela Nuredini MD PhD, Sofiela Telo PhD
Shefqet Ndroqi Hospital Center of Tirana, Albania

Abstrakt
Hyrje: Sarkoidoza është një sëmundje granulomatoze me etiologji të panjohur, e karakterizuar nga formimi i granulomave jo - kazeoze në mushkëri dhe në organe të tjera. Duke qenë me një spektër të gjerë klinik, sarkoidoza shpesh mbetet një sfidë diagnostike për shkak të mungesës së një testi specifik, duke e bërë të nevojshëm kombinimin e të dhënave klinike, laboratorike, radiologjike dhe histopatologjike. Biomarkerët laboratorikë si angiotensin - converting enzyme (ACE), raporti neutrofile / limfocite (NLR), raporti trombocite / limfocite (PLR) dhe proteina C - reaktive (CRP) janë propozuar si tregues të mundshëm për diagnostikimin dhe vlerësimin e ecurisë së sëmundjes. Megjithatë, roli i tyre mbetet i diskutueshëm dhe kërkon validim në popullata të ndryshme.
Qëllimi: Ky studim synon të vlerësojë rëndësinë e të dhënave klinike, laboratorike dhe radiologjike në diagnostikimin e sarkoidozës pulmonare, me fokus në rolin e tyre përballë nevojës për konfirmim histopatologjik. Gjithashtu, identifikohen faktorët që lidhen me forma më të avancuara të sëmundjes, përfshirë praninë e fibrozës dhe stadifikimin kliniko - radiologjik.
Metodologjia: U realizua një studim retrospektiv analitik mbi 93 pacientë të hospitalizuar me diagnozën sarkoidozë pulmonare. Të dhënat demografike, klinike, laboratorike, radiologjike dhe histopatologjike u

përpunuan dhe analizuan nëpërmjet SPSS v. 27. U aplikuan analiza përshkruese, krahasuese (t - test, Mann–Whitney U, Chi - square / Fisher's exact test), korelative (Pearson / Spearman) dhe ROC (Receiver Operating Characteristic) për vlerësimin e vlerës diagnostike të biomarkerëve si ACE, NLR, PLR dhe CRP.
Rezultate: Mosha mesatare ishte 54. 2 ± 11. 6 vjeç; 66. 7% ishin femra. Simptomat më të zakonshme ishin dobësia trupore (86%), kolla (80. 6%) dhe dispnea (74. 2%). Vlera mesatare e ACE ishte 85 U / L (e rritur në 43%), CRP 1. 3 mg / dl (e rritur në 36. 6%), NLR 2. 54 dhe PLR 183. 43. Radiologjikisht, adenopatia hilare (88. 2%) dhe nodujt pulmonarë (57%) ishin më të shpeshtat; fibroza ishte e pranishme në 10. 8% të rasteve. NLR me cut - off 2. 5 tregoi ndjeshmëri 85% dhe specificitet 55% për identifikimin e fibrozës; PLR tregoi vlera më të ulëta diagnostike. ACE me cut - off 76. 65 tregoi AUC 0. 746, ndjeshmëri 71% dhe specificitet 78% për dallimin e stadit 1–2 nga 3–4; CRP tregoi vlera më të ulëta (AUC 0. 62). Prania e nodujve pulmonarë në HRCT është e lidhur ndjeshëm me uljen e parametrave MEF50 dhe MEF25 (P - vlera = 0. 006). Analiza me testin Mann - Whitney U tregoi një diferencë statistikisht domethënëse midis grupeve (U = 329. 000; p = 0. 036), me pacientët që kishin infiltrime në bronkoskopi duke shfaqur reduktim të MEF50, çka sugjeron kompromet im të rrugëve të vogla të ajrit.
Përfundime: Biomarkeri ACE rezultoi si një tregues i besueshëm për identifikimin e stadit të hershëm të sarkoidozës pulmonare, ndërsa NLR doli i ndjeshëm për detektimin e fibrozës. CRP dhe PLR mund të përdoren si parametra ndihmës, por me kapacitet më të kufizuar diagnostik. Të dhënat klinike dhe radiologjike ofrojnë një potencial të rëndësishëm në drejtimin diagnostik dhe stadifikues të sëmundjes, por biopsia mbetet metoda më e besueshme për konfirmimin histopatologjik dhe "gold standard" në praktikën klinike. Për më tepër, infiltrimi bronkoskopik dhe nodularitet në HRCT shoqërohen me kompromet im të parametrave spirometrikë të rrugëve të vogla, si MEF50 dhe MEF25, duke sugjeruar se dëmtimi morfologjik ka pasoja funksionale të matshme. Këto rezultate nënvizojnë rëndësinë e një qasjeje multidisiplinare dhe mbështesin nevojën për një vlerësim të kombinuar morfologjik, funksional dhe laboratorik në monitorimin dhe menaxhimin e pacientëve me sarkoidozë pulmonare.

Fjalë kyçe: Sarkoidoza, sëmundje granulomatoze, biopsi, sfidat diagnostike.

KOMPLIKIMET OKULARE DHE NEUROLOGJIKE TË HERPES ZOSTER CEFALIK: RËNDËSIA E DIAGNOSTIKIMIT TË HERSHËM – RAPORTIM RASTI.

Anxhela Nikolla, Ermira Muço, Najada Çomo, Arjan Harxhi
Departamenti dhe Shërbimi i Sëmundjeve Infektive, Fakulteti i Mjekësisë, QSUT

Abstrakt
Hyrje: Herpes Zoster Cefalik (HZC) përbën një formë të veçantë të reaktivizimit të virusit Varicella Zoster (VZV), me lokalizim në degët kraniale të nervit trigeminal, kryesisht atë oftalmike (V1). Përfshirja okulare dhe neurologjike në këto raste lidhet me rrezik të lartë për komplikime të rënda dhe humbje të përhershme të funksionit vizual; ndaj identifikimi dhe trajtimi i hershëm mbeten thelbësorë për prognozën klinike.
Materiale dhe metoda: Qëllimi është të përshkruajmë këtë rast të rrallë klinik me diagnozën "Herpes Zoster Cefalik, me ndërlikime oftalmike dhe neurologjike", si një rast të veçantë, të trajtuar me sukses.
Rasti Klinik: Pacientja 71 - vjeçare paraqitet në Shërbimin e Sëmundjeve Infektive me cefale të forta, temperaturë, ethe, të vjella, skuqje të syrit, pamundësi për të mbajtur sytë hapur, fotofobi, edemë, prurit të syrit dhe gjysmës së fytyrës, si dhe dobësi të theksuar trupore prej dy ditësh, të nisura me temperaturë. Në ekzaminimin objektiv vihet re edemë e dukshme e palpebrave, eritemë difuze dhe elemente vezikuloze në regjionin frontal e temporal të djathtë. Pacientja u shtrua në spitalin tonë ku u vërejtën: Analizat laboratorike treguan limfocitozë dhe rritje të testeve inflamatore. Likidi cerebrospinal (CSF) rezultoi me 54 qeliza: limfocitozë 90%, neutrofile 10% – pamje karakteristike për encefalit viral. Testi HIV doli negativ, ndërsa hemokulturat ishin sterile. Imazheria kraniale (CT) përjashtoi lezione fokale, por konfirmoi edemë të indeve të buta periorbitale dhe cervikale, më e theksuar në anën e djathtë. Ekzaminimi okulistik evidentoi lezion paracentral korneal me defekt epitelial (1 / 3–1 / 6 e kornesë), ngjyrim pozitiv me fluoresceinë dhe visus të reduktuar në 1 / 10, duke sugjeruar keratit herpetik aktiv. Trajtimi dhe Ecuria Klinike: U aplikua terapi antivirale sistemike me Acyclovir, Ceftriaxone 2 g / ditë, Dexamethasone, si dhe terapi okulare me ung. Acyclovir 3%, Sol. Ciloxan dhe Sol. Atropine. Pacientja u ndoq klinikisht për 15 ditë, gjatë të cilave u vu re përmirësim i ndjeshëm i simptomave okulare dhe cefalike, me epitelizim gradual të kornesë dhe stabilizim të parametrave laboratorikë.

Përfundime: Ky rast nënvizon rëndësinë e diagnostikimit të hershëm klinik dhe laboratorik të Herpes Zoster Cefalik për të parandaluar komplikimet okulare dhe neurologjike potencialisht të pakthyeshme. Bashkëpunimi i ngushtë midis infeksionistit dhe okulistit është determinant për një rezultat të favorshëm klinik. HZC me përfshirje okulare dhe neurologjike përfaqëson një emergjencë infektive që kërkon vlerësim multidisiplinar dhe trajtim agresiv. Komplikimet më të shpeshta variojnë nga keratiti stromal, uveiti kronik, neuriti optik deri te meningoencefaliti.

Fjalë kyçe: Herpes zoster cefalik, komplikime okulare, keratit herpetik, encefalit, acyclovir, diagnostikim i hershëm.

EPIDEMIOLOGJIA DHE MENAXHIMI I GURËVE NË TRAKTIN URINAR. FAKTORËT E RREZIKUT, DIAGNOSTIFIKIMI DHE TRAJTIMI BASHKËKOHOR.

Arba Berisha

Abstrakt

Hyrja: Gurët në traktin urinar (urolitiaza) përfaqësojnë një ndër çrregullimet më të zakonshme të sistemit urinar dhe një sfidë e vazhdueshme në praktikën urologjike. Incidenca e kësaj patologjie është në rritje në mbarë botën, sidomos në vendet me klimë të ngrohtë dhe me stil jetese bashkëkohore që përfshin faktorë të riskut metabolik dhe dietetik. Sipas të dhënave epidemiologjike të dekadës së fundit, urolitiaza prek rreth 10–15% të popullatës së rritur, me prevalencë më të lartë te meshkujt. Rritja e rasteve lidhet ngushtë me faktorë të stilit të jetesës moderne si: konsumimi lartë i natriumit dhe proteinave shtazore, hidratimi i pamjaftueshëm, obeziteti, inaktiviteti fizik dhe ndryshimet klimatike që ndikojnë në humbjen e lëngjeve. Krahas faktorëve dietetikë dhe mjedisorë, edhe gjendjet metabolike si diabeti mellitus dhe sindroma metabolike luajnë një rol të rëndësishëm në formimin dhe përsëritjen e gurëve urinarë.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të trajtojë urolitiazën si një sfidë klinike me rëndësi në rritje, duke analizuar literaturën më të fundit shkencore që lidhet me përhapjen, faktorët e rrezikut, diagnostikimin dhe trajtimin modern të kësaj patologjie. Përmes një rishikimi sistematik të burimeve relevante, synohet të përmblidhen njohuritë aktuale dhe të nxirren në pah zhvillimet bashkëkohore në menaxhimin e saj klinik. Në një kohë kur incidenca e gurëve në traktin urinar po rritet ndjeshëm, ky punim ndihmon në thellimin e kuptimit të faktorëve ndikues dhe në orientimin drejt qasjeve më efikase për parandalim dhe trajtim të qëndrueshëm.

Materiale dhe metoda: Ky punim është një rishikim i literaturës shkencore mbi urolitiazën, me fokus në aspektet epidemiologjike, faktorët e rrezikut, qasjet diagnostike dhe trajtimin bashkëkohor të kësaj patologjie. Literatura është përzgjedhur nga databaza ndërkombëtare të njohura si PubMed, Medline, ScienceDirect, Google Scholar dhe EMJ Reviews, duke u përqendruar në publikime të botuara gjatë viteve të fundit. Janë analizuar meta - analiza, rishikime sistematike dhe studime klinike origjinale me evidencë të nivelit të lartë, që përmbushin kriteret e përputhshmërisë tematike dhe cilësisë metodologjike. Për interpretim më të thelluar të përmbajtjes, është përdorur gjithashtu literaturë referenciale nga tekste mjekësore dhe burime akademike të përditësuara.

Rezultate: Incidenca e urolitiazës është në rritje në nivel global, e ndikuar nga faktorë të shumtë metabolikë, dietikë dhe ambientalë. CT pa kontrast mbetet standardi i artë në diagnostikim, ndërsa teknikat e reja ofrojnë përfitime shtesë, por me përdorim të kufizuar. Trajtimi bazohet kryesisht në qasjet standarde si Litotripsia me vale goditëse jashtëtrupore (ESWL), ureteroskopia dhe nefrolitotomia perkutane (PCNL), ndërsa teknologjitë e avancuara si mini - PCNL dhe ureteroskopia robotike kanë rol plotësues në qendrat e specializuara.

Konkluzione: Menaxhimi i urolitiazës kërkon një qasje të integruar që përfshin diagnostikimin e hershëm, trajtimin e përshtatur sipas pacientit dhe strategji të qëndrueshme për parandalim. Përparimet teknologjike janë të rëndësishme, por vetëm përmes kombinimit të tyre me masa parandaluese dhe edukim shëndetësor mund të arrihet një përmirësim i qëndrueshëm në kujdesin ndaj këtyre pacientëve.

Fjalë kyçe: Urolitiaza, faktorët e rrezikut, diagnostikimi, trajtim bashkëkohor.

VITAMINA D DHE NEUROZHVILLIMI.

Dr. Arba Thaçi

Abstrakt

Hyrje: Vitamina D (apo kalciferoli) është një vitaminë e tretshme në yndyrë cilën mund ta marrim përmes ushqimit, suplementeve dietike apo në mënyre endogjene përmes kontaktit të rrezeve UV B me lëkurën e njeriut. Kjo vitaminë nxit absorbimin e kalciumit dhe fosfatit në zorrë duke ndikuar në mirëmbajtjen e shëndetit të eshtrave, dhëmbëve dhe muskujve. Në anën tjetër, roli i vitaminës D si neurosteroid është tashmë i njohur ku ndikimi i saj në rregullimin e faktorëve neurotrofikë, në sinjalizimin e neurotransmiterëve në tru dhe në rritjen e aftësisë anti - inflamatore të neuroneve është vërtetuar përmes studimeve të ndryshme të bëra in vivo apo in vitro.

Qëllimi: Objektivi i këtij rishikimi literature është potencimi i rolit të vitaminës D në trurin e njeriut, spjegimi i mekanizmave përmes të cilave kjo vitaminë ndikon në aftësinë rritëse dhe anti - inflamatore të trurit si dhe funksionin që ajo ka në parandalimin e sëmundjeve neurodegjenerative siq është Alzheimeri, Parkinsoni etj.

Metodologjia: Ky punim paraqet një përmbledhje të literaturës aktuale dhe provave të fundit klinike rreth ndërlidhjes së Vitaminës D dhe zhvillimit të trurit të njeriut.

Diskutimi: Sipas një studimi të kryer tek një grup prej 56 personave të diagnostifikuar me depresion, shtimi i suplementeve tetë - javore me 50, 000 IU / 2 javë vitaminë D rriti përqendrimin e 25(OH)D tek subjektet me depresion të lehtë deri të moderuar dhe përmirësoi ndjeshëm ashpërsinë e depresionit të tyre. Receptorët e Vitaminës D janë të shpërndarë gjerësisht në indin truror dhe forma aktive biologjike e Vitaminës D (1, 25(OH)(2)D3) ka treguar efekte neuroprotektive përfshirë pastrimin e pllakave amiloide, një shenjë dalluese e sëmundjes së Alzhaimerit. Po ashtu është vërtetuar që deficienca e Vitamines D në shtatzënat lidhet me zhvillimin e crregullimeve skizofrenike, demtimit hipoksik të trurit si dhe sëmundje tjera mendore.

Përfundimi: Pas shqyrtimit të rasteve të ndryshme klinike dhe rishikimit të literaturës së fundit në lidhje me rolin e Vitaminës D në neurozhvillim mund të thuhet që kjo vitaminë është një neurosteroid që bart veprimtari kyçe në trurin e njeriut duke ndikuar në aftësinë anti - inflamatore, rritëse dhe sinjalizuese të neuroneve si dhe në parandalimin e sëmundjeve të ndryshme neurodegjenerative dhe më gjerë.

Fjalë kyçe: vitamina D, neurozhvillimi, alzheimeri, absorbim.

MENAXHIMI KIRURGJIKAL I TUMOREVE TË GJËNDRËS MBIVESHKORE.

A. Beqiri[1], A. Gjata[1]

[1]Departamenti i Kirurgjisë së Përgjithshme dhe të Aparatit Tretës, Universiteti i Mjekësisë, QSUT "Nënë Tereza", Fakulteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Hyrje: Incidentalomat mbiveshkore (gjetje rastësore të masave në gjëndrat mbiveshkore) vlerësohet të shfaqen në rreth 2% të rasteve, me shumicën e tyre beninje, dhe vetëm 2% që përfaqësojnë kancer adrenokortikal (Mark Sherlock, 2020). Kompleksiteti strukturor dhe funksional i gjëndrave mbiveshkore lidhet me një gamë të gjerë masash mbiveshkore, secila nga të cilat kërkon një qasje kirurgjikale të individualizuar.

Qëllimi: Të studiohen incidenca dhe karakteristikat e masave mbiveshkore, menaxhimi kirurgjikal dhe rezultatet afatgjata në popullatën shqiptare të pacientëve.

Materiale dhe metoda: Prezantimi i përvojës së menaxhimit të rasteve me masa mbiveshkore të referuara nga Shërbimi i Mjekësisë së Brendshme dhe HTA (Hipertensioni Arterial) në Departamentin e Kirurgjisë së Përgjithshme dhe të Aparatit Tretës në Tiranë, Shqipëri, gjatë periudhës janar 2012 - qershor 2022.

Rezultate: Në total u ndoqën 65 raste, ku shumica prej tyre, 46. 2% (30 / 65), u diagnostikuan si adenoma e Conn - it dhe 38. 5% (25 / 65) si feokromocitoma. Vetëm 3 raste, që përbëjnë 4. 6%, ishin tumore malinje. Metodat kirurgjikale përfshinin kirurgjinë e hapur me qasje anteriore dhe kirurgjinë laparoskopike të aplikuar së fundmi, që treguan rezultate shumë të mira.

Përfundime: Tumoret e gjëndrës mbiveshkore paraqesin një sfidë serioze kirurgjikale dhe përfshijnë një gamë të ndryshme patologjish, ku më të shpeshtat janë adenoma e Conn - it dhe feokromocitoma. Përvoja jonë kirurgjikale bazuar në të dhënat e dhjetë viteve ka demonstruar sigurinë dhe suksesin e qasjes laparoskopike, veçanërisht në tumoret e vogla dhe rastet në fazat e hershme.

Fjalë kyçe: Tumoret mbiveshkore, adenoma e Conn - it, feokromocitoma, kirurgjia laparoskopike.

AVANCIMET DHE SFIDAT AKTUALE TË PACIENTËVE TË HEMODIALIZËS.

Arben Kamami

Abstrakt

Hyrje: Hemodializa vazhdon të mbetet trajtimi më i përdorur për zëvendësimin e funksionit të veshkave te pacientët me sëmundje renale kronike në stad terminal. Gjatë dekadave të fundit janë bërë përparime të mëdha në teknologjinë e dializës, në menaxhimin e aksesit vaskular, në kontrollin e infeksioneve, si dhe në ofrimin e kujdesit të personalizuar dhe të përqendruar te pacienti. Megjithatë, pavarësisht këtyre zhvillimeve, sfida të shumta klinike, biologjike dhe psikosociale vazhdojnë të ndikojnë ndjeshëm në ecurinë terapeutike dhe në cilësinë e jetës së pacientëve që i nënshtrohen hemodializës.

Qëllimi: Ky rishikim literature synon të përmbledhë evidencat aktuale mbi zhvillimet e fundit, sfidat e vazhdueshme dhe strategjitë në zhvillim në lidhje me menaxhimin e pacientëve që i nënshtrohen hemodializës.

Metoda: Një rishikim i kujdesshëm i literaturës u realizua duke përdorur burime të tilla si PubMed, Scopus dhe Science Direct duke përfshirë studime të publikuara midis viteve 2015 dhe 2025. Fjalët kyçe përfshinin hemodializë, SRK, cilësinë e jetës dhe rezultatet e pacientëve. Artikujt përkatës u shqyrtuan dhe u analizuan në mënyrë kritike për të identifikuar temat dhe trendet kryesore.

Rezultate: Studimet e fundit theksojnë rëndësinë e recetave të individualizuara të dializës si dhe integrimin e mjeteve digjitale shëndetësore për monitorimin e pacientëve. Për më tepër, qasjet multidisiplinare që përfshijnë nefrologë, infermierë, dietologë dhe psikologë kanë paraqitur rezultate premtuese në rritjen e rezultateve dhe reduktimin e komplikacioneve. Pavarësisht këtyre avancimeve, pengesa të tilla si mosfunksionimi i aksesit vaskular, rreziqet e infeksionit dhe barra psikosociale mbeten shqetësime të mëdha në kujdesin afatgjatë të hemodializës.

Konkluzione: Inovacioni i vazhdueshëm në teknologjinë e dializës, i shoqëruar me modele kujdesi holistike dhe të përqendruara te pacienti, është thelbësor për përmirësimin e mbijetesës dhe cilësisë së jetës për pacientët e hemodializës. Studimet e ardhshme duhet të përqendrohen në protokollet e trajtimit të personalizuar, strategjitë parandaluese dhe përdorimin e inteligjencës artificiale për të optimizuar rezultatet e dializës.

Fjalë kyçe: hemodializë, SRK, kujdesi për pacientin, cilësia e jetës.

ETIKA PROFESIONALE NË INFERMIERI, RESPEKTIMI DHE SFIDAT.

Arben Krasniqi Msc.

Infermier, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, Prizren, Kosovë, Anëtar, Komisioni për Çështje Etike i OIK, Prishtinë, Kosovë

Abstrakt

Hyrje: Kodi etik përcakton parimet, rregullat, standardin e sjelljes profesionale dhe etikën të cilat infermierët janë të detyruar ta respektojnë. Kodi etik ka për qëllim të ruaj lirinë dhe reputacionin e profesionit infermieror, të rris cilësinë e shërbimeve shëndetësore, të forcojë besimin midis pacientëve dhe infermierëve dhe besimin ndërkolegial, duke respektuar betimin e Hipokratit, betimin e infermierit, të drejtat themelore të njeriut konceptin e autonomisë profesionale dhe të drejtave të pacientëve të parapara sipas ligjit në fuqi.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është sjellja e vëmendjes dhe diskutimi i rëndësisë së etikës profesionale, respektimi i saj dhe sfidat që dalin në respektimin e etikës profesionale infermierore në ditët e sotme.

Metodologjia: Metodologjia e përdorur është përshkruese dhe analitike. Bazë e këtij punimi janë marrë gjetjet gjatë vizitave në institucionet shëndetësore dhe diskutimet me infermierët.

Rezutate: Është vënë re se në përgjithësi, niveli i njohjes së etikës profesionale nga ana e infermierëve, lë për të dëshiruar. Në 60% të rasteve, shkeljet eventuale të etikës profesionale, vijnë si shkak i mosnjohjes së saj sa duhet, në 30% të rasteve të shkeljeve kemi të bëjmë me rastet kur infermierët janë të mbingarkuar me punë dhe vetëm në 10% vërehen se shkeljet etike bëhen për shkaqe ordinere.

Konkluzione: Njohja e pakët e kodit etik vie për shkak të interesimit të ulët për të përcjell risitë sa i përketë legjislacionit nga ana e infermierëve si dhe mungesës së materialeve sensibiliziuese – informuese sa i përketë

kësaj teme në institucionet shëndetësore. Në institucionet shëndetësore (sidomos ato publike), ka munngesë të stafit infermieror dhe mbingarkesa në punë lë pak mundësi për të qenë i kujdesshëm në aspektin etik. Raportimet e shkeljeve/anashkalimeve të etikës janë të mangëta, kryesisht për shkak të mentalitetit të komunitetit. Nevoja për fushata informuese sa i përket etikës profesionale dhe pasojave të rastet e shkeljeve, duhet të jetë prioritet.

Fjalë kyçe: Etikë, punë, infermierë, pacientë, fuqizimi, domosdoshmëri.

NDIKIMI I ALKOOLIT DHE LËNDËVE NARKOTIKE NË AKSIDENTET AUTOMOBILISTIKE.

Arben Lloja, Raisa Varfi

Abstrakt

Ky studim trajton ndikimin e konsumit të alkoolit dhe substancave narkotike në aksidentet automobilistike në Shqipëri, duke e analizuar nga këndvështrimi toksikologjik, mjekoligjor dhe statistikor. Qëllimi kryesor është të evidentohen pasojat psikofizike dhe ligjore të përdorimit të këtyre substancave te drejtuesit e automjeteve, si dhe të shqyrtohen përmasat reale të këtij fenomeni në vendin tonë. Në këtë pjesë të punimit është zhvilluar një analizë statistikore e mbështetur mbi të dhëna të marra nga burime zyrtare si INSTAT, Policia Rrugore dhe Instituti i Mjekësisë Ligjore. Të dhënat janë përpunuar për të pasqyruar shpërndarjen e aksidenteve të ndikuara nga substancat psikoaktive, sipas grupmoshës, gjinisë, rajonit dhe kategorisë së mjetit. Përmes tabelave dhe grafikëve, paraqitet një panoramë përfaqësuese mbi lidhjen ndërmjet përdorimit të substancave dhe rritjes së rrezikut të aksidenteve, me qëllim sensibilizimin institucional dhe publik mbi pasojat mjekoligjore dhe sociale të këtij fenomeni.

Fjalë kyçe: Alkool, substanca narkotike, toksikologji.

INTELIGJENCA ARTIFICIALE (IA) PO REVOLUCIONARIZON GJINEKOLOGJINË ONKOLOGJIKE DUKE PËRMIRËSUAR PARASHIKIMIN, DIAGNOSTIKIMIN DHE TRAJTIMIN E KANCERIT TË QAFËS SË MITRËS DHE PARARENDËSVE TË TIJ SI NEOPLAZIA INTRAEPITELIALE E QAFËS SË MITRËS (CIN).

Arben Pepa[1], Arjan Shtylla[2]

[1]*Departamenti i Obstetrikës dhe Gjinekologjisë, Fakulteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri*

[2]*Departamenti i Obstetrikës dhe Gjinekologjisë, SUOGJ "K. Gliozheni", Tiranë, Shqipëri*

Abstrakt

Modelimi parashikues: Modelet e drejtuara nga IA mund të analizojnë grupe të dhënash komplekse për të parashikuar ashpërsinë e CIN, duke mundësuar ndërhyrje në kohë dhe duke zvogëluar trajtimin e tepërt. Këto modele integrojnë të dhëna demografike, të stilit të jetës, riprodhuese dhe virologjike për të ofruar vlerësime të personalizuara të rrezikut.

Stratifikimi i rrezikut: IA ndihmon në identifikimin e pacientëve me rrezik të lartë, duke lejuar strategji të dedikuara të shqyrtimit dhe trajtimit. Kjo qasje mund të optimizojë shpërndarjen e burimeve, të zvogëlojë procedurat e panevojshme dhe të përmirësojë rezultatet e pacientëve.

Mjekësia e personalizuar: Algoritmet e drejtuara nga IA mund të analizojnë karakteristikat individuale të pacientëve, duke ofruar rekomandime të përshtatura për shqyrtimin, trajtimin dhe kujdesin pasues.

Përfitimet: Saktësi e përmirësuar: Modelet e IA - së mund të zbulojnë modele delikate në të dhëna, duke përmirësuar saktësinë diagnostikuese dhe duke zvogëluar fals pozitivët.

Shpërndarje efikase e burimeve: Stratifikimi i rrezikut i drejtuar nga IA - ja u mundëson ofruesve të kujdesit shëndetësor të përqendrohen te pacientët me rrezik të lartë, duke optimizuar shfrytëzimin e burimeve.

Rezultate të përmirësuara të pacientëve: Duke mundësuar zbulimin dhe ndërhyrjen e hershme, IA kontribuon në rezultate më të mira të trajtimit dhe uljen e morbiditetit.

Teknikat e mësimit uutomatik: Mbështetja e Makinerive Vektoriale (SVM): Efektive në parashikimin e ashpërsisë së CIN dhe dallimin midis lezioneve të gradës së lartë dhe të gradës së ulët.

Mësim i thellë: Mundëson analizën e llojeve komplekse të të dhënave, duke përfshirë imazhet dhe të dhënat gjenomike.

Sfidat dhe drejtimet e ardhshme: Cilësia dhe disponueshmëria e të dhënave: Setet e të dhënave me cilësi të lartë janë thelbësore për trajnimin dhe validimin e modeleve të IA - së.
Bashkëpunim ndërdisiplinor: Integrimi efektiv i IA - së në praktikën klinike kërkon bashkëpunim midis shkencëtarëve të të dhënave, klinicistëve dhe profesionistëve të kujdesit shëndetësor.
Konsiderata etike: Adresimi i shqetësimeve rreth privatësisë së pacientit, paragjykimit algoritmik dhe transparencës është thelbësor për miratimin e përgjegjshëm të IA - së.

Fjalë kyçe: inteligjenca artificiale, kanceri i qafës së mitrës, neoplazia intraepiteliale cervikale (CIN), Makineri Vektoriale e Mbështetur (SVM), mjekësi e personalizuar, onkologji gjinekologjike

TRANSFORMIMI I PRAKTIKËS KLINIKE PËRMES INTELIGJENCËS ARTIFICIALE (AI).

Prof Arben Pilaca
International Hospital of Tirana

Abstrakt
Hyrje: Inteligjenca Artificiale (AI) po e ndryshon me shpejtësi peisazhin e mjekësisë moderne, duke ofruar potencial transformues në diagnostikim, planifikimin e trajtimit dhe menaxhimin e pacientëve. Ky prezantim eksploron integrimin e teknologjive AI në protokollet klinike, duke theksuar si mundësitë ashtu edhe sfidat që shoqërojnë këtë ndryshim paradigme. Unë, në këtë konferencë do të përpiqem të prezantoj aplikacionet kryesore në praktikën klinike të AI, si algoritmet e mësimit të makinerive për zbulimin e hershëm të sëmundjeve, përpunimin e gjuhës natyrore në regjistrat elektronikë të shëndetit dhe analitikën parashikuese për mjekësinë e personalizuar. Studime të rasteve në botën reale ilustrojnë se si mjetet e drejtuara nga AI po përmirësojnë saktësinë diagnostike, po thjeshtojnë detyrat administrative dhe po përmirësojnë rezultatet për pacientët. Megjithëse premton shumë, adoptimi i AI në mjediset klinike ngre pyetje kritike rreth privatësisë së të dhënave, përshtatjes algoritmike dhe nevojës për kuadrin rregullator të fortë.

Fjalë kyçe: AI, transformim, praktikë klinike, pacient etj.

ZBULIMI DHE TRAJTIMI I HERSHËM I SEPSIS NË PRAKTIKËN AMBULATORE.

Dr. Arbër Avdiu, Dr. Agnesa Koxha

Abstrakt
Qëllimi: Sepsis është një nga sfidat më të mëdha në mjekësinë moderne, veçanërisht në ambientin ambulator ku mungojnë mjetet diagnostike të avancuara. Ky punim synon të ofrojë një pasqyrë të qartë mbi njohjen dhe trajtimin e hershëm të sepsis në praktikën e mjekut të familjes, duke theksuar rëndësinë e veprimit të menjëhershëm dhe zbulimin e hershëm.
Metodologjia: Është realizuar një rishikim i literaturës relevante nga vitet 2010–2024, përfshirë udhëzimet ndërkombëtare si "Surviving Sepsis Campaign" dhe përkufizimin Sepsis - 3. Janë shqyrtuar mjetet diagnostike në dispozicion të mjekut të kujdesit parësor (si qSOFA dhe CRP), strategjitë empirike të trajtimit dhe rëndësia e ndjekjes dinamike të pacientëve.
Rezultate: Pavarësisht prezantimit jo specifik klinik, sepsa mund të zbulohet herët përmes vlerësimit të statusit mendor, shenjave vitale dhe përdorimit të skemave të thjeshta si qSOFA. Ndërhyrjet e hershme si fillimi i antibiotikëve dhe administrimi i lëngjeve IV në ambulantë, para dërgimit në spital, mund të ulin ndjeshëm mortalitetin.
Përfundime: Roli i mjekut të familjes është vendimtar në thyerjen e zinxhirit të avancimit të sepsës. Zbatimi i protokolleve të thjeshta, edukimi i pacientëve dhe bashkëpunimi ndërprofesional janë çelës për përmirësimin e mbijetesës së pacinetëve me sepsis.

Fjalë kyçe: Sepsis, trajtim i hershëm, mjek familje.

NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE RINITI ALERGJIK.

Arber Maxhuni

Abstrakt

Hyrje: Riniti alergjik është një sëmundje atopike e karakterizuar nga simptoma si kongjestioni nazal, rhinorrhea, teshtima, rrjedhja post - nazale dhe kruarja e hundës. Prevalenca e tij është rritur me kalimin e viteve së bashku me rritjen e urbanizimin dhe ndotësit mjedisorë, të cilët konsiderohen si disa nga shkaqet kryesore të sëmundjes. Riniti alergjik klasifikohet në rinitin sezonal(intermittent) dhe rinitin perenial(kronik) ku prej të cilave 20% të rasteve janë të tipit sezonal, 40% perenial dhe 40% të dy tipet. Sipas guidelines - it të ARIA - s rinitin alergjik intermittent karakterizohet me simptoma të cilat janë prezente më pak se 4 ditë për javë ose më pak se 4 javë rresht, ndërsa riniti alergjik persistent me simptome prezente më shumë se 4 ditë në javë dhe për më shumë se 4 javë rresht. Qëllimi i trajtimit të rinitit alergjik është lehtësimi i simptomeve. Kjo arrihet përmes këtyre opsioneve terapeutike si: masat e shmangies së alergjenëve, antihistaminic oral, kortikosteroide intranasale apo edhe kombinimi i këtyre të dyjave në formë spreji. Antagonistët e receptorëve të leukotrienëve, alergjen imunoterapia dhe kortikosteroidët oral jane formë tjetër e trajtimit.

Qëllimi: Ky punim ka për qëllim të tregoj aspektet e përgjithshme të rinitit alergjik dhe ndikimin e ndryshimeve klimatike në rritjen e prevalencës dhe ekzacerbimin e simptomave të tij. Gjithashtu impaktin që kanë faktorët si: ndotja e ajrit, ndotësit e trafikut dhe rritja e temperaturave në rinitin alergjik.

Materiali dhe metodologjia: Ky punim paraqet shqyrtimin të literaturës ekzistuese. Kërkimi i literaturës është kryer duke shfrytëzuar bazat e të dhënave si: PubMed Central, Journal of Clinical Medicine, National Library of Medicine (NCBI), Allergy, Asthma & Clinical Immunology, The Journal of Immunology.

Rezultatet dhe konkluzionet: Ekspozimi ndaj NO_2 e rrit rrezikun për rinit alergjik tek personat që ju ekspozohen temperaturave të larta të qëndrueshme. Ndotja e ajrit, veçanërisht nga emetimet e naftës, është treguar se përkeqëson simptomat e AR dhe kontribon në zhvillimin e sëmundjes. Grimcat e shkarkimit të naftës (DEP) dhe ndotësit ajrorë (NO_2, SO_2, PM) përkeqësojnë AR duke rritur përgjigjen imune ndaj alergjenëve. Këto grimca prishin barrierën epiteliale të hundës, duke lejuar alergjenët të depërtojnë më thellë në sistemin e frymëmarrjes. Fexofenadine është i vetmi medikament i testuar për zbutjen e simptomave të AR të përkeqësuara nga grimcat e shkarkimit të naftës. Sipas nje studimi retrospektiv të realizuar në Holandë, gjatë viteve 1995 - 2019, mbi ndikimin e rritjes së temperaturave në rinitin alergjik u konkludua se ndryshimet klimatike kanë ndikuar në rritjen graduale të temperaturës së ajrit, gjegjësisht në zgjatjen e sezonës se polenit. Si rrjedhojë e kësaj SAR filloi 1. 7 ditë më herët dhe zgjati 1. 3 ditë më shumë / vit. O3 dhe bashkë - ekspozimi i temperaturës së lartë përkeqësuan simptomat e rinitit dhe dëmtimin e mukozës së hundës në minjtë. Ekspozimet para dhe pas lindjes ndaj ndotësve të ajrit u shoqëruan me AR të fëmijërisë. Përmes këtij studimi është identifikuar se ekspozimi ndaj ndotësve të ajrit të lidhur me trafikun gjatë tremestrit të tretë të shtatzanisë është shoqëruar me prevalencë më të lartë të AR tek femijët parashkollor. Për të reduktuar rrezikun dhe përkeqësimin e sëmundjeve alergjike respiratore, nevojiten strategji për reduktimin e ndotjes dhe monitorimin e kushteve klimatike.

Fjalë kyçe: riniti alergjik, alergjenët, ndotësit e ajrit, ndryshimet klimatike etj.

URGJENCAT NË UROLOGJI - TRAUMA RENALE: PËRMBLEDHJE DHE RAPORTIME RASTESH.

Neziri A. [1], Demaci Sh. [2], Cuni Xh. 1, Selmani L. [1]

[1]*Klinika e Urologjisë, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Prishtinë, Kosovë*

[2]*Klinika e Kirurgjisë Torakale, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Prishtinë, Kosovë*

Abstrakt

Hyrje: Trauma renale është e pranishme në deri në 5% të të gjitha rasteve të traumave. Më e zakonshme tek burrat e rinj dhe ka një incidencë të përgjithshme të popullsisë prej 4. 9 për 100, 000. Lëndimet e mprehta vijnë nga automjetet, lëndimet, lëndimet sportive, etj. Më saktesisht, tendosja e papritur mund të rezultojë në një dëmtim avulsiv që përfshin enët e gjakut në qafën e hilusit ose pieloureterit (UPJ).

Metoda diagnostikuese: e zgjedhur për traumën renale bazohet në tomografinë kompjuterike me kontrast (CT), e cila është e indikuar te të gjithë pacientët e qëndrueshëm me hematuri të trashë dhe te pacientët që paraqiten me hematuri mikroskopike dhe hipotension. Skanimi me CT duhet të kryhet kur mekanizmi i dëmtimit ose gjetjet e ekzaminimit fizik sugjerojnë dëmtim të veshkave (p. sh. , ngadalësim i shpejtë, fraktura të brinjëve etj.).

Rishikimi: Ne paraqesim një përmbledhje të traumës renale siç ilustrohet nga tre raste interesante të traumës renale të topitura që u trajtuan në Departamentin e Urgjencës dhe Departamentin e Urologjisë. Rasti i parë - pacienti 21 - vjeçar pati një aksident me motoçikletë. Rasti i dytë ishte pacienti 16 - vjeçar që ishte pasagjer në sediljen e pasme në një aksident rrugor. Rasti i tretë ishte pacienti mashkull 17 - vjeçar që pati gjithashtu një aksident me motoçikletë. Të tre pacientët kishin këputje të veshkave të gradës V. Në të gjithë ata ne bëmë nefrektomi shpëtimtare nëpërmjet laparotomisë së vijës së mesit.
Përfundimi: Menaxhimi i traumës renale ka evoluar gjatë dekadave të fundit, me një evolucion të dallueshëm drejt një qasje jo - operative. Pavarësisht kësaj, në disa kushte, metoda e zgjedhur është nefrektomia shpëtimtare nëpërmjet laparotomisë së vijës së mesit.

Fjalë kyçe: trauma renale, klasifikimi, menaxhimi operativ, nefrektomia shpëtimtare.

APLIKIMI I ADJUVANTËVE NË ANESTEZINË SPINALE DHE EPIDURALE.

Arbnor Ukaj
Head of Urgency Department of Prizren

Abstrakt
Hyrja: Anesteza spinale dhe epidurale aplikohen gjatë anestezisë dhe analgjezisë regjionale, gjatë dhe pas interventeve kirurgjike. Përparësia e këtyre dy metodave është e madhe, duke pasur parasysh shkallën e ulët të komplikimeve dhe efekteve anësore. Adjuvantët janë agjentë që përdoren për të zgjatur efektin e anestetikëve lokalë dhe njëkohësisht për të zvogëluar efektet anësore eventuale. Adjuvantët mund të jenë opioidë dhe joopioidë.
Qëllimi: Ky punim ka pasur për qëllim të analizojë aplikimet e adjuvantëve në anestezinë spinale dhe epidurale. Gjithashtu ka eksploruar benefitet dhe efektet anësore të mundshme të llojeve të ndryshme të adjuvantëve.
Materiali dhe metoda: Ky punim është pjesë e hulumtimit të literaturës dhe janë përdorur burimet sekondare prej artikujve me kredibilitet. Këto burime janë marrë prej PubMed, MedLine, dhe The American Journal of Medicine.
Rezultate: Janë analizuar hulumtime eksperimentale me adjuvantët prej dy grupeve, pra opioidë dhe joopioidë. Adjuvantët e hulumtuar janë: klonidina, morfina, sufentanili, fentanili dhe dexamedetomidina. Të dhënat e këtyre eksperimenteve janë krahasuar dhe janë diskutuar me detajet e adjuvantëve që janë dhënë në hyrje të kësaj teme. Adjuvantët që nuk janë hulumtuar janë për shkak të mungesës së literaturës.
Konkluzione: Bazuar ne hulumtimin e literatures dhe rezultatet e hulumtimeve te fundit nderkombetare, konstatojme se përdorimi i adjuvanteve në anestezinë spinale dhe epidurale, në kombinim me anestetikët lokal, ka ndikuar në zgjatjen e kohës së bllokut sensoro - motorik tek pacientët të cilat kanë ndërhyrje të caktuara kirurgjike si dhe ndihmojnë në uljen e dhimbjes postoperatore si dhe ulin efektet anësore të anestetikëve lokal kur administrohen në kombinim me adjuvantët.

Fjalët kyçe: anestezi, spinale, epidurale, anestetik, adjuvantë, opioid, joopioid.

HIDRADENITIS SUPPURATIVA: NJË STUDIM EPIDEMIOLOGJIK PROSPEKTIV NË SHQIPËRI.

Arbnore Tafica, [1] Monika Fida, [1] Ermira Vasili, [1] Ervin Toçi[2] Brunilda Bardhi[3]
[1]*Departamenti i Dermatologjisë, Qendra Spitalore Universitare "Nëna Terezë", Tiranë, Shqipëri*
[2]*Departamenti i Shëndetit Publik, Fakulteti i Mjekësisë, Tiranë*
[3]*Poliklinika Nr. 3, Tiranë, Shqipëri*

Abstrakt
Hyrje: Hidradenitis suppurativa (HS) është një sëmundje kronike inflamatore e njësisë pilosebace, shpesh e nën - diagnostikuar dhe me ndikim të rëndësishëm në cilësinë e jetës. Të dhënat epidemiologjike për HS në Shqipëri dhe në Ballkan janë të kufizuara.
Qëllimi: Të vlerësohet prevalenca, karakteristikat demografike, klinike dhe faktorët e rrezikut të HS në popullatën shqiptare.

Metoda: U krye një studim prospektiv me qendër të vetme, duke përfshirë 43 pacientë me HS të diagnostikuar sipas udhëzimit evropian S1 për trajtimin e HS (Zouboulis et al. , 2015) gjatë periudhës 2020–2022. U analizuan të dhënat demografike, klinike, fenotipet, BMI, zakonet e pirjes së duhanit dhe komorbiditetet.
Rezultate: Prevalenca e HS në Tiranë u vlerësua 0. 0085%. Raporti mashkull / femër ishte 1. 5: 1 (60% meshkuj), me grupmoshën më të prekur 19–29 vjeç. Në total, 33% kishin histori familjare të HS, 53% ishin duhanpirës dhe 46. 5% obezë. Shumica e pacientëve (67%) ishin në stadet Hurley II–III, me kohë mesatare të vonesës diagnostike 2. 9 vjet. Lokalizimi më i shpeshtë ishte aksilar (65%), fenotipi mbizotërues inflamator (95. 3%) dhe 51% kishin komorbiditete (më së shpeshti çrregullime endokrine, akne dhe sinus pilonidal).
Konkluzione: Studimi ynë ofron të dhëna të vlefshme mbi epidemiologjinë e HS në Shqipëri, duke theksuar dallimet nga Europa Perëndimore dhe bota. Gjetjet nënvizojnë nevojën për studime kombëtare gjithëpërfshirëse me kritere të unifikuara diagnostikuese për të siguruar të dhëna demografike më të sakta.

Fjalë kyçe: Hidradenitis suppurativa, sëmundje kronike, inflamacion, demografi etj.

ROLI I PADISKUTUESHËM I TEKNIKUT TË ANESTEZISË NË URGJENCAT KIRURGJIKALE: ANALIZË RETROSPEKTIVE E PËRVOJËS ME 100 RASTE NË SHËRBIMIN TONË.

Ardian Balla[1] Kristi Meçolli[1], Ervin Bekteshi MD[1], Krisli Serani MD[2]
[1]Shërbimi i Anetsezi Reanimacion Trita Hospital
[2]Shërbimi i Anestezi Reanimacion, QSUT

Abstrakt
Hyrje: Urgjencat kirurgjikale kërkojnë reagim të menjëhershëm, koordinim të saktë dhe funksionim optimal të ekipit multidisiplinar. Brenda këtij ekipi, tekniku i anestezisë ka një rol jetik në përgatitjen, sigurimin dhe monitorimin e pacientit për ndërhyrje të menjëhershme. Përgatitja teknike, reaktiviteti dhe profesionalizmi i tij ndikojnë drejtpërdrejt në suksesin e procedurës anestezike dhe kirurgjikale.
Qëllimi: Të vlerësohet roli i teknikëve të anestezisë në menaxhimin e rasteve kirurgjikale urgjente dhe ndikimi i tyre në ecurinë perioperative dhe post - operative të pacientëve.
Materiale dhe Metoda: U realizua një analizë retrospektive e 100 rasteve urgjente kirurgjikale të kryera në spitalin tonë gjatë periudhës janar 2024 – maj 2025, ku tekniku i anestezisë ishte pjesë aktive e ekipit intraoperativ. Rastet përfshinin ndërhyrje emergjente për apendicit akut, peritonit, hemorragji intraabdominale, trauma torako - abdominale dhe ndërhyrje gjinekologjike urgjente. U analizuan roli i teknikëve në: përgatitjen e sallës, vendosjen e linjave venoze, asistencën gjatë intubimit, monitorimin vital, menaxhimin e barnave, si dhe dokumentimin intraoperativ.
Rezultate: Në të gjitha rastet, tekniku i anestezisë luajti rol kyç në përgatitjen e mjedisit të sigurt anestezik, duke reduktuar kohën e induksionit dhe rritur efikasitetin e ekipit. Në 86% të rasteve, tekniku siguroi akses venoz të menjëhershëm në kushte të vështira. Në 12% të ndërhyrjeve, kontributi i tyre gjatë komplikacioneve të papritura (hipotension, bronkospazëm) ishte vendimtar për stabilizimin e pacientit. Nuk u raportuan gabime teknike në përgatitjen e pajisjeve apo barnave, duke dëshmuar për përgatitjen dhe vigjilencën profesionale të këtij roli.
Rekomandime: Rekomandohet fuqimisht standarizimi i trajnimeve, përfshirja aktive në simulime emergjente dhe vlerësimi periodik i teknikëve të anestezisë si pjesë thelbësore e sigurisë pacientit në urgjenca kirurgjikale.
Konkluzione: Tekniku i anestezisë është një hallkë e pazëvendësueshme në menaxhimin e suksesshëm të urgjencave kirurgjikale. Përvoja jonë tregon se prania dhe përgatitja e tyre e ul ndjeshëm kohën e reagimit, rrit sigurinë perioperative dhe përmirëson ndjeshëm rrjedhën e procedurave kirurgjikale në kushte emergjente. Në ambientin kompleks dhe dinamik të sallës operatore, roli i teknikut të anestezisë është i pazëvendësueshëm. Ai përfaqëson bashkëpunëtorin më të afërt të anestezistit, duke garantuar përgatitjen teknike të aparaturave, sigurinë e barnave anestezike dhe mbështetjen gjatë gjithë periudhës perioperatore. Pavarësisht rëndësisë së këtij roli, shpesh ai mbetet në hije dhe nënvlerësohet në diskursin profesional.

Fjalë kyçe: urgjenca kirurgjikale, anestezi, akses venoz, aparatura.

ROLI I ALPRAZOLAMIT NË MJEKIMIN E ÇRREGULLIMIT TË ANKTHIT.

Dr. Ardian Braho

Abstrakt

Hyrje: Çrregullimet e ankthit përbëjnë një grup të gjërë çrregullimesh psikiatrike me prevalencë të lartë në popullatën e përgjithshme dhe ndikim të theksuar në funksionimin psikosocial të individëve. Alprazolami, një benzodiazepinë me veprim të shkurtër dhe fillim të shpejtë, përdoret gjerësisht për trajtimin simptomatik të ankthit dhe çrregullimit të panikut.

Qëllimi: Ky punim synon të analizojë rolin klinik të Alprazolamit në menaxhimin e çrregullimeve të ankthit, efektet farmakologjike, efikasitetin terapeutik, si dhe kufizimet dhe rreziqet e mundshme të përdorimit të tij.

Materiale dhe metoda: Është realizuar një rishikim i literaturës shkencore përmes databazave PubMed, Medline dhe Cochrane, duke përzgjedhur artikuj të publikuar në 20 vitet e fundit që trajtojnë përdorimin e Alprazolamit në trajtimin e çrregullimeve të ankthit. Janë analizuar të dhëna nga studime klinike, përmbledhje sistematike dhe udhëzime ndërkombëtare.

Rezultate: Alprazolami vepron si agonist allosterik pozitiv i receptorëve GABA - A, duke rritur aktivitetin frenues të këtij neurotransmetuesi dhe duke reduktuar excitabilitetin neuronal. Ai tregon efikasitet të lartë në kontrollin afatshkurtër të simptomave të ankthit akut dhe çrregullimeve të panikut. Megjithatë, përdorimi afatgjatë shoqërohet me rrezik të lartë për zhvillimin e tolerancës, varësisë, abuzimit dhe sindromës së tërheqjes. Për këtë arsye, përdorimi i tij rekomandohet për periudha të kufizuara dhe nën mbikëqyrje mjekësore, duke marrë në konsideratë edhe alternativat farmakologjike me profil më të favorshëm të sigurisë.

Përfundime: Alprazolami përbën një alternativë efektive për trajtimin afatshkurtër të simptomave të ankthit, por kërkon kujdes të shtuar në përdorim për shkak të potencialit për varësi. Kombinimi me psikoterapi dhe përdorimi i barnave alternative si SSRI dhe SNRI mund të ofrojë një qasje më të qëndrueshme dhe më të sigurt në trajtimin afatgjatë të çrregullimeve të ankthit.

Fjalë kyçe: Alprazolami, çrregullimi i ankthit, benzodiazepina, GABA - A, varësia, çrregullimi i panikut, anksiolitikë, farmakoterapi.

PREZANTIM RASTESH: SHKAQET ENDOKRINOLOGJIKE TË HIPOKALEMISË DHE ROLI I EKG - SË NË DIAGNOSTIKIMIN E TYRE.

Ardian Dika[1], Vjollca Hashani[1], Baton Bekeri[2], Riza Selimi[2]

[1]Klinika e Endokrinologjise, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Prishtinë, Kosovë

[2]Qendra Emergjente, Qendra Kliinike Universitare e Kosovës, Prishtinë, Kosovë

Abstrakt

Hipokalemia definohet si kaliumi në gjak nën 3. 5 mmom / l. Shumë sëmundje endokrine shoqërohen me hipo / hiperkalemi sepse hormonet luajnë rol kyç në metabolizmin e kaliumit. Mekanizmat prapa hipokalemisë në çrregullimet endokrinologjike përfshijnë zhvendosjen intracelulare të K^+, eksesin mineralokortikoid dhe çrregullimet acido - bazike me ekskretimin renal të kaliumit. Meqenëse simptomet në fillim janë jospecifike, hipokalemia është shpesh treguesi i parë që tërheq vërejtjen drejt sëmundjes endokrine. Në përgjithësi nuk ekziston ndonjë korrelacion i mirë mes nivelit të kaliumit dhe simptomeve klinike. Nga ana tjetër, ndryshimet në EKG korrelojnë mirë me shkallën e hipokalemisë, sadoqë kjo nuk është gjithmonë lineare. Mund të ndodh që hipokalemia e moderuar të shoqërohet me ndryshime të theksuara në EKG, sikurse që mund të ketë hipokalmi të thellë me EKG pothuajse normale. Në këtë punim po prezantojmë katër raste që ilustrojnë vlerën diagnostike të EKG - së në hipokalemitë si pasojë e çrregullimeve endokrine. Dy rastet e para janë pacientë me hipertension rezistent kohëgjatë, të diagnostikuar me sëmundje të Conn - it, respektivisht hiperplazi adrenale primare, falë ndryshimeve në EKG. Rasti i tretë është një pacient me sëmundje Cushing me depresione difuze të segmentit ST, zgjatje të intervalit QT dhe valën U. Rasti i katërt është pacient me sëmundje Grejvs që ka zhvilluar hipokalemi në kuadër të paralizës periodike tireotoksike. Kjo seri e rasteve klinike thekson rëndësinë e EKG - së në diagnostikimin e çrregullimeve endokrine që prezantojnë me hipokalemi. Klinicistët duhet të kenë indeks të lartë të dyshimit për patologji endokrine në rastet e hipokalemive të paqarta, posaçërisht në prezencë të ndryshimeve në EKG, edhe në rastet kur simptomet janë subtile apo jo - specifike. Identifikimi i hershëm i këtyre ndryshimeve mundëson diagnostikimin dhe trajtimin me kohë dhe ndihmon në parandalimin e komplikimeve.

Fjalë kyçe: sëmundjet endokrine, hipokalemia, ndryshimet në EKG.

LIPOPROTEINA(A): RËNDËSIA KLINIKE DHE ZHVILLIMET E FUNDIT TERAPEUTIKE.

Ardit Bislimaj[1], Rina Skeraj
[1]PhDc, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë

Abstrakt
Hyrje: Rritja e niveleve të lipoproteinës(a) [Lp(a)] paraqet një faktor rreziku të pavarur për sëmundjet kardiovaskulare aterosklerotike. Ndryshe nga LDL, nivelet e Lp(a) - së janë kryesisht të përcaktuara gjenetikisht dhe qëndrojnë relativisht të pandryshueshme gjatë jetës, si dhe nuk ndikohen nga stili i jetesës e as nga barnat klasike anti - lipidike. Deri më sot nuk ekziston një terapi që targeton specifikisht Lp(a) - në, prandaj trajtimi specifik për të është ende në studim e sipër. Përmes këtij punimi jemi përpjekur të sjellim disa nga të dhënat më të fundit rreth rëndësisë klinike të Lp(a) - së dhe opsioneve terapeutike që janë treguar premtuese.
Metodologjia: Ky punim përbën një rishqyrtim literature, për të cilin janë marrë të dhëna nga databazat e mëdha ndërkombëtare, si Pubmed, Cochrane, Embase dhe ClinicalTrials. gov. Kërkimi është kufizuar në punimet e publikuara në 5 vitet e fundit, me fokus të veqantë në barnat të cilat targetojnë specifikisht lipoproteinën(a) [Lp(a)].
Rezultate: Studimet e deritanishme observacionale dhe meta - analiza të ndryshme, ndërlidhin nivelet e larta të Lp(a) - së (> 50 mg / dl), me rrezik të shtuar për shumë sëmundje, përfshirë sëmundjet kardiovaskulare aterosklerotike, stenozën aortike, insultin cerebrovaskular iskemik, insuficiencën kardiake, fibrilacionin atrial dhe sëmundjen e arterieve periferike (PAD). Në disa raste klinike, koncentrimet e larta të Lp(a) - së mund të jenë edhe më aterogjenike sesa LDL. Në shumë udhërrëfyes rekomandohet të paktën një matje e Lp(a) - së gjatë jetës, mirëpo në praktikë implementimi i saj mbetet suboptimal. Sa i përket trajtimit, ndryshe nga statinat të cilat janë treguar joefektive në uljen e Lp(a) - së, PCSK9 inhibitorët janë treguar të sukseshëm në uljen jo vetëm të LDL - së por edhe të Lp(a) - së. Barnat që targetojnë specifikisht Lp(a) - në sikurse oligonukleotidet antisense (pelacarsen - i), “small interfering RNAs” (olpasiran, lepodisiran dhe zerlasiran), si dhe inhibuesit oral (muvalaplin) janë në fazat e fundit të testimit klinik dhe kanë treguar ulje të niveleve plazmatike të Lp(a) - së deri në 90%. Duhet theksuar se afereza lipoproteinike është e vetmja terapi e aprovuar nga FDA për trajtim të niveleve të larta të Lp(a) - së (vetëm te pacientët me hiperkolesterolemi familjare dhe nivele të LDL - C > 100 mg / dl), me reduktim prej së paku 65 % pas një sesioni të vetëm. Studimet poashtu kanë treguar që ulja e niveleve të LDL - C - së redukton edhe rrezikun kardiovaskular të lidhur me Lp(a) duke e bërë targetimin e LDL - C - së një strategji të rëndësishme në praktikën klinike.
Përfundime: Lp(a) ka impakt të lartë në sëmundshmëri, prandaj trajtimi për uljen e niveleve të saj ka rëndësi të madhe klinike. Momentalisht barnat në dispozicion për zvogëlimin e Lp(a) - së janë të limituara. Është e nevojshme të kryhen studime klinike të reja të cilat analizojnë jo vetëm opsionet e trajtimit por edhe profilin e sigurisë të barnave në fjalë.

Fjalë kyçe: Lipoproteina a, LDL - C; trajtimi, sëmundjet kardiovaskulare.

INCIDENCA E SEPSIS DHE TRAJTIMI I TYRE NË KLINIKËN INFEKTIVE TË QENDRËS KLINIKE UNIVERSITARE TË KOSOVËS.

Ardit Emini

Abstrakt
Hyrje: Sepsis është një sëmundje kërcënuese për jetën e shkaktuar nga reagimi i trupit tuaj ndaj një infeksioni. Sistemi juaj imunitar ju mbron nga shumë sëmundje dhe infeksione, por është gjithashtu e mundur që ai të mbingarkohet si përgjigje ndaj një infeksioni që mund të qoj në përgjigje të crregulluar të sistemit imunitar e cila qon deri te dëmtimi i organizmit. Pra është një gjendje që kërkon intervenim të shpejtë dhe me vdekshmëri të lartë deri 25 % dhe me pasoja të shumta edhe pas shërimit.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është që te hulumtohen rastet me sepsis në klinikën infektive në QKUK gjatë vitit 2019. Në këtë punim do te hulumtohet incidenca e tyre gjatë vitit 2019, krahasimi i incidencës me sëmundjet

tjera infektive, të dhënat demografike të rasteve me sepsis, etiologjia, trajtimi, koha e qëndrimit në spital dhe përfundimi i tyre. Në bazë të këtij studimi ne mund të dalim në përfundime se sa është e rrezikshme sepsa si sëmundje dhe si mund ta parandalojmë atë.
Materiali dhe metoda: Studimi është bazuar në hulumtim retrospektiv kuantitativ për sepsin gjatë vitit 2019. Të dhënat demografike, incidenca, shkaktari, trajtimi, hospitalizimi, përfundimi janë mbledhur në mënyrë retrospektive nga 81 pacientë të hospitalizuar në klinikën infektive të QKUK – së në Prishtinë me sepsis në periudhën janar 2019 – qershor 2019.
Rezultate: Numri i pacientëve të hulumtuar për periudhën kohore janar 2019 – qershor 2019 është 81 pacientë ose 5. 2 % të të gjitha sëmundjeve infektive, ku prej tyre 56. 8 % ishin meshkuj dhe 43. 2 % ishin femra, prej tyre kanë vdekur 23. 5 % kurse 76. 5 % të pacientëve përfunduan gjallë. Më shumë të vdekur ishin nga gjinia mashkullore me 52. 6 %, kurse gjinia femrore me 47. 4 %. Prejardhja apo origjina e sepsisit ishte në shumicën e rasteve sistemi urinar me 40. 7 % dhe sistemi respirator me 22. 2 %. Sepsis ishte më shumë e pranishme në moshat e vona mbi 60 vjeç me 70. 6 %. Numri më i madh i pacientëve me sepsis që morrën trajtim në QKUK ishte nga komuna e Prishtinës me 33. 3 %.
Përfundimi: Sepsa ka ende një incidencë dhe vdekshmëri të lartë në Kosovë dhe duhet punuar më shumë për parandalimin e saj.

Fjalë kyçe: Sepsis, incidenca, trajtimi, klinika infective.

NDIKIMI I PËRMIRËSIMIT TË INFRASTRUKTURËS SPITALORE NË INFEKSIONET KIRURGJIKALE.

Ardit Kacani

Abstrakt
Hyrje: Infeksionet kirurgjikale janë tipi i dytë më i shpeshtë i infeksioneve nosokomiale. Ato përfaqësojnë një nga ndërlikimet kryesore te pacientët që i janë nënshtruar një operacioni, me implikime të mëdha në aspektin e sëmundshmërisë, duke përfshirë procedurat shtesë kirurgjikale ose transferimin në një njësi të kujdesit intensiv, vdekshmërinë, kohëzgjatja më e gjatë e qëndrimit në spital dhe barra financiare. Qëllimi i këtij studimi është të përcaktojë frekuencën e infeksioneve kirurgjikale në shërbimin e kirurgjisë digjestive, në një spital të kujdesit terciar, QSUNT dhe të identifikojë faktorët e riskut.
Metodologjia: U grumbulluan të dhënat e 429 pacientëve, të operuar në Klinikën 3 të kirurgjisë digjestive, QSUNT, për një periudhe 3 - mujore, 01. 05. 2024 - 30. 07. 2024. Kampioni i rasteve përbëhet nga pacientë të moshës adulte (n=12) dhe studimi është i tipit retrospektiv dhe deskriptiv. Për klasifikimin e infeksioneve kirurgjikale të plagës u përdor sistemi CDC. Shpërndarja e rasteve u bë sipas moshës, gjinisë, sëmundjeve bashkëshoqëruese, patogjenëve shkaktarë.
Rezultate: Në studim u përfshinë 429 pacientë që iu nënshtruan ndërhyrjeve kirurgjikale. Nga krahasimi i vlerave të infeksioneve të plagës me periudha më të hershme kohore u vu re një rënie e këtyre vlerave. Përqindja totale e infeksionit ishte në shifrat 2. 79%. Faktorë risku të rëndësishëm u panë që ishin interventet e klasifikuara si probabilisht të kontaminuara. Enterococcus faecalis ishte patogjeni i izoluar më i zakonshëm. Sëmundjet bashkëshoqëruese më të shpeshta ishin HTA dhe DM2.
Konkluzione: Ky studim ndihmon në identifikimin e faktorëve kryesorë të riskut që mund të synohen si pikë referimi për përmirësim. Prandaj, midis mjeteve të parandalimit, integrimit të metodave të avancuara kirurgjikale, mbikëqyrjes së vazhdueshme, identifikimi dhe kontrolli i faktorëve të njohur të rrezikut, ka rezultuar të jetë faktor i pavarur për uljen afatgjatë të incidencës së SSI, duke përmirësuar në fund rezultatet dhe sigurinë e pacientëve.

Fjalë kyçe: infeksione nosokomiale, infeksione të plagës, faktorë risku, parandalim, infrastrukturë spitalore.

APPENDEKTOMIA DHE TRAJTIMI LAPAROSKOPIK I TIJ, PËRPARËSITË NDAJ METODËS KONVENCIONALE.

Arian Haxhosaj, Floren Kavaja, Fatos Haxhosaj
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina "
Kavaja Hospital,
Spitali i Përgjithshëm "Isa Grezda " - Gjakovë

Abstrakt
Hyrje: Apendiciti akut është një nga urgjencat kirurgjikale abdominale më të shpeshta në mbarë botën. Trajtimi standard është apendektomia, e cila mund të kryhet përmes metodës konvencionale (të hapur) ose asaj laparoskopike. Ky studim synon të analizojë dhe të krahasojë rezultatet klinike të të dyja metodave për të evidentuar përparësitë e qasjes laparoskopike.
Metodologjia: Ky studim analitik krahasues përfshiu një total prej rreth 100 pacientësh të diagnostikuar me apendicit akut. Pacientët u ndanë në dy grupe: Grupi A (n=50) iu nënshtrua apendektomisë konvencionale, ndërsa Grupi B (n=50) iu nënshtrua apendektomisë laparoskopike. Të dhënat u mblodhën në mënyrë retrospektive. Ne kemi krahasuar pikat kryesore si kohëzgjatja e operacionit, koha e qëndrimit në spital, kohëzgjatja e terapisë post - operative, shkalla e infeksioneve të plagës, madhësia e incizionit, incidenca e hernieve post - incizionale dhe cilësia e vizualizimit të kavitetit abdominal.
Rezultate: Appendektomia laparoskopike tregoi një kohë operacioni mesatarisht pak më të gjatë (65 min) krahasuar me metodën e hapur (50 min). Megjithatë, grupi laparoskopik demonstroi përparësi të konsiderueshme në parametrat e tjerë: kohë më e shkurtër e qëndrimit në spital (1. 8 ditë kundrejt 4. 2 ditë), nevojë më e reduktuar për terapi analgjezike post - operative, shkallë më e ulët e infeksioneve të plagës (2% kundrejt 8%), incizione dukshëm më të vogla (porte 5 - 10 mm kundrejt një incizioni 5 - 8 cm), dhe mungesë të hernieve post - incizionale (0% kundrejt 4%). Vizualizimi i kavitetit abdominal ishte superior në grupin laparoskopik.
Përfundime: Pavarësisht një kohe operacioni pak më të zgjatur, apendektomia laparoskopike ofron përparësi të qarta klinike ndaj metodës konvencionale, duke përfshirë rikuperim më të shpejtë të pacientit, më pak dhimbje post - operative, rrezik më të ulët të komplikimeve si infeksionet dhe herniet, dhe rezultate më të mira kozmetike. Këto gjetje mbështesin fuqimisht përdorimin e apendektomisë laparoskopike si metodë të preferuar për trajtimin e apendicitit akut në rastet e përshtatshme.

Fjalë kyçe: Apendiciti akut, appendektomi laparoskopike, appendektomi konvencionale, rezultatet postoperative, kirurgji minimalisht invazive.

EDUKIMI TERAPEUTIK I PACIENTIT.

Ariana Pojani

Abstrakt
Hyrje: Edukimi terapeutik i pacientit është një komponent thelbësor i kujdesit shëndetësor bashkëkohor. Ai i mundëson pacientit të kuptojë më mirë gjendjen e tij shëndetësore dhe të marrë pjesë aktive në menaxhimin e saj. Në mjedisin spitalor, mami luan një rol të rëndësishëm në këtë proces, sidomos në drejtim të përmirësimit të komunikimit dhe rritjes së ndërgjegjësimit të pacientes për shëndetin e saj.
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të evidentojë rëndësinë e edukimit terapeutik në përkujdesjen spitalore dhe të theksojë rolin e mamisë në këtë proces, si dhe të analizojë marrëdhënien komunikative midis pacientes dhe mamisë nga të dy këndvështrimet.
Metodologjia: Studimi mbështetet në një analizë cilësore të praktikave të edukimit terapeutik në nivel klinik, duke shqyrtuar literaturën përkatëse dhe përvojat nga praktika spitalore. Vëmendje e veçantë i është kushtuar aspektit komunikativ midis mamisë dhe pacientes, përmes vëzhgimeve dhe përshkrimeve të situatave reale.
Sintezë: Komunikimi efektiv midis pacientes dhe mamisë është një element kyç për suksesin e edukimit terapeutik. Nga këndvështrimi i pacientes, ndjeshmëria, empatia dhe qartësia e informacionit janë thelbësore për ndërtimin e besimit. Ndërsa nga perspektiva e mamisë, edukimi kërkon qasje individuale, durim dhe aftësi të mira ndërpersonale.

Përfundime: Edukimi terapeutik kontribuon në rritjen e pavarësisë së pacientes dhe përmirësimin e rezultateve shëndetësore. Mami, si pjesë integrale e ekipit shëndetësor, ka një rol të pazëvendësueshëm në këtë proces përmes edukimit, motivimit dhe komunikimit të vazhdueshëm.

Fjalë kyçe: Edukimi terapeutik, pacientja, mami, komunikimi klinik, ndërgjegjësimi shëndetësor, marrëdhënia pacient - profesionist.

NDËRPRERJA E FEEDBACK - UT MES ZEMRËS DHE VESHKAVE: NJË KËNDVËSHTRIM PRAGMATIK MBI SINDROMAT AKUTE KARDIORENALE (TIPI 1 DHE 3)

Ariana Strakosha, Amantia Imeraj, Ambra Methasana, Nevi Pasko, Vilma Cadri
Departamenti i Nefrologjisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Hyrje: Sindromat akute kardiorenale janë një problem dypalësh: një dëmtim i papritur i zemrës mund të shkaktojë dëmtime në veshka (tipi 1), dhe një dëmtim i papritur i veshkave mund të shkaktojë dëmtime në zemër (tipi 3). Këto gjendje janë të shpeshta në kardiologji, nefrologji dhe në pacientët e njësive të kujdesit intensiv dhe lidhen me rrezik të lartë afatshkurtër. Dëmtimi nuk vjen vetëm nga perfuzioni i ulët i gjakut — grumbullimi i lëngjeve në venat, aktivizimi i tepërt i hormoneve (sistemi RAAS dhe sistemi simpatik), inflamacioni i enëve të vogla dhe presioni i lartë intraabdominal janë faktorë të rëndësishëm kontribuues. Përmbledhje klinike: Në sindromën kardiorenale tip 1 (CRS), dekompensimi i papritur i zemrës shkakton ishemi tubulare dhe rritje të reabsorbimit të natriumit përmes ndryshimeve të shpejta të pre - load dhe after - load, aktivizimit të sistemit simpatik dhe RAAS - it, si dhe stresit oksidativ—gjë që përkeqëson kongjestionin. Në sindromën kardiorenale tip 3, dëmtimi akut i veshkave nga sepsa, ishemia ose nefrotoksinat shkakton çrregullime elektrolitike dhe acid - bazike, akumulim të toksinave uremike dhe inflamacion miokardial, duke rezultuar në aritmi dhe dëmtime të kontraktilitetit të zemrës. Fenotipizimi i hershëm në shtrat është thelbësor. Në kontekstin tonë—ku nuk janë në dispozicion markerët NGAL dhe cystatin C—përqendrohemi në mjete praktike: monitorimin e hemodinamikës dhe kongjestionit (presioni i gjakut, frekuenca kardiake, presioni venoz i jugularit, edema, diureza orare, pesha ditore), ultrazërit në vend (linjat B të mushkërive, vena cava inferior / VExUS) dhe trendet laboratorike rutinë (kreatinina dhe ura në seri, elektrolitet, gazrat e gjakut). Kur janë të disponueshme, troponina dhe NT - proBNP ndihmojnë në vlerësimin e rrezikut kardiak. Indikatorët urinare (natriumi i urinës së rastësishme, Fraksioni i Ekskretimit të Natriumit dhe Urës) dhe testi i përgjigjes ndaj diuretikëve ndihmojnë në dallimin midis mungesës së volumit dhe mbingarkesës venoze, duke mundësuar terapi të synuar për dekongjestion ose përmirësim të perfuzionit pa u mbështetur në biomarkerë të paqasshëm. Menaxhimi: Plani i koordinuar kardiorenal duhet të përfshijë: dekongjestionin fillestar me diuretikë të llojit loop (duke konsideruar bllokimin sekencial të nefronit me tiazide) dhe ultrafiltrim të kujdesshëm në rast rezistence ndaj diuretikëve ose edema të zorrëve që pengon përgjigjen; optimizimin e perfuzionit me vazodilatatorë / inotropë kur është e nevojshme, duke shmangur hipotensionin iatrogenik; korrigjimin e shkaktarëve (sepsa, nefrotoksinat, kontrasti) dhe faktorëve metabolikë; fillimin e hershëm të terapi modifikuese të sëmundjes pas stabilizimit—veçanërisht inhibitorët e SGLT2—për mbrojtje të dyfishtë zemër - veshkë. Rëndësi ka kryerja e vizitave multidisiplinare dhe rivlerësimeve të shpeshta (diureza, pesha, ultrazëri, niveli i laktatit) për dozimin e terapisë.
Përfundime: Sindromat akute kardiorenale tip 1 dhe 3 bazohen në një cikël vetë - forcues të kongjestionit dhe inflamacionit. Fenotipizimi i hershëm, terapia e synuar për dekongjestion dhe fillimi i hershëm i trajtimeve mbrojtëse për organet ofrojnë mundësinë më të mirë për ndërprerjen e këtij cikli dhe përmirësimin e rezultateve klinike. Studime të ardhshme duhet të përmirësojnë mjetet parashikuese dhe algoritmet terapeutike që personalizojnë dekongjestionin duke ruajtur perfuzionin renal.

Fjalë kyçe: Sindroma kardiorenale, kongjestion, inflamacion, toksina uremike.

ZGJATJA E VERDHËZËS TEK FOSHNJAT NË QENDRËN KLINIKE UNIVERSITARE TË KOSOVËS GJATË VITIT 2020.

Arianit Bajraktari[1]
[1]*Fakulteti i Mjekësisë, Prishtinë, Kosovë*

Abstrakt

Hyrje: Verdhëza neonatale është zverdhja e lëkurës dhe e të bardhës së syve tek një foshnjë e porsalindur për shkak të niveleve të larta të bilirubinës. Simptoma të tjera mund të përfshijnë përgjumje të tepërt ose refuzim për të ngrënë. Komplikimet mund të përfshijnë konvulsione, paralizë cerebrale ose kernicterus. Rreth 60% e foshnjave të porsalindura dhe 80% e foshnjave të parakohshme mund të kenë verdhëz. Në shumicën e rasteve nuk ka ndonjë çrregullim specifik themelor (fiziologjik). Në raste të tjera rezulton nga shkatërrimi i rruazave të kuqe të gjakut, sëmundje të mëlçisë, infeksion, hipotiroidizëm ose çrregullime metabolike (patologjike). Një nivel bilirubine prej më shumë se 34 μmol / l (2 mg / dL) mund të jetë i dukshëm. Shqetësimet tek foshnjat e shëndetshme ndodhin kur nivelet janë më të mëdha se 308 μmol / L (18 mg / dL). Veçoritë kryesore të hiperbilirubinemisë patologjike janë: verdhëza shfaqet në orët e para pas lindjes (icterus praecox), përparon shpejt, është më intensive se fiziologjike (icterus gravis) dhe zgjat shumë (icterus prolongatus). Në ata me gjetje shqetësuese, rekomandohet hetim i mëtejshëm për të përcaktuar shkakun themelor. Në nivel global, mbi 100, 000 foshnja të lindura para kohe dhe të vonuara vdesin çdo vit si rezultat i verdhëzës. Trajtimi: Nivelet e bilirubinës ndryshojnë me moshën dhe gjendjen shëndetësore të të porsalindurit. Megjithatë, çdo i porsalindur me një vlerë totale të bilirubinës në serum më të madh se 359 μmol / l (21 mg / dL) duhet të marrë fototerapi. Foshnjat me verdhëz neonatale mund të trajtohen me dritë me ngjyrë të quajtur fototerapi, e cila funksionon duke ndryshuar trans - bilirubin në izomer cis - bilirubin të tretshëm në ujë. Fototerapia nuk është terapi me rreze ultravjollcë, por një frekuencë specifike e dritës blu. Drita mund të aplikohet me llamba ajri, që do të thotë që sytë e foshnjës duhet të jenë të mbuluara, ose me një pajisje të quajtur bilibanket, e cila ulet nën veshjen e foshnjës afër lëkurës së tij. Përdorimi i fototerapisë u zbulua për herë të parë në Spitalin Rochford në Essex, Angli, kur një infermiere, infermierja Jean Ward, vuri re se foshnjat e ekspozuara ndaj dritës së diellit kishin reduktuar verdhëzën dhe një patolog Dr. Perryman, i cili vuri re se një pikë gjaku kishte mbetur në dielli u bë i gjelbër. Dr. Cremer, Richards dhe Dobbs i kombinuan këto vëzhgime, duke çuar në një provë klinike të rastësishme që u botua në Pediatrics në 1968 dhe iu deshën dhjetë vjet të tjera për t'u ekzekutuar. Aktualisht nuk ka asnjë provë të besueshme nëse fototerapia e aplikuar në shtëpi ose në spital është më efektive për foshnjat me verdhëz.

Objektiva: Qëllimi i këtij punimi është të fitojë njohuri të përditësuara rreth verdhëzës në latente dhe punimi do të fokusohet kryesisht në: frekuencën, etiologjinë, faktorët predispozues, patofiziologjinë, gjenetikën, shenjat dhe simptomat, manifestimet sistemike, format e verdhëzës, diagnozën, trajtimin dhe shtrirja e verdhëzës në latente. Objektivi i këtij punimi është të hetojë rastet e verdhëzës tek neonatët, në Departamentin e Neonatologjisë, pranë Qendrës Klinike Universitare të Kosovës.

Materiale dhe metoda: Hulumtimi është retrospektiv dhe është realizuar në Departamentin e Neonatologjisë, pranë Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Subjektet e studimit ishin të porsalindurit me verdhëz.

Rezultate: Studimi është kryer në Klinikën e Neonatologjisë, afër Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Në këtë studim janë marrë të dhëna për pacientët e shtruar në spital gjatë vitit 2020 me verdhëz të zgjatur. Në spital janë shtruar gjithsej 842 të porsalindur, nga të cilët 123 kanë pasur verdhëz. Sipas studimit 12 mujor gjatë vitit 2020, rezulton se 120 janë shëruar plotësisht, ndërsa 3 prej tyre kanë vdekur. Struktura gjinore tregon se meshkujt marrin pjesë në 72 raste (58, 53%), ndërsa femrat në 51 raste (41, 46%).

Konkluzione: Diagnostifikimi në kohë dhe trajtimi adekuat i komplikimeve ka bërë që ky problem i rëndësishëm shëndetësor në vendin tonë të trajtohet mirë dhe rezultatet tona janë të ngjashme me ato të qendrave të tjera të cituara në literaturën bashkëkohore për këtë temë.

Fjalë kyçe: Verdhëza neonatale, papajtueshmëria me Rh dhe ABO, hiperbilirubinemia, verdhëza.

INCIDENCA E KARDIOMIOPATIVE(KMP - VE) NË SPITALET E KOSOVËS.

Arianita Bytyqi[1], Prof. Dr. Shpend Elezi[2]
[1]*Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Mjekësisë së Përgjithshme, Prishtinë, Kosovë*

Abstrakt

Hyrje: Kardiomiopatit janë një grup sëmundjesh të karakterizuara nga dëmtime strukturore dhe funksionale të miokardit. Etiologjitë e kardiomiopative janë të ndryshme, duke filluar nga mutacionet gjenetike që ndikojnë në funksionet themelore të miokardit deri te çrregullimet sistemike që rezultojnë në dëmtime që përhapen në zemër. Përkufizimi dhe klasifikimi i kardiomiopative ka evoluar në mënyrë të konsiderueshme vitet e fundit. Vitet e fundit, përkufizimi i kardiomiopatisë është kufizuar në format idiopatike të sëmundjes së miokardit dhe është grupuar në tre kategori të përgjithshme: kardiomiopatia kongjestive ose dilatative, kardiomiopatia hipertrofike dhe kardiomiopatia restriktive.

Qëllimi: Ky hulumtimi ka për qëllim paraqitjen e incidencës së Kardiomiopative të të gjitha formave në Klinikën e Kardiologjisë për vitin 2024, dhe rezultate të tjera mbi valiablat si, numrin e rasteve me KMP, vdekshmërinë e tyre, trajtimin, faktorët e rrezikut, të ofroj informatat më të fundit nga rishqyrtimi i literaturës, dhe të bëjë krahasime mes vendit tonë dhe vendeve të tjera.

Hipotezat: H1: Pritet përhapje afërsisht e njejtë e kardiomiopative në të dy gjinitë.

H2: Pritet që moshat e shtyera të jenë më të prekura, për shkak të faktorëve primar të rrezikut si hipertensioni dhe problemet valvulare.

Metodologjia: Në këtë hulumtim retrospektiv do përfshihen pacientët e diagnostikuar dhe trajuar me Kardiomiopati (KMP) në Klinikën e Kardiologjisë gjatë vitit 2024. Të dhënat e mbledhura nga arkivi i Klinikës së Kardiologjisë do të përpunohen përmes programit Excel, permes tabelave dhe grafikoneve do prezantojmë rezultatet përfundimtare, të cilat do i krahasojm me punime në vende të tjera, dhe të ngrisim hipoteza se si mund të qëndrojnë këto dallime në incidencë.

Rezultate: Numri total i pacientëve të trajtuar me Kardiomiopati gjatë vitit 2024 është 490. Ku ka një dominim të Meshkujve 68%, dhe të moshave mbi 70 vite. Qyteti që prin me numrin më të madhë të rasteve është Prishtina me 21. 2%, pastaj Podujeva me 8. 8%. Në bazë të rezultateve mesatarja e moshës së pacientëve të dignostikuar me kardiomiopati është 67 vjeç, ku 47. 9% e pacientëve janë të grupmoshës +70 vjeç.

Fjalë kyçe: Kardiomiopati, klasifikimi, idiopatike, miokardi, sëmundje sistemike.

SINDROMA E OVAREVE POLICISTIKE DHE LIDHSHMËRIA E SAJ ME INSULINOREZISTENCËN.

Dr. Arianitë Xhafa[1], Dr. Drin Gurguri[2]
[1]*Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, Mitrovicë, Kosovë.*
[2]*Qendra Klinike Universitare e Kosovës, specializant i Gjinekologjisë me Obstetrikë.*

Abstrakt

Sindroma e ovareve policistike (PCOS) është një nga çrregullimet më të shpeshta endokrinologjike me një incidencë relativisht të rëndësishme tek gjinia femërore në moshën riprodhuese. Mekanizmi i saktë patofiziologjik i kësaj sindrome nuk është i njohur. Në qendër të patofiziologjisë të kësaj sindrome qëndron rezistenca periferike ndaj insulinës që çon në hiperinsulinizëm. Kjo sindromë lidhet ngushtë me rezistencën ndaj insulinës, obezitetin dhe hiperandrogjenizmin. Inflamacioni kronik me intensitet të ulët, rritja e glukozës dhe stresi oksidativ ndikojnë në përkeqësimin e gjendjes, duke shkaktuar çrregullime metabolike si diabeti tip II, dislipidemia dhe rreziku kardiovaskular. Hulumtime të fragmentuara preliminare në Kosovë tregojnë se incidenca e kësaj sindrome është në përputhje me raportimet nga rajoni mirëpo duhet vënë theks i veçantë në mosraportime eventuale signifikante për arsye sociale dhe të tjera. Megjithatë, PCOS është një çrregullim heterogjen, ku obeziteti dhe rezistenca ndaj insulinës përforcojnë simptomat duke krijuar një cikël të përsëritshëm. Hiperandrogjenizmi është shenja më e dukshme klinike, që shkakton obezitet, akne, rënie flokësh dhe probleme psikologjike. Terapitë si pilulat kontraceptive, metformina dhe spironolaktoni ndihmojnë në uljen e androgjenëve dhe përmirësimin e fertilitetit. Megjithë hulumtimet e shumta, mekanizmat patologjikë të këtij çrregullimi mbesin të paqartë. Kombinimi i vëzhgimeve klinike bashkë me hulumtimet shkencore mbesin si metoda më e përshtatshme në të kuptuarit dhe trajtimin e këtij sindromi në të ardhmen në Kosovë, por edhe në vende të tjera.

Fjalët kyçe: çrregullim endokrin, mbipeshë, ndjeshmëri e zvogëluar ndaj insulinës, komplikime metabolike.

BIOMARKERËT E RINJ PËR DIAGNOSTIKIMIN E HERSHËM TË KANCERIT TË ENDOMETRIT: PERSPEKTIVA TË REJA NË ONKOLOGJINË GJINEKOLOGJIKE.

Ariola Kuka

Abstrakt

Hyrje: Kanceri i endometrit është neoplazia gjinekologjike më e shpeshtë tek gratë postmenopauzale. Zbulimi në faza të hershme përmirëson ndjeshëm mbijetesën, megjithatë mjetet aktuale diagnostike kanë ndjeshmëri dhe specificitet të kufizuar.

Qëllimi: Të vlerësohen zhvillimet e fundit në biomarkerët molekularë dhe serologjikë, me fokus tek microRNA - t, proteinat e matriksit ekstracelular dhe mediatorët inflamatorë, si dhe roli i tyre krahasuar me markerët tradicionalë (CA - 125, HE4).

Metodologjia: U krye një rishikim narrativ i studimeve të publikuara gjatë periudhës 2018–2025, me analizë të performancës diagnostike dhe integrimit me teknika imazherike dhe algoritme të inteligjencës artificiale.

Rezultatet: Panelet e kombinuara të biomarkerëve, veçanërisht nënshkrimet e microRNA - ve, treguan saktësi më të lartë diagnostike (sensitivitet dhe specificitet 85–90%) në krahasim me përdorimin e vetëm të markerëve klasikë.

Përfundimi: Strategjitë e reja të biomarkerëve paraqesin potencial për diagnostikim më të hershëm, më pak invaziv dhe më të saktë të kancerit të endometrit. Nevojiten studime prospektive dhe multiqendrore për validim klinik.

Fjalë kyçe: kanceri i endometrit, biomarkerë, microRNA, diagnostikim i hershëm, onkologji gjinekologjike.

LIDHJA MIDIS SASISË SERIKE TË FAKTORIT SOLUBLE FMS - LIKE TYROSINE KINASE - 1 (SFLT - 1), FAKTORIT TË RRITJES PLACENTARE (PLGF), DHE RAPORTIT SFLT - 1 / PLGF NË SHTATZËNINË UNIKE DHE DISTAKO PLACENTE.

Arjan Shtylla, Rea Domi

SUOGJ "K. Gliozheni", Tiranë, Shqipëri,

Abstrakt

Hyrje: Distako placentae, së bashku me kufizimin e rritjes fetale (FGR) dhe preeklampsinë (PE), përbëjnë një spektër komplikacionesh obstetrikale, si pasojë e disfunksionit placentar dhe mbeten shkaktarë kryesorë të morbiditetit dhe mortalitetit maternal dhe fetal. Distako placente, i cili përkufizohet si shkëputja e plotë ose e pjesshme e placentës nga stratum spongiosum i deciduas para lindjes, prek rreth 0. 6% deri 1. 4% të të gjitha shtatzënive. Në ekzaminimin histologjik të indeve të shtresës placentare të marra nga rastet e distako, shpesh evidentohet mungesa e invazionit të trofoblasteve në arteriet spirale, duke sugjeruar ngjashmëri midis distakos, PE dhe FGR. Në një shtatzëni normale, përqendrimet e PlGF rriten në mënyrë të vazhdueshme nga tremujori i parë deri në javët 29 - 33 gestacionale, dhe pastaj fillojnë të ulen. Nga ana tjetër, sFlt - 1, është relativisht i qëndrueshëm deri në javët 29 - 33 dhe, më pas, rritet në mënyrë të qëndrueshme deri në lindje, duke reflektuar stresin e trofoblasteve. Në PE me fillim të hershëm, përqendrimet e sFlt - 1 në qarkullimin amtar janë më të larta, ndërsa përqendrimet e PlGF janë më të ulëta. Ritja e sFlt - 1 fillon rreth 1 muaj para shenjave klinike. Ky çrregullim placentar shoqërohet zakonisht me FGR. Çrregullime të ngjashme janë vërejtur tek gratë me distacco placentae. Edhe pse raporti sFlt - 1 / PlGF lidhet me shkallën e stresit oksidativ të trofoblasteve, ai nuk është specifik për asnjë nga patologjitë e sipërpërmendura. Nga pikëpamja klinike, përdorimi i faktorëve angiogjenikë lejon njohjen e çrregullimeve placentare në faza presimptomatike, gjë që mund të përmirësojë menaxhimin dhe prognozën e shtatzënive të prekura.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë nëse gratë me shtatzëni unike, të cilat u diagnostikuan më pas me distako placente kanë përqendrime më të ulëta të faktorëve të rritjes placentare (PlGF) në serum, përqendrime më të larta të faktorit soluble fms - like tyrosine kinase - 1 (sFlt - 1) dhe një raport më të lartë sFlt - 1 / PlGF, në krahasim me gratë me shtatzëni unike pa distako placentae.

Lidhja midis përqendrimit të PlGF në qarkullimin amtar dhe distako placente: Të dhënat u ndanë në 2 nëngrupe në varësi të kohës së marrjes së mostrës së gjakut: përpara ose në javën e 21 - të gestacionale ose pas javës së 21 - të gestacionale. Përqendrimet e PlGF në mostrat amtare të marra përpara ose në javën 21 gestacionale u vlerësuan në 598 gra, prej të cilave 88 përjetuan distacco placentae në javët e ardhshme të shtatzënisë. Nuk u evidentua një lidhje e rëndësishme midis biomarkuesve dhe distakos. SMD në këtë rast ishte –0, 9 (95% CI, –1, 86 deri 0, 06). As në nëngrupin me mostra PlGF të vlerësuara pas javës 21 gestacionale nuk u evidentua lidhje me distaccon. Në këtë rast ishin në dispozicion të dhënat e vetëm 96 grave: 36 me distako dhe 58 raste kontrolli. SMD ishte –1, 25 (95% CI, –5, 06 deri 2, 56).
Lidhja midis përqendrimit amtar të sFlt - 1 dhe distako placente: Të dhënat e 88 rasteve me distako dhe të 510 rasteve kontrolli me mostra përpara ose në javën 21 gestacionale nuk evidentuan një lidhje të tillë. SMD ishte 0, 41 (95% CI, –0, 52 deri 1, 33). Përqendrimet e sFlt - 1 të vlerësuara pas javës 21 gestacionale treguan një lidhje me distakon. Në studim u përfshinë 36 raste me distako dhe 58 raste kontrolli. SMD ishte 1, 89 (95% CI, 1, 29 deri 2, 50).
Lidhja midis raportit sFlt - 1 / PlGF dhe distako placente: U analizuan 96 raste me distako dhe 827 raste kontrolli me mostra para dhe pas javës 21 gestacionale. U evidentua një lidhje e rëndësishme midis raportit sFlt - 1 / PlGF dhe distako placente. SMD ishte 3, 05 (95% CI, 0, 69 deri 5, 41). U realizua edhe një analizë nëngrupi te gratë me diagnozë ose simptoma të PE. Të dhënat e 14 rasteve me distako dhe të 309 rasteve kontrolli nga 3 studime u analizuan në këtë nëngrup. Modeli me efekte të rastit nuk tregoi një lidhje të rëndësishme midis raportit sFlt - 1 / PlGF dhe distako placente te gratë me PE (SMD: 4, 18; 95% CI, 1, 64–10, 01).
Përfundime: Rezultatet kryesore të kësaj meta - analize janë si më poshtë: 1) përqendrimi amtar i PlGF nuk ndryshoi midis grave me dhe pa distako placente, 2) përqendrimi amtar i sFlt - 1 ishte më i lartë te gratë me distako placente, veçanërisht në gjysmën e dytë të shtatzënisë dhe 3) raporti amtar sFlt - 1 / PlGF ishte më i lartë te gratë me distako placente, si në gjysmën e parë ashtu edhe në gjysmën e dytë të shtatzënisë, me ndryshimin që nuk ishte më statistikisht i rëndësishëm te gratë me manifestime të PE.

Fjalë kyçe: Distako placentae, preeklampsia, Tyrosine Kinase - 1 (Sflt - 1), shtatzëni unike.

TRAJTIMI ORAL ANTIHIPERTENSIV GJATË SHTATZËNISË: NJË RISHIKIM SISTEMATIK.

Arjan Shtylla[1], Daniela Teferici[2]
[1]*Shërbimi Obstetrikës UHOG "K. Gliozheni", Tiranë, Shqipëri,*
[2]*Shërbimi i Kardiologjisë, UHC "Nënë Tereza" Tiranë, Shqipëri*

Abstrakt
Sfondi: Për të përcaktuar efektet e trajtimit oral antihipertensiv antenatal me nifedipinë, labetalol ose metildopa gjate çrregullimeve hipertensive të shtatzënisë në morbiditetin dhe vdekshmërinë e nënës, fetusit ose neonatit.
Metoda: Kërkim i literaturës në Pubmed, Embase. com, CENTRAL nga gushti 2023 i të gjitha studimeve të rastësishme (RCT) me trajtim oral me metildopa, labetalol ose nifedipin gjatë shtatzënisë ne raport mbi komplikacionet e nënës si hipertensioni i rëndë, preeklampsia, eklampsia, HELLP, goditja në tru, hemorragjia në mëlçi dhe vdekja e nënës. Gjithashtu u analizuan efekte te fetusi si pesha e lindjes (peshë e vogël dhe e ulët në lindje), prematuriteti, rezultati Apgar dhe vdekshmëria neonatale.
Rezultate: Kur krahasohen tre medikamentet mbi hipertensionin e rëndë, duket se labetaloli dhe metildopa kishin një efekt te rëndësishëm. Për preeklampsinë, në 40 studime duket se labetaloli kishte një efekt të rëndësishëm kundrejt metildopës. Në lindje dhe peshë të ulët në lindje, përkatësisht 40 dhe 17 studime nuk tregojnë superioritet në secilin trajtim. Në lindjen e parakohshme, në 50 studime u gjet një incidencë statistikisht më e ulët e lindjeve të parakohshme nën 37 javë në grupin e labetalolit krahasuar me nifedipinën. Në 20 studime mbi vdekshmërinë fetale / neonatale dhe 4 studime me rezultatin Apgar nën 7, nuk u gjet asnjë ndryshim statistikor midis barnave.
Përfundime: Nuk kishte superioritet në lidhje me hipertensionin e rëndë ose peshën në lindje për metildopën, labetalolin ose nifedipinën. Duket se labetaloli është superior ndaj nifedipinës në lidhje me preeklampsinë dhe lindjen e parakohshme. Hulumtimet e ardhshme duhet të përqendrohen në të dhënat retrospektive të spitalit në jetën reale.

Fjalë kyçe: antihipertensiv oral, shtatzënia, hipertensioni i shtatzënisë, preeklampsia, metildopa

EFEKTIVITETI, SIGURIA DHE KOSTO - EFEKTIVITETI KRAHASUES I METODAVE TË INDUKSIONIT TË LINDJES: NJË RISHIKIM SISTEMATIK.

Arjan Shtylla[1], Daniela Teferici[2], Elsa Spahiu[1], Rea Domi[1], Nazmie Ceni[1]
[1]*Shërbimi Obsterik - Gjinekologjisë, "SUOGJ", K. Gliozheni", Tiranë, Shqipëri*
[2]*Shërbimi Kardiologjisë, QSU "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri*

Abstrakt
Hyrje: Induksioni i lindjes është një ndërhyrje e zakonshme obstetrike, që ndërmerret më shpesh në kohën e lindjes tek gratë me një qafë të mitrës të pafavorshme, dhe përdorimi i saj në rritje globale nënvizon nevojën për të identifikuar strategjitë optimale që balancojnë efektivitetin, sigurinë dhe kosto - efektivitetin. Ky rishikim sistematik synonte të vlerësonte efektivitetin, sigurinë dhe kosto - efektivitetin krahasues të metodave farmakologjike, mekanike dhe të kombinuara të induksionit në shtatzënitë në kohën e lindjes, duke përfshirë gratë nullipare dhe pluripare që i nënshtrohen induksionit te planifikuar te lindjes.
Materiale dhe Metoda: Rishikimi ndoqi udhëzimet e Preferuara të Raportimit për Rishikime Sistematike dhe Meta - Analiza (PRISMA). Një kërkim sistematik i PubMed, Scopus, Web of Science dhe Embase u krye për studime të kontrolluara të rastësishme (RCT) të publikuara midis viteve 2015 dhe 2025. Dhjetë RCT u përfshinë dhe u vlerësuan për rrezikun e paragjykimit duke përdorur mjetin Cochrane RoB 2. Një sintezë narrative u krye për shkak të heterogjenitetit klinik dhe metodologjik.
Rezultate: Në 10 RCT (n = 8, 683 pjesëmarrës), misoprostoli oral dhe kateteri Foley demonstruan efektivitet dhe siguri të krahasueshme për pjekjen dhe induksionin e qafës së mitrës. Metodat e kombinuara (p. sh. , misoprostoli plus kateteri Foley) shkurtuan ndjeshëm intervalet nga induksioni në lindje dhe ritën mundësinë e lindjes vaginale brenda 24 orëve krahasuar me metodat e vetme. Rezultatet e sigurisë ishin përgjithësisht të favorshme, megjithëse u raportuan shkallë më të larta të sëmundshmërisë infektive me metodat mekanike tek gratë me plasje të membranave para lindjes. Analizat e kostos treguan se misoprostoli dhe kateteri Foley kanë kosto të ngjashme për pacientët e shtruar në spital, ndërsa zbutja e qafes se mitres me kateterin Foley në pacientët ambulatorë ofron kursime të konsiderueshme. Për më tepër, induksioni në javën e 41 - të ishte më efektiv nga ana e kostos sesa menaxhimi në pritje deri në javën e 42 - të, veçanërisht për gratë nullipare.
Konkluzione: Provat sugjerojnë që misoprostoli oral dhe kateteri Foley janë opsione të linjës së parë po aq efektive, ndërsa metodat e kombinuara dhe strategjitë ambulatore mund të optimizojnë rezultatet në varësi të paritetit, statusit të qafës së mitrës dhe mjedisit të kujdesit shëndetësor.

Fjalë kyçe: induksioni i lindjes, obstetrike, kohën e lindjes, gra etj.

KUR TA NDALIM TRAJTIMIN? – SFIDA ETIKE NË VENDIMET PËR KUFIZIMIN E MASAVE REANIMUESE: REFLEKTIME NGA PËRVOJA KLINIKE.

Arjana Laci MD[1], Krisli Serani MD[1], Prof. Asc. Majlinda Naço[1], Prof. Asc. Alma Cani, Prof. Krenar Lilaj
[1]Shërbimi i Anestezi Reanimacion, QSUT.

Hyrje: Vendimmarrja për të ndaluar ose për të mos nisur masat reanimuese është një ndër sfidat më të ndërlikuara në praktikën e reanimacionit. Këto vendime prekin thellësisht dimensionin etik, profesional dhe njerëzor të mjekut. Në një kohë kur protokollet për reanimacionin (CPR), ndihma në situatat e vdekjes cerebrale, si dhe kufizimi i trajtimeve invazive ekzistojnë, zbatimi i tyre kërkon jo vetëm dije shkencore por edhe ndjeshmëri të lartë humane dhe përvojë klinike.
Qëllimi: Të analizojmë përmes përvojës sonë klinike sfidat etike dhe profesionale në marrjen e vendimeve për kufizimin e trajtimeve reanimuese, duke reflektuar mbi tre raste reale që kanë lënë gjurmë në formimin tonë si mjekë reanimatorë.
Materiale dhe metoda: Ky është një raport përshkrues retrospektiv i tre rasteve të trajtuara në shërbimin e reanimacionit në periudhën janar 2024 – maj 2025. Të tre rastet janë karakterizuar nga situata kritike ku u kërkua marrja e vendimeve për ndalimin ose mosvazhdimin e masave reanimuese. Janë analizuar të dhënat klinike, konteksti familjar, bashkëpunimi multidisiplinar dhe reflektimi etik mbi vendimet e marra.

Përshkrimi i rasteve: Rasti 1: Pacient 52 vjeç me neoplazi metastatike dhe arrest kardiak në ICU. Pas dy ciklesh të CPR pa rezultat, vendosëm të ndalnim masat reanimuese. Reflektimi mbi kufirin mes përpjekjes dhe mospërfitimit ishte emocionalisht sfidues.
Rasti 2: Paciente 34 vjeç me hemorragji cerebrale masive dhe diagnostikim të vdekjes cerebrale. Për herë të parë asistova procesin e shpalljes së "brain death" por në perputhje me legjislacionin shqiptar iu vazhdua asistenca reanimatore me ventilim mekanik e droga inotrope e vazopresore deri ne arrest kardiak pas 72 oresh.
Rasti 3: Pacient 79 vjeç me insuficiencë multiorganike, ku në dakordësi me familjen u vendos kufizimi i ndërhyrjeve invazive dhe u aplikua trajtim paliativ aktiv.
Konkluzione: Kufizimi i trajtimeve reanimuese mbetet një fushë ku etika, komunikimi dhe gjykimi klinik duhet të ndërthuren me kujdes. Për mjekët e rinj reanimatorë, përballja me vdekshmërinë dhe përgjegjësinë për vendime të tilla është pjesë e rritjes profesionale dhe njerëzore.
Rekomandime: Nevojitet formim i strukturuar mbi etikën klinike dhe përfshirje aktive në vendimmarrjet multidisiplinare. Protokollet për CPR, vdekjen cerebrale dhe trajtimin paliativ duhet të zbatohen me fleksibilitet njerëzor dhe të përshtaten në kontekstin kulturor dhe emocional të çdo rasti.

Fjalë kyçe: trajtim, sfida etike, masa reanimuese, përvojë klinike.

PRECIZIONI NË DEDEKTIM: ROLI I PCR NË SËMUNDJET SEKSUALISHT TË TRANSMETUESHME.

Arjana Marku[1], Oltiana Petri[1, 2], Esmeralda Angjeli[1], Dhimitrulla Skuri[1]
[1]Laboratori i Mikrobiologjisë, Cambridge Clinical Laboratorie, Tiranë, Shqipëri
[2]Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit, Universiteti i Sporteve të Tiranës, Shqipëri

Abstrakt
Hyrje: Globalisht, çdo ditë ndodhin më shumë se 1 milion infeksione seksualisht të transmetueshme (IST) të trajtueshme. Sipas OBSH - së, ka afërsisht 376 milion infeksione të reja të katër IST - ve të shërueshme – klamidia, gonorrea, sifilizi dhe trichomonas.
Metoda: Në Cambridge Clinical Laboratories, nga shkurti 2025 deri në shtator 2025, ne analizuam 98 mostra nga mosha 18 - 67 vjeç me PCR Multiplex (Virusi Herpes simplex 1 (HSV1), Virusi Herpes simplex 2 (HSV2), Mycoplasma hominis, Mycoplasma genitalium, Ureaplasma parvum, Ureaplasma urealyticum, Neisseria gonorrea, Gardnerella vaginalis, Chlamydia trachomatis, Treponema pallidum, Trichomonas vaginalis). Sensibiliteti i PCR - se u përcaktua në 10 kopje të gjenomit bakterial / viral / µl. Pas izolimit të acidit nukleik, kryhet një PCR multiplex në një tub të vetëm. Testi i dedektimit i 11 STI është një analizë PCR multiplex në kohë reale që lejon amplifikimin, dedektim dhe diferencimin e njëkohshëm të acideve nukleike të targetuara të 11 llojeve të patogjenëve të treguar. Testi gjithashtu përmban Kontroll të Brendshëm endogjen për të kontrolluar çdo frenim që mund të ndodhë gjatë reaksionit PCR.
Rezultati: Të dhënat tona treguan se nga 98 mostrat e testuara, 66 ishin pozitive ndaj të paktën një patogjeni. Nga këto, 11 ishin pozitive ndaj Gardnerella vaginalis, 3 ishin pozitive ndaj HSV1, 1 ndaj HSV2, 4 ndaj Neisseria gonorrea, 3 ndaj Chlamydia trachomatis, 1 ndaj Treponema pallidum, 1 ndaj Trichomonas vaginalis dhe 19 ishin pozitive ndaj të paktën njërit prej Ureaplasma ose Mycoplasma. Ureaplasma dhe Mycoplasma u vunë re gjithashtu se ishin të shoqëruara me Gardnerella vaginalis. Përqindja më e lartë e rasteve pozitive ishte tek meshkujt krahasuar me femrat, 61% kundrejt 39%.
Konkluzione: Ky studim tregoi se prevalenca e diagnostikimit të IST me PCR ka një përqindje të lartë të lidhur me metodat tradicionale si kultura ose testet e shpejta antigjenike. PCR të bazuar në zbulimin e ADN / ARN ka revolucionarizuar fushën, duke lejuar një diagnozë më të shpejtë dhe të ndjeshme krahasuar me mikroskopinë ose kulturën tradicionale, dhe duke theksuar mundësinë e screening të IST në grupet në rrezik.

Fjalë kyçe: PCR, SST**,** prevalencë, klamidia, gonorrea, sifilizi dhe trichomonas.

ANALIZIMI I ROLIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË MENAXHIMIN E NJOHURIVE NË SPITALE.

Dr. Arjanit Hoxha[1], Dr. Zamira Qerimi [2], Dr. Uresa Sherifi[3]

Abstrakt

Hyrje: Ky studim rasti ka për qëllim të analizojë rolin e teknologjisë së informacionit në menaxhimin e njohurive në ambiente spitalore. Ndërsa shëndetësia është një fushë komplekse dhe sfiduese, përdorimi i teknologjisë së informacionit ka shfaqur potencialin për të përmirësuar efikasitetin dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor.

Në këtë studim, shqyrtohet literatura aktuale lidhur me përdorimin e teknologjisë së informacionit në menaxhimin e njohurive në fushën shëndetësore. Analizohen përfitimet e integritetit të sistemeve të dosjeve elektronike, ndikimi i inteligjencës artificiale dhe analizës së të dhënave në optimizimin e proceseve shëndetësore. Duke identifikuar problemet aktuale në menaxhimin e njohurive në spitale, ky studim propozon një metodologji për të vlerësuar efektivitetin e teknologjisë së informacionit në këtë kontekst. Përmes anketave dhe intervistave me profesionistë shëndetësorë, analizohen përfitimet dhe sfidat e përdorimit të teknologjisë së informacionit. Në fazën e prezantimit dhe analizës së rezultateve, studimi përqendrohet në të arriturat konkrete të implementimit të teknologjisë së informacionit, duke theksuar përmirësimet në qasjen dhe ndarjen e informacionit shëndetësor dhe reduktimin e gabimeve mjekësore.

Në konkluzion, ofrohen rekomandime për organizatat shëndetësore për të përmirësuar përdorimin dhe integrimin e teknologjisë së informacionit në menaxhimin e njohurive në spitale. Ky studim synon të kontribuojë në njohurinë mbi rëndësinë e teknologjisë së informacionit në përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së kujdesit shëndetësor në ambientet spitalore.

Fjalë kyçe: teknologjia e informacionit, menaxhimi i njohurive, spitale, kujdesi shëndetësor, inteligjenca artificiale, dosje elektronike, analiza e të dhënave.

KARAKTERISTIKAT E REZONANCËS MAGNETIKE (MRI) TË TUBERKULOZIT TË GJURIT: NJOHJA E SHENJAVE RADIOLOGJIKE.

Arjeta Docaj

Mjeke Radiologe, Spitali Hygeia, Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Tuberkulozi i artikulacionit të gjurit është një formë e rrallë e tuberkulozit muskuloskletal, shpesh me shenja klinike jo specifike që vonojnë diagnozën. Rezonanca magnetike (MRI) është shfaqur si modaliteti më i ndjeshëm për zbulimin e hershëm dhe karakterizimin e artritit tuberkuloz.

Qëllimi: Të evidentohen veçoritë e MRI - së në tuberkulozin e artikulacionit te gjurit dhe rëndësia e tyre diagnostike në dallimin e tuberkulozit nga shkaqe të tjera të monoartritit kronik.

Metodologjia: U realizua një shqyrtim retrospektiv i pacientëve të diagnostikuar me tuberkuloz të artikulacionit te gjurit, me fokus në gjetjet e MRI - së. U vlerësuan imazhet T1, T2, STIR dhe ato me kontrast për trashje sinoviale, likid intra - artikular, edemë të palcës kockore, errozione subkondrale dhe formim abscesesh.

Rezultate: Gjetjet më të zakonshme në MRI përfshinin likid intra - artikular ne sasi të moderuar deri të konsiderueshme, trashje sinoviale hipointense në imazhet T1 shoqeruar me hiperintensitet përkatës në sekuencat T2 / STIR dhe përforcim periferik pas injektimit te kontrastit I / V. Edema kockore subartikulare dhe erozionet kortikale ishin të shpeshta, sidomos në kondilet femorale dhe platone tibial. Në rastet e avancuara u identifikuan abscesse intraosseoze dhe në indet e buta, me formim fistulash.

Përfundime: MRI ofron një avantazh të madh diagnostik në vlerësimin e tuberkulozit të artikulacionit te gjurit. Njohja e veçorive specifike radiologjike është thelbësore për diagnozën e saktë, trajtimin në kohë dhe rezultatet optimale për pacientin.

Fjalë kyçe: Tuberkulozi i artikulacionit te gjurit, MRI, TB osteoartikular, sinovitis, edemë e palcës kockore, likid artikular, abscess.

MENAXHIMI KIRURGJIKAL I GLAUKOMËS KONGENITALE BILATERALE ME KOMBINIMIN TRABEKULOTOMI - TRABEKULEKTOMI.
Prof. Asc. Arjeta Grezda, Dr. Erindi Murati, Prof. Asc. Alketa Tandili, Dr. Irgen Zervoi.

Abstrakt
Hyrje: Glaukoma kongenitale primare është një patologji e rrallë, por potencialisht shkatërruese për shikimin, që rezulton nga zhvillimi jonormal i këndit iridokorneal dhe pengimi i drenimit të lëngut ujor. Ky studim paraqet një rast klinik të një foshnjeje të lindur prematurë në javën e 31 - të të shtatzënisë peshë 1400gr, me anamnezë familjare pozitive për glaukomë dhe shenja të qarta klinike të sëmundjes, përfshirë mjegullimin e kornesë, blefarospazmin, fotofobinë dhe lotimin e shtuar bilateral. Matja e presionit intraokular rezultoi 36 mmHg OU, duke konfirmuar diagnozën e glaukomës kongenitale bilaterale.
U aplikua një procedurë e kombinuar trabekulotomi - trabekulektomi (CTT) nën anestezi të përgjithshme. Pas operacionit, u vu re ulje graduale e edemës korneale dhe reduktim i presionit intraokular në ~20 mmHg. Për të parandaluar formimin e aderenzave fibrotike dhe për të optimizuar funksionin e blebit filtrues, u aplikua injeksion intrableb i anti - VEGF, në vend të Mitomicinës - C ose 5 - Fluorouracilit, për shkak të profilit më të mirë të sigurisë. Rezultatet post - operative treguan një përmirësim të ndjeshëm anatomik dhe funksional, duke theksuar rolin potencial të kombinimit kirurgjik me anti - VEGF në menaxhimin e glaukomës kongenitale.

Fjalë kyçe: glaukoma kongenitale primare, patologji, shikim, pacient etj.

HYPOTIREOZA: TË DHËNA TË PËRGJITHSHME.
Arjola Salillari
Mjeke Endokrinologe pranë Poliklinikës së Specialiteteve nr. 1, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Hypotireoza është një nga diagnozat më të zakonta në praktikën klinike në fushën e endokrinologjisë, ku shkaqet më të shpeshta të hypotireozës janë tiroiditi Hashimoto dhe nga
shkaqet jatrogjene heqja kirurgjikale dhe ablacioni me J131.
Objektivi: Vlerësim i përgjithshëm i hypotireozës, të dhënat epidemiologjike, etiologjia, fizpatologjia, klinika, diagnostifikimi dhe trajtimi. Informim i përgjithshëm për edukimin e mjekëve të rinj.
Metoda e studimit: U studiuan të dhënat e literaturës online. U përzgjodh material i përshtatshëm për hypotireozën nga diagnostikimi deri tek trajtimi.
Përfundime: Arritja e informimit të mjekëve në lidhje me përditësimin e informacionit për hypotireozën për një diagnostikim dhe trajtim sa më të mirë.

Fjalë kyçe: hypotireoza, diagnoza, endokrinologji, etiologjia, të dhëna.

SHEAR - WAVE ELASTOGRAFI E GJIRIT. VLERAT MAKSIMALE NË KPA TË CARCINOMAVE DUCTALE MAMMARE HORMONE RECEPTORE POSITIVE, HER 2 NEGATIVE. NJË STUDIM RETROSPEKTIV 1 VJECAR NË QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA".
Dr. Arla Harka, Dr. Qamile Arapi

Abstrakt
Hyrje: Kanceri i gjirit vazhdon të jetë një nga shkaqet kryesore të vdekshmërisë te femrat, duke prekur 1 në 8 femra gjatë jetës së tyre. Detektimi i hershëm është faktor i rëndësishëm në mbijetesë. Ekografia është një metodë imazherike diagnostikuese me rëndësi të vecantë sidomos në moshat e reja, apo në femrat me densitet të rritur mamar, ndërkohë që elastografia është një element plus, që na jep informacione më të sakta lidhur dhe me statusin e receptorëve hormonal, Në studimin tonë kemi matur vlerat maksimale në kPa (shear wave elastografi), te lezione mammare BIRADS 5, duke koreluar më pas me refertin histopatologjik të lezioneve të cilat paraqesin statusin hormonal (ER+, PR+, Her 2 -)
Qëllimi: Aktualisht shumë pak studime janë realizuar përsa i përket Shear Wave elastografisë së gjirit, ndërkohë që kjo metodë ekzaminimi është aprovuar gjerësisht në shumë Qendra Spitalore për sa i përket patologjive

hepatike, duke pasur vlera konkrete në kPA përsa i përket fibrozës së saj. Studimet kanë treguar se parametrat e SW elastografisë janë të ndryshme në subtype të ndryshme të carcinomave mamare ductale. Duke qenë se carcinoma mamare ductale hormone positive është më e shpeshta, ky studim do japë ndihmesë në rritjen e saktësisë së diagnostikimit të saj, duke ndihmuar në parashikimin e receptorëve hormonale, me përdorimin e vlerave në kPA. Në këtë mënyrë vlerat e elastografisë mund të shërbejnë si një biomarker jo invasiv, në diagnostikim i kancerit të gjirit, duke na ofruar protokolle trajtimi personale në varësi të biologjisë tumorale për cdo pacient.
Rezultate: Matjet janë realizuar në zonat ku me strain elastografi shikonim stiffnes më të lartë, kryesisht në periferi, sidomos në lezionet mbi 2 cm, ku nuk mund të matej stiffnes mesatar për shkak të nekrozës centrale. Vlerat në kPa maximale arrinin ndërmjet 70 - 120. Në lezionet me dm rreth 1 cm, u vu re një vlerë mesatare në Kpa rreth 80 - 90 kPa, vlera të cilat konsiderohen të larta probabilisht në terren të fibrozës të shprehur të tyre, Ki 67 jo të lartë duke ulur mundesinë e nekrozave.

Fjalë kyçe: kanceri i gjirit, vdekshmëri, femra etj.

TRAJTIMI I FËMIJËVE ME ATROFI SPINALE MUSKULARE ME RISDIPLAM NË KOSOVË.
Dr. Arlind Rushiti

Abstrakt
Hyrja: Atrofia Spinale Muskulare (SMA) është një sëmundje neurodegjenerative gjenetike që prek qelizat motorike në palcën kurrizore, duke shkaktuar dobësi progresive muskulare dhe paaftësi të rëndë motorike. Në mungesë të trajtimit, SMA përparon shpejt, veçanërisht në tipet e saj të rënda. Risdiplam është një terapi e re orale që ka sjellë përparim të konsiderueshëm në menaxhimin e SMA. Në Kosovë, përdorimi i tij është një zhvillim i vonshëm dhe ende i kufizuar.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të analizojë trajtimin me Risdiplam te fëmijët me SMA në Kosovë, rezultatet e përdorimit te risdiplam, rezultatet në periudhat para përdorimit te trajtimit dhe të paraqesë sfidat aktuale të zbatimit të terapisë.
Materiale dhe metoda: Ky studim retrospektiv përfshin të gjithë pacientët e diagnostikuar me SMA të trajtuar ose të vlerësuar për trajtim me Risdiplam në Klinikën e Pediatrisë – Njësia e Neurologjisë Pediatrike në QKUK. Të dhënat janë mbledhur nga dokumentacioni klinik dhe rezultatet e testimeve gjenetike.
Rezultate dhe diskutime: Në studim u përfshinë 11 fëmijë me diagnozë të konfirmuar gjenetikisht për SMA 5q, të cilët filluan trajtimin me Risdiplam pas qershorit 2024 në QKUK. Përmirësime të dukshme në funksionin motorik dhe qëndrueshmërinë klinike u evidentuan sidomos te pacientët më të vegjël. Megjithatë, sfida të rëndësishme përfshijnë vonesat në diagnostikim dhe mungesën e testimit gjenetik brenda vendit, që pengojnë fillimin e hershëm të terapisë.
Përfundime: Risdiplam paraqet një mundësi terapeutike premtuese për pacientët pediatrikë me SMA në Kosovë, veçanërisht kur fillohet herët. Megjithëse sfidat sistemike si vonesat në diagnostikim dhe mungesa e skriningut neonatal mbeten prezente, rezultatet fillestare janë inkurajuese dhe mbështesin integrimin e tij në praktikën klinike kombëtare.

Fjalë kyçe: Atrofi spinale muskulare, risdiplam, trajtim, fëmijë, Kosovë, skema funksionale motorike.

EPILEPSIA MIOKLONIKE PROGRESIVE TIPI 2A (LAFORA) NË MOSHËN PEDIATRIKE: RAPORTIM RASTI
Armand Shehu
Shërbimi i Neuropediatrisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë
Departamenti i Pediatrisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë Tiranë

Abstrakt
Variantet patogjene në gjenin EPM2A shoqërohen me epilepsinë mioklonike progresive të tipit 2A (Lafora), një çrregullim autozomal recesiv i karakterizuar nga nje fillim gradual i neurodegjenerimit progresiv midis moshës 8 dhe 18 vjeç. Shenjat fillestare mund të përfshijnë dhimbje koke, vështirësi në shkollë, dridhje mioklonike,

kriza të gjeneralizuara dhe shpesh halucinacione vizuale. Mioklonia, krizat dhe halucinacionet përkeqësohen gradualisht dhe bëhen të pakontrollueshme. Kjo shoqërohet me rënie progresive të funksioneve njohëse, duke çuar në demencë. Rreth 10 vjet nga fillimi, individët e prekur paraqesin miokloni pothuajse të vazhdueshme me kriza të absencës, kriza të gjeneralizuara frekuente, demencë të thellë ose gjendje vegetative. Studimet histologjike të shumë indeve, përfshirë trurin, muskujt, mëlçinë dhe zemrën tregojnë trupat e Laforas intraqelizore, të cilët janë akumulime të dendura të molekulave të glikogjenit të deformuar dhe të patretshme, të quajtura poliglukanë.

Fjalë kyçe: Epilepsi mioklonike progresive, Lafora, EPM2A, neurodegjenerim, pediatri, mioklonia, demencë, poliglukanë.

EPILEPSIA DHE / OSE ÇRREGULLIMET NEUROZHVILLIMORE TË LIDHURA ME GENIN SCN8A TEK FËMIJËT: RAPORTIM RASTI.

Armand Shehu[1, 2]
[1]*Shërbimi i Neuropediatrisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë*
[2]*Departamenti i Pediatrisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë Tiranë*

Abstrakt
Epilepsia dhe / ose çrregullimet neurozhvillimore të lidhura me SCN8A trashëgohen në mënyrë autozomale dominante. Individët me fenotipe më të rënda të lidhura me SCN8A kanë më shumë gjasa ta kenë çrregullimin si pasojë e një varianti patogjen de novo, krahasuar me individët me fenotipe më të lehta. Çdo pasardhës i një individi me epilepsi dhe / ose çrregullime neurozhvillimore të lidhura me SCN8A ka një probabilitet 50% për të trashëguar variantin patogjen të SCN8A.
Pasi të identifikohet varianti patogjen i SCN8A tek një anëtar i prekur i familjes, bëhen të mundura testimi gjenetik prenatal dhe testimi gjenetik paraimplantues.

Fjalë kyçe: Epilepsi, SCN8A, çrregullime neurozhvillimore, trashëgimi autozomale dominante, testim gjenetik, pediatri.

RËNDËSIA E NDËRHYRJEVE JOFARMAKOLOGJIKE NË MENAXHIMIN E ANKTHIT, STRESIT DHE DEPRESIONIT TEK FËMIJËT E SHTRUAR NË SPITAL.

Armela Bara[1], YllkaThemeli[2], Ramadan Bara[3]
[1]*Univeristeti "Barleti"*
[2]*Universiteti i Mjekësisë*
[3]*Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë – Shqipëri.*

Abstrakt
Hyrje: Hospitalizimi është një nga përvojat më stresuese për fëmijët, sidomos ata me sëmundje kronike që kërkojnë trajtime të përsëritura. Përvoja e shtrimit në spital mbetet një burim i rëndësishëm ankthi dhe frike jo vetëm për fëmijën por edhe familjen e tij. Në këtë kontekst, ndërhyrjet jofarmakologjike luajnë një rol të rëndësishëm në lehtësimin e shqetësimeve emocionale.
Metoda: Ky punim shqyrton ndërhyrjet jo farmakologjike të aplikuara në mjedisin spitalor, duke përfshirë terapinë e lojës, terapinë e muzikës, teknikat e relaksimit dhe mbështetjen psikologjike, duke vlerësuar ndikimin e tyre në reduktimin e ankthit, stresit dhe depresionit, si dhe përmirësimin e mirëqënies emocionale.
Rezultate: Shqyrtimi i literaturës tregon se këto ndërhyrje janë efektive, të sigurta dhe përmirësojnë ndjeshëm bashkëpunimin e fëmijëve gjatë trajtimit. Ato gjithashtu reduktojnë nevojën për medikamente shtesë dhe rrisin kënaqësinë e fëmijëve.
Përfundime: Ndërhyrjet jofarmakologjike luajnë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e ankthit, stresit dhe depresionit tek fëmijët e hospitalizuar dhe ndihmojnë për të përmirësuar cilësinë e kujdesit infermieror. Përdorimi i qëndrueshëm dhe i planifikuar i tyre mund të sjellë përfitime të dukshme në praktikën pediatrike.

Fjalë kyçe: Ankth pediatrik, stres pediatrik, depresion pediatrik, ndërhyrje infermierore, terapia e lojës, relaksim, kujdes infermieror.

MENAXHIMI URGJENCAVE ALERGJIKE NË QKMF - SKËNDERAJ.

Dr. Armend Rexhepaj[1], Dr. Gëzim Latifi[2]
[1]*Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Prishtinë, Kosovë.*
[2]*QKMF "Dr Fatmir Fazlija", Skënderaj, Kosovë.*

Abstrakt
Hyrje: Alergjitë janë një preokupim i shpeshtë i njerëzve. Ato paraqesin një reaksion hipersensitiv ndaj një substance normale që mund të jetë edhe e padëmshme. Ka IIoj - IIoj substancash, që ndryshe quhen alergjen, e që mund të shkaktojnë probleme te pacienti. Alergjenët e zakonshëm janë një mori barnash e ushqimesh, aeroalergjenët, insektet e ndryshme, etj. Disa alergji kryesisht shkaktojnë simptoma të vështirësisë në frymëmarrje, e disa të tjera mund të shkaktojnë simptoma të ndryshme, sikur kokë dhembje, lodhje, temperaturë një ethe, dhimbje stomaku e shoqëruar me të vjellje etj.
Qëllimi: Ky punim synon të bëjë identifikimin e rasteve të pacientëve të prekur nga alergjitë, marrjen e anamnezës së saktë deri në identifikimin e shkaktarëve, triazhimin sa më të saktë në identifikimin e urgjencave, parandalimin e komplikimeve, si dhe menaxhimin e rasteve nga reaksionet alergjike në mënyrë sa më adekuate, pranë QKMF - së Skenderaj, gjatë periudhës kohore qershor 2025 - Gusht 2025. Gjithashtu do të shqyrtohen faktorët relevantë që lidhen me sjelljen e pacientëve gjatë kohës sa janë të prekur nga kjo sëmundje.
Menaxhimi në këtë rast konsiston në identifikimin e simptomave dhe gjendjes së pacientit në përgjithësi, kohën e paraqitjes së simptomave dhe trajtimin e pacientëve deri në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme të pacientëve. Në rastin tonë, janë trajtuar 68 raste të pacientëve të prekur nga alergjitë, prej grupmoshave dhe gjinive të ndryshme. Mosha mesatare e pacientëve të prekur me alergji ishte 19. 45 vjet.
Rezultate: Rezultatet të rëndësishme shkencore të këtij studimi konsistojnë në faktin se rezultatet e studimit do të jenë të vlefshme për pacientët, njerëzit e rëndomtë dhe personelin e kujdesit shëndetësor, për të fituar një pasqyrë më të qartë rreth problematikave që sjellin alergjitë dhe rëndësisë së menaxhimit të tyre.

Fjalë kyçe: menaxhimi i rasteve, alergjitë, pacientët.

PËRDORIMI I VAKSINËS PËR PROFILAKSI NDAJ INFEKSIONEVE URINARE.

Armida Ajasllari
[2]*Poliklinika e Specialiteteve nr 2, Tiranë.*

Abstrakt
Infeksionet urinare janë mjaft të shpeshta në popullatë, 10 herë më të shprehura te gratë sesa te burrat. Kur kthehen në infeksione urinare kronike kërkojnë trajtim të vazhdueshëm dhe të zgjatur me antibiotikë duke rritur prevalencën e rezistencës bakteriale. Përdorimi i vaksinave të prodhuara nga baktere inaktive janë një alternativë mjaft efikase dhe pa efekte anësore evidente.
Afërsisht 1 / 3 e grave referojnë një episodë të infeksionit urinar përgjatë jetës së tyre. Pikun e incidencës së infeksioneve rekurente të traktit urinar e arrijnë në moshën 16 - 35 vjec. Protokollet e tanishme rekomandojnë për parandalimin e infeksioneve urinare përdorimin e terapisë antibakteriale me nitofurantoin, fosfomicin dhe Sulfamethoxazole / Trimethoprim (SMX / TMP) për 3 deri në 6 muaj në doza mbajtëse. Përvecse ka ndikuar në rritjen e rezistencës bakteriale ka ndikur dhe në prishjen e mikrobiomës natyrale të traktit gastrointestinal dhe në uljen e imuniteti në përgjithesi. Kështuqë ndihet nevoja për alternative të tjera përvec antibiotikoterapisë, në pacientët të cilët nga ana anatomike dhe strukturale e sistemit urinar nuk paraqesin patologji. Studime të shumta kanë vlerësuar efektivitetin e vaksinave sublinguale si një opsion mjaftë i përshtatshëm dhe të suksesshëm si formë profilaksie për infektionet urinare rekurente. Në praktikën time klinike pranë poliklinikës së specialiteteve përdorimi i apither imunoterapi bakteriale ka rezultuar në përmirësim të gjëndjes së përgjithshme të pacienteve, në ulje te rekurencave të infeksioneve urinare, në uljen e kostove që kishin pacientët në blerjen e shpeshtë të antibiotikëve.

Fjalë kyçe: apither imunoterapi bakteriale, administrim sublingual, infeksione urinare rekurente.

OSTEOTOMIA E TIBIAS NË TRAJTIMIN E GENU VARUS: QASJE MINIMALISHT INVAZIVE DHE KOSTO - EFEKTIVE – PËRVOJA KLINIKE.

Arsel Dizdari MD1, Dorina Ruci Prof Asc[2]
[1]*Spitali Rajonal Memorial Fier,*
[2]*Mjeke reumatologe QSUT*

Hyrje: Genu varus (deformimi i këmbës në formë harku) është një patologji e zakonshme ortopedike që çon në dëmtime të hershme të artikulacionit të gjurit dhe progresion të artrozës mediale. Osteotomia e tibias është një teknikë kirurgjikale që synon të rikthejë aksin mekanik të gjurit dhe të shmangë / ngadalësojë nevojën për artroplastikë totale. Në vitet e fundit, qasjet minimalisht invazive në osteotomi janë bërë gjithnjë e më të përhapura për shkak të rikuperimit të shpejtë dhe reduktimit të komplikacioneve.
Qëllimi: Të paraqitet përvoja jonë klinike me 37 pacientë të trajtuar me osteotomi të tibias për genu varus, duke vlerësuar rezultatet klinike, kohën e qëndrimit në spital dhe komplikacionet post - operative.
Materiale dhe metoda: Studimi përfshin 37 pacientë të trajtuar ndërmjet janarit 2023 dhe majit 2025 në shërbimin e ortopedisë. Janë përzgjedhur pacientë me deformim genu varus të moderuar deri të avancuar, pa dëmtime të rëndësishme laterale ose instabilitet ligamentor. Osteotomia u realizua me teknikë të hapur ose të mbyllur, me fiksim plakash dhe vidash, nën anestezi spinale ose të përgjithshme. Koha mesatare e qëndrimit spitalor ishte 24 - 48 or. ë
Rezultate dhe diskutime: Rezultate të mira funksionale* u raportuan në 31 nga 37 rastet (84%) pas 3–6 muajsh ndjekje. Rikthimi në aktivitetin normal ndodhi mesatarisht pas 4–6 javësh. U evidentuan disa komplikacione: 2 raste me hemorragji post - operatore, 1 rast me infeksion lokal, 2 raste me vazhdim të dhimbjes dhe 1 rast me mosngjitje të plotë të osteotomisë, që kërkoi ndërhyrje të dytë. Nuk u raportuan komplikacione të rënda neurovaskulare.
Konkluzione: Eksperienca jonë mbështet osteotominë e tibias si një zgjidhje minimale invazive dhe kosto - efektive në trajtimin e genu varus. Me qëndrim spitalor të shkurtër dhe rezultate të kënaqshme klinike, kjo metodë përfaqëson një alternativë të vlefshme për ruajtjen e artikulacionit natyror.
Rekomandime: Osteotomia e tibias është një metodë efektive në menaxhimin e genu varus, veçanërisht tek pacientët e rinj dhe aktivë që nuk janë kandidatë idealë për protezë të gjurit. Teknikat minimalisht invazive, krahas përvojës kirurgjikale dhe kujdesit post - operativ, reduktojnë ndjeshëm komplikacionet dhe kohën e hospitalizimit, duke ulur njëkohësisht edhe kostot për sistemin shëndetësor.

Fjalë kyçe: osteotomia e tibias, trajtim, genu varus, përvoja klinike.

TRAJTIMI KIRURGJIK I PATOLOGJIVE INSULARE: PËRVOJA JONË KLINIKE.

Arsen Seferi

Abstrakt
Hyrje: Korteksi insular është një strukturë cerebrale e thellë, e përfshirë në një sërë funksionesh integruese, përfshirë perceptimin ndijor, funksionet autonome dhe ndërgjegjësimin. Patologjitë insulare, përfshirë neoplazitë, malformacionet vaskulare dhe epilepsinë e rezistent ndaj mjekimit, paraqesin sfida të veçanta diagnostike dhe kirurgjikale për shkak të lokalizimit të thellë dhe marrëdhënieve të ngushta me strukturat vaskulare vitale (arteria cerebralis media) dhe rrjetin funksional të trurit.
Objektivi: Të paraqesim përvojën tonë në trajtimin kirurgjik të patologjive insulare, duke u fokusuar në sigurinë, qasjet kirurgjikale, menaxhimin e strukturave vaskulare, dhe rezultatet klinike post - operatore.
Materiale dhe metoda: Në këtë studim retrospektiv janë përfshirë 22 pacientë të trajtuar në shërbimin tonë neurokirurgjikal gjatë periudhës 2018–2024 për patologji të lokalizuara në korteksin insular. Janë analizuar të dhënat demografike, diagnoza preoperative (me anë të rezonancës magnetike dhe DTI), qasja kirurgjikale (trans - silviane, trans - operculare, ose transkortikale), dhe rezultatet klinike sipas shkallës mRS dhe kontrollit të sëmundjes.

Rezultate: 12 pacientë kishin glioma të gradës së ulët, 5 me glioblastoma, 3 me epilepsi të shkaktuar nga displazi kortikale fokale dhe 2 me kavernoma. U përdorën qasje kirurgjikale trans - silviane në 15 raste dhe transkortikale në 7 raste. Reseksioni i plotë u arrit në 14 pacientë (63. 6%), me morbiditet të ulët neurologjik (deficite të përkohshme motorike në 4 raste). Nuk pati mortalitet intra - operator. Përdorimi i neuronavigacionit dhe kortikostimulimit intraoperativ u konsiderua thelbësor për suksesin e ndërhyrjeve.
Konkluzione: Trajtimi kirurgjik i patologjive insulare është i realizueshëm dhe relativisht i sigurt kur kryhet në qendra të specializuara, me përdorim të teknikave të avancuara si neuronavigacioni dhe monitorimi funksional. Zgjedhja e qasjes kirurgjikale duhet të personalizohet bazuar në lokalizimin e lezionit dhe marrëdhëniet e tij me strukturat kritike vaskulare dhe funksionale.

Fjalë kyçe: Korteksi insular, kirurgjia cerebrale, glioma, neuronavigacion, epilepsi kirurgjikale, qasje trans - silviane, patologji të thella cerebrale.

HEMANGIOMA FACIALE TE FOSHNJET: TRAJTIMI I SUKSESSHËM ME PROPRANOLOL.

Art Uka[1], Prof. Ass. Violeta Grajqevci - Uka[2, 3]
[1]*Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë*
[2]*Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Klinika e Pediatrisë, Reparti i Hemato - Onkologjisë*
[3]*Alma Mater Europaea kolegji "Rezonanca"*

Abstrakt
Hyrje: Hemangiomat infantile janë tumore beninje vaskulare më të shpeshta në fëmijëri, të cilët shfaqen zakonisht në javët e para të jetës dhe shpesh ndodhen në regjionin e fytyrës. Megjithëse në shumicën e rasteve kanë ecuri beninje me regresion spontan, disa prej tyre mund të shkaktojnë probleme funksionale, estetike dhe psikologjike.
Qëllimi: Qëllimi i këtij prezentimi është paraqitja e një rasti klinik të hemangiomës faciale dhe efikasiteti i trajtimit të saj me propranolol.
Metodologjia: Paraqitet një foshnje femër, 2 muajshe, në Klinikën e Pediatrisë në QKUK, për shkak të zmadhimit progresiv të një lezioni vaskular mbi vetullën e djathtë. Pas ekzaminimeve klinike, laboratorike dhe imazherike, u vendos diagnoza e hemangiomës faciale. Foshnja u trajtua me propranolol në dozë të përshtatur sipas peshës trupore.
Rezultate: Gjatë ecurisë klinike u vu re reduktim gradual i përmasave dhe intensitetit të ngjyrës së hemangiomës, pa u evidentuar efekte anësore serioze. Parametrat hemodinamikë dhe laboratorikë mbetën brenda kufinjve normalë.
Konkluzione: Ky rast konfirmon se propranololi është një terapi efektive dhe e sigurt në menaxhimin e hemangiomave infantile, veçanërisht në lokalizimet faciale, ku mund të parandalojë komplikime estetike dhe funksionale. Raportimi i rasteve klinike ndihmon në zgjerimin e përvojës sonë dhe në përforcimin e përdorimit të propranololit si terapi të linjës së parë.

Fjalë kyçe: Hemangioma infantile, propranolol, raport rasti, foshnje.

ABERACIONET LIPIDIKE DHE KORRELACIONI I TYRE ME HOMOCYSTEINËN (Hcy).

Dr. Sci. Med. Art Zylbeari[1, 2, 3], Elita Zylbeari - Masha[2], Zamira Bexheti[3], Gazmend Zylbeari[1, 2], Prof. Dr. Milka Zdravkovska[2]
[1]*Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës, RMV.*
[2]*Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Goce Delcev Universiteti, Stip, RMV.*
[3]*Universiteti i Evropës Juglindore - Tetovë, RMV.*

Abstrakt
Hyrje: Një lidhje e anasjelltë midis frakcioneve lipidike (veçanërisht HDL - ch - lipoproteinës me dendësi të lartë) dhe nivelet e larta të homociateinës (Hcy) është dokumentuar në shumë studime viteve te fundit si faktorë riskant për sëmundjet kardiovaskulare(SKV) për sëmundjen arteriale okluzive, trombozën venoze, insultit cerbral, dëmtimin endotelial të enëve tëgjakut dhe proceseve aterosklerotike premature. Hiperhomocis -

teinemia (HHcy) është një gjendje patologjike e karakterizuar nga nivele të rritura të homocisteinës (Hcy) në serum (një aminoacid i prodhuar gjatë metabolizmit të metioninës). Bashkëjetesa në të njëjtën kohë, me çrregullime të frakcioneve lipidike (me hiperholes - terolemi, hiertrigliceridemi dhe nivele të ulta të HDL - ch të apoliporoteinës A1 dukshëm e rrisin shkallën e dëmtimeve endoteliale të arterieve koronare, cerbrale dhe ato periferike. Edhe pse mekanizmi i lidhjes nuk dihet plotësisht, studimet e fundit kanë demonstruar fuqimisht rëndësinë e ekuilibrit metabolik midis S - adenozilmetioninës (SAM), S - adenozilhomocisteinës (SAH), fosfatidilkolinës (PC), fosfatidileta - nolaminës (PE) dhe kolinës në metabolizmin e Hcy, hipolipoproteineminë, funksionin e mëlçisë dhe sëmundjet kardiovaskulare (SKV). Disa studime që lidhin HHcy me metabolizmin e çrregulluar të HDL - C treguan se Hcy mund të zvogëlojë HDL - C në qarkullim duke penguar sintezën e proteinave ApoA - I dhe duke rritur pastrimin e HDL - Ch.
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë korrelacionin statistikor midis niveleve të homocisteinës dhe profilit lipidik (kolesteroli total, LDL - ch, HDL - ch dhe trigliceridet - TG) me sëmundjen ishemike të zemrës.
Materiali dhe metodat: Dizajni i studimit ishte retrospektiv përshkrues - analitik. Studimi me një kohëzgjatje prej 12 muajsh përfshinte 100 pacientë të ndarë në dy grupe: grupi A: 50 pacientë me hiperhomocisteinemi (>15 µmol / L) dhe grupi B: 50 pacientë me homocisteinemi normale (≤15 µmol / L) të randomizuar sipas moshës dhe gjinisë. Të gjithë pacientët u analizuan në gjendje urie çdo 4 muaj. Te të gjithë pacientat u bë ekzaminimi i: Hcy (µmol / L), kolesteroli total (tCH - mg / dL), LDL - ch (mg / dL), HDL (mg / dL), triglicerideve (mg / dL). Metodat statistikore: përshkrimi i mesatareve dhe devijimeve standarde, testi T për krahasim midis dy grupeve dhe korrelacioni Pearson midis parametrave të homocisteinës dhe lipideve. P<0. 05 u konsiderua statistikisht i rëndësishëm.
Rezultate: Të dhënat e këtij studimi treguan se midis fraksioneve lipidike të HHcy dhe ekziston një lidhje e fortë pozitive e rëndësishme, veçanërisht me rritjen e LDL - ch dhe tregliceridеve dhe dhe një korrelacion negativ midis HHcy dhe HDL - ch, rezultate që janë konsistente edhe me studimet mbi këte dukuri.
Përfundime: Hiperhomocisteinemia shfaqet në një lidhje statistikisht të rëndësishme me profilet e lipideve të çrregulluara, duke rritur rrezikun e ndërlikimeve kardiovaskulare. Monitorimi paralel i homocisteinës dhe lipidogramës duhet të merret në konsideratë në vlerësimin e rrezikut kardiovaskular, veçanërisht tek pacientët me faktorë të tjerë predispozues.

Fjalë kyçe: hiperhomocisteinemi, fraksionet lipidike**,**

VLERA PROGNOSTIKE E NIVELEVE TË RRITURA TË NT - PROBNP NË ENDOKARDITIN INFEKTIV.

Arta Karruli [1, 2], Emanuele Durante - Mangoni [1]
[1]*Department of Precision Medicine, University of Campania "L. Vanvitelli", Naples, Italy*
[2]*Shërbimi i Sëmundjeve Infektive, Spitali Rajonal i Kukësit, Shqipëri*

Abstrakt
Hyrje: Endokarditi infektiv (EI) është një infeksion akut ose subakut i zemrës me një shkallë të lartë vdekshmërie. Insuficienca akute e zemrës është një nga ndërlikimet më të zakonshme që shkakton vdekshmëri të hershme dhe gjithashtu afatmesme. NT - proBNP është ndër faktorët e lidhur me mosfunksionimin / dështimin kardiak dhe prognozën.
Objektivi: Qëllimi i këtij studimi ishte vlerësimi i rolit prognostik të NT - proBNP tek pacientët me EI dhe faktorëve që lidhen me rritjen e tij.
Materiale dhe metoda: Ky ishte një studim observacional, retrospektiv dhe prospektiv i 267 pacientëve të diagnostikuar me EI midis 2016 dhe 2022 në Spitalin Monaldi, Napoli, Itali. U mblodhëm të dhëna klinike, hematokimike dhe imazherike.
Rezultate: Niveli mesatar bazë i NT - proBNP ishte 2468 pg / mL. Nivelet më të larta të NT - proBNP u shoqëruan me rritje të rrezikut për vdekshmëri (p <0. 001). Pacientët me moshë më të madhe (p=0. 008), sëmundje ishemike të zemrës (p=0. 005), sëmundje obstruktive pulmonare (p=0. 009), sëmundje kronike të veshkave (p<0. 001), numër më të ulët të trombociteve (p=0. 001), te hemoglobinës (p<0. 001), albuminës (p<0. 001), HDL - C (p=0. 040), kolesterol total (p=0. 035), fibrinogjenit (p=0. 029), nivele më të larta të pro - ADM (p<0. 001), kopeptinës (p<0. 001), glicemsei (p=0. 002), kreatininës (p<0. 001), prokalcitoninës (p=0. 046), D - dimer (p=0. 004) ishin të shoqëruar me nivele më të larta të NT - proBNP. Gjithashtu, infeksioni nga Staphylococcus aureus ishte më i zakonshëm tek pacientët me nivel të lartë të NT - proBNP (p=0. 041). Nivelet

më të larta të NT - proBNP u shoqëruan gjithashtu me një shans më të lartë për të pasur një indikacion për ndërhyrje kirurgjikale (p=0. 023).
Perfundime: Nivelet më të larta të NT - proBNP ishin të lidhura me vdekshmërinë dhe indikacionin për kirurgji tek pacientët me EI. Duke pasur parasysh vlerën prognostike të këtij faktori, do të ishte shumë e dobishme në praktikën klinike të futej ky mjet në procesin diagnostik të EI.

Fjalë kyçe: NT - proBNP, mortaliteti, endoakrditi infektiv, faktorë risku.

TRAJTIMI I FRAKTURAVE TË KALKANEUSIT ME REPONIM TE HAPUR DHE FIKSIM INTERN.

Artan Bano, Rene Baraj, Ardit Zanaj, Vilson Ruci.
Klinika e Dytë Ortopedike, Spitali Universitar i Traumës, Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt
Hyrje: Frakturat e kalkaneusit përbëjnë dëmtimet më të shpeshta të kockave tarsale, të cilat zakonisht ndodhin si pasojë e traumave aksiale me energji të lartë, pas rënieve nga lartësi apo aksidenteve automobilistike. Perfshirja intra - artikulare ndodh në rreth 75% të rasteve dhe shoqërohet me dëmtime funksionale të konsiderueshme nëse nuk trajtohen në mënyrën e duhur.
Qëllimi: Vlerësimi i indikacioneve, teknikës kirurgjikale dhe rezultateve të trajtimit të frakturave të zhvendosura intra - artikulare të kalkaneusit me metodën e reponimit të hapur dhe fiksimit të brendshëm (ORIF).
Metoda: Pacientët me fraktura të zhvendosura të kalkaneusit (tip Sanders II–IV) u trajtuan me ORIF. U arrit reponim anatomik i facetit posterior dhe restaurim i lartësisë, gjerësisë dhe aksit të kalkaneusit duke përdorur pllaka dhe vida. Protokolli postoperator i cili u aplikua në të gjithë pacientët, përfshin ushtrime të hershme të lëvizshmërisë dhe më pas ngarkeses graduale me peshë.
Rezultate: Trajtimi me ORIF mundësoi përmirësim të dukshëm në rikonstruksionin anatomik të kalkaneusit dhe në rezultatet funksionale të pacientëve. Komplikacionet si nekroza e plagës operatore dhe infeksionet u reduktuan falë trajtimit të kujdesshëm të indeve të buta dhe voneses së ndërhyrjes derisa u ul edema. Vlerësimi funksional sipas shkallës AOFAS tregoi rezultate të mira në shumicën e rasteve.
Konkluzione: Reponimi i hapur dhe fiksimi i brendshëm mbeten standardi i artë për trajtimin e frakturave të zhvendosura intra - artikulare të kalkaneusit, duke ofruar rezultate superiore anatomike dhe funksionale kur kryhen me teknikë të kujdesshme dhe përzgjedhje të përshtatshme të pacientëve. Rehabilitimi i hershëm është thelbësor për të optimizuar rikuperimin dhe për të reduktuar kontrakturen e artikulacionit.

Fjalë kyçe: kalkaneus, frakturë, traumë, dëmtim etj.

NDIKIMI NË SHËNDET I FAKTORËVE USHQYES DHE DIETIKË TE PACIENTËT ME TIROIDITIN HASHIMOTO.

Md Artan Bitri[1], Phd. R Nezaj[2, 3] Md V. Kamberi[4], Msc. Telma Aliaj[5]
[1]*Mjek Familje në Qendrën Shëndetësore Nr. 9 në Tiranë*
[2]*Fakulteti i Shkencave Teknike Mjekësore, UMT*, [3]*Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit, UBT*
[4] *Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Logos University,* [5]*Fakulteti i Mjekësisë, UMT*

Abstrakt
Hyrje: Tiroiditi i Hashimotos (HT) është një çrregullim kronik autoimun, i karakterizuar nga çrregullime të funksionit imunitar, ndryshime metabolike dhe nivele të alteruara të elementëve gjurmë esencialë. Evidencat sugjerojnë se faktorët ushqimorë dhe nutricionalë mund të ndikojnë ndjeshëm si në zhvillimin, ashtu edhe në ecurinë e kësaj sëmundjeje.
Qëllimi: Ky rishikim synon të eksplorojë rolin e përbërësve specifikë dietikë të tillë si proteina, yndyrnat, vitamina D, jodi, seleni dhe gluteni si dhe mikrobiota e zorrëve, në rrezikun dhe rrjedhën klinike të tiroiditit të Hashimotos. Qëllimi i studimit ishte të vlerësohej ndikimi i këtyre faktorëve në shfaqjen dhe menaxhimin e sëmundjes, me fokus te tiroiditi Hashimoto dhe reagimi imunitar.

Materiale dhe Metoda: Është kryer një rishikim gjithëpërfshirës i literaturës duke përdorur bazën e të dhënave PubMed, duke analizuar artikuj shkencorë të publikuar gjatë 10 viteve të fundit. Fjalët kyçe të përdorura ishin: Hashimoto, ushqyerja, faktorët dietikë, ndikimi në shëndet. Studimet e përzgjedhura trajtonin marrëdhënien ndërmjet modelit të të ushqyerit, statusit të mikroelementëve dhe sëmundjes së Hashimotos.
Rezultate: Konsumi i tepërt i jodit u identifikua si një nga faktorët mjedisorë kryesorë në patogjenezën e HT. Mungesa e selenit gjithashtu kontribuon në rritjen e rrezikut për zhvillimin e sëmundjes, ndërsa suplementimi me selen dhe vitaminë D lidhej me reduktimin e antitrupave tiroidalë (si anti - Tg). Nivelet e vitaminës D rezultuan të jenë më të ulëta te pacientët me HT në krahasim me popullatën e përgjithshme. Mungesa e proteinës në dietë lidhej me rritje të TSH - së dhe ulje të hormoneve tiroide, ndërsa llojet e ndryshme të yndyrnave ushqimore ndikojnë ndryshe në funksionin e tiroides. Ndryshime në përbërjen e mikrobiotës intestinale janë vërejtur gjithashtu tek pacientët me HT, duke sugjeruar një lidhje imunitare ndërmjet shëndetit të zorrëve dhe autoimunitetit tiroidal.
Përfundime: Faktorët dietikë ndikojnë ndjeshëm në zhvillimin dhe përparimin e tiroiditit të Hashimotos. Strategjitë ushqimore të pasura me mikroelementë thelbësorë si seleni, zinku, magnezi dhe vitamina D, së bashku me ushqime të pasura me antioksidantë dhe dieta të balancuara me proteina, mund të ndihmojnë në modulimin e imunitetit dhe në rregullimin e hormoneve tiroide. Këto gjetje nënvizojnë rëndësinë e ndërhyrjeve dietike të personalizuara si pjesë e menaxhimit të plotë të HT.

Fjalë kyçe: Tiroiditi i Hashimotos, ushqyerja, elementë gjurmë, vitamina D, jod, faktorë dietikë

SUBCORNEAL PUSTULAR DERMATOSIS.

Artan Dafa, Prof. Ermira Vasili
Shërbimi Dermatologjisë QSU "Nënë Tereza" Tiranë

Hyrje: SPD është një sëmundje e rrallë me ecuri kronike dhe shkak të panjohur që prek më shpesh femrat mbi 40 vjeç. Manifestohet me puçrra të shumta që dalin në lëkurë normale ose zona me lëkurë eritematoze që lokalizohen në trup, në palë të lëkurës si sqetulla dhe rrezë kofshëve. Puçrrat thahen dhe krijohen krusta dhe skuama të imta që shoqërohen me rishfaqje të puçrrave. Elementët ikin duke lënë njolla të hiperpigmentuara. Karakteristike është pucrra - vezikul me gjysmën e poshtme purulente dhe gjysmën e sipërme me likid të qartë. SPD shpesh shoqërohet nga patologji si: IgA monoclonal gammopati, myeloma multiple, pyoderma gangrenosum etj. Diagnoza diferenciale kryhet me Psoriasis pustular, AGEP, pemphigus foliaceus, Subcorneal IgA pemphigus, dermatitis herpetiformis. Biopsia konfirmon diagnozën.
Trajtimi: Dapson, retinoide orale, terapi biologjike (adalimumab, infliximab).
Raportim rasti: Pacienti R. K 48 vjeç, ankon për shfaqje të puçrrave me qelb fillimisht në duar e më pas trup, qafë dhe ekstremitete që i provokojnë kruarje dhe djegie të lehtë. Referon se sëmundja i ka filluar para 8 vjetësh.
Objektivi: Procesi patologjik i lokalizuar në qafë, trup dhe ekstremitete. Karakterizohet nga elementë puçrralë, vezikulo - puçrral me likid purulent në gjysmën e poshtme dhe likid të qartë në ½ e sipërme, elementë plakë erithematoze me dimensione nga 1 - 2. 5 cm me skuama e krusta në sipërfaqe si dhe macula me hiperpigmentim. U kryen ekzaminimet laboratorike si dhe biopsia e elementit kutan që rezulton Subcorneal Pustular Dermatosis. Pas 5 muaj mjekim me Dapson kemi persistencë të elementëve. Mjekimi me Adalimumab u shoqërua me remision të plotë të sëmundjes.
Konkluzione: Përdorimi i Adalimumabit është opsion i mirë terapeutik në rastin tonë.

Fjalë kyçe: Subcorneal Pustular Dermatosis, dermatozë pustulare, diagnozë diferenciale, adalimumab.

IMPLANTET SIMPTOMATIKE DHE HEQJA E TYRE NË PRAKTIKËN ORTOPEDIKE: NJË STUDIM RETROSPEKTIV.

Artan Distafa, MD, Arben Celiku, MD, Elton Lepuri, MD
Departamenti i Kirurgjisë Ortopedike, Spitali Universitar i Traumës, Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt

Sfondi: Heqja e implanteve ortopedike mbetet një praktikë e zakonshme, por e debatuar. Ndërsa implantet janë të dizajnuara për fiksim të përhershëm, implantet simptomatike mund të çojnë në dhimbje, acarim ose infeksion që justifikon heqjen.
Objektiva: Të vlerësohen indikacionet, rezultatet dhe ndërlikimet e heqjes së implanteve simptomatike në një qendër ortopedike terciare.
Metoda: Ky studim retrospektiv përfshin 46 pacientë që iu nënshtruan heqjes së implantit midis janarit 2021 dhe dhjetorit 2024. Të dhënat mbi vendin e implantit, indikacionin dhe rezultatet u shqyrtuan nga të dhënat e spitalit.
Rezultate: Vendet më të zakonshme ishin tibia (30%), femuri (26%), kyçi i këmbës (22%) dhe parakrahu (22%). Indikacionet kryesore ishin dhimbja (43%), dalja e implantit (28%), infeksioni (15%), kufizimi funksional (9%) dhe kërkesa e pacientit (5%). Tetëdhjetë e shtatë përqind e pacientëve përjetuan lehtësim të dhimbjes ose përmirësim të funksionit pas operacionit. Komplikime të vogla ndodhën në 3 pacientë (6. 5%), të gjitha infeksione sipërfaqësore që u zgjidhën me antibiotikë. Nuk u vunë re fraktura ose dëmtime neurovaskulare.
Konkluzioni: Heqja simptomatike e implantit është përgjithësisht e sigurt dhe çon në përmirësim të simptomave në shumicën e pacientëve. Përzgjedhja e kujdesshme dhe teknika e kujdesshme kirurgjikale janë thelbësore për të minimizuar komplikimet.
Fjalë kyçe: heqja e implantit, implatet simptomatike, kirurgjia ortopedike, komplikimet kirurgjikale.

REVASKULARIZIMI TE PACIENTËT ME NSTEMI DHE SËMUNDJE MULTIVAZALE - NJË RISHIKIM GJITHËPËRFSHIRËS KLINIK.
Dr. Artan Kristo, Dr. Klaudio Hoxha, Dr. Kristi Ziu
Shërbimi i kardiologjisë, QSUNT

Abstrakt
Sindromi koronar akut përbën një spektër të gjerë gjendjesh klinike të shkaktuara nga ishemia akute e miokardit, i cili përfshin anginën e paqëndrueshme, infarktin akut të miokardit me ngritje të segmentit ST (STEMI) dhe infarktin pa ngritje të segmentit ST (NSTEMI). Shkaku kryesor lidhet me çekuilibrin ndërmjet kërkesës dhe furnizimit me oksigjen të miokardit, zakonisht si pasojë e stenozave koronare të shkaktuara nga pllaka aterosklerotike dhe komplikacionet e saj trombotike. Lezioni përgjegjës për infarktin, i njohur si lezioni kulprit, trajtohet në mënyrë standarde me ndërhyrje perkutane koronare (PCI), e cila mbetet strategjia terapeutike kryesore në praktikën klinike bashkëkohore. Rreth 70% e pacientëve me NSTEMI paraqiten me sëmundje multivazale, ku është treguar se revaskularizimi i plotë përmirëson dukshëm ecurinë afatgjatë dhe prognozën. Udhëzimet e fundit të Shoqatës Evropiane të Kardiologjisë (ESC 2023) rekomandojnë marrjen në konsideratë të revaskularizimit të plotë tek kjo kategori pacientësh (Klasa IIa), megjithatë koha optimale e trajtimit të lezioneve jokulprit mbetet ende e paqartë dhe një fushë debati aktiv. Studimet klinike dhe meta - analizat kanë prodhuar rezultate jo gjithmonë të njëtrajtshme: disa sugjerojnë se revaskularizimi i menjëhershëm gjatë procedurës indekse mund të reduktojë incidencën e infarktit të përsëritur dhe nevojën për reintervenim, ndërsa të tjera kanë evidentuar një rritje të mundshme të mortalitetit afatshkurtër. Nga ana tjetër, strategjia e revaskularizimit ne dy etapa, ul ngarkesën e kontrastit dhe redukton kompleksitetin e procedurës. Në mungesë të provave të qarta dhe përfundimtare, vendimmarrja klinike duhet të individualizohet mbi bazën e stabilitetit hemodinamik të pacientit, funksionit renal, kompleksitetit anatomik të lezioneve, si edhe disponueshmërisë së teknikave shtesë si vlerësimi me FFR apo imazheria intrakoronare. Nevojiten studime të mëtejshme të randomizuara dhe me fuqi të mjaftueshme statistikore, për të përcaktuar qasjen optimale të revaskularizimit në pacientët me NSTEMI dhe sëmundje multivazale, duke synuar balancimin e sigurisë me përfitimin afatgjatë.

Fjalë kyçe: Sindromi koronar akut, NSTEMI, ishemi akute, miokard.

NDIKIMI I AKTIVITETIT FIZIK NË SËMUNDJET KRONIKE TEK PUNONJËSIT E POLICISË: NJË VËSHTRIM LITERATURE.

Artiljere Dura[1], Lumturi Merkuri[2]
[1]*Akademia e Sigurisë, Tiranë, Shqipëri*
[2]*Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Tiranë, Shqipëri*

Abstrakt
Hyrje: Punonjësit e policisë përballen me orë të gjata pune, punë me turne dhe mbingarkesë profesionale, që ndikojnë në kufizimin e mundësive për aktivitet fizik të rregullt. Mungesa e aktivitetit fizik në këtë grup profesional është një faktor kyç që kontribuon në rritjen e incidencës së sëmundjeve kronike, përfshirë hipertensionin, diabetin dhe sëmundjet kardiovaskulare.
Metodologjia: Studimi bazohet në një shqyrtim sistematik të literaturës shkencore lidhur me ndikimin e kushteve të punës të punonjësve të policisë në aktivitetin fizik dhe për pasojë në shëndetin kronik. Janë analizuar studime që trajtojnë lidhjen mes orareve të punës, stresit profesional dhe niveleve të aktivitetit fizik në këtë target grup.
Rezultate: Evidencat nga literatura tregojnë se puna me orare të zgjatura dhe turne, si dhe ngarkesa e lartë psikofizike, janë faktorë që ndalojnë ose ulin ndjeshëm pjesëmarrjen e efektivëve të rendit në aktivitet fizik. Ulja e aktivitetit fizik korrespondon me rritje të faktorëve të rrezikut për sëmundje kronike dhe ulje të mirëqenies së përgjithshme. Studimet nënvizojnë gjithashtu se programet e personalizuara dhe fleksibile të aktivitetit fizik mund të përmirësojnë shëndetin e këtij grupi.
Konkluzione: Literatura shkencore evidencon se oraret e punës dhe stresorët e tjerë janë pengesa kryesore për aktivitetin fizik të rregullt te punonjësit e policisë, duke kontribuar në zhvillimin e sëmundjeve kronike. Për këtë arsye, aktiviteti fizik duhet të inkorporohet në mënyrë sistematike në jetën profesionale të efektivëve për të parandaluar pasoja afatgjata shëndetësore.
Rekomandime: Zhvillimi i programeve të aktivitetit fizik fleksibël dhe të përshtatura për kushtet specifike të punës në polici, krijimi i infrastrukturës dhe hapësirave të dedikuara për ushtrime fizike në ambientet e punës, promovimi i kulturës organizative që inkurajon mirëqenien fizike dhe psikologjike, edukimi i punonjësve mbi rëndësinë e aktivitetit fizik si mjet parandalues për sëmundjet kronike, janë disa nga mjetet parandaluese për sëmundjet kronike te efektivët e rendit.

Fjalë kyçe: Polici, aktivitet fizik, sëmundje kronike, parandalim, shëndet

SPONDILOARTROPATITË – KLINIKA, DIAGNOSTIKIMI DHE TRAJTIMI.

A. Kollçaku[1], J. Kollçaku[2], V. Duraj[1], A. Shiroka[1], N. Dushaj[1]
[1]*Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri*
[2]*Qendra e specialiteteve nr. 3, Tiranë, Shqipëri*

Abstrakt
Spondiloartropatitë janë një grup heterogjen i sëmundjeve inflamatore kronike i karakterizuar nga inflamacion i artikulacioneve aksiale dhe / ose periferike shpesh i shoqëruar me inflamacione ekstra - artikulare të syve, lëkurës ose sistemit tretës dhe që përmbledh sëmundjet e spondilitit ankilozant, artritit reaktiv, artritit psoriatik dhe artritit / spondilitit të shoqëruar me sëmundje inflamatore të sistemit tretës. Etiologjia e spondiloartropative është ende e panjohur, por ndërveprimi midis faktorëve gjenetikë dhe ambientalë priren të luajnë rol kryesor në shfaqjen e sëmundjes. Ka një korrelacion të drejtë të prevalencës së spondiloartropative dhe aleleve HLA - B27. Raporti meshkuj / femra varion nga 2: 1 deri në 3: 1. Ekzaminimi imazherik është i rëndësishëm për të dalluar ndryshimet e hershme në artikulacionet sakroiliake dhe entezitis. Diagnoza e hershme është e rëndësishme për të parandaluar komplikacionet në sy dhe organe të tjera. ASAS / EULAR rekomandojnë diagnozën e hershme si shumë të rëndësishme për shumë arsye: diagnozë e hershme e saktë shmang proçedura të mëtejshme diagnostike dhe trajtimet e gabuara, është mjaft i rëndësishëm fillimi i trajtimit sa më herët, bën të mundur fillimin dhe vazhdimin e trajtimit me anti - inflamatorë josteroidë në pacientë simptomatikë menjëherë me vendosjen e diagnozës, bën të mundur fillimin e trajtimit me barna anti - TNF në pacientë me forma rezistente ndaj trajtimit konvencional dhe me prezencë të aktivitetit të sëmundjes.

Fjalë kyçe: Spondiloartropatitë, sëmundje inflamatore, alele HLA, artikulacione sakroiliake.

NEURALGJIA TRIGEMINALE, DEKOMPRESIONI MIKROVASKULAR ME QASJE PLOTËSISHT ENDOSKOPIKE MINI - INVAZIVE.

Prof. Artur XHUMARI[1], Dr. Sidorela SELMANI[2], Dr. Sc. Kliti PILIKA[3], Dr. Myfit SARACI[3], Dr. Maren RUKA[4]

[1]Neurokirurg, Shef i Shërbimit të Neurokirurgjisë, QSU "Nënë Tereza" Tiranë

[2]Specializant në Neurokirurgji, QSU "Nënë Tereza" Tiranë

[3]Anestezist në Shërbimin e Neurokirurgjisë, QSU "Nënë Tereza" Tiranë

[4]Neurokirurg në Shërbimin e Neurokirurgjisë, QSU "Nënë Tereza" Tiranë

Abstrakt

Neuralgjia trigeminale (NT), e njohur ndryshe si tic douloureux, është një çrregullim neuropatik i karakterizuar nga paroksizma dhimbjeje fytyre të padurueshme, therëse, përgjatë shpërndarjes së nervit trigeminal. Trajtimi i neuralgjisë trigeminale zakonisht fillon me terapi medikamentoze (antikonvulsantë, agjentë antispazmodikë, injeksion me Botox). Në rastet kur trajtimi farmakologjik nuk është efektiv, aplikohen metoda të tjera: rizotomia (injeksion me glicerinë, kompresion me balonë, lezion termik me radiofrekuencë), radiokirurgjia (gamma knife) ose kirurgjia (dekompresioni mikrovaskular). Ky studim synon të vlerësojë rezultatet e trajtimit kirurgjikal të NT.

Metoda: U zhvillua një seri rastesh prospektive jo - krahasuese, duke përdorur regjistrin elektronik mjekësor për identifikimin e të gjithë pacientëve që iu nënshtruan dekompresionit mikrovaskular plotësisht endoskopik për NT në Shërbimin e Neurokirurgjisë, QSU "Nënë Tereza", gjatë periudhës janar 2016 – shtator 2023, nga një kirurg i vetëm (AXh). Për rastet e identifikuara u mblodhën të dhënat klinike, imazherike, videot intraoperative dhe ekzaminimet neurologjike postoperatore. Pas vlerësimit fillestar, u kryen intervista telefonike ndjekëse afatgjata me fokus në vlerësimin e lehtësimit të dhimbjes.

Rezultate: Demografia: Studimi përfshiu 36 pacientë, nga të cilët 65. 71% ishin femra dhe 34. 29% meshkuj. Etiologjia: Konflikt neurovaskular (77. 14%), shvannoma vestibulare (11. 43%), meningioma e këndit pontocerebelar (8. 71%), kist epidermoid i këndit cerebelopontin (2. 86%). Klasifikimi klinik preoperator: NT1 78. 8%, NT2 20. 3%, 1% dhimbje neuropatike trigeminale. Shkalla preoperative BNI (Barrow Neurological Institute): shkalla 4 – 63. 8%, shkalla 5 – 36. 1%. Shkalla postoperatore BNI: shkalla 1 – 86. 1%, shkalla 2 – 8. 3%, shkalla 3 – 5. 6%. Trajtimi aktual: 1 pacient merr Tegretol.

Përfundimi: Dekompresioni mikrovaskular plotësisht endoskopik mund të lehtësojë ndjeshëm dhimbjen e lidhur me NT, me shumicën e pacientëve që përjetojnë zhdukje të plotë të dhimbjes.

Fjalë kyçe: Neuralgjia trigeminale, ndërhyrje kirurgjikale, vlerësim i dhimbjes, diagnozë me MRI

TRAJTIMI MULTIMODAL I PITNET GH SEKRETORE.

Prof. Dr. Artur Xhumari, Emanuel Fizi

Abstrakt

Hyrje: Adenomat GH - sekretore të hipofizës janë tumore beninje të qelizave somatotrope që shkaktojnë hipersekretim të hormonit të rritjes (GH) dhe rritje të nivelit të IGF - 1, duke çuar në zhvillimin e akromegalisë. Kjo gjendje lidhet me morbiditet dhe mortalitet të shtuar, kryesisht për shkak të komplikacioneve kardiovaskulare, respiratore dhe metabolike. Qëllimi kryesor i trajtimit është arritja e remisionit biokimik, reduktimi i masës tumorale dhe parandalimi i efekteve afatgjata të hipersekretimit hormonal. Modalitetet terapeutike përfshijnë ndërhyrjen kirurgjikale, trajtimin medikamentoz dhe radioterapinë, të cilat mund të përdoren individualisht ose në kombinim. Kirurgjia transsfenoidale mbetet zgjedhja e parë për shumicën e pacientëve, duke ofruar mundësi të larta për shërim, veçanërisht në rastet me mikroadenoma ose tumore pa invazion të strukturave përreth.

Objektivi: Ky studim synon të vlerësojë rezultatet e trajtimit kirurgjikal transsfenoidal tek 17 pacientët me adenoma GH - sekretore që kishin kaluar një terapi multidisiplinare kirurgjikale, mjekësore dhe radiokirurgjikale duke analizuar normat e remisionit biokimik, reduktimin e masës tumorale dhe incidencën e

komplikacioneve perioperatore. Gjithashtu, studimi synon të identifikojë faktorët prognostikë që ndikojnë në suksesin kirurgjikal dhe nevojën për trajtime adjuvante, duke u bazuar në të dhëna klinike dhe laboratorike të pacientëve të operuar në Shërbimin e Neurokirurgjisë.
Materiale dhe metoda: Janë shqyrtuar retrospektivisht 17 raste të njëpasnjëshme të adenomeve hipofizare që sekretojnë GH, të cilët i ishin nënshtruar kirurgjisë transsfenoidale endoskopike, midis viteve 2022 dhe 2024 dhe perfshiheshin 9M dhe 8F nga mosha 35 - 66. Tumoret u klasifikuan sipas diametrit të tyre, të matur me MRI, si mikro - ose makroadenoma, dhe përhapja e tyre në sinusin kavernos u analizua bazuar në shkallën e vlerësimit Knosp. Periudha mesatare e ndjekjes ishte 24 muaj. Ne analizuam rezultatet kirurgjikale të pacientëve sipas kritereve më të reja për remission.
Rezultate: Një normë e përgjithshme e remisionit së plotë hormonale (GH dhe IGF - 1 në normë) u arrit në 76. 5% të pacientëve me anë të kirurgjisë vetëm. Norma e remisionit biokimik ishte më e lartë tek pacientët me mikroadenoma (100%) sesa tek ata me makroadenoma (43%). Analiza e nivelit të IGF - 1 në 8 pacientë me të dhëna të plota tregon se mesatarisht ky nivel ra me rreth 62. 5% pas trajtimit kirurgjikal. GTR u arrit në 13 pacientë dhe STR në 4 pacientë. Vdekshmëria: 0; Meningiti: 0; Rrjedhje e likuorit gjatë operacionit (CSF): 5 raste; Rrjedhje e likuorit pas operacionit (CSF): 1 rast; Diabet insipid i përkohshëm: 4 raste; Përmirësim i shikimit: te të gjithë pacientët; Recidive 1 rast. 4 pacientë me macroadenome u trajtuan me analoge të somatostatinës ose 23. 5%; asnjë rast nuk u trajtua me Radioterapi. U identifikuan disa faktorë parashikues, të cilët mund të kenë ndikuar në normën e remisonit hormonale: madhësia e tumorit, përhapja në sinusin kavernos e matur sipas shkallës Knosp dhe shkalla e rezekimit subtotal të tumorit.
Përfundime: Kirurgjia transsfenoidale endoskopike përfaqëson një opsion efektiv për trajtimin e pacientëve me akromegali nisur nga rezultatet ku 13 pacientë arritën remission vetëm me anë të kirurgjisë dhe vetëm 4 prej tyre kerkuan trajtim adjuvant. Shkalla e lartë e kontrollit të sëmundjes dhe numri i vogël i komplikacioneve janë disa nga pikat më të rëndësishme të lidhura me këtë teknikë. Mund të arrihen norma të favorshme të remisonit hormonal dhe klinik pas rezekimit transsfenoidal të adenomeve hipofizare që sekretojnë GH; megjithatë, menaxhimi mbetet sfidues, ku përvoja e shtuar kirurgjikale është e rëndësishme për nivele më të larta shërimi**.** Grada e Knosp - it si dhe përmasat e tumorit**,** ndikojnë në shkallën e rezekimit**.** Nëse nuk arrihet një normalizim hormonal pas operacionit, mund të rekomandohet terapi shtesë mjekësore ose radio - kirurgjikale.

Fjalë kyçe: Adenomat GH - sekretore, tumore beninje, somatotrope, hipersekretim.

OPTIMIZIMI I TRAJTIMIT TË PACIENTËVE ME LUPUS ERITEMATOZ SISTEMIK.

Prof. Asc. Artur Zoto, Dr. Valbona Salko, Dr. Shk. Ervin Rapushi, Prof. Dr. Teuta Backa, Dr. Florenc Spaho
QSUNT

Abstrakt
Hyrje: Standartet e përkujdesjes dhe trajtimit të pacientëve me Lupus Eritematoz Sistemik (LES) janë gjithmonë objekt i rishikimeve dhe përditësimeve nga specialistët e fushës. Terapitë aktuale përfshijnë steroidët, anti malarikët e sintezës, imunosupresorët, disa biologjikë, imunoglobulinat intravenoze, plazmaferezën etj. Strategjia aktuale e trajtimit është përdorimi i tyre si treat to target për të arritur aktivitet të ulët të sëmundjes ose remision të plotë.
Qëllimi: Rishikimi i strategjisë së trajtimit të pacientëve me LES duke analizuar dhe marrë në konsideratë të gjitha rekomandimet e shoqatave të rëndësishme reumatologjike: EULAR, ACR dhe KDIGO. Kjo nevojshmëri lind pasi ende ka sfida dhe nevoja të papërmbushura për këta pacientë në rekomandimet aktuale.
Metoda: Të gjithë rekomandimet aktuale të shoqatave të rëndësishme reumatologjike internacionale.
Rezultate: Në përfundim të kësaj analize u evidentua që shpesh shkak i dështimit të strategjive të mjekimit është dritarja e zgjatur kohore nga shfaqja e simptomave deri në vendosjen e diagnozës dhe si pasojë kjo e bën më sfiduese vendosjen nën kontroll të sëmundjes në momentin që është bërë një diagnostikim i vonuar. Gjithashtu u analizua raporti risk - përfitim për preparatet aktuale në përdorim dhe u paraqit mendimi për minimizimin e përdorimit të disa prej tyre, kryesisht të glukokortikoideve. U analizuan të gjithë barnat që janë në faza studimore dhe paraqiten premtuese, sidomos për lupus nefritis. Vigjilenca për prekjet multiorganore që bën sëmundja duhet të jetë e lartë, ashtu si kujdesi specifik që kërkohet për pacientet shtatzëna me LES.
Konkluzione: Që strategjitë e trajtimit të LES të jenë sa më afër synimit treat to target duhet të bëhet një rishikim i kujdesshëm që në përkufizimin e sëmundjes, kriteret përkatëse të vendosjes së diagnozës, vlerësimi i

biomarkerëve të rinj që po studiohen etj. Gjithashtu në anën e trajtimit duhet të rishikohen benefitet në terapitë aktuale dhe të konsiderohen barnat që janë në studim.
Rekomandime: Trajtimi i pacientit me LES në thelb është kompleks dhe multidisiplinar. Kërkon vlerësime periodike për të parë ecurinë e trajtimit, prekjet organore apo efektet anësore nga barnat.

Fjalë kyçe: lupus, eritematoz, sistemik.

PREVALENCA E OSTEOPOROZËS NË SËMUNDJET REUMATIZMALE.
Prof. Asc. Artur Zoto, Dr. Valbona Salko, Dr. Shk. Ervin Rapushi, Prof. Dr. Teuta Backa, Dr. Florenc Spaho
QSUNT

Abstrakt
Hyrje: Osteoporoza është një komplikacion i shpeshtë te pacientët me sëmundje reumatizmale, i cili ndikohet nga inflamacioni kronik dhe efektet anësore të terapive farmakologjike, veçanërisht përdorimi i kortikosteroideve dhe imunosupresorëve.
Qëllimi: Vlerësimi i prevalences së osteoporozës dhe faktorët e lidhur me të, te pacientët me Artrit Reumatoid (AR), Spondilit Ankilozant (SA) dhe Lupus Eritematoz Sistemik (LES).
Metoda: Ky studim eshte studim retrospektiv dhe përfshin 75 pacientë të ndarë në mënyrë të barabartë në tre grupe: lupus eritematoz sistemik (LES), artrit reumatoid (AR) dhe Spondilit Ankilozant (SA). U analizuan të dhënat demografike (mosha, gjinia), kohëzgjatja e sëmundjes dhe përdorimi i medikamenteve. Densiteti mineral i kockës u mat me metodën DEXA dhe rezultatet u shprehën me T - score (osteoporozë T - score ≤ –2. 5).
Rezultate: Osteoporoza u gjet te 61 % te pacientëve, më e shprehur tek pacientët me LES (32%) krahasuar me AR (23%) dhe SA (6 %). Femrat, veçanërisht pas menopauzës, përdorimi i kortikosteroideve dhe immunosupresorëve për më shumë se nje vit si dhe dëmtimet organore kishin nje risk më të lartë për osteoporoz (69% kundrejt 31%). Frakturat osteoporotike u regjistruan te 8 % të pacientëve, duke prekur kryesisht vertebrat, koksofemoralet dhe parakrahët.
Përfundime: Ky studim thekson rëndësinë e vlerësimit dhe monitorimit të densitetit kockor te pacientët me keto sëmundje reumatizmale. Identifikimi i hershëm dhe monitorimi i densitetit kockor në këta pacientë mund të lejojë ndërhyrje parandaluese nëpërmjet mjekimeve dhe mënyrës së jetesës si dhe të reduktojë komplikacionet nga osteoporoza sic janë frakturat, duke përmirësuar cilësinë e jetës.

Fjalë kyçe: osteoporoza, lupus, artriti.

PREVALENCA E FAKTORIT REUMATOID DHE ANTI - CCP NË ARTRITIN REUMATOID.
Prof. Artur Zoto, Dr. Valbona Salko, Dr. Shk. Ervin Rapushi, Prof. Dr. Teuta Backa, Dr. Florenc Spaho.
QSUNT

Abstrakt
Hyrje: Artriti reumatoid (RA) është një sëmundje inflamatore autoimune kronike që prek artikulacionet dhe shpesh çon në dëmtime të pakthyeshme të tyre. Dy markuesit serologjikë të rëndësishëm për diagnozën dhe parashikimin e ecurisë klinike të sëmundjes janë faktori reumatoid (FR) dhe antitrupat anti - CCP (anti - cyclic citrullinated peptide).
Qëllimi: Vlerësimi i prevalencës së FR dhe anti - CCP tek pacientët e diagnostikuar me RA, si dhe korelacioni midis tyre dhe karakteristikave klinike të sëmundjes.
Metoda: Ky është një studim retrospektiv, i kryer ne 90 pacientëve të diagnostikuar me RA. Janë analizuar të dhënat demografike, rezultatet laboratorike për FR dhe anti - CCP, si dhe shkalla e aktivitetit të sëmundjes.
Rezultate: Nga 80 pacientë me RA, 70% rezultuan pozitivë për RF, 60% pozitivë për anti - CCP dhe 50% e pacientëve ishin pozitivë për të dy markerët, ndërsa vetëm 15% rezultuan negativë për të dy. U vu re një lidhje e drejtpërdrejtë midis seropozitivitetit dhe formave më të avancuara klinike të sëmundjes. Seropozitiviteti ishte më i lartë tek pacientët e moshës mbi 50 vjeç si dhe tek femrat.

Përfundime: FR dhe anti - CCP mbeten biomarkerat thelbësorë në diagnostikimin dhe vlerësimin e rrezikut tek pacientët me artrit reumatoid jo vetëm për dëmtimet artikulare por edhe ato organore. Rekomandohet përdorimi rutinë i këtyre testeve në praktikën klinike për përmirësimin dhe menaxhimin e sëmundjes.

Fjalë kyçe: Artriti reumatoid, faktori reumatoid, anti - CCP.

FORAMEN OVALE PATENTE "KALIMTAR" RASTËSOR APO BASHKËPUNËTOR NË KRIM.

Dr Astrit Ceka, Dr Briand Shehu

Abstrakt

Foramen Ovale Patent (PFO) është një komunikim i mbetur midis atriumit të djathtë dhe të majtë të zemrës, i cili normalisht mbyllet pas lindjes. Në rreth 25–30% të popullatës së rritur, ky komunikim mbetet i hapur dhe zakonisht zbulohet si një gjetje rastësore. Megjithatë, në raste të veçanta, PFO mund të shërbejë si mekanizëm patofiziologjik që favorizon embolizmin paradoksal dhe goditjen ishemike. Ky prezantim synon të paraqesë një pasqyrë të plotë mbi epidemiologjinë, embriologjinë, diagnostikimin dhe opsionet terapeutike të PFO - së, si dhe të diskutojë udhëzimet ndërkombëtare mbi trajtimin e tij. Nga pikëpamja klinike, shumica e pacientëve me PFO janë asimptomatikë, por komplikacionet mund të përfshijnë stroke kriptogjenik, sindromën platipnea - ortodeoksi, sëmundjen e dekompresionit dhe migrenën. Diagnoza bazohet kryesisht në ekokardiografi, veçanërisht në transesofageale dhe testin me mikro - flluska. Rreziku i lidhjes mes PFO - së dhe AVC - së vlerësohet me RoPE score dhe klasifikimin Pascal, të cilat ndihmojnë në përcaktimin e probabilitetit shkak - pasojë. Opsionet terapeutike përfshijnë mbylljen perkutane të PFO - së me pajisje specifike si Amplatzer apo Gore, të cilat krahasohen për efikasitet dhe siguri. Rekomandimet e SCAI sugjerojnë mbylljen e PFO tek pacientët 18–60 vjeç me AVC të përsëritura, duke përfshirë menaxhimin post - procedural me terapi antiagregante dhe monitorim të rregullt ekokardiografik. Përfundimisht, rëndësia e vlerësimit individual të pacientit është thelbësore, duke marrë parasysh faktorët e rrezikut, anatominë e PFO - së dhe probabilitetin e lidhjes së tij me ngjarjet klinike.

Fjalë kyçe: Foramen Ovale Patent, stroke kriptogjenik, embolizëm paradoksal, mbyllje perkutane, terapi antitrombotike.

CONDYLOMA ACUMINATA TE NJË VAJZË ADOLESHENTE 19 - VJEÇARE, NJË RAPORTIM RASTI!

Astrit Xhemali[1], Ilir Dimareli[2], Bujar Bregaj[2], Kejsara Tahiri[2]
[1] Reparti i Kirurgjisë së Përgjithshme, Spitali Universitar "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri
[2] Rezident në Kirurgji të Përgjithshme, Spitali Universitar "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Hyrje: Kondilomat, ose lythat gjenitale, janë një infeksion i zakonshëm seksualisht i transmetueshëm (IST) i shkaktuar nga papilomavirusi njerëzor (HPV), kryesisht llojet 6, 11, 16, 18 dhe 31. Megjithëse në përgjithësi beninje, kondilomat mund të shkaktojnë shqetësime të konsiderueshme, shqetësime psikologjike dhe një rrezik në rritje për infeksione të tjera seksualisht të transmetueshme, duke përfshirë llojet e HPV me rrezik të lartë të shoqëruara me kancerin e qafës së mitrës dhe kancera të tjere. Trajtimet aktuale, të tilla si mjekimet topikale, krioterapia dhe ndërhyrjet kirurgjikale, ndryshojnë në efikasitet dhe tolerancën e pacientit.

Prezantim i rastit: Një paciente femër 19 - vjeçare u paraqit në departamentin e urgjencës duke përmendur skuqje dhe kruajtje të të gjithë zonës gjenitale. Në historinë e saj mjekësore, ajo raporton se 5 muaj më parë ka pasur raport seksual me një burrë pa përdorur prezervativ, dhe shqetësimet e saj u shfaqën 2 javë para se të vinte në spital. Ekzaminimi objektiv: vërehen disa lezione të shumëfishta rreth organeve gjenitale, kryesisht në vulvë, me më të madhen që mat rreth 8 mm në diametër, shumica e të cilave janë formacione verukoze, që shtrihen në të gjithë zonën perineale dhe rreth anusit.

Procedura e trajtimit: Ekzistojnë disa mënyra për të trajtuar lythat, varësisht nga numri, madhësia, vendndodhja ose faktorë të tjerë të tyre. Kremra topikalë që përmbajnë përbërës të tillë si: imikuimod,

podofilotoksinë, acid trikloroacetik, interferon alfa n - 3, sinekatecinate. Heqje e thjeshtë, krioablacion me azot të lëngshëm, elektrokauterizim, kirurgji e zgjatur. Në rastin konkret i nënshtrohet ndërhyrjes kirurgjikale dhe heqja e të gjitha lezioneve kryhet me elektrokauterizim.
Diskutim: Cila do të ishte mënyra më e mirë për të trajtuar Kondilomën? Një parandalim i mirë kundër HPV - së, apo trajtim radikal kirurgjikal.
Konkluzione: Kondilomat gjenitale vazhdojnë të përfaqësojnë një problem të rëndësishëm të shëndetit publik tek gratë e reja. Vaksinimi i hershëm kundër HPV - së dhe edukimi gjithëpërfshirës për shëndetin seksual janë thelbësorë për të zvogëluar incidencën dhe përsëritjen. Terapia e kombinuar me imikuimod dhe krioterapi ose kirurgji është qasja më efektive dhe miqësore për pacientin për trajtimin e kondilomave.

Fjalë kyçe: papilomavirusi njerëzor, kondilomat gjenitale, gratë e reja, përsëritja, vaksinimi, kirurgjia, elektrokauterizimi.

TRANSFORMIMI I PROFESIONISTËVE SHËNDETËSORË NË EPOKËN E INOVACIONIT TEKNOLOGJIK: RËNDËSIA, SFIDAT DHE PERSPEKTIVAT E REJA.
Dr. Aurela Beqiri

Abstrakt
Avancimi i profesionistëve shëndetësorë është thelbësor për përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor dhe përshtatjen e sistemeve shëndetësore ndaj zhvillimeve të shpejta teknologjike. Me rritjen e ndikimit të Inteligjencës Artificiale (AI), robotikës dhe telemjekësisë, praktikat mjekësore po transformohen drejt një modeli më të personalizuar dhe efikas. Megjithatë, ky proces has në sfida të shumta, si mungesa e përgatitjes digjitale të profesionistëve, kostot e larta të pajisjeve dhe trajnimeve, si dhe rezistenca ndaj ndryshimeve teknologjike.
Ky studim analizon rëndësinë e përfshirjes së teknologjive të reja në praktikën mjekësore, duke u mbështetur në literaturën bashkëkohore, studime rastesh dhe intervista me profesionistë të shëndetësisë. Qëllimi është identifikimi i mënyrave efektive për zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe integrimin e sigurt të inovacioneve teknologjike në sistemet shëndetësore.
Rezultatet theksojnë nevojën për politika mbështetëse, trajnime të vazhdueshme dhe infrastrukturë edukative që mundëson përshtatje më të shpejtë dhe efikase me teknologjitë moderne, duke kontribuar kështu në rritjen e cilësisë së kujdesit për pacientët dhe përgatitjen për të ardhmen e shëndetësisë globale.

Fjalë kyçe: Inteligjenca Artificiale, robotika, telemjekësia, zhvillim profesional, sistem shëndetësor, trajnime, inovacion teknologjik.

NDIKIMI I EDUKIMIT SHËNDETËSOR NË PARANDALIMIN E TENSIONIT ARTERIAL.
Auron Qerimi

Abstrakt
Hyrje: Hipertensioni arterial përbën një nga problemet më të shpeshta të shëndetit publik në mbarë botën dhe është ndër faktorët kryesorë të rrezikut për sëmundjet kardiovaskulare. Edukimi shëndetësor luan një rol thelbësor në promovimin e një stili jetese të shëndetshëm dhe në rritjen e ndërgjegjësimit për faktorët që ndikojnë në parandalimin e kësaj gjendjeje.
Metodologjia: Ky studim ka ndjekur një qasje kuantitative dhe është realizuar përmes një pyetësori të strukturuar, i cili u shpërnda te qytetarët dhe profesionistët shëndetësorë në rajonin e Ferizajt. Të dhënat e mbledhura u analizuan me programin SPSS, me qëllim vlerësimin e ndikimit të edukimit shëndetësor në njohuritë dhe sjelljet e individëve që lidhen me parandalimin e hipertensionit.
Rezultate: Shumica e pjesëmarrësve ishin të vetëdijshëm për rreziqet që sjell hipertensioni dhe shfaqën interes për marrjen e informacionit edukativ mbi mënyrat e parandalimit. Edukimi i ofruar nga profesionistët shëndetësorë, mediat dhe institucionet arsimore rezultoi të ketë ndikim pozitiv në sjelljet parandaluese të pjesëmarrësve.

Diskutime: Gjetjet e studimit konfirmojnë se edukimi shëndetësor është një komponent thelbësor për kontrollin dhe parandalimin e hipertensionit. Rezultatet nënvizojnë rëndësinë e trajnimeve të vazhdueshme, fushatave informuese dhe përfshirjes më aktive të infermierëve dhe mjekëve familjarë në procesin edukativ.
Konkluzione: Edukimi shëndetësor kontribuon ndjeshëm në uljen e incidencës së hipertensionit duke rritur ndërgjegjësimin dhe duke nxitur adoptimin e zakoneve të shëndetshme si aktiviteti fizik, reduktimi i konsumit të kripës dhe ndalimi i duhanit. Bashkëpunimi ndërdisiplinor mbetet një element kyç për suksesin e programeve edukative në nivel komunitar.

Fjalë kyçe: edukimi shëndetësor, hipertensioni arterial, parandalimi, ndërgjegjësim, stili i jetesës, infermieria.

VARIACIONI I INFLAMACIONIT SUBKLINIK NË PROFILET EPIDEMIOLOGJIKE DHE TË RREZIKUT KLINIK TE PACIENTËT QË I NËNSHTROHEN ANGIOGRAFISË KORONARE ELEKTIVE.

Fjolla Zymberi[1], Flaka Rexhaj[1], Vigan Mahmutaj[2], Aurora Bakalli[12]
[1]*Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë*
[2]*Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Klinika e Kardiologjisë*

Abstrakt
Hyrja: Inflamacioni konsiderohet të jetë faktor thelbësor në procesin e aterosklerozës. Proteina C - reaktive me ndjeshmëri të lartë (hs - CRP) është një tregues i inflamacionit që mund të zbulojë nivele shumë të ulëta të CRP - së. Identifikimi i gjendjëve klinike, parametrave epidemiologjik me inflamacion të lartë mund të ndihmojë në parandalimin e sëmundjes kardiovaskulare.
Qëllime: Objektivi i këtij studimi ishte të analizonte ndërlidhjen e hsCRP në rrezikun klinik për sëmundje aterosklerotike dhe me parametrat epidemiologjik.
Materiale dhe Metoda: Studimi është i tipit kros –sekcional observues. Në studim u përfshin 128 pacientë të cilët janë paraqitur për koronarografi elektive në QKUK dhe të cilët nuk kishin sëmundje të dokumentuar të arterieve koronare. Ata u ndanë në dy grupe, në varësi të vlerave të hsCRP (hsCRP të lartë ≥ 2, hsCRP të ulët < 2). Për të testuar lidhjen ndërmjet grupeve të krahasuara për secilin lloj variabli, janë përdorur: testi T, testi Mann - Whitney U dhe testi χ^2 (chi - katror).
Rezultate: Individët me nivele më të larta të hsCRP kishin peshë më të lartë (84, 9 ± 13, 5 kg kundrejt 79, 7 ± 13, 2 kg, p = 0, 032) dhe një indeks më të lartë të masës trupore (BMI) (29, 2 ± 4, 62 kg / m² kundrejt 27, 6 ± 3, 7 kg / m². p = 0. 030). Kohëzgjatja e diabetit melit ishte dukshëm më e shkurtër në grupin me hsCRP të lartë (mediane 6, 5 vjet, IQR 4 - 8) krahasuar me grupin me hsCRP të ulët (mesatarja 10, 5 vjet, IQR 4 - 15, p=0, 039. Mosha gjithashtu iu afrua rëndësisë statistikore, me një moshë mesatare më të lartë në grupin me hsCRP të lartë (62, 1 ± 8, 61 vjeç) krahasuar me grupin me hsCRP të ulët (59, 1 ± 8, 51 vjeç, p = 0, 052).
Konkluzione: Individët me BMI më të lartë, peshë më të lartë kishin nivel më të lartë inflamacionit. Poashtu individët me kohëzgjatje me të shkurtër të diabetit treguan nivel më të lartë të inflamacionit.

Fjalë kyçe: inflamacioni, factor, aterosklerozë etj.

RRISKU PERIOPERATOR PËR ANAFILAKSI I PACIENTËVE ME MASTOCITOZË. MENAXHIMI MULTIDISIPINAR.

Aurora Skenderi, MD.
Specialiste Alergologe dhe Imunologe Klinike

Abstrakt
Hyrje: Mastocitoza përfaqëson një grup çrregullimesh karakterizuar nga akumulimi dhe hiperaktivizimi i mastociteve, duke rritur ndjeshmërinë ndaj agjentëve trigger. Në intervalin perioperatore, pacientët me mastocitozë janë në rrezik të lartë për anafilaksi, për shkak të ekspozimit ndaj barnave anestetike dhe procedurave kirurgjikale. Njohja e mekanizmave patofiziologjikë dhe menaxhimi i ndërhyrjes perioperative janë thelbësore për të parandaluar komplikacione fatale.

Qëllimi: Të përshkruhet strategjia multidisiplinare perioperativa për pacientët me mastocitozë, duke përfshirë: identifikimin e faktorëve të riskut, profilaksinë para - anestezike, trajtimin e anafilaksisë intraoperative, rolin qendror të alergologut në koordinatorin e menaxhimit.
Materiale dhe metoda: Rishikim i literaturës së fundit (2020–2025) nga PubMed, ClinicalTrials. gov, dhe udhëzimet e EAACI 2023 dhe ECNM, duke përfshirë prezantime klinike nga EAACI 2024, sesionet mbi Mast Cell Disorders.
Rezultate: Identifikimi i riskut: Matja e triptazës bazale dhe vlerësimi i historisë së anafilaksisë janë themelore. Profilaksia perioperativa: Kombinimi i antihistaminikëve H1 / H2, kortikosteroideve dhe benzodiazepinave para procedurës ul ndjeshëm incidencën e reaksioneve.
Zgjedhja e barnave: Preferohen relaksantët muskulorë jo - depolarizues, propofol dhe opioide me risk më të ulët; barnat me potencial të lartë për çlirimin e mediatorëve duhet shmangur. Anafilaksia intraoperative: Matja e triptazës serike diagnostikon shpejt, dhe adrenalina mbetet trajtimi kryesor. Ndjekja pas ngjarjes: Testim alergjik dhe përditësimi i kartës së emergjencës janë të domosdoshme.
Përfundime: Pacientët me mastocitozë përbëjnë një sfidë klinike kritike në intervalin perioperator. Njohja e hershme e riskut, protokollet e profilaksisë dhe koordinimi midis alergologut, anestezistit dhe hematologut janë të domosdoshme për të parandaluar anafilaksitë fatale. Strategjia e personalizuar dhe monitorimi i kujdesshëm transformojnë përvojën kirurgjikale në një proces të sigurtë dhe të kontrolluar.

Fjalë kyçe: mastocitozë, mastocitet, anafilaksi perioperative, triptazë, profilaksi, alergolog.

FLORA MIKROBIKE NORMALE E GOJËS, PERIODONTITI DHE MYKOZAT BUKALE.

Dr. Aurora Xhixha[1] Alfred Xhixha[2] Trevor Xhixha[3] Lunareda Keraj[4]
[1]*Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Rajonal, Tiranë Ish Drejtoria e Shëndetit Publik Tiranë*
[2]*Mjek, pranë Imi Farma.*
[3]*Student, Fakulteti i Mjekësisë Tiranë, Universiteti i Mjekësisë Tiranë.*
[4]*Stomatologe, KlinikA Stomatologjike Keraj.*

Abstrakt
Hyrje: Rreth 500 specie bakteriesh janë të pranishme në kavitetin oral, si në sipërfaqen e dhëmbëve ashtu edhe në mukozën orale. Fillimisht dominojnë bakteret fakultative Gram pozitive si streptokokët dhe aktinomicetët, por me kalimin e kohës rritet prania e bakstereve anaerobe, Gram negative dhe spiroketave. Ky ekuilibër mikrobik ndikon ndjeshëm në zhvillimin e periodontitit, një sëmundje inflamatore që prek indin gingival, kockën alveolare dhe ligamentin periodontal.
Qëllimi: Ky punim synon tSë theksojë rëndësinë e promovimit të shëndetit oral, përdorimit të kujdesshëm të antibiotikëve dhe bashkëpunimit ndërmjet mjekëve për përmirësimin e ecurisë klinike të pacientëve.
Metoda: U përshkrua një rast atipik i kandidozës bukale, i lokalizuar në gingivë dhe mukozën vestibulare, i shfaqur si komplikacion pas antibiotikoterapisë me Diagnozë Dentare: Vatër patogjene e një parodontopatie distrofike supurative e shoqëruar me dhimbje të vazhdueshme të mukozës së gojës.
Rezultate: Pacienti paraqiti leukocitozë të lehtë (11. 000 / mm³). Ekzaminimi histopatologjik dhe mikologjik konfirmoi diagnozën e kandidozës gingivale me prani të qelizave levuriforme dhe pseudomicelieve. Kultura në terren Sabouraud Dextrose Agar me kloramfenikol rezultoi pozitive për Candida albicans. Trajtimi përfshiu administrim të Mykostatinës, vitaminave B dhe C, si dhe ekstraksion të dhëmbëve me periodontit të avancuar. Pas ndërhyrjes u aplikua larja e gojës me permanganat kaliumi dhe kolargol. Brenda gjashtë ditësh u vërejt përmirësim i dukshëm, ndërsa terapia antimykotike u vazhdua për dy javë të tjera. Pas një muaji, ulceracionet u zhdukën plotësisht dhe pacienti u rehabilitua me proteza dentare.
Diskutime: Ky rast ilustron sesi çrregullimi i florës bakteriale normale dhe shfaqja e Candida albicans si infeksion oportunist theksojnë rëndësinë e higjienës orale, kontrolleve periodike dhe kujdesit në përdorimin e antibiotikëve për ruajtjen e shëndetit oral.

Fjalë kyçe: shëndeti oral, antibiotikoterapi, kandidomykozë, vatër patogjene, periodontit, mykostatinë.

ARRESTI KARDIAK INTRAOPERATIV – PËRVOJA E ANESTEZIOLOGËVE NË KOSOVË.

Dr. Bardhë Agaj, Dr. Bardhyl Hasani, Prof. Dr. Sci. Antigona Hasani
Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Prishtinë

Abstrakt
Arresti kardiak intraoperativ është një situatë kritike që ndodh gjatë ndërhyrjeve kirurgjike nën anestezion dhe kërkon reagim të menjëhershëm, koordinim efikas dhe njohuri të avancuara për trajtim nga ana e ekipit mjekësor. Ky studim shqyrton përvojat dhe qëndrimet e profesionistëve të anesteziologjisë në Kosovë në lidhje me menaxhimin e rasteve të arrestit kardiak intraoperativ.
Përmes një pyetësori elektronik me 30 pjesëmarrës (specialistë, subspecialistë dhe specializantë), u grumbulluan të dhëna mbi përvojën e tyre klinike, përdorimin e protokolleve standarde të reanimimit si dhe përceptimin e tyre lidhur me nevojën për trajnime të vazhdueshme.
Rezultatet treguan se 97% e pjesëmarrësve kishin hasur të paktën një rast arresti kardiak intraoperativ gjatë karrierës së tyre. Megjithatë, vetëm 57% kishin ndjekur trajnime të avancuara për reanimim gjatë dy viteve të fundit, dhe 30% nuk ishin të sigurt nëse protokollet për trajtim ishin të standardizuara në institucionin ku punonin. Shumica e rasteve ndodhën gjatë fazës intraoperative, duke konfirmuar të dhënat nga literatura, që evidentojnë këtë periudhë si më kritike. Për më tepër, pjesa më e madhe e të anketuarve e konsideruan thelbësore përditësimin periodik të njohurive për CPR dhe ALS. Ky studim thekson domosdoshmërinë për edukim të vazhdueshëm, aplikimin e simulimeve praktike dhe vendosjen e protokolleve të qarta institucionale për të përmirësuar gatishmërinë dhe sigurinë klinike gjatë situatave të arrestit kardiak intraoperativ.

Fjalë kyçe: arrest kardiak intraoperativ, anesteziologji, trajnime CPR, reanimim, protokolle standarde, siguri klinike.

VLERËSIMI DHE MENAXHIMI I PSA - SË SË RRITUR: INTEGRIMI I UDHËZIMEVE, BIOMARKUESVE DHE EKZAMINIMEVE TË REJA NË NJË ALGORITËM KLINIK TË PËRDITËSUAR.

Prof. Ass. Dr. Bashkim Gllareva, Dr. Sci. ,
Urolog Pranë Qendrës Klinike Universitare E Kosovës, Asistent Profesor Pranë Departamentit Të Shëndetit Publik, Universiteti i Prishtinës.

Abstrakt
Hyrje: PSA (antigjeni specifik i prostatës) është përdorur gjerësisht në zbulimin e hershëm të kancerit të prostatës, por niveli i tij mund të ndikohet nga faktorë beninj si hiperplazia beninje e prostatës (BPH), infeksionet, manipulimet urologjike apo inflamacioni. Në një kohë kur ekziston rreziku i mbidiagnostikimit dhe mbitrajtimit, është i domosdoshëm një model vlerësimi më selektiv dhe i bazuar në rrezik. Qëllimi i këtij punimi është të ofrojë një pasqyrë të përditësuar mbi protokollet e vlerësimit të PSA - së së rritur, si dhe një algoritëm praktik për përdorim klinik.
Materiale dhe metoda: U realizua një rishikim i literaturës nga databazat PubMed dhe Scopus (2018–2025) për PSA - në dhe mjetet moderne të vlerësimit. U analizuan udhëzimet më të fundit nga EAU, AUA dhe NCCN për vleresimin, diagnostikimin dhe trajtimin e pacientëve me PSA të rritur. Vëmendje e veçantë iu kushtua përdorimit të rezonancës magnetike multiparametrike (mpMRI), biomarkuesve të gjakut dhe urinës (PHI, 4Kscore, PCA3), dhe parametrave si densiteti i PSA - së dhe raporti PSA i lirë / total.
Rezultate: Interpretimi i niveleve të PSA - së: PSA <4 ng / mL: Shpesh konsiderohet në kufijtë normalë, por nuk përjashton kancerin, veçanërisht në pacientë me histori familjare ose gjenetikë të riskuar. PSA 4–10 ng / mL (zona gri): Rreziku për kancer klinikisht të rëndësishëm është mesatar (~25%), por vendimi për biopsi kërkon shtresa të mëtejshme vlerësimi. PSA >10 ng / mL: Kjo rrit ndjeshëm probabilitetin për kancer të prostatës (deri në 60–70%), dhe zakonisht kërkon vlerësim të menjëhershëm me mpMRI dhe biopsi. Mjetet ndihmëse për vendimmarrje: PSA density (PSAD). Free / Total PSA ratio: PSA velocity (rritja në kohë). Biomarkues të avancuar: PHI (Prostate Health Index), 4Kscore, PCA3 (urinë). Roli i mpMRI: Rrit ndjeshëm saktësinë e diagnostikimit dhe ndihmon në shmangien e biopsive të panevojshme. PIRADS 3–5 kërkon biopsi.
PIRADS 1–2, sidomos në pacientë me rrezik të ulët, mund të çojë në ndjekje pa biopsi. Pas diagnozës: Rrezik i ulët: Menaxhohet me mbikëqyrje aktive (PSA periodik, mpMRI, biopsi të përsëritura të synuara). Rrezik i ndërmjetëm / larte: Zgjedhja e trajtimit bazohet në moshë, komorbiditete dhe preferencat e pacientit, opsionet

përfshijnë prostatektomi radikale, radioterapi ose terapi fokale. Sëmundja e avancuar: Terapitë e reja sistemike (anti - androgjenët e gjeneratës së re) dhe imazheria me PSMA PET janë thelbësore për stadifikim dhe ndjekje.
Përfundime: Vlerësimi i PSA - së së rritur duhet të jetë shumëdimensional, duke përfshirë analizën e PSA - së, parametrat ndihmës, biomarkuesit dhe imazherinë moderne. Kjo qasje përmirëson ndjeshëm përzgjedhjen e pacientëve për biopsi dhe trajtim, duke shmangur ndërhyrjet e panevojshme dhe duke rritur shanset për kapjen e hershme të kancerit klinikisht domethënës. Algoritmi i propozuar mund të ndihmojë urologët në praktikën e përditshme për të ofruar një kujdes më të saktë, personalizuar dhe të bazuar në evidencë.

Fjalë kyçe: PSA (antigjeni specifik i prostatës), kanceri të prostates, (BPH.

ROLI, PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT E SHËRBIMEVE EMERGJENTE NË RASTET E ARRESTIT KARDIAK NË AMBIENTET PARASPITALORE DHE SPITALORE.

Basri Lenjani[1], Dardan Lenjani[2], Entela Lenjani[3]
[1]Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK), Klinika e Emergjencës
[2]Fakulteti i Mjekësisë, Prishtinë
[3]Fakulteti i Shkencave Mjekësore "REZONANCA"

Abstrakt
Hyrje: Arresti kardiak mbetet një nga shkaqet kryesore të vdekjes së papritur në nivel global, si në ambientet paraspitalore ashtu edhe në ato spitalore. Ndërhyrja e menjëhershme dhe e mirëkoordinuar nga shërbimet emergjente është thelbësore për përmirësimin e shkallës së mbijetesës dhe të rezultateve neurologjike.
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të identifikojë dhe analizojë rolet, përgjegjësitë dhe detyrat e shërbimeve emergjente gjatë arresti kardiak si në mjediset paraspitalore, ashtu edhe në ato spitalore.
Metodologjia: Ky studim përshkrues - analitik është realizuar përmes rishikimit të literaturës dhe analizës cilësore të protokolleve dhe udhëzimeve ekzistuese, si dhe të të dhënave vëzhguese nga ekipet e reagimit emergjent në institucione të përzgjedhura shëndetësore. Të dhënat janë mbledhur nga publikime shkencore, vëzhgime në terren dhe intervista me personel mjekësor emergjent.
Rezultate: Studimi evidenton dallime të rëndësishme në rolet dhe ndërhyrjet e shërbimeve emergjente në ambientet paraspitalore krahasuar me ato spitalore. Ekipet paraspitalore fokusohen në njohjen e shpejtë të arresti kardiak, zbatimin e RKP - së (reanimimi kardiopulmonar) me cilësi të lartë, defibrilimin, menaxhimin e rrugëve të frymëmarrjes dhe transportin e shpejtë drejt spitalit.
Në ambientet spitalore, ekipet e posaçme për arrest kardiak veprojnë sipas protokolleve të avancuara të reanimimit, duke përfshirë administrimin e barnave, monitorimin dhe kujdesin pas reanimimit. Komunikimi efektiv, trajnimi i vazhdueshëm dhe respektimi i udhëzimeve të përditësuara janë identifikuar si faktorë kyç që ndikojnë në rezultatet pozitive.
Diskutim: Rezultatet tregojnë se mbijetesa pas arresti kardiak përmirësohet ndjeshëm kur shërbimet emergjente reagojnë me shpejtësi, ndjekin protokollet e bazuara në evidencë dhe veprojnë brenda një sistemi të koordinuar kujdesi. Sfidat kryesore mbeten në njohjen e hershme të arresti kardiak, shkallën e ulët të RKP - së nga dëshmitarët (bystander CPR) dhe vazhdimësinë e kujdesit pas reanimimit.
Përfundime: Shërbimet emergjente luajnë një rol jetik në çdo hallkë të "zinxhirit të mbijetesës". Përgatitja, koha e reagimit dhe respektimi i standardeve të reanimimit janë vendimtare për përmirësimin e rezultateve në rastet e arresti kardiak.
Rekomandime: Të forcohet trajnimi emergjent paraspitalor, përfshirë edukimin publik mbi RKP - në. Të standardizohen protokollet e arresti kardiak në të gjitha institucionet shëndetësore. Të implementohet trajnimi i rregullt me simulime klinike. Të përmirësohet komunikimi ndërmjet ekipeve paraspitalore dhe atyre spitalore.

Fjalë kyçe: Arrest kardiak, shërbime emergjente, kujdes paraspitalor, kujdes spitalor, RKP, defibrilim, reanimim, përgjegjësi të shërbimeve emergjente.

RETINOPATIA E PREMATURËVE NË MAQEDONINË E VERIUT – SKRINIMI DHE MENAXHIMI TERAPEUTIK.

Tateshi B. [1, 2], Klenkoski S. [1, 3], Tateshi - Veliu E. [2, 4]
[1]Klinika Universitare Okulistike, Shkup, Maqedonia e Veriut.
[2]Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti "Goce Dellçev", Shtip, Maqedonia e Veriut.
[3]Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti "St. Cyril and Methodius", Shkup, Maqedonia e Veriut.
[4]Spitali Rajonal "8 Shtatori", Shkup, Maqedonia e Veriut.

Abstrakt
Qëllimi: Retinopatia e paraprindësisë (ROP) është një sëmundje proliferative e enëve të retinës që prek foshnjat e parakohshme me retinë të pasakte të vaskularizuar dhe shpesh është shkaku kryesor i dëmtimit të shikimit dhe verbërisë në fëmijëri në mbarë botën. Qëllimi i këtij punimi është të diskutojë rëndësinë e zbulimit të hershëm dhe ndërhyrjes për të parandaluar humbjen e shikimit të lidhur me ROP, përmes programeve të rregullta të skriningut, dhe të analizojë rezultatet tona të skriningut dhe trajtimit tek foshnjat e parakohshme të lindura në Maqedoninë e Veriut gjatë periudhës 2009–2024.
Materiale dhe metoda: Në këtë studim retrospektiv, analizuam të dhënat e foshnjave të parakohshme të ndjekura gjatë periudhës 2009–2024. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për skriningun e ROP përdoren rekomandimet e Shoqatës Amerikane të Oftalmologjisë Pediatrike dhe Strabizmit, me kritere të qarta për përfshirjen në programin e skriningut për ROP për të gjitha neonatet e parakohshme me peshë lindjeje (BW) 1500 g ose më pak dhe / ose të lindura në javën e 30 - të të gestacionit (GW) ose më herët, si dhe për foshnjat e përzgjedhura me peshë lindjeje midis 1500 dhe 2000 g me kurs klinik të paqëndrueshëm dhe vlerësim të lartë të rrezikut nga neonatologu.
Rezultatet: Sipas të dhënave të analizuar, nga një total prej 20, 261 ekzaminimesh të kryera, sipas kritereve të miratuara, skriningu u krye tek 6, 256 foshnja të parakohshme. Skriningu i këtyre foshnjave rezultoi në zbulimin e retinopatisë aktive me indikacion absolut për trajtim tek 686 foshnja. Për më tepër, 390 foshnja u trajtuan me fotokoagulim lazer, ndërsa 296 foshnja u trajtuan me terapi Anti - VEGF.
Përfundimi: Retinopatia e paraprindësisë mbetet një shqetësim dhe sfidë e rëndësishme për okulistët në mbarë botën, duke theksuar rëndësinë e zbulimit të hershëm, ndërhyrjes në kohë dhe ndjekjes së ngushtë. Rezultatet tona tregojnë se foshnjat e parakohshme me kritere të qarta për përfshirje duhet të skrinohen domosdoshmërisht për ROP, me qëllim parandalimin e progresionit të sëmundjes, përmirësimin e rezultateve afatgjata të shikimit dhe minimizimin e barrës së ROP për foshnjat e prekur dhe familjet e tyre.

Fjalë kyçe: skrining për ROP, retinopatia e paraprindësisë (ROP), foshnja të parakohshme, peshë lindjeje (BW), mosha gestacionale (GA), fotokoagulim lazer (LFC), terapi Anti - VEGF.

EKSPERIENCAT TONA NË DIAGNOSTIKIMIN DHE MENAXHIMIN E RETINOPATISË SË PREMATURITETIT (ROP).

Belinda Pustina
Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Klinika e Syve

Abstrakt
Hyrje: Retinopatia e prematuritetit (ROP) mbetet një nga shkaqet kryesore të verbërisë së parandalueshme tek foshnjat e lindura para kohe. Zbulimi i hershëm dhe trajtimi në kohë janë thelbësorë për ruajtjen e shikimit. Ky studim paraqet eksperiencën tonë në diagnostikimin, trajtimin dhe ndjekjen e rasteve me ROP në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, Klinikë të Syve dhe Neonatologjisë.
Metodat: U përfshinë 219 foshnja të lindura para kohe me peshë të ulët gjatë një periudhe 1 vjeçare. Ekzaminimet oftalmologjike u kryen sipas udhëzimeve ndërkombëtare për ROP. Të dhënat u analizuan për incidencën, stadet e sëmundjes dhe rezultatet pas trajtimit me anti VEGF.
Rezultatet: Nga 219 foshnjat e ekzaminuara, ROP u diagnostikua në 25 foshnje dhe 16 pacientë kërkuan trajtim aktiv, ndërsa të tjerët u ndoqën deri në regresion spontan. Pas trajtimit, u arrit stabilizim i sëmundjes në 100% të rasteve. Komplikacionet ishin të rralla dhe u menaxhuan me sukses.
Perfundimi: Screening - u i rregullt dhe trajtimi në kohë i ROP janë thelbësorë për ruajtjen e shikimit tek foshnjat e lindura para kohe. Eksperienca jonë tregon rëndësinë e bashkëpunimit multidisiplinar ndërmjet neonatologëve dhe oftalmologëve.

Fjalë kyçe: Retinopatia e prematuritetit, prematuriteti, anti - VEGF, screening.

NDIKIMI I KËSHILLAVE MJEKËSORE NË MIRËQENIEN E PACIENTËVE NË QKMF FERIZAJ.

Dr. Belkise Lohaj[1], Dr. Flutura Hyseni[1]
[1]QKMF - Ferizaj, Kosovë

Abstrakt

Hyrje: Këshillat mjekësore janë një komponent thelbësor i kujdesit parësor shëndetësor, duke ndikuar drejtpërdrejt në ndryshimin e sjelljeve shëndetësore dhe përmirësimin e mirëqenies së pacientëve. Ky studim synon të vlerësojë ndikimin e këshillave mjekësore në mirëqenien e pacientëve në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Ferizaj, përmes analizës së perceptimit të pacientëve, nivelit të zbatimit të rekomandimeve dhe faktorëve që ndikojnë në këtë proces. Përmes një qasjeje të kombinuar metodologjike (mixed methods), janë mbledhur të dhëna përmes pyetësorëve me 150 pacientë dhe intervistave gjysmë të strukturuara me 20 pacientë dhe 10 mjekë. Rezultatet paraprake tregojnë se pacientët që marrin këshilla të personalizuara dhe komunikim të qartë nga profesionistët shëndetësorë kanë një nivel më të lartë të ndjekjes së rekomandimeve. Ndërkohë, faktorët socio - ekonomikë, niveli i edukimit shëndetësor dhe besimi në mjekë paraqiten si pengesa ose lehtësues kryesorë të këtij procesi. Gjetjet e studimit nënvizojnë rëndësinë e përmirësimit të komunikimit mjek - pacient, fuqizimit të edukimit shëndetësor dhe adresimit të faktorëve socio - ekonomikë për të rritur efektivitetin e këshillave mjekësore. Rekomandimet që dalin nga ky hulumtim mund të ndihmojnë në zhvillimin e strategjive më efikase për përmirësimin e kujdesit shëndetësor parësor. Këshillat mjekësore luajnë një rol vendimtar në përmirësimin e mirëqenies së pacientëve dhe menaxhimin e sëmundjeve kronike. Në sistemin e kujdesit shëndetësor parësor, edukimi dhe këshillimi mjekësor ndihmojnë pacientët të bëjnë zgjedhje të informuara mbi shëndetin e tyre, duke ndikuar në sjelljet e tyre të përditshme në lidhje me ushqyerjen, aktivitetin fizik dhe përdorimin e medikamenteve.

Qëllimi i hulumtimit: Ky studim ka për qëllim të shqyrtojë ndikimin e këshillave mjekësore në mirëqenien e pacientëve në Qendrën e Mjekësisë Familjare (QKMF) Ferizaj, duke analizuar perceptimin e pacientëve mbi këshillat e marra, nivelin e zbatimit të tyre dhe faktorët që ndikojnë në këtë proces.

Metodologjia: Ky studim është realizuar duke përdorur metodologjinë e kombinuar (mixed methods), ku janë përdorur pyetësorë me 150 pacientë dhe intervista gjysmë të strukturuara me 20 pacientë dhe 10 mjekë. Të dhënat sasiore janë analizuar përmes SPSS, ndërsa të dhënat cilësore janë përpunuar me analizën tematike për të nxjerrë temat kryesore mbi perceptimin dhe ndjekjen e këshillave mjekësore.

Konkluzionet: Studimi do të ndihmojë në kuptimin e ndikimit të këshillave mjekësore në mirëqenien e pacientëve dhe do të ofrojë rekomandime mbi mënyrat për të rritur zbatimin e tyre në praktikë. Përmirësimi i komunikimit mjek - pacient, fuqizimi i edukimit shëndetësor dhe zhvillimi i strategjive mbështetëse mund të ndihmojnë në rritjen e efektivitetit të këshillave mjekësore dhe përmirësimin e kujdesit shëndetësor në përgjithësi.

Fjalë Kyçe: Këshilla mjekësore, mirëqenia e pacientëve, komunikimi mjek - pacient, edukimi shëndetësor, ndikimi i këshillave, sjelljet shëndetësore.

NIVELI I PTH DHE KORRELACIONI KALCIUM - FOSFOR TE TË SËMURËT NË HEMODIALIZË.

Belma Gjinali

Abstrakt

Hyrja: Insuficienca kronike renale (IKR) është një problem shumë i përhapur që prek 10 - 13% të popullsisë në tërë botën. Insuficienca kronike renale është një rënie progresive e funksionit të veshkave, e shkaktuar kryesisht nga diabeti dhe hipertensioni. Zakonisht është asimptomatike dhe shpesh diagnostikohet në faza të avancuara, kur dializa është thelbësore për jetën e pacientëve. Fillon si një anomali biokimike, por

përfundimisht, humbja e proceseve ekskretuese, metabolike dhe endokrine të veshkave çon në simptoma klinike dhe shenja të dështimit të veshkave, të njohura si uremia. Sëmundja renale në fazën përfundimtare (ESRD) është shpesh rezultat i IKR. Hemodializa është vërtetuar se është metoda më e zakonshme e trajtimit për ESRD në mbarë botën.
Qëllimi: Përmes rishikimit të literaturës dhe punimeve shkencore të publikuara, ky punim ka treguar ndikimin e niveleve te parathormonit dhe korrelacionin kalcium / fosfor te pacientët që janë nënshtruar hemodializës si dhe efikasitetin e përdorimit të hemodializës te pacientet me insuficience kronike renale.
Materiale dhe Metoda: Punimi bazohet në llojin "rishikim i literaturës ekzistuese", ku përfshihen libra dhe revista mjekësore, punimet shkencore më bashkëkohore dhe më të përditësuara të cilat janë të indeksuara në databazat më të njohura si Pubmed, Medline, Scopus, Google Scholar etj. , të punuara nga autorë të fushës. Kërkimi i literaturës në databaza është bërë duke përdorur termat që lidhin abnormalitet biokimike në insuficiencën renale kronike, efektin e përdorimit të hemodializës në parandalimin e përparimit te insuficiences kronike renale.
Rezultate dhe Konkluzione: Me hulumtimin e rolit të parathormonit dhe korrelacionit të kalciumit dhe fosforit në IKR, është analizuar ndikimi i këtyre në paraqitjen e sëmundjes, ku përmes meta - analizës së punimeve të ndryshme evidenohet që hiperfosfatemia është një nga faktorët kryesorë përgjegjës për ndryshimet në metabolizmin mineralo - kockor te pacientët me dializë. Nga të dhënat që kemi mbledhur nga studimet e analizuara konkludojmë se ekziston një korrelacion pozitiv midis PTH dhe fosforit në serum, dhe një korrelacion negativ ndërmjet PTH dhe kalciumit në serum. Nga këto studime vërejmë se nivelet e larta të fosforit, kalciumit dhe PTH në serum janë të lidhura me rritjen e rrezikut të vdekshmërisë në pacientët me hemodializë.

Fjalë kyçe: PTH, Ca / P, IKR, hemodializë, parandalim, trajtim.

EKOKARDIOGRAFIA KONVENCIONALE DHE BIOMARKERËT PËR IDENTIFIKIMIN E HERSHËM DHE TË VONSHËM TË KARDIOTOKSICITETIT TË INDUKTUAR NGA KIMIOTERAPIA: NJË STUDIM PROSPEKTIV OBSERVACIONAL.

Dr. Benard Shehu[1], Dr. Shk. M Klerida Shehu[2]
[1]*Shërbimi kardiologjisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"*
[2]*Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësise Tiranë.*

Abstrakt
Hyrje: Kimioterapia, veçanërisht antraciklinat dhe trastuzumabi, shoqërohet me rrezik të lartë për kardiotoksicitet tek pacientët me kancer gjiri. Në mjediset klinike ku mungon aksesimi i Global Longitudinal Strain (GLS), është e domosdoshme përdorimi i metodave alternative. Ky studim synoi të vlerësonte disfunksionin kardiak subklinik, të hershëm dhe të vonshëm, të lidhur me kimioterapinë, duke u mbështetur në parametrat e ekokardiografisë konvencionale dhe biomarkerët kardiakë qarkullues.
Materiale dhe metoda: U realizua një studim prospektiv observacional, ku u përfshinë 135 paciente femra me kancer gjiri që iu nënshtruan kimioterapisë kardiotoksike. U matën fraksioni i ejeksionit të ventrikulit të majtë (EF), raporti E / e', shpejtësitë septale dhe laterale të tissue Doppler (TDI), troponina I me ndjeshmëri të lartë (hs - cTnI) dhe N - terminal pro - B - type natriuretic peptide (NT - proBNP), në tri kohë: në fillim, pas dy cikleve dhe pas përfundimit të trajtimit.
Rezultate: EF mesatare u ul nga 60. 8% në 54. 9%. Raporti E / e' u rrit nga 8. 1 në 11. 4. Shpejtësia septale e' ra nga 9. 0 në 6. 2 cm / s, ndërsa lateral e' nga 10. 2 në 7. 5 cm / s. Pozitiviteti i hs - cTnI u konstatua në 20% të pacienteve, ndërsa rritja e NT - proBNP në 30%. Të gjitha ndryshimet ishin statistikisht të rëndësishme ($p < 0.001$). Një rënie klinikisht e rëndësishme e EF (>10%) u evidentua në 11. 9% të pacienteve.
Përfundime: Kombinimi i ekokardiografisë konvencionale dhe biomarkerëve kardiak ofron një metodë të besueshme, të aksesueshme dhe me kosto të ulët për zbulimin e hershëm dhe të vonshëm të kardiotoksicitetit të induktuar nga kimioterapia, veçanërisht në mjediset klinike me burime të kufizuara.

Fjalë kyçe: Kardiotoksiciteti, kimioterapia, kanceri i gjirit, ekokardiografia, biomarkerët, kardio - onkologjia.

FRAKTURAT OSTEOPOROTIKE TE PACIENTËT NË DIALIZË: SFIDAT DHE MENAXHIMI BASHKËKOHOR PËR KIRURGUN ORTOPED.

Dr. Klevis Hoxha[1], PhD. Benereta Hoxha[2]
[1]*Ortoped*
[2]*Nefrologe*

Abstrakt

Hyrje: Pacientët që i nënshtrohen dializës kanë një rrezik të rritur ndjeshëm për fraktura, rezultat i ndërveprimit kompleks midis osteoporozës dhe çrregullimit të mineralizimit dhe kockës si pasojë e sëmundjes kronike të veshkave. Këta pacientë përjetojnë një rrezik për fraktura 4–6 herë më të lartë krahasuar me popullatën e përgjithshme, me morbiditet dhe mortalitet shumë më të lartë, veçanërisht pas frakturave të legenit ose të shtyllës kurrizore.

Qëllimi: Të rishikohet menaxhimi ortopedik i pacientëve me fraktura që janë në dializë, sipas udhezimeve të fundit si dhe të diskutohen standardet për kujdesin preoperativ, trajtimin postoperativ dhe strategjitë parandaluese.

Materiale dhe metoda: U realizua një rishikim i fokusuar i literaturës dhe udhëzimeve aktuale, së bashku me protokollet kirurgjikale institucionale, me theks në: Optimizimin metabolik para operacionit (kalciumi, fosfori, hormoni paratiroide), vendimmarrje të individualizuar për trajtim kirurgjikal kundrejt atij konservativ, aspektet intraoperative për shkak të cilësisë së dobët të kockave, kujdesi postoperativ dhe strategjitë për parandalimin e frakturave.

Rezultate: Trajtimi kirurgjikal rekomandohet zakonisht për shumicën e frakturave të zhvendosura (legenit, femurit, humerusit) te pacientët në dializë, për të mundësuar mobilizimin e hershëm dhe për të kufizuar ndërlikimet. Vendimi për të operuar duhet të merret në një kornizë multidisiplinare që merr në konsideratë statusin metabolik, jetëgjatësinë, komorbiditetet dhe modelin e frakturës.

Përfundime: Menaxhimi i frakturave te pacientët në dializë kërkon një qasje të individualizuar dhe multidisiplinare, me theks në stabilizimin metabolik dhe laboratorik si strategji kirurgjikale të përshtatura për cilësinë e dobët të kockave.

Fjalë kyçe: Frakturat osteoporotike, dializë, strategji parandaluese.

ANGINA LUDWIG: NJE RISHIKIM SISTEMATIK.

Bensar Shuteriqi MD, PhD
Universiteti i mjekësisë Tiranë, QSUNT "Nënë Tereza"

Abstrakt

Angina Ludwig paraqitet me një infeksion të hapesirës submandibulare, që përparon shpejt duke u bërë kërcënuese për rrugët ajrore. Shkaku më i shpeshtë i anginës Ludwig vjen kryesisht nga një infeksion dentar, por mund të vijë edhe nga infeksione të tjera të hapësirës orofaringeale. Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë veçoritë klinike dhe llojet e trajtimit. Për këtë studim ju përdoren burime dytësore. Disa ndërlikime të Angina Ludwig si: tromboflebiti, mediastiniti, empyema, effusioni perikardiak, abscesi subfrenik, pneumonia aspirative, duhet të merren në konsideratë. Ky studim nxjerr në pah rëndësinë e diagnozës së hershme, si dhe kontrollin e rrugës ajrore, terapinë me antibiotikë të spektrit të gjerë, si dhe ndërhyrjen e mundshme të ruajtjes së rrugës ajrore. Ky studim analitik është një ilustrim i Angina Ludwig në lidhje me sfidat e trajtimit të saj. Suksesi mbetet në një diagnozë dhe ndërhyrje sa më të shpejtë dhe të saktë. Megjithëse angina Ludwig ka mortalitet të lartë, nëse ndërhyhet me shpejtësi dhe saktësi, mund të arrihen rezultate të mira, pra një diagnostikim të shpejtë, menaxhim dhe kujdes i duhur të rrugëve ajrore, trajtim intensiv me antibiotikë, incizion drenim adekuat, pa harruar një monitorim të kujdesshëm dhe të vazhdueshëm.

Fjalë kyçe: Angina Ludwig, obstruksion i rrugëve ajrore, antibiotikoterapi.

PREVALENCA DHE NDIKIMI I ALERGJIVE TË DIAGNOSTIKUARA DHE TË PADIAGNOSTIKUARA TEK ADOLESHENTËT: NJË VLERËSIM EPIDEMIOLOGJIK NË POPULLATËN SHKOLLORE 15 - 18 VJEÇ.

Dr. Besim Durguti, Dr. Blertë Bibaj, Dr. Ronesa Derguti

Abstrakt

Hyrje: Alergjia përkufizohet si një përgjigje inflamatore e ndërmjetësuar nga imuniteti ndaj alergjenëve të zakonshëm mjedisorë që normalisht janë të padëmshme për organizmin. Diagnoza e alergjisë varet nga simptomat që shfaqen gjatë ekspozimit ndaj një alergjeni së bashku me praninë në gjak të IgE - së specifike për alergjenin. Alergjitë janë një shqetësim i rëndësishëm për shëndetin publik, me një ndikim të dukshëm në mirëqenien e fëmijëve të moshës shkollore. Ndërsa shumë alergji zhvillohen në fëmijëri, adoleshenca paraqet një moshë të rëndësishme për të kuptuar ndërveprimin kompleks të gjenetikës, mjedisit dhe zhvillimit të sistemit imunitar. Kjo periudhë e rritjes së shpejtë dhe ndryshimeve hormonale mund të ndikojnë në ndjeshmërinë ndaj alergjive, duke e bërë të rëndësishëm hetimin e rolit të historisë familjare në formësimin e rrezikut të alergjisë. Ky abstrakt përmbledhë kuptimin aktual të prevalencës së alergjive në këtë popullatë. Studimet tregojnë se 5 - 8% e fëmijëve të moshës shkollore përjetojnë alergji ushqimore, me një prevalencë më të lartë të alergjive sezonale që varion nga 10 - 30%. Alergjitë e zakonshme ushqimore përfshijnë kikirikë, qumështin, vezët, sojen, grurin. Alergjitë sezonale shpesh të shkaktuara nga poleni, janë të përhapura gjatë stinëve të veçanta. Ndikimi i alergjive në jetën e fëmijëve është i konsiderueshëm, duke çuar në simptoma si skuqje të lëkurës, probleme të frymëmarrjes, probleme me tretjen dhe ndonjëherë edhe anafilaksinë.

Qëllimi: Përmes ketij punimi synohet të vlerësohet prevalenca e alergjive te fëmijët e moshës së adoleshencës, simptomat më të shpeshta, ndërgjegjësimi i tyre rreth njohjes së alergjive, lidhjen me faktorët mjedisorë dhe gjenetik, menaxhimi dhe ndikimi i alergjive në jetën e adoleshentëve, si dhe te identifikohen rastet e mundshme të alergjive të padiagnostikuara.

Metodologjia: Ky studim është studim i tipit transversal Cross - sectional study, i realizuar përmes një ankete të strukturuar në popullatën shkollore për grupmoshat 15 - 18 vjeçare, në qytetin e Ferizajit, pa ndërhyrje terapeutike apo eksperimentale, me qëllim vlerësimin e prevalencës dhe ndikimin e alergjive te adoleshentët. Anketa është shpërndarë nëpër shkolla duke i ruajtur të dhënat personale dhe me pëlqimin e informuar nga pjesëmarrësit.

Rezultate: Nga 400 mostra të analizuara, 34. 1% i përkasin moshës 16 vjeç, 31. 3% i përkasin moshës 17 vjeç, 26. 1% i përkasin moshës 15 vjeç dhe 8. 5% i përkasin moshës 18 vjeç. Në grupmoshën 15 vjeç, 33. 33% e të anketuarve raportuan alergji, ndërsa në moshën 16 vjeç kjo përqindje ishte 36. 5%. Në grupmoshën 17 vjeç, 34. 4% raportuan simptoma të alergjisë, ndërsa në moshën 18 vjeç kjo shifër arriti në 41. 18%. Në analizën sipas gjinisë, 36. 61% e femrave u përgjigjën pozitivisht në pyetjen nëse kanë alergji, ndërsa tek meshkujt kjo përqindje ishte 29. 23%. Sipas vendbanimit, 35. 25% e banorëve në zonat rurale raportuan alergji, krahasuar me 35. 67% të banorëve në zonat urbane, duke sugjeruar një përhapje të ngjashme të alergjive në qytete dhe fshatra. Prevalenca e alergjive shënoi rritje të ndjeshme gjatë stinës së pranverës me 38. 6%, ndërkohë që simptomat e alergjisë ishin të pranishme gjatë gjithë vitit në 23. 8% të rasteve. Stina e verës përbënte 18. 8% të rasteve me simptoma alergjike. Këto të dhëna sugjerojnë një lidhje të fortë mes faktorëve sezonalë dhe simptomave alergjike. Sipas të dhënave të grumbulluara, shumica e të prekurve përjetonin simptoma alergjie vetëm një herë në disa muaj (52. 6%), duke sugjeruar një shpërndarje sporadike të tyre. 30. 1% e të anketuarve raportuan simptoma disa herë gjatë muajit, 6. 8% çdo javë, ndërsa 10. 5% përjetonin simptoma alergjie çdo ditë. Alergjitë respiratore ishin më të përhapurat, duke prekur 50. 4% të të anketuarve, të ndjekura nga alergjitë e lëkurës me 14. 5% dhe alergjitë nazale me 9. 5%. Një përqindje e vogël (7%) raportoi lloje të tjera alergjish, duke nënvizuar diversitetin e reaksioneve alergjike. Anafilaksia u raportua nga 1. 8% e të anketuarve, ndërsa 4. 8% raportuan reaksione të tjera të rënda alergjike.

Konkluzione: Nga ky studim rezulton se ka alergji të shumta që shfaqen në moshën e adoleshencës dhe se vërehet një lidhje mes alergjive dhe historisë familjare, vendit ku banon, ndikimin e ushtrimeve dhe sforcimeve fizike. Nevojiten kërkime të mëtejshme për të kuptuar ndërveprimin kompleks të faktorëve mjedisorë, gjenetikë dhe të stilit të jetesës që kontribuojnë në rritjen e prevalencës së alergjive. Strategjitë efektive për parandalimin, diagnostikimin dhe menaxhimin e alergjive janë thelbësore për përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së fëmijëve në shkolla.

Fjalë kyçe: Alergji, adoleshencë, prevalencë, gjenetike, ushqimore.

KARAKTERISTIKAT EKOGRAFIKE DHE VËSHTIRËSITË DIAGNOSTIKE TË ENDOMETRIOZËS.

Besjona Kodra, PhD, Fatjon Balla PhD, Marsi Danaka MD
SUOGJ, Mbretëresha Geraldinë

Abstrakt

Hyrje: Endometrioza është një sëmundje heterogjene me shfaqje të ndryshme klinike dhe imazherike. Ekografia transvaginale (TVUS) është mjeti kryesor diagnostik për shkak të aksesueshmërisë dhe specifitetit të lartë, por saktësia e saj ndikohet ndjeshëm nga tipi i lezionit, përvoja e operatorit dhe protokolli i skanimit.

Qëllimi: Të rishikohen studimet e fundit (2020–2025) mbi karakteristikat ekografike të endometriozës dhe të diskutohen kufizimet aktuale dhe përparimet e reja në diagnostikim.

Metoda: U krye një rishikim narrativ përmes bazave të të dhënave PubMed dhe Scopus. U përfshinë rishikime sistematike, meta - analiza dhe studime prospektive që vlerësonin tiparet sonografike, saktësinë diagnostike dhe faktorët që ndikojnë në zbulimin e endometriozës.

Rezultate: Gjetjet tipike ekografike përfshijnë ciste unilokulare me echogenicitet homogjen "si pluhur qelqi" për endometriomat ovariane dhe noduse hipokoike ose lezione fibrotike retraktile për endometriozën infiltrative të thellë (DIE). TVUS ka specifitet të lartë (>90%) për endometriomat dhe lezione rektovaginale, por ndjeshmëri më të ulët për endometriozën sipërfaqësore. Vështirësitë diagnostike lidhen me madhësinë e vogël të lezioneve, gazrat e zorrëve, obezitetin dhe mungesën e trajnimit të mjaftueshëm. Zbatimi i protokolleve të standardizuara (IDEA, eTVUS) rrit riprodhueshmërinë dhe saktësinë e hartëzimit. Teknologjitë e reja si ekografia 3D, kontrasti ekografik dhe analiza e imazheve me inteligjencë artificiale janë premtuese, por kërkojnë validim shtesë.

Përfundime: TVUS mbetet metoda themelore jo invazive për diagnostikimin dhe planifikimin kirurgjikal të endometriozës. Megjithatë, ekzistojnë boshllëqe diagnostike, veçanërisht për sëmundjen sipërfaqësore. Trajnimi i gjerë, standardizimi i protokolleve dhe adoptimi i teknologjive të reja mund të përmirësojnë ndjeshëm zbulimin dhe saktësinë diagnostike.

Fjalë kyçe: endometrioza, ekografi transvaginale, sëmundje etj.

ROLI I AKTIVITETIT FIZIK NË PËRMIRËSIMIN E GJENDJES FIZIKE DHE EMOCIONALE TE PACIENTËT ME OSTEOPOROZË: NJË STUDIM PËRSHKRUES.

Besmir Hasani
QKMF "Dr. Fatmir Fazlija", Skënderaj, Kosovë

Abstrakt

Hyrje: Osteoporoza është një sëmundje kronike e skeletit që karakterizohet nga ulja e densitetit kockor dhe rritja e rrezikut për fraktura, veçanërisht në shtyllën kurrizore dhe pjesët periferike të skeletit. Ajo shpesh mbetet e pazbuluar deri në paraqitjen e frakturës së parë, ndaj parandalimi dhe rehabilitimi përmes aktivitetit fizik dhe trajtimit fizioterapeutik janë thelbësorë. Aktiviteti fizik i rregullt ndihmon në ruajtjen e masës kockore, përmirësimin e ekuilibrit dhe forcës muskulare, duke reduktuar ndjeshëm rrezikun e frakturave dhe përmirësuar cilësinë e jetës.

Qëllimi: Ky punim ka dy qëllime: 1) të vlerësoj nivelin e përfshirjes së pacientëve me osteoporozë në aktivitete fizike, dhe 2) të analizojë ndikimin e aktivitetit fizik në gjendjen fizike dhe emocionale të pacientëve me osteoporozë.

Metodologjia: Studimi është i tipit përshkrues transverzal (cross - sectional). Në këtë hulumtim janë përfshirë 40 pacientë me osteoporozë (27 femra, 13 meshkuj), të moshës 48–81 vjeç, të trajtuar dhe monitoruar në ambulancën ortopedike të spitalit "Dr. Sami Haxhibeqiri" në Mitrovicë të Jugut. Të dhënat u mblodhën përmes një pyetësori të standardizuar dhe u analizuan me Microsoft Excel. Përqindjet janë llogaritur në raport me numrin e përgjithshëm të pjesëmarrësve (n=40).

Rezultate: Në nivel të përgjithshëm, 70% e pacientëve ishin të përfshirë në aktivitete fizike, ndërsa 30% nuk ushtronin fare. Kohëzgjatja dhe frekuenca: 46% kryenin ushtrime 10–20 minuta në ditë; 27. 5% vetëm 1–2 herë në javë. Përmirësimi subjektiv: 35% raportuan përmirësim të plotë, 27% mesatar, 27% minimal dhe 11% aspak. Simptoma gjatë aktivitetit fizik: 37% kishin dhimbje shpine / gjuri, 32% lodhje, 15% marramendje, 16% pa simptoma. Zakone të dëmshme: 37. 5% konsumonin duhan; 37. 5% konsumonin alkool (rregullisht ose

nganjëherë). Terapia medikamentoze: 50% e përdornin rregullisht; 45% sipas nevojës. Sipas gjinisë: Femrat (67. 5%) ishin më të prekura, kryesisht prej moshës 61 deri në 70 vjeç. Shumica kryenin ushtrime të lehta (ecje, not) 1–2 herë në javë (40%), ndërsa 30% nuk ushtronin fare. Vetëm 2. 5% konsumonin alkool rregullisht dhe 17. 5% duhan. Meshkujt (32. 5%) kryesisht nga mosha 68 deri në 81 vjeç. Rreth 38% raportuan për realizimin 3–4 herë në javë të ushtrimeve mesatare (vrap, tenis), 20% konsumonin duhan dhe 7. 5% alkool rregullisht.
Përfundime: Rezultatet tregojnë se përfshirja e rregullt në aktivitet fizik ndikon pozitivisht në gjendjen fizike dhe emocionale të pacientëve me osteoporozë, duke reduktuar simptomat dhe rrezikun për fraktura. Programet e ushtrimeve dhe fizioterapisë përmirësojnë forcën muskulare, balancën, qëndrueshmërinë dhe cilësinë e jetës. Ndërhyrjet edukative dhe programet e personalizuara duhet të jenë pjesë e trajtimit standard multidisiplinar për pacientët me osteoporozë.

Fjalë kyçe: Osteoporozë, aktivitet fizik, fizioterapi, frakturë, densitet kockor.

ONYCHOMYCOSIS, NJË KOMBINIM EFEKTIV I TRAJTIMIT LOKAL ANTIFUNGAL ME LASER ND: YAG, ME PULS TË GJATË 1064NM. : RASTE KLINIKE.

Dr. Shk. Besmira Zama Ingris
Mjeke Mikrobiologe
Departamenti i Laboratorëve, Mikrobiologji klinike, Spitali Memorial Fier, Shqipëri.

Abstrakt
Hyrje: Onychomycosis një infeksion fungal që prek thonjtë e këmbëve ose të duarve. Mund të prekë të gjitha pjesët përbërëse të thoit. Onychomycosis nuk është kërcënuese për jetën, mund të shkaktojë dhimbje, shqetësim deri në dëmtime serioze fizike. Ka pesë nëntipe kryesore si: onychomycosis distale laterale subunguale, onychomycosis superficiale, onychomycosis proximale subunguale, onychomycosis endonyx dhe onychomycosis candidiale. Diagnoza bëhet me mikroskopi të drejtpërdrejtë si hidroksid kaliumi (KOH) 20% dhe kulturë në agar glukoze Sabouraud. Ekzistojnë trajtime të ndryshme për Onychomycosis.
Qëllimi: Të vlerësohet efikasiteti i një trajtimi të kombinuar të trajtimit antifungal lokal me një laser Nd: YAG me puls të gjatë 1064 nm.
Materiale dhe metoda: Studimi përfshin trajtimin me antifungale lokal dhe laser Nd: YAG me puls të gjatë 1064 nm në katër seanca në intervale 4 - javore, me 6 pacientë, katër femra dhe dy meshkuj, të lokalizuar në thonjtë e këmbëve dhe njëri në thoin e dorës.
Rezultate: Pas katër seancave, rezultatet e diagnostikimit mykologjik ishin negative në 60%.
Konkluzione: Kombinimi i trajtimit antifungal lokal me terapinë me lazer Nd: YAG 1064 - nm me puls të gjatë është i sigurt dhe efektiv për trajtimin e onychomycosis por është shumë i nevojshëm edhe trajtimi oral sepse rezultatet pozitive për trajtimin e plotë kërkojnë trajtime afatgjata kohore.

Fjalë kyçe: Onychomycosis, Nd: YAG 1064nm me puls të gjatë, antifungal.

PASOJAT NË DJEGIET E FYTYRËS DHE PALPEBRAVE, EKTROPIONI.

Besnik Faskaj, Gëzim Xhepa, Gjergji Belba
Shërbimi i Djegies dhe Kirurgjisë Plastike në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza"

Abstrakt
Hyrje: Djegiet e fytyrës janë një pasojë e zakonshme e traumës termike dhe përfshirja okulare është relativisht e zakonshme, me incidencë midis 7. 5% dhe 27% të pacientëve të shtruar në njësitë e djegies. Djegiet e palpebrave përfaqësojnë një problem të vështirë menaxhimi. Edhe me transplantimin e lëkurës, shenjat dhe kontraksioni mund të rezultojnë në ektropion. Kjo gjendje krijon një deformim të theksuar estetik, paraqet rrezik për ekspozimin e kornesë dhe rrezikon shikimin e pacientit. Historikisht, transplantet e lëkurës me trashësi të plotë dhe tarsorafitë janë përshkruar për të menaxhuar ektropionin e përsëritur.
Materiale dhe metoda: U ekzaminuan raste të ndryshme me djegie të plotë të fytyrës dhe palpebrave të shtruara në klinikën tonë. Më të rëndësishmet janë një pacient 14 - vjeçar me dëmtime nga flaka të shkallës së tretë në

fytyrë dhe qepalla, një burrë 50 - vjeçar me dëmtime nga flaka të shkallës së tretë në fytyrë dhe qepalla dhe një burrë 38 - vjeçar me nekrozë të të dy palpebrave të poshtme nga një sëmundje infektive e trajtuar me HBOT. Tek të gjithë pacientët, shërimi u shoqërua me kontraksione të konsiderueshme, duke rezultuar në krijimin e ektropionit të palpebrave të sipërme dhe / ose të poshtme. Ata u trajtuan me ndërhyrje kirurgjikale në faza të ndryshme të procesit të shërimit me STSG dhe FTSG.
Rezultate: Djegiet me trashësi të plotë shkatërrojnë epidermën, dermën dhe të gjithë elementët rigjenerues dhe korrespondojnë me zonën e koagulimit në modelin e plagës së djegies së Jacksonit. Lëkura është e thatë, e butë dhe indi i prekur është avaskular dhe i bardhë. Pacienti 14 - vjeçar kreu një operacion të palpebrave me FTSG në të dy sytë me parandalimin dhe trajtimin e ektropionit, burri 50 - vjeçar u ndërhy në kohë të ndryshme, STSG në fytyrë dhe qepallë, u rindërhy përsëri me STSG në qepallat e djathta, por vazhdoi të kishte ektropion bilateral. Burri 38 - vjeçar u trajtua me HBTO dhe FTSG muaj pas nekrozës me rezultate të mira.
Përfundime: Menaxhimi i ektropionit të palpebrës së poshtme pas djegies është i vështirë, pasi tkurrja e transplantit të lëkurës mund të shkaktojë deformime sekondare. Ekzistojnë polemika në lidhje me rolin e lubrifikimit profilaktik okular, heqjes dhe debridementit të eskarit, qepjes së përkohshme dhe tarsorafisë kirurgjikale, kohës së operacionit për tkurrjen e palpebrës, dhe rolin e transplanteve të lëkurës me trashësi të plotë dhe të pjesshme në rindërtimin e qepallës. Në rajonin periorbital, nëse kontraktura shoqërohet me mosfunksionim të lehtë të mbylljes së syve, mund të kryhet prerje minimale për lirimin e kontrakturës dhe mbylljen e plagës me lembo lokale. Nëse konjuktiva dhe lamela e mesme janë të paprekura, por ka mosfunksionim të rëndë të mbylljes së syve, duhet të përdoret transplantimi i lëkurës. Transplantet e lëkurës me trashësi të pjesshme për palpebrat e sipërme të lëvizshme dhe transplantet e lëkurës me trashësi të plotë për palpebrat e poshtme përdoren në rutinë. Heqja e hershme e indeve të prekura dhe transplantimi i lëkurës është pothuajse gjithmonë i nevojshëm për të parandaluar ektropionin dhe ndërlikimet sekondare të kornesë.

Fjalë kyçe: Djegiet e fytyrës, palpebra, ektropioni.

MORBUS BEHÇET DHE KOMPLIKIMET E TIJ.
Betina Hasani, Fitim Gashi

Abstrakt
Hyrja: Sëmundja e Behçet - it është vaskulit kronik, rekurrent i karakterizuar me ulçera orale rrekurrente, ulçera gjenitale, manifestime mukokutane, lezione okulare dhe manifestimet neurologjike, artikulare, gastrointestinale, kardiake, pulmonare dhe renale. Ajo karakterizohet nga një ecuri klinike e paparashikueshme dhe lidhet ngushtë me faktorë gjenetikë, veçanërisht antigjenin HLA - B51. Sëmundja shoqërohet me një shkallë të lartë vdekshmërie, veçanërisht te meshkujt e rinj, kur preken enët e mëdha të gjakut, sistemi nervor, trakti gastrointestinal dhe zemra.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është zgjerimi i njohurive rreth sëmundjes së Behçet - it, epidemiologjisë, etiopatogjenezës, pasqyrës klinike, kriteret diagnostike, trajtimit dhe komplikimet e mundshme.
Materiale dhe metoda: Ky punim bën pjesë në grupin e hulumtimeve të rishikimit të literaturës. Është realizuar duke mbledhur, analizuar, krahasuar e vlerësuar të gjitha të dhënat të marra nga literatura ndërkombëtare.
Rezultate dhe diskutime: Sëmundja e Behçet është një sëmundje e rrallë, e cila haset në mbarë botën, me prevalencë më të lartë në vendet e rajonit të Mesdheut dhe Azisë Lindore, një zonë që përkon me Rrugën e Vjetër të Mëndafshit (Old Silk Road), një rrugë e lashtë tregtare që shtrihej nga Mesdheu, në Lindjen e Mesme dhe Lindjen e Largët. Sëmundja është më e shpeshtë tek meshkujt, të cilët gjithashtu kanë edhe një ecuri klinike më të rëndë. Mosha më e prekur është ajo në mes 30 - 40 vjeç, duke prekur kryesisht të rinjtë, megjithatë sëmundja mund të shfaqet edhe në moshat pediatrike. Manifestimi më i zakonshëm dhe universal është ulçera orale, kurse simptomat e tjera ndryshojnë në varësi të rajonit. Shkaku kryesor i morbiditetit është ruptura e aneurizmës pulmonare.
Përfundime: Nga rishikimi i literaturës dalim në konkluzion se sëmundja e Behçet është një sëmundje kronike dhe multisistemike, me periudha të relapsit dhe remisionit, e cila kërkon diagnostifikim të hershëm, menaxhim të duhur dhe një qasje multidisplinare për të kontrolluar simptomat, parandaluar komplikimet dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës.

Fjalë kyçe: Sëmundja e Behçetit, vaskulit, ulçera orale rekurrente.

HIPERTENSIONI ARTERIAL DHE NDRYSHIMET HISTOLOGJIKE NË MURIN E ENËVE TË GJAKUT.

Bimza Ibrahimi

Abstrakt

Hipertensioni arterial përfaqëson një nga faktorët kryesorë të rrezikut për sëmundjet kardiovaskulare dhe vdekshmërinë globale. Në këtë punim trajtohet ndikimi i tij afatgjatë mbi strukturën dhe funksionin e murit të enëve të gjakut, duke u fokusuar në ndryshimet histologjike që ndodhin si pasojë e presionit të lartë të gjakut. Enët e gjakut pësojnë një sërë ndryshimesh patologjike, përfshirë trashjen e murit, disfunksionin endotelial, riorganizimin e qelizave të muskulit të lëmuar vaskular (VSMC), depozitimin e tepërt të kolagjenit nga fibroblastet, si dhe çrregullime në aktivitetin e qelizave intersticiale dhe periciteve. Gjithashtu, trajtohet roli i faktorëve humoralë si angiotensina II dhe aldosteroni në aktivizimin e sistemit reninë - angiotenzinë - aldosteron (RAAS), i cili ndikon drejtpërdrejt në rritjen e tonusit vaskular dhe rigjenerimin patologjik të indeve. Ky punim shqyrton gjithashtu mekanizmat molekularë që ndikojnë në ndryshimin e sjelljes së qelizave vaskulare dhe kontributin e tyre në rritjen e rezistencës periferike, duke ndikuar në përkeqësimin e gjendjes hipertensive. Duke u mbështetur në literatura shkencore bashkëkohore dhe të verifikuara, janë analizuar të dhëna që lidhen me strukturën mikroskopike të murit arterial, përfshirë shtresat tunica intima, media dhe adventitia, si dhe indin dhjamor përivaskular (PVAT), duke theksuar kontributin e çdo komponenti në homeostazën dhe patologjinë vaskulare. Këto ndryshime jo vetëm që shërbejnë si bazë për komplikime afatgjata, por edhe si objektiva potencialë për trajtim dhe parandalim. Ky rishikim ofron një panoramë të qartë mbi proceset molekulare dhe qelizore që shoqërojnë zhvillimin e hipertensionit dhe pasojat e tij sistemike.

Fjalë kyçe: Hipertension arterial, ndryshime histologjike, disfunksion endotelial, VSMC, rimodelim vaskular, RAAS, PVAT, fibrozë.

MENAXHIMI FARMAKOLOGJIK I UROLITIAZËS: UDHËZIME, EVIDENCA DHE TERAPITË MË EFEKTIVE.

[1]Bjeshkatore Selmani
Nefrologe Spitali Rajonal Kukës

Abstrakt

Hyrje: Urolitiaza, që përfshin gurët në veshka, ureter, vezikën urinare dhe zonën juxtavezikale, mbetet një problem i zakonshëm klinik, i karakterizuar nga morbiditet akut dhe një rrezik të lartë të rikthimit. Duke qenë se ndërhyrjet kirurgjikale mbartin kosto dhe rreziqe të konsiderueshme, trajtimi farmakologjik përfaqëson një qasje thelbësore për parandalimin dhe menaxhimin afatgjatë.

Materiale dhe metoda: Një studim observues, rishikim i literaturës dhe meta - analizave nëpër studime të viteve të fundit duke përdorur fjalë kyce si; urolitiazë dhe terapi ekspulsive.

Rezultate: Udhëzimet më të fundit ndërkombëtare nga Shoqata Amerikane e Urologjisë (AUA) dhe Shoqata Evropiane e Urologjisë (EAU) theksojnë rëndësinë e qasjes së individualizuar bazuar në përbërjen e gurëve dhe vlerësimin metabolik. Literatura aktuale mbështet fort përdorimin e alfa bllokuesve, sidomos tamsulosin dhe silodosin, për lehtësimin e kalimit spontan të gurëve të ureterit distal. Kombinimi i tamsulosin me tadalafil gjithashtu tregon rezultate premtuese në rritjen e normës së daljes së gurëve dhe shkurtimin e kohës së trajtimit. Për gurët me përbërje ac. urike, alkalinizimi i urinës me citrat kaliumi ose bikarbonat natriumi ka treguar shkallë të lartë të shpërbërjes së plotë, kur pH i urinës mbahet mbi 6. 5 për një kohë të gjatë. Në pacientët me uricemi të lartë ose ekskretim të shtuar të acidit urik, rekomandohet shtimi i allopurinolit ose febuksostatit. Për rastet e cistinurisë, përdorimi i agjentëve tiolë si tiopronina është treguar efektiv në reduktimin e formimit të gurëve dhe të nivelit urinar të cistinës, me tolerancë më të mirë në krahasim me penicilaminën. Në rastet me gurë infektivë (struvit), kontrolli i infeksionit është esencial. Në raste të përzgjedhura, përdorimi i acidit acetohidroksamik, një inhibitor i ureazës, mund të ndihmojë në frenimin e rritjes së gurëve. Terapitë emergjente, duke përfshirë ndërhyrjet mbi mikrobiomën intestinale (Oxalobacter formigenes), antagonistët e receptorëve të vazopresinës V2, dhe terapitë gjenike për gurët monogjenikë janë aktualisht në faza eksperimentale dhe mund të ofrojnë alternativa të reja në menaxhimin farmakologjik.

Konkluzione: Terapitë më të mbështetura nga evidenca shkencore përfshijnë: bllokuesit alfa për gurët në ureterin distal; alkalinizimin e urinës për gurët urikë; agjentët tiolë për cistinurinë; si dhe diuretikët tiazidikë dhe

citratin për parandalimin e gurëve kalcikë. Këto qasje janë të bazuara në prova të forta nga studime të kontrolluara dhe analiza sistematike, duke përfaqësuar themelin e trajtimit modern farmakologjik të urolitiazës.

Fjalë kyçe: Urolitiaza, gurët në veshka, ureter, vezikë urinare, zonën juxtavezikale.

MENAXHIMI I KRIZAVE HIPERGLICEMIKE NË KONDITAT E URGJENCËS.

Bledar Hysenbelli
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Shërbimi i Urgjencës, Tiranë.

Abstrakt
Hyrje: Ketoacidoza diabetike (DKA) dhe koma hiperosmolare hiperglicemike (HHS) janë dy urgjencat hiperglicemike më serioze, akute dhe kërcënuese për jetën tek individët me diabet tip 1 (T1D) dhe diabet tip 2 (T2D). Të dhënat e dekadës së fundit, në rang global tregojnë qartë një rritje të numrit të rasteve që paraqiten në urgjencë me diagnozën DKA dhe HHS. Statistikat e Federatës Ndërkombëtare të Diabetit, raportojnë një rritje prej 55% në shkallën e shtrimeve në spital për DKA, veçanërisht tek të rriturit <45 vjeç. DKA karakterizohet nga triada e hiperglicemisë, rritjes së përqendrimit të ketoneve në gjak dhe / ose urinë, dhe acidozës metabolike, ndërsa HHS karakterizohet nga hiperglicemia e rëndë, hiperosmolaliteti dhe dehidratimi në mungesë të ketozës ose acidozës së konsiderueshme.
Qëllimi: Ky referim ka për qëllim të paraqesë rekomandimet bazë për menaxhimin e dy urgjencave madhore të lidhura me Diabetin Mellitus. Çrregullimet metabolike në DKA vijnë si rezultat i kombinimit të mungesës absolute ose relative të insulinës (nivele të pamjaftueshme për të frenuar glukoneogjenezën dhe prodhimin e ketoneve) dhe rritjes së hormoneve kundër - rregulluese (glukagoni, epinefrina, norepinefrina, kortizoli dhe hormoni i rritjes). Në HHS, ekziston një sasi e mbetur e sekretimit të insulinës që minimizon ketozën, por nuk kontrollon hipergliceminë.
Rezultate: Të dhënat në literaturë konfirmojnë se si DKA ashtu edhe HHS mund të ndodhin në çdo moshë tek njerëzit me T1D, T2D ose çdo lloj tjetër diabeti. DKA është më e zakonshme tek të rinjtë me T1D, dhe HHS raportohet më shpesh tek të rriturit më të moshuar me T2D. Edhe pse çdo sëmundje akute ose stres fiziologjik mund të përshpejtojë DKA dhe HHS, shkaqet më të shpeshta janë infeksioni, veçanërisht infeksionet e traktit urinar dhe pneumonia, si dhe mungesa e terapisë me insulinë. Vitet e fundit, është zbuluar se edhe klasa e re e preparative anti diabetik oral si frenuesit e ko - transportuesit të natriumit - glukozës 2 (SGLT2) rrisin rrezikun e DKA, më shpesh kur përdoren në T1D, por edhe në T2D. Incidenca e DKA dhe HHS është raportuar të jetë rritur gjatë pandemisë COVID - 19.
Konkluzione: Diagnoza dhe menaxhimi i hershëm i DKA dhe HHS janë thelbësore për të përmirësuar rezultatet. Shtyllat kryesore të trajtimit të DKA dhe HHS janë zëvendësimi i lëngjeve, terapia me insulinë, rimbushja e elektroliteve dhe trajtimi i shkaqeve precipituese. Trajtimi i duhur ka përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme prognozën e jetës së pacientëve diabetik që prezantohen në urgjencë me kriza hiperglicemike.

Fjalë kyçe: Diabeti, ketoacidoza diabetike, koma hiperglicemike hiperosmolare, reparti i urgjencës.

RETINOPATIA DIABETIKE SI NJË NGA ARSYET KRYESORE TË HUMBJES SË SHIKIMIT.

Dr. Bledar Kruja
Oftalmolog

Abstrakt
Hyrje: Retinopatia diabetike përbën një nga komplikacionet më të shpeshta dhe serioze të diabetit mellitus dhe është shkaku kryesor i humbjes së shikimit tek të rriturit në moshë aktive. Hiperglicemia kronike shkakton dëmtime mikrovaskulare në retinë, të cilat çojnë në hemorragji, edemë makulare dhe neovaskularizim patologjik. Zbulimi i hershëm i ndryshimeve retinale përmes ekzaminimit oftalmologjik dhe metodave të imazherisë (funduskopi, OCT, fluorescein angiografi) është thelbësor për parandalimin e progresionit të sëmundjes. Trajtimi i hershëm i komplikacioneve përfshin kontrollin strikt të glukemisë, ndërhyrje me lazer, injeksione intravitreale dhe në raste të avancuara kirurgjinë vitreoretinale.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të theksojë rëndësinë e diagnostikimit të hershëm dhe ndërhyrjes në kohë për reduktimin e riskut të humbjes së shikimit tek pacientët me diabet.
Përfundime: Njohja e faktorëve rrezikues, ndjekja e rregullt oftalmologjike dhe trajtimi i hershëm i komplikacioneve janë elementë kyç në parandalimin e humbjes së shikimit nga retinopatia diabetike.

Fjalë kyçe: Retinopatia diabetike, diabeti mellitus, diagnostikim, humbje shikimi.

SËMUNDJA E VON WILLEBRAND. DIAGNOZA DHE MENAXHIMI I SAJ.

Bledi Kalaja
Hematolog
Qendra Kombetare e Hemofilisë
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"

Abstrakt
Hyrje: Sëmundja e Von Willebrandit është një çrregullim hemorragjik, zakonisht e trashëguar, rrallë e fituar që vjen si rezultat i deficitit sasior ose cilësor të faktorit Von Willebrand plazmatik. Në varësi të defektit sëmundja mund të trashëgohet në mënyrë dominante ose recesive. Mekanizmat e mutacioneve janë të shumta duke e bërë këtë patologji mjaft heterogjene. Gjeni i VWF lokalizohet në kromozomin 12 (12p13. 3), përfshin 52 ekzone, nga të cilët 2 - 52 kodojnë proteinën e VWF. Rreth 1 / 10 000 individë në popullatë mund të pësojnë fenomene hemorragjike në terren të një deficiti të VWF. Faktori Von Willebrand është një proteinë adezioni, multimerike, me një seri dimerësh me subunitete të maturuara me peshë molekulare 20 000 KD. Ai merr pjesë si në hemostazën primare ashtu edhe në atë sekondare të koagulimit. Von Willebrandi sintetizohet dhe multimerizohet në megakariocitet dhe qelizat endoteliale. Depozitohet në granulat alfa të trombociteve dhe në trupat Weibel - Palade të qelizave endoteliale në formën e multimerëve. Sekretohet në plazmë në një shteg konstitutiv dhe të mirë rregulluar. Ndihmon në adezionin e trombociteve me enën e gjakut me anë të receptorëve GpIb dhe GpαIIbI. Ndihmon në agregimin ndër trombocitar me anë të GpIIbIIIa dhe GpIIαbIII. Në plazmë proteolizohet nga një metalo - protezë ADAMTS - 13. Mosfunksionimi i kësaj metalo - proteaze do të çonte në çlirimin plazmatik të multimerëve të VWF jonormal. Sëmundja e Von Willebrandit mund të ndahet në tre tipe në varësi të llojit të defektit të faktorit. Tipi 1 dhe 3 janë defekte sasiore përkatësisht jo i plotë (më i shpeshtë) / i plotë i proteinës, tipi 2 (me nëntipe 2A, 2B, 2M, 2N) defekte cilësore. Klasifikimi i Von Willebrand Disease. Klinika, është primare hemorragjia, pikëzimi i saj. Testet laboratorike si FVIII: C niveli, VWF: Ag (vlerësimi sasior), VWF: RCo, RIPA, multimerët, VWF: CB, VWF: FVIII si vlerësime cilësore, koha e hemorragjisë, PFA - 100, etj. Vlerësimi klinik. Fenomenet hemorragjike dhe shpeshtësia e tyre në varësi të lokalizimit (kryesisht muskulo - kutane). Kriteret e diagnozës, algoritmet. Roli i Von Willebrand në angiogjenezë dhe angiodisplazi. Çrregullimet e fituara të VWF. Alternativat e trajtimit në varësi të llojit, tipit, shpeshtësisë së fenomeneve hemorragjike, efektit optimal janë të ndryshme. Desmopresina si stimuluese e çlirimit të faktorit endogjen nga qelizat endoteliale vaskulare. Mënyrat e mjekimit me desmopresinë, dozat dhe ndjekja në dinamikë. Kriteret e përgjigjes ndaj mjekimit me desmopresinë, kundërindikimet. Koncentratet me VWF dhe VWF / FVIII, llojet, dozat, kriteret e mjekimit dhe ndjekja në dinamikë. Acidi traneksamik si medikament shoqërues etj, pilulat e kontrollit të lindjes (efekti i estrogjenit mbi faktorin VIII dhe VWF). Protokolle në vende të ndryshme. Rastet e VWD të fituar. Studimet e fundit (çrregullimet e sekretimit të VWF, aftësitë lidhëse të VWF me strukturat e tjera) dhe alternativa mjekimi të reja (përdorimi i nano - pjesëzave platelet like, terapia me siRNA, manipulimi në molekulën RalB në sekretimin e VWF) në studim e përdorimin praktik.
Konkluzione: VWD është çrregullimi hemorragjik më i shpeshtë, me një heterogjenitet të gjerë dhe kompleks të fenotipit. Gjenetika është e qartësuar pothuajse plotësisht në vitet e fundit. Diagnostikimi niset gjithmonë nga historia hemorragjike dhe stadifikimi i saj. Risku i hemorragjisë në VWD, varion në lidhje me tipin. Profilaksia bëhet në raste të caktuara specifike.

Fjalë kyçe: Sëmundja e Von Willebrandit, çrregullim hemorragjik.

REKONSTRUKTIMI I GJIRIT PAS MASTEKTOMISË.
Blend Mati

Abstrakt
Hyrje: Rekonstruksioni i gjirit pas mastektomisë është një procedurë kirurgjikale komplekse dhe emocionuese që synon t'i rikthejë integritetin fizik dhe emocional të femrës pas heqjes të gjirit për shkak të kancerit të gjirit ose për shkaqe të tjera shëndetësore. Ky studim shqyrton procesin dhe rezultatet e rekonstruksionit të gjirit, duke përfshirë qëllimin e tij, metodologjinë dhe implikimet e tij për pacientët dhe mjekët.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të ofrojë një pasqyrë të hollësishme dhe të përqendruar mbi procedurën dhe rezultatet e rekonstruksionit të gjirit pas mastektomisë. Studimi synon të analizojë avantazhet dhe sfidat e teknikave të ndryshme kirurgjikale dhe të rikujtojë rëndësinë e mbështetjes multidisiplinore për pacientët në këtë proces të kujdesit shëndetësor.
Metodologjia: Për të arritur qëllimin e studimit, është kryer një analizë e literaturës dhe një shqyrtim i rasteve klinike për të dokumentuar praktikat aktuale dhe rezultatet e rekonstruksionit të gjirit. Analiza përfshin diskutimin e përparësive dhe sfidave të teknikave të ndryshme kirurgjikale, si dhe vlerësimin e ndikimit psikologjik dhe social të kësaj procedure për pacientët.
Përfundime: Rekonstruksioni i gjirit pas mastektomisë është një hap i rëndësishëm në trajtimin dhe rimëkëmbjen e grave me kancer të gjirit. Nëse bëhet me sukses, ky proces mund t'i sjellë rikthimin e vetëbesimit dhe ndjenjën e plotësimit për pacientet. Megjithatë, sfidat teknike dhe emocionale që mund të paraqiten në rrugën e rekonstruksionit të gjirit shpesh kërkojnë një ekip të specializuar dhe mbështetjen e vazhdueshme të pacientit për të siguruar një rezultat optimal dhe një rimëkëmbje të suksesshme. Studimet e ardhshme duhet të vazhdojnë të përqendrohen në përmirësimin e teknikave kirurgjikale dhe në rritjen e kujdesit të përgjithshëm për pacientët në këtë fushë kritike të kujdesit shëndetësor.

Fjalë kyçe: Rekonstruksioni i gjirit, mastektomia, kanceri i gjirit.

VENDIMARRJA PAS DËMTIMIT TË RËNDË CEREBRAL SI PASOJË E ARRESTIT TË ZGJATUR KARDIOPULMONARE.
Dr. MD Blerim Arapi
Shef i Shërbimit të Anestezisë dhe Reanimacionit i Spitalit Hygeia dhe Spitalit Amerikan 2

Abstrakt
Hyrje: Arresti i zgjatur kardiopulmonare shoqërohet shpesh me pasoja të rënda neurologjike, veçanërisht me dëmtime të mëdha hipoksiko - ishemike të trurit. Vendimmarrja në fazat që pasojnë një dëmtim të tillë cerebral përfshin konsiderata komplekse etike, klinike dhe familjare. Ky studim synon të ndajë përvoja klinike dhe të eksplorojë perspektiva të ndryshme multidisiplinare në vendimmarrjen pas një AZKP të zgjatur që ka çuar në dëmtime të rënda cerebrale.
Objektiva: Të analizohen rrugët e vendimmarrjes pas dëmtimeve të rënda të trurit si pasojë e NKP së zgjatur. Të vlerësohet roli i prognozës neurologjike në udhëheqjen e planeve të kujdesit. Të shqyrtohen sfidat etike dhe perspektivat e familjarëve dhe profesionistëve shëndetësorë.
Metodologjia: U krye një analizë retrospektive mbi 13 pacientë të shtruar në njësinë e kujdesit intensiv (ITU) gjatë viteve 2020–2024, të cilët kishin pësuar NKP të zgjatur (>10 minuta) dhe kishin zhvilluar dëmtime të rënda cerebrale. U rishikuan të dhënat klinike, studimet imazherike, rezultatet e EEG - së dhe intervistat me familjarët. Gjithashtu, u zhvilluan intervista gjysmë të strukturuara me stafin e ITU - së, neurologë dhe bioetikë për të mbledhur mendimet e tyre.
Rezultate: Nga 13 pacientë: 5 mbetën në gjendje vegjetative të përhershme, 2 mbetën në një gjendje minimale të vetëdijes, 3 rifituan vetëdijen brenda 2 javësh, 3 ndërruan jetë brenda një jave. Në 10 nga 13 raste, familjarët u përfshinë në diskutimet mbi vazhdimin apo ndërprerjen e trajtimeve mbajtëse të jetës. Vendimmarrja shpesh u vonua për shkak të pasigurisë në prognozë dhe stresit emocional të familjarëve. Faktorët më me ndikim në këtë proces ishin vlerësimet neurologjike (EEG, MRI), udhëzimet klinike dhe vlerat e dëshirat e familjes. Në 4 nga 13 raste, u diskutua ndërprerja e trajtimit me familjarët, por pacientët u përkeqësuan shpejt përpara se të merrej një vendim zyrtar për ndërprerjen e terapisë. Mungesa e legjislacionit të qartë e komplikoi edhe më shumë procesin e vendimmarrjes.

Diskutime: Kjo përvojë thekson nevojën për protokolle të standardizuara dhe sisteme mbështetëse më të forta për familjet që përballen me vendime të vështira në fund të jetës. Trajnimi i profesionistëve të kujdesit shëndetësor në komunikimin etik dhe përfshirja e këshilltarëve etikë në fazat e hershme të procesit mund të përmirësojnë ndjeshëm cilësinë e vendimmarrjes.
Përfundime: Vendimmarrja për pacientët në gjendje vegjetative me prognozë të dobët pas ndalesës kardiake është një proces i vështirë dhe kompleks. Ndikim të madh kanë faktorë të tillë si: ngarkesa emocionale, prognoza e dobët neurologjike, vlerat kulturore, mosha e pacientit, përfshirja e familjes, komunikimi i hapur dhe etik, dhe kuadri ligjor i zbatueshëm. Këto vendime duhet të udhëhiqen gjithashtu nga konventat ndërkombëtare dhe legjislacioni që vendi ynë ka ratifikuar, për të siguruar që praktikat të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe etikës mjekësore.

Fjalë kyçe: vlerësime, pacientë, vendimmarrje, arrest kardiopulmonar.

MBËSHTETJA E SHËNDETIT MENDOR PËR PUNONJËSIT E KUJDESIT SHËNDETËSOR. STRATEGJITË PËR QËNDRUESHMËRI DHE MIRËQENIE.

Enkelejda Trebicka, Blerina Boshnjaku

Abstrakt
Hyrje: Në sektorin e kujdesit shëndetësor, mbështetja e shëndetit mendor të punonjësve është jetike për sigurimin e qëndrueshmërisë dhe mirëqenies në vendin e punës. Punonjësit e kujdesit shëndetësor, si mjekët, infermierët dhe stafi ndihmës, përballen me sfida të përditshme që përfshijnë lodhjen fizike, streset emocionale, dhe rrezikun e djegies profesionale (burnout).
Qëllime: Ky studim ka për qëllim të analizojë burimet kryesore të stresit dhe presionit psikologjik në vendin e punës për punonjësit e kujdesit shëndetësor dhe vlerësojë strategjitë për të mbështetur shëndetin mendor dhe për të përmirësuar mirëqenien e punonjësve të kujdesit shëndetësor. Duke u bazuar në shqyrtim të literaturës ekzistuese, zhvillimin e pyetsorëve dhe intervista me punonjës të fushës, ky studim eksploron teknikat më të mira për menaxhimin e stresit, përmirësimin e fleksibilitetit në punë, dhe zhvillimin e një kulture mbështetëse në vendin e punës.
Materiale dhe Metoda: Ky studim përdor një qasje hulumtuese cilësore dhe sasiore për të analizuar strategjitë e mbështetjes së shëndetit mendor dhe përmirësimit të mirëqenies për punonjësit e kujdesit shëndetësor. Metodologjia është strukturuar në dy faza kryesore: mbledhja e të dhënave përmes pyetësorëve të ngarkuar në Google Forms dhe shpërndarë tek 431 staf infermieror në Kukës dhe Tiranë, intervistave, si dhe analizimi i rezultateve duke përdorur mjete statistikore dhe përshkruese.
Rezultate dhe konkluzione: Rreth 72. 6% e të anketuarve e perceptojnë nivelin e stresit si nga mesatar deri në shumë të lartë. Ngarkesa e punës dhe komunikimi i dobët janë faktorët dominues të stresit. Rreth 56. 3% e të anketuarve nuk ndihen gjithmonë të mbështetur nga kolegët. 61. 2% e të anketuarve e vlerësojnë mbështetjen psikologjike si të rëndësishme. Rezultatet tregojnë se niveli i stresit në vendin e punës është i lartë, i ndikuar kryesisht nga ngarkesa e punës dhe komunikimi i dobët. Mbështetja nga kolegët dhe mundësitë për mbështetje psikologjike janë të paqëndrueshme ose të pamjaftueshme, ndërsa mungesa e trajnimeve për menaxhimin e stresit tregon nevojë për ndërhyrje të strukturuar.

Fjalë kyçe: Shëndeti mendor, mirëqenia e punonjësve, kujdesi shëndetësor, qëndrueshmëria në punë, burnout, mbështetje psikologjike.

KONDROSARKOMA MIKSOIDE EKSTRASKELETALE, PREZANTIM RASTI, RISHIKIM I LITERATURËS.

Blerina Cela[1], Edmond Gashi[1], Paolo Racugno[2], Alketa Pere[1], Daniela Xhemalaj[1], Eriselda Kurushi[3], Viola Cala[1], Yllson Ibrahimllari[1], Pranvera Hoxha[1], Jona Prifti[1]
[1]*Spitali Italian Salus, Tiranë*
[2]*SAP health services, Bari, Itali*
[3]*Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë*

Abstrakt
Kondrosarkoma miksoide ekstraskeletale është një neoplazi mezenkimale e rrallë, e cila nuk ka një diferencim të qartë. Karakteristikat e saj kryesore janë matriksi i bollshem i natyrës miksoide, arkitektura multilokulare dhe uniformiteti qelizor, i organizuar në korda, grupe dhe rrjete retikulare. Ngjashmëria ultrastrukturale me indin kondroid i japin emrin kondrosarkomë, pavarësisht se nuk është një tumor me origjinë kartilaginoze. Do të paraqesim rastin e një pacienti të diagnostikuar me kondrosarkomë miksoide ekstraskeletale, duke theksuar rëndësinë e diagnostikimit dhe diskutimit multidisiplinar për përcaktimin e saktë të trajtimit të rasteve me një diagnozë të tillë, kaq të rrallë dhe sfiduese. Pacienti, mashkull, 54 vjec, referon se prej rreth 8 - 9 muaj evidentoi nje formacion ne regjionin femoral dexter, i cili erdhi duke u rritur me kalimin e kohes. Ne ekzaminimet imazherike rezulton formacion multilokular me diameter maksimal 12 cm ne muskulin vastus intermedius dexter, me ndryshime kistike dhe degjenerative nekrotike ne brendesi, pa prekje te strukturave kockore. Nuk u verejt perhapje ne distance. Nga biopsia trucut e lezionit rezultoi Lezion mezenkimal me ndryshime miksoide. Pas vleresimit multidisiplinar pacienti i nenshtrohet kirurgjise me ekscizion total te mases, ku, pas ekzaminimit histopatologjik dhe imunohistokimik rezulton Kondrosarkome miksoide ekstraskeletale. Teknika për vlerësimin histopatologjik, trucut apo biopsi ekscizionale, sëbashku me teknikat e tjera mbështetëse, si imunohistokimia, apo biologjia molekulare, janë thelbësore për arritjen e një diagnozë të saktë që do të orientojë për më tej trajtimin dhe follow - up e pacientit.

Fjalë kyçe: Kondrosarkome, ekstraskeletale, miksoide, multilobular, mezenkimal, indet e buta.

PËRDORIMI I PLAZMËS SË PASUR ME TROMBOCITE (PRP) NË TRAJTIMIN E AKNEVE DHE SHENJAVE POSTAKNEIKE.

PhD Blerina Radi

Abstrakt
Hyrje: Aknet përbëjnë një nga çrregullimet dermatologjike më të zakonshme, që prek kryesisht adoleshentët dhe të rriturit e rinj. Pas shërimit të lezioneve inflamatore, shumë pacientë përballen me shenja postakneike, të cilat ndikojnë ndjeshëm në vetëvlerësim dhe cilësinë e jetës. Trajtimi i këtyre shenjave ka qenë gjithmonë një sfidë për dermatologët. Së fundmi, përdorimi i Plazmës së Pasur me Trombocite (PRP) është vlerësuar si një terapi inovative, natyrale dhe efektive për rigjenerimin e lëkurës.
Qëllimi: Të vlerësohet efikasiteti i trajtimit me PRP në reduktimin e lezioneve akneike aktive dhe në përmirësimin e strukturës së lëkurës në shenjat postakneike, duke krahasuar rezultatet klinike përpara dhe pas trajtimit.
Materiale dhe Metoda: Në studim u përfshinë pacientë të moshës 18–40 vjeç, me prani të akneve të moderuara dhe shenjave postinflamatore. Secilit pacient iu aplikuan 3–4 seanca trajtimi me PRP, në intervale 3 - javore. PRP u përgatit nga gjaku autolog duke përdorur centrifugim të dyfishtë, sipas protokolleve standarde. Për vlerësimin klinik u përdorën shkallët GAIS (Global Aesthetic Improvement Scale) dhe ECCA (Echelle d'Evaluation Clinique des Cicatrices d'Acné) përpara dhe pas trajtimit.
Rezultate: Pas ciklit të trajtimeve, u vu re përmirësim i dukshëm në uniformitetin e tonit të lëkurës, reduktim i ndjeshëm i eritemës dhe përmirësim i strukturës së shenjave postakneike. Pacientët raportuan gjithashtu rritje të elasticitetit dhe shkëlqimit të lëkurës. Efektet anësore ishin minimale dhe kalimtare, si skuqje e lehtë dhe ënjtje lokale për 24–48 orë.
Përfundime: PRP përfaqëson një metodë të sigurt, efektive dhe natyrale në trajtimin e akneve dhe rigjenerimin e shenjave postakneike. Ajo stimulon proceset e vetë - riparimit të lëkurës përmes faktorëve të rritjes të pranishëm në trombocite, duke nxitur sintezën e kolagjenit dhe elastinës. Rezultatet tregojnë se PRP mund të konsiderohet një alternativë e vlefshme ose terapi mbështetëse në dermatologjinë estetike moderne.

Fjalë kyçe: Plazma, akne, trombocite, trajtim.

APARATI URINAR, NORMA DHE VARIANTET E SAJ.

Blerina Sararaci Qirinxhi, Denis Qirinxhi, Durim Çela
Shërbimi Universitar i Imazherisë dhe Mjekësisë Nukleare FM / QSUNT

Abstrakt
Hyrje: Imazheria në moshat pediatrike shpesh është sfiduese, përveç të tjerash edhe për faktin se ka shumë variante norme në kazuistikën e saj. Ndonjëherë këto variante norme mund të mos njihen apo evidentohen, duke sjellë në diagnozë të gabuar edhe në moshën adulte.
Qëllimi: Paraqitja e ndryshimeve radiologjike më të spikatura që hasen në kabinetet e radiologjisë pediatrike, por jo vetëm, dhe që përbëjnë variante norme në pacientët që kryejnë ekzaminime të aparatit urogjenital.
Diskutimi: Fusha e radiologjisë në përgjithësi dhe ajo pediatrike në veçanti është e lidhur jo vetëm me grupmoshat e ndryshme, duke filluar që nga neonati deri te adoleshentët apo adultët e rinj, por edhe me variantet e normës. Në këtë prezantim do të citohen këto variante radiologjike sipas grupmoshës, rëndësisë dhe modalitetit imazherik të përdorur. Prezantimi do të jetë konceptuar në trajtën e një rishikimi literature, e pasuruar me raste klinike të evidentuara në praktikën tonë klinike.
Konkluzione: Ekzaminimet radiologjike pediatrike dhe jo vetëm janë sfiduese si për radiologun e përgjithshëm, por shpesh edhe për radiologun e fokusuar në fushën pediatrike. Për këtë arsye duhet të mbahen në mendje diferencat moshore dhe jo vetëm, si në qasje dhe në pritshmëri e për këtë, leksione të tilla kanë një rëndësi të veçantë.

Fjalë kyçe: Imazheria pediatrike, aparati urinar, variante norme, ekzaminim radiologjik.

HIPOTIROIDIZMI KONGENITAL: RËNDËSIA E SKRININGUT NEONATAL DHE NDIKIMI NË ZHVILLIMIN NEUROKOGNITIV.

Blerta Begaj

Abstrakt
Hyrje: Hipotiroidizmi kongenital (HK) është një ndër çrregullimet endokrine më të shpeshta në periudhën neonatale që shfaqet në rreth 1: 2000 - 1: 4000 të porsalindur duke çuar në probleme të rritjes dhe paaftësi të mundshme intelektuale nëse nuk diagnostifikohet dhe trajtohet me kohë. Në shumicën e rasteve, foshnjat me HK janë asimptomatike në lindje, por pa trajtim mund të zhvillojnë simptoma si ikter te zgjatur, konstipacion, mbipeshë, vonesa në rritje dhe zhvillim, letargji (mungesë energjie, e shoqëruar me lodhje dhe përgjumje gjatë tërë ditës), lëvizje e ngadaltë, e qarë e ngjirur, vështirësi në ushqyerje, lëkurë e thatë dhe e ashpër, temperaturë trupore e ulët, tonus muskulor jashtëzakonisht i dobët, herni umbilikale. Vazhdimësia e hipotiroidizmit të rëndë dhe të patrajtuar rezultoi në dëmtime të rënda mendore, me një IQ nën 80 në shumicën e rasteve. Diagnoza e HK bazohet kryesisht në skriningun neonatal, i cili mat nivelet e hormonit stimulues të tiroides (TSH) dhe / ose tiroksinës (T4) në gjakun e foshnjës në ditën e dytë ose të tretë të jetës. Konfirmimi bëhet me analizat laboratorike të përsëritura dhe imazherinë e tiroides. Trajtimi është i bazuar në zëvendësimin hormonal me levotiroksinë, i cili duhet të nisë sa më shpejt, idealisht brenda dy javëve të para të jetës, për të parandaluar dëmtimet neurokognitive të përhershme.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të analizojë të dhënat ekzistuese shkencore mbi rëndësinë e skriningut neonatal për hipotiroidizmin kongenital, efektin e diagnostikimit dhe trajtimit me kohë mbi zhvillimin neurokognitiv të fëmijëve, pasojat afatgjata të mosdiagnostikimit apo trajtimit të vonuar të HK, rekomandimet aktuale ndërkombëtare mbi protokollet e skriningut dhe menaxhimit klinik.
Metodologjia: Ky punim është realizuar përmes një rishikimi të literaturës shkencore. Përzgjedhja e burimeve u krye në bazat e të dhënave ndërkombëtare si PubMed, Scopus dhe ScienceDirect.
Rezultate: Rezultatet e këtij punimi tregojnë se skriningu neonatal për hipotireozën kongjenitale është ndërhyrje kyçe për parandalimin e vonesave neurokognitive. Veçanërisht, në foshnjat premature dhe ato me peshë shumë të ulët në lindje, është dokumentuar rritje e vonuar e TSH - së që shpesh nuk detektohet në skriningun fillestar,

çka nënvizon nevojën për testime të përsëritura pas ditës së 30 të jetës. Evidenca shkencore tregon se fillimi i trajtimit me levotiroksinë brenda 14 ditëve të para të jetës është thelbësor për zhvillimin normal neurokognitiv. Po ashtu, përdorimi i dozave fillestare më të larta të L - tiroksinës është treguar si më efektive për të arritur rezultate më të mira kognitive. Programet e skriningut neonatal kanë eliminuar kryesisht aftësinë e kufizuar intelektuale të rëndë në hipotiroidizmin kongjenital. Pavarësisht ndërhyrjes së hershme dhe trajtimit adekuat, vazhdojnë të evidentohen deficite të lehta neurozhvillimore, si dhe një prevalencë më e lartë e ADHD - së dhe të vështirësive në të mësuar, krahasuar me popullatën e përgjithshme.

Fjalë kyçe: hipotiroidizmi kongjenital, skriningu neonatal, zbulimi i hershëm, T4, TSH, deficitet neurologjike.

KARAKTERISTIKAT KLINIKE DHE DEMOGRAFIKE TË MYASTHENIA GRAVIS NË SHQIPËRI.

Blerta Qazimllari[1, 3], Altin Kuqo[2], Jera Kruja[2, 3]
[1]*Spitali "Petro Nako", Sarandë, Shqipëri*
[2]*Qendra Universitare Spitalore "Nënë Teresa", Tirana, Shqipëri*
[3]*Universiti i Mjekësisë, Tirana, Shqipëri*

Abstrakt
Qëllimi: Analizimi i karakteristikave klinike dhe demografike të pacientëve të hospitalizuar me Miasteni Grave (MG), si dhe faktorët që ndikojnë në ecurinë e tyre.
Materiale dhe metoda: Ky është një studim retrospektiv me natyrë përshkruese i bazuar në të dhënat mjekësore të kartelave të hospitalizimit të pacientëve me MG në periudhën Janar 2019 - Dhjetor 2022. U mblodhën të dhënat mbi gjininë, moshën e debutimit të sëmundjes, simptomat prezantuese, rezultatet e testeve serologjike dhe të patologjisë së timusit, prania e sëmundjeve shoqëruese dhe ecuria klinike e pacientëve e përcaktuar sipas shkallës së klasifikimit klinik MGFA (Myasthenia Gravis Foundation of America). Analiza statistikore e regresionit multivariabël u realizua për të identifikuar faktorët që ndikojnë në ecurinë klinike të pacientëve.
Rezultate: Në studim u përfshinë 67 pacientë nga të cilët 44 pacientë diagnostikuar për herë të parë me MG gjatë periudhës kohore të shtrirjes së studimit. Predominon gjinia femër me 61. 2% të kampionit, me moshë më të hershme të fillimit të sëmundjes sesa meshkujt (42. 5 vs 50. 9 vjeç). 71. 6% e pacientëve janë seropozitive (53. 7% me parani të antitrupave anti - AchR dhe 17. 9% anti - MuSK) dhe 7. 5% seronegative. Patologjia e timusit u gjet në 26. 9% të pacientëve. Sëmundjet shoqëruese autoimune u gjetën në 13. 4% të pacientëve. Simptomat prezantuese okulare u raportuan në 46. 3% të pacientëve, ato bulbare në 29. 9% dhe të gjeneralizuara në 47. 8%. Simptomat prezantuese ndryshojnë në varësi të gjinisë dhe profilit serologjik. Gjinia, mosha e fillimit, simptomat debutuese të sëmundjes, profili serologjik dhe sëmundjet shoqëruese janë faktorë që ndikojnë në vonesën në diagnostikim. Pozitiviteti për antitrupat anti - MuSK shoqërohet me ditëqendrim më të gjatë në spital, nevojë më të madhe për trajtim me plazmaferezë dhe ecuri më të pafavorshme krahasuar me nëngrupet e tjera, si dhe është faktor sinjifikant dhe i pavarur i riskut për exitus ($p<0.01$).
Konkluzione: MG përbën më tepër një sindrom të karakterizuar nga nëngrupe me karakteristika klinike, demografike, serologjike dhe ecuri të ndryshme. Është e domosdoshme njohja e secilës prej këtyre karakteristikave dhe ndërlidhja ndërmjet tyre në menaxhimin sa më të mirë të pacientëve dhe parashikimin e ecurisë klinike.

Fjalë kyçe: MG, MGFA, antitrupa anti - MuSK, sëmundje autoimune.

SFIDAT KLINIKE DHE PSIKOLOGJIKE TË LIPEDEMËS: NDIKIMI I SAJ NË CILËSINË E JETËS.

Dr. Blertë Bibaj, Dr. Besim Durguti, Dr. Ronesa Derguti

Abstrakt
Hyrje: Ky punim paraqet një rishikim të literaturës mbi lipedemën, duke analizuar jo vetëm karakteristikat e saj klinike, por edhe ndikimin e thellë psikosocial dhe emocional që kjo sëmundje ushtron. Lipedema përshkruhet si një çrregullim kronik dhe progresiv i indit dhjamor nënlëkuror, që prek kryesisht gratë dhe shpesh ngatërrohet me obezitetin ose limfedemën. Përveç pasojave fizike si dhimbja, edema dhe kufizimi në

lëvizshmëri, lipedema ndikon drejtpërdrejt në shëndetin mendor të pacientëve, duke rritur ndjeshëm rrezikun për depresion, ankth, çrregullime të imazhit trupor, çrregullime të të ngrënit dhe deri në veprime suicidale. Studimet e fundit tregojnë se dhimbja kronike, stigma sociale, diagnozat e vonuara dhe mungesa e mbështetjes emocionale përbëjnë faktorë kyç që nxisin stresin psikologjik dhe vetëvlerësimin e ulët. Ky punim synon të theksojë nevojën që lipedema të trajtohet jo vetëm si sëmundje fizike, por si gjendje që prek rëndë mirëqenien emocionale dhe cilësinë e jetës së grave që vuajnë prej saj.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të rishikojë literaturën më të fundit mbi lipedemën dhe të theksojë ndikim e saj në shëndetin mendor.
Metodologjia: Ky punim është i llojit të shqyrtimit të literaturës. Për realizimin e këtij punimi janë marrë të dhënat më të reja duke shfrytëzuar literaturën elektronike e cila është ilustruar me figura dhe tabela të ndryshme dhe të gjitha janë listuar tek pjesa e referencave.
Përfundime: Lipedema është çrregullim i depozitimit të indit dhjamor, i cili dallon nga obeziteti për nga karakteristikat e saj. Ky çrregullim ka ndikim në aspektin fizik dhe emocional të pacientëve dhe shoqërohet me simptoma fizike si dhimbja, lodhja, ndjeshmëria e rritur, edema dhe ato psikike si depresioni, ankthi, çrregullimi i imazhit dhe vlerësimit të vetvetes.

Fjalë kyçe: Lipedema, depresioni, ankthi, dhimbja kronike, cilësia e jetës.

MENAXHIMI I HIPOTIROIDIZMIT REZISTENT NDAJ TRAJTIMIT.

Blertina Dyrmishi
Western Balkans University, Tirana, Albania
Hygeia Hospital Tirana

Abstrakt
Hyrje: Hipotiroidizmi trajtohet me terapi orale me levotiroksinë. Megjithatë, një grup pacientësh vazhdon të shfaqë simptoma të hipotiroidizmit dhe nivele të larta të TSH - së, pavarësisht dozave në rritje të medikamentit: kjo gjendje njihet si hipotiroidizëm rezistent ndaj trajtimit.
Qëllimi: Të eksplorohen shkaqet themelore të rezistencës ndaj terapisë standarde me levothyroxine dhe të vlerësohen strategjitë alternative të trajtimit për të optimizuar rezultatet klinike.
Metodologjia: Rishikimi i evidencës klinike nxjerr në pah faktorë si mungesa e përkushtimit ndaj trajtimit, ndërveprimet medikament - ushqim, malabsorbimi gastrointestinal dhe metabolizimi i përshpejtuar i levotiroksinës. Qasjet diagnostike përfshijnë testimin e absorbimit të levotiroksinës nën mbikëqyrje dhe vlerësimin e substancave ndërhyrëse. Terapitë e reja, administrimi parenteral kanë treguar rezultate premtuese në përmirësimin e kontrollit biokimik dhe përkushtimit të pacientit.
Rezultate: Studimet tregojnë se në rastet e pacientëve me nivele të larta të vazhdueshme të TSH, pavarësishtë trajtimit me levothyroxine, para se të mendohet dhe eksplorohet për malabsorbim, duhet përjashtuar edhe mungesa e aderencës nga pacienti. Gjithashtu, marrja e medikamentit në kohë të përshtatshme në raport me ushqimin dhe shmangia e agjentëve ndërhyrës (p. sh. , kalcium, hekur, fibra, kafe) përmirëson absorbimin e medikamentit.
Përfundime: Menaxhimi efektiv i hipotiroidizmit rezistent kërkon një qasje të shumëanshme, duke përfshirë edukimin e pacientit, regjime të personalizuara dozimi dhe shqyrtimin e metodave alternative të administrimit. Testi i absorbimit të T4 është i nevojshëm të përdoret për të përjashtuar diagnozën e pseudomalabsorbimit. Strategjitë e personalizuara mund të rikthejnë eutiroidizmin dhe të përmirësojnë cilësinë e jetës së individëve të prekur.

Fjalë kyçe: Hypotiroidizmi rezitent, pseudomalabsorbim, levothyroxine.

MUNGESA E EDUKIMIT INTERPROFESIONAL NË SHËNDETËSI: SFIDË STRUKTURORE PËR ZHVILLIMIN PROFESIONAL TË INTEGRUAR.

Blerton Mulliqi

Abstrakt

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional për profesionistët shëndetësorë është domosdoshmëri për sistemet moderne të kujdesit shëndetësor. Në Kosovë dhe rajonin e Ballkanit, edukimi profesional shpesh zhvillohet në mënyrë të fragmentuar brenda disiplinave të veçanta, duke anashkaluar përfshirjen ndërdisiplinare. Kjo pengon zhvillimin e kapaciteteve kolektive dhe krijimin e ekipeve të bashkërenduara në praktikën klinike. Qëllimi i këtij punimi është të analizojë ndikimin e mungesës së edukimit interprofesional në zhvillimin profesional të integruar dhe nevojën për reforma në trajnimet e vazhdueshme. Përmes një analize krahasuese të literaturës ndërkombëtare dhe realitetit lokal, tregohet se mungesa e trajnimeve ndërdisiplinare kontribuon në izolim profesional, rritje të gabimeve në komunikim dhe vendimmarrje jo - koordinuese në kujdesin ndaj pacientit. Krijimi i moduleve të përbashkëta, mbështetja institucionale dhe ndryshimet në kurrikula janë hapa kyç për një zhvillim profesional më të integruar dhe të qëndrueshëm. Pa bashkëpunim dhe trajnime të përbashkëta, zhvillimi profesional mbetet i fragmentuar dhe me ndikim të kufizuar në cilësinë e kujdesit ndaj pacientit.

Fjalë kyçe: Mungesë e edukimit, zhvillim profesional.

INFLAMACIONI DHE SËMUNDJET KARDIOVASKULARE: NGA MEKANIZMAT PATOFIZIOLOGJIKË TE QASJET TERAPEUTIKE.

Dr. Blond Latifi - MD

Abstrakt

Qëllimi: Ky punim synon të ofrojë një rishikim të thelluar mbi rolin qendror të inflamacionit në patogjenezën e sëmundjeve kardiovaskulare, me fokus të veçantë në mekanizmat molekularë dhe qelizorë që ndërmjetësojnë lidhjen midis inflamacionit dhe aterosklerozës. Gjithashtu, shqyrtohet potenciali terapeutik i ndërhyrjeve anti - inflamatore në reduktimin e riskut kardiovaskular, si pjesë e strategjive të avancuara për parandalimin sekondar.
Materiale dhe Metedologjia: Ky është një rishikim narrativ i literaturës bashkëkohore shkencore, që përfshin studime laboratorike, prova klinike të randomizuara, meta - analiza dhe rishikime sistematike. Vëmendje e veçantë i kushtohet biomarkerëve inflamatorë si interleukina - 6 (IL - 6), faktori nekrotizues i tumorit alfa (TNF - α) dhe proteina C - reaktive me sensibilitet të lartë (hs - CRP), të cilët janë të lidhur ngushtë me incidencën dhe rikthimin e ngjarjeve kardiovaskulare.
Rezultate: Inflamacioni është i përfshirë në të gjitha fazat e procesit aterosklerotik–nga disfunksioni endotelial dhe infiltrimi i qelizave imune, deri te formimi, rritja dhe destabilizimi i pllakës. Terapitë e synuara që ndërhyjnë në rrugët inflamatore, si inhibitorët e IL - 1β dhe kolkicina, kanë treguar reduktim të ndjeshëm të ngjarjeve kardiovaskulare tek pacientët me inflamacion aktiv dhe rrezik të mbetur, përtej niveleve të lipideve.
Përfundime: Inflamacioni nuk është vetëm një faktor shoqërues, por një mekanizëm drejtues në zhvillimin dhe përparimin e aterosklerozës. Terapitë anti - inflamatore paraqesin një qasje premtuese për reduktimin e riskut kardiovaskular dhe mund të përbëjnë një shtesë të vlefshme ndaj trajtimeve standarde.

Fjalë kyçe: inflamacion; aterosklerozë; sëmundje kardiovaskulare; biomarkerë; terapia anti - inflamatore.

KANCERI I GJIRIT TEK MESHKUJT.

Borjana Jahaj, Helidon Nina, Gerta Elezaj, Mauricia Kuci
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Kanceri i gjirit te meshkujt është një patologji e rrallë, duke përbërë rreth 1% të të gjitha rasteve të tumoreve te meshkujt dhe 1% të rasteve totale me kancer gjiri në të dyja gjinitë. Në Amerikë numërohen rreth 2000 raste në vit, kurse në vendin tonë 10–15 raste. Strategjitë e trajtimit në këtë subgrup janë marrë duke

inkorporuar atë të kancerit të gjirit te femrat, duke qenë se s'ka të dhëna të mbledhura apo studime të randomizuara mjaftueshëm në këtë subgrup. Mosha mesatare e prekjes është 75 vjeç.
Materiale dhe Metoda: Ne kemi analizuar të dhënat dhe rishikimin e literaturës nga punimet e ndryshme rreth trajtimit multidisiplinar dhe të dhëna specifike në këtë subgrup, tre viteve të fundit, me diagnozë të konfirmuar në core - biopsi. Në vitin 2022 në qendrën tonë kanë qenë gjithsej 815 pacientë me kancer gjiri, nga të cilët 15 pacientë janë meshkuj, në 2023: 807 raste të reja dhe 14 raste meshkuj, në 2024: 780 raste nga të cilat 12 raste meshkuj, dhe nga janari deri më sot në 2025 kemi 9 raste. U vu re se 90% e rasteve janë stade lokalisht të avancuara që i janë nënshtruar gjithë modaliteteve të trajtimit.
Rezultate: Shumica e pacientëve paraqiten si LABC në vendin tonë. Nga mbledhjet retrospektive të të dhënave rezultoi se 90% e rasteve janë ER pozitive dhe 80% janë PgR pozitive. AR nuk është e paraqitur në raportin e biopsisë. Përsa i përket Her2, në 10% të rasteve është pozitiv, dmth më i ulët se tek femrat, dhe Ki67 vërehet se varion dhe rreth 20% e rasteve janë me Ki67 më të lartë se 20%. Statusi nodal mbetet një faktor prognostik shumë i rëndësishëm ku në 85% të rasteve rezultojnë N+. Shumica e rasteve në literaturë dhe në vendin tonë janë me biopsi karcinoma duktale infiltrative ku persiston G2. 90% janë subgrupi i luminal B, 10% janë Her2 overexpressed dhe 1 rast TNBC.
Konkluzione: Në vendin tonë nuk ka të dhëna rreth biologjisë molekulare në këtë subgrup apo mbi faktorët dhe shkaqet e sëmundjes. Modalitetet kryesore të trajtimit janë kirurgjia ku persiston mastektomia, RT dhe KT sipas linjave udhëzuese të njëjta me ato të kancerit të gjirit te femrat, duke qenë se të dhënat janë të limituara. Endokrino terapia e preferuar është ajo me tamoxifen, ndërsa përsa i përket agjentëve mbrojtës të kockave, ka treguar që s'kanë efikasitet si trajtim adjuvant.

Fjalë kyçe: Kanceri i gjirit, meshkuj, patologji e rrallë, tumor, mastektomia.

KORELACIONI MIDIS NIVELEVE TË GLUKOZËS NË GJAK DHE ÇEKUILIBRIT TË ELEKTROLITEVE TEK PACIENTËT DIABETIKË.

Msc. Brandi Fahriu[1], Doc. Elona Hasalla[2], Phd. Ilda Taka[2], Msc. Xhoana Shusha[2], Msc. Klajdi Tarko[2], Msc. Nertila Luri[2]
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan.
Fakulteti i Shkencave Mjëksore Teknike, Teknikë Laboratori; Universiteti i Mjeksisë Tiranë.
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike; Intermedica.
Departamenti i Lëndëve Paraklinike, Departamenti i Specialiteteve Mjekësore Teknike.
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Fakulteti i Mjeksisë Dentare Tiranë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Abstrakt
Hyrje: Diabeti mellitus është një çrregullim kronik metabolik që karakterizohet nga hiperglicemia e vazhdueshme, e cila ndikon në shumë sisteme të organizmit, përfshirë edhe balancën elektrolitike. Hiperglicemia shkakton ndryshime në ekuilibrin osmolar, çon në humbje të ujit dhe elektroliteve përmes diurezës osmotike dhe ndikon në funksionet jetësore si ato kardiake dhe neuromuskulare. Çrregullimet më të shpeshta përfshijnë hiponatremi relative dhe luhatje të nivelit të kaliumit, të cilat në mungesë të monitorimit të kujdesshëm mund të çojnë në komplikacione serioze metabolike.
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë marrëdhënien ndërmjet niveleve të glukozës në gjak dhe çekuilibrit të elektroliteve (Na^+, K^+, Cl^-) tek pacientët diabetikë, si dhe të nënvizojë rëndësinë klinike të monitorimit të tyre në parandalimin e komplikacioneve akute metabolike.
Materiali dhe Metoda: Në këtë studim u përfshinë pacientë të diagnostikuar me diabet mellitus, të cilëve iu kryen analiza laboratorike rutinë. Për çdo pacient u matën nivelet e glukozës esëll në gjak dhe elektrolitet serike (natriumi, kaliumi dhe klori) duke përdorur metodën spektrofotometrike dhe analizues automatik biokimik. Të dhënat u përpunuan statistikisht për të vlerësuar lidhjen midis hiperglicemisë dhe çekuilibrit elektrolitik.
Rezultate: Nga analizimi i të dhënave u vu re një korrelacion negativ midis niveleve të glukozës dhe natriumit serik, që tregon tendencë drejt hiponatremisë në pacientët me hiperglicemi. Gjithashtu, u identifikuan luhatje të dukshme të kaliumit, të cilat lidhen me statusin hidratues dhe metabolik të pacientëve diabetikë. Ndryshimet në nivelet e klorit ishin më të lehta, por të pranishme në raste me hiperglicemi të theksuar. Rezultatet mbështesin idenë se çekuilibri elektrolitik është i lidhur ngushtë me kontrollin e glicemisë.

Fjalë kyçe: diabeti mellitus, glukoza në gjak, elektrolitet, hiperglicemia.

KOMPLIKACIONET TORAKALE TË TRAKEOTOMISË PERKUTANE: RISHIKIM KLINIK DHE VLERËSIM DIAGNOSTIK.

Dr. Brikena Danaj, Spitali Universtar i Traumes, Departamenti ORL, Prof. Dr. Fadil Gradica
Spitali Universitar Shefqet Ndroqi, Departamenti i Kirurgjise Torakale.

Abstrakt

Hyrje: Trakeotomia perkutane është një teknikë gjerësisht e përdorur në kujdesin intensiv në Spitalin e Traumës, me përfitime të njohura në krahasim me trakeotominë kirurgjikale, si invazivitet më i ulët dhe kohë më e shkurtër procedurale. Megjithatë, ajo mbart rreziqe të caktuara, përfshirë komplikacione të rralla, por serioze torakale.

Qëllimi: Të shqyrtohen komplikacionet torakale të lidhura me trakeotominë perkutane dhe të vlerësohet roli i diagnostikimit të hershëm përmes imazherisë në reduktimin e pasojave klinike.

Materiale dhe Metoda: U realizua një rishikim retrospektiv i rasteve të trakeotomisë perkutane të kryera në shërbimin e kujdesit intensiv të Spitalit të Traumës, gjatë periudhës janar 2024 - shtator 2025. U analizuan të dhënat për prezencën e komplikacioneve torakale (pneumotoraks, hemotoraks, emfizemë subkutane) dhe metoda e diagnostikimit.

Rezultate: Nga 124 raste të trakeotomisë perkutane, 9 pacientë (7. 2%) zhvilluan komplikacione torakale, ku pneumotoraksi ishte më i shpeshti (4. 8%). Në të gjitha rastet, komplikacionet u diagnostikuan përmes radiografisë torakale ose CT - scan. Ndërhyrja e menjëhershme përmes drenazhit torakal ishte e nevojshme në 5 raste. Nuk u raportuan raste me mortalitet të lidhur direkt me këto komplikacione.

Përfundime: Komplikacionet torakale të trakeotomisë perkutane, megjithëse jo të shpeshta, kërkojnë vëmendje të veçantë për shkak të potencialit për përkeqësim të shpejtë klinik. Monitorimi i kujdesshëm post - procedural dhe përdorimi rutinë i imazherisë janë kyçe për diagnozën dhe menaxhimin e hershëm.

Fjalë kyçe: trakeotomia perkutane, komplikacione torakale, pneumotoraks, kujdes intensiv, diagnostikim imazherik.

SINDROMA SJOGREN NË PACIENTËT ME LUPUS ERITEMATOS SISTEMIK.

Dr. Brikena Selimi, Prof Asc. Artur Zoto
QSUNT

Abstrakt

Hyrje: Sindroma Sjogren dhe Lupusi janë sëmundje autoimune të cilat mund të shfaqen si bashkëshoqëruese të njëra - tjetrës, ku sindroma Sjogren mund të jetë primare ose si rezultat i Lupusit.

Qëllimi: Prevalenca e Sindromit Sjogren në pacientët e diagnostikuar me Lupus.

Materiale dhe Metoda: Janë marrë në studim dhe janë vlerësuar 85 paciente me Lupus të cilët plotësonin kriteret e diagnozës në bazë të ACR dhe EULAR. Pacientët janë konsultuar me Okulistin dhe diagnoza e Sindromit Sjogren është vendosur në bazë të kritereve të përcaktuara nga AECG. Janë përjashtuar nga studimi të gjithë ata paciente të cilët kishin patologji bashkëshoqëruese ose merrnin medikamente të cilat alteronin ekzaminimin e syve.

Rezultate: 81 (95, 3 %) paciente ishin femra dhe 4 (4, 7%) meshkuj. Mosha mesatare e pacienteve ishte 46 vjeç, kohezgjatja e sëmundjes ishte mesatarisht 8 vite. Nga 81 paciente vetëm 16 (18, 8%) paciente plotësuan kriteret e Sindromit Sjogren dhe të gjitha ishin femra.

Konkluzione: Prevalenca e sindromit Sjogren në pacientët me Lupus ishte 18, 8 %. Shfaqet shumë më shpesh te femrat të cilat kishin më shumë vite me Lupus si dhe aktivitet të sëmundjes.

Fjalë kyçe: Sjogren, lupus, sindromë.

“KURTHET” DHE SFIDAT DIAGNOSTIKE NË KUJDESIN AKUT PARASPITALOR: MËSIME NGA TERRENI.

Brita Collaku

Abstrakt

Hyrje: Në kujdesin akut paraspitalor, mungesa e mjeteve diagnostike si imazheria dhe analizat laboratorike e detyron mjekun të mbështetet në gjykim të shpejtë klinik. Kjo shpesh çon në gabime diagnostike, të cilat bëhen të dukshme pas pranimit në spital.

Objektivi: Të analizohet shpeshtësia dhe shkaqet e gabimeve diagnostike në kujdesin emergjent paraspitalor dhe të theksohen strategjitë që mund të përmirësojnë saktësinë diagnostike në kushte me resurse të kufizuara.

Metoda: U analizuan rastet dhe literatura mbi gabimet e shpeshta, veçanërisht tek sindroma koronare akute, goditja në tru, pneumotoraksi, embolia pulmonare dhe sepsa.

Rezultate: Gjetjet sugjerojnë se shkaqet më të shpeshta të gabimeve diagnostike përfshijnë simptomatologjinë e mbivendosur, presionin kohor, mungesën e historisë së plotë të pacientit dhe mungesën e mjeteve diagnostike në terren. Strategjitë që reduktojnë normën e gabimeve përfshijnë përdorimin e protokolleve të strukturuara të vlerësimit, integrimin e mjeteve të lëvizshme diagnostike (EKG, ultrazë portativ), trajnimin e vazhdueshëm dhe përmirësimin e komunikimit me ekipet spitalore.

Përfundime: Gjetjet sugjerojnë se shkaqet më të shpeshta të gabimeve diagnostike përfshijnë simptomatologjinë e mbivendosur, presionin kohor, mungesën e historisë së plotë të pacientit dhe mungesën e mjeteve diagnostike në terren. Strategjitë që reduktojnë normën e gabimeve përfshijnë përdorimin e protokolleve të strukturuara të vlerësimit, integrimin e mjeteve të lëvizshme diagnostike (EKG, ultrazë portativ), trajnimin e vazhdueshëm dhe përmirësimin e komunikimit me ekipet spitalore.

Fjalë kyçe: imazheri, kujdes, paraspitalor etj.

DEPISTIMI NEONATAL NË SHQIPËRI, ME FOKUS NË ELBASAN.

Dr. Brunilda Mëhilli[1], Anila Rrupulli2, Jonila Cela[3], Figali Topi[4], Dr. Zamira Çabiri[5]

[1]*Mjeke laboratori klinik - biokimik, Lektore, Universiteti I Elbasanit “A. Xhuvani”, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Departamenti i Lëndëve Klinike*

[2]*Endokrinologe, Qendra Spitalore "Xhaferr Kongoli", Elbasan, Asistente lektore, Universiteti i Elbasanit, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike*

[3]*PhD Candidate, Gastro Hepatologe, Universiteti I Elbasanit “A. Xhuvani”, Fakulteti i Shkencave Mjeksore Teknike, Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore*

[4]*Menaxhere, lektore, Universiteti i Elbasanit “A. Xhuvani”, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Departamenti i Marketingut dhe Inxhinierisë*

[5]*Mjeke, Lektore Universiteti i Elbasanit “A. Xhuvani”, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Departamenti i Lëndëve Klinike, Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore*

Abstrakt

Hyrje: Depistimi neonatal është një komponent thelbësor i kujdesit të hershëm për foshnjat, i cili synon të identifikojë dhe trajtojë në kohë të hershme çrregullimet kongenitale, humbjen e dëgjimit dhe çrregullimet metabolike. Identifikimi i hershëm i këtyre gjendjeve përmirëson ndjeshëm rezultatet e trajtimit, redukton morbiditetin dhe mortalitetin dhe përmirëson shëndetin dhe zhvillimin afatgjatë të foshnjës. Në Shqipëri, programet e depistimit neonatal janë implementuar për disa dekada, duke u fokusuar kryesisht në hipotiroidizmin kongenital dhe fenilketonurinë. Gjatë viteve të fundit janë zhvilluar edhe iniciativa pilote për depistimin e dëgjimit tek të porsalindurit, me qëllim identifikimin e hershëm të deficiteve auditive.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të përmbledhë të dhënat e disponueshme për Maternitetin e Elbasanit dhe të ofrojë një kontekst kombëtar mbi depistimin neonatal në Shqipëri.

Metodat dhe rezultate: Të dhënat u morën nga raportet publike të Institutit të Shëndetit Publik (ISHP), studime të publikuara mbi implementimin e newborn hearing screening dhe statistika lokale. Analiza përfshiu numrin e lindjeve, prevalencën e anomalive kongenitale, mbulimin e programeve pilote dhe vdekshmërinë neonatale. Rezultatet tregojnë se Materniteti i Elbasanit regjistroi rreth 950 lindje në vitin 2023. Sipas survejimit kombëtar, prevalenca e anomalive kongenitale gjatë periudhës 2010–2013 ishte 7. 6 / 1000 lindje, ndërsa një studim rajonal aktiv për periudhën 2007–2012 raportoi vlera më të larta, 18. 4–24. 6 / 1000 lindje. Programet pilote të “newborn

hearing screening" përfshinë katër maternitetet kryesore të vendit, duke arritur një mbulim prej 96. 6%; megjithatë, Elbasani nuk ishte përfshirë në fazën pilote, duke lënë një boshllëk të rëndësishëm në të dhënat e përditësuara. Vdekshmëria neonatale në Elbasan, sipas buletineve të ISHP, ishte rreth 5 / 1000 lindje.
Përfundime: Diskutimi thekson nevojën urgjente për një sistem të unifikuar raportimi dhe përfshirjen e Elbasanit në programet kombëtare të ardhshme për të siguruar mbulim universal dhe monitorim të saktë të rezultateve. Plotësimi i boshllëqeve të të dhënave është i domosdoshëm për përmirësimin e cilësisë së kujdesit neonatal, udhëzimin e politikave shëndetësore dhe planifikimin e ndërhyrjeve të synuara. Ky studim nënvizon rëndësinë kritike të programeve gjithëpërfshirëse të depistimit për identifikimin e hershëm, trajtimin dhe përmirësimin e shëndetit afatgjatë të të porsalindurve në Elbasan dhe në Shqipëri.

Fjalë kyçe: Depistimi neonatal, anomalitë kongenitale, newborn hearing screening, Elbasan, Shqipëri.

VETËKUJDESI DHE PËRCAKTUESIT DEMOGRAFIKË TEK PACIENTËT ME SËMUNDJE KRONIKE NË KUJDESIN PARËSOR SHËNDETËSOR NË SHQIPËRI.

Brunilda Sherri[1,2], Silvana Gripshi[3]
[1]Studente e Masterit në Programin e Infermierisë, Universiteti "Western Balkans", Shqipëri
[2]Qendra e Kujdesit Parësor Shëndetësor Nr. 7, Durrës, Shqipëri
[3]Udhëheqëse Shkencore, Departamenti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti "Western Balkans", Shqipëri

Abstrakt
Hyrje: Sëmundjet kronike përbëjnë një barrë të rëndësishme për sistemet shëndetësore në mbarë botën, duke kërkuar angazhim të vazhdueshëm në vetëkujdes për të parandaluar komplikacionet. Në Shqipëri, ekziston një mungesë e dukshme e evidencave mbi ndikimin e faktorëve demografikë në vetëkujdesin e pacientëve në kujdesin parësor.
Qëllimi: Të vlerësohet niveli i vetëkujdesit tek pacientët me sëmundje kronike në qendrat e kujdesit parësor në Durrës dhe të analizohet ndikimi i gjinisë, moshës, arsimit dhe të ardhurave në këto praktika.
Metodologjia: Studimi u realizua në dy qendra të kujdesit parësor në Durrës, me pjesëmarrjen e 100 pacientëve (≥18 vjeç) të cilët kanë sëmundje kronike të konfirmuar dhe janë ndjekur rregullisht gjatë tre muajve të fundit. Të dhënat u mblodhën nga 5–20 maj 2025, duke përdorur instrumentin e validuar Self - Care of Chronic Illness Inventory (SC - CII) në versionin shqip. Analiza u krye me SPSS v. 25 duke përdorur statistika përshkruese, testin chi - square dhe regresionin $p < 0.05$.
Rezultate: Mosha tregoi një lidhje të fortë pozitive me vetëkujdesin ($r = 0.62$, $p < 0.001$); pacientët më të moshuar respektonin më shumë praktikat shëndetësore. Diferencat gjinore ishin domethënëse ($t = 4.25$, $p < 0.001$), ku gratë demonstruan sjellje më të mira vetëkujdesi. Të ardhurat kishin korrelacion pozitiv ($t = 2.36$, $p = 0.020$), ndërsa arsimi nuk tregoi efekt të rëndësishëm. Këto gjetje përputhen me literaturën ndërkombëtare për moshën, gjininë dhe të ardhurat, por ndryshojnë për arsimin, duke reflektuar kontekstin socio - kulturor shqiptar.
Përfundime: Faktorët demografikë ndikojnë ndjeshëm në vetëkujdesin e pacientëve në kujdesin parësor shqiptar. Nevojiten ndërhyrje dhe politika të përshtatura për të reduktuar pabarazitë dhe për të mbështetur praktika gjithëpërfshirëse vetëkujdesi. Ky studim kontribuon në literaturën kombëtare të shëndetit publik dhe thekson prioritetet për programe edukimi dhe ndërgjegjësimi.

Fjalë kyçe: Sëmundje kronike, menaxhimi i sëmundjeve, edukim shëndetësor, vetëkujdes, kujdesi parësor në Shqipëri.

USHQYERJA DHE SHËNDETI MENDOR.

Msc. Bukurie Hyseni[1]; Prof. Asc. Adrian Hoxha[2]
[1]Drejtoria Qendrore, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, NAPH
[2]Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, NAPH

Abstrakt
Hyrje: Mënyra e të ushqyerit ndikon ndjeshëm jo vetëm në mirëqënien fizike, por edhe në mirëqënien mendore,

veçanërisht gjatë periudhës së adoleshencës. Studimet bashkëkohore evidentojnë lidhje të forta midis zakoneve ushqimore dhe çrregullimeve emocionale si ankthi dhe depresioni. Adoleshentët përbëjnë një grup - moshë veçanërisht të ndjeshme, e cila shpesh nuk ndjek një dietë të shëndetshme, gjë që ndikon negativisht në shëndetin e tyre mendor.
Qëllimi: Ky studim synon të identifikojë lidhjen midis stilit të jetesës, ushqyerjes dhe shëndetit mendor tek adoleshentët e moshës 13–15 vjeç, në disa shkolla 9 - vjeçare të Tiranës.
Metoda: Në këtë studim transversal u administruan 300 pyetësorë vetëplotësues në tre shkolla ("Servete Maçi", "Andrea Stefani", "28 Nëntori"). Të dhënat u analizuan për të vlerësuar lidhjet midis zakoneve ushqimore, treguesve truporë (BMI) dhe ndjenjave emocionale të ankthit, trishtimit dhe lodhjes.
Rezultate: 22% e pjesëmarrësve kishin BMI normale, 44% ishin nën peshë dhe 35% mbipeshë. 91% konsumonin ushqime të shpejta mbi dy herë në javë, ndërsa 87% konsumonin ushqime të ëmbla me të njëjtën shpeshtësi. Adoleshentët që konsumonin shpesh ushqime të shpejta raportuan nivele më të larta ankthi, ndërsa ata që konsumonin më shumë ëmbëlsira shfaqnin shenja më të theksuara trishtimi. 38% e pjesëmarrësve deklaruan se nuk kanë marrë asnjëherë këshillim nga personeli shëndetësor i shkollës.
Konkluzione: Të dhënat tregojnë një lidhje të qartë midis mënyrës së ushqyerjes dhe gjendjes emocionale tek adoleshentët. Ndërhyrjet edukative dhe përfshirja më aktive e personelit shëndetësor në shkolla janë të domosdoshme për të promovuar zakone të shëndetshme ushqimore dhe mirëqenie mendore.

Fjalë kyçe: ushqyerja, shëndeti mendor, adoleshentët.

OBEZITETI DHE KEQUSHQYERJA NË KOSOVË DHE BALLKAN: PREVALENCA, KRAHASIME DHE FAKTORË.
Burim Lumi

Abstrakt
Hyrje: Obeziteti dhe kequshqyerja përbëjnë një nga barrat më të mëdha të dyfishta të shëndetit publik global, me tendenca veçanërisht shqetësuese në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme si Kosova dhe shtetet e tjera të Ballkanit. Kjo bashkëjetesë e tepricës dhe mungesës ushqimore, e njohur si "barra e dyfishtë e kequshqyerjes", pasqyron ndryshime të thella socio - ekonomike, urbanizim të shpejtë, ndikimin e dietave perëndimore dhe uljen e aktivitetit fizik. Në rajonin e Ballkanit, fenomeni përkeqësohet nga qasja e pabarabartë në kujdesin shëndetësor, mungesa e edukimit ushqimor dhe pabarazitë e vazhdueshme ekonomike. Ndërkohë që nënushqyerja ka shënuar një rënie graduale gjatë dekadave të fundit, normat e obezitetit dhe mbipeshës janë rritur ndjeshëm, veçanërisht në mesin e fëmijëve dhe popullatave urbane.
Qëllimi: Ky punim synon të ofrojë një përmbledhje gjithëpërfshirëse të provave shkencore më të fundit që lidhen me prevalencën, faktorët përcaktues dhe ndryshimet rajonale të mbipeshës, obezitetit dhe kequshqyerjes në Kosovë, Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbi. Gjithashtu, synon të identifikojë faktorët socio - demografikë dhe të stilit të jetesës që ndikojnë në këto trende dhe të theksojë nevojën për strategji të koordinuara të shëndetit publik në rajon.
Metodologjia: U realizua një rishikim sistematik i literaturës përmes bazave të të dhënave shkencore si PubMed, Scopus, Google Scholar dhe ResearchGate. Kriteret e përfshirjes u fokusuan në studimet e rishikuara nga kolegët, të publikuara gjatë periudhës 2010–2025, të cilat vlerësuan statusin ushqimor përmes treguesve antropometrikë si BMI sipas moshës, gjatësia për moshë dhe pesha për moshë, së bashku me faktorët sjellorë dhe socio - ekonomikë. Të dhënat krahasuese rajonale u siguruan gjithashtu nga platformat ndërkombëtare statistikore si CEIC Data dhe UNICEF.
Rezultate: Në bazë të literaturës së shqyrtuar, prevalenca e mbipeshës dhe obezitetit në Kosovë dhe vendet fqinje tregon një trend të vazhdueshëm në rritje. Në Kosovë, gjetjet e fundit tregojnë se rreth 68% e të rriturve janë mbi peshë ose obezë, me përqindje më të lartë obeziteti tek gratë (31. 9%) dhe tek individët mbi 60 vjeç. Niveli arsimor, statusi i punësimit dhe banimi urban u identifikuan si faktorë parashikues të rëndësishëm të obezitetit, duke dëshmuar lidhjen e fortë të tij me determinantët socialë dhe të stilit të jetesës. Tek fëmijët, studimet raportojnë deri në 9% mbipeshë dhe 2–3% obezitet, në përputhje me trendet e vërejtura në popullatat e tjera ballkanike. Kequshqyerja akute, ndonëse më e ulët se në dekadat e kaluara, mbetet e pranishme tek fëmijët parashkollorë, veçanërisht në zonat me kushte të pafavorshme ekonomike. Krahasimet me Shqipërinë, Malin e Zi dhe Serbinë tregojnë modele të ngjashme, me ndryshime të vogla gjinore, por me dominim të qartë të zonave urbane. Për më tepër, obeziteti në adoleshencë shpesh shoqërohet me kapacitet aerobik të ulët dhe

përqindje më të lartë dhjami trupor, duke sugjeruar ndikime fiziologjike të hershme dhe rrezik të shtuar për sëmundje kardiovaskulare në të ardhmen.
Përfundime: Barra e dyfishtë e obezitetit dhe kequshqyerjes në Kosovë dhe Ballkan përfaqëson një sfidë urgjente dhe komplekse për shëndetin publik. Kërkohet një qasje parandaluese dhe shumësektoriale, që përfshin programe ushqimore në shkolla, edukim masiv për stilin e shëndetshëm të jetesës dhe ndërhyrje në nivel komunitar që promovojnë dieta të balancuara dhe aktivitet fizik të rregullt. Duhet të krijohen sisteme afatgjata monitorimi për treguesit antropometrikë dhe dietikë, të cilat do të drejtojnë politikat shëndetësore dhe do të mundësojnë vlerësimin e progresit. Zgjidhja e kësaj epidemie të dyfishtë kërkon integrimin e politikave të arsimit, shëndetësisë, bujqësisë dhe planifikimit urban, për të krijuar mjedise që mbështesin ushqyerje të shëndetshme, të qëndrueshme dhe të barabartë për të gjitha grupmoshat.

Fjalë kyçe: obeziteti, kequshqyerja, mbipesha, prevalenca, Kosova, Ballkani, shëndeti publik, tranzicioni ushqimor, faktorët e stilit të jetesës, determinantët socio - ekonomikë.

ANALIZA E DUHANPIRJES NË MESIN E SHTATËZËNAVE.

Butrint Avdiu

Abstrakt
Hyrje: Pirja e duhanit gjatë shtatzënisë mbetet një problem i rëndësishëm i shëndetit publik, duke paraqitur rreziqe serioze për shëndetin e nënës dhe zhvillimin e fetusit. Në rajonin e Ballkanit, prevalenca arrin deri në 25%, duke e bërë atë një sfidë të theksuar shëndetësore.
Metodologjia: Është realizuar një rishikim i gjerë i literaturës përmes databazave ndërkombëtare (PubMed, Web of Science) dhe raporteve të OBSH - së, duke përfshirë mbi 50 studime longitudinale dhe meta - analiza.
Rezultate: Duhanpirja gjatë shtatzënisë zvogëlon furnizimin me oksigjen dhe ushqyes, duke rritur rrezikun për peshë të ulët në lindje, lindje të parakohshme dhe sindromën e vdekjes së papritur të foshnjës (SIDS). Ekspozimi prenatal lidhet me deficite neurokognitive, obezitet dhe rritje të rrezikut për diabet tip 2 dhe sëmundje kardiovaskulare në moshë të re. Tek nënat, shtohet rreziku për pre - eklampsi, abort spontan dhe çrregullime psiko - emocionale.
Përfundime: Evidencat tregojnë se edukimi para shtatzënisë, programet ndërgjegjësuese dhe politikat anti - duhan janë efikase në uljen e prevalencës së duhanpirjes gjatë shtatzënisë. Promovimi i një shtatzënie pa duhan është thelbësor për përmirësimin e shëndetit të nënës dhe brezave të ardhshëm.

Fjalë kyçe: Pirja e duhanit, shtatzëni, rreziqe.

PENGESAT DHE MUNDËSITË PËR KËRKIME ME TË DHËNA ELEKTRONIKE SHËNDETËSORE.

Dafina Luzha

Abstrakt
Hyrje: Të dhënat elektronike shëndetësore po transformojnë kërkimet shkencore, duke përmirësuar cilësinë, rritur efikasitetin dhe optimizuar dizajnin e studimeve observuese dhe eksperimentale. Identifikimi i pacientëve relevant, zvogëlimi i shpenzimeve, kursimi i kohës dhe rritja e sigurisë shëndetësore të popullatës pjesmarrëse në studim paraqesin përparësi në krahasim me zhvillimin tradicional të kërkimeve, ku bartja manuale e të dhënave nga regjistrat në letër është më e lodhshme, kërkon më shumë kohë dhe lë hapësirë për gabime teknike. Megjithatë, duhet të adresohen sfidat ligjore, teknike dhe etike si privatësia dhe marrja e pëlqimit mjekësorë. Ndërveprueshmëria dhe standardizimi janë të domosdoshme për përdorimin efikas të të dhënave elektronike në kërkimet mjekësore.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është që përmes rishikimit të literaturës, të theksohet rëndësia e përdorimit të të dhënave elektronike shëndetësore për kërkime klinike, mundësitë e shfrytëzimit të tyre dhe sfidat që paraqiten gjatë punimit me to.

Metodologjia: Ky punim është realizuar me metodën e rishikimit të literaturës ekzistuese në databazat kryesore shkencore si PubMed, ResearchGate, Google Scholar dhe Scopus si dhe literaturë tjetër ku janë shfrytëzuar bazat e të dhënave, figurat dhe tabelat.
Rezultate: Hulumtimet tregojnë se përdorimi i të dhënave elektronike shëndetësore ka përmirësuar ndjeshëm efikasitetin e kërkimeve shkencore. Përparësitë kryesore përfshijnë menaxhimin efikas të kohës, kostos, resurseve njerëzore dhe dizajnit të studimit. Megjithatë, sfidat kryesore të tanishme përfshijnë çështjet e privatësisë, mungesën e ndërveprueshmërisë midis sistemeve, standardeve dhe rezistencën ndaj ndryshimit për shkak të mosbesimit apo mungesës së trajnimit. Përdorimi efektiv i të dhënave elektronike shëndetësore kërkon adresimin e këtyre pengesave për dobi më të mëdha.
Konkluzione: Me analizimin e literaturës, kemi arritur në përfundimin se përdorimi i të dhënave elektronike shëndetësore ofron mundësi për avancimin e teknikave të përdorura në zhvillimin e kërkimeve shkencore. Megjithatë, adresimi i sfidave kërkon bashkëpunim midis institucioneve, studiuesve, politikëbërësve dhe pacientëve për një ekosistem etik dhe inovativ, i cili bën të mundur një revolucion në zhvillimin e kërkimeve shkencore.

Fjalë kyçe: kërkim klinik, të dhëna shëndetësore elektronike, çështje, përparime, privatësi, cilësia e të dhënave, ndërveprueshmëri, prova klinike, të dhëna mjekësore.

PROVAT RESPIRATORE FUNKSIONALE TË PACIENTËVE ME KOLAGENOPATI.

Dajana Kapllaj

Abstrakt
Hyrje: Kolagenopatitë, përfshirë sëmundjet sistemike autoimune të indit lidhor si artriti reumatoid (AR), lupus eritematos sistemik (LES), sindroma e Sjögren - it dhe patologjitë mikse të indit lidhor, janë shpesh të shoqëruara me përfshirje pulmonare. Manifestimet respiratore, ndonëse ndonjëherë subklinike, mund të ndikojnë ndjeshëm në prognozën dhe cilësinë e jetës së pacientëve. Vlerësimi i funksionit respirator nëpërmjet spirometrisë dhe imazherisë torakale luan një rol kyç në zbulimin e hershëm dhe monitorimin e ndërlikimeve pulmonare.
Qëllimi: Të vlerësohet funksioni respirator dhe të identifikohet frekuenca dhe modeli i përfshirjes pulmonare tek pacientët e hospitalizuar me kolagenopati, përmes analizës së spirometrisë, saturimit të oksigjenit, gjetjeve radiologjike dhe rezultateve klinike.
Metodologjia: Ky ishte një studim retrospektiv i tipit cross - sectional, i zhvilluar në Shërbimin e Reumatologjisë të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" në Tiranë. Në studim u përfshinë 105 pacientë të hospitalizuar gjatë periudhës 2019–2025 me diagnozë të konfirmuar të një kolagjenopatie dhe që kishin kryer të paktën një test funksional respirator. Të dhënat e mbledhura përfshinin informacione demografike, kohëzgjatjen e sëmundjes, trajtimin, simptomat respiratore, parametrat spirometrikë (FEV1 / FVC), saturimin e oksigjenit, gjetjet radiologjike pulmonare, numrin e hospitalizimeve, nevojën për oksigjenoterapi apo ventilim mekanik, dhe outcome - in spitalor.
Rezultate: Popullata e studimit ishte kryesisht femra (74. 3%), me artrit reumatoid (40%) dhe Lupus Eritematoz Sistemik (24. 8%) si diagnozat më të shpeshta. Simptomat më të zakonshme ishin dispnea (61%) dhe kolla (48. 6%). Modeli restriktiv spirometrik u identifikua në 36. 2% të pacientëve dhe fibroza intersticiale në imazheri në 31. 4%. Desaturimi gjatë efortit ishte I pranishëm në 32. 4%, ndërsa oksigjenoterapia e vazhdueshme ishte e nevojshme në 11. 4%. U identifikua një korrelacion i fortë midis gjetjeve radiologjike dhe nevojës për oksigjenoterapi ($r = 0. 704$; $p < 0. 001$). Kohëzgjatja e sëmundjes lidhej në mënyrë të ndjeshme me numrin e hospitalizimeve ($r = 0. 313$; $p = 0. 0011$).
Përfundime: Përfshirja pulmonare në kolagjenopati është e zakonshme dhe mund të jetë e pranishme që në stadet e hershme. Modelet restriktive në spirometri dhe gjetjet fibrotike në imazheri janë çrregullimet më të shpeshta. Një vlerësim i integruar respirator është thelbësor për identifikimin e pacientëve në risk dhe për drejtimin e ndërhyrjeve terapeutike në kohë.

Fjalë kyçe: kolagenopati, sëmundjet e indit lidhor, prova funksionale respiratore, spirometri, kapacitet difuziv DLCO, volumet pulmonare, çrregullime restriktive respiratore, skleroderm sistemike, lupus eritematoz sistemik, polimiozit, dermatomiozit.

CEFALETË NË SHËRBIMIN E URGJENCËS.

Daniel Hoxha[1], Besmira Bogdani [2] Besmir Kocia[1], Besmir Fetahu
[1]Shërbimi i Urgjencës Sëmundjeve të Brendshme.
[2]Shërbimi Pediatrisë së Specialitetve nr 2

Abstrakt

Hyrje: Pacientët me dhembje koke, që nuk lidhet me traumën përbëjnë rreth 0. 5 - 4. 5% të vizitave në Shërbimin e Urgjencës. Megjithëse, cefaletë primare përfaqësojnë shkakun kryesor, dhe shkaqet sekondare jetë - kërcënuese të cefaleve duhen patur në konsideratë në mënyrë që të shmangen gabimet në diagnozë dhe trajtim.
Objektivat: Cefaleja në shërbimin e urgjencës është një diagnozë që haset shpesh në praktikën e përditshme të punës. Objektivi i temës është të përcaktohen kriteret në diferencimin e cefalesë primare nga ajo sekondare.
Metodologjia: Ky është një studim i tipit prospektiv, observues - analitik. Janë marrë në shqyrtim rastet e pacientëve të paraqitur në shërbimin e urgjencës, gjatë orareve 8 - 12 dhe 18 - 22 përgjatë 6 muajve shtator 2021 - mars 2022. Pacientët u klasifikuan në pacientë me cefale primare dhe sekondare dhe u krahsuan midis tyre në lidhje me moshën, gjininë, karakterin e dhembjes, intensitetin e dhembjes, kohëzgjatjen nga fillimi i shenjave deri në paraqitjen në urgjencë, nëse kishin histori për migrenë, të dhënat e EON, praninë e deficiteve neurologjike, praninë e shenjave të tjera shoqëruese, sëmundjet shoqëruese dhe ekzaminimet imazherike.
Rezultate: Janë përfshire në studim 78 pacientë me diagnozë cefale. Cefaletë primarë kanë qenë shkaku kryesor i paraqitjes në spital në 53. 8% të rasteve pasuar nga cefaletë sekondare në 42. 3 % të rasteve. Mosha mesatare e pacientëve ka qenë 53 vjeç dhe moshat e mëdha janë më të prirura për të bërë cefale sekondare ($p \leq 0.0001$). Faktorët që lidhen më shumë me cefalet primare janë: historia për migrenë pozitive ($p<0.001$), prania e fotofobisë ($p=0.007$) dhe karakter dhembje pulsues ($p<0.001$). Cefaletë sekondare janë më të shpeshta te meshkujt ($p=0.015$), kanë më shumë karakter therës ($p<0.001$), shoqërohen më shumë me zgjime nga gjumi ($p=0.026$), shoqërohen më shume me dizartri($p=0.012$), hemiparezë ($p=0.004$) dhe rezultat anormal në CT koke ($p=<0.001$). Shtrimi në spital ka qenë i nevojshëm në 15% të rasteve.
Përfundimi: evidentimi i kritereve diferencuese midis cefaleve primare dhe sekondare do të ndihmontë në diagnozën e këtyre pacientëve dhe në menaxhimin më të mirë të tyre.

Fjalë kyçe: Dhimbje koke, trauma, diagnozë cefale, urgjenca.

KRIJIMI I SHËRBIMIT TË KONSULTAVE NË KUJDESIN PALIATIV PËR TË RRITUR DHE FËMIJË NË QSUNT: NJË INICIATIVË PILOT PËR PËRMIRËSIMIN E CILËSISË SË JETËS DHE ULJEN E SHTRIMEVE TË PANEVOJSHME NË REANIMACION NË SHQIPËRI.

Orges Spahiu[1], Donjeta Bali[2], Daniela Bega[3], Marsela Prendi[4]
[1]Departamenti i Onkologjisë, QSUT "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri
[2]Departamenti i Pediatrisë, QSUT "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri
[3]Departamenti i Onkologjisë, QSUT "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri
[4]Departamenti i Onkologjisë, QSUT "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Hyrje: Shqipëria ka standarde kombëtare për kujdesin paliativ pavarësisht kësaj mungojnë shërbimet e strukturuara spitalore. Në QSUT, qendra kryesore terciare në vend, pacientët me kancer të avancuar shpesh paraqiten në shërbimin e urgjencës dhe reanimacionit në rastet kur gjendja e tyre shëndetësore përkeqesohet dhe shërbimin mjekësor ata nuk e marrin dot në banesë, po ashtu dhe fëmijët me sëmundje kërcënuese për jetën mbeten pa mbështetje të specializuar. Kjo sjell simptoma të pakontrolluara, shqetësim të madh për familjet dhe përdorim joefikas të burimeve spitalore.
Objektiva: Kjo nismë pilot synon: 1. Të krijojë shërbimin e konsultave paliative për të rritur dhe fëmijë në QSUT. 2. Të përmirësojë kontrollin e simptomave dhe cilësinë e jetës. 3. Të ofrojë mbështetje psikosociale dhe në fund të jetës për familjet. 4. Të trajnojë ≥20 profesionistë spitalorë në parimet e kujdesit paliativ. 5. Të ulë me 30% shtrimet e panevojshme në reanimacion për pacientët e rritur apo pavione te tjera si dhe në veçanti shërbimin onkologjik. 6. Të vlerësojë fizibilitetin dhe ndikimin e kujdesit paliativ pediatrik.
Materiale dhe metoda: Do të formohet një ekip multidisiplinar (onkolog / pediatër, infermier, psikolog / punonjës social). Do të hartohen rrugë referimi me onkologjinë, pediatrinë, neurologjinë, mjekësinë e

brendshme dhe reanimacionin. Shërbimi do të kryejë 2–3 vizita në javë pranë shtratit të pacientit. Do të zhvillohen dy workshop - e mbi menaxhimin e simptomave, komunikimin dhe planifikimin e kujdesit. Të dhënat do të përfshijnë rezultatet e raportuara nga pacientët, shkallën e shtrimeve në reanimacion apo pavionet e tjerat ne QSUT dhe në vecanti shërbimin onkologjik dhe feedback - un e stafit.
Rezultate: Parashikohet përmirësim i kontrollit të simptomave, rritje e kënaqësisë së familjeve dhe kompetencës së stafit, si dhe një ulje e matshme e mbingarkesës së reanimacionit dhe pavioneve te tjera. Gjetjet do të mbështesin hartimin e një dokumenti politikash për integrimin e përhershëm të kujdesit paliativ në QSUT.
Përfundime: Ky është shërbimi i parë i strukturuar spitalor për kujdesin paliativ në Shqipëri. Duke adresuar boshllëqet kritike si te të rriturit ashtu edhe tek fëmijët, kjo iniciativë ka potencial për ndikim të rëndësishëm klinik, etik dhe ekonomik, si dhe për të shërbyer si model i zbatueshëm në nivel kombëtar.

Fjalë kyçe: Kujdes paliativ, pediatri, onkologji, reanimacion, Shqipëri, shërbim konsulte, cilësi jete.

ENDOMETRIOZA NË SHQIPËRI: NJË REALITET I FSHEHUR PËRBALLË MUNGESËS SË DIAGNOSTIKIMIT TË HERSHËM.

[1]Daniela Nakuci PhDc, [2]Leart Berdica Prof. Asc, [1]Eliona Demaliaj Prof. Dr
[1]Spitali Universitar i Obstetrikë - Gjinekologjisë "Mbretëresha Geraldinë", Tiranë, Shqipëri [2]Departamenti i Anatomisë –Patologjike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Hyrje: Endometrioza është një çrregullim gjinekologjik kronik, i karakterizuar nga prania e indeve të ngjashme me endometrin jashtë mitrës, që shkakton dhimbje, infertilitet dhe ulje të ndjeshme të cilësisë së jetës. Megjithëse prek rreth 10–15% të grave në moshë riprodhuese në nivel global, në Shqipëri kjo sëmundje mbetet ende e nën - diagnostikuar dhe e raportuar në mënyrë të kufizuar. Mungesa e ndërgjegjësimit si tek gratë ashtu edhe tek profesionistët e shëndetit ndikon në vonesën e diagnostikimit dhe në trajtime jo të përshtatshme.
Materiale dhe metoda: U zhvillua një studim përshkrues i tipit prerje në një grup prej 200 grash të moshës 18–45 vjeç, të cilat frekuentonin klinika gjinekologjike në Tiranë dhe në disa spitale rajonale gjatë periudhës janar–gusht 2025. Të dhënat u mblodhën përmes pyetësorëve të strukturuar që vlerësonin simptomat menstruale, intensitetin e dhimbjes, problemet e fertilitetit, sjelljen ndaj kujdesit shëndetësor dhe historikun diagnostik. Për më tepër, u realizuan intervista me gjinekologë për të identifikuar vështirësitë diagnostike dhe burimet e disponueshme në praktikën klinike.
Rezultate: Nga pjesëmarrëset, 62% raportuan dismenorre të rëndë, 48% përjetuan dhimbje gjatë marrëdhënieve seksuale dhe 31% kishin histori infertiliteti. Megjithatë, vetëm 12% ishin
vlerësuar ndonjëherë për endometriozë, dhe vetëm 8% kishin një diagnozë të konfirmuar — duke treguar një mungesë të dukshme në identifikimin e rasteve. Rreth 75% e grave raportuan një periudhë pritjeje mbi tre vjet nga shfaqja e simptomave deri në vlerësimin mjekësor. Faktorët kryesorë të vonesës ishin mungesa e njohurive, perceptimi se dhimbjet menstruale janë
"normale", si dhe qasja e kufizuar në ekzaminime të specializuara (laparoskopi, rezonancë
magnetike).
Përfundime: Endometrioza në Shqipëri mbetet një sëmundje e panjohur dhe e nën - diagnostikuar, me ndikim të rëndësishëm klinik dhe social. Njohja e hershme e simptomave, edukimi i mjekëve të kujdesit parësor dhe nismat për ndërgjegjësimin publik janë thelbësore për të reduktuar vonesat diagnostike dhe për të përmirësuar rezultatet e shëndetit riprodhues tek gratë shqiptare.

Fjalë kyçe: Endometrioza, Shqipëri, dismenorre, infertilitet, vonesë diagnostikimi, shëndeti i grave.

MOMENTET KYÇE NË TRAJTIMIN E NJË PACIENTI HEMOFILIK DHE TË REJAT TERAPEUTIKE.

Daniela Nika [1], Bledi Kalaja [1], Mirela Xhafa [2], Mirzana Kapllani [2], Donjeta Bali [2]
[1]Qendra e Referencës e Hemofilisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë
[2]Shërbimi i Onko - Hematologjisë Pediatrike, QSUNT, Tiranë.

Abstrakt

Hyrje: Trajtimi i pacientëve hemofilikë është një proçes kompleks që përfshin disa momente kyçe. I rëndësishëm është trajtimi i menjëhershëm sapo dyshohet për një episod hemorragjie për të parandaluar dëmtimin e përhershëm. Strategjitë trajtuese përfshijnë profilaksinë dhe trajtimin e episodeve hemorragjike. Trajtimi duhet të administrohet idealisht në shtëpi, sa më shpejt të jetë e mundur. Terapia më e përshtatshme është zakonisht terapia zëvendësuese e faktorëve, por ka edhe opsione të tjera që përfshijnë desmopresinën (DDAVP) dhe acidin tranexamic për raste të lehta, terapinë me antitrupa bispecifikë dhe tashmë edhe terapinë gjenike (për hemofilinë A dhe B tek të rriturit).

Qëllimi: Të diskutojmë mbi momentet kyçe në trajtimin e një pacienti hemofilik duke bërë një rishikim të literaturës dhe udhëzuesve klinikë bazuar në terapitë e reja.

Metodologjia: Diskutim teorik mbi strategjitë trajtuese të formave të ndryshme të hemofilisë, A dhe B, me apo pa inhibitorë.

Rezultate: Bazuar në literaturë momentet kyçe në trajtimin e Hemofilisë përfshijnë: diagnozën e saktë, menaxhimin e episodeve të hemorragjisë, trajtimin profilaktik, edukimin e pacientëve dhe familjarëve, follow - up (in) e rregullt të niveleve të faktorëve të koagulimit dhe kontrollin e shëndetit të përgjithshëm të pacientit. Të rejat më të fundit në trajtimin e hemofilisë janë të fokusuara në përmirësimin e cilësisë së jetës për pacientët, rritjen e efektivitetit të trajtimit dhe zvogëlimin e rrezikut të hemorragjive. Ato përfshijnë: terapitë e zëvendësimit të faktorëve mungues, qofshin plazmaderivate apo të modifikuar biologjikisht, terapinë me antikorpe monoklonale që modifikojnë përgjigjen imunitare ndaj faktorëve të koagulimit, duke rritur efikasitetin e trajtimit. menaxhimin e hemorragjisë në situata të veçanta (operacione ose trauma të rënda) dhe terapinë gjenike që synon të korrigjojë defektet genetike që shkaktojnë hemofilinë, duke ofruar një zgjidhje potencialisht të përhershme.

Konkluzione: Parandalimi dhe trajtimi i episodeve hemorragjike si dhe alternativat trajtuese për hemofilinë duhet të njihen nga çdo profesionist mjekësor dhe të disponohen në çdo spital.

Fjalë kyçe: hemofilia, terapia zëvendësuese e faktorëve, terapia me antikorpe monoklonale, terapia gjenike.

SËMUNDJET KARDIAKE GJATË SHTATZËNISË.

Prof. Asc. Daniela Teferiçi
Departamenti i Kardiologjisë dhe Kardiokirurgjisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë.

Abstrakt

Hyrje: Sëmundjet kardiovaskulare (SKV) përbëjnë një nga shkaqet kryesore të morbiditetit dhe mortalitetit matern. Reduktimi i këtyre vlerave mbetet një prioritet ndërkombëtar, i theksuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH). Gjatë shtatzënisë, ndryshimet fiziologjike si rritja e vëllimit të gjakut, takikardia fiziologjike, dhe rritja e rrahjeve kardiake krijojnë stres shtesë mbi zemrën, duke përkeqësuar patologjitë ekzistuese ose duke nxitur shfaqjen e patologjive të reja kardiake. Menaxhimi i pacientëve me valvula mekanike është veçanërisht i ndërlikuar për shkak të nevojës për antikoagulim të vazhdueshëm, ndërsa përdorimi i warfarinës në tremujorin e parë është i ndaluar për shkak të efektit teratogjen dhe rrezikut për embriopati të shkaktuar nga warfarina. Regjimet e rekomanduara përfshijnë përdorimin e heparinës me peshë të ulët molekulare (LMWH) gjatë tremujorit të parë, ose një strategji të kombinuar "heparinë–warfarinë–heparinë", me monitorim të rreptë të parametrave të koagulimit. Nga ana tjetër, valvulat bioprotetike kërkojnë më pak ose aspak antikoagulim, por shoqërohen me rrezik më të lartë për degjenerim strukturor të valvulës (SVD), veçanërisht në popullatën e re.

Përfundime: Menaxhimi i sëmundjeve kardiake në shtatzëni kërkon ekuilibrim të kujdesshëm midis nevojave terapeutike të nënës dhe mbrojtjes së fetusit, duke marrë parasysh rreziqet e trombozës, hemorragjisë, teratogjenicitetit dhe ndërlikimeve perinatale. Trajtimi duhet të personalizohet për secilin rast, me përfshirjen e një ekipi multidisiplinar, dhe planifikim të detajuar për momentin e lindjes.

Fjalë kyçe: shtatzënia dhe zemra, sëmundje kardiovaskulare, valvula mekanike, warfarinë, heparinë me peshë të ulët molekulare, antikoagulim, embriopati, komplikime obstetrike, vdekje maternale, SVD, menaxhim multidisiplinar.

PËRHAPJA NËPËRMJET HAPËSIRAVE AJRORE SI NJË FAKTOR MBROJTËS DHE PROGNOSTIK TE PACIENTËT ME KANCER PULMONAR ME QELIZA JO TE VOGLA.

Prof. Asc. Daniela Xhemalaj[1], Kleida Mati[2], Arben Tanka[3], Eritjan Tashi[3], Blerina Cela[1], Albina Ndoja[2], Prof. Asc. Leart Berdica[1,2], Prof. Mehdi Alimehmeti[1]
[1]*Departamenti i Anatomisë Patologjike, Universiteti i Mjekësisë*
[2]*Spitali Amerikan*
[3]*Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi", Tiranë*

Abstrakt
Hyrje: Kanceri pulmonar përbën kancerin e dytë më të përhapur në popullatën e përgjithshme dhe të tretin më të shpeshtë tek gratë. STAS (Spread Through Air Spaces – Përhapja përmes Hapsirave Ajrore) është një term që përdoret në patologji, veçanërisht në rastet e karcinomës së mushkërive, dhe i referohet përhapjes së qelizave tumorale nëpër hapsirat ajrore të indeve pulmonare.
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi ishte të vlerësonte rëndësinë e STAS si një faktor parashikues dhe prognostik, si dhe të analizonte ndikimin e zbulimit të STAS në vendimmarrjen për trajtimin kirurgjikal dhe farmakologjik pasues. Prania e STAS është identifikuar si një faktor rreziku për metastaza nodulare të fshehta. Gjithashtu, ajo është shoqëruar me invazion limfatik, vaskular dhe pleural. Aktualisht, standardi i artë për diagnostikimin e STAS mbetet ekzaminimi patologjik pas operacionit. Fatkeqësisht, kjo qasje kufizon mundësinë për të marrë vendime të sakta kirurgjikale para operacionit. Për pasojë, kërkimet e vazhdueshme kanë si synim zhvillimin e metodave diagnostikuese preoperative që mund të identifikojnë në mënyrë të saktë praninë e STAS dhe të mbështesin planifikimin optimal kirurgjikal.
Përfundime: Identifikimi i STAS në NSCLC ndikon drejtpërdrejt në vendimet terapeutike. Kërkimi shkencor mbi STAS mbetet i kufizuar. Tek pacientët me NSCLC, prania e STAS njihet si një faktor prognostik negativ.

Fjalë kyçe: STAS, karceri pulonar, kirurgjia torakale.

TUMORET E TIROIDES, KORRELACIONET KLINIKO - MORFOLOGJIKE DHE PERSPEKTIVA E TESTEVE MOLEKULARE.

Daniela Xhemalaj, Xhulia Mata

Abstrakt
Hyrje: Tumoret e gjendrës tiroide njihen si një grup heterogjen neoplazmash endokrine me sjellje klinike biologjike të ndryshme, duke filluar nga noduse beninje, në noduse me malinjitet të panjohur e deri në karcinoma shumë agresive. Kjo tezë synon të eksplorojë ndikimin e biopsisë kirurgjikale mbi bazën e korrelacioneve kliniko - morfologjike në vendosjen e diagnozës përfundimtare dhe planifikimin e një qasje të integruar dhe efektive trajtimi. Vlerësimi kritik i rolit në zhvillim të testimit molekular në rritjen e saktësisë diagnostikuese dhe personalizimin e trajtimit, perspektivat në të ardhmen. Identifikimi i korrelacioneve ndërmjet prezantimit klinik dhe karakteristikave histopatologjike të tumoreve të tiroides është thelbësor për stratifikimin e riskut dhe menaxhimin e specializuar mjekësor, të cilat duket se po marrin një tjetër drejtim falë zhvillimit sot të testeve molekulare.
Qëllimi: Vlerësimi i ndikimit të biopsisë kirurgjikale mbi bazën e korrelacioneve kliniko - morfologjike në diagnozën precise dhe planifikimin e trajtimit të tumoreve të tiroides në laboratorin e departamentit të Anatomisë Patologjike pranë Q. S. U. N. T, si dhe perspektiva e testeve molekulare në të ardhmen.
Materiale dhe metoda: Ky studim është i tipit retrospektiv, observacional, deskriptiv - analitik me nuanca të një studimi perspektiv të pjesës teorike mbi testet molekulare. U analizuan në total të dhënat e 102 pacientëve të cilët i janë nënshtruar procedurës së biopsisë në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, gjatë

periudhës janar - dhjetor 2024. Të dhënat u përpunuan në programin Power BI. Gjetjet u raportuan mbi bazën e të dhënave të aksesueshme në arkivat elektronike të laboratorit të institucionit tonë. Rezultatet u krahasuan me të dhënat e literaturës ndërkombëtare bashkëkohore.
Rezultate: Nga 102 pacientë me diagnozën fillestare klinike të strumës multinodulare, biopsia kirurgjikale pohoi ekzistencën e strumës në 49 raste, ose 48. 04% në terren të anormaliteteve të tjera të gjendrës tiroide, ndërsa vërtetoi dyshimin klinik për tumor në 53 pacientë të tjerë, ose të 51. 96% të të gjithë rasteve klinike të paraqitura me rekomandim për të kryer biopsi. Nga 53 pacientë me diagnozë tumoriale, 66. 04% rezultuan malinje, 22. 64% me potencial malinj të panjohur, ndërkohë 11. 32% rezultuan me karakter beninj.
Konkluzione: Cilësimi dhe njohja e korrelacioneve kliniko - morfologjike qartëson dallimin e lezioneve beninje, të papërcaktuara dhe ato malinje nga njëra - tjetra si dhe rafinon strategjinë menaxhuese të tyre. Kombinimi i vlerësimit klinik, morfologjik dhe molekular rrit saktësinë diagnostike dhe na ofron një tablo më të detajuar të prognozës. Shqyrtimi i shënjuesve tumoralë me metoda imunohistokimike në diferencimin e llojeve të tumorit përcakton krahas metodave terapeutike që duhen ndjekur edhe riskun për metastaza.

Fjalë kyçe: Nodul, korrelacion kliniko - morfologjik, biopsi kirurgjikale, testimi molekular.

KUJDESI INFERMIEROR NDAJ INFEKSIONEVE NOZOKOMIALE.

Msc. Manjola Pjetri, Msc. Klea Kazazi, Elona Topuzi, Daniela Balliu

Abstrakt
Hyrje: Infeksionet nozokomiale, të quajtura ndryshe infeksione spitalore, janë infeksione që pacienti i fiton gjatë qëndrimit në spital ose në një institucion shëndetësor, dhe që nuk ishin të pranishme në momentin e pranimit. Këto infeksione përbëjnë një problem serioz për sistemet shëndetësore në mbarë botën, pasi ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e sëmundshmërisë, vdekshmërisë dhe kostove të kujdesit shëndetësor. Roli i infermierit është thelbësor në parandalimin, identifikimin e hershëm dhe menaxhimin e këtyre infeksioneve, përmes respektimit të masave të higjienës dhe protokolleve spitalore.
Qëllimi i studimit: Të evidentojë rëndësinë e kujdesit infermieror në parandalimin e infeksioneve nozokomiale; të analizojë faktorët që çojnë në përhapjen e infeksioneve në ambientet spitalore; të theksojë masat e nevojshme që infermierët duhet të zbatojnë për të ruajtur sigurinë e pacientëve.
Përfundime: Kujdesi infermieror është faktori më i rëndësishëm në parandalimin e infeksioneve nozokomiale. Një infermier i trajnuar dhe i ndërgjegjshëm për rolin e tij kontribuon në reduktimin e përhapjes së infeksioneve, përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientëve dhe uljen e kostove spitalore. Zbatimi i protokolleve të higjienës dhe edukimi i vazhdueshëm janë thelbësorë për ruajtjen e një mjedisi të sigurt spitalor.

Fjalë kyçe: infeksione, nozokomiale, protokolle, infermierë, spital.

KUJDESI POST - OPERATIV I PACIENTËVE PAS NDËRHYRJEVE KIRURGJIKALE: QASJE MULTIDISIPLINARE PËR PËRMIRËSIMIN E REZULTATEVE KLINIKE.

Dr. Dastid Paçarizi
Qendra e Mjekësisë Familjare, Zhur, Republika e Kosovë, QKMF - Prizren

Abstrakt
Hyrje: Kujdesi post - operativ përfaqëson një fazë kritike të trajtimit kirurgjikal, ku menaxhimi efektiv i dhimbjes, parandalimi i infeksioneve dhe rehabilitimi i hershëm ndikojnë drejtpërdrejt në shërimin e pacientit. Qëllimi i këtij punimi është të vlerësojë praktikat kryesore të kujdesit post - operativ dhe të paraqesë përvojat lokale në menaxhimin e pacientëve pas ndërhyrjeve kirurgjikale në kujdesin parësor.
Metoda: Është realizuar një rishikim narrativ i literaturës duke përdorur bazat e të dhënave PubMed, Scopus dhe Cochrane Library (2015–2024), me fokus në kujdesin multidisiplinar post - operativ. Gjithashtu janë analizuar të dhëna retrospektive nga Qendra e Mjekësisë Familjare në Zhur për periudhën Janar–Dhjetor 2024, që përfshijnë pacientët e ndjekur pas ndërhyrjeve kirurgjikale.
Rezultate: Gjatë një periudhe njëvjeçare janë ndjekur gjithsej 62 pacientë pas operacioneve (40% meshkuj, 60% femra). Ndërhyrjet më të shpeshta përfshinin kolecistektominë (8%), ndërhyrjet gjinekologjike (29%),

hernioplastinë (19%) dhe procedurat ortopedike (25%). Komplikimet më të zakonshme post - operative ishin infeksionet e plagëve (11%), edema lokale (8%) dhe dhimbja e menaxhuar jo adekuat (15%). Shumica e pacientëve (70%) u shëruan pa komplikime serioze. Ndjekja e rregullt dhe edukimi i pacientëve ndikuan ndjeshëm në reduktimin e komplikimeve.
Diskutime: Gjetjet tona konfirmojnë rëndësinë e monitorimit të vazhdueshëm dhe rolin e mjekësisë familjare në menaxhimin e fazës post - operative. Kombinimi i udhëzimeve ndërkombëtare me praktikën lokale mundëson kujdes të individualizuar dhe rezultate më të mira. Bashkëpunimi midis kirurgëve dhe mjekëve të kujdesit parësor është thelbësor.
Përfundime: Qasja multidisiplinare në kujdesin post - operativ është thelbësore për rezultate klinike optimale. Përvoja në kujdesin parësor tregon se ndjekja aktive dhe edukimi i pacientëve redukton komplikimet dhe përmirëson cilësinë e jetës. Mjekësia familjare duhet të jetë më e integruar në strategjitë e rikuperimit post - operativ.

Fjalë kyçe: post - operator, pacient, ndërhyrje, kirurgji etj.

HERNIA DISKALE LUMBARE – PËRVOJA KLINIKE NË PACIENTËT E OPERUAR NË BLLOKUN OPERATOR TË NEUROKIRURGJISË, 2020–2025.
Dava Deda, Anita Lleshi, Manjola Pjetri

Abstrakt
Hyrje: Hernia diskale lumbare është një patologji e shpeshtë që kërkon trajtim kirurgjikal në rastet e avancuara. Në bllokun operator të neurokirurgjisë (2020–2025) janë trajtuar një numër i konsiderueshëm pacientësh, ku menaxhimi perioperativ dhe kujdesi infermieror kanë qenë faktorë kyç për suksesin terapeutik.
Qëllimi: Të paraqitet përvoja klinike dhe menaxheriale me pacientët e operuar për hernie diskale lumbare në shërbimin e neurokirurgjisë, duke theksuar rolin e kujdesit infermieror në periudhën para, gjatë dhe pas ndërhyrjes kirurgjikale.
Metodologjia: Studimi përfshin pacientët e operuar për hernie diskale lumbare gjatë periudhës 2020–2025. Janë analizuar karakteristikat demografike, simptomat klinike, protokollet kirurgjikale dhe kujdesi infermieror në bllokun operator dhe repartin pas operacionit.
Rezultatet e pritshme: Pritet të evidentohen përmirësimet klinike pas trajtimit kirurgjikal, ulja e komplikacioneve postoperatore dhe rëndësia e protokolleve standarde të kujdesit infermieror në suksesin e trajtimit.
Përfundime: Hernia diskale lumbare mbetet një sfidë, por përvoja e viteve 2020–2025 në bllokun operator të neurokirurgjisë tregon se ndërthurja e teknikave kirurgjikale moderne me kujdesin infermieror të strukturuar përmirëson ndjeshëm rezultatet klinike dhe cilësinë e jetës së pacientëve.

Fjalë kyçe: hernia diskale lumbare, përvojë klinike, pacient, neurokirurgji.

MEKANIZMAT KOLINERGJIKË NË RRITJEN E BRONKOKONSTRIKSIONIT, SEKRETIMIT TË MUKUSIT DHE KUFIZIMIN NË RRJEDHEN E AJRIT.
Dea Cahasi

Abstrakt
Sistemi kolinergjik luan një rol të rëndësishëm në ruajtjen e funksioneve homeostatike të rrugëve të frymëmarrjes dhe njëkohësisht, është i përfshirë në zhvillimin e fenomeneve patologjike të zakonshme në sëmundje respiratore si astma dhe sëmundja pulmonare obstruktive kronike. Përveç veprimit të tij klasik përmes neurotransmetimit nervor, acetilkolina vepron gjithashtu nëpërmjet qelizave jo - neuronale të mushkërive, duke moduluar tonusin bronkial, sekretimin mukoz dhe përgjigjet inflamatore. Ky studim synon të analizojë mekanizmat qelizorë dhe molekularë nëpërmjet të cilëve sinjalizimi kolinergjik kontribuon në bronkokonstriksionin, hipersekrecionin mukoz dhe kufizimin e rrjedhës së ajrit. Përmes rishikimit të literaturës së fundit shkencore (2018–2025), janë identifikuar rrugët kryesore të ndërveprimit midis receptorëve muskarinikë dhe strukturave të rrugëve të frymëmarrjes. Aktivizimi i receptorëve M3 del si një mekanizëm

kryesor në nxitjen e ngushtimit të rrugëve ajrore dhe sekrecionit të mukusit, ndërkohë që çrregullimi i funksionit të receptorëve M2 përkeqëson tonusin kolinergjik në patologjitë inflamatore. Terapitë antikolinergjike, veçanërisht ato të bazuara në antagonistë selektivë të receptorëve muskarinikë, kanë treguar efikasitet në përmirësimin e parametrave pulmonarë dhe në uljen e incidencës së eksacerbimeve. Gjetjet e përmbledhura në këtë punim mbështesin konceptin që modulimi specifik i sinjalizimit kolinergjik përfaqëson një qasje premtuese terapeutike për kontrollin më të mirë të sëmundjeve obstruktive respiratore.

Fjalë kyçe: Sistem kolinergjik, acetilkolinë, bronkokonstriksion, hipersekrecion mukoz, kufizim i rrjedhës së ajrit, receptorë muskarinikë, nervi vagus, astma, BPOC, terapi antikolinergjike.

INSUFICIENCA AKUTE RENALE TE PACIENTËT ME GJENDJE SEPTIKE.

Delvina Lamallari

Abstrakt

Hyrja: Insuficienca akute renale te pacientët në gjendje septike është një ndërlikim i shpeshtë i këtyre pacientëve, veçanërisht me sëmundje kritike dhe shoqërohet me morbiditet dhe mortalitet të lartë. Parandalimi i zhvillimit të këtij komplikimi është i vështirë sepse në kohën kur pacientët kërkojnë kujdes mjekësor, shumica tashmë kanë zhvilluar insuficiencë akute renale. Kështu, diagnostikimi i hershëm është thelbësor për të ofruar trajtim mbështetës dhe për të kufizuar dëmtimet e mëtutjeshme. Kriteret aktuale diagnostike për insuficiencën akute renale kanë kufizuar zbulimin e hershëm; megjithatë, biomarkerët e rinj të stresit dhe dëmtimit të veshkave janë vërtetuar kohët e fundit për parashikimin e rrezikut dhe diagnostikimin e hershëm të dëmtimit akut të veshkave në kushtet e sepsës.

Qëllimi: Përmes rishikimit të literaturës aktuale në dispozicion dhe punimeve shkencore të publikuara të arritshme përmes internetit, është tentuar të arrihen njohuri më të gjera sa i përket insuficiencës akute renale te pacientët me gjendje septike. Është bërë analizimi i të dhënave të marra nga punimet shkencore të publikuara, si dhe të marra nga Klinika e Nefrologjisë në QKUK.

Materiale dhe metoda: Ky punim diplome është rishikim i literaturës ekzistuese dhe hulumtim shkencor retrospektiv, ku përmes hulumtimit është arritur deri në një seleksionim të mirëfilltë të informatave.

Rezultate dhe Diskutime: Është diskutuar roli i faktorëve të rrezikut në paraqitjen e IAR septike, roli i terapisë zëvendësuese renale, si dhe në bazë të të dhënave nga QKUK numri i pacientëve me IAR septike gjatë periudhës Janar 2023 - Dhjetor 2023 ishte 10.

Përfundime: Përmes një shqyrtimi të hollësishëm të literaturës dhe të dhënave klinike të disponueshme, kemi ardhur në përfundim që ky komplikim si pasojë e sepsës është një sëmundje e rëndësishme në të cilën duhet reaguar shpejtë, pasi diagnostikimi dhe trajtimi i hershëm luan rol të madh në shkallën e mbijetesës së pacientëve, sidomos atyre me gjendje kritike. Duhet të vlerësohet funksioni i veshkëve dhe të jepet terapia zëvendësuese renale sa më shpejt të jetë e mundur.

Fjalë kyçe: Sepsa, insuficienca akute renale, terapia zëvendësuese renale.

PROFILI MIKROBIOLOGJIK I FLORËS BAKTERIALE NE PACIENTET ME INFEKSIONE UROGJENITALE: VLERËSIMI I PATOGJENËVE OPORTUNISTË NË INFEKSIONET SEKSUALISHT TË TRANSMETUESHME.

D. Laçej[1, 2], K. Laçej[2], E. Meta[2, 3], A. Koraqi[2, 3]
[1]*Insituti i Shëndetit Publik, Tiranë*
[2]*Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*
[3]*Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë*

Abstrakt

Hyrje: Simptomat urogjenitale përbejnë një shqetësim të shpeshtë të pacientëve që paraqiten në praktikën klinike. Identifikimi i mikroorganizmave shkaktarë mbetet i domosdoshëm për vendosjen e diagnozës së saktë dhe përzgjedhjen e trajtimit të përshtatshëm

Qëllimi: Vlerësimi i profilit mikrobiologjik të florës bakteriale te pacientët me simptoma urogjenitale dhe përcaktimi i rolit të patogjenëve oportunistë
Materialet dhe Metodat: Studimi përfshiu 41 pacientë me simptoma të traktit urogjenital. U kryen kultura bakteriale për identifikimin e mikroorganizmave patogjenë dhe oportunistë, bashkë me teste serologjike për patogjenë seksualisht të transmetueshëm (Chlamydia trachomatis, Mycoplasma hominis, Ureaplasma urealyticum dhe Neisseria gonorrhoeae).
Rezultate: Shumica e mostrave rezultuan pozitive për prani të mikroorganizmave oportunistë. Edhe pse numri i rasteve per patogjenë seksualisht të transmetueshëm ishte i kufizuar, në disa pacientë u vërejt bashkëprani e florës oportuniste me seropozitivitet për IST duke sugjeruar një ndërveprim të mundshëm në shfaqjen e simptomave klinike.
Përfundime: Profilizimi mikrobiologjik i florës bakteriale jep informacion të vlefshëm për kuptimin e mekanizmave patogjenetike së infeksioneve urogjenitale. Kombinimi i kulturës bakteriale me serologjinë vazhdon të jetë një qasje diagnostike efektive në kushte te mungeses te metodave molekulare, duke kontribuar në përmirësimin e menaxhimit klinik dhe parandalimin e rikthimeve.

Fjalë kyçe: patogjenë oportunistë. kulturë bakteriale, serologji.

AUTOMATIZIMI I LABORATORËVE MIKROBIOLOGJIKË SPITALORË: PËRFITIMET DHE KOSTO - EFEKTIVITETI I I APLIKIMIT NË PRAKTIKE.

D. Laçej[1, 2], K. Laçej[2], M. Parllaku[3]
[1]*Insituti i shendetit Publik, Tirane Albania*
[2]*Fakulteti i Mjekesise, Universiteti i Mjekesise, Tirane, Albania*
[3]*Spitali Continental*

Abstrakt
Në vitet e fundit, automatizimi dhe inteligjenca artificiale kanë filluar të transformojnë ndjeshëm mënyrën se si funksionojnë laboratorët mikrobiologjikë. Kjo qasje është një hap thelbësor drejt përmirësimit të diagnozes, sigurisë klinike dhe menaxhimit racional të burimeve. Integrimi i teknologjive të automatizuara me algoritme të inteligjencës artificiale (AI) po ndryshon mënyrën se si identifikohen mikroorganizmat, interpretohen rezultatet dhe merren vendimet klinike. Automatizimi lejon identifikim të shpejtë dhe të saktë të patogjenëve, profilizim të menjëhershëm të ndjeshmërisë ndaj antibiotikëve dhe reduktim të gabimeve manuale. Kjo ben te mundur trajtime të personalizuara, ul përdorimin e panevojshëm të antibiotikëve, rrit standartizimin e rezultateve diagnostike dhe përmirëson menaxhimin e pacientëve. Nga këndvështrimi ekonomik, përdorimi i teknologjive inteligjente optimizon burimet laboratorike, ul nevojën për analiza të përsëritura dhe redukton kohën e hospitalizimit. Implementimi i automatizimit në laboratorët mikrobiologjikë spitalorë përmirëson ndjeshëm saktësinë dhe gjurmueshmërinë e rezultateve. optimizon fluksin e punës, redukton gabimet njerëzore dhe rrit besueshmërinë e rezultateve. Përfitimet afatgjata, si standardizimi i proceseve dhe rritja e efikasitetit, e bëjnë nje strategji te qendrueshme dhe një hap të domosdoshëm drejt laboratorit modern dhe menaxhimit të zgjuar të infeksioneve

Fjalë kyçe: automatizim laboratorik,, kosto - efektivitet, diagnostikim, menaxhim laboratorik.

MJEKËSIA E FAMILJES NË KONTEKSTIN E PANDEMISË COVID - 19: ROLI, SFIDAT DHE PERSPEKTIVAT E SISTEMIT SHËNDETËSOR PARËSOR.

MSc. Denada Mema
Mjeke e Përgjithshme, Qëndra Shëndetësore Mollas, Elbasan

Abstrakt
Hyrje: Pandemia e COVID - 19 solli një krizë të paprecedentë globale, duke ekspozuar brishtësinë dhe elasticitetin e sistemeve shëndetësore. Në këtë kontekst, mjekësia e familjes u bë boshti qendror i menaxhimit të kujdesit parësor, duke siguruar vazhdimësinë e shërbimeve, mbështetjen komunitare dhe ndërmjetësimin midis politikave të shëndetit publik dhe nevojave individuale të pacientëve.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të analizojë ndikimin e pandemisë në strukturën, funksionimin dhe etikën profesionale të mjekut të familjes, duke eksploruar transformimet që ndodhën në praktikat klinike, në qasjen digjitale të telemjekësisë dhe në marrëdhënien pacient - mjek. Përdorimi i një metodologjie të kombinuar — kuantitative dhe kualitative — ka mundësuar vlerësimin e efektivitetit të ndërhyrjeve dhe perceptimit të mjekëve për ngarkesën psikologjike dhe profesionale gjatë pandemisë.
Rezultate: Rezultatet tregojnë se mjekët e familjes ishin jo vetëm linja e parë e diagnostikimit, por edhe ura lidhëse e besimit shoqëror në një klimë pasigurie. Në përfundim, pandemia e COVID - 19 ka theksuar rëndësinë e fuqizimit të mjekësisë familjare përmes trajnimit të vazhdueshëm, mbështetjes psikosociale dhe integrimit të inovacioneve digjitale në kujdesin shëndetësor parësor.

Fjalë kyçe: Mjekësia e familjes, COVID - 19, kujdesi parësor, telemjekësia, pandemia, etikë profesionale, elasticitet shëndetësor.

QASJA LAPAROSKOPIKE NË RIPARIMIN E HERNIES INGUINALE BILATERALE.

Denis Godaj; Ambra Doku; Eri Stafa; Arvin Dibra; Xheladin Draçini
Klinika I e Kirurgjisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tirana, Albania

Abstrakt
Herniet inguinale bilaterale janë një gjendje klinike e zakonshme, dhe riparimi kirurgjikal mbetet opsioni më i mirë i trajtimit. Qasja laparoskopike — kryesisht me teknikat transabdominale preperitoneale (TAPP) dhe totalisht ekstraperitoneale (TEP) — ofron përparësi të rëndësishme ndaj riparimit tradicional të hapur. Përmes prerjeve minimale, të dy defektet herniale mund të riparohen njëkohësisht, duke reduktuar traumën operative. Krahasuar me metodën e hapur, riparimi laparoskopik shoqërohet me më pak dhimbje pas operacionit, rikuperim më të shpejtë, qëndrim më të shkurtër spitalor dhe kthim më të hershëm në aktivitetet normale, veçanërisht e rëndësishme kjo për rastet bilaterale.
Kjo qasje gjithashtu lejon një vizualizim më të mirë të orificiumit miopektineal dhe zbulimin e hernieve të fshehura duke përmirësuar saktësinë diagnostike. Një element i rëndësishëm është fakti që riparimi laparoskopik lidhet me një incidencë më të ulët të dhimbjes kronike pas operacionit për shkak të manipulimit më të vogël të nervave inguinalë. Edhe pse kërkon një periudhë më të gjatë mësimi dhe mund të ketë kosto fillestare më të larta, këto balancohen nga përfitimet afatgjata, duke përfshirë norma më të ulëta të recidivave dhe komplikacioneve kur kryhet nga kirurgë me përvojë. Prandaj, për herniet inguinale bilaterale riparimi laparoskopik përfaqëson një alternativë superiore, veçanërisht për pacientët aktivë ose në moshë pune.

Fjalë kyçe: Riparimi laparoskopik i hernies, hernie inguinale bilaterale, TAPP, TEP, dhimbje kronike, kirurgji minimalisht invasive.

HERNIA INGUINALE REKURRENTE: A ËSHTË QASJA LAPAROSKOPIKE TRAJTIMI MË I MIRË?

Denis Godaj, Ambra Doku, Eri Stafa, Arvin Dibra, Xheladin Draçini
Klinika I e Kirurgjisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tirana, Albania.

Abstrakt
Herniet inguinale rekurrente përbëjnë një problem kirurgjikal kompleks për shkak të anatomisë së ndryshuar, cikatrizimit dhe rrezikut të shtuar për komplikacione. Qasja laparoskopike — kryesisht përmes teknikave transabdominale preperitoneale (TAPP) ose totalisht ekstraperitoneale (TEP) — është shfaqur si një alternativë superiore në krahasim me riparimin e hapur për rastet rekurrente, veçanërisht pas një ndërhyrjeje të mëparshme anteriore (të hapur). Laparoskopia ofron hyrje në hapësirën preperitoneale në një plan indi të paprekur në pacientët që kanë pasur më parë riparim të hapur, duke shmangur kështu cikatricen dhe duke ulur vështirësinë operative.
Kjo qasje gjithashtu siguron një vizualizim më të mirë të hernieve bilaterale dhe femorale, duke mundësuar diagnostikimin dhe trajtimin e plotë të defekteve të fshehura ose të shumëfishta. Disa studime kanë treguar se riparimi laparoskopik i hernieve inguinale rekurrente rezulton në më pak dhimbje pas operacionit, norma më të

ulëta infeksionesh, qëndrim më të shkurtër spitalor dhe kthim më të shpejtë në aktivitetet e përditshme. Një element i rëndësishëm është se dhimbja kronike inguinale — një ndërlikim i zakonshëm i riparimit të hapur — reduktohet ndjeshëm falë manipulimit minimal të nervave. Megjithëse teknikat laparoskopike kërkojnë aftësi të avancuara dhe pajisje të specializuara, përfitimet afatgjata, duke përfshirë uljen e rikthimeve dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, favorizojnë fuqimisht përdorimin e tyre. Për pacientët me rekurrencë pas një riparimi të mëparshëm me rrjetë (mesh) të hapur, udhëzimet ndërkombëtare aktuale rekomandojnë një qasje laparoskopike sa herë që është e mundur. Prandaj, tek pacientët e përzgjedhur siç duhet, riparimi laparoskopik duhet të konsiderohet si trajtimi i zgjedhur për herniet inguinale rekurrente.

Fjalë kyçe: Hernie inguinale rekurrente, riparim laparoskopik, TAPP, TEP, dhimbje kronike, kirurgji minimalisht invasive.

PROTOKOLLET E REJA TË VAKSINIMIT NDAJ HPV NË BOTË DHE NË SHQIPËRI.

Dr. Denisa Golemi

Abstrakt
Infeksioni nga Human Papilloma Virus (HPV) është shkaku kryesor i kancerit të qafës së mitrës dhe patologjive të tjera anogenitale, duke përbërë një sfidë të rëndësishme për shëndetin publik global. Gjatë viteve të fundit, strategjitë e vaksinimit janë përditësuar ndjeshëm: Organizata Botërore e Shëndetësisë rekomandon tashmë përdorimin e një doze të vetme për grupmoshat 9–20 vjeç, duke u bazuar në evidenca të forta mbi imunogjenicitetin dhe mbrojtjen afatgjatë. Kjo qasje ka për qëllim të rrisë mbulimin, të thjeshtojë logjistikën dhe të ulë kostot, duke u adoptuar tashmë në shumë vende me programe kombëtare imunizimi. Në Shqipëri, vaksinimi ndaj HPV u përfshi në kalendarin kombëtar në vitin 2022 me skemë dydozëshe për vajzat 13–14 vjeç. Aktualisht po shqyrtohen rekomandimet ndërkombëtare për reduktimin e dozave dhe zgjerimin e grupmoshave, përfshirë djemtë dhe grupet me rrezik të lartë. Këto ndryshime synojnë të rrisin aksesin, ndërgjegjësimin publik dhe të përafrojnë praktikat kombëtare me standardet globale. Ky prezantim paraqet zhvillimet më të fundit mbi vaksinimin ndaj HPV dhe diskuton përshtatjen e tyre në Shqipëri, sfidat dhe mundësitë për përmirësimin e mbulimit imunizues.

Fjalë kyçe: HPV, imunizim, kanceri cerviksit, vaksina.

DIABETI TIP 2 DHE VETËMENAXHIMI I SËMUNDJES NGA VETË PACIENTI.

Denisa Qahaja

Abstrakt
Hyrje: Diabeti mellitus është një sëmundje endokrinologjike dhe / ose metabolike me incidencë dhe prevalencë në rritje e cila shoqërohet me rritje të sheqerit ne gjak. Ndërkohë që diabeti mellitus tipi 2 (DM 2) është duke u shdërruar në një epidemi në disa shtete, në të cilat pritet që numri i njerëzve te prekur të dyfishohet dekadën tjetër për shkak të plakjes së popullsisë. Modalitetet e trajtimit përfshijnë modifikimin e mënyrës së jetesës, trajtimin e mbipeshës, agjentët hipoglicemik oral dhe sensibilizuesit e insulinës si metformina, biguanidet që zvogëlojnë rezistencën ndaj insulinës. Theksi do të vihet në njohuritë dhe mënyrat e vetmenaxhimit të sëmundjes.
Qëllimi i studimit: Vlerësimi i nivelit të vetmenaxhimit të diabetit tipi 2 te pacientët që trajtohen nga mjeku i familjes në qëndra shëndetësore në qytetin e KORCËS si dhe identifikimi i faktorëve të mundshëm dhe pengesave që ndikojnë në vetmenaxhimin dhe vetëkujdesin e sëmundjes.
Metodologjia: Studimi do të jetë i tipit transversal. Të dhënat e studimit u mblodhën në periudhën Qershor – Korrik 2020 nëpërmjet një pyetesori standart anonim të bazuar në literaturë. Shëpërndarja e pyetësorit u krye nëpërmjet platformës google form. Identifikimi i personave me Diabet tipi 2 u krye nga regjistrat e mjekut të familjes. Pyetësori përbëhej nga 5 seksione me pyetje për vetëmenaxhimin e diabetit si dhe një seksion për të dhënat socio - demografike. Në studim u përfshin 134 pacientë të grupmoshës 18 - 85 vjeç. Vlera të p< 0. 05 u konsideruan të rëndësishme nga ana statistikore.

Rezultate: Mosha mesatare pacientëve ishte 42. 7 vjeç dhe SD±15, 5. 69. 40% e pjesëmarrësve ishin femra dhe 30. 60% meshkuj. Lidhje sinjifikante statistikore u gjet midis të dhënave socio - demografike, (gjinisë) dhe variablit ‘’dieta ushqimore”, p< 0. 001, si edhe midis gjinisë dhe”aktivitetit fizik” p< 0. 001 Gjithashtu u gjetën lidhje të rëndësishme midis njohurive për vetmenaxhim të sëmundjes edhe arsimimit p< 0. 05.
Konkluzione: Studimi evidentoi mungesën e pranisë së informacioneve në mënyrë të barabartë për popullatën e përfshirë në studim për vetmenaxhimin e sëmundjes. Femrat ishin ato që kryenin vetmenaxhim më të mirë në krahasim me meshkujt në lidhje me dietën ushqimore dhe aktivitetin fizik. Studimi evidentoi edhe rëndësinë e shkollimit në njohuritë për vetmenaxhim të sëmundjes, kështu personat me arsim të lartë kishin njohuri më të mira për vetmenaxhim të sëmundjes. Fokus i vecantë duhet dhënë drejt krijimit të programeve edukative sipas target grupeve nga profesionistët e shëndetit me qëllim rritjen e nivelit të vetmenaxhimit të diabetit tipi 2 dhe reduktim të kostove shëndetësore të sëmundjes.

Fjalë kyçe: Pacientë, diabet tipi 2, vetmenaxhim, vlerësim, modifikim.

ALERGJIA NGA NIKELI DHE IMPAKTI I TIJ MULTISISTEMIK.

Denisa Spahiu
Spitali Continental

Abstrakt
Në vendet e industrializuara, nikeli konsiderohet si metali më i shpeshtë përgjegjës për simptoma të hipersensibilitetit, pasi prek rreth 8–19% të adultëve dhe 8–10% të fëmijëve. Shumë objekte të përdorimit të zakonshëm përmbajnë nikel: aksesorë metalikë për rrobat, vathë dhe në përgjithësi shpues, ushqime, korniza metalike për syze, bizhuteri, monedha, çelësa, enë kuzhine, kozmetikë, etj. Në këtë kuadër, alergjia nga nikeli mund të jetë profesionale (punëtorët e metaleve, parukierët, muzikantët, teknikët dentarë, këpucarët, kasierët, personeli mjekësor, etj.) ose joprofesionale, duke marrë në këtë formë një rëndësi të veçantë për t’u diagnostikuar. Patologjia më e shpeshtë e lidhur me të është dermatiti alergjik i kontaktit (ACD), por mund të shfaqet edhe me simptomatologji sistemike (SNAS), p. sh. simptoma gastrointestinale, neurologjike, edemë palpebrale apo, rrallë, prekje respiratore, duke cenuar më tej cilësinë e jetës. Në fusha të ndryshme mjekësore, hipersensitiviteti ndaj nikelit mund të jetë një shkaktar madhor në ecurinë e trajtimit të pacientit, pasi mund të luajë rol në refuzimin / flakjen e pajisjeve mjekësore, p. sh. ortopedike (pllaka, vida, proteza), valvulave kardiake artificiale, mbushjeve specifike në stomatologji, pajisjeve intrauterine, etj. , duke e bërë kështu rëndësinë e diagnostikimit paraprak dhe trajtimit jetike për këta pacientë. Imunoterapia për nikelin dhe terapitë biologjike që janë në studim mbeten hapa madhorë në trajtimin e hipersensibilitetit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientëve që vuajnë nga kjo alergji.

Fjalë kyçe: Alergji, nikeli, metale.

VENTILIMI JOINVAZIV (NIV), NË TRAJTIMIN E INSUFICIENCËS RESPIRATORE AKUTE HIPERKAPNIKE, EKSPERIENCA JONË KLINIKE.

Dr. shk. Dhimitraq Argjiri, Dr. Viola Selmani, Dr. Eritjan Tashi, Dr. Jonalda Bami, Dr. Eda Gjordeni

Qendra Spitalore Rajonale “Shefqet Ndroqi”, Tiranë; Shërbimi i Pneumologjisë; Klinika I - rë.

Abstrakt
Hyrje: Ventilimi joinvaziv (NIV) është administrimi i suportit ventilator duke përdorur maska ose mjete të ngjashme, pa përdorimin e një rrugë artificiale respiratore si tub endotrakeal ose tub trakeostome. Ventilimi joinvaziv pakëson punën e muskujve respiratorë, rrit volumin tidal, ul frekuencën respiratore. VJI është trajtim i zgjedhur në pacientët me Sëmundje Pulmonare Obstruktive Kronike (SPOK) të riakutizuar me insuficiencë respiratore hiperkapnike.
Qëllimi i studimit: Është të raportojë mbi përvojën tonë në trajtimin e insuficiencës respiratore akute hiperkapnike me NIV, në klinikën e pneumologjisë.

Materiali dhe metoda: Ne analizuam në mënyrë retrospektive të dhënat demografike dhe klinike të pacientëve me insuficiencë respiratore akute hiperkapnike të trajtuar me NIV për një periudhë njëvjeçare (tetor 2024–shtator 2025). Variablat në studim ishin: mosha, seksi, pH, $PaCO_2$, PaO_2 dhe $SatO_2$ para NIV, 1–2 orë pas NIV dhe në përfundimin e NIV. U analizua gjithashtu diferenca në efikasitetin e NIV sipas vendit të aplikimit dhe kohës së fillimit, komplikacionet gjatë trajtimit dhe shkaku i dështimit.
Rezultate: Bazuar në të dhënat e studimit, mosha mesatare e pacientëve ishte 62. 0 ± 14. 1; raporti M / F: 2: 1. Indikacioni më i shpeshtë për NIV ishte përkeqësimi akut i COPD (AECOPD: 50%), sindromi i hipoventilimit nga obeziteti (20%), overlapi COPD / apnea e gjumit (20%) dhe sëmundjet neuromuskulare (10%). Shumica e pacientëve (55%) rezultojnë në gradën e tretë të dispnesë sipas mMRC, 40% e rasteve në gradën e dytë dhe vetëm 5% e pacientëve në gradën e katërt. pH mesatar para fillimit të NIV ishte 7. 327 ± 0. 054; $PaCO_2$ mesatar 63. 16 ± 12. 3 mmHg (min: 47. 9 dhe max: 96. 1 mmHg). IPAP mesatar ishte 16. 05 ± 4. 3 cmH_2O; EPAP mesatar 6 ± 0. 59 cmH_2O; Pressure Support (PS) mesatar 9. 95 ± 1. 09 cmH_2O (min 8 cmH_2O dhe max 13 cmH_2O).
Komplikacionet më të shpeshta si efekte anësore të lidhura me NIV ishin: ulçeracioni i lëkurës së hundës, tharje të mukozave, axhitimi dhe në një rast hipotension i rëndë.
Konkluzione: NIV shpëton jetë në forma të caktuara të insuficiencës respiratore akute, veçanërisht tek pacientët me riakutizim të COPD, duke ulur nevojën për intubim dhe komplikacionet e lidhura me të. Është një mjet i domosdoshëm në arsenalin e kujdesit respirator modern. Fillimi i trajtimit me NIV, titrimi, monitorimi dhe vlerësimi i efikasitetit janë tashmë kompetenca të padiskutueshme të pneumologëve në repartet e pneumologjisë. Trajnimi praktik i ekipeve (vendosja e maskës, identifikimi i asinkronive, menaxhimi i pajisjeve) rrit shkallën e suksesit të NIV.

Fjalë kyçe: Insuficienca respiratore akute, NIV, BiPAP, Astrupograma.

SËMUNDJA E MEMBRANËS SË HOLLË BAZALE GLOMERULARE. DIAGNOZA, TRAJTIMI, PROGNOZA.

Prof. Diamant Shtiza[1], Dr. Ornela Xhango[1], Prof. Enkelejda Shkurti[2]
[1]Departamenti i Pediatrisë, Shërbimi i Nefrologjisë dhe Hemodializës Pediatrike, QSUT, UMT
[2]Lektore e Statistikës, FSHMT, UMT

Abstrakt
Sëmundja e membranës së hollëbazale glomerulare është një sëmundje e rrallë gjenetike.
Incidenca e saj është 5 - 9% të popullsisë. Në bazë të saj qëndron prania e rruazave të kuqe në urinë. Përgjithësisht, pacientët janë asimptomatikë. Diagnoza realizohet dhe konfirmohet nga biopsia renale. Ajo duhet të diferencohet me sëmundjet e tjera gjenetike, kryesisht me Sindromin Alport, por edhe me shkaktarët e tjerë të mikro dhe makrohematurisë, si IgA nefropatia, hiperokslauria etj. Kërkon një ndjekje progresive. Administrohet me trajtime që bazohen te ACE inhibitoret. Prognoza në shumicën e rasteve është e mirë.

Fjalë kyçe: Membrana bazale glomurale, sëmundje gjenetike, trajtim.

SINDROMI NEFROTIK.

Dr. Era Guda, Prof. Dr. Diamant Shtiza.

Abstrakt
Hyrje: Sindromi nefrotik është një grup simptomash që ndodhin për shkak të dëmtimit të veshkave dhe karakterizohet nga proteinuria, edemë, hiperlipidemia dhe hipotensioni.
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë mekanizmat e patogjenezës, paraqitjen klinike dhe trajtimin e sindromit nefrotik, duke analizuar ndikimin e faktorëve të ndryshëm etiologjikë dhe efektivitetin e terapive moderne.
Metodologjia: Studimi përfshin një analizë retrospektive të rasteve klinike të pacientëve me sindrom nefrotik të trajtuar në Klinikën e Pediatrisë – Reparti i Nefrologjisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, gjatë periudhës 2020–2025, me një ndarje të këtyre viteve në dy periudha, periudhën e parë post COVID (vitet 2020 - 2023)

dhe në periudhën e dytë post COVID (vitet 2024 - 2025) me një analizë më të detajuar mbi periudhën e dytë me vëmendje të veçantë mbi rezultatet e analizave të urinës, biokimisë së gjakut dhe përgjigjen ndaj trajtimit me kortikosteroide.
Rezultatet: Studimi përfshiu 96 pacientë me sindrom nefrotik (61. 5% meshkuj, mosha mesatare 8 vjeç). Shumica vinin nga Tirana (46. 3%). Në periudhën 2020–2023 u regjistruan më shumë raste se në vitet 2024 - 2025. Kohëzgjatja mesatare e shtrimit varionte 8. 8 - 16. 2 ditë. Simptomat kryesore ishin lodhja, temperatura dhe edemat. Analizat treguan hipoalbuminemi, proteinuri të lartë dhe hiperlipidemi. Terapia më e përdorur ishte prednisoni, albumina, diuretikët dhe antibiotikët. Numri i recidivave ishte më i lartë në vitin 2024.
Përfundime: Sindromi nefrotik pediatrik u shfaq kryesisht tek meshkujt me moshë mesatare 8 vjeç. Gjetjet klinike dhe laboratorike pasqyrojnë tiparet tipike të sëmundjes. Rezultatet theksojnë nevojën për diagnostikim të hershëm dhe monitorim të vazhdueshëm.

Fjalë kyçe: sindromi nefrotik, patogjeneza, analizat laboratorike, biokimia e gjakut, terapitë me imunosupresore.

DIAGNOSTIKA E URGJENCËS PEDIATRIKE NË QYTETIN E SHKODRËS.

Prof. Dr. Diamant Shtiza, Sibora Lohja

Abstrakt
Hyrje: Urgjencat pediatrike përfaqësojnë një sfidë madhore për shëndetin publik, pasi fëmijët janë më vulnerabël ndaj gjendjeve akute. Këto përfshijnë patologji respiratore, gastrointestinale, neurologjike, infektive dhe traumatike, të cilat kërkojnë diagnostikim të hershëm dhe menaxhim të menjëhershëm.
Qëllimi: Ky studim synon të vlerësojë shpërndarjen e diagnozave pediatrike në urgjencën e Spitalit Rajonal të Shkodrës gjatë vitit 2024, në varësi të faktorëve demografikë dhe sezonalë, si dhe të identifikojë diagnozat më të shpeshta duke i lidhur me faktorë demografikë, sezonalë, parametrat laboratorikë dhe manifestimet klinike.
Objektiva: Objektivat e studimit përfshijnë identifikimin e patologjive më të zakonshme në urgjencën pediatrike, analizimin e variacioneve sezonale dhe grupmoshave, si dhe vlerësimin e ndryshimeve klinike e laboratorike në sëmundjet kryesore.
Metodologjia: U krye një studim prospektiv duke u bazuar në shqyrtimin e kartelave klinike në Spitalin Rajonal Shkodër gjatë vitit 2024. U analizuan 5000 pacientë pediatrikë të përzgjedhur në mënyrë rastësore të cilët morën terapi ditore, ose u shtruan në njësinë klinike të pavionit apo reanimacionit.
Rezultate: Shumica e rasteve, 77% e tyre, u trajtuan në terapinë ditore, 20% në pavion dhe vetëm 3% në reanimacion. Meshkujt përbënin 57% të rasteve, ndërsa grupmosha më e prekur ishte 2–5 vjeç (44%). 53% e pacientëve vinin nga zonat rurale. Patologjitë më të shpeshta ishin infeksionet virale në terapinë ditore, bronkopneumonia bilaterale në pavion dhe bronkioliti akut në reanimacion, me shpërndarje sezonale karakteristike: infeksionet respiratore mbizotëruan në dimër dhe pranverë, ndërsa gastroenteritet në verë.
Përfundime: Studimi tregon se patologjitë infektive dhe respiratore përbëjnë barrën kryesore të urgjencës pediatrike, veçanërisht tek fëmijët nën 5 vjeç dhe në zonat rurale. Bronkioliti akut, bronkopneumonia dhe infeksionet virale dominojnë në frekuencë, ndërsa parametrat laboratorikë dhe shenjat klinike mbeten të domosdoshme për diferencimin diagnostik dhe menaxhimin e saktë të rasteve.

Fjalë kyçe: Urgjenca pediatrike, diagnoza, bronkioliti akut, bronkopneumonia, infeksione.

PSORIAZA INVERSE SI SFIDË NË DIAGNOZË DHE TRAJTIM: RAPORTIM RASTI.

Diana Muja[1], Prof. Ermira Vasilili[2], Migena Gega[3,] Valbona Zenelaj[4]
[1]*Dermatologe, Poliklinika e Specialiteteve nr 2, Tiranë*
[2]*Shefe e Shërbimit të Dermatologjisë*
[3]*Dermatologe, Klinika Skin Tech, Tiranë*
[4]*Dermatologe, Spitali i Traumës, Tiranë*

Abstrakt
Hyrje: Psoriaza është një sëmundje kronike, inflamatore e lëkurës, me një prevalencë në popullate rreth 2%. Është një nga dermatozat më të zakonshme që prekin lëkurën gjenitale. Psoriaza inverse (intertriginoze)

karakterizohet nga përfshirja e zonave të plikave kutane siç jane ato inguinale, gluteale, aksilat dhe organet gjenitale. Ekzistojnë pak studime të bazuara në evidencë mbi trajtimin e psoriazës inverse. Ne raportojmë një rast të psoriazës inverse të trajtuar me sukses me acitretinë.
Materiale dhe metoda: Pacientja 50 - vjeçare u paraqit në departamentin tonë të dermatologjisë me pllaka eritematoze në vulvë, regionin inguinal dhe zonën perianale. Pacientja kishte marrë më parë një gamë të gjerë trajtimesh topikale dhe sistemike, të cilat u ndërprenë për shkak te efekteve anësore. Ajo u trajtua me acitretinë 25 mg në ditë për 4 javë dhe më pas për 8 javë 10 mg, me përmirësim të dukshëm të lezioneve kutane dhe mukozale. Pacienti paraqitet në remision të plotë në kontrollin pas 6 muajsh, me takrolimus 0. 1% lokalisht.
Rezultate dhe diskutime: Psoriaza gjenitale është një sëmundje e lëkurës që shkakton shqetësim të madh fizik dhe emocional tek pacientët. Është e rëndësishme të përfshihet ekzaminimi i regionit gjenital në praktikën klinike të përditshme. Kërkimet në këtë fushë janë të varfra. Acitretina është alternativë efektive dhe e përshtatshme për trajtimin e psoriazës inverse, me kontroll efektiv të sëmundjes.
Konkluzione: Medikamente sistemike dhe topikale mund të përmirësojnë lezionet e psoriazës inverse, por mungojnë evidencat për të udhëhequr vendimmarrjen klinike. Pavarësisht prevalencës së lartë të psoriazës inverse, pothuajse gjysma e pacientëve me lezione intertriginoze nuk diskutojnë simptomat e tyre me mjekun.
Rekomandime: Mungesa e komunikimit dhe ndërgjegjësimit për psoriazën inverse në mjedisin shëndetësor mund të çojë në nën - diagnostikim dhe nën - trajtim të saj, duke rritur më tej rrezikun e vetetrajtimeve të papërshtatshme.

Fjalë kyçe: Psoriaza, sëmundje kronike, inflamatore.

TESTET SEROLOGJIKE PËR DIAGNOSTIKIMIN E COVID - 19.

Diar Buzhala

Absrakt
Hyrje: Testet serologjike kanë një rëndësi të veçantë në menaxhimin dhe kontrollin e pandemisë së Covid - 19, duke ndihmuar në monitorimin e përhapjes së virusit dhe vlerësimin e imunitetit në popullatë. Ato identifikojnë antitrupat, e klasës IgM dhe IgG, të zhvilluara pas infektimit ose vaksinimit, duke mundësuar krijimin e një kuptimi më të qartë për dinamikën e infeksionit dhe efektivitetin e ndërhyrjeve shëndetësore. Deri më tani, janë aplikuar disa lloje testesh serologjike duke përdorur teknikat ELISA, CLIA dhe LFIA, secila me avantazhet dhe kufizimet e veta. Përdorimi i këtyre testeve ka nxjerrë në pah sfida të tilla si ndjeshmëria dhe specificiteti i ulët, vonesa në zhvillimin e antitrupave dhe kufizimet në matjen e imunitetit afatgjatë. Megjithatë, ato mbeten një mjet i vlefshëm për studimet epidemiologjike, monitorimin e imunitetit të popullatës dhe përmirësimin e politikave shëndetësore. Në përfundim, testet serologjike ofrojnë një kontribut të rëndësishëm në menaxhimin e pandemisë, por kërkojnë një përdorim të kujdesshëm dhe të mirëinformuar. Nevojiten përmirësime teknologjike dhe protokolle të standardizuara për të rritur saktësinë e tyre, ndërkohë që respektohen parimet etike dhe ruhet privatësia e individëve.

Fjalë kyçe: testet serologjike, covid - 19, imunitet, epidemiologji, politikat shëndetësore.

NDIKIMI I TERAPISË BIOLOGJIKE NË MIKROBIOMËN INTESTINALE TË PACIENTËVE ME SËMUNDJE INFLAMATORE TË ZORRËVE.

Diar Kabashi, Argjira Juniku - Shkololli
Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës
Klinika e Gastroenterologjisë, Qendra Klinike Universitare e Kosovës

Abstrakt
Sëmundjet inflamatore të zorrëve (SIZ) paraqesin sfidë komplekse për mjekësinë moderne, ku zhvillimet e fundit në fushën molekulare dhe analitike kanë hapur mundësi të reja për diagnostikim dhe monitorim. Roli i mikrobiomës në ruajtjen e shëndetit intestinal po studiohet intenzivisht për shkak të ndikimit të saj në përgjigjen ndaj terapisë, duke ofruar kështu një perspektivë të re për menaxhimin e SIZ. Ky punim synon të identifikojë markuesit mikrobiomikë që parashikojnë efektivitetin e trajtimeve dhe të ndihmojnë në personalizimin e terapive për pacientët. Studimi bazohet në një analizë gjithëpërfshirëse të literaturës shkencore dhe studimeve

klinike, duke integruar të dhëna nga teknikat molekulare dhe analitike moderne. Poashtu do të paraqiten të dhëna nga projekti, i cili është duke u zhvilluar në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës tek pacientët me SIZ. Përdorimi i metodave si PCR, ekstraktimi i ADN - së, metabolomika dhe proteomika ka lejuar identifikimin e ndryshimeve në përbërjen dhe funksionin e mikrobiomës tek pacientët që marrin terapi biologjike. Rezultatet tregojnë një korrelacion të fortë midis ndryshimeve në mikrobiomë dhe përgjigjes ndaj terapisë biologjike. Këto gjetje sugjerojnë se monitorimi i mikrobiomës mund të shërbejë si një mjet prognostik dhe diagnostik, duke e bërë të mundur një vlerësim më të saktë të efektivitetit të trajtimeve të SIZ. Integrimi i analizave mikrobiomike në protokolet klinike të menaxhimit të IBD - së ofron një qasje inovative dhe të personalizuar që mund të përmirësojë cilësinë e jetës së pacientëve. Rezultatet theksojnë nevojën për studime të mëtejshme për të thelluar njohuritë mbi markuesit mikrobiomikë dhe për të optimizuar përdorimin e terapisë biologjike në një ambient klinik të vazhdueshëm.

Fjalë kyçe: Mikrobiomë, sëmundje inflamatore e zorrëve (SIZ), terapi biologjike, monitorim, cilësi jete.

HERNIET E MURIT ABDOMINAL: STUDIM KRAHASUES NDËRMJET FORMAVE TË HERNIOPLASTIKËS SË MURIT ABDOMINAL.

Diellza Shala[1]
[1]Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Prishtinë, Kosovë
[2]Spitali Rajonal i Prizrenit "Prim. Dr. Daut Mustafa", Reparti i Kirurgjisë Abdominale, Prizren, Kosovë

Abstrakt
Hyrje: Hernia është një protruzion(dalje) jonormale e përmbajtjes kavitare përmes një pike të dobët të murit të kavitetit, duke marrë me vete të gjitha shtresat mbështjellëse të kavitetit abdominal. Herniet mund të konsiderohen si "shembje apo defekt", qoftë anatomikisht apo të (fituara) dhe qoftë për shkak të çrregullimeve të trashëguara (kongenitale) të kolagjenit, megjithatë këta dy faktorë zakonisht veprojnë së bashku tek shumica e pacientëve. Herniet mund të shfrytëzojnë hapje natyrore siç janë kanalet inguinale, kanalet femorale, kërthiza ose mund të dalin përmes "zonave të dobësuara" (p. sh. hernia epigastrike) ose nga një prerje kirurgjikale. Herniet abdominale kanë një qeskë peritoneale, qafa e së cilës shpesh është e ngushtë dhe përbën një burim të mundshëm kompresimi të përmbajtjes së hernies.
Qëllimi: Qëllimi i punimit është analizimi pacientëve të trajtuar në Spitalin Rajonal të Prizrenit "Prim. Dr. Daut Mustafa" me hernie të murit abdominal për periudhën kohore: 1 janar 2022 - 31 dhjetor 2024. Përmes grumbullimit retrospektiv të të dhënave për një periudhë 3 vjeçare, është synuar të fitohen njohuri rreth: numrit të pacientëve me hernie të murit abdominal përgjatë periudhës 2022 - 2024, karakteristikat si gjinia, mosha, llojet e hernieve të murit abdominal, trajtimit dhe komplikimet e hernieve të murit abdominal.
Metodologjia: Hulumtimi është i tipit retrospektiv, i realizuar me të dhënat e pacientëve të protokoleve operative në repartin e kirurgjisë abdominale, në kuadër të Spitalit Rajonal të Prizrenit, "Prim. Dr. Daut Mustafa" për periudhën kohore 1 Janar 2022 - 31 Dhjetor 2024. Regjistrimi i të dhënave është realizuar me marrjen e lejeve përkatëse dhe plotësimin e principeve etike. Përpunimi dhe analizimi i të dhënave është bërë me programin Microsoft Excel dhe janë prezantuar nëpërmjet tabelave dhe grafikoneve. Është konsultuar literatura shkencore, në platforma si: PubMed, Google Scholar, etj.
Rezultatet: Nga hulumtimi i bërë për periudhën kohore nga 1 janar 2022 - 31 dhjetor 2024, në repartin e kirurgjisë abdominale në Spitajin Rajonal të Prizrenit janë konstatuar gjithsej 861 raste me hernie të murit abdominal ku prej tyre 73% janë të gjinisë mashkullore 27% janë të gjinisë femërore. Është konkluduar se grupmosha që është takuar më shpesh është 61 - 70 vjeç me 196 raste apo 23% dhe 51 - 60 vjeç me 179 raste apo 21%. Hernia inguinale e djathtë (HID) rezultoi me 23% të rasteve të përgjithshme me 204 pacientë. Pas saj vjen menjëherë hernia inguinale e majtë (HIS) me 16% të rasteve të përgjithshme ose me 138 pacientë. Trajtimi kirurgjikal me mesh apo (me rrjetë) është metoda më e shpeshtë nga të gjitha llojet e trajtimeve kirurgjikale me 46% të rasteve apo me 395 pacientë. Në Spitalin Rajonal të Prizrenit, shumica e hernieve janë trajtuar në program elektiv (të planifikuar), ndërkaq 4% prej tyre apo 32 pacientë janë trajtuar në mënyrë emergjente si hernia e inkarceruar (H inkarc.). Dhe si komplikimi më i shpeshtë ishte Hernia recidivante(HR) me 3% të rasteve apo 23 pacientë.
Përfundime: Meshkujt ishin më të prekur nga herniet e murit abdominal 73% të rasteve krahasuar me femrat 24% të rasteve, duke treguar një prevalencë më të lartë te meshkujt. Grupmosha që është takuar më shpesh është 61 - 70 vjeç me 196 raste apo 23% dhe 51 - 60 vjeç me 179 raste apo 21%. Hernia inguinale e djathtë (HID)

ishte lloji më i shpeshtë i hernieve të murit abdominal e ndjekur pas me hernien inguinale të majtë (HIS). Trajtimi kirurgjikal me mesh (me rrjetë) ishte trajtimi më i zakonshëm i hernieve të murit abdominal. Hernia recidivante (HR) ishte komplikimi më i shpeshtë i hernieve të murit abdominal në Spitalin Rajonal të Prizrenit.

Fjalë kyçe: Hernia abdominale, studim retrospektiv, hernia inguinale, trajtimi kirurgjikal me rrjetë, komplikimet post - operatore.

KOMORBIDITETI DHE ETIOPATOGJENEZA E DERMATIT SEBOROIK.

Dr. Diellza Tahiraj, MD

Abstrakt

Hyrje: Dermatiti seboroik është një sëmundje inflamatore kronike, që paraqitet kryesisht në zonat seboroike të trupit të njeriut. DS manifestohet me shfaqjen e shtresave të yndryshme me ngjyrë të kuqe më shpesh në pjesën e kokës, krahërorit dhe fytyrës.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është shqyrtimi në mënyrë të detajuar i faktorëve etiopatogjenikë të dermatitit seboroik dhe vlerësimi i komorbiditeteve me qëllim përmirësimin e trajtimit dhe prevenimit të dermatitit seboroik.

Metoda dhe Metodologjia: Ky punim është rishqyrtim i literaturës dhe hulumtimeve të fundit me shumë relevancë mbi komorbiditetin dhe etiopatogjenzën e dermatit seboroik. Punim është i bazuar nga literature e dermatologjisë vendëse dhe asaj ndërkombëtare si dhe nga pubmed, scopus etj.

Rezultate dhe Diskutimi: Në studimet e analizuara ka të dhëna të cilat tregojnë që pacientët me dermatit seboroik në të shumtën e rasteve kanë qenë të përcjellur me sëmundje të tjera shoqëruese që lidhen me sisitemin imunitar, nervor, hipertensionin, diabetin mellitus, osteoporozën etj. Komorbiditetet më të shpeshta tek këta pacientë ishin ato kutane më gjegjësisht acne vulgaris, rosacea, dermatitis atopik dhe psoriaza. Duke u bazuar në rezultatet e studimeve të analizuara doli që sëmundja e Parkinsonit kishte rezultuar si sëmundja neurologjike më e shpeshtë tek këta pacientë. HIV, diabeti mellitus dhe sindroma metabolike po ashtu ishin prezente te një numër i madh i pacientëve. Dhe në studimet krahasuese tek pacientët me ose pa dermatit seboroik kur i është analizuar tensionin arterial ka rezultuar se pacientët me DS kanë pasur tension artetial më të lartë 27. 1% në krahasim me pacientët pa dermatit seboroik. Etiopatogjeneza e DS është multifaktoriale dhe përfshin ndërveprimeve të shumë faktorëve, duke filluar nga aktiviteti i tepërt i gjëndrave dhjamore pastaj kërpudha Malassezia që me anë të lipideve të sebumit arrin të çlirojë substanca që irritojnë lëkurën dhe nxisin një reagim inflmator. Disbalanca hormonale, faktori gjenetik, mungesa e lëndëve ushqyese (B6, B2, Zink) poashtu kanë ndikim në paraqitjen e DS.

Përfundimi: Dermatiti seboroik është një sëmundje lëkurore që gërsheton në vete faktorë të shumtë etiopatogjenikë dhe ka shkallë të lartë të komorbiditetit. Sëmundja e Parkinsonit, HIV / AIDS, diabeti mellitus, sindroma metabolike, demenca, psoriaza, rosacea, hipertensioni dhe çrregullimet psikiatrike janë të pranishme me frekuencë të lartë te pacientët me dermatit seboroik. Etiopatogjeneza është komplekse, që përfshin ndërveprimin ndërmjet aktivitetit të shtuar të gjëndrave sebace, kolonizimit nga Malassezia, disbalancës hormonale dhe mungesën e lëndëve ushqyese dhe kërkon një qasje multidisiplinare për diagnostikimin dhe trajtimin efektiv të kësaj sëmundjeje.

Fjalë kyçe: dermatitis seboroik, malassezia, gjëndrat sebace, hipertension, Parkinson.

KUR ANKESA NUK PËRPUTHET ME DIAGNOZËN: ZBULIMI I MODELEVE KLINIKE NË KUJDESIN URGJENT PARËSOR.

Donart Zymberi

Abstrakt

Hyrje: Në urgjencën parësore, diagnoza shpesh vendoset pa luksin e analizave laboratorike apo imazherisë. Në këtë realitet të përditshëm, mjekët përballen me ankesa të paqarta ose të gabuara, që fshehin sëmundje serioze. Aftësia për të njohur modelet klinike të fshehura dhe për të interpretuar sinjalet delikate bëhet thelbësore për të shmangur vonesa kritike në trajtim. Qëllimi i këtij punimi është të dokumentohen pesë raste akute, ku ankesa

kryesore ishte dukshëm e ndryshme nga diagnoza përfundimtare, duke theksuar rëndësinë e ekzaminimit fizik dhe vigjilencës klinike në vendimmarrje.
Metodologjia: Punimi përmbledh pesë raste të vërteta nga praktika ditore e kujdesit urgjent parësor. Rastet janë përzgjedhur për kompleksitetin e paraqitjes dhe vlerën mësimore. Të gjitha janë menaxhuar në kontaktin e parë, pa ndjekje të mëvonshme ose imazheri të avancuar.
Rezultate: Rasti i parë përfshinte një mashkull me dhimbje epigastrike pas ushqimit, që rezultoi infarkt miokardi inferior pas rikthimit të simptomave dhe zhvillimit të pa rehatësisë mandibulare. Rasti i dytë ishte një grua me marramendje të përsëritshme, me tension arterial 250 / 120 mmHg – urgjencë hipertensive e padeklaruar. Rasti i tretë përfshinte një mashkull me dhimbje mesi dhe këmbë, por pa puls periferik dhe me diferencë tensioni ndërmjet krahëve – një diseksion aorte me ishemi të gjymtyrës e maskuar si sciatica. Rasti i katërt ishte një mashkull i moshuar me nevoja të veqanta, me ankesa të gripit që rezultoi një hepatit fulminant i maskuar nga kushtet e jashtme të ambientit. Rasti i fundit, një mashkull 57 - vjeçar me ndjesi "shkëputjeje", u diagnostikua me fibrilacion atrial në mungesë të simptomave kardiake.
Përfundim: Ky punim nuk paraqet thjesht pesë raste, por pesë mësime të qarta mbi pasigurinë e prezantimit klinik dhe fuqinë e vëmendjes diagnostike në mungesë të mjeteve të avancuara. Për mjekët në vijën e parë, aftësia për të dyshuar përtej asaj që duket është shpesh vendimtare.

Fjalë kyçe: diagnozë, pacient, ankesë etj.

NDRYSHIMI NË BMI, PESHË DHE GJATËSI NË FËMIJËT E TRAJTUAR ME LLA DHE LIDHJA E TYRE ME ECURINË E SËMUNDJES.

Gentjan Dyrmishi, Donjeta Bali1, Mirela Xhafa1, Mirzana Kapllanaj1, Enkeleda Duka[1], Besjana Dibra[1]
[1]Shërbimi i Onkohematologjisë Pediatrike
Departamenti i Pediatrisë
Fakulteti i Mjekësisë, UMT

Abstrakt
Hyrje: Leuçemia Limfoblastike Akute (LLA) është neoplazia hematologjike më sfiduese e mjekësisë pediatrike, por falë përparimeve terapeutike, mbijetesa 5 - vjeçare sot i kalon 80%. Kjo mbijetesë shoqërohet shpesh me komplikacione afatgjata, ku më i zakonshmi është mbipesha dhe obeziteti i induktuar nga trajtimi. Rritja e BMI - së gjatë trajtimit nuk është vetëm pasojë, por përfaqëson një faktor rreziku për patologji metabolike si diabeti tip 2, sëmundjet kardiovaskulare, recidiva të hershme apo neoplazi sekondare.
Qëllimi: Të vlerësojë lidhjen ndërmjet trajtimit të LLA - së dhe parametrave antropometrikë, me fokus të veçantë në shfaqjen dhe progresin e peshës deri obezitet.
Metodologjia: Studim kohort retrospektiv, observacional dhe longitudinal qe përfshin të dhënat e fëmijëve të diagnostikuar me LLA, trajtuar në shërbimin e Onko - Hematologjisë Pediatrike pranë "Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza", gjatë periudhës 2015 - 2025. Nga 153 pacientë gjate kësaj periudhe, 44 pacientë u përfshinë në analizë më të plotë. Në lidhje me peshën gati 55% e tyre kishin peshë mbi normale në momentin e diagnozës dhe në përfundim të mjekimit mbajtës kjo vlerë rritet në 73%. Sa i përket gjatësisë, 3 pacientë kishin vonesë në rritje në momentin e diagnozës, ndërsa pas trajtimit numri i tyre u rrit mbi dyfish. Vlerat e BMI - SDS > +2, që korespondojnë me obezitetin, pothuajse u trefishuan deri në përfundim të trajtimit, ndërkohë që numri i pacientëve me BMI - SDS < - 2 u reduktua nga 7 në 1 raste. 7 pacientë bënë recidivë pas përfundimit të trajtimit dhe prej tyre 3 ishin mbipeshë në diagnozë dhe 100% ishin mbipeshë në përfundim të mjekimit mbajtës. 2 pacientë mbipeshë / obezë u diagnostikuan me diabet mellitus dhe 4 patën çregullime kardiake.
Konkluzione: Mbipesha\obeziteti mbeten shqetësues për shkak të lidhjes së tyre me zhvillimin e patologjive shoqëruese dhe rrezikut për rikthim të sëmundjes. Në këtë kontekst, monitorimi periodik i BMI - së që në fazat e hershme të trajtimit dhe nevoja për implementim te ndërhyrjeve multidisiplinare për menaxhimin e peshës trupore gjatë gjithë procesit terapeutik, pas tij dhe afatgjatë vite pas trajtimit mbeten imperative.

Fjalë kyçe: leuçemi limfoblastike akute, femije, trajtim, bmi, komplikacione.

NDRYSHIMET OKULARE NË FËMIJËT E TRAJTUAR PËR MALINJTETE DHE MENAXHIMI I TYRE.

Livia Varaku, Donjeta Bali[1], Mirela Xhafa[1], Mirzana Kapllanaj[1], Enkeleda Duka[1], Besjana Dibra[1]
[1] *Shërbimi i Onkohematologjisë Pediatrike, Departamenti i Pediatrisë*
Fakulteti i Mjekësisë, UMT

Abstrakt

Hyrje: Në dekadat e fundit, mjekësia pediatrike onkologjike ka përjetuar përparime të rëndësishme, duke çuar në rritje të ndjeshme të mbijetesës afatgjatë. Në Shqipëri, falë zbatimit të protokolleve të standardizuara ndërkombëtare dhe përmirësimit të aksesit në terapi, është bërë e mundur rritja e shkallës së kontrollit të sëmundjes dhe mbijetesës. Manifestimet oftalmologjike përfshijnë një spektër të gjerë patologjish, nga çrregullimet okulomotorike (nistagmus, strabizëm, diplopi), papiledema dhe neuropatitë optike toksike, te retinopatitë eksudative, atrofia e nervit optik, gabimet refraktive, edemat orbitale, deri te komplikacionet vaskulare retinale. Shkaqet janë multifaktoriale: efektet toksike prej agjentëve kimioterapikë, neurotoksiciteti e radioterapia kraniale, komplikacione prej ndërhyrjeve kirurgjikale cerebrale apo invazion direkt nga masa tumorale në orbitë apo tru. Komplikacionet okulare përbëjnë një sfidë të veçantë për shkak të ndikimit potencialisht të përhershëm në zhvillimin vizual, funksionalitetin dhe cilësinë e jetës së fëmijëve. Ndërhyrja e hershme, diagnostikimi në kohë dhe monitorimi i strukturuar janë thelbësore për të parandaluar dëmtimet permanente.

Qëllimi: Studimi synon të informojë dhe të ofrojë udhëzime bazë, veçanërisht për mjekun e familjes, pediatrin, mjekun specialist okulist dhe për të gjithë stafin mjekësor multidisiplinar, lidhur me komplikacionet okulare më të shpeshta që shfaqen para, gjatë dhe pas trajtimit per malinjitete, si dhe të nxisë një ndjekje sa më të mirë dhe monitorim afatgjatë të këtyre efekteve.

Metodologjia: Ky është një studim kohort, retrospektiv, observacional dhe longitudinal, që përfshin gjithashtu një review narrativ të literaturës. Për realizimin e këtij punimi u hulumtuan të dhëna mbi komplikacionet okulare dhe lidhjen e tyre me kohën e shfaqjes, gjininë, moshën dhe llojin e trajtimit. U përdorën 235 burime, nga PubMed, MEDLINE, Frontiers, Cochrane, etj, të periudhës 2010–2024. Studimi deskriptiv u bë mbi pacientët e trajtuar në Shërbimin e Onkohematologjisë Pediatrike gjatë 2020–2024, bazuar në regjistrin e shtrimeve dhe kartelat përkatëse të repartit dhe shërbimit ditor. 20 nga 236 pacientë (8. 5%) paraqitën manifestime okulare: çrregullimet okulomotorike (35%), papiledema (25%) dhe edemë orbitale / periorbitale (15%). Pjesë e studimit ishte edhe një seri rastesh specifike, të ilustruara në detaje, që përfshinte tre pacientë.

Konkluzione: Komplikacionet okulare u shfaqën në 8. 5% të pacientëve të studiuar. Barrierat praktike, si qasja e kufizuar në shërbime, niveli i ulët socio - ekonomik dhe mungesa e personelit të specializuar mjekësor, mund të vonojnë trajtimin dhe të rrisin rrezikun e dëmtimeve vizuale. Një qasje e integruar dhe proaktive interdisiplinare është kyç për përmirësimin e cilësisë së jetës së këtyre pacientëve.

Fjalë kyçe: Komplikacione okulare, kancer, fëmijë, trajtim, cilësi jete.

OBEZITETI DHE GERD.

Dr. Dorentina Ukmata

Abstrakt

Hyrje: Sëmundja e refluksit gastroezofageal (GERD) është një gjendje e përhapur që manifestohet kryesisht me urth dhe regurgitim. Ajo lidhet ngushtë me obezitetin, i cili është në rritje të vazhdueshme dhe përbën një faktor kryesor rreziku. Obeziteti ndikon negativisht në funksionimin e sistemit gastroezofageal duke rritur presionin intraabdominal dhe duke lehtësuar kthimin e përmbajtjes së stomakut në ezofag.

Qëllimi: Ky punim synon të shqyrtojë lidhjen mes obezitetit dhe GERD, duke vlerësuar mekanizmat që i lidhin këto dy gjendje, rëndësinë klinike dhe opsionet kryesore të trajtimit, përfshirë rolin e ndërhyrjeve konservative dhe kirurgjikale.

Metodologjia: U analizuan të dhëna nga udhëzimet klinike të fundit dhe publikime në PubMed mbi epidemiologjinë, patofiziologjinë dhe trajtimin e GERD te individët obezë, duke krahasuar efektet e strategjive të ndryshme të reduktimit të peshës.

Rezultate: Studimet tregojnë se prevalenca e GERD rritet në mënyrë të qartë me shtimin e peshës trupore. Humbja e peshës shoqërohet me reduktim të simptomave, ulje të nevojës për terapi me ilaçe dhe parandalim të

komplikacioneve si ezofagiti dhe Barrett. Nga ndërhyrjet kirurgjikale, bypass - i gastrik ka dhënë rezultatet më të qëndrueshme në përmirësimin e GERD, ndërsa procedurat si sleeve gastrectomy dhe gastric banding kanë dhënë rezultate të ndryshme dhe jo gjithmonë pozitive.
Diskutime: Obeziteti është një determinant i rëndësishëm i GERD, dhe menaxhimi i tij duhet të jetë pjesë qendrore e trajtimit. Ndërhyrjet në stilin e jetesës janë të domosdoshme për të gjithë pacientët, ndërsa kirurgjia bariatike–veçanërisht bypass - i gastrik–rekomandohet në obezitetin e rëndë me simptoma refraktare.
Përfundime: Trajtimi i obezitetit jo vetëm që redukton incidencën dhe ashpërsinë e GERD, por gjithashtu përmirëson cilësinë e jetës dhe ul rrezikun e komplikacioneve. Për këtë arsye, kontrolli i peshës duhet të konsiderohet si strategji themelore në menaxhimin afatgjatë të GERD.

Fjalë kyçe: GERD, obezitet, humbje peshe, refluks, kirurgji bariatike, bypass gastrik.

INTELIGJENCA ARTIFICIALE NË IMAZHERI MJEKËSORE DHE DIAGNOSTIKE.
Doresa Rraci.

Abstrakt
Hyrje: Inteligjenca artificiale (IA) është shndërruar në një nga teknologjitë më transformuese në imazherinë mjekësore, sidomos falë rrjeteve të thella nervore dhe modeleve me transformera. Aplikimet e saj shtrihen në radiologji, patologji, dermatologji dhe oftalmologji, duke përfshirë klasifikimin e imazheve, segmentimin, zbulimin e anomalive dhe përmirësimin e imazheve me dozë të ulët.
Qëllimi: Ky punim synon të shqyrtojë rolin e IA në imazherinë mjekësore, duke theksuar arritjet e fundit, implikimet klinike dhe sfidat e vazhdueshme në integrimin praktik.
Metodologjia: Është realizuar një përmbledhje narrative e studimeve më të rëndësishme të publikuara gjatë viteve 2020–2025, duke u bazuar në rishikime me ndikim dhe analiza sistematike nga databaza si PubMed, Scopus dhe burime të tjera me recensim shkencor.
Rezultate: Evidencat tregojnë se IA mund të rrisë ndjeshëm saktësinë diagnostike, të reduktojë variabilitetin mes specialistëve dhe të përmirësojë efikasitetin e proceseve klinike. Modelet gjenerative hapin mundësi të reja për krijimin e të dhënave sintetike dhe reduktimin e zhurmës në imazhe. Megjithatë, mbeten sfida të tilla si përgjithësueshmëria për popullata të ndryshme, mungesa e transparencës në vendimmarrje dhe barrierat rregullatore.
Përfundime: IA ka potencial të riformësojë imazherinë diagnostike duke përmirësuar precizionin, efikasitetin dhe aksesueshmërinë. Megjithatë, për një adoptim të qëndrueshëm klinik, nevojitet më shumë validim, shpjegueshmëri dhe siguri etike.

Fjalë kyçe: inteligjenca artificiale, deep learning, imazheri mjekësore, radiologji diagnostike, shpjegueshmëri, modele gjenerative.

NËN - TIPET E KANCERIT TË GJIRIT DHE EPIDEMIOLOGJIA E TYRE.
Dorina Aliu
Spitali Hygeia, Tiranë.

Abstrakt
Hyrje: Kanceri i gjirit përbën një çështje të rëndësishme të shëndetit publik global. Ai është kanceri më i shpeshtë te gratë (24% e të gjitha rasteve me kancer tek femrat), shkaku kryesor i vdekjeve nga kanceri te gratë dhe kanceri i dytë më i zakonshëm në përgjithësi.
Objektiva: Të paraqitet panorama epidemiologjike e kancerit të gjirit dhe rëndësia e përcaktimit të nën - tipeve biologjike për diagnostikimin, trajtimin e synuar dhe strategjitë e depistimit.
Metoda: Ky studim bazohet në shqyrtimin e të dhënave epidemiologjike ndërkombëtare dhe analizën e faktorëve të rrezikut për zhvillimin e kancerit të gjirit. Për më tepër, përfshin përshkrimin e rolit të analizave imunohistokimike dhe klasifikimit molekular në përcaktimin e nën - tipeve të ndryshme të tumorit.
Diskutime: Shkalla e incidencës së kancerit të gjirit ka qenë në rritje në shumicën e vendeve me të ardhura të ulëta dhe të mesme për shkak të adoptimit të "stilit perëndimor të jetesës". Në vendet me të ardhura të larta, si

SHBA, Kanada, Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe Australia, incidenca u ul në fillim të viteve 2000, kryesisht si rezultat i reduktimit të përdorimit të terapisë hormonale postmenopauzë. Megjithatë, plakja e popullsisë ka ndikuar në rritjen e ngarkesës globale. Grupet më të rrezikuara janë popullatat në Australi, Evropë dhe Amerikën e Veriut, ku 8–9% e grave diagnostikohen me kancer gjiri përpara moshës 75 vjeç. Faktorët e rrezikut ndahen në të pandryshueshëm (mosha, gjinia, gjenetika – BRCA1 / 2) dhe të ndryshueshëm (faktorët hormonalë, mënyra e jetesës, alkooli, obeziteti). Përcaktimi i nën - tipeve përmes analizës imunohistokimike (ER, PR, HER2) është thelbësor për zgjedhjen e trajtimit të synuar. Kuptimi i ndryshimeve në imazheri sipas nën - tipeve ndihmon në përzgjedhjen e metodës më të përshtatshme (mamografi, ultratinguj, MRI) dhe në vlerësimin e përgjigjes ndaj trajtimit.

Përfundime: Njohja e trendeve epidemiologjike dhe e nën - tipeve biologjike të kancerit të gjirit është thelbësore për zhvillimin e strategjive efektive të depistimit dhe trajtimit të personalizuar. Radiologët dhe onkologët luajnë një rol kyç në planifikimin multidisiplinar të kujdesit, duke ndihmuar në përcaktimin e terapive të synuara dhe vlerësimin e përgjigjes ndaj trajtimit.

Fjalë kyçe: Kancer i gjirit, epidemiologji, nën - tipe biologjike, imazheri, terapi e synuar.

DIAGNOZA DHE MENAXHIMI I ALERGJISË USHQIMORE.

Dorina Qerimi, Etleva Qirko, Mehmet Hoxha.
Spitali Rajonal Durrës, Durrës, Shqipëri.
QSUNT, Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt

Hyrje: Alergjia ushqimore është një problem shëndetsor në rritje. Ajo ka një impakt të rëndësishëm, jo vetëm në nivel personal, por edhe në një nivel më të gjërë social dhe ekonomik. Vendosja e saktë e diagnozës në alergjinë ushqimore ka një rëndësi të veçantë sepse parandalon ekspozimin me ushqimin që mund të shkaktojë reaksion alergjie të rëndë si anafilaksi e shok anafilaktik, parashikon severitetin e reaksionit alergjik dhe tolerancën e mënyrës së konsumit të ushqimit të gjallë ose të procesuar. Duke qenë se alergjia ushqimore prek shumë shpesh moshat pedriatike është shumë e rëndësishme që të mos përjashtohen në mënyrë të panevojshme ushqime të rëndësishme në dijeten ushqimore pediatrike si qumështi, veza, etj. Standarti i artë për vendosjen e diagnozës është prova me ushqimin e dyshuar. Kjo provë jo vetëm që mbart një risk për reksion alergjik me rendesë të paparashikueshme por edhe kërkon kohë dhe kosto ekonomike. Në këto kushte evidentimi i metodave të tjera për diagnoztikimin dhe parashikimin e alergjive ushqimore është shumë i rëndësishëm.

Qëllimi: Të përshkruajmë metodat diagnostikuese për alergjinë ushqimore si alergologjia molekulare, BAT, prick test për alergenët ushqimor dhe të vlerësojmë rëndesinë edhe rradhën e përdorimit të tyre në vendojen e diagnozës, dhe menaxhimin e alergjisë ushqimore.

Konkluzione: Alergologjia molekulare, prick test, BAT janë metoda qe ndihmojnë në diagnostikimin dhe menaxhimin e alergjive ushqimore.

Fjalë kyçe: Alergji ushqimore, prick test, BAT, reaksion alergjik.

TERAPITË BASHKËKOHORE INOVATIVE NË TRAJTIMIN E SKLERODERMISË SISTEMIKE.

Prof. Asc. Dorina Ruci, Prof. Asc. Vilson Ruci, Dr. Krisli Serani, Dr. Arsel Dizdari, Vasilika Gjika MD, Prof. Dr. Teuta Backa

Abstrakt

Hyrje: Sëmundjet autoimune janë patologji të shkaktuara nga dëmtimi i mekanizmave të tolerancës së sistemit imun. Një nga këto sëmundje është edhe Sklerodermia Sistemike e cila karakterizohet nga depozitimi jonormal i kolagjenit në lëkurë dhe në organet e brendshme duke rezultuar në fibrozë të këtyre indeve si dhe vaskulopati si pasojë e dëmtimit të angiogjenezës. Sklerodermia Sistemike klasifikohet në formën e limituar dhe atë difuze të cilat dallojnë nga niveli i prekjes kutane, profili i antitrupave si dhe nga forma e përfshirjes organore. Terapitë e përdorura aktualisht për trajtimin e kësaj patologjie bazohen në përdorimin e medikamenteve imunosupresore si: Methotrexate, MMF, Ciklofosfamidi, Rituximabi si dhe medikamentet per menaxhimin e prekjeve të

ndryshme organore. Në këto 2 dekadat e fundit terapia me qeliza staminale ka filluar të konsiderohet gjerësisht si opsion terapeutik për menaxhimin e mjaft sëmundjeve autoimune duke përfshirë këtu edhe Sklerodermin Sistemike. Kjo për shkak të aftësive unike të qelizave staminale për tu diferncuar në qeliza të specializuara të indit të dëmtuar si dhe aftësive të tyre imunomodulatore në sëmundjet autoimune. Ekzistojnë 2 lloje kryesore qelizash staminale që mund të përdoren: mezenkimale dhe hematopoietike.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është diskutimi teorik i efikasitetit, sigurisë, efekteve anësore dhe efekteve imunologjike të terapisë me qeliza staminale si inovacion në trajtimin e Sklerodermisë Sistemike.
Konkluzione: Trajtimi i sëmundjeve autoimune si Sklerodermia Sistemike përbën sfidë për specialistët e mjekësisë për shkak të terapive të kufizuara dhe efikasitetit të tyre. Për këtë arsye studimi dhe përdorimi i metodave të reja terapeutike si terapia me qeliza staminale konsiderohet arritje e rëndësishme dhe shpresëdhënëse për të ardhmen.

Fjalë kyçe: Sklerodermia sistemike, qeliza staminale, autoimune, imunosupresorë, terapi.

STOMAT INTESTINALE: INDIKACIONET, KLASIFIKIMI, MENAXHIMI DHE KOMPLIKACIONET.

Doruntina Shala[1]
[1]Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Prishtinë, Kosovë
[2]Spitali Rajonal i Prizrenit "Prim. Dr. Daut Mustafa", Reparti i Kirurgjisë Abdominale, Prizren, Kosovë

Abstrakt
Hyrje: Stoma (fjalë greke - stomat që do të thotë hapje apo gojë) është një anastomozë e qëllimshme midis një segmenti të traktit gastrointestinal dhe lëkurës së murit të përparmë të barkut. Një stomë mund të krijohet pothuajse kudo përgjatë traktit gastrointestinal. Mirëpo, për devijimin e masave fekale, stomitë kryesisht krijohen në pjesën distale të zorrës së hollë (p. sh. ileostomia) dhe zorrën e trashë (d. m. th. kolostomia). Llojet më të shpeshta të stomave intestinale të përdoruara në nivel botërorë janë: kolostoma, ileostoma, caecostoma. Një stomë intestinale është një hapje e krijuar kirurgjikisht që e nxjerr një pjesë të zorrës së hollë ose të trashë përmes murit të barkut, me qëllim që përmbajtja intestinale të derdhet diku tjetër. Ileostomitë zakonisht bëhen për të iu shmangur zorrës së hollë në rast sëmundjesh si inflamacioni i zorrëve, kanceri i kolonit ose si divertim parandalues, dhe shkarkimi që prodhojnë është i lëngshëm deri gjysmë - lëngshëm, ndaj kërkon menaxhim të kujdesshëm të ushqyerjes dhe hidratimit. Kolostomitë krijohen nga zorrët e trasha dhe përbëhen nga përmbajtje më e formuar, me nevojë më të vogël për zbrazje të shpeshta.
Qëllimi: Qëllimi i punimit është analizimi pacientëve të trajtuar në Spitalin Rajonal të Përgjithshëm të Prizrenit "Prim. Dr. Daut Mustafa" me stoma intestinale për periudhën kohore: 1 janar 2020 - 31 dhjetor 2024. Përmes grumbullimit retrospektiv të të dhënave për një periudhë 5 vjeçare, është synuar të fitohen njohuri rreth: numrit të pacientëve me stoma intestinale përgjatë periudhës 2020 - 2024, karakteristikat si gjinia, mosha, llojet e stomave intestinale dhe diagnoza. **Materiale dhe metoda:** Hulumtimi është i tipit retrospektiv, i realizuar me të dhënat e pacientëve të protokoleve operative në repartin e Kirurgjisë Abdominale, në kuadër të Spitalit Rajonal të Përgjithshëm të Prizrenit, "Prim. Dr. Daut Mustafa" për periudhën kohore 1 Janar 2020 - 31 Dhjetor 2024. Regjistrimi i të dhënave është realizuar me marrjen e lejeve përkatëse dhe plotësimin e principeve etike. Të gjitha të dhënat e regjistruara kanë ruajtur anonimitetin e pacientëve. Pas marrjes dhe grumbullimit të të dhënave është bërë përpunimi dhe analizimi i tyre me programin Microsoft Excel dhe janë prezantuar nëpërmjet tabelave dhe grafikoneve. Është konsultuar literatura shkencore, në platforma si: PubMed, Google Scholar, etj.
Rezultate: Nga hulmtimi i bërë për periudhën kohore 2020 - 2024, në repartin e Kirurgjisë Abdominale në Spitalin Rajonal të Përgjithshëm të Prizrenit janë konstatuar gjithsej 14 raste me stoma intestinale, ku 50% apo 7 raste kanë rezultuar nga gjinia mashkullore dhe 50% apo 7 raste nga gjinia femërore. Grupmoshat më të takuara janë 71 - 80 vjeç me 5 raste apo 36% dhe 61 - 70 vjeç me 4 raste apo 29%. Sa i përket llojit më të shpeshtë të stomave të përdorura në repartin e Kirurgjisë Abdominale në Spitalin e Prizrenit kolostoma ka rezultuar të jetë lloji më i përdorur i stomave intestinale me një përqindje prej 65% të rasteve të përgjithshme me 9 pacientë. Karcinoma më e shpeshtë e diagnostifikuar tek e cila janë përdorur stomat intestinale është karcinoma e sigmës që rezultoi me 36% të rasteve të përgjithshme me 5 pacientë.
Përfundime: Të dy gjinitë kishin prevalence të njejtë të stomave intestinale 50% të rasteve meshkujt dhe 50% të rasteve femrat. Grupmosha që është takuar më shpesh nga stomat intestinale është 71 - 80 vjeç me 5 raste apo 36% dhe 61 - 70 vjeç me 4 raste apo 29% të rasteve. Në përputhje me hulumtimin që ishte bërë në një shtet

tjetër ku grupmosha më e prekur ishte mbi 60 vjeç me një interval (48–67 vjeç). Colostoma ishte lloji më i shpeshtë i stomave intestinale me 65% me 9 raste. Diagnoza më e shpeshtë tek e cila janë përdorur stomat intestinale ishte karcinoma sigmës me 36% me 5 raste.

Fjalë kyçe: Stoma intestinale, kolostomi, ileostomi, karcinoma e sigmës, studim retrospektiv.

SHKAKTARËT E SEPSIS NEONATALE.

Dr. Drande Sermaxhaj [1], Prof. Dr. Lidvana Spahiu [2]
[1]*Doktor i Mjekësisë*
[2]*Pediatër*

Abstrakt
Hyrje: Sepsis neonatale është një gjendje serioze që shfaqet tek të porsalindurit brenda 28 ditëve të para të jetës, e karakterizuar nga një përgjigje sistemike inflamatore ndaj infeksionit, e cila mund të jetë e shkaktuar nga patogjenë bakterial, viral ose fungal.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të identifikohen shkaktarët e sepsis neonatale në Klinikën e Neonatologjisë për periudhën janar 2023 - dhjetor 2024 në QKUK si dhe korelacionet që ndihmojnë në kuptimin e incidencës dhe ashpërsisë, duke theksuar ndikimin e faktorëve maternal dhe neonatal, si lindja e parakohshme dhe ekspozimet ndaj rreziqeve mjedisore ose klinike në shfaqjen dhe përparimin e kësaj gjendje.
Metodologjia: Studimi i takon tipit retrospektiv. Të dhënat janë mbledhur nga Klinika e Neonatologjisë në QKUK, për periudhën kohore janar 2023 - dhjetor 2024. Punimi është plotësuar me të dhëna nga studimet relevante dhe bashkëkohore.
Rezultate: Gjatë periudhës janar 2023 – dhjetor 2024, në Klinikën e Neonatologjisë janë trajtuar gjithsej 290 foshnja me sepsis neonatale të konfirmuar me hemokulturë. Shumica e rasteve ishin meshkuj (62%) dhe dominonte sepsis me fillim të vonshëm (67%). Mosha mesatare gestacionale ishte 33 javë gestacionale, ndërsa lindjet cezariane përbënin 69% të rasteve. Patogjenët më të shpeshtë të izoluar ishin Staphylococcus spp. (91 raste), Klebsiella pneumoniae (71 raste), dhe Serratia marcescens (37 raste). Vdekshmëria totale ishte 12% (34 raste), ndërsa mesatarja e qëndrimit në spital ishte 25. 7 ditë. Terapia më e përdorur ishte kombinimi empirik i Ampicilinës, Amikacinës, Meropenemit dhe Vankomicinës, duke mbulurar patogjenëve Gram - pozitivë dhe Gram - negativë, përfshirë edhe bakteret rezistente.
Perfundime: Studimi ofron një analizë të thelluar të incidencës, karakteristikave klinike, faktorëve të rrezikut, patogjenëve dhe strategjive terapeutike të sepsis neonatale në Klinikën e Neonatologjisë në QKUK gjatë viteve 2023 dhe 2024.

Fjalë kyçe: sepsis neontal, maternale, neonatale, terapi empirike, hemokultura.

OBEZITETI MATERNAL DHE NDIKIMI I TIJ NË SHËNDETIN OBSTETRIK, PERINATAL DHE NEONATAL.

Dr. Drenica Nika

Abstrakt
Obeziteti gjatë shtatzënisë përbën një sfidë serioze për shëndetin obstetrik dhe neonatal, me ndikime të rëndësishme në ecurinë e shtatzënisë dhe zhvillimin e fetusit. Ky punim ka për qëllim të rishikojë literaturën shkencore bashkëkohore mbi faktorët kontribues, komplikimet obstetrike, perinatale dhe neonatale të obezitetit maternal, si dhe qasjet menaxhuese më efektive në praktikën klinike. U krye një rishikim narrativ duke përzgjedhur artikuj kërkimorë, meta - analiza dhe udhëzime klinike nga databazat PubMed dhe Google Scholar, të publikuar në vitet e fundit. Gjetjet tregojnë se obeziteti maternal është i lidhur ngushtë me rrezik të shtuar për preeklampsi, diabet gestacional, lindje me operacion, makrosomi fetale, anomalitë kongenitale dhe çrregullime metabolike në neonatë. Menaxhimi efektiv kërkon qasje të hershme, këshillim para konceptimit, ndjekje të peshës gjatë shtatzënisë dhe bashkëpunim multidisiplinar. Rritja e ndërgjegjësimit dhe përfshirja aktive e profesionistëve të kujdesit shëndetësor janë thelbësore për të përmirësuar shëndetin e nënës dhe të foshnjës.

Fjalë kyçe: Obezitet maternal, shtatëzëni, komplikime, menaxhim klinik.

PREMATURITETI SI FAKTORË RISKU NË VONESA DHE DEFIÇITE NEUROZHVILLIMORE AFATGJATA: RASTE KLINIKE.

Drita Bujari
Mjeke Neonatologe, SUOGJ "Koço Gliozheni"

Abstrakt
Hyrje: Çdo vit, rreth 1 në 10 fëmijë lind para javës së 37 të shtatzënisë. Pavarësisht përparimeve të mëdha në kujdesin perinatal — përfshirë ventilimin joinvaziv, mbështetjen ushqyese të hershme dhe menaxhimin e komplikacioneve neonatale — prematuriteti mbetet një faktorë kryesor rreziku për vonesa dhe defiçite neurozhvillimore afatgjata. Studimet tregojnë se foshnjat e lindura para kohe shpesh paraqesin reduktim të sipërfaqes kortikale, veçanërisht në rajonet frontale dhe temporale, si dhe vëllime të zvogëluara të strukturave subkortikale (ganglionet bazale, talamusi dhe truri i vogël). Këto ndryshime shoqërohen me vonesa në arritjen e piketave zhvillimore, deficite njohëse dhe vështirësi në rregullimin emocional dhe social gjatë fëmijërisë.
Qëllimi: Kjo përmbledhje paraqet disa raste klinike të fëmijëve të lindur para kohe në Maternitetin "Koço Gliozheni", duke ndjekur progresin e tyre neurozhvillimor që nga diagnostikimi i hershëm imazherik dhe klinik, deri në vlerësimin e arritjeve zhvillimore.
Rezultate: Vëzhgimet klinike tregojnë se fëmijët e lindur para kohe, veçanërisht ata me prematuritet ekstrem (<28 javë), janë në rrezik të shtuar për çrregullime të spektrit neurozhvillimor, si: - Vonesa motorike dhe çrregullime të tonusit, që lidhen me dëmtimet e substancës së bardhë periventrikulare; - Defiçite kognitive dhe të funksioneve ekzekutive, si vëmendje, kujtesë dhe planifikim; - Vështirësi gjuhësore dhe komunikimi social; - Çrregullime të sjelljes dhe të rregullimit emocional, si ankthi, hiperaktiviteti dhe vështirësitë në ndërveprimet shoqërore; - Rritje e prevalencës së çrregullimeve të spektrit autik dhe vështirësive në mësime në moshë shkollare.
Përfundime: Megjithëse incidenca e paralizës cerebrale ka pësuar rënie, çrregullimet e lartë përmendura kanë një ndikim të thellë në funksionimin e përditshëm. Ndërhyrjet e hershme të koordinuara ndërmjet neonatologut, neurologut pediatër, fizioterapistit dhe psikologut kanë treguar rezultate të favorshme në përmirësimin e rezultateve njohëse, motorike dhe sociale. Optimizimi i cilësisë së jetës dhe i performancës neurokognitive të fëmijëve të lindur para kohe mbetet sfida kryesore e neonatologjisë moderne. Ndjekja afatgjatë, diagnostikimi i hershëm dhe integrimi i qasjeve neuroshkencore me kujdesin klinik janë thelbësore për të identifikuar në kohë deficitet, për të ndërhyrë herët dhe për të maksimizuar potencialin zhvillimor të çdo fëmije.

Fjalë kyçe: Preterm, RTIN, neuroplasticitet, vonesa neurozhvillimore.

NDËRLIKIMI DHE KRONICIZIMI I SËMUNDJES SË BRUCELOZËS NË PACIENTËT E HOSPITALIZUAR NË SPITALIN E GJIROKASTRËS.

Dr. Dritan Rami[1]
[1]*Departamenti i Infermierisë, FSHN, Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër*

Abstrakt
Hyrje: Bruceloza është një sëmundje infektive sistemike me një klinikë shumë të larmishme. Sipas dekursit dallojmë formën akute që shfaqet kryesisht me: ethe, temperaturë, djersë profuze; formën subakute dhe kronike me shfaqe klinike të ndërlikimeve dhe me kronicizime. Sipas gravitetit dallojmë forma me dekurs tipik (akut - subakut), forma me dekurs atipik (forma subklinike, hipertoksike, kronike) si dhe bruceloza e organeve. Prekjet osteoartikulare janë një nga shaqet kryesore të komplikacioneve (20 - 60% të rasteve). Përmendim dhe sistemin nervor (5 - 10%), sistemi tretës (20 - 60%), sistemi urogenital (2 - 20%), sistemi kardiovaskular (1 - 2%), sistemi limfopoetik (10 - 20%), sistemi respirator (25%), sistemi okular (1 - 2%) dhe lëkura - mukozat (5%).
Materiale dhe metoda: Në këtë studim janë analizuar 86 kartela të pacientëve të diagnostikuar me brucelozë në spitalin "Omer Nishani" në Gjirokastër, gjatë viteve 2013 - 2023. Është bërë studimi i ndërlikimeve dhe kronocizimi i sëmundjes tek këta pacientë të hospitalizuar gjatë kësaj periudhe.

Rezultate: Nga të dhënat e mbledhura nga studimi i kartelave të 86 pacientëve të prekur nga bruceloza rezultoi se në një numër të lartë rastesh klinike (51%) është vënë re dukuria e ndërlikimeve të shkaktuara nga bruceloza. Është bërë e mundur verifikimi i 44 pacientëve të cilët kanë shfaqur shenja fokale dhe kërcënuese për shëndetin. Predominojnë dhimbjet dhe diskonforti lumbar (18 raste), hepatomegalia dhe splenomegalia (9 raste), epididimo - orkiti (4 raste), komplikacionet pulmonare (4 raste), prekje e vertebrave (3 raste), e mandej uretritet, dhimbje dhe diskonfort abdominal, komplikacione neurologjike dhe manifestime kutane në intervalet 1 - 2 raste. Kronicizimi i sëmundjes së brucelozës është dokumentuar tek 16 pacientë ose 19% e rasteve të studiuara. Nuk ka dallim në prirjen për kronicizim mes meshkujve dhe femrave.
Konkluzione: Bruceloza pavarësisht masave të marra për uljen e incidencës së saj ngelet një zoonozë e rëndësishme në aspektin epidemiologjik dhe klinik. Trajtimi spitalor i saj rezulton të ketë qenë me një eficencë të mirë. Në çdo rast me forma të ndërlikuara trajtimi duhet të jetë kompleks dhe më i zgjatur. Duhen monitoruar shpesh për të evidentuar shenjat e relapsit dhe të komplikacioneve të munshme. Evidentimi në kohë dhe dhe mjekimi i hershëm i tyre ul mundësinë për sekela dhe invalidizim të këtyre pacientëve.

Fjalë kyçe: Bruceloza, shenja fokale, kronicizim.

DEPISTIM KUNDREJT HEPATITIT B, HIV DHE SIPHILIZ NË NJË KLINIKË STOMATOLOGJIKE NË TIRANË SI DHE TESTIMI I MBROJTJES IMUNITARE NDAJ VIRUSIT TË HEPATITIT B NË VITIN 2025.

D. Ulqinaku, E. Ali, Sh. Qyra
Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Punonjësit e kujdesit shëndetësor janë të ekspozuar në punë ndaj një sërë sëmundjesh infektive gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor kërkon që një gamë të gjerë punonjësish, siç janë mjekët, infermierët, stomatologët, punonjësit e laboratorit klinik, etj që e kanë për detyrë të tenë afër individëve me probleme shëndetsore dhe rrjedhimisht, të jenë të ekspozuar kundrejt infeksineve të ndryshme. Mbas infeksioneve aerogene, një peshë të rëndësishme marrin edhe infeksionet të cilat transmetohen me anë të gjakut ose dhe me transmetim me kontakt të ngushtë seksual. Detyrë parësore është mbrojtja nga infeksione të tilla të parandalueshme sikurse janë pa dyshim hepatitet virale B dhe C, dhe HIV. Mbrojtja kundrejt tyre momentalisht realizohet vetëm kundrejt hepatitit B me anë të vaksinës kurse për infeksionet e tjera janë masat personale të mbrojtjes ku futen sjelljet e shëndetshme dhe paisjet individuale të mbrojtjes.
Qëllimi: Të vlerësohet prevalenca e hepatitit B, C dhe HIV si dhe të shikohet mbrojtja imunitare ndaj hepatitit B të punonjësve të klinikës stomatologjike të përzgjedhur.
Materjale dhe metoda: Të gjithë individët e klinikës stomatologjike pranuan që të testoheshin përmes marrjes së gjakut për të vlerësuar statusin shëndetësor të tyre kundrejt hepatitit B, C dhe HIV si dhe për të parë mbrojtjen që ata kishin kundrejt hepatitit viral B. U morën 76 mostra gjaku dhe u testuan për anti HBs me metodën ELISA HBs Ab DIA. PRO. Testimi per HBsAg me metodën ELISA - Kiti i perdorur Hbs Ag one DIA. PRO. Testimi per HIV Ab me metodën RDT - kiti i përdorur HIV 1 - 2. 0 Card. Test FIRST RESPONSE. Testimi për HCV Ab me metodën RDT - Kiti i përdorur HCV Card Test FIRST RESPONSE. Sipas rekomandimit të OBSH - së vlera e anti HBs më e madhe ose e barabartë me 10 mIU / mL (antiHBs≥10mIU / mL) konsiderohet si kufi që tregon për mbrojtje kundër HBV.
Rezultate: Të gjithë punonjësit e klinikës rezultuan negative përsa i përket hepatitit B, C dhe HIV. Pas testimit të mostrve të gjakut u llogaritën vlerat sasiore të anti HBs - së për secilën mostër bazuar dhe tek kufiri i vlerës (cur - off) që tregon për mbrojtje ndaj hepatitit B. Rezultatet treguan që mbrojtja imunitare (anti HBs) ndaj hepatitit B ishte e pranishme në 29% e punonjësve, ndërsa 71% e tyre kishin nivele më të ulta se sa kufiri i nivelit mbrojtës, pra rezultojnë të pa mbrojtur ndaj hepatiti B.
Konkluzione dhe rekomandime: Personat që punojnë në klinika stomatologjike janë personel me rrisk të lartë për marrjen infeksioneve përmes gjakut apo likideve biologjike që përmbajnë gjak, përfshirë këtu dhe hepatitin B. Ky studim demostroj se incidence e infeksioneve të përmendura ishte zero por nga ana tjeter tregon se niveli mbrojtës ndaj virusit të hepatitit B është në nivele të ulëta. Për individët e pambrojtur u rekomandua të rivaksinohen edhe një herë sipas skemës të vaksinimit për hepatitin B si dhe ritestim pas vaksinimit për nivelin e anti HBs.

Fjalë kyçe: Hepatiti viral B, C dhe HIV si dhe anti HBs, personeli dentar, mbrojtja imunitare.

ANEUPLOIDITË E KROMOZOMEVE TË GJINISË TE NJERIU, SINDROMA TURNER DHE KLINEFELTER - QASJA MJEKËSORE.

Dr. Durim Gashi Autor i dytë: Dr. Mirush Gjocaj

Abstrakt

Hyrje: aneuploiditë janë ndryshime jo normale të numrit të kromozomeve. Varësisht se cilat kromozome afektohen kemi aneuploidi të kromozomeve somatike apo të gjinisë. Në këtë punim do të trajtohen aneuploiditë e kromozomeve te gjinisë dhe sindromat që vijnë si rrjedhojë e këtyre ndryshimeve numerike kromozomale tek ky çift kromozomesh.

Qëllimi: Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të përshkruhen sindromat që rezultojnë nga ndryshimet jo normale në numrin kromozomeve të gjinisë, duke u fokusuar në shkaktarët dhe mekanizmat molekular që qojnë në këto ndryshime, manifestimin klinik të tyre, me theks të veçantë në aspektet shëndetësore që afektojnë më së shumti mirëqenien e jetës së pacientëve nga këto sindroma dhe qasjen mjekësore ndaj tyre. Punimi fokusohet më shumë në sindromat Turner dhe Klinefelter, qasjen diagnostike, aspektet e fertilitetit në lidhje me këto dy sindroma dhe rëndësinë e diagnostikimit të hershëm më qëllim të ruajtjes së fertilitetit dhe mbrojtjen ndaj neoplazive tek personat me sindromat e tilla.

Metodologjia: Ky punim është i tipit "rishikim i literaturës shkencore". Prandaj për të arritur qëllimin e kësaj teme janë hulumtuar punimet shkencore të botuara në revista të besueshme. Materialet e përdorura në punimin e kësaj teme janë marrë nga Google Scholar, Elsevier, PubMed, NCBI dhe nga faqet tjera që janë të indeksuara dhe të cituara.

Përfundime: Aneuploidia e kromozomeve seksuale është një gjendje ku numri i kromozomeve seksuale nuk është normal. Disa prej aneuploidive të zakonshme të kromozomeve seksuale janë Sindroma Turner (monosomia X) dhe Sindroma Klinefelter (trisomia XXY). Këto sëmundje kanë shenja klinike të veçanta, si infertiliteti, ndryshime në zhvillimin seksual dhe karakteristikat fizike të ndryshuara. Diagnostikimi bëhet përmes analizave gjenetike si kariotipizimi. Trajtimi përqendrohet në menaxhimin e simptomave dhe komplikacioneve të mundshme, si dhe në përkrahjen e personave të prekur dhe familjes së tyre.

Fjalë kyçe: AND, kromozom, aneuploidi, sindroma, XY, Sindroma Turner, Sindroma Klinefelter.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI SENSIBILIZIMIN IGE - VARTËS TEK PERSONAT NËN 18 VJEÇ.

Edina Zhabjaku[1], Etleva Qirko Loloçi[2]

[1]*Alergologe dhe Imunologe Klinike, Shërbimi i Sëmundjeve të brendshme, Spitali Universitar i Traumës, Tiranë, Shqipëri*

[2]*Shërbimi i Alergologjisë dhe Imunologjisë Klinike, Departamenti i Sëmundjeve të brendshme, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Shqipëri*

Abstrakt

Hyrje: Sëmundjet alergjike prekin rreth 20% të popullsisë globale, me një rritje të dukshme të incidencës tek fëmijët gjatë dy dekadave të fundit. Tendencat e ndryshme të sensibilizimit janë të rëndësishme për diagnozën, trajtimin e personalizuar dhe prognozën e sëmundjeve alergjike.

Objektiva: Kjo përmbledhje synon të analizojë prevalencën, tendencat dhe profilin e sensibilizimit IgE - vartës tek popullata pediatrike (mosha <18 vjeç) në Europë.

Rezultate dhe Diskutime: Sensibilizimi ndaj aero - alergenëve fillon shpesh që në vitin e parë të jetës dhe rritet me moshën. Studime në Hollandë, Suedi, etj. , tregojnë se edhe foshnjat mund të kenë IgE specifike ndaj aero - alergenëve. Sensibilizimi ndaj ushqimit është më i përhapur në fëmijëri dhe dominon sensibilizimi ndaj vezës dhe qumështit. Me kalimin e moshës dominon sensibilizimi ndaj aero - alergenëve. Evidentohen dallime të qarta rajonale dhe të lidhura me klimën në sensibilizimin ndaj alergenëve, ndërkohë që paraqiten edhe mospërputhje që varen nga stili i jetesës dhe dieta. Polisensibilizimi është i zakonshëm tek fëmijët me simptoma alergjike. Një

pjesë e konsiderueshme e fëmijëve të sensibilizuar nuk zhvillojnë domosdoshmërisht sëmundje alergjike klinike serioze, por sensibilizimi mbetet faktor rreziku në zhvillimin e sëmundjeve alergjike.
Konkluzione: Sensibilizimi IgE - vartës tek personat nën 18 vjeç në Europë është i shpeshtë dhe fillon herët në jetë. Testimi mbi sensibilizimin dhe studime më të detajuara molekulare janë të rëndësishme për identifikimin e faktorëve të rrezikut, profilin rajonal të alergenëve, trajtimin e personalizuar dhe për zbatimin e strategjive të parandalimit të sëmundjeve alergjike në të ardhmen.

Fjalë kyçe: Aero - alergenë, sëmundje alergjike, fëmijë, sensibilizim.

DEFICITI I CARNITINE PALMITOYLTRANSFERASE II (CPT II).
Edina Zogaj

Abstrakt
Hyrje: Deficiti i Carnitine Palmitoyltransferase II (CPT II) është një çrregullim i rrallë autosomal recesiv që pengon oksidimin mitokondrial të acideve yndyrore me zinxhir të gjatë. Ky defekt metabolik çon në prodhim të pamjaftueshëm të energjisë dhe akumulim të acilkarnitinave toksike, duke shkaktuar manifestime klinike që variojnë nga forma neonatale fatale deri te forma miopatike e të rriturve me kriza të përsëritura të rhabdomiolizës.
Qëllimi: Ky rishikim i literaturës synon të analizojë metodat bashkëkohore të diagnostikimit të deficitit të CPT II, të vlerësojë ndjeshmërinë dhe specifitetin e testeve biokimike dhe molekulare, si dhe të theksojë sfidat praktike në identifikimin e formave të lehta.
Metodologjia: U shqyrtuan artikuj të përzgjedhur nga bazat e të dhënave PubMed dhe GeneReviews (2018–2024), duke u fokusuar në fushat: profilimi i acilkarnitinave (MS / MS), testimi enzimatik dhe analizat molekulare të gjenit CPT2. U përfshinë gjithashtu studime që trajtojnë skriningun neonatal dhe algoritmet diagnostikuese.
Rezultate: Diagnostifikimi bazohet në një qasje të kombinuar: identifikimi i rritjeve të acilkarnitinave me zinxhir të gjatë (C16, C18: 1) në gjak përmes spektrometrisë me masë; konfirmimi me testim molekular të gjenit CPT2; dhe matja e aktivitetit enzimatik në fibroblaste ose biopsi muskulare në raste të paqarta. Studimet e fundit tregojnë se rezultatet e testeve biokimike mund të jenë normale jashtë episodeve akute, prandaj marrja e mostrave gjatë krizave metabolike është thelbësore për rritjen e ndjeshmërisë diagnostikuese.
Përfundime: Qasja bashkëkohore diagnostikuese për deficitin e CPT II kërkon integrimin e analizave biokimike, molekulare dhe klinike. Ndërgjegjësimi për variabilitetin fenotipik dhe për interpretimin e profileve të acilkarnitinave është thelbësor për diagnozë të saktë dhe menaxhim të hershëm. Përmirësimi i skriningut neonatal dhe përdorimi i sekuencimit gjenetik të zgjeruar përbëjnë hapa premtues drejt zbulimit më efikas të kësaj patologjie të rrallë metabolike.

Fjalë kyçe: Deficiti i Carnitine Palmitoyltransferase II (CPT II), ndërgjegjësim, patologji e rrallë.

LUPUS NEUROPSIKIATRIK APO ENCEFALIT ANTI - NMDAR? NJË SFIDË DIAGNOSTIKE NË KONTEKSTIN E AUTOIMUNITETIT SISTEMIK. RISHIKIM LITERATURE DHE PREZANTIM RASTI.
Ediola Çobo[1], Oneda Çibuku[2]
[1]*Mjeke Reumatologe, Spitali Rajonal Berat*
[2]*Mjeke Neurologe Shërbimi Neuro Vaskular Stroke dhe Post Stroke, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Teresa" Tiranë*

Abstrakt
Hyrje: Lupusi eritematoz sistemik (LES) është një sëmundje autoimune kronike me përfshirje multisistemike, ku manifestimet neurologjike dhe psikiatrike – të njohura si lupus neuropsikiatrik (LNPS) – përbëjnë një nga ndërlikimet më serioze. Këto manifestime shfaqen në rreth 40–60% të pacientëve dhe përfshijnë një spektër të gjerë që varion nga çrregullimet e lehta të konjicionit deri te psikozat, krizat epileptike dhe aksidentet cerebrovaskulare. Patogjeneza është multifaktoriale, duke përfshirë mikroangiopatinë cerebrale, dëmtimin e

barrierës hemato - encefalike dhe prodhimin e autoantitrupave patogjenë si anti - ribosomal P dhe anti - NR2 (GluN2), të cilët ndërveprojnë me receptorët neuronalë të NMDA, duke shkaktuar exitotoksicitet dhe dëmtim neuronal. Gjatë viteve të fundit është vënë re mbivendosja ndërmjet LNPS dhe encefalitit autoimun të receptorëve të NMDA (anti - NMDAR - E) – një encefalit i ndërmjetësuar nga antitrupat anti - GluN1 – për shkak të ngjashmërisë klinike dhe vështirësive diagnostike. Ky raport paraqet një rast të rrallë bashkëekzistence të LES dhe NMDAR - E, duke theksuar rëndësinë e testimit imunologjik në format rezistente të lupusit neuropsikiatrik.
Materiale dhe Metoda: U analizua retrospektivisht paraqitja klinike, gjetjet neuroimazherike, analiza e likuorit cerebrospinal (LCS) dhe profili imunologjik i një pacienteje 31 - vjeçare me histori njëvjeçare LES, e cila zhvilloi episode neuropsikiatrike të përsëritura, rezistente ndaj trajtimit konvencional. Vlerësimi diagnostik përfshiu MRI cerebrale, analizë të LCS - së dhe testim për antitrupa ndaj sipërfaqes neuronale, përfshirë anti - GluN1.
Rezultate: Pacientja, me diagnozë paraprake të lupusit kutano - artikular (ANA dhe anti - dsDNA pozitiv), u paraqit me psikozë akute, halucinacione dhe çrregullime njohëse. Analizat laboratorike treguan hipokomplementemi (C3: 60 mg / dL; C4: 13 mg / dL) dhe rritje të anti - dsDNA (54 U / mL). MRI e trurit zbuloi leziona hiperintense jo specifike në traktet piramidale dhe rajonet hipokampale. Analiza e LCS ishte normale, përveç pranisë së antitrupave anti - GluN1 IgG, që konfirmuan diagnozën e encefalitit anti - NMDAR në bashkëekzistencë me LES. Pacientja kishte marrë më parë metilprednizolon me doza të larta dhe ciklofosfamid për lupus cerebritis të supozuar, pa përmirësim klinik. Pas konfirmimit të NMDAR - E, u trajtua me imunoglobulinë intravenoze (IVIg) dhe plazmaferezë, me përmirësim të dukshëm të gjendjes neuropsikiatrike. Trajtimi mirëmbajtës me azatioprinë dhe rituximab siguroi stabilitet klinik në ndjekje afatgjatë.
Diskutime: Ky rast ilustron kompleksitetin e manifestimeve neuropsikiatrike të lupusit, ku mbivendosja e autoimunitetit mund të maskojë diagnozën e saktë. Edhe pse LNPS dhe NMDAR - E përfshijnë të dy receptorin NMDA, ato ndryshojnë në nënnjësitë e synuara (GluN2 për LNPS dhe GluN1 për NMDAR - E) dhe kërkojnë strategji të ndryshme terapeutike. Identifikimi i antitrupave anti - GluN1 në LCS është vendimtar, pasi NMDAR - E përgjigjet mirë ndaj imunoterapisë së drejtuar me IVIg, plazmaferezë dhe rituksimab, ndryshe nga LNPS që trajtohet kryesisht me kortikosteroide dhe imunosupresantë konvencionalë. Raportime të mëparshme (Wu et al. , 2016; Vera - Lastra et al. , 2025) mbështesin konceptin në rritje të "mbivendosjes autoimune" midis sëmundjeve sistemike dhe atyre organ - specifike.
Përfundime: Përfshirja neurologjike në LES përbën një shkak kryesor të morbiditetit dhe mortalitetit. Bashkëekzistenca e lupusit neuropsikiatrik me encefalitin anti - NMDAR nënvizon nevojën për vlerësim imunologjik të plotë tek pacientët me simptoma psikiatrike atipike ose rezistente ndaj trajtimit standard. Diagnostikimi i hershëm i antitrupave neuronalë lejon ndërhyrje të synuara që mund të përmirësojnë ndjeshëm ecurinë klinike dhe rezultatin funksional.

Fjalë kyçe: Lupus eritematoz sistemik, lupus neuropsikiatrik, encefaliti anti - NMDAR, antitrupa anti - GluN1, encefalit autoimun, imunoterapi.

MENAXHIMI INFERMIEROR NË URGJENCË: SFIDA DHE QASJE PËR PËRMIRËSIMIN E KUJDESIT AKUT.

Edison Sinaj
Spitali Hygeia, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Shërbimi i urgjencës përbën një nga mjediset më dinamike dhe sfiduese të sistemit shëndetësor. Infermierët në këtë ambient janë përgjegjës për vlerësimin fillestar të pacientit, stabilizimin e gjendjes së tij dhe bashkërendimin e trajtimit me ekipin multidisiplinar. Menaxhimi efektiv infermieror është thelbësor për garantimin e reagimit të shpejtë, të sigurt dhe efikas ndaj situatave kritike.
Zhvillime: Ky studim synon të evidentojë rolin dhe rëndësinë e menaxhimit infermieror në repartet e urgjencës, duke analizuar sfidat që lidhen me mungesën e stafit, ngarkesën e lartë të punës, menaxhimin e stresit dhe komunikimin ndërprofesional. Përmes një vëzhgimi të praktikave në shërbimin e urgjencës së Spitalit Hygeia, u identifikuan nevoja të vazhdueshme për trajnime praktike, zbatim të protokolleve të standardizuara dhe përmirësim të koordinimit ndërmjet strukturave të shërbimit. Rezultatet tregojnë se përfshirja aktive e

infermierëve në vendimmarrje klinike, përdorimi i algoritmeve të menaxhimit të urgjencave dhe komunikimi efektiv me mjekët përmirësojnë ndjeshëm cilësinë e kujdesit dhe reduktojnë kohën e ndërhyrjes.
Konkluzione: Menaxhimi infermieror në urgjencë kërkon profesionalizëm, përgatitje të vazhdueshme dhe bashkëpunim të ngushtë ndërprofesional. Zhvillimi i kompetencave klinike dhe përdorimi i praktikave të bazuara në evidencë janë faktorë kyç për rritjen e sigurisë së pacientit dhe përmirësimin e rezultateve klinike. Investimi në trajnimin dhe fuqizimin e rolit të infermierit është thelbësor për funksionimin optimal të çdo shërbimi emergjent.

Fjalë kyçe: Menaxhimi infermieror, urgjenca mjekësore, kujdesi akut, komunikimi ndërprofesional, siguria e pacientit.

MBESHTJELLËSI BËRTHAMOR DHE SËMUNDJET E LIDHURA ME FUNKSIONIMIN E ÇRREGULLUAR TË TIJ.

Edita Jetishi

Abstrakt
Hyrje: Mbështjellësi bërthamor përbën një strukturë themelore për mbrojtjen dhe organizimin e materialit gjenetik, ndërsa komplekset e poreve bërthamore (KPB) mundësojnë transportin selektiv të proteinave dhe ARN - ve ndërmjet bërthamës dhe citoplazmës. Defektet në këtë mekanizëm çojnë në çrregullime serioze qelizore dhe janë të lidhura ngushtë me një sërë sëmundjesh.
Qëllimi: Ky punim ka për qëllim të analizojë rolin e mbështjellësit bërthamor dhe çrregullimet që rezultojnë nga defektet në strukturën dhe funksionin e tij, me fokus tek patologjitë e lidhura.
Diskutime: Proteinat e mbështjellësit bërthamore janë të përfshira në shumë sëmundje të rralla dhe komplekse. Laminopatitë, që shkaktohen kryesisht nga mutacionet në laminen A / C dhe proteina shoqëruese si emerina, manifestohen me një gamë të gjerë patologjishë që variojnë nga miopatitë e deri te sindroma e progerisë (plakja e parakohshme). Mutacionet në proteinat e poreve bërthamore lidhen gjithashtu me kancerin dhe me sindroma të rralla si sindroma e trefishtë A. Në sistemin nervor, dëmtimet në transportin nukleocitoplazmatik dhe grumbullimi jonormal i proteinave kontribuojnë në neurodegjenerim. Kjo përfshin sëmundje si skleroza laterale amiotrofike (ALS), demenca frontotemporale (FTD), sëmundja e Huntingtonit (HD) dhe sëmundja e Alzheimerit (AD), të cilat karakterizohen nga akumulimi i proteinave toksike dhe ndërprerja e homeostazës qelizore.
Përfundime: Sëmundjet e lidhura me mbështjellësin bërthamor dhe me kompleksin e poreve bërthamore tregojnë rëndësinë jetike të transportit bërthamor në ruajtjen e funksionit qelizor. Kuptimi i mekanizmave të këtyre patologjive hap rrugë të reja për diagnostikim dhe trajtime të mundshme terapeutike.

Fjalë kyçe: Mbështjellësi bërthamor, kompleksi i poreve bërthamore, laminopati, transport nukleocitoplazmatik, sëmundje neurodegjenerative.

SINDROMI INFLAMATOR SISTEMIK (SIRS) TEK PACIENTËT PAS RIPARIMIT ENDOVASKULAR TË AORTËS PËR DISEKACION AORTAL: RAST KLINIK DHE RISHIKIM LITERATURE.

Edjola Lulja[1], Arjan Harxhi[1, 2], Najada Como[1, 2], Ervin Rapushi[3]
[1]Departamenti i Sëmundjeve Infektive, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti Mjekësor i Tiranës, [2]Shërbimi i Sëmundjeve Infektive, Qendra Spitalore Universitare e Tiranës "Nënë Tereza" [3]Shërbimi i Reumatologjise, Qendra Spitalore Universitare e Tiranës "Nënë Tereza"

Abstrakt
Hyrje: Në disa pacientë që i janë nënshtruar riparimit endovaskular të aortës torakale (TEVAR), mund të zhvillohet një përgjigje inflamatore sistemike e njohur si sindromi i post - implantimit (PIS). Ky sindrom karakterizohet nga temperaturë, leukocitozë dhe rritje e proteinës C - reaktive, duke plotësuar të paktën dy nga kriteret e SIRS. Incidenca raportohet të jetë 25–30% pas TEVAR dhe besohet se shkaktohet nga dëmtimi i endotelit dhe përgjigjja ndaj materialit të huaj të protezës. Simptomat zakonisht shfaqen pas një periudhe latente

0–48 orë dhe mund të ngatërrohen me infeksion. Diferencimi nga infeksioni aktiv është thelbësor për të shmangur përdorimin e panevojshëm të antibiotikëve. Komplikacionet përfshijnë qëndrim më të gjatë në spital, rihospitalizime dhe probleme kardiovaskulare. Trajtimi përfshin anti - inflamatorë jo - steroidalë ose kortikosteroide.
Qëllimi: Të paraqitet një rast klinik i SIRS pas protezimit të aortës për disekacion aortal, duke theksuar sfidat diagnostike, rëndësinë e diferencimit nga infeksioni aktiv dhe qasjen terapeutike të suksesshme.
Përshkrimi i rastit: Pacient mashkull 45 - vjeç, me diabet mellitus tip 2, hipertension arterial dhe dislipidemi, paraqiti temperaturë deri në 38°C, mialgji, dhimbje kyçesh dhe dobësi trupore që nisën rreth 2 javë pas implantimit të endoprotezës për disekacion të aortës tip B dhe zgjatën për 2 muaj e gjysmë. Në ekzaminimin fizik, pacienti ishte hemodinamikisht i qëndrueshëm, pa shenja të infeksionit aktiv. Gjetjet laboratorike dhe imazherike - Anemi e lehtë: Hgb 11. 7 g / dL. - Parametra inflamatorë të rritur: CRP 11 mg / dL, Ferritinë 1563 ng / mL, Fibrinogjen 663 mg / dL, LDH 558 U / L, ESR 80 mm / h, D - Dimer i rritur. - Prokalcitoninë negative. - Elektroforeza: hipoalbuminemi, rritje e α1 dhe α2 globulinave, raport A / G 0. 59. - Funksioni renal: brenda normës. - Kulturat e gjakut, urinës dhe testet serologjike për HIV, HBsAg, sifiliz: negative. - Ekokardiografia: proteza dhe aorta ascendente pa veçori patologjike, funksion sistolik i ruajtur, regurgitim aortal minimal, pa shenja të infeksionit aktiv. Konsulta reumatologjike konfirmoi sindrom inflamator post - protezim aorte. Menaxhimi dhe ecuria: - Fillimisht trajtuar me Levofloxacin 500 mg IV për 7 ditë (reaksion ndaj Ceftriaxone). - Më pas u shtua kortikoterapi: Prednisolone IV 40 mg për 3 ditë, e ndjekur nga Medrol per os 28 mg / ditë me ulje graduale çdo 5 ditë. Pas fillimit të kortikosteroideve, pacienti pati përmirësim të shpejtë klinik dhe ulje të parametrave inflamatorë.
Diskutime: SIRS pas protezimit të aortës është një ndërlikim i rrallë, shpesh i ngatërruar me infeksionin e protezës ose endokarditin. Diferencimi i hershëm nga infeksioni aktiv është thelbësor për të shmangur antibiotikoterapi të panevojshme dhe të zgjatur. Kortikoterapia e përshtatur dhe monitorimi multidisiplinar luajnë rol vendimtar në trajtim. Literatura raporton një incidencë prej 25–30% pas TEVAR, me ndikim në zgjatjen e qëndrimit spitalor dhe rritjen e kostos së trajtimit.
Përfundime: Ky rast thekson rëndësinë e: 1. Vlerësimit të SIRS si komplikacion pas ndërhyrjeve vaskulare madhore 2. Diferencimit të hershëm nga infeksioni aktiv 3. Qasjes së koordinuar multidisiplinore dhe terapisë anti - inflamatore, që çuan në rezultat të favorshëm klinik.

Fjalë kyçe: Sindromi inflamator sistemik (SIRS), disekacion aortal.

SINDROMA E VEZORES POLICISTIKE: MENAXHIMI BASHKËKOHOR DHE SFIDAT KLINIKE.

Prof. Asoc. Dr. Edlira Bylykbashi[1], Ph. D. Ilta Bylykbashi[1], Ph. D. Ilir Bylykbashi
[1]Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri
Klinika Bylykbashi, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Sindroma e vezores policistike (SVP) është çrregullimi endokrin më i shpeshtë tek gratë në moshë riprodhuese, që prek rreth 8–13% të grave globalisht. Ajo shfaqet me disfunksion ovarian kronik, hiperandrogjenizëm dhe ndryshime metabolike, të cilat shpesh çojnë në infertilitet dhe rrezik të shtuar për komplikacione kardiometabolike. Për shkak të natyrës së saj heterogjene, SVP paraqet sfida të vazhdueshme në diagnostikim dhe menaxhim.
Qëllimi: Të vlerësohet qasja bashkëkohore në diagnostikimin dhe menaxhimin e sindromës së vezores policistike dhe të identifikohen sfidat kryesore klinike që ndikojnë në trajtimin efektiv dhe cilësinë e jetës së pacientëve.
Objektiva: Të analizohen kriteret diagnostike më të përdorura (Rotterdam, NIH, AE - PCOS).
Të shqyrtohen qasjet aktuale terapeutike hormonale dhe metabolike. Të vlerësohet rëndësia e menaxhimit multidisiplinar.
Materiale dhe metoda: U realizua një rishikim sistematik narrativ i literaturës ndërkombëtare (PubMed, Scopus, 2015–2024), duke përfshirë rreth 60 artikuj shkencorë mbi diagnostikimin, menaxhimin farmakologjik dhe qasjet e reja terapeutike të SVP - së. U analizuan të dhëna mbi prevalencën, kriteret diagnostike, efektet e trajtimit hormonal dhe ndikimin metabolik.
Rezultate: Prevalenca mesatare globale e SVP - së: 10. 2% (varion nga 6% në 18% sipas rajoneve). Përdorimi i letrozole si terapi e linjës së parë për induktimin e ovulacionit ka treguar rritje të shkallës së shtatzënisë me

~25% krahasuar me klomifenin. Ndryshimi i stilit të jetesës (aktiviteti fizik dhe dieta) redukton ndjeshëm rezistencën ndaj insulinës dhe ndihmon në rregullimin e ciklit menstrual. Menaxhimi multidisiplinar (gjinekolog, endokrinolog, dietolog, psikolog) përmirëson cilësinë e jetës me rreth 30% sipas studimeve të fundit.
Përfundime: Menaxhimi i sindromës së vezores policistike kërkon një qasje të personalizuar dhe të integruar që synon jo vetëm rregullimin hormonal, por edhe përmirësimin e parametrave metabolikë dhe mirëqenies psikologjike. Zbatimi i kritereve të standardizuara diagnostike dhe përdorimi i metodave të reja terapeutike janë kyçe për përmirësimin e rezultateve klinike dhe reduktimin e komplikacioneve afatgjata.

Fjalë kyçe: Sindroma e vezores policistike, menaxhim modern, fertilitet, diagnozë, sfida klinike, metabolizëm.

ZHVILLIMET BASHKËKOHORE NË DIAGNOSTIKIMIN DHE MENAXHIMIN E FIBROIDËVE UTERINE: RËNDËSIA E ULTRASONOGRAFISË SË STANDARDIZUAR.

Prof. Asoc. Dr. Edlira Bylykbashi[1], Ph. D. Ilta Bylykbashi[1], Ph. D. Ilir Bylykbashi
[1]Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri
Klinika Bylykbashi, Tiranë

Abstrakt
Leiomiomat uterine (fibroidet) janë tumore beninje të muskulaturës së lëmuar të mitrës, me prevalencë të lartë te gratë në moshë fertile, që shpesh shoqërohen me gjakderdhje menstruale të rëndë, dhimbje pelvike, presion mbi organet fqinje dhe probleme riprodhuese. Diagnostikimi i hershëm dhe vlerësimi i saktë janë kyç për zgjedhjen e strategjisë terapeutike më adekuate. Ekzaminimi ekografik i standardizuar, duke përfshirë ekografinë transvaginale dhe transabdominale, siguron informacion të detajuar mbi numrin, madhësinë, vendndodhjen dhe echostrukturën e fibroidëve, duke lehtësuar klasifikimin e tyre sipas sistemit FIGO dhe planifikimin e trajtimit individual. Strategjitë bashkëkohore të menaxhimit të leiomiomave përfshijnë monitorimin aktiv të rasteve asimptomatike, terapinë medikamentoze për kontrollin e gjakderdhjes dhe zvogëlimin e volumit, procedurat minimal - invazive si embolizimi i arterieve uterine dhe miomectomia laparoskopike ose histeroskopike, si dhe trajtimin kirurgjikal definitive kur nevojitet. Roli i ekografisë standarde është thelbësor jo vetëm për diagnostikimin, por edhe për monitorimin e progresionit të fibroidëve dhe vlerësimin e përgjigjes ndaj terapive. Ky studim thekson rëndësinë e qasjes sistematike dhe standardizimi i ekzaminimit ekografik si bazë për vendimmarrjen klinike dhe optimizimin e rezultateve trajtues te pacientet me fibroidë uterine, duke integruar teknikat moderne diagnostikuese dhe opsionet terapeutike më efikase dhe të personalizuara.

Fjalë kyçe: Fibroidëve uterine, tumor beninj, mitër.

UDHËRRËFYESIT E FUNDIT PËR MENAXHIMIN E KANCERIT TË TIROIDES ME RISK TË ULËT.

Dr. Edlira Hoxha[1], Dr. Anila Rrupulli[2], Prof. Asoc. Arben Mitrushi[3], Prof. Asoc. Anila Kristo[4]

Abstrakt
Dy tipat më të shpeshtë të karcinomave të diferencuara të tiroides (DTC) janë forma papilare dhe folikulare. DTC zakonisht kanë një rritje të ngadaltë, janë të trajtueshme dhe në më të shumtën e rasteve kanë prognozë të mirë. Karcinoma papilare e tiroides është më e shpeshtë, shpesh përhapet në limfonodujt regjional të qafës. Ndërsa forma folikulare është më e rrallë, mund të përhapet gjithashtu në limfonoduj, por ka një probabilitet më të madh për të dhënë edhe prekje në distancë si p. sh në pulmon apo kocka. Incidenca e DTC ka ardhur në rritje në vitet e fundit kryesisht për shkak të rritjes së diagnostikimit rutinë, ndërsa mortaliteti ka mbetur i pandryshuar. Incidenca varion në lidhje me moshën dhe është më e lartë te femrat. Menaxhimi i DTC përfshin kërkon bashkëpunim multidisiplinar dhe përfshin një diapazon modalitetesh të ndryshme. Por ajo që vihet re në vitet e fundit janë ndryshimet e udhërrëfyesve duke theksuar rëndësinë e trajtimit të individualizuar. Në këtë mënyrë shmangen mbitrajtimet për rastet e DTC low risk (me risk të ulët) dhe evidentohen rastet që kërkojnë një trajtim më intensiv dhe follow up më të zgjatur. Një fokus i veçantë është mbi trajtimin post operator të karcinomave

te diferencuara të tiroides me risk të ulur (low risk), mbështetur mbi rezultatin e biopsisë dhe ekzaminimit citopatologjik. Low risk do të thotë që forma e karcinomës që ka pacienti ka një probabilitet shumë të ulur për rekurenca dhe mortalitet. Modalitetet kryesore të trajtimit post operator për DTCS përfshijnë trajtimin ablativ me jodradioaktiv, terapinë suprimuese hormonzëvendësuese, follow up - i dhe vlerësimi i markerave molekularë. Sipas guideline - ve të fundit të 2025 të Shoqatës Europiane të Endokrinologjisë (ETA), për karcinoma low risk nuk rekomandohet rutinë trajtimi me jod radiokativ, gjithnjë nëse tumori plotëson kriteret (I vogël në përmasa, intratiroidien, pa tipare të tjera high risk). Pas kirurgjisë, pacientët zakonisht marrin trajtim hormon - zëvendësues për të mbajtur TSH në intervalin midis kufirit të poshtëm - normal të normës (0. 5 - 2 mUI / L). Rekomandohet follow - up i rregullt me ultrasonografi e qafës dhe matja e tireoglobulinës e antikorpeve anti - Tg sidomos në vitet e para post op. Por nëse të dhënat tregojnë rezultate të qëndrueshme dhe përgjigje të mirë në kohë, monitorimi mund të rrallohet derisa të ndërpritet.

Fjalë kyçe: Kancer i tiroides, karcinoma, DTC.

UDHËRRËFYESIT E FUNDIT PËR MENAXHIMIN E KANCERIT TË TIROIDES ME RISK TË ULËT.

Dr. Edlira Hoxha[1], Dr. Anila Rrupulli[2], Prof. Asoc. Arben Mitrushi[3], Prof. Asoc. Anila Kristo[4]

Abstrakt

Dy tipat më të shpeshtë të karcinomave të diferencuara të tiroides (DTC) janë forma papilare dhe folikulare. DTC zakonisht kanë një rritje të ngadaltë, janë të trajtueshme dhe në më të shumtën e rasteve kanë prognozë të mirë. Karcinoma papilare e tiroides është më e shpeshtë, shpesh përhapet në limfonodujt regjional të qafës. Ndërsa forma folikulare është më e rrallë, mund të përhapet gjithashtu në limfonoduj, por ka një probabilitet më të madh për të dhënë edhe prekje në distancë si p. sh në pulmon apo kocka. Incidenca e DTC ka ardhur në rritje në vitet e fundit kryesisht për shkak të rritjes së diagnostikimit rutinë, ndërsa mortaliteti ka mbetur i pandryshuar. Incidenca varion në lidhje me moshën dhe është më e lartë te femrat. Menaxhimi i DTC përfshin kërkon bashkëpunim multidisiplinar dhe përfshin një diapazon modalitetesh të ndryshme. Por ajo që vihet re në vitet e fundit janë ndryshimet e udhërrëfyesve duke theksuar rëndësinë e trajtimit të individualizuar. Në këtë mënyrë shmangen mbitrajtimet për rastet e DTC low risk (me risk të ulët) dhe evidentohen rastet që kërkojnë një trajtim më intensiv dhe follow up më të zgjatur. Një fokus i veçantë është mbi trajtimin post operator të karcinomave te diferencuara të tiroides me risk të ulur (low risk), mbështetur mbi rezultatin e biopsisë dhe ekzaminimit citopatologjik. Low risk do të thotë që forma e karcinomës që ka pacienti ka një probabilitet shumë të ulur për rekurenca dhe mortalitet. Modalitetet kryesore të trajtimit post operator për DTCS përfshijnë trajtimin ablativ me jodradioaktiv, terapinë suprimuese hormonzëvendësuese, follow up - i dhe vlerësimi i markerave molekularë. Sipas guideline - ve të fundit të 2025 të Shoqatës Europiane të Endokrinologjisë (ETA), për karcinoma low risk nuk rekomandohet rutinë trajtimi me jod radiokativ, gjithnjë nëse tumori plotëson kriteret (I vogël në përmasa, intratiroidien, pa tipare të tjera high risk).

Pas kirurgjisë, pacientët zakonisht marrin trajtim hormon - zëvendësues për të mbajtur TSH në intervalin midis kufirit të poshtëm - normal të normës (0. 5 - 2 mUI / L).

Rekomandohet follow up i rregullt me ultrasonografi e qafës dhe matja e tireoglobulinës e antikorpeve anti - Tg sidomos në vitet e para post op. Por nëse të dhënat tregojnë rezultate të qëndrueshme dhe përgjigje të mirë në kohë, monitorimi mund të rrallohet derisa të ndërpritet.

Fjalë kyçe: Kancer i tiroides, karcinoma, DTC.

DEPRESIONI NË MOSHËN GERIARTRIKE, SFIDAT DIAGNOSTIKE DHE TERAPEUTIKE, RISHIKIM LITERATURE.

Edlira Lashi[1], Klea Lashi[2], Behije Zaimi [3], Fatbardha Osmani [4]
[1]*Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Albanian University*
[2]*Departamenti i Biokimisë Klinike, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri*
[3]*Qendra Shëndetësore nr 8, Tiranë*
[4]*Qendra Socio - Shëndetësore nr 1, Tiranë*

Abstrakt
Hyrje: Depresioni në geriatri është një sëmundje mendore multifaktoriale me ndikim të lartë në cilësinë e jetës, pavarësitë funksionale dhe mortalitetin te të moshuarit. Ai shpesh mbetet i padiagnostikuar dhe i keqtrajtuar për shkak të mbivendosjes klinike me sëmundjet kronike somatike, çrregullimet kognitive dhe perceptimit të gabuar se simptomat depresive janë pjesë e "plakjes normale", si lodhja, anoreksia apo dhimbja kronike. Studimet tregojnë se prevalenca e depresionit madhor në popullatën ≥ 65 vjeç varion nga 7% në komunitet deri në 30% në institucionet e kujdesit afatgjatë (Jaros et al. , 2024).
Qëllimi: Analizimi i sfidave diagnostike dhe terapeutike të depresionit në të moshuarit, duke u mbështetur në rishikimet e literaturës dhe udhëzimet bashkëkohore (NICE 2022; USPSTF 2023).
Materiale dhe metoda: U krye një analizë narrative e literaturës së 10 viteve të fundit në databazat PubMed, Cochrane dhe NICE, me fokus në trajtimet farmakologjike, ndërhyrjet psikoterapeutike dhe modelet e kujdesit bashkëpunues.
Rezultate: Diagnostikimi mbetet i vështirë për shkak të prezantimeve klinike atipike dhe polifarmacisë. SSRI - të mbeten linja e parë e trajtimit, megjithatë kërkohet kujdes për efektet anësore si hiponatremia dhe rreziku i rrëzimeve (Chaplin, 2022). Kombinimi i farmakoterapisë me terapi konjiktive të sjelljes ose (problem - solving therapy) përmirëson kliniken dhe ul rikthimin (Unützer et al. , 2024). Modelet e kujdesit të integruar mes shërbimit të psikiatrisë, mjekësisë familjare dhe shërbimeve sociale kanë treguar efikasitet të lartë në depresionin madhor. (Reynolds et al. , 2022). Për rastet rezistente, elektrokonvulsoterapia (ECT) mbetet metoda më e efektshme me profil sigurie të pranueshëm, ndërsa stimulimi transkranial magnetik (rTMS) përfaqëson një alternativë me efikasitet të moderuar (Huang et al. , 2025; IJGP 2024).
Përfundime: Menaxhimi i depresionit në geriatrik kërkon një qasje multidisiplinare dhe të personalizuar, që integron depistimin e hershëm, rishikimin e barnave, ndërhyrjet psikoterapeutike dhe përdorimin e kujdesshëm të agjentëve farmakologjikë. Udhëzimet aktuale theksojnë rëndësinë e modeleve bashkëpunuese dhe të monitorimit afatgjatë për të reduktuar barrën funksionale dhe sociale të kësaj patologjie.

Fjalë kyçe: Depresioni, geriatria, diagnoza, trajtimi, rishikim literature.

ENDOKARDITI SUBAKUT NGA SALMONELLA TYPHI ME PËRFSHIRJE TRIKUSPIDALE DHE INSUFICIENCË MULTIORGANORE: RAPORTIM RASTI.

Edlira Petoshati[1]. Nevila Kryemadhi[1]. Dorela Kolldani[1]. Martin Hamolli[1]. Ermir Tafaj[2]. Renato Osmenaj[3]. Elton Petoshati[4]. Najada Como[1].
[1]*Sherbimi I Semundjeve Infektive QSUT*
[2]*Sherbimi I Kardiologjise QSUT*
[3]*Sherbimi I Imazherise QSUT*
[4]*Poliklinika Specialiteteve Nr 3*

Abstrakt
Hyrje: Endokarditi infektiv është një infeksion serioz, zakonisht i shkaktuar nga Staphylococcus spp, Streptococcus spp dhe Enterococcus spp. Përfshirja e valvulës trikuspidale nga Salmonella Typhi është tepër e rrallë dhe zakonisht lidhet me prognozë të rezervuar për shkak të komplikacioneve sistemike.
Paraqitja e rastit: Pacienti mashkull 42 - vjeçar, me hepatit C kronik dhe krioglobulinemi, i cili paraqitet me dispne, edema të gjeneralizuara dhe alterim të gjëndjes së përgjithshme. Pesë javë më parë diagnostikuar si endokardit trikuspidal nën terapi me antibiotike orale. Në ekografi transtorakale vihet re: regurgitim i rëndë trikuspidal me një vegjetacion të lëvizshëm, dilatim i kaviteteve të djathta, efuzion pericardial i moderuar. Analizat laboratorike evidentuan anemi të rëndë, insuficiencë renale, dëmtim të rëndë hepatocelular, nivele të larta të NT - proBNP, shenja inflamacioni dhe çrregullime të koagulimit. Testi Widal rezultoi pozitiv me titra

të larta për Salmonella Typhi. Hemokulturë pozitive me patogenë Gram negative. Rasti u vendos nën antibioterapi për shaktarin etiologjik të izoluar të këtij endokarditi subakut nën të cilën pacienti pati ecuri të mirë klinike edhe imazherike. Ky rast paraqet një formë shumë të rrallë të endokarditit subakut trikuspidal nga Salmonella Typhi, i komplikuar me insuficiencë renale dhe hepatike në sfondin e hepatitit kronik dhe krioglobulinemisë. Të tilla prezantime janë të rralla në literaturë dhe kanë prognozë të rëndë pavarësisht trajtimit.
Përfundim: Endokarditi i valvulës trikuspidale nga Salmonella Typhi është një entitet klinik jashtëzakonisht i rrallë. Diagnostikimi i hershëm dhe menaxhimi multidisiplinar janë të domosdoshëm për përmirësimin e rezultateve klinike. Rasti në fjalë, falë izolimit në kohë edhe ndjeshmerisë ndaj antibioterapisë së përdorur, pati nje ecuri të mirë klinike edhe imazherike.

Fjalë kyçe: Endokardit infektiv, Salmonella Typhi, valvula trikuspidale, insuficiencë multiorganore, raportim rasti.

RASTI KLINIK I NJË PACIENTI ME SARKOMË EKSTRASKELETIKE: QENDRIMI QË MBAHET.

Dr. Edmond Gashi[1], Prof. Dr. Helidon Nina[2], Herta Axhami[3]
[1]Kirurg Onkolog Senolog Onkoplastik
[2]Kirurg Onkolog
[3]Infermiere Onkologjike Kirurgjikale

Abstrakt
Rasti i një pacienti 54 vjeç me një sarchome ekstraskeletike, del në pah: - Sarchoma ekstraskeletike është një tumor i rrallë i cili takohet në moshat 45 - 60 vjeç në ndryshim nga sarkomat e tjera skeletike të cilat takohen në mosha të reja. - Trajtimi kërkon një qasje multidisiplinare. - Rol vendimtar është stadifikimi i saktë me CT dhe MRI, së fundmi dhe Pet - CT. - Kirurgjia luan një rol të rëndësishëm në trajtimin e kësaj patologjie, ku para se të meret një vendim sic tham dhe më sipër duhet stadifikimi i saktë dhe Tru - Cut Biopsia e masës për vlerësimin histopatologjik, ku në rastin tonë ishte Condrosarchome extraskeletike gradë e ulët (raste të rralla). - Rezeksioni RO është vendimtar, ku në këtë rast është realizuar me Biopsi extempora. - Trajtimi KT+RT është i domosdoshëm, ndikon në jetëgjatësinë dhe cilësinë e jetës. - Rastet metestatike kërkohet KT neandjuvante.

Fjalë kyçe: Sarchoma ekstraskeletike, tumor, CT - MRI, ekzaminim.

ZHVILLIMI I KAPACITETEVE PËR KUJDESIN NDAJ PËRDORIMIT TË ANTIMIKROBIKËVE NË SHQIPËRI.

Edmond Puca[1], Elda Qyra[1], Migena Qato[1], Ermira Muço[1], Entela Puca[2,3], Najada Como[1,4]

[1]Shërbimi i Sëmundjeve Infektive, QSUT, Tiranë
[2]Shërbimi i Endokrinologjisë, Spitali Amerikan
[3]Universiteti Western Balkan, Tiranë
[4]Departamenti i Sëmundjeve Infektive dhe Dermatologjisë, Fakulteti i Mjekësisë, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Rezistenca antimikrobike (AMR) mbetet një kërcënim madhor për shëndetin publik global, duke ndikuar në mënyrë të veçantë në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme (LMIC). Studimi cilësor i Global Point Prevalence Survey of Antimicrobial Consumption and Resistance (Global - PPS 2025) identifikoi faktorët kryesorë që përcaktojnë suksesin e programeve të kujdesit ndaj përdorimit të antimikrobikëve (AMS), si mbështetja e drejtuesve spitalorë, bashkëpunimi shumëdisiplinar, kapaciteti diagnostik dhe financimi i qëndrueshëm.
Shqipëria, me nivele në rritje të rezistencës mikrobike, ende nuk ka krijuar një rrjet kombëtar të AMS; prandaj, përkthimi i evidencës ndërkombëtare në veprim kombëtar është thelbësor.

Materiale dhe metoda: Bazuar në udhëzuesin e OBSH - së për AMS në LMIC, u vlerësuan strukturat aktuale shëndetësore, kapacitetet e mikrobiologjisë dhe programet ekzistuese të parandalimit të infeksioneve. U propozua një model i përshtatur për zbatimin e AMS në spitale, me theks në angazhimin e drejtuesve, edukimin ndërprofesional, përdorimin e të dhënave për vendimmarrje dhe integrimin e AMS në komitetet ekzistuese të IPC.
Rezultate: Faktorët lehtësues përfshijnë praninë e specialistëve të sëmundjeve infektive dhe mikrobiologjisë, pjesëmarrjen në rritje të laboratorëve në survejimin e AMR dhe ndërgjegjësimin kombëtar nëpërmjet iniciativave arsimore të lidhura me udhëzimet e Shoqatës Europiane të Mikrobiologëve Klinikë dhe Infektologëve (ESCMID).
Pengesat përfshijnë mungesën e infrastrukturës diagnostike, sistemet jo - elektronike të recetave dhe mungesën e një strukture formale të AMS. Formimi i ekipeve pilot të AMS në spitalet terciare, të mbështetura nga politika kombëtare dhe mentorim akademik, mund të shërbejë si bazë për zgjerimin kombëtar.
Konkluzione: Shqipëria ka burime njerëzore dhe përgatitje institucionale për të nisur aktivitete të AMS. Shfrytëzimi i kornizës Global - PPS dhe udhëzimeve të ESCMID mund të lidhë boshllëkun midis matjes dhe veprimit. Zhvillimi i ekipeve të qëndrueshme shumëdisiplinare të AMS do të jetë kyç për përmirësimin e përdorimit të antibiotikëve dhe luftën ndaj rezistencës mikrobike në nivel kombëtar.

Fjalë kyçe: Kujdesi ndaj antibiotikëve, rezistenca antimikrobike, antimikrobikë, AMS, LMIC.

NJË KUJTIM I PADËSHIRUAR NGA PUSHIMET: LARVA MIGRANS CUTANEA PAS UDHËTIMIT, STUDIM RASTI.

Dea Puca[1], Edmond Puca[2], Entela Puca[3], Albana Daka[4]

[1]Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Tiranë
[2]Shërbimi i Sëmundjeve Infektive, Tiranë
[3]Universiteti Western Balkan, Tiranë
[4]Klinika Fit Health, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Larva migrans cutanea është një infeksion parazitar i lëkurës i shkaktuar nga larvat e ankilostomidëve që zakonisht parazitojnë te kafshët, por rastësisht infektojnë edhe njeriun. Infeksioni karakterizohet nga lezione serpiginoze, kruarje dhe dhimbje lokale. Rastet janë më të shpeshta në zona tropikale dhe subtropikale, por mund të shfaqen edhe te udhëtarët që kthehen nga këto rajone.
Qëllimi: Raportimi i një rasti të rrallë të larva migrans cutanea të lokalizuar në gishtat e këmbës te një paciente udhëtare, me qëllim theksimin e rëndësisë së anamnezës epidemiologjike dhe diagnozës së hershme.
Prezantimi i rastit: Pacientja femër, 56 vjeç, u paraqit me dhimbje, eritemë dhe ndjesi kruarje dhe përhapjeje në gishtat e këmbës së djathtë. Anamneza tregoi se ajo kishte udhëtuar në Arabinë Saudite tre javë më parë, ku kishte ecur zbathur në rërë. Në ekzaminimin klinik u vërejtën vija eritematoze serpiginoze me migrim ditor dhe ndjesi djegieje lokale. Nuk kishte shenja sistemike. Diagnoza u vendos klinikisht si larva migrans cutanea. Pacientja u trajtua me albendazol 400 mg në ditë për 3 ditë dhe aplikim lokal të tiabendazolit, me përmirësim të dukshëm të simptomave pas një jave.
Përfundime: Ky rast nënvizon rëndësinë e marrjes së një anamneze të detajuar epidemiologjike në rastet me lezione eritematoze migratore, si dhe rolin e diagnozës së hershme në parandalimin e komplikacioneve. Larva migrans cutanea duhet të merret në konsideratë në diagnozën diferenciale të lezioneve të ngjashme te udhëtarët që kthehen nga rajone tropikale.

Fjalë kyçe: Larva migrans cutanea, infeksion parazitar, lëkura, larvat e ankilostomidëve.

ANOMALITË E LINDURA TË MURIT ABDOMINAL.
Edone Hoxha

Abstrakt
Hyrje: Anomalitë kongenitale më të zakonshme të murit abdominal përfshijnë gastroshizën dhe omfalocelën, në të cilat ekziston mbyllje jo e plotë e murit të barkut gjatë zhvillimit të fetusit që lejon daljen e organeve te barkut jashtë kavitetit abdominal. Faktorët gjenetikë dhe mjedisorë mund të ndikojnë në shfaqjen e tyre. Shoqërohen edhe me anomali të lindura të organeve tjera. Diagnoza prenatale luan rol në menaxhimin e lindjes, trajtimin pas lindjes dhe prognozën e këtyre fëmijëve. Trajtimi përfundimtar është kirurgjik me mbyllje primare apo riparim me faza të defektit.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është analizimi i numrit të rasteve të anomalive më të shpeshta të murit abdominal (gastroshizës dhe omfalocelës), në Klinikën e Kirurgjise së Fëmijëve dhe Neonatologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës për periudhën kohore 2013 - 2023.
Metedologjia: Hulumtimi është i tipit retrospektiv me komponentë deskriptive që përfshin gjithsej 36 pacientë me anomali të lindur të murit abdominal për periudhën kohore 2013 - 2023.
Rezultate: Nga 36 pacientë, 23 (64%) prej tyre janë të diagnostifikuar me gastroshizë dhe 13 (36%) me omfalocelë. Nga numri i përgjithshëm, 19 (53%) pacientë janë të gjinisë mashkullore dhe 17 (47%) të gjinisë femërore. Në vitin 2021 dhe 2022 është shënuar numri më i lartë i pacientëve me nga 6 raste në vit. Lindja me prerje cezariane ka qenë në 83% të fëmijëve kurse 17% e tyre kanë lindur me lindje normale. Pacientët më gastroshizë në 23% të rasteve kanë peshën trupore nën dy kilogram (<2kg) që tregon ngecje të rritjes intrauterine. Fëmijët me omfalocelë nuk kanë ngecje të rritjes intrauterine. 72% e fëmijëve i janë nënshtruar trajtimit kirurgjik me mbyllje primare të defektit ndërsa 28% prej tyre i janë nënshtruar riparimit me faza. Sepsa është komplikimi më i shpeshtë postoperativ i këtyre fëmijëve në 46% të rasteve. Anomalitë më të shpeshta shoqëruese të omfalocelës janë anomalitë kardiake në 47% të rasteve dhe Sindroma Beckwith - Wiedmann në 22% të rasteve. Gastroshiza komplekse shihet në 4 raste e shoqëruar me atrezi të kolonit.
Përfundime: Nga rezultatet e prezantuara mund të konkludojmë se shfaqja e gastroshizës është
1. 7 herë me e lartë se shfaqja e omfalocelës. Gjinia mashkullore është lehtësisht më e prekur se gjinia femërore. Pesha mesatare për fëmijët me gastroshizë është 2335. 5 gr, kurse pesha mesatare e fëmijëve me omfalocelë është 3200 gr. Lindja realizohet me prerje cezariane në 83% të rasteve. Sipas rezultateve mbyllja primare e defektit është metoda më e përdorur për trajtim (72%). Sepsa është komplikimi më i shpeshtë postoperativ i këtyre fëmijëve në 46% të rasteve. Anomalitë kardiake 47% dhe Sindroma Beckwith - Wiedmann 25% kanë shoqëruar fëmijët me omfalocelë. Atrezia e kolonit konstatohet në 4 raste të fëmijëve me gastroshizë. Shkalla e vdekshmërisë për fëmijët me gastroshizë dhe omfalocelë është 31%.

Fjalë kyçe: Gastroshizë, omfalocelë, anomalitë, atrezia, sepsa.

REZULTATET E TRAJTIMIT TË PACIENTËVE DIABETIK ME SGLT2.
Edone Zeka

Abstrakt
Hyrje: Diabeti mellitus tip 2 është ndër sëmundjet kronike më të përhapura në botë dhe paraqet një sfidë serioze për sistemet shëndetësore për shkak të ndërlikimeve që shfaqen me kalimin e kohës. Trajtimi i saktë dhe i vazhdueshëm është thelbësor për të parandaluar komplikimet. Një nga zhvillimet më të fundit në trajtimin farmakologjik është përdorimi i barnave që veprojnë duke penguar transportuesin e natriumit dhe glukozës në veshka – të njohura si inhibitorë të ko - transportuesit natrium - glukozë tip 2 (SGLT2i) të cilët përveç efektit në normalizimin e glicemisë, kanë edhe efekt mbrojtës nga ngjarjet mikro dhe makrovaskulare.
Qëllimi: Duke rishikuar literaturën aktuale në dispozicion dhe punime shkencore të publikuara të arritshme përmes internetit, është tentuar të arrihen njohuri më të gjera e më te thella, sa i përket përdorimit dhe efekteve të terapisë me SGLT2 inhibitorë tek pacientët me diabet mellitus. Tema fokusohet në analizimin e të dhënave të marra nga pacientët me diabet mellitus të trajtuar me SGLT2 inhibitorë në Klinikën e Endokrinologjisë, në QKUK.
Materiale dhe metoda: Ky punim është një rishikim i literaturës ekzistuese dhe hulumtim shkencor retrospektiv. Duke hulumtuar nëpër libra me renome botërore në fushën e mjekësisë dhe punime shkencore të

arritshme e përmes web - faqeve, si dhe ilustrimi me anë të figurave në mënyrë që të arrihet deri në një seleksionim të mirëfilltë të informatave.
Rezultate dhe diskutimi: Nga tre studimet e përfshira në këtë punim, janë paraqitur dhe diskutuar rezultatet e fituara në lidhje me përgjigjen e pacientëve me diabet mellitus tip 2 ndaj terapisë me SGLT2 inhibitorë. Gjithashtu, janë analizuar të dhënat nga pacientët me diabet mellitus tip 2 që janë trajtuar me SGLT2 inhibitorë në Klinikën e Endokrinologjisë, në periudhën Janar 2025 - Maj 2025, ku gjithsej ishin 35 raste. Prej të cilëve 21 janë meshkuj dhe 14 janë femra. Prej grupit të SGLT2 inhibitorëve, bari i përdorur në 100% të rasteve ka qenë empagliflozina, e cila ka treguar rezultate të mira dhe është toleruar mjaft mirë nga shumica e pacientëve, ku vetëm 2 pacientë janë paraqitur me efekte anësore të lehta të vërejtura, kryesisht të lidhura me infeksione të traktit urogjenital.
Përfundime: Përmes një shqyrtimi të hollësishëm të literaturës dhe të dhënave klinike të disponueshme, kemi arritur në përfundimin që terapia me SGLT2i ka arritë një përmirësim të kontrollit të glicemisë si dhe ka siguruar mbrojtje të organizimit nga ngjarjet mikro dhe makrovaskulare.

Fjalë kyçe: SGLT2 inhibitorët, empagliflozina, diabeti mellitus.

EKSPERIENCA JONË ANESTEZIOLOGJIKE DHE REANIMATORE NË NDËRHYRJET BARIATRIKE TIP "GASTRIC SLEEVE": VLERËSIM RETROSPEKTIV.

Edvin Bekteshi MD[1], Krisli Serani MD[2], Marsel Dhima MD[2], Ardian Balla[1], Kristi Meçolli[1]
[1]*Shërbimi i Anetsezi Reanimacion Trita Hospital*
[2]*Shërbimi i Anestezi Reanimacion, QSUT*

Abstrakt
Hyrje: Obeziteti morbid përfaqëson një sfidë gjithnjë në rritje për sistemet shëndetësore, me pasoja të shumta sistemike dhe kërkesa të veçanta në trajtimin kirurgjikal. Teknikat bariatrike si "Gastric Sleeve" kanë treguar efikasitet të lartë në reduktimin e peshës dhe përmirësimin e komorbiditeteve, por mbartin kompleksitete të konsiderueshme anestezike dhe reanimatore. Qëllimi i këtij punimi është të paraqesim përvojën tonë me menaxhimin peri - intra dhe post operativë të pacientëve të operuar me këtë teknikë gjatë një viti.
Materiale dhe metoda: U krye një analizë retrospektive e 97 pacientëve të operuar për "Gastric Sleeve" nga maji 2024 deri në maj 2025 në shërbimin tonë. Të gjithë pacientët kishin indeks të masës trupore (BMI) >40, dhe trajtimi përfshiu menaxhimin anesteziologjik, monitorimin intraoperativ, si dhe kujdesin postoperator nga ekipi reanimator dhe kirurg.
Rezultate: Sfida kryesore anesteziologjike ishte menaxhimi i rrugëve të frymëmarrjes, me ventilim dhe intubim shpesh teknikisht të vështirë dhe nevojë për pozicionim të kujdesshëm dhe pajisje ndihmëse. Ventilimi intraoperator kërkonte strategji të personalizuara për të minimizuar barotraumën dhe hipoventilimin. Në periudhën postoperatorë u evidentuan tre komplikacione të rëndësishme: një rast me fistulë gastrike, i cili u menaxhua me riintervent kirurgjikal, dhe dy raste me insuficiencë respiratore të cilat u stabilizuan në ICU me ventilim mekanik për 2–4 orë. Asnjë rast nuk paraqiti hemorragji.
Kohëzgjatja e qëndrimit në spital ishte 2–3 ditë. Ushqyerja fillonte pas rifillimit të peristaltikës dhe hiqeshin drenat brenda 48 orëve, çka lejonte largimin në shtëpi në mënyrë të sigurt.
Konkluzione: Menaxhimi anesteziologjik dhe reanimator i pacientëve me obezitet morbid që i nënshtrohen ndërhyrjeve bariatrike paraqet sfida të konsiderueshme, por me përgatitje të mire paraprakisht, standarde të qarta dhe koordinim multidisiplinar, rezultatet mund të jenë të favorshme dhe të qëndrueshme. Eksperienca jonë tregon një siguri të lartë të procedurës dhe një incidencë të ulët të komplikacioneve seriozë, duke mbështetur më tej përdorimin e kësaj metode në trajtimin e obezitetit morbid.
Rekomandime: Rekomandohet një protokoll i qartë për intubimin, ventilimin dhe ndjekjen postoperative, si dhe trajnimi i ekipit për menaxhimin e rasteve të ndërlikuara. Roli i ICU është kyç për zgjidhjen e komplikacioneve të mundshme dhe për garantimin e një rikuperimi të shpejtë dhe të sigurt. Kirurgjia estetike, si ndërhyrje me karakter elektiv dhe rezultat të pritur estetik, kërkon protokolle anesteziologjike që garantojnë siguri, rikuperim të shpejtë dhe eksperiencë sa më të këndshme për pacientin.

Fjalë kyçe: Gastric Sleeve, obezitet morbid, ndëryhrje bariatrike.

PROGRAMI I PARË KOMBËTAR I DEPISTIMIT PËR RETINOPATINË E PREMATURITETIT NË SHQIPËRI.

Eglantina Bulica PhD - C[1], Vilma Mema Assoc. Prof[2], Alketa Tandili Assoc. Prof[2], Ilir Arapi Assoc. Prof[2], Spiro Dama Phd[3], Amarilda Hysenshahaj Msc[4]
[1]Okuliste, Poliklinika e Specialiteteve, Nr. Tiranë, Shqipëri
[2]Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri
[3]Neonatolog, Spitali Obstetrik Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë", Tiranë, Shqipëri
[4]Staticiene, Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Hyrje: Ky studim hulumton mbi incidencën dhe faktorët e lidhur me rrezikun për retinopatinë e prematuritetit (ROP) dhe formën posteriore të saj (P - ROP), e përcaktuar si sëmundje e lokalizuar në polin posterior, në zonën I ose posteriorisht zonës II, në stadin III dhe / ose me "plus disease". Gjithashtu, vlerësohet përqindja e foshnjave që kërkojnë trajtim dhe rezultatet klinike afatshkurtra të ROP në Shqipëri.
Materiale dhe metoda: U krye një studim prospektiv, në 2 pavione të kujdesit intensiv neonatal të nivelit terciar në Shqipëri. Në studim u përfshinë të gjithë të porsalindurit me peshë në lindje (BW) ≤1500 g dhe / ose moshë gestacionale (GA) ≤32 javë, të lindur midis 1 shtatorit 2024 dhe 1 shtatorit 2025.
Rezultate: Në total u ekzaminuan 135 foshnja, nga të cilat rezultuan me ROP në çdo stad në 61 (45%) raste, ndërsa P - ROP në 11 (8. 1%) foshnja. Analiza multivariate identifikoi aneminë (p < 0. 0064) dhe distresin respirator (p = 0. 003) si parashikues të rëndësishëm për zhvillimin e ROP, ndërsa GA ≤32 javë (p = 0. 03) dhe sepsisi (p = 0. 002) u lidhën në mënyrë të pavarur me ROP agresive (A - ROP). Dy foshnja (nga ato që kërkonin trajtim) morën ndërhyrje me injeksion intravitreal dhe një u trajtua me terapi lazer. Në përgjithësi, 90% e foshnjave me ROP arritën një rezultat të favorshëm afatshkurtër. Dy foshnja zhvilluan komplikacione, të dyja me P - ROP që kërkuan kirurgji, dhe një rast përfundoi me shkolitje të retinës.
Përfundime: P - ROP përfaqëson formën më agresive të ROP, e lidhur ngushtë me prematuritetin ekstrem dhe sepsisin neonatal. Përpjekjet duhet të përqendrohen në uljen e lindjeve shumë të parakohshme dhe për në parandalimin e sepsisit të hershëm dhe të vonshëm neonatal me qëllim zvogëlimin e rrezikut për P - ROP në Shqipëri.

Fjalë kyçe: Retinopatia e prematuritetit, ROP posteriore, "plus disease", terapi me lazer, foshnja premature.

KONTROLLI NEUROENDOKRIN NË PCOS.

Eglantina Dema[1], Tea Shehu Kolnikaj[2]
[1]Spitali Gjerman
[2]Spitali Amerikan 3

Abstrakt
Sekretimi pulsatil i GnRH nga hipotalamusi është thelbësor për ruajtjen e homeostazës riprodhuese. Neuronet KNDy në bërthamën arcuate përbëjnë gjeneratorin qendror të pulsit: kisspeptina dhe neurokinina - B nxisin çlirimin e GnRH, ndërsa dynorphina ndërmjetëson feedback - un frenues të progesteronit. Përveç tyre, inputi GABAergjik dhe sinjalet metabolike modulojnë aktivitetin e neuroneve GnRH, duke krijuar një ekuilibër të ndjeshëm mes stimulimit dhe frenimit. Në sindromën e vezores policistike (PCOS), ky ekuilibër prishet. Pulset e GnRH bëhen më të shpeshta dhe më të fuqishme, duke favorizuar sekrecionin relativisht të lartë të LH ndaj FSH dhe duke nxitur prodhimin ovarial të androgjenëve. Faktorët kryesorë që kontribuojnë janë: (1) hiperaktiviteti i neuroneve KNDy dhe ulja e ndjeshmërisë ndaj feedback - ut të progesteronit; (2) rritja e inputit GABAergjik, që shton aktivitetin e neuroneve GnRH; (3) nivelet e larta të AMH, të cilat veprojnë drejtpërdrejt mbi neuronet GnRH / KNDy dhe rrisin frekuencën pulsatile; (4) hiperinsulinemia, e cila amplifikon sinjalizimin qendror dhe njëkohësisht rrit steroidogjenezën tekale, duke fuqizuar hiperandrogjenizmin. Ky kuadër neuroendokrin shpjegon pse PCOS nuk duhet parë vetëm si çrregullim ovarian, por si rezultat i një ndërthurjeje të deregulimeve qendrore dhe periferike. Objektivat terapeutikë përfshijnë rivendosjen e feedback - ut progesteronik, përdorimin e antagonistëve të receptorit NK3 për të ulur pulset e LH, si dhe ndërhyrje metabolike që adresojnë hiperinsulineminë. Kuptimi i këtyre mekanizmave hap rrugën drejt fenotipizimit më të saktë dhe zhvillimit të terapive të synuara për PCOS.

Fjalë kyçe: PCOS, GnRH, KNDy, kisspeptinë, AMH, GABA, insulinë, hiperandrogjenizëm.

IVF POST ADNEXECTOMI DEXTER DHE TUBEKTOMI SINISTER.

Eglantina Dema, Denisa Balo

Abstrakt

Pacientja në moshën 12 vjeçare paraqitet në urgjencë me dhimbje të forta në fosa iliaka dexter dhe diagnostikohet dhe operohet për appendicitis akut. Gjatë operacionit ishte hequr edhe adneksi i djathtë (tubi dhe ovar dexter), por pacientja dhe familjarët nuk kishin dijeni për këtë. Menarka në moshën 14 vjeçe. Cikli menstrual i rregullt 28 - ditor, por menstruacionet me shumë dhimbje. Nga kontrollet, pa probleme akute gjinekologjike. Në moshën 19 vjeçe kishte sekrecione kafe në mes të ciklit. Nga kontrolli gjinekologjik diagnostikohet me kist endometriozik 57x75 mm. Ca125 negativ. Uterus me formë, madhësi, strukturë normale. Papritmas fillon dhimbje në fund të barkut majtas. Dhimbja bëhet e fortë dhe përhapet në gjithë barkun. Operacioni i vështirë që zgjati disa orë sepse pacientja kishte bërë peritonit. Gjatë kontrollit u vu re që vezorja e djathtë nuk ishte dhe u hoq tubi i majtë i dëmtuar së bashku me kistin çokollatë të rupturuar dhe u ruajt ovari i majtë. Pas 5 vitesh u bë IVF që rezultoi pa sukses dhe një vit më pas u realizua IVF e dytë me 3 embrione që rezultoi e suksesshme me 2 embrione, hemorragji në javën e 10 - të, regjim shtrati dhe mjekim, u bë cerclage në javën e 21 dhe lindja cezariane në 37 javë e 5 ditë. Lindën 2 djem të shëndetshëm 2790 gramë dhe 2670 gramë, që sot janë në klasën e parë.

Fjalë kyçe: IVF post adnexectomi dexter, tubektomi sinister.

PARANDALIMI I INSULTIT CEREBROVASKULAR: ROLI I KUJDESIT PARËSOR NË ZBULIMIN DHE MENAXHIMIN E FAKTORËVE TË RREZIKUT.

Dr. Egzona Sadiku[1] Dr. Merita Gërguri[2] Dr. Endrita Tora[3]
[1]*QKMF - Mitrovicë, Kosovë*
[2] *QKUK - Klinika e Neurologjisë, Kosovë*
[3] *QKMF - Specializante e Mjekësisë Familjare, Prishinë, Kosovë*

Abstrakt

Hyrje: Insulti cerebrovaskular i trurit përkufizohet si deficit neurologjik fokal i papritur, i shkaktuar nga një sëmundje cerebrovaskulare që zgjat më shumë se 24 orë. Insulti cerebrovaskular në përgjithësi ndahet në ishemik dhe hemoragjik. Insulti cerebrovaskular (ICV) është një nga shkaqet kryesore të vdekshmërisë dhe paaftësisë në nivel global dhe vendor. Rreth 80–85% e rasteve janë ishemike dhe lidhen drejtpërdrejt me faktorë rreziku të modifikueshëm si hipertensioni, diabeti, dislipidemia, obeziteti, duhanpirja dhe çrregullimet e ritmit kardiak. Pavarësisht zhvillimeve të fundit në trajtimin spitalor, mbetet e domosdoshme që vëmendja të përqendrohet tek parandalimi dhe menaxhimi i hershëm i faktorëve të rrezikut në nivel komunitar.

Qëllimi: Qëllimi i këtij prezantimi është të theksojë rolin e kujdesit parësor në parandalimin primar të insultit cerebrovaskular, duke përfshirë zbulimin e hershëm, menaxhimin e faktorëve të rrezikut, menaxhimin farmakologjik dhe jo - farmakologjik të sëmundjeve kronike, si dhe kujdesin e pacientëve post ICV për parandalimin e rikthimit.

Metoda: Ky punim bazohet në rishikimin e literaturës shkencore ndërkombëtare dhe përvojës klinike në nivel të kujdesit parësor. Janë analizuar strategjitë për skriningun e hipertensionit, diabetit, dislipidemisë dhe fibrilacionit atrial, si dhe praktikat e promovimit të një jetese të shëndetshme. Gjithashtu, është shqyrtuar roli i mjekut familjar dhe infermierit në monitorimin e pacientëve post ICV dhe në zbatimin e masave të parandalimit sekondar.

Diskutime: Parandalimi i ICV në kujdesin parësor përfshin menaxhimin e faktorëve të rrezikut dhe përdorimin e barnave të përshtatshme. Para sulmit, antihipertensivët, statinat dhe antiagreguesit ndihmojnë në reduktimin e rrezikut ishemik, ndërsa antikoagulantët përdoren kur ka indikacione të tjera kardiake. Pas sulmit, fokusi është në vazhdimin e terapive të përshtatshme, kontrollin e tensionit të gjakut, glukozës dhe lipideve, si dhe edukimin

dhe mbështetjen për rehabilitimin dhe parandalimin e rikthimit. Kjo qasje ndihmon në uljen e incidencës, rikthimeve dhe komplikacioneve, duke përmirësuar cilësinë e jetës së pacientëve.
Përfundime: Kujdesi parësor ka rol qendror në reduktimin e incidencës dhe rikthimit të insultit cerebrovaskular. Forcimi i skriningut, monitorimi i vazhdueshëm i faktorëve të rrezikut dhe edukimi shëndetësor i popullatës përbëjnë strategji efektive dhe me kosto të ulët për përmirësimin e shëndetit. Një qasje e integruar multidisiplinare në nivel komuniteti është thelbësore për uljen e barrës së kësaj sëmundjeje dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientëve.

Fjalë kyçe: insult cerebrovaskular - ICV, parandalim, kujdes parësor, faktorë rreziku, rehabilitim.

STRABIZMI: ASPEKTET KLINIKE, DIAGNOSTIKE DHE TERAPEUTIKE - RISHIKIM LITERATURE.
Egzona Selmani

Abstrakt
Hyrje: Strabizmi është një çrregullim okulomotor i karakterizuar nga devijimi i boshteve vizuale, i cili prek rreth 2–4% të popullsisë. Ai përbën jo vetëm një problem mjekësor, por edhe social dhe psikologjik. Forma më e shpeshtë është ezotropia, ndërsa përhapja e llojeve të strabizmit ndryshon sipas rajonit gjeografik dhe faktorëve etnikë.
Qëllimi: Ky punim synon të rishikojë literaturën mjekësore mbi aspektet klinike, diagnostike dhe terapeutike të strabizmit, duke analizuar evidencat më të fundit lidhur me prevalencën dhe menaxhimin e tij.
Metodologjia e punimit: U realizua një rishikim i literaturës përmes bazave të të dhënave shkencore dhe teksteve mjekësore, duke u fokusuar në studime klinike dhe epidemiologjike mbi strabizmin. Janë përdorur fjalë kyçe si strabismus, extraocular muscles, strabismus prevalence dhe strabismus treatment.
Rezultate: Evidencat tregojnë se diagnostikimi i hershëm dhe qasja multidisiplinare përmirësojnë dukshëm rezultatet vizuale dhe funksionale. Prevalenca ndryshon sipas rajonit: në vendet perëndimore dominon ezotropia akomoduese, ndërsa në vendet aziatike ekzotropia intermitente është më e zakonshme. Incidenca është më e lartë te fëmijët nën 5 vjeç dhe shfaqet pak më shumë te femrat se te meshkujt.
Përfundime: Strabizmi mbetet një patologji e shpeshtë okulare me ndikim të madh në cilësinë e jetës. Diagnostikimi i hershëm dhe trajtimi adekuat janë thelbësorë për të parandaluar ambliopinë dhe për të ruajtur shikimin binokular. Diferencat gjeografike dhe gjenetike sugjerojnë nevojën për hulumtime të mëtejshme dhe protokolle të personalizuara terapeutike.

Fjalë kyçe: strabizmi, shikimi binokular, ezotropia, ekzotropia, diagnostikim, trajtim.

VAKSINAT: INFORMIMI DHE DEZINFORMIMI - LUFTA MES SHKENCËS DHE MEDIAVE.
Ejona Shabani, Arbër Aliu
Doktor i Mjekësisë

Abstrakt
Hyrje: Vaksinat luajnë një rol kyç në reduktimin e rrezikut të infeksioneve. Hezitimi ndaj vaksinave nënkupton vonesën ose refuzimin për të marrë vaksinat e rekomanduara, edhe pse ato janë lehtësisht të disponueshme.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është që të përshkruhet roli i vaksinimit, informimi dhe dezinformimi në lidhje me to. Një luftë mes shkencës dhe mediave. Janë sqaruar disa raste, ku për shkak të dezinformimit edhe sot ka hezitim në vaksinim.
Metodologjia: Metodologjia e përdorur për realizimin e këtij punimi është ajo e rishikimit të literaturës botërore, OBSH, duke përfshirë publikime shkencore të viteve të fundit.
Rezultate: Organizata Botërore e Shëndetësisë e ka renditur hezitimin ndaj vaksinave si një nga dhjetë kërcënimet më të mëdha për shëndetin publik global. Hezitimi ndaj vaksinës është një fenomen kompleks, i formuar nga një gamë e gjerë faktorësh ndërthurës, përfshirë: Statusi socio - ekonomik, keqinformimi, besimet personale dhe preferencat shëndetësore, bindjet kulturore dhe fetare, ndikimi i rrjeteve sociale dhe rrethit shoqëror, roli i mediave dhe informacionit public, stigma dhe diskriminimi dhe dezinformimi i organizuar.

Përfundime: Vaksinat shpëtojnë jetë. Ato ulin sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë për 40% në nivel global. Nga OBSH vlerësohet se vetëm 50 vitet e fundit janë shpëtuar së paku 150 milion jetë në mbarë botën, dhe rreth 101 milion ishin fëmijë nën moshën 1 vjeç.
Të dhëna studimore tregojnë se vaksinat janë të sigurta, dhe se inkurajohen të gjithë për vaksinim.

Fjalë kyçe: roli i vaksinimit, OBSH, informimi dhe dezinformimi, mediat.

ÇRRGULLIMET E NGRËNIES NË SHQIPËRI NË ADOLESHENTË.

Ela Mitro
Mjek psikiatër për fëmijë dhe adoleshentë, Spitali "Petro Nako" Sarandë

Abstrakt
Hyrje: Të dhënat epidemiologjike për çrregullimet e ngrënies në Shqipëri dhe vendet e tjera Mesdhetare janë ende shumë të limituara. Edhe pse duke parë prevalencën e tyre te lartë, sëmundshmërine, vdekshmerinë dhe mundesitë e ndryshme të trajtimit, çrregullimet e ngrënies ngelen ende të nëndiagnostikuara nga profesionistët. Adoleshenca është një stad i zhvillimit me risk shumë të lartë për çrregullime të ngrënies. Shumë adoleshentë ngelen të patrajtuar fare, nuk shërohen, ose trajtohen pjesërisht.
Qëllimi: Studimi i marrëdhënies që ekziston midis qëndrimit ndaj ushqimit, indeksit të masës trupore dhe shfaqjes së çrregullimeve të ngrënies.
Materiale dhe metoda: 114 nxënës shkolle u përzgjodhën në mënyrë të randomizuar dhe plotësuan parametrat antropometrike për llogaritjen e Indeksit të masës trupore (BMI) dhe testin e qëndrimit ndaj ngrënies (EAT - 26 (forma e shkurtuar). Pyetsorët u realizuan në Sarandë dhe në Konispol. Grupi i studimit kishte diapazonin moshor 12 deri në 16 vjeç. Të dhënat u përpunuan nëpërmjet SPSS versioni 25.
Rezultate: 65. 7% e grupit të studimit, nisur nga analiza satistikore e të tre pjesëve të pyetësorit janë në rrezik për të zhvilluar ndonjë nga nënkategoritë e çrregullimeve të ngrënies dhe kërkojnë vlerësim nga specialisti. Ndërkohë 38. 6% (n=44) e grupit kanë rrezik të shfaqjes së çrregullimeve të ngrënies nisur vetëm nga pjesa e dytë e testit, pikëzimi. Të dhënat sugjerojnë që gjinia femërore dhe nxënësit e zonës rurale kishin më shumë gjasë për të shfaqur çrregullime të ngrënies.
Përfundime: Është studimi i parë që realizohet për qëndrimin ndaj ushqimit dhe çrregullimet e ngrënies. Rezultatet e studimit në grupin tonë duket të jenë të ngjashme dhe në përputhje me studimet ndërkombëtare. Është e nevojshme që të bëhet një studim më i zgjeruar, si në lidhje me përdorimin e EAT ose të ndonjë instrumenti tjetër në popullatën shqiptare, ashtu edhe për të eksploruar psikopatologjinë e lidhur me ushqimin.

Fjalë kyçe: Çrrgullimet e ngrënies, adoleshentë, Shqipëri.

ONIKOMYKOSIS: SFIDA KLINIKE DHE PËRDORIMI I NANOTEKNOLOGJISË SI QASJE TERAPEUTIKE.

Dr. Ela Treko
Mjeke Dermato - Venerologe

Abstrakt
Hyrje: Onychomycosis është patologjia më prevalente e çrregullimeve të thoit në botë, me një prevalencë globale 4 - 8% dhe incidencë vjetore 2 - 5% në të rritur. Shkaku më i shpeshtë ngelen dermatofitet, ndërkohë që vërehet rritje e rasteve nga jo - dermatofitet dhe infeksionet mikse. Infeksioni çon në impakt fizik, psikologjik dhe social të individëve të prekur, sidomos në të moshuar, persona me imunodificiencë dhe ata diabetikë.
Qëllimi: Ky studim ka për qëllim të ofrojë rishikim të literaturës mbi: epidemiologjinë globale të onychomycosis, metodat diagnostikuese aktuale, si dhe trajtimet ekzistuese dhe qasjet inovative me përdorimin e nanoteknologjisë për përmirësimin e efikasitetit terapeutik.
Materiale dhe metoda: Të dhënat e nxjerra janë me anë të përdorimit të PubMed, Google Scholar, Science Direct, PMC dhe Wiley Online, prej vitit 1997 deri në 2025.

Rezultate dhe Diskutime: Onychomycosis është një patologji në rritje dhe përbën rreth 50% të patologjive të thoit. Metodat diagnostike klasike, ndonëse të përdorura gjerësisht, kanë ndjeshmëri dhe specifitet të kufizuar, ndërsa PCR paraqet një risi për diagnostikim më të saktë. Trajtimet konvencionale shpesh kërkojnë kohë të gjatë dhe kanë normë të lartë kthimi. Studimet e fundit mbi nanoteknologjinë tregojnë se lipidet, nanoemulsionet dhe nanopartikulat polimerike përmirësojnë depërtimin në pllakën e thoit dhe mund të reduktojnë kohën e trajtimit dhe të rrisin efikasitetin.
Konkluzione: Onychomycosis ngelet një sfidë dermatologjike e zakonshme, por shpesh e nënvlerësuar. Diagnostikimi i saktë është thelbësor për trajtimin efektiv. Inovacionet në nanoteknologji paraqesin një perspektivë premtuese për të përmirësuar rezultatet klinike dhe reduktimin e rikthimeve.
Rekomandime: 1. Rritja e përdorimit të diagnostikimeve molekulare në praktikën klinike. 2. Përdorimi i trajtimeve me nanoteknologji në rastet e rezistencës apo rikthimit. 3. Realizimi i studimeve klinike të gjera dhe afatgjata për të vlerësuar efikasitetin dhe sigurinë e terapive të reja.

Fjalë kyçe: Onychomycosis, dermatologji, infeksion, trajtim.

PREVALENCA DHE SPEKTRI I NEUROPATISË PERIFERIKE NË PACIENTËT ME SËMUNDJE RENALE KRONIKE PRE - DIALIZË – ANALIZË STATISTIKE MULTIFAKTORIALE.

Elda Çule[1], Merita Rroji[2]
[1]Departamenti i Nefrologjisë, Hygeia Hospital Tirana
[2]Departamenti i Nefrologjisë, Spitali Universitar "Nënë Tereza", Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Neuropatia periferike (NP) është një komplikim i shpeshtë në pacientët me sëmundje renale kronike (SRK), shumë përpara stadit të hemodializës. Patogjeneza e saj përfshin toksinat uremike, çrregullimet metabolike dhe sëmundjet bashkëshoqëruese. Për arsye të impaktit të rëndësishëm në cilësinë e jetës, NP mbetet e nëndiagnostikuar në stadet e hershme të SRK. Ky studim eksploron prevalencën dhe spektrin e NP në pacientët me SRK pre - dializë, duke integruar vlerësimet klinike dhe elektrofiziologjike me analizën statistikore.
Metodologjia: Ky është një studim transversal i 63 pacientëve adultë, 18–75 vjeç, nga të cilët 57% ishin në stadin 3–4 dhe 33% në stadin 5 (jo në dializë). Neuropatia periferike u diagnostikua në bazë të literaturës me pikëzimin sipas MNSI më shumë se 7 dhe / ose gjetjeve jonormale në studimet e konduksionit të nervave (ENG). Pastaj u aplikuan statistikat përshkruese, grupet e krahasimit, testimet korreluese dhe analizat e regresionit multivariat.
Rezultate: Mosha mesatare e pacientëve: 65. 1 vjeç; 33% femra. NP u gjet me prevalencë më të lartë dhe në spektër më të rëndë në stadin 5 të sëmundjes, me 63% të regjistrimit të pikëve MNSI >7 krahasuar me 27% të atyre në stadet 3–4 ($p < 0.001$). Të dhënat u nxorën nga vlerësimet klinike të strukturuara dhe regjistrat laboratorikë. Gjetjet më të rëndësishme përfshinë sëmundjet bashkëshoqëruese: hipertensionin (80%), diabetin mellitus (35%) dhe sëmundjet autoimune (10%). Mjetet e vlerësimit të neuropatisë si MNSI me pikëzimin maksimal 8.2 ± 1.5; 65% me pikëzim ≥ 7 (sugjerues për NP). ENG me gjetje jonormale në 68. 3% të pacientëve; predominon polineuropatia aksonale periferike. Ultratingulli – sipërfaqja tërthore (CSA): u gjet më e rëndësishme në nervin tibial në grupin me NP (mesatarisht 13. 4 mm^2 vs 9. 2 mm^2, $p < 0.01$). Korrelimet laboratorike: eGFR lidhet në mënyrë të kundërt me pikëzimin MNSI ($r = -0.42$, $p < 0.01$). Kreatinina serike e lidhur në mënyrë pozitive me anomalitë në ENG ($r = 0.38$, $p = 0.02$). PTH e lartë dhe nivele të ulëta të kalciumit ishin më të shpeshta në pacientët NP - pozitivë ($p < 0.05$).
Konkluzione: Neuropatia periferike është me prevalencë të lartë në pacientët pre - dializë dhe lidhet ngushtë me disfunksionin renal dhe me diabetin. Vlerësimet e shumta të përdorura dhe të kombinuara në vlerësimin klinik, elektrofiziologjinë dhe ultratingullin e nervave përforcojnë përpikmërinë diagnostike. Analizat statistikore ripërforcojnë vlerën parashikuese të eGFR dhe markuesve metabolikë. Diagnostikimi dhe ndërhyrja e hershme duhet të kenë përparësi kryesore për të parandaluar përkeqësimin neurologjik dhe për ruajtjen e cilësisë së jetës së këtyre pacientëve.

Fjalë kyçe: sëmundje renale kronike, uremic neuropathy, Michigan Neuropathy Screening Instrument, ultratingulli i nervit tibial.

STRATEGJITË BASHKËKOHORE TERAPEUTIKE NË TRAJTIMIN EMERGJENT TË INFEKSIONEVE TË SYRIT.

Dr. Elda Lota

Abstrakt

Hyrje: Infeksionet e rënda të syrit, si keratiti bakterial, endoftalmiti dhe orbitopatia infektive, përbëjnë emergjenca oftalmologjike që mund të rezultojnë me dëmtime ireversibile të shikimit nëse nuk trajtohen në kohë. Prevalenca e tyre është e lidhur shpesh me faktorë rreziku si trauma okulare, përdorimi i lenteve të kontaktit, ndërhyrjet kirurgjikale, si dhe sëmundjet imunosupresore.

Qëllimi: Të theksohet rëndësia e diagnostikimit të hershëm dhe qasjes së menjëhershme terapeutike në reduktimin e komplikimeve dhe ruajtjen e funksionit vizual.

Metodologjia: Punimi bazohet në shqyrtimin e literaturës së viteve të fundit mbi menaxhimin emergjent të infeksioneve okulare, duke analizuar qasjet diagnostike dhe strategjitë terapeutike të zbatuara në praktikën klinike.

Rezultate: Studimet tregojnë se inicimi i menjëhershëm i terapisë empirike me antibiotikë ose anti - fungal me spektër të gjerë, përmirëson ndjeshëm ecurinë klinike. Në keratitin bakterial, fluorokinolonet ose preparatet fortifikuese reduktojnë komplikimet në >80% të rasteve kur aplikohen brenda 24 orëve. Endoftalmite post - kirurgjikale menaxhohen me injeksione intravitrealë të vancomicinës dhe ceftazidimit, ndërsa vitrektomia e hershme ruan shikimin në 60–70%. Orbitopatitë infektive trajtohen me antibiotikë intravenozë dhe debridim kirurgjikal, duke ulur rrezikun e komplikimeve sistemike mbi 50%.

Përfundime: Infeksionet e rënda të syrit kërkojnë ndërhyrje të shpejtë dhe të koordinuar. Diagnostikimi i hershëm, trajtimi i menjëhershëm dhe bashkëpunimi multidisiplinar janë faktorë kyç në parandalimin e humbjes së shikimit dhe komplikimeve sistemike. Edukimi i pacientëve dhe zbatimi i protokolleve klinike të standardizuara janë thelbësore për menaxhimin efektiv të këtyre rasteve.

Fjalë kyçe: infeksionet okulare, keratit, endoftalmit, emergjencë oftalmologjike.

HIV DHE ÇRREGULLIMET PSIKOTIKE – NJË DIMENSION SHPESH I NËNVLERËSUAR.

Elda Qyra, Migena Qato, Edmond Puca, Monika Dede, Eljona Shega, Ina Hatellari.
Departamenti i Sëmundjeve Infektive, QSUNT.

Abstrakt

Infeksioni nga virusi i imunodeficiencës humane, vazhdon të jetë një problem për shëndetin publik dhe jo vetëm, me ndikime të shumta në shëndetin fizik, mendor dhe social të individëve të prekur. Përveç ndikimeve organore dhe imunologjike, sëmundja e HIV / AIDS ka ndikim të drejtpërdrejtë edhe në sistemin nervor qendror duke shkaktuar një gamë të gjerë manifestimesh neuro - psikiatrike. Çrregullimet psikotike në kontekstin e HIV / AIDS mund të jenë pasojë e mekanizmave të ndryshëm patofiziologjikë. Ato mund të lindin si rezultat i infektimit të drejtpërdrejtë të sistemit nervor nga virusi (neuro - HIV), të ndryshimeve inflamatore dhe neurodegjenerative që shoqërojnë infeksionin kronik, ose të efekteve anësore të terapisë antiretrovirale. Gjithashtu, faktorët psikologjikë dhe socialë si stigmatizimi, izolimi, depresioni mund të kontribuojnë në shfaqjen ose përkeqësimin e simptomave psikotike.

Nga ana klinike, manifestimet variojnë nga simptoma psikotike të lehta (ankth, irritabilitet, konfuzion, ide paranoide) deri te psikoza e plotë me halucinacione, deluzione dhe humbje të kontaktit me realitetin. Këto manifestime shpesh përfshihen edhe me çrregullime të tjera neurokognitive të lidhura me HIV, duke e bërë diagnozën diferenciale të vështirë. Në këtë këndvështrim, vlerësimi multidisiplinar që përfshin mjekun infeksionist, psikiatrin dhe neurologun është thelbësor për identifikimin dhe trajtimin e duhur të këtyre gjendjeve.

Menaxhimi kërkon një qasje të integruar që kombinon trajtimin farmakologjik (antipsikotikë të përzgjedhur me kujdes për shkak të ndërveprimeve me terapinë antiretrovirale) me mbështetjen psikosociale dhe ndërhyrjet psikoedukuese. Edukimi i pacientit dhe familjarëve, ndjekja e rregullt mjekësore dhe reduktimi i stigmatizimit janë komponentë thelbësorë për përmirësimin e ecurisë klinike dhe të cilësisë së jetës. Ne synojmë të theksojmë rëndësinë e njohjes së hershme të çrregullimeve psikotike te pacientët me HIV / AIDS dhe nevojën për qasje të

gjithanshme për kujdesin e tyre. Vetëm përmes ndërthurjes së trajtimit mjekësor dhe mbështetjes psikosociale mund të arrihet një menaxhim i plotë dhe efektiv i këtyre rasteve komplekse.

Fjalë kyçe: HIV / AIDS, çrregullimet psikotike, infeksion, virus.

KUR PICKIMI PREK VESHKAT: DEKURS I PAZAKONTË I DËMTIMIT RENAL AKUT SHKAKTUAR NGA HELMIMI I GJARPRIT.

Elena Gjecka

Abstrakt

Hyrje: Pickimi nga gjarpri përbën një urgjencë mjekësore me potencial për komplikacione sistemike, përfshirë dëmtimin renal akut (AKI). Mekanizmat përfshijnë hipovoleminë, hemolizën, rabdomiolizën dhe efektin nefrotoksik direkt të helmit.

Paraqitja e rastit: Paraqitet rasti i një gruaje rreth 40 vjeç, e pickuar në dorën e majtë. Ekstremiteti ishte edematoz dhe cianotik. Pacientja mori një dozë antivenomi (Antivipera) menjëherë pas paraqitjes në urgjencë. Brenda 48 orëve u vu re rritje e kreatininës në rreth 3 mg / dL dhe ulje e diurezës. U trajtua mes të tjerash, me furosemid intravenoz (180 mg / 24h). Më pas, diureza u rikthye gradualisht dhe funksioni renal u përmirësua.

Diskutime: Dëmtimi renal akut pas pickimit nga gjarpri është një ndërlikim serioz me patogjenezë multifaktoriale. Përveç nefrotoksicitetit direkt, ndikojnë edhe faktorë si hipotensioni, koagulopatia dhe dëmtimet nga pigmentet. Trajtimi i hershëm me antivenom dhe mbështetja adekuate hemodinamike janë kyçe për parandalimin e dëmtimit të pakthyeshëm renal.

Përfundime: Ky rast thekson rëndësinë e monitorimit të hershëm të funksionit renal pas pickimit nga gjarpri, edhe në rastet e trajtimit në kohë, për të siguruar një ecuri të favorshme klinike.

Fjalë kyçe: Pickim gjarpri, dëmtim renal akut, helmim nga gjarpri, nefrotoksicitet, raport rasti.

RRUGËT E FRYMËMARRJES TË PËRBASHKËTA NË ORL PEDIATRIKE.

Dr. Elida Agaci
QSUT "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Hyrje: Menaxhimi i rrugëve të frymëmarrjes të përbashkëta në otorinolaringologjinë (ORL) pediatrike paraqet sfida të veçanta për shkak të anatomisë delikate, diametrave më të vegjël të rrugëve të ajrit dhe ndjeshmërisë më të lartë ndaj hipoksisë tek fëmijët. Menaxhimi i suksesshëm i rrugëve të frymëmarrjes kërkon bashkëpunim të ngushtë ndërmjet anesteziologëve dhe kirurgëve ORL, veçanërisht gjatë procedurave si kirurgjia endoskopike e rrugëve të ajrit, mikrolaringoskopia dhe bronkoskopia. Komplikacione si obstruksioni i rrugëve të ajrit, hipoksemia dhe paqëndrueshmëria hemodinamike janë më të zakonshme në pacientët pediatrikë dhe mund të ndikojnë ndjeshëm në ecurinë perioperative.

Materiale dhe Metoda: Për pacientët pediatrikë që iu nënshtruan procedurave ORL që kërkonin menaxhim të përbashkët të rrugëve të frymëmarrjes, u përdor një qasje multidisiplinare. Vlerësimi paraoperativ përfshinte analizën e anatomisë së rrugëve të ajrit, komorbiditeteve dhe faktorëve të rrezikut për intubim të vështirë. Gjatë ndërhyrjes u përdorën tuba endotrakealë të përshtatshëm për moshën, maska laringeale, ventilim me jet (jet ventilation) ose teknika të oksigjenimit apneik. Monitorimi i vazhdueshëm i oksigjenimit, ventilimit dhe parametrave hemodinamikë udhëhoqi menaxhimin intraoperativ. U vendosën protokolle komunikimi për të optimizuar koordinimin mes ekipeve të anestezisë dhe kirurgjisë.

Rezultate: Zbatimi i protokolleve të strukturuara për menaxhimin e rrugëve të përbashkëta të frymëmarrjes siguroi një menaxhim të sigurt të tyre tek pacientët pediatrikë në ndërhyrjet ORL. Ndërhyrjet në kohën e duhur minimizuan rrezikun e hipoksemisë dhe bllokimit të rrugëve të ajrit. Qasja multidisiplinare mundësoi akses kirurgjikal të saktë duke ruajtur ventilimin dhe oksigjenimin e duhur. Nuk u raportuan komplikacione të mëdha perioperative dhe rikuperimi postoperativ ishte në përgjithësi pa probleme.

Diskutime: Menaxhimi i rrugëve të përbashkëta të frymëmarrjes tek fëmijët në ndërhyrjet ORL mbetet një aspekt i domosdoshëm por me rrezik të lartë i kirurgjisë pediatrike. Koordinimi multidisiplinar, vlerësimi i kujdesshëm paraoperativ dhe përdorimi i strategjive të përshtatshme të ventilimit sipas moshës janë thelbësore

për minimizimin e komplikacioneve. Standardizimi i protokolleve dhe strategjive të komunikimit përmirëson sigurinë e pacientit dhe efikasitetin e ndërhyrjes kirurgjikale.
Përfundime: Një qasje e strukturuar, e bazuar në bashkëpunimin e ekipit për menaxhimin e rrugëve të përbashkëta të frymëmarrjes në ORL pediatrike optimizon oksigjenimin, redukton rreziqet perioperative dhe lehtëson aksesin kirurgjikal. Zbatimi i protokolleve të standardizuara mund të përmirësojë sigurinë, efikasitetin dhe rezultatet në procedurat që përfshijnë rrugët e frymëmarrjes tek pacientët pediatrikë.

Fjalë kyçe: ORL, pacientë pediatrik, oksigjenim, kirurgji, anestezi.

FAZA PREANALITIKE DHE RËNDËSIA E SAJ. GABIMET MË TË SHPESHTA TË KËSAJ FAZE.
Elida Hanaj
[1]*Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.*
[2]*Spitali Universitar Obsetrik - Gjinekologjik "Koço Gliozheni".*

Abstrakt
Hyrja: Faza preanalitike përfshin gjithë etapat komplekse përpara se kampioni të analizohet në laborator. Shumica e gabimeve laboratorike rrjedhin nga moszbatimi korrekt i protokolleve të fazës preanalitike. Studimi i të gjithë hapave të fazës preanalitike për të minimizuar sa më shumë gabimet preanalitike. Faktoret preanalitik perfshijnë variablat që lidhen me pacientin si dieta, mosha, seksi etj. Teknikat e mbledhjes dhe etiketimit të mostrave, konservantët dhe antikoagulantët e mostrave, transporti i mostrës, perpunimi dhe ruajtja.
Qëllimi: Të përcaktojmë terminologjinë përkatëse. Të identifikojmë ekzaminimet e kërkuara. Të demostrojmë variablave preanalitike që ndikojnë në rezultatet e testeve laboratorike. Të identifikojmë kuptimin dhe nevojën e shërbimeve këshilluese.
Materialet dhe metodat: Në këtë studim u morën të gjitha rastet problematikë, gabimet e fazës preanalitike, që janë paraqitur në Laboratorin Networks në Spitalin Universitar Obsetrik Gjinekologjik 'Koço Gliozheni' për një periudhë njëvjecare.
Rezultate: Në këtë studim njëvjecar nga 14400 kampione të gjakut komplet rezultojnë: 272 kampione të koaguluar, 40 kampione të gabuara, 10 kampione të paidentifikuar, 7 identifikim i gabuar dhe 223 kampione me sasi të pamjaftueshme. Nga 7200 kampione biokimike rezultojnë: 224 kampione të hemolizuar, 12 kampione të gabuara, 6 të paidentifikuar, 12 kampione të gabuara dhe 208 sasi e pamjaftueshme. Nga 4800 kampione për faktorët e koagulimit rezultojnë: 240 kampione të hemolizuar, 62 kampione të koaguluar, 7 kampione të gabuara, 16 kampione të paidentifikuar dhe 296 raport jo i saktë anticoagulant - gjak. Nga 3600 kampione për njëvit rezultojnë: 248 sasi e pamjaftueshme, 298 kampione të koaguluara, 16 kampione të gabuara, 5 kampion të padentifikuara dhe 25 identifikim i gabuar. Në këtë studim rezultoi: 6. 4% të kampioneve janë paraqitur në laborator me probleme për analizat biokimike, 3. 6% të kampioneve me probleme për ekzaminimet me K3 EDTA, 13. 4% të kampioneve me probleme për ekzaminimet me citrate NA, si dhe 16. 4% të kampioneve me probleme për ekzaminimet të astrupogramës.
Përfundime: Është e rëndësishme, komunikimi me pacientin. Mbledhja e saktë e mostrave. Identifikim i duhur, ruajtja dhe transporti. Zbatim i udhëzimeve dhe protokolleve. Trajnim i personelit që merret kryesisht me fazën preanalitike. Reduktimi i gabimeve rrit besueshmerinë, standartin e shërbimeve që ofron laboratori.

Fjalë kyce: Preanalitika, variablat preanalitik, indikacionet, shërbimet këshilluese, kampionet.

KARAKTERISTIKAT KLINIKE DHE LABORATORIKE TE FEMIJET ME LEUKEMI AKUTE MIELOIDE.
Eldijana Morina

Abstrakt
Hyrje: Leukemia është njëri ndër tipet e kancerit të gjakut, e cila karakterizohet me proliferim dhe predominim të leukociteve të papjekura ose imature, duke rezultuar me grumbullimin e tyre në palcën kockore, gjakun periferik dhe më pas infiltrimin në inde dhe organe. Ndryshimet patologjike fillojnë që në stadin e krijimit të

qelizave staminale mieloide. Shkaktarë mund të jenë faktorët gjenetikë, rrezatimet jonizuese, çrregullimet dhe sëmundjet e palcës kockore, shkaqe idiopatike etj.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është hulumtimi i leukemisë akute mieloide tek fëmijët në Klinikën Pediatrike, në repartin e Hematologjisë, në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, ku me theks të veçantë i është kushtuar vëmendje llojit dhe kohëzgjatjes së manifestimeve klinike, si dhe vlerave laboratorike të sëmundjes.
Materiali dhe metodologjia: Hulumtimi është retrospektiv dhe është përdorur metoda e studimit të rasteve. Të dhënat janë marrë nga Klinika Pediatrike, reparti i Hematologjisë, në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Paraprakisht është marrë leje nga Katedra e Pediatrisë dhe Komiteti Etiko - Profesional i SHSKUK - së për përdorimin e këtyre rasteve për këtë punim diplome. Në hulumtim janë përfshirë rastet me leukemi akute mieloide dhe rastet me leukemi akute limfoide. Të dhënat për fëmijët e sëmurë me leukemi akute mieloide janë marrë për periudhën kohore Janar 2019 deri në Dhjetor 2020.
Rezultate: Nga të dhënat e marra në Klinikën e Pediatrisë, reparti i Hematologjisë së fëmijëve në QKUK, konstatojmë se në periudhën Janar 2019 deri në Dhjetor 2020 janë trajtuar gjithsej 10 pacientë me leukemi akute mieloide, të grupmoshave 5–17 vjeç. Më shumë janë të prekura femrat se meshkujt dhe LAM shfaqet më rrallë se LAL.
Diskutime: Nga të dhënat e grumbulluara në Klinikën Pediatrike, reparti i Hematologjisë në QKUK, janë diskutuar dhe marrë parasysh rezultatet e hulumtimeve të cekura në punim.
Përfundime: Si përfundim, në bazë të studimeve konstatohet se LAM është një sëmundje me etiologji ende jo mirë të njohur, me manifestim klinik të qartë, me ndryshime laboratorike të theksuara, dhe për t'u shëruar kërkon terapi të rëndë, e cila shpesh shoqërohet edhe me efekte anësore te pacientët.

Fjalë kyçe: leukemia akute mieloide, leukemia akute limfoide, hematologji pediatrike, QKUK, terapi citotoksike.

REALITETI VIRTUAL DHE REDUKTIMI I ANKTHIT DHE DHIMBJES PERIOPERATIVE.

Dr. Elira Nuraj
Universiteti i Prishtinës

Abstrakt
Hyrje: Stresi perioperativ përbën një nga sfidat më të zakonshme në procesin kirurgjikal, i cili ndikon në mënyrë të ndjeshme si në përvojën emocionale të pacientit, ashtu edhe në rrjedhën e rikuperimit pas operacionit. Ankthi para ndërhyrjes, frika nga dhimbja dhe pasiguria për rezultatin mund të çojnë në shtim të nevojës për sedacion, zgjatje të periudhës së rikuperimit dhe rritje të komplikacioneve postoperatore. Realiteti virtual (VR) ofron një qasje moderne, imersive dhe jo - invazive që ndihmon në uljen e stresit, edukimin e pacientëve dhe përgatitjen e tyre për procedurat kirurgjikale.
Qëllimi: Ky punim synon të vlerësojë efektivitetin e realitetit virtual si mjet edukativ dhe terapeutik për reduktimin e stresit perioperativ, duke analizuar evidencat më të fundit shkencore dhe duke theksuar potencialin e tij për t'u integruar në praktikën klinike.
Metodologjia: U realizua një rishikim narrativ i literaturës ndërkombëtare (2020–2025) përmes bazave të të dhënave PubMed, Scopus dhe Cochrane Library. U përfshinë studime të kontrolluara të rastësishme, meta - analiza dhe studime pilot që analizojnë ndikimin e VR në uljen e ankthit, perceptimit të dhimbjes dhe kënaqësinë e pacientëve.
Rezultate: Rezultatet treguan se përdorimi i VR para ndërhyrjes kirurgjikale ul ndjeshëm ankthin preoperativ (deri në 50%), përmirëson përvojën emocionale dhe ul nevojën për sedacion. Efekti më i madh u vërejt tek pacientët pediatrikë. Gjithashtu, VR po përdoret me sukses në edukimin e studentëve të mjekësisë dhe stafeve spitalore.
Përfundime: Realiteti virtual përfaqëson një qasje inovative, të sigurt dhe efektive për menaxhimin e stresit perioperativ dhe edukimin mjekësor. Integrimi i tij në kujdesin klinik mund të rrisë cilësinë e përvojës së pacientëve dhe të ulë kostot e trajtimit. Rekomandohet zhvillimi i protokolleve standarde për aplikimin e VR në mjediset spitalore.

Fjalë kyçe: realitet virtual, ankth perioperative, edukim shëndetësor, teknologji mjekësore, kirurgji pediatrike.

HULUMTIM I ADERENCËS SË PACIENTËVE NDAJ TERAPISË, MENAXHIMIN DHE STRATEGJITË PËR PËRMIRËSIMIN E SAJ.

E. Usejni[1], H. Hajzeri[2], F. Doko[3]
[1]*PZU Duo Medika - Strugë, Maqedonia e Veriut*
[2]*Departamenti i Urgjencës, QKMF - Dr. Fatmir Fazlija, Skenderaj, Kosovë*
[3]*Farmacia Primavita - Strugë, Maqedonia e Veriut*

Abstrakt
Hyrje: Aderenca mund të përkufizohet si shkalla në të cilën sjellja e një personi përputhet me marrjen optimale të një medikamenti, pra është shkalla në të cilën një pacient ndjek regjimin e trajtimit. Ajo është kyçe për arritjen e qëllimeve terapeutike dhe për përmirësimin e rezultateve shëndetësore të pacientit. Pacientët nuk i marrin medikamentet e tyre shumicën kohës. Edhe pse shumica e mjekëve besojnë se mospërputhshmëria lidhet kryesisht me mungesën e aksesit ose harresën, ajo shpesh mund të jetë një zgjedhje e qëllimshme e pacientit. Për të studiuar adherencën e pacientëve ndaj terapive të dhëna, përdorëm një pyetësor me përgjigje me zgjedhje të shumëfishta. Pacientëve u kërkua të përgjigjen në bazë të përvojës së tyre lidhur me përputhshmërinë ndaj terapisë. Pacientët u përfshinë në studim në mënyrë rastësore. Modeli i studimit ishte "i prerjes së tërthore" (cross - sectional). Në studim morën pjesë N=102 pacientë. Studimi u zhvillua në Komunën e Strugës, Maqedoni e Veriut, ku 60% e pjesëmarrësve ishin femra dhe 40% meshkuj. Të dhënat u përpunuan dhe u vizualizuan përmes programit MS Excel 2016.
Rezultate: Nga rezultatet e marrë në pyetjen nëse pacientët harrojnë të marrin barnat, 11. 1% u përgjigjën se i harrojnë shpesh, 27. 3% thanë se ndonjëherë i harrojnë, 26. 3% rrallëherë, dhe 35. 4% thanë se kurrë nuk i harrojnë. Sa i përket pyetjes: "A e ndërprisni ndonjëherë marrjen e barnave kur ndiheni më mirë?", 12% e pacientëve thanë "gjithmonë", 29% "shpesh", 31% "rrallë" dhe 28% "kurrë". Në praktikën time të përditshme, pas analizës së rezultateve të studimit, përzgjodha 10 pacientë me hipertension të pakontrolluar, të cilët kishin terapi të përshkruar, por e harronin shpesh marrjen e barnave. Për të përmirësuar përputhshmërinë me terapinë, instalova në telefonin e tyre një aplikacion që kujton marrjen e barnave, dhe i ftova çdo dy ditë për kontroll, gjatë së cilës ua matja vetë tensionin e gjakut. Pas një muaji, u vunë re përmirësime të dukshme në gjendjen e tyre shëndetësore dhe në përputhshmërinë me terapinë antihipertensive.
Konkluzione: Zbatimi i këtyre strategjive duhet të jetë i domosdoshëm në të gjitha ordinancat dhe strukturat e kujdesit shëndetësor në Maqedonine e Veriut, pasi në një popullatë të vogël, brenda një ordinance, ato kanë treguar rezultate shumë të suksesshme. Nëse hartohet dhe zbatohet një plan i mirë i koordinuar në nivel shtetëror, përmirësimi i gjendjes shëndetësore të popullatës do të jetë i ndjeshëm dhe me ndikim të madh.

Fjalë kyçe: Aderenca, hipertensioni, kujdesi parësor.

MANIFESTIMET KUTANE TE PACIENTËT UREMIKË TË TRAJTUAR ME HEMODIALIZË KRONIKE.

Dr. Elita Zylbeari - Masha[1, 2], Ass. Mr. Dr. Gazmend Zylbeari[1, 2], Ass. Dr. Art Zylbeari [1, 2, 4.], Doc. Dr. Zamira Bexheti [3], Prof. Dr. Lutfi Zylbeari [1, 4], Prof. Dr. Bistra Angelovska[2]
[1]*Fakulteti i ShkencaveMjekësore, Universiteti i Tetovës, RMV*
[2] *Fakulteti i ShkencaveMjekësore, Goce Delcev Universiteti, Stip, RMV*
[3] *Universiteti i Evropës Juglindore - Tetovë, RMV*
[4]*Spitali Klinik i Tetovës - Tetovë, RMV*

Abstrakt
Manifestimet kutane shpesh vërehen te pacientët uremik të trajtuar me hemodializë kronike (HD) dhe ndikojnë në cilësinë e jetës së tyre. Patofiziologjia e saktë e manifestimeve lëkurore tek pacientët me HD mbetet e panjohur. Supozohet se ka etiologji multifaktoriale duke përfshirë aneminë, renale, vetë trajtimi me HD dhe modalitetet e ndrysheme të HD, ndikimi i toksinave uremike, çrregullimet endokrine - metabolike, elektroliteve dehidratimin e lëkurës, depozitimin e pigmentit, imunitetin e dëmtuar të lëkurës dhe hiperparatiroidizmi sekondar, dehidratimin e lëkurës, shkaktojnë ndryshime strukturore dhe funksi - onale të lëkurës me kruarje uremike, çrregullimi i të gjumit, xseroza uremike dhe janë manifetsimet i më të shpeshta dhe që negativisht ndikojnë në cilësinë e jetës së pacientëve që i nënshtrohen dializës. Manifesti - met kutane tek pcientët uremik

klasifikohen në dy kategori: jospecifike dhe specifike. Manifestimet jospecifike manifestohen me: kruarje, ndryshime te thonjt, zbehje, kserozë, dhe hiperpigme - ntimi, ndërsa ato specifike shfaqen me fibrozë sistemike, dermatozë, kalcinozë etj. Patofiziologjia e saktë e manifestimeve të dermatologjike tek pacientët uremik që i nënshtrohen HD mbetet e panjohur dhe multifaktoriale. Prej simptomeve dermatologjike dominonë kruarja uremike, xeroyat, hiperpigmentimin, deformitetet e thonjëve etj. Të cilat ndikoi negativisht në cilësinë e jetës së pacientëve që i nënshtrohen dializës.
Qëllimi i punimit: Ky studim hetoi manifestimet e ndryshme të lëkurës tek pacientët që i nënshtrohen HD.
Materiali: në studim ishin të përfëshir 100 pacienta uremik (45 gra dhe 55 meshkuj me moshë mesatare identike prej 59. 60±12. 0 vjeçare) të trajtuar me HD bikarbonate mbi 60 muaj me frekuencë prej 3 herë në javë nga 4, 5 orë.
Rezultatet: prej simptomeve lëkurore te 92% domionte zbehja, 75 % kruarja 57 % xerosa dhe deformim të thonjëve te 47 % e pacientëve.
Konkluzioni: në përfundim nga studimi jonë na konkludojmë se tratimi drematologjike nuk arrinë përmirësime më të mëdha në cilësinë e jetës dhe trajtimin e manifestimeve lëkuror, por kohëzgjatja e seancës së HD dhe përdorimi i membranave me tokoferol dhe biokompatibile me flux të lartë dukshm ndikonin në zbutjen e manifestimeve lekurore.

Fjalë kyçe: uremia, hemodializa, manifestimet lëkurore.

PREVALENCA E DERMATOZAVE TË FËMIJËRISË.

Dr. Eljesa Ilir Krusha
Klinika e Dermatovenerologjisë – Qendra Klinike Universitare E Kosovës, Prishtinë.

Abstrakt
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të hulumtohet prevalenca e dermatozave te fëmijët në klinikën e Dermatovenerologjisë - QKUK, Prishtinë. Të analizohen llojet e dermatozave dhe prevalenca e shfaqjes së këtyre llojeve te fëmijët. Të analizohet incidenca e dermatozës te fëmijët sipas strukturës gjinore dhe vendbanimit. Të krahasohen grup - moshat sipas gjinisë.
Metodologjia: Ky hulumtim është një studim retrospektiv i fëmijëve të diagnostikuar me dermatozë në klinikën e dermatovenerologjisë - qkuk, prishtinë. Të dhënat janë marrë nga protokollet e arkivuara te fëmijëve të diagnostikuar në periudhën kohore 2 vjeçare, janar 2020 – dhjetor 2021.
Rezultate: Në periudhën kohore 2 vjeçare janar 2020 - dhjetor 2021 në klinikën e dermatovenerologjisë në kuadër të QKUK - së, në Prishtinë, me dermatozë, kanë qenë të diagnostikuar gjithsej 109 fëmijë. Nga llojet e dermatozave te fëmijët dermatozat me prevalencë më të lartë ishin urtikaria akute me 65 raste (60%) dhe scabiesi me 16 raste (15%). Nga 109 fëmijë, 46 (42%) ishin femra dhe 63 (58 %) ishin meshkuj. Grup - mosha më e atakuar ishte 0 - 5 vjeçare me 48 raste (44%). Qyteti më i prekur ka qenë Prishtina me 36 raste
(33 %).
Përfundime: Në bazë të ekzaminimeve tona kemi arritur në përfundim se dermatozat te fëmijët shfaqen tek të dy gjinitë, me një incidencë më të lartë për gjininë mashkullore dhe moshat e reja, si dhe ndërlidhet me probleme të hendikepimit dhe transmetimit të infeksionit në shoqëri.

Fjalë kyçe: Dermatoza, urtikaria akute, scabiesi, prevalenca.

DIAGNOZA PRENATALE E HUMBUR E SINDROMËS BECKWITH - WIEDEMANN: NJË ANALIZË MULTIDISIPLINARE E NEGLIZHENCËS MJEKËSORE, IMPLIKIMEVE ETIKE DHE PASOJAVE LIGJORE.

Prof. Asc. Elmas Shaqiri, Prof. Asc. Daniela Xhemalaj, Prof. Dr. Arben Lloja
Departamenti i Anatomisë Patologjike dhe Mjekësisë Ligjore, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Abstrakt
Sfondi: Sindroma Beckwith - Wiedemann (BWS) është një çrregullim i njohur i rritjes së tepërt, është një nga sindromat somatike të rritjes së tepërt që prek organe të shumta njerëzore, bazuar në çrregullimin gjenetik të imprintimit me karakteristika dalluese ultrasonografike prenatale duke përfshirë makroglosinë, omfalocelën dhe makrosominë fetale.

Ajo shfaq shprehje të ndryshuar të gjeneve në rajonet 15. 5 te kromozomit nr. 11, të cilat rregullojnë rritjen e fetusit. Diagnoza e hershme prenatale mundëson këshillim të përshtatshëm, planifikim të lindjes dhe koordinim të menjëhershëm të kujdesit pas lindjes. Amplifikimi i sondës së varur nga lidhja multiplekse (MS - MLPA) specifik për metilimin rekomandohet si mjeti molekular i linjës së parë sepse zbulon njëkohësisht statusin e metilimit ICR1 / ICR2 dhe numrat e kopjeve që zgjidhin shumicën e rasteve klinike në skenarin prenatal.
Prezantimi i Rastit: Ne raportojmë një rast të diagnozës së humbur prenatale të BWS ku makroglosia e dukshme fetale u vu re gjatë ultrasonografisë rutinë në javën 25+6 të shtatzënisë, por u keqinterpretua nga mjeku ekzaminues si "humor fetal" - fetusi "nxori gjuhën jashtë" në mënyrë të gjallë. Sonografi nuk arriti ta njohë këtë si një gjetje patologjike që kërkon hetime të mëtejshme. Ekzaminime të shumta pasuese vazhduan të raportonin "zhvillim normal të fetusit" pavarësisht makroglosisë së vazhdueshme. Foshnja lindi në javën e 39 - të me makroglosia të rëndë, omfalocele dhe hemihipertrofi, duke konfirmuar diagnozën e BWS. Menaxhimi pas lindjes kërkoi ndërhyrje të shumta kirurgjikale duke përfshirë kirurgjinë e reduktimit të gjuhës në Austri, terapi të vazhdueshme të të folurit dhe kujdes mjekësor të specializuar. Fotografi klinike që demonstrojnë tipare karakteristike të sindromës Beckwith - Wiedemann. (A) Makroglosia e rëndë - zgjatimi i spikatur i gjuhës që ishte i dukshëm gjatë ultrazërit prenatal në javën 25+6, por u keqinterpretua si "humor fetal" në vend që të njihej si "gjetje patologjike". (B) Gropa e veshit (gropëza preaurikulare) - një anomali e vogël e pranishme në afërsisht 75% të rasteve të BWS, duke mbështetur diagnozën sindromike. Të dyja tiparet ilustrojnë natyrën gjithëpërfshirëse të BWS që duhej të ishte njohur përmes vlerësimit të duhur prenatal.
Përfundime: Ky rast thekson rëndësinë kritike të trajnimit të duhur në zbulimin e anomalive prenatale, respektimin e protokolleve diagnostikuese dhe pasojat serioze ligjore dhe etike të dështimeve diagnostikuese. Sistemet e kujdesit shëndetësor duhet të sigurojnë masa të përshtatshme arsimore dhe të sigurimit të cilësisë për të parandaluar raste të ngjashme të diagnozave prenatale të humbura. Mungesa e përvojës klinike në zbulimin e sindromave të tilla çon në diagnoza të humbura.

Fjalë kyçe: Sindroma Beckwith - Wiedemann, diagnoza prenatale, keqpërdorim mjekësor, makroglosia, ultrasonografia, neglizhenca mjekësore, implikime etike.

NIVELET E PROTEINËS C - REAKTIVE POSOPERATIVE TE PACIENTËT ME OPERACIONE INTERABDOMINALE.

Elmedina Ibishi, BSc, Prof. Ass. Dr. Halit Maloku[2]
[1]*Teknike e laboratorit*
[1]*Spitali Special për Kirurgji "ALOKA" dhe Universiteti "Hasan Prishtina" Republika e Kosovës*

Abstrakt
Hyrje: Infeksionet intra - abdominale përbëjnë një spektër të gjerë patologjish që përfshijnë peritonitin, absceset intra - abdominale, divertikulitin dhe kolangitin, të cilat paraqesin sfida të mëdha si në aspektin klinik ashtu edhe diagnostik. Etiologjia e këtyre infeksioneve shpesh lidhet me perforacionet gastrointestinale, ndërhyrjet kirurgjikale ose traumat.
Materiale dhe metoda: Ky është një studim retrospektiv. Janë analizuar rastet me komplikacione infektive postoperatore në Spitalin Special për Kirurgji "ALOKA" gjatë periudhës janar 2023 – janar 2025. Të dhënat laboratorike dhe klinike u siguruan përmes sistemit elektronik të dokumentimit të pacientëve të hospitalizuar. Pacientët i përkisnin grupmoshës 18–81 vjeç. Janë përfshirë vlerat e CRP - së dhe formulës leukocitare gjatë ditëve të para postoperatore.
Rezultate: Nga 54 pacientë të përfshirë, mosha mesatare ishte 52 vjeç, me 46. 3% femra dhe 53. 7% meshkuj. Vlerat mesatare të CRP ishin më të larta në ditën e dytë postoperatore (150. 3 mg / L), duke u ulur në 53. 2 mg / L në ditën e katërt. Leukocitet u ulën nga 14. 19 në 8. 79 x10^9 / L. U konstatua korrelacion statistikisht i rëndësishëm midis niveleve të CRP - së dhe leukociteve ($p < 0. 01$). Ulja e vlerave të CRP dhe leukociteve tregon përgjigje të mirë ndaj trajtimit postoperativ.
Përfundime: Ky hulumtim tregon se CRP është një shënues i hershëm dhe i dobishëm laboratorik për detektimin e komplikacioneve infektive postoperatore. Rritja e vazhdueshme e CRP - së dhe leukociteve lidhet me qëndrim më të gjatë spitalor dhe kërkon monitorim të kujdesshëm klinik. Përdorimi rutinë i matjes së CRP - së mund të ndihmojë në zbulimin e hershëm të komplikacioneve dhe optimizimin e trajtimit postoperativ.

Fjalë kyçe: Infeksionet intra - abdominale, CRP, leukocitet, komplikacionet postoperatore.

KELOIDET – TRAJTIME TË REJA DHE NË ZHVILLIM.

Dr. Elmijola Lame Janushaj
Dermatologe - Venerologe, Klinika Dok_Derma

Abstrakt

Hyrje: Keloidet janë cikatrice fibroproliferative jonormale që shkaktohen nga depozitimi i tepërt i kolagjenit gjatë procesit të shërimit të plagës, duke rezultuar në lezionet e ngritura, të forta dhe shpeshherë pruriginoze. Ato mund të shfaqen pas traumave, ndërhyrjeve kirurgjikale apo edhe spontanisht. Për shkak të ndikimit që kanë si në pamjen fizike ashtu edhe në mirëqenien psikologjike, strategjitë efektive të menaxhimit janë thelbësore. Janë studiuar disa opsione terapeutike, por rezultatet mbeten të ndryshme.

Materiale dhe metoda: Formimi i keloideve vjen si pasojë e një çekuilibri midis sintezës dhe degradimit të kolagjenit, i ndikuar nga predispozita gjenetike, tensioni i lëkurës dhe përgjigja inflamatore. Aktivizimi i shtuar i fibroblasteve dhe ndryshimet në matricën extraqelizore luajnë rol qendror. Trajtimet e njohura përfshijnë: Kortikosteroidet intralezionale: reduktojnë inflamacionin dhe prodhimin e kolagjenit, duke përmirësuar sheshimin e mbresës. Ekscizioni kirurgjikal dhe Z - plasty: heqin lezionin dhe ulin tensionin, por shoqërohen me rrezik të lartë rikthimi. Fletët e xhelit të silikonit: ofrojnë hidratim dhe presion, duke zbutur keloidet. Lazeri (CO_2 fraksional, pulse dye laser PDL): përmirësojnë strukturën dhe pigmentimin përmes rimodelimit të kolagjenit dhe reduktimit të vaskularizimit. Krioterapia shkakton nekrozë duke çuar në zvogëlim të dukshëm të lezionit. Mikro - needling përmirëson strukturën e lëkurës përmes stimulimit të kolagjenit të ri. Terapitë e kombinuara: qasjet multimodale (p. sh. kortikosteroide + 5 - Fluorouracil) japin rezultate më të mira dhe ulin shkallën e rikthimit. Modalitete të reja në zhvillim përfshijnë përdorimin e 5 - Fluorouracil, toksinës botulinike, terapi me plazmë të pasur me trombocite (PRP), antitrupa monoklonalë që shënjestrojnë citokinat profibrotike, si dhe qasje eksperimentale me terapi gjenike.

Diskutime: Megjithëse rezultatet e përdorimit të 5 - Fluorouracilit dhe toksinës botulinike janë premtuese, shumica e literaturës i trajton këto modalitete trajtimi veçmas. Kombinimi i tyre mbështetet në mekanizmat plotësues të veprimit - 5 - Fluorouracil që ndalon proliferimin qelizor dhe toksina botulinike që redukton tensionin mekanik - duke sugjeruar një potencial sinergjik. Po ashtu, terapi të tjera si PRP, antitrupat monoklonalë dhe teknologjitë e reja të silikonit po studiohen për efikasitetin e tyre.

Përfundime: Menaxhimi efektiv i keloideve kërkon një qasje të individualizuar, të përshtatur sipas karakteristikave të lezionit dhe preferencave të pacientit. Kërkimet e vazhdueshme mbi terapitë e reja dhe kombinimet e tyre janë thelbësore për përmirësimin e rezultateve dhe uljen e recidivave. Duhet pasur parasysh edhe efektet anësore të mundshme (dhimbje gjatë procedurës, flluska, hipopigmentim apo hiperpigmentim). Për më tepër, përgjigja klinike mbetet e ndryshme: disa pacientë përfitojnë dukshëm, ndërsa të tjerë mund të mos kenë përgjigje të kënaqshme, me rikthim të mundshëm të keloideve, sidomos në rastet me keloide të shumta.

Fjalë kyçe: Keloide, trajtim, cikatrice, hipertrofike, 5 - Fluorouracil, toksina botulinike, kortikosteroide.

PËRDORIMI I LAZERTI VBEAM TE PACIENTËT ME PORT WINE STAIN (PWS).

Dr. Shk. Elna Çano, Dr. Arbnora Tafica,
Dermatologe / Venereologe, Anassa Spitali Hygeia

Abstrakt

Hyrje: Lazerët kanë aplikime të gjera në trajtimin dhe diagnostikimin e sëmundjeve ne fusha të ndryshme mjekësore. Terapia me laser si metodat e tjera ka avantazhe dhe disavantazhe. Disa rreziqe si hemorragjia, dhimbja dhe infeksioni krijohen pas terapisë me lazer. Kohët e fundit, terapia me laser për trajtimin e lezioneve të lëkurës me origjinë vaskulare ka marrë një zhvillim dhe përparim thelbësor në fushën teknike. Port Wine Stain (PWS) janë keqformime kapilare. PWS shfaqet në lindje si një njollë rozë e zbehtë në të kuqe të përcaktuar mirë dhe rritet në madhësi në përpjesëtim me rritjen e pacientit. Lokalizohen në zonën e kokës dhe qafës por mund të ndodhin kudo në lëkurë dhe mukozë. Pulsed Dye Laser (PDL) konsiderohet si një nga zgjedhjet e mundshme terapeutike për trajtimin e keqformimeve vaskulare dhe PWS. Përparësitë dhe disavantazhet e llojit të trajtimit duhet të merren parasysh në mënyrë që të zgjidhni trajtimin më të mirë me sa më pak efekte anësore.

Ndërgjegjësimi i pacientëve për efektet anësore të mundshme përpara trajtimit dhe gjithashtu një ndjekje dhe menaxhim efektiv i pacientëve pas veprimit janë dy pika të rëndësishme në terapinë me lazer.
Materiali dhe Metodat: Lazerët vaskularë, veçanërisht Candela Vbeam Perfecta, që është pjesë e këtij studimi, janë pajisur me një sistem ftohjeje duke e bër proceduren me komoditet më të lartë për pacientin gjatë ekzaminimit. PDL; 585 nm, 0. 45 milisekonda janë trajtimi i zgjedhur për njollat e kuqe (PWS).
Objektiva: Objektivi i këtij prezantimi është paraqitja e disa rasteve dhe efektet e trajtimit pas aplikimit të 2 / 4 seancash. Përgjigja e trajtimit u vlerësua në mënyrë subjektive (fotografi).
Rezultate: Të gjithe pacientë treguan një përgjigje të mirë (50 - 75% ndryshim), e cila u mbështet nga pamjet e tyre fotografike. PDL me rreze 595 nm duket se arrin ndryshime të dukshme dhe shumë të kënaqshme si për mjekun dhe për pacientët.

Fjalë kyçe: lazer vaskulare, komplikacione, hemorragji, mukoza, lëkurë, qafë.

DEFIÇITI I VITAMINËS D TEK NEONATËT: NJË SFIDË QË NË LINDJE. STUDIM EPIDEMIOLOGJIK NË NJË POPULLATË RASTËSORE TË PORSALINDURISH.

Elona Gjylbegaj[1], Dr. Niketa Koliçi [2], Vangjush Lekgjika[1], Alba Jonuzi[1], Luljeta Marku[3]
[1]*Shërbimi i Neonatologjisë, Spitali Amerikan 3, Tiranë – Neonatolog*
[2] *Shërbimi i Neonatologjisë, Spitali Amerikan 3, Tiranë – Shefe e Shërbimit*
[3]*Shërbimi i Laboratorit, Spitali Amerikan 3, Tiranë – Mjeke laboratori*

Abstrakt
Hyrje: Vitamina D është një hormon steroid me një rol të rëndësishëm në metabolizmin e kaciumit e fosforit duke siguruar mineralizimin kockor, ka rol të rëndësishëm në funksionet neuromuskulare, maturimin pulmonar tek të porsalindurit si dhe në përgjigjen imunitare të individëve.
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është njohja me nivelin e vitaminës D në një popullatë rastësore të porsalindurish**.**
Metodologjia: Ky është një studim kohort i shtrirë nga shtatori i vitit 2024 deri në gusht të vitit 2025. Është testuar vitamina D në të porsalindur të shëndetshëm, të marrë në mënyrë rastësore. Janë analizuar vlerat e vitaminës D sipas nivelit, gjinisë, mënyrës së lindjes.
Rezultate: Në studim u përfshinë 256 bebe, vitamina D rezultoi 17. 9 ng\ml; nga këto rezultuan me defiçit të rëndë 38 bebe (14. 8%), defiçitarë 137 bebe (53. 5 %), insufiçientë në vitaminë D 60 bebe (23. 4 %) dhe me nivel optimal të vitaminës D vetëm 21 bebe (8. 3%); 138 (53. 9%) ishin meshkuj dhe 118 (46. 1%) femra, me vlerë të vitaminës D përkatësisht 17. 37ng\ml dhe 18. 67 ng\ml; 188 (73. 4%) të lindur me sc dhe 68 (26. 6 %) per via vaginalis me vlerë të vitaminës D 17. 2ng / ml dhe 18. 9ng\ml.
Përfundime: Ky studim vuri në dukje se 91. 7% e të porsalindurve kanë defiçit të vitaminës D që në lindje, duke lënë të hapur diskutimet për screening rutine apo ndryshimin e protokolleve të marrjes së vitaminës D.

Fjalë kyçe: 25 hidroksi vitamina D, neonat, deficit.

REHABILITIMI FIZIOTERAPEUTIK SI PJESË KYÇE E TRAJTIMIT MULTIDISIPLINAR TEK FËMIJËT ME SPINA BIFIDA.

Alisia Maliqi[1], Elona Laçi[2], Roxhensa Sula[3]
[1]*Universiteti Aldent, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Dega Fizioterapi*
[2]*Universiteti Aldent, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Dega Fizioterapi*
[3]*Universiteti Aldent, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Dega Fizioterapi*

Abstrakt
Hyrje: Spina bifida është një patologji e lindur e tubit neural që ndodh gjatë zhvillimit embrional dhe lidhet me pasoja të ndryshme neurologjike dhe muskuloskeletore. Fëmijët me këtë gjendje përballen shpesh me vështirësi

në ecje, probleme posturale, deficite sensomotorike dhe kufizime të realizimit të aktiviteteve te jetës së përditshme.
Qëllimi: Ky studim synon të theksojë rëndësinë e rehabilitimit fizioterapeutik si pjesë kyçe e trajtimit multidisiplinar tek pacientët me spina bifida, duke u fokusuar tek funksionet motorike, kontrolli postural dhe rritja e pavarësisë. Një rast klinik i një pacienti 8 - vjeçar me spina bifida lumbosakrale meningocele u analizua për të vlerësuar ndikimin e ndërhyrjeve fizioterapeutike.
Metodologjia: Për matjen e progresit u përdorën instrumenta standarde si *GMFM* (Gross Motor Function Measure), lëvizshmëria, testimi i forcës muskulore dhe vlerësimi i ecjes. Programi rehabilitues përfshiu ushtrime për forcim muskulor, përmirësim të lëvizshmërisë, të posturës dhe realizimin e aktiviteteve të jetës së përditshme.
Rezultate: Pas një programi të strukturuar rehabilitimi, pacienti tregoi përmirësime të dukshme në lëvizshmëri, stabilitet gjatë ecjes dhe reduktim të lëvizjeve ndihmëse. Gjithashtu u vu re rritje e forcës muskulore dhe e qëndrueshmërisë funksionale.
Konkluzione: Rehabilitimi fizioterapeutik është një element thelbësor i trajtimit multidisiplinar tek fëmijët me spina bifida. Ndërhyrja e hershme dhe programi rehabilitues individual jo vetëm që përmirësojnë zhvillimin motorik, por ndikojnë edhe cilësinë e jetës.

Fjalë kyçe: spina bifida, rehabilitim multidisiplinar, fizioterapia pediatrike, kontroll postural, funksionalitet motorik.

QASJET FIZIOTERAPEUTIKE PËR NXITJEN E AFTËSIVE MOTORIKE DHE NDIJORE TEK FËMIJËT 0–3 VJEÇ ME ZHVILLIM TË VONUAR.

Nina Rrodhe, Elona Laçi, Roxhensa Sula
Universiteti "Aldent" Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike Departamenti I Infermierisë Dhe Fizioterapisë Dega Fizioterapi

Abstrakt
Hyrje: Vonesat zhvillimore tek fëmijët e moshës 0–3 vjeç përfaqësojnë një problematik të rëndësishëm klinik, pasi kjo periudhë është vendimtare për maturimin motorik, ndijor dhe njohës. Ndërhyrja e hershme fizioterapeutike është thelbësore për të shfrytëzuar potencialin neuroplastik të trurit në vitet e para të jetës dhe për të parandaluar komplikacione afatgjata.
Objektivi: Ky studim ka për qëllim të vlerësojë rolin dhe efektivitetin e ndërhyrjeve fizioterapeutike në zhvillimin e aftësive motorike grose, fine dhe ndijore tek fëmijët e vegjël me vonesa zhvillimore.
Metodologjia: Në këtë studim u analizuan dy raste klinike të trajtuara në një klinikë private. Për vlerësim u përdorën shkalla Bayley, testimi i forcës muskulore, matja e lëvizshmërisë artikulare (ROM). Të dy fëmijët iu nënshtruan një programi të personalizuar rehabilitimi, i cili përfshinte aktivitete motorike funksionale, ushtrime për integrim ndijor dhe stimulim të koordinimit.
Rezultate: Analiza tregoi progres të dukshëm në parametrat motorikës fine dhe grose. Njëri pacient shfaqi përmirësim të shpejtë në koeficientin e zhvillimit ndërsa tjetri pati përmirësim më modest. Megjithatë, në të dy rastet u evidentua avancim i dukshëm.
Konkluzione: Portokolli fizioterapeutik individual në moshë të hershme ka një rol kyç në përmirësimin e zhvillimit motorik dhe jo vetëm. Qasjet individuale, të kombinuara me ndërhyrje të hershme dhe pjesëmarrje aktive të familjes, mund të ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në progresin e fëmijëve me vonesa zhvillimore.

Fjalë kyçe: Zhvillim i vonuar, fizioterapi pediatrike, grose, fine, rehabilitim, bayley, rom, trajtim terapeutik, fëmijë 0–3 vjeç.

MUTACIONI I GENIT RYR 2 DHE ANESTEZIA E PËRGJITHSHME. RAPORTIM RASTI.

[1]Msc Md Elona Naqellari, [2]Prof Assoc Eno Gace, [2]Msc Md Jonela Burimi, [3]Msc Md Marina Babali Parllaku
[1]IC and Anesthesia, Continental Hospital
[2]Dental Service
[3]Laboratori Service

Abstrakt

Hyrje: Mutacioni në genin Ryr 2 lidhet me kushte serioze të zemrës, veçanërisht takikardinë ventrikulare polimorfike të shkaktuar nga katekolaminat (CPVT) dhe kardiomiopatinë aritmogjene të ventrikulit të djathtë (ARVC). Elektrofiziologjikisht kjo karakterizohet nga takikardi ventrikulare bidireksionale e shkaktuar nga stresi emocional ose ushtrimet fizike, e cila mund të rezultojë deri në arrest kardiak.

Qëllimi: Minimizimi i stresit perioperator është i rëndësishëm pasi mund të reduktojë aritmitë fatale tek pacienti ynë me CPVT.

Raportim rasti: Pacienti ynë është një fëmijë 5 - vjeçar me prapambetje mendore dhe mungesë totale të komunikimit, i diagnostikuar në moshën 3 - vjeçare me një mutacion në genin RYR2, i cili do i nënshtrohet anestezisë së përgjithshme për mbushje dhëmbësh në një seancë të vetme dentare që zgjati 2 orë. Medikamentet anestetike që përdorëm ishin Propofol, Remifentanyl dhe Vecuronium. Kirurgjia orale u krye me sukses nën anestezi të përgjithshme për të reduktuar stresin, dhe nuk u vërejtën aritmi në periudhën intraoperatore.

Diskutime: Ky raportim rasti tregon suksesin e anestezisë së përgjithshme për mbushjen dentare te një pacient me CPVT. Ky protokoll siguroi reduktim të mjaftueshëm të stresit intraoperator dhe parandaloi aritmitë fatale të shkaktuara nga CPVT. Menaxhimi anestetik, përfshirë sedacionin IV ose anestezinë e përgjithshme, është i nevojshëm gjatë kirurgjisë orale tek pacientët me CPVT sepse lëshimi endotermik i katekolaminave, i shkaktuar nga stresi ose ankthi, mund të shkaktojë aritmi ventrikulare deri në vdekje të papritur kardiake. Në zhvilluam planin anestetik për këtë pacient bazuar në konsideratat e mëposhtme: Parandalimi i rritjes së katekolaminave endogjene si pasojë e frikës ose niveleve të pamjaftueshme të anestezisë dhe analgjezisë. Parandalimi i katekolaminave ekzogjene, veçanërisht agonistëve β - adrenergjikë. Përgatitja për menaxhimin akut të takikardisë ventrikulare gjatë periudhës perioperatore. Anestetikët që përdorëm për të menaxhuar pacientët me CPVT përfshijnë propofol, remifentanil dhe vecuronium. Duhet të shmanget ketamina sepse stimulojnë sistemin nervor simpatik.

Fjalë kyçe: Takikardia ventrikulare polimorfike katekolaminergjike, vdekja e papritur kardiake, anestezia e përgjithshme.

DIABETI MELLITUS DHE SËMUNDJET E MUSHKËRIVE: NJË MARRËDHËNIE E NËNVLERËSUAR.

Elona Xhardo[1], Bledar Hysenbelli[2]
[1]Qendra Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi", Tirana, Albania.
[2]Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tirana, Albania.

Abstrakt

Hyrje: Diabeti mellitus është një çrregullim metabolik sistemik i lidhur me inflamacionin dhe stresin oksidativ i cili mund të dëmtojë shumë organe si veshkat, retina dhe sistemin vaskular. Pato - fiziologjia, mekanizmat dhe pasojat e diabetit në këto organe janë studiuar gjerësisht. Megjithatë, ka ende paqartësi në lidhje me pulmonet si organ target i diabetit dhe implikimet e tij për sëmundjet e mushkërive.

Qëllimi: Në këtë prezantim synohet të hidhet dritë mbi efektet e diabetit mellitus dhe preparateve antidiabetik në traktin respirator dhe sëmundjet kryesore të mushkërive, duke përfshirë Pneumonine akute, Sëmundjen Pulmonare Obstruktive Kronike (SPOK), fibrozën pulmonare idiopatike dhe hipertensionin pulmonar. Baza e ndërveprimit molekular në rastet e ko - ekzistencës së diabetit me sëmundjet pulmonare ende nuk është studiuar mirë ndaj qëllimi ynë është të thellohemi e të kuptojmë më shumë rreth kësaj marrëdhënie të nënvlerësuar për shumë kohë.

Rezultate: Të dhënat në literaturë konfirmojnë se diabeti ka një impakt të rëndësishëm në ashpërsinë dhe ecurinë klinike të patologjive pulmonare.

Konkluzione: Megjithëse lidhja diabet - mushkëri është epidemiologjikisht dhe klinikisht e vërtetuar mirë, veçanërisht në SPOK dhe Astma Bronkiale, mekanizmi themelor dhe patofiziologjia nuk janë plotësisht të qartë.

Janë sugjeruar disa mekanizma, të lidhur kryesisht me vetitë pro - inflamatore dhe proliferative të diabetit, por edhe në lidhje me efektet mikro - dhe makrovaskulare të diabetit në vaskulaturën pulmonare. Gjithashtu, preparatet antidiabetik oral apo injektabël mund të ndikojnë në sëmundjet e mushkërive në mënyra të ndryshme. Për shembull, metformina konsiderohej një agjent potencial terapeutik në sëmundjet e mushkërive, ndërsa insulina u tregua se përkeqësonte sëmundjet e mushkërive; kjo sugjeron që efektet e tyre shtrihen përtej vetive hipoglikemike.

Fjalë kyçe: Diabeti, sëmundje pulmonare obstruktive kronike, SPOK, fibrozë pulmonare idiopatike, pneumoni, preparate antidiabetik.

EFEKTI I BARNAVE ANTIREUMATIZMALË MODIFIKUESE TË SËMUNDJES (DMARD - VE) BIOLOGJIKE DHE SINTETIKE TË SYNUARA NË MANIFESTIMET PERIFERIKE NË SPONDILOARTRITIN AKSIAL: NJË RISHIKIM SISTEMATIK I LITERATURËS (2022–2025).

Elona Xherahu [1], Teuta Backa [2], Artur Zoto [2]

[1] *Shërbimi i Mjekësisë Interne, Spitali Rajonal Memorial, Fier, Shqipëri*

[2] *Shërbimi i Reumatologjisë, QSUNT, Tiranë, Shqipëri.*

Abstrakt

Hyrje: Trajtimi i spondiloartritit aksial (axSpA) është përmirësuar ndjeshëm me zhvillimin e barnave antireumatizmalë modifikuese të sëmundjes, biologjike dhe sintetike të synuara (bDMARD dhe tsDMARD), veçanërisht për pacientët që nuk reagojnë ndaj terapisë konvencionale. Megjithatë, evidenca mbi efikasitetin në kontrollin e manifestimeve periferike mbetet më e kufizuar në krahasim me ato aksiale.

Qëllimi: Vlerësimi i efikasitetit të bDMARD dhe tsDMARD, në trajtimin e manifestimeve periferike tek pacientët me axSpA, bazuar në të dhënat e tre viteve të fundit.

Materiale dhe metoda: U krye rishikim sistematik në bazat e të dhënave PubMed, Embase dhe Cochrane Library për literaturën e botuar në periudhën janar 2022 – qershor 2025. U përzgjodhën studime të kontrolluara të rastësishme, meta - analiza dhe studime observacionale që raportonin efikasitetin e bDMARD - ve (anti - TNF, anti - IL - 17) dhe tsDMARD - ve (inhibitorë të JAK) në pacientë me axSpA me përfshirje periferike.

Rezultate: U analizuan 16 studime (10 RCT, 3 meta - analiza, 3 observacione). Anti - TNF - të (si certolizumab pegol, adalimumab biosimilar) kanë ruajtur efikasitetin me përmirësim statistikisht domethënës kundrejt placebos (në mbi 60–70% të pacientëve) në reduktimin e entezitit dhe artritit periferik ($p < 0.001$). Anti - IL - 17 (secukinumab dhe ixekizumab) vazhdojnë të tregojnë efikasitet të lartë në reduktimin e entezitit, (65 - 75% të pacientëve) sidomos në pacientët që kanë dështuar ndaj nga anti - TNF ($p < 0.01$). Inhibitorët e JAK (tofacitinib, upadacitinib, filgotinib) janë përfshirë në studime të reja të fazës III, duke treguar efikasitet ndaj placebos në javët e para të trajtimit ($p < 0.05$) për entezitin dhe artritin periferik. Daktiliti mbetet më pak i studiuar, por disa studime sugjerojnë një trend pozitiv kundrejt placebos.

Konkluzione: Në tre vitet e fundit, është vërejtur rritje e interesit për terapitë e reja, veçanërisht JAK inhibitorët dhe anti - IL - 17, të cilët kanë treguar rezultate të favorshme në manifestimet periferike të axSpA.

Rekomandime: Janë të nevojshme më shumë studime mbi daktilitin dhe krahasime direkte ndërmjet klasave të ndryshme të DMARD - ve.

Fjalë kyçe: Trajtimi i spondiloartritit aksial (axSpA), bDMARD, tsDMARD, terapi konvencionale.

TIROIDITI HASHIMOTO DHE TRAJTIMI I TIJ.

Dr. Elsa Dërmaku

Abstrakt

Hyrje: Tiroiditi Hashimoto është një sëmundje autoimune kronike e gjëndrës tiroide, që karakterizohet nga infiltrimi limfocitar, prania e autoantitrupave dhe shkatërrimi gradual i parenkimës tiroide. Ky punim paraqet një rishikim të literaturës bashkëkohore mbi etiologjinë, mekanizmat patologjikë, manifestimet klinike dhe

qasjet terapeutike të kësaj patologjie. Sëmundja shfaqet kryesisht tek femrat e moshës së mesme dhe lidhet me faktorë gjenetikë, hormonalë, imunologjikë dhe mjedisorë, përfshirë nivelet e jodit dhe selenit në organizëm. Diagnoza bazohet në identifikimin e antitrupave anti - TPO dhe anti - TG, si dhe në karakteristikat ekografike të gjëndrës tiroide. Trajtimi standard mbetet terapia zëvendësuese me L - tiroksinë, e cila normalizon funksionin hormonal dhe përmirëson cilësinë e jetës së pacientëve. Megjithatë, studimet e fundit sugjerojnë rolin mbështetës të mikronutrientëve si seleni, vitamina D, magnezi, hekuri dhe zinku, të cilët ndikojnë në ekuilibrin imunologjik dhe efektivitetin terapeutik. Në përfundim, theksohet nevoja për hulumtime të reja mbi biomarkerë imunologjikë dhe qasje personalizuese të trajtimit, me synimin për të ndikuar drejtpërdrejt në mekanizmat autoimunë që shkaktojnë dëmtimin e gjëndrës tiroide.

Fjalë kyçe: Tiroiditi Hashimoto, autoimune, femrat, L - tiroksina, biomarkerë imunologjik, mikronutrientët.

MENAXHIMI I INTERTRIGOS PERIANALE ME INFEKSION SEKONDAR: NJË STUDIM RASTI NË EFIKASITETIN E TRAJTIMIT TË KOMBINUAR TOPIKAL.

Dr. Elsa Dyla

Abstrakt
Qëllimi: Të paraqitet efikasiteti i një trajtimi të kombinuar topikal me antibiotik, antifungal dhe kortikosteroid në menaxhimin e intertrigos perianale me infeksion sekondar fungal.
Paraqitja e rastit: Një femër 25 - vjeçare paraqiti shenja të inflamacionit të lëkurës në zonën perianale, përfshirë kruarje, eritemë, parehati dhe shenja të mbirjes fungale. Këto simptoma u shfaqën pas një trajtimi 9 - ditor me antibiotik sistemik (Amoxiclav) dhe përdorimit të pecetave menstruale. Trajtimi përfshiu pastrimin lokal me çaj kamomili, tharjen me kompresa të buta dhe aplikimin topikal të një kremi që përmban triamcinolone acetonide, neomycin dhe nystatin. Kremi u aplikua dy herë në ditë gjatë javës së parë dhe një herë në ditë gjatë javës së dytë.
Rezultate: U vu re përmirësim i dukshëm klinik brenda 14 ditësh, me zhdukje të plotë të simptomave dhe pa efekte anësore të raportuara.
Përfundime: Ky rast tregon se trajtimi i kombinuar topikal është një alternativë efektive për intertrigon e komplikuar dhe thekson rëndësinë e terapisë së personalizuar.

Fjalë kyçe: Intertrigo perianale; infeksion fungal sekondar; terapia e kombinuar topikale; triamcinolone; neomycin; nystatin; raport rastesh; inflamacion.

FREKUENCA DHE MENAXHIMI I HEMORRAGJISË POSTPARTUM NË NJË SPITAL TERCIAR: FAKTORËT E RREZIKUT DHE NDËRHYRJET EFEKTIVE.

Dr. Elsa Spahiu, D. Sh. M. Arjan Shtylla
Departamenti I Obstetrikës dhe Gjinekologjisë, SUOGJ "Koço Gliozheni"

Abstrakt
Hyrje: Hemorragjia postpartum (HPP) vazhdon të jetë një ndër shkaqet kryesore të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë amtare globalisht, pavarësisht përparimeve në kujdesin obstetrikal. Njohja e hershme dhe menaxhimi i strukturuar janë vendimtarë për përmirësimin e rezultateve klinike.
Qëllimi: Të vlerësohet frekuenca, faktorët e rrezikut dhe strategjitë menaxheriale të HPP në një spital terciar, si dhe të identifikohen ndërhyrjet që lidhen me rezultate më të mira klinike.
Materiale dhe metoda: U krye një studim retrospektiv në Shërbimin e Obstetrikë–Gjinekologjisë të një spitali universitar terciar gjatë periudhës janar 2022 –dhjetor 2025. Të gjitha lindjet ≥24 javë u përfshinë në analizë. HPP u përcaktua si humbje gjaku ≥500 mL pas lindjes vaginale ose ≥1000 mL pas lindjes cezariane. U analizuan karakteristikat amtare, faktorët obstetrikalë dhe ndërhyrjet terapeutike me regresion logjistik multivariat për të identifikuar faktorët prediktivë të hemorragjisë së rëndë (>1500 mL).
Rezultate: Nga 7, 840 lindje, HPP u regjistrua në 624 raste (8. 0%), nga të cilat 148 (1. 9%) ishin të rënda. Faktorët kryesorë të rrezikut ishin placenta previa (OR 5. 2), shtatzënitë multiple (OR 3. 1), lindja e zgjatur >12

orë (OR 2. 7) dhe lindjet cezariane të mëparshme (OR 1. 9). Uterotonikët u përdorën në 98. 5% të rasteve, masazhi uterin në 74. 2%, ndërsa acidi traneksamik në 69. 8%. Ndërhyrje kirurgjikale u kërkuan në 11. 7% të rasteve (duke perfshire tamponimin me balon bakri në 2. 3% të rasteve dhe histerektomi në 1. 6% të rasteve). Zbatimi i një protokolli standard të menaxhimit uli morbiditetin e rëndë me 35% krahasuar me vitet paraprake.
Përfundime: HPP mbetet një komplikacion i shpeshtë në spitalet terciare, me placenta previa dhe shtatzënitë multiple si faktorët kryesorë të rrezikut. Menaxhimi i hershëm me uterotonikë dhe acid traneksamik, së bashku me protokollet e strukturuara, përmirësojnë ndjeshëm rezultatet klinike.

Fjalë kyçe: Hemorragjia postpartum, faktorët e rrezikut, spital terciar, uterotonikë, acid traneksamik, morbiditet amtar.

REZULTATET E TRAJTIMIT DHE MEKANIZMAT E REZISTENCËS PAS PËRDORIMIT TË NJËPASNJËSHËM TË INHIBITORËVE BTK DHE BCL2 NË LEUÇEMINË LIMFOCITARE KRONIKE (CLL).

E. Çalliku, A. Perolla, A. Çili, P. Pulluqi, A. Ivanaj

Abstrakt
Hyrje: Zhvillimi i terapive target ka transformuar trajtimin e Leuçemisë Limfocitare Kronike (CLL); megjithatë, rezistenca ndaj inhibitorëve të tirozine kinazes Bruton (BTK) dhe ndaj inhibitorëve të proteinës B - celulare të limfomës 2 (BCL2) përbën një sfidë të rëndësishme terapeutike. Përdorimi i njëpasnjëshëm i këtyre agjentëve çon në efikasitet të kufizuar të trajtimit vijues dhe në rezultate të dobëta klinike.
Materiale dhe metoda: U realizua një sintezë e të dhënave kyçe nga studime klinike të rëndësishme dhe të dhëna reale nga regjistrat klinikë, me fokus tek rezultatet dhe mekanizmat molekularë të rezistencës në pacientët e trajtuar në mënyrë të njëpasnjëshme me inhibitorë BTK dhe BCL2. Të dhënat kryesore u morën nga punimet e Mato et al. (2022, 2023), Kutsch et al. (2023), Zygmunciak et al. (2024, 2025) dhe autorë të tjerë.
Rezultate: Pacientët me CLL të ekspozuar ndaj të dy klasave të barnave paraqesin një kohë mediane deri në ndërprerjen e terapisë ose vdekjen prej vetëm 5. 5–5. 6 muajsh pas fillimit të trajtimit pasues, duke reflektuar një popullatë me rrezik të lartë dhe rezistente ndaj dy linjave të trajtimit, me mundësi të kufizuara terapeutike. Të dhënat reale konfirmojnë mbijetesë të ulët pa ngjarje dhe mbijetesë të përgjithshme të shkurtuar, pavarësisht rendit të përdorimit të inhibitorëve. Rezistenca ndaj inhibitorëve kovalentë të BTK lidhet kryesisht me mutacione BTK C481S / R dhe PLCG2, ndërsa rezistenca ndaj inhibitorëve të BCL2 shoqërohet me mutacione BCL2 G101V / D103Y, rritje të shprehjes së MCL - 1 dhe BCL - XL, si dhe evolucion klonal. Inhibitorët jo - kovalentë të BTK, si pirtobrutinibi, tregojnë aktivitet premtues (≈70% normë përgjigjeje; mbijetesa pa progres ≈19. 6 muaj), por remisionet e plota mbeten të rralla.
Përfundime: Ekspozimi i njëpasnjëshëm ndaj inhibitorëve BTK dhe BCL2 përkufizon një nëngrup biologjikisht kompleks dhe klinikisht rezistent të pacientëve me CLL. Rrugët molekulare të ndryshme që qëndrojnë në bazë të rezistencës specifike për çdo klasë ilaçi, si dhe fakti që inhibitorët e gjeneratës së re ofrojnë vetëm përfitime të përkohshme, theksojnë nevojën urgjente për strategji të reja terapeutike dhe qasje kombinatore që synojnë mekanizma të shumtë të rezistencës.

Fjalë kyçe: Leuçemia limfocitare kronike, inhibitorët BTK, inhibitorët jo - kovalentë të BTK, efikasiteti i trajtimit, rezistenca.

KARAKTERISTIKAT KLINIKE DHE EPIDEMIOLOGJIKE TË GJAKDERDHJES GASTROINTESTINALE PARA DHE PAS COVID - 19.

Prof. Asoc. Edmond ZAIMI, Dr. Elton Dervishi
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë. Fakulteti i Mjekësisë, Shërbimi i Emergjencës.

Abstrakt
Hyrje: Gjakderdhjet akute të traktit gastrointestinale (GI) janë një fenomen i zakonshëm në mbarë botën, me një incidencë vjetore prej 40 - 150 raste për 100, 000 banorë, që shpesh çojnë në hospitalizim dhe janë të lidhura me morbiditet dhe mortalitet të konsiderueshëm, veçanërisht te të moshuarit. HGI është shfaqja e gjakut në

traktin tretës. Karakterizohet nga vjellja e gjakut, gjakderdhje rektale, jashtëqitje të zeza ose gjakderdhje kronike e fshehtë. Manifestimet klinike të gjakderdhjeve të traktit tretës varen nga vendi i gjakderdhjes, sasia e gjakderdhjes dhe prania e sëmundjeve të tjera. Nga gjakderdhja gastrointestinale kuptojmë çdo gjakderdhje në lumenin e traktit tretës. Shkaqet e gjakderdhjes mund të jenë lokale dhe të përgjithshme (hemofilia, leucemia, trombocitopenia, etj.).

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë ndikimin e COVID - 19 mbi gjakderdhjet gastrointestinale (HGI) përmes krahasimit të të dhënave epidemiologjike të rasteve me gjakderdhje të traktit të tretjes në Departamentin e Emergjencës të QSUT në dy periudha tre - mujore të ndryshme në vitet 2019 dhe 2022 (para dhe pas COVID - 19).

Materiali dhe Metoda: U realizua një studim retrospektiv, i tipit seri - raste, në një total prej 223 pacientësh me gjakderdhje të traktit të tretjes që u paraqitën në Departamentin e Emergjencës të QSUT në dy periudha tre - mujore të vitit 2019 dhe 2022 (para dhe pas COVID - 19). U rishikuan të dhënat nga regjistrat mjekësorë të pacientëve që u pranuan në Departamentin e Emergjencës. Për analizën statistikore u përdorën programet statistikore SPSS V17 dhe Excel. U shqyrtuan variablat: grupmosha, përdorimi i alkoolit, duhanit, CHD, statusi post - COVID - 19, vaksinimi, të dhënat klinike dhe laboratorike.

Rezultate: U regjistruan 142 raste (63. 7%) me HGI në tremujorin e fundit të vitit 2022 dhe 81 raste (36. 3%) në tremujorin e fundit të vitit 2019. Mosha mesatare e pacientëve ishte 62. 75+15. 18 vjet.

Përfundimi: U gjet një rritje e dukshme e rasteve me HGI në vitin 2022 (pas COVID - 19) krahasuar me vitin 2019. U vërejt një ulje e moshës mesatare te pacientët me HGI, ndonëse nuk u gjet një rritje e vlerave të INR në të dyja grupet e popullsisë; u vërejt rritje e konsumit të alkoolit (më shumë pacientë me HGI), përdorimi i duhanit, përdorimi i antikoagulantëve, antiinflamatorëve (steroide dhe jo - steroide).

Fjalë kyçe: HGI, diagnoza, endoskopia.

SFIDAT NË DIAGNOSTIKIMIN E HERSHËM DHE MENAXHIMIN E INFEKSIONEVE VIRALE PAS TRANSPLANTIT RENAL.

Elvana Rista[1,2], Arjana Strakosha[3], Alma Idrizi[3], Vilma Cadri[3], Amantia Imeraj[3], Kristi Saliaj[1], Teuta Dedej[3], Silva Bino[4], Eugena Tomini[4], Alma Robo[4]

[1] Universiteti Europian i Tiranës, Shqipëri

[2] Spitali Hygeia, Tiranë, Shqipëri

[3] Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" (QSUT), Tiranë, Shqipëri

[4] Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Hyrje: Infeksionet oportuniste virale mbeten një shkak kryesor i morbiditetit, disfunksionit të graftit dhe mortalitetit pas transplantit të veshkës. Ndër to, citomegalovirusi (CMV), poliomavirusi BK (BKPyV), virusi Epstein–Barr (EBV) dhe parvovirusi B19 paraqesin sfida të veçanta për shkak të patogjenezës komplekse, manifestimeve klinike të buta dhe prezantimeve të mbivendosura.

Objektiva: Ky studim synon të vlerësojë sfidat në diagnostikimin dhe menaxhimin e infeksioneve me CMV, BKPyV, EBV dhe parvovirus B19 tek marrësit e transplantit të veshkës në Shqipëri, si dhe të theksojë rëndësinë kritike të diagnostikimit të hershëm për përmirësimin e rezultateve klinike dhe mbijetesës së graftit.

Metodologjia: Po zhvillohet një studim prospektiv vëzhgues tek marrësit e transplantit të veshkës të ndjekur në qendrat e transplantit në Shqipëri. Monitorimi virologjik realizohet përmes PCR kuantitativ dhe testimeve serologjike si pjesë e ndjekjes rutinë pas transplantit. Të dhënat përfshijnë momentin e shfaqjes së infeksionit, dinamikën e ngarkesës virale, manifestimet klinike, ndërhyrjet terapeutike dhe ndikimin mbi funksionin e graftit.

Diskutime: Zbulimi i hershëm i infeksioneve virale është thelbësor për të parandaluar dëmtimin e pakthyeshëm të graftit dhe humbjen e tij. Diferencimi midis viremive asimptomatike dhe sëmundjeve klinikisht të rëndësishme mbetet një sfidë diagnostikuese. Strategjitë e menaxhimit, duke përfshirë rregullimin e imunosupresionit dhe terapinë antivirale të synuar, kërkojnë një ekuilibër të kujdesshëm midis kontrollit të infeksionit dhe parandalimit të refuzimit. Monitorimi i rregullt molekular, vigjilenca klinike dhe trajtimi i individualizuar janë thelbësorë për rezultate optimale.

Përfundime: Diagnostikimi dhe menaxhimi i hershëm i infeksioneve me CMV, BKPyV, EBV dhe parvovirus B19 janë kyç për reduktimin e ndërlikimeve dhe përmirësimin e mbijetesës së graftit pas transplantit të veshkës.

Fjalë kyçe: Transplant i veshkës, CMV, virusi BK, EBV, Parvovirusi B19, zbulim i hershëm, menaxhim.

DIFERENCA NË VLERAT E LIKIDIT AMNIOTIK DHE PARAMETRAVE BIOMETRIK FETAL NË TREMUJORIN E FUNDIT TEK SHTATZËNITË ME DHE PA DIABET.

Elvana Toska
SUOGJ Mbreteresha Geraldine, Tiranë.

Abstrakt
Objektiva: Indeksi i Likidit Amniotik (AFI) përdoret gjerësisht për vlerësimin e mirëqenies fetale. Ky studim ka si qëllim vlerësimin dhe krahasimin e AFI, në tremujorin e fundit të shtatzënisë, tek pacientet me dhe pa Diabet, për të vlerësuar korrelacionin mes AFI dhe Parametrave biometrik fetal.
Metoda: U vlerësuan ekografikisht 148 paciente normale dhe 95 paciente me diabet, me moshë barrë 27 – 42 javë. Çdo paciente u studjua vetëm një herë. Në ekzaminim u bë matja e AFI sipas teknikës standarde të katër kuadranteve, Diametri Biparjetal (DBP), Cirkumferenca e Kokës Fetale (HC), Cirkumferenca Abdominale (AC), Gjatësia e Femurit (FL).
Rezultate: AFI në shtatzënitë normale ishte më i ulët sesa në ato me diabet gjatë gjithë intervalit 27 - 42 javë. Në shtatzënitë normale mesatarja e AFI në javën e 27 ishte 14 cm dhe ulej në 7. 5 cm në javën 40 - 42. Në shtatzënitë me diabet mesatarja e AFI në 27 javë ishte 18. 5 cm, në javën 32 AFI mesatare >24 cm, në javën 40 - 42 >14. 5 cm. Ka një diferencë të dukshme në të dy grupet në AFI, DBP, HC dhe AC si dhe një korrelacion pozitiv mes AFI dhe percentileve të AC si dhe, AFI dhe Peshës së përafërt fetale.
Përfundime: Ky studim vlerëson të dhënat ekografike biometrike dhe AFI në tremujorin e fundit, tek shtatzënitë me dhe pa diabet. Në shtatzënitë me diabet AFI ka vlera më të larta sesa në shtatzënitë normale nga javë e 27 - 42. AFI korrelon pozitivisht me vlerat AC dhe peshë fetale në të dy grupet duke sugjeruar një lidhje mes AFI dhe fetuset LGA të pavarur nga diabeti.

Fjalë kyçe: AFI, DBP, HC, AC, FL, Polyhidramnion, Oligohidramnion, Diabet Gestacional.

BORDERLINE AFI DHE MIRËQENIA FETALE NË SHTATZËNITË E PAKOMPLIKUARA NË TERM.

Elvana Toska
SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë", Tiranë

Abstrakt
Objektiva: Të vlerësohet mirëqenia fetale në shtatzënitë e pakomplikuara në term, që kanë vlera kufitare (borderline) të Indeksit të Lëngut Amniotik (AFI).
Metoda: Studim retrospektiv, ku u përfshinë paciente me shtatzëni unike, në term (>37 javë), të pakomplikuara nga patologji të mëparshme ose gjatë shtatzënisë. Vlerat kufitare të AFI u konsideruan 5 < AFI < 8 cm, ndërsa vlerat normale të AFI u konsideruan 8 < AFI < 24 cm. Të dy grupet u krahasuan për: ndërhyrjet me prerje cezariane, sufrencën fetale, vlerësimin Apgar <7 në minutën e 5 - të, ditët e qëndrimit në Reanimacionin Neonatal dhe peshën fetale SGA.
Rezultate: Vlerat kufitare të AFI nuk u shoqëruan me ndryshime të rëndësishme në sufrencën fetale, vlerat Apgar në minutën e 5 - të, apo ditët e qëndrimit në Reanimacion Neonatal. Nga ana tjetër, neonatët me peshë më të vogël për moshën gestacionale (SGA), si dhe rastet e induktimit të lindjes dhe lindjes me prerje cezariane, rezultuan më të shpeshta në grupin e pacienteve me AFI kufitar (borderline).
Përfundime: Në shtatzënitë në term, të pakomplikuara nga patologji të tjera, vlerat kufitare të Indeksit të Lëngut Amniotik nuk shoqërohen me rrezik të shtuar për mirëqenien fetale.

Fjalë kyçe: AFI, SGA, borderline.

KOLECISTITI KRONIK KALKULOZ.

Dr. Elvina Syla[1], Prof. Ass. Dr. Halit Maloku [2]
[1] *Doktor i Mjekësisë*
[2] *Kirurg i Përgjithshëm*

Abstrakt

Hyrje: Kolecistiti kalkuloz kronik është një inflamacion kronik i kolecistës si pasojë e obstruksionit rekurent nga gurët biliarë, duke çuar në fibrozë dhe disfunksion. Manifestohet me fryrje, nauze dhe shqetësim pas ngrënies. Diagnoza bëhet me ultratingull ose skanimin HIDA. Terapia medikamentoze lehtëson simptomat, ndërsa kolecistektomia është trajtimi definitiv për të parandaluar përsëritjen dhe ndërlikimet.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është që të shqyrtohen indikacionet per trajtim kirurgjik te pacientët me kolecistit kronik kalkuloz, të evidentohen të dhëna rreth trajtimit kirurgjik të pacientëve me kolecistit kronik kalkuloz në Klinikën e Kirurgjisë Abdominale, të identifikohen faktorët e rrezikut për ndërhyrje kirurgjike te pacientët me kolecistit kronik dhe të bëhen krahasime të kolecistektomisë së hapur dhe laparaskopike për nga menaxhimi kirurgjik.

Metodologjia: Studimi i takon tipit retrospektiv. Të dhënat janë mbledhur nga Klinika e Kirurgjisë Abdominale të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës për periudhën kohore janar 2023 – dhjetor 2024. Hulumtimi është plotësuar me të dhëna nga studime relevante dhe bashkëkohore.

Rezultate: Gjatë viteve 2023–2024 janë regjistruar gjithsej 589 raste me kolecistit kronik kalkuloz, me përqendrim të lartë te femrat (78%) dhe në grupmoshat 40–60 vjeç, ndërsa prevalenca mujore kulmonte në nëntor (68 raste). Prishtina përfaqëson 34% të rasteve totale (203 raste), dhe 91. 5% e pacientëve janë trajtuar me kolecistektomi laparoskopike. Nëntori 2024 pati një rritje të ndjeshme me 45 raste krahasuar me 23 raste në nëntor 2023, duke reflektuar një rritje prej gati 95%.

Përfundime: Kolecistiti kronik kalkuloz mbetet një problem shëndetësor i shpeshtë, sidomos te femrat 40–60 vjeç. Numri i rasteve mbetet i lartë, me përhapje më të madhe në zonat urbane dhe gjatë muajve të ftohtë. Trajtimi laparoskopik dominon dhe kërkohet monitorim e parandalim më i mirë.

Fjalë kyçe: kolecistit kalkuloz, akut, kronik, laparoskopi, kolecistektomia.

FRAKTURË - EPIFIZIOLIZË TIBIA DISTALE S - H TIP 2, REPONIM I MBYLLUR DHE FIKSIM INTERN ME 3 SHTIZA KIRSCHNER. PREZANTIM RASTI.

Elvind Çela
SUT

Abstrakt

Qëllimi: Qëllimi i prezantimit të ktij rasti është të paraqesë rastin e një vajzë 10 vjeç me një diagnozë jo të shpeshtë në praktikën klinike dhe menaxhimin ortopedik të traumës.

Materiale dhe metoda: Ky është një prezantim rasti. Janë përdorur të dhënat laboratorike, imazherike dhe të ekzaminimit fizik nga kartela klinike e pacientes E. V, prezantuar ne urgjencën e SUT, dhe trajtuar në klinikën e dytë ortopedike me diagnozën Frakturë - Epifiziolizë Cruris Distal Salter Harris tip 2.

Prezantim rasti: Pacientja E. V 10 vjeç prezantohet pranë shërbimit të urgjencës SUT pas një traume direkte në fundin e kërcirit të majtë, gjatë një loje me top. Në ekzaminimin objektiv vihet re dhimbje, edemë, deformim i dukshëm, pamundësi për të mbështetur këmbën e majtë në tokë. Statusi neurovaskular është intakt. Nga ekzaminimet imazherike, rografitë talocrural sin në dy projeksione AP dhe LL, rezulton: Frakturë - Epifiziolizë Cruris Distal Sin Salter Harris tip 2. Fibula e paprekur. Parametrat e analizave të gjakut janë brenda normës. Menjëherë, nën anestezi gjenerale, tentohet reponim i mbyllur dhe fiksim intern i frakturë - epifiziolizës me 3 shtiza Kirschner nën kontrollin e fluoroskopisë C - ARM. Arrihet reponim i plotë. Rasti kërkon një ndjekje në dinamikë të kujdesshme për shkak të komplikacioneve madhore që mund të shfaqë, ku përmendim arrest i zonës së rritjes, mbyllje e parakohshme e fizës, deformim dhe shkurtesë e anësisë inferiore të prekur, disporpocion mes dy gjymtyrëve inferiore, deformime valgus / varus.

Konkluzione: Frakturë - epifiziolizat e tibies distale janë relativisht të rralla në moshën pediatrike. Rezultojnë nga traumat direkte në moshat pediatrike me zonat e rritjes të pambyllura ende. Më të zakonshmet janë SH tipi

2. Përbëjnë emergjencë mjekësore dhe duhet të reponohen sa me shpejt të jetë e mundur për të minimizuar riskun e komplikacioneve.

Fjalë kyçe: Frakturë, epifiziolizë, cruris distal, tibie, trauma, reponim.

VLERA DIAGNOSTIKE E KARAKTERISTIKAVE TË EKOGRAFISË TRANSTORAKALE NË PARASHIKIMIN E MALINJITETIT TË LIKIDIT PLEURAL TË PADIAGNOSTIKUAR: *NJË STUDIM DIAGNOSTIK PROSPEKTIV.*

Emira Hysa Dr[1], Amela Hasa Dr[1], Agusta Zerva Dr[1], Aurel Dezhgiu Dr[1], Ergys Cuka Dr[1], Sofiela Telo Msc[1], Regina Hasa Dr. Sc[3], Alma Teferiçi Dr[4], Marsel Broqi Dr[4], Serxho Golgota Dr[4], Franc Rrumbullaku Dr[4].
[1]*Shërbimi i Radiologjisë, Qëndra Spitalore Rajonale e Tiranës "Shefqet Ndroqi"*
[2]*Shërbimi i Statistikës, Qëndra Spitalore Rajonale e Tiranës "Shefqet Ndroqi"*
[3]*Laboratori Biokimik Klinik, Qëndra Spitalore Rajonale e Tiranës "Shefqet Ndroqi"*
[4]*Shërbimi i Urgjences, Qëndra Spitalore Rajonale e Tiranës "Shefqet Ndroqi"*

Abstrakt
Hyrje: Likidi pleural është një manifestim klinik i shpeshtë që paraqet një sfidë të vazhdueshme diagnostike, për shkak të gamës së gjëre etiologjike dhe nevojës për të diferencuar nëse është beninj apo malinj. Për të arritur në një diagnozë të saktë, shpesh kërkohen metoda invazive, por përdorimi i ekografisë transtorakale (TUS), një teknikë jo - invazive, e sigurt dhe e lehtë për t'u aksesuar, ka fituar një rëndësi të madhe si mjet i shpejtë dhe efikas për vlerësimin e karakteristikave të likidit pleural dhe strukturave përreth. Vlerësimi dhe përdorimi i parametrave të caktuar ekografikë mund të ndihmojë në identifikimin e rasteve që kanë një probabilitet të lartë për malinjitet, duke orientuar vendimmarrjen klinike dhe duke sugjeruar hapa të mëtejshëm diagnostik.
Qëllimi: Të vlerësohet vlera diagnostike e disa karakteristikave ekografike në parashikimin e malinjitetit në pacientët me likid pleural të padiagnostikuar.
Materiali dhe Metoda: Ky është një studim diagnostik prospektiv, i zhvilluar në Shërbimin e Radiologjisë të QSRT "Shefqet Ndroqi" gjatë vitit 2025, i cili përfshiu 80 pacientë adultë, të paraqitur në urgjencë me likid pleural për herë të parë. Të gjithë pacientët iu nënshtruan ekografisë transtorakale, dhe u vlerësuan parametrat si: Trashësia e pleurës parietale, prania e nodujve pleuralë dhe lezionet aderuar subpleurale, prezenca e strukturave septale,
ekogjeniteti i likidit pleural (anekogjen vs korpuskular "plankton sign"), lëvizshmëria pulmonare dhe prania e shenjës "jellyfish. Diagnoza përfundimtare u përcaktua në bazë të analizës citologjike të likidit pleural. Të dhënat u analizuan me programin SPSS v. 26, duke përdorur analizat ROC dhe Regresion Logjistik Binar për të vlerësuar vlerën diagnostike të secilës karakteristikë.
Rezultate: Trashësia e pleurës ≥ 2. 35 mm tregoi aftësi të lartë diferencuese për malinjitet (AUC = 0. 96), me sensitivitet 95. 8%, specificitet 87. 5% dhe Youden Index 0. 833. Prania e nodujve pleuralë rezultoi gjithashtu një tregues i fuqishëm, me sensitivitet dhe specificitet 93. 8%, dhe Youden Index 0. 875. Karakteristika të tjera si prania e septave, lëvizshmëria e reduktuar pulmonare dhe shenja "jellyfish" nuk shfaqën vlerë të lartë diagnostike. Analiza e regresionit logjistik binar konfirmoi se trashësia e pleurës ≥ 2. 35 mm dhe prania e nodujve pleuralë ishin prediktorë të pavarur dhe statistikisht të rëndësishëm për malinjitetin ($p < 0.001$).
Përfundime: Ekografia transtorakale përfaqëson një metodë me vlerë të lartë në parashikimin e malinjitetit në rastet me likid pleural të padiagnostikuar. Karakteristika si trashësia fokale e pleurës dhe prania e nodujve pleuralë janë tregues të rëndësishëm që mund të ndihmojnë në përzgjedhjen e rasteve që kanë nevojë për proçedura të mëtejshme diagnostike dhe terapeutike.

Fjalë kyçe: ekografi transtorakale, likid pleural, malinjitet, noduj pleuralë, trashësi pleure, torakocentezë, diagnostikë radiologjike.

KORELACIONI MES PROFILIT LIPIDIK DHE PARAMETRAVE TË GJAKUT KOMPLET.

E. Koliçi, N. Koliçi, A. Koja, A. Xhaferi, E. Thoma, A. Nurçe, A. Cerekja, Xh. Shusha
Universiteti i Mjekësisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Qelizat e gjakut perferik luajnë një rol të rëndësishëm si në proçesin e aterosklerozës ashtu dhe në metabolizmin e lipideve. Hiperlipemia, kryesisht kolesteroli total dhe LDL - kolesteroli janë të lidhura ngushtë me patologji si diabeti, sëmundje të arterieve koronare, obeziteti dhe hipertensioni. Gjithashtu trombocitet luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e trombeve mbi pllakat aterosklerotike, prandaj vlerësimi i tyre merr një rëndësi të veçantë në rastin e dislipidemive. Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë lidhjen mes parametrave të gjakut periferik dhe profilit lipidik.

Materiale dhe metoda: Në studim u përfshinë 100 pacientë, 63 meshkuj dhe 37 femra. Në këtë grup pacientësh 30 ishin grup kontrolli dhe 70 pacientë të diagnostikuar me hiperlipidemi. Për të gjithë pacientët u vlerësuan parametrat e gjakut periferik si dhe profili lipidik (kolesteroli total, HDL - kolesterol, LDL - kolesterol si dhe trigliceridi).

Rezultate: Në bazë të rezultateve u vu re se kolesteroli total dhe LDL - kolesteroli shoqeroheshin me rritje të limfociteve dhe eritrociteve, ndërsa nr total i leukociteve shoqërohet me rritjen e triglicerideve dhe uljen e HDL - kolesterolit. Numri i trombociteve ka korelacion pozitiv me rritjen e LDL - kolesterolit. Përsa u përket trombociteve dhe konstanteve trombocitare, ato ishin më të larta se ato të grupit të kontrollit përkatësisht MPV (11. 4 ± 1. 71), PDW (13. 83 ± 2. 51) dhe PLCR (29. 87 ± 10. 7) krahasuar me grupin e kontrollit MPV (9. 12 ± 1. 71), PDW (12. 1 ± 2. 40) dhe P - LCR (24. 90 ± 11. 47) (vlera $p < 0.05$). Nuk u vu re ndonjë ndryshim i rëndësishëm midis grupit të studimit dhe grupit të kontrollit në lidhje me PC dhe PCT.

Konkluzione: Nivelet e larta të lipideve në organizëm shoqërohen me reaksione imune specifike nga qelizat e gjakut perifeik. Kështu nivele te larta të triglicerideve shoqërohen me rritje të numrit total të leukociteve ndërsa rritja e LDL - kolesterolit me reaksionet trombotike. Gjithashtu trombocitet luajnë një rol të rëndësishëm në metabolizmin e lipideve. Vlerësimi i gjakut komplet është një metodë e thjeshtë, me kosto të ulët për të parashikuar dhe parandaluar episode trombotike në pacientë hiperlipemik.

Fjalë kyçe: Profili lipidik, kolesterol, triglicerid, trombocite.

PANKREATITI AKUT "KËMBANË ALARMI".

Dr. Endri Katro, Dr. Monika Kallfa, Dr. Marina Parllaku
Spital Continental, Tiranë

Abstrakt

Hyrje: PA i përkufizuar si inflamacion i pankreasit me etiologji multifakroriale. Karaktrerizohet nga 4 stade, i mesëm, i moderuar, sever dhe kritik. Sot po përdoret dhe termi potencialisht sever i cili i referohet të ashtuquajtura "sinjale alarmi" të cilat ndikojnë në një dështim në rikuperimin e plotë. Faktorët që lidhen me këtë dukuri janë mosha, obeziteti, likidi pleural, mbrojtjet abdominale, alterimi i vetëdijes; radiologjike: likidi peritoneal, efuzioni pleural; biologjike - Hematokriti > 44%, Prokalcitonina më e madhe se 0. 5 ng / mL gjatë 24 orëve të para; Proteina C - reaktive (CRP) > 150 mg / L, ose një rritje progresive në 48 orë; dhe shkalla e prognozës: APACHE - 0 > 6; APACHE II > 8; Ranson - Glasgow > 3 pikë.

Qëllimi: Vlerësimi "sinjaleve alarmuese" në një pacientë me PA calculosicdhe menaxhimi tij.

Prezantim rasti: Pacienti 63 vjeç, mashkull i cili paraqitet me dhimbje të forta abdominale të lokalizuar në epigaster dhe në kuadrantet e djathta të shoqëruar me nauze, anoreksi, të vjella, dobësi trupore, prej disa orësh për të cilat transportohet me ambulancë pranë spitalit tonë, gjendja jo e mirë, koshient. Lëkura dhe mukozat lehtësisht të zbehta. Parametrat vital stabël. Abdomeni i dhimbshëm në epigaster dhe në hypokondrin dexter. Në parametrat laboratorike konstatohet: Amilazemia 7434 U / l dhe Lipazemi 10650 U / l AST – 200 U. l, ALT – 113U, L. WBC 23000m PCR 62, g, dl dhe Procalcitonin 1, 5 mg. dl. Në CT konstatohet likid abdominal, pankreasi edematoz me vatra nekrotike te vogla. Kolecista me mikrokalkula. U reanimua dhe filloi terapia e kombinuar antibiotike plus antiacidem likide, Gjatë dekursit u izolua pseudomonas aeruginoza në urokulture si rrjedhoje e prezencës prej vitesh katateri urinar, për të cilën u përshtat antibioterapia sipas sensibilitetit. Ecuria klinike dhe laboratorike u përmirësua përmes trajtimit konservativ me rënie të markuesve inflamatorë dhe atyre pankreatik, pas 10 ditësh dehospitalizohet duke u ndjekur ambulatorisht.

Konkluzione: Vlerësimi i hershëm i kritereve të severitetit dhe menaxhimi adekuat i tyre në PA, ul jo vetëm mortalitetin por dhe gravitetin, përmirëson prognozën.

Fjalë kyçe: Pankreatit, adult, kritere.

NDIKIMI I BANJAVE TERMALE NË SHËNDETIN KARDIOVASKULAR.

Endrit Bajraktaraj

Abstrakt

Hyrje: Për shumë shekuj, njerëzit janë drejtuar te banjat termale si një mënyrë natyrale për t'u relaksuar dhe për t'u rikuperuar nga lodhja fizike dhe problemet shëndetësore. Në vitet e fundit, disa studime kanë filluar të hulumtojnë efektet e tyre mbi zemrën dhe enët e gjakut, duke treguar se përdorimi i rregullt i ujërave termale mund të ndihmoj në përmirësimin e funksionit kardiovaskular. Uji i ngrohtë dhe i pasur me minerale nxit zgjerimin e enëve të gjakut, duke lehtësuar qarkullimin dhe duke ndihmuar në uljen e lehtë të tensionit të gjakut. Efektet e kombinuara të nxehtësisë, forcës lundruese dhe presionit të ujit duket se përmirësojnë edhe furnizimin me oksigjen dhe ulin ngarkesën e punës së zemrës. Disa prova sugjerojnë se banjat termale mund të përmirësojnë shëndetin endotelial dhe të reduktojnë stresin e përditshëm, dy faktorë që lidhen me rezultate më të mira kardiovaskulare. Megjithatë, këto terapi duhet të përdoren me kujdes, veçanërisht te pacientët me gjendje të paqëndrueshme të zemrës, aritmi apo hipertension të pakontrolluar. Në thelb, banjat termale nuk duhet të zëvendësojnë trajtimin mjekësor konvencional, por mund të shërbejnë si një metodë ndihmëse dhe e dobishme për shëndetin e përgjithshëm të zemrës.

Fjalë kyçe: banjat termale, shëndeti kardiovaskular, qarkullimi i gjakut, tensioni i gjakut, hidroterapia, terapi holistike.

PËRDORIMI I KALORIMETRISË INDIREKTE NË MJEKIMIN INTENSIV.

Dr. Endrit Bytyqi
Universiteti i Prishtinës

Abstrakt

Kalorimetria indirekte është një metodë e avancuar për vlerësimin e shpenzimeve energjetike te pacientët në mjekimin intensiv. Kjo teknikë mundëson një përshtatje më të saktë të mbështetjes ushqyese, duke ndihmuar në optimizimin e trajtimit dhe përmirësimin e rezultateve klinike. Ky studim shqyrton rolin e kalorimetrisë indirekte në menaxhimin e pacientëve kritikë, duke analizuar përfitimet e saj në krahasim me metodat tradicionale të vlerësimit të nevojave metabolike. Gjithashtu, paraqiten sfidat dhe kufizimet e përdorimit të kësaj metode në praktikën klinike. Gjetjet tregojnë se kalorimetria indirekte kontribuon në një kujdes më të personalizuar, redukton mbingarkesën metabolike dhe ndihmon në parandalimin e komplikacioneve të lidhura me ushqyerjen. Megjithatë, nevojiten studime të mëtejshme për të për caktuar ndikimin e saj afatgjatë në mjekimin intensiv.

Fjalë kyçe: Kalorimetria indirekte, mjekimi intensiv, metabolizmi, mbështetja ushqyese, nevojat energjetike.

EFIKASITETI I FIZIOTERAPISË KARDIORESPIRATORE NË KUJDESIN INTENSIV: RISHIKIM LITERATURE.

Msc. Enea Miho, Prof. Ass. Ermira Zicishti, Msc. Endrit Mone, Msc. Roen Xhaferaj
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"
Njësia e Rehabilitimit të Sëmundjeve të Brendshme

Abstrakt

Hyrje: Fizioterapia kardiorespiratore luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin e pacientëve nën Kujdes Intensiv (KI). Ky studim ofron një rishikim të praktikave në lidhje me fizioterapinë kardiorespiratore në KI. Studimi përfshin teknikat e vlerësimit dhe ndërhyrjet terapeutike të përdorura nga fizioterapistët për të optimizuar funksionin respirator dhe kardiovaskular në pacientët në gjëndje kritike.

Qëllimi: Qëllimi i studimit është të theksojë efikasitetin e fizioterapisë në Kujdesin Intensiv si dhe sfidat unike me të cilat pacientët përballen në KI, duke përfshirë kolapsin respirator, kompromentimin kardiovaskular dhe qëndrimin e zgjatur në shtrat.

Materiale dhe metoda: U krye një rishikim narrativ i literaturës duke shqyrtuar 42 artikuj me përmbajtje reale, bazuar në kriteret e përfshirjes / përjashtimit. Artikujt u kërkuan duke përdorur databaza elektronike të ndryshme si PubMed, Pedro, APTA, WHO, WCPT, Medscape, Scholar dhe ResearchGate. Strategjia e kërkimit përfshinte RCT, studime tërthore dhe studime kohortë.

Rezultate: Ne identifikuam gjithsej 54 artikuj nga databaza të ndryshme elektronike. Nga këta, 42 artikuj u përzgjodhën me përmbajtje reale. Studimi raportoi se rehabilitimi fizik dhe terapia respiratore kanë përmirësuar funksionimin fizik të pacientëve në kujdesin intensiv dhe kanë sjellë përfitime në kujdesin respirator duke rritur pastrimin e rrugëve të frymëmarrjes dhe duke ulur gjasat për zhvillimin e dobësisë së lidhur me KI.

Konkluzione: Studimi ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të fizioterapisë kardiorespiratore në KI, duke theksuar rëndësinë e saj në kujdesin holistik të pacientëve kritikë. Evidencat dhe praktikat aktuale shërbejnë si një burim i vlefshëm për personelin e kujdesit shëndetësor, trajnuesit dhe studiuesit, duke nxitur një kuptim më të thellë të rolit të fizioterapisë në optimizimin e rezultateve për pacientët në KI me kompromis kardiorespirator.

Fjalë kyçe: Fizioterapi kardiorespiratore, Kujdes Intensiv (KI), ndërhyrje terapeutike.

POLIFARMACIA: MES RREZIKUT DHE DOMOSDOSHMËRISË.

Eneida Hoxha, Somida Kuka, Ledio Collaku, Pandush Pojani, Margarita Resuli Gjata
Qëndra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Departamenti i Mjekësisë Interne, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Hyrje: Polifarmacia, e përkufizuar si përdorimi i njëkohshëm i disa barnave, është bërë një tipar karakteristik i mjekësisë interne moderne, veçanërisht tek pacientët e moshuar dhe ata me sëmundje të shumta kronike. Edhe pse shpesh e pashmangshme, polifarmacia shoqërohet me reaksione të padëshiruara medikamentoze, ndërveprime ndërmjet barnave, rrezik më të lartë për rrëzime dhe rihospitalizime. Nga ana tjetër, tek pacientët me komorbiditete si sëmundjet kardiovaskulare, diabeti dhe sëmundja kronike e veshkave, përdorimi i disa barnave mbetet i domosdoshëm për të arritur objektivat terapeutike të bazuara në evidenca. Kjo e vendos polifarmacisë njëkohësisht në rolin e rrezikut dhe nevojës në praktikën e mjekësisë interne.

Objektiva: Qëllimi i këtij punimi është të analizojë prevalencën, implikimet klinike dhe pasojat e polifarmacisë në mjekësinë interne, me fokus në identifikimin e strategjive për të balancuar rreziqet me përfitimet terapeutike.

Materiale dhe Metoda: U krye një rishikim narrativ i literaturës së viteve 2018–2024, përfshirë bazat e të dhënave PubMed dhe Scopus, me fokus tek pacientët e mjekësisë interne me multimorbiditet dhe polifarmaci. U përfshinë gjithashtu përvoja klinike nga Shërbimi i Mjekësisë Interne për të ilustruar sfidat praktike.

Rezultate: Polifarmacia prek mbi 50% të pacientëve të hospitalizuar në repartet e mjekësisë interne, duke arritur deri në 80% tek popullatat geriatrike. Ngjarjet e padëshiruara medikamentoze rezultuan dukshëm më të shpeshta në grupet me polifarmaci, duke kontribuar në 10–25% të rihospitalizimeve. Megjithatë, evidencat tregojnë gjithashtu se polifarmacia racionale përmirëson mbijetesën në patologji si insuficienca kardiake, fibrilacioni atrial dhe parandalimi sekondar i sëmundjes ishemike të zemrës.

Konkluzione: Polifarmacia përfaqëson një ekuilibër delikat midis rrezikut dhe domosdoshmërisë në mjekësinë interne. Ajo nuk duhet parë thjesht si fenomen negativ, por si një sfidë që kërkon përshkrim racional, rishikim periodik të terapisë dhe kujdes të orientuar nga pacienti. Zbatimi i mjeteve të strukturuara për depreskribim dhe

personalizimi i terapisë mund të minimizojnë dëmet duke ruajtur përfitimet terapeutike. Mjekët internistë kanë një rol qendror në transformimin e polifarmacisë nga barrë në strategji të personalizuar terapeutike.

Fjalë kyçe: Polifarmacia, mjekësia interne modern, pacientët e moshuar.

MENAXHIMI DHE KUJDESI INFERMIEROR I PORT - A - CATH TE FËMIJËT NË ONKOLOGJINË PEDIATRIKE.

Enerida Lamçellari[1], Megina Muço[3], Mirzana Kapllanaj[2], Lavdije Shehu[1], Mirela Xhafa[2], Enkeleda Duka[2], Donjeta Bali[2]
[1]*Infermier pranë shërbimit të Onkohematologjisë - QSUT*
[2]*Shërbimi i Onkohematologjisë Pediatrike, Departamenti i Pediatrisë - QSUT*
[3]*Specializant pranë Shërbimit të Pediatrisë - QSUT*

Abstrakt
Hyrje: Kateteri port është një pajisje venoze qendrore, e implantuar nën klavikulë dhe në venën subklavikulare. Në onkologjinë pediatrike preferohet për akses të sigurt venoz gjatë administrimit të kimioterapisë, gjakut dhe produkteve të tij, si dhe terapive të tjera intravenoze, duke shmangur venopunkturat e shpeshta. Megjithëse përdorimi i tij në vendin tonë është ende i kufizuar, port - a - cath përfaqëson një zgjidhje moderne dhe të sigurt për menaxhimin e pacientëve pediatrikë që kërkojnë terapi të zgjatur intravenoze.
Qëllimi: Të vlerësohet përvoja e shërbimit të onko - hematologjisë pediatrike në përdorimin dhe menaxhimin e port - a - cath tek tre pacientë me diagnoza onko - hematologjike dhe të identifikohen përfitimet dhe sfidat e hasura gjatë praktikës klinike.
Materiale dhe metoda: Në studim u përfshinë tre pacientë pediatrikë me diagnoza të ndryshme hematologjike malinje, tek të cilët u implantua port - a - cath gjatë trajtimit. U shqyrtuan aspektet kirurgjikale të implantimit, kujdesi rutinë, si dhe komplikacionet e mundshme infektive, trombotike dhe mekanike.
Rezultate: Të tre pacientët përfituan akses venoz të qëndrueshëm për administrimin e kimioterapisë dhe transfuzioneve. Dy pacientë nuk shfaqën komplikacione serioze, përveç një episodi okluzioni të përkohshëm, i zgjidhur me shpëlarje protokollare. Njëri pacient zhvilloi infeksion lokal në vendin e implantimit, i lidhur me mosrespektimin e asepsisë për shkak të encefalopatisë shoqëruese. Respektimi rigoroz i protokolleve të sterilitetit dhe edukimi i prindërve u treguan vendimtarë për funksionalitetin afatgjatë të pajisjes.
Përfundime: Përvoja jonë e kufizuar tregon se port - a - cath është një mjet i sigurt dhe praktik për fëmijët me sëmundje onko - hematologjike, duke lehtësuar trajtimin dhe përmirësuar cilësinë e jetës. Zgjerimi i përdorimit të tij dhe trajnimi i stafit mjekësor e infermieror mund të përmirësojnë ndjeshëm përkujdesjen dhe të reduktojnë komplikacionet.

Fjalë kyçe: Port - a - cath, onko - hematologji pediatrike, kujdes infermieror, menaxhim, kimioterapi, komplikacione.

DHIMBJET E BARKUT, QASJE KLINIKE E DIAGNOSTIKE.

Enesa Hysenaj

Abstrakt
Hyrje: Dhimbja e barkut është një ndër ankesat kryesore me të cilën haset pediatri në jetën e përditshme. Qëllimi i studimit është të identifikoj dhimbjen abdominale që mund të jetë indikacion për mjekun kirurg nga ajo që është problematike e mjekut pediatër. Studimi ka për qëllim të identifikoj dhe faktorët prediktiv të një problematike kirurgjikale që mund të ndihmoj mjekun pediatër në vendosjen e diagnozës.
Metoda: Janë marr në konsideratë rreth 8000 kartela të shtrimeve në QSUNT por në studim kanë vetem rastet ku në kartelat e shtrimit kanë plotësuar disa kritere specifike.
Rezultate: Numri gjithësej i kartelave që plotësonin këto kritere ishte 298. Meshkujt 166 dhe femrat 132. Diagnozat kryesore ishin App. Akut, Colica abdominale dhe Gastroenteriti Akut. Apendicit Gangrenoz është më e shpeshtë tek meshkujt (32%) sesa tek femrat (21. 9%). Colica abdominale është diagnoza më e zakonshme për femrat (35. 9%), ndërsa për meshkujt është e barabartë me Apendicit Gangrenoz (32%). P vlerë: p = 0. 086.

Moshat më të vogla preken nga gastroenterit akut ndërsa më të mëdhaja preken nga apendicit akut. WBC është më i lartë në Peritonit apendikular dhe në Apendicit. Neutrofilët janë më të lartë tek Peritonit apendikular dhe Apendicit gangrenoz. Limfocitet janë më të larta te Colica abdominale. PCR është shumë më i lartë tek Peritonit apendikular dhe Apendicit gangrenoz. Vlera e cut - off është 3. 955 për studimin tonë. Ekografia ka specifictet të ulët 31. 8%.

Konkluzioni: Abdomeni akut ka një klinike me severe, rritje severe e neutrofilisë dhe ulje e limfociteve. Është më i shpeshtë te mosha prepuberale - puberale. Gastroenteriti te mosha e laktanteve. Nëpërmjet këtyre të dhënave kemi llogaritur NLR që për ne është klinikisht domethënëse mbi 3. 955 sepse në abdomen akut kemi rritje të neutrofileve dhe ulje të limfociteve. Ekografia mbetet ekzaminim sekondar në apendicitin akut pasi kemi specificitet të ulët.

Fjalë kyçe: dhimbje barku, apendicit akut, pacient etj.

INTELIGJENCA ARTIFICIALE NË NEUROIMAZHERI: KUANTIFIKIMI I ATROFISË SË TRURIT SI NJË BIOMARKUES I AFTËSISË SË KUFIZUAR NË SKLEROZËN MULTIPLE NË SHQIPËRI.

Eni Reka[1], Suzana Gjeci[2], Altin Kuqo[2], Arben Rroji[3], Artan Simaku[4] Jera Kruja[2]
[1]*Neurology Department, Regional Hospital of Elbasan, Elbasan, Albania*
[2]*Neurology Department, University Hospital Center "Mother Theresa", Tirana, Albania*
[3]*Neuroimaging Department, University Hospital Center "Mother Theresa", Tirana, Albania*
[4]*Institute of Public Health, Tirana, Albania*

Abstrakt

Hyrje: Modelet e të mësuarit të thellë si Rrjetet Neuronale Konvolucionale (RNK) janë qasje të zakonshme të Iinteligjences artificiale dhe Machine Learning, që përdoren në neuroimazheri edhe për përcaktimin sasior të vëllimit të trurit. Gjithashtu, softuerë të ndryshëm të automatizuar dhe gjysmëautomatik ndihmojnë në përcaktimin sasior të atrofisë në Sklerozën Multiple (SM). Atrofia e trurit është pjesë e patogjenezës së Sklerozës Multiple (SM) dhe korrelon me përparimin e sëmundjes dhe paaftësinë fizike deri në perfundimin e pacienteve ne karrige me rrota. Atrofia e trurit është pjesë e patogjenezës së Sklerozës Multiple (MS) dhe korrelon me progresionin e sëmundjes.

Materialet dhe metoda: Ky është nje studim longitudinal retrospektiv, i pacientëve me së paku 10 vite kohëzgjatje të historisë së sëmundjes me MS. Të ekspozuar ndaj terapive imunomodulatore dhe jo domosdoshërisht nën imunoterapi në kohën e zhvillimit të studimit viti 2022 - 2023. Pas vlerësimit paraprak të 96 pacientëve dhe 193 ekzaminimeve MRI u përfshinë në studim 51 pacientë dhe 102 ekzaminime MRI sipas protokollit të atrofisë sekuenca T1 ISO 1mm / 3 mm ose FLAIR. U matën volumet totale të trurit të 51 pacientëve nëpërmjet programit gjysmë të automatizuar 3D slicer (v. 4. 0), dhe u krahasuan nga 2 ekzaminime për çdo pacient në dy kohë të ndryshme në index dhe në post_index_follow - up. U përllogarit përqindja e humbjes vjetore të trurit (PBVC) te të gjithë pacietët PBVC=Vol post index - Vol Index: 100 / Nr e viteve mes MRI - ve. Është përdorur modeli linear gjeneral i regresioni (GLM) univariat dhe multivariat dhe modeli ANOVA për parashikimin e humbjes së masës trunore.

Rezultate: Në total në studim u përfshinë 51 pacientë 30 (58. 8%) femra dhe 21 (41. 2%) meshkuj. Mosha mesatare e pacientëve është 41. 1 (11. 3) vjeç që varion nga 23 deri në 66 vjeç. Rezultatet treguan një ulje të volumit trunor në post_index follow - up krahasimisht me në index baseline dhe korrelim të kësaj humbje trunore me dizabilitetin fizik dhe rritjen e EDSS (Expanded Disability Status Scale). Diferenca mesatare e volumit të humbur është 148. 6 (102. 8) që varion nga 11. 3 cm3deri ne 530. 3 cm3. Diferenca e volumeve Index – Post index varion nga 1SD deri në mbi 3SD. Luhatja e vlerave të PBVC varion nga 1SD deri në pothuajse 3SD. U gjet një përkeqësim klinik dhe rritje në pikëzimin EDSS përkundrejt atyre që humbin më shumë se PBVC> - 0, 4 % volum trunor në vit. Gjithashtu, në modelin linear të regresionit u gjet marrëdhënie sinjifikante e ndryshimit të score EDSS me PBVC (y = - 0. 08026 x p<0. 01).

Konkluzioni: Kuantifikimi atrofisë së trurit është ndër biomarkerat më të rëndësishëm invivo për të matur shkallën e patologjisë neurodegjenerative në MS. Atrofia në MS korrelon me progresionin e sëmundjes, nis herët dhe është prezente në të gjitha format klinike. Inkorporimi i volumetrisë me software gjysëm të automatizuar dhe të automatizuar në rutinën klinike ndihmon klinicistin për përqasje holistike karshi rasteve klinike dhe ndihmon në evidentimin herët të pacientëve në progresion klinik për të ofruar një trajtim të individualizuar për çdo pacient.

Fjalë kyçe: inteligjenca artificiale, neuroimazheri, atrofi, biomarkues, skleroza multiple.

NDIKIMI I EVROPIANIZIMIT NË KONSUMIMIN E ALKOOLIT NË BALLKANIN PERËNDIMOR.
Eni Tresa

Abstrakt
Hyrje: Procesi i Evropianizimit pritet të ndikojë në shtetet e reja anëtare dhe në vendet kandidate në politikat e Shëndetit Publik. Vendet e Ballkanit Perëndimor (BP) kanë nivele të larta të konsumit të alkoolit dhe alkooli përbën një shqetësim për shëndetin publik, ashtu si edhe në vendet e tjera evropiane. Deri më tani, nuk ka studime lidhur me ndikimin e procesit të Evropianizimit në konsumimin e alkoolit në rajon.
Objektivi: Ky studim eksploron ndikimin e procesit të Evropianizimit, në lidhje me tendencat e konsumimit të alkoolit ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor nga viti 1990 deri në vitin 2011.
Metodologjia: Ky është një studim kuantitativ që përdor një qasje ekologjike. Të dhënat janë mbledhur nga bazat e të dhënave të Bankës Botërore dhe OBSH - së mbi konsumimin e alkoolit në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor gjatë periudhës 1991–2011. Armenia dhe Gjeorgjia janë konsideruar si vende kontrolli. Për analizimin e rezultateve janë përdorur ANOVA dhe analiza e Diferencës në Diferencë (Difference - in - Difference).
Rezultate: Procesi i Evropianizimit ka ndikuar në politikat e përgjithshme të vendeve të BP në lidhje me shëndetin dhe alkoolin përmes acquis të BE - së, direktivave dhe legjislacionit përkatës. Ai ka ndikuar veçanërisht në uljen e konsumit të pijeve alkoolike të forta (Spirits) në BP. Pas fillimit të procesit të Evropianizimit, konsumi i pijeve të forta në Kroaci dhe në Maqedoninë e veriut u ul me 1. 06 litra për frymë (95%CI: - 1. 63; - 0. 49) dhe me 1. 02 litra për frymë në Serbi (95%CI: - 1. 9; - 0. 1).
Përfundime: Ky studim sjell dëshmi mbi ndikimin e procesit të Evropianizimit në politikat publike që lidhen me përdorimin e alkoolit në vendet e Ballkanit Perëndimor, duke kontribuar kështu në përmirësimin afatgjatë të shëndetit të popullatave.

Fjalë kyçe: alkool, pije të forta, proces Evropianizimi, politika publike.

PREVALENCA E KONSUMIMIT TË PIJEVE ENERGJIKE NË MES TË STUDENTËVE TË UNIVERSITETIT ALDENT.
Alesia Jashari[1], Eni Tresa[1], Meliha Beqo[1], Denata Beqiri[1], Irina Peposhi[1]
[1]*Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Fakulteti i Shkencave Teknike Mjekësore, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.*

Abstrakt
Hyrje: Konsumimi i pijeve energjike është rritur ndjeshëm në mbarë botën, veçanërisht tek të rinjtë dhe studentët universitarë. Studime të mëparshme në vende të ndryshme evropiane kanë treguar se një përqindje e lartë e studentëve konsumojnë pije energjike për t'u përballur me stresin akademik, për të rritur përqendrimin ose thjesht sepse u pëlqen shija e tyre. Ky studim synon të vlerësojë lidhjen midis gjinisë dhe konsumimit të pijeve energjike, të identifikojë markat më të përdorura, të përcaktojë arsyet më të shpeshta të konsumit dhe të analizojë ndikimin e programeve të studimit në sjelljen e konsumit.
Materiale dhe Metoda: Ky studim i tipit cross - sectional kishte për qëllim të vlerësonte prevalencën e konsumit të pijeve energjike midis studentëve të Universitetit Aldent gjatë vitit 2025. Me një nivel besueshmërie prej 95%, një marzh gabimi prej 5% dhe një proporcion popullate prej 45%, N=2500, madhësia minimale e mostrës së nevojshme ishte 331. Në total morën pjesë 342 studentë në një pyetësor të strukturuar anonim. Të dhënat u përpunuan statistikisht duke përdorur SPSS 21.
Rezultate: Në përgjithësi, 72. 9% e studentëve konsumojnë pije energjike. Pothuajse gjysma e tyre (45. 7%) raportuan se i përdorin sepse u pëlqen shija. Ndërkohë, 16. 1% i konsumojnë për të pasur më shumë energji gjatë ditës, 10. 6% për t'u përballur me lodhjen, 8% për të qëndruar zgjuar dhe 6. 4% për të përmirësuar përqendrimin gjatë studimit. Një përqindje më e vogël raportoi se i konsumon për shkak të një shijeje të preferuar (8%) ose për të fituar më shumë energji. Konsumi më i lartë u vu re në grupmoshat më të reja: 45. 5% në moshat

18–20 vjeç, 37. 8% në moshat 21–23 vjeç, 10. 3% në moshat 24–26 vjeç dhe vetëm 6. 5% tek ata mbi 26 vjeç. Nuk u gjet asnjë lidhje domethënëse midis konsumimit të pijeve energjike dhe programit të studimit ose gjinisë.

Fjalë kyçe: pije energjike, studentë, konsum, efekte anësore, lodhje, takikardi, përqendrim.

ARSYET KRYESORE QË I NXISIN STUDENTËT TË STUDIOJNË FIZIOTERAPI.

Alesia Marjanaku[1], Sami Ruko[1], Xhesika Meta[1], Luciana Karemanaj[1]
[1] Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt
Hyrje: Studimi synon të analizojë arsyet kryesore që ndikojnë në zgjedhjen e studentëve për të ndjekur studimet në degën e fizioterapisë. Duke qenë se kërkesa për profesionistë të kësaj fushe po rritet në mënyrë të qëndrueshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, është e rëndësishme të kuptohet se cilët faktorë personalë, socialë dhe ekonomikë ndikojnë në këtë zgjedhje.
Materiale dhe metoda: Kërkimi është i tipit transversal me natyrë përshkruese, i realizuar në Universitetin Aldent, Tiranë, gjatë prillit 2025. Në studim morën pjesë 96 studentë të cikleve "Bachelor" dhe "Master" në fizioterapi. Të dhënat u mblodhën përmes një pyetësori me pyetje të mbyllura dhe shkallë vlerësimi, duke u analizuar përmes metodave statistikore deskriptive.
Rezultate dhe diskutime: Të dhënat treguan se faktorët kryesorë që ndikojnë në zgjedhjen e fizioterapisë janë mundësitë e punësimit (25%), paga e kënaqshme (22. 9%) dhe fleksibiliteti në punë (21. 9%). Ndikimi i familjes dhe zgjedhja rastësore rezultuan më pak të rëndësishme. U vu re se rritja e moshës rrit ndjeshëm mundësinë për punësim në këtë profesion.
Përfundime: Zgjedhja e fizioterapisë ndikohet kryesisht nga faktorë ekonomikë dhe profesionalë. Institucionet arsimore duhet të forcojnë orientimin profesional dhe të promovojnë zhvillimin e karrierës në këtë fushë.

Fjalë kyçe: fizioterapi, arsye zgjedhjeje, punësim, studentë, motivim.

NDIKIMI I PUNËS ME PACIENTË TË IMOBILIZUAR NGA AKSIDENTET TEK STAFI INFERMIEROR.

Erdjesa Sena, Qamile Zili, Eni Tresa
Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt
Hyrje: Aksidentet nga shkaku i nëntë thelbësor i mortalitetit dhe imobilitetit (1999) janë zhvendosur në shkakun e tretë në vitin 2020 në botë sipas OBSH. Nga viti 2014 - 2020 në Shqipëri në total janë regjistruar 12366 aksidente rrugore me pasojë në lëvizshmëri dhe fatalitete ku numri më i lartë rezulton në vitin 2016 dhe më i ulët në 2020. Pacientët e imobilizuar paraqesin një kategori me nevoja komplekse. Ky studim ka për qëllim të vlerësojë ndikimin e punës me pacientë të imobilizuar nga aksidentet në mirëqenien fizike, emocionale dhe profesionale të stafit infermieror.
Materiale dhe metoda: Studimi i kryer është një studim i llojit transversal. Ai është ndërmarrë në vitin 2025 në qytetin e Tiranës në Spitalin Universitar të Traumës në repartin e reanimacionit dhe ortopedisë. Pyetësori është zhvilluar për stafin infermieror me tematiken e ndikimit të punës me pacientë të imobilizuar nga aksidentet. Numri i pyetësorëve të plotësuar nga stafi është 79. Kampioni është llogaritur duke marrë në konsideratë IC = 95%, Proporcioni i popullatës = 7%, N=107, marzhin e gabimit = 5%. Gjithashtu u përdor regjistri i pacientëve të imobilizuar në këto pavione.
Rezultate: 48, 1% e infermierëve raportuan gjendje emocionale të vështirë gjatë punës me pacientë të imobilizuar; 44, 9% raportuan lodhje fizike të vazhdueshme, (mbi 5 vite përvojë në repartin e reanimacionit / ortopedisë) 53, 2% e konsideronin punën me pacientë të imobilizuar si një nga faktorët kryesorë që ndikonin drejtpërdrejt në mirëqenien e jetesës së tyre. Eksperienca në punë ka një ndikim thelbësor në gjendjen

emocionale të stafit infermieror. Rritja e eksperiencës në punë me 2 vite çon në zvogëlimin me 40% të stresit emocional dhe fizik të vetëperceptuar nga stafi infermieror (R= - 0. 49 p≤0. 001).
Përfundime: Ky studim evidentoi se puna me pacientë të imobilizuar si pasojë e aksidenteve ka ndikim të theksuar psikologjik dhe emocional mbi stafin infermieror.

Fjalë kyçe: pacientë të imobilizuar, stafi infermieror, stresi në punë.

BASHKËINFEKSIONI HEPATIT B DHE HEPATIT D. KU JEMI ME TESTIMIN E DYFISHTË "REFLEX TESTING"?

Enida Kuci, Najada Çomo, Arjan Harxhi
Departamenti dhe Shërbimi i Sëmundjeve Infektive, FM, QSUT.

Abstrakt
Hyrje: Hepatiti viral B është një infeksion kronik i shpeshtë që mund të komplikohet nga bashkë infeksioni me virusin e Hepatitit D. Bashkëinfeksioni HBV / HDV lidhet me ecuri më të shpejtë drejt fibrozës së avancuar hepatike, cirozës dhe karcinomës hepatocelulare, duke e bërë identifikimin e tij të hershëm një prioritet klinik. Megjithatë testimi për HDV shpesh neglizhohet edhe tek pacientët me infeksion kronik HBV, duke çuar në nën - diagnostikim dhe menaxhim të pamjaftueshëm.
Materiale dhe Metoda: Ky studim përfshin 426 pacientë të diagnostikuar me Hepatit B kronik, të ndjekur në shërbimin infektiv. Për secilin pacient janë analizuar të dhënat klinike, laboratorike dhe elastografike. Të gjithë pacientët janë testuar për prezencën e antitrupave anti - HDV dhe, kur rezultati ka qenë pozitiv, është kryer matja e ngarkesës virale të HDV (HDV - ADN).
Raste Klinike: Nga 426 pacientë me Hepatit B, 6 raste (1. 41%) kanë rezultuar pozitivë për anti - HDV, duke treguar praninë e bashkëinfeksionit. Të dhënat e detajuara klinike për secilin prej tyre janë si më poshtë: Rasti 1: Femër, 37 vjeç. Diagnostikuar në Maj 2023 gjatë dhurimit të gjakut. HBV - ADN 661 IU / mL, AST 24 U / L, ALT 17 U / L, Fibroscan 6. 3 kPa, anti - HDV pozitiv. Rasti 2: Mashkull, 59 vjeç. Diagnostikuar në Shkurt 2025 gjatë skriningut për purpurë trombocitopenike idiopatike. HBV - ADN e padetektueshme, AST 108 U / L, ALT 153 U / L, Fibroscan 9. 1 kPa, anti - HDV pozitiv. Rasti 3: Mashkull, 54 vjeç. Diagnostikuar në Nëntor 2014 gjatë skriningut për Leucemi Mieloide Kronike. HBV - ADN e padetektueshme, AST 188 U / L, ALT 149 U / L, Fibroscan 5. 7 kPa, anti - HDV pozitiv. Rasti 4: Femër, 33 vjeç. Diagnostikuar në Nëntor 2017 për shkak të hipertransaminazemisë. HBV - ADN 190, 000, 000 IU / mL, AST 51. 3 U / L, ALT 102. 5 U / L, Fibroscan 4. 9 kPa, anti - HDV pozitiv por HDV - ADN e padetektueshme. Në ritestim pas 6 vitesh rezulton negative. Rasti 5: Mashkull, 50 vjeç. Diagnostikuar në Nëntor 2016 (me psoriasis vulgaris dhe artrit psoriatik) për shkak të hipertransaminazemisë. HBV - ADN 253 IU / mL, AST 61 U / L, ALT 53 U / L, Fibroscan 9 kPa, anti - HDV pozitiv por HDV - ADN e padetektueshme. Rasti 6: Mashkull, 70 vjeç. Diagnostikuar në Tetor 2017 për shkak të bilirubinës se rritur. HBV - ADN 30755705 IU / mL, AST 30 U / L, ALT 37 U / L, Fibroscan 18 kPa, anti - HDV pozitiv, por HDV - ADN e padetektueshme. Të gjashtë pacientët kanë filluar terapi me Tenofovir Disoproxil 245mg prej momentit të diagnostikimit.
Përfundime: Frekuenca e bashkëinfeksionit HBV / HDV në këtë grup ishte relativisht e ulët (1. 41%), por rëndësia klinike e tij është e madhe për shkak të ecurisë më agresive të sëmundjes. Këto të dhëna theksojnë rëndësinë e testimit të dyfishtë (HBV dhe HDV) për të përmirësuar diagnostikimin e hershëm dhe menaxhimin klinik të pacientëve.

Fjalë kyçe: Hepatit B, Hepatit D, bashkëinfeksion, testim.

SËMUNDJET KARDIOVASKULARE TEK PACIENTËT ME ARTRIT REUMATOID.

Dr. Enida Xhaferi[1], Dr. Altina Xhaferi[1], Dr. Alma Imami Lelcaj[1], Dr. Fatbardha Lamaj[2]
[1]*Universiteti I Mjekësisë / Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Tiranë, Shqipëri*
[2]*Intermedica Laboratory, Tiranë, Shqipëri*

Abstrakt
Artriti Reumatoid është një sëmundje kronike inflamatore e karakterizuar nga prania e sinovitit dëmtues, shfaqja e ndryshimeve në strukturat artikulare dhe shkatërrimi i parikthyeshëm kockor. Patogjeneza e sëmundjes autoimune, prevalencë e së cilës varion ndërmjet 0. 5–1. 0% në pjesën më të madhe të popullatave, është multifaktoriale dhe rezultat i ndërveprimit kompleks ndërmjet gjeneve, faktorëve të mjedisit dhe atyre rastësor. Sëmundja karakterizohet nga prania e autoantikorpeve, më kryesoret e së cilave janë faktori rheumatoid dhe antikorpet kundër proteinës së citrulinuar. Artikulacionet janë strukturat kryesore që dëmtohen në Artritin Reumatoid. Artriti në këtë sëmundje është simetrik, erroziv, deformues, që shkatërron kryesisht artikulacionet e vogla të duarve, këmbëve (preken artikulacionet interfalangeale proksimale dhe metakarpofalangeale ndërsa ato interfalangeale distale ngelen përgjithësisht të padëmtuara) kyçeve, gjunjëve, bërrylave, temporomandibulare ose të shpatullave. Përveç prekjes artikulare pacientët shfaqin dëmtime sistemike ekstrartikulare në organet e tjeras si në pulmone, sy, veshka, vaskulit reumatoid dhe sëmundje kardiovaskulare. Pacientët me Artrit Reumatoid kanë rrisk më të shtuar për shfaqje sëmundjesh kardiovaskulare dhe këto patologji janë shkaktarë kryesorë vdekshmërie për këta pacientët. Studimet kanë treguar se tek pacientët me Artrit Reumatoid, rrisku për shfaqen e Sëmundjes së Arterieve Koronare është 1. 5 - 2 herë më i lartë se ai i popullatës së përgjithëshme, bazuar në praninë e gjëndjes së përgjithshme pro inflamatore. Inflamacioni influencon në mënyrë të drejtpërdrejtë pllakat aterosklerotike dhe përforcon faktorët klasikë të riskut kardiovaskular (diabeti, hipertensioni, dislipidemia, obesiteti, duhanpirja, gjenetika) dhe ndikon në komponentët strukturorë kardiovaskular. Përveç çrregullimeve ishemike, studimet kanë treguar se pacientët me Artrit Reumatoid kanë risk të shtuar për shfaqjen e Insuficiencës Kardiake jo ishemike; një numër i konsiderueshëm i tyrë shfaqin perikardit, çrregullime të përçimit, dëmtime valvulare, miokardit.
Ky studim fokusohet në diskutimin e riskut dhe komponentëve të patogjenezës së sëmundjeve kardiovaskulare tek pacientët me Artrit Reumatoid, impaktin e terapive antireumatizmale, dhe rekomandimet e shoqatave të specializuara për menaxhimin e sëmundjeve kardiovaskulare tek të sëmurët me këtë çrregullim.

Fjalë kyçe: Artriti Reumatoid, sëmundje kardiake, sëmundja e arterieve koronare.

MANIFESTIMET KLINIKE NË MIOPATITË INFLAMATORE.

Kristina Kamberi, Enida Xhaferi

Abstrakt
Hyrje: Miopatitë inflamatore përfaqësojnë një grup heterogjen sëmundjesh autoimune të muskulit skeletik, të karakterizuara kryesisht nga dobësi progresive muskulore simetrike me predominim proksimal. Pacientët shpesh paraqiten me vështirësi në kryerjen e aktiviteteve të përditshme si ngjitja e shkallëve, ngritja e objekteve apo krehja e flokëve. Dobësia mund të shoqërohet me mialgji, lodhje dhe atrofi muskulore në fazat e avancuara. Manifestimet klinike ndryshojnë sipas nëntipit. Dermatomioziti shoqërohet me lezione tipike kutane si rash heliotropik dhe papulat Gottron, të cilat shpesh kanë rëndësi diagnostike. Polimioziti paraqitet kryesisht me dobësi muskulore pa shenja kutane, ndërsa miopatia e trupave inkluzive karakterizohet nga kurs kronik, disfagi dhe përfshirje të muskujve distalë, shpesh me rezistencë ndaj terapisë imunosupresive. Përveç simptomave muskulore, shpesh vërehen manifestime sistemike si sëmundja intersticiale e mushkërive, përfshirje kardiake, artralgji, fenomen Raynaud dhe disfagi e rëndë. Identifikimi i autoantitrupave specifikë ka rol të rëndësishëm në përcaktimin e nëntipit, prognozës dhe përgjigjes terapeutike. Kjo e bën menaxhimin e pacientëve me miopati inflamatore një proces kompleks që kërkon qasje multidisiplinare.

Fjalë kyçe: miopati, autoimune, muskuj, mialgji, atrofi, autoantitrupa.

EKZAMINIMET IMAZHERIKE NË SËMUNDJET REUMATIZMALE.
Jesmina Selmani, Enida Xhaferi

Abstrakt
Hyrje: Sëmundjet reumatizmale përfshijnë një spektër të gjerë patologjish kronike inflamatore dhe degjenerative që prekin nyjet, indet e buta periartikulare dhe sistemin muskuloskeletal. Diagnostikimi i hershëm dhe monitorimi i saktë i progresionit janë thelbësorë për parandalimin e dëmtimeve strukturore dhe invaliditetit afatgjatë. Në këtë drejtim, ekzaminimet imazherike përfaqësojnë një instrument të domosdoshëm në praktikën klinike reumatologjike. Radiografia konvencionale mbetet një metodë standarde për vlerësimin e erozioneve kockore, osteofiteve dhe ngushtimit të hapësirave artikulare, duke qenë veçanërisht e rëndësishme në artritin reumatoid dhe artrozë. Megjithatë, ndjeshmëria e saj është e kufizuar në fazat e hershme të patologjisë, pasi ndryshimet strukturore bëhen të dukshme vetëm pas evoluimit të procesit inflamator. Ekografia muskuloskeletale ka fituar terren si një mjet me rezolucion të lartë në detektimin e sinovitit, efuzioneve, entezitëve dhe ndryshimeve të indeve të buta, duke ofruar avantazhin e një procedure jo invazive, të përsëritshme dhe të aksesueshme. Rezonanca magnetike (MRI) është metoda më e ndjeshme për detektimin e inflamacionit subklinik, dëmtimeve të palcës kockore dhe erozioneve të hershme, duke mundësuar një diagnostikim më të hershëm dhe një vlerësim më të plotë të aktivitetit të sëmundjes. Përfundimisht, integrimi i metodave të ndryshme imazherike sipas qëllimit klinik – diagnostikim, monitorim i evoluimit apo vlerësim i përgjigjes terapeutike – është thelbësor për menaxhimin optimal të pacientëve me sëmundje reumatizmale. Përdorimi i kombinuar i radiografisë, ekografisë dhe MRI - së siguron një qasje të individualizuar, duke kontribuar në parandalimin e dëmtimeve strukturore dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientëve.

Fjalë kyçe: inflamatore, erozione, artrid rheumatoid, MRI.

TUMORËT E MUSHKËRIVE.
Enis Gashi

Abstrakt
Hyrje: Tumorët janë masë indore jonormale që formohen kur qelizat rriten dhe ndahen më shumë se ç'duhet ose nuk vdesin kur duhet. Mund të quhen edhe si neoplazi. Mund të jenë beninje dhe malinje nga sjellja, duke shkaktuar komplikime mjekësore dhe madje edhe vdekje. Tumorët e mushkërive janë formacione që krijohen nga indet e mushkërive ose nga përhapja e largët e kancerit nga një pjesë tjetër e trupit, të njohura si neoplazi metastazike.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është që të fitojmë njohuri konkrete rreth tumorëve pulmonarë, klasifikimin e tyre, etiologjinë, patologjinë, fiziologjinë patologjike, klinikën, diagnostikimin dhe trajtimin. Janë analizuar studime, hulumtime dhe meta analiza të ndryshme.
Metodologjia: Punimi është hulumtim retrospektiv që bën krahasimin e tumorëve pulmonarë. Hulumtimi është i bazuar në publikimet e mëhershme kryesisht të patologjisë, por edhe të disiplinave të tjera mjekësore si, onkologjisë, kirurgjisë etj. Metodë kryesore hulumtimi ka qenë shfletimi i literaturës dhe analizimi i të dhënave statistikore.
Diskutime: Në vitin 2015, pati pothuajse 1. 7 milionë vdekje në mbarë botën nga kanceri i mushkërive. Tumorët pulmonarë paraqesin 12. 4% të të gjitha rasteve të reja të kancerit në SHBA. Në vitin 2017 në Sh. B. A. , kishte rreth 222, 500 raste të reja të diagnostikuar. Kanceri i mushkërive është më i shpeshtë tek meshkujt sesa tek femrat. Pirja e duhanit shkaku kryesor i kancerit të mushkërive. Në Kinë llojet më të zakonshme histologjike të kancerit të mushkërive ishin karcinoma skuamocelulare tek meshkujt dhe adenokarcinoma tek femrat. Rreth 700 persona në vit diagnostikohen me kancer te mushkërive në Kosovë. Incidenca sillet rreth 40 raste të reja për 100 mijë banorë. Në Kosovë 90% e tumorëve pulmonar janë të natyrës malinje ndërsa 10% janë beninje apo metastaza sekondare.
Përfundime: Tumorët pulmonarë janë kryesisht të natyrës malinje 90%. Klinika e varfër, simptomatologjia e vonshme dhe metastazat e hershme janë tre nga faktorët qe i bëjnë tumorët pulmonarë një problematikë shëndetësore. Në Kosovë nuk ka regjistër qendror për të prekurit nga sëmundjet neoplazike.

Fjalë kyçe: tumori, kanceri, patologjia, mushkëri.

ROLET DHE MEKANIZMAT E VEPRIMIT TË AMPK - SË NË KANCERA.

Dr. Enis Poturqoj
Universiteti i Prishtinës

Abstrakt

Hyrje: Kinaza e aktivuar nga AMP (AMPK) është një sensor kryesor i energjisë qelizore, që rregullon ekuilibrin metabolik duke aktivizuar rrugë katabolike dhe duke frenuar ato anabolike. Në qelizat kanceroze, ku metabolizmi pëson ndryshime të mëdha për të mbështetur proliferimin dhe mbijetesën, AMPK merr role të dyfishta, si supresor i tumorit por në raste të caktuara edhe si mbështetës i rritjes tumorale.

Metoda dhe Rezultate: Ky punim paraqet një rishikim narrativ të literaturës së fundit të publikuar në databazën PubMed. Artikujt e përzgjedhur fokusohen në ndikimin e AMPK në metabolizmin qelizor, ndërveprimet me rrugë sinjalizuese si mTOR, ndikimin në proliferim, apoptozë dhe progresion të kancerit. Të dhënat tregojnë se aktivizimi i AMPK zakonisht frenon rritjen tumorale duke bllokuar lipogjenezën dhe duke aktivizuar β - oksidimin, por në disa kontekste specifike ai mund të kontribuojë në mbijetesën e qelizave kanceroze nën stres metabolik.

Përfundime: AMPK është një rregullator i rëndësishëm i metabolizmit qelizor dhe homeostazës energjetike në kancer. Ndërveprimi i tij me rrugë kyçe si mTOR dhe ndikimi në proceset metabolike sugjerojnë se ai ka potencial të madh si target terapeutik. Megjithatë, duke qenë se efektet e tij varen nga konteksti dhe tipi i kancerit, nevojiten studime të mëtejshme për të qartësuar në cilat raste aktivizimi i AMPK është i favorshëm për parandalimin dhe trajtimin e kancerit.

Fjalë kyçe: AMPK, kancer, homeostazë etj.

BLEFAROPLASTIKA INFERIORE: AVANTAZHET E TEKNIKËS ME LEMBO TË ADAMSON - IT NDAJ TEKNIKËS TRADICIONALE.

Enis Zorba, Vladimir Filaj
Shërbimi i Djegies - Plastika, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë

Abstrakt

Qëllimi: Blefaroplastika inferiore mbetet një ndër procedurat më të zakonshme në kirurgjinë estetike të fytyrës. Megjithatë, teknikat tradicionale shpesh shoqërohen me komplikacione si ektropion, deformimi "hollow" infraorbital dhe humbje e volumit natyral. Qëllimi i këtij studimi është të krahasojë rezultatet estetike dhe funksionale midis blefaroplastikës tradicionale dhe teknikës me lembo muskulare të Adamson - it.

Materiale dhe metoda: U analizuan pacientë të trajtuar me blefaroplastikë inferiore. Në grupin e parë (tradicional), u krye ekzicioni subciliar me heqje të depozitave dhjamore dhe lëkurës së tepërt. Në grupin e dytë (Adamson flap), u përdor lembo i muskulit orbicularis oculi, i cili ngrihet dhe ripozicionohet supero - lateralisht dhe fiksohet ne periosteum te kufirit orbitar superior.

Rezultate: Pacientët e trajtuar me teknikën tradicionale shfaqën rezultat të mirë estetik në rastet me lëkurë elastike dhe deficit minimal volumetrik, por në disa raste u vu re retraksion i qepallës dhe pamje e sheshtë infraorbitale. Në grupin Adamson, u evidentua tranzicion më i butë midis qepallës dhe faqeve, mbajtje më e mirë e volumit dhe risk më i ulët i ektropionit. Edema postoperative ishte më e zgjatur, por pa komplikacione të qëndrueshme.

Përfundime: Teknika me lembo të Adamson - it ofron një alternativë superiore në aspektin e mbështetjes funksionale dhe harmonisë estetike të regjonit infraorbital. Ajo rekomandohet veçanërisht për pacientë me atrofi malare ose tear trough të theksuar, duke reduktuar rrezikun e deformimeve sekondare dhe duke ruajtur pamjen natyrale të syrit.

Fjalë kyçe: blefaroplastikë inferiore, lembo të Adamson - it, orbicularis oculi, ektropion, regjioni infraorbital, kirurgji estetike e fytyrës.

MASTOCITOZA KUTANE DHE ILUSTRIMI ME NJË RAST KLINIK.

Enkeleda Duka, Endrina Kola, Loreta Kuneshka, Mirzana Kapllanaj, Mirela Xhafa, Donjeta Bali
Shërbimi i Onkohematologjisë pediatrike, Departamenti i Pediatrisë
Qëndra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"

Abstrakt

Hyrje: Mastocitoza është një patologji e rrallë e karakterizuar nga një akumulim patologjik i mastociteve në inde. Ajo mund të jetë vetëm e kufizuar në lëkurë (mastocitoza kutane) ose të prekë edhe inde ekstrakutane (mastocitoza sistemike). Simptomat klinike janë rezultat i akumulimit te mastociteve në këto inde dhe clirimit të mediatorëve mastocitarë si histamina, heparina, leukotrienet, prostaglandinat, proteazat dhe citokinat. Simptomat janë të ngjashme me ato të një reaksioni alergjik ose anafilaktik. Në moshën pediatrike mbizotëron forma kutane. Simptomat karakteristike janë lezionet kutane makulo - papulare eritematoze në fillim, që bëhen kafe dhe shtohen me kalimin e kohës. Ato skuqën nëse ngacmohen. Nga aktivizimi i mastociteve atom mund të shfaqin shenja sistemike si takikardi, skuqje, diarre, lodhje nën ndikimin e faktorëve fizikë ose medikamentozë. Përqindja më e madhe e rasteve shfaqen para moshës 2 vjeç. Diagnoza dyshohet nga karakteristikat e lezioneve kutane dhe konfirmohet nga biopsia e një lezioni. Në format sistemike diagnozat vendoset nga prezenca e mastociteve në indet ekstrakutane ose palcës kockore dhe një nga kriteret minore: triptaza serike e rritur, gjetja e mutacioneve tipike. Trajtimi fillon me menaxhimin e simptomave të ndërmjetësuara nga qelizat mastocitare si pruritus dhe skuqje. Duhen shmangur faktorët që shkaktojnë çlirimin mediatorëve mastocitarë. Pruritusi dhe skuqja shpesh trajtohen me një antihistaminik si cetirizina. Rreziku i anafilaksisë në fëmijët me mastocitozë është 5 - 10%. Prandaj, parandalimi ose eliminimi i nxitësve për anafilaksinë është qëllimi kryesor. Marrja e masave me epinefrinë është shumë e rëndësishme për menaxhimin e anafilaksisë jashte spitalore, sidomos te fëmijët me episode të mëparshme të anafilaksise dhe / ose nivele të larta të triptazës në serum.

Prezantimi i Rastit: Djalë 15 muajsh ka shfaqur njollat e para ngjyrë kafe në moshën 5 muajsh, në pjesën lubmosakrale dhe janë shtuar progresivisht, të cilat skuqen dhe qetësohen. Defekime diarreike intermitente dhe grindje. Objektivisht ka lezione makulopapulare kafe në të gjithë kurrizin, Darier sign pozitive. Pa prekje të sistemeve të tjera. Në imazheri nuk ka prekje pulmonare dhe të organeve parenkimatoze. Ekzaniminet laboratorike rezultojne në normë. Triptaza 4. 43 ng / mL (brenda normes). Biopsi kutane - Infiltrim dens mononuklear me bërthama lehtësisht të zgjeruara. Në IHC rezultoi: CD117 pozitive, Giemsa pozitive, ndryshime këto në perputhje me mastocitozën. Bëhet një plan ndjeke dhe trajtimi sipas simptomave që zhvillohen dhe masat që duhet të merren për të menaxhuar një anafilaksi të mundshme.

Konkluzione: Mastocitoza është një sëmundje e rrallë. Rëndësia e diagnostikimit dhe dallimi midis formave është për të bërë një plan të përshtatshëm terapeutik dhe parandalues të një anafilaksie të rëndë. Kjo sëmundje zbehet dhe vetëkufizohet me moshën. Ndjekja çdo 6 muaj dhe matja e triptazës çdo 12 muaj shërben për të vlerësuar ecurinë e sëmundjes.

Fjalë kyçe: Mastocitoza, kutane, sistemike, trajtim.

ERITEMË ANULARE CENTRIFUGALE E SHKAKTUAR NGA INFEKSIONI ME PROTEUS MIRABILIS, QË NGJAN ME NJË REAKSION ALERGJIK NGA MEDIKAMENTET.

Enkeleda Kryezi, Klodiana Velcani, Drita Jaka, Vasillaq Jorga
Spitali i Burgut QSUNT, Qsh numër 3, Tiranë.

Abstrakt

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të paraqesë një rast klinik unik të një pacienteje që zhvilloi Erythema Annulare Centrifugum (EAC) pas një ndërhyrjeje kirurgjikale gjenitale, ku shkaku themelor rezultoi të ishte një infeksion bakterial me Proteus mirabilis. Rasti përfaqëson një formë të rrallë të manifestimeve dermatologjike të lidhura me infeksione urinare, që mund të ngatërrohen klinikisht me reaksione alergjike ndaj ilaçeve si enoxaparina.

Metodologjia: Rasti përfshin një paciente 58 - vjeçare që pas ndërhyrjes vaginale (vaginoplastikë anteroposterior) dhe përdorimit të enoxaparin sodium si antikoagulant pas operacionit, zhvilloi lezione anulare jo - pruritike në bark dhe gjymtyrë. Pacientja u referua fillimisht si rast i dyshuar për reaksion alergjik ndaj ilaçit, por vlerësimet laboratorike, histopatologjike dhe mikrobiologjike treguan një tablo të ndryshme. Janë

kryer analiza të gjakut, funksione hepatike dhe renale, autoantitrupa, PCR, ultratinguj abdominal, si dhe kulturë urinare dhe biopsi e lëkurës.
Përfundime: Ky raport përfaqëson rastin e parë të dokumentuar të EAC të lidhur me infeksionin nga Proteus mirabilis në literaturën mjekësore shqiptare. Rezultatet sugjerojnë se ky bakter gram - negativ mund të ketë rol patogjenetike në zhvillimin e lezioneve dermatologjike anulare. Njohja e hershme dhe trajtimi i duhur me antibiotikë mund të parandalojnë përsëritjen e simptomave dhe komplikacionet. Rastet e tilla ndihmojnë në zgjerimin e njohurive mbi ndërveprimet ndërmjet infeksioneve sistemike dhe sëmundjeve të lëkurës.

Fjalë kyçe: Erythema Annulare Centrifugum, proteus mirabilis, enoxaparin sodium, reaksion alergjik, infeksion urinar, dermatologji klinike.

KUJDESI INFERMIEROR NË PACIENTË ME DEMENCË.
Enkelejda Pillati
Q. S. U. T. "Nënë Tereza", Shërbimi i Neurologjisë

Abstrakt
Hyrje: Demenca është një sindromë që përfshin rënien e kujtesës, të menduarit, sjelljes dhe aftësisë për të kryer aktivitetet e përditshme, shpesh duke u përkeqësuar me kalimin e kohës.
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është që të njihemi me simptomat, shkaqet, format e demencës faktoret e riskut dhe trajtimi etj.
Rezultate: Në këtë sëmundje burrat edhe gratë janë të prekura nga sëmundja. Terapitë: Stimulim njohës, terapi okupacionale, kujdes mbështetës për pacientin dhe familjen. Edukimi shumë i pakët i pacientëve dhe i popullatës në lidhje me këtë patologji.
Rekomandime: Rekomandoj që ti kushtohet një rëndësi më të madhe kësaj patologjie. Të ofrohen informacione të ndryshme edhe për familjarët, pasi edhe ata luajnë një rol shumë të rëndësishëm në jetën e pacientit. T'ju japim sa më shumë informacione se si duhet të veprojnë në momente të caktuara.
Konkluzione: Demenca është një çrregullim neurologjik progresiv që dëmton funksionin njohës, duke prekur kujtesën, të menduarit, arsyetimin dhe funksionimin e përditshëm të një individi. Bëhen testet laboratorike për të përjashtuar kushte të tjera që mund të shkaktojnë dëmtim njohës.

Fjalë kyçe: Demenca, AD, demenca për shkak të sëmundjes së huntingtonit, demenca për shkak të sëmundjes PICK, demenca për shkak të sëmundjes Creutzfeldt - Jakob.

AGENESIA KONGENITALE E VENËS PORTA: PREZANTIM RASTI DHE RISHIKIM I LITERATURËS.
Eno Beqja[1], Erald Vasili[2], Ergisa Toska[3], Mamica Erebara[1], Adriana Babameto[1]
[1]*Shërbimi i Gastrohepatologjisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë*
[2]*Spitali GVM, Departmenti Imazherisë.*
[3]*Shërbimi i Imazherisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë*

Abstrakt
Hyrje: Agenesia kongenitale e venës porta ose mungesa funksionale e saj është një anomali vaskulare e rrallë që çon në drenim direkt porto sistemik të gjakut, hipertension portal dhe komplikacione të shumta hepatike dhe sistemike. Prezantohen ndryshime imazherike karakteristike dhe manifestime klinike që kërkojnë vlerësim multidisiplinor.
Raportimi i rastit: Paraqitet një i ri, 24 vjeç, me melena dhe dobësi të përgjithshme trupore. Ekzaminimet laboratorike tregojnë anemi mikrocitare hipokromike me Hgb 9. 4 g / dL, ferritinë 18. 8 ng / mL dhe probleme të lehta të koagulimit me INR 1. 44. Elektroforeza e proteinave dhe markuesit tumorale janë brenda normës. Fibrogastroskopia evidenton gastrit, bulbit eroziv dhe ezofagit. Ekografia abdominale dhe Angio - CT konfirmojnë mungesën e venës porta dhe degëve të saj, prani të shumta shuntesh porto sistemike dhe vena varikotike kryesisht perigastrike dhe në hilusin lienal. Vërehet splenomegali e shprehur me diametër longitudinal rreth 24 cm dhe disproporcion segmentesh hepatike me hipertrofi të lobit të majtë dhe hipotrofi të

lobit të djathtë dhe çrregullime perfuzioni; nuk dokumentohen lezione fokale hepatike ose zgjerim i rrugëve biliare intrahepatike. Nuk shihen limfadenopati retroperitoneale apo lezione metastatike të dukshme. Kombinimi i mungesës së venës porta, shunteve kolaterale dhe splenomegalisë përputhet me diagnozën e agenesisë portale me hipertension portal kronik.
Përfundime: Rasti përfaqëson një prezantim të agenesisë së venës porta tek i riu, me pasoja hemodinamike dhe klinike. Mungesa e sisitemit portal dhe prania e shunteve porto - sistemike kanë shkaktuar komplikacione hepatike, splenomegali dhe formim të rrjeteve varikotike. Kombinimi i këtyre faktoreve rrit rrezikun për hemorragji, çrregullime të funksionit hepatik dhe komplikacione të tjera vaskulare. Nevojiten vlerësime të mëtejshme hematologjike dhe imazherike për vendimmarrje terapeutike.

Fjalë kyçe: Agenesia kongenitale, vena porta, anomali vaskulare, drenim.

MANIFESTIMET AKUTE DHE KRONIKE TË SËMUNDJES SË ENËVE TË VOGLA CEREBRALE (CSVD).
Dr. Shk. Entela Basha[1], Dr. Eris Ranxha[1], Dr. Olsi Taka[1]
[1]Shërbimi Neurovaskular QSUNT, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Sëmundja e enëve të vogla të gjakut cerebrale (CSVD) është një grup sëmundjesh cerebrovaskulare prekin enët shumë të vogla të trurit – arteriolat, kapilarët dhe venulat. Kjo sëmundje është një nga shkaqet më të shpeshta të AVC ishemike lakunare, dëmtimeve të lëndës së bardhë të trurit dhe rënies kognitive deri në demencë vaskulare.
CSVD ndodh si pasojë e dëmtimit kronik të endotelit dhe autorregulimit të rrjedhjes së gjakut në tru, shpesh për shkak të hipertensionit arterial kronik, diabetit mellitus, dislipidemisë, duhanpirjes, moshës së avancuar dhe angiopatise amiloide. Këto faktorë çojnë në trashje të murit të enëve (lipohialinozë), ngushtim të lumenit vaskular dhe mikroinfarkte. Manifestimet klinike ndahen në dy grupe të mëdha, akute dhe kronike: CSVD shpesh zhvillohet në mënyrë të heshtur, por mund të jap deficite kognitive (ngadalësim i përpunimit, vështirësi në vëmendje), çrregullime të ecjes, çrregullime të humorit (depresion vaskular), inkontinencë urinare dhe goditje të vogla lakunare. Gjetjet në imazheri (MRI): MRI tregon white matter hyperintensities (WMH), infarkte lakunare, mikrohemorragji cerebrale, zgavra perivaskulare dhe atrofi cerebrale, të cilat janë tregues tipikë të CSVD. Klasifikimet kryesore: Arteriolosklerotike (hipertensive), Angiopatia amiloide, Inflamatore / imune, Gjenetike si CADASIL, CARASIL. Pasojat afatgjata: Rritje e rrezikut për demencë vaskulare, demencë të përzier (vaskulare + Alzheimer), goditje të përsëritura dhe rënie funksionale. Nuk ka trajtim kurativ, por kontrolli i faktorëve të riskut është thelbësor – presioni arterial, glicemia, dislipidemia, ndalimi i duhanit, aktiviteti fizik dhe dieta mesdhetare. Antiplateletë përdoren në rastet me infarkte lakunare. Studime të rëndësishme: LADIS (lidhja mes lezioneve të substancës së bardhë dhe paaftësisë funksionale), Rotterdam (lidhja e WMH dhe mikroinfarkteve me demencën), dhe Nun Study (ndryshimet vaskulare kontribuojnë në demencë edhe pa patologji Alzheimer të rëndë).

Fjalë kyçe: Sëmundje, enët e vogla të gjakut cerebrale (CSVD).

KONTROLLI NEUROMUSKULAR ME ANË TË ELEKTROMIOGRAFISË: ANALIZË RETROSPEKTIVE NË KLINIKËN E NEUROLOGJISË – QKUK.
Dr. Entela Beqiri

Abstrakt
Hyrje: Ky punim trajton rëndësinë e elektromiografisë (EMG) si një metodë diagnostikuese dhe monitoruese në sëmundjet neuromuskulare. Fillimisht paraqitet një përmbledhje e anatomisë dhe fiziologjisë së sistemit neuromuskular, me qëllim të kuptimit të bazave mbi të cilat funksionon EMG. Më tej, shtjellohet koncepti i elektromiografisë, duke u ndalur tek procesi nga gjenerimi i impulsit nervor deri tek përpunimi i tij, përmes aparaturës diagnostikuese. Punimi ndalet edhe në përdorimin e elektrodave sipërfaqësore dhe atyre me gjilpërë, si dhe avantazhet dhe kufizimet e tyre. Në pjesën tjetër trajtohen sëmundjet neuromuskulare më të shpeshta, me

theks te gjetjet karakteristike në EMG dhe rëndësia e interpretimit të rezultateve. Në pjesën praktike, paraqitet interpretimi i një rasti klinik të trajtuar në QKUK, në Klinikën e Neurologjisë, ku EMG ka pasur rol vendimtar në përcaktimin e diagnozës. Gjithashtu, punimi përfshin një hulumtim retrospektiv mbi 948 pacientë të diagnostikuar me anë të EMG gjatë një periudhe gjashtëmujore në Klinikën e Neurologjisë, ku analizohen diagnozat e hasura sipas gjinisë dhe vendbanimit. Rezultatet tregojnë se EMG ka rol thelbësor jo vetëm në diagnostikimin e hershëm të sëmundjeve neuromuskulare, por edhe në ndjekjen e pacientëve gjatë fazës së rehabilitimit. Të dhënat janë interpretuar dhe analizuar statistikisht, duke nxjerrë në pah shpërndarjen e patologjive sipas karakteristikave demografike. Nga të dhënat e përfituara, punimi arrin në përfundimin se elektromiografia ka rol të pazëvendësueshëm në diagnostikimin e hershëm, diferencimin e sëmundjeve neuromuskulare dhe monitorimin e fazës së rehabilitimit, duke e bërë atë një metodë thelbësore në praktikën klinike bashkëkohore.

Fjalë kyçe: elektromiografia, kontroll neuromuskular, elektroda, diagnostikim, sëmundje neuromuskulare.

PANORMË KLINIKOETIOLOGJIKE E PATOLOGJIVE TË KOLONIT.

Dr. Entela Kerxhaliu, Prof. Dr. Enton Bollano, Dr. Monika Kallfa, Dr. Ada Myrto, Dr. Endri Katro, Dr. Elona Naqellari, Dr. Marina Parllaku, Dr. Daniela Xhemalaj
Spital Continental, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Polipet e zorrës së trashë janë ndër patologjitë më të shpeshta të zorrës së trashë, të gjetura në 15 - 40% të të rriturve, që variojnë nga të padëmshme në prekanceroze; kanceri i zorrës së trashë përbën afërsisht 7. 8% të të gjitha diagnozave të reja të kancerit në mbarë botën; polipet hiperplastike hasen në rreth 10% të personave gjatë kolonoskopive rutinë, konsiderohen jo kancerogjene.
Qëllimi: Evidentimi i patologjive të kolonit të zbuluara nga ekzaminimi rutinë përmes endoskopisë.
Materiale dhe metoda: Ky studim retrospektiv i referohet 260 pacientëve të referuar në njësi endoskopie të Spitalit Continental, të moshës 18 - 78 vjeç, të cilët përmbushën të gjitha kriteret e përfshirjes. Analiza e të dhënave u krye mbi karakteristikat endoskopike dhe histopatologjike të të gjitha lezioneve të zbuluara, duke përfshirë polipet e zorrës së trashë dhe lezionet neoplastike.
Rezultate: Bazuar në gjininë, ishin 133 femra dhe 127 meshkuj; grupmosha mesatare ishte 46. 03 (±16. 8). Gjakderdhja rektale ishte simptoma më e shpeshtë (40. 9%). 113 (15. 6%) u gjetën me polipe të zorrës së trashë dhe u zbuluan 11 raste (1. 52%) të kancerit kolorektal. Shumica e polipeve ishin të vendosura në zorrën e trashë descendente (67. 5%). Nuk kishte ndryshim statistikor në prevalencën e polipeve adenomatoze midis grupmoshës 40 - 49 vjeç dhe 50 - 59 vjeç (P = 0. 77). Ekzaminimi i detajuar i të dhënave duke përdorur analizën e kurbës së karakteristikave operative të marrësit (ROC) jo vetëm që tregoi se mosha është një faktor rreziku për praninë e polipeve të zorrës së trashë, por gjithashtu zbuloi moshën kufitare prej 42. 5 vjeç për praninë e të gjitha llojeve të polipeve të zorrës së trashë (44. 5 vjeç për polipet adenomatoze).
Përfundim: Ky studim ka treguar një prevalencë të ngjashme të polipeve në grupmoshën 40 - 49 vjeç krahasuar me grupmoshën 50 - 59 vjeç. Studimi ynë sugjeron që ekzaminimi i duhur i zorrës së trashë duhet të kryhet në një moshë më të re për të arritur zbulimin e hershëm të polipeve të zorrës së trashë.

Fjalë kyçe: Kolon, patologji, adult**.**

NDRYSHIMET HORMONALE GJATË PROCESIT TË PLAKJES.

Entela Puca[1, 2], Nerida Xhabija[2, 3], Sonila Bitri[2, 4], Dea Puca[5], Edmond Puca[6]
[1]*Shërbimi i Endokrinologjisë, Spitali Amerikan, Tiranë.*
[2]*Universiteti Western Balkan, Tiranë.*
[3]*Shërbimi i Kardiologjise, Spitali Amerikan, Tiranë.*
[4]*Shërbimi i Toxikologjise, Spitali Amerikan, Tiranë.*
[5]*Universiteti katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Tiranë.*
[6]*Shërbimi i Sëmundjeve Infektive, QSU, Tiranë.*

Abstrakt

Hyrje: Plakja është një proces kompleks biologjik që ndikon në të gjitha sistemet e organizmit, përfshirë dhe sistemin endokrin. Me kalimin e moshës, ndodh një ulje graduale e sekretimit hormonal, që shoqërohet me ndryshime në ndjeshmërinë e receptorëve, në ritmet cirkadiane dhe në mekanizmat e feedback - ut hormonal. Këto ndryshime kontribuojnë në prishjen e homeostazës metabolike, uljen e masës muskulore dhe rritjen e rrezikut për sëmundje kronike si diabeti, osteoporoza dhe sëmundjet kardiovaskulare.
Objektiva: Të analizohen mekanizmat fiziologjikë dhe ndryshimet kryesore hormonale që ndodhin gjatë procesit të plakjes, si dhe implikimet e tyre klinike në shëndetin e përgjithshëm të individit të moshuar.
Materiale dhe metoda: U krye një përmbledhje narrative e literaturës së viteve të fundit në bazat e të dhënave "PubMed, Scopus dhe Endocrine Reviews", me fokus në studime që trajtojnë ndryshimet në boshtet endokrine HPA, HPG, HPT dhe GH / IGF - 1, si dhe ndikimin e tyre metabolik e kognitiv.
Rezultate: Procesi i plakjes shoqërohet me: a) Aksin HPA: Aktivitet i shtuar bazal i kortizolit dhe zbehje e ritmit cirkadian, që kontribuojnë në stres kronik dhe rezistencë ndaj insulinës. b) Aksin HPG: Reduktim të estrogjenit dhe testosteronit, me pasoja në densitetin kockor, funksionin seksual dhe humorin. c) Aksin HPT: Rritje relative të TSH, që ngadalësojnë metabolizmin bazal. d) Aksin GH / IGF - 1: Ulje të sekrecionit, e lidhur me sarkopeni dhe rritje depozites dhjamore vecanerisht abdominale. e) Insulinë dhe leptinë: Rezistencë qelizore, që çon në obezitet visheral dhe sindromë metabolike.
Konkluzione: Ndryshimet hormonale gjatë plakjes përfaqësojnë një komponent thelbësor të plakjes fiziologjike. Kuptimi i këtyre proceseve është i domosdoshëm për zhvillimin e strategjive parandaluese dhe terapive të personalizuara që synojnë ruajtjen e ekuilibrit hormonal, forcës muskulore, densitetit kockor dhe mirëqenies kognitive tek të moshuarit.

Fjalë kyçe: Ndryshime hormonale, mekanizma fiziologjikë, plakje.

SFIDA E TRAJTIMIT TË NJË PACIENTI ME PEMFIGUS VULGARIS DHE KOMORBIDITETE.

Entela Shkodrani[1], Alert Xhaja[1], Gloria Hoxhallari[1], Silvan Frangaj[2], Valbona Duraj[1], Ermira Vasili[1].
[1]Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"
[2]Spitali Rajonal Shkodër

Abstrakt
Hyrje: Pemfigus vulgaris është një sëmundje autoimune kronike buloze që prek epitelin shumë - shtresor, e karakterizuar nga akantolizë suprabazale për shkak të autoantitrupave kundër desmogleinave. Menaxhimi i saj përbën një sfidë të veçantë, sidomos tek pacientët e moshuar me komorbiditete të shumta, për shkak të nevojës për terapi imunosupresive dhe rrezikut të lartë për komplikacione.
Paraqitja e rastit: Paraqesim rastin e një pacienteje 78 - vjeçare me histori të hipertensionit arterial, diabet mellitus, aksident vaskular cerebral, demencë të lidhur me sëmundjen e Parkinsonit dhe tromboemboli pulmonare. Në momentin e paraqitjes, pacientja kishte lezione të shumta vezikulo - buloze dhe erozione të krustëzuara në trung, gjymtyrë, skalp, fytyrë dhe mukozën orale, të shoqëruara me prurit të theksuar. Biopsia e lëkurës konfirmoi diagnozën e pemfigus vulgaris.
Trajtimi dhe ecuria: Pacientja u trajtua me kortikosteroide sistemike (prednisolon) të kombinuara me azatioprinë, si dhe terapi mbështetëse që përfshinte antibiotikë, antihistaminikë dhe trajtim lokal. Komorbiditetet u menaxhuan në bashkëpunim me specialistët përkatës. Gjatë qëndrimit spitalor u vu re përmirësim i ndjeshëm klinik. Pacientja u largua nga spitali me një skemë të reduktuar gradualisht të prednisolonit dhe mjekime të përshtatura për gjendjet e saj kronike.
Konkluzione: Rasti thekson rëndësinë e një qasjeje multidisiplinare në trajtimin e pemfigus vulgaris, sidomos tek pacientët e moshuar me komorbiditete komplekse. Menaxhimi i suksesshëm kërkon bashkëpunim të ngushtë ndërmjet disiplinave për të arritur kontroll efektiv të sëmundjes dhe për të minimizuar rreziqet që lidhen me terapinë imunosupresive dhe patologjitë bashkëshoqëruese.

Fjalë kyçe: pemfigus vulgaris, komorbiditet, menaxhim etj.

NODUL HEMORRAGJIK QË ZHVILLOHET MBI NJË CIKATRICE HIPERTROFIKE TEK NJË PACIENTE 23 - VJEÇARE: RAPORTIM RASTI.

Assoc. Prof. Entela Shkodrani[1], PhD Alert Xhaja[1], Assoc. Prof. Sokol Isaraj[2], Assoc. Prof. Leart Berdica[3], Assoc. Prof. Valbona Duraj[4], Barbara Shkodrani MD[5], Jola Ormenaj MD[1]
[1] Klinika e Dermatologjisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri
[2] Klinika e Djegieve dhe Kirurgjisë Plastike, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri
[3] Departamenti i Patologjisë, Spitali Amerikan, Tiranë, Shqipëri
[4] Njësia e Gjenetikës Mjekësore, Universiteti "Tor Vergata", Romë, Itali
[5] Klinika e Reumatologjisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt
Hyrje: Cikatrice hipertrofike është një problematike që karakterizohet nga depozitime të shtuara të kolagjenit, të cilat krijojnë një cikatrice të ngritur në vendin e dëmtimit. Cikatrica hipertrofike është rezultat i një mekanizmi të dëmtuar të procesit të shërimit të plagëve. Pavarësisht se ajo dhe keloidet shpesh përdoren në mënyrë të ndërsjellë, ato nuk janë e njëjta gjë. Në cikatricen hipertrofike, indi cikatricial kufizohet në vendin fillestar të dëmtimit, ndërsa në keloide, cikatrica mund të zgjerohet përtej kufijve të plagës fillestare. Cikatrica hipertrofike është një problem sinjifikativ, pasi dhimbja dhe kruajtja e vazhdueshme mund të shkaktojnë erozione, ulceracione si dhe një rezultat estetik të pakënaqshëm.
Raportim rasti: Ne paraqesim rastin e një pacienteje 23 - vjeçare e cila zhvilloi dy brazda të trasha cikatriceje hipertrofike në të dy regjionet inguinale, si pasojë e djegieve që rezultuan nga aplikimi i zgjatur i një kremi depilator. Një vit pas zhvillimit të cikatriceve, u vu re prania e një nodusi të kuq në regjionin inguinal të djathtë, që dilte nga një pjesë e ngritur dhe e butë e cikatrices. Sipas pacientes, ky nodus eritematoz u zhvillua si rezultat i kruarjes së përsëritur dhe dhimbjes që origjinonte nga cikatrica. U vëzhgua gjithashtu një erozion i vogël hemorragjik aty pranë. Në ekzaminimin dermoskopik u identifikuan enë gjaku me forma të ndryshme, përfshirë ato të shkurtra, të gjata, të degëzuara dhe të ndërprera. Diagnozat klinike të mundshme për këtë nodus përfshinin granulomën piogjene, nodul hipertrofik dhe cist epidermal inkluziv. U morën gjithashtu në konsideratë karcinoma me qeliza skuamoze dhe melanoma amelanotike. Pacientja u referua për ekcizion kirurgjikal, dhe vlerësimi histologjik zbuloi vetëm praninë e indit granulacioni të shtuar mbi cikatrice.
Përfundime: Qëllimi i paraqitjes së këtij rasti qëndron në faktin se, edhe pse një nodus mbi një cikatrice hipertrofike mund të përfaqësojë thjesht ind granulacioni i cili shpesh shfaqet i kuq, i ngritur dhe me tendencë për gjakosje të lehtë, ai mund të ngatërrohet me lezione më serioze. Vlerësimi klinik, dermoskopik dhe histologjik është i nevojshëm për ta diferencuar atë nga lezione të tjera beninje dhe malinje.

Fjalë kyçe: cikatrice hipertrofike, ulceracion, ind granulacioni.

SINDROMI I TUNELIT KARPAL NË PACIENTËT E HEMODIALIZËS.

Dr. Enxhi Rusta, Prof. Asc. Erjola Likaj, Prof. Alma Idrizi, Prof. Asc. Arjana Strakosha
Departamenti i Nefrologjisë - Dializë – Transplantit Renal, QSUT Tiranë.

Abstrakt
Hyrje: Sindroma e Tunelit Karpal është një nga ndërlikimet më të zakonshme që zhvillohet tek pacientët nën trajtim afatgjatë me hemodializë. Shkaku kryesor i sindromit të tunelit karpal tek pacientët që i nënshtrohen hemodializës afatgjatë është depozitimi i amiloidit β2 - mikroglobulinë në tunelin karpal, i cili kompreson nervin median. Kjo është një formë e amiloidozës së lidhur me dializën.
Metodologjia: Ky studim përfshiu 40 pacientë kronikë aktual nën trajtim me hemodializë në departamentin e dializës, QSUT "Nënë Tereza". Pacientët e konfirmuar me Sindromin e Tunelit Karpal u studiuan në varësi të kohëzgjatjes së trajtimit nën hemodializë, pranisë së antitrupave anti - HCV, llojin e aksesit vaskular dhe procedurës së trajtimit.
Rezultate: Sindroma e Tunelit Karpal u diagnostikua në pesë nga dyzet pacientë nën trajtim kronik me hemodializë. Diagnoza u bazua në shenjat klinike dhe simptomat fizike, të tilla si mpirje, ndjesi shpuese në dorë dhe gishta, dhimbje nate në shpërndarjen e nervit median, testet stimuluese pozitive, veçanërisht "shenja Tinel"; dhe u konfirmua me anë të testeve të përçueshmërisë nervore dhe testit diagnostik elektrofiziologjik siç është Elektroneurografia (ENG). Këta pacientë realizojnë seancat e hemodializës 3 herë në javë, duke përdorur fistul arteriovenoze të krahut, për rreth 4 orë çdo seancë. Të pestë pacientët e konfirmuar me këtë diagnozë janë

trajtuar për një periudhë të gjatë kohe nën hemodializë, konkretisht për më shumë se 10 vjet secili prej tyre. Tre nga pacientët u raportuan të ishin anti - HCV - pozitivë. Trajtimi fillestar, siç është mobilizimi i kyçit të dorës, shmangia e aktiviteteve që përkeqësojnë simptomat, u raportua të jetë më pak efektiv tek këta pacientë të hemodializës, gjendja e të cilëve nxitet nga depozitimi progresiv i amiloidit. Kirurgjia e lirimit të tunelit karpal është parë të jetë trajtimi përfundimtar dhe më efektiv për Sindromën e Tunelit Karpal të avancuar në pacientët e hemodializës. Pacientët e konfirmuar me sindromën e tunelit karpal të gradës IV - V në testin e elektroneurografisë (ENG), të cilët I janë nënshtruar procedurës kirurgjikale të tunelit karpal, raportuan se ndjenë lehtësim efektiv dhe të shpejtë të simptomave.
Përfundim: Sindroma e Tunelit Karpal është një ndërlikim i zakonshëm i terapisë afatgjatë nën hemodializë. Kohëzgjatja e terapisë së dializës është një faktor rreziku statistikisht i rëndësishëm në zhvillimin e kësaj sindrome. Sindroma e Tunelit Karpal ndodh dukshëm më shpesh tek pacientët anti - HCV pozitivë, gjë që mund të lidhet me periudhën më të gjatë kohore nën terapi me hemodializë. Incidenca shihet gjithashtu të varet nga vendndodhja e fistulës arterio - venoze, duke kontribuar në zhvillimin e saj përmes hipertensionit venoz dhe zhvendosjes së likideve që mund të kompresojnë nervin median. Procedura kirurgjikale e lirimit të tunelit karpal është metoda më efektive e trajtimit të kësaj sindrome.

Fjalë kyçe: pemfigus vulgaris, komorbiditet, menaxhim.

NJOHJA DHE MENAXHIMI I HERSHËM I PUBERTETIT PREKOKS: PERSPEKTIVA PEDIATRIKE.

Dr. Era Kurti[1]; Dr. Jon Cane[2]
[1]*Mjeke pediatre endokinologe, Qëndra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë*
[2]*Mjek obstetër - gjinekolog, Spitali Rajonal Lezhë, Lezhë*

Abstrakt
Hyrje: Puberteti i parakohshëm, i përcaktuar si shfaqja e karakteristikave sekondare seksuale para moshës 8 vjeç te vajzat dhe 9 vjeç te djemtë, po vërehet gjithnjë e më shpesh në popullatën pediatrike. Aktivizimi i hershëm i boshtit hipotalamo–hipofizo– gonadal mund të jetë idiopatik ose pasojë e lezioneve të sistemit nervor qendror, faktorëve gjenetikë apo ekspozimit ndaj preparateve që prishin ekuilibrin hormonal. Obeziteti dhe stresi psikosocial gjatë fëmijërisë janë gjithashtu faktorë kontribues.
Qëllimi: Të paraqitet një përmbledhje e të dhënave aktuale, strategjive diagnostike dhe qasjeve terapeutike për pubertetin e parakohshëm, duke theksuar rolin qendror të pediatrit në identifikimin e hershëm dhe kujdesin gjithëpërfshirës.
Metoda: U krye një rishikim i plotë i literaturës dhe udhëzimeve klinike, me fokus në algoritmet diagnostike, vlerësimet hormonale, teknikat imazherike dhe rezultatet e trajtimit te fëmijët me pubertet të parakohshëm qendror ose periferik.
Rezultate: Fëmijët me pubertet të parakohshëm zakonisht paraqiten me rritje të përshpejtuar, moshë të avancuar kockore dhe maturim të hershëm seksual. Vlerësimi diagnostik përfshin matjen bazale dhe të stimuluar të gonadotropinave, nivelet e hormoneve seksuale dhe rezonancën magnetike të trurit për të përjashtuar shkaqet organike. Puberteti qendror i parakohshëm trajtohet me sukses me analoge të hormonit çlirues të gonadotropinës (GnRH), që ndalon aktivizimin hormonal të hershëm të aksit dhe ndihmon në pëmirësimin e vlerave të gjatësisë definitive. Mbështetja psikosociale është pjesë thelbësore e menaxhimit të pubertetit të parakohshëm.
Përfundime: Njohja dhe ndërhyrja e hershme janë thelbësore për të parandaluar problemet me rritjen dhe ato psikologjike. Pediatri luan rol kryesor në identifikimin e hershëm të shenjave, koordinimin e vlerësimeve endokrinologjike dhe mbështetjen e vazhdueshme të fëmijëve dhe familjeve. Bashkëpunimi multidisiplinar përmirëson rezultatet e parametrave te ekzaminimit fizik dhe ato emocionale tek fëmijët.

Fjalë kyçe: Puberteti prekoks, endokrinologji pediatrike, terapi me GnRH, zhvillim i hershëm, ndikim psikosocial.

INDIKACIONET E RADIOTERAPISË NË MASTECTOMI POST - KIMIOTERAPI NEOADJUVANTE. RISHIKIM LITERATURE.

Erald Karaulli
Shërbimi Onkologjik, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"

Abstrakt

Hyrje: Radioterapia pas mastectomisë (PMRT) ul recurrencën lokale dhe përmirëson mbijetesën tek pacientët me tumor primar mbi 5 cm dhe limofonoduj pozitiv. Kimioterapia neoadjuvante (NAC) është një trajtim standart në kancerin e gjirit, vecanërisht në rastet me biologji agresive. Për shkak se NAC mund të zvogëloj stadin e sëmundjes, indikacionet për PMRT tek pacientët që kanë kryer NAC janë të diskutueshme dhe duhen marrë në konsideratë stadi i sëmundjes në fillim, përgjigjia patologjike dhe biomarkerat.

Metoda: Në këtë vëzhgim të literaturës, janë vlerësuar disa studime kohort - retrospektive. Të gjithë pacientët janë trajtuar me NAC me apo pa PMRT. Në këtë studim janë analizuar dhe vlerësuar të dhënat të cilat rekomandojnë PMRT pas NAC tek pacientët cT3 - 4, cN+, limfonoduj rezidual pozitiv si dhe mundësinë e mos kryerjes së PMRT në pacientët me përgjigje patologjike komplete dhe cT1 - 2N0 - 1 në momentin e diagnostikimit.

Rezultate: Të gjitha studimet e përfshira në këtë vëzhgim të literaturës e kanë vlerësuar PMRT pas NAC si një variabël të vetëm. PMRT përmirëson si mbijetesën ashtu edhe recurrencën lokale vecanërisht tek pacientët me sëmundje të avancuar në diagnozë dhe tek ato me biologji agresive të sëmundjes.

Konkluzione: PMRT është trajtim shumë i rëndësishëm sidomos tek pacientët me risk "të moderuar - të lartë", tumor primar të avancuar dhe limfonoduj pozitiv. Në pacientët cT1 - 2N0 - 1 në momentin e diagnozës dhe me përgjigje patologjike komplete PMRT mund të përjashtohet si modalitet trajtimi.

Fjalë kyçe: mastectomi, kimioterapi, NAC, PMRT.

APLIKIMET E NANOTEKNOLOGJISË NË MJEKËSI ME FOKUS NË IMAZHERINË DIAGNOSTIKE.

Erald Vasili[2], Durim Cela[2], Adriana Babameto[3], Liri Cuko[3]
Spitali GVM, Departamenti Imazherisë.
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Shërbimi i Imazherisë.
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Shërbimi i Gastro - Hepatologjisë.

Abstrakt

Hyrje: Nanoteknologjia është shfaqur si një qasje transformuese në mjekësi, me zbatime të gjera në diagnostikë dhe terapi. Në imazherinë diagnostikuese, ajo ka rritur ndjeshëm saktësinë, ndjeshmërinë dhe specifikën në zbulimin e sëmundjeve, duke tejkaluar modalitetet tradicionale të imazherisë. Nanopjesëzat, të tilla si nanopjesëzat magnetike dhe të arit, kanë kontribuar në përmirësimin e rezolucionit dhe kontrastit, duke mundësuar diagnoza më të hershme dhe më të sakta, siç është përdorimi i nanopjesëzave superparamagnetike të hekurit në zbulimin e tumoreve në fazat e hershme. Pavarësisht premtimit të saj, zbatimi klinik i nanoteknologjisë përballet me sfida të rëndësishme, duke përfshirë kostot e larta, mungesën e kornizave rregullatore të standardizuara për përdorimin e saj (të tilla si udhëzimet për vlerësimin pasues) dhe shqetësimet në lidhje me sigurinë afatgjatë të nanopjesëzave. Adresimi i këtyre çështjeve kërkon kërkime të mëtejshme për të siguruar integrimin e saj të sigurt dhe efektiv në mjediset klinike. Është e dobishme të hedhim një vështrim mbi rolin e nanoteknologjisë në imazherinë diagnostikuese, duke u përqendruar në zbatimet e saj në përmirësimin e teknikave të tilla si imazheria me rezonancë magnetike, tomografia e kompjuterizuar dhe ultratingulli dhe në të njëjtën kohë të njihemi me sfidat aktuale dhe drejtimet e ardhshme, duke theksuar nevojën për kërkime të vazhdueshme për të realizuar plotësisht potencialin e nanoteknologjisë në praktikën klinike.

Fjalë Kyçe: nanoteknologji, imazheri, diagnostikë etj.

RAPORTIM RASTI: INFLAMACIONI KORNEAL NË RASTET E KONTAKTIT ME BIMËN EUFORBIA SAP.

Eralda Leci

Abstrakt

Hyrje: Kontakti me lëngun (latex - in) e bimëve të gjinisë Euphorbia, veçanërisht Euphorbia Sap, është i njohur për efektet toksike që mund të shkaktojë në lëkurë dhe mukozë. Lëngu i saj përmban komponime irrituese dhe kimikate që mund të shkaktojnë reaksione akute inflamatore, përfshirë edhe sistemin okular. Ekspozimi ndaj syve përbën një urgjencë oftalmologjike që mund të shoqërohet me dëmtime korneale serioze. Në këtë punim paraqitet një rast klinik i inflamacionit korneal pas kontaktit me Euphorbia Sap, me qëllim ndërgjegjësimin mbi pasojat okulare të kontaktit me këtë bimë dhe rëndësinë e ndërhyrjes së menjëhershme terapeutike.

Qëllimi: Të paraqes një rast klinik të ecurisë së inflamacionit korneal të shkaktuar nga kontakti me bimën Euforbia Sap, që gjendet në fusha dhe kultivohet në kopshte për dekorim.

Metodologjia: Ky është një raport rast klinik. Pacientja u paraqit me shenja të combustio chimica në syrin e djathtë, të shkaktuara nga kontakti me latex - in e bimës Euphorbia. U krye ekzaminim klinik i plotë përmes biomikroskopisë, vlerësim i gjendjes së përparmë të segmentit të syrit dhe dokumentim i shenjave klinike (injeksion ciliar, edemë korneale, fotofobi, epiforë). Trajtimi u iniciua menjëherë me lavazh të bollshëm të syrit, pasuar nga terapia intensive lokale dhe sistemike anti - inflamatore dhe antibiotike. U krye ndjekje spitalore dhe më pas ambulatorë për një periudhë 3 - javore. Ecuria u krahasua me raste të ngjashme të raportuara në literaturën bashkëkohore.

Rezultate dhe përfundime: Pavarësisht ndërhyrjes së menjëhershme, pacientja shfaqi inflamacion të theksuar korneal, me ecuri relativisht të zgjatur dhe shenja të irritimit kronik. Ky rast thekson se kontaktet me Euphorbia Sap mund të shkaktojnë dëmtime serioze okulare me rrjedhë të zgjatur klinike. Ndërhyrja e hershme, edukimi mbi rreziqet e bimëve toksike dhe përfshirja e menjëhershme e specialistëve oftalmologë janë kyçe për minimizimin e dëmtimeve afatgjata.

Fjalë kyçe: Inflamacion korneal, Euphorbia Sap, djegie kimike okulare, biomikroskopi, rast klinik.

DIAGNOZA DHE MANIFESTIMET KLINIKE TË ALERGJISË NDAJ NSLTP: NDËRVEPRIMI MIDIS FAKTORËVE TË RREZIKUT DHE KO - FAKTORËVE.

Eralda Lekli[1, 2] Mehmet Hoxha[1, 3]

1. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri

2. Spitali Salus Tirana, Shqipëri

3. Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"

Abstrakt

Hyrje: Proteinat transportuese të lipideve jo - specifike (nsLTP) janë identifikuar si panalergjenë bimore me rëndësi klinike, sensibilizimi ndaj të cilave mund të manifestohet në një spektër të gjerë të sëmundjeve alergjike, që nga simptomat e lehta orale deri te anafilaksia kërcënuese për jetën. Përfundimi klinik i një individi varet jo vetëm nga modeli i sensibilizimit molekular, por edhe nga një kontekst më i gjerë i faktorëve të rrezikut (si ekspozimi gjeografik, polisensibilizimi, predispozita imunitare) dhe ko - faktorëve (si ushtrimi fizik, përdorimi i NSAIDs, alkooli, infeksionet) që ndikojnë në pragun dhe ashpërsinë e reagimit.

Metodat: U krye një kërkim në literaturë në databazat PubMed dhe Google Scholar. Fjalët kyçe të përdorura për të identifikuar botime relevante përfshinin: "alergjia ndaj nsLTP", "manifestimet klinike", "diagnoza e nsLTP", "faktorët e rrezikut", "ko - faktorët", "Pru p 3" dhe "Can s 3". Të dhënat u nxorën dhe u sintetizuan për të nxjerrë në pah ndërveprimin midis sensibilizimit, ko - faktorëve, diagnozës dhe rezultateve klinike.

Rezultate: Të dhënat e reja tregojnë për një rritje të alergjisë ndaj nsLTP në vendet e Europës Veriore dhe një shtim të sensibilizimit tek fëmijët, shpesh i pavarur nga alergjia ndaj polenit, ndryshe nga përgjigjet e ndërmjetësuara nga PR - 10 apo profilina. Reagimet klinike shpesh janë sistemike dhe të rënda, veçanërisht te personat që nuk kanë polinozë ndaj betules. Pru p 3, alergjeni kryesor i pjeshkës, është sensibilizuesi fillestar më i zakonshëm, që nxit reagime të kryqëzuara ndaj nsLTP - ve të tjera nga bimë të ndryshme, përfshirë familjen Rosaceae, arrat dhe drithërat si gruri, misri dhe orizi. Inhalimi i Can s 3 nga Cannabis sativa është identifikuar së fundmi si një rrugë alternative sensibilizimi, duke theksuar një mekanizëm të ri për këtë sindromë. Diagnoza mbetet sfiduese, pasi jo të gjithë pacientët me alergji ndaj nsLTP reagojnë ndaj ekstrakteve të pjeshkës që

përmbajnë Pru p 3; megjithatë, diagnostikimi i bazuar në komponentë molekular (CRD), është më i saktë sesa prick testet, dhe Testi i Aktivizimit të Bazofileve mund të ndihmojë në dallimin midis sensibilizimit të thjeshtë dhe alergjisë klinike të mirëfilltë. Prognoza është e ndryshueshme, por pacientët monosensibilizuar ndaj nsLTP kanë rrezik më të lartë për reagime të rënda. Menaxhimi përfshin shmangien e ushqimeve përkatëse, përdorimin e adrenalinës në raste urgjente dhe, në raste të zgjedhura, imunoterapi nën gjuhë me Pru p 3, e cila ka treguar premtime në desensibilizim.
Përfundime: Alergjia ndaj nsLTP është një sindromë alergjike në rritje, potencialisht e rëndë, që kërkon përmirësim në diagnozë dhe menaxhim. Ndërgjegjësimi më i madh klinik dhe përdorimi i diagnostikimit të avancuar janë thelbësore për identifikimin e pacientëve me rrezik të lartë dhe udhëheqjen e trajtimit efektiv.

Fjalë kyçe: Alergjia ndaj nsLTP, diagnoza, manifestimet klinike, risk faktorët, ko - faktorët.

ZBULIME TË REJA NË KARDIOLOGJI: MEDIKAMENTE, DIETA, INTELIGJENCA ARTIFICIALE DHE QASJE INOVATIVE NË PARANDALIMIN DHE TRAJTIMIN E SËMUNDJEVE TË ZEMRËS.
Dr. Eranda Muja, Dr. Ermal Muja

Abstrakt
Hyrje: Sëmundjet kardiovaskulare përfaqësojnë shkakun kryesor të vdekshmërisë globale, me mbi 17 milionë vdekje çdo vit. Përparimet e fundit të prezantuara në Kongresin e Shoqatës Evropiane të Kardiologjisë (ESC) 2025 në Madrid kanë sjellë zbulime me ndikim të rëndësishëm klinik.
Qëllimi: Ky punim shqyrton zbulimet më të fundit në kardiologji dhe aplikimin e këtyre zbulimeve në parandalimin dhe trajtimin sëmundjeve të zemrës.
Metodologjia: Ky punim bazohet në një analizë të literaturës së fundit nga databaza PubMed, Scopus dhe ESC Journals (2015–2025). Të dhënat e prezantuara në ESC Congress 2025 janë integruar me provat klinike të nivelit A (randomized controlled trials), meta - analizat dhe udhëzimet klinike të ESC / AHA.
Rezultate dhe përfundime: Medikamentet e reja si baxdrostat ofrojnë një opsion të fuqishëm për trajtimin e hipertensionit rezistent, ndërsa clopidogrel ka treguar efikasitet më të lartë sesa aspirina në parandalimin sekondar të ngjarjeve trombotike. Po ashtu, agonistët GLP - 1 dhe inhibitorët SGLT2 kanë reduktuar ndjeshëm rrezikun për insuficiencë kardiake. Në aspektin e stilit të jetesës, një dietë e pasur me kalium ka treguar ulje të incidencës së hipertensionit dhe ngjarjeve kardiovaskulare. Inovacionet teknologjike përfshijnë stetoskopin e pajisur me inteligjencë artificiale, i cili mundëson diagnostikim brenda sekondash me ndjeshmëri të lartë. Gjithashtu, testet gjenetike jo - invazive për arrhythmogenic cardiomyopathy tek fëmijët mundësojnë diagnozë të hershme dhe parandalim të vdekjeve të papritura. Vaksinat, veçanërisht ajo kundër herpes zoster, janë shfaqur si një strategji parandaluese për reduktimin e infarktit dhe goditjes cerebrale. Këto zhvillime sugjerojnë një paradigmë të re në menaxhimin e sëmundjeve të zemrës, me implikime të gjera klinike dhe politike shëndetësore.

Fjalë kyçe: hipertension, baxdrostat, clopidogrel, inteligjenca artificiale, dietë me kalium, arrhythmogenic cardiomyopathy, vaksinë, sëmundje kardiovaskulare.

ROLI I BIOPSISË SË LËNGSHME NË DIAGNOSTIKIMIN DHE MENAXHIMIN E KANCERIT TË MUSHKËRIVE.
Erblin Jashari MD

Abstrakt
Hyrje: Kanceri i mushkërive është një nga shkaqet kryesore të vdekjeve nga kanceri në mbarë botën, shpesh i diagnostikuar në faza të avancuara. Biopsia tradicionale e indeve, megjithëse është standardi aktual për diagnostikim dhe përcaktim të terapisë, është metodë invazive dhe nuk ofron gjithmonë pasqyrimin e plotë të heterogjenitetit tumoral. Për këtë arsye, është rritur interesi për biopsinë e lëngshme, e cila lejon analizimin e biomarkerëve qarkullues si ADN tumoral (ctDNA), qeliza tumorale qarkulluese (CTCs), ekzosome, miRNA dhe trombocite të edukuar nga tumori (TEPs).

Qëllimi i punimit: Ky punim synon të paraqesë një përmbledhje të mekanizmave biologjikë mbi të cilët bazohet biopsia e lëngshme, aplikimet e saj klinike në diagnostikim, prognozë dhe monitorim të trajtimit tek pacientët me kancer të mushkërive, si dhe avantazhet dhe sfidat që lidhen me implementimin e saj në praktikën klinike.
Materiale dhe metodologjia: Për përgatitjen e kësaj teme janë shfrytëzuar punimet shkencore të botuara në revista shkencore dhe të pranishme në PubMed. Punimet e përdorura shkencore janë burim i të dhënave reprezentative dhe punime të kohëve të fundit.
Përfundime: Biopsia e lëngshme është një metodë jo - invazive, e përsëritshme dhe potencialisht më e ndjeshme për të pasqyruar heterogjenitetin tumoral dhe për të monitoruar përgjigjen ndaj terapisë. Ajo ofron mundësi të reja për diagnostikim të hershëm, personalizim të trajtimit dhe prognozë më të saktë. Megjithatë, përfshirja e saj në praktikën rutinë klinike kërkon standardizim të metodave, ulje të kostove, validim të mëtejshëm klinik dhe bashkëpunim ndërdisiplinar për ta integruar atë si një mjet të besueshëm në menaxhimin e kancerit të mushkërive.

Fjalë kyçe: kanceri i mushkërive, biopsia e lëngshme.

INFEKSIONET DUALE TË SISTEMIT NERVOR QENDROR(SNQ) NË KLINIKËN PËR SËMUNDJE INFEKTIVE.

Erblina Krasniqi

Abstrakt
Hyrje: Infeksionet duale të sistemit nervor qendror (SNQ) janë raste klinike komplekse ku dy ose më shumë patogjenë – si bakteret, viruset, kërpudhat, apo patogjenët tjerë – infektojnë njëkohësisht trurin, palcën kurrizore ose strukturat mbrojtëse të tyre. Këto bashkë - infeksione çojnë në prezantime klinike të shumëllojshme dhe të papritura, duke sfiduar mjekët në procesin e diagnostikimit. Vështirësia diagnostikuese rritet për shkak të përplasjes së simptomave dhe parametrave laboratorike që shpesh përshkruajnë një entitet të rrallë, por me pasoja të rënda terapeutike.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është që përmes rishikimit të literatures dhe analizës së tre rasteve klinike specifike të diagnostifikuara dhe mjekuar në Klinikën Infektive në Prishtinë të eksplorojë fenomenin e infeksioneve duale të sistemit nervor qendror (SNQ).
Materiali dhe Metodologjia: Ky hulumtim është një analizë retrospektive e tre rasteve të infeksioneve duale të SNQ të trajtuara në Klinikën Infektive të QKUK - së gjatë periudhës 2023 - 2025. Përveç kësaj, është kryer një rishikim i literaturës nga databaza Pubmed, për studimet rreth infeksioneve duale te SNQ. Gjithsej jane analizuar 21 studime ne Pubmed nga viti 1980 - 2024.
Rezultate: Analiza e rasteve klinike tregon një variacion në paraqitjen simptomatike dhe në rezultatet laboratorike. Shfaqet një bashkëinfeksion bakterial dhe viral, ku parametrat e lëngut cerebrospinal evidentojnë prani të patogjenëve specifikë si Streptococcus pneumoniae, Acinetobacter baumannii, Epstein - Barr virus, dhe Enterovirus. Gjithashtu, analizat imazherike kanë zbuluar lezione të shumta inflamatore dhe përkeqësime që kërkojnë ndërhyrje terapike të shpejtë. Krahasimi me studimet ndërkombëtare evidenton se, megjithëse infeksionet duale janë të rralla, sfidat diagnostikuese dhe terapeutike janë të përbashkëta, me dallime që lidhen me faktorët epidemiologjikë dhe demografikë lokalë.
Përfundime: Punimi thekson rëndësinë e diagnostikimit të hershëm dhe të saktë në menaxhimin e infeksioneve duale të SNQ. Integrimi i metodave laboratorike të avancuara, si PCR e LTSH, është thelbësor për diagnostifikimin e infeksioneve duale. Rezultatet sugjerojnë se një qasje multidisiplinare, që përfshin bashkëpunimin ndërmjet 7 infektologëve, neurologëve dhe specialistëve të kujdesit intensiv, mund të përmirësojë rezultatet klinike dhe të ulet rreziku i komplikacioneve neurologjike. Krahasimi me literaturën ndërkombëtare gjithashtu thekson nevojën për studime të mëtejshme për të zbuluar faktorët predispozues dhe për të zhvilluar strategji terapeutike të reja, të përshtatura me kontekstin lokal.

Fjalë kyçe: infeksione duale të SNQ, Sistemi Nervor Qendror, Ko - infeksione bakteriale - virale, lëngu cerebrospinal, PCR, acid laktik, presepsina, imazheria diagnostikuese, qasje multidisiplinare, komplikime neurologjike, sëmundje infektive, Kosovë.

SFIDAT DIAGNOSTIKE DHE TERAPEUTIKE NË HIPERTENSIONIN ENDOKRIN.

Ergita Nelaj
Shërbimi i Mjekësisë Interne & HTA,
Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë
QSU "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Hyrje: Hipertensioni arterial është një problem global i shëndetit publik, me prevalencë në rritje dhe pasoja të rënda kardiovaskulare e renale. Megjithëse pjesa më e madhe e rasteve janë esenciale, rreth 5–15% i atribuohen shkaqeve sekondare, kryesisht endokrine. Format më të zakonshme përfshijnë hiperaldosteronizmin primar, feokromocitomën, sindromën Cushing dhe çrregullimet tiroide / paratiroide. Njohja e hershme e hipertensionit endokrin është thelbëeore, pasi shpesh ofron mundësi për trajtim definitiv.
Qëllimi: është të paraqitet një përmbledhje e të dhënave më të fundit mbi hipertensionin endokrin, me theks në mekanizmat fiziopatologjikë, tiparet klinike dhe strategjitë aktuale diagnostike e terapeutike.
Metodologji: U realizua një rishikim i literaturës ndërkombëtare të publikuar gjatë 5 viteve të fundit në bazat e të dhënave PubMed dhe Scopus, me fjalë kyç "endocrine hypertension", "primary aldosteronism", "pheochromocytoma", "Cushing's syndrome", "thyroid disorders". Artikujt përfshinin studime klinike, udhëzime dhe metaanaliza, si dhe udhërrëfyesit përkatës.
Rezultate: Të dhënat tregojnë se hiperaldosteronizmi primar është shkaku më i shpeshtë i hipertensionit endokrin dhe lidhet me risk më të lartë kardiovaskular sesa hipertensioni esencial me të njëjtin nivel presioni arterial. Feokromocitoma, megjithëse e rrallë, mbetet shkaku më i rrezikshëm për komplikacione akute. Sindroma Cushing dhe çrregullimet tiroide / paratiroide përbëjnë një spektër më heterogjen, por me impakt të qartë mbi presionin arterial. Zbatimi i protokolleve moderne diagnostike (matja e raporteve hormonale, testet dinamike, imazheria e avancuar) ka rritur ndjeshëm shkallën e diagnostikimit.
Përfundime: Hipertensioni endokrin është një komponent i rëndësishëm, shpesh i nënvlerësuar, i hipertensionit sekondar. Përmirësimi i njohurive, sensibilizimi i klinicistëve dhe aplikimi i strategjive diagnostike të standardizuara janë thelbësore për të mundësuar trajtim efektiv, shpesh kurativ, dhe reduktim të rrezikut afatgjatë kardiovaskular.

Fjalë kyçe: hipertensioni endokrin, hiperaldosteronizëm primar, feokromocitomë, sindroma Cushing, diagnozë.

REHABILITIMI I DHIMBJES KRONIKE TË MESIT TEK FUTBOLLISTËT NËPËRMJET TRAJNIMIT TË CORE - IT.

Ergys Rexha
Doktorant Universiteti Sporteve Tiranë, Albanian University

Abstrakt
Hyrje: Dhimbja kronike e mesit (CLBP) është një patologji e shpeshtë tek futbollistët, shpesh e shkaktuar nga stresi i përsëritur, qëndrimi i gabuar dhe disbalancat muskulore. Strategjitë efektive të rehabilitimit janë thelbësore për rikthimin e funksionit, reduktimin e dhimbjes dhe parandalimin e ri - dëmtimeve. Menaxhimi i dhimbjes kronike të mesit (CLBP) shpesh është multidisiplinar dhe përfshin një kombinim të fizioterapisë instrumentale dhe ushtrimeve terapeutike Trajnimi i stabilitetit të core - it ka treguar se përmirëson stabilitetin e trungut, kontrollin neuromuskular dhe balancën e muskujve të kolonës vertebrale.
Qëllimi: Ky studim synon të vlerësojë efektivitetin e kombinimit të fizioterapisë instrumentale me ushtrimet e stabilitetit të core - it në reduktimin e dhimbjes dhe përmirësimin e kapacitetit funksional tek futbollistët me CLBP.
Metoda: Ky studim u zhvillua në klinikën e fizioterapisë Fast Recovery gjatë periudhës Janar - Korrik 2025. Pjesëmarrës ishin futbollistë profesionistë të diagnostikuar me lumbago kronike dhe të cilëve mjeku ortoped u kishte përshkruar fizioterapi instrumentale për një periudhë dy javore. Ata u ndanë në dy grupe: Grupi A perdori vetëm fizioterapinë instrumentale të përshkruar, ndërsa Grupi B përveç saj kreu edhe një program gjashtë - javor të ushtrimeve të stabilitetit të core - it, tre herë në javë. Intensiteti i dhimbjes, performanca funksionale, stabiliteti i trungut dhe ekuilibri dinamik u vlerësuan para dhe pas ndërhyrjes duke përdorur teste klinike dhe biomekanike të standardizuara.

Rezultate: Lojtarët e Grupit B, të cilët përveç fizioterapisë kryen edhe ushtrime të stabilitetit të core - it, treguan reduktime më të mëdha të dhimbjes dhe përmirësime më të dukshme të ekuilibrit dinamik dhe kapacitetit funksional krahasuar me Grupin A. Ndërhyrja rezultoi efektive në rritjen e stabilitetit të trungut dhe në uljen e kohës së aktivizimit të muskujve stabilizues, duke kontribuar në rezultate më të mira rehabilituese. U vu re gjithashtu përmirësim i koordinimit neuromuskular dhe kontrollit postural, duke treguar ndikimin pozitiv të ushtrimeve specifike të core - it në rikuperimin funksional.
Konkluzione: Trajnimi i core - it përfaqëson një strategji efektive rehabilitimi për futbollistët që vuajnë nga dhimbja kronike e mesit. Integrimi i tij në protokollet e rehabilitimit mund të nxisë rikuperim më të shpejtë, të përmirësojë performancën sportive, përmirësimin funksional krahasuar vetem me përdorimin e fizioterapisë. dhe të reduktojë rrezikun e ri - dëmtimeve. Rekomandohet kërkim i mëtejshëm për të optimizuar protokollet e trajnimit dhe për të hetuar rezultatet afatgjata.

Fjalë kyçe: Core training, fizioterapi, posture, parandalim, rehabilitim, stabilitet.

OBEZITETI SI FAKTOR RREZIKU PËR INFERTILITETIN: PERSPEKTIVA NGA STUDIMET E FUNDIT.

Dr. Erina Caka [1], Dr. Vlera Haxhishabani [1], Dr. Violeta Binishi [2], Dr. Teuta Stavileci [2]
[1] QKMF Gjakovë, Doktor i Mjekësisë
[2] Spitali Rajonal Gjakovë, Reparti i Gjinekologjisë dhe Obstetrikës

Abstrakt
Hyrje: Infertiliteti përkufizohet si pamundësi për të arritur nje shtatzëni pas 12 muajsh marrëdhënie të rregullt pa mbrojtje dhe prek rreth 15 % të çifteve në botë. Obeziteti është një nga faktorët e modifikueshëm kryesorë që kontribon në këtë problem dhe ka marrë përmasa epidemike globale.
Qëllimi: Ky rikshikim i literaturës ka per qellim te paraqesë nderlidhjen mes obezitetit dhe infertilitetit dhe metodatterapeutike te disponueshme. Poashtu ka perqëllim të ofroje njohuri të cilat ndihmojnë në përmiresimin e shendetit dhe reduktimin e obezitetit në popullate.
Metodologjia: Ky rishkrim i literaturës u mbështet kryesisht ne literaturë egzistuese duke u bazuar në studimet më të fundit që trajtojnë lidhjen midis obezitetit dhe infertilitetit. Informatat jane shqyrtuar nga të dhënat e publikuara kryesisht në PubMed, MEDLINE, Scopus dhe Google Scholar. Janë përfshirë studimet origjinale, rishikimet sistematike dhe metaanalizat që ofrojnë të dhëna mbi mekanizmat biologjikë, evidencën klinike dhe ndërhyrjet terapeutike.
Rezultate: Nga pikëpamja klinike, literatura tregon qartë se edhe nivelet e moderuara të mbipeshës mund të rrisin rrezikun për infertilitet, ndërsa obeziteti i rëndë përkeqëson dukshëm rezultatet e trajtimeve të riprodhimit të asistuar (IVF). Ky fakt nënvizon rëndësinë e identifikimit dhe trajtimit të hershëm të obezitetit në çiftet që kërkojnë ndihmë për konceptim. Ndërhyrjet që synojnë humbjen e peshës kanë treguar efekte pozitive në normalizimin e funksionit riprodhues. Ndryshimet në stilin e jetes mbeten zgjidhje e parë, por në raste të obezitetit morbid, kirurgjia bariatrike ofron përmirësime me të dukshme. Megjithatë, këto rezultate kërkojnë mbështetje afatgjate.
Përfundime: Nga një këndvështrim klinik, trajtimi i obezitetit duhet të jetë një komponent kyç i menaxhimit të infertilitetit. Këshillimet e vazhdueshme për aspektin e stilit të jetës, monitorimit metabolik dhe ndërhyrjeve terapeutike jo vetëm që rrit potencialin e suksesit riprodhues, por kontribon edhe në përmirësimin e shëndetit të përgjithshëm. Në këtë rast mund të vijnë në ndihmë mjekë të riprodhimit, endokrinologë, nutricionistë dhe psikologë dhe kjo paraqet strategjinë më të efektshme për reduktimin e ndikimit të obezitetit në fertilitet.

Fjalë kyçe: Obeziteti, infertiliteti, patofiziologjia, infertiliteti mashkullor, infertiliteti femëror, trajtimi, kirurgjia bariatrike.

EFEKTET ANËSORE AFATSHKURTRA TË VAKSINAVE NDAJ COVID - 19 NË POPULLATËN SHQIPTARE.

Erina Lazri[1], Adriatik Gabrani[1, 2]
[1]Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
[2]Shërbimi i Reumatologjisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"

Abstrakt

Hyrje: Efektet anësore të vaksinave përbëjnë një shqetësim real në popullatë. Studimi ynë i realizuar në popullatën shqiptare evidenton efektet anësore afatshkurtra të vaksinave ndaj COVID - 19 dhe faktorët që ndikojnë në intensitetin dhe gravitetin e tyre.

Qëllimi: Evidentimi i efekteve anësore afatshkurtra të vaksinave ndaj COVID - 19 (temperatura, dhimbje lokale, edemë lokale, dobësi trupore, nause, dhimbje koke, dhimbje muskulare, dhimbje artikulare dhe ankesave të tjera) në raport me: gjininë; moshën; nëse e kanë kaluar apo jo COVID - 19 më parë; stadin e infeksionit të kaluar; llojin e vaksinave të aplikuara; sëmundjet shoqëruese dhe diagnozat e tyre.

Metodologjia: Studimi është retrospektiv me karakter deskriptivo - analitik. Në studim u përfshinë 1167 individë të përzgjedhur në mënyrë rastësore në regjistrin elektronik të 4 qendrave shëndetësore në Tiranë dhe 1 qendre shëndetësore në qytetin e Beratit nga të cilët; 65. 5% janë femra; 51. 5% i përkasin grupmoshës 50 - 70 vjeç; 42% deklarojnë se kanë sëmundje shoqëruese; 66% deklarojnë se janë infektuar me Covid - 19 dhe nga këta, mbi 56% kanë kaluar formë të mesmë dhe të rëndë të sëmundjes; 51. 7% janë vaksinuar me vaksinën Pfizer - BioNTech, 33. 0% me CoronaVac, 14. 1% me AstraZeneca dhe 1. 2% me Sputnik V. Përmes koefiçientit të korelacionit të Kendal u analizuan lidhjet statistikore midis faktorëve demografikë dhe klinikë dhe shfaqjes së efekteve anësore afatshkrurtra pas vaksinimit ndaj COVID - 19.

Rezultatet: Gjinia (femrat) dhe mosha përbëjnë faktorë të rëndësishëm të rritjes së probabilitetit për efekte anësore pas vaksinimit. Në raport me stadin e infeksionit të kaluar: sa më i rëndë aq më të shpeshta janë simptomat post - vaksinim (koefiçienti i korrelacionit është pozitiv për shumicën e simptomave). Lloji i vaksinës ka një ndikim të qartë në shfaqjen e shumë simptomave (Pfizer - BioNTech e ndjekur nga AstraZeneca dhe më pas CoronaVac janë vaksinat të shoqëruara më tepër me efekte anësore afatshkurtra). U gjetën lidhje statistikisht të rëndësishme me: temperaturën, dhimbjen lokale, edemën, dobësinë trupore, nausean, dhimbjen e kokës, muskulare dhe artikulare.

Nuk u gjetën lidhje statistikisht të rëndësishme midis sëmundjeve shoqëruese dhe ndonjërës prej simptomave post - vaksinim. Asnjë ankesë tjetër përveç atyre të analizuara kanë pohuar 98. 5% e individëve.

Konkluzion: Lloji vaksinës, gjinia, mosha dhe stadi i infeksionit të kaluar më parë janë faktorë determinantë në intensitetin dhe gravitetin e efekteve anësore afatshkurtra. Vlen të theksohet gjithashtu që shumica e efekteve anësore afatshkurtra të vaksinave ndaj COVID - 19 janë të zakonshme edhe pas aplikimit të vaksinave të tjera.

Fjalë kyçe: COVID - 19, Pfizer - BioNTech, AstraZeneca, CoronaVac, Sputnik V, efekte anësore afatshkurtra.

UDHEZIMET E AKADEMISEË EUROPIANE TË NEUROLOGJISË PËR MENAXHIMIN E SLA.

Erind Thartori
Shef i Sektorit Infermieristik / Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"

Abstrakt

Hyrje: Skleroza Laterale Amiotrofike është një sëmundje neurodegjenerative progressive që prek motoneuronet duke shkaktuar dobësi muskulare, disfagi, insuficencë respiratore. Për shkak të kompleksitetit të saj klinik dhe impaktit të gjërë në cilësinë e jetës menaxhimi i pacientëve me SLA kërkon një qasje të integruar multidisiplinare. Akademia europiane e Neurologjisë në bashkëpunim me European Reference Network for Neuromuscular Diseases (ERN Euro - NMD) ka publikuar udhëzimet më te fundit 2024) për menaxhimin e SLA të cilat bazohen në evidencë shkencore dhe metodologjinë GRADE.

Metodologjia: U përdor qasja Grade (Grading of Recommendations, Assesment, development and evaluation) për të vlerësuar cilësine e evidencës dhe fuqinë e rekomandimeve. U formulua një set prej 26 pyetjesh klinike (PICO) që mbulojnë: Terapite, kujdesin multidisiplinar, menaxhimin e simptomave, komunikimin dhe pajisjet ndihmëse dhe kujdesin psikologjik dhe paliativ. Për çdo pyetje u krye nje rishikim sistematik i literaturës dhe evidenca u kategorizua sipas forcës (e lartë, moderuar dhe e ulet). Rekomandimet janë zhvilluar nga një panel

expertësh multidisiplinar të EAN dhe ERN - EURO MND, duke përfshirë neurologë, terapistë, logopedë, infermierë, dhe përfaqësues të pacientëve.
Përfundime: Riluzoli mbetet terapia standarte për të gjithë pacientët që nga diagnostikimi. Tofersen rekomandohet për pacientët me SLA të lidhur me mutacionin SOD1. Edavarone dhe AMS0035 nuk rekomandohen për përdorim rutinë për shkak të evidencave të pamjaftueshme. Kujdesi multidisiplinar rrit mbijetesën dhe përmirëson cilësinë e jetës. Mbështetja ushqimore dhe ventilimi jo invaziv janë shtylla kryesore të menaxhimit të rastit. Menaxhimi i simptomave (spasticiteti, krampe, sialorrea, lodhja, labiliteti emocional është thelbësor për komoditetin e pacientëve. Planifikimi i hershëm i kujdesit në fund të jetës është i domësdoshëm për respektimin e dëshirave të pacientit.
Rekomandime: Të gjithë pacientët me SLA duhet të fillojne trajtimin me riluzol që në diagnostikimin e hershëm. Pacientët me mutacion SOD1 duhet të vlerësohen për trajtim me Tofersen. Trajtimet e tjera (edavarone, AMX0035, qelizat staminale) nuk duhet të përdoren jashtë protokolleve kërkimore. Kujdesi multidisiplinar duhet të jetë standart, me vizita të rregullta çdo 2 - 3 muaj. Vlerësimi i hershëm për disfaginë dhe planifikimi i gastrostomisë kur është e nevojshme. Monitorimi i funksionit respirator dhe ofrimi i ventilimit jo - invaziv në kohën e duhur. Menaxhimi i simptomave me qasje farmakologjike sipas nevojës. Diskutim i hershëm dhe i vazhdueshëm për preferencat e pacientit në lidhje me trajtimet dhe kujdesin në fundin e jetës.

Fjalë kyçe: SLA, udhëzime klinike. EAN, riluzole, kujdes multidisiplinar.

SFIDAT NË DIAGNOSTIKIMIN E KANCERIT TË VESHKAVE DHE NËNTIPAVE TË TIJ MOLEKULARË.

Erion Sukaj[2,3], Leart Berdica [1,2,3], Albina Ndoja [2,3], Teona Bushati [1,2,3]
[1]Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Patologjisë dhe Mjekësisë Ligjore.
[2] Universiteti Western Balkans
[3] Cambridge Clinical Laboratories

Abstrakt
Karcinoma e qelizave renale (RCC) përfaqëson një grup të larmishëm neoplazish malinje të veshkave që burojnë nga epiteliumi tubular renal dhe përbëjnë afërsisht 90% të kancereve të veshkave. Diagnostikimi i saktë mbetet një sfidë e rëndësishme klinike për shkak të mungesës së simptomave në fazat e hershme të sëmundjes dhe ngjashmërisë së karakteristikave histopatologjike midis nëntipave të ndryshëm. Megjithëse imazheria dhe histologjia tradicionale janë thelbësore, ato shpesh nuk arrijnë të zbulojnë kompleksitetin molekular që qëndron në themel të heterogjenitetit të RCC - së. Profilizimi molekular ka revolucionarizuar kuptimin e RCC - së duke identifikuar nëntipa të dallueshëm me ndryshime unike gjenetike dhe epigjenetike. Karcinoma renale me qeliza të pastra (ccRCC), forma më e zakonshme, shkaktohet kryesisht nga inaktivizimi i gjenit VHL në kromozomin 3p, duke çuar në akumulimin e faktorëve të induktuar nga hipoksia (HIFs) dhe mbiekspresionin e mediatorëve angiogjenikë si VEGF dhe PDGF. Karcinoma papilare renale (pRCC) përfshin dy nëntipa kryesorë: tipi 1, që lidhet shpesh me aktivizimin e proto - onkogjenit MET, dhe tipi 2, i karakterizuar nga ndryshime në FH, NRF2, ose CDKN2A. Karcinoma renale kromofobe (chRCC) shfaq humbje të shumta kromozomale (1, 2, 6, 10, 13, 17, 21) dhe mutacione në TP53 dhe PTEN. Studimet molekulare të fundit kanë zbuluar gjithashtu nëntipa më të rrallë, si karcinoma e kanalit mbledhës dhe RCC e translokacionit, të përcaktuara nga fuzioni i gjeneve TFE3 ose TFEB. Pavarësisht këtyre përparimeve, përkthimi i njohurive molekulare në diagnostikën klinike mbetet i kufizuar për shkak të heterogjenitetit intratumoral, mungesës së testeve molekulare të standardizuara dhe kostos së lartë të platformave të sekuencimit. Megjithatë, nëntipizimi molekular ofron një potencial të madh për përmirësimin e saktësisë diagnostike, udhëzimin e zgjedhjes së terapive të synuara dhe parashikimin e përgjigjes ndaj trajtimit. Në përfundim, diagnostikimi i RCC - së përballet ende me sfida të vazhdueshme që rrjedhin nga diversiteti i saj molekular dhe patologjik. Integrimi i profilizimit gjenomik dhe transkriptomik në proceset diagnostike është thelbësor për evolucionin e onkologjisë precize në kancerin e veshkave. Kërkimet e ardhshme duhet të fokusohen në validimin e biomarkerëve molekularë, harmonizimin e sistemeve të klasifikimit dhe zhvillimin e mjeteve diagnostike me kosto të ulët për të mbushur hendekun midis zbulimit molekular dhe aplikimit klinik.

Fjalë kyçe: Karcinoma e qelizave renale, Nëntipet molekulare, Diagnostikim, Biomarkerë, Onkologji precize.

KANCERI I PANKREASIT, PËRGJIGJJA NDAJ TRAJTIMIT DHE MBIJETESA E PËRGJITHSHME.

Eriona Hereni

Abstrakt

Hyrje: Kanceri i pankreasit është një nga neoplazitë më agresive dhe me prognozë të dobët në mbarë botën. Pavarësisht avancimeve në trajtimet sistemike, mbijetesa e pacientëve mbetet e kufizuar. Analiza e faktorëve klinikë dhe patologjikë që ndikojnë në progresionin e sëmundjes është thelbësore për optimizimin e strategjive terapeutike.

Qëllimi i studimit: Të vlerësohet koha deri në progresionin e parë (PFS1) dhe mbijetesa e përgjithshme (OS) sipas stadit, tipit histologjik dhe gradës tumorale te pacientët me kancer pankreatik.

Metoda: U realizua një studim retrospektiv mbi 97 kartela klinike të pacientëve të trajtuar në Shërbimin e Onkologjisë të QSUT gjatë viteve 2018–2024. Përpunimi statistikor u krye me SPSS 25, duke përdorur analiza përshkruese, Testin T, ANOVA dhe korrelacionin Pearson.

Rezultate: Shumica e pacientëve (80. 4%) ishin në stad IV. Adenokarcinoma duktale dominoi rastet (63. 9%), ndërsa PanNET përbënin 13. 4%. Mesatarja e PFS1 ishte 4. 7 muaj, ndërsa e OS 7. 1 muaj. U gjet një lidhje domethënëse midis tipit histologjik dhe OS (p=0. 034), ndërsa stadifikimi nuk ndikoi ndjeshëm në mbijetesën totale ose kohën deri në progresion.

Konkluzione: Pavarësisht kufizimeve në infrastrukturë dhe akses në trajtime moderne, rezultatet tona janë të krahasueshme me ato të raportuara ndërkombëtarisht, duke reflektuar agresivitetin universal të sëmundjes. Këto gjetje nënvizojnë nevojën globale për kërkime të mëtejshme dhe zhvillimin e strategjive të reja diagnostike dhe terapeutike për përmirësimin e ecurisë së pacientëve.

Fjalë kyçe: kanceri i pankreasit, përgjigjja ndaj trajtimit, periudha e lirë pa progresion, mbijetesa e përgjithshme, Shqipëria.

REAKSIONI ALERGJIK MEDIKAMENTOZ NGA BETA - LAKTAMIKËT RISHIKIM I LITERATURËS DHE RAST KLINIK.

Prof. Asoc. Eris Mësonjësi; Dr. Antonela Simaku
Shërbimi i Alergologjisë dhe Imunologjisë Klinike
Qendra Spitalore Universitare "Nene Tereza" Tiranë

Abstrakt

Antibiotikët beta - laktam janë një nga klasat më të zakonshme të barnave që përshkruhen, me shumë indikacione klinike. Përdorimi i tyre, që nga vitet '30 të shekullit njëzet, ndryshoi në mënyrë drastike luftën kundër sëmundjeve infektive bakteriale. Kategorizohen në 4 klasa penicilnat, cefalosporinat, karbapenemet,, monobaktamet. Nga pikëpamja biokimike, këto barna kanë një veçori të përbashkët, e cila është unaza me 3 atome karboni dhe 1 atom azoti (unaza beta - laktamike), që është shumë reaktive që mund të veprojë si hapten dhe të nxisë një përgjigje imune. Alergjia ndaj antibiotikëve beta - laktamikë përfaqëson një ndër reagimet më të shpeshta të hipersensibilitetit ndaj barnave, me pasoja të rëndësishme klinike në menaxhimin e infeksioneve bakteriale. Reagimet alergjike ndaj këtyre barnave variojnë nga urtikariet dhe angioedema, deri te anafilaksi, që mund të jetë potencialisht fatale. Vlerësimi i saktë i historisë së pacientit, testi i lëkurës dhe testet e provokimit medikamentoz janë thelbësore për të konfirmuar diagnozën dhe për të shmangur etiketimin e gabuar të pacientëve si alergjikë, situatë që shpesh çon në përdorimin e antibiotikëve alternativë më pak efektivë dhe më të kushtueshëm. Për më tepër, përparimet në imunologji dhe teknikat e testimit molekular po kontribuojnë në përmirësimin e identifikimit të alergjisë së vërtetë ndaj beta - laktamëve. Një qasje e kujdesshme diagnostike dhe ndërhyrje të bazuara në prova janë të domosdoshme për të përmirësuar sigurinë e pacientit dhe për të ruajtur efikasitetin e trajtimeve antimikrobike. Do paraqitet dhe një rast klinik me anafilaksi të përsëritur ndaj antibiotikëve dhe përqasja që patëm me pacientin.

Fjalë kyçe: alergji, anafilaksi, beta laktamike, skin prick test, provokim medikamentoz.

DERMATITI ATOPIK - RISITË NË TRAJTIM.

Prof. Asoc. Eris Mësonjësi, Dr. Ardida Ibraj
Shërbimi i Alergologjisë dhe Imunologjisë Klinike
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Dermatiti atopik është një sëmundje inflamatore kronike me etiologji multifaktoriale. Është shfaqja kutane e një sërë sëmundjesh alergjike të hipersensibilitetit imediat si astma bronkiale, alergjia ushqimore dhe rinokonjuktiviti alergjik. Faktorët që ndikojnë në zhvillimin e tij janë: predispozita gjenetike, disfunksioni epidermal, çrregullimet imunologjike, mekanizmat neuroimunologjikë dhe mikrobioma. Duke u bazuar ne fenotip, dermatiti atopik klasifikohet në ekstrinsek dhe intrinsek. Sipas morfologjisë lezionet ndahen në akute, subakute e kronike. Sipas karakteristikave të lidhura me moshën, ndahet në fazën infantile të hershme, të fëmijërisë dhe adoleshentë - adult. Dermatiti atopik karakterizohet nga lezione ekzematoze shoqëruar me prurit të shprehur. Ka evolucion kronik me riakutizime. Është e lidhur me atopi familjare. Diagnoza bazohet në anamnezën dhe ekzaminimin objektiv, testet kutane dhe IgE specifike. Trajtimi ka për qëllim qetësimin e pruritit, restaurimin e funksionit barrier të lëkurës, eleminimin e faktorëve që e acarojnë sëmundjen dhe përmirësimin e inflamacionit. Në fazat e para fillojmë trajtimin me emolientë, më pas kortikosteroide topikalë e frenues topikë të kalcineurinës në shumicën e pacientëve. Imunosupresorët sistemikë përdoren si trajtim në pacientët me forma të rënda të dermatitit atopik. Në vitet e fundit, janë hartuar dhe zhvilluar strategji të reja terapeutike duke synuar ndërhyrjet në hallka të caktuara në zinxhirin e ngjarjeve molekulare që çojnë në fenotipin e AD. Një numër gjithnjë e në rritje i terapive innovative premtojnë arritjen e kontrollit të sëmundjes, duke përfshirë edhe pacientët me formë të rëndë. Fokusi i këtij prezantimi do jetë mbi alternativat e reja mjekësore për kontrollin e Dermatiti Atopik.

Fjalë kyçe: dermatit atopik, IgE, prurit, multifaktoriale, antitrupa monoklonalë.

ASTMA BRONKIALE SI SINDROMË HETEROGJENE DHE QASJA BASHKËKOHORE E TRAJTIMIT TË PERSONALIZUAR.

Prof. Asoc. Eris Mësonjësi; Dr. Meri Ashiku
Shërbimi i Alergologjisë dhe Imunologjisë Klinike
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Astma bronkiale përbën një nga sëmundjet kronike më të shpeshta të sistemit respirator, e karakterizuar nga inflamacioni kronik i rrugëve të frymëmarrjes dhe nga hiperreaktiviteti bronkial. Sot ajo nuk konsiderohet më një entitet i vetëm, por një sindromë heterogjene, e përbërë nga nëntipe klinike dhe biologjike (fenotipe dhe endotipe) që reflektojnë mekanizma të ndryshëm patofiziologjikë. Gjatë dekadës së fundit, avancimi në njohjen e bazës imune dhe inflamatore të astmës ka mundësuar ndarjen e saj në fenotipe dhe endotipe, duke hapur rrugën për mjekësinë e personalizuar. Fenotipi përshkruan manifestimet klinike të sëmundjes (si astma alergjike, eozinofilike, neutrofilike etj.), ndërsa endotipi përcakton mekanizmat biologjikë që qëndrojnë në themel të këtyre manifestimeve. Kuptimi i këtyre mekanizmave është thelbësor për përcaktimin e trajtimit më të përshtatshëm për secilin pacient. Qasja moderne synon jo vetëm kontrollin simptomatik, por targetimin specifik të rrugëve inflamatore përmes terapive biologjike. Në pacientët me astmë të rëndë të pakontrolluar nga trajtimet konvencionale (kortikosteroide inhalatore dhe β2 - agonistë), terapitë biologjike kanë sjellë një përmirësim të ndjeshëm në kontrollin e sëmundjes dhe në reduktimin e ekzacerbimeve. Omalizumabi ishte biologjiku i parë i aprovuar për trajtimin e astmës së rëndë alergjike tek pacientët mbi 6 vjeç. Ai është një antitrup monoklonal anti - IgE që redukton aktivizimin e qelizave mastocitare dhe bazofile, duke ulur reagimin alergjik. Mepolizumabi, një antitrup monoklonal kundër interleukinës - 5 (IL - 5), ka treguar efikasitet të lartë tek pacientët me astmë eozinofilike, duke reduktuar ndjeshëm numrin e ekzacerbimeve dhe nevojën për kortikosteroide sistemike. Më pas miratimi i preparate të tjera biologjike, si Reslizumabi, Benralizumabi dhe Dupilumabi, të cilët veprojnë mbi mekanizma të ndryshëm inflamatorë (IL - 5, IL - 4, IL - 13) ofruan rezultate shumë të mira në përmirësimin e funksionit pulmonar dhe reduktimin e krizave astmatike, si tek të rriturit, ashtu edhe tek adoleshentët. Astma bronkiale përfaqëson një sindromë heterogjene me nëntipe të ndryshme biologjike, që kërkon qasje terapeutike të individualizuar. Zhvillimi i terapive biologjike ka revolucionarizuar menaxhimin e astmës së rëndë, duke e

bërë të mundur mjekimin preciz (precision medicine) në praktikën klinike. Njohja e fenotipeve dhe endotipeve të pacientëve, së bashku me përdorimin e biomarkerëve specifikë, përbën bazën e një trajtimi më efektiv dhe me rezultate afatgjata në përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientëve me astmë.

Fjalë kyçe: astma bronkiale, simptomat, fenotipet, menaxhim.

VDEKJA E PAPRITUR NË EPILEPSI (SUDEP): FAKTORËT E RREZIKUT DHE PARANDALIM.

Eris Ranxha, Emili Mara

Abstrakt

Hyrje: Vdekja e papritur në epilepsi (SUDEP) është shkaku kryesor i mortalitetit të lidhur me epilepsinë, përgjegjëse për deri në 17% të të gjitha vdekjeve tek pacientët me epilepsi dhe duke prekur afërsisht 1 në 1, 000 të rritur me epilepsi në vit. Rreziku është edhe më i lartë - deri në 9 në 1, 000 në vit - tek individët me kriza farmakorezistente. Mekanizmat e saktë fizpatologjikë mbeten të paqartë, por evidencat aktuale orientojnë drejt një procesi multifaktorial që përfshin mosfunksionim kardiorespirator, instabilitetin autonom dhe suprimimin postiktal.

Faktorët e riskut: Janë identifikuar disa faktorë rreziku për SUDEP, si krizat bilaterale toniko - klonike të padominueshme, frekuenca e lartë e krizave. Të tjerë faktorë përfshijnë krizat nokturne, fillimin e hershëm të epilepsisë, politerapinë dhe mosmarrja e rregullt e terapisë. Njohja e këtyre faktorëve të riskut është e rëndësishme duke qenë se pjesa e më e madhe e tyre janë të modifikueshëm.

Parandalimi: Strategjitë parandaluese përqëndrohen kryesisht në kontrollin optimal të krizave përmes përdorimit në kohë të antiepileptikëve, kirurgjisë së epilepsisë ose neuromodulimit në rastet refraktare. Masat ndihmëse si monitorimi gjatë natës, pajisjet e detektimit të krizave dhe edukimi i pacientit mund ta ulin më tej riskun.

Përfundim: SUDEP mbetet një ndërlikim fatal dhe i nënvlerësuar i epilepsisë. Ndërgjegjësimi për epidemiologjinë dhe faktorët e riskut, ndërhyrjet në kohë për menaxhimin e krizave dhe këshillimi i përqendruar te pacienti janë hapa thelbësorë me qëllim uljen e mortalitetit.

Fjalë kyçe: epilepsi, vdekje, rrezik, parandalim etj.

KATETERI TRANS - LUMBAL SI AKSES VASKULAR NË HEMODIALIZË. TË PROVOSH, TË SFIDOSH, TË PRANOSH: NË SHËRBIM TË JETËS SË PACIENTIT.

Erjola Bolleke

Abstrakt

Hyrje: Aksesi vaskular është komponent kyç për kryerjen efektive të hemodializës te pacientët me sëmundje kronike terminale të veshkave (ESRD). Metodat tradicionale si fistulat arteriovenoze (AVF), graftet arteriovenoze (AVG) dhe kateterët e vendosur në vena qendrore (CVC) shpeshherë bëhen të papërdorshme për shkak të komplikacioneve si stenozat e venave qendrore, trombozat e përsëritura ose infeksionet. Në raste të tilla të ndërlikuara, kateteri trans - lumbal, i cili vendoset në venën cava inferior (IVC) përmes një qasjeje posteriore, paraqet një alternativë të vlefshme dhe shpëtimtare.

Prezantimi i Rastit Klinik: Një pacient mashkull, 62 vjeç, me historik të gjatë ESRD, filloi trajtimin me hemodializë në vitin 2006 përmes një kateteri të përkohshëm subklavik, i cili funksionoi për rreth tre muaj. Ndërkohë u tentua krijimi i një AVF radiocefalike, por pa sukses. Tentativat e mëvonshme për krijimin e AVF brahiocefalike në të njëjtin dhe pastaj në anën tjetër të sipërme, rezultuan jetëshkurtra për shkak të trombozave të përsëritura dhe infeksioneve të shpeshta të CVC - ve në gjymtyrët e poshtme. Për shkak të efikasitetit të pamjaftueshëm të dializës, u shqyrtua kalimi në dializë peritoneale (PD), por pacienti ishte jo bashkëpunues dhe i papërshtatshëm për shkak të ndërhyrjes së mëparshme për hernie inguinale. Me të gjitha opsionet tradicionale të aksesit të ezauruara, u vendos vendosja e një kateteri trans - lumbal nën guidim fluoroskopik. Imazheria pas procedurës konfirmoi vendosjen e saktë të kateterit dhe pacienti nisi hemodializën ditën pasardhëse.

Ecuria dhe Ndjekja: Gjatë një periudhe 6 - vjeçare ndjekjeje, pacienti përjetoi vetëm një episod infeksioni të rrugës së gjakut të lidhur me kateterin, i cili u trajtua me sukses me antibiotikë.

Dializa mbeti brenda normave të rekomanduara (Kt / V > 1. 2), ndërkohë që kateteri ruajti përshkueshmërinë e tij pa episode tromboze.
Diskutim: Vendosja e kateterit trans - lumbal përfaqëson një zgjidhje të vlefshme për pacientët me akses të limituar vaskular. Procedura ofron një rrugë të besueshme për hemodializë dhe shoqërohet me një nivel të pranueshëm komplikacionesh. Kujdesi i përpiktë post - procedural është jetik për të parandaluar infeksionet dhe për të garantuar përshkueshmërinë afatgjatë të kateterit.
Përfundime: Ky është rasti i vetëm i njohur në vendin tonë me kateter trans - lumbal funksional, dhe ilustron efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e kësaj metode për sigurimin afatgjatë të aksesit për hemodializë në pacientë me histori vaskulare komplekse. Pavarësisht riskut për infeksione, komplikacionet mund të minimizohen me ndjekje të rregullt klinike dhe kontroll rigoroz të higjienës së aksesit. Kateteri trans - lumbal duhet të konsiderohet një alternativë e vlefshme në arsenalin e strategjive të aksesit vaskular për pacientët me pamundësi të tjera të trajtimit.

Fjalë kyçe: kateter trans - lumbal, akses vaskular, hemodializë, insuficienca terminale e veshkave, rast klinik, komplikacione, dializë e zgjatur.

GLOMERULONEFRITI I SHOQËRUAR ME MALINJITET: PATOGJENEZA, DIAGNOSTIKIMI DHE MENAXHIMI.

Prof. As. Erjola Likaj

Abstrakt
Hyrje: Glomerulonefriti i lidhur me sëmundjet malinje (MAGN) është një manifestim i rrallë renal, që përfaqëson një formë të dëmtimit glomerular të shkaktuar nga faktorë të derivuar nga tumori dhe jo nga invazioni direkt i tumorit në veshka. Këto gjendje shfaqen shpesh në formën e sindromës nefrotike dhe mund të paraqiten para, në të njëjtën kohë, ose pas diagnozës së malignitetit. Patofiziologjia përfshin mekanizma imunë, ku antigjenet tumorale shkaktojnë përgjigje autoimune dhe dëmtime në strukturat glomerulare.
Patogjeneza: MAGN është kryesisht një gjendje imunologjike paraneoplastike, e drejtuar nga antigjenet tumorale qarkulluese që nxisin prodhimin e autoantitrupave. Në nefropatinë membranoze (MN), për shembull, janë identifikuar antitrupa kundër antigjeneve si THSD7A (Thrombospondin Type - 1 Domain - Containing 7A) dhe NELL - 1 (Neural Epidermal Growth Factor–Like 1). Këto komplekse imune depozitohen subepitelialisht, aktivizojnë komplementin, dhe shkaktojnë dëmtim të filtrit glomerular. Asociimi kohor midis shfaqjes së sindromës nefrotike dhe diagnozës së tumorit përforcon origjinën paraneoplastike të glomerulonefritit.
Pamja Klinike: Pacientët me MAGN zakonisht paraqiten me sindromë nefrotike, karakterizuar nga: proteinuri massive, hipoalbuminemi, edemë e përgjithshme, hiperlipidemi. Mund të shoqërohet edhe me hematuri mikroskopike dhe dëmtim të funksionit renal në varësi të përparimit të sëmundjes onkologjike. Shpesh, evolucioni i manifestimeve renale ndjek progresin e tumorit.
Diagnostikimi: Diagnostikimi i MAGN kërkon vigjilencë të lartë klinike, veçanërisht tek pacientët me sindromë nefrotike idiopatike dhe histori të dokumentuar ose dyshuar të tumorit. Biopsia renale është thelbësore për vlerësim histologjik (shpesh tregon nefropati membranoze, sëmundje me ndryshime minimale, apo glomerulonefrit membranoproliferativ). Imunofluorescenca mund të zbulojë komplekset imune ose antigjene tumorale në glomerula. Vlerësimi onkologjik paralel, përmes imazherisë (CT, PET - CT) dhe markuesve tumoralë, është i domosdoshëm për identifikimin e shkakut parësor.
Menaxhimi: Trajtimi parësor i MAGN është menaxhimi efektiv i tumorit nënshtrues. Në shumë raste, remisioni i sëmundjes renale ndjek trajtimin onkologjik. Masat mbështetëse përfshijnë: ACE - inhibitorë / ARB për reduktimin e proteinurisë. Diuretikë për menaxhimin e edemës. Statina për kontrollin e dislipidemisë. Kujdes i personalizuar nefrologjik për mbajtjen e funksionit renal. Në raste ku tumori nuk është i trajtueshëm ose i operueshëm, trajtime imunusupresive si kortikosteroidet, ciklofosfamidi, ose rituximabi, mund të përdoren me kujdes, ndonëse efikasiteti mbetet i ndryshueshëm.
Përfundime: Glomerulonefriti i lidhur me neoplazitë është një komplikacion i rrallë, por klinikisht i rëndësishëm i sëmundjeve malinje. Njohja e hershme dhe trajtimi agresiv i neoplazisë primare janë vendimtarë për përmirësimin e rezultateve renale. Hulumtimet në vazhdim mbi identifikimin e antigjeneve tumorale specifike dhe zhvillimi i terapive të synuara mund të hapin rrugë të reja për menaxhimin e këtyre patologjive.

Fjalë kyçe: glomerulonefriti paraneoplastik, sëmundje glomerulare, sëmundje malinje, sindromë nefrotike, THSD7A, NELL - 1, nefropatia membranoze, biopsia renale, komplekse imune, dëmtim renal, imunoterapi.

MENAXHIMI I DHIMBJES AKUTE PAS FRAKTURAVE: QASJET FARMAKOLOGJIKE DHE JO FARMAKOLOGJIKE.

Erjon Berisha[1]
[1]Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Tetova, Mqedoni e Veriut.

Abstrakt
Hyrje: Dhimbja akute pas frakturave është një përvojë e kudo ndodhur dhe shpesh dobësuese që ndikon ndjeshëm në rikuperimin e pacientit, rezultatet funksionale dhe cilësinë e jetës afatgjatë. Menaxhimi efektiv i dhimbjes është parësor, megjithatë kujdesi jo - optimal mbetet një sfidë e vazhdueshme, duke kontribuar në qëndrime të zgjatura në spital, rritje të kostove të kujdesit shëndetësor dhe potencialin për zhvillimin e dhimbjes kronike. Ky punim argumenton se një qasje gjithëpërfshirëse, multimodale, që integron strategjitë farmakologjike dhe jo - farmakologjike, është paradigma optimale për menaxhimin e dhimbjes akute pas frakturave. Ai shqyrton në mënyrë kritike provat aktuale dhe praktikat më të mira për ndërhyrje të ndryshme farmakologjike, duke përfshirë acetaminofenin, barnat anti - inflamatore jo - steroide (NSAID), opioidet, anestezinë rajonale dhe terapitë ndihmëse, duke theksuar mekanizmat, përfitimet dhe rreziqet e tyre të natyrshme. Njëkohësisht, ai eksploron spektrin e larmishëm të modaliteteve jo - farmakologjike, të tilla si imobilizimi, krioterapia, mobilizimi i hershëm, ndërhyrjet psikologjike (p. sh. , terapia njohëse e sjelljes, teknikat e relaksimit) dhe terapitë plotësuese (p. sh. , akupunktura, TENS). Argumenti qendror pohon se zbatimi sinergjik i këtyre qasjeve të ndryshme minimizon mbështetjen në agjentë të vetëm, veçanërisht opioidet, duke zvogëluar kështu efektet anësore, ndërsa arrin një kontroll superior të dhimbjes dhe restaurim funksional. Ky punim trajton më tej sfidat në zbatimin e menaxhimit multimodal të dhimbjes, duke përfshirë edukimin e pacientëve, ndarjen e burimeve dhe trajnimin e ofruesve të kujdesit shëndetësor, dhe propozon drejtime të ardhshme për kërkimin dhe praktikën klinike për të përmirësuar kujdesin e përqendruar te pacienti dhe për të optimizuar rezultatet në dhimbjen akute të frakturave.

Fjalë kyçe: dhimbje akute, frakturë, menaxhim dhimbjeje, farmakologjik, jo - farmakologjik, analgjezi multimodale, kursim i opioideve, rezultate të pacientëve.

KUJDESI INFERMIEROR NË KOHËN E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE.

Erlin Najtellari
Departamenti i Onkologjisë, Spitali Italian SALUS
Departamenti i Mjekësisë Interne, Spitali Italian SALUS

Abstrakt
Hyrje: Inteligjenca artificiale (IA) po shndërrohet në një mjet të rëndësishëm për transformimin e kujdesit shëndetësor. Përtej diagnostikës dhe analizës mjekësore, IA po fiton terren edhe në kujdesin infermieror, duke ndihmuar në monitorimin e pacientëve, parashikimin e rreziqeve dhe planifikimin e burimeve. Në një realitet ku mungesa e stafit dhe rritja e kompleksitetit klinik janë sfida të përditshme, teknologjitë inteligjente ofrojnë një mbështetje të vlefshme për vendimmarrjen infermierore.
Qëllimi: Të shqyrtohen fushat kryesore të përdorimit të IA në kujdesin infermieror dhe të vlerësohen ndikimet e saj në praktikën klinike, edukim dhe etikë profesionale, me një fokus të veçantë në kontekstin shqiptar.
Metoda: U realizua një përmbledhje narrative e literaturës ndërkombëtare të viteve të fundit, duke analizuar aplikimet e IA në parashikimin e rënieve, sepsisit, ngarkesës së punës dhe kujdesin ndaj plagëve. U përfshinë gjithashtu shembuj konkretë të përdorimit të chatbotëve dhe përpunimit të gjuhës natyrore në proçeset infermierore.
Rezultate: Përdorimi i algoritmeve të mësimit makinerik ka përmirësuar ndjeshëm parashikimin e rreziqeve klinike dhe menaxhimin e burimeve infermierore. Megjithatë, këto teknologji mbeten ende të pazhvilluara në sistemin shëndetësor shqiptar, për shkak të mungesës së infrastrukturës dixhitale, të dhënave të standardizuara

dhe trajnimeve të posaçme për personelin infermieror. Integrimi i IA kërkon investim në kapacitete teknologjike dhe bashkëpunim ndërmjet universiteteve, spitaleve dhe institucioneve publike.
Konkluzione: IA përfaqëson një potencial të madh për rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të kujdesit infermieror. Në Shqipëri, hapi i parë drejt këtij zhvillimi duhet të jetë ndërtimi i bazave digjitale, edukimi i stafit dhe përfshirja aktive e infermierëve në projektet inovative. Kujdesi njerëzor mbetet thelbi i profesionit; teknologjia është mjet, jo zëvendësim.

Fjalë kyçe: kujdesi infermieror, inteligjencë artificiale, pacient etj.

TRAJTIMI KIRURGJIKAL I RUPTURËS SË MIOKARDIT: EKSPERIENCA E QENDRËS SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA", 2021–2025.

Ermal Likaj, Klodiana Durici, Selman Dumani, Alessia Mehmeti, Fjorba Mana, Ervin Bejko, Altin Veshti.
Departamenti i Kardiokirurgjisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt
Hyrje: Ruptura e miokardit është një ndërlikim mekanik i rrallë, por katastrofik i infarktit akut të miokardit, traumës kardiake, infeksioneve kardiake, tumoreve kardiake, sëmundjeve infiltrative të zemrës dhe diseksionit të aortës. Ruptura e miokardit mund të ndodhë edhe në mënyrë jatrogjene gjatë procedurave kardiake perkutane (përfshirë implantimin e device - ve) ose kirurgjisë së hapur të zemrës (veçanërisht zëvendësimit të valvulës mitrale). Ajo shoqërohet me vdekshmëri jashtëzakonisht të lartë nëse nuk trajtohet. Riparimi kirurgjikal përfaqëson opsionin kryesor terapeutik, megjithëse prognoza mbetet sfiduese dhe varet nga diagnoza dhe ndërhyrja e shpejtë.
Objektivi: Të analizohet menaxhimi kirurgjikal dhe rezultatet e pacientëve me rupturë traumatike dhe pas infarktit të miokardit të trajtuar në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" (QSUT), Tiranë, midis viteve 2021 dhe 2025.
Metoda: Ne analizuam në mënyrë retrospektive të dhënat mjekësore të të gjithë pacientëve që iu nënshtruan operacionit për rupturë të miokardit gjatë periudhës së studimit. Të dhënat e mbledhura përfshinin të dhëna demografike, prezantim klinik, gjetje diagnostikuese, llojin e rupturës (mur i lirë, septal, muskul papilar), teknikat kirurgjikale, menaxhimin perioperativ dhe rezultatet.
Rezultate: Një total prej 16 pacientësh, me moshë mesatare 62 vjeç, 75% meshkuj dhe 25% femra iu nënshtruan riparimit kirurgjikal urgjent për rupturë miokardiale ishemike (62, 5%), traumatike (18, 7%) dhe jatrogjenike (18, 7%). Shumica paraqitën instabilitet hemodinamik dhe shok kardiogjen (10 pacientë). Vendet e rupturuara të regjistruara ishin: muri i lirë atrial (1 pacient), muri i lirë ventrikular (3 pacientë), sulkusi atrio - ventrikular (2 pacientë), septumi interventrikular (2 pacientë), muskuli papilar (8 pacientë). Strategjitë kirurgjikale përfshinin: riparim me suture direkte me përforcim me pledget (5 pacientë), riparim i septumit me patch Dacron (2 pacientë), zëvendësim të valvulës në rastet me rupture të muskulit papilar (9 pacientë) të cilat shpesh shoqëroheshin me CABG (6 pacientë). Mbijetesa e hershme postoperative ishte 87, 5%, me vdekshmëria spitalore prej 12, 5%. Komplikacionet kryesore postoperative përfshinin: ulja e debitit kardiak, dëmtim I funksionit renal dhe aritmitë. Mbijetesa afatshkurtër shoqërohej me ndërhyrjen e hershme kirurgjikale dhe stabilizimin hemodinamik para operacionit.
Konkluzione: Trajtimi kirurgjikal i rupturës së miokardit, megjithëse me rrezik të lartë, mbetet jetëshpëtues. Përvoja jonë thekson nevojën për diagnostikim të shpejtë, ndërhyrje të menjëhershme kirurgjikale dhe një qasje multidisiplinare për të përmirësuar mbijetesën në këtë ndërlikim shkatërrues të infarktit akut të miokardit apo traumave kardiake.

Fjalë kyçe: ruptura e miokardit, ndërlikim pas infarktit, trauma e miokardit, kirurgji kardiake, riparim kirurgjikal.

ZHVILLIMI DHE PËRDORIMI I KËRCIT ARTIFICIAL TË NDJESHËM NDAJ PH - SË PËR TRAJTIMIN E ARTRITIT.

Dr. Ermal Muja, Dr. Eranda Muja

Abstrakt

Hyrja: Artriti është një sëmundje e përhapur inflamatore e kyçeve që prek qindra miliona njerëz në mbarë botën. Në osteoartrit (OA) dhe forma të tjera të artritit, dëmtimi i kërcit artikular çon në dhimbje kronike dhe vështirësi në lëvizje. Kërci artikular është avaskular dhe pa nerva, kështu që rigjenerimi i tij natyral është i kufizuar.

Qëllimi: Ky punim shqyrton zbulimet më të fundit mbi kërcin artificial stimuli - reagues ndaj pH - së dhe aplikimin e tij në trajtimin e artritit. Diskutohen sfidat për implikimet klinike dhe hapa të mëtejshëm kërkimor për implementimin në praktikë

Materiale dhe Metoda: Ky punim është rishikim i literaturës shkencore dhe për këtë punim është shfrytëzuar materiali i marrë nga burimet e ndryshme të njohura siç janë: NCBI, Google Scholar etj. Rishikimi ynë përfshin literaturën bashkëkohore mbi hidrogjelet inteligjente, përparimet në dizajnin e kërcit artificial dhe rezultatet in vitro / simuluese.

Rezultate dhe përfundime: Trajtimet konvencionale (ilaçe anti - inflamatore, injeksione kortikosteroide dhe kirurgji) shpesh ofrojnë vetëm lehtësim të përkohshëm dhe mund të kenë efekte anësore serioze. Studimet e fundit në Universitetin e Cambridge - t kanë zhvilluar një hidrogjel inteligjent që reagojnë ndaj uljes së pH - së në kyçe të inflamuar, duke lëshuar barin anti - inflamator pikërisht në vend dhe kohën kur nevojiten. Në laborator, ky material i ngarkuar me një ngjyrues fluoreskues (model i ilaçit) ka shfaqur çlirim të shtuar të barit në kushtet acide të një kyçi artritik krahasuar me pH normal. Studimet tregojnë se hidrogjelet pH - reaguese kanë dhënë rezultate premtuese në trajtimin e OA. Hidrogelët e reja pH - reaguese zhvillohen zakonisht si rrjeta 3D polimerike me lidhje dinamikisht të riveshshme. Rezultatet tregojnë se materialet e reja pH - reaguese mund të rrisin efikasitetin e trajtimit duke zvogëluar efektet anësore, duke mundësuar çlirim të kontrolluar dhe të vazhdueshëm të ilaçeve.

Fjalë kyçe: kërci artificial, pH, artriti, osteoartriti, hidrogjeli inteligjent, dizajni i kërcit artificial.

AFLIBERCEPT 8 MG – NJË EPOKË E RE NË MENAXHIMIN E RETINOPATISË DIABETIKE: PREZANTIME RASTESH KLINIKE.

Dr. Ermal Simaku[1], Dr. Brisilda Danaj[1]

[1]Mjekë Oftalmologë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"

Abstrakt

Hyrje: Të paraqitet roli i Aflibercept 8 mg në menaxhimin e retinopatisë diabetike përmes rasteve klinike ilustrative, duke vlerësuar efikasitetin e tij dhe përfitimin nga zgjatja e intervaleve të trajtimit.

Materiale dhe Metoda: Tre pacientë me retinopati diabetike jo - proliferative të shoqëruar me edemë makulare klinikisht të rëndësishme u trajtuan me injeksione intravitreale të Aflibercept 8 mg. Vlerësimi përfshiu maturimin e mprehtësisë vizive më të mirë të korrigjuar (BCVA), tomografinë koherente optike të makulës (OCT), si dhe fotografinë e fundusit. Ndjekja u realizua deri në 9 muaj.

Rezultate: Rasti 1: Pacient 58 - vjeçar me BCVA fillestare 5 / 10 tregoi stabilizim të edemës makulare dhe përmirësim në 8 / 10 pas tre injeksioneve me Aflibercept 8 mg, me zgjatje të intervaleve të ndjekjes deri në 16 javë. **Rasti 2:** Pacient 62 - vjeçar me bashkëpunim të dobët në trajtimet e mëparshme, paraqiti reduktim të trashësisë makulare qëndrore me 120 µm dhe ruajti BCVA 7 / 10 pa rikthim të edemës në një periudhë 6 - mujore. **Rasti 3:** Pacient 55 - vjeçar me formë të hershme të retinopatisë diabetike proliferative tregoi regresion të neovaskularizimit dhe reduktim të edemës makulare, duke shtyrë nevojën për ndërhyrje me laser në fazën fillestare të sëmundjes.

Përfundime: Aflibercept 8 mg shfaq një efikasitet të lartë në trajtimin e retinopatisë diabetike, me përfitime shtesë në aspektin e zgjatjes së intervaleve të trajtimit dhe përmirësimit të përkushtimit të pacientëve ndaj terapisë. Rastet e paraqitura sugjerojnë se ky agjent përfaqëson një hap përpara në epokën e re të menaxhimit të kësaj patologjie kronike dhe progresive.

Fjalë kyçe: Aflibercept 8 mg, retinopatia diabetike, raste klinike, anti - VEGF, injeksione intravitreale.

DIAGNOZA RADIOLOGJIKE E STRIKTURËS SË URETRËS MASHKULLORE.

Dr. Sh. M. Ermal Tako[1], Prof. Dr. Astrit Hoxhaj[2] Dr. Sh. M. Edip Bezhani[3] Dr. Bilbil Hoxha[3], Dr. Silvana Tako[4]
[1]Imazherist, Spitali "Amerikan 2", [1]QOD "Ungjëllizimi"
[2]Drejtues i Departamentit të Imazherisë në Spitalin "Amerikan 2" Tiranë
[3]Urolog QSUT "Nënë Tereza", Tiranë
[3]Urolog QSUT "Nënë Tereza" Tiranë
[4]Mjek familjeje "Qendra Shendetesore" Nr. 10, Tiranë.

Abstrakt
Hyrje: Striktura e uretrës mashkullore mbetet një nga patologjitë më të rëndësishme urologjike për vete specifikat që ka lidhur me diagnostikimin, trajtimin dhe invaliditetin që shkakton. Kjo patologji është relativisht e shpeshtë. Bazuar në disa të dhëna të përgjithshme statistikore të marra nga literatura e huaj, prevalenca e përgjithshme e strikturës së uretrës mashkullore në varësi të popullatës së studiuar dhe metodës diagnostike të përdorur është 0. 6% - 1% në popullatën e përgjithshme të meshkujve, ndërsa incidenca është rreth 200 - 1200 raste për 100000 meshkuj në vit. Strikturat e lidhura me moshën janë më të shpeshta dhe ndodhin kryesisht pas moshës 55 vjeç. Në moshat e reja strikturat lidhen kryesisht me traumat dhe infeksionet. Në vendet e zhvilluara janë kryesisht jatrogjenike, të lidhura me traumat, kateterizimin dhe ndërhyrjet kirurgjikale, ndërsa në vendet në zhvillim janë të lidhura me infeksionet veneriane.
Ky studim është bazuar në raste të praktikës klinike në spitalin "HYGEIA", Tiranë, si dhe në klinikën QOD "Ungjëllizimi". Janë marrë në shqyrtim 87 raste të periudhës 2003 - 2013, të cilat pas kryerjes së RU i janë nënshtruar cistouretroskopisë dhe uretrotomisë interne optike (OIU).
U përcaktuan sensitiviteti, specifiteti dhe vlerat prediktive negative dhe pozitive.
Në ekzaminime janë përdorur pajisjet e mëposhtme: *SIEMENS Axiom iconos R200*(HYGEIA) dhe *SIEMENS SIREGRAF CF* (QODU). Ekzaminimet u kryen me kateterë *Foley* 16 - 18Fr. Në disa raste kur kateteret nuk kaluan injektimi i kontrastit në uretër u krye direkt me shiringë 20ml.
Qëllimi: Përcaktimi i vlerës së uretrografisë retrograde (RU) në diagnostikimin e strikturave të uretrës.
Rezultatet: Sensitiviteti i RU rezultoi 92%, ndërsa specifiteti 71%. PPV 89%, NPV 77%. Përbërja e rasteve në baze të klinikës dhe diagnozës përfundimtare ishte si më poshtë: 30 striktura inflamatore, 18 striktura nga patologjitë e prostatës, 3 striktura pas *bypass* - it të koronareve, 22 normale, 10 striktura nga kateterizimi dhe 4 striktura posttraumatike. Nga 87 pacientë, 75 e cilësuan si ekzaminim të dhimbshëm, 15 prej tyre patën uretrorragji, 4 raste intravazim të kontrastit dhe 2 raste patën infeksione urinare subsekuente.
Konkluzion: RU pavaresisht se është një ekzaminim tradicional i radiologjisë konvencionale dhe efekteve të padëshirura që jep, vazhdon të mbetet si ekzaminimi më i përdorshëm në diagnostikimin e strukturave të uretrës mashkullore. Megjithëse MRI (Uretrografia me Rezonancë Magnetike ose MRU) tregon sensitivitet (92. 1%) dhe specifitet (100%) më të lartë për diagnostikimin e strikturave uretrale te meshkujt, RU është ende ekzaminimi rutinë për shkak të kostos më të ulët dhe mundësisë së kryerjes thuajse në cdo kabinet radiologjik.

Fjalë kyçe: striktura, uretra mashkullore, patologji etj.

RËNDËSIA E FOSFATAZËS ALKALINE NË SËMUNDJET KARDIOVASKULARE.

Dr. Ermir Tafaj
Klinika Kardiologji II, Q. S. U. T

Abstrakt
Hyrje: Fosfataza alkaline (ALP) është një enzimë e rëndësishme që gjendet në mëlçi, kocka dhe indet vaskulare, e cila tradicionalisht përdoret si tregues i funksionit hepatik dhe metabolizmit të kockave. Së fundmi, është vërtetuar se ALP luan një rol të drejtpërdrejtë në proceset patologjike të sistemit kardiovaskular, përfshirë kalcifikimin vaskular dhe inflamacionin kronik. Studime të shumta kanë treguar se nivelet e larta të ALP lidhen me rritje të kalcifikimit arterial, rrezik më të lartë për sëmundje koronare, si dhe prognozë më të keqe pas revaskularizimit perkutan. Është me rëndësi analizimi për rolin biologjik, mekanizmat e veprimit dhe rëndësinë klinike të fosfatazës alkaline në sëmundjet kardiovaskulare. ALP luan rol qendror në konvertimin e qelizave të muskujve të lëmuar vaskularë në fenotip osteoblastik, duke nxitur depozitimin e kalciumit në murin arterial dhe rrjedhimisht dhe kalcifikimin vaskular. Nga ana tjetër kemi praninë e inflamacionit sistemik ku nivelet e larta të

ALP lidhen me rritje të proteinës C - reaktive dhe citokinave proinflamatore, duke përshpejtuar proceset aterosklerotike. Gjithashtu rritja e ALP mund të dëmtojë strukturën e endotelit, duke përkeqësuar elasticitetin vaskular dhe rritur rrezikun
për ngjarje trombotike.

Fjalë kyçe: fosfataza alkaline, sëmundje kardiovaskulare, pacient etj.

LUPUSI ERITEMATOZ SISTEMIK SI FAKTOR RISKU PËR SËMUNDJEN E ARTERIEVE KORONARE.

Dr. Ermir Tafaj, Dr. Klara Qefalia
Klinika Kardiologji II, Q. S. U. T

Abstrakt
Hyrje: Lupusi Eritematoz Sistemik (LES) është një sëmundje kronike autoimune, e karakterizuar nga inflamacion i përhapur dhe dëmtim i indeve që përfshin shumë sisteme dhe organe. Studime të shumta kanë treguar se pacientët me LES kanë një rrezik dukshëm më të lartë për zhvillimin e aterosklerozës së parakohshme dhe sëmundjes së arterieve koronare (SAK), krahasuar me popullatën e përgjithshme. LES kontribuon në zhvillimin e SAK përmes mekanizmave tradicionalë dhe atyre specifikë të sëmundjes. Inflamacioni kronik sistemik, depozitimi i kompleksеve imune, disfunksioni endotelial dhe dëmtimi vaskular i ndërmjetësuar nga autoantitrupat përshpejtojnë aterosklerozën. Për më tepër, përdorimi afatgjatë i kortikosteroideve, dislipidemia, hipertensioni dhe përfshirja renale rrisin më tej rrezikun kardiovaskular. Studimet tregojnë se gratë me LES, veçanërisht ato në moshë riprodhuese, kanë deri në 50 herë rrezik më të lartë për infarkt miokardi krahasuar me grupet e kontrollit të së njëjtës moshë. Integrimi i vlerësimit të rrezikut kardiovaskular në kujdesin rutinë të pacientëve me LES është jetik për përmirësimin e rezultateve afatgjata.

Fjalë kyçe: lupusi eritematoz sistemik, faktor risku, arterie koronare.

KOMPLIKACIONET NEUROLOGJIKE NË NJË FËMIJË 15 - VJEÇAR ME PFIC TIPI 2 (RAPORTIM RASTI).

Dervishi. E, Velmishi. V, Hoxha. G, Tako. A, Cullufe. P
Departamenti Pediatrisë, Klinika Specialiteteve & Sëmundjeve Metabolike

Abstrakt
Hyrje: Kolestaza intrahepatike familjare progresive e tipit 2 (PFIC2) është një çrregullim i rrallë autosomal recesiv i shkaktuar nga mutacionet në gjenin ABCB11 që kodon pompën e eksportit të kripërave biliare (BSEP), duke çuar në kolestazë të rëndë dhe keqpërthithje të vitaminave të tretshme në yndyrë. Mungesa e vitaminës E është një ndërlikim i njohur që mund të rezultojë në pasoja të rënda neurologjike nëse nuk trajtohet.
Prezantimi i rastit: Ne do të raportojmë rastin e një djali 15 - vjeçar me PFIC2 të diagnostikuar në fëmijërinë e hershme i cili zhvilloi ndërlikime të rënda neurologjike duke përfshirë ataksi cerebellare, retinopati dhe alopeci sekondare nga mungesës së thellë të vitaminës E. Ekzaminimet laboratorike zbuluan nivele jashtëzakonisht të ulëta të vitaminës E në serum pavarësisht përpjekjeve të mëparshme për marrjen e vitaminës E në rrugë orale. Pacienti u paraqit me funksion konjiktiv normal, por me vështirësi të konsiderueshme në koordinimin motorik. Për shkak të kundërindikacioneve për transplantimin e mëlçisë, menaxhimi mbeti i kufizuar në suplementimin oral të vitaminës E, përveç suportit të mëparshëm.
Menaxhimi & Rezultati: Pacienti u trajtua me suplement oral të vitaminës E në doza terapeutike. Monitorimi klinik tregoi përmirësim minimal në simptomat neurologjike gjatë periudhës së trajtimit, në përputhje me faktin se manifestimet neurologjike nga mungesa e avancuar e vitaminës E mund të jenë pjesërisht të pakthyeshme pasi vendosen.
Përfundime: Ky rast thekson rëndësinë kritike të njohjes së hershme dhe trajtimit agresiv të mungesës së vitaminës E tek pacientët me PFIC2. Zhvillimi i komplikacioneve të rënda neurologjike, duke përfshirë ataksi, retinopati dhe alopeci, nënvizon nevojën për strategji të specializuara të plotësimit të vitaminave të tretshme në yndyrë, veçanërisht formulime të tretshme në ujë si tokofersolan (TPGS), në sëmundjet kolestatike të mëlçisë.

Kur transplanti i mëlçisë nuk është i realizueshëm, plotësimi optimal i vitaminës E mbetet ndërhyrja kryesore terapeutike, megjithëse rikuperimi neurologjik mund të jetë i kufizuar pas vendosjes së deficititeve.

Fjalë kyçe: Kolestaza intrahepatike familjare progresive, PFIC2, mungesë e vitaminës E, ataksi, retinopati, alopecia, kolestaza, komplikacione neurologjike.

LEGIONELLA, SI NJË KERCENIM REAL PËR BOTEN E CIVILIZUAR. PSE JO EDHE PER NE?

Muco E[1], Dede M[2], Nikolla A[1], Vasili O[3], Xhaferri M[3]
[1] Shërbimi i Sëmundjeve Infektive, Qendra Spitalore Univeristare "Nënë Tereza" Tiranë.
[2]Mjek i Sëmundjeve Infektive, Spitali Amerikan 3. Tiranë.
[3]Fakulteti i Mjekësisë, Tiranë.

Abstrakt
Hyrje: Sëmundja e Legjionarëve është patologji infektive me shkaktar bakteret e gjinisë Legionella. L. Pneumophilia u njoh si shkak i sëmundjeve njerëzore në vitin 1976, pas shfaqjes së pneumonisë atipike epidemike të rëndë mes veteranësh, pas takimit të tyre në Filadelfia, SHBA. Rezervuaret e ujit janë agjentë të transmetimit të legjionelozës. Legionella shumëzohet në mjedise ujore si sistemet e ujit të ngrohtë shtëpiak, kullat e ftohjes, pishinat ku ka ujë të ngrohtë dhe të ndenjur me ndërprerje. Shfaqja është më e shpeshtë mes udhëtaresh dhe turistësh. Vendi ynë është kthyer në një atraksion turistik me bum vizitorësh vitet e fundit. Legioneloza është një kërcënim real në këtë realitet hotelesh, resortesh, pishinash, restorantesh me ajër të kondicionuar, lëvizje turistike etj.
Qëllimi: Le të kontribuojmë në njohjen e kësaj patologjie infektive, faktorëve predispozues, mjeteve diagnostikuese dhe metodave të trajtimit sa më profesional te saj.
Materiale dhe Metoda: Gjetjet shkencore bashkëkohore mbi epidemiologjinë, metodat diagnostike laboratorike si dhe metodat e trajtimit për këtë patologji infektive në botë dhe në vendin tonë, u bënë baza e punës sonë. Ne mblodhëm të dhëna nga raportet e ISHP, Shoqatës së Turizmit dhe Ministrisë së Kulturës, pasi vendi ynë ka legjislacion dhe udhëzime për kontrollin e Legionellës.
Rezultate: Sëmundja shfaqet në mënyrë sporadike, por edhe epidemike. Në BE, u raportuan 29 shpërthime nga Franca, Gjermania, Italia, Holanda dhe Mbretëria e Bashkuar në vitin 2019. Paraqitja klinike mund të jetë e ngjashme me gripin (ethet Pontiac), por edhe me përfshirje të rëndë të sistemit të frymëmarrjes (pneumoni atipike / sëmundja e Legjionarit), hepato - renale, nervore etj, me një shkallë vdekshmërie mbi 12%, veçanërisht te njerëzit me imunitet të kompromentuar. Vendi ynë është bërë tashmë një destinacion turistik, pasi vetëm në periudhën Janar - Gusht 2025, rreth 9 milionë turistë e vizituan atë, 2. 3 milionë prej të cilëve në sezonin e verës. Qytetet me numrin më të lartë të hoteleve dhe njësive akomoduese janë Saranda 2854, Vlora 2853, Tirana 2390, Durrësi 1506 etj. Shqipëria ka legjislacion dhe udhëzime për kontrollin e Legjionelles pasi është patologji e njoftueshme nga i gjithë sistemi shëndetësor publik dhe privat.
Konkluzione: Sëmundja e legjionarëve është e pakraportueshme megjithëse studimet dokumentojnë një incidencë në rritje, duke e bërë atë një problem të shëndetit publik në të gjithë botën dhe sigurisht dhe për ne. Ndërtimi i një algoritmi epidemiologjik, diagnostikues (mikrobiologjik / imazherik / klinik) do t'i ndihmojë shumë klinicistët tanë.

Fjalë kyçe: legjionele, pneumoni, sisteme uji, ajër i kondicionuar, turizëm.

AKNET DHE DIETA: RISHIKIM LITERATURE.

Prof. Ermira Vasili, Sindi Shandro Md, Ornela Cela Md
Shërbimi i Dermatologjisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt
Hyrje: Akne vulgaris është një patologji kronike inflamatore e njësisë pilosebace të lëkurës. Prek rreth 85% të adoleshentëve, por mund të ndodhë ose të përsistojë edhe në moshën adulte. Përbën një patologji multifaktoriale, ku përfshihen hiperkeratinizimi folikular, *Cutibacterium acnes*, mbiprodhimi i sebumit dhe mekanizma të tjerë kompleksë inflamatorë, të cilët përfshijnë imunitetin e lindur si edhe atë të fituar, faktorë gjenetikë dhe

mjedisorë. Për rolin e dietës në patologjinë e akne vulgaris, historikisht ka pasur mendime dhe studime kontradiktore.
Qëllimi: Të paraqesim një rishikim sistematik të literaturës me evidenca të cilësisë së lartë në lidhje me shoqërimin e dietës me aknegjenezën.
Metodologjia: Për shkak të implikimeve në shumë nga faktorët e sipërpërmendur, dieta ka qenë për dekada pjesë e diskutimeve mbi aknen. Nëpërmjet rishikimit të literaturës së viteve të fundit (2020–2025) në PubMed, në gjuhën angleze, duke përdorur fjalët kyçe: dietë, akne vulgaris, indeks glicemik dhe ngarkesë glicemike, si edhe duke marrë në konsideratë kontekstin historik të zhvillimit të debateve, vendosim përballë qëndrimet e ndryshme mbi rolin e dietës në fiziopatologjinë e aknes, duke synuar paraqitjen finale të evidencave të bazuara mbi studime të kryera në mënyrë korrekte.
Diskutime: Pavarësisht qëndrimeve konfliktuale, një dietë perëndimore e vendeve të industrializuara, e karakterizuar nga produkte me indeks glicemik të lartë, mund të përkeqësojë aknegjenezën dhe ashpërsinë e aknes, ndërkohë që adoptimi i një diete me indeks glicemik të ulët favorizon uljen e numrit dhe të ashpërsisë së lezioneve, pavarësisht rajonit gjeografik. Në drejtim të ndikimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, evidencat janë mikse. Roli i acideve yndyrore omega - 3, antioksidantëve, zinkut, vitaminës A dhe fibrave dietike mbetet i paqartë.
Konkluzione: Ndikimi i dietës në akne nuk mund të kundërshtohet. Tashmë ka mjaftueshëm evidenca bindëse se dietat me ngarkesë glicemike të lartë kanë efekt proaknegjen dhe mund ta përkeqësojnë sëmundjen. Megjithatë, nevojiten studime të mëtejshme rastësore të kontrolluara për të përcaktuar plotësisht shoqërimet potenciale mes dietës dhe akneve. Me anë të këtij prezantimi, inkurajojmë profesionistët të eksplorojnë këto efekte si edhe të modifikojnë përqasjen në trajtimin e plotë të pacientëve me akne, bazuar në evidenca.
Fjalë kyçe: akne, dietë, indeks glicemik i lartë.

ROLI I ANESTEZISË DHE TEKNIKAT E SEDACIONIT GJATË PROCEDURAVE ENDOSKOPIKE.

Ernest Caka, Marsel Dhima, Zamira Hysenaj, Pranvera Doko, Ilir Nezha
Mjek anestezist reanimator në shërbimin e kirurgjisë, QSUT, "Nënë Tereza", Tiranë.

Abstrakt
Hyrje: Në këtë material është trajtuar përdorimi i propofolit krahasuar me teknikat alternative. Procedurat endoskopike, të cilat përfaqësojnë një nga metodat më të rëndësishme diagnostike dhe terapeutike në mjekësinë moderne, shpesh kërkojnë menaxhim adekuat të sedacionit për të siguruar konfort të pacientit dhe sukses të procedurës. Sedacioni me propofol është i njohur për induksionin e shpejtë, kohëzgjatjen e shkurtër të veprimit dhe rikuperimin e shpejtë, por njëkohësisht lidhet me rrezik të lartë për komplikacione respiratore dhe hemodinamike, duke kërkuar praninë e anestezistit gjatë procedurës. Nga ana tjetër, teknikat alternative si përdorimi i benzodiazepinave, opioideve apo kombinimeve si ketofol, ofrojnë profile sigurie të ndryshme dhe përdoren gjerësisht në varësi të gjendjes së pacientit dhe llojit të procedurës. Ky material ka synuar të kryejë një analizë krahasuese mbi efikasitetin dhe sigurinë e propofolit në raport me teknikat alternative të sedacionit gjatë endoskopisë. Janë vlerësuar parametra të rëndësishëm si incidenca e komplikacioneve respiratore e kardiovaskulare, cilësia e sedacionit, koha e rikuperimit si dhe siguria e mirëqënies së pacientëve. Rezultatet treguan se propofoli mbetet agjenti më i efektshëm për arritjen e një sedacioni të qëndrueshëm dhe procedurë të qetë, megjithëse kërkon monitorim të rreptë dhe asistence të specializuar. Teknikat alternative, megjithëse me siguri të shtuar në disa aspekte, shpesh ofrojnë sedacion më pak të parashikueshëm dhe rikuperim më të ngadaltë. Në përfundim, studimi nënvizon rëndësinë e zgjedhjes së kujdesshme të teknikës së sedacionit bazuar në profilin klinik të pacientit dhe kompleksitetin e procedurës endoskopike, duke theksuar rolin vendimtar të anestezistit në menaxhimin e sigurt të këtyre ndërhyrjeve.
Fjalë kyçe: sedacion i thelle, propofol, ketofol.

KOMPLIKIMET INFEKTIVE TË DJEGIEVE - RISHIKIM I LITERATURËS INFECTIOUS COMPLICATIONS OF INJURIES – LITERATURE REVIEW.

Dr. Erona Syla

Abstrakt

Hyrje: Djegiet janë një nga traumat më të rënda që prekin integritetin e lëkurës dhe sistemin imunitar, duke i ekspozuar pacientët ndaj komplikimeve infektive serioze. Këto infeksione përbëjnë një nga shkaqet kryesore të mortalitetit pas djegieve dhe kërkojnë njohuri të thella mbi mikrobiologjinë, diagnostikimin dhe menaxhimin terapeutik.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të analizojë shkaqet, mekanizmat patofiziologjikë dhe ndikimin klinik të komplikimeve infektive që shfaqen te pacientët me djegie, si dhe të theksojë rëndësinë e diagnostikimit të hershëm dhe parandalimit në reduktimin e mortalitetit.

Metodologjia: Ky studim është bazuar në një rishikim bibiliografik sistemik të literaturës shkencore të publikuar gjatë viteve 2000 - 2024, përfshirë artikuj nga bazat e të dhënave PubMed, ScienceDirect dhe SpringerLink. U përzgjodhën studime që trajtonin incidencën, mikrobiologjinë, menaxhimin terapeutik dhe rezultatet klinike të infeksioneve pas djegies. Te dhënat u analizuan në mënyrë krahasuese për të identifikuar faktorët kryesorë që ndikojnë në shfaqjen dhe përkeqësimin e infeksioneve.

Rezultatet dhe përfundimi: Rezultatet tregojnë se komplikimet infektive përbejnë shkakun kryesor të vdekshmërisë te pacientët me djegie të rënda, duke qenë të lidhura ngushtë me shkallën e dëmtimit të lëkurës, përqindjen e sipërfaqes trupore dhe kujdesin higjieno - sanitar spitalor. Mikroorganizmat më të zakonshëm janë Pseudomonas aeruginosa, Staphylococcus aureus, Klebsiella pneumoniae dhe kërpudhat oportuniste. Trajtimi efektiv kërkon përdorim racional të antibiotikëve, kujdes të specializuar të plagëve dhe bashkëpunim multidisiplinar.

Fjalë kyçe: djegie, infeksion, sepsë, Pseudomonas aeruginosa, komplikime, antibiotikë, trajtim.

MENAXHIMI I RRUGËVE TË FRYMËMARRJES NË SINDROMËN CROUZON (LEFORT III). CASE REPORT.

Ervin Bejko
Spitali SKZKM

Abstrakt

Hyrje: Sindroma Crouzon është një çrregullim i rrallë gjenetik i trashëguar që shkakton bashkim të parakohshëm të kockave të kafkës, duke çuar në deformime dhe të fytyrës. Karakteristikat kryesore përfshijnë një ballë të sheshtë, hipoplazi të mesit të fytyrës (mesi i fytyrës i pazhvilluar), sy të dalë (esoftalmus) dhe një hundë "me sqep". Shkaktohet nga një mutacion në gjenin FGFR2 dhe menaxhohet me ndërhyrje kirurgjikale për të ndarë kockat e kafkës, së bashku me terapi për të korigjuar problemet e shikimit, dëgjimit dhe frymëmarrjes.

Shqetësimi kryesor anestezik në sindromën Crouzon lidhet me menaxhimin e rrugëve të frymëmarrjes, kështu që ventilimi me maskë eshte i veshtire për shkak të hipoplazisë së mesit të fytyrës, proptozës dhe pranisë së distraktorëve pas një operacioni korrigjues, pasi maska mund të mos përshtatet siç duhet. Pacienti 22 vjeç, 70 kg, i ekstubuar në njësinë e kujdesit intensiv, paraqit një episod të apnesë së natës. Humbje e vetëdijes, konvulsione, mosmarrje fryme. Hemogas analiza u analizua menjëherë dhe PcO2 ishte ne nivelet e 55 mmHg. Ventilimi me maskë nuk u krye për shkak të distraktorit. Pacientit u aspirua dhe ventilimi u bë me LMA numër 4, por LMA nuk puthitej ne rruget ajrore shumë mirë. Keshtu qe u aplikua RSI me sukinilkolinë, propofol dhe fentanyl dhe pacienti u intubua me videolaringoskop me TET numër 7. Gjatë auskultimit, të dyja mushkëritë ventiloheshin bilateralisht. Pas 3 orësh nivelet e PcO2 ishin 35 mmHg dhe acidoza respiratore u korrigjua, pacienti u ekstubua dhe vazhdoi trajtimin në kujdesin intensiv.

Fjalë kyçe: menaxhim, rrugë të frymëmarrjes, Sindromën Crouzon (Lefort III) etj.

FENOMENET EPIGJENETIKE NË NIVEL MAKRO SI DHE MIKRO MOLEKULARE NË PËRGJIGJEN NDAJ STRESIT. MEKANIZMAT BAZË NDËRLIDHESE DHE KONVERGUESE.

Ervin Marku[1], Hamide Shllaku[2]
[1]*Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, UMT.*
[2]*Departamenti i laboratorit, Spitali Katolik "Zoja e këshillit të mirë", Tiranë.*

Abstrakt

Hyrje: Stresin mund ta përcaktojmë në terma të përgjithshme si përgjigje e organizmit, qoftë kjo fiziologjike apo / dhe psikologjike ndaj stimujve irritues fizik, sëmundjeve, gjëndjeve emocionale apo ndaj eksperiencave sociale dhe mjedisore në tërësine e tyre. Korrelacioni i stresit kronik me sëmundshmëritë madhore në popullatë sidomos në lëmin e problemeve të shëndetit mendor janë tashmë faktuar dhe pranuar gjerësisht. Shumë sisteme organike dhe mekanizma molekularë ndërveprojnë dhe kryqëzohen me njëra tjetrën si përgjigje ndaj stresit kronik (sistemi endokrin, sistemi imunitar, dhe sistemi nervor) dhe çrregullimet e tyre mund te çojnë në patologji të caktuara të sëmundjeve mendore. Prandaj studimet fiziologjike dhe molekulare në përgjigjen e individëve të ndryshëm ndaj stresit janë thellësisht të studjuara sot në Botë. Këtu përfshihen shumë mekanizma qelizorë dhe molekularë, faktorë gjenetik dhe epigjenetik dhe teori të ndryshme etiologjike të asaj që quhet përgjigje ndaj stresit në nivele të ndryshme dhe në kohë të ndryshme. Dukuritë epigjenetike luajnë një rol kritik në rregullimin e funksioneve nervore, jo vetëm në trurin e fëmijëve, por edhe në trurin e të rriturve. Modeli epigjenetik ofron një shpjegim të përgjithshëm për ndërtimin gradual të cënueshmërisë, i cili fillon me ekspozimin ndaj faktorëve të dëmshëm mjedisorë në periudhat e zhvillimit, kalon përmes modifikimit të shprehjes së gjeneve dhe arrin fiziologjinë qelizore dhe organike që sjell një rrezik në rritje për zhvillimin e sëmundjeve mendore.

Fjalë kyçe: stresi, shëndeti mendor, modeli epigjenetik, mekanizmat qelizor dhe molekular.

SËMUNDJET SISTEMIKE AUTOIMMUNE SI PREZANTIM I SINDROMAVE MIELODISPLAZIKE.

E. Rapushi, A. Zoto, T. Backa, V. Salko, A. Kolaci, F. Zenelaj, S. Janko
Shërbimi i Reumatologjisë, QSUNT

Abstrakt

Sëmundjet sistemike autoimune (SSAI) dhe sindroma mielodisplastike (MDS) mund të shoqërohen në afërsisht 10 - 20% të rasteve. Edhe pse ky shoqërim është njohur mirë, nuk diagnostikohet lehtë. Mekanizmi i saktë fiziopatologjik i përfshirë ende nuk është përcaktuar, por duket se është shumëfaktorial: vetë ecuria e SSAI, aktiviteti i rritur inflamator, trajtimi i SSAI me imunosupresorë, imunomodulatorë dhe preparate biologjike etj. , janë disa nga shkaqet më të shpeshta të cilat kanë nxitur fushën e kërkimit. SSAI janë gjendje patologjike që vijnë si pasojë e një mosfunksionimi të sistemit imunitar dhe që prekin 3 - 10% të popullsisë së përgjithshme. Ndër të tjera, sistemi hematopoetik mund të preket, duke çuar në citopeni periferike. MDS është një çrregullim që prek qelizat staminale të palcës së kockave. Karakterizohet nga dismielopoeza, duke prekur linjat eritroide, mieloide dhe megakariocitike në shkallë të ndryshme. Prandaj, anemia, neutropenia dhe / ose trombocitopenia janë manifestimet e saj kryesore klinike. MDS konsiderohet si një sëmundje e cila prek moshat e treta, më shpesh meshkujt, të cilët diagnostikohen rreth moshës 70 vjeç. SSAI më të shpeshta që shoqërohen apo komplikohen me MDS klasifikohen në 5 entitete: vaskuliti sistemik (PAN, GCA, Morbus Behçet, arteritis Takayasu, vaskuliti me ANCA), çrregullimet e indit lidhor (LES, sindroma Sjögren, sklerodermia sistemike), fenomenet autoimune të izoluara (AR, Gouta), anomalitë hematologjike të ndërmjetësuara nga imuniteti dhe anomalitë serologjike imunologjike asimptomatike. Studimet tregojnë që vaskuliti dhe çrregullimet e indit lidhor, të ndjekura nga artriti inflamator, janë gjendjet autoimune më të përshkruara tek pacientët me MDS. MDS dhe SSAI mund të bashkëjetojnë ose të ndërlikojnë njëra - tjetrën me një hark kohor prej muajsh deri në vite. MDS dhe SSAI kanë disa aspekte specifike epidemiologjike dhe klinike, por nuk kanë efekte të mëdha në mbijetesë. Edhe pse kjo lidhje është vërtetuar nga disa studime, ndonjëherë është e vështirë të diagnostikohet dhe MDS duhet të merret gjithmonë në konsideratë në algoritmin diagnostik të pacientëve që kanë SSAI, kur citopenia nuk mund të shpjegohet nga çrregullimet imunologjike.

Fjalë kyçe: Sëmundjet sistemike autoimune, sindroma mielodisplastike, MDS, SSAI, citopeni, palca e kockave, dismielopoeza, çrregullimet hematologjike, mekanizmi fiziopatologjik, imunosupresorë, imunomodulatorë,

preparate biologjike, vaskuliti sistemik, çrregullimet e indit lidhor, LES, sindroma Sjögren, sklerodermia sistemike.

KRITERET DIAGNOSTIKUESE PËR MORBUS BUERGER (TROMBOANGITI OBLITERANS), TE RISHIKUARA.

E. Rapushi, A. Zoto, T. Backa, A. Kolaci, F. Zenelaj, S. Janko
Shërbimi Reumatologjisë QSUNT

Abstrakt
Morbus Buerger (MB) mbetet një nga vaskulitet më sfiduese dhe diagnoza e hershme është parësore për menaxhimin efektiv të saj. Pavarësisht shumë kritereve diagnostikuese të publikuara për MB, kritere selektive janë përdorur në qendra të ndryshme vaskulare në bashkëpunim me reumatologët apo edhe me specialitetet e tjera për të menaxhuar pacientët me MB. Një studim ndërkombëtar i kohëve të fundit Delphi Consensus mbi kriteret diagnostikuese të MB tregoi se asnjë nga këto kritere diagnostikuese të publikuara nuk është pranuar universalisht si një standard i artë. Përveç pranisë së pirjes së duhanit, këto kritere diagnostikuese të publikuara kanë dallime të dallueshme midis tyre, duke e bërë të vështirë krahasimin e drejtpërdrejtë të rezultateve të pacientëve. Prandaj, komitetet e ekspertëve nga VAS - European Independent Foundation in Angiology, Vascular Medicine, EULAR, ACR dhe APLAR shqyrtuan në mënyrë kritike gjetjet nga studimi Delphi dhe dhanë rekomandime praktike mbi kriteret diagnostikuese për MB, duke lehtësuar përdorimin e tij universal. Rekomandimet janë që diagnoza "përfundimtare" e MB duhet të kërkojë praninë e tre karakteristikave (historia e pirjes së duhanit, karakteristikat tipike angiografike dhe karakteristikat tipike histopatologjike) dhe përdorimin e një kombinimi të kritereve kryesore dhe të vogla për diagnozën "e dyshuar" të MB. Kriteri kryesor është historia e pirjes së duhanit aktiv. Pesë kriteret dytësore janë fillimi i sëmundjes në moshën më pak se 45 vjeç, përfshirja ishemike e gjymtyrëve të poshtme, përfshirja ishemike e njërës ose të të dyja gjymtyrëve të sipërme, tromboflebiti migrans dhe nuanca e kuqe - blu e njollosjes vjollcë në gishtërinjtë e edematozë të këmbëve ose duarve. Ne rekomandojmë që një diagnozë e dyshuar e MB të konfirmohet në prani të një kriteri madhor plus katër ose më shumë kritereve dytësore. Në mungesë të kriterit madhor ose në rastet e më pak se katër kritereve dytësore, të dhënat e imazherisë dhe laboratorit mund të lehtësojnë diagnozën. Studimet e validimit mbi përdorimin e këtyre kritereve kryesore dhe dytësore janë duke u zhvilluar. Si përfundim nuk ka një konsensus përfundimtar për MB, klinika, të dhënat e imazherisë të mbështetura mbi ekzaminimet laboratorike (glikemia në plazmë, profili lipidik, testet e koagulimit, serologjia virale, autoantitrupat e vaskuliteve) mund të plotësojnë kuadrin e diagnozës së MB.

Fjalë kyçe: Tromboangiit obliterans, MB, ishemi, glicemi, gishtërinj të edematizuar.

UDHËRRËFYESIT E RINJ MBI MENAXHIMIN E STENOZËS SË AORTËS.

Dr. E. Shirka, Dr. Shk. H. Gjergo, Dr. A. Gjika, Prof. Dr. A. Dibra *Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"*

Abstrakt
Hyrje: Stenoza e aortës (AS) është një nga sëmundjet valvulare më të shpeshta duke prekur kryesisht popullatën mbi 65 vjeç. AS severe simptomatike e patrajtuar shoqërohet me një prognozë të keqe, me mortalitet që mund të arrijë mbi 50% brenda dy vitesh. Tradicionalisht, vendimmarrja për ndërhyrje është bazuar në shfaqjen e simptomave klinike por shumë pacientë me AS mbeten asimptomatikë deri në momentin e diagnostikimit, gjë që e bën menaxhimin e tyre sfidues. Udhërrëfyesit e rinj ESC / EACTS 2025 sjellin ndryshime të rëndësishme në diagnostikimin dhe trajtimin e AS. Një theks i veçantë i vihet ndërhyrjes së hershme, edhe tek pacientët asimptomatikë me AS severe dhe gradient të lartë, për të parandaluar dëmtimin e pakthyeshëm të miokardit dhe ngjarjet kardiake të rënda. Një tjetër ndryshim i rëndësishëm është zgjerimi i indikacioneve për TAVI (transcatheter aortic valve implantation), duke ulur pragun e moshës në ≥70 vjeç për pacientët me anatomi trikuspide, pavarësisht rrezikut kirurgjikal. Në pacientët më të rinj ose ata me valvula bikuspide, strategjia e preferuar mbetet zëvendësimi kirurgjikal i valvulës (SAVR) për shkak të qëndrueshmërisë afatgjatë. Roli i imazherisë multimodale, veçanërisht CT calcium scoring, konsiderohet si një mjet objektiv për të vlerësuar severitetin e stenozës, sidomos tek pacientët me gjetje ekokardiografike të paqarta, AS low flow - low gradient

ose forma paradoksale. Matja e kalçifikimit mund të ndihmojë në stratifikimin e rrezikut, përcaktimin e kohës optimale për ndërhyrje dhe planifikimin e ndjekjes afatgjatë. Pragjet sipas gjinisë për AS severe janë mbi 2000 njësi Agatston (AU) tek meshkujt dhe mbi 1250 AU tek femrat. Udhërrëfyesit theksojnë gjithashtu vendimmarrjen në ekip multidisiplinar, i cili përcakton trajtimin më të përshtatshëm duke marrë parasysh moshën e pacientit, sëmundjet bashkëshoqëruese, anatominë, funksionin ventrikular, preferencat e pacientit dhe strategjinë afatgjatë për menaxhimin e sëmundjes.

Fjalë kyçe: Stenoza e aortës (AS), sëmundje valvulare, pacient etj.

KUJDESI INFERMIEROR NË NJËSINË E KUJDESIT INTENSIV (ICU).

Ervis Kembora
Spitali Hygeia, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Njësia e Kujdesit Intensiv (ICU) përbën një nga ambientet më të ndërlikuara dhe dinamike të sistemit shëndetësor, ku pacientët trajtohen për gjendje kritike që kërcënojnë jetën. Roli i infermierit në këtë mjedis është vendimtar për sigurimin e stabilitetit fiziologjik, përmirësimin e rezultateve klinike dhe ruajtjen e dinjitetit njerëzor të pacientit. Kujdesi infermieror në ICU përfshin monitorimin e vazhdueshëm të funksioneve jetësore, menaxhimin e ventilimit mekanik, administrimin e terapisë medikamentoze, si dhe zbatimin rigoroz të protokolleve të parandalimit të infeksioneve spitalore. Infermierët luajnë një rol thelbësor në vlerësimin e hershëm të ndryshimeve hemodinamike, në bashkëpunimin me ekipin multidisiplinar dhe në komunikimin me familjarët e pacientëve. Edukimi i vazhdueshëm profesional, menaxhimi i stresit dhe qëndrueshmëria emocionale janë elementë të domosdoshëm për ofrimin e një kujdesi cilësor.
Konkluzione: Kujdesi infermieror në ICU është një proces kompleks që kërkon përkushtim, aftësi të avancuara klinike dhe vendimmarrje të shpejtë. Investimi në trajnimin profesional të infermierëve dhe në mbështetjen e tyre psikologjike ndikon drejtpërdrejt në sigurinë e pacientëve dhe në cilësinë e përgjithshme të shërbimit shëndetësor.

Fjalë kyçe: kujdes infermieror, terapi intensive, pacient kritik, ventilim mekanik, infeksione spitalore, komunikim multidisiplinar.

TERAPIA NEUROPROTEKTIVE NË GLAUKOMË.

Erza Jashari MD

Abstrakt
Hyrje: Glaukoma është një sëmundje kronike e syrit që përfaqëson një nga shkaqet kryesore të verbërisë në mbarë botën. Ajo karakterizohet nga dëmtimi progresiv i nervit optik, shpesh i lidhur me rritjen e presionit intraokular (PIO). Përveç trajtimeve tradicionale që synojnë uljen e PIO - së, është rritur interesi për zhvillimin e strategjive që synojnë mbrojtjen e qelizave ganglionare të retinës (QGR) nga dëmtimi dhe vdekja, duke hapur rrugë për terapitë neuroprotektive si një shtyllë shtesë në menaxhimin e kësaj patologjie.
Qëllimi: Ky punim synon të paraqesë një përmbledhje të qartë dhe të detajuar të agjentëve neuroprotektivë të përdorur në glaukomë, mekanizmat përmes të cilëve ata veprojnë, si dhe sfidat dhe perspektivat që lidhen me terapitë neuroprotektive. Përmes analizës së burimeve të ndryshme shkencore, ofrohet një pasqyrë mbi substancat ekzistuese dhe ato eksperimentale që mund të ndikojnë pozitivisht në mbrojtjen e strukturave neuronale të retinës.
Metodologjia: Për përgatitjen e kësaj teme janë shfrytëzuar punimet shkencore të botuara në revista shkencore dhe të pranishme në PubMed. Punimet e përdorura shkencore janë burim i të dhënave reprezentative dhe punime të kohëve të fundit.
Përfundime: Agjentët si citikolina, melatonina, koenzima Q10, ekstrakti i Ginkgo biloba, dhe teknologjitë inovative si terapia gjenetike dhe nanoteknologjia, paraqesin potencial të konsiderueshëm në ruajtjen e funksionit vizual dhe ngadalësimin e dëmtimit në glaukomë. Hulumtimet e mëtejshme janë të nevojshme për të vërtetuar efektivitetin klinik të këtyre ndërhyrjeve, për të optimizuar dozat, format e administrimit dhe për të

përcaktuar kombinimet më efikase. Në të ardhmen, integrimi i këtyre qasjeve me terapitë tradicionale mund të përmirësojë ndjeshëm trajtimin dhe prognozën e pacientëve me glaukomë.

Fjalë kyçe: Glaukoma, neuroproteksion, citikolina, Ginkgo biloba.

KARCINOMA GASTRIKE, DIAGNOZA, KLASIFIKIMI DHE MENAXHIMI.

Erza Vrapcani

Abstrakt

Hyrje: Karcinoma gastrike paraqet malinjitetin e katërt më të zakonshëm në gjithë botën, dhe sot zë vendin e dytë pas kancerit pulmonar, si shkaktar i vdekjeve nga kanceri. Çdo vit diagnostikohen rreth 990. 000 njerëz, prej të cilëve rreth 738. 000 vdesin. Faktorët e riskut që ndikojnë në shfaqjen e këtij kanceri përfshijnë infeksionin me Helicobacter pylori, dietën e pasur me kripë dhe konservantë, konsumimin e duhanit dhe faktorët gjenetikë. Pavarësisht përmirësimit të metodave diagnostikuese dhe të stadifikimit, shumica e karcinomave diagnostikohet në faza të avancuara të tumorit. Kështu që rezultatet e trajtimit pas operacionit, i cili ende mbetet si terapia e zgjedhur, mbeten zhgënjyese me norma të përgjithshme të mbijetesës 5 - vjeçare prej rreth 20 - 25% edhe pas procedurave të zgjeruara rezektive.

Qëllimi: Ky punim ka për qëllim të përcaktoj numrin e pacientëve me karcinomë gastrike të trajtuar në klinikën e Kirurgjisë Abdominale, në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, për periudhën trevjeçare 2021 - 2023, të zbuloj karakteristikat epidemiologjike të rasteve, identifikoj moshat më të prekura dhe të determinoj metodat e trajtimit kirurgjik të përdorura.

Matodologjia: Hulumtimi është i tipit retrospektiv - deskriptiv dhe për realizimin e tij janë mbledhur të dhënat nga protokolet e klinikës së Kirurgjisë Abdominale QKUK. Përpunimi i të dhënave është bërë me anë të programit Microsoft Excel dhe paraqitja e rezultateve është bërë me anë të tabelave dhe grafikoneve.

Rezultate: Gjatë periudhës 2021 - 2023, në klinikën e Kirurgjisë Abdominale në QKUK janë trajtuar gjithsej 9725 pacientë ku prej tyre 109 janë diagnostikuar me karcinomë gastrike. Ndër ta 72 i përkisnin gjinisë mashkullore duke përbërë një përqindje dukshëm më të lartë (66, 1%) krahasuar me femrat të cilat ishin vetëm 37 (33, 9%). Pas analizimit të moshës del se numri më i madh i pacientëve i takon grupmoshës 61 - 80 vjet me 62. 4%, pasuar nga grupmosha 41 - 60 vjet me 34. 9%, ndërsa numri më i vogël i pacientëve është në grupmoshat e reja nën 40 vjet me vetëm 0. 9%. Sa i përket procedurave kirurgjikale të cilat i'u nënshtruan pacientët me karcinomë, 85. 3% e tyre ishin rezeksion i lukthit, 12. 8% laparotomi eksplorative me biopsi dhe 1. 8% realizim i stomës nutritive.

Përfundime: Prognoza për karcinomën gastrike mbetet ende e dobët, me shkallë të mbijetesës që varet në mënyrë të konsiderueshme nga stadi i sëmundjes dhe disponueshmëria e opsioneve të trajtimit.

Fjalë kyçe: karcinoma, gastrike, grupmosha, Helicobacter pylori, kirurgji.

KARAKTERISTIKAT KLINIKE DHE EPIDEMIOLOGJIKE TË VËREJTURA NË TË SËMURËT ME COVID - 19 GJATË PANDEMISË.

Esi Duka, Najada Como.
Shërbimi i Sëmundjeve Infektive, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë.

Abstrakt

Hyrje: COVID - 19 është një sëmundje respiratore e shkaktuar nga virusi SARS - CoV - 2, tip i coronavirusit që shkaktoi pandeminë e COVID - 19. Sëmundja përhapet nëpërmjet spërklave respiratore. Simptomat variojnë nga të lehta dhe të ngjashme me ftohjen dhe deri në të rënda dhe kërcënuese për jetën.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është paraqitja e karakteristikave klinike dhe epidemiologjike në të sëmurët me COVID - 19 gjatë periudhës së pandemisë në shërbimin e Sëmundjeve Infektive.

Metoda: Në këtë studim retrospektiv janë përfshirë 1001 pacientë me COVID - 19 të hospitalizuar në shërbimin e Sëmundjeve Infektive gjatë periudhës 9 mars - 31 dhjetor 2020. Të dhënat janë marrë në shërbimin e Statistikës në QSUNT. Analizimi i të dhënave është realizuar duke përdorur SPSS 26. 0.

Rezultate: Në këtë studim, 65% ishin meshkuj dhe 35% ishin femra. Mosha mesatare e popullatës është 60. 4 ± 13. 9 [mesatare (Me) 62, IQR: 18 vjeç]. Mosha mesatare e popullatës për femrat është 60. 5 ± 13. 5, p= 0. 782. Mosha mesatare e popullatës për meshkujt është 60. 3 ± 14. 1, p= 0. 782. Simptomat më të përhapura që u vunë re ishin dispnea, kolla e thatë dhe dobësia trupore.
Konkluzione: Në popullatën e marrë në studim, meshkujt dominojnë me 65 %. Nga simptomat klinike dominoi dispnea në 77% të rasteve e ndjekur nga kolla e thatë me 67% të rasteve dhe dobësia trupore me 63. 8% të rasteve.

Fjalë kyçe: COVID - 19, SARS - CoV - 2, pandemia, dispnea.

SFIDAT MENAXHUESE NË STADET E AVANCUARA TË HIV / AIDS.
[1, 2]Esmeralda Meta, [2]Marina Parllaku, [2]Blerina Koprencka, [1]Mirela Rexhepi, [1]Alma Sallahu, [1, 2]Pavllo Djamandi, [1]Ergeta Ktona.
[1]QSUT, [2]Spital Continental, Tiranë.

Abstrakt
Hyrje: Pacientët HIV / AIDS i nënshtrohen një menaxhimi afatgjatë dhe një procesi kompleks mjekësor. Këta subjekte janë nga pikëpamja klinike, sociale, dhe emocionale të brishtë, përballen me shumë sfida dhe shpesh stigmatizohen. Në vlerësimin e manifestimeve neurologjike në kontekstin e HIV, diagnoza diferenciale përcaktohet nga faza e infeksionit HIV, historia e trajtimit të mëparshëm, aderenca me medikamentet dhe të dhënat objektive të përfshirjes së sistemit nervor, qendror dhe / ose periferik. Komplikacionet neurologjike të HIV - it vazhdojnë të prekin zakonisht njerëzit që jetojnë me HIV në epokën pas terapisë së kombinuar antiretrovirale. Spektri i këtyre çrregullimeve është i larmishëm, duke përfshirë sistemin nervor qendror dhe sistemin nervor periferik, shpesh njëkohësisht. Në erën e ART - ve, infeksionet oportuniste të SNQ kanë rënë ndjeshëm, megjithatë ato vazhdojnë të shkaktojnë morbiditet dhe vdekshmëri të konsiderueshme tek personat që jetojnë me HIV, veçanërisht tek ata që nuk janë të vetëdijshëm për statusin e tyre HIV. Ndër IO më të hasura janë Toxoplasmosis, Criptokokoza, CMV, Herpes viruset, VZV, PML, Aspergilozat, TBC, Limfomat primare të SNQ, Mielite transverse, Polineuropati demilenizante inflamatore akute dhe kronike. Imunosupresioni i rëndë, ngarkesa e lartë virale e HIV - it, mosha avancuar në diagnozën e Infeksioneve oportuniste indikojnë mbijetesë të shkurtër dhe vdekshmëri të lartë, ashtu si edhe paraqitja e vonë dhe / ose mosrespektimi i ART - së.

Fjalë kyçe: HIV / AIDS, SNQ, oportunisma.

EFEKTIVITETI I KINESIO TAPING NË REDUKTIMIN E DHIMBJES DHE PËRMIRËSIMIN E FUNKSIONIT TEK SPORTISTËT, NJË RISHIKIM I LITERATURËS.
Esmeralda Novruzaj

Abstrakt
Hyrje: Kinesio Taping (KT) është një metodë terapeutike që përdor shirita elastikë për të mbështetur muskujt, përmirësuar propriоceptivitetin dhe reduktuar dhimbjen. Ky rishikim literaturor analizon efektivitetin e KT në reduktimin e dhimbjes dhe përmirësimin e funksionit tek sportistët dhe individët me çrregullime muskuloskeletore. Metodologjia përfshin një analizë sistematike të studimeve eksperimentale, rishikimeve sistematike dhe meta - analizave të publikuara midis viteve 2010–2025, të identifikuara përmes bazave të të dhënave PubMed, PEDro dhe Google Scholar. Nga 120 artikuj të shqyrtuar, 25 studime u përfshinë bazuar në kriteret e përshtatshmërisë. Rezultatet tregojnë se KT ofron lehtësim afatshkurtër të dhimbjes (20–30% reduktim në studime të ndryshme) dhe përmirësim subjektiv të stabilitetit, veçanërisht tek sportistët me lëndime të lehta muskuloskeletore. Megjithatë, efektet mbi forcën muskulare, performancën sportive dhe funksionin afatgjatë mbeten të paqarta dhe të ndryshueshme, me disa studime që raportojnë mungesë të ndryshimeve objektive. KT shfaqet më efektive si metodë mbështetëse në rehabilitim, por jo si trajtim primar. Kufizimet përfshijnë kampione të vogla, heterogjenitetin e teknikave të aplikimit dhe efektin e mundshëm placebo. Përfundimet sugjerojnë që KT mund të integrohet në programe rehabilitimi për lehtësim afatshkurtër dhe përmirësim të perceptimit të stabilitetit, por nevojiten studime më të mëdha dhe afatgjata për të vërtetuar efektivitetin e tij.

Metodologjia: Ky rishikim literaturor ndjek një qasje sistematike për të analizuar provat ekzistuese mbi efektivitetin e Kinesio Taping. Bazat e të dhënave dhe fjalët kyçe. Bazat e të dhënave: PubMed, PEDro, Google Scholar.
Përfundime: Kinesio Taping ofron lehtësim afatshkurtër të dhimbjes dhe përmirësim subjektiv të stabilitetit tek sportistët dhe individët me çrregullime muskuloskeletore. Megjithatë, efektet e tij mbi forcën muskulare dhe performancën afatgjatë janë të kufizuara dhe të ndryshueshme. KT është më efektive si një metodë mbështetëse brenda një programi të integruar rehabilitimi dhe nuk duhet të konsiderohet trajtim primar. Për të konfirmuar përfitimet dhe për të standardizuar aplikimin, nevojiten studime më të mëdha, me metodologji rigoroze dhe ndjekje afatgjata.

Fjalë kyçe: Kinesio Taping, dhimbje muskuloskeletore, fizioterapi sportive, performancë funksionale, rehabilitim.

NDIKIMI I MIKROBIOMËS TE KANCERI.
Dr. Esmralda Sera
Onkologe

Abstrakt
Hyrje: Mikrobioma njerëzore është një ekosistem kompleks që ndikon në homeostazën e organizmit dhe në patogjenezën e shumë sëmundjeve, përfshirë kancerin. Evidencat e fundit tregojnë se disbioza intestinale shoqërohet me rritjen e inflamacionit kronik, modulimin e përgjigjes imune dhe prodhimin e metabolitëve prokancerogjenë, të cilët kontribuojnë në karcinogjenezë, veçanërisht në kancerin kolorektal. Po ashtu, ndryshimet në mikrobiomën orale janë lidhur me incidencë të shtuar të kancereve të kokës dhe qafës. Roli i mikrobiomës nuk kufizohet vetëm në zhvillimin e tumorit, por shtrihet edhe në ndikimin mbi efikasitetin e trajtimeve onkologjike, përfshirë imunoterapinë dhe kimioterapinë. Këto të dhëna hapin perspektiva të reja për aplikimin e strategjive terapeutike inovative, si modulimi i mikrobiomës përmes probiotikëve, prebiotikëve, transplantit fekal dhe dietës së personalizuar, me qëllim rritjen e përgjigjes terapeutike dhe përmirësimin e mbijetesës. Kuptimi i mekanizmave të ndërveprimit mikrob–tumor mbetet një fushë premtuese për zhvillimin e onkologjisë së personalizuar.

Fjalë kyçe: mikrobiomë, kancer, pacient etj.

FIZIOTERAPIA DERMATOFUNKSIONALE: RËNDËSIA E MICRONEEDLING DHE RADIOFREKUENCËS.
MSc. Esmeralda Sheqi[1], Dr. Migena Gega[2]
[1]Fizioterapiste, [2]Dermatologe

Abstrakt
Hyrje: Fizioterapia dermatofunksionale përfaqëson një nën - degë të re dhe në zhvillim të fizioterapisë, e cila fokusohet në përmirësimin estetik dhe funksional të lëkurës përmes teknikave minimale invazive. Ky punim synon të paraqesë rëndësinë e dy metodave kryesore - microneedling dhe radiofrekuenca - të cilat kanë treguar rezultate të dukshme në stimulimin e rigjenerimit të lëkurës, rritjen e prodhimit të kolagjenit dhe elastinës, si dhe përmirësimin e shenjave të plakjes dhe dëmtimeve të lëkurës. Gjithashtu, theksohet roli i fizioterapistit dermatofunksional në aplikimin e sigurt dhe efektiv të këtyre procedurave. Përdorimi i pajisjeve të avancuara që kombinojnë microneedling me radiofrekuencën (si teknologjitë Vivace dhe Morpheus8) përfaqëson një hap inovativ që rrit efikasitetin terapeutik dhe redukton kohën e rikuperimit. Konkluzionet e këtij punimi nënvizojnë potencialin e madh të kësaj fushe në integrimin e saj në praktikën klinike dhe në arsimin universitar të fizioterapisë në Shqipëri dhe më gjerë.
Metodologjia: Ky punim është bazuar në një rishikim të literaturës shkencore dhe në përvojën klinike të fituar në praktikën e dermoestetikës. Janë analizuar studime ndërkombëtare që mbështesin përdorimin e microneedling dhe radiofrekuencës në përmirësimin e cilësisë së lëkurës. Gjithashtu, është vlerësuar përdorimi i teknologjive të kombinuara për të rritur efikasitetin terapeutik.

Rezultate: Microneedling ka treguar se përmirëson dukshëm strukturën e lëkurës përmes stimulimit të prodhimit të kolagjenit dhe elastinës. Indikacionet kryesore përfshijnë trajtimin e shenjave të akneve, rrudhave të imëta, strijave dhe dëmtimeve nga dielli. Nga ana tjetër, radiofrekuenca ndikon në ngrohjen e thellë të dermës, duke nxitur kontraktimin e fibrave ekzistuese dhe stimulimin e prodhimit të ri të kolagjenit, me efekte të dukshme në tonin dhe elasticitetin e lëkurës. Kombinimi i të dyjave, si në rastin e pajisjeve Vivace dhe Morpheus8, ofron rezultate optimale duke përshpejtuar procesin e rigjenerimit dhe duke reduktuar kohën e rikuperimit. Evidenca klinike dhe kënaqësia e pacientëve mbështesin përdorimin e këtyre metodave si të sigurta dhe efektive.
Konkluzione: Fizioterapia dermatofunksionale, përmes teknikave si microneedling dhe radiofrekuences, përfaqëson një fushë inovative dhe me potencial të madh zhvillimi. Rezultatet klinike dëshmojnë përmirësime të dukshme estetike dhe funksionale, ndërkohë që kombinimi i këtyre metodave jep efekte të dukshme. Për këtë arsye, është e nevojshme që kjo nën - degë të promovohet dhe të integrohet më tej në programet universitare të fizioterapisë dhe në praktikën klinike në Shqipëri.

Fjalë kyçe: fizioterapia dermatofunksionale, microneedling, radiofrekuencë, rigjenerim, kolagjen, lekura, antiage.

SFIDAT E ANESTEZISË INFANTILE NË URGJENCAT KIRURGJIKALE: PËRVOJA KLINIKE MBI 70 RASTE DHE MENAXHIMI ENDOSKOPIK I NJË RASTIT TË RRALLË TË GËLLTITJES SË TRUPAVE TË HUAJ MAGNETIKË

Estela Muho MD[1], Krisli Serani MD[1], Prof. asc. Majlinda Naço[1], Prof. asc. Alma Cani, Prof. Krenar Lilaj
[1]*Shërbimi i Anestezi Reanimacion, QSUT*

Abstrakt
Hyrje: Anestezia infantile në urgjencat kirurgjikale mbart sfida të veçanta për shkak të fiziologjisë së ndryshme të fëmijëve, kufizimeve të bashkëpunimit, vështirësive në vlerësim klinik të shpejtë dhe rrezikut të lartë për destabilizim hemodinamik e respirator. Qasja anestezike duhet të jetë e menjëhershme, individualizuar dhe multidisiplinare. Në këtë punim paraqesim përvojën tonë me 70 raste urgjente pediatrike gjatë periudhës janar–maj 2025, si dhe analizojmë një rast unik që u menaxhua me sukses nëpërmjet anestezisë për procedurë endoskopike.
Materiale dhe Metoda: U përfshinë 70 pacientë pediatrikë të moshës 8 muaj deri në 13 vjeç, të paraqitur në urgjencë me diagnoza që kërkonin ndërhyrje të menjëhershme: apendicit akut, volvulus intestinal, invaginacion intestinal, trup të huaj të traktit tretës dhe testikuj të ngujuar me torsion. Për çdo rast u dokumentuan: qasja anestezike, agjentët e përdorur, stabiliteti hemodinamik intra - dhe post - operator, si dhe komplikacionet e mundshme.
Rasti Klinik: Një vajze 3 vjeç, pa histori mjekësore të veçantë, u paraqit me dhimbje barku, të vjella dhe pamundësi për jashtëqitje. Radiografia abdominale zbuloi praninë e *64 rruazave magnetike* të gëlltitura, të grupuara në zorrën e hollë dhe stomak. Rreziku për perforim ose fistulizim intestinal ishte i lartë. U krye endoskopi nën anestezi gjenerale me monitorim të avancuar. Procedura zgjati 55 minuta dhe trupat e huaj u nxorën të gjithë pa komplikacione. Pacienti u extubua në sallë dhe u transferua në pediatri me rikuperim të plotë.
Rezultate: Nga 70 rastet, 64 procedura u realizuan me anestezi të përgjithshme, 6 me sedacion të thellë. Në 90% të rasteve nuk pati komplikacione anestezike të rëndësishme. Sfidat më të shpeshta përfshinin: vështirësi në sigurimin e aksesit venoz, intubim të vështirë, bronkospazëm dhe labilitet tensioni.
Përfundime: Anestezia në urgjencat infantile kërkon përgatitje të lartë, vlerësim të shpejtë dhe bashkëpunim të ngushtë me kirurgët dhe pediatrët. Raste të rralla si gëlltitja masive e trupave të huaj kërkojnë vendimmarrje të shpejtë dhe përdorimin e teknikave minimale invazive me siguri maksimale për pacientin.

Fjalë kyçe: anestezia infantile, urgjenca kirurgjikale, sfida etj.

ABDOMINOPLASTIKA SI PROCEDURË FUNKSIONALE DHE ESTETIKE: INDIKACIONET DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES SË PACIENTËVE.

Dr. Ester Tabaku[1], Dr. Rezarta Kapaj[2]
[1]*Shërbimi i Djegie - Plastikës, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë*
[2]*Spitali Amerikan 2*

Abstrakt

Hyrje: Abdominoplastika, e njohur gjerësisht si "heqja e dhjamit të barkut", është një ndërhyrje kirurgjikale që shkon përtej qëllimit estetik, duke sjellë një përmirësim të ndjeshëm në aspektin funksional, fizik dhe psikologjik të pacientit. Përveç riformësimit të kontureve të barkut dhe rikthimit të një siluete të harmonizuar trupore, kjo procedurë ndikon në qëndrueshmërinë e muskujve të trungut (core stability), përmirëson posturën dhe redukton shqetësimet e shkaktuara nga lëkura e tepërt. Në shumë raste, abdominoplastika nuk shihet vetëm si një zgjedhje estetike, por si një zgjidhje funksionale që rrit komoditetin dhe cilësinë e jetës së përditshme. Indikacionet për këtë ndërhyrje përfshijnë prani të lëkurës së tepërt apo të varur në murin abdominal, diastazë të muskujve rectus abdominis, deformime pas ndërhyrjeve të mëparshme kirurgjikale, si dhe dobësi të strukturës muskulore që ndikon në posturë dhe funksionalitet. Ajo rekomandohet gjithashtu për pacientët që kanë pësuar humbje të konsiderueshme në peshë (p. sh. pas ndërhyrjeve bariatrike si gastric sleeve) dhe për gratë pas shtatzënisë, ku rikthimi i formës së barkut dhe riparimi i muskujve përbëjnë një aspekt të rëndësishëm të rikuperimit trupor.

Materiale dhe Metoda: Studimi përfshin periudhën Prill 2024 – Shtator 2025. Në total u përfshinë 38 paciente, nga të cilat 90% ishin femra, me një moshë mesatare 37 vjeç. Pjesa më e madhe e pacientëve ishin italiane; ndër to, disa kishin kryer më parë kirurgji bariatrike (post - gastric sleeve) dhe kërkonin korrigjimin e lëkurës së tepërt, ndërsa të tjera e zgjodhën ndërhyrjen si një metodë për riformësim trupor. Procedurat e aplikuara përfshinë panniculectomy, liposuction me teknologjinë VASER dhe riparimin e diastazës me teknikën corset - tight. Të gjitha rastet u trajtuan në Spitalin Amerikan, ku u realizua vlerësimi preoperator (analizat laboratorike dhe ekzaminimet imazherike), ndërhyrja kirurgjikale dhe ndjekja postoperator.

Rezultate: Vlerësimi postoperator tregoi përmirësim të dukshëm në simetrinë trupore, forcimin e murit abdominal dhe rritjen e kënaqësisë subjektive të pacientëve me pamjen e re trupore. U theksua rëndësia e përzgjedhjes së kujdesshme të pacientëve, pasi duhanpirësit, pacientët me varice, ata me BMI të lartë, me ndërhyrje të mëparshme në abdomen apo me moshë të avancuar, paraqesin rrezik më të shtuar për komplikacione. Pacientet me spirale intrauterine apo në trajtim hormonal u këshilluan të ndërprisnin terapinë për rreth pesë javë para ndërhyrjes për të shmangur efektet mbi koagulimin dhe procesin e shërimit.

Përfundime: Abdominoplastika paraqitet si një procedurë me ndikim të shumëfishtë, që ndërthur përfitime estetike dhe funksionale. Rezultatet e studimit theksojnë rëndësinë e përgatitjes preoperative, përzgjedhjes së kujdesshme të pacientëve dhe menaxhimit individual të faktorëve të rrezikut. Përmes një qasjeje multidisiplinare dhe teknikave moderne kirurgjikale, është e mundur të arrihen rezultate të qëndrueshme, me përmirësim të dukshëm në cilësinë e jetës dhe vetëvlerësimin e pacientëve.

Fjalë kyçe: Abdominoplastikë, panniculectomy, diastazë, liposuksion VASER, riparim muskulor, përfitime funksionale, pacientë bariatrikë, kirurgji estetike.

KARCINOMA BAZOCELULARE PERIOKULARE: PARAQITJA KLINIKE, TRAJTIMI KIRURGJIKAL DHE REZULTATET REKONSTRUKTIVE.

Dr. Etleva Gjurashaj [1], Dr. Migena Beqiri
[1]*Oftalmokirurge, Spitali "Nënë Tereza", Tiranë.*

Abstrakt

Hyrje: Karcinoma bazocelulare (BCC) është tumori malinj më i shpeshtë i palpebrës, që përbën rreth 90% të malinjiteteve të kësaj zone. Këndet mediale dhe palpebrat e poshtme janë më të prekura për shkak të ekspozimit kronik ndaj rrezeve ultraviolet dhe strukturës së hollë të lëkurës periokulare. Edhe pse metastazat janë të rralla, trajtimi i vonuar mund të shkaktojë invazion lokal, dëmtim të indeve dhe humbje funksionale.

Qëllimi: Të paraqiten raste të karcinomës bazocelulare periokulare të trajtuara kirurgjikisht, duke theksuar karakteristikat diagnostike, teknikat e ekscizionit dhe qasjet rekonstruktive për rikthimin e funksionit dhe estetikës.

Metodologjia: Pacientët me lezionet e dyshimta u trajtuan me ekscizion të plotë kirurgjikal me vlerësim të kufijve intraoperativ (me seksione të ngrira ose teknikë Mohs). Rikonstruksioni u realizua përmes mbylljes direkte, lëkurë - lëvizëse (flap) ose rrotulluese lokale, në varësi të madhësisë dhe lokalizimit të defektit. Në ndjekjen pas operacionit u vlerësuan pozicioni i palpebrës, funksioni i kanalit të lotit dhe rikthimi i mundshëm i lezionit.
Rezultate: Të gjitha lezionet u konfirmuan histologjikisht si BCC nodulare ose ulcerative. Këndi medial ishte lokalizimi më i shpeshtë. U arritën kufij të pastër kirurgjikal në të gjitha rastet. Rikuperimi pas operacionit ishte pa komplikacione, me ruajtje të plotë të funksionit të palpebrës dhe rezultate kozmetike shumë të mira. Nuk u evidentuan rikthime gjatë periudhës 6–12 mujore të ndjekjes.
Përfundimi: Diagnoza e hershme dhe ekscizioni i plotë janë thelbësorë për parandalimin e dëmtimeve lokale nga karcinoma bazocelulare. Teknikat e përshtatshme rekonstruktive mundësojnë rezultate optimale funksionale dhe estetike. Ndjekja afatgjatë është e rëndësishme, veçanërisht për lezionet në këndin medial ku rreziku i rikthimit është më i lartë.

Fjalë kyçe: Karcinoma bazocelulare, tumori i palpebrës, këndi medial, kirurgji okuloplastike, rikonstruksion.

KLASIFIKIMI DHE DIAGNOSTIKIMI I ANGIOEDEMËS HEREDITARE.

Etleva Qirko Loloci
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Abstrakt
Hyrje: Angioedema e trashëguar (HAE) është një çrregullim i rrallë, autosomal dominant, i karakterizuar nga episode të përsëritura të edemes subkutane dhe / ose submukoze. Literatura e kohëve të fundit ka fokusuar përpjekjet për përmirësimin e strategjive diagnostikuese dhe sistemeve të klasifikimit për të rritur zbulimin dhe menaxhimin e hershëm.
Metodologjia: U krye një rishikim i gjithanshëm i literaturës, duke analizuar studime të publikuara midis 2015 dhe 2025. U përdorën databaza si kryesore si PubMed dhe ScienceDirect me terma si "diagnostikimi i Angioedemës së Trashëguar", "klasifikimi i HAE", dhe "deficiti i C1 inhibitorit". Studimet u selektuan bazuar në relevancën, rigorozitetin metodologjik dhe kontributin aktual.
Rezultate: HAE klasifikohet në tre tipe kryesore. Tipi I karakterizohet nga nivele të ulëta të C1 esterase inhibitorit funksional (C1 - INH), ndërsa Tipi II shfaq nivele normale ose të larta të C1 - INH por ai paraqitet me funksion jo normal. Tipi III ndodh megjithëse nivelet e C1 - INH janë normale dhe shpesh lidhet me mutacione në gjenin F12. Gjatë dekadës së fundit nje rol te rëndësishëm luan edhe zhvillimi i sistemeve të vlerësimit klinik, si Shkalla e Vlerësimit të Diagnostikimit të Angioedemës së Trashëguar (HADES), e cila integron historinë e pacientit dhe tiparet klinike për të mbështetur diagnozën. Testimi gjenetik gjithashtu ka marrë një rol thelbësor, veçanërisht në rastet atipike ose të paqarta, duke mundësuar konfirmim më të saktë të diagnozes, tipit te angioedemes dhe kesisoj edhe vendimeve terapeutike të përshtatshme.
Përfundime: Diagnoza e hershme dhe e saktë e HAE është thelbësore për menaxhimin efektiv. Integrimi i sistemeve të vlerësimit klinik dhe testimit gjenetik ka përmirësuar ndjeshëm saktësinë diagnostikuese, ndërsa hulumtimet e vazhdueshme mbi fiziopatologjinë dhe opsionet e trajtimit vazhdojnë të përmirësojnë rezultatet për pacientët.

Fjalë kyçe: HAE, HADES, diagnose etj.

VLERA KLINIKE E D - DIMERIT NË DIAGNOZËN SPITALORE. RIVLERËSIMI I PËRDORIMIT TË TESTIT NË PERIUDHËN POST - COVID.

Etleva Refatllari; Eva Luniku

Abstrakt
Hyrje: D - dimeri është një produkt degradimi i fibrinës, që përdoret gjerësisht si biomarker për diagnostikimin ose përjashtimin e tromboembolisë venoze. Megjithatë, specificiteti i tij është i kufizuar, pasi nivelet e larta mund të pasqyrojnë gjithashtu procese inflamatore, infektive apo dëmtime organike, veçanërisht tek pacientët

nefropatë. Në këtë kontekst, qëllimi i studimit ishte të vlerësonte shpërndarjen e vlerave të D - dimerit dhe lidhjen e tyre me parametra laboratorikë e klinikë te pacientët nefropatë në periudhën post - COVID.
Metodologjia: U realizua një studim retrospektiv deskriptiv–observacional në Shërbimin e Nefrologjisë në QSUNT gjatë periudhës janar–mars 2025. U përfshinë 55 pacientë me vlera të D - dimerit >0. 5 µg / mL. U mblodhën të dhëna demografike, klinike dhe laboratorike. Analiza statistikore u realizua me programin JASP (Jeffreys's Amazing Statistics Program) dhe përfshijnë metoda deskriptive dhe teste krahasimore për të dhënat e shpërndara jo - normalisht (Mann–Whitney U, Spearman rho).
Rezultate: Mesatarja e vlerës së D - dimerit ishte 4. 5 µg / mL, me rritje të konsiderueshme edhe në mungesë të trombozës së konfirmuar (vetëm 1. 8% e rasteve). Nuk u identifikuan dallime statistikisht të rëndësishme sipas insuficiencës renale akute, sëmundjes renale kronike, dyshimit klinik për trombozë apo dializës. Korelacionet treguan lidhje më të forta me CRP, urenë dhe leukocitet, duke sugjeruar se rritja e D - dimerit reflekton më shumë inflamacionin sistemik dhe dëmtimin renal se sa prani të trombozës.
Diskutime: Rezultatet përputhen me literaturën ndërkombëtare, e cila thekson se interpretimi i D - dimerit duhet bërë gjithmonë në kontekstin klinik, duke pasur parasysh specificitetin e kufizuar dhe faktorët komorbidë.
Konkluzione: Rritja e D - dimerit te pacientët nefropatë lidhet kryesisht me procese inflamatore dhe dëmtime organike, ndërsa roli i tij si tregues i drejtpërdrejtë i ngjarjeve trombotike mbetet i kufizuar.

Fjalë kyçe: D - dimer, tromboza venoze, trombembolia pulmonare, COVID - 19, QSUNT.

VLERËSIMI KARDIAK TEK ATLETËT: NJË RISHIKIMI I BAZUAR NË UDHËRREFYESIT E SHOQATES EVROPIANE TE KARDIOLOGJISË.
Eva Muja (Duraku), Ambra Kanani, Ilirian Laci
Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Spitali Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"

Abstrakt
Hyrje: Zemrat e atletëve përshtaten me stërvitjen në mënyra që mund të ngjajnë me sëmundjen. Ndërsa vdekja e papritur kardiake (SCD) në sport është e rrallë, ndikimi i saj është shkatërrues dhe vlerësimi i sigurt dhe i shpejtë, është thelbësor.
Qëllimi: Të përmbledhë rekomandimet e Shoqërisë Evropiane të Kardiologjisë (ESC) të vitit 2020 për vlerësimin kardiologjik të atletëve.
Metoda: Rishikim i bazuar në udhëzime që mbulon shqyrtimin kryesor (histori, ekzaminim fizik, EKG, ekokardiografi), imazheri të avancuar (CMR, CT), testim funksional, bioshënjues dhe udhëzime specifike për sëmundjen.
Rezultate: ESC promovon një qasje hap pas hapi: filloni me anamnezen, ekzaminimin dhe EKG - në me 12 derivacionee; shtoni ekokardiografinë nëse shfaqen ndryshime; përdorni MRI ose CT në raste të paqarta; përdorni proven ushtrimore dhe monitorimin Holter për të zbuluar aritmitë ose isheminë. Këshillat specifike për sëmundjen përfshijnë kufizim të rreptë në ARVC, lehtësim të përshtatur në HCM dhe sëmundje kongjenitale të zemrës, dhe 3 - 6 muaj përjashtim nga sporti pas miokarditit. Mjetet në zhvillim (IA, pajisjet e veshshme, gjenetika) janë premtuese, por ende nuk janë rutinë.
Konkluzion: Udhëzimet e ESC mbështesin vlerësimin individual që parandalon vdekjen kardiake të papritur duke shmangur kufizimet e panevojshme. Ky ekuilibër siguron që atletët të mund të marrin pjesë në mënyrë të sigurt, me vendimmarrjen e përbashkët në qendër të procesit.

Fjalë kyçe: ESC, atlet, zemra, rishikim kardiologjik etj.

URGJENCA KOMBËTARE MJEKËSORE.
Eva Gjoka, Dr. Svetllana Bitinicka

Abstrakt
Hyrje: Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore në Shqipëri menaxhon numrin unik kombëtar 127, i cili është linja e emergjencës për ndihmën mjekësore të shpejtë në të gjithë territorin e vendit. Ky shërbim funksionon 24 orë në ditë, duke pranuar thirrjet emergjente, vlerësuar situatat në kohë reale dhe koordinuar ndërhyrjen e

menjëhershme për të ofruar ndihmën e parë dhe transportin në spital kur është e nevojshme. Stafi i urgjencës është i trajnuar profesionalisht dhe përditësohet me praktikat më të fundit për të garantuar shërbim cilësor dhe akses të menjëhershëm mjekësor për çdo qytetar, pavarësisht vendndodhjes së tij. Ambulancat më të afërta arrijnë shpejt në vendngjarje ku ofrojnë ndihmën fillestare dhe vlerësimin e nevojës për trajtim të mëtejshëm. Qëllimi kryesor i Urgjencës Kombëtare 127 është të shërbejë si një urë lidhëse midis qytetarëve dhe sistemit shëndetësor në raste emergjencash, duke siguruar reagim të shpejtë dhe koordinim optimal për çdo rast urgjent në Shqipëri, duke qenë një element kyç i sistemit shëndetësor kombëtar për menaxhimin e emergjencave mjekësore.

Fjalë kyçe: emergjencë, ndihmë mjekësore, staf etj.

JETA E MIRË NIS ME USHQYERJEN ME GJI.

Dr, Evelina Balliu, Dr. Stela Prifti
Njësia vendore e kujdesit shëndetësor, Durrës.

Abstrakt
Qëllimi: Qëllimi i këtij prezantimi është të advokojmë për rëndësinë e ushqyerjes me gji.
Metoda: Ky prezantim është bazuar në analizën e informacionit shëndetësor në bashkëpunim me 18 QSH. Gjithashtu, ky prezantim është bazuar në dokumenta strategjik të OBSH–së, Unicef, MSHMS, ISHP.
Rezultate: Ne kemi indikator të ushqyerjes me gji të krahasueshëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Shumë aktorë lokalë janë përfshirë në cështjet e ushqyerjes së shëndetshme.
Konkluzion: Sot, të gjithë ia kanë kushtuar vëmendjen shëndetit si një faktor kyç në zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe njerëzor të shoqërisë në nivel global, rajonal, kombëtar dhe lokal. Dhe një jetë e mirë fillon me ushqyerjen e mirë. Përmirësimi i indikatorëve të ushqyerjes ekskluzive me gji mbetet një përparësi për ne për të përmirësuar ushqyerjen, për të parandaluar vdekshmërinë dhe, në planin afatgjatë, për të parandaluar sëmundjet jo - ngjitëse (SJT). Ushqyerja e shëndetshme përmirësohet kur institucionet shëndetësore dhe jo - shëndetësore, mbi të gjitha qeverisja vendore, bashkohen.

Fjalë kyçe: ushqyerje me gji, vëmendje, indikator etj.

SINDROMI HEMORAGJIK ME PNEUMORAGJI TEK NJË NEONAT NË TERM: PREZANTIM RASTI.

Evelina Kreko[1], Alketa Hoxha[2]
[1]*Neonatologe SUOGJ Koco Gliozheni, Tiranë*
[2]*Shef e Shërbimit të Neonatologjisë UM, Tiranë*

Abstrakt
Hyrje: Sindromi hemoragjik në periudhën neonatale është një gjendje potencialisht fatale, shpesh e lidhur me prematuritetin, trauma obstetrikale ose çrregullime koagulimi. Paraqitja e saj tek një neonat në term me insuficiencë respiratore është e rrallë dhe paraqet sfidë terapeutike.
Prezantimi i rastit: Foshnja e gjinisë femër lindur në javën e 37 - të të shtatzënisë, me sc, peshë 2550 g, pas një shtatzënie të komplikuar nga preeklampsia e nënës. APGAR 8 / 9, por menjeherë pas lindjes me shenja të detresit respirator dhe sekrecione hemoragjike nga goja. Transferohet në shërbimin e terapisë intensive neonatale, ku për shkak të përkeqësimit të gjendjes me cianozë të përgjithshme e pneumorragji intubohet dhe u vendos në ventilim mekanik (ACMV) me parametra maksimalë (PIP 30 cmH_2O, PEEP 6 cmH_2O, FR 50 / min, FiO_2 100%). Trajtimi përfshiu administrim të surfaktantit (Curosurf), vitaminë K, albuminë humane, plazmë të freskët të ngrirë dhe transfuzion gjaku. Analizat fillestare evidentuan acidozë respiratore e më pas alkalozë respiratore, që çoi në reduktim gradual të parametrave të ventilimit. Testet e koagulimit para transfuzionit të PFN ishin në normë duke përfshirë edhe fibrinogjenin. Pa trombocitopeni dhe indekse infektive negative. FO apertum në ekokardigrafi. Në ditët pasuese u arrit përmirësim hemodinamik dhe funksioni respirator duke cuar në ekstubim dhe daljen nga spitali javën e tretë të jetës në gjendje të mirë.

Konkluzione: Rasti paraqet një kombinim të rrallë të insuficiencës respiratore të rëndë si rezultat i pneumorragjisë tek një neonat në term. Asnjë nga shkaqet e njohura te pneumorragjisë tek foshnjat në term si: koagulopatite, infeksionet e hershme neonatale, kardiopatitë, trauma obstetrikale, neoplazma, fibroza kistike nuk u konfirmuan nga analizat dhe egzaminimet instrumentale. Megjithatë, ky rast nënvizon rëndësinë e diagnostikimit të hershëm dhe menaxhimit multidisiplinar të shpejtë të sindromit hemoragjik dhe komplikacioneve respiratore neonatale, edhe tek foshnjat në term, pavarësisht shkakut të saj. Ndalimi i hemorragjisë me vendosjen e hershme në ventilim mekanik me titrim të kujdesshëm të parametrave dhe administrimi i surfaktantit, si dhe sigurimi i shkëmbimit të përshtatshëm të gazeve mund të përmirësojë dukshëm mbijetesën dhe prognozën e këtyre foshnjave.

Fjalë kyçe: pneumorragji, insuficience respiratore, ventilim mekanik, lindje në term.

VLERA PARASHIKUESE E ECHO DOPPLER TRANSVAGINAL NË PARASHIKIMIN E KANCERIT TË ENDOMETRIT TEK GRATË ME HEMORRAGJI POSTMENOPAUZIKE.

Evis Binaj, Prof. Dr. Eljona Demaliaj
SUOGJ ``Mbretëresha Geraldinë``

Abstrakt
Objektivi: Studimi ka për qëllim të vlerësojë vlerën parashikuese të echo Doppler transvaginal në diagnostikimin e kancerit të endometrit tek gratë me hemorragji postmenopauzike.
Materiale dhe metoda: Në këtë studim u përfshinë gra postmenopauzale me hemorragji vaginale, të cilave iu nënshtruan echo Doppler transvaginal. Parametrat e matura përfshinin Indeksin e Rezistencës (RI), Indeksin e Pulsimit (PI), dhe vlerësimin e vaskularizimit endometrial. Rezultatet e ekografise u krahasuan me ato histopatologjike për të përcaktuar sensitivitetin, specifikën, vlerën parashikuese pozitive dhe negative.
Rezultate: Studimet e mëparshme kanë treguar se echo Doppler transvaginal ka një sensitivitet të lartë në identifikimin e kancerit të endometrit. Raportohet një sensitivitet prej 96% dhe një specificitet prej 88% në diagnostikimin e kancerit të endometrit tek gratë me hemorragji postmenopauzale. Gjithashtu, trashësia endometriale më e madhe se 4 mm është një tregues i mundshëm për praninë e lezioneve malinje.
Diskutim: Echo Doppler transvaginal ofron një mjet jo - invaziv dhe të disponueshëm për vlerësimin e pacientëve me hemorragji postmenopauzale. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se echo Doppler duhet të përdoret në kombinim me faktorë të tjerë klinikë dhe diagnostikë për të arritur një vlerësim të saktë.
Përfundimi: Echo Doppler transvaginal është një mjet i vlefshëm në diagnostikimin e kancerit të endometrit tek gratë postmenopauzale me hemorragji vaginale. Përdorimi i tij mund të ndihmojë në identifikimin e pacienteve që kërkojnë vlerësim dhe trajtim të mëtejshëm.

Fjalë kyçe: echo doppler, transvaginal, kancer, endometri etj.

NDIKIMI ENDOKRIN I MIKROBIOTËS INTESTINALE: NDËRVEPRIMI ME AKSIN HHA, METABOLIZMIN E ENERGJISË DHE EKUILIBRIN HORMONAL. STUDIMI I PARË I NË POPULLATËN SHQIPTARE.

Evis Nushi1, Nensi A. Dilo[1, 2], Bianka Agaraj[1, 3], Majlinda Toska[1]
[1]*Laboratori Dr. Limbach Albania.*
[2] *Spitali Universitar Obstetrik - Gjinekologjik "Koço Gliozheni".*
[3]*Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza, Departamenti i Anatomisë Patologjike.*

Abstrakt
Hyrje: Mikrobiota intestinale është tashmë e njohur për funksionet e saj të shumta në ruajtjen e shëndetit të organizmit pritës, por së fundmi është vënë në pah roli i saj si një organ funksional me veprim endokrin. Përmes prodhimit të metabolitëve si acidet yndyrore me zinxhir të shkurtër (SCFA), lipopolisakaridet (LPS) dhe neurotransmetues të ndryshëm, ajo ndikon në boshtin hipotalamik–hipofizë–adrenale (HHA), metabolizmin e glukozës, si dhe në balancën energjetike dhe hormonale.

Objektiva: Evidentimi i rolit të mikrobiotës intestinale në: Modulimin e aksit HHA dhe prodhimin e kortizolit, ndikimin në rezistencën ndaj insulinës dhe metabolizmin e glukozës, lidhja mes raportit Firmicutes / Bacteroidetes (F / B) dhe predispozitës për obezistet dhe roli i β - glukuronidazës fekale në metabolizmin e estrogjenit dhe çrregullime si PCOS apo endometrioza.
Materiale dhe metoda: Krahasim mes literaturës botërore dhe analizimi i mikrobiotës intestinale të një popullate prej 29 pacientësh shqiptarë me shqetësime gastrointestinale, të cilëve iu analizuar mostra e feces me metodën NGS (Next Generation Sequencing). U vlerësua raporti Firmicutes / Bacteroidetes, si dhe aktiviteti i β - glukuronidazës fekale si biomarker potencial me ndikim hormonal.
Rezultate: 31% e pacientëve paraqitën një raport F: B të rritur (>1. 5), i cili lidhet me rritje të ekstraktimit të energjisë dhe predispozitë për obezitet. Literatura e mëparshme (Turnbaugh et al. , Nature 2006) tregon se për të njëjtën sasi ushqimi, individët me dominim të Firmicutes mund të ekstraktojnë deri në 150 kcal më shumë. Aktiviteti i shtuar i β - glukuronidazës u identifikua si faktor që mund të rrisë rikirkulimin e estrogjenëve, duke kontribuar në dominancë estrogjenike, sidomos në PCOS dhe endometriozë.
Konkluzione: Mikrobiota intestinale vepron si një organ endokrin dhe metabolik që ndikon në aksin HHA, ndjeshmërinë ndaj insulinës, metabolizmin e energjisë dhe ciklin hormonal. Balanca e saj është thelbësore për parandalimin e obezitetit, rezistencës ndaj insulinës dhe çrregullimeve hormonale femërore.
Rekomandime: Mikrobiota intestinale duhet të trajtohet si një organ endokrin aktiv dhe të përfshihet në algoritmet diagnostikë të endokrinologjisë moderne. Personalizimi i dietës dhe trajtimit sipas përbërjes mikrobiale mund të përmirësojë ndjeshëm menaxhimin e çrregullimeve metabolike dhe hormonale.

Fjalë kyçe: Mikrobiota intestinale; aks HHA; organ endokrin; β - glukuronidazë fekale; Firmicutes / Bacteroidetes; PCOS; obezitet.

LËNGJET DHE ELEKTROLITET.
Evisa Zaka
*Spitali Hygeia Tiran*ë

Abstrakt
Hyrje: Ruajtja e ekuilibrit të lëngjeve dhe elektroliteve është thelbësore për stabilitetin fiziologjik dhe funksionimin normal të organizmit. Çrregullimet në këtë ekuilibër mund të çojnë në dehidrim, çrregullime elektrolitike dhe dëmtime të funksioneve organike.
Qëllimi: Të përshkruhen parimet kryesore dhe përgjegjësitë infermierore në monitorimin dhe ruajtjen e ekuilibrit të duhur të lëngjeve dhe elektroliteve te pacientët.
Metodologjia: Ky përmbledhje bazohet në rishikimin e udhëzimeve klinike dhe praktikave infermierore të bazuara në dëshmi, që lidhen me matjen e marrjes dhe nxjerrjes së lëngjeve, vlerësimin e hidratimit dhe parandalimin e çekuilibrave në grupmosha të ndryshme.
Rezultate dhe Diskutime: Monitorimi i saktë i marrjes dhe nxjerrjes (I&O) ndihmon në identifikimin e hershëm të çekuilibrave. Prodhimi i urinës nën 30 mL / orë mund të tregojë dehidrim ose dëmtim të funksionit renal. Infermierët kanë rol kyç në vlerësimin e hidratimit, edukimin e pacientëve dhe familjeve, si dhe në zbatimin e ndërhyrjeve parandaluese, veçanërisht te foshnjat dhe të moshuarit.
Përfundime: Menaxhimi efektiv i lëngjeve dhe elektroliteve ndihmon në ruajtjen e homeostazës, parandalon komplikacionet dhe përmirëson rezultatet klinike të pacientëve.

Fjalë kyçe: lëngje, elektrolite, kujdes infermieror, hidratim, bilanci i lëngjeve, marrje dhe nxjerrje.

REZULTATET E HERSHËME DHE TE VONËSHME, VDEKSHMËRIA DHE SËMUNDSHMËRIA MADHORE PAS OPERACIONIT TË KANCERIT TË MUSHKËRIVE PËR KARCINOMËN PRIMARE.

Gradica F. Lisha L, Argjiri Dh, Cani A, Kokici F, Muhameti R, Xhemalaj D, Vata Y, Shpataraku L, Shima E, Vyshka A, Argjiri I.
Spitali Universitar i Sëmundjeve të Mushkërive, "Shefqet Ndroqi" Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt

Hyrje: Rezeksioni radikal kirurgjikal i kancerit të mushkërive me ose pa trajtim ndihmës është ende një remisë për trajtim. Përparimet në kujdesin operativ dhe postoperativ çuan në një rënie të ndërlikimeve dhe shkallës së vdekshmërisë gjatë dekadave të fundit. Pavarësisht mënyrave të ndryshme shtesë të trajtimit, mbijetesa është ende e dobët.

Objektivi: Të shqyrtohet vdekshmëria dhe morbiditeti operativ pas operacionit të kancerit të mushkërive dhe të identifikohen faktorët që lidhen me një rezultat të pafavorshëm.

Materiale dhe metoda: Studimi përbëhej nga 1051 pacientë të njëpasnjëshëm të cilët u referuan në Spitalin Universitar të Sëmundjeve të Mushkërive, "Shefqet Ndroqi", në Tiranë, Shqipëri, për karcinomë të mushkërive gjatë një periudhe 18 - vjeçare (janar 2004 - dhjetor 2024). Të gjithë pacientët iu nënshtruan ekzaminimeve rutinë laboratorike, spirometrisë dhe skanimit paraoperativ CT të toraksit dhe barkut të sipërm. PET - CT, EBUS - EUS, Mediastinotomia ose Mediastinoskopia, nuk u kryen në mënyrë rutine.

Rezultate: Nga 1101 pacientë, 774 (70. 3%) ishin meshkuj dhe 327 (29. 7%) ishin femra. Mosha mesatare ishte 65. 5±9. 4 vjeç (varionin nga 15 - 87 vjeç). Lobektomia ishte modaliteti kirurgjikal më i përdorur në 696 (63. 2%) pacientë, ndërkohë që pneumonektomia u krye në 125 (11. 3%) pacientë. Komplikime të vogla gjatë operacionit ndodhën në 131 (11. 8%) të pacientëve. Rrjedhja e vazhdueshme e ajrit ishte komplikacioni më i përhapur pas operacionit që ndodhi në 35. 3% të pacientëve, e ndjekur nga atelektaza e mushkërive në 32. 8% dhe komplikimet kardiovaskulare në 26. 4%.

Përfundime: Rezultatet tona tregojnë vdekshmëri dhe morbiditet të ulët pas operacionit të kancerit të mushkërive. Megjithatë, pacientët me kapacitet të reduktuar të mushkërive, në moshë të shtyrë madhore dhe ata që i nënshtrohen pneumonektomisë duhet të trajtohen me shumë kujdes.

Fjalë kyçe: rezultati, komplikime, kanceri i mushkërive, kirurgjia torakale.

STRATEGJITË PRAKTIKE PËR KALIMIN E "LOOPEVE" NË KOLONOSKOPI.

Fadil Sherifi, Sabri Tmava, Marigona Zubaku - Rakovica, Ardian Bytyçi, Besian Bajraktari, Genc Shala.
Spitali Amerikan, Prishtinë

Abstrakt

Hyrje: Formimi i loopeve gjatë kolonoskopisë përbën një sfidë të zakonshme teknike që mund të vështirësojë përparimin e skopit, të shkaktojë dhimbje te pacienti dhe të rrisë rrezikun për nderlikime. Ky fenomen ndodh kryesisht në kolonin sigmoide dhe transverss për shkak të fleksibilitetit dhe gjatësisë së zorrës. Identifikimi i hershëm i looping - ut dhe ndërhyrja e menjëhershme janë thelbësore për mbarëvajtjen e procedurës. Gjatë avancimit të skopit në kolon, sidomos në kolonin sigmoide dhe transversal, mund të ndodhë që zorra të zgjerohet dhe të formojë lakime të mëdha (looping), duke e bërë të vështirë përparimduke shkaktuar: humbje të kontrollit të drejtimit të skopit, rritje të rezistencës gjatë përparimit, dhimbje të konsiderueshme për pacientin, rrezik për komplikime si perforacion ose gjakderdhje nga koloni, etj. Lakesat apo loopet më të zakonshme jane: Alpha loop – zakonisht në kolonin sigmoide, N - loop, Reverse alpha – në kthesat e zorrës, Gama loop në kolon transversal, etj. Teknikat bazë për parandalimin dhe menaxhimin e loopeve janë si vijon: A) manipulimi i aparatit me kujdes: rrotullimi i aparatit në drejtim të orës ose kundër orës mund të ndihmojë në orientimin dhe zgjidhjen e lakimeve, pastaj tërheqja selektive (pull - back), si dhe teknika dy hapa para dhe nje pas. B) ndihma nga asistenti me presion te jashtëm abdominal C) ndryshimi i pozites se pacientit, etj. Aplikimi sistematik i këtyre strategjive ndihmon në parandalimin e komplikacioneve, rrit shkallën e kompletimit të kolonoskopisë dhe përmirëson ndjeshëm përvojën e pacientit. Përvoja e operatorit, bashkëpunimi me ekipin ndihmës dhe përshtatja e teknikave sipas karakteristikave anatomike të pacientit janë elemente kyçe për suksesin e procedurës.

Fjalë kyçe: kolonoskopi, pozita e pacientit, shtypja nga jashtë, manipulim i kolonoskopit.

SINUSITI KRONIK DHE LIDHJA ME ASTMËN BRONKIALE.

Fat Huma

Abstrakt

Hyrje: Sinusiti kronik përfaqëson një patologji të shpeshtë të traktit të sipërm respirator, me një ndikim të madh në cilësinë e jetës së pacientëve. Një numër i konsiderueshëm studimesh ka treguar se ekziston një lidhje e ngushtë midis sinusitit kronik dhe astmës bronkiale, duke sugjeruar se prania e njërës prej tyre shpesh ndikon në shfaqjen ose përkeqësimin e tjetrës.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të analizohet marrëdhënia mes sinusitit kronik dhe astmës bronkiale, duke u fokusuar në mekanizmat patofiziologjikë, impaktin klinik dhe qasjet terapeutike bashkëkohore.

Metodologjia: Është kryer një rishikim i literaturës së fundit (2015–2025) mbi bazë të artikujve të publikuar në databazat PubMed, Scopus dhe Cochrane. Janë analizuar studime klinike, meta - analiza dhe udhëzime ndërkombëtare që trajtojnë lidhjen Sinusit Kronik–Astma Bronkiale.

Rezultate: Studimet tregojnë se pacientët me Sinusit Kronik kanë prevalencë më të lartë të Astmës Bronkiale, sidomos ata me rinosinuzit kronik me polipe nazale. Inflamacioni i përbashkët, ndërmjetësuar nga citokina si IL - 4, IL - 5 dhe IL - 13, duket të jetë mekanizmi kyç. Trajtimi i Sinustiti Kronik me kortikosteroide intranazale, kirurgji endoskopike të sinusëve dhe terapitë biologjike të reja (p. sh. dupilumab) kanë treguar përmirësim të ndjeshëm në kontrollin e astmës dhe reduktimin e shtrimeve spitalore.

Përfundime: Lidhja midis sinusitit kronik dhe astmës bronkiale është e qartë dhe kërkon një menaxhim të integruar multidisiplinar. Identifikimi dhe trajtimi i hershëm i Sinustit Kronik tek pacientët astmatikë jo vetëm përmirëson simptomat respiratore, por edhe redukton barrën shëndetësore dhe ekonomike. Qasjet e reja terapeutike, sidomos përdorimi i biologjikëve, paraqesin një perspektivë premtuese për të dyja patologjitë.

Fjalë kyçe: sinusiti kronik, astma bronkiale, rinosinuzit, inflamacion, terapi biologjike.

MENAXHIMI I ARTROZËS SË GJURIT: NGA TRAJTIMI KONSERVATIV DERI TE NDËRHYRJA KIRURGJIKALE.

Dr. Fatbardh Halitaj[1], Dr. Learta Nika[1]

[1.] *Fakulteti I Mjekësisë Universiteti i Prishtinës*

Abstrakt

Hyrje: Artroza e gjurit (KOA) përbën një nga shkaqet më të shpeshta të vështirësive në lëvizje, duke prekur një pjesë të konsiderueshme të popullsisë globale. Menaxhimi i saj përfshinë një qasje multimodale që kombinon trajtimet konservative, farmakologjike dhe kirurgjikale, të përshtatura sipas stadit të sëmundjes.

Qëllimi: Ky artikull përmbledh strategjitë aktuale mbi menaxhimin multimodal të artrozës së gjurit, duke përshkruar kalimin nga trajtimi konservativ deri te ndërhyrja kirurgjikale dhe duke nxjerrë në pah përditësimet nga udhëzimet klinike ndërkombëtare dhe kërkimet shkencore.

Materiale dhe Metoda: Ky punim përfaqëson një rishikim të literaturës, i bazuar në analizën e detajuar të studimeve shkencore të fundit nga bazat e të dhënave mjekësore si PubMed dhe Google Scholar, si dhe në tekstin mjekësor "Apley & Solomon's System of Orthopaedics and Trauma" (Ashley Blom, David Warwick, Michael R. Whitehouse). Ky rishikim ka vlerësuar trajtimet konservative, farmakologjike dhe intra - artikulare, si dhe procedurat minimale invazive dhe menaxhimin kirurgjikal të artrozës së gjurit.

Rezultate: Trajtimi konservativ i artrozës së gjurit, duke përfshirë fizioterapi, kontroll të peshës dhe edukim të pacientit, rezultoi në përmirësim të ndjeshëm të dhimbjes dhe funksionit ($p < 0.05$), siç është raportuar në një studim të publikuar me metodë të strukturuar të ushtrimeve dhe kontrollit të peshës. Injeksionet intra - artikulare me PRP në një studim me 1, 995 pacientë shënuan reduktim mesatar të dhimbjes 2. 5 pikë VAS dhe përmirësim të funksionit WOMAC 15% pas 6 muajsh ($p < 0.01$), ndërsa kombinimi PRP + HA në 288 pacientë tregoi përfitim afatgjatë në 12 muaj ($p < 0.05$). Kortikosteroidet dhanë lehtësim afatshkurtër 1–3 javë ($p < 0.05$). Në stadet e avancuara, artroplastika totale e gjurit rezultoi në përmirësim të funksionit dhe reduktim të dhimbjes

mbi 70% pas 12 muajsh ($p < 0.01$), ndërsa artroskopia nuk ofroi përfitime afatgjate krahas trajtimit konservativ ($p > 0.05$).

Fjalë kyçe: Artroza e gjurit, trajtim konservativ, terapi farmakologjike, injeksione intra - artikulare, artroplastika totale e gjurit, trajtim multimodal.

PLASTIKA E VALVULËS SË AORTËS: SFIDË E FITUAR?

Fation Hamiti, Altin Veshti, Klodian Krakulli, Afërdita Veseli
[1]*Shërbimi i Kardiokirurgjisë, Qëndra Spitalore Universitare 'Nënë Tereza', Tiranë*

Abstrakt
Hyrje: Plastika e valvulës së aortës po fiton terren si një alternativë e vlefshme ndaj zëvendësimit klasik me proteza, veçanërisht te pacientët e rinj me anatomi të favorshme. Ruajtja e strukturës native të valvulës ofron avantazhe në funksionin hemodinamik dhe redukton nevojën për antikoagulim afatgjatë. Qëllimi i këtij prezantimi është të pasqyrojë rezultatet afatshkurtra të pacientëve të trajtuar në Shërbimin e Kardiokirurgjisë, dhe nëse është një sfidë e fituar në bazë të rezultateve afatshkurtër; të vlerësojë rezultatet afatshkurtra dhe afatgjata të plastikës së valvulës së aortës dhe të analizojë nëse kjo qasje përfaqëson një "sfidë të fituar" në praktikën moderne kardiokirurgjikale.
Materiale dhe Metoda: Do të realizohet një pasqyrim i numrit të rasteve të kryera në Shërbimin e Kardiokirurgjisë. Bëhet një përmbledhje kritike e literaturës së fundit shkencore mbi plastikën e valvulës së aortës, përfshirë studime retrospektive, analiza të rezultateve klinike në qendra të specializuara dhe të dhëna të regjistrave ndërkombëtarë. Janë shqyrtuar faktorët që ndikojnë në suksesin e plastikës, si morfologjia e valvulës (trikuspidale / bikuspide), teknikat kirurgjikale, përvoja e kirurgut dhe indikacionet klinike.
Rezultate: Studimet tregojnë mbijetesë 5 - dhe 10 - vjeçare konkurruese me zëvendësimin valvular kirurgjikal, me norma të ulëta të ri - operimeve dhe performancë të qëndrueshme valvulare në pacientët e zgjedhur me kujdes. Teknika të tilla si resuspensioni i kuspiseve, anuloplastika dhe valve - sparing aortic root replacement janë shoqëruar me rezultate të mira afatgjata. Sidoqoftë, suksesi është i lidhur ngushtë me përvojën kirurgjikale dhe përzgjedhjen e duhur të pacientëve.
Përfundime: Plastika e valvulës së aortës paraqet një qasje premtuese, që në kirurg të trajnuar e me eksperiencë dhe për pacientë të përzgjedhur, mund të ofrojë rezultate të shkëlqyera funksionale dhe mbijetesë të gjatë pa protezim valvular. Megjithatë, nevojiten më shumë studime të randomizuara për të përcaktuar më saktë vendin e saj përballë opsioneve të tjera terapeutike.

Fjalë kyçe: Plastika e valvulës së aortës, valve - sparing, regurgitimi aortal, aortic valve repair, aortic root replacement.

PËRVOJA DHE BURNOUT - I I INFERMIERËVE NË SHËRBIMIN PARASPITALOR.

Fatjon Bajraktari

Abstrakt
Hyrja: Burnout - i është një fenomen kompleks që prek në mënyrë të veçantë profesionistët shëndetësorë, veçanërisht infermierët që punojnë në shërbimin paraspitalor. Ky grup përballet çdo ditë me ngarkesë të lartë emocionale, fizike dhe psikologjike për shkak të natyrës urgjente të punës, orareve të gjata dhe situatave të paparashikueshme. Si rezultat, burnout - i ndikon në shëndetin e tyre mendor dhe fizik, si dhe në cilësinë e kujdesit që u ofrohet pacientëve.
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë nivelin e burnout - it dhe lidhjen e tij me përvojën e punës tek infermierët në shërbimin paraspitalor, duke identifikuar faktorët kontribuues dhe mundësitë për përmirësim të mirëqenies në punë.
Metodologjia: Studimi është realizuar përmes një pyetësori të strukturuar dhe anonim, i shpërndarë tek 14 infermierë që punojnë në shërbimin paraspitalor, me moshë mesatare 32 vjeç dhe përvojë pune që varion nga më pak se 1 vit deri në mbi 10 vite. Të dhënat janë analizuar në mënyrë deskriptive për të vlerësuar nivelin e lodhjes emocionale, fizike dhe mbështetjen në vendin e punës.

Rezultate: Niveli mesatar i lodhjes emocionale ishte 3. 2 dhe i lodhjes fizike 3. 1 (nga 1 në 5), duke treguar një nivel të moderuar deri të lartë të burnout - it. Mbështetja psikologjike mungon plotësisht në ambientet paraspitalore, duke treguar një boshllëk të rëndësishëm institucional. Faktorët kryesorë të përmendur për reduktimin e lodhjes ishin: pagë më e mirë, orare më fleksibël, shtim i stafit infermieror dhe mbështetje psikologjike. Pas orëve të gjata të punës, u vu re një rritje e ndjeshme e vështirësisë për të ruajtur empatinë ndaj pacientëve, si edhe shenja të lodhjes profesionale të akumuluar.
Rekomandime: Rishikimi i ngarkesës së punës dhe organizimi më i mirë i orarit. Krijimi i strukturave të qëndrueshme për mbështetje psikologjike, të cilat aktualisht mungojnë. Shtimi i numrit të stafit për të shpërndarë më mirë përgjegjësitë. Përmirësimi i kushteve të punës dhe zhvillimi i trajnimeve për menaxhimin e stresit dhe burnout - it.
Përfundime: Burnout - i në shërbimin paraspitalor është një problem serioz që ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien e infermierëve dhe në cilësinë e shërbimeve të emergjencës mjekësore. Krijimi i mekanizmave mbështetës dhe përmirësimi i kushteve të punës janë hapa të domosdoshëm për të reduktuar lodhjen profesionale dhe për të rritur efikasitetin në kujdesin ndaj pacientëve.

Fjalë kyçe: Burnout - i, kujdesi paraspitalor, emergjencat mjekësore, lodhje profesionale.

REZULTAT I SUKSESSHËM SHTATËZANIE PAS KRYERJES SË STRASSMANN METROPLASTIKËS PËR UTERUS BIKORN.
Fatjon Balla, Marsida Danaka

Abstrakt:
Anomalitë Mülleriane kanë një impakt të rëndësishëm si në infertilitet edhe në ecurinë e shtatzënisë. Uterusi bikorn, septa, didelphus bëjnë pjesë në anomalitë e fuzionimit dhe përfaqësojnë rreth 26% të të gjitha anomalive uterine. Studimet kanë treguar se pacientet me këtë anomali kanë rrezik aborti prej 36%, si dhe mundësi lindjeje të parakohshme prej 23%. Fertiliteti dhe shtatëzania, në këto paciente nuk janë të favorshme. Metroplastika Strassmann përbën procedurën standarde për unifikimin e dy kaviteteve uterine në një kavitet unik duke përmirësuar ndjeshëm kapacitetin riprodhues. Pas kryerjes se ndërhyrjejes, është raportuar rritje e konsiderueshme e shkallës së shtatzënive të suksesshme dhe reduktim i aborteve. Përveç rrugës tradicionale me laparotomi, laparaskopia po përdoret gjithnjë e më shume, duke ofruar të gjitha përparësitë e një ndërhyrjeje minimalisht invazive.

Fjalë kyçe*:* uterusi bikorn, laparaskopi, ndërhyrjeje minimalisht invazive, metroplastika Strassmann, unifikimi i uterusit.

NDIKIMI I ENDOMETRIOZËS DHE TRAJTIMIT KIRURGJIKAL MBI NIVELET E HORMONIT ANTI - MÜLLERIAN (AMH): NJË RISHIKIM I EVIDENCAVE TË REJA.
Fatjon Balla PhD, Besjona Kodra PhD (c), Marsi Danaka MD
SUOGJ Mbretëresha Geraldinë

Abstrakt
Hyrje: Endometrioza, veçanërisht endometriomat ovariane, lidhet me uljen e rezervës ovariane. Hormoni Anti - Müllerian (AMH) shërben si tregues kryesor për vlerësimin e kësaj rezerve. Megjithatë, si vetë sëmundja ashtu edhe trajtimi kirurgjikal mund të ndryshojnë nivelet e AMH - së, duke ndikuar në potencialin fertil dhe vendimmarrjen klinike.
Qëllimi: Të rishikohen publikimet e viteve 2020–2025 që vlerësojnë ndryshimet e niveleve të AMH - së para dhe pas trajtimit kirurgjikal të endometriozës dhe të përmblidhen faktorët që ndikojnë në rezervën ovariane pas operacionit.
Metoda: U krye një rishikim i literaturës në bazat e të dhënave PubMed dhe Scopus, duke u fokusuar në rishikime sistematike, meta - analiza dhe studime prospektive që raportonin nivelet serike të AMH - së para dhe pas kistektomisë laparoskopike ose ndërhyrjeve të tjera kirurgjikale për endometriozën.

Rezultate: Meta - analizat e fundit konfirmojnë se gratë me endometrioma kanë nivele më të ulëta fillestare të AMH - së krahasuar me gratë pa sëmundje. Kistektomia laparoskopike zakonisht shkakton një ulje të mëtejshme të konsiderueshme, mesatarisht 30–40% të nivelit paraoperativ. Rënia është më e theksuar në rastet me ciste bilaterale, me madhësi më të madhe, dhe kur përdoret koagulimi bipolar për hemostazë. Një rikuperim i pjesshëm i AMH - së vërehet pas 6–12 muajsh, veçanërisht pas kirurgjisë unilaterale ose kur përdoren teknika që ruajnë indin ovarian. Pavarësisht uljes së AMH - së, rezultatet riprodhuese si normat e shtatzënisë nuk bien në të njëjtën masë, duke sugjeruar rikuperim funksional të pjesshëm të vezores.
Përfundime: Endometrioza dhe trajtimi i saj kirurgjikal ndikojnë ndjeshëm në rezervën ovariane të reflektuar nga AMH. Këshillimi para operacionit duhet të balancojë kontrollin e simptomave dhe ruajtjen e fertilitetit. Rekomandohen teknika kirurgjikale konservative dhe strategji që ruajnë funksionin ovar për të minimizuar humbjen e AMH - së.

Fjalë kyçe: endometriozë, hormon anti - müllerian, rezervë ovariane, kistektomi, fertilitet.

SFIDAT E SHUMËLLOJSHME TË NDËRVEPRIMIT KARDIOVASKULAR DHE RESPIRATOR NË NJË RAST KOMPLEKS: HIPERTENSIONI KRONIK, INSUFICIENCA KARDIAKE ME FRAKSION TË RUAJTUR TË HEDHJES(HFPEF) DHE KOMPLIKIMET RESPIRATORE.

Fatjon Haxhaj
Shërbimi i Kardiologjisë, Klinika e Mjekësisë Interne, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Prishtinë, Republika e Kosovës
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti i Mjekësisë, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Abstrakt
Hyrje: Insuficienca kardiake me fraksion të ruajtur të hedhjes(HFpEF) shpesh shoqërohet me hipertension kronik, obezitet dhe inflamacion sistemik. Simptomat e përziera kardiake dhe pulmonare sikurse dispnea dhe hipoksia mund ta vështirësojnë diagnostikimin, pasi biomarkerët dhe imazheria rutinore mund të jenë të paqartë në rastet me HFpEF.
Prezantimi i rastit: Një grua 67 - vjeçare me hipertension të gjatë (me kardiomiopati hipertensive) dhe obezitet, me HFpEF (FE ~55%), është paraqitur me përkeqësim të dispnesë dhe me lodhje. Në pranimin e saj u konstatuan hipoksemia me krepitacione bilaterale pulmonare dhe hipertension i rëndë. Analizat laboratorike treguan troponinat kardiake të ngritura, BNP - në e lartë, leukocitozë dhe CRP / prokalcitoninë shumë të rritur. Radiografia native e kraharorit dhe CT - angio evidentuan kardiomegali dhe konsolidime pulmonare bilaterale (pa emboli pulmonare). Ekokardiografia konfirmoi EF (fraksionin e ejeksionit të ruajtur) me rreth (~55%), si dhe hipertrofi të lehtë të ventrikulit të majtë dhe dilatim të ventrikulit të djathtë. Trajtimi fillestar përfshinte diuretikë dhe kontroll agresiv të tensionit arterial. Megjithatë, ethet e vazhdueshme dhe rritje e prokalcitoninës rezultuan në konsultë me Infektologjinë dhe fillim të terapisë me antibiotikë.
Konkluzione: Ky rast ilustron vështirësinë diagnostike kur HFpEF mbivendoset nga infeksioni respirator. Vlerësimi i integruar (ekokardiografi, biomarkerë, radiografi) ishte kyç për identifikimin e shkaqeve kardiake dhe pulmonare. Trajtimi përfshiu terapinë e udhëzuar nga udhëzimet për HFpEF (kontroll i tensionit, diuretikë dhe bllokues të SGLT2) së bashku me trajtim të menjëhershëm të infeksionit. Një ekip multidisiplinar i koordinuar (kardiologjia, pulmologjia dhe infektologjia) është thelbësor në raste të tilla komplekse.

Fjalë kyçe: insuficienca kardiake, fraksion ejeksioni, hipertensioni kronik, dispne, troponina.

RADIOTERAPIA NË KANCERIN E GJIRIT NË STAD TË HERSHËM: IDENTIFIKIMI I PACIENTEVE ME PËRFITIM KLINIK.

Fatjona Kraja[1, 2], Erald Karaulli[2], Athina Papallopullo[2], Edit Zaganjori[2], Florina Hoxha[2], Enes Hafizi[2], Helidon Nina[1, 2]

[1]*Departmenti i Kirurgjisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë Tiranë.*

[2]*Shërbimi Onkologjikë, Qëndra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë.*

Abstrakt

Hyrje: Radioterapia adjuvante (RT) pas kirurgjisë konservuese të gjirit (BCS) ul rrezikun e rekurrencës lokale ipsilaterale (IBTR), por përfitimi absolut ndryshon sipas rrezikut fillestar. Me terapitë sistemike moderne dhe profilizimin molekular, një nëngrup pacientesh me rrezik shumë të ulët të rekurrencës lokale mund të konsiderohen për heqje të indikacionit për radioterapi adjuvate.

Metodologjia: U analizuan të dhënat nga studimet e rastësishme në gra të moshuara me kancer të gjirit në stad të hershëm, receptorë hormonalë pozitivë (HR+), si dhe studimet prospektive dhe udhëzimet aktuale klinike. Rezultatet kryesore ishin IBTR, metastazat në distancë, mbijetesa e përgjithshme (OS), toksiciteti dhe cilësia e jetës (QoL).

Rezultate: Dy studime të randomizuara konfirmojnë se heqja e RT është e sigurt tek gratë e moshuara me sëmundje HR+ me rrezik të ulët që marrin terapi hormonale. Studimi CALGB 9343 (mosha ≥70 vjeç, T1N0, ER+) tregoi një rritje të rikthimit lokal në 10 vjet pa RT (rreth 10% kundrejt 2% me RT) por pa dallim në mbijetesën e përgjithshme. Studimi PRIME II (mosha ≥65, ER+, ≤3 cm, N0) konfirmoi një rritje të ngjashme absolute (~9–10%) në IBTR në 10 vjet, pa ndikim në OS. Studime të tjera prospektive të bazuara në biologjinë e tumorit tregojnë se indikacioni për RT adjuvante mund të ndikohet nga kritere të tjera përtej kriterit të moshës. Në studimin LUMINA, për gra ≥55 vjeç me tumore luminal A (ER+, HER2–, gradë 1–2, Ki - 67
≤13. 25%) të trajtuara vetëm me terapi hormonale, rikthimi lokal në 5 vjet ishte rreth 2–3%, me kontroll të mirë në distancë edhe pa RT. Studimet në vazhdim, si PRECISION dhe EXPERT, po vlerësojnë përdorimin e testeve gjenomike (Oncotype DX, Prosigna / PAM50) për të udhëhequr vendimin për heqjen e RT adjuvante në raste specifike. Në carcinomën duktale in situ (DCIS), të dhënat e studimeve të randomizuara dhe prospektive mbështesin përdorimin e RT në shumicën e rasteve, megjithatë lezionet e vogla, të gradës së ulët, me margo të gjera mund të jenë të përshtatshme për vetëm kirurgji ose ndjekje aktive. Aktualisht po zhvillohen studime mbi ndjekjen aktiv në këtë grup pacientësh. Nga ana tjetër, format e de - eskalimit si RT e ultra - hipofraksionuar dhe RT parciale e gjirit ofrojnë kontroll lokal të krahasueshëm me një johëzgjatje dhe një volum më të vogël trajtimi.

Përfundime: Heqja e RT është e sigurt për paciente të përzgjedhura me kujdes, si gra të moshuara me tumore të vegjël, pa përfshirje nyjesh, ER+ dhe që trajtohen me terapi hormonale, pa kompromet uar mbijetesën. Profilizimi biologjik dhe gjenomik mund të ndihmojnë më tej në përzgjedhjen e pacienteve. Vendimmarrja e përbashkët, respektimi i terapisë hormonale dhe diskutimi multidisiplinar mbeten thelbësore.

Fjalë kyçe: radioterapia adjuvante (RT), kirurgji konservuese e gjirit (BCS), IBTR etj.

TRAJTIMI FARMAKOLOGJIK I RETINOPATISË DIABETIKE. RISHIKIM I LITERATURËS.

Fatlinda Berisha[1], Shend Kryeziu[1], Elton Bahtiri [2], Avni Kryeziu[3]

[1]*Doktor i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës, Kosovë.*

[2]*Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Klinika e Endokrinologjisë, Prishtinë, Kosovë.*

[3]*Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Klinika e Reumatologjisë, Prishtinë, Kosovë.*

Abstrakt

Hyrja: Retinopatia diabetike (DR) është një ndërlikim mikrovaskular i diabetit dhe një shkak kryesor i verbërisë tek individët në moshë pune (15–64 vjeç). Terapitë farmakologjike të reja, përfshirë agjentët anti - VEGF dhe kortikosteroidet, kanë përmirësuar menaxhimin e DR - së, duke u bërë linja e parë e trajtimit. Megjithatë, sfidat klinike vazhdojnë duke theksuar nevojën për zhvillime të mëtejshme, ndërkohë që trajtimet si bllokuesit e receptorëve të angiotensinës, fibratet dhe NSAIDs kanë efikasitet më të kufizuar.

Qëllimi i punimit: Ky studim ka për qëllim vlerësimin e efektivitetit të trajtimeve farmakologjike në menaxhimin e DR - së, me fokus te terapitë anti - VEGF për ngadalësimin e progresionit të sëmundjes dhe

parandalimin e komplikimeve, përdorimi i deksametazonit intravitreal si trajtim i vetëm në pacientët me DME të patrajtuar, dhe vlerësimi i fibrateve në përmirësimin e ecurisë së sëmundjes.
Metodologjia: Ky studim bazohet në një rishikim të literaturës shkencore të dekadës së fundit mbi trajtimet farmakologjike të DR - së, me fokus në efikasitetin, rezultatet klinike dhe efektet anësore. Kërkimi bibliografik u krye në databaza të njohura si PubMed, Embase, Scopus dhe ResearchGate, si dhe në udhëzime nga institucione ndërkombëtare si American Diabetes Association (ADA), Cleveland dhe Mayo, duke përdorur fjalët kyçe përkatëse.
Rezultate: Pesë studimet e shqyrtuara evidentojnë rolin thelbësor të terapive anti - VEGF dhe kortikosteroide në trajtimin e DR - së dhe edemës makulare diabetike (DME). Aflibercepti shfaq efikasitet të lartë në parandalimin dhe trajtimin e DME - së së rëndë, ndërsa bevacizumabi përfaqëson alternativën më kosto - efektive. Ranibizumabi intravitreal rezulton jo - inferior ndaj fotokoagulimit me laser, dhe implanti intravitreal i deksametazonit është treguar efektiv te pacientët e patrajtuar më parë. Poashtu, theksohet rëndësia e kontrollit të faktorëve sistemikë, veçanërisht dislipidemisë, ku fibratet luajnë një rol mbështetës në menaxhimin e sëmundjes.
Përfundimi: Terapitë farmakologjike moderne luajnë rol kyç në menaxhimin e DR - së. Aflibercepti ngadalëson progresionin nga NPDR - ja në PDR dhe është veçanërisht efektiv në DME të rëndë. Të tre agjentët anti - VEGF (aflibercept, bevacizumab dhe ranibizumab) ruajnë përmirësimin vizual afatgjatë, me ranibizumabin jo - inferior ndaj PRP - së. Implantet me deksametazon ofrojnë alternativë për pacientët refraktarë, ndërsa fenofibrati kontribuon në ngadalësimin e DR - së në fazat e hershme.

Fjalë kyçe: retinopatia diabetike, neovaskularizimi, Anti VEGF, kortikosteroidet.

DHIMBJA E KOKËS NË PRAKTIKËN E PËRDITSHME: SI TA DIFERENCOJMË URGJENCËN NGA BENINJITETI.

Dr. Fatlire Gashi - Hoxha
Mjeke e përgjithshme

Abstrakt
Hyrje: Dhimbja e kokës është një ndër arsyet më të shpeshta të vizitave te mjeku i përgjithshëm dhe në shërbimet e urgjencës. Shumica e rasteve janë beninje, por një përqindje e vogël mund të përfaqësojnë urgjenca mjekësore serioze, të cilat kërkojnë identifikim dhe trajtim të menjëhershëm.
Qëllimi: Të paraqitet një qasje praktike për dallimin e dhimbjeve të kokës beninje nga ato që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme.
Metodologjia: U krye një rishikim i literaturës bashkëkohore mbi diagnostikimin e dhimbjes së kokës, I kombinuar me përvojën klinike në praktikën e mjekësisë familjare dhe urgjencës. U identifikuan shenjat kryesore paralajmëruese ("red flags") dhe u strukturua një algoritëm klinik për mjekun e vijës së parë.
Rezultate: Shenjat "red flags" si dhimbje e papritur dhe e fortë, shoqërimi me deficit neurologjik, temperaturë apo mosha mbi 50 vjeç, janë tregues të fortë për vlerësim urgjent. Një algoritëm i thjeshtë I bazuar në anamnezë dhe ekzaminim fizik ndihmon në diferencimin më të sigurt të rasteve beninje nga ato urgjente.
Shembuj klinikë: Një paciente 28 - vjeçare me dhimbje koke difuze, të lidhur me stresin dhe pa simptoma neurologjike shoqëruese, u menaxhua si cefale tensionale, duke shmangur ekzaminime të panevojshme. Ndërsa një pacient 52 - vjeçar, me dhimbje koke të re, të fortë dhe të shoqëruar me mpirje të gjymtyrëve, u dërgua urgjentisht për imazheri dhe iu diagnostikua me goditje cerebrale.
Diskutimi: Zbatimi i një qasjeje të strukturuar redukton rrezikun e diagnostikimit të vonuar të patologjive serioze dhe shmang ekzaminimet e panevojshme në rastet beninje. Mjeku i përgjithshëm mbetet në pozicion kyç për menaxhimin fillestar të këtyre pacientëve.
Përfundime: Një qasje e standardizuar në vlerësimin e dhimbjes së kokës rrit sigurinë e pacientit dhe forcon rolin e mjekut të parë në kujdesin shëndetësor.

Fjalë kyçe: dhimbje koke, urgjencë, mjekësi familjare, red flags, diagnostikim i hershëm.

KANDIDIAZA VULVOVAGINALE.

Dr. Fatlum Bajraj, Dr. Dardan Kolshi

Abstrakt

Hyrje: Kandidiaza vulvovaginale është një infeksion i zakonshëm mykotik që prek kryesisht gratë, me një prevalencë të lartë, sidomos gjatë viteve të riprodhimit. Ky infeksion shkaktohet nga kërpudha të familjes Candida, me Candida albicans që është patogjeni më i zakonshëm. Ajo mund të shkaktojë simptoma të ndryshme, përfshirë kruajtje, skuqje, sekrecione të bardha dhe dhimbje gjatë urinimit ose marrëdhënieve seksuale. Faktorët e riskut për zhvillimin e kandidiazës vulvovaginale përfshijnë përdorimin e antibiotikëve, ndryshimet hormonale (sidomos gjatë shtatëzanisë ose përdorimit të kontraceptivëve), sëmundjet që ndikojnë në imunitet (si diabeti), si dhe stilin e jetesës (ushqyerja e pasur me sheqer).

Materiale dhe metoda: Diagnostikimi i kandidiazës vulvovaginale bëhet kryesisht përmes vlerësimit të simptomave klinike dhe konfirmimit laboratorik, duke përfshirë mikroskopinë për kërpudhat dhe kultivimin e mostrave nga vagina. Gjithashtu, mund të përdoren testet molekulare për të identifikuar më saktë prani të kërpudhave. Përdorimi i medikamenteve antifungalë, si flukonazoli (i administruar oral) dhe kremrat antifungalë (si clotrimazole dhe miconazole) janë opsionet kryesore të trajtimit. Trajtimi mund të jetë lokal ose sistematik, në varësi të rëndësisë së simptomave dhe shpeshtësisë së infeksionit. Disa studime kanë sugjeruar përdorimin e probiotikëve për të mbështetur ripushtimin e florës vaginale normale dhe për të parandaluar recidivat.

Diskutime: Kandidiaza vulvovaginale, megjithëse e mundshme të trajtohet dhe menaxhohet, shpesh ka një tendencë për recidivë, sidomos tek gratë që janë të prekura nga faktorët e riskut të përmendur më sipër. Studime të shumta kanë treguar se trajtimi antifungal është shumë efektiv për eliminimin e simptomave, por parandalimi i infeksioneve të ardhshme kërkon një qasje gjithëpërfshirëse që mund të përfshijë ndryshime në stilin e jetesës dhe menaxhimin e faktorëve të rrezikut. Përveç trajtimit mjekësor, është e rëndësishme që gratë të jenë të vetëdijshme për higjienën e duhur dhe përdorimin e produkteve që nuk dëmtojnë florën vaginale. Sidoqoftë, më shumë kërkime janë të nevojshme për të kuptuar më mirë mekanizmat që çojnë në zhvillimin e kandidiazës dhe për të optimizuar strategjitë e parandalimit dhe trajtimit. Kjo përmbledhje ofron një pasqyrë më të detajuar për kandidiazën vulvovaginale dhe metodat e trajtimit, duke përfshirë aspektet e diagnostikimit, trajtimit dhe menaxhimit të faktorëve të riskut.

Fjalë kyçe: Candida albicans, ndryshimet hormonale, diagnostikimi, vlerësimit të simptomave, metodat e trajtimit, faktorët e riskut.

OMFALOCELA – STUDIM RASTI.

Eris Ramushi [1], Vita Krasniqi[1], Rina Krasniqi[1], Butrint Krasniqi[1], Faton Krasniqi[2]
[1]*Fakulteti i Mjekësisë, Prishtinë*
[2]*Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Klinika e Neonatologjisë, Prishtinë.*

Abstrakti

Omfalocela është një defekt i rrallë kongjenital i murit të barkut me një prevalencë të raportuar prej 3. 38 për 10, 000 shtatzëni. Shkalla e mbijetesës është afër 80% dhe lidhet drejtpërdrejt me ashpërsinë e anomalive të shoqëruara, pasi foshnjat me omfalocelë të izoluar kanë një shkallë më të lartë mbijetese (90%). Ne kemi prezantuar një të porsalindur femër, e lindur me termin, me sectio cesarea me omafalocelë. Fëmija nga shtatëzënia e parë, e kontrolluar rregullisht, 39 javë të gjestacionit, me peshë të lindjes 2750g, gjatësi trupore 50cm, A / S: 7 / 8. Foshnja transferohet menjëhere nga salla e operimit në njësinë e kujdesit intensiv, përpunohet nga aspekti kliniko - laboratorik, i hapet vija venoze, fluide sipas protokolit, terapi empirike. Analizat laboratorike rutinë ishin në vlera referente, hemokulturë sterile. Prej ekzaminimeve plotësuese, eko e trurit pa ndryshime, eko e zemrës; DAP, PFO. Pas përgatitjeve të nevojshme foshnja i nënshtrohet operimit, pa komplikime gjatë dhe pas operimit. Fillimisht mostolerancë nga sonda nazogastrike, pastaj ushqehet minimal enteral duke e rritur sasinë e ushqimit gradualisht. Pastrimi dhe fashimi i plagës bëhet cdo të tretën ditë nga kirurgu pediatrik. Ishte një anomali kirurgjike neonatale e pa diagostifikuar in utero, në bashkëpunim me kirurgët e fëmijëve është operuar në mënyrë të suksesshme, foshnja nuk kishte anomali shoqëruese përcjellëse. Foshnja lëshohet në gjendje të mirë shëndetësore, me rekomandime konsultim me kirurgun e fëmijëve sipas nevoje dhe vizita të rregullta pediatrike.

Fjalë kyçe: omfalocela, anomali kirurgjike neonatale, NICU.

EPIDEMIOLOGJIA E INTOKSIKACIONEVE PEDIATRIKE NGA PESTICIDET - NJË STUDIM RETROSPEKTIV (2024–2025).

Feride Imeraj[1], Prof. Dr. Numila Kuneshka (Maliqari)[1], Klevisa Seferi[1], Floreta Korumi(Plaku)[1], Ermioni Eirini Prifti[2]

[1]*Qendra Spitalore Universitare"Nënë Tereza", Departamenti i Pediatrisë, Shëërbimi i Pediatrisë së Përgjithshme, Tiranë, Shqipëri.*

[2]*Spitali Hygeia*

Abstrakt

Hyrje: Helmimi nga pesticidet mbetet një problem serioz i shëndetit publik te fëmijët për shkak të ndjeshmërisë biologjike dhe ekspozimit të lartë mjedisor. Gëlltitja është rruga më e zakonshme, ndërsa substancat kryesore përfshijnë organofosfatet, karbamatet, herbicidet me glifosat, rodenticidet dhe strikninën.

Objektiva: Të vlerësohet shpeshtësia, shpërndarja sipas grupmoshës, lloji i substancës dhe incidenca stinore e intoksikimeve pediatrike nga pesticidet, si dhe lidhja me parametrat laboratorikë dhe qëndrimin spitalor.

Metodologjia: Studim retrospektiv me 18 raste pediatrike (0–14 vjeç) gjatë viteve 2024–2025. Analiza e të dhënave u krye me programin JASP (v. 0. 95. 1. 0), duke përdorur statistika përshkruese dhe testin ANOVA ($p < 0.05$).

Rezultate: Nga 114 raste intoksikimesh akute, 18 raste (15. 8%) kishin lidhje me pesticidet. Grupmosha më e prekur: 0–4 vjeç (55. 6%), e ndjekur nga 5–9 vjeç (33. 3%) dhe 10–14 vjeç (11. 1%). Substancat: rodenticidet (38. 9%), insekticidet (27. 8%), pesticide të tjera (22. 2%), herbicidet (11. 1%). Sezoni me incidencën më të lartë: vera (66. 7%, kulmi në qershor & gusht).

Konkluzione: Helmimi nga pesticidet përfaqëson një pjesë të konsiderueshme të intoksikimeve pediatrike. Grupi 0–4 vjeç është më i ndjeshmi, me incidencë më të lartë në verë. Rodenticidet dhe insekticidet janë më të shpeshtat. Masa parandaluese, edukimi dhe kontrollet rigoroze janë thelbësore.

Fjalë kyçe: helmim nga pesticidet, fëmijët, intoksikime akute, rodenticide, incidencë sezonale.

PERSPEKTIVAT AKTUALE NDAJ KOMPLIKACIONEVE KARDIOVASKULARE NË SËMUNDJEN E DIABETIT.

Dr. Feride Kryeziu[1]

[1]*Mjeke e Përgjithshme, Qendra Kryesore e Mjekësise Familjare "Shaban Geci" - Kamenicë*

Abstrakt

Hyrja: Sëmundjet kardiovaskulare vazhdojnë të jenë shkaku kryesor i vdekshmërisë dhe morbiditetit tek individët me diabet mellitus. Diabeti përkeqëson proceset themelore që kontribuojnë në zhvillimin e aterosklerozës dhe insuficiencës kardiake. Fatkeqësisht, këto procese nuk adresohen në mënyrë të mjaftueshme nga trajtimet që fokusohen vetëm në arritjen e kontrollit optimal të glicemisë përmes medikamenteve ose metodave aktuale.

Objektiva: Qëllimi është të ofrohet një analizë gjithëpërfshirëse e kuptimit aktual mjekësor lidhur me komplikacionet kardiovaskulare tek pacientët me diabet mellitus, me fokus në ndërveprimin patofiziologjik midis hiperglicemisë dhe përparimit të sëmundjes kardiovaskulare. Ky rishikim synon të vlerësojë të dhënat më të fundit nga provat klinike, terapitë e udhëzuara nga udhëzimet dhe strategjitë emergjente të trajtimit që adresojnë rrezikun kardiovaskular përtej kontrollit glicemik në menaxhimin e diabetit.

Metodologjia: Ky rishikim narrativ është hartuar për të sintetizuar literaturën mjekësore bashkëkohore mbi komplikacionet kardiovaskulare të lidhura me diabetin mellitus, me një fokus të veçantë në perspektivat klinike në zhvillim dhe paradigmave terapeutike. Një kërkim gjithëpërfshirës i literaturës është realizuar nëpër databaza kryesore biomjekësore, përfshirë PubMed, Google Scholar dhe Scopus.

Rezultate: Evidencat konfirmojnë se sëmundja kardiovaskulare është shkaku kryesor i morbiditetit dhe mortalitetit në diabet. Ndërsa hiperglicemia kontribuon në dëmtimin vaskular, kontrolli i vetëm i glicemisë ka treguar një efekt të kufizuar në reduktimin e ngjarjeve kardiovaskulare. Kjo ka çuar në një ndryshim drejt

menaxhimit të integruar të rrezikut, megjithatë ende ekzistojnë boshllëqe në rezultatet afatgjata dhe strategjitë e përshtatura për popullata specifike.
Konkluzione: Komplikacionet kardiovaskulare në diabet kërkojnë një qasje gjithëpërfshirëse të menaxhimit përtej kontrollit të glukozës. Hulumtimet në vazhdimësi janë thelbësore për përmirësimin e strategjive dhe rezultateve te pacientët.

Fjalë kyçe: Diabeti Mellitus, sëmundjet kardiovaskulare, komplikacionet, ateroskleroza.

PREZANTIM I RASTIT TË PARË TË DIAGNOSTIKUAR NË SHQIPËRI ME MENINGIOENCEFALIT SHKAKTUAR NGA VIRUSI I NILIT PERËNDIMOR DHE TË DHËNA EPIDEMIOLOGJIKE QË NGA RASTI I PARË DERI NË VITIN 2025.
Ferit Zavalani, Sara Zavalani
Universiteti Luarasi, Poliklinika Specialiteteve Nr 1. Tiranë

Abstrakt
Qëllimi: Në këtë prezantim do të përshkruhet një rast me meningoencefalit, shkaktuar nga virusi i Nilit perëndimor. Virusi i Nilit është identifikuar ne vitin 1937 në Uganda në Afrikë lindore. Ai bën pjesë në familjen e flavi viruseve dhe transmetohet nëpërmjet mushkonjave, të cilat pickojnë zogjtë e infektuar. Rreth 1% e njerëzve të infektuar me virusin e Nilit perëndimor zhvillojnë simptoma të rënda (e quajtur sëmundje neuroinvasive, si encefalit, meningoencefalit ose West Nil poliomielit). Në rastet e rënda kërkohet trajtim agresiv.
Materiali dhe metoda: Në këtë studim janë përfshirë të dhëna marë nga Qendra Europiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC).
Rezultate: Rastet e infektimit në vend të raportuara nga Shqipëria në vitin 2011 (5 raste) në 2024 (106 raste), në 2025 (3 raste).
Rast klinik: Një fëmijë 12 vjec I. H me banim në Pogradec, shtrohet në fund të Korrikut 2010. Fëmija paraqiste: temperaturë të lartë, të vjella, dhimbje të forta koke që perhapeshin në qafë dhe shpinë, dhimbje të forta mesi, vështirsi për tu ngritur nga shtrati, vështirësi në ecje, fotofobi, diplopi (figurat i shihte dyshe), nuk urinonte dot. Në ekzaminimin fizik fëmija paraqiste intoksikim të përgjithshëm, i zbehtë, pozicioni pasiv (i shtrirë), qafa me rigiditet të shprehur, me Brudzinski e Kerning pozitiv, reflekset osteotendinoze prezente, reflekset kutane të ulura. Likuori cerebrospinal: ngjyra e qartë; Celula 181; Limfocite 98%; neutrofile2%. Ekzaminimi bakteriologjik i likuorit cerebro spinal steril, CT e kokës normale. Rezonanca magnetike me kontrast: Vihet re përforcim patologjik i meningjeve. Fundus oculi: stazë venoze, edemë papilare stadi i parë. Serologjia për Virusin e Nilit Perëndimor, rezultoi pozitiv nga laboratori i Selanikut. Del nga spitali klinikisht shëndoshë.
Konkluzion: rasti rezultoi me formën neuroinvazive të shkaktuar nga virusi i Nilit perëndimor.

Fjalë kyçe: meningoencefalit, virusi i Nilit perëndimor, pacient etj.

ONKOFERTILITETI SI DISIPLINË MJEKËSORË, ME FOKUS GJININË FEMËRORE.
Festa Kelmendi.

Abstrakt
Hyrje: Kanceri dhe trajtimet e tij mund të ndikojnë në fertilitet në një sërë mënyrash dhe përparimet e fundit në zbulimin dhe trajtimin e kancerit kanë çuar në një numër në rritje të të mbijetuarve për të cilët fertiliteti i ardhshëm është një shqetësim parësor. Onkofertiliteti është studimi i ndërveprimeve midis kancerit, terapisë kundër kancerit, fertilitetit dhe shëndetit riprodhues. Ruajtja e fertilitetit (FP) është një çështje e rëndësishme e cilësisë së jetës për të mbijetuarit e kancerit në moshë riprodhuese. Pavarësisht ekzistencës së udhëzimeve të gjera ndërkombëtare, ofrimi i kujdesit onkofertil, veçanërisht tek pacientët pediatrikë, adoleshentë dhe të rinj, mbetet një sfidë për profesionistët e kujdesit shëndetësor (SHK). Kimioterapia dhe radioterapia me dozë të lartë kanë rritur rrënjësisht mbijetesën afatgjatë të pacientëve të rinj me kancer, por efektet anësore kryesore të këtyre trajtimeve janë dështimi i vezoreve dhe infertiliteti. Shumë nga këto paciente nuk do të sterilizohen menjëherë pas trajtimit, por do të vuajnë nga menopauza e parakohshme. Në vitet e fundit, janë propozuar procedura të

ndryshme për trajtimin e infertilitetit. Një nga metodat më të reja është përdorimi i krioprezervimit të fragmenteve ovariane pas trajtimit të kancerit. Sipas disa studimeve, kjo metodë jep rezultate shumë të kënaqshme. Transplantimi i indeve ovariane është treguar se rikthen ciklet hormonale dhe pjellorinë, por një pjesë e madhe e rezervës së folikulit humbet si pasojë e ekspozimit ndaj hipoksisë. Një shqetësim tjetër thelbësor është rreziku i riimplantimit të qelizave malinje së bashku me indin e shartuar.
Qèllimi: Qëllimi i këtij punimi është që të shqyrtojë rëndësinë e onkofertilitetit si disiplinë mjekësore duke bërë ndërlidhjen e mjekësisë onkologjike dhe atë riprodhuese me fokus në ruajtjen e fertilitetit të pacientët me sëmundje malinje që i nënshtrohen terapive citotoksike. Synohet të shtjellohen mënyrat e mundshme të mbrojtjes së fertilitetit nga trajtimi i malinjiteteve si dhe të krahasohen dhe dikutohen shkalla e suksesit e këtyre metodave te pacientët e mbijetuar.
Metodologjia: Punimi është një rishikim i literaturës ekzistuese, bazohet në literaturën shkencore dhe burime të besueshme ndërkombëtare me qëllim që të ofrohet një pasqyrë e plotë mbi onkofertilitetin, mënyrat e ruajtjes së fertilitetit te pacientët me sëmundje malinje në moshën riprodhuese si dhe arritja në rrezulltate specifike gjatë krahasimit të studimeve të publikuara ndër vite mbi suksesin e këtyre metodave në pacientet e mbijetuar.
Rezultate dhe Diskutime: Nga të dhënat e mbledhura në literaturën e publikuar në pubmed kemi arituar në disa rezultate pozitive mbi suksesin e përdorimit të mënyrave të mundshme të ruajtjës së fertilitetit te gratë e mbijetuara nga kanceri. Sipas studimeve të publikuara është arritur në përfundim që krioprezervimi i oociteve dhe embrioneve mer përqindje më të madhe të suksesit krahasuar me metodat tjera të përdorura, gratë më të reja (nën 35 vjeç) kanë pasur shkallë më të lartë të shtatzënisë dhe lindjeve të gjalla krahasuar me grupmoshat më të mëdha, si dhe kemioterapia agresive e ul shkallën e suksesit.
Përfundime: Onkofertiliteti si disiplinë mjekësore duhet të vihet në qendër të vëmendjes së rrjeteve profesionale të onkologëve dhe gjinekologëve, duke marrë parasysh rëndësinë e madhe që ka në shëndetin e gruas dhe në cilësinë e jetës pas trajtimit të suksesshëm të malinjiteteve. Duke qenë se suksesi i metodave të ruajtjes së fertilitetit ndikohet drejtpërdrejt nga stadi i kancerit dhe momenti i ndërhyrjes, është thelbësore që të rritet niveli i informimit dhe këshillimit për gratë që përballen me këto sfida, në mënyrë që ato të marrin vendime të hershme dhe të informuara mbi opsionet e disponueshme.

Fjalë kyçe: malinjitetet, fertiliteti, krioprezervimi i oociteve, gjinia femërore.

MIKROBIOMA INTESTINALE SI FAKTOR KYÇ NË OBEZITET DHE DIABET TIP 2: PERSPEKTIVA KLINIKE.

Dr. Festa Xhepa

Abstrakt
Hyrje: Mikrobioma intestinale është shfaqur si një faktor kyç në zhvillimin e obezitetit dhe diabetit tip 2. Ndryshimet në përbërjen dhe diversitetin e florës intestinale ndikojnë drejtpërdrejt në metabolizmin e energjisë, inflamacionin kronik me gradë të ulët dhe ndjeshmërinë ndaj insulinës.
Qëllimi: Qëllimi i punimit është rishikimi i literaturës dhe hulumtimeve ndërkombëtare për të shqyrtuar rolin i mikrobiomës intestinale në patogjenezën e obezitetit dhe diabetit tip 2, si dhe potenciali e saj si target terapeutik.
Metodologjia: Punimi është bazuar në rishikim të literaturës së publikuar në vitet 2020–2025. Për rishikimin e literaturës janë përdorur faqet të internetit ScienceDirect, Pubmed dhe Cochrane.
Rezultate: Pacientët obezë dhe me diabet tip 2 shfaqin ulje të diversitetit bakterial, shtim të baktereve pro - inflamatore dhe reduktim të specieve mbrojtëse si Akkermansia muciniphila dhe Faecalibacterium prausnitzii. Këto ndryshime lidhen me deficit të SCFA - ve, permeabilitet intestinal të rritur dhe endotoksemi metabolike. Intervenimet me probiotikë, prebiotikë dhe dieta të personalizuara kanë dhënë përmirësime modeste, ndërsa transplantimi fekal (FMT) ofron rezultate premtuese në ndjeshmërinë ndaj insulinës, megjithëse evidenca mbetet e kufizuar.
Diskutime: Mikrobioma intestinale nuk është vetëm pasqyrë e statusit metabolik, por edhe modulues aktiv i tij. Ndërhyrjet mbi mikrobiotën ofrojnë perspektiva të reja në menaxhimin e obezitetit dhe diabetit tip 2, megjithatë sfidat kryesore mbeten heterogjeniteti i rezultateve, mungesa e standardizimit të protokolleve dhe nevoja për studime afatgjata.
Përfundime: Mikrobioma intestinale përfaqëson një faktor kyç dhe një target të mundshëm terapeutik në obezitet dhe diabet tip 2. Në të ardhmen, integrimi i analizave të mikrobiotës në praktikën klinike dhe zhvillimi i terapive të personalizuara mund të transformojnë qasjen ndaj këtyre sëmundjeve kronike.

Fjalë kyçe: Mikrobioma intestinale, obeziteti, diabeti tip 2, inflamacion, terapi të personalizuara.

ROLI I INFERMIERËVE PËR PARANDALIMIN E INFEKSIONEVE NOZOKOMIALE NË REPARTIN E TERAPISË INTENSIVE NEONATALE.

Festime Sadiku

Abstrakt

Hyrje: Infeksionet nozokomiale përbëjnë një ndër sfidat kryesore në njësitë e kujdesit intensiv neonatal (NICU), duke ndikuar drejtpërdrejt në mortalitetin dhe morbiditetin e neonatëve. **Qëllimi:** Synimi i këtij studimi është të vlerësojë rolin e infermierëve në parandalimin e infeksioneve nozokomiale dhe të evidentojë praktikat më efektive që kontribuojnë në reduktimin e incidencës së tyre.

Metodologjia: Studimi u realizua nëpërmjet analizës së praktikave infermierore në NICU dhe krahasimit të tyre me standardet ndërkombëtare të kontrollit të infeksioneve. U shqyrtuan strategjitë që lidhen me higjienën e duarve, kujdesin për linjat qendrore, trajnimin profesional dhe zbatimin e ndërhyrjeve të tipit "bundle care", një paketë ndërhyrjesh të koordinuara që zbatohen çdo ditë, në çdo pacient, nga çdo infermiere, për të parandaluar infeksionet spitalore. Të dhënat u bazuan në evidencat e raportuara në disa njësi klinike ndërkombëtare dhe në përvojën e drejtpërdrejtë infermierore.

Rezultatet: U vu re se respektimi rigoroz i protokolleve të higjienës së duarve, edukimi i vazhdueshëm dhe mbikëqyrja institucionale lidhen me ulje deri në 50% të rasteve të infeksioneve nozokomiale. Po ashtu, raporti adekuat infermier–pacient dhe mbështetja menaxheriale ndikojnë ndjeshëm në përputhshmërinë me standardet e sigurisë. Infermieret gjithashtu luajnë rol në vëzhgimin klinik të hershëm të shenjave të infeksioneve si ndryshime në ngjyrën e lëkurës, temperaturë ose reagimeve të neonatit, që mundëson ndërhyrje të shpejtë dhe që shpesh shpëton jetë. Studimet tregojnë se ngarkesa e lartë e punës dhe mungesa e stafit rrisin incidencën e sepsis nozokomiale, ndërsa trajnimi i vazhdueshëm profesional ul ndjeshëm rastet e infeksioneve. Po ashtu, trajnimi i vazhdueshëm profesional është thelbësor. Një projekt i publikuar në Cureus Journal (2024) tregoi se një program edukimi për infermieret mbi kontrollin e infeksioneve uli ndjeshëm rastet e infeksioneve nozokomiale pas tre muajve zbatimi. Një rishikim nga Frontiers in Pediatrics (2022) evidentoi se infermieret që ndiheshin të mbështetura dhe të përfshira në politika spitalore kishin përputhshmëri më të lartë me udhëzimet e kontrollit të infeksioneve.

Përfundime: Infermieret janë hallka qendrore në zinxhirin e kujdesit neonatal dhe luajnë rol vendimtar në parandalimin e infeksioneve nozokomiale. Forcimi i trajnimeve të vazhdueshme, auditimi periodik dhe krijimi i një kulture sigurie klinike janë elemente thelbësore për të përmirësuar cilësinë e kujdesit dhe për të reduktuar rrezikun infektiv në NICU.

Fjalë kyçe: infermierë, NICU, infeksione nozokomiale, parandalim, higjiena e duarve, edukim profesional.

ROLI I INFERMIERIT NË MENAXHIMIN E PACIENTËVE ME INFARKT AKUT TË MIOKARDIT: STUDIM RASTI.

Msc. File Braçja[1], Dr. Shk. Rajmonda Milloshi[1]
[1]*Fakulteti Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti Mjekësisë Tiranë*

Abstrakt

Hyrje: Infarkti akut i miokardit (IAM) është një emergjencë kardiake që kërkon trajtim të menjëhershëm dhe kujdes të vazhdueshëm infermieror për të parandaluar komplikacionet fatale. Roli i infermierit është thelbësor në identifikimin e hershëm të simptomave, monitorimin e parametrave jetësorë, administrimin e terapisë dhe edukimin e pacientit për stilin e jetesës pas episodit akut.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të vlerësohet rëndësia e ndërhyrjeve infermierore në menaxhimin klinik të pacientëve me infarkt akut të miokardit dhe ndikimi i tyre në stabilizimin e gjendjes hemodinamike dhe rehabilitimin e pacientit.

Metodologjia: Ky studim përfshin një rast klinik të trajtuar në pavionin e patologjisë / kardiologjisë në Spitalin Rajonal Fier. Të dhënat janë mbledhur përmes observimit të drejtpërdrejtë, dokumentacionit infermieror dhe analizave laboratorike të pacientit gjatë periudhës së hospitalizimit:
Përshkrimi i rastit klinik: Pacienti X, 63 vjeç, mashkull. Anamneza: Pacienti u paraqit në urgjencë me dhimbje të fortë retrosternale që rrezatonte në krahun e majtë dhe qafë, e shoqëruar me djersitje të ftohtë, nauze dhe ndjenjë frike për vdekje. Simptomat kishin filluar rreth 45 minuta para paraqitjes në spital. Në anamnezë kishte hipertension arterial të mjekuar me amlodipinë dhe histori familjare me sëmundje koronare. Pinte duhan prej 30 vitesh. Shenjat klinike në momentin e pranimit: Tension arterial: 90 / 60 mmHg, Frekuencë kardiake: 112 rrahje / min, Frymëmarrje: 26 / minm, Saturim oksigjeni: 89%, Dhimbje torakale 9 / 10 në shkallën VAS, Ngjyrë e zbehtë dhe djersitje e ftohtë. Analizat laboratorike: Troponina I: pozitive (+++), CK - MB: e rritur, EKG: ngritje e segmentit ST në derivacionet V2–V5 → Infarkt anterior akut i miokardit
Diskutime: Ky rast thekson rëndësinë e identifikimit të hershëm të simptomave të infarktit dhe ndërhyrjes së menjëhershme infermierore. Kujdesi infermieror i orientuar drejt stabilitetit hemodinamik, lehtësimit të dhimbjes dhe përgatitjes për ndërhyrje koronarografike është thelbësor për uljen e mortalitetit. Edukimi i vazhdueshëm i pacientit luan rol kyç në parandalimin e episodeve të përsëritura.
Përfundime: Roli i infermierit në menaxhimin e pacientëve me infarkt akut të miokardit është jetik. Monitorimi i kujdesshëm, reagimi i shpejtë dhe edukimi i pacientit për ndryshimin e stilit të jetesës ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e prognozës dhe cilësisë së jetës.

Fjalë kyçe: infarkt akut i miokardit, kujdes infermieror, koronarografi, monitorim, edukim shëndetësor.

NDIKIMI I DIABETIT MELLITUS TIP 2 NË KUALITETIN E JETËS.

Msc. File Braçja[1], Msc. Fribianka Hoxha[1, 2]
[1]*Fakulteti Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë*
[2]*Pedagoge, Albanian University*

Abstrakt
Hyrje: Diabeti mellitus përfaqëson një ndër sfidat më të mëdha shëndetësore të shekullit XXI, me një ndikim të gjerë në aspektin metabolik, psikologjik dhe social të pacientëve. Kjo sëmundje kronike manifestohet si pasojë e mungesës relative ose absolute të insulinës, apo paaftësisë së organizmit për ta përdorur atë në mënyrë efikase. Menaxhimi i përditshëm i diabetit kërkon një angazhim të vazhdueshëm, i cili shpesh perceptohet si barrë nga pacientët, duke gjeneruar një fenomen të njohur si "diabet i mbingarkuar" (overwhelmed diabetes). Kjo gjendje ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së tyre dhe në mirëqenien e përgjithshme.
Qëllimi: Ky studim ka për qëllim të vlerësojë cilësinë e jetës tek pacientët me diabet mellitus tip 2 të moshës 55 - 60 vjeç, të hospitalizuar në pavionin e Endokrinologjisë në QSUT.
Metodologjia: Studimi ndjek një qasje kuantitative. Mostra përfshin 18 pacientë të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme nga pavioni i Endokrinologjisë. Është përdorur pyetësori i standardizuar WHOQOL - BREF, i hartuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (1996), i përkthyer dhe i adaptuar në gjuhën shqipe. Ky instrument vlerëson cilësinë e jetës në disa fusha themelore: fizike, psikologjike, sociale dhe mjedisore.
Rezultate: Rezultatet tregojnë se 46. 7% e pacientëve ndihen të pakënaqur me gjendjen e tyre shëndetësore dhe e vlerësojnë cilësinë e jetës si të dobët. Nga ana demografike, gjinia mashkullore përbën 60% të kampionit. Mosha e pjesëmarrësve varion nga 55 deri në 60 vjeç, me përqendrimin më të lartë në moshën 57 vjeç (33. 3%). Sa i përket dimensionit psikologjik, 46. 7% e pacientëve raportojnë shfaqje të shpeshta të ndjenjave negative si humor i keq, ankth dhe depresion, duke reflektuar praninë e komorbiditeteve psiko - emocionale të lidhura me diabetin mellitus tip 2.
Përfundime: Studimi nxjerr në pah ndikimin negativ të diabetit mellitus tip 2 mbi cilësinë e jetës, veçanërisht në aspektin fizik dhe psikologjik. Të dhënat sugjerojnë nevojën për një qasje multidisiplinare në trajtimin e pacientëve me diabet, që përfshin jo vetëm kontrollin metabolik, por edhe mbështetje psikologjike dhe ndërhyrje për përmirësimin e mirëqenies së përgjithshme. Integrimi i shërbimeve psikosociale në kujdesin për pacientët me diabet mund të ndihmojë në reduktimin e barrës së sëmundjes dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre.

Fjalë kyçe: diabet tip 2, ndikim, kualitet jetese, pacientë.

NDIKIMI I EDUKIMIT TË VAZHDUESHEM PROFESIONAL NË INTEGRIMIN DHE ZHVILLIMIN E ROLIT TË INFERMIERËVE NË SISTEMIN SHEËNDETËSOR.

Msc. File Braçja[1], Msc. Luiza Lushi[2], Phd Cand. Erind Thartori[3], Dr. Shk. Svetllana Bitincka[4]
[1]*Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti Mjekësisë Tiranë.*
[2]*Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Europian i Tiranës.*
[3]*Qendra Spitalore Universitare N*ënë Tereza,
[4]*Mjeke Infeksioniste, Petagoge pranë Albanian University dhe Universitetit Mesdhetar.*

Abstrakt
Hyrje: Edukimi i vazhdueshëm profesional (EVP) është një proces thelbësor për garantimin e cilësisë së shërbimit shëndetësor dhe përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave infermierore. Në një sistem shëndetësor që përballet me sfida të reja, teknologji të avancuara dhe nevoja gjithnjë në rritje të pacientëve, përditësimi i njohurive dhe aftësive të infermierëve është thelbësor. EVP kontribuon jo vetëm në rritjen e kompetencave klinike, por edhe në fuqizimin e rolit të infermierëve si pjesë e ekipit multidisiplinar, duke ndikuar drejtpërdrejt në integrimin e tyre më të plotë në strukturat shëndetësore. Megjithatë, pjesëmarrja në këto programe shpesh kufizohet nga faktorë si mungesa e kohës, burimeve financiare apo mbështetjes institucionale, çka e bën të domosdoshëm studimin e ndikimit të tyre.
Qëllimi: Ky studim synon të vlerësojë ndikimin e edukimit të vazhdueshëm profesional në integrimin dhe zhvillimin e rolit të infermierëve në sistemin shëndetësor, duke analizuar perceptimet, pjesëmarrjen dhe sfidat kryesore të personelit infermieror.
Metodologjia: U zhvillua një studim deskriptiv - analitik me anë të një pyetësori të strukturuar, i shpërndarë te personeli infermieror në institucione të ndryshme shëndetësore. Të dhënat u përpunuan dhe u analizuan me metoda statistikore përshkruese dhe krahasuese.
Rezultate: Në studim morën pjesë gjithsej 230 infermierë, nga të cilët 61% ishin femra dhe 39% meshkuj. Sipas të dhënave të mbledhura rezulton se 75% i përkisnin moshës 18–40 vjeç. Rreth 40% e pjesëmarrësve raportuan se marrin pjesë rregullisht në trajnime, konferenca dhe seminare, ndërsa pjesa tjetër pranoi se nuk kanë gjithmonë mundësi për të ndjekur aktivitete të tilla. Rezultatet tregojnë se pjesëmarrja e vazhdueshme në edukim profesional ka ndikim pozitiv në zhvillimin e rolit të infermierëve dhe integrimin e tyre në ekipin multidisiplinar.
Përfundime: Studimi nxjerr në pah rëndësinë e EVP si një mjet i domosdoshëm për zhvillimin profesional të stafit infermieror si dhe për forcimin e rolit të tyre në sistemin shëndetësor. Pjesëmarrja e rregullt në trajnime dhe seminare lidhet ngushtë me aftësinë për të përmirësuar cilësinë e kujdesit ndaj pacientit, për të rritur sigurinë klinike dhe për të lehtësuar integrimin në strukturat institucionale. Megjithatë, mungesa e mbështetjes institucionale dhe pengesat financiare mbeten sfida që kërkojnë adresim. Rekomandohet hartimi i politikave kombëtare dhe institucionale që nxisin EVP, duke e bërë atë më të aksesueshëm dhe më të përshtatur me nevojat reale të praktikës infermierore.

Fjalë kyçe: Edukimi i vazhdueshëm profesional, integrimi i infermierëve, zhvillimi profesional, kujdes shëndetësor, trajnimet.

MORTALITETI DHE MBIJETESA E PACIENTËVE DIABETIKË NË DIALIZË: NJË ANALIZË GJITHËPËRFSHIRËSE E REZULTATEVE KLINIKE.

Fiona Nasto

Abstrakt
Objektiva: Diabeti mellitus (DM) është shkaku kryesor i sëmundjes renale në fazën përfundimtare dhe një përcaktues kyç i mbijetesës tek pacientët në dializë. Ky studim vlerësoi trendet demografike, shkallët e vdekshmërisë dhe parashikuesit e mbijetesës midis pacientëve diabetikë dhe jo - diabetikë që i nënshtrohen dializës në pesë qendra në Shqipëri nga viti 2020 deri në vitin 2024.
Metoda: Ne kryem një analizë retrospektive kohorte të 2, 125 pacientëve në dializë (mosha mesatare që rritet nga 59. 6 në 63. 1 vjeç; 33–34% femra) të trajtuar në Vlorë, Shkodër, Lezhë, Elbasan dhe Korçë. Të dhënat përfshinin moshën, seksin, llojin e aksesit vaskular, statusin e diabetit dhe vdekshmërinë vjetore. Regresioni shumëvariabël i Cox u përdor për të identifikuar parashikuesit e vdekshmërisë.

Rezultate: Popullsia totale e dializës u rrit nga 396 (2020) në 476 (2024), me prevalencën diabetike që rritet nga 23. 5% në 30. 0%. Shpërndarja e moshës u zhvendos drejt grupeve më të vjetra, me pacientët ≥75 vjeç që u rritën nga 9% në 15%. Vdekshmëria ra nga 23. 3% në vitin 2020 në 14. 3% në vitin 2024. Vdekshmëria midis pacientëve diabetikë mbeti më e lartë se tek pacientët jo - diabetikë çdo vit (2020: 27. 9% kundrejt 21. 4%; 2024: 25. 4% kundrejt 10. 6%). Pacientët ≥75 vjeç kishin vazhdimisht vdekshmërinë më të lartë (>40% në vitet 2020–2022).
Regresioni i Cox tregoi se mosha ishte parashikuesi më i fortë i pavarur i vdekshmërisë: krahasuar me <20 vjeç, HR për moshën 60–79 vjeç ishte ~2. 6 dhe për ≥80 vjeç ~3. 3–4. 3 ($p<0.01$). Seksi mashkull nuk ishte i lidhur ndjeshëm me vdekshmërinë. Diabeti u bë një parashikues i pavarur në vitet 2023–2024 (HR ~1. 25, $p<0.05$). Aksesi vaskular ndikoi fuqishëm në rezultatet: kateterët venoz central I perkohshem rezultoi me rrezikun më të lartë (HR 5. 6–8. 3, $p<0.001$ kundrejt fistulës arteriovenoze), dhe kateterët e perhershem gjithashtu rritën rrezikun (HR ~1. 5–1. 7).
Përfundime: Gjatë pesë viteve, numri i pacientëve në dializë dhe mosha u rritën, ndërsa vdekshmëria ra në përgjithësi. Megjithatë, statusi diabetik, mosha e avancuar dhe aksesi vaskular (kateteret venoz central) mbetën parashikuesit kryesorë të vdekshmërisë. Përpjekjet për të optimizuar aksesin vaskular dhe për të menaxhuar diabetin mund të përmirësojnë mbijetesën tek pacientët në dializë.

Fjalë kyçe: diabeti mellitus, sëmundje renale, dializë, vdekshmëri.

GASTROENTERITI AKUT - RISHIKIM I LITERATURËS.

Dr. Fisnik Frangu

Abstrakt
Hyrje: Gastroenteriti akut është një sëmundje që manifestohet me inflamacion të papritur të stomakut dhe zorrëve. Është një ndër infeksionet më të shpeshta në botë me milliona të infektuar, dhe zakonisht infeksioni mirret nga ushqimi. Shkaktohet nga një numër i madh mikroorganizmash gastrointestinal, si nga: bakteret, virusët, parazitët. Klinikisht manifestohet me diarre, vjellje, temperaturë, plogështi, dhembje barku, të përziera (nausea), dobësi dhe lodhje. Trajtimi arrihet përmes rehidrimit, dietës së lehtë, barnave simptomatikë, antibiotikëve (në rast se infeksioni është bakterial).
Qëllimi i punimit: Qëllimi i këtij punimi është rishikimi edhe një herë i simptomave të përgjithëshme të gastroentertit akut, menaxhimin dhe trajtimin adekuat të tyre.
Metodologjia e punës: Punimi është realizuar në trajtën e "rishikimit të literaturës", duke përdorur artikuj shkencor dhe profesional të publikuara në databaza elektronike si PubMed, National Library of Medicine, MedLine Plus.
Përfundime: Gastroenteriti akut është një inflamacion i stomakut dhe zorrëve, që manifestohet me simptoma të zakonshme si diarre, të vjella, temperaturë dhe dhimbje barku. Trajtimi duhet të jetë i përshtatur në bazë të etiologjisë (bakteriale, virale apo parazitare), duke siguruar qasje të shpejtë dhe efektive për të parandaluar komplikimet.

Fjalë kyçe: Gastroenteriti akut, infeksion, simptoma, trajtim.

NDËRLIDHJA E OBEZITETIT ME MUNGESËN E VITAMINËS D.

Fisnik Kelmendi

Abstrakt
Hyrje: Obeziteti përfaqëson një gjendje metabolike kronike që karakterizohet nga akumulimi i tepërt i yndyrës trupore dhe është i lidhur ngushtë me rritjen e rrezikut për sëmundje kardiovaskulare, diabet të tipit 2 dhe sindromë metabolike. Rritja e prevalencës së obezitetit është bërë një problem i madh shëndetësor në mbarë botën tek të rriturit, si dhe tek fëmijët dhe adoleshentët. Adipoziteti total dhe akumulimi i yndyrës subkutane trunkale gjatë adoleshencës shoqërohen pozitivisht dhe në mënyrë të pavarur me arteriosklerozën në moshat e rritura. Akumulimi qendror i yndyrës trupore shoqërohet me rezistencën ndaj insulinës, ndërsa shpërndarja e

yndyrës trupore në një model periferik është metabolikisht më pak e rëndësishme. Në anën tjetër, vitamina D luan rol të rëndësishëm në homeostazën e kalciumit, funksionin imunitar dhe shëndetin kardiometabolik. Studimet kanë treguar se mungesa e vitaminës D është më e përhapur tek personat obezë, si rezultat i shpërndarjes së saj në indin dhjamor dhe efektit të hollimit volumetrik. Kjo lidhje komplekse mes obezitetit dhe vitaminës D është veçanërisht e rëndësishme për pacientët që i nënshtrohen kirurgjisë bariatrike, të cilët janë në rrezik të shtuar për mangësi ushqyese. Ky punim shqyrton mekanizmat e mundshëm të kësaj lidhjeje, rëndësinë klinike dhe nevojën për qasje të personalizuara në suplementim.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të ofrojë një rishikim dhe analizim të literaturëss aktuale në dispozicion në raport me nderlidhjen e obezitetit me mungesën e vitaminëss D në mosha të reja si dhe të bëhet vlersimi i rëndësise klinike të këtij ndikimi.
Metodologjia: Punimi është realizuar në trajtë të rishikimit të literaturës ekzistuese. Duke hulumtuar në libra me renome botërore në fushën e mjekësisë dhe punime shkencore të arritshme përmes Web faqeve kredibile mjekësore është tentuar të arrihen njohuri me të gjera dhe me të thella si dhe paraqitja e figurave për një ilustrim më të mirëfillt e informativ.
Rezultate dhe diskutime: Sipas studimit ekziston një ndërlidhje në mes obezitetit dhe mungesës së vitaminës D, në rastet e analizuara është ardhur në përfundim se konsumimi i tepërt i vitaminës D tek obezët rezulton me mungesë të saj në gjak përshkak të akumulimit në indin dhjamor si dhe humbja e peshës pas një diete ketogjenike rezulton në rritje të nivelit të vitaminës D në gjak që aprovon faktin që vitamina D çlirohet nga rezervat dhjamore gjatë reduktimit të yndyrës trupore. Sipas studimit 2 pavarsisht rajonit prevalenca e mungesës së vitaminës është 35% më e lartë të individet obezë. Sipas studimit 3 ekziston një dallim në nivel të rajonit sa I përket ndërlidhjes së mungesës së vitaminës D dhe obezitetit, dallim i cili fokusohet në stilin e jetesës.
Përfundime: Si rezultat i rishikimit dhe analizimit të punimeve shkencore aktuale kemi ardhur në përfundim se është prezente mungesa e vitaminës D në serum të përsonat obezë megjithëse nuk përbënë rëndësi të madhe klinike përshkak të marrjes së vitaminës D prej vendeve ku është e akumuluar në trup. Një dietë e shëndetshme që do të ndihmonte obezitetin do të ndikonte pozitivisht në rritjen e vitaminës D në serum. Pavarsisht mos ndikimit të theksuar të rëndësisë klinike ekziston një nevojë e përsonalizuar në trajtimin me suplemente të vitaminës D te përsonat obezë e sidomos kjo nevojë theksohet në rastet e kirurgjisë bariatrike ku mangësite ushqyese janë të shpeshta dhe potencialisht të rrezikshme.

Fjalë kyçe: vitamina D, obeziteti, efektit i hollimit volumetrik, kirurgjia bariatrike.

RËNDËSIA E KOMUNIKIMIT NË NDËRTIMIN E MARËDHËNIES.
Fitore Doma

Abstrakt
Hyrje: Komunikimi dhe marrëdhëniet infermier–pacient: ura e besimit në kujdesin shëndetësor. Komunikimi midis infermierit dhe pacientit nuk është thjesht shkëmbim informacioni; është një urë që lidh njohuritë profesionale me zemrën dhe besimin e pacientit. Fjala e kujdesshme, dëgjimi i vëmendshëm dhe empatia krijojnë marrëdhënie të forta, që ndikojnë drejtpërdrejt në përvojën dhe mirëqenien e pacientit. Kjo temë vlerëson rëndësinë e komunikimit terapeutik, etikën profesionale dhe dimensionin human të kujdesit shëndetësor. Ajo thekson se marrëdhënia që ndërtohet me pacientin është themeli i shërimit, respektit reciprok dhe besimit, duke e bërë kujdesin infermieror jo vetëm teknik, por edhe human dhe të ndjerë.
Metodologjia: Ky është një studim përshkrues dhe analitik. Analizohen situata reale në Qendrën Shëndetësore ose në pavijonin spitalor ku infermieri ka kontakt të drejtpërdrejtë me pacientin. Popullata e studimit: 50 pacientë të trajtuar në qendër shëndetësore dhe spital. 20 infermierë me eksperiencë mbi 5 vite në shërbim.
Rekomandime: Infermierët duhet të marrin trajnim të vazhdueshëm në komunikim dhe ndjeshmëri. Politikat e kujdesit shëndetësor duhet të fokusohen në zvogëlimin e peshës administrative për infermierët për të lejuar më shumë ndërveprim me pacientët. Të krijohet një mjedis që inkurajon komunikimin e hapur mes infermierëve dhe pacientëve.

Fjalë kyçe: marrëdhënia humane, etika e komunikimit, forca e empatisë, harmonia infermier–pacient etj.

INTELIGJENCA ARTIFICIALE NË MJEKËSINË DIAGNOSTIKE.
Fjolla Ahmetxhekaj

Abstrakt
Hyrje: Inteligjenca Artificiale (AI) është një forcë e fuqishme në sektorë të ndryshëm, dhe kujdesi shëndetësor nuk bën përjashtim. Në mjekësinë diagnostike, teknologjitë e AI po integrohen gjithnjë e më shumë në praktikën klinike, duke ndryshuar rrënjësisht mënyrën se si profesionistët e kujdesit shëndetësor i qasen vlerësimit dhe diagnostikimit të pacientëve. Rëndësia e diagnostikimit të saktë dhe në kohë nuk mund të mbivlerësohet, pasi ato përbëjnë shtyllën kurrizore të planeve efektive të trajtimit të pacientëve.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të theksojë synimet kryesore që i ka përdorimi i intelegjences artificiale në diagnostic për përmirësimin e rezultateve të pacientëve, rritjen e efikasitetit të sistemeve të kujdesit shëndetësor dhe personalizimin e qasjeve të trajtimit.
Metodologjia: Ky punim kategorizohet në grupin e rishikimeve të literaturës. Metodat e përdorura në këtë punim janë metoda përshkruese dhe metoda krahasuese. Literatura ekzistuese që ndërlidhet me përdorimin e inteligjencës artificiale në mjekësinë diagnostike u sigurua përmes një kërkimi të literaturës në bazat e të dhënave si PubMed, Google Scholar, Medline, The Lancet. Kërkimi u krye me fjalët kërkimore në gjuhën angleze "Artificial Intelligence (AI)", "Machine Learning", dhe "Diagnostic Imaging".
Rezultate: Rezultatet kanë treguar se AI ka potencial të rëndësishëm në përmirësimin e mjekësisë diagnostikuese përmes rritjes së shkallës së saktësisë, efikasitetit, dhe kujdesit të personalizuar të pacientëve. Megjithatë, për të realizuar plotësisht potencialin e tij, palët e interesuara duhet t'i adresojnë sfidat ekzistuese dhe të nxisin një mjedis të favorshëm për inovacionin dhe praktikën etike të përdorimit të inteligjencës artificiale në diagnostikim.
Përfundime: Ndërsa AI vazhdon të evoluojë, integrimi i saj në praktikat diagnostike është i domosdoshëm për të transformuar ofrimin e kujdesit shëndetësor dhe për ta bërë kujdesin me cilësi të lartë më të përfshirë për të gjithë.

Fjalë kyçe: inteligjenca artificiale, imazheria diagnostike, diagnostikë e përparuar.

HIPERTENSIONI INTRAKRANIAL DHE MENAXHIMI I TIJ.
Fjolla Morina

Abstrakt
Hyrja: Hipertensioni intrakranial, i njohur edhe si presioni i rritur intrakranial, paraqet gjendje neurologjike komplekse që vjen si pasojë e një numri të madh të patologjive. Etiologjia e HIK varion nga lëndimet traumatike të kokës, hemorragjitë, lezionet okupuese, malformacionet kongjenitale, hidrocefalia, shkaktarët e shumtë ekstrakranialë. Presioni i rritur intrakranial paraqet sfidë të vërtetë në praktikën klinike, dhe diagnostikimi i hershëm dhe qasja multidisiplinare janë celësi i suksesit.
Qëllimi: Ky punim ka për qëllim përmbledhjen e njohurive ekzistuese mbi temën përkatëse dhe konsolidimin e të dhënave nga burime e publikime të ndryshme. Duke rishikuar dhe përmbledhur këtë literaturë, njihemi më mirë me etiologjinë, pasqyrën klinike, diagnostikimin e menaxhimin e hipertensionit intrakranial.
Metodologjia: Ky prezantim paraqet rishikim sistematik të literaturës bazuar në punimet shkencore të publikuara në databaza si PubMed, dhe në revistat prestigjioze si Acta Neurochirurgica, Anasthesia and Analgesia, Nevue Neurologique, Neurocritical care, Journal of Neurosurgery e të ngjashme.
Rezultate: Janë prezantuar hulumtime mbi rëndësinë e monitorimit të presionit intrakranial te pacientët me hemorragji subarachnoidale dhe lëndime traumatike të trurit, dhe është përfunduar se egziston një lidhshmëri mes monitorimit të vazhdueshëm të presionit dhe uljes së mortalitetit. Po ashtu, është prezantuar edhe një tjetër hulumtim për lidhjen e mundshme të zvogëlimit të mortalitetit dhe trajtimit të pacientëve me terapi medikamentoze plus kraniektomi dekompresive krahasuar me ata që trajtohen vetëm në mënyrë konzervative. Ky hulumtim nuk ka ofruar evidenca të forta se pacientët që trajtohen me medikamente dhe me kraniektomi dekompresive kanë rezultate më të mirë në menaxhimin e hipertensionit intrakranial.

Fjalë kyçe: hipertension, intrakranial, menaxhimi etj.

NJOHURITË E POPULLATËS MBI FAKTORËT E RREZIKUT NË SËMUNDJET KARDIOVASKULARE.

Fjollë Destani

Abstrakt
Hyrje: Sëmundjet e zemrës dhe të enëve të gjakut, të njohura ndryshe si sëmundje kardiovaskulare (SKV), janë shkaktari kryesor i vdekjeve në botë. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, e cila thekson se rreth 17. 9 milionë vdekje çdo vit, që do të thotë se afër një e treta e të gjitha vdekjeve globale janë shkaktuar nga këto sëmundje.
Qëllimi: Qëllimi primar i këtij punimi është të vlerësojë nivelin e njohurive të popullatës mbi faktorët e rrezikut të lidhur me sëmundjet kardiovaskulare. Nëpërmjet këtij punimi masteri, qëllimi është të kuptohet më thellë niveli i vetëdijes së popullatës dhe raporti i tyre ndërmjet njohurive dhe sjelljeve në fushën e shëndetit kardiovaskular si dhe në vlerësimin e ndikimit të faktorëve socio - ekonomikë, edukativë dhe demografikë në këtë njohuri.
Materiale dhe metoda: Hulumtimi ka qasje kualitative, duke u përqendruar në vlerësimin e njohurive të popullsisë në lidhje me faktorët e rrezikut për sëmundjet kardiovaskulare, përmes një kombinimi të pyetësorëve dhe intervistave të organizuara.
Rezultatet e Pritshme: Duke u bazuar në qëllimin e punimit dhe në përvojat e mëparshme të ngjashme, pritjet janë që rezultatet do të hedhin në pah se nivelin e njohurive në popullatën e Komunës së Gjilanit për faktorët e rrezikut të sëmundjeve kardiovaskulare.

Fjalë kyçe: popullatë, faktorë rreziku, sëmundje kardiovaskulare etj.

CIST HIDATIK KARDIAK: NJË PARAQITJE E RRALLË E INFEKSIONIT NGA ECHINOCOCCUS.

Fjorba Mana[1], Ketjon Menkshi[2], Adeline Musliu[1], Klodian Krakulli[1], Edvin Prifti[1], Altin Veshti[1]
[1]*Shërbimi i Kirurgjisë Kardiake në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë*
[2]*Shërbimi i Kirurgjisë Kardiake në Qendrën Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi", Tiranë*

Abstrakt
Hyrje: Hidatidoza kardiake është një formë tepër e rrallë e infeksionit nga Echinococcus, me shfaqje të cisteve hidatike në zemër, që përbën vetëm 0. 5–2% të të gjitha rasteve të sëmundjes hidatide. Më shpesh lokalizohet në miokardin e ventrikulit të majtë, por mund të përfshijë gjithashtu ventrikulin e djathtë, atriumet, perikardin dhe septumin ndërventrikular. Prezantimi klinik është shumë i ndryshueshëm, nga pacientë asimptomatikë deri në raste të rënda me shok kardiogjen apo vdekje të papritur. Ky punim paraqet një rast të rrallë të një cisti Ekinokoku intramiokardiale në murin e lirë të ventrikulit të majtë, te një pacient 14 - vjeçar nga një zonë rurale në veri të Shqipërisë. Pacienti u paraqit në gjendje shoku kardiogjen TA 60 / 40 mm Hg, temperature 37. 8*C dhe takikardi paroksizmale supraventrikulare. Prej 2 javesh me simptoma si: kollë, dhimbje kraharori, palpitacione, vështirësi në frymëmarrje, lodhje, nauze dhe dhimbje abdominale. Ekokardiografia zbuloi një cistë anekoegjen me përmasa 7×7 cm që shkaktonte regurgitim mitral të rëndë. Rezonanca magnetike konfirmoi lezionin, ndërsa imazheria e mëtejshme përjashtoi përfshirje të organeve të tjera. Pacienti iu nënshtrua ndërhyrjes kirurgjikale me sternotomi mediane, aspirim dhe ekscizion të cistit nën asistencë të bypass - it kardiopulmonar. Histologjia konfirmoi ekinokokozën kardiake. Pas operacionit, u fillua trajtimi me Albendazol për 12 javë. Pacienti u largua nga spitali në gjendje të mirë në ditën e shtatë pas operacionit. Ky rast nënvizon rëndësinë e diagnozës së hershme dhe trajtimit multidisiplinar për parandalimin e komplikacioneve dhe rikthimit të sëmundjes.

Fjalë kyçe: cist hidatik, ekinokokozë kardiake, infeksion parazitar, kirurgji kardiake.

DIAGNOSTIKIMI I SËMUNDJES HASHIMOTO NË KUJDESIN PARËSOR: SFIDA DHE MUNDËSI PËR PËRMIRËSIM TË HERSHËM TË MENAXHIMIT KLINIK.

Flamur Bajrami

Abstrakt

Hyrje: Tiroiditi Hashimoto është një sëmundje autoimune kronike që prek gjëndrën tiroide dhe është shkaku më i shpeshtë i hipotiroidizmit në vendet me jod të mjaftueshëm. Diagnoza e hershme dhe e saktë në kujdesin parësor është thelbësore për të parandaluar komplikacionet afatgjata dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së pacientëve.

Qëllimi: Ky punim synon të shqyrtojë rëndësinë e njohjes klinike të shenjave dhe simptomave të hershme të Hashimotos nga mjekët e kujdesit parësor, të analizojë rolin e testeve laboratorike si TSH, anti - TPO dhe anti - TG në diagnostikim, si dhe të vlerësojë sfidat që hasin profesionistët shëndetësorë në praktikën e përditshme.

Përfundime: Bazuar në literaturën më të fundit dhe përvojën klinike, propozohet një qasje sistematike për identifikimin dhe referimin e pacientëve në fazat e para të sëmundjes. Gjetjet tregojnë se mungesa e protokolleve standarde, variacionet në prezantimin klinik dhe aksesueshmëria në testime specifike paraqesin barriera për diagnozën e hershme. Forcimi i trajnimeve për mjekët e familjes dhe përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet niveleve të kujdesit shëndetësor janë thelbësore për menaxhimin efektiv të kësaj patologjie në nivelin bazë të shërbimeve shëndetësore.

Fjalë kyçe: Hashimoto, kujdesi parësor, hipotiroidizëm, diagnozë, autoimunitet, mjekësia familjare.

TUMORËT PRIMAR DHE SEKONDAR TË TRURIT DHE TRAJTIMI I TYRE.

Fleta Balidemaj

Abstrakt

Hyrja: Tumoret ndahen në dy grupe: beninje dhe malinje. Ato beninje i karakterizon rritje e kufizuar, mbeten të lokalizuara dhe nuk përhapen në vende tjera, ndërsa tumoret malinje, të cilat kolektivisht quhen 'kancer', invadojnë e shkatërrojnë strukturat fqinje dhe përhapen në organet në largësi, dukuri të cilën e quajmë metastazim. Tumoret e trurit, bazuar në prejardhjen e tyre qelizore, si dhe atë se si do t'i trajtojmë në këtë punim, mund të jenë primare dhe sekondare. Incidenca vjetore e tumorëve intrakranial është nga 10 deri në 17 për 100000 persona, me ç'rast gjysma deri tre të katërtat janë primare, e pjesa tjetër janë metastatike (sekondare). Tumorët e trurit mund të jenë intra - aksialë dhe ekstra - aksialë.

Qëllimi: Ky punim ka për qëllim të analizojë numrin e rasteve të trajtuara për tumorë të trurit në Klinikën e Neurokirurgjisë në QKUK, gjatë vitit 2022 dhe 2023, të analizojë karakteristikat epidemiologjike të këtyre rasteve, llojet më të shpeshta të tumorëve dhe trajtimin e tyre.

Metodologjia: Punimi është i tipit retrospektiv deskriptiv. Të dhënat janë mbledhur nga protokollet e Klinikës së Neurokirurgjisë në QKUK, pas lejes nga Komiteti Etik i Fakultetit të Mjekësisë dhe nën mbikqyrje të stafit përgjegjës. Analiza statistikore është bërë me programin Microsoft Excel dhe rezultatet janë paraqitur me tabela e grafikë.

Rezultate: Gjatë periudhës dyvjeçare 2022 – 2023, në Klinikën e Neurokirurgjisë në QKUK janë hospitalizuar gjithsej 1391 raste dhe 197 pacientë kanë qenë të hospitalizuar / trajtuar për tumore intrakraniale, duke përbërë 14. 16% të të gjithë pacientëve. Grupmosha më e prekur është ajo nga 61 – 80 vjet, me gjithsej 89 raste apo 45. 18% e të gjitha rasteve dhe pastaj kemi grupmoshën 41 – 60 vjet, me 78 raste (39. 59%). Tumori i regjistruar më së shumti është meningioma (28 raste), e të dytët me radhë vijnë tumoret metastatike me 12 raste. 19. 3% e pacientëve kishin manifestuar hemiparezë, 5. 1% disfazi (5. 1%), 3. 55% epilepsi sekondare e kështu me radhë. Sa i përket trajtimit, numri më i madh i pacientëve i është nënshtruar metodës së kraniotomisë osteoplastike (177 raste apo 89. 84%).

Përfundime: Tumorët intrakranial të trurit, ndonëse nuk janë tumoret më të shpeshta që paraqiten mes popullatës, mbesin problematike për shkak të shkallës së lartë të morbiditetit dhe mortalitetit që kanë. Megjithatë, avancimi në modalitetet imazherike të përdorura për diagnostikim, trajtimi i hershëm kirurgjik me reseksion të plotë të tumorit dhe ndjekja post - operative e pacientëve, maksimalizon shërimin, përmirëson prognozën dhe minimizon rastet për rekurencë.

Fjalë kyçe: tumore, intrakraniale, prognoza, modalitete imazherike.

NATYRALE APO SINTETIKE: VLERËSIM I OPSIONEVE TË TRAJTIMIT NGA PERSPEKTIVA E PACIENTËVE.

Flora Doko[1], Sead Salkoski [1], Elita Usejni [2]
[1]*Farmaci "Primavita" - Strugë, Maqedoni e Veriut*
[2]*PZU "Duo Medica" - Strugë, Maqedoni e Veriut.*

Abstrakt
Përdorimi i trajtimeve me bazë natyrore ka ekzistuar për mijëra vjet në kulturën e pothuajse çdo popullate në botë. Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë, kur bëhet fjalë për trajtimet, ende beson se ajo që është natyrale është më e sigurt nga ajo që është produkt " jonatyral" ose sintetik. Kjo ngjalli kuriozitetin tonë për të hulumtuar preferencat e pacientëve tanë, si dhe sigurinë dhe efektivitetin e barnave natyrale dhe sintetike për trajtimin e gjendjeve të ndryshme shëndetësore si: kapsllëku, diarreja, dermatiti, gripi dhe ftohja. Një studim cross - sectional, i bazuar në pyetësorë u përdor për të hulumtuar perspektivat e pacientëve (N = 156) në lidhje me preferencat dhe përvojat e trajtimit me produkte me bazë natyrale krahasuar me ato sintetike. Studimi u bazua në Komunën e Strugës, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe pjesëmarrës në studim ishin 57 meshkuj dhe 99 femra. Rezultatet e grumbulluara u analizuan dhe vizualizuan nga MS. Excel 2016. Nga rezultatet e grumbulluara vërejtëm se 88% e pjesëmarrësve ndanë mendimin se barnat me bazë natyrale janë alternativë më e mirë për të trajtuar gjendjet e lehta shëndetësore sesa barnat sintetike. 63% e pjesëmarrësve në studim ishin të bindur se produktet natyrale kanë më pak efekte anësore sesa alternativat sintetike dhe 21% e tyre i konsideronin produktet natyrale më efektive sesa produktet sintetike. Sa i përket ftohjes dhe gripit, 33% e pacientëve të anketuar zgjodhën produkte natyrale për trajtimin e gripit dhe ftohjes, ndërsa 42% e pacientëve preferojnë të përdorin kombinimin e barnave natyrale dhe sintetike. Si përfundim, rezultatet sugjerojnë se pacientët kryesisht zgjedhin produkte me bazë natyrale për trajtimin e gjendjeve të lehta shëndetësore, për më tepër, i konsiderojnë produktet natyrale të kenë më pak efekte anësore. Gjithashtu, pacientët kryesisht marrin në konsideratë sigurinë dhe potencialin për efekte anësore kur zgjedhin midis këtyre trajtimeve.

Fjalë kyçe: Produkte natyrale, produkte sintetike, perspektivat e pacientëve.

VLERËSIMI I ZAKONEVE DHE PREFERENCAVE USHQYESE TEK STUDENTËT INFERMIER, GJATË VITIT AKADEMIK 2024 - 2025.

Flora Zyberaj, Altina Lajqi, Stela Muça.

Abstrakt
Hyrje: Ushqyerja e duhur është një nga faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në zhvillimin e duhur të njeriut, gjendjen ushqyese dhe ruajtjen e shëndetit të mirë. Diplomimi dhe arritja e aftësive personale, është një periudhë e zhvillimit të aftësive të vetëvendosjes dhe vetërealizimit, edhe në rastin e të ushqyerit. Studentët dhe të rinjtë, janë grupi më i prekshëm ndaj efekteve të të ushqyerit jo të duhur. Mënyra e të ushqyerit gjatë kësaj periudhe, ndikon në shëndetin psikofizik dhe emocional, efektivitetin në procesin e të nxënit dhe ka ndikim në shëndetin në moshë madhore.
Objektivi: Qëllimi i këtij studimi ishte të vlerësonte zakonet dhe preferencat ushqyese studentëve infermier të vitit I, II, III dhe të identifikohen ndryshimet në gjendjen psikoemocionale të tyre.
Materiale dhe metoda: Në studim morën pjesë 398 studentë efektiv, të vitit parë, dytë, tretë, diploma infermieri, përgjatë vitit akademik 2024 - 2025. Materiali i kërkimit ishte, pyetësor standart me vetraportim që përmbante pyetje që shqyrtonin zakonet e të ngrënit të studentëve të anketuar. Analiza statistikore u krye duke përdorur programin StatSoft, Inc. STATISTICA versioni 20. 0. Për të vlerësuar ndryshimet midis dy cilësive të ekzaminuara, u përdor testi Chi2, i pavarësisë. Si nivel statistikisht i rëndësishëm u supozua niveli $p \leq 0.05$. sjelljeve të tyre të të ngrënit.
Rezultate: Në grupin e anketuar të studentëve, më shumë se gjysma (61. 6%) hanin 4 - 5 vakte në ditë. 91, 3% e stu të shdentëve, deklaruan se hanë ushqime të lehta midis vakteve, dhe kishin një peshë normale Midis vakteve, të rinjtë konsumonin më shpesh fruta dhe perime (65%) dhe ëmbëlsira (59. 66%). Konsumi ditor i mëngjesit të parë para daljes nga shtëpia deklaruan më shumë se gjysma (75%) e studentëve të anketuar. Konsumimi i produkteve që përmbajnë proteina të plota disa herë në javë u deklarua nga 71. 2 %. Buka integrale konsumohej çdo ditë nga 29. 8% e të anketuarve, dhe produktet e drithërave konsumoheshin çdo ditë nga 54% e të rinjve. 43. 33% pinin qumësht dhe produkte qumështi çdo ditë, ndërsa frutat dhe perimet disa herë në ditë

konsumoheshin nga 64. 66% e studentëve të anketuar. Konsumi i produkteve të tipit "ushqim i shpejtë" disa herë në muaj u deklarua nga 51. 66%, ndërsa konsumimi i parregullt i vakteve u deklarua nga 21. 33% e nxënësve të studentëve. Aktiviteti fizik u deklarua nga 91. 99%, dhe 4 - 5 herë në javë nga vetëm 20. 68% e studentëve të anketuar.
Konkluzione: Hulumtimi i kryer mi statusin ushqimor të studentëve infermier, tregon se zakonet e të ngrënit të shumicës së studentëve të anketuar, janë të kënaqshme. Krahasimi i zakoneve të të ngrënit midis studentëve nuk tregoi dallime të rëndësishme. Megjithëse u gjetën edhe zakone jo të shëndetëshme si: ngrënia e ëmbëlsirave midis vakteve, vakte të parregullta dhe aktivitet fizik i pamjaftueshëm. Një fenomen pozitiv ishte ngrënia e frutave dhe perimeve midis vakteve dhe përzgjedhja e ujit mineral dhe lëngjeve, si pijet më të konsumuara.

Fjalë kyçe: ushqyerje, student, zakone etj.

LIDHJA MIDIS PREFERENCAVE USHQIMORE DHE STATUSIT USHQIMOR TEK FËMIJËT DHE ADOLESHENTËT NË TIRANË: NJË STUDIM TRANSVERSAL.

Floriana Marku (Kandidat për PhD) [1], Prof. Ass. Loreta Kuneshka[2], Prof. Ass. Arbenita Hasani[3]

Abstrakt
Hyrje: Zakoni i ushqyerjes dhe preferencat ushqimore luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e statusit ushqimor tek fëmijët dhe adoleshentët. Studimet tregojnë se preferencat për ushqime me densitet të lartë energjie, të pasura me sheqer dhe yndyra, shpesh shoqërohen me rritje të indeksit të masës trupore (BMI), ndërsa preferencat për fruta, perime dhe ushqime tradicionale lidhen me një status ushqimor më të shëndetshëm. Në Shqipëri, të dhënat për këtë lidhje mbeten të kufizuara.
Qëllimi: Të vlerësohet marrëdhënia midis preferencave ushqimore dhe statusit ushqimor (BMI) tek nxënësit e shkollave 9 - vjeçare dhe gjimnazeve në qytetin e Tiranës.
Metoda: Studimi ishte transversal dhe përfshiu 623 nxënës (mosha 6–17 vjeç), të përzgjedhur me metodë të rastësishme nga shkolla publike të qytetit të Tiranës. Të dhënat u mbledhën gjatë periudhës Janar - Mars 2024, me pyetësor të strukturuar mbi preferencat ushqimore, ndërsa matjet antropometrike (peshë, gjatësi, BMI) u kryen sipas protokolleve standarde të OBSH. Analizat statistikore u realizuan me SPSS 27, duke përdorur testin joparametrik Kruskal - Wallis për të vlerësuar ndryshimet e BMI - së sipas kategorive të ushqimeve të preferuara.
Rezultate: Nga 612 nxënës që plotësuan pyetësorin mbi preferencat ushqimore: 3. 6% preferonin fruta, 19. 3% perime, 33. 0% drithëra (oriz / bukë / makarona), 17. 3% mish / peshk / vezë, 1. 3% bulmet, 21. 7% fast - food, 3. 6% ëmbëlsira / snacks dhe 0. 2% pije me gaz / energjike. Vajzat preferonin më shumë fruta dhe perime, ndërsa djemtë ushqime të shpejta dhe të përpunuara. Drithërat ishin më të preferuara në të gjitha grupmoshat (6–17 vjeç). Testi Kruskal - Wallis tregoi një diferencë statistikisht të rëndësishme të BMI - së midis grupeve ushqimore ($\chi^2(7) = 21. 07$, $p = 0. 004$). BMI më i lartë u vërejt tek nxënësit që preferonin mish / peshk / vezë dhe drithëra (oriz / bukë / makarona), ndërsa BMI më i ulët u shënua tek ata që preferonin bulmet, fruta dhe perime. Nxënësit që preferonin ëmbëlsira dhe snacks kishin BMI më të lartë se grupi i frutave dhe perimeve, por më të ulët se grupi i mishit. Kategoria fast - food tregoi gjithashtu një trend për BMI më të lartë.
Konkluzione: Preferencat ushqimore lidhen ngushtë me statusin ushqimor të fëmijëve dhe adoleshentëve. Rezultatet sugjerojnë nevojën për programe edukative dhe ndërhyrje në shkolla për promovimin e zakoneve ushqyese të shëndetshme, me përfshirjen aktive të prindërve dhe mësuesve.

Fjalë kyçe: preferencat ushqimore, fëmijët, adoleshentët, BMI, Tirana.

OSTEOGENESIS IMPERFECTA – NJË ÇRREGULLIM MULTISISTEMIK PËRTEJ PATOLOGJISË SKELETIKE.

Florid Zenelaj, Artur Zoto, Ervin Rapushi, Teuta Backa, Anastasio Kolaci, Stela Janko, Xhoi Doko, Sindi Dizdari.
Shërbimi Reumatologjisë, QSUT ''Nënë Tereza".

Abstrakt
Hyrje: Osteogenesis Imperfecta (OI) është një çrregullim i rrallë trashëgimor i indit lidhor, i karakterizuar nga rritje e dobësisë kockore, fraktura të përsëritura dhe masë e ulët kockore, që rrjedhin kryesisht nga variante patogjene në gjenet COL1A1 dhe COL1A2 që kodojnë kolagjenin e tipit I. Megjithëse tradicionalisht është konsideruar një sëmundje skeletike, OI po njihet gjithnjë e më shumë si një çrregullim multisistemik që përfshin strukturat kardiovaskulare, pulmonare, dëgjimore dhe dentare, me ndikim të ndjeshëm në cilësinë e jetës dhe funksionalitetin e pacientëve.
Objektivi: Të paraqitet një përmbledhje e përditësuar mbi mekanizmat patofiziologjikë, spektrin klinik, strategjitë diagnostike dhe zhvillimet e fundit terapeutike në Osteogenesis Imperfecta, duke theksuar natyrën e saj sistemike dhe rëndësinë e menaxhimit multidisiplinar.
Metoda: U krye një rishikim i gjerë i literaturës përmes bazave të të dhënave PubMed, Scopus dhe Embase, duke përfshirë studimet e publikuara gjatë periudhës 2015–2025. U përfshinë artikuj që trajtonin aspektet e gjenetikës molekulare, fenotipet klinike, imazherinë dhe qasjet terapeutike farmakologjike dhe jofarmakologjike.
Rezultate: Mutacionet që çojnë në defekte sasiore ose cilësore të kolagjenit të tipit I rezultojnë në fenotipe të ndryshme, nga format letale perinatale (tipi II) deri te forma e butë me jetëgjatësi pothuajse normale (tipi I). Përtej manifestimeve skeletike, shpesh vërehen përfshirje kardiovaskulare (dilatacion i rrënjës së aortës, insuficiencë valvulare), sëmundje pulmonare restriktive, humbje dëgjimi dhe dentinogenesis imperfecta. Përparimet në imazheri (DXA, HR - pQCT) dhe në markerët biokimikë kanë përmirësuar ndjeshëm monitorimin e sëmundjes. Trajtimet bashkëkohore përfshijnë përdorimin e bisfosfonateve, hormonit të rritjes humane rekombinante dhe qasje të reja molekulare si oligonukleotidet antisense dhe terapitë me qeliza staminale, të cilat ofrojnë potencial real për ndryshimin e ecurisë së sëmundjes.
Përfundime: Osteogenesis Imperfecta përfaqëson një çrregullim heterogjen dhe sistemik që tejkalon patologjinë kockore. Diagnostikimi i hershëm gjenetik, ndjekja multidisiplinare dhe strategjitë terapeutike të personalizuara janë thelbësore për përmirësimin e rezultateve funksionale dhe jetëgjatësisë. Kërkimi translacional në zhvillim synon të zhvendosë paradigmën nga menaxhimi simptomatik drejt terapive molekulare të synuara.

Fjalë kyçe: osteogenesis imperfecta, kolagjeni i tipit i, dobësia kockore, bisfosfonatet, çrregullim multisistemik, terapia gjenetike.

KARAKTERISTIKAT EPIDEMIOLOGJIKE TË PACIENTËVE ME TUBERKULOZ NË SPITALIN E PËRGJITHSHËM TË PEJËS GJATË PERIUDHËS 1 JANAR - 30 SHTATOR 2025.

Fluturim Ramaj[1]
[1]Doktor i Mjekësisë, Spitali i Përgjithshëm Pejë

Abstrakt
Hyrja: Tuberkulozi mbetet një nga sëmundjet infektive më të rëndësishme globalisht dhe një problem i vazhdueshëm i shëndetit publik në vendin tonë. Pavarësisht masave parandaluese, rastet e reja vazhdojnë të paraqiten, veçanërisht në zonat rurale dhe te grupmoshat e moshuara. Njohja e karakteristikave epidemiologjike është thelbësore për përmirësimin e kontrollit dhe menaxhimit të sëmundjes.
Qëllimi: Qëllimi i këtij hulumtimi ishte të analizohen karakteristikat epidemiologjike të pacientëve me tuberkuloz të hospitalizuar në Spitalin e Përgjithshëm të Pejës, gjatë periudhës 1 Janar - 30 Shtator 2025, në bazë të moshës, gjinisë, vendbanimit, lokalizimit klinik, konfirmimit diagnostik dhe statusit të trajtimit.
Materiale dhe metoda: Ky është një hulumtim retrospektiv, i cili përfshin të gjithë pacientët e diagnostikuar me tuberkuloz gjatë periudhës së përmendur në Spitalin e Përgjithshëm të Pejës. Të dhënat janë marrë nga arkiva spitalore dhe janë analizuar sipas parametrave demografikë dhe klinikë: mosha, gjinia, vendbanimi, tipi i sëmundjes, mënyra e konfirmimit dhe statusi terapeutik.

Rezultate: Gjatë periudhës së studiuar janë regjistruar gjithsej 33 raste me tuberkuloz, prej tyre 18 femra (54. 5%) dhe 15 meshkuj (45. 5%). Sipas strukturës moshore, grupmoshat më të prekura ishin 66–70 vjeç (6 raste; 18. 2%) dhe 71–75 vjeç (4 raste; 12. 1%), ndërsa numri më i ulët i rasteve u regjistrua te grupmoshat 36–40 vjeç dhe 41–45 vjeç me nga 1 rast (3%). Në aspektin e vendbanimit, 22 raste (66. 7%) ishin nga zonat rurale, ndërsa 11 raste (33. 3%) nga zonat urbane. Sipas lokalizimit klinik, 29 raste (87. 9%) ishin me tuberkuloz pulmonar, ndërsa 4 raste (12. 1%) me tuberkuloz ekstrapulmonar (1 rast i perikarditit, 1 i zorrëve, 1 i kockave dhe 1 tjetër i lekurës). Në bazë të diagnostikimit, 23 raste (69. 7%) u konfirmuan bakteriologjikisht, ndërsa 10 raste (30. 3%) u përcaktuan klinikisht. Sipas statusit të trajtimit, 29 raste (87. 9%) ishin raste të reja, ndërsa 4 raste (12. 1%) ishin rimjekime.
Përfundime dhe konkluzione: Tuberkulozi në këtë periudhë u shfaq më shpesh te popullata rurale dhe te grupmoshat më të moshuara. Dominimi i formave pulmonare dhe numri i lartë i rasteve të reja theksojnë nevojën për forcimin e programeve të depistimit, diagnostikimit të hershëm dhe ndërgjegjësimit të komunitetit për parandalimin dhe trajtimin e duhur të kësaj sëmundjeje.

Fjalë kyçe: Tuberkulozi, epidemiologjia, pacientët, rastet pulmonare, rastet ekstrapulmonare.

PËRDORIMI I INOSITOLIT NË PACIENTËT ME SINDROMËN E VEZORES POLICISTIKE (PCOS): NJË PËRMBLEDHJE E LITERATURËS.

Msc. Fribianka Hoxha
Master i Shkencave, Teknikë Laboratori Mjekësor.
Lektore, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Albanian University.

Abstrakt
Hyrje: Sindroma e vezores policistike (PCOS) është një çrregullim endokrin kompleks që prek rreth 6–15% të grave në moshë riprodhuese, i karakterizuar nga anovulacioni kronik, hiperandrogjenizmi dhe morfologjia policistike e vezoreve. Inositoli, një përbërës natyral i familjes së vitaminave të kompleksit B, ka tërhequr vëmendje për rolin e tij në përmirësimin e ndjeshmërisë ndaj insulinës dhe funksionit ovarian. Ky punim shqyrton evidencat e literaturës mbi përdorimin e myo - inositolit dhe D - chiro - inositolit në trajtimin e PCOS.
Metodologjia: U krye një përmbledhje narrative e literaturës përmes kërkimeve në bazat e të dhënave PubMed, Scopus dhe Cochrane Library për periudhën 2010–2024. U përdorën fjalët kyçe: "inositol", "myo - inositol", "D - chiro - inositol", "PCOS", "insulin resistance", "ovulation". U përfshinë studime klinike, meta - analiza dhe rishikime sistematike në gjuhën angleze që vlerësonin efektet e inositolit në parametrat metabolikë, hormonalë dhe riprodhues të grave me PCOS.
Rezultate: Nga analiza e 38 studimeve, shumica treguan një përmirësim të ndjeshëm në ndjeshmërinë ndaj insulinës, reduktim të niveleve të testosteronit total dhe lira, si dhe rregullim të ciklit menstrual. Kombinimi myo - inositol me D - chiro - inositol në raport 40: 1 rezultoi më efektiv në rikthimin e ovulacionit krahasuar me përdorimin e vetëm një forme. U vërejtën gjithashtu efekte pozitive në cilësinë e oociteve dhe rritje të shkallës së shtatzënisë spontane, pa efekte anësore të rëndësishme.
Sugjerime: Bazuar në evidencat aktuale, inositoli mund të konsiderohet si një alternativë e sigurtë, efektive dhe me kosto të ulët për menaxhimin e PCOS, veçanërisht për pacientet me rezistencë ndaj insulinës ose që kërkojnë përmirësim të funksionit ovulator. Megjithatë, nevojiten studime të mëtejshme afatgjata për të përcaktuar dozën optimale, kohëzgjatjen e trajtimit dhe kombinimet me terapi hormonale.

Fjalë kyçe: PCOS, inositol, myo - inositol, D - chiro - inositol, rezistenca ndaj insulinës, ovulacion, fertilitet.

HIPERTENSIONI PULMONAR: NGA DIAGNOSTIKIMI I HERSHËM TEK TERAPITË E TARGETUARA.

Gani Haxhiu

Abstrakt
Hyrje: Hipertensioni pulmonar (HP) mbetet një patologji e rëndë dhe shpesh e nën - diagnostikuar, me mortalitet të lartë në mungesë të trajtimit adekuat. Pavarësisht se klinikisht shpesh manifestohet me dispne dhe

lodhje progressive - simptoma jo specifike - dentifikimi i hershëm është kyç për prognozën. Përparimet në ekokardiografi, testimin hemodinamik dhe imazherinë e avancuar kanë lehtësuar diferencimin ndërmjet formave të ndryshme të HP, veçanërisht hipertensionit pulmonar arterial (HPA), hipertensionit pulmonar nga sëmundjet e mushkërive dhe atij të lidhur me insuficiencën kardiake. Në dekadën e fundit, zhvillimi i terapisë së targetuar që synon rrugët endoteliale (endotelinë, NO / cGMP, prostaciklinë) ka ndryshuar rrënjësisht qasjen terapeutike. Agjentët si endothelin receptor antagonists (ERA), phosphodiesterase - 5 inhibitors (PDE5i) dhe prostacyclin analogues kanë demonstruar përmirësim në simptomat, kapacitetin e ushtrimit dhe mbijetesën. Për më tepër, qasja e kombinuar terapeutike dhe personalizimi i trajtimit bazuar në profilet klinike po përbën standardin modern të menaxhimit. Në këtë prezantim do të diskutohen sfidat në diagnostikimin e hershëm, roli i biomarkerëve si NT - proBNP, ndikimi i klasifikimit të ri hemodinamik, si dhe evidenca më e fundit për terapitë e targetuara dhe perspektivat për agjentë të rinj. Përfshirja multidisiplinare (kardiolog, pneumolog, reumatolog) mbetet thelbësore për optimizimin e trajtimit dhe përmirësimin e mbijetesës së pacientëve me hipertension pulmonar.

Fjalë kyçe: hipertension pulmonar, terapitë e targetuara, diagnostikim i hershëm, endotelinë, prostaciklinë, PDE5 inhibitorë.

NDIKIMI I TRASHËGIMISË EPIGJENETIKE NDËRBREZNORE NË SËMUNDJET HUMANE.

Gazmend Kadriu
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare "Dr. Safet Idrizi", Vushtrri, Kosovë

Abstrakt

Hyrja: Trashëgimia epigjenetike ndërbreznore (transgenerational epigenetic inheritance, TEI) i referohet transmetimit të modifikimeve epigjenetike, si metilimi i ADN - së, modifikimet e histoneve, ARN - ja jo koduese, nga një brez te brezi tjetër përtej brezit të ekspozuar direkt, duke ndikuar në fenotipe të shëndetit ose sëmundjeve. Këto studime vërtetojnë se jo vetëm gjenet, por edhe ekspozimi mjedisor mund të kenë ndikim për breza të ardhshëm.

Qëllimi: Të përmblidhen dhe analizohen studimet më të fundit që ofrojnë dëshmi për trashëgiminë epigjenetike ndërbreznore tek njerëzit dhe vertebrorët; të sqarohen mekanizmat molekularë që mundësojnë transmetimin e markuesve epigjenetikë përmes linjës germinale; si dhe të shqyrtohet ndikimi i këtij procesi në zhvillimin e sëmundjeve kronike bashkëkohore, përfshirë obezitetin, çrregullimet metabolike, patologjitë kardiovaskulare dhe çrregullimet neuropsikiatrike.

Metodologjia: Ky punim është një rishikim i literaturës shkencore të publikuar gjatë dy dekadave të fundit në bazat e të dhënave PubMed, Frontiers, Clinical Epigenetics dhe Trends in Genetics. Janë përfshirë studime eksperimentale në modele kafshësh (minj - mice dhe rats), ku brezi prindëror është ekspozuar ndaj stresit, dietës jo të shëndetshme apo toksinave, dhe janë vëzhguar ndryshimet epigjenetike te brezat F2 dhe F3. Gjithashtu, janë analizuar studime epidemiologjike humane që lidhin ekspozimet në fëmijërinë e hershme me rrezikun për sëmundje kronike te pasardhësit.

Rezultate: Studimet në fushën e epigjenetikës ofrojnë prova të shumta që mbështesin trashëgiminë epigjenetike ndërbreznore përmes mekanizmave të ndryshëm, përfshirë metilimin e ADN - së, modifikimet e histoneve dhe ARN - të jo koduese. Studimet në modelet shtazore tregojnë se ekspozimi ndaj kimikateve, si bisfenoli A dhe pesticidet, shkakton ndryshime epigjenetike në metilimin e ADN - së dhe në profilin e transkriptomit (ARN dhe proteinat). Këto ndryshime mund të transmetohen në brezat pasardhës, dhe janë të lidhura kryesisht me çrregullime metabolike, riprodhuese dhe të sjelljes. Stresi i vazhdueshëm tek minjtë shkakton ndryshime epigjenetike në spermë dhe në embrione. Disa nga këto ndryshime nuk fshihen gjatë zhvillimit të embrionit dhe kalojnë te brezat pasardhës, duke ndikuar në tipare të trashëguara si sjellja dhe reagimi ndaj stresit. Një studim observues ka treguar se ushqyerja e tepërt e gjyshërve meshkuj gjatë fëmijërisë shoqërohet me rritje të rrezikut për mortalitet nga diabeti dhe sëmundjet kardiovaskulare te nipërit meshkuj. Kjo lidhje nuk u vërejt midis gjysheve dhe mbesave, duke sugjeruar një efekt të mundshëm të linjës mashkullore. Rezultatet nënvizojnë ndikimin e mundshëm ndërbreznor të kushteve të ushqyerjes në shëndetin e pasardhësve, megjithëse mekanizmat biologjikë, përfshirë ata epigjenetikë, mbeten ende për t'u sqaruar.

Përfundime: TEI është një fushë premtuese që sfidon mënyrën tradicionale të të menduarit mbi trashëgiminë, duke përfshirë ndikimet jo vetëm të ADN - së, por edhe të epigjenetikës të transmetuar ndër breza. Ajo paraqet një mundësi premtuese për parandalimin e sëmundjeve kronike në brezat e ardhshëm përmes ndërhyrjeve të

fokusuara tek prindërit, si përmirësimi i kushteve mjedisore, adaptimi i një diete të shëndetshme, reduktimi i stresit dhe kufizimi i ekspozimit ndaj toksinave. Megjithatë, nevojiten studime afatgjata me mostra në njerëz, dhe analiza të hollësishme molekulare për të vërtetuar transmetimin epigjenetik përmes qelizave germinale ndër breza.

Fjalë kyçe: trashëgimi epigjenetike, metilim i ADN - së, histone, ARN jo koduese, trashëgimi ndërbreznore.

PASOJAT E RRJEDHJES (TORTUOZITETI) SË ARTERIES BAZILARE (AB).

Gazmend Zylbeari[1, 2], Art Zylbeari[1, 2], Zamira Bexheti[3], Elita Masha[2], Tose Krstev[2], Sadi Bexheti[1]
[1]*Fakulteti i ShkencaveMjekësore, Universiteti i Tetovës, RMV.*
[2]*Fakulteti i ShkencaveMjekësore, Goce Delcev Universiteti, Stip, RMV.*
[3]*Universiteti i Evropës Juglindore - Tetovlë, RMV.*

Abstrakt
Hyrje: Arteria bazilare (AB) formohet nga bashkimi i dy arterieve veretbrale dhe ndodhet në pjesën e poshteme të trurit dhe është një nga enët më të rëndësishme në furnizimin e trurit me gjak. Tortuoziteti i AB konsiston me derdhje (me kthesa të theksuara dhe me lakesa) të pazakont të gjakut nga ajo fiziologjike. Tortueziteti i AB mund të jetë me etiologii - fiziologjike (si variacione anatomike pa pasoja) dhe patrologjike me rrezik në qarkullimin e gjakut dhe sëmundjeve cerebrovaskulare. Tortuozitetit mund të jetë si pasojë edhe e hipertensionit rezistent, ateroskle - rozës premature, anomalive të lindura, gjatë së AB, hiperkolesterolemisë, duhanpirja dhe moshës. Pasojat e rrjedhjes (tortuezitetit) të AB kan rëndësi të madhe sepse ato ndikojnë në presionin e strukturave nervore, në rrjedhjen e gjakut duke e rritur rrezikun nga ishemia cerebrale, aneurizëm, të cilat shfaqen me simptomë vertiginoze, çrreullime në ecje, humbje të ekuilibrit, marramendje, humbje të vetëdijes etj. Diagnostikimi i tyre bëhet me CT ose Rezonance magnetike. Trajtimi i tyre nënkupton kontrollim dhe ekuilibrim të faktorëve predisponues, terapi me antkoagulant, antihipertonik, statina ose fibrate, ndërsa në raste më të ralla trajtim me ndërhyrje kirurgjikale.
Qëllimi i punimit: të identifikohen faktorët kontribues që ndikojnë në shfaqjen e rrjedhjes së AB, pasojat ndaj qarkullimit posterior të trurit etj.
Materiale dhe metoda: në studim u përfshinë 60 pacientë (25 gra dhe 35 meshkuj me moshë mestare identike prej 48, 70±12, 50 vjeçare me simptomë të hipertensionit rezistent, sindromë vertiginoz, dhimbje në pjesën cervikale.
Rezultate: Nga numri total 64 % e pacientëve kishin tortuizitet të AB ndërsa te 36 % e pacientëve nuk u vërejt tortuozitet edhe pse kishin simptoma të marramendjes dhe hipertension.
Përfundimi: në konkulzion mund të preferojmë se detekimi dhe trajtimi i tortuozitetit te AB që në fazat e hershme të paraqitjes së simptomave dukshëm ndikon në parandalimin e pasojave në qarkullimin cerbrovaskular.

Fjalë kyçe: tortuoziteti i arteries bazilare, pasojat.

INCIDENTALOMAT NË HEPAR DHE METODAT IMAZHERIKE.

Dr. Genc Bahtiri

Abstrakt
Hyrje: Zhvillimi i vazhdueshëm i metodave imazherike klinike me sensitivitet të shtuar ka rritur mundësinë e zbulimit të lezioneve fokale të heparit. Këto tumore të heparit pa simptoma specifike si kolestaza, të zbuluara aksidentalisht janë quajtur "incidentaloma". Metodat diagnostike si sonografia, tomografia e kompjuterizuar ose rezonanca magnetike po përdoren gjithnjë e më shumë tek individët asimptomatik me një diagnozë të pa definuar në kuadër të parandalimit të përgjithshëm apo përndjekjes pas një historie të malinjitetit. Pavarësisht përmirësimit të vazhdueshëm të metodave diagnostikuese, disa dyshime në lidhje me sjelljen e tumoreve beninje ose malinje akoma mbeten. Në rastet kur para ndërhyrjes kirurgjikale arrihet të zbulohet me siguri një hemangiomë asimptomatike ose FNH atëherë indikacioni për ndërhyrje kirurgjikale është i plotë dhe i pa evitueshëm. Në rast të lezioneve simptomatike të heparit, reseksioni kirurgjik duhet të indikohet vetëm atëher

kur kemi shfaqje të simptomave specifike të tumorit. Në rastet kur kemi të bëjmë me lezione beninje të heparit, rekomandohet ndjekja e strategjisë "shikoni dhe prisni". Ndërhyrja kirurgjike është e indikuar kur kemi të bëjmë me diagnozë të pasigurt, veçanërisht te pacientët me histori pozitive të një tumori malinj ose kur egziston dyshimi për prani të adenomës hepatoqelizore. Shkak i përmirësimit të vazhdueshëm të teknikave kirurgjikale, reseksioni i heparit duhet bërë me teknikën laparoskopike. Kirurgjia laparoskopike karakterizohet me morbiditet më të ulët dhe periudha e hospitalizimit është më e shkurtër krahasuar me ndërhyrjen kirurgjike të hapur.

Fjalë kyçe: hepar, metoda imazherike, tumor etj.

KANCERI I PANKREASIT: SFIDAT E DIAGNOSTIKIMIT TË HERSHËM DHE QASJET MODERNE TERAPEUTIKE.

Gent Hoti

Abstrakt

Hyrje: Kanceri i pankreasit është një ndër neoplazitë më vdekjeprurëse dhe me shkallë shumë të ulët mbijetese, për shkak të mungesës së simptomave specifike në fazat e hershme dhe diagnostikimit të vonuar. Në shumicën e rasteve, sëmundja zbulohet në faza të avancuara, ku trajtimi kirurgjikal nuk është më i mundur. Përmirësimi i diagnostikimit të hershëm përmes biomarkerëve molekularë, imazherisë së avancuar dhe testeve gjenetike përbën një drejtim të rëndësishëm kërkimor. Krahas kësaj, zhvillimet në kemoterapi, imunoterapi dhe terapitë e synuara molekulare kanë sjellë përmirësime të moderuara në mbijetesë dhe cilësi jete. Ky punim shqyrton pengesat aktuale në diagnostikimin e hershëm dhe rolin e qasjeve moderne terapeutike në menaxhimin e kancerit të pankreasit.

Qëllimi: Qëllimi i punimit është të shqyrtojë sfidat e diagnostikimit të hershëm të kancerit të pankreasit, të analizojë teknikat moderne diagnostikuese dhe qasjet terapeutike, dhe të vlerësojë ndikimin e tyre në përmirësimin e mbijetesës dhe cilësisë së jetës së pacientëve.

Të analizohen teknikat e reja diagnostikuese dhe roli i biomarkerëve molekularë. Të vlerësohen qasjet moderne terapeutike në përmirësimin e mbijetesës. Të paraqiten sfidat dhe drejtimet e ardhshme kërkimore në këtë fushë.

Metodologjia: Ky punim bazohet në rishikim të literaturës bashkëkohore (2014–2025), përfshirë artikuj shkencorë të publikuar në bazat e të dhënave PubMed, Scopus dhe WHO. Janë përzgjedhur studime që trajtojnë diagnostikimin e hershëm të kancerit pankreatik dhe zhvillimet e reja terapeutike. Të dhënat janë analizuar në mënyrë përmbledhëse, duke u fokusuar në efikasitetin diagnostik, mbijetesën dhe rezultatet klinike.

Rezultate: Të dhënat tregojnë se mungesa e simptomave të hershme dhe mungesa e biomarkerëve sensitivë janë faktorët kryesorë që çojnë në diagnostikim të vonuar. Kombinimi i CA 19 - 9 me teknika të imazherisë si CT me kontrast, MRI pankreatike dhe endosonografia (EUS) përmirëson ndjeshëm zbulimin në faza më të hershme. Terapitë moderne si FOLFIRINOX dhe kombinimi gemcitabine–nab - paclitaxel kanë rritur mbijetesën mesatare me 3–6 muaj. Po ashtu, imunoterapia dhe terapitë e synuara molekulare (KRAS, BRCA1 / 2, PD - L1) ofrojnë perspektiva premtuese për pacientët e përzgjedhur gjenetikisht.

Përfundime: Kanceri i pankreasit mbetet një sfidë e madhe klinike për shkak të mungesës së shenjave të hershme dhe rezistencës ndaj trajtimeve standarde. Përdorimi i diagnostikës molekulare, imazherisë me precizion të lartë dhe trajtimeve të personalizuara paraqet rrugën drejt përmirësimit të mbijetesës. Bashkëpunimi midis kërkuesve, klinicistëve dhe laboratorëve molekularë është thelbësor për zbulimin e hershëm dhe menaxhimin më efektiv të kësaj sëmundjeje.

Fjalë kyçe: kanceri i pankreasit, diagnostikim i hershëm, biomarkerë, imazheri, kemoterapi, imunoterapi, terapi e synuar, mbijetesë.

PËRVOJA JONË ME ABDOMINOPLASTIKËN PA DRENA: ANALIZË E REZULTATEVE DHE PËRFITIMEVE TË PACIENTËVE.
Gentian Zikaj, Virxhinia Çuka, Alba Naska

Abstrakt
Hyrje: Abdominoplastika ka qenë historikisht e lidhur me përdorimin rutinë të drenave për menaxhimin e hapësirës së vdekur dhe parandalimin e seromës. Megjithatë, përparimet në teknikat kirurgjikale kanë mundësuar një qasje të re që eliminon nevojën për drena, duke reduktuar ndjeshëm morbiditetin post - operator dhe duke përmirësuar rehatinë e pacientëve. Ky punim synon të paraqesë evolucionin e abdominoplastikës nga teknikat tradicionale me drena drejt metodave moderne të fiksimit progresiv të lëkurës dhe fascies (progressive tension sutures). Në këtë analizë përfshihen përvoja klinike dhe rezultatet e pacientëve që iu kanë nënshtruar abdominoplastikës pa drena, duke u krahasuar me grupin tradicional me drena. U vlerësuan parametrat si incidenca e seromës, koha e rikuperimit, niveli i dhimbjes post - operator, dhe kënaqësia subjektive e pacientëve. Rezultatet treguan reduktim të dukshëm të komplikacioneve, shkurtim të kohës së hospitalizimit, dhe rikthim më të shpejtë në aktivitetet e përditshme tek grupi pa drena. Konkluzioni mbështet faktin se teknikat progresive të fiksimit të lëkurës përfaqësojnë një hap evolucionar të rëndësishëm në kirurgjinë estetike abdominale, duke mundësuar një trajtim më të sigurt, më komod dhe me rezultat estetik superior për pacientin.

Fjalë kyçe: abdominoplastikë, teknika pa drena, sutura progresive, seromë, kirurgji estetike abdominale.

HEMORRAGJITË E SIPËRME GASTROINTESTINALE.
Gentiana Collaku

Abstrakt
Hyrje: Hemorragjia e sipërme GI paraqet një urgjencë, ku diagnostikimi i hershëm dhe trajtimi në mënyrë adekuate kanë rol kyç në uljen e vdekshmërisë.
Qëllimi: Qëllimi kryesor i këtij punimi është të zgjerojë njohuritë mbi shkaqet e shfaqjes së hemorragjisë së sipërme GI, mbi pasqyrën klinike, diagnostikimin, menaxhimin dhe trajtimin e saj. Ky punim është i rëndësishëm sepse jep informacione mbi sëmundjet që shkaktojnë hemorragji të sipërme GI dhe rolin thelbësor që ka diagnostikimi në kohën e duhur dhe trajtimi i përshtatshëm.
Materiale dhe metoda: Përzgjedhja e materialit dhe metodave për realizimin e këtij studimi u bazua dhe u përshtat sipas natyrës së hulumtimit. Është përdorur metoda e hulumtimit retrospektiv, ku janë përfshirë pacientët me hemorragji të sipërme GI, të hospitalizuar në Klinikën e Gastroenterologjisë në QKUK gjatë periudhës Janar–Dhjetor të vitit 2020.
Rezultate: Në hulumtimin retrospektiv janë përfshirë gjithsej 172 pacientë me hemorragji të sipërme GI, të cilët janë hospitalizuar gjatë periudhës Janar–Dhjetor të vitit 2020. Shkaktari më i shpeshtë i hemorragjisë së sipërme GI ishte gastriti eroziv, ndërsa gjinia më e prekur ishte gjinia mashkullore. Mosha më e prekur ishte mbi 60 vjeç dhe terapia më e përdorur ishte medikamenti Pantoprazole.
Konkluzione: Në shfaqjen e hemorragjisë së sipërme GI ka rëndësi të madhe identifikimi i shkaktarit, ekspozimi ndaj faktorëve të rrezikut, menaxhimi dhe trajtimi adekuat. Hemorragjia e sipërme GI paraqet urgjencë mjekësore për shkak të mortalitetit të lartë dhe kërkon trajtim të menjëhershëm. Shfaqja e hemorragjisë së sipërme GI rritet me rritjen e moshës.

Fjalë kyçe: hemorragji, hematemezë, melenë, gastroduodenoskopi, NSAID, vdekshmëri.

NDRYSHIMET E LËKURËS TE TË SËMURËT ME DIABET.
Gentiana Maxhuni

Abstrakt
Qëllimi i punimit: është të paraqesë shpeshtësinë e ndryshimeve të lëkurës te të sëmurët me diabet në Klinikën e Dermatovenerologjisë, në QKUK, Prishtinë, në periudhën kohore Janar - Dhjetor 2022, të analizohen këto raste sipas strukturës gjinore, grup - moshës, të analizohen rastet sipas vendbanimit, të analizohen cili tip i

diabetit që ndryshime në lëkurë dhe të vlerësohen cilat sëmundje të lëkurës i hasim më shpesh te të sëmurët me diabet.
Metodologjia: Hulumtimi është retrospektiv dhe është përdorur metoda e studimit të rasteve. Të dhënat janë marrë nga Klinika e Dermatovenerologjisë në QKUK. Ky hulumtim përfshin raste të analizuara në periudhën Janar – Dhjetor 2022. Në studim janë përfshirë të dhënat nga historitë e pacientëve të diagnostikuar dhe trajtuar në këtë klinikë. Hulumtimi është aprovuar nga Komiteti Etik i Fakultetit të Mjekësisë dhe OMK. Qasja në arkivën e Klinikës së Dermatovenerologjisë është bërë nën mbikqyrjen e punonjësve përgjegjës të arkivës.
Rezultate: Në hulumtim janë përfshirë gjithsej 50 pacientë. Pacientët meshkuj ishin në përqindje më të madhe 66% në krahasim me 34%. Vendbanimi më i prekur ka qenë Prishtina me 18 paciente (36%), për nga numri më i madh të banorëve në këtë qytet. Në periudhën kohore Janar - Dhjetor 2022 më shumë raste janë regjistruar në muajin Gusht me 12 raste (25%) dhe në muajin Dhjetor me 22 raste (44%). Nga 50 paciente asnjë nuk ka qenë me Diabet Tip I, 100% kanë qenë me diabet tip II. Sëmundja më e shpeshtë e lëkurës te pacientët me diabet është Erysipelas me 7 raste ose 14% ndërsa ato më të rrallat janë: Prurigo chronica, Furunculosis, Lichen rubber planus, Granuloma annulare, Ichtyosis, Candida oris, Candida intertriginosus, Onychomycosis, Dermatitis hypostatica, Bulla diabetike, dhe Erythema nodusum me nga vetëm një rast ose 2%.

Fjalë kyçe: bulla diabetike, erythema nodusum, diabet, ndryshime kutane, lichen rubber planus.

ROLI I MRCP - së NË DIAGNOSTIKIMIN DHE MENAXHIMIN E KOLECISTITIT AKUT KALKULOZ.
Gentiana Zeneli

Abstrakt
Hyrje: Kolecistiti akut kalkuloz është një gjendje inflamatore e vezikës biliare që shkaktohet nga prania e gurëve biliarë dhe përbën 90% të kolecisteve akute. Diagnostikimi i saktë dhe në kohën e duhur mundëson trajtimin adekuat. Krahas metodave të rëndësishme diagnostike kemi MRCP - në. MRCP - ja paraqet një teknikë jo - invazive që siguron imazhe të detajizuara të sistemit hepatobiliar dhe pankreatik. MRCP - ja ndihmon në diagnostikim dhe zgjedhjen e duhur të trajtimit në rastet me kolecistit akut kalkuloz të pakomplikuar si dhe në rastet e shoqëruara me komplikime.
Qëllimi i punimit: Të vlerësohet roli i MRCP - së në diagnostikimin dhe planifikimin e trajtimit te kolecistiti akut kalkuloz, duke përfshirë këtu edhe komplikimet shoqëruese. Krahasimi i MRCP - së me modalitete të tjera të imazherisë siç janë ultratingulli dhe CT.
Metodologjia e punës: Për realizimin e këtij hulumtimi retrospektiv, janë përdorur të dhënat e pacientëve në Spitalin "Aloka" gjatë vitit 2024, pas aprovimit nga Bordi i Etikës së Fakultetit të Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës dhe Oda e Mjekëve të Kosovës (OMK). Numri i përgjithshëm i pacientëve të përfshirë në studim ishte 323 pacientë. Të dhëna janë klasifikuar në bazë të gjinisë, moshës, muajve dhe diagnozës, me fokus të veçantë në kolecistitin akut kalkuloz.
Rezultate: Nga 323 pacientëve që i janë nënshtruar MRCP, 180 pacientë janë diagnostikuar me kolecistit akut kalkuloz (55. 7%). Prej tyre, 59. 4% ishin të gjinisë femërore dhe 40. 5% të gjinisë mashkullore. Mosha dominuese ishte mbi 57 vjeç. MRCP arriti të diagnostikojë saktë praninë e gurëve biliarë dhe komplikimeve siç janë: nekroza, mikroabceset, trashjet e murit të kolecistës etj. Metodë dominuese e trajtimit ishte kirurgjia laparaskopike.
Përfundime: MRCP është një metodë e rëndësishme diagnostike jo - invazive dhe pa rrezatim. MRCP ndihmon në diagnostikimin dhe trajtimin adekuat të kolecistitit akut kalkuloz dhe komplikimive që lidhen me të. MRCP po zëvendëson gjithnjë e më shumë metodat invazive siç është Kolangiopankreatografike endoskopike retrograde(ERCP).

Fjalë kyçe: Kolecistit akut kalkuloz, MRCP, trajtim, komplikime, diagnostikim jo - invaziv.

KOMORBIDITETI PSIKIATRIK I SIMPTOMAVE DEPRESIVE NË PERIUDHËN POSTPARTUM TË GRAVE TË PARAQITURA NË URGJENCËN PSIKIATRIKE.

Dr. Gentjan Asllanaj

Abstrakt

Hyrje: Periudha postpartum është një fazë shumë vulnerable për zhvillimin e crregullimeve psikiatrike. Gratë e paraqitura në shërbimin e urgjencës psikiatrike me stres postpartum shpesh kanë dhe depresion komorbid dhe simptoma ankthi, që e komplikon diagnozën dhe menaxhimin e menjëhershëm të rastit. Vlerësimi i hershëm i tyre ka vlerë të lartë në parandalimin e veprimeve vet dëmtuese tek këto zonja dhe dhënien e kujdesit të duhur shëndetësorë ndaj tyre.

Objektiva: Gjetja e prevalencës dhe profilit klinik të komorbiditetit psikiatrik që shoqëron simptomat depresive tek gratë në periudhën postpartum që paraqiten në urgjencën psikiatrike.

Materialet dhe metodat: Studimi është prospektive i zhvilluar në shërbimin e urgjencës psikiatrike në qëndrën spitalore Nënë Tereza Tiranë. Gratë postpartum brenda 6 muajve pas lindjes, të ardhura me stres emocional dhe crregullime të sjelljes u vlerësuan me shkallën e depresionit postnatal Edinburgh (EPDS) dhe pyetësorin klinik DSM - 5. U analizuan edhe të dhënat si faktorët sociodemografik, historia psikiatrike, lloji i lindjes, stresorët psikosocialë.

Rezultatet: Në gratë postpartum, 54% kishin simptoma depresive sinjifikante si crregullime akthi (32%), reagime stresi akut (18%) dhe crregullime paniku (16%). Ato gra që kishin histori të mëparshme psikiatrike, mbështetje familjare të vogël apo komplikacione obstretike shfaqnin komorbiditet më të lartë. U bë ndërhyrje e menjëhershme tek nënat me sjellje suicidale dhe vet dëmtuese.

Konkluzione: Komorbiditeti psikiatrik është i lartë në gratë postpartum të ardhura në shërbimin e urgjencës psikiatrike me simptoma depresioni dhe ankesa ankthi. Protokolli i kujdesshëm për vlerësimin e shëndetit mendorë dhe strategjitë e ndihmës mjekësore që në urgjencat gjinekologjike dhe psikiatrike janë me rëndësi të lartë për identifikimin e hershëm, kujdesin efektivë e të sigurt.

Fjalë kyçe: depresioni postpartum, komorbiditeti psikiatrik, ankthi, dëmtimi i vetes.

PARIMET E PARANDALIMIT TË PNEUMONISË VENTILATORE.

Gentrit Uka

Abstrakt

Hyrje: Pneumonia ventilatore (VAP) është pneumoni që zhvillohet të paktën 48 orë pas intubimit endotrakeal ose brenda 48 orëve pas ekstubimit. Pneumonia ventilatore është një nëngrup i pneumonisë së fituar në spital, që përfshin pneumoninë në pacientët e hospitalizuar që nuk marrin ventilim mekanik.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të paraqesim se çfarë është pneumonia ventilatore, të identifikojmë shenjat dhe simptomat që i hasim më shpesh e që janë më specifike, të përmenden mënyra të diagnostikimit dhe forma të trajtimit, të analizohet incidenca e pneumonisë ventilatore në popullata të ndryshme pacientësh, karakteristikat e pacientëve me pneumoni të shoqëruar me ventilator, shkalla e vdekshmërisë për pneumoninë ventilatore. Gjithashtu e rëndësishme te ky punim është edhe përmendja e disa principeve të parandalimit te pneumonisë ventilatore si nga ofruesit e kujdesit shëndetësor ashtu edhe nga vetë pacientët dhe synohet të analizohet pneumonia ventilatore në Kosovë.

Metodologjia: Metodologjia e përdorur për realizimin e këtij punimi është ajo e rishikimit të literaturës botërore, duke përfshirë literaturën nga librat shkencorë të botuar dhe publikimet shkencore të viteve të fundit nga PubMed, Medscape, NIH, U. S Centers for Disease Control and Prevention, Mayo Clinic, NEJM.

Përfundime: Parandalimi i VAP kryhet nëpërmjet masave farmakologjike dhe jo farmakologjike që fokusohen kryesisht në faktorët e rrezikut të modifikueshëm. Me këtë rishikim synimi ynë ishte t'i qasemi masave parandaluese më konsensuale që përshkruhen në udhëzimet e hartuara nga shoqëritë mjekësore shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Fjalë kyçe: pneumoni ventilatore, intubim, spital etj.

PROFILOPLASTIKA SI NJË STRATEGJI KIRURGJIKALE MULTIDIMENSIONALE: ANALIZA E INDIKACIONEVE, TEKNIKAVE DHE REZULTATEVE KLINIKE.

Dr. Gera Tagani, Prof. Assoc. Vladimir Filaj

Abstrakt

Hyrje: Profiloplastika përfaqëson një qasje të gjithanshme në kirurgjinë estetike, e cila synon të harmonizojë profilin e fytyrës duke arritur ekuilibër proporcional midis strukturave kraniofaciale. Ajo zakonisht kombinon rinoplastikën dhe mentoplastikën, ndërsa në raste të përzgjedhura mund të plotësohet me augmentim malar, lipofilling ose teknika të tjera korrigjuese. Arritja e simetrisë dhe proporcionalitetit të fytyrës mbetet një shtyllë themelore e perceptimit estetik dhe e kënaqësisë së pacientit. Ndryshe nga ndërhyrjet e izoluara që përmirësojnë një element të vetëm, profiloplastika ofron një strategji të integruar që rikthen balancën e përgjithshme dhe konturet natyrale të fytyrës. Popullariteti në rritje i kësaj qasjeje të kombinuar pasqyron pritshmëritë gjithnjë e më të mëdha të pacientëve për rezultate që përfshijnë jo vetëm përmirësimin estetik, por edhe mirëqenien psikologjike dhe vetëbesimin social.

Materiale dhe Metoda: Kjo analizë retrospektive shqyrtoi rastet klinike në të cilat profiloplastika është kryer si procedurë e njëkohshme ose e ndarë në disa faza. Analiza u përqendrua në indikacionet e pacientëve, metodat kirurgjikale dhe rezultatet pas operacionit. Çdo rast u vlerësua në lidhje me ekuilibrin estetik, saktësinë teknike dhe rezultatet psikosociale. Komponentët kryesorë kirurgjikalë përfshinin rinoplastikën dhe mentoplastikën, të shoqëruara kur ishte e nevojshme me lipofilling ose augmentimin malar. Kriteret e përzgjedhjes së pacientëve bazoheshin në një vlerësim të detajuar kraniofacial, përshtatshmërinë mjekësore dhe gatishmërinë psikologjike. Planifikimi preoperativ theksoi përdorimin e simulimeve digjitale dhe këshillimin e thelluar për të siguruar një mirëkuptim të qartë midis kirurgut dhe pacientit mbi rezultatet e arritshme dhe kufizimet e mundshme.

Rezultate: Në të gjitha rastet e analizuara, profiloplastika solli përmirësime të dukshme në simetrinë dhe harmoninë estetike të fytyrës. Niveli i kënaqësisë së pacientëve ishte vazhdimisht i lartë, veçanërisht tek ata që kishin pritshmëri realiste dhe që ishin të përfshirë në mënyrë aktive në fazën e planifikimit para operacionit. Vlerësimet pas operacionit treguan përmirësime të rëndësishme në vetëbesim dhe mirëqenie psikosociale, përveç përfitimeve të matshme estetike. Komplikacionet pas operacionit ishin minimale dhe kufizoheshin në rreziqet e zakonshme kirurgjikale, duke konfirmuar sigurinë e qasjes së kombinuar kur ajo zbatohet nën protokolle të rrepta klinike dhe me monitorim të kujdesshëm pas operacionit.

Përfundime: Profiloplastika duhet të njihet si një qasje individuale dhe multidisiplinare në kirurgjinë estetike moderne, e aftë të prodhojë rezultate të balancuara dhe afatgjata. Suksesi i kësaj procedure varet nga analiza e plotë preoperatore, ekspertiza teknike dhe komunikimi i hapur midis pacientit dhe kirurgut. Kërkimet e vazhdueshme me mostra më të gjera pacientësh do të ndihmojnë në konsolidimin e udhëzimeve të standardizuara dhe në forcimin e praktikave të bazuara në evidencë për konturimin e integruar të fytyrës.

Fjalë kyçe: profiloplastikë, balancë e fytyrës, rinoplastikë, mentoplastikë, kirurgji e kombinuar, rezultate estetike, ndikim psikosocial, vlerësim klinik.

KARAKTERISTIKAT KLINIKO - PATOLOGJIKE TË KANCERIT TË GJIRIT TRIPLE NEGATIV (TNBC) NË NJË DEKADË NË QSUT (2013–2023).

MD. Gerta Elezaj, Prof. Ass. Albana Fico, MD. Florina Hoxha, Prof. Dr. Helidon Nina

Abstrakt

Hyrje: Kanceri i gjirit triple negativ (TNBC) përbën 15–20% të të gjitha rasteve të kancerit të gjirit. Karakterizohet nga mungesa e receptorëve hormonalë (ER ≤1%, PR ≤1%) dhe mungesa e amplifikimit të HER2. Ky nën - tip përfaqëson një formë biologjikisht agresive, e cila prek më shpesh gratë premenopauzale dhe ka prirje për metastaza viscerale (mushkëri, tru, hepar), me mbijetesë më të shkurtër. Rreth 20% e pacientëve me TNBC janë bartëse të mutacioneve BRCA, veçanërisht BRCA1.

Metodologjia: U krye një studim retrospektiv deskriptiv në Shërbimin e Onkologjisë pranë QSUT për periudhën 1 janar 2013 – 31 dhjetor 2023. Në analizë u përfshinë të gjitha pacientet me diagnozë TNBC (ER ≤1%, PR ≤1%, HER2 0–1+ ose 2+ me FISH negativ). U vlerësuan karakteristikat demografike, histopatologjike, shkalla e diferencimit tumoral, indeksi proliferativ Ki - 67, stadifikimi TNM, si dhe modalitetet e trajtimit.

Rezultate: Nga gjithsej 1762 raste me kancer gjiri, 1362 kishin klasifikim imunohistokimik të plotë. Prej tyre, 130 raste (9. 5%) u identifikuan si TNBC. Mosha mesatare ishte 55 ± 12. 5 vjeç (22–85); 99% femra. Rreth 14% kishin histori familjare pozitive për kancer gjiri ose gjinekologjik. Karcinoma duktale invazive ishte tipi më i shpeshtë histologjik. 54% e tumoreve ishin të keqdiferencuara, G3. 45% kishin indeks proliferimi Ki - 67 >45%. U gjet një lidhje statistikisht domethënëse midis moshës së re dhe Ki - 67 të lartë ($p \leq 0.05$). Në momentin e diagnostikimit, 16% ishin në stadi I, 41% në stadi II, 34. 5% në stadi III dhe 8. 5% në stadi IV. Në 107 paciente u krye ndërhyrje kirurgjikale, kryesisht mastektomi (80. 2%). Kimioterapia adjuvante u përdor në 80 raste, ndërsa 20 paciente morën kimioterapi neoadjuvante. 50% e të cilave patën përgjigje të plotë aksilare dhe 14% përgjigje patologjike të plotë.
Përfundime: TNBC në popullatën tonë paraqitet me karakteristika agresive histopatologjike, shkallë të lartë proliferimi dhe incidencë të rritur në dekadën e fundit. Rezultatet theksojnë nevojën për programe të zgjeruara të skriningut, testim gjenetik për BRCA dhe akses më të gjerë në trajtime moderne sistemike.

Fjalë kyçe: TNBC, kanceri i gjirit, BRCA, Ki - 67, kimioterapia neoadjuvante.

INOVACIONE NË MONITORIMIN NEONATAL.

Dr. Shk Gertiana Mullalli Bime
Shefe e Neonatologjisë në Spitalin Amerikan nr 2

Abstrakt
Monitorimi në vazhdimësi i neonateve me risk të lartë është thelbësor për menaxhimin në kohë të patologjive të ndryshme. Megjithatë mbështetja aktuale në teknologjinë e sensoreve me kontakt për monitorimin e shenjave vitale shpesh çon në komplikacione si diskomfort, dëmtime në lëkurë, dhe infeksione të cilat ndërhyjnë negativisht në menaxhimin mjekësor, kujdesin infermieror dhe lidhjen me prindërit. Për më tepër varësia ndaj disa pajisjeve është problematike duke qenë se ato nuk janë të ndërlidhuara ose të sinkronizuara në kohë, përdorin kabllo dhe sensore të ndryshëm dhe janë të dizenjuara mbi bazën e specifikimeve të të rriturve. Prandaj është një nevojë emergjente zhvillimi i teknologjisë me kontakt minimal ose jo - adezive që të integrojnë disa sinjale në një platformë të vetme, të dizenjuar në mënyrë specifike për neonatët.

Fjalë kyçe: inovacion, monitorimi neonatal, kujdesin infermieror.

SINDROMA E FERMENTIMIT ENDOGJEN DHE MIKROBIOMA INTESTINALE: NJË ÇRREGULLIM I RRALLË METABOLIK ME NDIKIM NË SIMPTOMAT KLINIKE DHE FLORËN MIKROBIALE.

Gëzim Latifi
QKMF "Dr. Fatmir Fazlija", Skënderaj, Kosovë.

Abstrakt
Hyrje: Sindroma e fermentimit endogjen (Auto - Brewery Syndrome – ABS) është një çrregullim i rrallë metabolik ku mikroorganizmat intestinalë, kryesisht kërpudhat dhe bakteret, fermentojnë karbohidratet ushqimore duke prodhuar etanol. Ky etanol absorbohet në gjak, duke shkaktuar nivele të larta të alkoolit pa konsum të jashtëm. Për shkak të simptomave jo specifike dhe mungesës së njohjes klinike, ABS - ja shpesh mbetet e padiagnostikuar ose diagnostikohet gabimisht.
Qëllimi: Të rishikohen të dhënat klinike mbi ABS - në; të identifikohen faktorët predispozues si disbioza intestinale, përdorimi i antibiotikëve dhe dieta; të përmblidhen metodat diagnostike dhe trajtimet efektive, si dhe të vlerësohen strategjitë që synojnë mikrobiomën si qasje terapeutike.
Metodologjia: Ky punim bazohet në një rishikim të literaturës që përfshin raporte rastesh, seri rastesh dhe artikuj përmbledhës mbi ABS - në. Studimet e përzgjedhura kanë përdorur analizën mikrobiologjike dhe biofizike për të identifikuar llojet e mikro - organizmave që prodhojnë etanol, si Saccharomyces cerevisiae, Candida spp. dhe Klebsiella pneumoniae, si dhe kanë analizuar efektivitetin e trajtimeve përfshirë terapinë antifungale, dietat me pak karbohidrate dhe transplantimin e mikrobiomës fekale.

Rezultate: Raportet klinike tregojnë se ABS - ja shpesh zhvillohet pas përdorimit të antibiotikëve, që rezulton me çrregullim të mikrobiomës dhe mbiprodhim të specieve fermentuese si Candida dhe Klebsiella. Diagnostikimi bëhet zakonisht duke matur nivelin e etanolit në gjak pas marrjes së karbohidrateve, bashkë me analizën e kulturës mikrobiale dhe përjashtimin e konsumit të alkoolit. Trajtimet e suksesshme kanë përfshirë përdorimin e antifungalëve (si flukonazoli), dieta të varfra në karbohidrate dhe, në rastet rezistente, transplantimin e mikrobiomës fekale.
Përfundime: ABS - ja është çrregullim i rrallë metabolik me pasoja klinike dhe sociale, duke përfshirë simptoma të ngjashme me dehjen, çrregullime metabolike dhe probleme ligjore. Trajtimet që synojnë mikrobiomën intestinale dhe modifikimet dietike kanë dhënë rezultate premtuese, megjithatë mungojnë kritere diagnostike të standardizuara dhe studime të kontrolluara. Kërkime të mëtejshme janë të nevojshme për të përcaktuar prevalencën, faktorët e rrezikut dhe efektet afatgjata të trajtimit.

Fjalë kyçe: sindroma e fermentimit endogjen, mikrobioma intestinale, etanol endogjen, disbiozë, Candida, Klebsiella.

APLIKIMI I DY LEMBOVE VASKULARE AURIKULARE NË KORREKTIMIN ESTETIK TË CONSTRICTAURIS.

Prof. Asc. Gëzim Xhepa
Shërbimi i Djegje - Plastikës, QSU "Nënë Tereza"

Abstrakt
Hyrje: Dismorfitë e regjionit skafo - helicien janë shumë të rralla dhe kanë të bëjnë me deficite, apo hipertrofi zhvillimi. Këtu inkuadrohet dhe constrictauris, i cili në literaturë njihet si veshët kupë. Në këtë dismorfi zhvillimi deficitar i helixit nuk lejon zhvillimin e skafës, si dhe pengon formimin e krusit të pasmë të antiheliksit. Për incidencën e ulët të tij dhe vetë problematikat korrektuese ende nuk ka një teknikë stabël dhe plotësisht të pranueshme në korrektimin e tij.
Prezantim i teknikës kirurgjikale: Në këtë prezantim, japim alternativën tonë të aplikuar vetëm në 6 raste, dhe argumentojmë linjat anatomike që mbështesin alternativën tonë kirurgjikale, si dhe korrektimin selektiv regjional të dismorfisë, duke tentuar një rezultat estetik të kënaqshëm, sa më pranë relievit natyral aurikulare, me risqe sa më të ulta kirurgjikale dhe jetëgjatësi të rezultatit postoperator.
Diskutim i teknikës: Shtysa në konturimin e kësaj teknike kirurgjikale u mor nga konfigurimi i zonave vaskulare aurikulare dhe akset vaskularizuese kryesore të aurikulës, duke diferencuar angiosomitet e saj. Për aq kohë sa regjioni konko - antihelicien dhe lëkura laterale aurikulare kanë aks anterior vaskular, ndërsa lëkura mediale aurikulare dhe kërci skafohelicien kanë aks vaskular posterior, aurikula jep mundësinë e krijimit të dy lembove kartilago - kutaneale me vaskularizimi të pavarur që janë ajo laterale konko - antiheliciene dhe ajo mediale kutano – heliciene, me ndarje aurikulare në trajektoren e sulkusit helicien. Shkarja e lembos mediale mbi atë laterale çliron strangulacionin helicien, ndërsa rikonfigurimi i antihelksit me sutura permanent të fundosura në lembon laterale rrit lartësinë aurikulare dhe i jep aurikulës një konfiguracion natyral.
Konkluzion: Ndonëse e aplikuar në pak raste, teknika e propozuar duket shpresëdhënëse dhe paraqet interes në raport me teknika të tjera bashkëkohore, pasi karakterizohet nga një mbrojtje maksimale e vaskularizimit dhe integritetit strukturor të zonave morfologjike aurikulare, si dhe korrekton në mënyrë të pavarur dy regjione aurikulare që në këtë dismorfi, kanë problematika morfologjike diametralisht të kundërta, ku hipotrofia heliciene bashkëshoqërohet me deformim konfigurues antihelicien.

Fjalë kyçe: Dismorfitë e regjionit skafo - helicien, lembo vaskulare, korrektim, constrictauris.

SFIDAT KIRURGJIKALE REKONSTRUKTIVE TË BUZËS SË SIPËRME PAS EKSCIZIONIT TË LEZIONEVE NEOPLAZIKE (SERI RASTESH).

Prof. Assoc. Gëzim Xhepa[1], Prof. Helidon Nina[2], Prof. Assoc. Sokol Isaraj[1], Dr. Senera Hoxha
[1]Department of Plastic and Burn Surgery, UHC "Mother Teresa. "
[2]Department of Oncology, UHC "Mother Teresa"

Abstrakt

Hyrje: Kanceri i buzës së sipërme është më i rrallë se ai i buzës së poshtme, duke përfshirë vetëm 7 deri në 10% të lezioneve neoplazike të buzëve. Në ndryshim nga buza e poshtme që manifeston një dominancë të tipit skuamocelular dhe frekuencë të lartë prekjeje në meshkuj, në buzën e sipërme haset një predominim të tipit bazocelular dhe një shpërndarje thuajse të barabartë ndërmjet dy gjinive. Në studimet e fundit haset një tendencë në rritje të tipit skuamocelular në lezionet malinje të kësaj buze, si dhe një prognozë më e rezervuar e kësaj patologjie në raport me të njëjtin tip në buzën e poshtme.

Prezantim rastesh: Në këtë punim kemi prezantuar 10 raste, me rritje progresive të lezioneve dhe për pasojë dhe të përmasave të defekteve të krijuara nga ekscizimi i tyre, duke detajuar në çdo rast diferencat korrektuese me buzën e poshtme, që për veçoritë anatomike të saj krijon komoditet dhe lehtësi korrektuese për shkak të labilitetit të lartë indor. Me rritjen progresive të defekteve, prezantojmë një kalim gradual nga lembot kuadratike avancuese, në ato triangulare rotative avancuese, në kuadratiket rotative, në avancimet bilaterale, në kuadratike bukale zhvendosësh, e deri në lembo të pedunkuluara bukale treshtresore në formimin e plotë të buzës inferiore.

Diskutime: Me gjithë dizavantazhet e veta anatomike në drejtim të zhvendosjes kirurgjikale indore, vaskularizimi i saj i bollshëm, si dhe mobiliteti i lartë bukal i regjioneve fqinjë mundësi tërheqjeje dhe tensionimi, krijojnë mundësi praktike në rekonstruksionin estetik dhe morfofunksional të saj. Mungesa e eksperiencës botërore dhe standardizimit të interventeve rekonstruktive për shkak të frekuencës së ulët të patologjive të saj, i transformojnë interventet korrektuese të buzës së sipërme në një sfidë kreative kirurgjikale.

Konkluzion: Rekonstruksioni kirurgjikal i buzës superiore mbetet një sfidë kirurgjikale bashkëkohore në kushtet e rritjes së frekuencës dhe agresivitetit malinj të lezioneve neoplazike të kësaj buze.

Fjalë kyçe: buza e sipërme, carcinoma squamocellularis, carcinoma basocellularis, avancimi i indeve të faqeve, lembo kuadratike, lembo triangulare angulare, lembo rotative, lembo bukale aksiale.

RAPORTIM RASTI: MELANOMË EPITHELIOIDE E PARAQITUR SI MASË CERVIKALE.

Dr. Gjergj Andrea[1], Dr. Fjoralba Mulgeci[1], Dr. Irisi Xure[1]
[1] Klinika e Tretë e Kirurgjisë dhe Traktit Digjestiv, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Masat cervikale tek të rriturit shpesh paraqesin një sfidë diagnostike, me malinjitetin që mbetet një konsideratë kryesore në rastet persistente ose atipike. Melanoma epithelioide është një nënlloj i rrallë, por agresiv i melanomës, që mund të shfaqet si një masë në qafë, ndonjëherë pa lezion primar të identifikueshëm, duke krijuar pasiguri diagnostike.

Prezantimi i rastit: Paraqesim rastin e një pacienti mashkull 35 - vjeçar, i cili u paraqit me një masë progresivisht në rritje në regjionin supraklavikular të majtë për një periudhë gjashtëmujore. Ekzaminimet imazherike zbuluan një lezion me përforcim pas kontrasti dhe limfadenopati përreth. Pacienti iu nënshtrua ekscizionit të plotë kirurgjikal të masës. Ekzaminimi histopatologjik konfirmoi diagnozën e melanomës epithelioide. Pas vlerësimeve dermatologjike dhe sistemike të detajuara, nuk u identifikua ndonjë lezion primar kutan.

Përfundimi: Melanoma epithelioide duhet të merret në konsideratë në diagnozën diferenciale të masave cervikale, veçanërisht kur gjetjet klinike dhe radiologjike janë të paqarta. Njohja e hershme dhe ekscizioni i plotë kirurgjikal, i ndjekur nga një vlerësim multidisiplinar, janë thelbësore për përmirësimin e rezultateve. Ky rast thekson rëndësinë e mbajtjes së një niveli të lartë dyshimi për neoplazitë e rralla dhe agresive tek pacientët që paraqiten me masa të izoluara në qafë.

Fjalë kyçe: melanomë epithelioide, masë cervikale, malignitet, ekscizion kirurgjikal, diagnozë diferenciale

GRAVIDANCA EKSTRAUTERINE KORNUALE – PREZANTIM I TRE RASTEVE KLINIKO - KIRURGJIKALE.

Dr. Gjergji Gjata, Enida Avdolli
Obstetër - Gjinekolog – Sptiali Rajonal Korçë.

Abstrakt

Hyrje: Gravidanca kornuale është një formë e rrallë e shtatzënisë ektopike, e cila zhvillohet në këndin e uterusit dhe është e lidhur me rrezik të lartë për komplikacione. Kur shoqërohet me anomali të tjera anatomike, si noduset fibromatoze ose uterus bikorn, menaxhimi mund të komplikohet. Ky studim përfshin tre raste klinike të trajtimit kirurgjikal të gravidanacës kornuale, duke ruajtur integritetin uterin.

Objektiva: Të paraqiten tre raste klinike të gravidancës kornuale: njëra me nodus fibromatoz, njëra në një uterus bikorn dhe një rast me hemoperitoneum masiv, si dhe të diskutohet rëndësia e anamnezës së detajuar dhe ekzaminimit ekografik në vendosjen e diagnozës për të kaluar më pas tek menaxhimi kirurgjikal me fokus në ruajtjen e fertilitetit.

Materiale dhe metoda: Rasti 1: Pacientja A. K. , 43 - vjeç, G2P2, me dhimbje abdominale dhe betaHCG pozitive. Ekografia tregoi një masë në zonën kornuale dhe një nodus fibromatoz. U realizua kornuektomi dhe miomektomi, me ruajtje të uterusit. Rasti 2: Pacientja A. F, 28 - vjeç, G1P1 me vonesë të menstruacioneve, betaHCG pozitive dhe sekrecione vaginale hemorragjike. Ekografia tregoi gravidancë kornuale në një uterus bikorn. U realizua kornuektomi dhe heqje e masës gestacionale me ruajtje të uterusit. Rasti 3: Pacientja Xh. Gj, 22 - vjeç, me amenorre 7–8 javë, dhimbje të forta abdominale, lipotimi dhe betaHCG pozitive. Ekografia dhe eksplorimi intraoperativ treguan gravidancë ektopike kornuale me hemoperitoneum masiv (gjak i pastër dhe koagula). U realizua ndërhyrje kirurgjikale me ruajtje të fertilitetit dhe pacientja u rikuperua plotësisht.

Rezultate: Në të tre rastet, pacientet kaluan me sukses procedurat kirurgjikale dhe patën një rikuperim të plotë post - operator.

Konkluzione: Gravidanca kornuale është një entitet i rrezikshëm, dhe shoqërimi me probleme anatomike si noduset fibromatoze, uterusi bikorn apo komplikime akute si hemoperitoneumi masiv mund të komplikojë diagnostikimin dhe menaxhimin. Kirurgjia konservative, si kornuektomia, është një opsion i mundshëm për të ruajtur fertilitetin.

Rekomandime: Rritja e vigjilencës diagnostike për gratë me formacione uterine të njohura është e domosdoshme. Marrja e një anamneze të detajuar luan një rol thelbësor në dyshimin diagnostik. Kirurgjia konservative duhet të merret parasysh për gratë që dëshirojnë të ruajnë fertilitetin.

Fjalë kyçe: gravidanca cornuale, bicorn, kirurgjia konservative, fertilitet, noduse fibromatose.

PËRPARIMET E ARRITURA NË TRAJTIMIN E PACIENTËVE ME TUMORE INFILTRATIVE TË VEZIKËS URINARE, NJË RISHIKIM I LITERATURËS.

Gjergji Karamitri, MD
Urolog, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"

Abstrakt

Hyrje: Kanceri infiltrativ i vezikës urinare është një sëmundje malinje shumë agresive, me një rrezik mjaft të lartë për t'u përsëritur pas cistektomisë radikale dhe gjithashtu me sëmundshmëri dhe mortalitet të lartë. Kombinimi i kimioterapisë neoadjuvante me cistektominë radikale ka treguar përmirësim të rezultateve, duke reduktuar masën tumorale në vezikën urinare dhe duke eliminuar mikrometastazat përpara kryerjes së kirurgjisë. Kështu, duke përmirësuar mbijetesën e përgjithshme dhe cilësinë e jetës pas trajtimit, është bërë tashmë metoda standarde e trajtimit, e rekomanduar nga ne urologët. Megjithatë, rreth 35%–45% e pacientëve do të manifestojnë përsëritjen e sëmundjes edhe pas këtij trajtimi. Ndërkohë, një numër i konsiderueshëm pacientësh me tumor infiltrativ të vezikës urinare nuk mund të trajtohen me medikamente me bazë cisplatine, apo refuzojnë këtë trajtim, duke bërë që të përballemi me një situatë të ndryshme klinike, duke kërkuar mënyra të tjera trajtimi.

Metodologjia: Ky është një rishikim sistematik dhe meta - analizë që përfshin prova të rastësishme kontrolli për të vlerësuar aplikimin e kimioterapisë neoadjuvante me cistektomi radikale në pacientët me tumor infiltrativ të vezikës urinare pa metastaza, në stadin T2–T3 (invazion sipërfaqësor i muskulit vs sëmundje më e avancuar).

Rezultati primar për t'u vlerësuar ishte përgjigjja e plotë ndaj mjekimit, e përcaktuar si T0, ndërkohë që rezultati i dytë për t'u parë ishte mbijetesa e përgjithshme dhe efektet anësore.
Rezultate: Këto vlerësime të rastësishme, që analizuan rreth 2340 pacientë, treguan se pacientët e trajtuar me kimioterapi neoadjuvante dhe cistektomi radikale arritën rezultatin më të lartë pas trajtimit, me një raport të ndodhur (OR) prej 50. 2%, të krahasuar me cistektominë radikale të aplikuar si trajtim i vetëm. Studimet treguan gjithashtu përmirësimin e mbijetesës në përgjithësi, të shoqëruar me mungesën e qelizave tumorale në preparatet indore pas cistektomisë.
Konkluzione: Duke e krahasuar me cistektominë radikale si trajtim të vetëm, kimioterapia neoadjuvante e ndjekur nga cistektomia radikale rrit mundësinë e eliminimit të qelizave kanceroze në preparatet indore dhe është e shoqëruar me rritjen e jetëgjatësisë tek pacientët me kancer të avancuar të vezikës urinare. Megjithatë, mënyrat e tjera të trajtimit mbeten të nevojshme në rastet e pacientëve që nuk mund t'u aplikohet kimioterapia neoadjuvante.

Fjalë kyçe: cistektomi radikale, kimioterapia neoadjuvante, masa tumorale, preparate indore.

SËMUNDJA GAUCHER - KORELACIONI GJENOTIP - FENOTIP NË RAPORTIN MOTËR - VËLLA.

Gladiola Hoxha[1], Ermira Dervishi[1], Virtut Velmishi[1], Aferdita Tako[1], Paskal Cullufe[1]
[1]*Shërbimi i Pediatrisë së Specialiteteve nr 2 QSUT.*

Abstrakt
Hyrje: Sëmundja Gaucher (GD) është një nga sëmundjet më të shpeshta me depozitim lysosomial, rezultat i varianteve patogjenike të gjenit GBA1. Sëmundja karakterizohet nga një heterogjenetitet i madh gjenetik, me mbi 800 variante patogjenike të identifikuara në GBA1 dhe shprehet me një polimorfizëm të jashtëzakonshëm fenotipik të ndarë në dy grupe kryesore; pa prekje neruologjike që është dhe forma më e shpeshtë (rreth90%), dhe me prekje neurologjike. Forma neurologjike e sëmundjes nGD, ndahet tradicionalisht në dy nëntipe: nGD2, i cili shfaqet që para lindjes apo në javët e para pas saj dhe nGD3, manifestimet klinike të secilës shfaqen me vonë deri në adoleshencë. Pavarësisht kësaj ndarje nGD shfaqet si një spektër i gjerë dhe i vazhdueshëm fenotipik pa dallime strikte mes tipave të ndryshëm të sëmundjes. Ndryshimet fenotipike vërehen jo vetëm mes pacientëve bartës të varianteve të ndryshëm patogjenik, por edhe kur kanë të njejtin gjenotip, madje edhe në fëmijë binjakë.
Raportim rasti: Po paraqisim dy pacientë, motër e vëlla, të diagnostikuar me nGD3, me të njejtin genotip F213I: H255Q / D409H, dhe ndërkohë paraqiten me fenotipe krejt të ndryshëm. Motra u paraqit në shërbim në moshën rreth 4 vjeçare për ankesa viscerale, hepatosplenomegali anemi, trombocitopeni, të shoqëruar me apraxi oculomotore (palse gazy). Ndërsa vëllai u diagnostikua pas motrës dhe përvec shenjave viscerale, manifestonte edhe shenja të tjera neurologjike; distoni, tremor të shprehur, rigiditet të qafës dhe trupit, vështirësi të shprehur motorike dhe globale, ataksi, disfagi, dizartri, hipofoni, apraksi okulomotore të cilat erdhën në progresion drejt rëndimit gradual të tyre.
Përfundim: Korelacioni gjenotip / fenotip në GD është i kufizuar; pacientë me të njejtin gjenotip mund të shfaqen me fenotipe krejt të ndryshme, cka nënvizon rolin e mundshëm edhe të faktorëve të tjerë si epigjenetike, ambientale etj.

Fjalë kyçe: Sëmundja Gaucher, gjenotip, fenotip, formë neuronopatike.

VETË - VLERËSIMI I NIVELIT TË VITAMINËS D DHE EKSPOZIMI NË DIELL NË POPULLATËN SHQIPTARE 2024.

Prof. Assoc. Dr. Blerina Zeza, Dr. Glorja Demika
*Albanian University, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Departmenti i Stomatologjis*ë, *Tiranë, Shqipëri 2025*

Abstrakt
Qëllimi*:* Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë nivelin e informimit dhe të vetëdijes që individët në Shqipëri kanë për nivelin e tyre të vitaminës D dhe ndikimin e ekspozimit në diell për prodhimin e vitaminës D.

Materialet dhe metodat: Të dhënat u mblodhën duke përdorur një pyetësor të shpërndarë përmes formularëve të Google zyrtarisht për të gjithë punonjësit dhe studentët e Albanian University me sugjerimin për ta shpërndarë atë tek familjarët dhe miqtë për një popullsi më të gjerë. Pyetësori ishte aktiv nga nëntori 2024 deri në janar 2025. Pyetjet e përfshira në pyetësor kishin të bënin me informacionin e stilit të jetesës në lidhje me ekspozimin në diell, dietën, marrjen e suplementeve dhe analizën e vitaminës D.
Rezultate: Një total prej 1016 individësh iu përgjigjën pyetësorit nga një shpërndarje fillestare mes individëve dhe studentëve nga universiteti ynë. Mosha mesatare e të përzgjedhurve është 32 vjeç ku 76. 6% femra dhe 23. 4% meshkuj. Përdorimi i suplementeve është parë në 407 (40. 2%) persona dhe 124 prej tyre e kanë rimatur atë. Ndërkohë 710 individë ishin dhe 296 nuk ishin të vetëdijshëm se prodhimi i vitaminës D në lëkurën tonë ndodh vetëm kur ekspozohemi ndaj dritës së diellit dhe hija është më e shkurtër se gjatësia e trupit tuaj.
Konkluzione: Është ende e nevojshme të rritet ndërgjegjësimi për testimin e vitaminës D, ekspozimi i sigurt por efikas në diell si dhe stili i jetesës për individët në Shqipëri, në mënyrë që të reduktohen rreziqet e deficencës gjithashtu dhe të përmirësohet shëndeti i tyre i përgjithshëm.

Fjalë kyçe: vitaminë D, mungesë e vitaminës D, suplemente të vitaminës D, ekspozim në diell.

MODALITETET E TRAJTIMIT TË OSTEOMIELITIT.

Dr. Arbër Behrami [1] Dr. Gramoz Bunjaku [1], Asst. Dr. Gëzim Morina [2], Asst. Dr. Luljeta Hasani [2], Dr. Lirim Tafilaj [2], Dr. Diellza Elezaj [2], Enida Kavaja [2], Mentor Krasniqi [2], Fleta Kuçi [2,] Dr. Plaurat Krasniqi, Prof. Asst. Dr. Sadije Namani[1] Asst. Dr. Mrikë Bunjaku [2]
Fakulteti i Mjekësisë, UPHP - QKUK, Klinika e Sëmundjeve Infektive [1,2]
Fakulteti i Mjekësisë [2]
Fakulteti i Mjekësisë, UPHP - QKUK, Klinika e Dermatovenerologjisë [3]
Fakulteti i Mjekësisë, UPHP - QKUK, Klinika e Radiologjisë [2]

Abstrakt
Hyrje: Osteomieliti përfaqëson një infeksion kompleks të kockës që kërkon menaxhim multidisiplinor dhe të individualizuar. Shkaktarët më të zakonshëm përfshijnë Staphylococcus aureus (përfshirë format MRSA), bakteret gram - negativë dhe në raste të caktuara patogjenë fungalë ose mikobakterialë. Pavarësisht përparimeve diagnostike, trajtimi mbetet sfidues për shkak të formimit të biofilmit, perfuzionit të kufizuar në indin kockor dhe potencialit për rikthim kronik të infeksionit.
Qëllimi: Ky rishikim synon të përmbledhë modalitetet kryesore të trajtimit të osteomielitit, duke theksuar rëndësinë e kombinimit të terapisë mjekësore dhe kirurgjikale, si dhe qasjet adjuvante moderne.
Metodologjia: Janë analizuar publikime të përzgjedhura nga bazat e të dhënave PubMed, Scopus dhe Cochrane Library (2010–2025), përfshirë udhëzimet e IDSA, EBJIS dhe IWGDF. Përfshirja është kufizuar në studime dhe udhëzime që trajtojnë trajtimin sistematik dhe kirurgjikal të osteomielitit në forma akute dhe kronike.
Rezultate: Terapia antibiotike përbën bazën e trajtimit dhe duhet të udhëhiqet nga rezultatet e kulturave të kockës dhe antibiogramës. Kombinimi i antibiotikëve intravenozë për 2–6 javë me kalim të hershëm në terapi orale (me biodisponibilitet të lartë) rezulton efektiv në forma të përzgjedhura. Për osteomielitin kronik, debridimi kirurgjikal dhe heqja e indeve nekrotike janë të domosdoshme, shpesh të shoqëruara me përdorim të spacer - ave lokalë me antibiotikë. Në rastet e lidhura me implante, heqja e protezës në një ose dy faza mbetet standardi terapeutik. Modalitetet adjuvante si oksigjeni hiperbarik, terapia me presion negativ (VAC) dhe rekonstruksioni i indeve të buta ndihmojnë në përmirësimin e shërimit lokal. Kohëzgjatja totale e trajtimit duhet të individualizohet, zakonisht 4–12 javë, në varësi të patogjenit, lokalizimit dhe statusit imun të pacientit.
Përfundime: Menaxhimi i osteomielitit kërkon qasje të integruar midis terapive mjekësore dhe kirurgjikale. Përdorimi racional i antibiotikëve, ndërhyrjet kirurgjikale të hershme dhe aplikimi i teknikave adjuvante përbëjnë gurët themelorë të suksesit terapeutik. Studimet e ardhshme duhet të përqendrohen në optimizimin e kohëzgjatjes së trajtimit dhe vlerësimin e efektivitetit të metodave të reja biologjike dhe të shpërndarjes lokale të antibiotikëve.

Fjalë kyçe: Osteomieliti, antibiotikoterapia, debridim kirurgjikal, biofilm, trajtim multidisiplinor, terapi adjuvante.

NGA PËRSËRITJA NË KOMUNIKIM: ROLI I NDËRHYRJEVE LOGOPEDIKE NË ÇRREGULLIMIN E "ECHOLALIAS" - STUDIM RASTESH.

MSc. Granit Haliti

Abstrakt

Hyrje: Echolalia është një formë e përsëritjes së menjëhershme ose të vonuar të fjalëve dhe frazave, e cila mund të shfaqet në zhvillimin e hershëm të gjuhës ose si pjesë e çrregullimeve të ndryshme të komunikimit. Ajo përfaqëson një sfidë në përdorimin funksional të gjuhës, por njëkohësisht edhe një mundësi për ta transformuar përsëritjen në një mjet të vlefshëm komunikimi. Qasjet logopedike moderne e trajtojnë echolalinë si potencial për zhvillimin e gjuhës, duke synuar shndërrimin e saj në komunikim më të kuptueshëm dhe funksional.

Metodologjia: Përmes metodës hulumtuese të studim rasteve, zbatua një qasje e bazuar në "Modelimin Gjuhësor të Zgjeruar" (Gjuha Gestalt) tek 5 fëmijë, e cila përfshin përdorimin e pyetjeve të hapura dhe të zgjeruara, modelimin e frazave më të plota dhe inkurajimin e të folurit spontan. Plani i ndërhyrjes u organizua në disa faza të strukturuara, duke përdorur materiale vizuale, udhëzime të thjeshta por të zgjeruara dhe pjesëmarrjen aktive të prindërve për të mbështetur zhvillimin gjuhësor në mjedisin e përditshëm.

Rezultate: Fëmijët që morën pjesë në ndërhyrje treguan reduktim të përsëritjeve jo - funksionale dhe një rritje të dukshme në përdorimin e frazave të strukturuara dhe të kuptueshme. Echolalia, në vend që të pengonte komunikimin, u shndërrua në një mjet për ndërveprim social, duke lehtësuar pjesëmarrjen në aktivitetet shkollore dhe në mjediset e përbashkëta.

Konkluzione: Ndërhyrjet logopedike të personalizuara dhe fleksibile, të kombinuara me bashkëpunim ndërprofesional dhe përfshirjen e prindërve, rezultojnë efektive për menaxhimin e echolalias. Qasja e "Modelimit Gjuhësor të Zgjeruar" (Gjuha Gestalt), rezultoi të jetë veçanërisht e suksesshme në shndërrimin e përsëritjeve në komunikim funksional, duke ofruar përmirësime të dukshme në aftësitë gjuhësore dhe sociale të fëmijëve.

Fjalë kyçe: echolalia, terapi e të folurit, komunikim funksional, modelim gjuhësor, zhvillim gjuhësor gjuhë gestalt / modelim gjuhësor i zgjeruar.

RISHIKIM I GUIDELINE - VE TË KLINIKËS PRAKTIKE TË KDIGO 2022 NË MENAXHIMIN E DIABETIT NË INDIVIDËT ME INSUFICIENCË RENALE KRONIKE.

Greis Kika

Abstrakt

Me ndërgjegjësimin në rritje se sëmundja kronike e veshkave (CKD) është një problem shëndetësor ndërkombëtar, KDIGO u krijua në vitin 2003 me synimin për të "përmirësuar kujdesin dhe rezultatet e pacientëve me sëmundje të veshkave në mbarë botën përmes promovimit të koordinimit, bashkëpunimit dhe integrimit të iniciativave për të zhvilluar dhe zbatuar udhëzime të praktikës klinike". Udhëzuesi i Praktikës Klinike KDIGO 2022 për Menaxhimin e Diabetit në Sëmundjen Kronike të Veshkave (CKD) vjen vetëm 2 vjet pas Udhëzuesit origjinal të Praktikës Klinike KDIGO 2020 mbi këtë temë. Përditësimi u motivua nga pasuria e informacionit të ri me cilësi të lartë që është bërë i disponueshëm shpejt që nga publikimi i udhëzuesit origjinal të vitit 2020 dhe nga thirrjet nga komuniteti për të ndihmuar në zbatimin e këtyre të dhënave të reja. Intervali i shkurtër midis udhëzimeve pasqyron ritmin e shpejtë të përparimit në trajtimin e diabetit dhe CKD. CKD (Sëmundja Renale Kronike) përkufizohet si anomali të strukturës ose funksionit të veshkave, të pranishme për >3 muaj, me implikime për shëndetin. Klasifikohet bazuar në Shkakun, kategorinë GFR (G1–G5) dhe kategorinë e Albuminurisë (A1–A3). Nga ana tjetër, prevalenca e diabetit në të gjithë botën ka arritur përmasa epidemike. Federata Ndërkombëtare e Diabetit vlerësoi se 537 milionë njerëz jetonin me diabet në vitin 2021. Ky numër pritet të rritet në 784 milionë deri në vitin 2045. Është vlerësuar se 40% ose më shumë e njerëzve me diabet do të zhvillojnë CKD, duke përfshirë një numër të konsiderueshëm që do të zhvillojnë dështim të veshkave që kërkon dializë ose transplantim. Përditësimet e seksioneve mbi SGLT2i dhe GLP - 1 RA përfshijnë të dhëna të reja, diskutime shtesë, modifikim të rekomandimit të SGLT2i për të reflektuar prova të reja të përfitimeve dhe sigurisë me shkallën e vlerësuar të filtrimit glomerular (eGFR) 20 ml / min për 1. 73 m2 (nga 30 ml / min për 1. 73 m2 më parë) midis njerëzve me diabet të tipit 2 (T2D), dhe pika praktike të rishikuara ose të shtuara dhe rekomandime kërkimore. Një seksion i ri mbi MRA - në u shtua në kapitullin mbi "Kujdesin

gjithëpërfshirës tek pacientët me diabet dhe CKD, me një rekomandim të ri që mbështet përdorimin e MRA - së josteroide për pacientët me T2D, albuminuri të mbetur pavarësisht trajtimeve të linjës së parë për diabetin dhe CKD - në, dhe përqendrim normal të kaliumit në serum. Udhëzuesi përfshin rekomandime të bazuara në prova për trajtimin farmakologjik për uljen e glukozës në T2D dhe CKD, por e shtyn trajtimin farmakologjik për uljen e glukozës në T1D, bazuar në insulinë, në udhëzimet ekzistuese nga organizatat e diabetit. Grupi i Punës synonte të gjenerone një udhëzues të përditësuar që është i përkushtuar rigorozisht ndaj provave ekzistuese dhe klinikisht i dobishëm.

Fjalë kyçe: Sëmundja kronike e veshkave (CKD), Diabeti mellitus tip 2 (T2D), KDIGO 2022, SGLT2 inhibitorë (SGLT2i).

EDEMA PULMONARE.

Gresa Mustafa

Abstrakt

Hyrje: Edema pulmonare paraqet një gjendje klinike akute, e karakterizuar nga akumulimi i lëngut në hapësirat intersticiale dhe alveolare të mushkërive. Ky proces ndikon drejtpërdrejt në shkëmbimin e gazeve dhe çon në hipoksemi të rëndë, shpesh të rrezikshme për jetën. Shkaqet më të shpeshta janë dështimi akut i ventrikulit të majtë, infarkti i miokardit, hipertensioni i papritur, si dhe forma jo - kardiogjene si sindroma e distresit respirator akut (ARDS), toksinat ose infeksionet e rënda sistemike.

Metodologjia: Ky studim përfshin analizën e të dhënave klinike, laboratorike dhe imazherike të pacientëve të trajtuar me diagnozë të edemës pulmonare në një periudhë 12 mujore. Janë shqyrtuar faktorët etiologjikë, manifestimet klinike, interpretimet radiologjike (RTG, CT toraksi) dhe efektiviteti i trajtimit emergjent përmes oksigjenoterapisë, CPAP, diuretikëve dhe menaxhimit të presionit të gjakut.

Rezultate kryesore: Rezultatet treguan se 72% e rasteve ishin me origjinë kardiogjene, kryesisht si pasojë e insuficiencës së ventrikulit të majtë. Forma jo - kardiogjene përfshinte 18% të rasteve dhe ishin të lidhura me ARDS, sepsë ose trauma torakale. Përdorimi i CPAP dhe diuretikëve rezultoi efektiv në stabilizimin e parametrave respiratorë dhe hemodinamikë në 85% të pacientëve brenda 24 orëve të para të trajtimit.

Përfundime: Edema pulmonare mbetet një urgjencë kritike që kërkon diagnozë të shpejtë, menaxhim multidisiplinar dhe monitorim të kujdesshëm. Kombinimi i terapive mbështetëse respiratore dhe farmakologjike redukton ndjeshëm mortalitetin dhe përmirëson cilësinë e jetës së pacientëve. Përdorimi i protokolleve standarde diagnostike dhe trajtuese është thelbësor për një menaxhim të suksesshëm.

Fjalë kyçe: edema pulmonare, dështim kardiak, CPAP, ARDS, urgjencë mjekësore, hipoksemi.

DEFICENCA E VITAMINËS D NË ANAMORAVË DHE LIDHJA ME SËMUNDJET KRONIKE.

Dr. Gresë Sinani

Abstrakt

Hyrje: Vitamina D është një mikronutrient esencial, i domosdoshëm për homeostazën e kalciumit, shëndetin muskuloskeletal dhe funksionin imun. Deficenca e saj përbën një problem të rëndësishëm shëndetësor publik, shpesh i nënvlerësuar në rajone me kushte gjeografike dhe socio - ekonomike të veçanta, si Anamorava.

Qëllimi: Ky studim synoi të përcaktojë prevalencën e deficitit të vitaminës D sipas grupmoshave dhe të vlerësojë asociacionin e saj me sëmundje kronike të përzgjedhura.

Metodologjia: U realizua një studim transversal gjatë periudhës Janar–Qershor 2025, ku u përfshinë 500 pjesëmarrës me nivele të ulëta të 25(OH)D të konfirmuara laboratorikisht: 100 fëmijë, 200 të rritur dhe 200 të moshuar. Për secilin grup u evidentuan të dhëna klinike dhe prania e patologjive kronike si osteoporoza, diabeti mellitus tip 2 dhe hipertensioni arterial.

Rezultate: Deficenca e vitaminës D rezultoi më e theksuar tek grupi i të moshuarve (mesatarja 14 ng / mL), veçanërisht tek gratë pas menopauzës. Tek fëmijët u identifikuan raste me çrregullime të rritjes dhe osteomalaci. Tek të rriturit dhe të moshuarit, prevalenca e sëmundjeve kronike në individët me deficit të vitaminës D ishte:

osteoporoza 35%, diabeti tip 2 – 22%, hipertensioni arterial – 28%. U vu re një korrelacion i qartë mes niveleve më të ulëta të 25(OH)D dhe rrezikut të shtuar për sëmundje të shumta bashkëshoqëruese.
Përfundime: Deficenca e vitaminës D është e përhapur gjerësisht në të gjitha grupmoshat në Anamoravë, me incidencë më të lartë tek të moshuarit. Gjetjet theksojnë domosdoshmërinë e masave preventive në nivel popullate, përfshirë suplementimin, edukimin shëndetësor dhe politikat e hershme të skriningut.

Fjalë kyçe: vitamina D, deficit, hypertension arterial etj.

VLERËSIMI EKOGRAFIK I ADNEKSEVE GJATË TREMUJORIT TE PARE TE SHTATËZANISË: RËNDËSIA KLINIKE DHE MENAXHIMI – BAZUAR NË NJË RAST KLINIK REAL.

Prof. Asc. Enkeleda Prifti, Dr. Greta Llupo

Abstrakt
Hyrje: Vlerësimi ekografik i adnekseve gjatë shtatzënisë është i domosdoshëm për të identifikuar ndryshimet fiziologjike dhe patologjike që mund të ndikojnë në ecurinë e shtatzënisë. Ndryshimet adnexale mund të paraqiten si masa ovarike të cilat, megjithëse shpesh janë beninje, mund të kërkojnë ndjekje të kujdesshme dhe ndërhyrje kirurgjikale nëse komplikohen.
Qëllimi: Të paraqitet rëndësia e vlerësimit ekografik të adneksëve gjatë shtatzënisë spontane, bazuar në një rast real klinik.
Rasti klinik: Pacientja A. D, 27 vjeç, paraqitet në maternitet me ankesat dhimbje dhe fryrje të barkut, të lokalizuara kryesisht në anën e djathtë. Në ekzaminimin ekografik rezulton: gravidancë intrauterine, evolutive, me CRL sa për 6 javë. Konstatohet në ovarin dexter një formacion hipoekogen, i rregullt, me përmasa 90 x 75 mm, me vaskularizim Color Score 1. Ovari sinister normal. Pa likid të lirë në douglas. Pacientja është ndjekur në dinamikë gjatë gjithë shtatzënisë dhe nuk ka pasur probleme nga ana obstetrikale. Në ekografi është vërejtur një rritje e përmasave të formacionit adnexial deri në 180 x 100 mm. Lindja u realizua per vias vaginalis, feto - vivo. Tre muaj pas lindjes, u realizua laparotomia dhe u krye heqja e një mase myomatoze 20 cm me pedunkul të gjerë, me aderenca me omentumin dhe kolonin ascendent. Në ekografinë e kontrollit 1 muaj pas operacionit, uterus kishte përmasa dhe strukturë normale, dhe ovaret ishin normale.
Diskutim: Ky rast ilustron rëndësinë e monitorimit të vazhdueshëm ekografik të masave adnexale gjatë shtatzënisë. Edhe pse shtatzënia vijoi normalisht dhe lindja u realizua pa komplikime, formacioni adnexial arriti përmasa të konsiderueshme dhe kërkoi ndërhyrje kirurgjikale pas lindjes. Vlerësimi i kujdesshëm me ekografi dhe vendimmarrja multidisiplinare sigurojnë menaxhim të sigurt për nënën dhe fetusin.
Përfundim: Vlerësimi sistematik i adneksëve gjatë shtatzënisë është thelbësor për diagnostikimin dhe ndjekjen e masave ovarike. Ndjekja dinamike e këtij rasti tregoi se, edhe kur shtatzënia zhvillohet pa komplikime, masat adnexale të mëdha mund të kërkojnë trajtim kirurgjikal pas lindjes.

Fjalë kyçe: ekografia transvaginale, adneksa, shtatzëni spontane, masë ovarike, laparotomi, myomë.

VLERËSIMI I NIVELEVE TË VITAMINËS D TEK FËMIJËT 0–12 VJEÇ NË TIRANË: STUDIM RASTI.

Griselda Korçari
[1]*Departamenti i Teknikë Laboratori Mjekësor dhe Imazheri, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.*

Abstrakt
Hyrje: Vitaminë D është një element kyç në ruajtjen e homeostazës së kalciumit dhe zhvillimin normal të sistemit muskuloskeletor tek fëmijët. Mungesa e saj është një problem shëndetësor publik që mund të çojë në pasoja serioze si rahitizmi dhe dobësi imunitare. Ky studim ka për qëllim të vlerësojë shpërndarjen e niveleve të vitaminës D në një kampion prej 100 fëmijësh të moshave 0 - 12 vjeç dhe të analizojë ndikimin e faktorëve demografikë, si mosha dhe gjinia, në këtë shpërndarje.
Materiale dhe metoda: Metodologjia përfshiu analizën laboratorike të niveleve të vitaminës D, të cilat u klasifikuan në katër kategori: deficit i rëndë (<10 ng / mL), deficiencë (11 - 19 ng / mL), pamjaftueshmëri (20 -

30 ng / mL) dhe vlerë normale (31 - 100 ng / mL). Pjesëmarrësit u ndanë në tre grupmosha (0–2, 3–5 dhe 6–12 vjeç). Analizat statistikore përfshinë One - Way ANOVA për krahasimin e mesatareve të vitaminës D ndër grupmosha dhe testin Chi - Square për lidhjen midis gjinisë dhe klasifikimit të vitaminës D.
Rezultate: Rezultatet treguan një prevalencë të lartë të mungesës së vitaminës D: vetëm 9% e fëmijëve kishin vlera normale, ndërsa 59% paraqisnin pamjaftueshmëri dhe 32% deficiencë apo deficit të rëndë. Nuk u identifikuan ndryshime statistikisht të rëndësishme midis grupmoshave (p=0. 382) apo midis gjinisë (p=0. 421). Kjo sugjeron se mungesa e vitaminës D është e përhapur në mënyrë homogjene në të gjitha grupmoshat dhe pa dallime gjinore.
Konkluzione: Studimi nënvizon nevojën urgjente për implementimin e politikave parandaluese, duke përfshirë edukimin shëndetësor, monitorimin rutinë dhe suplementimin adekuat të vitaminës D në popullatën pediatrike për të minimizuar rrezikun e komplikacioneve afatgjata shëndetësore.

Fjalë kyçe: Vitaminë D, deficiencë e vitaminës D, fëmijë, grupmosha, prevalence.

ANEMI HEMOLITIKE PAS RIPARIMIT TË VALVULËS MITRALE: NJË RAST I RRALLË.

Griselda Pelo[1], Marsela Shani[2], Marselda Tollozhina[3], Treisi Goxhaj[4]
[1] Qendra Shëndetësore e Burgjeve, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"
[2] Ospedale "Carlo Poma", Mantova, Itali
[3] Universiteti Shqiptar, Tiranë
[4] Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio"

Abstrakt
Hyrje: Anemia hemolitike është një ndërlikim i rrallë, por serioz pas riparimit të valvulës mitrale. Paraqitet një rast i një pacienti mashkull 58 - vjeçar, i cili zhvilloi anemi hemolitike të rëndë dhe insuficence renale akute pas riparimit të valvulës mitrale me kordone artificiale tendineae. Vlerësimet laboratorike treguan rritje të laktat dehidrogjenazës (LDH), ulje të haptoglobinës dhe prani të shistociteve në strishonë periferike. Ekokardiografia tregoi regurgitim mitral të lehtë, ndërsa ekzaminimi kirurgjikal evidentoi kordone artificiale jo të endotelizuara. Menaxhimi konservativ, përfshirë transfuzionet dhe plazmaferezën, rezultoi i paefektshëm. Hemoliza u zgjidh vetëm pas zëvendësimit të valvulës mitrale. Ky rast nënvizon rëndësinë e njohjes së hershme të hemolizës mekanike si ndërlikim i riparimit të valvulës mitrale. Anemia hemolitike pas ndërhyrjeve kirurgjikale të valvulave kardiake është e rrallë. Ajo mund të shkaktohet nga rrjedha me shpejtësi të lartë e regurgitimit, disfunksioni i valvulës protetike ose materialet jo të endotelizuara. Njohja e hershme është thelbësore për të parandaluar aneminë e rëndë, dështimin renal apo komplikime të tjera. Ky raport paraqet një rast të rrallë të anemisë hemolitike pas riparimit të valvulës mitrale si pasojë e kordoneve tendineae artificiale jo të endotelizuara.
Paraqitja e Rastit: Një pacient mashkull 58 - vjeçar, me histori sëmundjeje reumatizmale të zemrës, iu nënshtrua riparimit të valvulës mitrale duke përdorur kordone artificiale tendineae. Pas ndërhyrjes kirurgjikale, pacienti paraqiti urinë të errët dhe lodhje të përgjithshme. Analizat laboratorike treguan shenja të hemolizës. Ekokardiografia transtorakale evidentoi regurgitim mitral të lehtë. Terapia konservative, përfshirë transfuzionet dhe plazmaferezën, nuk solli përmirësim. Gjatë eksplorimit kirurgjikal u konfirmua prania e kordoneve artificiale jo të endotelizuara si faktor kontribues. Pas kryerjes së zëvendësimit të valvulës mitrale, hemoliza u zhduk plotësisht.
Diskutim: Hemoliza pas riparimit të valvulës mitrale shpesh ndodh si pasojë e traumës mekanike të eritrociteve nga flukset regurgituese ose nga materialet protetike. Në këtë pacient, regurgitimi i lehtë mitral drejtohej në unazën anuloplastike, ndërsa kordone tendineae artificiale jo të endotelizuara kontribuan në shkatërrimin e qelizave të kuqe të gjakut. Masat konservative shpesh dështojnë në raste të tilla, duke e bërë të nevojshëm zëvendësimin e valvulës. Te paturit ne vemendje te këtij ndërlikim të rrallë mundëson ndërhyrje të hershme dhe përmirësim të rezultatit klinik.
Përfundime: Anemia hemolitike duhet të merret në konsideratë tek pacientët me hemolizë të pashpjegueshme pas riparimit të valvulës mitrale. Kordone tendineae artificiale jo të endotelizuara, ndonëse rrallë, mund të luajnë rol të rëndësishëm në patogjenezë. Njohja e hershme dhe korrigjimi kirurgjikal janë të domosdoshme për zgjidhjen e gjendjes.

Fjalë kyçe: anemi hemolitike mekanike, riparimi i valvulës mitrale, kordone tendineae artificiale, dështim akut renal.

LIDHJET MIDIS HEMOGLOBINËS, CRP - SË DHE MBIJETESËS SË HERSHME TË FISTULËS ARTERIOVENOZE: NJË NDJEKJE TRE - MUJORE NGA NJË STUDIM PROSPEKTIV.

Gjana Grisilda. MD[1], Zenelaj Arben. Assoc. Prof. [1], Xhaferaj Medien. MD[1], Kapidani Loredana. MD[2]
[1]Departamenti i Sëmundjeve të Brendshme, Spitali Universitar i Traumës, Tiranë, Shqipëri
[2]Departamenti i Mjekësisë së Brendshme, Spitali Rajonal "Shefqet Ndroqi", Kavajë, Shqipëri

Abstrakt
Hyrje: Fistula arteriovenoze (FAV) mbetet akses vaskular i preferuar për hemodializë, për shkak të jetëgjatësisë dhe numrit të ulët të komplikimeve. Megjithatë, në praktikën e përditshme, dështimi i hershëm i fistulës ndodh më shpesh se sa pritej, shpesh përpara se ajo të arrijë maturimin e plotë. Bazuar në përvojën klinike të ekipit tonë, faktorë sistemikë si anemia dhe inflamacioni mund të ndikojnë në procesin e shërimit të murit vaskular pas operacionit.
Qëllimi: Ky studim synon të vlerësojë lidhjen midis vlerave paraoperative të hemoglobinës (Hb) dhe proteinës C - reaktive (CRP) me mbijetesën e hershme të fistulës arteriovenoze në qendrën tonë.
Materiale dhe Metoda: Në studim u përfshinë 24 pacientë (16 meshkuj dhe 8 femra, mosha mesatare 55 vjeç) që iu nënshtruan krijimit të një FAV të re dhe u ndoqën për tre muaj. Një fistulë u konsiderua funksionale nëse u përdor me sukses për dializë dhe jo funksionale nëse trombozohej ose nuk arrinte maturimin brenda 90 ditëve. Vlerat e Hb dhe CRP u matën para ndërhyrjes kirurgjikale dhe u rivlerësuan gjatë periudhës së ndjekjes. Analiza e mbijetesës u krye përmes metodës Kaplan–Meier, ndërsa regresioni Cox u përdor për të identifikuar faktorët parashikues të dështimit të hershëm.
Rezultate: Pas tre muajsh ndjekjeje, 14 fistula ishin funksionale dhe 10 kishin dështuar. Shumica e dështimeve ndodhën midis javës së dytë dhe të gjashtë pas operacionit. Pacientët me Hb më të ulët se 10 g / dL kishin një mbijetesë dukshëm më të shkurtër të fistulës ($p < 0.001$). Nivelet e larta të CRP (> 5 mg / L) u shoqëruan me një shkallë më të madhe dështimi (75% kundrejt 29% tek pacientët me CRP normale). Në analizën multivariate, CRP mbeti një faktor i pavarur rreziku, ndërsa hemoglobina e lartë tregoi efekt mbrojtës. Fistulat brakiocefalike kishin prirje për mbijetesë më të mirë, edhe pse pa rëndësi statistikore.
Përfundime: Rezultatet tona tregojnë se anemia dhe inflamacioni ndikojnë ndjeshëm në suksesin e hershëm të fistulave arteriovenoze. Optimizimi i niveleve të hemoglobinës dhe kontrolli i inflamacionit, para dhe pas ndërhyrjes kirurgjikale, mund të përmirësojnë maturimin dhe jetëgjatësinë e aksesit vaskular. Këto gjetje theksojnë rëndësinë e një qasjeje multidisiplinare, ku bashkëpunimi midis nefrologut, kirurgut dhe ekipit të hemodializës është thelbësor për ndjekjen dhe trajtimin optimal të pacientëve me fistula të reja.

Fjalë kyçe: Fistula arteriovenoze, hemoglobina, inflamacionit.

TRANSFERIMET NGA MATERNITETET E QARQEVE. ANALIZË PËRTEJ NUMRAVE.

Dr. G. Nasto[1], Dr. B. Gjoni[2], Prof. Asoc. Dr. A. Qosja (Hoxha)[3]
[1]Neonatolog, SUOGJ "Koço Gliozheni", Tiranë
[2]Pediatre, QSU "Nënë Tereza", Tiranë
[3]Shefe e Shërbimit të Neonatologjisë

Abstrakt
Hyrje: transferimet nga maternitetet e qarqeve përbëjnë një numër të konsiderueshëm të shtrimeve në reanimacionin tonë neonatal. përgjatë vitit 2024 janë bërë 124 shtrime nga maternitetet e qarqeve dhe spitalet private.
Qëllimi: ne do paraqesim nëpërmjet diagramave shtrimet nga maternitetet e qarqeve në SUOGJ "Koço Gliozheni", në reanimacionin neonatal. diagnozat e tyre dhe ditëqëndrimin në reanimacionin neonatal.
Metodologjia dhe rezultate: Të dhënat u morën nga regjistri i rikthimeve nga shtëpia dhe transferimeve nga maternitetet e qarqeve. Nga 329 shtrime gjithsej të këtij regjistri, 124 prej tyre ishin shtrime nga qarqet. Nga qarqet pjesën më të madhe të shtrimeve i kishin Maternitetet e qarqeve Elbasan dhe Korçë, më pak nga

maternitetet e qarqeve Vlorë dhe Kukës. Ditëqëndrimi mesatar në reanimacionin neonatal ishte 11, 42 ditë. Nga bebet e transferuara, 83 prej tyre ishin lindje në term dhe 41 preterm me diagnozat sipas diagramave.
Konkluzione: Bebet e transferuara nga maternitetet e qarqeve përbëjnë 37. 6% të shtrimeve nga bebet e rikthyera së bashku me ato të lindura në maternitetet e qarqeve.

Fjalë kyçe: transferim, reanimacion neonatal, maternitetet e qarqeve.

BRUCELLA EPIDIMO - ORKITIS: STUDIM RASTI.

Dr. Halil Xhibexhiu, Dr. A. Hazrolli, Dr. A. Rustemi, Dr. A. Hasani, Dr. S. Kastrati,
Spitali I Përgjithshëm, "Prim. Dr. Daut Mustafa", Prizren

Abstrakt
Hyrje: Bruceloza është një sëmundje infektive, zoonotike në kafshë dhe njerëz të ndryshëm të shkaktuar nga një sforcim gram - negativ coccobacilli si Brucella Melitensis ose Brucella Abortus. Transmetohet nëpërmjet mishit të ndotur dhe të patrajtuar, qumështit dhe produkteve të qumështit dhe nga kontakti i drejtpërdrejtë me kafshët e infektuara (gjedhët, delet, dhitë, derrat etj.), urinën, sekrecionet e trupit. Periudha e inkubacionit është nga një deri në katër javë. Bruceloza mund të përfshij e të shkaktoj prostatitis, epididymo - orchitis, cystitis, pyelonephritis, nephritis interstitial, glomerulonephritis exudative dhe absces renal. Brucella epididymo - orchitis është e rrallë, përveç në zona endemike. Ne e prezantojmë një pacient me brucelozë që paraqitet me epididymorchitis.
Pacient mashkull i pa martuar 22 vjeçar, ankohej nga ënjtje dhe dhimbje testikulare e djathtë, e shoqruar me ethe dhe temperature të larta 39 Cº për 4 - 5 ditët e mëparshme ku pranohet si rast urgjent në Rep. e Urologjisë. Ekzaminimi fizik ku vërehet ënjtjen dhe skuqje e himskrotumit të djathtë, palpohet testis dhe epidimiti i rritur dhe i dhembshëm në palpim. Analizat laboratorike - leucocytosis (26300 / mm3), SE 66 mm / h, CRP 247 mg / l, analiza e urinës 2 qelizave të bardha dhe 1 të kuqe të gjakut. Në ekzaminimin ultrasonografik me Doppler të scrotum, konstatojmë një testikul të djathtë të zmadhuar me përmasa 5. 18 x 3. 34 cm me rritje të qarkullimit të gjakut. Epididymis i djathtë i zmadhuar me dyshim e formacion për abscess. Epididemiti dhe testis i majtë – orchioctomi për shkak të torsionit të testisit me 2013. Për diagnozën diferenciale, kerkojmë tumor markerët që janë brenda kufijve normalë (AFP: 1. 03 U / L, hCG: 1 U / L). Fillojmë trajtimin standard me antibiotikë (Ceftriaxon 2. 0 g i. v. , b. i. d. +Amikacin 0. 5 i. v b. i. d) mjekim anti - inflamator jo - steroid, pushim të plotë, ngritje skrotale dhe aplikim lokal hipotermi. Simptomat lokale dhe klinike persistonin edhe pas 48 orëve, si dhe ënjtja skrotale dukej se ishte më e madhe në inspektim. Pas kësaj, me dyshimin për orkitin e shkaktuar nga Brucella, u kryen testet për brucelozë spot dhe Wright agglutination dhe secili prej tyre u zbulua të jetë pozitiv (ky i fundit në një titer prej 1 / 640), ASHB - pozitiv. Midis kulturave të mëparshme të cilat u morën gjatë periudhës së pranimit, bakteret në morfologjinë Brucella u izoluan nga kultura e gjakut, por kultura e urinës ishte sterile. Duke u mbështetur në këto gjetje klinike pacienti u diagnostikua si Brucella orchitis dhe trajtohet me Tab Doxyciclin në 100 mg P. O. qdo 12 h - - 6 javë dhe Rifampin. Në literaturë, incidenca e epididymoorchitis për Brucellosis në Turqi u vu re midis 2 - 12. 7%7 - 9. Rastet e brucelozës njerëzore në disa vende të Mesdheut janë të larta, si Greqia dhe Spanja ku incidenca e vërtetë për Brucella epididymo - orchitis është menduar të jetë përkatësisht 12% dhe 2 - 20%. Te ky rast kemi aspermi dhe azoospermia te dokumentuar me spermogramë. Si përfundim, Brucella epididymo - orchitis duhet mbajtur në mendje për etiologjinë e epididymo - orchitis rezistente ndaj qasjes standarde terapeutike veçanërisht në vendin tonë ku Bruceloza është endemike në disa rajone.

Fjalë kyçe: bruceloza, epididymo - orchitis, infeksionet gjenitale, epididymo - orchitis, infeksionet gjenitale.

EPIDEMIOLOGJIA E FIBROSËS CISTIKE: NJË PËRVOJË 10 - VJEÇARE RETROSPEKSIVE NË NJË QENDËR TË VETME.

Hamide Shllaku - Sefa[1], Ndok Marku[1]
[1]*Departamenti i Laboratorit, Spitali Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Tiranë, Shqipëri*

Abstrakt
Hyrje: Fibroza cistike (FC) është një çrregullim autosomal recesiv dhe shumica e bartësve të gjenit janë asimptomatikë. Është një sëmundje e funksionit të gjëndrave ekzokrine që përfshin sisteme të shumëfishta organesh, por kryesisht rezulton në infeksione kronike të traktit respirator, pamjaftueshmëri të enzimave pankreatike dhe shoqërohet me ndërlikime të shumta tek pacientët e patrajtuar. Diagnoza e FC bazohet në manifestimet tipike pulmonare, manifestimet e traktit gastro - intestinal, historinë familjare dhe rezultatet pozitive të testit të djersës.
Materiale dhe Metoda: Ne kryem një studim epidemiologjik retrospektiv duke përfshirë 567 pacientë që kishin kryer testin e djersës në laboratorin e tonë nga maji 2015 deri në maj 2025. Ne përdorëm Sweat - Chek Analyzer Model 3120 Macroduct nga Eli Tech Group. Analiza statistikore u krye duke përdorur versionin 2. 3. 28 të programit statistikor Jamovi.
Rezultate: Në studim u përfshinë 265 femra (47%) dhe 302 meshkuj (53%), mosha mesatare 36. 3 muaj (1 muaj deri në 39 vjeç). Simptomat respiratore mbizotëruan me 57. 3%, të ndjekura nga simptoma të traktit gastrointestinal me 14. 1%, 12. 3% ishin individë të shëndetshëm në momentin e testimit, 6. 2% e fëmijëve nuk shtonin në peshë, 2. 3% kishin histori familjare, 2% kishin test pozitiv të tripsinogjenit imunoreaktiv (IRT), 1. 6% kishin mutacione të konfirmuara në gjenin CFTR dhe 4. 2% kishin manifestime të tjera. Rezultate normale të testit të djersës u morën në 83. 4% të pacientëve, të dyshimta në 3% të pacientëve dhe rezultate pozitive në 11. 3% të pacientëve. Në 2. 3% të rasteve, patëm një rezultat "sasi jo të mjaftueshme" (QNS).
Përfundime: Fibroza cistike është një sëmundje multi - sistemike me shumë ndërlikime dhe me një prevalencë të lartë në popullatën shqiptare, prandaj implementimi i depistimit neonatal për FC dhe testi i djersës do të jenë shumë të dobishëm, pasi prognoza e pacientëve mund të përmirësohen përmes diagnozës së hershme.

Fjalë kyçe: fibrozë cistike, djersë, IRT, QNS.

BIOMARKERËT BIOKIMIKË NË ZBULIMIN E HERSHËM TË SËMUNDJEVE.

Dr. Hana Devolli

Abstrakt
Hyrje: Biomarkerët biokimikë janë tregues të matshëm që pasqyrojnë procese biologjike normale ose patologjike në organizëm dhe luajnë rol të rëndësishëm në diagnostikimin e hershëm të sëmundjeve. Këta përfshijnë proteina, enzima, hormone, acide nukleike dhe metabolitë që reflektojnë ndryshime të ndjeshme në nivel qelizor dhe molekular. Zhvillimet në bioteknologji dhe biokimi kanë bërë të mundur identifikimin e biomarkerëve specifikë për sëmundje të ndryshme si ato kardiovaskulare, neoplazike, inflamatore dhe metabolike. Përdorimi i biomarkerëve në fazat e hershme të sëmundjeve ndihmon në parandalim, trajtim më efektiv dhe personalizim të kujdesit shëndetësor.
Qëllimi: Ky studim synon të analizojë rëndësinë e biomarkerëve biokimikë në zbulimin e hershëm të sëmundjeve përmes shqyrtimit të literaturës më të fundit shkencore. Qëllimi kryesor është të identifikohen grupet kryesore të biomarkerëve të përdorur në mjekësinë bashkëkohore, të vlerësohet ndjeshmëria dhe specifikueshmëria e tyre diagnostikuese, si dhe të diskutohet roli i tyre në përmirësimin e rezultateve klinike dhe parashikimin e ecurisë së sëmundjeve.
Materiale dhe metoda: Punimi bazohet në një rishikim sistematik të literaturës së publikuar gjatë viteve të fundit në bazat e të dhënave shkencore si PubMed, ScienceDirect, Google Scholar dhe WHO Data Repository. Janë analizuar artikuj që trajtojnë përdorimin klinik të biomarkerëve në diagnostikën laboratorike, me fokus në sëmundjet kardiovaskulare, kanceret dhe patologjitë metabolike. Përzgjedhja e burimeve është bërë sipas relevancës, besueshmërisë dhe rëndësisë klinike të të dhënave.
Rezultate: Analiza e literaturës tregon se biomarkerët si troponina kardiake, proteinat C - reaktive (CRP), prostata specifike antigen (PSA) dhe hemoglobina e glukoziluar (HbA1c) kanë luajtur rol të rëndësishëm në diagnostikimin e hershëm dhe monitorimin e progresit të sëmundjeve. Zbulimi i hershëm përmes këtyre treguesve biokimikë ka ndihmuar në uljen e mortalitetit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientëve. Po

ashtu, biomarkerët molekularë dhe gjenetikë po fitojnë gjithnjë e më shumë rëndësi në identifikimin e predispozitave për sëmundje kronike. Megjithatë, kërkohet standardizim më i madh në interpretimin e rezultateve dhe zhvillim i mëtejshëm i teknologjive analitike për të rritur saktësinë diagnostikuese.

Fjalë kyçe: biomarkerë biokimikë, diagnostikim i hershëm, biokimi mjekësore, parandalim, analiza laboratorike.

MARRAMENDJA CERVIKOGJENIKE DHE NDIKIMI I NDËRHYRJEVE FIZIOTERAPEUTIKE NË PËRMIRËSIMIN E SAJ.

MSc. Hanke Çuni

Abstrakt

Hyrje: Marramendja cervikogjenike përfaqëson një entitet klinik kompleks, i cili rezulton nga disfunksionet biomekanike dhe neurofiziologjike të regjionit cervikal, duke shkaktuar çrregullime të ekuilibrit dhe perceptimit hapësinor. Megjithëse etiologjia e saj mbetet multifaktoriale, evidencat e fundit sugjerojnë një lidhje të ngushtë midis sinjaleve proprioceptive të alteruara nga segmentet cervikale dhe sistemeve vestibulare e vizuale.

Qëllimi: i këtij studimi është të vlerësojë efektivitetin e ndërhyrjeve fizioterapeutike në reduktimin e simptomave të marramendjes cervikogjenike dhe përmirësimin e funksionit cervikal. Është marrë në studim një pacient me marramendje cervikogjenike, i cili iu nënshtrua një programi terapeutik të strukturuar që përfshinte ushtrime të kontrollit neuromuskular, terapi manuale, mobilizime artikulare dhe trajnime proprioceptive. Gjithashtu, janë marrë në shqyrtim dhe artikuj të ndryshëm shkencorë. Rezultatet paraprake treguan një reduktim të ndjeshëm të intensitetit të marramendjes, përmirësim të ekuilibrit statik e dinamik, si dhe rritje të lëvizshmërisë cervikale. Këto të dhëna mbështesin rolin e fizioterapisë si komponent thelbësor në trajtimin multidisiplinar të marramendjes cervikogjenike dhe nënvizojnë nevojën për studime të mëtejshme me dizajn longitudinal për të vlerësuar qëndrueshmërinë e efekteve terapeutike.

Fjalë kyçe: marramendje cervikogjenike, fizioterapi, kontroll neuromuskular, proprioceptivitet, terapi manual.

KRAHASIMI I PËRDORIMIT TË DEXMETOMIDINËS E MORFINËS SI SHTESË ME BUPIVACAINËS INTRATEKAL NË OPERACIONET UROLOGJIKE.

Prof. Asoc. Haxhire Gani, Greta Gani, Prof. Asoc. Majlinda Naço, Prof. Krenar Lilaj, Xhoana Derraj, Ejona Sheshi.
QSU "Nënë Tereza", Tiranë.

Abstrakt

Hyrje: Anestezia spinale zë numrin më të madh të anestezive në urologji, për vetë llojet e operacioneve që bëhen. Anestezia spinale vetëm me Sol. Bupivacaine 0. 5%, jo vetëm që mund të jetë e pamjaftueshme në kohëzgjatje, dhe mund të lindë nevoja e shtimit edhe të anestezisë gjenerale, por gjithashtu të sëmurët kanë edhe shumë nevojë për analgjezi postoperatore. Kjo ka bërë që pothuajse gjithmonë të shtojmë medikamente të tjera krahas Bupivacainës në spinale. Deksmedetomidina është një agonist shumë selektiv i α2 AR që zotëron veti qetësuese, analgjezike dhe simpatikolitike dhe jep analgjezi të zgjatur kur përdoret intratekalisht pa depresion të frymëmarrjes. Morfinë jep analgjezi shumë të mirë postoperatore, por jep shumë të vjella dhe të kruara.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të krahasojë efektin e Dexmetomidinës me Morfinën si shtesë me Bupivacainën intratekal në operacionet urologjike.

Materiali dhe metoda: Në studim janë përfshirë 160 të sëmurë, të rritur, të operuar në urologji me anestezi spinale. Pacientët janë ndarë në dy grupe me nga 80 të sëmurë secili, ku njëri grup mori Dexmetomidinë me Bupivacaine (G. DX), e grupi tjetër mori Morfinë me Bupivacaine (G. M). Të dy grupet morën sol. Bupivacaine 0. 5% - 3ml, 15mg, dhe shtesat respektive ishin për G. DX 5 μg dhe G. M, 70 μg. U analizua si efekti anestetik, ai analgjezik postoperatore, si edhe efektet anësore. Të dy grupet nuk patën diferenca si përsa i përket moshës, komorbiditetit preoperator ashtu edhe llojit të ndërhyrjes. U përdor testi Fisher ekzakt.

Rezultate: Në G. DX, 2 prej pacientëve filloi efekti i anestezisë me vonesë. Të dridhura patën vetëm 3 të sëmurë, dhe ishin të lehta. Asnjë i sëmurë nuk bëri hipotension apo bradikardi të rëndë. Të sëmurët ishin të qetë e pa

depresion respirator. Postoperatore 1 i sëmurë pati nevojë për analgjezi postoperatore në 16 orët e para. Asnjë i sëmurë nuk pati nauze e të vjella e të kruara. Në G. M – anestezi shumë e mirë. Të dridhura patën 17 të sëmurë. Hipotension e bradikardi grave asnjë i sëmurë, gjithashtu as depresion respirator asnjë i sëmurë. Postoperatore asnjë i sëmurë s'pati nevojë për analgjezi në 16 - 20 orët e para pas ndërhyrjes. Të kruarat u hasën në 32 të sëmurë, ndërsa nauze në 33 prej tyre e të vjella në 28 të sëmurë.
Konkluzione: Përdorimi i Dexmetomidinës si shtesë krahas Bupivacainës në anestezi spinale rezulton të jetë me efektivitet të njëjtë anestetik e analgjezik postoperatore me Morfinën, por me më pak efekte anësore, kryesisht ato postoperatore si të nauze / të vjella ($p<0.05$) e të kruarat ($p<0.05$).

Fjalë kyçe: dexmetomidina, morfina, operacionet urologjike.

PËRDORIMI I TOURNIQUET NË HEMORAGJINË MASIVE JETËKËRCËNUESE DHE TEKNIKAT E TJERA TË NDALIMIT TË HEMORAGJISË NË AMBIENTET PARASPITALORE.

Haxhire Kurti
Universiteti Katolik Zoja e Këshillit të Mirë

Abstrakt
Hyrje: Tourniqueti është një pajisje shtrënguese ose ngjeshëse që përdoret për të kontrolluar qarkullimin venoz dhe arterial në një ekstremitet për një periudhë kohore. Presioni aplikohet në mënyrë rrethore mbi lëkurën dhe indet e poshtme të një gjymtyre dhe ky presion mbartet në muret e enëve, duke i bërë ato të mbyllen përkohësisht. Përdorimi më i hershëm i njohur i një tourniquet daton në vitin 199 para Krishtit. Është përdorur nga romakët për të kontrolluar gjakderdhjen, veçanërisht gjatë amputimeve. Në vitin 1718, kirurgu francez Jëan Louis Pëtit zhvilloi një pajisje vidë për mbylljen e rrjedhjes së gjakut për sallat kirurgjikale. Ai e quajti këtë pajisje sipas foljes franceze tourner (tourner), "tourniquet" siç njihet zakonisht dhe sot.
Klasifikimi dhe përdorimi: Për sa i përket klasifikimit të turniquetëve ato ndahen në turniquetë kirurgjikalë dhe ato të urgjencës. Turniquetët kirurgjikalë përdoren shpesh në kirurgjinë ortopedike ndërsa turniquetat e urgjencës janë të kufizuara në situata urgjente. Tourniquetët janë një mjet efektiv për ndalimin e hemorragjisë së jashtme kërcënuese për jetën nga dëmtimi i gjymtyrëve. Përdorimi i tyre nuk ka qënë më parë praktikë e pranuar për kujdesin para - spitalor të traumave civile për shkak të shqetësimeve të rëndësishme në lidhje me ndërlikimet e mundshme. Turniquetët e urgjencës përgjithësisht përdoren si mjeti i fundit, veçanërisht në aplikimet civile, sepse i gjithë qarkullimi i gjakut nën aplikimin e një turniquet urgjent ndalon dhe më pas mund të vrasë indin, duke çuar në humbjen përfundimtare të gjymtyrëve nën aplikim. Turniquetët konsiderohen një mjet efektiv sepse në disa situata të rralla aplikimi i turniquet është i nevojshëm dhe shpëtimtar. Ky është një rishikim që eksploron problemet e mundshme dhe mosbesimin e përdorimit të turniquetëve; shpjegon arsyet pse mund të jetë i nevojshëm përdorimi i turniquetit civil para - spitalor, përcakton indikacionet e qarta për përdorimin e tourniquet në kontrollin e hemorragjisë së jashtme dhe ofron informacion praktik mbi aplikimin dhe heqjen e turniquet.
Praktikuesit të cilët mund të jenë mjek, civilë të trajnuar duhet të familjarizohen me turniquet komercialë para - spitalorë dhe të jenë të përgatitur të përdorin një të tillë pa frikë joracionale nga komplikimet në rastet e duhura.
Rezultate: Në situata të rralla, aplikimi i tourniquteve do të jetë i nevojshëm dhë jetëshpëtues në mjedisin civil paraspitalor. Tourniquetet nuk konsiderohen më vetëm si një pajisjë "zgjidhjes së fundit". Praktikuesit duhet të familjarizohen me këtë pjesë të thjeshtë të pajisjes dhe të jënë të përgatitur ta përdorin atë në rastet e duhura pa një frikë irracionale nga komplikimet.

Fjalë kyçe: tourniquet, qarkullim venoz, arterie etj.

LIDERSHIPI TRANSFORMUES SI KATALIZATOR PËR MENAXHIMIN E NJOHURIVE NË KUJDESIN SHËNDETËSOR PARËSOR: NJË ANALIZË PËRSHKRUESE NË QENDRËN KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE (QKMF), PRIZREN, KOSOVË.

Dr. Hedon Hoxha
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), Prizren, Kosovë

Abstrakt

Hyrje: Menaxhimi i njohurive (KM) përbën një kapacitet strategjik të domosdoshëm për institucionet shëndetësore moderne, duke ndikuar në cilësinë e shërbimeve, sigurinë e pacientëve dhe inovacionin organizativ. Udhëheqja është faktori kyç që përcakton vizionin, kulturën dhe shpërndarjen e resurseve. Në sektorin e kujdesit parësor në Kosovë, ku burimet janë të kufizuara dhe infrastruktura digjitale ende e pazhvilluar, aftësia drejtuese bëhet vendimtare për krijimin dhe transferimin e njohurive.

Qëllimi: Ky studim synon të shqyrtojë rolin e udhëheqjes transformuese dhe të shpërndarë në avancimin e praktikave të KM në QKMF Prizren, duke identifikuar faktorët lehtësues, pengesat dhe strategjitë praktike për integrimin e KM në qeverisjen e kujdesit shëndetësor parësor.

Metodologjia: Është përdorur një studim deskriptiv–analitik, duke kombinuar një rishikim narrativ të literaturës ndërkombëtare (PubMed, Scopus, Google Scholar, WHO, deri në qershor 2025) me një analizë institucionale të QKMF Prizren. Janë shqyrtuar strukturat udhëheqëse, proceset e dokumentimit dhe ndarjes së informacionit, mekanizmat e edukimit të vazhdueshëm dhe kapaciteti digjital.

Rezultate: Evidenca ndërkombëtare dhe vëzhgimet institucionale tregojnë se udhëheqja transformuese dhe e shpërndarë, krijimi i roleve formale për KM, investimet në depo digjitale dhe ndërtimi i komuniteteve profesionale praktike (CoPs) nxisin rrjedhën e njohurive dhe standardizimin klinik. Në të kundërt, mungesa e një politike të KM, kapaciteti i kufizuar IT, ngarkesa e lartë klinike dhe boshllëqet në trajnimin menaxherial përbëjnë pengesa kryesore.

Përfundime: Rezultatet sugjerojnë se edhe ndërhyrjet me kosto të ulët—si miratimi i një politike të shkurtër për KM, caktimi i një pikë - fokusi, krijimi i arkivave të përbashkëta online dhe organizimi i trajnimeve të menaxhimit - mund të sjellin përmirësime të dukshme në cilësinë e shërbimeve. Udhëheqja që e integron KM në qeverisje, monitorim dhe zhvillim profesional transformon institucionet nga ofrues shërbimesh në organizata mësuese, të afta për të përthithur përvojë dhe për ta kthyer atë në performancë të qëndrueshme.

Fjalë kyçe: Menaxhimi i njohurive, udhëheqje transformuese, kujdesi parësor shëndetësor, Kosovë, QKMF Prizren, mësim organizativ, qeverisje shëndetësore.

QENDRA E GJIRIT NË STRUKTURËN ONKOLOGJIKE.

Prof Dr Helidon Nina
Drejtor Mjekësor, PAI Spitali Onkologjik.

Abstrakt

Hyrje: Epidemiologjike e kancerit të gjirit në Shqipëri është shumë e ngjashme me mesataren e popullatës së botës. Ashtu si në nivel global, edhe në Shqipëri, kanceri i gjirit përbën më shumë se 11% të të gjitha rasteve të reja me kancer të diagnostikuara çdo vit, ndërkohë që vlerësohet se rreth një e katërta e të gjitha grave në popullatë që jetojnë me një neoplazi malinje, kanë kancer gjiri. Në vitin 2023, u diagnostikuan 744 femra me kancer të gjirit në të gjithë vendin ose 61. 4 për 100, 000 femra. Tani është vërtetuar se qasja terapeutike ndaj pacientëve me kancer të gjirit duhet të zhvillohet brenda ambienteve të përshtatshme, të përfaqësuara nga Qendrat e Gjirit, ose "Njësitë e Gjirit", domethënë, "njësi multidisiplinare me volum të lartë ku diagnostikohet dhe trajtohet kanceri i gjirit. Kujdesi për pacientin brenda një Njësie të Gjirit ofron përparësi të shumta: nga njëra anë, i ofron pacientit një ekip profesionistësh të përkushtuar ndaj sëmundjes, ekspertë në fushë dhe të mësuar të punojnë si ekip përmes trajnimit profesional. Nga ana tjetër, optimizon menaxhimin e shërbimeve të ofruara nga profesionistët individualë, duke zvogëluar kohën e pritjes dhe duke arritur një përdorim më të mirë të burimeve të disponueshme. E gjithë kjo përkthehet në një përmirësim të cilësisë së jetës dhe madje edhe në një rritje të shkallave të mbijetesës. Në të vërtetë, pacientët e trajtuar brenda Qendrës arrijnë një rritje të shkallave të mbijetesës që, në disa raste, mund të arrijnë deri në 18%, siç theksohet nga disa studime në literaturë. Në nivel evropian, kërkesat e para të EUSOMA - s për qendrat e kujdesit për gjirin u botuan në vitin 2000 (të

përditësuara më pas në vitin 2013), ndërsa në Itali vetëm në vitin 2014 u lëshua një dokument që sanksionoi krijimin e Qendrave të Kujdesit për Gjirin.
Konkluzion: Prania e këtyre qendrave në strukturat onkologjike kombëtare, I jep një ngritje cilësore trajtimit multidisiplinar të pacientëve me patologji malinje të gjirit.

Fjalë kyçe*:* gjiri, kancer, qendër.

PËRDORIMI I LEMBOS PERFORATORE TENSOR FASCIA LATAE (TFL) NË REKONSTRUKSIONIN E DECUBITUSIT TROCHANTERIC.
Dr. Drinjak HJ; Prof. Asoc. Isaraj S. ; Dr. Geci Xh.

Abstrakt
Hyrje: Dekubituset (ulçera presive) trokanterike paraqesin sfida të konsiderueshme në kirurgjinë rekonstruktive për shkak të vendndodhjes, kroniçitetit dhe komorbiditeteve të lidhura. Ky raportim rasti përshkruan përdorimin e suksesshëm të një flap perforator të tensor fascia latae (TFL) për rekonstruktimin e një dekubitusi trokanterik te një pacient me paraplegji dhe histori kroniciteti.
Metodologji: Flapi TFL u zgjodh për furnizimin e tij të besueshëm vaskular, aftësinë për të ofruar mbulim të fortë të indeve të buta duke ruajtur funksionin muskulor. EKO Doppler para operacionit identifikoi një perforator dominant nga dega ascendente e arteries cirkumfleks femurale laterale, duke udhëzuar dizajnin e flapit. Procedura përfshiu debridimin e ulçerës, ngritjen e flapit dhe mbylljen primare të vendit donator.
Rezultate: Rezultatet pas operacionit treguan mbijetesë të plotë të flapit, mungesë të rikthimit të ulçerës në ndjekjen 6 - mujore dhe përmirësim të cilësisë së jetës së pacientit.
Përfundime: Flapi perforator TFL përfaqëson një opsion të qëndrueshëm për rekonstruktimin e dekubitusit trokanterik, duke ofruar morbiditet minimal të vendit donator dhe mbulim efektiv të plagës në raste komplekse.

Fjalë kyçe*:* lembo, flap, TFL etj.

DIVERTIKULI I PERFORUAR I KOLONIT, VARIACIONI SEZONAL – STUDIM VËZHGUES NJËVJEÇAR NË KLINIKËN KIRURGJIKALE TË QSUT.
Dr. Henry Beqiri[1], Dr. Fjoralba Mulgeci[1], Dr. Irisi Xure[1], Dr. Kejdi Domi[1], Dr. Enea Çuni[1], Dr. Devi Belalla[1], Prof. Asc. Dariel Thereska[1]
[1] Klinika e Tretë e Kirurgjisë dhe Traktit Digjestiv, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Divertikuli i perforuar i kolonit është një urgjencë kirurgjikale akute dhe një ndërlikim i rëndë i sëmundjes divertikulare, i karakterizuar nga çarja e divertikulave të inflamuara, shpesh me pasojë peritonitin. Ai ka morbiditet të lartë dhe kërkon ndërhyrje të menjëhershme kirurgjikale. Ndërsa incidenca e përgjithshme e divertikulitit është mirë e dokumentuar, faktorët që ndikojnë në progresin e tij deri në perforim mbeten objekt studimi. Është sugjeruar se ndryshimi sezonal mund të ketë ndikim, me muajt e ngrohtë që mund të ndikojnë në ecurinë e sëmundjes përmes mekanizmave mjedisorë dhe sjellorë.
Qëllimi: Të vlerësohet variacioni sezonal në incidencën e divertikulitit kolonik të perforuar të trajtuar kirurgjikisht gjatë një periudhe njëvjeçare në Klinikën Kirurgjikale të QSUT.
Metodologjia: U krye një rishikim retrospektiv i të gjithë pacientëve që iu nënshtruan ndërhyrjes kirurgjikale për divertikul të perforuar të kolonit gjatë një viti. Rastet u grupuan sipas stinës: - Dimër (Dhjetor, Janar, Shkurt) - Verë (Qershor, Korrik, Gusht).
Në analizë u përfshinë vetëm rastet me perforim të konfirmuar intraoperator.
Rezultatet: Gjatë periudhës së studimit u operuan gjithsej 11 pacientë për divertikul të perforuar të kolonit. Nga këto, 2 raste ndodhën në dimër, ndërsa 9 raste u paraqitën gjatë muajve të verës. Kjo përfaqëson një rritje më shumë se katërfish gjatë stinës së verës.
Përfundimi: Ky vëzhgim njëvjeçar tregon një model të qartë sezonal në incidencën e divertikulitit të perforuar, me një numër dukshëm më të madh rastesh gjatë verës. Këto gjetje përputhen me literaturën ekzistuese që

sugjeron se faktorë si dehidratimi, ndryshimet dietike dhe vonesa në kërkimin e ndihmës mjekësore gjatë pushimeve mund të kontribuojnë në rritjen e riskut gjatë muajve të ngrohtë. Njohja e këtyre tendencave mund të ndihmojë në përmirësimin e vigjilencës klinike, përgatitjes spitalore dhe në zhvillimin e strategjive parandaluese gjatë periudhave me risk të lartë.

Fjalë kyçe: divertikul i perforuar, variacion sezonal, perforacion i kolonit, urgjencë kirurgjikale, sëmundje divertikulare, incidencë verore.

OPTIMIZIMI I VLERËSIMIT TË APNESË SË GJUMIT NË PRAKTIKËN ORL: PËRDORIMI I PYETËSORËVE KLINIKË PËR ZBULIM TË HERSHËM, PROFILIZIM TË PACIENTËVE DHE VENDIMMARRJE PAS POLISOMNOGRAFISË.

Dr. Holta Sulaj[1], Dr. Majlinda Cani[2]
[1]Mjeke ORL, Spitali HYGEIA, Tiranë
[2]Mjeke ORL, Qendra Diagnostike Orthodokse, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Apnea obstruktive e gjumit (OSA) shpesh mbetet e padiagnostikuar, sidomos në shërbimet ORL ku simptomat janë të fshehura ose jo specifike. Integrimi i pyetësorëve të strukturuar në vlerësimin rutinë ORL mund të përmirësojë ndjeshëm zbulimin e hershëm, saktësinë diagnostike dhe udhëheqjen e trajtimit pas polisomnografisë (PSG).
Objektivi: Të vlerësohet roli i pyetësorëve multidimensionalë të gjumit në praktikën ORL, si në zbulimin e hershëm të OSA, ashtu edhe në ndërtimin e profilit klinik të pacientit dhe planifikimin e trajtimit të personalizuar bazuar në gjetjet e PSG.
Materiale dhe Metoda: U përdor një protokoll i strukturuar me pyetësorë, duke përfshirë: të dhëna të stilit të jetesës, histori mjekësore, inventari i simptomave, instrumente të validuara dhe gjetje të ekzaminimit ORL.
Rezultate: Pyetësorët ndihmuan në dokumentimin e saktë të simptomave, vlerësimin e rrezikut dhe interpretimin e PSG - së. Në rastet pediatrike, OSA - 18 ndihmoi në vlerësimin e ndikimit në cilësinë e jetës dhe në vendimmarrjen kirurgjikale (p. sh. adenotonsilektomi).
Përfundime: Përdorimi i pyetësorëve të detajuar në praktikën ORL përmirëson ndjeshëm vlerësimin klinik, ndihmon në zbulimin e hershëm të OSA dhe udhëheq trajtimin e personalizuar. Integrimi rutinë i këtyre mjeteve duhet të inkurajohet si pjesë e kujdesit standard për të rritur dhe fëmijë.

Fjalë kyçe: Apnea obstruktive e gjumit, PSG, protokoll, pyetësorë.

VLERËSIMI I ÇRREGULLIMEVE TË FRYMËMARRJES GJATË GJUMIT: PËRVOJA 8 - VJEÇARE ME 205 STUDIME GJUMI DHE ROLI I ORL NË MJEKËSINË MULTIDISIPLINARE TË GJUMIT.

Dr. Holta Sulaj[1], Dr. Adrien Xhuvani[2]
[1] Shërbimi ORL, Spitali HYGEIA, Tiranë
[2] Departamenti ORL, Paris, Francë

Abstrakt
Sfondi: Apnea obstruktive e gjumit (OSA) dhe çrregullimet e tjera të frymëmarrjes gjatë gjumit (SDB) përbëjnë një problem në rritje për shëndetin publik. Këto çrregullime kanë ndikime të rëndësishme në sistemin kardiovaskular, neurologjik dhe metabolik. Mjekët ORL luajnë një rol të rëndësishëm në identifikimin e faktorëve anatomikë dhe përzgjedhjen e pacientëve për trajtim të personalizuar.
Objektivi: Të paraqitet një analizë retrospektive 8 - vjeçare mbi 205 pacientë të vlerësuar për çrregullime të gjumit me poligrafi dhe polisomnografi, duke theksuar lidhjen me BMI, vendimmarrjen terapeutike dhe rolin e bashkëpunimit multidisiplinor.
Metodologjia: 72 pacientë u vlerësuan me poligrafi të avancuar në kushte shtëpie, ndërsa 133 pacientë me polisomnografi të plotë në laborator (me pajisje Cidelec). Vlerësimi ORL përfshinte historikun klinik,

endoskopinë nazale fleksibël dhe pyetësorët STOP - BANG, Epworth dhe PSQ. Indeksi i masës trupore (BMI) u kategorizua sipas standardeve të OBSH. Vendimmarrja për trajtim u bë në bashkëpunim me pneumologë, neurologë, ortodontë dhe kardiologë.
Rezultate: Shumica e pacientëve ishin mbipeshë ose obezë, me rritje të ashpërsisë së OSA në varësi të BMI. Poligrafia rezultoi e mjaftueshme për shumë raste të thjeshta të OSA, veçanërisht në fëmijë. Polisomnografia ishte e domosdoshme në rastet e ndërlikuara (REM, çrregullime lëvizjeje, apnea qendrore). Trajtimet përfshinë CPAP, ndërhyrje kirurgjikale ORL, pajisje mandibulare dhe terapi pozicionale. Vlerësimi paraoperativ i strukturuar nga ORL përmirësoi përzgjedhjen e pacientëve për kirurgji.
Përfundime: Specialistët ORL janë të pozicionuar në mënyrë optimale për të udhëhequr procesin diagnostik dhe trajtimin e personalizuar të çrregullimeve të gjumit. Zgjedhja e metodës diagnostike duhet të udhëhiqet nga kompleksiteti i rastit. Bashkëpunimi multidisiplinor është thelbësor për rezultate optimale klinike.

Fjalë kyçe: Apnea obstruktive e gjumit, SDB, bashkëpunimi multidisiplinor.

PËRDORIMI KLINIK I CALCIUM SCORE NË STENOZËN E AORTËS SIPAS UDHËRRËFYESVE TË RINJ 2025.

Dr. Shk. H. Gjergo, Dr. E. Shirka, Dr. A. Gjika, Prof. Dr. A. Dibra
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza".

Abstrakt
Hyrje: Stenoza e aortës (AS) është sëmundja më e shpeshtë valvulare në vendet e zhvilluara, e cila shoqërohet me morbiditet dhe mortalitet të lartë nëse nuk trajtohet. Udhërrëfyesit e rinj ESC / EACTS 2025 theksojnë ndërhyrjen sa më herët përgjatë ecurisë së sëmundjes dhe integrimin e imazherisë së avancuar nëpërmjet skanerit të aortës për stratifikimin e rrezikut. Matja e kalçifikimit të valvulës së aortës nëpërmjet skanerit pa kontrast është bërë një mjet i rëndësishëm, duke ofruar një vlerësim objektiv dhe të pavarur nga parametrat hemodinamikë. Përcaktimi i ngarkesës kalçike në valvulën e aortës është veçanërisht i dobishëm tek pacientët me të dhëna ekokardiografike të paqarta ose në kufi, përfshirë stenozën e aortës (AS) low flow - low gradient ose formën paradoksale. Vlerat cut - off sipas gjinisë për stenozën e aortës severe janë mbi 2000 njësi Agatston (AU) tek meshkujt dhe mbi 1250 AU tek femrat. Përtej konfirmimit të severitetit, ngarkesa kalçike përcakton dhe progresionin e sëmundjes dhe ecurinë klinike, duke ndihmuar në përcaktimin e kohës së ndërhyrjes dhe planifikimin e ndjekjes. Ky artikull thekson rolin dhe rëndësinë klinike të matjes së kalçifikimit të valvulës së aortës me CT në trajtimin adekuat dhe bashkëkohor të stenozës së aortës si dhe trajtimin individual të pacientëve duke u mbështetur në rekomandimet më të fundit të udhërrëfyesve mbi sëmundjet valvulare.

Fjalë kyçe: lembo, flap, TFL etj.

DISFUNKSIONI MITOKONDRIAL DHE ROLI I MENAXHIMIT NUTRICIONAL NË PATOLOGJITË ENDOKRINE: FOKUS NË PCOS DHE SINDROMËN METABOLIKE.

PhDc. Hyrida Basha
Dietologe Klinike, Biologe Molekulare, Kandidate e Doktoraturës në Università degli Studi di Roma "La Sapienza", në programin Translational Medicine and Oncology.

Abstrakt
Hyrje: Disfunksioni mitokondrial njihet si mekanizëm qendror në sëmundjet neurodegjenerative dhe onkologjike, por në patologjitë endokrine ky rol mbetet i nënvlerësuar. Evidencat e fundit tregojnë se tek PCOS (sindroma e vezoreve policistike) dhe sindroma metabolike, dëmtimi mitokondrial është hallkë e përbashkët që lidh rezistencën ndaj insulinës, inflamacionin kronik dhe çrregullimet hormonale.
Qëllimi: Ky studim synon të paraqesë një qasje translacionale që lidh funksionin mitokondrial me menaxhimin nutricional në këto patologji. Rëndësia praktike dhe akademike e studimit qëndron në faktin se ai adreson këtë mekanizëm të anashkaluar, duke evidentuar disfunksionin mitokondrial si objektiv të ri terapeutik dhe duke hapur rrugën për strategji inovative trajtimi që ndërthurin endokrinologjinë me dietologjinë klinike.

Medodologjia: Për këtë qëllim, u krye një rishikim gjithëpërfshirës i literaturës (2019–2024), duke analizuar studimet klinike dhe molekulare mbi rolin e mitokondrive dhe ndërhyrjet nutricionale në PCOS dhe sindromën metabolike.
Rezultate: Analiza tregon se tek PCOS vërehet rritje e prodhimit të ROS, dëmtim i ADN - së mitokondriale dhe ulje e shprehjes së faktorëve kryesorë të biogjenezës mitokondriale (p. sh. PGC - 1α, AMPK). Ndërsa në sindromën metabolike, mitokondritë e dëmtuara përkeqësojnë lipotoksicitetin dhe inflamacionin sistemik. Një dietë e pabalancuar, e pasur me yndyrna të ngopura, rrit stresin oksidativ mitokondrial, ndërsa dieta mesdhetare dhe përbërësit bioaktivë (polifenole, omega - 3, koenzimë Q10, magnez, vitaminë D) përmirësojnë bioenergjitikën qelizore dhe ulin inflamacionin. Veçanërisht, një studim klinik i vitit 2024 demonstroi se suplementimi me resveratrol përmirëson biogjenezën mitokondriale dhe ul stresin oksidativ tek gratë me PCOS.
Perfundime: Këto gjetje nënvizojnë se disfunksioni mitokondrial duhet të konsiderohet një objektiv terapeutik kyç në PCOS dhe sindromën metabolike. Bazuar në to, rekomandohet integrimi i menaxhimit nutricional të targetuar, përfshirë terapinë multinutrient, në kujdesin endokrinologjik si një strategji novatore dhe e personalizuar për të përmirësuar rezultatet metabolike - hormonale dhe për të nxitur bashkëpunimin ndërdisiplinor ndërmjet endokrinologëve dhe dietologëve klinikë.

Fjalë kyçe: sindromë metabolike; menaxhim nutricional; disfunksion mitokondrial; terapi multinutrient; PCOS.

LIMFOMA PRIMARE DIFUZE ME QELIZA TË MËDHA B (DLBCL) E CEKUMIT ME POLIPE TË TJERA SHOQËRUESE PËRGJATË KOLONIT. PREZANTIM RASTI.

Hysni Dede[1], Genta Cekodhima[2], Manjola Qordja[3], Rovena Roshi[4], Augusto Orlandi[5]
[1]Spitali Gjerman, Tiranë, Shqipëri
[2]Klinika Mjekësore Gastrohepatologjike "Dr. Nini", Tiranë, Shqipëri
[3]Qendra Mjekësore LA VITA, Tiranë, Shqipëri
[4]Operator i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Tiranë, Shqipëri
[5]Spitali Katolik Zonja e Këshillit të Mirë, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Hyrje: Limfoma primare difuze me qeliza të mëdha B (DLBCL) e cekumit përbën një formë të rrallë të limfomave gastrointestinale, (0. 2 - 1% të sëmundjeve malinje të kolonit) duke përfaqësuar një sfidë diagnostikuese dhe terapeutike për shkak të manifestimeve jo specifike klinike dhe heterogjenitetit morfologjik. Në këtë punim paraqitet një rast i një pacienteje 78 vjeçe me limfomë primare DLBCL të lokalizuar në cekum, në trajtën e një formacioni të madh polipoid nga i cili u morën mostra biopsie për ekzaminim histopatologjik. Në kolonoskopi pacienti paraqiti edhe disa polipe të tjera milimetrike përgjatë trajektit. Fillimisht pacientja paraqiti simptoma jo specifike si dhimbje abdominale dhe ndryshime në tranzitin intestinal, por vetë ekzaminimi i kujdesshëm endoskopik i cekumit, i cili u eksplorua përmes kolonoskopisë dhe imazherisë, zbuloi një masë thuajse obstruktive në cekum. Ekzaminimi histopatologjik i biopsive të marra nga masa cekale evidentoi fillimisht praninë e mukozës së kolonit me qeliza neoplazike, uniforme, rrethore, malinje që infiltrojnë të vecuara, pa konfigurim të ruajtur glandular duke sugjeruar për linfomë. Nga ekzaminimi imunohistokimik u panë fragmente gjerësisht të ulceruara me infiltrim nga elementë qelizorë atipike të përmasave të mëdha me nukleola evidente me fenotip (CD 20 poz, CD3 neg, Citicher AE1 / AE3 negativ, me indekse të larta proliferative (Ki - 67 >30%), duke konfirmuar diagnozën e DLBCL. Kjo paraqitje ngre dyshime mbi rolin e mundshëm të transformimit malinj të polipeve limfoide ose hiperplastike në limfomë agresive, megjithëse lidhja shkak - pasojë mbetet ende e paqartë dhe kërkon studime të mëtejshme.
Rasti në fjalë thekson rëndësinë e vlerësimit të kujdesshëm histopatologjik të çdo formacioni polipoid në traktin gastrointestinal, veçanërisht kur është i shoqëruar me polipe te tjere më të vegjël, si dhe nevojën për një qasje multidisiplinare në menaxhimin e limfomave primare intestinale. Trajtimi përfshiu kimioterapi sistemike me protokollin R - CHOP, me përgjigje pozitive të pjesshme. Ky raport kontribuon në literaturën ekzistuese duke ofruar më shumë të dhëna mbi prezantimin klinik, diagnozën diferenciale dhe trajtimin e kësaj patologjie të rrallë.

Fjalë kyçe: limfoma, cekum, polip etj.

SËMUNDJA WILSON: SHENJAT PARALAJMËRUESE DHE ROLI I DIAGNOSTIKIMIT TË HERSHËM NË PËRMIRËSIMIN E PROGNOZËS.

Dr. Idriz Trolli, Dr. Shqiponjë Morina

Abstrakt

Hyrje: Sëmundja Wilson, ndryshe e njohur si degjenerimi hepatolentilukar, është sëmundje e rrallë që trashëgohet në mënyrë autosomale recesive. Kjo sëmundje shkaktohet nga mutacioni në gjenin ATP7B që është përgjegjës për inkorporimin e bakrit në ceruloplazminë dhe ekskretimin e bakrit të tepërt në bilë për eliminim. Si pasojë e mutacionit, shfaqet grumbullim toksik i bakrit në organizëm, fillimisht në mëlçi pastaj edhe në organe tjera si në tru, korne, etj. Varësisht nga organet e prekura, varion simptomatologjia e cila mund të jetë hepatike, neurologjike, psikiatrike dhe manifestime tjera. Unazat Kayser - Fleischer që formohen nga depozitimi i bakrit në korne, janë karakteristikë e sëmundjes. Triada që nxit dyshimin klinik për këtë sëmundje është: cirroza hepatike, unazat Kayser Fleischer dhe simptomat neurologjike.

Qëllimi i punimit: Punimi synon të theksojë rëndësinë e diagnostikimit të hershëm përmes njohjes së shenjave klinike dhe përdorimit të kritereve të sakta laboratorike dhe imazherike. Përmes analizës së të dhënave nga studime të ndryshme, synohet të ofrohet një pasqyrë praktike mbi opsionet aktuale të trajtimit, efektiviteti i tyre si dhe menaxhimi afatgjatë i sëmundjes.

Metodologjia: Punimi është bazuar në një rishikim të literaturës bashkëkohore të publikuar në databaza shkencore si PubMed, ScienceDirect dhe Google Scholar. Janë analizuar studime që raportojnë të dhëna mbi prezantimin klinik, epidemiologjinë, trajtimin dhe ecurinë e pacientëve me sëmundjen Wilson.

Rezultate: Diagnostikimi shpesh bazohet në sistemin e pikëzimit Leipzig, duke u mbështetur në shenjat klinike, laboratorike dhe imazherike. Studimet tregojnë se diagnostikimi i hershëm përmirëson dukshëm prognozën, ndërsa mungesa e trajtimit çon në insuficiencë hepatike dhe vdekje. Mosha mediane e diagnostikimit është 10 - 20 vjeç, por mund të paraqitet që nga mosha 3 deri 70 vjeç. Prevalenca e kësaj sëmundje në Evropë është 1: 40, 000 - 1: 60, 000, ku si zonë dominante është Sardinia me prevalencë 1: 16, 000 ndërsa prevalenca më e lartë në botë raportohet në Costa Rica (4. 9: 100, 000 banorë). Menaxhimi është afatgjatë dhe konsiston në eliminimin e bakrit të tepërt nga organizmi, ku opsion kryesor i trajtimit në të gjitha vendet mbetet D - penicilamina (88. 8 - 94. 2% e rasteve), ndërsa të tjera opsione përfshijnë: trientina, zinku, transplanti i mëlçisë në rastet e hepatitit fulminant. Në shumicën e pacientëve janë të pranishme unazat Kayser - Fleischer (42. 8% të rasteve nga studimi në Greqi, 55. 6% të rasteve nga studimi në Brazil, 45. 7% të rasteve nga studimi në Indi), me frekuencë më të lartë të paraqitjes tek pacientët me manifestime neurologjike. Në të gjitha studimet, nivelet e ceruloplazminës në gjak ishin të ulëta në shumicën e pacientëve, ndërsa nivelet e bakrit në urinën 24 orëshe ishin të rritura, të dhëna këto që përforcojnë rëndësinë diagnostike të këtyre metodave. Rastet neurologjike shpesh kishin simptoma persistente edhe pas trajtimit.

Përfundimi: Edhe pse sëmundja Wilson është e rrallë, kjo nuk përjashton mundësinë e pranisë së saj te pacientët; prandaj është e rëndësishme të zgjerojmë njohuritë mbi simptomatologjinë dhe shenjat paralajmëruese, që të mund ta kemi në konsideratë në diagnozën diferenciale sepse diagnoza e hershme përmirëson dukshëm rezultatin e trajtimit dhe prognozën.

Fjalë kyçe: sëmundja Wilson, bakri, ATP7B, unazat Kayser - Fleischer, D - penicilamina.

NJË QASJE EPIDEMIOLOGJIKO - KLINIKE MBI ANOMALITË KARDIAKE KONGENITALE NË BEBET E LINDURA NË SUOGJ "MBRETËRESHA GERALDINË" NË PERIUDHËN 2018 - 2022 DHE RËNDËSIA E MOMENTIT TË DIAGNOSTIKIMIT.

Igesa Jonuzaj
Mjeke Pediatre - Neonatologe

Abstrakt

Qëllimi: Evidentimi i të dhënave epidemiologjike dhe klinike të Anomalive Kardiake Kongenitale në bebet e lindura pranë SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë", në mënyrë që të mund të krijohet një profil më i qartë i karakterit të shfaqjes së sëmundjes në vendin tonë.

Metodologjia: Studimi retrospektiv i pacientëve pediatrike te lindur në SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë", të rekrutuar në Shërbimin e Neonatologjisë dhe Terapisë intensive të bebes, gjatë periudhës 2018 - 2022.

U përfshinë pacientë me diagnozë primare një nga anomalitë kardiake kongenitale (Foramen Ovale, Tetradë Fallot, Defekti Septal Atrioventrikular, Koartacioni i Aortës, Ventrikuli i djathtë me dy dalje, Anomalia Ebstein, Sindroma e zemrës së majtë hypoplastike, Atrezia pulmonare, Atrezia Trikuspidale etj). Pacientët u vlerësuan për të dhënat me karakter administrativ dhe klinik mjekësor. **Përfundime:** Prevalenca e Anomalive Kardiake Kongenitale Komplekse është qartësisht e lartë, krahasuar me anomalitë e tjera kardiake të lindura. Viti 2019, ka patur numrin më të lartë të pacientëve të diagnositkuar me AKK. Numri i bebeve femra që u diagnostikuan me një AKK ka qenë lehtësisht më i lartë në krahasim me bebet meshkuj. Qytetet me numrin më të lartë të pacientëve që vuajnë nga këto sëmundje ishin Tiranë, Lushnje, Durrës. Periudha me numrin më të lartë të AKK ka rezultuar të jetë muaji gusht. Prevalenca e bebeve të lindura në term ishte e dukshme. Mosha amëtare me rastet më të shpeshta të bebeve të lindura me AKK i përket intervalit të vitit të lindjes 1986 - 1995.

Fjalë kyçe: Anomali Kardiake Kongenitale, atrezi, mosha amëtare, term.

PËRTEJ GJENETIKËS: VENDOSJA E DIAGNOZËS SË ADPKD DHE RËNDËSIA E NDJEKJES.
Dr. Ilda Nasufi, Dr. Vilma Çadri

Abstrakt
Hyrje: Diferencimi i ADPKD nga entitet e tjera kistike renale bëhet sfidues kur mungon anamneza familjare dhe testimi gjenetik. Megjithatë, klinika dhe imazheria shpesh janë të mjaftueshme për një diagnozë praktike që udhëheq menaxhimin dhe ndjekjen.
Rasti Klinik: Grua 51 - vjeçare, me 8 vite me sëmundje renale kronike dhe hipertension rezistent**,** u paraqit me simptoma uremike progresive dhe u hospitalizua për fillimin e terapisë renale zëvendësuese**.** Në mars 2023 kishte pësuar AKI të induktuar nga metotreksati me hemodializë të përkohshme. Eko / CT abdominale treguan veshka të mëdha (>18 cm**)** me kiste bilaterale (disa me densitet të rritur) dhe kiste hepatike. Laboratori shfaqi pancitopeni persistente pa dëshmi maligniteti hematologjik; rritje të faktorit reumatoid dhe hipokomplementemi si gjetje jo specifike. Mungesa e historisë familjare ngriti dyshimin për multikistozë renale bilaterale, por përmasat e rritura të veshkave**,** kistet hepatike dhe progresioni i shpejtë drejt dështimit renal favorizuan ADPKD.
Diskutime: Në mungesë të anamnezës familjare dhe testimit gjenetik, diagnoza e ADPKD mbështetet në triadën klinikë–imazheri–evoluim: rritje e volumit renal me kiste të shumta, manifestime ekstra - renale (p. sh. , kiste hepatike) dhe rritje graduale e insuficiencës renale e shoqëruar shpesh me hipertension rezistent. Njohja e hershme lejon planifikim të ndjekjes (kontroll i presionit arterial, vlerësim volumesh renale, screening i komplikimeve, edukim familjar) dhe orienton vendime terapeutike edhe në mjedise pa akses të menjëhershëm në gjenetikë.
Përfundime: Edhe pa histori familjare dhe pa test gjenetik, ADPKD mund të njihet me saktësi kur lexojmë së bashku klinikën dhe imazherinë: veshka të mëdha me kiste të shumta, kiste hepatike dhe hipertension i vështirë. Diagnoza e hershme ndryshon trajektoren: na lejon të strukturojmë ndjekjen (kontroll rigoroz të TA, monitorim të volumit renal, vlerësim të manifestimeve ekstra - renale) dhe të parandalojmë komplikimet duke shmangur nefrotoksikët dhe optimizuar terapinë.

Fjalë kyçe: ADPKD, veshka policistike, kiste hepatike, hipertension rezistent, imazheri, ndjekje, diagnozë pa test gjenetik.

PËRTEJ GJENETIKËS: VENDOSJA E DIAGNOZËS SË ADPKD DHE RËNDËSIA E NDJEKJES.
Dr. Ilda Nasufi, Dr. Vilma Çadri

Abstrakt
Hyrje: Diferencimi i ADPKD nga entitet e tjera kistike renale bëhet sfidues kur mungon anamneza familjare dhe testimi gjenetik. Megjithatë, klinika dhe imazheria shpesh janë të mjaftueshme për një diagnozë praktike që udhëheq menaxhimin dhe ndjekjen.
Rasti Klinik: Grua 51 - vjeçare, me 8 vite me sëmundje renale kronike dhe hipertension rezistent**,** u paraqit me simptoma uremike progresive dhe u hospitalizua për fillimin e terapisë renale zëvendësuese**.** Në mars 2023 kishte pësuar AKI të induktuar nga metotreksati me hemodializë të përkohshme. Eko / CT abdominale treguan veshka

të mëdha (>18 cm**)** me kiste bilaterale (disa me densitet të rritur) dhe kiste hepatike. Laboratori shfaqi pancitopeni persistente pa dëshmi maligniteti hematologjik; rritje të faktorit reumatoid dhe hipokomplementemi si gjetje jo specifike. Mungesa e historisë familjare ngriti dyshimin për multikistozë renale bilaterale, por përmasat e rritura të veshkave**,** kistet hepatike dhe progresioni i shpejtë drejt dështimit renal favorizuan ADPKD.
Diskutime: Në mungesë të anamnezës familjare dhe testimit gjenetik, diagnoza e ADPKD mbështetet në triadën klinikë–imazheri–evoluim: rritje e volumit renal me kiste të shumta, manifestime ekstra - renale (p. sh. , kiste hepatike) dhe rritje graduale e insuficiencës renale e shoqëruar shpesh me hipertension rezistent. Njohja e hershme lejon planifikim të ndjekjes (kontroll i presionit arterial, vlerësim volumesh renale, screening i komplikimeve, edukim familjar) dhe orienton vendime terapeutike edhe në mjedise pa akses të menjëhershëm në gjenetikë.
Përfundime: Edhe pa histori familjare dhe pa test gjenetik, ADPKD mund të njihet me saktësi kur lexojmë së bashku klinikën dhe imazherinë: veshka të mëdha me kiste të shumta, kiste hepatike dhe hipertension i vështirë. Diagnoza e hershme ndryshon trajektoren: na lejon të strukturojmë ndjekjen (kontroll rigoroz të TA, monitorim të volumit renal, vlerësim të manifestimeve ekstra - renale) dhe të parandalojmë komplikimet duke shmangur nefrotoksikët dhe optimizuar terapinë.

Fjalë kyçe: ADPKD, veshka policistike, kiste hepatike, hipertension rezistent, imazheri, ndjekje, diagnozë pa test gjenetik.

OSTEOMA GJIGANDIKE.
Ilia Baloma

Abstrakt
Hyrje: Osteomat e sinusëve paranazalë janë tumore fibro - osteozë beninje me rritje të ngadaltë, të cilat, kur janë më të mëdha se 30 mm, quhen "gigantike". Ato përfaqësojnë neoplazin më të shpeshtë beninj të hundës dhe sinusëve paranazalë, me një prevalencë prej rreth 3% në popullatën e përgjithshme.
Qëllimi: Qëllimi i kësaj teze është të kontribuojë në një kuptim më të gjerë të menaxhimit të osteomave gjigante, duke shqyrtuar literaturën dhe duke paraqitur një eksperiencë 15 - vjeçare nga një institucion i vetëm.
Materiale dhe Metoda: U shqyrtua literatura dhe u përzgjodh material nga 72 artikuj nga viti 1975 deri në vitin 2024. U krye një rishikim retrospektiv i të dhënave të pacientëve të trajtuar për osteoma gjigante të sinusëve paranazalë nga janari 2008 deri në dhjetor 2024. Për më tepër, të gjithë pacientët u rishikuan në fillim të vitit 2025 për komplikacione të vona ose rikthim klinik.
Diskutime: Osteomat e mëdha mund të shkaktojnë komplikacione serioze për shkak të shtrirjes së tyre në struktura anatomike fqinje. Trajtimi i tyre është kirurgjikal dhe rikthimi është i rrallë nëse ato hiqen plotësisht. Në vitet e fundit, teknikat endoskopike janë shfaqur si standardi i kujdesit për trajtimin e osteomave të sinusëve paranazalë. Megjithatë, menaxhimi ekskluzivisht endoskopik i osteomave gjigante në shumë raste është i pamjaftueshëm ose i pamundur. Qasjet e hapura mbeten të vlefshme, duke përfaqësuar një metodë alternative të sigurt për ekspozim të mjaftueshëm të rasteve më komplekse.

Fjalë kyçe: osteomë gjigandike, osteoma sinusë paranazalë, tumore beninje fibro - osteoze, trajtim kirurgjikal endoskopik.

DUHANPIRJA DHE PLLAKAT KAROTIDE ATEROSKLEROTIKE TEK PACIENTËT DIABETIKË: NDIKIMI GJINOR.
Ilir Gjermeni [1], Eliona Gjermeni [2], Margarita Gjata[1]
[1]Shërbimi i Mjekësisë Interne, QSU "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri.
[2]Poliklinika e Specialiteteve nr. 3, Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt
Hyrje: Duhanpirja dhe diabeti mellitus janë faktorë të njohur rreziku për zhvillimin e sëmundjeve kardiovaskulare. Një nga pasojat më serioze është formimi i pllakave aterosklerotike në arteriet karotide, i cili

rrit rrezikun për aksidente vaskulocerebrale. Ky studim synon të vlerësojë ndikimin e duhanpirjes në formimin e këtyre pllakave tek pacientët me diabet, duke marrë në konsideratë edhe ndryshimet sipas gjinisë.
Objektiva: Ky studim synon të vlerësojë lidhjen midis duhanpirjes dhe formimit të pllakave karotide aterosklerotike tek pacientët me diabet mellitus, të krahasojë trashësinë e kompleksit intima - media (IMT) sipas statusit të duhanpirjes, të analizojë ndryshimet gjinore në këtë marrëdhënie dhe të identifikojë faktorët bashkëveprues që mund të ndikojnë në progresionin e aterosklerozës karotide.
Metodologjia: Ky është një studim retrospektiv i kryer në Shërbimin e Mjekësisë Interne dhe HTA, QSUNT, në periudhën maj 2023 deri janar 2025 dhe përfshin pacientë me diabet mellitus nën trajtim, të vlerësuar me ekografi Doppler të arterieve karotide. Të dhënat u ndanë sipas gjinisë dhe statusit të duhanpirjes (duhanpirës, ish - duhanpirës, jo - duhanpirës), dhe u analizua prania e pllakave aterosklerotike, shkalla e stenozës dhe trashësia e kompleksit intima - media (IMT). Rezultatet u krahasuan ndërmjet grupeve për të vlerësuar ndikimin e duhanpirjes dhe ndryshimet gjinore.
Rezultate: Rezultatet tregojnë një prevalencë më të lartë të pllakave aterosklerotike tek pacientët duhanpirës me diabet, krahasuar me jo - duhanpirësit. Ky efekt ishte më i theksuar tek meshkujt sesa tek femrat, duke sugjeruar një ndërveprim të mundshëm midis gjinisë dhe ndikimit të duhanpirjes.
Përfundime: Duhanpirja është një faktor shtesë rreziku për formimin e pllakave aterosklerotike në arteriet karotide tek pacientët me diabet mellitus, me një ndikim potencialisht më të madh tek meshkujt. Këto gjetje theksojnë rëndësinë e ndërhyrjeve të synuara për ndalimin e duhanit në këtë popullatë me rrezik të lartë, duke marrë në konsideratë edhe faktorët gjinorë.

Fjalë kyçe: Duhanpirja, diabet mellitus, pllaka karotide, IMT, gjinia.

VLERËSIMI I MODULIMIT TË ENZIMAVE KOLESTATIKE DHE TRANSAMINAZAVE NGA KREATINA DHE ACIDI LINOELIK NË HEPARIN E MINJËVE.

Ilir Mazreku[1], Atea Ukella[1]
[1]*Universiteti I Prishtinës, Fakulteti i Shkencave Matematiko - Natyrore, Depertamenti i Biologjisë, 10000 Prishtina, Kosovë.*

Abstrakt
Suplementet dietike si kreatina dhe acidi linoleik shpesh përfshihen në regjime metabolike. Kuptimi i ndikimit të tyre në testet e funksionit hepatik (LFTs) është thelbësor, pasi ndryshimet në këto enzima (transaminazat dhe treguesit kolestatikë) mund të tregojnë dëmtim të qelizave hepatike ose mosfunksionim biliar. Ne realizuam një eksperiment për të vlerësuar dhe krahasuar efektet rregulluese të kreatinës dhe acidit linoleik mbi treguesit serikë të stresit hepatik te minjtë. Tre grupe minjsh (n = 10 secili) u ushqyen për katër javë me një dietë kontrolli, ose dieta të suplementuara me 0. 5% kreatinë ose 0. 5% acid linoleik. Serumi u analizua për komponentët kryesorë të LFT - ve: alanin aminotransferaza (ALT), aspartat aminotransferaza (AST), fosfataza alkaline (AP), transferaza gamma - glutamil (GGT), dehidrogjenaza e laktatit (LDH) dhe glukoza (Glu). Suplementimi prodhoi profile të ndryshme enzimatike. Kreatina uli në mënyrë të ndjeshme treguesit e kolestazës (AP dhe GGT) dhe të dëmtimit hepatocelular (AST), por në mënyrë të papritur rriti ndjeshëm nivelet e enzimës glikolike LDH dhe glukozës ($p < 0.05$). Acidi linoleik tregoi një efekt më të fokusuar, duke ulur ndjeshëm vetëm treguesit kolestatikë AP dhe GGT ($p < 0.05$), pa shkaktuar ndryshime domethënëse në transaminaza (ALT, AST), LDH ose Glu. Kreatina dhe acidi linoleik modifikojnë në mënyrë aktive parametrat e LFT - ve në një model murin, por nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm. Efektet e përziera të kreatinës, reduktim i disa enzimave, por rritje e pakontrolluar e LDH dhe glukozës, tregojnë një ndërveprim kompleks me metabolizmin ndërmjetës. Ndërkohë, acidi linoleik paraqet një profil më të pastër dhe të favorshëm për mbështetjen hepatike, përmes reduktimit të vetëm të treguesve kolestatikë. Studime të mëtejshme janë të nevojshme për të sqaruar rëndësinë klinike të rritjes së LDH - së dhe glukozës të lidhura me kreatinën.

Fjalë kyçe: funksioni hepatik, mosfunksionimi biliar, hemogram.

HEMOPTIZIA: VLERËSIMI DHE MENAXHIMI.

Ilir Peposhi MD, PhD, Ornela Nuredini MD, PhD, Alma Teferiçi MD, Serxho Golgota MD

Abstrakt

Hemoptizia është ekspektorimi i gjakut nga trakti i poshtëm respirator, zakonisht me origjinë nga arteriet bronkiale. Shkaqet më të shpeshta janë infeksionet akute respiratore, kanceri, bronkektazitë, dhe sëmundja pulmonare obstruktive kronike. Në 20% deri 50% të rasteve nuk është identifikuar shkaku. Hemoptizia duhet të diferencohet nga pseudohemoptizia, e cila është gjaku që merr origjinën nga nazofaringsi ose trakti gastrointestinal. Vlerësimi fillestar përfshin përcaktimin e gravitetit të hemorragjisë dhe stabilitetin e pacientit dhe mund të jetë e nevojshme bronkoskopia për të ruajtur rrugët ajrore. Hemoptizia e lehtë përbën rreth 90% të rasteve dhe ka prognozë të mirë, ndërkohë që hemoptizia massive ka shkallë të lartë mortaliteti. Anamneza dhe ekzaminimi fizik na ndihmojnë në identifikimin e etiologjisë, por që testet diagnostikuese janë të domosdoshme. Fillohet me një RTg pulmoni edhe pse sensibiliteti për të përcaktuar etiologjinë dhe vendin nga vjen hemorragjia është i limituar. CT skan dhe angio CT skan toraksi me kontrast venoz janë modalitetet e preferuara për të përcaktuar etiologjinë, por bronkoskopia luan një rol kyç si në diagnozë dhe në trajtim. Menaxhimi përveç trajtimit konservativ duhet të përfshijë trajtimin e faktorit shkaktar. Embolizimi i arteries bronkiale përdoret për të trajtuar hemoptizinë massive, sidomos në rastet kur identifikohet përfshirja në angio CT. Kirurgjia është e rezervuar për ata pacientë tek të cilët dështon trajtimi konservativ dhe embolizimi.

Fjalë kyçe: hemoptizia, gjak, vlerësim, menaxhim.

ROLI I BRONKOSKOPISË FLEXIBLE NË DIAGNOZËN DHE HEQJEN E TRUPAVE TË HUAJ NË RRUGËT AJRORE.

Ilir Peposhi MD. PhD, Alma Teferici MD, Ornela Nuredini MD. PhD *Shërbimi Pneumologjisë, Kabineti Bronkoskopisë QSRT "SH. Ndroqi"Tiranë*

Abstrakt

Hyrja: Bronkoskopia flexible është një proçedurë e shpejtë kosto - efektive dhe e sigurt në heqjen e trupave të huaj në rrugët ajrore.

Qëllimi: Të analizojë të dhënat demografike dhe ato endoskopike në të rriturit me aspirim të trupave të huaj në rrugët ajrore si dhe heqjen e trupave të huaj me anë të bronkokopisë flexible.

Metoda: Në analizë u morën 22 raste, të cilët u diagnostikuan me trupa të huaj në rrugët ajrore, heqja e të cilëve u realizua me ane te bronkoskopisë flexible. Nga këto 15 ishin meshkuj dhe 7 femra, mosha mesatare e të sëmurëve ishte rreth 40 vjeç. Prezantimi më i shpeshtë klinik ishte kolla, pasuar nga dispneja, wheezing dhe infeksionet e shpeshta respiratore. Trupat e huaj më të shpeshtë ishin kocka të aspiruara në rrugët e frymëmarrjes.

Rezultate: Në 22 raste, diagnoza dhe heqja e trupit të huaj në rrugët ajrore u realizua me sukses me anë të bronkoskopisë flexible. Pacientet patën një përmirësim të dukshëm klinik dhe të imazhit radiologjik.

Konkluzione: Bronkoskopia flexible duhet të konsiderohet si zgjedhje e parë në heqjen e trupave të huaj në rrugët ajrore. Ajo është një procedurë kosto - efektive dhe e sigurt. Bronkoskopi rigid duhet të përdoret si back up nëse kjo procedure dështon.

Fjalë kyce: Bronkoskopi flexible, CT Skaner, Trupat e huaj.

ROLI I REZONANCËS MAGNETIKE KARDIAKE (CMR) NË SËMUNDJEN E ARTERIES KORONARE (SAK).

Ilir Sharka[1]

[1]*Shërbimi i Kardiologjisë, QSUNT*

Sfondi: Sëmundja e arteries koronare (CAD) mbetet shkaku kryesor i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë në mbarë botën. Diagnostikimi i saktë, vlerësimi i rrezikut dhe përcaktimi i dëmtimit miokardial janë thelbësorë për menaxhimin optimal të pacientit. Rezonanca magnetike kardiake (MRI kardiake) paraqet një metodë jo -

invazive dhe gjithëpërfshirëse, që mundëson vlerësim të detajuar të patologjisë miokardiale të lidhur me perfuzionin koronar.
Qëllimi: Të përmblidhet vlera klinike dhe prognostike e MRI kardiake në diagnostikimin dhe menaxhimin e sëmundjes koronare.
Metodat dhe teknikat imazherike: CMR ofron një vlerësim multiparametrik përmes imazherisë cine për funksionin ventrikular, teknikave perfuzionale për zbulimin e ishemisë, teknikave post - kontrastografike të vonshme (LGE) për karakterizimin e infarktit, dhe hartëzimit T1 / T2 për analizën e karakterizimit të indeve. Imazheria e perfuzionit nën stresin farmakologjik me vazodilatorë (adenozinë, regadenozon ose dipiridamol) mundëson zbulimin e ishemisë me ndjeshmëri dhe specifitet të lartë, të krahasueshme ose më të larta se teknikat e imazherisë nuklerare apo CT.
Rezultate: LGE në MRI kardiake përcakton me saktësi madhësinë e infarktit, transmuralitetin dhe obstruksionin mikrovaskular – tregues kyç të viabilitetit indor dhe të prognozës. Hartëzimi parametrik (kuantitativ) i perfuzionit miokardial përmirëson zbulimin e hershëm të disfunksionit mikrovaskular dhe fibrozës difuze. Për më tepër, MRI kardiake është thelbësore për identifikimin e shkaktarëve jo - obstruktivë të 'ishemisë miokardike', si miokarditi apo kardiomiopatia Takotsubo, dhe për orientimin e vendim - marrjes për revaskularizimin koronar.
Përfundime: MIR kardiake përfaqëson standardin e artë për karakterizimin indor miokardial dhe ofron një vlerësim gjithëpërfshirës të SAK, duke integruar në një ekzaminim të vetëm informacion anatomik, funksional dhe perfuzional. Fuqia e saj prognostike dhe natyra jo - invazive e bëjnë atë një gur themeli në algoritmin bashkëkohor diagnostik të sëmundjes ishemike të zemrës.

Fjalë kyce: CAD, CMR, SAK, MRI.

AUTOIMUNITETI NË ÇRREGULLIMET PSIKIATRIKE PEDIATRIKE: NDËRLIDHJA MIDIS IMUNOLOGJISË DHE SHËNDETIT MENDOR NGA MEKANIZMAT TE MANIFESTIMET KLINIKE.
Ilir Skënderi

Abstrakt
Hyrje: Provat në rritje sugjerojnë se mekanizmat autoimunë kontribuojnë në patofiziologjinë e disa çrregullimeve psikiatrike te fëmijët dhe adoleshentët. Sindroma të tilla si Çrregullimet Neuropsikiatrike Pediatrike Autoimune të Lidhura me Infeksionet Streptokoksike (PANDAS) dhe Sindroma Pediatrike me Fillim të Papritur Neuropsikiatrik (PANS) përfaqësojnë mënyrën se si çrregullimet imune mund të shfaqen me simptoma psikiatrike të fillimit të menjëhershëm. **Objektiva:** Të përmblidhet njohuria aktuale mbi kontributet autoimune në çrregullimet psikiatrike pediatrike dhe të theksohen ndikimet e tyre në diagnozë dhe trajtim.
Metodologjia: Një rishikim përshkrues i literaturës së fundit, përfshirë studime klinike, raporte rastesh dhe kërkime në neuroimunologji, me fokus te çrregullimi obsesiv - kompulsiv (OCD), çrregullimet e tikeve, psikoza me fillim të hershëm dhe çrregullimet e humorit te fëmijët. **Rezultate:** Të dhënat tregojnë se autoantitrupat, çrregullimet e citokinave dhe neuroinflamacioni mund të luajnë rol në shfaqjen dhe ashpërsinë e simptomave. Fëmijët që paraqiten me simptoma psikiatrike me fillim të menjëhershëm, ecuri atipike ose reagim të dobët ndaj trajtimeve standarde mund të përfitojnë nga një vlerësim imunologjik. Qasjet multidisiplinare që integrojnë psikiatrinë, neurologjinë dhe imunologjinë tregojnë rezultate premtuese për përmirësimin e trajtimit.
Përfundime: Njohja e komponentit autoimun në çrregullimet psikiatrike pediatrike është thelbësore për diagnozë të hershme dhe strategji të personalizuara trajtimi. Kërkimet e ardhshme mbi biomarkerët dhe terapitë imunomoduluese mund të transformojnë praktikën klinike dhe të përmirësojnë rezultatet funksionale afatgjata.

Fjalë kyçe: autoimuniteti, psikiatria pediatrike, neuroinflamacioni, pandas, pans, shëndeti mendor i fëmijëve.

SHVANOMA (C7 - TH1) TUMOR NEUROGJENIK I MEDIASTINIT POSTERIOR I ZBULUAR RASTËSISHT SI MASË APIKALE NË HEMITORAKSIN E MAJTË: PREZANTIM RASTI.

Ilir Skënduli[1]
[1]Departamenti i Kirurgjisë Torakale, Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi" Sauk, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Hyrje: Tumoret neurogjenike në kafazin e kraharorit zakonisht gjenden në mediastinin posterior. Ata e marrin origjinën nga qelizat e kreshtës embrionale të qelizave nervore rreth ganglionit spinal, ose nga ganglionet simpatike dhe parasimpatike. Tumoret neurogjenike mund të jenë beninje ose malinje. Lezionet beninje klasifikohen ose si shvanoma ose si neurofibroma. Shvanomat janë më të shpeshta sesa neurofibromat. Pacientët me shvanoma shpesh janë asimptomatikë dhe rrallë manifestojnë shenja klinike si: komprimim i kanalit spinal, kollë, dispne, dhimbje të kafazit të kraharorit, ngrirje të zërit. Rreth 10% e këtyre tumoreve neurogjenike mund të shtrihen në vrimën vertebrale (vertebral foramina) dhe të prezantohen si dumbbell ose sandglass tumors. Trajtimi kirurgjikal mbetet trajtimi standard i këtyre tumoreve.

Materiale dhe metoda: Një burrë 52 vjeçar vjen në klinikë pasi kish bërë grafi, e cila kish zbuluar një hije apikale në hemitoraksin e majtë. Pacienti referonte se pesë vjet më parë ishte operuar pranë klinikës së neurokirurgjisë për neurinoma (C7 - TH1). Procedura e kryer rezultoi hemilaminektomia posteriore, fascetektomia unilaterale për heqjen e tumorit neurogjen. Rastësisht përgjatë pandemisë Covid - 19 pacienti realizon një grafi të kraharorit e cila zbulon një hije apikale në hemitoraksin e majtë. Pacienti shtrohet pranë klinikës tonë për t'iu nënshtruar ekzaminimeve më të specifikuara.

Rezultate: Tomografia e kompjuterizuar zbuloi tumorin me përmasa 6x5 cm në mediastinin posterior që e merrte origjinën nga C7 - TH1. Rezonanca manjetike po kështu konfirmoi praninë e formacionit me të njëjtat përmasa që merrte origjinën nga C7 - TH1 dhe me shtrirje ekstra durale në mediastinin posterior. Pacienti iu nënshtrua kirurgjisë së hapur nëpërmjet incizionit inter skapulo vertebral. Gjatë interventit kirurgjikal u konstatua masa tumorale e mbështetur në vertebrën torakale të parë dhe cervikalen e shtatë si dhe shtypte arterien subklavia por pa e infiltruar atë dhe strukturat përreth. Masa u hoq në kufij të shëndoshë duke ruajtur dhe rrënjën e nervit TH1. Periudha postoperatore ishte e kënaqshme, pa probleme të deficiteve neurologjike për pacientin. Biopsia rezultoi Shvanoma. Pacienti doli nga spitali në ditën e gjashtë postoperatore pa ndonjë problematikë të veçantë.

Konkluzione: Tumoret neurogjenike që marrin origjinën nga C7 - TH1 janë ekstremisht të rralla. Hapja e gjerë posteriore (incizioni inter skapulo vertebral) është procedurë e zgjedhur për heqjen e këtyre tumoreve të vendosura në këtë pozicion, me shtrirje ekstra durale dhe mbi 4 cm.

Fjalë kyçe: muri i kraharorit; tumoret mediastinale; mushkëritë; lezionet beninje.

KRIOABLACIONI I OSTEID OSTEOMES.

Prof. Asc. Ilirian Laçi[1, 3], Alketa Spahiu[2]
[1]Spitali Katolik Zoja e Këshillit të Mirë, Tiranë
[2]Poliklinika e Specialiteteve Nr 3, Tiranë
[3]Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Abstrakt

Osteid osteoma është një tumor beninj kockor i vogël, që prek më së shumti adoleshentët dhe të rinjtë, me një incidencë më të lartë te meshkujt. Karakterizohet nga dhimbje të forta, shpesh të natës, që lehtësohen ndjeshëm me përdorimin e antiinflamatorëve josteroidalë (NSAIDs). Në dekadën e fundit, trajtimi minimalisht invaziv me krioablacion perkutan është bërë metoda e preferuar për menaxhimin e këtij lezioni, duke zëvendësuar trajtimet kirurgjikale tradicionale.

Në këtë procedurë, nën guidim të vazhdueshëm me tomografi kompjuterike (CT), vendoset një age biopsie kockore për të marrë një mostër ("karrotë") për verifikim histologjik të diagnozës. Më pas, në të njëjtën trajektore, vendoset sonda IceForce për realizimin e krioablacionit. Formimi i sferës së akullit (ice ball) monitorohet në kohë reale dhe duhet të mbulojë plotësisht volumin e lezionit për të siguruar devitalizimin e plotë të tumorit.

Efekti klinik është i menjëhershëm, me lehtësim të simptomave që ditën e parë pas procedurës. Monitorimi radiologjik një muaj pas trajtimit konfirmon reduktimin e lezionit dhe mungesën e aktivitetit patologjik.

Krioablacioni është një teknikë e sigurt, efektive dhe me invazivitet minimal, që garanton rezultate të shkëlqyera klinike dhe funksionale, me kohë të shkurtër rikuperimi dhe pa komplikacione të rëndësishme.

Fjalë kyçe: Cryablation, osteid osteoma, ortopedi, radiologji intervencionuese.

KRIOABLACIONI I TUMORIT PULMONAR.

Prof. Asc. Ilirian Laçi[1, 3], Alketa Spahiu[2]
[1]*Spitali Katolik Zoja e Këshillit Të Mirë, Tiranë*
[2]*Poliklinika e Specialiteteve Nr 3, Tiranë*
[3]*Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*

Abstrakt
Cryoablation është metodë efikase trajtimi në kancerin e pulmonit. Edhe pse trajtimi klasik për kancerin e mushkërise është rezeksioni kirurgjik, një numër i madh pacientësh nuk janë të përshtatshëm për rezeksion kirurgjikal. Cryoablacioni i drejtuar nën CT luan një rol të rëndësishëm në pacientët me kancer të mushkërive të cilët nuk janë të përshtatshëm për kirurgji dhe ose zgjedhin kete metode trajtimi perkundrejt kirurgjise. Cryoablacioni nën CT guide përdoret gjerësisht në trajtimin klinik të tumoreve të mushkërive për shkak të avantazheve pasi ka më pak traume, më pak komplikikacione, shume efikasitet dhe shërim të shpejtë. Cryoablacioni jo vetëm që mund të shkaktojë nekrozë dhe apoptozë të tumorit, por gjithashtu të shkakton e çlirimin e autoantigjeneve me origjine nga tumori të cilat kalojnë në qarkullimin e gjakut dhe të stimulojë sistemin imunitar për të prodhuar një efekt imunitar anti - tumoral kundër tumoreve primare dhe metastatike. Është parë një lidhje e fortë e trajtimit me Cryoablation dhe mekanizmave imune në trajtimin e tumoreve pulmonare. Veçanërisht është parë efekt sinergjik kombinimi i Cryoablacionit me imunoterapinë.

Fjalë kyçe: Cryablation, kancer pulmonar, radiologji intervencionuese.

KRIOABLACIONI I TUMORIT RENAL.

Prof. Asc. Ilirian Laçi[1, 3], Alketa Spahiu[2]
[1]*Spitali Katolik Zoja e Këshillit Të Mirë, Tiranë*
[2]*Poliklinika e Specialiteteve Nr 3, Tiranë*
[3]*Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*

Abstrakt
Cryoablation i veshkave po bëhet një opsion i zgjedhur për trajtimin e tumoreve renale (RCC). Kjo procedurë ruan pjesën e shëndoshë të veshkës pa dëmtuar funksionin e veshkës dhe pa kompromentuar kontrollin e kancerit renal. Teknika moderne e Cryoablacionin renal kryhet në mënyrë perkutane. Procedura përfshin trajtimin dmth shkatërrimin e plotë të tumorit, por pa dëmtuar indet pranë apo organe të tjera. Kjo përfshin disa teknika ndihmëse për të mbrojtur inde dhe organe pranë tumorit. Gjatë procedurës bëhet monitorim dinamik duke evidentuar formimin e sferës së akullit e cila mbulon gjithë gjeometrinë e tumorit. Procedura përfshin gjithmonë dy cikle të plota ngirje dhe shkrije ëe minus 150 gradë Celsius dhe plus 50 gradë Celsius. Ky proces nëpërmjet dëmtimit të membranave qelizore shoqërohet me mbajtjen e ujit në qelizë, ku me procesin e dytë të ngrirjes pësohet carje e plotë e membranës qelizore duke shkaktuar lizë të plotë qelizore. Ndjekja pas procedurës bëhet (1, 3, 6, 12 muaj pas trajtimit dhe më pas çdo vit). Në ekzaminimet e njëpasnjëshme evidentohet zvogëlimi progresv i tumorit si pasojë e apoptozës qelizore që zhvillohet përreth tumorit.

Fjalë kyçe: Cryablation, kancer renal (RCC).

DIALOGU ENDOKRIN: ZBULIMI I LIDHJES SË FSHEHUR MIDIS HORMONEVE TË TIROIDES DHE PROLAKTINËS.

Ilirjana Agolli
Poliklinika e Specialiteteve Nr. 4, Tiranë.

Abstrakt

Hyrje: Nën sipërfaqen e çdo qelize shtrihet një simfoni e fshehur – një dialog ku dhe molekulat më të padurueshme performojnë në koncert për të mbajtur jetën. Në këtë balet të ndërlikuar, hormonet e tiroides dhe prolaktina shfaqen partnerë të papritur, duke u angazhuar në një bisedë dinamike të orkestruar nga hipotalamusi. Në zemër të këtij ndërveprimi është hormoni i lëshimit të tirotropinës (TRH), i cili jo vetëm që sugjeron prodhimin e hormonit stimulus të tiroides (TSH), por dhe shtyn prolaktinën në veprim. Ky rol i dyfishtë formon thelbin e eksplorimit tonë se si ndërprerjet në funksionin e tiroides mund të përhapen në peisazhe më të gjera fiziologjike duke ndikuar në gjithçka, nga metabolizmi deri tek riprodhimi.

Objektiva: Për të sqaruar mekanizmat, për të eksploruar implikimet klinike, për të kuptuar strategjitë diagnostikuese, për të hetuar qasjet terapeutike, për të inkurajuar njohuri më të gjera endokrine.

Materiale dhe Metoda: Dizajni i Studimit dhe Pjesëmarrësit – Pjesëmarrësit e rritur të moshës 18 - 65 vjeç janë rekrutuar nga një kujdes dytësor shëndetësor. Për të minimizuar variablat konfuze, individët me çregullime të njohura të hipofizës, sëmundjet e veshkave ose ilaçe të njohura që ndikojnë ekuilibrin hormonal janë të përjashtuara, Mbledhja e Mostrave dhe Analiza Hormonale, Studimet e Imazhit dhe Vlerësimet Shtesë, Analiza Statistikore, Sigurimi i Cilësisë, Menaxhimi i të Dhënave dhe Konfidencialiteti.

Rezultate: Rezultatet ofrojnë prova bindëse për dialogun endokrin midis hormoneve të tiroides dhe prolaktinës. Në kushtet e mungesës së hormonit tiroide (hipotiroidizmi) ngritja kompensusese në TRH drejton një rritje në të dy nivelet e TSH dhe prolaktinës. Kjo ndërlidhje hormonale nënvizon ndikimin sistemik të mosfunksionimit të tiroides dhe forcon rëndësinë klinike të vlerësimit të statusit të tiroides në pacientët që paraqesin hiperprolaktineminë.

Përmbledhje: Ky studim u fut në marrëdhënien e nuancuar, midis hormonit tiroide dhe prolaktinës në tre grupe të dallueshme, pacientë me hipotiroidizëm, ata me hipertiroidizëm, dhe një grup kontrolli të individëve eutiroid. Hetimi u përqëndrua në të kuptuarit se si një mangësi në hormonet e tiroides prish lakin normal të reagimit negativ, duke çuar në rritjen e prodhimit të hormonit të lëshimit të tirotropinës (TRH). TRH e ngritur, nga ana tjetër, stimulon jo vetëm hormonin stimulus të tiroides (TSH), por edhe sekretimin e prolaktinës.

Konkluzione: Korrelacioni i fortë i vërejtur midis TSH dhe prolaktinës në pacientët hipotiroidë konfirmon ndërveprimin biokimik në të cilin humbja e hormonit tiroide – frenimi i ndërmjetësuar luan një rol qendror.

Fjalë kyçe: Hormonet tiroide, prolaktina, hormoni lëshues - tirotropin (trh), hormoni stimulus - tiroid (tsh), hipotiroidizëm, hipertiroidizëm, aksi endokrin, hiperprolaktinemia, funksioni pituitar.

LIDHJA MIKROBIALE: EKSPLORIMI I NDIKIMIT TË UREAPLASMA NË PERSISTENCËN E HPV TE GRATË NULLIPARE NË SHQIPËRI.

Ph. D. Ilta Bylykbashi[1, 2], Prof. Asoc. Dr. Edlira Bylykbashi[1, 2], Ph. D. Ilir Bylykbashi[2]
[1]*Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri*
[2]*Klinika Bylykbashi*

Abstrakt

Hyrje: Ureaplasma spp. , veçanërisht U. parvum dhe U. urealyticum, kolonizon traktin gjenital femëror dhe mund të shkaktojë inflamacion mukozal. Infeksioni persistues me tipat e rrezikshëm të HPV (hrHPV) është një faktor kryesor në zhvillimin e karcinomës cervikale. Ndërveprimi midis kolonizimit me *Ureaplasma* dhe persistencës së HPV mbetet i paqartë, veçanërisht tek gratë nulipare.

Qëllimi: Të shqyrtohet marrëdhënia midis kolonizimit me Ureaplasma dhe infeksionit me HPV tek gratë nulipare në Shqipëri.

Metodat: Studim transversal me 3, 540 gra seksualisht aktive, 18–45 vjeç, të cilat morën pjesë në një klinikë shëndeti riprodhues (maj 2023–maj 2025). Swab - e cervikovaginale u analizuan për HPV me PCR dhe për U. urealyticum me PCR sasiore. Të dhënat demografike dhe sjellore u mbledhën me pyetësor të strukturuar.

Rezultatet: HPV u detektua tek 29. 2% e pjesëmarrëseve; Ureaplasma tek 31. 6%. Prevalenca e Ureaplasma ishte më e lartë tek gratë HPV - positive (43. 5%) krahasuar me HPV - negative (26. 8%; p<0. 001). Gratë me

kolonizim Ureaplasma kishin më shumë se dyfishin e mundësive për infeksion HPV (OR = 2. 14; aOR = 1. 78, 95% CI: 1. 46–2. 16). Marrëdhënia ishte edhe më e fortë për hrHPV (aOR = 1. 95, 95% CI: 1. 52–2. 30).
Konkluzioni: Kolonizimi me Ureaplasma lidhet në mënyrë të pavarur me infeksionin HPV, veçanërisht hrHPV. Studimi nënvizon rolin e mikrobiotës gjenitale në persistencën e HPV dhe nevojën për studime longitudinale.

Fjalë kyçe: Ureaplasma urealyticum, hrHPV, mikrobiota gjenitale, infeksion cervikovaginal, Shqipëri.

SUPLEMENTACIONI NË GRAVIDANCË NORMALE DHE ATË PATOLOGJIKE.

Ph. D. Ilta Bylykbashi[1, 2], Prof. Asoc. Dr. Edlira Bylykbashi[1, 2], Ph. D. Ilir Bylykbashi[2]
[1]Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri [2]Klinika Bylykbashi, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Ushqyerja gjatë shtatzënisë është e rëndësishme për të parandaluar çekuilibrin ushqimor që ka ndikim në të gjithë barrën. Mikronutrientët luajnë një rol kritik në embriogjenezë, rritjen fetale, shëndetin amtar, duke ditur se gjatë shtatzënisë rriten nevojat energjitike, proteinike, vitaminike dhe ato minerale. Rritja e nevojës kërkon rritjen e marrjes së mikronutrientëve nëpermjet dietës. Pamjaftueshmëritë e shprehura apo mbidozimet e mikronutrientëve të ndryshëm kanë efekte negative mbi rritjen fetale (IUGR, SGA, keqformime kongenitale) dhe zhvillimin e shtatzënisë (pre - eklampsi apo diabet gestacional). Ne investigojmë nëse është e nevojshme marrja e mikronutrientëve gjatë barrës për të përmirësuar shëndetin e gruas në këtë stad dhe nëse këto suplemente mund të parandalojnë apo kontrollojnë patologji të lidhura me shtatzëninë.
Qëllimi: rishikimi ynë ka për qëllim të përmbledhë evidenca (të dhëna) mbi ndikimin e deficiteve ushqyese në sëmundshmëritë feto - amtare.
Metodologjia: U bë një vlerësim kritik i rezultateve të publikuara nga studime të shumta mbi suplementet e nutrientëve të ndryshëm gjatë shtatzënisë. U konsultuan databaza shkencore të rëndësishme, tekste shkencore dhe faqe zyrtare në internet. U përdorën termat si shtatzëni apo shëndeti feto - amtar, vitamina e minerale apo suplemente dhe kërkesa apo deficite ushqimore në kërkimet në PubMed.
Rezultatet: Është pranuar tashmë përdorimi gjatë shtatzënise i acidit folik dhe suplementeve për të parandaluar defekte kongenitale të tubit neural, suplementet me jod dhe kalium për një zhvillim nervor normal, një suplement oral me hekur gjatë gjysmës së dytë të shtatzënise për të reduktuar aneminë dhe deficitet e hekurit tek nëna. Një numër mikronutrientësh janë vënë re se lidhen edhe me patologji si pre - eklampsia, diabeti gestacional mellitus dhe nauzet e të vjellat gravidike. Në përgjithësi, studimet eksperimentale janë të nevojshme për të treguar benefitet e suplementeve me mikronutrientë të ndryshëm dhe për të rregulluar dozat ditore të rekomanduara edhe ato perikoncepsionale.
Konkluzione: Aktualisht, ka të dhëna që vërtetojnë përfitimet e mikronutrientëve suplement në rezultatet perinatale, por dekurajohet përdorimi pa kriter i tyre pasi tashmë njihen edhe efektet anësore nga dozimet e tepërta të tyre. Të dhënat mbështesin idenë që deficitet me mikronutrientë mund të ndikojnë shëndetin amtar dhe ecurinë e shtatzënisë. Patjetër, duhet një zëvëndësim i kombinuar për të përfituar efektet e duhura, pasi asnjëri prej tyre i vetëm nuk arrin të plotësojë nevojën e integruar të deficiteve të ndryshme të krijuara gjatë shtatzënisë.

Fjalë kyçe: shtatëzeni, vitamina, minerale, suplemente, nevoja, shëndet amtaro - fetal**.**

RISHIKIMI I UDHËZIMEVE BASHKËKOHORE PËR PNEUMONINË: QASJE TË INDIVIDUALIZUARA DHE TË MBËSHTETURA NË EVIDENCË.

Ina Pojani[1], Serxho Golgota[1], Kristi Reveli[1], Elga Bardho[1], Doris Orgocka[1], Haki Rrugeja[1]
Mjekësia pulmonare, Qendra Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi", Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Pneumonia mbetet një shkak madhor i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë globale, duke nxitur rishikime të vazhdueshme të udhëzimeve ndërkombëtare të trajtimit. Përditësimet e fundit (ATS 2025, ERS 2023, Japoni 2024, Francë 2025) theksojnë qasjen e bazuar në ashpërsinë e sëmundjes, përdorimin racional të antibiotikëve dhe optimizimin e terapive suportive.

Metodologjia: Kjo përmbledhje sintetizon të dhënat nga rishikimet sistematike dhe metaanalizat më të fundit mbi diagnostikën, terapinë empirike, imunomodulimin dhe kujdesin suportiv.
Rezultate: Evidencat mbështetsin përdorimin e ekografisë pulmonare mbi radiografinë për diagnozën fillestare dhe theksojn rëndësinë e biomarkerëve (prokalcitonina, CRP) dhe shkallëzuesve klinikë (CURB - 65, PSI) në vendimmarrje. Strategjitë empirike të përshtatura kanë treguar përmirësim në rezultatet e CAP mesatare dhe të rëndë). Imunizimi (gripi sezonal, vaksina konjugate antipneumokokike) redukton ndjeshëm incidencën e rasteve të reja dhe komplikacionet. Kortikosteroidet rekomandohen vetëm në rastet e rënda, ndërsa oksigjenoterapia me fluks të lartë dhe agjentët imunomodulues tregojnë përfitime premtuese, megjithëse kërkojnë prova shtesë.
Përfundime: Udhëzimet bashkëkohore nxisin një qasje të individualizuar, të bazuar në ashpërsinë klinike, që integron diagnostikën e avancuar, strategjitë e targetuara të antibiotikëve dhe përdorimin selektiv të terapive imunomoduluese dhe suportive. Rishikimet në vazhdim pritet të rafinojnë më tej këto rekomandime.

Fjalë kyçe: Pneumonia, ekografia pulmonare, antibiotikë, biomarker.

LIPOPROTEINA(A): IMPAKTI MBI RISKUN KARDIOVASKULAR DHE IMPLIKIMET KLINIKE.
I. Refatllari, D. Godaj, A. Banushi, D. Kullolli, I. Kecaj. A. Goda
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Hyrje: Lipoproteina(a) [Lp(a)] është një kompleks makromolekuar plazmatike e përbërë nga një grimcë e ngjashme me lipoproteinën me densitet të ulët (LDL), e lidhur në mënyrë kovalente me apolipoproteinën(a). Përqendrimi i saj përcaktohet kryesisht nga variacionet gjenetike në gjenin *LPA* dhe mbetet pothuajse konstant gjatë gjithë jetës. Nivelet e rritura të Lp(a) janë identifikuar si faktor i pavarur dhe shkakor për sëmundjen aterosklerotike kardiovaskulare (ASCVD) dhe stenozën e kalcifikuar të aortës, duke kontribuar në riskun kardiovaskular rezidual pavarësisht kontrollit optimal të lipideve.
Qëllimi: Të përmblidhet evidenca më e fundit mbi ndikimin e Lp(a) në riskun kardiovaskular dhe të shqyrtohen implikimet klinike për diagnostikimin, parandalimin dhe trajtimin.
Materiale dhe metoda: U analizuan të dhëna nga studime prospektive të mëdha të publikuara gjatë pesë viteve të fundit, për të vlerësuar rrezikun e lidhur me Lp(a), mekanizmat fizpatologjikë dhe strategjitë e reja terapeutike.
Rezultate: Nivelet e larta të Lp(a) (>50 mg / dL ose >125 nmol / L) rrisin riskun e Sëmundjes Aterosklerotike Kardiovaskulare (SAK) ~ 1. 5–2. 5 herë, të pavarura nga niveli i LDL - kolesterolit dhe faktorët e tjerë klasikë. Mekanizmi përfshin efekte proinflamatore, protrombotike dhe oksidative të Lp(a). Statinat kanë efekt minimal mbi Lp(a), ndërsa inhibitorët e PCSK9 arrijnë ulje të moderuar (~25%). Terapitë e reja të bazuara në ARN, si pelacarsen (oligonukleotid antisens) dhe olpasiran (siRNA), kanë treguar ulje prej 80–90% të Lp(a) në studime faza 2 dhe 3. Udhëzimet aktuale rekomandojnë matjen e Lp(a) të paktën një herë gjatë jetës, veçanërisht tek individët (SAK) të hershëm, hiperkolesterolemi familjare apo histori familjare të fortë të sëmundjeve kardiovaskulare.
Përfundime: Nivelet e larta të Lp(a) përfaqësojnë një kontribues të rëndësishëm dhe gjenetikisht të përcaktuar të riskut rezidual kardiovaskular. Integrimi i matjes së Lp(a) në vlerësimin e rrezikut dhe zhvillimi i terapive specifike për uljen e saj pritet të përmirësojë ndjeshëm parandalimin e personalizuar kardiovaskular.

Fjalë kyçe: Lipoproteina(a), sëmundje kardiovaskulare, aterosklerozë, vlerësim risku, risk residual.

VLERESIMI I ÇREGULLIMEVE TË LINDURA METABOLIKE NË NJËSINË E KUJDESIT INTENSIV PEDIATRIK.
Inva Gjeta, Durim Sala, ILirjana Bakalli, Ermela Celaj, Vladimir Hoxha, Marsela Biqiku, Elmira Kola.
Shërbimi i Terapisë Intensive Pediatrike, Qendra Spitalore Universitare ''Nënë Tereza''

Abstrakt
Hyrje: Çregullimet e lindura të metabolizmit janë një kondicion gjenetik që vijnë si pasojë e dëmtimit të procesit fiziologjik të metabolizmit, shpesh si pasojë e një deficiti të një enzime apo transportuesi. Çrregullimet e lindura të metabolizmit janë nje grup i rrallë i sëmundjeve të trashëgueshme dhe për shkak të heterogjenecitetit të tyre,

çrregullime të ndryshme kanë epidemiologji, prezantim klinik dhe trashëgimi të ndryshme. Numërohen më shumë se 500 çrregullime metabolike të lindura dhe pjesa më e madhe shfaqen gjatë muajve të fëmijërisë. Disa prej tyre shfaqen me një dekonpensim akut metabolik në formën e krizës metabolike në njësitë e kujdesit intensiv, që është kërcënues për jetën. Njohja e hershme e simptomave dhe ndërhyrja adekuate jane kritike për reduktimin sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë.
Metodologjia dhe rezultate: Rishikimi i literaturës së botuar në 10 vitet e fundit, 2015 - 2025. Prezantimi klinik i tyre është i larmishëm, por çrregullimet neurologjike ndodhin në 80% të individëve dhe shfaqen me zhvillim të vonuar, humbje të gurëve themeltarë të zhvillimit, tonus i ulët, kriza konvulsive. Insuficienca respiratore akute dhe manifestimet gastrointestinale janë prezantimet klinike që pasojnë atë neurologjike me detres respirator akut që shpesh kërkon shtrim në njësitë intensive, të vjella, diarre, hepatomegali dhe mos shtim në peshë. Në vlerësimin laboratorik vihet re nivel i larte i laktateve, hipoglicemi, hyperamonemi, acide metabolike të rritura, ketonuri ose jo, rritje e kreatine kinazës. Këto ndryshime laboratorike mund të jenë tranzitore dhe nevojitet ndjekje në vazhdim dhe hulumtim diagnostik i kujdesshëm për konfirmim ose jo të diagnozës. Menaxhimi konsiston në disa principe në frenimin e katabolizmit duke ndërprerë proteinat në mënyrë tranzitore, ndërprerjen e rrugës enterale të ushqyerjes deri në qartësim të çrregullimit. Trajtmi me infuzion me glukozë 10% intravenoz me ritëm 1, 5 x të nevojave ditore, korrigjimi i acidozës, trajtimi i hyperamonemisë, evitimi i periudhave të gjata fasting, konsulta multidisiplinare me metabolistë, gjenetistë.
Konkluzion: Çrregullimet metabolike kanë një prezantim variabël deri në dekopensim akut jetëkërcënues. Njohja e hershme e shenjave jo specifike klinike dhe laboratorike që shpesh shoqëron këto çrregullime, ndihmon në uljen e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë.

Fjalë kyçe: insuficiencë respiratore akute, çrregullime metabolike, dekompesim, proteina.

PËRTEJ GLP - 1: EFIKASITETI I AGONISTËVE TË DYFISHTË GIP / GLP - 1 NË MENAXHIMIN E PESHËS.

Inva Sulejmani MD
Spitali Salus, Departamenti i Endokrinologjisë dhe Diabetologjisë, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Hyrje: Obeziteti është një sëmundje kronike me përfshirje multisistemike dhe rrezik të shtuar për patologji kardiovaskulare, diabet tip 2 dhe disa lloje kanceri. Trajtimet farmakologjike janë avancuar falë agonistëve të receptorëve të inkretinës, veçanërisht GLP - 1 RA. Së fundmi, tirzepatidi, agonist i dyfishtë i receptorëve GIP dhe GLP - 1, ka tërhequr vëmendje si alternativë më e fuqishme në krahasim me semaglutidën. Përveç përmirësimit të kontrollit glikemik, ky agjent ka treguar potencial të lartë në reduktimin e peshës trupore. Kjo ngritje terapeutike ngre pyetjen: a po ndryshon hierarkia e trajtimeve për obezitetin?
Objektiva: Të krahasohet efikasiteti i tirzepatidit me semaglutidën në reduktimin e peshës trupore përmes një meta - analize të të dhënave klinike dhe reale.
Materiale dhe Metoda: U realizua një meta - analizë që përfshiu dy RCT dhe pesë studime retrospektive me gjithsej 142, 811 pjesëmarrës. U përdor model me efekte të rastësishme për të llogaritur ndryshimin mesatar të peshës trupore, si dhe analiza të nëngrupeve sipas dozës dhe kohëzgjatjes së trajtimit**.**
Rezultate dhe Diskutime: Tirzepatidi rezultoi më efektiv në reduktimin e peshës trupore krahasuar me semaglutidën (MD = –4. 23%, CI 95%: –5. 25 deri –3. 22; P < 0. 01). Efekti ishte më i theksuar me doza >10 mg dhe trajtim >6 muaj. Superioriteti u ruajt në të gjitha nëngrupet, duke reflektuar mekanizmin e dyfishtë të veprimit.
Konkluzione: Tirzepatidi tregon efikasitet të shtuar në reduktimin e peshës dhe përfaqëson një opsion premtues në menaxhimin e obezitetit, veçanërisht kur GLP - 1 RA nuk është efektiv.
Rekomandime: Duke qenë se tirzepatidi ofron përfitime domethënëse, rekomandohet përfshirja e tij në udhëzimet klinike për obezitetin, sidomos për pacientët me BMI >30 kg / m² dhe bashkësëmundshmëri metabolike. Nevojiten studime afatgjata për të vlerësuar sigurinë dhe vendin e tij në algoritmet ekzistues. Qasja në këtë terapi duhet të garantohet përmes politikave të qarta të rimbursimit, për të realizuar ndikim real në nivel popullate**.**
Fjalë kyçe: tirzepatidi, RCT, obeziteti, semaglutid.

FIZIOTERAPIA NË MOSHËN PEDIATRIKE ME ÇRREGULLIMET E SPEKTRIT TË AUTIZMIT.

Prof. Dr. Irena Kola[1], Msc. Errda Shehu[2]
[1]*Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike;*
[2]*Up'n'Up Physio*

Abstrakt
Hyrje: Autizmi është një çrregullim kompleks neurologjik dhe zhvillimor me manifestim në fëmijërinë e hershme, i karakterizuar me simptoma në tre fusha të zhvillimit: ndërveprim social, komunikim dhe sjellje. Besohet se fizioterapia tek këta pacientë mund të kontribuojë në zhvillimin motorik, aktivizimin e përqëndrimit dhe integrimin social.
Objektivi: Qëllimi i këtij studimi është efektiviteti i fizioterapisë në përmirësimin e simptomave dhe motorikës te fëmijët me ASD.
Metodologjia: Hulumtimi ka qasje krahasuese ku 2 pacientët e marrë në studim janë 2 fëmijë të moshës pediatrike 5 vjeç, me gjatësi 100 / 102 cm dhe peshë trupore 17 / 18 kg të gjinisë mashkullore, të cilët janë diagnostikuar me ASD por nuk kanë kryer seanca fizioterapie më përpara. Instrumentat e përdorur për vlerësimin e dy pacientëve janë 2 teste: CARS (Shkalla e vlerësimit të autizmit te fëmijët) dhe FIM (Matja e Pavarësisë Funksionale). Seancat e fizioterapisë u zhvilluan për të dy pacientët 2 herë në javë me kohëzgjatje 30 - 40 min.
Rezultate: Integrimi i teknikave të fizioterapisë dhe strategjive sensore tregojnë rritje të pikëve të grumbulluar në të dyja testet nga të dy pacientët duke rritur pavarësinë në funksionalitetin e tyre.
Përfundime: Përmirësimet e vërejtura sugjerojnë efektivitetin e mundshëm të integrimit të teknikave fizioterapeutike dhe strategjive sensoriale. Hulumtime të mëtejshme me mostra më të mëdha janë thelbësore për të vërtetuar dhe zgjeruar këto rezultate paraprake.

Fjalët kyçe: ASD, fizioterapi, rehabilitim, deficit motor.

PËRTEJ TROMBOZËS: HIPERTENSIONI PORTAL I MAJTË NË TERREN TË INFLAMACIONIT KRONIK.

Irgen Tafaj[1], Frenkli Tushi[1], Oksana Allko[1]
[1]*Shërbimi Gastroenterologji - Hepatologji, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë*

Abstrakt
Hyrje: Hipertensioni portal i majtë (HTPM) paraqet një formë të rrallë të hipertensionit portal segmentar, zakonisht si pasojë e obstruksionit të venës lienale nga patologjitë e pankreasit. Megjithëse efekti masë ose tromboza e shkaktuar nga pseudokistet e mëdha janë shkaqe të njohura, ky rast vë në dukje një mekanizëm më pak të raportuar, inflamacionin kronik dhe fibrozën perivenoze, të cilat mund të shkaktojnë pengesë funksionale të venës lienale.
Rast klinik: Një pacient mashkull 49 - vjeçar, me histori pankreatiti kronik alkoolik, abstinent nga alkooli për më shumë se dy vjet dhe duhanpirës i rëndë, u paraqit me dhimbje të vazhdueshme në anën e majtë të barkut. Ai kishte pasur një pseudokist pankreatik tre vite më parë, i cili ishte zgjidhur pa ndërhyrje. Tomografia e kompjuterizuar me kontrast zbuloi një lezion me pamje cistike në segmentin kaudal të pankreasit, që shtrihej drejt fosës iliake të majtë dhe ishte në vazhdimësi me lokalizimin e pseudokistit të mëparshëm. Vena lienale rezultoi me diametër të reduktuar, por e hapur, pa shenja tromboze. U evidentuan variçe perigastrike dhe splenomegali. Endoskopia e sipërme konfirmoi praninë e variçeve ezofageale fillestare dhe gastropatisë hipertensive portale. Pacienti u trajtua në mënyrë konservative për shkak të mungesës së komplikimeve hemorragjike apo hematologjike.
Diskutim: Ky rast tregon se inflamacioni kronik dhe fibroza përreth venës lienale, edhe në mungesë të trombozës ose efektit të dukshëm masiv, mund të rezultojnë në zhvillimin e HTPM. Gjetjet radiologjike dhe endoskopike mbështesin ekzistencën e një pengese funksionale. Njohja e këtij mekanizmi është e rëndësishme për diagnozën e hershme dhe menaxhimin konservativ të rasteve të përzgjedhura.
Përfundimi: Ndryshimet inflamatore kronike të shkaktuara nga pseudokistet mund të nxisin zhvillimin e hipertensionit portal të majtë përmes fibrozës perivenoze, duke theksuar nevojën për ndjekje të rregullt afatgjatë me imazheri, edhe në rastet jo obstruktive të pankreatitit kronik.

Fjalë kyçe: HTPM, obstruksion, vena lienale, pseudokist, fibroza perivenoze.

RAST KLINIK: TUMOR NEUROENDOKRIN I RRALLË ME SHFAQJE METASTATIKE.

Irida Kecaj
Shërbimi i Mjekësisë Interne, QSU "Nënë Tereza", Tiranë.

Abstrakt
Hyrje: Tumoret neuroendokrine (NET) janë entitete neoplazike të rralla, me prevalencë rreth 2% në popullatën e përgjithshme. Origjinojnë nga qelizat e shpërndara të sistemit neuroendokrin dhe kanë një incidencë të ulët tek fëmijët dhe tek adultët. Mosha mesatare e diagnostikimit është dekada e pestë deri e gjashtë, ndërsa femrat preken pak më shpesh se meshkujt. Shfaqja klinike shpesh është e vonuar dhe me shenja jospecifike, çka kontribuon në diagnostikim të vonuar. Prognoza varet nga lokalizimi, përmasat dhe shkalla histologjike e tumorit; mbijetesa 5 - vjeçare raportohet mbi 90% në sëmundje lokale dhe bie në rreth 20% në rastet metastatike.
Rast klinik: Një paciente 74 - vjeçare u shtrua për dispne në efort minimal, diskomfort torako - abdominal dhe edema të gjymtyrëve të poshtme. Pas përjashtimit të trombembolisë pulmonare dhe sindromës koronare akute, ekzaminimet imazherike (eko abdominale, CT total body, MRI abdominale) ngritën dyshimin për tumor të kolecistës me përhapje hepatike. Tru - cut biopsia e lezioneve hepatike evidentoi infiltrat karcinomatoz nga karcinomë neuroendokrine. Rasti përfaqëson një NET të avancuar me manifestime të sindromës karcinoide dhe me vendndodhje primare të papërcaktuar.
Diagnoza dhe Menaxhimi: Diagnoza përfundimtare u vendos përmes ekzaminimit histopatologjik dhe imunohistokimik, të cilat konfirmuan diferencimin neuroendokrin. Menaxhimi në këto raste mbështetet në qasje multidisiplinare, duke përfshirë onkologë, patologë dhe radiologë. Kur vendndodhja primare nuk identifikohet, trajtimi udhëhiqet nga grada histologjike, aktiviteti hormonal, ekspresioni i receptorëve të somatostatinës dhe ngarkesa tumorale. Opsionet terapeutike përfshijnë analogët e somatostatinës, terapitë e synuara, kimioterapinë ose trajtime të drejtuara në mëlçi në rastet metastatike.
Përfundime: Rritja e incidencës së NET - eve thekson nevojën për vigjilencë të shtuar klinike. Njohja e hershme dhe qasja multidisiplinare janë thelbësore, ndërsa ekzaminimet molekulare dhe imunohistokimike mbeten instrumente kyç për karakterizimin dhe menaxhimin optimal të sëmundjes.

Fjalë kyçe: Tumor neuroendokrin, metastaza hepatike, tru - cut biopsi, imunohistokimi

REHABILITIMI I LIGAMENTIT KRUCIAT ANTERIO NË KONTEKSTIN E OSTEOGENEZËS IMPERFEKTE.

Dr. Sh. M. Iris Myftiu, Luljeta Stanaj.
Spitali Universitar i Traumës, Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt
Hyrje: Osteogeneza imperfekte (OI) është një sëmundje kongenitale me karakter sistemik dominant trashëgimor, e shkaktuar nga mutacionet e gjeneve *COL1A1* dhe *COL1A2*. Klinikisht, pacientët paraqesin kocka të brishta, lëkurë të hollë, hemorragji muskulare, hiperlaksitet artikular, sklerë me ngjyrë blu, dentinogjenezë imperfekte dhe dëmtime të dëgjimit, zakonisht në tipin I. Diagnoza vendoset nëpërmjet ekzaminimeve gjenetike, amniocentezës gjatë jetës intrauterine, si dhe përmes vëzhgimit të ndryshimeve sklerale. Diagnoza mbështetet gjithashtu nga ekzaminimet radiografike. Nuk ekziston një trajtim specifik; menaxhimi është simptomatik dhe terapeutik, duke përfshirë përdorimin e bisfosfonateve për osteoporozën, pajisjeve ortotike, fizioterapisë, dhe në rastet e rënda, ndërhyrjes kirurgjikale.
Paraqitja e rastit: Pacienti me inicialet Xh. C. , 28 vjeç, me histori të osteogenezës imperfekte kongenitale, tipi III. Në anamnezën morbi, raporton një traumë të lehtë që rezultoi në frakturë maleolare të fibulës së djathtë, si dhe rupturë të ligamentit të kryqëzuar anterior dhe të meniskut medial të të njëjtit këmbë. Pacienti është paraqitur në një spital në Gjermani në mars 2024. Është kryer osteosintezë me pllakë dhe vida, si dhe është aplikuar imobilizim me gips për frakturën maleolare. Për rupturën e ligamentit kruciat anterior, u aplikua ortezë për dy javë. Pas dy javësh, u realizua artroskopi kirurgjikale me përdorimin e një transplanti tendinoz të marrë nga muskujt hamstring. Ekstremiteti u imobilizua me gips për katër javë.

Objektiva: Të evidentojë rolin e rehabilitimit post - rekonstruktiv të ligamentit kruciat anterior në kontekstin e osteogenezës imperfekte, përmes rezultateve të arritura. Të vlerësojë: amplitudën e lëvizjes artikulare (ROM) të gjurit para dhe pas terapisë, forcën muskulare, masën muskulare, si dhe nivelin e dhimbjes.
Metodologjia: Studimi është raport klinik rasti. Rehabilitimi është zhvilluar gjatë periudhës maj – korrik 2025. Në këtë studim është trajtuar një pacient që ka kryer rekonstruksion të ligamentit kruciat anterior me tendinën e hamstring - ut, në kontekstin e osteogenezës imperfekte. Subjekti është trajtuar në një klinikë fizioterapie ambulatore për katër javë, me pesë seanca në javë, dhe për dy javë të tjera me frekuencë dy seanca në javë. Çdo seancë fizioterapie zgjati 60 minuta dhe përfshinte modalitete terapeutike si stimulimi elektrik i muskujve (EMS – 20 minuta). Progresi funksional u vlerësua çdo javë përmes matjes së dhimbjes, amplitudës së lëvizjes artikulare me goniometër, forcës muskulare (kur ishte e mundur) dhe vlerësimit sipas shkallës MRS (0–5). Qëllimi i rehabilitimit ishte arritja e stabilitetit funksional, rikuperimi dhe ruajtja e forcës muskulare.
Përfundime: Dëmtimet e ligamentit kruciat anterior shkaktojnë instabilitet anterior të artikulacionit të gjurit — veçanërisht kur ndodhin në sfondin e osteogenezës imperfekte, gjë që e bën trajtimin më delikat dhe kërkon kujdes të shtuar. Rehabilitimi fizioterapeutik i ligamentit kruciat anterior në këtë rast ka luajtur një rol thelbësor në rikthimin e funksionalitetit artikular dhe muskulor, si dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientit.

Fjalë kyçe: Osteogeneza imperfekte, rupture, ligamenti kruciat anterior, rehabilitim fizioterapeutik.

SHËNDETI RIPRODHUES MASHKULLOR TE PACIENTËT ME LES DHE SPONDILIT ANKILOZANT.

Prof. Asoc. Ismet H. Bajraktari[1], Arianit Bajraktari
[1]Profesor i Mjekësisë Interne - Reumatologjisë, AMECC, Rezonanca - Ordinanca Internistike - Reumatologjike, PRORHEUMA

Abstrakt
Hyrje*:* Sponfiliti ankilozant dhe Lupusi eritematoz sistemik janë sëmundje inflamatore me veprim sistemik në organizmin e njeriut, e rrjedhimisht edhe në shëndetin reproduktiv mashkullor.
Qëllimi: Ky studim kishte për qëllim të hulumtonte prevalencën, faktorët primar, sekondar dhe veprimin e barnave me të cilat trajtohen këto sëmundje në shëndetin riprodhues mashkullor.
Materiali dhe metodat: Nga rishikimi i literaturës dhe hulumtimeve në databazat shkencore botërore kemi identifikuar shkaktarët dhe prevencën e shëndetit riprodhues mashkullor.
Rezultatet: Nga veprimi i mekanizmave inflamator disfunksioni seksual, disfunksioni erektil, veprimi i mekanizmave autoimun në fertilitetin mashkullor nga LES dhe SpA, dëmtimi në cilësi dhe sasi i numrit të spermatozoideve, varikocelat, barnat me veprimine tyre mutagjen dhe teratogjen, insuficienca hormonale, antitrupat kundër spermatozideve janë parametrat bazë të dëmtimit të shendetit riprodhues mashkullor nga LES dhe SpA.
Përfundime: Zvoglimi i sasisë, lëvizshmërisë dhe numrit të spermatozoideve është prezentë te numri më i madh i pacientëve me SpA dhe LES. Sa më e lartë që është shkalla e inflamacionit, aq më e madhe është shkalla e dëmtimit të shëndetit riprodhues. Në trajtimin farmakologjik të pacientëve duhet marr parasysh gjendja familjare e burrave dhe nevojat e planifikimit familjar të tyre. Çrregullimet e shëndetit riprodhues janë problem më i rendë social i pacientëve dhe familjes së tyre. Gjithmonë kur kemi para vetes një pacient të moshës së re apo të mesme duhet të marrim në konsideratë raportet intime, gjendjen dhe planifikimin familjar të tyre.

Fjalë kyce: riprodhim, inflamacion, disfunksion, spermogram, hormone.

VLERËSIMI I PËRHAPJES SË KANCERIT TË PROSTATËS DUKE PËRDORUR PSMA PET / CT NË KOMBINIM ME MRI.

Jakub Xhigoli

Abstrakt
Hyrje: Kanceri i prostatës është një nga sëmundjet më të zakonshme malinje tek meshkujt dhe përbën një sfidë të madhe për sistemet shëndetësore, veçanërisht për shkak të nevojës për stadifikim të saktë dhe vendimmarrje

të personalizuar terapeutike. Metodat tradicionale të imazherisë kanë kufizime në detektimin e përhapjes së sëmundjes, veçanërisht për mikrometastaza. PSMA PET / CT dhe rezonanca magnetike (MRI) janë dy teknologji të avancuara që ofrojnë vlerësim të saktë anatomik dhe funksional të sëmundjes.
Qëllimi: synon të analizojë literaturën e disponueshme mbi efikasitetin e kombinimit të PSMA PET / CT me MRI në diagnostikimin dhe stadifikimin e kancerit të prostatës, duke përqëndruar vëmendjen në grumbullimin, vlerësimin dhe analizimin e të dhënave nga burime të ndryshme.
Metodologjia: përfshin rishikim të literaturës shkencore ndërkombëtare mbi përdorimin e PSMA PET / CT dhe MRI në vlerësimin e përhapjes së kancerit të prostatës. Janë analizuar studime relevante të publikuara pas vitit 2015, të zgjedhura nga databaza të njohura si PubMed, ScienceDirect dhe Web of Science, duke u fokusuar në ndjeshmërinë, specificitetin dhe vlerën klinike të secilës metodë dhe të kombinimit të tyre.
Rezultate: të gjeturat përfshijnë që PSMA PET / CT ka treguar ndjeshmëri dhe specifikitet të lartë në detektimin e metastazave, veçanërisht limfatike dhe kockore, ndërsa MRI është shumë e dobishme për vlerësimin e përhapjes lokale dhe orientimin e biopsive të synuara. Kombinimi i të dyjave përmirëson ndjeshëm stadifikimin TNM dhe ndihmon në përzgjedhjen më të saktë të trajtimit. Në shumë raste, kjo qasje multimodale ka ndryshuar planin terapeutik në mënyrë domethënëse.
Përfundime: tregojnë se përdorimi i integruar i PSMA PET / CT dhe MRI përfaqëson një përparim të madh në diagnostikimin dhe menaxhimin e kancerit të prostatës. Kjo qasje hibride ofron një vlerësim më të saktë të përhapjes së sëmundjes, ndihmon në shmangien e nën - ose mbistadifikimit dhe përmirëson ndjeshëm marrjen e vendimeve terapeutike të personalizuara.

Fjalë kyçe: Kanceri i prostatës, PSMA PET / CT, MRI, stadifikim, metastaza, imazheri molekulare.

ROLI I AI DHE PET / CT RADIOMICS TEK KANCERI I MUSHKËRIVE.

Dr. Januz Gashi
Doktor i mjekësisë

Abstrakt
Inteligjenca artificiale (AI) përfaqëson një teknologji të rëndësishme shumë inovative. Edhe pse ka pasur shumë debate për ndikimin e Inteligjencës artificiale në karrierën e mjekëve, megjithatë ajo ka rritur mundësinë në avancim të njohurive si dhe ka gjetur përdorim të duhur në zhvillimin e Mjekësisë diagnostike në kuadër të përparimit në diagnostikim, statistikë, analizim të imazheve si dhe ka rritur përgjegjësitë dhe njohuritë edhe të stafit teknik. Përdorimi i AI dhe PET / CT radiomics tek kanceri i mushkërive mund të japin rezultat në diagnostikimin, vlerësimin e përgjigjes ndaj trajtimit dhe parashikimin e rezultateve përfundimtare tek pacientët me kancer të mushkërive. Në këtë shkrim do të trajtohen specifikisht disa punime metaanalizë të kryera nga autorë të huaj në lidhje me përdorimin e AI dhe PET / CT RADIOMICS dhe rolin e tij tek kanceri i mushkërive.

Fjalë kyçe: Inteligjenca artificiale, PET / CT, kancer mushkërive.

ROLI I INDEKSIT TRIGLICERIDE / GLUKOZË NË VLERËSIMIN E RREZIKUT KARDIOVASKULAR.

Jehona Ali

Abstrakt
Sëmundjet kardiovaskulare përbëjnë shkakun kryesor të vdekshmërisë në botë dhe incidenca e tyre është rritur në mënyrë të konsiderueshme gjatë dekadave të fundit. Nivelet e larta të glukozës dhe trigliceridreve në gjendje esëll janë të lidhura ngushtë me zhvillimin e patologjive kardiometabolike dhe përfaqësojnë faktorë të rëndësishëm rreziku. Indeksi trigliceride - glukozë (TyG), është pozitivisht i lidhur me një sërë faktorësh kardiometabolikë dhe nivelet e tij të larta shoqërohen me prevalencë më të madhe të sëmundjeve të arteries koronare, sindromës metabolike dhe diabetit të tipit 2. Në këtë studim retrospektiv janë përfshirë 568 pacientë me patologji kardiovaskulare dhe një grup kontroll i përbërë nga 50 individë të shëndetshëm, tek të cilët u përcaktuan nivelet e glukozës dhe trigliceridreve, ndërsa indeksi TyG u llogarit me formulën standarde. Rezultatet treguan se pacientët me sëmundje kardiovaskulare kishin vlera dukshëm më të larta të glukozës,

triglicerideve dhe indeksit TyG në krahasim me grupin kontroll, me diferenca të rëndësishme statistikisht. Mesatarja e indeksit TyG rezultoi dukshëm më e lartë në grupin me sëmundje kardiovaskulare, duke reflektuar lidhjen e ngushtë të këtij treguesi me këto patologji. Rezultatet mbështesin përdorimin e indeksit TyG si një tregues të vlefshëm dhe praktik për identifikimin dhe parashikimin e rrezikut kardiovaskular. Ky indeks mund të shërbejë si parametër ndihmës në praktikën klinike për vlerësimin e hershëm të pacientëve me predispozitë për sëmundje kardiovaskulare.

Fjalë kyçe: Indeksi trigliceride - glukozë (TyG), sëmundje kardiovaskulare, glukozë, trigliceride.

RADIOLOGJIA E SË ARDHMES: INTELIGJENCA ARTIFICIALE DHE AUTOMATIZIMI QË TRANSFORMOJNË DIAGNOSTIKIMIN.

Prof. Asst. Jeton Shatri, Prof. Asst. Kreshnike Dedushi - Hoti, Jona Kosova, Antigona Kabashi, Vloriana Arifaj, Diar Kabashi

Abstrakt

Hyrje: Radiologjia moderne po përballet me një rritje eksponenciale të volumit të imazherive dhe presion të lartë për diagnostikim të shpejtë, të saktë dhe të standardizuar. Këto sfida po nxisin nevojën për zgjidhje të avancuara që përmirësojnë rrjedhën e punës dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor. Inteligjenca artificiale (IA) dhe automatizimi i proceseve po paraqiten si mjete transformuese në këtë drejtim.

Qëllimi: Ky studim synon të analizojë ndikimin e automatizimit dhe të inteligjencës artificiale në përmirësimin e efikasitetit operacional të radiologjisë, me fokus në pajisje diagnostike, procesin e raportimit dhe integrimin ndërmodal të të dhënave imazherike.

Metoda: Është kryer një rishikim sistematik i zhvillimeve të fundit në teknologjitë e automatizuara dhe algoritmet e IA në radiologji. Janë analizuar zgjidhje si "zero - click AI" që mundësojnë raportim automatik pas imazherive CT, MR dhe X - ray; sistemet e integruara për bashkimin e imazheve nga modalitete të ndryshme (p. sh. 3D, multiformat); si dhe automatizimi i parametrave të skanimit dhe pozicionimit të pacientit. Studimi përfshin krahasim të kohës së raportimit, shkallës së gabimeve diagnostike dhe kosto - efikasitetit ndërmjet institucioneve që përdorin këto teknologji dhe atyre që ende aplikojnë qasje tradicionale.

Rezultatet: Pritet një reduktim domethënës në kohën nga imazheria deri te raporti përfundimtar, rritje të saktësisë diagnostike dhe standardizimit të raporteve, si dhe ulje të ngarkesës së punës dhe stresit profesional tek radiologët. Implementimi i këtyre teknologjive mund të ketë ndikim të veçantë pozitiv në mjedise me burime të kufizuara.

Përfundime: Integrimi i inteligjencës artificiale dhe automatizimit në radiologji ka potencial të lartë për të transformuar praktikën klinike, duke e bërë procesin diagnostik më efikas dhe të qëndrueshëm. Megjithatë, suksesi i zbatimit kërkon investim në infrastrukturë teknologjike, trajnime të personelit, mirëmbajtje të vazhdueshme dhe siguri të plotë të të dhënave për përputhshmëri me standardet etike dhe ligjore.

Fjalë kyçe: Inteligjenca artificiale, Radiologjia moderne, diagnostikim.

KORRELACIONI NDËRMJET NDRYSHIMEVE NË PARAMETRAT RADIOLOGJIKË CERVIKAL DHE ASIMETRISË FACIALE.

Joana Hankollari[1], Nikollaq Leka[2]
[1]*Albanian University Tiranë,*
[2]*Universiteti i Mjekësisë Tiranë*

Abstrakt

Hyrje: Në praktikën e përditshme si mjeke reumatologe, ndër patologjitë më të shpeshta që trajtoj janë ato të regjionit cervikal të kolonës. Në disa raste të paraqitura me ndryshime posturale të kolonës vertebrale cervikale, ka qënë shumë e dukshme dhe prania e asimetrisë faciale. Ky studim synon të evidentojë ndryshimet morfometrike të kolonës vertebrale cervikale dhe korrelacionin e tyre me asimetrinë faciale. Evidentimi i një korrelacioni të mundshëm do të kishte një rëndësi shumë të madhe nga ana klinike, pasi mjekët që trajtojnë

patologjitë e kolonës cervikale do të ishin më vigjilentë dhe ndaj problematikave të lidhura me asimetrinë faciale.
Metodologjia: Në këtë studim prospektiv u përfshinë 32 pacientë të moshës 18 - 64 vjeç, të cilët paraqitën ankesa të lidhura me kolonën cervikale. Parametrat cervikale që u matën përmes radiografisë cervikale për secilin pacient përfshinë: CL, T1S, TIA, NT, C2–C7 SVA, përkuljen cervikale dhe kraniale. Asimetria faciale u vlerësua përmes inspeksionit dhe cefalometrisë postero - anteriore.
Rezultate: Ndryshimet në parametrat radiografikë cervikal u evidentuan në 53. 13% të pacientëve. Parametrat që patën më shumë alterime ishin: CL, T1S, SVA C2–C7, përkulja cervikale dhe kraniale. Asimetria e fytyrës u evidentua në 64. 71% të pacientëve që patën ndryshime në këto parametra, ndërsa vetëm 20% e rasteve pa alterime në parametrat radiologjikë cervikal kishin asimetri të fytyrës.
Konkluzione: Asimetria e fytyrës është më e përhapur tek pacientët me ndryshime në parametrat radiologjikë cervikal krahasuar me pacientët pa ndryshime në parametrat radiologjikë cervikal.

Fjalë kyçe: korrelacion, parametra radiologjikë, cervical, asimetri faciale.

EFIKASITETI I NJË PROGRAMI USHTRIMOR TË PERSONALIZUAR DHE EDUKIMI I PRINDËRVE TEK NJË FËMIJË 19 MUAJSH, ME VONESA TË ZHVILLIMIT MOTORIK - RAST KLINIK.

Prof. Asoc. Alma Nurçe[1], MSc. Jola Çini[2],
[1]*Universiteti i Mjekësisë*
[2]*Universiteti Barleti*

Abstrakt
Hyrje: Dobësia muskulare dhe tonusi i ulët në fëmijërinë e hershme mund të shkaktojnë vonesa të zhvillimit motorik dhe probleme me ekuilibrin. Rrëzimet e shpeshta rrisin frikën e lëvizjes duke reduktuar vetëbesimin dhe ecjen spontane. Ndërhyrjet e hershme fizioterapeutike dhe edukimi i prindërve për një pjesëmarrje aktive në këtë proces luajnë një rol thelbësor.
Qëllimi: Vlerësimi i efikasitetit të një programi të personalizuar ushtrimor dhe edukimi i prindërve për pjesëmarrje aktive në të, tek një fëmijë 19 muajsh.
Metodologjia: Prezantohet një rast klinik, vajzë, 19 muajshe. Pas vlerësimit objektiv nga fizioterapisti u vu re tonus i ulët muskular, dobësi muskulare, vështirësi në ruajtjen e ekuilibrit dhe ecje vetëm me ndihmë. Prindërit referojnë se vajza në muajin e 16 - të, sapo filloi të hidhte hapat e parë e pavarur, rrëzohet. U hartua një plan ushtrimor i fokusuar në stabilitetin e trungut; forcimin e muskujve të ekstremiteteve dhe trajnimi i balancës. Gjithashtu u bë edhe edukimi i prindërve për kryerjen e duhur të ushtrimeve në shtëpi, çdo ditë, për 4 javë, me sete ushtrimore prej 20 minutash, 2 - 3 sete çdo ditë. Prindërit për shkak të distancës (Maqedoni) paraqiteshin 1 herë / javë për vlerësim objektiv tek fizioterapisti.
Rezultate: Pas 4 javësh, fëmija tregoi përmirësime shumë të mëdha në funksionin motorik gros si ecja e pavarur në distanca të shkurtra, përmirësimi i balancës, forcës dhe tonusit muskular, përmirësimi i ecjes këmbadorasi dhe stabilitetit të trungut.
Rekomandime: Vlerësimi dhe ndërhyrja e hershme fizioterapeutike, së bashku me edukimin e prindërve janë shumë efektive në progresin e zhvillimit në vitet e para të jetës. Kontrollet periodike dhe mbikëqyrja nga fizioterapisti është kombinimi i duhur për arritjen e gurëve zhvillimorë në kohë.

Fjalë kyçe: ndërhyrje e hershme, fizioterapi, ecje, edukim i prindërve, ushtrime.

TORSIONI ADNEKSIAL GJATË GRAVIDANCËS: DY RASTE KLINIKE TË RRALLA.

Dr. Jon Cane[1], Dr. Era Kurti[2]
[1]*Mjek obstetër - gjinekolog, Spitali Rajonal Lezhë, Lezhë*
[2]*Mjeke pediatre endokinologe, Qëndra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë*

Abstrakt
Hyrja: Torsioni adneksial i izoluar është një patologji që haset rrallë gjatë zhvillimit të gravidancës, më

specifikisht 1 rast në 120 000 shtatzëni (Hasson et al. , 2022). Vetëm 12% e rasteve në total të torsionit tubar hasen gjatë shtatzënisë (Varras et al. , 2003). Me arritjen e termit gjatë gravidancës kjo mundësi është edhe më e vogël si pasojë e rritjes së volumit uterin dhe lëvizshmërisë të kufizuar të adekseve. Diagnoza diferenciale e patologjisë gjatë gravidancës ngelet sfiduese dhe komplekse ndërkohë që spektri i patologjike obstetrikale, kirurgjikale dhe gjinekologjike mbivendosen.
Objektiva: Të analizojme simptomatologjinë, klinikën, diagnozën dhe menaxhimin e dy rasteve të torsionit adneksial të izoluar gjatë tremestrit të tretë të gravidancës dhe kompleksitetin e lartë të situatës. Të kryejmë rishikimin e literaturës më bashkëkohore në lidhje me torsionin adneksial gjatë gravidancës.
Materiale dhe Metoda: Janë analizuar dy raste paraqitur në urgjencë në trimestrin e III - të të gravidancës. Janë shfrytëzuar burimet e udhëzuesve klinike, studimet e viteve të fundit për patologjinë e torsionit adneksial për të dalë në rekomandime mbi këtë patologji në shtatzëni.
Rezultate: Pacientet janë paraqitur pranë urgjencës së maternitetit me dhimbje abdominale. Në vlëresimin e gravidancave nuk paraqiten probleme akute obstetrikale. Me pas vleresimi ka vazhduar me konsultat kirugjikale. Kompleksiteti i situatës ka qënë i lartë për shkak të shtatzënisë (nje prej rasteve prematur 35 javë) dhe riskut të komplikacioneve të vetë situatës mbi të. Te dy rastet i janë nënshtruar interventit nga ku është konstatuar torsioni adneksial i izoluar.
Konkluzione: Torsioni i izoluar adkesial gjatë gravidancës megjithëse i rrallë si patologji duhet konsideruar në spektrin e kolikave abdominale duke i diferencuar ato qartazi nga spektri obstetrikal i situatës. Diagnoza e hershme dhe ndërhyrja në kirurgjikale kohen e duhur parandalojnë dëmtimin ishemik të adekseve dhe rrisin mundësinë për një outcome feto - maternal më të mirë.
Rekomandime: Rekomandojmë vëmendje ndaj patologjive gjinekologjike gjatë periudhës së gravidancës duke theksuar se torsioni tubar mund të paraqitet me simptoma atipike. Bashkëpunimi multidisiplinar midis obstetër - gjinekologëve, radiologëve dhe kirurgëve është kritik për rezultate sa më të sukesshme.

Fjalë kyçe: gravidancë, prematur, feto - maternal, torsioni adneksial, dhimbje abdominale.

TRAJTIMI ENDOSKOPIK I RUPTURAVE TË MENISKEVE TË GJURIT.
Jon Vula

Abstrakt
Hyrje: Menisku luan një rol thelbësor në stabilitetin dhe funksionin biomekanik të artikulacionit të gjurit, dhe dëmtimet e tij janë ndër patologjitë më të shpeshta ortopedike që kërkojnë trajtim kirurgjikal. Zhvillimet e fundit në fushën e artroskopisë kanë transformuar qasjen terapeutike ndaj këtyre dëmtimeve, duke mundësuar ndërhyrje më precize, më pak invazive dhe me rezultate më të mira afatgjata.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të paraqesë rëndësinë, efikasitetin dhe avantazhet e trajtimit endoskopik në menaxhimin e rupturave të meniskeve të gjurit, duke e krahasuar me kirurgjinë tradicionale të hapur.
Kirurgjia endoskopike (artroskopia) është një metodë moderne minimale invazive, e cila përmes një kamere të vogël dhe instrumenteve të specializuara, lejon vizualizim të drejtpërdrejtë të strukturave intraartikulare dhe trajtim të menjëhershëm të dëmtimit. Krahasuar me kirurgjinë e hapur, kjo metodë karakterizohet nga një numër përparësish të rëndësishme: inçizion minimal që shmang prerjet e mëdha dhe traumën e indeve, reduktim të ndjeshëm të rrezikut për infeksione për shkak të hapjes së kufizuar, kohë më të shkurtër rikuperimi dhe kthim të shpejtë të pacientit në aktivitetet e përditshme, dhimbje postoperative më të lehta si dhe një rezultat estetik shumë më të kënaqshëm për shkak të shenjave minimale kirurgjikale. Një tjetër përparësi e artroskopisë është kombinimi i funksioneve diagnostike dhe terapeutike në të njëjtën ndërhyrje. Kjo lejon vlerësim të saktë të strukturave intraartikulare, identifikim të dëmtimeve të tjera të mundshme dhe trajtim të menjëhershëm pa nevojën e ndërhyrjeve shtesë. Përveç efikasitetit të lartë, kjo metodë redukton ndjeshëm qëndrimin spitalor dhe kostot e trajtimit.
Përfundime: Trajtimi endoskopik i rupturave të meniskeve të gjurit përfaqëson standardin bashkëkohor në kirurgjinë ortopedike, duke garantuar efikasitet të lartë, siguri më të madhe dhe përmirësim të ndjeshëm të cilësisë së jetës së pacientëve. Përparësitë e shumta klinike, estetike dhe funksionale e vendosin këtë metodë si zgjedhjen e parë për trajtimin e dëmtimeve meniskale në praktikën moderne mjekësore.

Fjalë kyçe: trajtim endoskopik, aetroskopia, funksionin biomekanik, menisk.

ROLI I TESTEVE LABORATORIKE NË DIAGNOSTIKIMIN DHE MENAXHIMIN E PCOS.

Jona Bërdufi
Msc. Teknik Laboratori

Abstrakt

Hyrje: Sindroma e vezoreve policistike (PCO - S) është një çrregullim hormonal i shpeshtë tek femrat në moshën riprodhuese. Karakterizohet nga cikle menstruale të çrregullta, të rralla apo edhe me nivele të larta të hormoneve mashkullore (androgjeneve). Ndodhen rastet kur në vezore krijohen qeska të vogla të shumta, të mbushura me likid dhe të vendosura kryesisht në shtresën periferike të saj (ndryshe të quajtura mikrokiste). Prezenca e tyre shkakton çrregullime të ciklit menstrual dhe në disa raste edhe mungesë të ovulacionit. **Qëllimi:** Të informohet mbi rolin që testet laboratorike kanë në pacientet që diagnostikohen me PCOS. Të indentifikohen llojet e testeve laboratorike më efikase. Të ketë një protokoll mbi ndjekjen e procedurave për sa i përket trajtimit të PCOS.

Metodologjia: Për këtë studim janë marrë 81 raste nga një laborator jopublik në qytetin e Elbasanit.

Rezultate: Nga rastet e përzgjedhura, 59 raste rezultuan pozitive për Sindromën e Ovareve Policistike falë kryerjes së analizave hormonale dhe metabolike së bashku me ultratingullin. Përzgjedhja e moshës është >18. Ka rezultuar që femrat më të prekura janë grupmosha 18 - 29 vjeç.

Konkluzione: Nga studimi arritëm në konkluzionin se PCOS është një sëmundje komplekse e cila mund të prekë këdo në moshën e pjekurisë fertile.

Nga ekzaminimet laboratorike rezultoi që testet hormonale dhe metabolike ndihmojnë mjaft qartë në vendosjen e diagnostikimit dhe menaxhimit.

Fjalë kyçe: PCOS, femra, analiza laboratorike, hormone.

MRI DHE SPEKTROSKOPIA TEK FËMIJËT ME ÇRREGULLIME METABOLIKE: GJETJE KARAKTERISTIKE DHE KORRELACION KLINIK.

Ass. Dr. Jona Kosova

Abstrakt

Hyrje: Çrregullimet metabolike pediatrike janë sëmundje të rralla me simptoma neurologjike të paqarta dhe progresive. Diagnostikimi i hershëm është i domosdoshëm për menaxhim efektiv dhe parandalimin e dëmtimeve cerebrale. MRI dhe MRS luajnë një rol kyç në identifikimin e ndryshimeve strukturore dhe metabolike të trurit, duke ndihmuar diagnostikimin diferencial të këtyre sëmundjeve.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi ishte përshkrimi dhe karakterizimi i gjetjeve MRI dhe MRS tek fëmijët me çrregullime metabolike, si dhe vlerësimi i korrelacionit ndërmjet modeleve imazherike dhe manifestimeve klinike.

Metoda: Në këtë studim retrospektiv u përfshinë 45 fëmijë (mosha 0–12 vjeç) me diagnoza të konfirmuara të çrregullimeve metabolike. MRI u realizua duke përdorur sekuenca standarde (T1, T2, FLAIR) dhe spektroskopi (MRS). U vlerësua përfshirja e substancës gri, të bardhë dhe ganglioneve bazale. Të dhënat imazherike u krahasuan me referencat nga literatura ndërkombëtare.

Rezultate: Hiperintensitetet difuze të substancës së bardhë u identifikuan në 80% të rasteve, kryesisht në lobet frontal dhe parietal. Ndryshimet në ganglionet bazale u evidentuan në 60% të pacientëve. MRS tregoi rritje të sinjalit të laktatit dhe ulje të raportit glutamat / glutaminë në 71% të rasteve, në përputhje me gjetjet laboratorike biokimike.

Përfundimi: MRI dhe MRS janë mjete diagnostike thelbësore për identifikimin e hershëm dhe karakterizimin e çrregullimeve metabolike pediatrike. Kombinimi i tyre ofron informacion të vlefshëm për menaxhimin e personalizuar të pacientëve dhe përmirësimin e prognozës neurologjike.

Fjalë kyçe: Çrregullime metabolike, MRI, spektroskopi, fëmijë, substancë e bardhë, ganglione bazale, metabolizëm cerebral.

HER2 - LOW NË KANCERIN GASTRIK - NGA NEGATIVITETI NË NJË HORIZONT TË RI TERAPEUTIK.

Jona Prifti[1], Erlin Najtellari[1], Alketa Ymeri[1], Blerina Çela[3], Carmelo Pozzo[1, 2]
[1]*Departamenti i Onkologjisë, Spitali Italian SALUS*
[2]*Departamenti i Onkologjisë Mjekësore, Comprehensive Cancer Center, Fondazione Policlinico Universitario Agostino Gemelli IRCCS, Romë, Itali*
[3]*Departamenti i Anatomisë Patologjike, Spitali Italian SALUS*

Abstrakt
Hyrje: Roli i HER2 në kancerin gastrik është njohur prej kohësh, veçanërisht për pacientët që përfitojnë nga trajtimi antiHer. Por në vitet e fundit, vëmendja është zhvendosur drejt një grupi më "të heshtur" pacientësh; atyre me HER2 - low, që deri dje konsideroheshin negativë. Ky nën - grup, i përcaktuar me shprehje të ulët të HER2 (1+ ose 2+ pa amplifikim gjenik), po fiton rëndësi të re falë terapive të reja që targetojnë edhe nivelet më të ulëta të ekspresionit.
Objektivi: Të paraqiten zhvillimet më të fundit mbi rolin e HER2 - low në kancerin gastrik dhe mundësitë që ofrojnë trajtimet e reja të tipit te kombinuar antitrup–ilaç, si trastuzumab - deruxtekan.
Materiale dhe Metoda: U shqyrtuan studimet më të rëndësishme të pesë viteve të fundit që trajtojnë rolin e HER2 në kancerin gastrik, me fokus tek grupi HER2 - low. U morën në konsideratë të dhënat mbi efektivitetin klinik të terapive të reja dhe vështirësitë praktike të diagnostikimit në terren, si variabiliteti ndërmjet laboratorëve dhe heterogjeniteti i shprehjes së HER2 në tumore.
Rezultate: Të dhënat e fundit tregojnë se pacientët me kancer gastrik dhe ekspresion të ulët të HER2 mund të përfitojnë nga terapitë e reja që më parë ishin të rezervuara vetëm për rastet "pozitive". Kjo qasje sfidon mënyrën tradicionale të ndarjes pozitive / negative dhe hap derën për një klasifikim më të hollësishëm e të drejtë për pacientët. Megjithatë, zbatimi në praktikën e përditshme kërkon standardizim të vlerësimit imunohistokimik, përmirësim të komunikimit mes patologëve dhe onkologëve, si dhe akses më të gjerë në terapitë e reja.
Konkluzione: Koncepti HER2 - low po ndryshon mënyrën si e kuptojmë dhe e trajtojmë kancerin gastrik. Ai përfaqëson një hap drejt mjekësisë më të personalizuar dhe një mundësi reale për pacientët që deri tani kishin pak alternativa trajtimi. Për sistemin tonë shëndetësor, kjo është edhe një thirrje për të investuar në diagnostikë më të saktë dhe në qasje bashkëkohore ndaj trajtimit onkologjik.

Fjalë kyçe: HER2 - low, kancer gastrik, trajtim target, personalizim terapeutik

NDRYSHIMET MORFOLOGJIKE NË PANKREATITIN AKUT: RIVLERËSIM I ROLIT TË TYRE NË PËRCAKTIMIN E PROGNOZËS.

Jonila Çela[1], Anila Kristo[2], Brunilda Mëhilli[1]
[1]*Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Elbasan*
[2]*Departamenti i Morfologjisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësië, Tiranë.*

Abstrakt
Pankreatiti akut (PA) përbën një sfidë klinike, me një incidencë në rritje, me nje mortalitet që varion nga 5% deri në 47% në prekjet multiorganore. Vlerësimi i gravitetit dhe i prognozes është çelësi kryesor në menaxhimin e sëmundjes pas vendosjes të diagnozës, për një mjekim sa më të efektshëm në mënyrë që të parandalohen ndërlikimet e hershme e te vonshme. Graviteti vlerësohet nga të dhënat klinike, morfologjike dhe histologjike. Stadifikimi përfaqëson diferencimin midis ecurive të lehta, të moderuara dhe të rënda nga pikëpamja klinike dhe midis pankreatitit intersticial edematoz (PIE) dhe pankreatitit nekrotizues (PN) nga këndvështrimi morfologjik. Vitet e fundit janë propozuar sisteme të ndryshme pikëzimi për përcaktimin e gravitetit dhe prognozës të PA, që përfshijnë kriteret Ranson, sistemin e klasifikimit APACHE II, BISAP dhe CTSI (indeksi i gravitetit imazherik). Studimet e fundit sugjerojnë se kombinimi i ndryshimeve morfologjike (të pankreasit, indeve peripankreatike dhe organeve të tjera), në korelacion me të dhënat klinike - biokimike, janë të nevojshme, duke përdorur kritere radiologjike dhe klinike lehtësisht të identifikueshme, për të vlerësuar gravitetin, ndërlikimet, prognozën dhe si rrjedhoje mjekimin adekuat. Ndërlikimet në PA mund të jenë lokale dhe sistemike. Në ndërlikimet lokale të pankreasit përfshihen: nekrozë e pankreasit, pseudokist, abces; ndërsa në ndërlikimet lokale ekstrapankreatike përfshihen: asciti, trombozat lienale, hemoragji intraperitoneale, ikter

mekanik. Lokalizimi anatomik i ascitit dhe karakteristikat e ascitit janë faktorë prognostik të pavarur në PA, duke ndihmuar potencialisht në identifikimin e hershëm të pacientëve me risk më të lartë për ndërlikime dhe mortalitet të lartë. Në ndërlikime sistemike përfshihen: dëmtimet pulmonare, kardiake, hematologjike, gastrointenstinale, renale, metabolike (hipokalcemia, hiperglicemia, hipertrigliceridemia, acidozë), nervore, rabdomiolizë. Insufiçenca respiratore mund të fillojë me hypoxemi, por më pas mund të përparojë në versament pleural, atelektazë deri në ARDS. Versamentet pleurale në 68 % të rasteve janë në anën e majtë, në 22% janë bilateral dhe 10% janë në anën e djathtë. Në pacientët me pankreatit akut është i rëndësishëm stadifikimi sa më i saktë i gravitetit, me qëllim trajtimin sipas gravitetit dhe uljen e komplikacioneve, uljen e shkallës së mortalitetit dhe rritjen e shkallës së suksesit ndaj mjekimit.

Fjalë kyce: pankreatit akut, ndryshime morfologjike, vleresim i gravitetit.

STRATEGJITË NË TRAJTIMIN E REFLUKSIT VEZIKO - URETERAL NË MOSHAT PEDIATRIKE - VLERËSIMI I QASJEVE BASHKËKOHORE.

Msc, MD Jorgjia Bucaj[1], Prof. Dr. Diamant Shtiza[2]
[1]*Mjeke Pediatre Spitali Rajonal Vlorë*
[2]*Shef i Shërbimit të Nefrologjisë dhe Hemodializës Pediatrike*

Abstrakt
Hyrje: Refluksi vezikoureteral (RVU) është një anomali kongenitale e traktit urinar, ku urina rrjedh në mënyrë retrograde nga vezika drejt ureterëve dhe ndonjëherë deri në veshka. RVU shpesh diagnostikohet pas një ITU - je febrile, dhe metoda standarde e imazherisë për konfirmim është cistouretrografia miksonale (VCUG). Ky studim kishte si qëllim vlerësimin e strategjive në trajtimin e refluksit veziko - ureteral në moshat pediatrike si dhe vlerësimin e qasjeve bashkëkohore.
Metodologji: Ky është një studim deskriptiv i të dhënave të pacientëve të Sherbimit të Nefrologjisë dhe Hemodializës Pediatrike pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" si dhe të dhënat nga një klinikë private në të cilën ndiqen fëmijë ambulatorisht për probleme nefrologjike. Të dhënat e studimit u përpunuan në periudhën Maj – Qershor 2025. Ato ishin të dhëna të cilat u mblodhën dhe u përpunuan për vitet 2020 – 2024. Programi statistikor IBM - SPSS – 22 u përdor për përpunim e të dhënave.
Rezultate: Në total në studim nga rishikimi i kartelave u përfshin 1025 fëmijë. Nga totali i fëmijëve të diagnostikuar me RVU, 31 (35. 3%) patën si prezantim klinik IVU. RVU primar u diagnostikua tek pjesa më e madhe e fëmijëve (n=60, 68. 2%) ndërsa RVU dhe Patologji Obstruktive të ureterit u diagnostikua tek 9 (10. 2%) fëmijë. Në 15 raste u diagnostikuan Malformacionet / Anomalitë strukturore të cilat shkaktohen nga RVU. Në total 61 fëmijë kanë zhvilluar ndërhyrje kirurgjikale të hapur për korrigjimin e refluksit veziko - ureteral në periudhën 2020 - 2025. Nga pacientët ambulator 6 (15. 4%) u kategorizuan si grada 1 ndërsa në gradën 2 - 3 dhe 4 - 5 u gjetën 13 (33. 3%) dhe 20 (51. 3%) respektivisht.
Konkluzione: Rastet me RVU janë menaxhuar sipas udhëzimeve Europiane, ndërsa teknikat e ndërhyrjes janë bashkëkohore. Ndjekja në mënyrë ambulatore e pacientëve me gradë më të lartë është qartazi një qasje e mirë dhe e bazuar në udhëzimet ndërkombëtare. Studime të tjera do ishte e nevojshme të kenë një follow - up mbi ecurinë afatgjatë të këtyre pacientëve.

Fjalë kyçe: refluks veziko - uretral, ureter, anomali, kartela, cistouretrografi.

MANIFESTIMET KUTANE TË SINDROMAVE PARANEOPLAZIKE.

Jorida Memini[2], Alesja Palaj[1,3], Oljeda Kacani[3], Ina Sotiri[1,3], Monika Fida[1,3]
[1]*Universiteti i Mjekësisë, Departamenti i Sëmundjeve Infektive dhe Dermatologji, Tiranë, Shqipëri*
[2]*Poliklinika e Specialiteteve Nr. 3, Tiranë, Shqipëri*
[3]*Klinika Aderma, Tiranë.*

Abstrakt
Hyrje: Sindromat paraneoplazike përfaqësojnë shenja klinike që pasqyrojnë praninë e një tumori të brendshëm. Manifestimet kutane kanë rëndësi të veçantë pasi mund të paraprijnë diagnostikimin dhe të shërbejnë si tregues të progresit

ose rikthimit të sëmundjes.
Objektiva: Të evidentohen roli dhe vlera klinike e manifestimeve kutane në kontekstin e sindromave paraneoplazike dhe rëndësia e tyre për një qasje multidisiplinare.
Materiale dhe metoda: U krye një rishikim i literaturës shkencore mbi manifestimet kutane të sindromave paraneoplazike, me fokus në mekanizmat patogjenetikë, shfaqjen klinike dhe implikimet diagnostike.
Rezultate: U konstatua se manifestimet kutane shpesh paraqiten si shenja të para të një tumori të brendshëm, duke ofruar një mundësi të vlefshme për zbulim të hershëm. Ato gjithashtu mund të përdoren si matësa për monitorimin e aktivitetit tumoral dhe vlerësimin e përgjigjes ndaj trajtimit.
Konkluzione: Njohja e manifestimeve kutane të sindromave paraneoplazike është thelbësore për mjekët e specialiteteve të ndryshme. Lëkura duhet parë si një "dritare" e organizmit, ku shfaqen sinjale të rëndësishme onkologjike, duke e bërë bashkëpunimin multidisiplinar të domosdoshëm për diagnostikim dhe menaxhim optimal.

Fjalë kyçe: sindroma paraneoplazike, manifestime kutane, diagnostikim i hershëm, multidisiplinar.

ARTRITI INFLAMATOR "GOUT", RASTE KLINIKE.

J. Kollçaku[1], A. Kollçaku[2]
[1]*Qëndra e specialiteteve nr. 3, Tiranë, Shqipëri*
[2]*Qëndra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri.*

Abstrakt
"Gout" është formë artriti inflamator, që shkaktohet nga depozitimi i kristaleve "monosodium urate" në artikulacione dhe në indet periartikulare. Formimi i kristaleve monosodium të urateve është rrjedhojë e hiperuricemisë. Ndonjëherë, persona me hiperuricemi nuk shfaqin "gout", sikurse mund të ketë raste me nivele normale serike të acidit urik dhe të manifestojnë klinikisht shenjat e "gout". Incidenca dhe prevalenca e "gout" është rritur në ditët e sotme, duke varijuar nga 0, 6 deri 2, 9 për 1000 banorë për vit dhe 0, 68% deri në 3, 9% në persona mbi 18 - 20 vjeç, për shkaqe si dieta e pasur me proteina, konsumi i tepërt i alkoolit, prania e hiperuricemisë në shumë persona me sindrom metabolik, si dhe mjaft shkaqe të tjera. Kjo formë artriti është e hasur tashmë dhe në femra, te të cilat kjo sëmundje është e nënvlerësuar. Identifikimi i kristaleve të acidit urik në likidin sinovial, si dhe teknikat e reja si ultrasonografia, ndihmojnë mjaft në diagnostikimin e hershëm dhe në parandalimin e atakeve të përsëritura të "gout", si dhe të komplikacioneve të kësaj patologjie, të cilat rritin morbiditetin dhe invaliditetin në këta pacientë. Edukimi i pacientëve, trajtimi i atakeve akute, parandalimi i riakutizimeve dhe profilaksia mundësojnë përmirësimin klinik të tyre dhe parandalojnë situata kritike dhe me risk të lartë invaliditeti dhe ndonjëherë edhe fatale. Paraqitja e rasteve klinike, të hasura në praktikën e përditshme, jep shembuj edhe më konkrete për rëndësine e njohjes së "gout", diagnostikimit sa më të hershëm të saj dhe fillimit të trajtimit specifik.

Fjalë kyçe: gout, artriti inflamator, kristale uratesh, hiperuricemi, likid synovial.

NDIKIMI I PANDEMISË COVID - 19 NË SËMUNDJEN E VARIÇELËS.

Juliana Çela[1], Gjeorgjina Kuli - Lito[2]
[1]*Spitali Hygeia, Departamenti i Pediatrisë*
[2] *QSUNT, Departamenti i Pediatrisë Infektive*

Abstrakt
Hyrje: Varicela është një infeksion viral shumë i përhapur në fëmijëri, zakonisht me ecuri beninje, por në disa raste mund të rezultojë në komplikacione serioze që kërkojnë trajtim spitalor. Pandemia COVID - 19 ndikoi ndjeshëm në qarkullimin dhe ecurinë klinike të sëmundjeve virale në popullatën pediatrike, përfshirë edhe varicelën.
Qëllimi: Të vlerësohet shpërndarja epidemiologjike dhe spektri i komplikacioneve të varicelës në popullatën pediatrike të hospitalizuar, si dhe të analizohet ndikimi i pandemisë COVID - 19 në dekursin klinik të sëmundjes.
Materiali dhe Metoda: Studim retrospektiv mbi 553 fëmijë të hospitalizuar me diagnozën "Varicelë" në Shërbimin e Pediatrisë Infektive gjatë viteve 2017–2024. Të dhënat u analizuan sipas grupmoshave, stinës,

ditëqëndrimit dhe tipologjisë së komplikacioneve. Periudha u nda në tre intervale: para, gjatë dhe pas pandemisë COVID - 19. U përdorën analiza statistikore për vlerësimin e lidhjeve të mundshme mes variableve të studiuara.
Rezultate: Nga 553 raste, 309 ishin meshkuj dhe 244 femra. Grupmosha më e prekur ishte 1–5 vjeç (67. 26%). Shtimi i rasteve u vu re në muajt dimër dhe pranverë. Gjatë pandemisë COVID - 19 u regjistrua rënie e ndjeshme e rasteve (N=39), ndërsa pas saj pati një rritje të konsiderueshme (N=246). Koha mesatare e qëndrimit spitalor ishte 6 ditë. Në total u identifikuan 213 raste me komplikacione, ku më të shpeshtat ishin ato respiratore (56. 34%), ndjekur nga kutane / inde te buta (33. 34%) dhe ato neurologjike (7. 04%).
Përfundimet: Pas përfundimit të pandemisë COVID - 19, u vërejt një rritje e incidencës së varicelës. U evidentua rritje statistikisht sinjifikante e komplikacioneve në periudhën post - pandemike (p<0. 05)**,** si dhe lidhje domethënëse midis moshës, sezonalitetit dhe zhvillimit të komplikacioneve (p<0. 05)**.**
Rekomandime: Rekomandojme futjen e vaksinës së varicelës në kalendarin kombëtar të vaksinimit, për fëmijët në grupmoshën 1–5 vjeç, për uljen e barrës së sëmundjes.

Fjalë kyçe: varicela, komplikacione, pediatri, COVID - 19, vaksinim.

KORRELIMI MIDIS NT - PROBNP DHE STRAIN TË ATRIUT TË MAJTË TE PACIENTËT ME INSUFICIENCË KARDIAKE ME FRAKSION TË RUAJTUR TË EJEKSIONIT (HFPEF).

Juliana Karanxha MD[1], Mirjeta Guni, MD[2], Nereida Xhabija PhD[1], Monika Dede, MD [2], Iris Mone Assoc Prof [3]

[1]Spitali Amerikan Nr2 Tiranë, Shqipëri
[2]Spitali Amerikan Nr2 Tiranë, Shqipëri
[3]Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Hyrje: NT - proBNP është biomarkues i rëndësishëm i stresit miokardial, por përdorimi i tij ka kufizime në HFpEF. Deformimi i atriumit të majtë (strain) i matur me ekokardiografi speckle - tracking jep informacione të hollësishme mbi funksionin atrial.
Qëllimi: Të vlerësohet lidhja midis NT - proBNP dhe parametrave të strain - it të LA tek pacientët me HFpEF.
Metoda: 200 pacientë me HFpEF u përfshinë në studim; u matën nivelet e NT - proBNP dhe u krye ekokardiografi me vlerësim të strain - it (LASr, LASc, LASct).
Rezultate: NT - proBNP tregoi korrelacion negativ me LASr (r = –0. 15, p = 0. 03) dhe LASc (r = –0. 26, p < 0. 001). Vetëm LASc rezultoi parashikues i pavarur i NT - proBNP.
Përfundime: Deformimi i atriumit të majtë, veçanërisht funksioni i konduktimit, ka korrelacion të fortë me NT - proBNP dhe mund të shërbejë si plotësim diagnostik e prognostik në HFpEF.

Fjalë kyçe: NT - proBNP, HfpEF, insuficiencë kardiake.

DALLIMET GJINORE NË INSUFICIENCËN KARDIAKE ME FRAKSION TË RUAJTUR EJEKSIONI (HFPEF): NJË STUDIM ME 200 PACIENTË.

MD Juliana Karanxha[1], MD Mirjeta Guni[2], PhD Nereida Xhabija[1], MD Monika Dede[2], Prof Assoc Iris Mone[3]
[1]Spitali Amerikan Nr2 Tiranë, Shqipëri
[2]Spitali Amerikan Nr2 Tiranë, Shqipëri
[3]Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Hyrje: Dallimet gjinore ndikojnë dukshëm në fenotipin e HFpEF, por krahasimet direkte të ekokardiografisë, EKG - së dhe biomarkerëve në praktikën klinike janë të kufizuara.
Metoda: U përfshinë 200 pacientë me HFpEF (≥50% LVEF). U analizuan karakteristikat klinike, parametrat ekokardiografikë, EKG dhe biomarkerët sipas gjinisë.
Rezultate: Nga 200 pacientë, 120 (60%) ishin femra. Femrat kishin më shpesh ristrukturim koncentrik, E / e′ më të lartë, LA volum më të madh, QTc më të gjatë dhe NT - proBNP më të lartë. Meshkujt kishin LV më të

madh, GLS më të ulët, QRS më të gjerë, më shumë blloqe përçimi, troponinë dhe acid urik më të lartë, si dhe më shumë sëmundje koronare.
Konkluzione: Fenotipe të ndryshme gjinore në HFpEF u vërejtën. Femrat shfaqën profil "stres atrial / diastolik", ndërsa meshkujt profil "dëmtim strukturor". Këto të dhëna sugjerojnë rëndësinë e qasjeve të personalizuara sipas gjinisë.

Fjalë kyçe: dallime gjinore, HfpEF, biomarkerët, fenotipe.

HERNIA "HANDLEBAR": NJË RAST KLINIK I TRAUMËS SË MBYLLUR ABDOMINALE NË FËMIJË.

Juliana Shahu[1], MD, Gazmend Xhembulla[1], MD, Elda Shahu[2], MD, Eltona Malo[2], MD,
[1]*Shërbimi i Kirurgjisë së Përgjithshme, Spitali Rajonal Dibër, Shqipëri*
[2]*Shërbimi i Imazherisë dhe Mjekësisë Bërthamore, QSUNT*

Abstrakt
Hyrje: Hernia traumatike e murit abdominal (TAWH) është një pasojë e rrallë e traumës së mbyllur abdominale, veçanërisht tek fëmijët. Ajo ndodh si rezultat i një force të papritur, të përqendruar, që shkakton një difekt të shtresave muskulo - aponeurotike të murit abdominal, ndërkohë që lëkura mbetet e intakte. Diagnostikimi i hershëm është thelbësor për të parandaluar komplikacionet e vonshme, siç janë inkarcerimi i ansave ose dëmtimet viscerale.
Paraqitja e rastit: Një djalë 14 - vjeçar u paraqit në shërbimin e urgjencës pas një rënieje nga biçikleta, duke ankuar për dhimbje abdominale ne kuadratet e majta abdominale. Në ekzaminim fizik u evidentua një kontuzion rrethor, me kufij të qartë, me diametër rreth 4 cm në kuadrantin e poshtëm të majtë të abdomenit — tipik për një "shenjë timoni" (handlebar mark). Nën lezion, u palpua një fryrje e butë, e dhimbshme dhe e reduktueshme, e cila bëhej më e dukshme gjatë kollitjes, sugjestive për hernie traumatike. Analizat laboratorike ishin pa ndryshime të rëndësishme. Tomografia kompjuterike (CT) demonstroi një defekt të murit abdominal me protruzion të një ansë intestinale përmes planit muskulor, duke konfirmuar praninë e hernies traumatike. Gjatë eksplorimit kirurgjikal u identifikua një defekt i paretit abdominal, në brendësi të të cilit protuzononte një segment i zorrës së hollë, një hematomë e vogël e mezenterit dhe një shenjë tipike "handlebar" në një segment të zorrës, e shoqëruar me sasi minimale lëngu serohematik në kavitetin peritoneal. U krye riparim primar i defektit dhe ecuria postoperative ishte pa komplikacione.
Përfundime: TAWH duhet të merret gjithmonë në konsideratë tek pacientët që paraqiten me kontuzione ose fryrje të lokalizuara pas një traume të shurdhër, edhe kur analizat laboratorike dhe imazherike janë brenda vlerave normale. Shenja "handlebar" mbetet një tregues diagnostik kyç. Vlerësimi i hershëm kirurgjikal është thelbësor, pasi dëmtimet intra - abdominale të shoqëruara mund të ekzistojnë edhe në mungesë të shenjave të dukshme klinike.

Fjalë kyçe: Handlebar, hernie, kirurgji, trauma.

ARITMITË KARDIAKE DHE PROFILI I SIGURT I MENAXHIMIT TË TYRE NË MOSHAT GERIATRIKE.

Julinda Koçi
Shërbimi i Kirurgjisë Vaskulare, QSUT "Nënë Tereza", Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Sëmundjet kardiovaskulare dhe veçanërisht aritmitë kardiake kanë një prevalencë të shtuar më plakjen e popullsisë. Fibrilacioni Atrial dhe Takikardia Ventrikulare janë ndër më të shpeshtat në popullatën geriatrike. Procesi i plakjes shoqërohet me ndryshime progresive, degjenerative të sistemit kontraktues dhe përçues të zemrës, të cilat bëhen shkak për aritmi duke rritur morbiditetin edhe mortalitetin kardiovaskular në këtë grupmoshë. Terapia farmakologjike në këta pacientë është sfiduese për shkak të riskut të lartë të toksicitetit dhe hemorragjisë.

Objektiva: Kjo temë ka si qëllim të përshkruajë aritmitë kardiake më të shpeshta në pacientët geriatrikë dhe të vlerësojë trajtimin farmakologjik ose kirurgjikal të tyre dhe profilin e sigurisë së tyre. Për shkak se pacientët geriatrikë janë shumë pak të studiuar në projekte shkencorë kërkimorë dhe udhërrëfyesit ekzistues bazohen në mosha më të reja, rekomandimet e tyre shpesh nuk janë të përshtatshme për këtë moshë dhe duhet të adaptohen.
Metoda dhe materiale: Për realizimin e temës janë përdorur udhërrëfyesit e fundit të ESC, ESH, EHRA, AHA, American Geriartrics Society si dhe publikime të lidhura me geriatrinë në faqet më të njohura mjekësore si Mayo Clinic, PubMED, etj.
Konkluzione: Parandalimi i aritmive kardiake dhe trajtimi i duhur i tyrë në pacientët geriatrikë përbën një sfidë për shkak të mungesës së studimeve në këtë grup - popullatë. Prevalenca e këtyre aritmive është në rritje duke e bërë shumë të rëndësishme antikoagulimin e tyre. Menaxhimi i suksesshëm i aritmive kardiakë në këto mosha, kërkon një qasje të koordinuar dhe të personalizuar për secilin pacient, duke patur parasysh faktorët individualë si mosha, historia mjekësore, sëmundjet bashkëshoqëruese dhe avantazhet apo disavantazhet e trajtimit.

Fjalë kyçe: aritmi kardiake, fibrilacion atrial, NOAC, ablacion, antikoagulim.

ROLI I CT NË ZBULIMIN E SËMUNDJEVE SHOQËRUESE NË SPOK.

J. Gjoni, M. Broqi, L. Agolli, A. Hasa, E. Qeli

Abstrakt
Hyrje: Sëmundja pulmonare obstruktive kronike (SPOK) shoqërohet me disa komorbiditete pulmonare dhe ekstrapulmonare. Komorbiditetet kanë ndikim të rëndësishëm në shëndet, shërbime shëndetësore dhe vdekshmëri tek pacientët me SPOK. Ndërsa disa komorbiditete janë lehtësisht të dallueshme klinikisht, të tjerat janë më pak të dukshme dhe kërkojne ekzaminime plotesuese per tu evidencuar.
Qëllimi: Studimi ka vlerësuar shpeshtësinë e sëmundjeve shoqëruese në të sëmurët me SPOK dhe rolin e CT në zbulimin e patologjive shoqëruese pulmonare dhe ekstrapulmonare.
Materiali me metoda: Studimi është prospektiv në 44 të sëmurë të shtruar me SPOK në Spitalin Universitar "Sh. Ndroqi". Të sëmurët në studim ishin të moshës 45 - 85 vjec (69±9. 8); SPOK A – 6(13. 6%), B - 11(25%) dhe E – 27(61. 4%). Në protokollin e ekzaminimeve është përfshirë dhe ekzaminimi MDCT.
Rezultate: Rezultoi se 42 (95. 5%) e të sëmurëve paraqiten një ose më shumë sëmundje shoqëruese. Një sëmundje shoqëruese patën 17 (39. 6%) të sëmurë, dy – 14 (31. 8), me tri – 10 (22. 7%) dhe një i sëmurë me 5 (2. 2%) sëmundje shoqëruese. CT pulmonar evidentoi në teresi këto sëmundje shoqëruese: Bronchectasia – 16 (36. 4%), të dhëna të infeksionit pulmonar – 7 (15. 9%), Kancer pulmonar – 5 (11. 5%), ILD – 1 (2. 3%), sëmundje pleurale – 11 (25%), SAD – 29 (65. 9%), të tjera lezione – 7 (15. 9%). Në një rast (2. 3%) nuk u konstatuan lezione pulmonare. Gjithashtu në ekzaminimin skanerik u vunë re ndryshime ekstrapulmonare në 33 (75%) të sëmurë. Crregullimet e evidentuara në tërësi janë: Hernie hiatale – 13 (29. 5%), pllaka në a.
Koronare – 9 (20. 9%), Aneurizëm i aortës – 1(2. 3%), patologji e tiroides – 2(4. 7%) dhe crregullime të tjera në 15 (34%).
Konkluzion: Pacientët e hospitalizuar me SPOK kanë shpeshtësi të rritur të sëmundjeve shoqëruese, që kontribuojnë ndjeshëm në barrën e sëmundjes. MDCT është mjet i rëndësishëm jo - invaziv, që mund të zbulojë me saktësi vendndodhjen dhe shkallën e patologjisë pulmonare dhe ekstrapulmonare te pacientët me SPOK.

Fjalë kyçe: CT, SPOK, pulmon, pacient etj.

KUJDESI MBËSHTETËS DHE HOLISTIK PËR PACIENTËT ME SËMUNDJE ONKOLOGJIKE.

Dr. Juventina Ngjela [1], Dr. Agim Koçiraj [2], Cand. Dr. Erind Thartori [3]
[1]Pedagog, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, FSHM, Albanian University
[2] Pedagog, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, FSHM, Albanian University
[3] Pedagog, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, FSHM, Albanian University.

Abstrakt
Hyrje: Kujdesi mbeshtetës dhe holistik përfaqëson një proces të integruar trajtimi që ka në qendër përmirësimin e cilësisë së jetës për personat që përballen me sëmundje të rënda dhe të pashërueshme. Ai synon jo vetëm

kontrollin e simptomave fizike, por edhe adresimin e aspekteve emocionale, sociale dhe shpirtërore që shoqërojnë përvojën e sëmundjes. Për pacientët me diagnoza malinje, kujdesi paliativ merr një rëndësi të veçantë, pasi lehtëson vuajtjet, ul ndjeshëm nivelin e ankthit e depresionit dhe ndihmon në ruajtjen e dinjitetit gjatë gjithë rrugëtimit mjekësor. Ky proces mbështetet në bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet profesionistëve të shëndetit – mjekëve, infermierëve, psikologëve dhe punonjësve socialë – për të siguruar kujdes gjithëpërfshirës dhe njerëzor.
Qëllimi: Ky punim synon të vlerësojë ndikimin e kujdesit paliativ në rritjen e cilësisë së jetës së pacientëve me sëmundje malinje dhe të theksojë nevojën për përfshirjen e tij të plotë në sistemin e kujdesit shëndetësor. Në mënyrë të veçantë, qëllimi është të analizohen rolet dhe kontributet e profesionistëve multidisiplinarë në ofrimin e këtij kujdesi, duke marrë në konsideratë dimensionet etike, humane dhe ligjore që e shoqërojnë.
Metodologjia: Studimi mbështetet në analizën e literaturës bashkëkohore dhe të studimeve kërkimore mbi praktikat e kujdesit paliativ, si dhe në intervista të strukturuara me profesionistë të shëndetit – psikologë, personel mjekësor, punonjës socialë dhe specialistë të shëndetit publik. Qasja metodologjike synon të identifikojë përvojat, sfidat dhe praktikat më të efektshme në mbështetjen e pacientëve me sëmundje onkologjike.
Konkluzionet: Kujdesi mbështetës dhe holistik mbetet një komponent thelbësor i sistemit shëndetësor modern, pasi ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe mirëqenies së pacientëve që përballen me sëmundje të rënda. Ai ofron një qasje humane dhe gjithëpërfshirëse, që kombinon menaxhimin klinik të simptomave me mbështetjen emocionale dhe sociale. Për të arritur rezultate të qëndrueshme, është e domosdoshme që institucionet shëndetësore të investojnë në trajnimin e vazhdueshëm të personelit dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërdisiplinar. Rezultatet e pritshme të studimit pritet të vërtetojnë se kujdesi paliativ i strukturuar, empatik dhe i bazuar në standarde profesionale, përmirëson ndjeshëm jetën e pacientëve dhe të familjarëve të tyre.

Fjalë kyçe: kujdesi holistik, cilësia e jetës, mbështetja emocionale, aspektet psiko – sociale, pacient.

ROLI I TUMOR MARKERËVE NË PROGNOZË DHE DIAGNOZË TË TUMORËVE.

Kaan Krasniqi, Zana Baruti - Gafurri.
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti i Mjekësisë, Prishtinë Kosovë.

Abstrakt
Hyrja: Tumorët malinj përbëjnë një sfidë të konsiderueshme në mjekësinë moderne për shkak të prevalencës së lartë dhe kompleksitetit biologjik. Zbulimi i hershëm dhe përcaktimi i saktë i tipit dhe stadit të tumorit janë vendimtare për trajtimin efektiv dhe përmirësimin e mbijetesës. Në këtë kontekst, biomarkerët tumoralë paraqiten si mjete shtesë të vlefshme për diagnostikim, vlerësim të prognozës dhe monitorim të përgjigjes ndaj terapisë**.**
Qëllimi i punimit: Ky punim synon të analizojë rolin e biomarkerëve kryesorë tumoralë në diagnozën dhe prognozën e neoplazmave malinje, duke përfshirë përdorimin klinik të tyre në lloje të ndryshme tumoresh dhe ndikimin e tyre në menaxhimin terapeutik të pacientëve.
Metodologjia: Ky punim bazohet në rishikimin e literaturës shkencore të 15 viteve të fundit, të publikuara në databaza të besueshme si PubMed, PMC dhe Scopus. Janë analizuar artikuj që trajtojnë përdorimin klinik të biomarkerëve si CA15 - 3, CEA + CA19 - 9 + CA125, β - hCG, AFP, Kalcitonina, PSA, LDH
Rezultate: Biomarkerët tumoralë si CA15 - 3, CEA, CA19 - 9, CA125 dhe kombinimi i AFP me CA19 - 9 kanë vlerë diagnostike dhe prognostike në tumoret e ndryshme solide. β - hCG nuk ishte i besueshëm për diagnostikimin e hershëm të kancerit ovarian. Nivelet e larta të Ct dhe LDH lidhen me stad më të avancuar dhe prognozë të keqe. Radioterapia e hershme shpëtuese (eSRT) për pacientët me PSA të persistuar pas prostatektomisë përmirëson prognozën afatgjatë.
Përfundime: Ky hulumtim pritet të ofroj njohuri gjithëpërfshirëse mbi dobinë klinike të tumor markerëve të zgjedhur, duke kontribuar kështu në zhvillimin e algoritmeve diagnostifikuese më të sakta dhe modeleve prognostike të personalizuara që në fund mund të përmirësojë kujdesin ndaj pacientit dhe rezulatin në onkologji.

Fjalë kyçe: biomarkerët tumoralë, prognozë, diagnozë, terapia, neoplazmat malinje.

DEMENCA – FAKTORËT E RREZIKUT TË MODIFIKUESHËM.
Kaltrina Grezda

Abstrakt
Hyrje: Demenca është një sindromë progresive që ndikon në funksionet kongnitive dhe pavarësinë e individit. Rreth 40% e rasteve mund ti atribuohen faktorëve të modifikueshëm të rrezikut, ndaj parandalimi përmes ndryshimeve në stilin e jetës është thelbësor.
Metodologjia: Ky është një rishikim i literaturës i viteve 2018 - 2025, bazuar në burimet shkencore ndërkombëtare, që analizon ndikimin e faktorëve të ndryshëm të modifikueshëm në rrezikun për demencë.
Rezultate: Janë identifikuar 12 faktorë kryesorë të rrezikut: arsimimi i ulët, humbja e dëgjimit, traumat në tru, hipertensioni, konsumimi i akoolit, obeziteti, duhanpirja, depresioni, izolimi social, inaktiviteti fizik, diabeti dhe ndotja e ajrit. Secili prej tyre paraqet një lidhje të qartë me rritjen e rrezikut për demencë. Shumica e këtyre faktorëve shfaqin ndikim të madh kur janë të pranishëm gjatë moshës së mesme dhe mund të zbuten nëpërmjet ndërhyrjeve të synuara.
Përfundime: Parandalimi i demencës përmes modifikimit të faktorëve të rrezikut paraqet një mundësi të rëndësishme për uljen e barrës globale të kësaj sëmundjeje. Ndërhyrjet e hershme, promovimi i stilit të shëndetshëm të jetesës dhe politikat e shëndetit publik që adresojnë këta faktorë mund të luajnë një rol kyç në përmirësimin e shëndetit kognitiv të popullatës në moshë të shtyrë.

Fjalë kyçe: demenca, faktorë rreziku, stil i shëndetshëm jetese, hipertensioni.

ROLI I TOMOGRAFISË ME KOHERENCË OPTIKE - ANGIOGRAFI (OCT - A) NË DIAGNOSTIKIMIN DHE MONITORIMIN E DEGJENERIMIT MAKULAR NEOVASKULAR TË LIDHUR ME MOSHËN (NDMLM).
Dr. Katerina Kasa[1], Prof. Pajtim Lutaj[2], Prof As. Marsida Krasniqi[3]
[1]Spitali Universitar i Traumës, Tiranë
[2]Fakulteti i Mjekësisë, QSUT, Tiranë
[3]Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës

Abstrakt
Degjenerimi makular i lidhur me moshën (DMLM) është një sëmundje progresive që prek makulën, e cila ndodhet në pjesën qendrore të retinës, dhe përfaqëson një nga shkaqet kryesore të humbjes së shikimit në popullatën e moshuar. Forma neovaskulare e DMLM karakterizohet nga zhvillimi i neovaskularizimit koroidal(CNV), e cila përparon shpejt dhe ndikon ndjeshëm në uljen e pamjes. Diagnoza e hershme dhe ndjekja e kujdesshme janë baza për menaxhimin efektiv të sëmundjes. Metodat kryesore imazherike diagnostike përfshijnë angiografinë me fluoresceinë (FA), tomografinë me koherencë optike (OCT), si dhe OCT - angiografinë (OCT - A). OCT siguron të dhëna të rëndësishme strukturore si trashësia retinale qendrore, prania e lëngut intraretinal (IRF) ose subretinal (SRF), prezenca e shkolitjes së epitelit të pigmentuar (PED), dhe integriteti i epitelit të pigmentuar pigmentor të retinës (RPE). OCT - A ofron një përparësi të rëndësishme diagnostike pasi mundëson vizualizimin e rrjetit vaskular pa përdorim të kontrastit intravenoz. Kjo lejon jo vetëm identifikimin dhe klasifikimin e saktë të CNV, por edhe dallimin e shpejtë të ndryshimeve vaskulare subklinike, përpara se të shfaqet eksudacioni. Për më tepër, të dhënat strukturore (si prania e lëngut, PED dhe ndryshimet në RPE) të kombinuara me informacionin vaskular (rjeti, përmasat, dendësia dhe fluksi i lezioneve) shërbejnë si biomarkues të vlefshëm për vlerësimin e aktivitetit dhe stabilitetit të sëmundjes. Integrimi i teknologjive OCT dhe OCT - A në praktikën klinike ka përmirësuar ndjeshëm diagnostikimin, monitorimin dhe përshtatjen individuale të trajtimit të pacientëve me DMLM neovaskulare, duke çuar në rezultate më të mira vizuale dhe klinike.

Fjalët kyçe: OCT - A (tomografia me koherencë optike - angiografia), OCT (tomografia me koherencë optike), DMLM (degjenerimi makular i lidhur me moshën), neovaskularizim, makula, retina.

NDËRPRERJA E VENA CAVA INFERIOR ME VAZHDIM AZYGOS.

Katrine Hasanaj

Abstrakt

Hyrje: Ndërprerja e venës kava inferiore me vazhdim azygos (IIVC) është një anomali e rrallë vaskulare kongenitale, me një prevalencë të vlerësuar midis 0, 2% dhe 3% në popullatën e përgjithshme dhe rreth 0, 6% te pacientët me sëmundje të lindura të zemrës. Kjo gjendje rezulton nga mosformimi i segmentit hepatik të venës kava inferiore gjatë zhvillimit embrional, duke shkaktuar devijimin e kthimit venoz përmes sistemit azygos. IIVC mund të paraqitet si gjetje e izoluar ose në shoqërim me defekte të tjera të lindura të zemrës dhe isomerizëm të majtë.

Metodat: U krye një analizë e literaturës bashkëkohore mbi karakteristikat embriologjike, ekografike dhe klinike të IIVC me vazhdim azygos. U shqyrtuan studime ekokardiografike fetale, raporte klinike dhe kërkime gjenetike te pacientët me diagnozë prenatale dhe postnatale të IIVC, me qëllim identifikimin e kritereve diagnostikuese, lidhjeve patologjike dhe implikimeve klinike.

Rezultate: Modeli më i zakonshëm është vazhdimi azygos me pozicion normal të zemrës dhe organeve abdominale. Diagnoza prenatale bazohet në gjetje tipike ekografike, si dilatimi i venës azygos pas aortës ("shenja e dyfishtë e enëve") dhe rrjedhja e kundërt midis aortës dhe venës azygos në Doppler. Rreth 90% e rasteve janë të izoluara dhe asimptomatike, ndërsa pjesa tjetër lidhet me defekte komplekse të zemrës si kanali atrioventrikular, lidhja anormale e venave pulmonare, dalja e dyfishtë e ventrikulit të djathtë, defekti i septumit atrial dhe stenoza ose atrezia pulmonare. IIVC mund të shërbejë gjithashtu si tregues i heterotaksisë, një gjendje e lidhur shpesh me mutacione në gjenet ZIC3 dhe rrugën sinjalizuese NODAL / TGFβ.

Diskutimi: Diagnoza prenatale e IIVC ka rëndësi thelbësore në planifikimin e trajtimit postnatal dhe këshillimin gjenetik. Megjithëse zakonisht është e padëmshme kur paraqitet në mënyrë të izoluar, identifikimi i hershëm lejon një menaxhim të personalizuar në rastet e shoqëruara me sëmundje kardiake ose gjenetike. Vlerësimi ekografik i detajuar dhe qasja multidisiplinare janë thelbësore për optimizimin e rezultateve perinatale.

Përfundime: Ndërprerja e venës kava inferiore me vazhdim azygos është një anomali e rrallë, por me rëndësi klinike. Diagnoza e saktë prenatale dhe bashkëpunimi i ngushtë midis kardiologëve, gjenetistëve dhe neonatologëve janë thelbësore për menaxhim efektiv. Roli i saj si tregues i mundshëm i heterotaksisë thekson nevojën për ta përfshirë këtë anomali në protokollet standarde të diagnostikimit fetal.

Fjalë kyçe: vena cava inferior, Doppler, aortë, septum atrial, ventrikul.

PROFILI EPIDEMIOLOGJIK DHE KLINIK I PACIENTËVE QË I JANË NËNSHTRUAR KIRURGJISË PËR SËMUNDJE TË TIROIDES.

Kei Xhixhabesi

Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Hyrje: Çrregullimet tiroidiene përfaqësojnë një nga patologjitë endokrine më të përhapura në botë, dhe një pjesë e konsiderueshme e rasteve kërkojnë ndërhyrje kirurgjikale. Në vendet me mungesë të vazhdueshme të jodit, sëmundjet nodulare të tiroides mbeten një barrë madhore për shëndetin publik.

Material dhe metoda: U krye një studim retrospektiv - deskriptiv që përfshiu 211 pacientë të nënshtruar kirurgjisë për patologji tiroidiene, në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" në Tiranë. Të dhënat e analizuara përfshinë moshën, gjininë, vendbanimin, simptomat kryesore, historinë familjare, diagnozën paraoperatore, sëmundjet bashkëshoqëruese dhe kohëzgjatjen e qëndrimit spitalor.

Rezultate: Nga 211 pacientë, 88. 1% ishin femra, me moshë mesatare 46. 4 vjeç. Diagnoza më e shpeshtë ishte struma nodulare. Tumefaksioni i qafës ishte simptoma më e raportuar (>60% e rasteve). Hipertensioni arterial u evidentua në 37. 9% të pacientëve, ndjekur nga fibrilacioni atrial (25. 6%) dhe dislipidemia (23. 2%). Tiroidektomia totale u krye në 86% të rasteve. Tridhjetë për qind e pacientëve raportuan histori familjare të sëmundjes së tiroides. Shumica jetonin në zona urbane, kryesisht në Tiranë.

Konkluzion: Sëmundja nodulare tiroidiene mbetet e përhapur me predominim të dukshëm tek femrat. Tumefaksioni i qafës është shenja kryesore paraqitëse. Strategjitë parandaluese, diagnostikimi i hershëm dhe menaxhimi kirurgjikal i strukturuar, janë thelbësore për përmirësimin e rezultateve klinike.

Fjalë kyçe: tiroidja, kirurgjia e tiroides, epidemiologjia, struma nodulare, Shqipëri.

ROLI I INFERMIERIT NË ADMINISTRIMIN DHE VLERËSIMIN E TERAPISË ME PREDNIZOLON DHE FUROSEMID TEK PACIENTËT PULMONARË.

Msc. Klea Kazazi, Msc. Manjola Pjetri**,** Dr. Thoma Kalefi

Abstrakt

Hyrje: Sëmundjet pulmonare, si bronkopneumonia, BPOK - u (Bronkopneumopatia Kronike Obstruktive), insuficienca respiratore apo edemat pulmonare, kërkojnë kujdes të vazhdueshëm dhe trajtime të kombinuara farmakologjike. Dy nga barnat më të përdorura janë Prednizoloni, një kortikosteroid anti - inflamator, dhe Furosemidi, një diuretik që ndihmon në eliminimin e lëngjeve të tepërta. Administrimi korrekt dhe vlerësimi i efektivitetit të këtyre medikamenteve janë përgjegjësi të rëndësishme të infermierit, i cili duhet të sigurojë trajtim të sigurt, efektiv dhe pa komplikacione.

Qëllimi i studimit: Të evidentojë rëndësinë e rolit të infermierit në administrimin e terapisë me Prednizolon dhe Furosemid; të analizojë mënyrat e vlerësimit të efektivitetit të këtyre barnave te pacientët me sëmundje pulmonare; të identifikojë masat parandaluese ndaj efekteve anësore dhe komplikacioneve.

Përfundime: Roli i infermierit në administrimin e terapisë me Prednizolon dhe Furosemid është vendimtar për sigurinë e pacientit pulmonar. Përmes kujdesit të vazhdueshëm, monitorimit të efektivitetit dhe edukimit shëndetësor, infermierët kontribuojnë në uljen e komplikacioneve, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe stabilizimin e gjendjes respiratore. Një administrim korrekt dhe një vlerësim profesional janë çelësi i suksesit në trajtimin e pacientëve pulmonarë.

Fjalë kyçe: bronkopneumonia, prednizolon, furosemid, infermierë, komplikacione.

KANCERI I NAZOFARINGUT NË MOSHË TË RE – RAST KLINIK.

Dr. Klevis Thomai, Dr. Klea Shuaipi

Shërbimi i Otorinolaringologjisë Qendra Spitalore Universitare 'Nënë Tereza', Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Abstrakt

Hyrje: Kanceri i nasofaringut është një patologji tepër e rrallë në popullatën e re, kryesisht tipike për dekadën e IV - V të jetës. Kjo patologji ka shfaqje klinike në stade të vonshme, ku evidentohet në pjesën më të madhe të rasteve një masë laterocervikale unilaterale në përmasa të kosnideruеshme. Diagnostikimi i patologjisë në stade të hershme, ndodh si pasojë e ekzaminimeve rutinë duke qënë se patologjia nuk karakterizohet nga një klinikë tipike. Në rastet kur gjendemi përballe dyshimit për diagnozën e kancerit të nasofaringut ekzaminimet plotësuese janë endoskopi dhe Ct - scan, por ajo që e konfirmon si diagnozë dhe ndikon më tej në skemën e trapisë që do të ndiqet është biopsia.

Prezantimi i rastit: Prezantohet rasti i një pacienti mashkull, mosha 23 vjec, i cili paraqitet në Urgjencën e Shërbimit ORL, me epistaksis aktiv. Pacienti nuk ankon për shqetësime të tjera përvec vështirësisë në frymëmarrje prej vitesh dhe prezencës së një deviacioni të septumit nazal të theksuar. Realizohet tamponadë anteriore bilaterale dhe situata arrihet të menaxhohet. Pas një periudhe dy mujore pa shqetësime pacienti rikthehet sërisht me të njejtat ankesa dhe ritamponohet. Bazuar në moshën e re, vështirësisë në frymëmarrje prej vitesh, pranisë së deviacionit dhe epistaksit, pacientit i rekomandohet septoplaatika e cila realizohet pas dhënies së konsentit. Rikthehet sërisht pas dy muajsh me të njëjtat ankesa dhe hospitalizohet për tu plotësuar me ekzaminime të tjera. Suspektohet Ca. Nasofaringu dhe më tej realizohet CT - scan dhe marrja e biopsisë për konfirmimin e diagnozës. Pasi konfirmohet diagnoza pacienti transferohet në shërbimin e Onkologjikut për trajtim dhe ndjekje të mëtejshme.

Diskutimi: Kanceri i nasofaringut është një patologji me incidencë të ulët, që diagnostikohet në faza të vonshme, gjë që e bën të vështirë arritjen e një rezultari pozitiv afatgjatë në trajtim. Qëllimi është te rritja e vigjilencës dhe suspektimi i një diagnoze të tillë dhe në pacientë me klinikë dhe faktorë etiologjik atipik. Diagnostikimi i hershëm çon në prognozë të mirë dhe trajtim të sukseshëm.

Fjalë kyçe: kancer, nasofaring, pacient, kontroll etj.

"ÇMIMI" I TË LINDURIT IUGR – STUDIM 1. 5 VJEÇAR NË SUOGJ "KOÇO GLIOZHENI".

Klea Troka[1], Erda Elezi[1], Erisa Xake[1], Franceska Petriti[1], Adiola Konika[1], Prof. Asc. Alketa Qosja (Hoxha)[2]
SUOGJ "Koço Gliozheni", Tiranë, Shqipëri
[1]Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"
[2]Spitali Universitar Obstetrik - Gjinekologjik "Koço Gliozheni"

Abstrakt
Hyrje: IUGR (Intrauterine Growth Restriction) dhe SGA (Small for Gestational Age) lidhen me rrezik të shtuar për komplikacione neonatale, veçanërisht tek të lindurit para kohe dhe ata që kërkojnë kujdes intensiv.
Qëllimi: Ky studim synoi të vlerësonte prevalencën dhe profilin e komplikacioneve të IUGR dhe SGA tek të porsalindurit në maternitetin "Koço Gliozheni" gjatë Janar 2024 – Qershor 2025.
Materiale & Metoda: Ky është një studim retrospektiv përshkrues, i bazuar në rishikimin e të dhënave mjekësore të të porsalindurve të regjistruar gjatë periudhës së studimit. U përfshinë të gjitha lindjet, si dhe të porsalindurit e shtruar në Repartin e Terapisë Intensive Neonatale (RTI), pavarësisht vendit të lindjes. Të dhënat u analizuan sipas vitit të lindjes, moshës gestacionale dhe statusit IUGR / SGA, duke u përllogaritur prevalencat dhe komplikacionet më të shpeshta për secilin grup.
Rezultate: Gjatë periudhës u regjistruan 5, 676 lindje (3, 901 në 2024; 1, 775 në gjysmën e parë të 2025). Prevalenca e IUGR ishte 3. 1%, e SGA 3. 2% dhe e kombinuar 6. 3%. Lindjet para kohe përbënin 10. 3% të totalit; në këtë grup IUGR ishte 16. 6%, SGA 7. 4% dhe IUGR / SGA 24. 0%. Nga 1, 115 shtrime në RTI, IUGR u pa në 10. 0%, SGA në 3. 9% dhe IUGR / SGA në 14. 1%. Tek IUGR (n=112), komplikacionet kryesore ishin hiperbilirubinemia (22. 3%), anemia (9. 8%) dhe arresti kardiopulmonar (8. 0%), të ndjekura nga sepsis dhe konvulsione (7. 1% secila). Tek SGA (n=44), hiperbilirubinemia ishte 18. 2%, anemia 6. 8%, arresti kardiopulmonar dhe pneumotoraksi 4. 5% secili, ndërsa koliti nekrotizant 2. 3%.
Konkluzione: IUGR / SGA ka prevalencë të lartë tek të lindurit para kohe dhe në shtrimet në RTIN. IUGR shoqërohet me spektër më të gjerë komplikacionesh, sidomos infektive dhe hematologjike, ndërsa SGA ka incidencë relativisht më të lartë të pneumotoraksit dhe kolitit nekrotizant. Hiperbilirubinemia mbetet komplikacioni më i shpeshtë në të dy grupet.

Fjalë kyçe: maternitet, foshnja, RTI etj.

RËNDËSIA E MATJES SË OKSIDIT NITRIK TË EKSPIRUAR (FENO) NË RINITIN ALERGJIK DHE NË ASTMË.

Klea Xhelilaj[1] Gjustina Loloci[2]
[1]Alergologe dhe Imunologe Klinike, Spitali Amerikan 1
[2]Alergologe dhe Imunologe Klinike, Spitali Gjerman

Abstrakt
Matja e oksidit nitrik të ekspiruar (FeNO) është një metodë jo - invazive, e shpejtë dhe e përsëritshme që reflekton praninë e inflamacionit të tipit 2, veçanërisht atij eozinofilik, në rrugët e frymëmarrjes. Ky biomarker ka fituar një rol të rëndësishëm në diagnostikimin dhe menaxhimin e astmës dhe sëmundjeve alergjike. FeNO përdoret kryesisht si test dytësor (second - line) në pacientët me dyshim për astmë, veçanërisht kur rezultatet e spirometrisë nuk janë përfundimtare. Gjithashtu, ka një rol të rëndësishëm në pediatri, ku ofron një alternativë objektive dhe jo - invazive për vlerësimin e inflamacionit të rrugëve ajrore. Megjithatë, përcaktimi i vlerave kufi (cut - off values) mbetet një sfidë për shkak të variabilitetit ndërindividual, moshës dhe komorbiditeteve. Vlerat e larta të FeNO parashikojnë përgjigje të mirë ndaj trajtimit me kortikosteroide inhalatore dhe lidhen me një rrezik të shtuar për ekzacerbime kur nuk trajtohen në mënyrë adekuate. Përdorimi i rregullt i këtij biomarkeri ndihmon në personalizimin e terapive, monitorimin e adhrencës dhe vlerësimin e kontrollit të sëmundjes. Integrimi i FeNO në praktikën klinike përmirëson qasjen terapeutike dhe ndihmon në reduktimin e barrës shëndetësore dhe ekonomike të këtyre sëmundjeve kronike.

Fjalë kyçe: FeNO, astma, rinit alergjike, inflamacioni i tipit 2, biomarker, menaxhim personalizuar

TRAUMAT NË SFERËN ORL.

Kledia Pollo, MD, MBA, MPH; Agron Dogjani, MD, PhD, FACS, FISS, FICS; Hekuran Braho, MD; Alma Teliti, MD, PhD; Leodita Gjana, MD; Mina Mustafaraj, MD; Julja Lulja, MD
Spitali Universitar i Traumës, Tiranë, Albania

Abstrakt
Hyrje: Trauma përfaqëson një ndër sfidat më të mëdha të shëndetit publik global, duke qenë shkaku i gjashtë i vdekjeve në botë dhe shkaku i pestë i invaliditetit. Rreth gjysma e rasteve fatale ndodhin në grupmoshën 15–45 vjeç, ndërsa incidenca është dukshëm më e lartë tek meshkujt. Në fushën e Otorinolaringologjisë, traumat e kokës, qafës dhe fytyrës përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të rasteve emergjente, shpesh të lidhura me aksidente automobilistike ose dhunë fizike.
Metodologjia: Ky studim përmbledh të dhënat epidemiologjike, klinike dhe ekonomike të traumave në sferën ORL, duke analizuar faktorët e riskut, pasojat dhe rëndësinë e menaxhimit multidisiplinar në trajtimin e tyre.
Rezultate: Mbi 50–70% e të mbijetuarve nga aksidentet rrugore paraqesin dëmtime faciale, ndërsa traumat kraniofaciale shpesh shoqërohen me dëmtime cerebrale (15–48%). Kostot e trajtimit janë shumë të larta, duke e renditur traumën ndër patologjitë më të shtrenjta për kujdes shëndetësor, për shkak të komplikacioneve dhe nevojës për ndërhyrje të përsëritura kirurgjikale.
Përfundime: Traumat në sferën ORL kërkojnë vlerësim të menjëhershëm të rrugëve ajrore dhe trajtim të koordinuar kirurgjikal për të parandaluar pasoja afatgjata. Parandalimi mbetet thelbësor përmes përdorimit të rripave të sigurimit, helmetave dhe zbatimit rigoroz të legjislacionit rrugor.

Fjalë kyçe: trauma, ORL, dëmtime faciale, epidemiologji, kirurgji emergjente, parandalim.

PERITONITI MULTIFAKTORIAL I ASOCIUAR ME DIALIZËN PERITONEALE: RAST KLINIK.

Klejda Çollaku[1], Prof. Asoc. Merita Rroji[2], Armanda Saraci[3]
[1] Departamenti i Nefrologjisë, Spitali Rajonal Peshkopi, Shqipëri
[2] Departamenti i Nefrologjisë, Dializës dhe Transplantimit, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri
[3] Departamenti i Nefrologjisë, Spitali i Krujës, Shqipëri

Abstrakt
Hyrje: Dializa peritoneale (DP) është një metodë e terapisë zëvendësuese renale tek pacientët me sëmundje renale në stadin përfundimtar (ESRD). Pavarësisht përparimeve në teknikën dhe kontrollet infektive, peritoniti i lidhur me Dializën Peritoneale mbetet shkaku kryesor i morbiditetit, shtrimeve spitalore dhe ndërprerjes së DP. Udhëzimet e Shoqatës Ndërkombëtare për Dializën Peritoneale (ISPD, 2022) rekomandojnë që norma e peritonitit të ruhet nën 0. 40 episode në vit, duke theksuar rëndësinë e diagnostikimit të hershëm dhe terapisë së synuar për të ruajtur funksionin peritoneal [1, 2].
Prezantim i Rastit klinik: Një pacient mashkull 58 - vjeçar, me ESRD nën dializë peritoneale ambulatorë të vazhdueshme (CAPD) për 5 vite, u paraqit me ethe të larta, dhimbje të forta abdominale dhe dobësi të përgjithshme. Analizat fillestare: Urea: 73. 1 mg / dl; Kreatinina: 7. 11 mg / dl; Albumina: 2. 4 g / dl; Kalciumi: 7. 7 mg / dl; CRP: 23. 52 mg / dl. Likidi peritoneal (04. 09. 2023): numër qelizash 6300 qeliza / mm³ (97% neutrofile, 2% eozinofile, 1% limfocite), kulturë sterile.
Terapia empirike: Cefuroxim (750 mg intraperitoneal), Ciprofloksacinë IV (200 mg / 100 ml); Gentamicinë (40 mg intraperitoneale). Më datë 12. 09. 2023 u izolua Staphylococcus epidermidis (numër qelizash 1800 / mm³). Cefuroxima iu ndërpre dhe u shtua Vankomicina 1 g IP çdo 3 ditë, sipas udhëzimeve të ISPD. Evolucioni klinik: 18. 09. 2023: 1300 qeliza / mm³ (60% neutrofile, 40% limfocite) 26. 09. 2023: 120 qeliza / mm³.
Përmirësim laboratorik: PCR: nga 23. 52 në 3. 2 mg / dl; Albumina: nga 2. 4 në 2. 8 g / dl. Nuk pati rikthim të efuzionit apo nevojë për heqjen e kateterit se dializës. Dializa peritoneale u vazhdua me sukses.

Diskutim: Ky rast ilustron një episod tipik të peritonitit të lidhur me DP të shkaktuar nga Staphylococcus epidermidis, një nga patogjenët Gram - pozitivë më të shpeshtë në DP kronike [3]. Efuzioni fillimisht steril, por me numër të lartë neutrofilësh, tregonte një përgjigje inflamatore të hershme përpara pozitivizimit të kulturës. Terapia empirike me kombinim të cefalosporinës, aminoglikozidit dhe fluorokinolonit ishte në përputhje me rekomandimet e ISPD [1, 2]. Kalimi në terapi të synuar me vankomicinë siguroi mbulimin specifik të patogjenit dhe shërimin e plotë klinik. Albumina e ulët dhe CRP e rritur pasqyronin inflamacion sistemik, të dyja tregues prognostikë të rezultateve më të këqija në peritonitin e DP [4, 5]. Monitorimi i vazhdueshëm i qelizave në likidin peritoneal dhe parametrave biokimikë ndihmoi në përcaktimin e kohëzgjatjes së trajtimit dhe konfirmimin e shërimit.
Përfundime: Peritoniti i lidhur me dializën peritoneale mbetet një sfidë madhore, pavarësisht përmirësimeve në parandalim dhe trajnimin e pacientëve. Diagnoza e hershme, terapia e drejtuar nga kultura dhe menaxhimi i faktorëve të modifikueshëm (si kontaminimi apo hipoalbuminemia) janë thelbësore për një rezultat të suksesshëm. Ky rast thekson rëndësinë e ndjekjes së udhëzimeve të ISPD dhe të përdorimit racional të antibiotikëve, për të shmangur dështimin e teknikës dhe për të ruajtur DP si modalitet afatgjatë.

Fjalë kyçe: dializë peritoneale; peritonit; staphylococcus epidermidis; udhëzime ISPD; vankomicinë; rast klinik; CAPD.

PREVALENCA DHE FAKTORËT E LIDHUR ME SINDROMIN METABOLIK NË PACIENTËT SHQIPTARË ME SËMUNDJE TË MËLÇISË JO - ALKOLIKE (NAFLD): NJË STUDIM TRANSVERSAL 2022–2025 NË TIRANA POLYCLINIC.

Klerida Shehu[1], Benard Shehu[2]
[1]Departamenti i Shkencave Paraklinike, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri
[2]Departamenti i Kardiologjisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Hyrje: Sëmundja e mëlçisë jo - alkolike (NAFLD) përbën një nga patologjitë më të zakonshme të mëlçisë në nivel global, e lidhur ngushtë me sindromin metabolik (SM), obezitetin dhe diabetin tip 2. Në Shqipëri mungojnë të dhëna të standardizuara mbi këtë lidhje. Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë prevalencën dhe faktorët e lidhur me SM në pacientët shqiptarë me NAFLD gjatë periudhës 2022–2025 në Tirana Polyclinic.
Metodologjia: Ky ishte një studim transversal retrospektiv në 112 pacientë të ndjekur në Tirana Polyclinic (2022–2025). U përfshinë të rritur me diagnozë të konfirmuar të NAFLD dhe pa konsum të alkoolit >20 g / ditë. U regjistruan BMI, presioni arterial, lipidet, HbA1c dhe HOMA - IR. Sindromi Metabolik u përcaktua sipas kriterit NCEP - ATP III. Analizat statistikore u kryen me SPSS v26 me nivel domethënieje $p < 0.05$.
Rezultate: Nga 112 pacientë, 66 (58. 9%) kishin NAFLD. Prevalenca e Sindromit Metabolik ishte 63. 6% në grupin NAFLD. Pacientët me SM ishin më të moshuar, me LDL më të lartë dhe HDL më të ulët, ndërsa BMI ishte e ngjashme midis grupeve. HbA1c dhe HOMA - IR ishin gjithashtu më të larta në grupin me SM.
Diskutime: Rezultatet përputhen me studime ndërkombëtare që tregojnë lidhje të fortë midis NAFLD dhe SM. Mosha dhe dislipidemia dolën si faktorët kryesorë të lidhur me SM, duke nënvizuar nevojën për menaxhim të hershëm metabolik dhe skrining sistematik në nivel parësor.
Përfundime: Sindromi Metabolik është shumë i përhapur tek pacientët shqiptarë me NAFLD. Faktorët më të lidhur janë mosha, dislipidemia dhe kontrolli i dobët i glukozës. Integrimi i skriningut metabolik në kujdesin parësor është i domosdoshëm për parandalimin e komplikacioneve hepatike dhe kardiovaskulare.

Fjalë kyçe: sindrom metabolik, LDL, NAFLD, lipide, HbA1c.

MENAXHIMI I EMERGJENCAVE: TRUPAT E HUAJ NË RRUGËT RESPIRATORE, DIAGNOZA DIFERENCIALE.

Dr. Klevis Thomai
Shërbimi ORL, QSUT.

Abstrakt

Hyrje: Trupat e huaj në rrugët e poshtme respiratore janë një nga urgjencat më të mëdhaja në mjekësi, të cila pa menaxhimin e duhur shoqërohen me mortalitet mjaft të lartë. Por dhe mbivlerësimi apo mosdiagnostikimi i saktë shpie në kryerjen e procedurave të rrezikshme në pacientët pa trup të huaj.

Qëllimi i këtij prezantimi do të jetë sintetizimi i një planveprimi të qartë dhe të unifikuar kombëtar për diagnozën diferenciale të situatave akute dhe jo - akute në lidhje me trupat e huaj.

Shërbimi ORL në QSUT është i vetmi në Shqipëri që bën të mundur heqjen kirurgjikale të trupave të huaj; duke mbajtur barrën më të madhe dhe rrjedhimisht eksperiencën më të madhe. Për këtë arsyje në këtë temë do të trajtohen diagnostikimi sa më i saktë, ndërhyrjet mjeksore të cilat ulin mundësitë e krijimit të situatave dramatike, manaxhimin e këtyre të fundit, përmirësimi i prognozës preoperatore të pacientëve me trup të huaj në rrugët respiratore. Do të ndahet me auditorin eksperienca e klinikës tonë, dhe do të prezantohen zgjidhjet ndërkombëtare më të fundit në lidhje me këtë diagnozë.

Fjalë kyçe: trupa të huaj, rrugë respiratore, mortalitet etj.

NJË RAST FIBROELASTOME PAPILARE E NGJITUR NË TRABEKULAT E VENTRIKULIT TË MAJTË.

Klodian Krakulli, Altin Veshti, Fation Hamiti, Jonela Burimi

Abstrakt

Hyrje: Fibroelastomat papilare janë tumore të vogla dhe të izoluara që ngjasojnë me vegjetacione. Fibroelastoma papilare kardiake (FPK) është një neoformacion primar, i rrallë dhe benign i zemrës, me prevalencë të panjohur. Megjithëse janë histologjikisht beninje dhe zakonisht asimptomatike, FPK - të mund të çojnë në komplikacione serioze dhe potencialisht fatale si infarkti i miokardit, iktusi cerebral, embolia pulmonare, arresti kardiak, etj. Për shkak të rrezikut për komplikacione të rënda, fibroelastomat papilare duhet të hiqen sapo të diagnostikohen.

Një paciente 63 - vjeçare u referua në repartin tonë të kirurgjisë kardiake për heqjen e një mase kardiake në barkushen e majtë. Ekokardiografia transozofageale evidentoi një masë mobile me sipërfaqe rreth 2. 1 cm² dhe përmasa 1. 8 x 1. 5 cm në kavitetin e barkushes së majtë, me vendin e fiksimit të dukshëm në septumin anterior, në nivelin medio - apikal, e lidhur me një pedikul të shkurtër. Masa u hoq me sukses pa ndonjë komplikacion pas operacionit dhe u identifikua si fibroelastomë papilare kardiake në barkushen e majtë (FPK - BM).

Fjalë kyçe: neoplazma të zemrës, fibroelastomë, kirurgji kardiake.

OSTEOPOROZA NË GRATË ME MENOPAUZË.

Klodiana Poshi [1, 2], Violeta Hoxha [1], Xhuma Veseli [2]
[1]*Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"*
[2]*Fakulteti i Shkencave Teknike Mjekësore*

Abstrakt

Osteoporoza përfaqëson një problem madhor shëndetësor publik, veçanërisht tek gratë post - menopauzë, për shkak të ndryshimeve hormonale që nxisin humbjen e masës kockore dhe rrisin rrezikun për fraktura. Studimi është realizuar si një studim transversal në Klinikën "Albaturk" në Tiranë, gjatë periudhës qershor–gusht, mbi një grup grash post - menopauzë. Jane vlerësuar komponentët biologjikë, socialë dhe psiko - emocionalë të sëmundjes. Në studim trajtohen aspektet etiologjike të osteoporozës, me theks te roli i deficitit estrogjenik, ndryshimet metabolike, ndikimi i stilit të jetesës dhe faktorët gjenetikë. Analiza tregoi se gratë post - menopauzë përballen me ulje të ndjeshme të densitetit mineral kockor, shpesh të padiagnostikuar deri në momentin e

shfaqjes së frakturave. Kjo gjendje lidhet me pasoja të rënda si humbja e pavarësisë funksionale, rritja e invaliditetit dhe kosto të larta për sistemin shëndetësor. Gjithashtu janë analizuar masat parandaluese, si ushqyerja e ekuilibruar, aktiviteti fizik i rregullt dhe suplementimi me kalcium e vitaminë D. Po ashtu, janë trajtuar terapitë farmakologjike më të përdorura, si bifosfonatet, denosumabi dhe modulatorët selektivë të receptorëve të estrogjenit, të cilat kanë treguar efikasitet në reduktimin e frakturave. Një rëndësi e veçantë i është kushtuar edukimit shëndetësor dhe ndërgjegjësimit, duke theksuar rolin e mjekëve, infermierëve dhe familjes në mbështetjen e grave për adoptimin e sjelljeve mbrojtëse. Përfundimet theksojnë se diagnostikimi i hershëm, qasja multidisiplinare dhe politikat shëndetësore të mirëstrukturuara janë thelbësore për menaxhimin efektiv të osteoporozës. Investimi në kujdesin afatgjatë për gratë post - menopauzë ndikon drejtpërdrejt në reduktimin e komplikimeve, ruajtjen e shëndetit kockor dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre.

Fjalë kyç: Osteoporoza, gratë post - menopauzë, studim transversal, densiteti mineral kockor, trajtim, parandalim.

INFEKSIONET URINARE NË PACIENTËT ME DIABET MELLITUS.

Klodiana Poshi [1, 2], Violeta Hoxha [1], Anisa Kertuka [2]
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"[1]
Fakulteti i Shkencave Teknike Mjekësore[2]

Abstrakt
Diabeti Mellitus përfaqëson një nga patologjitë më të përhapura kronike në botë, me pasoja të shumta multisistemike, duke përfshirë edhe dëmtimet e aparatit uro - gjenital. Ndër komplikacionet më të shpeshta, përfshihen infeksionet urinare të përsëritura, nefropatia diabetike, disfunksioni seksual dhe problemet e fertilitetit, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së pacientëve. Qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë ndikimin e diabetit në aparatin uro - gjenital, duke analizuar mekanizmat patologjikë, faktorët e rrezikut dhe pasojat klinike. Metodologjia e kërkimit është mbështetur në rishikimin e literaturës bashkëkohore shkencore, si dhe në mbledhjen e të dhënave klinike nga pacientë me diagnozë të konfirmuar si Diabet Mellitus, të cilët janë paraqitur me komplikacione uro - gjenitale. Studimi analizon në detaje lidhjen ndërmjet hiperglicemisë dhe shfaqjes së patologjive urinare dhe seksuale. Rezultatet sugjerojnë se kontrolli i pamjaftueshëm i glicemisë rrit ndjeshëm probabilitetin e dëmtimeve të aparatit uro - gjenital, duke përshpejtuar përkeqësimin e funksioneve të tij. Për më tepër, ndikimi psikologjik i komplikacioneve, sidomos atyre seksuale, është i theksuar dhe shpesh nënvlerësohet gjatë menaxhimit klinik. Studimi sugjeron nevojën për një qasje multidisiplinare, ku endokrinologu, nefrologu, urologu dhe psikologu bashkëpunojnë në parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e hershëm të këtyre komplikacioneve. Dëmtimet e aparatit uro - gjenital te pacientët me Diabet Mellitus përbëjnë një dimension të rëndësishëm të sëmundjes, që kërkon vëmendje të shtuar nga profesionistët e shëndetit. Monitorimi i rregullt, edukimi i pacientëve dhe përfshirja e strategjive parandaluese mund të ulin incidencën dhe të përmirësojnë ndjeshëm cilësinë e jetës së pacientëve.

Fjalë kyç: Diabet Mellitus, aparati uro - gjenital, nefropatia diabetike, disfunksioni seksual, infeksionet urinare.

VLERËSIMI I NDRYSHIMEVE STRUKTURORE DHE FUNKSIONALE TË ZEMRËS NË LIDHJE ME TERAPINË HIPOGLICEMIANTE.

Klodiana Spahiu, Edi Spahiu
Spitali Rajonal Durrës

Abstrakt
Hyrje: Mjekimi me hipoglicemiante mund të ndikojë në strukturën dhe funksionin e zemrës. Disa prej klasave kanë efekte mbrojtëse kardiake, ndërsa të tjerë mund të rrisin rrezikun për komplikacione kardiovaskulare.
Qëllimi i studimit: Korrelacioni midis tipit të terapisë (insulinë vs. hipoglicemiantë oralë) në ndryshimet anatomo - morfologjike dhefunksionale të ventrikulit të majtë (VM).
Metoda dhe Rezultatet: Për një periudhë 3 vjeçare u përfshinë në studim 200 persona pa shenja klinike të insuficiencës kardiake (IK) nga të cilët: 100 paciente me diabet mellitus tip 2 dhe 100 persona jodiabetike pa patologji të tjera të cilët shërbyen si grup kontrolli. Pacientët u ndanë sipas trajtimit me antidiabetikë orale

(ADO) dhe insulinë. U vlerësuan nëpërmjet ekokardiografisë ndryshimet anatomike dhe funksionale te VM dhe u analizuan të dhënat në lidhje me terapinë e marrë. Vetëm 8% e pacientëve që u trajtuan me ADO kanë HVM kundrejt 22. 9% të pacientëve me insulinë (p< 0. 03). Rimodelimi i VM ishte më i shpeshtë në grupin me insuline kundrejt pacientëve me ADO (25% vs 60%, p < 0. 001). Vëllimi i AM ishte në mënyrë sinjifikante më i rritur në grupin me insulinë kundrejt pacientëve me ADO (p<0. 04). Pacientët që u trajtuan me insulinë kishin presione mbushëse të VM (E / E`) më të larta se pacientët që u trajtuan me ADO (p< 0. 03) dhe po ashtu funksioni sistolik longitudinal (i vlerësuar nga Sm lateral dhe septal) ishte më i prekur në pacientët me insuline kundrejtë pacientëve me ADO.

Përfundime: Në studimin tonë pacientët e trajtuar me antidiabetikë orale (ADO) ku në 90% të rasteve medikamenti ishte metformina, kishin më pak ndryshime morfologjike dhe funksionale të zemrës sesa pacientët diabetikë që u trajtuan me insuline.

Fjalë kyç: funksion, zemër, komplikacione kardiovaskulare, antidiabetikë orale (ADO).

AXILLARY WEB SYNDROME(AWS) NË GRATË ME KANCER GJIRI.

(Phd. c) Msc Klodjana Naco, Prof Ass. Ermira Zicishti, Msc Enea Miho
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"
Njësia e Rehabilitimit të Sëmundjeve të Brendshme

Abstrakt

Hyrje: Axillary Web Syndrome (AWS) përfaqëson një ndërlikim të shpeshtë pas trajtimit kirurgjikal të kancerit të gjirit, veçanërisht pas diseksionit të nyjeve limfatike aksilare. Ky shqyrtim i literaturës synon të analizojë në mënyrë gjithëpërfshirëse incidencën, patofiziologjinë, faktorët e rrezikut, ndikimin funksional dhe opsionet terapeutike të AWS. Të dhënat tregojnë se prevalenca e sindromës varion nga 6% deri në 86%, në varësi të metodës kirurgjikale dhe kohës së ndjekjes. Patofiziologjia lidhet me inflamacionin dhe fibrozën e enëve limfatike të dëmtuara, që çojnë në formimin e kordeve nënlëkurore të dhimbshme përgjatë krahut. Faktorët e rrezikut përfshijnë numrin e nyjeve të hequra, mosmarrjen e CDT - së në kohë, dhe BMI të ulët. AWS ndikon ndjeshëm në funksionin e shpatullës, përfshirë uljen e amplitudës së lëvizjes dhe dhimbjen kronike. Trajtimet më efektive përfshijnë terapinë e plotë dekongjestive (CDT), stretching progresiv, mobilizimin e indeve të buta dhe edukimin e pacientit. Edhe pse shumica e rasteve përmirësohen brenda disa javësh, disa paciente përjetojnë simptoma të përsëritura. Literatura thekson nevojën për protokolle standarde të rehabilitimit dhe për studime të reja klinike që matin efektet afatgjata të CDT dhe ndërhyrjeve fizike.

Fjalë kyçe: Axillary Web Syndrome, kanceri i gjirit, diseksioni aksilar, limfedema, fizioterapi, CDT.

NJË RAST I NJË PACIENTI ME KOLLË DHE DHIMBJE TORAKALE TË SHKAKTUAR NGA SARKOIDOZA, I TRAJTUAR PËR SINDROMËN RADIKALE TORAKALE DHE LARINGITIN.

Velçani Klodjana Md[1], Kryeziu (Zekthu) Enkeleida Md[2]
[1]*Qendra Shëndetësore Nr. 3, Dispanceria, Tiranë, Shqipëri*
[2]*Qendra Spitalore e Burgjeve, QSUNT, Tiranë, Shqipëri*

Abstrakt

Hyrje: Raportohet një rast i një pacienti 30 - vjeçar që kishte 6 muaj kollë jo - produktive, vështirësi në frymëmarrje gjatë ushtrimeve, ethe, djersitje nate, humbje peshe dhe dhimbje të fortë në gjoks. Ai u trajtua gjatë kësaj periudhe nga një mjek ortoped për sindromë radikale cervikale me Apranax plus, Gel Deep Relief dhe Arthimine 4, pa ndonjë përmirësim. U kthye te mjeku i familjes, ku u trajtua me diagnozën e bronkitit bilateral me Davixon 1gr 2x1 dite, Notus forte syrup dhe një multivitaminë për 8 ditë pa ndonjë rezultat. U referua në repartin pulmonar me diagnozën "Bronkopneumoni Bilaterale të Rëndë". Trajtimi i tij me zgjerim bilateral hilar dhe mediastinal të nyjeve limfatike nuk ishte i lidhur me ndonjë anomali pulmonare.

Metoda: Duke marrë parasysh anamnezën dhe ekzaminimin klinik, pacienti u trajtua me terapi antibiotike dhe kortikosteroide. U vlerësua se nuk ishte bronkopneumoni, kështu që pacienti u ekzaminua me CT me rezolucion të lartë, e cila tregoi nyje të vogla bilaterale në një model miliari. Pacienti kishte gjithashtu adenopati

mediastinale dhe hilare. Kjo përkon me sëmundjen në fazën II.
Rezultate: Tomografia kompjuterike me rezolucion të lartë (CT) e kraharorit zbuloi infiltrate bilaterale difuze me pamje të granulozës, sëmundje bulluoze, zona kavituese dhe pneumotoraks bilateral, si dhe limfadenopati mediastinale dhe hilare. Matjet arteriale të gazrave në ajër të ambientit ishin: PaO_2 47 mmHg, $PaCO_2$ 33 mmHg, pH 7. 41. Analizat e gjakut treguan një hemoglobinë prej 10. 2 g / dL, numër qelizash të bardha 5, 800 / mm^3 (68. 3% neutrofile, 16% limfocite, 12. 2% monocite, 2. 1% eozinofile, 1. 4% bazofile), dhe numër trombocitesh 312, 000 / mm^3. Nivelet e ureës, kreatininës, elektroliteve, kohës së protrombinës dhe kohës së pjesshme të tromboplastinës ishin normale. LDH ishte 314 IU / L (normalja 100–205 IU / L), fosfataza alkaline 241 IU / L (normalja 36–125 IU / L), AST 48 IU / L (normalja 2–50 IU / L), albumina serike 3. 4 g / dL, hiperkalcemia ishte prezente dhe enzima ACE pozitive. Testi Kveim ishte pozitiv. Terapia me kortikosteroide zgjidhi simptomat.
Përfundimi: Një diagnozë më e mirë diferenciale e bronkopneumonisë që nga vizita e parë do të kishte shmangur vonesat në diagnostikimin përfundimtar dhe do të kishte evituar vuajtjen e pacientit.

Fjalë kyçe: kollë, pacient, ethe, djersitje etj.

REKONSTRUKSIONI I DEFEKTEVE KUTANE DHE SUBKUTANE.
Ass. Dr. Korab Berisha PhD candidate

Abstrakt
Qëllimi: Rekonstruksioni i defekteve kutane dhe subkutane përbën një komponent thelbësor të kirurgjisë plastike dhe rekonstruktive, me objektiv rivendosjen e integritetit anatomik, funksional dhe estetik të indeve të dëmtuara. Qëllimi i këtij punimi është të paraqesë përvojën klinike dhe qasjet operative në menaxhimin e defekteve të ndryshme të lëkurës dhe nënlëkurës.
Materiali dhe metodat: Janë analizuar rastet e pacientëve me defekte të ndryshme, të trajtuar me metoda të ndryshme rekonstruktive: mbyllje direkte, graft lëkure, flepa lokale dhe rajonale. Përzgjedhja e metodës u bazua në përmasën dhe lokalizimin e defektit, gjendjen e indeve përreth dhe faktorët e përgjithshëm të pacientit.
Rezultatet: Në shumicën e rasteve u arrit mbulim i suksesshëm i defektit me ruajtje të funksionit dhe estetikës. Komplikimet ishin të rralla dhe me karakter të përkohshëm. Flepat lokale rezultuan të përshtatshme për defekte të vogla e të mesme, ndërsa flepat mikro - vaskulare për defekte të mëdha dhe komplekse.
Përfundimi: Zgjedhja e metodës rekonstruktive duhet të personalizohet në varësi të tipit të defektit dhe karakteristikave të pacientit. Planifikimi i kujdesshëm kirurgjikal dhe njohja e mirë e teknikave të ndryshme janë thelbësore për arritjen e rezultateve optimale funksionale dhe estetike.

Fjalë kyçe: defekte, lëkurë, rekonstruksion, komplikacione, graft.

EFIKASITETI I METODËS GENEXPERT KRAHASUAR ME METODAT TRADICIONALE NË DIAGNOSTIKIMIN E TUBERKULOZIT.
Korab Hoxha

Abstrakt
Hyrje: Tuberkulozi (TB) mbetet një sfidë madhore për shëndetin publik global, veçanërisht në vendet me burime të kufizuara. Metodat tradicionale të diagnostikimit si mikroskopia, kulturat dhe PCR - ja konvencionale shpesh kufizohen nga koha, kostoja dhe ndjeshmëria.
Qëllimi: Të vlerësohet efikasiteti i metodës molekulare GeneXpert MTB / RIF në krahasim me teknikat tradicionale të diagnostikimit të TB - së, me fokus në ndjeshmëri, specifikë dhe vlefshmërinë klinike.
Metoda: U shqyrtuan studime krahasuese që përfshinin mostra pulmonare dhe ekstrapulmonare, ku GeneXpert MTB / RIF u testua kundrejt kulturave në terrene të ngurta dhe të lëngshme, mikroskopisë Ziehl - Neelsen dhe fluoreshente, si dhe PCR - së në kohë reale.
Rezultate: GeneXpert tregoi ndjeshmëri të lartë (deri në 98. 8%) dhe specifikë të krahasueshme me metodën e kulturës, me përparësi të dukshme në shpejtësi dhe detektimin e rezistencës ndaj Rifampicinës. Për mostrat ekstrapulmonare ndjeshmëria varionte nga 58–77%, ndërsa për mostrat pulmonare ishte dukshëm më e lartë.

Krahasuar me ngjyrosjet tradicionale, GeneXpert përmirësoi ndjeshëm ndjeshmërinë dhe ofroi rezultate më të shpejta, por mbetet një metodë më e kushtueshme.
Përfundimi: GeneXpert MTB / RIF përfaqëson një përparim të rëndësishëm në diagnostikimin e TB - së, duke kombinuar ndjeshmëri të lartë, specifikë të kënaqshme dhe detektim simultan të rezistencës ndaj Rifampicinës. Kjo e bën atë veçanërisht të vlefshëm në vendet me burime të kufizuara, ndonëse kostot e larta kufizojnë aplikimin universal.

Fjalë kyçe: Tuberkuloz, GeneXpert MTB / RIF, diagnostikim molekular, kulturë bakteriale, Rifampicinë.

ANEURIZËM VENOZE POPLITEALE TEK NJË PACIENT 69 - VJEÇAR ME HIPERTENSION: NJË GJETJE E RRALLË VASKULARE.

Dr. Korab Lokaj[1], Ass. Dr. Adhurim Koshi[12] PhD (c) Fjolla Cacaj [1]
[1] Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës
[2] Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Klinika e Kirurgjisë Vaskulare

Abstrakt
Hyrje: Aneurizmat primare venoze paraqesin anomali të rralla vaskulare, të cilat shpesh konsiderohen me rëndësi të kufizuar klinike. Megjithatë, aneurizmat venoze popliteale kërkojnë vëmendje të veçantë për shkak të lidhjes së tyre të dokumentuar me komplikime serioze tromboembolike, ndër të cilat më kritiku është embolia pulmonare. Duke marrë parasysh potencialin për pasoja kërcënuese për jetën, njohja e hershme dhe menaxhimi adekuat i aneurizmave venoze popliteale janë thelbësore për të parandaluar episodet tromboembolike që përndryshe mund të çojnë në pasoja fatale.
Raport Rasti: Raportohet rasti i një pacienti mashkull 69 - vjeçar me histori hipertensioni arterial, i referuar Departamentit të Kirurgjisë Vaskulare për vlerësimin e ënjtjes difuze që përfshinte të gjithë ekstremitetin e poshtëm të majtë. Historia e tij mjekësore ishte e rëndësishme për venat varikoze ipsilaterale. Në ekzaminimin fizik u vunë re ndryshime dermatologjike lokale, veçanërisht purpura, në rajonin krural të këmbës së majtë, të lidhura me venat varikoze në të njëjtën anë. Pulsacionet periferike ishin të prekshme bilateralisht, dhe nuk u identifikuan anomalitë e sistemit arterial. Ultrasonografia me Doppler ngjyror e ekstremitetit të poshtëm të majtë zbuloi insuficiencë të venës safene të madhe (GSV) në shoqërim me një aneurizëm venoze popliteale me përmasa 20 × 18 × 21 mm. Nuk u identifikuan anomalitë e tjera të sistemit venoz. Analizat laboratorike treguan një nivel të rritur të D - dimerit, megjithëse nuk kishte dëshmi të trombozës së venave të thella (DVT). Duke marrë parasysh prezantimin asimptomatik të pacientit, moshën e avancuar dhe komorbiditetet ekzistuese, u fillua terapi antikoaguluese lifelong me rivaroksaban 20 mg një herë në ditë si qasje terapeutike e preferuar. Gjithashtu, pacientit iu rekomandua përdorimi i çorapeve elastike për mbështetje venoze. Kontrollime të rregullta janë planifikuar çdo tre muaj për monitorim dhe rivlerësim të vazhdueshëm klinik.
Konkluzione: Ky rast tregon një aneurizëm venoze popliteale të rrallë tek një pacient mashkull 69 - vjeçar me hipertension arterial, i shoqëruar me insuficiencë të venës safene të madhe dhe vena varikoze ipsilaterale. Megjithëse asimptomatik, aneurizma paraqiste një rrezik potencial për komplikime tromboembolike, siç evidentohet nga nivelet e rritura të D - dimerit. Diagnostikimi i hershëm me anë të ultrasonografisë me Doppler ngjyror mundësoi menaxhim adekuat me terapi antikoaguluese dhe mbështetje kompresive. Ky rast nënvizon rëndësinë e konsiderimit të aneurizmave venoze popliteale edhe tek pacientët e moshuar, veçanërisht ata me vena varikoze, dhe thekson se monitorimi i kujdesshëm dhe strategjitë individuale të trajtimit janë thelbësore për të parandaluar ngjarje kërcënuese për jetën, si embolia pulmonare.

Fjalë kyçe: Vena popliteale, aneurizëm, emboli pulmonare, vena varikoze, antikoagulantë.

DIAGNOZA DHE TRAJTIMI I SEPSISIT MBËSHTETUR NË STRATEGJITË UDHËZUESE TË BIOMARKERVE.

Prof. Krenar Lilaj, MD, PhD
Drejtues i Shërbimit te Anestezi - Reanimacionit, Departamenti i Kirurgjisë, QSUT "Nënë Tereza", Universiteti i Mjekësisë, Tirana, Albania

Abstrakt
Sepsis vazhdon të përfaqësojë një sfidë kritike për shëndetin global, e nxitur nga patofiziologjia e saj komplekse dhe e ndryshueshme. Gjatë viteve të fundit, kërkimi mbi biomarkerët ka transformuar kuptimin e sepsis nga një gjendje uniforme në një spektër sindromash biologjikisht të dallueshme. Për shkak të dëmtimit të shumë organeve që shkaktohet nga faza hiper–inflamatore dhe imunosupresive e sepsis, biomarkerët e studiuar përfaqësojnë një gamë të gjerë procesesh themelore. Ata janë thelbësorë për përmirësimin e diagnostikimit dhe udhëzimin e terapisë në sepsis bakterial dhe viral. Kandidatë premtues si proteina që lidhet me heparinën, variacioni në përmasa dhe morfologji e monociteve, interleukina - 10, presepsina, prokalcitonina dhe CRP mbështesin njohjen dhe vlerësimin e hershëm të rrezikut, ndërsa biomarkerët endotelialë dhe kardiakë, përfshirë dipeptidil peptidazën 3, mund të ndihmojnë në individualizimin e strategjive të fluideve dhe vazopresorëve. Biomarkerët imunologjikë (receptori i aktivizuesit plazminogjenik urokinazë dhe interferoni - gama) theksojnë më tej potencialin e imunoterapisë së udhëzuar nga biomarkerët. Edhe pse sfida praktike si kostoja, specifikimi dhe standardizimi vazhdojnë të ekzistojnë, një strategji e kombinuar me shumë biomarkerë mund te ndihmojnë në identifikimin më herët të pacientëve me rrezik të lartë dhe të përshtatin ndërhyrjet në mënyrë më efektive — një qasje që mund të kontribuojë realisht në uljen e vdekshmërisë së lartë që shoqëron sepsis.

Fjalë kyçe: sepsis, biomarkerë, diagnostikë, trajtim, prokalcitoninë, presepsinë, CRP, imunoterapi, vlerësimi i rrezikut.

NDRYSHIMET MIKROVASKULARE RETINALE SI BIOMARKERË JO - INVAZIVË TË RREZIKUT PËR INSUFICIENCËN KARDIAKE.

Krenar Xhafa [1], Alberta Humolli [1]
[1]*Universiteti i Ljubljanës, Fakulteti i Mjekësisë, Ljubljana, Slloveni*

Abstrakt
Insuficienca kardiake (IK) përbën një sfidë madhore shëndetësore në shkallë globale, ndërsa disfunksioni mikrovaskular është identifikuar si një komponent i rëndësishëm i patogjenezës së saj. Imazheria retinale ofron një qasje jo - invazive për vlerësimin e mikroqarkullimit sistemik, duke reflektuar ndryshime strukturore dhe funksionale në enët e gjakut. Ky rishikim narrativ sintetizon të dhënat nga katër studime që kanë analizuar parametrat retinale tek pacientët me IK, përfshirë diametrin mesatar arteriolar (CRAE), diametrin mesatar venular (CRVE), raportin arteriolë / venulë (AVR) dhe dilatimin e induktuar nga stimulimi me dritë (FID). Rezultatet treguan një rritje të rrezikut për hospitalizim dhe mortalitet të lidhur me IK me 30% (OR = 1. 29; 95% CI 1. 13–1. 47; p = 0. 001) për çdo njësi rritje të CRVE, ndërsa lidhjet me CRAE humbën fuqinë pas rregullimeve multivariable. Pacientët me IK shfaqën përgjigje FID dukshëm më të ulëta (arteriolare 1. 24% ± 1. 14% dhe venulare 2. 89% ± 1. 33%) në krahasim me kontrollet e shëndetshme (3. 78% ± 1. 85% dhe 3. 88% ± 1. 83%). AVR ishte gjithashtu dukshëm më i ulët tek pacientët me IK (0. 79 kundrejt 0. 84; p = 0. 004). Një studim rastor mbi një ndërhyrje aerobike 12 - javore dokumentoi përmirësim të CRAE, CRVE dhe FID, duke sugjeruar potencial për reversibilitet të disfunksionit mikrovaskular. Tek pacientët me pajisje ndihmëse të ventrikulit të majtë (LVAD), shpejtësitë më të larta të pompës u shoqëruan me reduktim të indeksit pulsatil retinal (PI), duke treguar perfuzion mikrovaskular të kompromentuar. Të dhënat mbështesin CRVE dhe FID si biomarkerë premtues, jo - invazivë, për vlerësimin e hershëm dhe monitorimin e rrezikut në IK. Integrimi i këtyre parametrave në vlerësimin kardiovaskular mund të avancojë stratifikimin e rrezikut dhe procesin vendimmarrës klinik; megjithatë, kërkohet verifikim në studime me kampione më të mëdha dhe më heterogjene.

Fjalë kyçe: mikroqarkullimi retinal, kalibri i enëve retinale, imazheria retinale, insuficienca Kardiake, biomarkerë jo - invazivë, disfunksioni i ventrikulit të majtë.

GLAUKOMA FAKOGJENE.
Kreshnik Miftari

Abstrakt
Hyrja: Glakukoma Fakogjene (LIG) është një gjendje e shpeshtë, që paraqitet tek pacientët me kataraktë senile dhe është një nga format më të shpeshta të glaukomës sekondare. Veçoria që paraqitet në ekzaminim është eskavacioni "kupëzimi" që duket si një "zbrazje" e kokës së nervit optik. Menaxhohet përfundimisht me anë të kirurgjisë me largim të thjerrëzës dhe vendosjes së thjerrëzës së re.
Qëllimi: Thellimi i njohurive lidhur me Glaukomën Fakogjene në lidhje me: pasqyrën klinike, diagnostikimin e hershëm dhe metodat e trajtimit efikas.
Metodologjia: Metoda e përdorur për këtë punim është rishikimi i literaturës ekzistuese duke u bazuar në informata kredibile të marra nga të dhënat akademike, bibliotekat dixhitale si PubMed, GoogleScholar dhe libra si American Academy of Ophthalmology.
Rezultate: Sëmundja diagnostikohet duke vërejtur shenjat klinike si dhe duke përcjellë ato, me anë të aparaturave për matjen e IOP ku si standard i artë konsiderohet Goldmann AT. Kohëzgjatja e sëmundjes mund të shkaktojë ndryshime të dukshme strukturore dhe dëmtime serioze të të pamurit.
Përfundime: Çasja e shpejtë në shërbime shëndetësore, pra diagnostikimi i hershëm dhe trajtimi efikas janë faktorët që prevenojnë dëmtimin e shikimit.

Fjalë kyçe: Glaukoma Fakogjene, thjerrëza, IOL, terapia antiglaukomatoze, ECCE, ICCE, rehabilitimi i të pamurit.

PARAMETRAT ANTROPOMETRIK DHE SËMUNDJET KARDIOVASKULARE.
Kreshnik Zeka

Abstrakt
Parametrat antropometrik janë matje kuantitative të muskujve, kockave dhe indit yndyror që përdoren per të vlerësuar përbërjen e trupit. Elementet thelbësore të antropometrisë janë gjatësia, pesha, indeksi i masës trupore (IMT), perimetrat e trupit (beli, ijet dhe gjymtyrët). Këto matje janë të rëndësishme sepse ato përfaqësojnë kritere diagnostike për mbipeshën, gjë që rrit ndjeshëm rrezikun për gjendje si sëmundje kardiovaskulare, hipertensioni, diabet mellitus dhe shumë më tepër. Qëllimi i këtij punimi është që duke u bazuar në të dhënat e literaturës adekuate dhe aktuale, të prezantohet rëndësia e parametrave antropometrik në parashikimin e sëmundjeve të arterieve koronare të ndërlidhura me obezitetin. Gjatë viteve të fundit ka pasur disa debate mbi parametrat që duhet të përdoren në mënyrë që të shërbejnë si një indeks për të matur rrezikun për SAK në njerëzit me mbipeshë dhe obezë. Parametrat e zakonshëm antropometrik për vlerësimin e statusit të peshës janë perimetri i belit (WC), raporti bel – ije (WHR), raporti bel me lartësi (WHtR) dhe indeksi i masës trupore (IMT). WC, WHR dhe WHtR përdoren për të matur obezitetin abdominal, dhe IMT është përdorur si një masë për obezitetin e përgjithshëm apo total. Shpërndarja e indit dhjamor varet nga hormonet seksuale, përdorimi i glukortikoideve, gjenet etj. Akumulimi i indit dhjamor në pjesën ë sipërme (abdominale) të trupit shoqërohet me zhvillimin e sëmundjeve të lidhura me obezitetin, kurse obeziteti në pjesën distale të trupit mund të shoqërohet edhe me profil mbrojtës të lipideve. Për këtë arsye parametrat antropometrik që masin obezitetin abdominal (WH, WHR, WtHR) në shumicën e studimeve të përmendura në këtë punim kanë pasur korrelacion më të lartë me SAK në krahasim me IMT i cili mat obesitetin total.

Fjalë kyçe: parametrat antropometrik, IMT, SAK, indi dhjamor.

MANIFESTIMET MRI TË HIPOKSISË INTRAUTERINE DHE INFARKTEVE VENOZE CEREBRALE TEK NEONATËT.

Prof. Dr. Kreshnike Dedushi Hoti

Abstrakt

Hyrje: Hipoksia intrauterine (HI) është një faktor madhor rreziku për dëmtim cerebral neonatal, shpesh e shoqëruar me infarkte venoze dhe ndryshime ischemike difuze. Diagnostikimi i hershëm është thelbësor për menaxhimin dhe parashikimin neurologjik. Imazheria me rezonancë magnetike (MRI), veçanërisht Diffusion Weighted Imaging (DWI) dhe Magnetic Resonance Venography (MRV), ofron identifikim të saktë të dëmtimeve vaskulare cerebrale. Studimet e fundit kanë theksuar rëndësinë e këtyre teknikave në zbulimin e infarkteve subklinike dhe karakterizimin e përfshirjes venoze tek neonatët me HI.

Qëllimi: Të përshkruhen tiparet imazherike MRI të infarkteve venoze tek neonatët me hipoksi intrauterine, bazuar në literaturën aktuale dhe përvojën klinike të qendrës sonë.

Metoda: U realizua një review narrative e literaturës (2015–2024) në bazat e të dhënave PubMed, Scopus dhe Embase, duke përfshirë 42 studime relevante. Njëkohësisht u analizuan 38 raste neonatale me hipoksi intrauterine të konfirmuar, të ekzaminuara me MRI, DWI dhe MRV brenda 7 ditëve pas lindjes.

Rezultate: Infarktet venoze u lokalizuan kryesisht në lobet frontal dhe parietal. DWI identifikoi edemë citotoksike në 70% të rasteve, ndërsa MRV zbuloi trombozë ose obstruksion venoze në 40%. Krahasimi me literaturën ndërkombëtare tregon përputhje të plotë me shpërndarjen e dëmtimeve dhe vlerën prognostike të MRI.

Përfundime: MRI me përfshirje të sekuencave DWI dhe MRV është esenciale për diagnostikimin e hershëm të infarkteve venoze cerebrale pas hipoksisë intrauterine. Protokollet e standardizuara MRI mundësojnë zbulim të saktë, parashikim më të mirë të rezultatit neurologjik dhe ndërhyrje të hershme terapeutike.

Fjalë kyçe: Hipoksia intrauterine; MRI; DWI; MRV; infarkt venoz neonatal; dëmtim cerebral; neonatologji.

KARCINOMA E REKTUMIT: ANALIZA E RASTEVE ME KANCER REKTAL TË TRAJTUAR NË QENDRËN KLINIKE UNIVERSITARE TË KOSOVËS NË PERIUDHËN 2021 - 2023.

Krijon Gallopeni

Abstrakt

Hyrje: Karcinoma e rektumit është një problem global, e cila së bashku me kancerin e kolonit si kancer kolorektal, paraqet kancerin e tretë më të shpeshtë në botë. Rreth 45000 raste të reja të kancerit rektal diagnostikohen çdo vit në SHBA. Incidenca e kancerit rektal është në rritje të vazhdueshme në mbarë botën, veçanërisht në vendet që po adaptojnë mënyrën "perëndimore" të jetesës.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është analizimi i pacientëve me kancer rektal të trajtuar në QKUK, konkretisht në klinikën e Kirurgjisë Abdominale, përgjatë periudhës 2021 - 2023.

Metodologjia: Ky hulumtim klinik i tipit restrospektiv përshkrues është realizuar përmes grumbullimit të të dhënave nga protokollet e repartit të Kirurgjisë Abdominale në QKUK, në periudhën kohore Janar 2021 - Dhjetor 2023.

Rezultate: Në këtë hulumtim numri total i rasteve të analizuara është 131, ku 41 raste janë në vitin 2021, 33 raste në vitin 2022 dhe në vitin 2023 kemi një numër prej 57 rasteve. Nga 131 raste të pacientëve me karcinomë të rektumit 75 pacientë i takojnë gjinisë mashkullore apo 57% e totalit, ndërsa të gjinisë femërore janë 56 pacientë apo 43%.

Konkluzione: Nga rezultatet e fituara mund të konkludojmë se kanceri i rektumit në Kosovë është më i shpeshtë tek gjinia mashkullore. Numri më i madh i pacientëve është nga Prishtina.

Fjalë kyçe: karcinoma e rektumit, epidemiologjia, kolostomë, anastomozë.

RËNDËSIA E TERAPISË INTENSIVE NË PACIENTËT ME LUPUS ERITEMATOZ SISTEMIK - PREZANTIMI I TRE RASTEVE KLINIKE DHE RËNDËSIA E QASJES MULTIDISIPLINARE NË ICU.

Krisli Serani Md[1], Prof. Asc Dorina Ruci[2], Enri Kaci Md[2]
[1]Shërbimi i Anestezi - Reanimacion, QSUT
[2]Departamenti i Reumatologjisë, QSUT

Abstrakt
Hyrje: Lupus Eritematoz Sistemik (LES) mbetet një sëmundje autoimune me shtrirje sistemike dhe evoluim të paparashikueshëm, që shpesh çon në komplikacione akute, potencialisht fatale. Menaxhimi multidisiplinar dhe ndërhyrja e hershme në njësinë e terapisë intensive (ICU) janë faktorë kyç në përmirësimin e mbijetesës.
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë rëndësinë e kujdesit intensiv në pacientët me LES të shtruar në ICU gjatë një periudhe 3 - vjeçare, si dhe të evidentojë faktorët prognostikë që ndikojnë në ecurinë klinike.
Materiale dhe Metoda: Studimi përfshiu 57 pacientë me diagnozë të konfirmuar të LES, të shtruar në ICU në periudhën shtator 2022 – shtator 2025. Janë analizuar të dhënat demografike, organet e përfshira, shkaqet e shtrimit, modalitetet terapeutike dhe ecuria klinike. Të dhënat u përpunuan në mënyrë retrospektive.
Rezultate: Mesatarja e moshës ishte 38 ± 12 vjeç; 82% ishin femra. Shkaqet më të shpeshta të shtrimit ishin insuficienca respiratore (35%), shoku septik (28%) dhe përfshirja renale e avancuar (22%). 46% e pacientëve kërkuan ventilim mekanik, ndërsa 31% trajtim me hemodializë. Mortaliteti total ishte 26%.
Rekomandime dhe Konkluzione: Terapia intensive luan rol jetik në menaxhimin e komplikacioneve akute të LES, duke ofruar mundësi mbijetese për pacientë në gjendje kritike. Vlerësimi i hershëm i përfshirjes multiorganike, bashkëpunimi ndërdisiplinar dhe qasja individuale terapeutike përbëjnë bazën e përmirësimit të rezultateve klinike dhe reduktimit të mortalitetit.

Fjalë kyçe: Lupus Eritematoz Sistemik, ICU, insuficiencë multiorganike, imunosupresion, mbijetesë.

ROLI THELBESOR I TEKNIKUT TË ANESTEZISË NË SALLËN OPERATORE: VLERËSIM I EKSPERIENCËS SONË ME MBI 1300 NDËRHYRJE KIRURGJIKALE (MAJ 2024 – MAJ 2025).

Kristi Meçolli [1], Ervin Bekteshi MD[1], Krisli Serani MD[2], Marsel Dhima MD[2], Ardian Balla [1]
[1] Shërbimi i Anetsezi Reanimacion Trita Hospital
[2] Shërbimi i Anestezi Reanimacion, QSUT

Abstrakt
Hyrje: Në ambientin kompleks dhe dinamik të sallës operatore, roli i teknikut të anestezisë është i pazëvendësueshëm. Ai përfaqëson bashkëpunëtorin më të afërt të anestezistit, duke garantuar përgatitjen teknike të aparaturave, sigurinë e barnave anestezike dhe mbështetjen gjatë gjithë periudhës perioperatore. Pavarësisht rëndësisë së këtij roli, shpesh ai mbetet në hije dhe nënvlerësohet në diskursin profesional.
Qëllimi: Të vlerësojmë kontributin praktik dhe klinik të teknikëve të anestezisë në funksionimin efikas të sallës operatore dhe sigurinë e pacientit, duke u mbështetur në eksperiencën tonë të një viti në sallat kirurgjikale të ndryshme.
Materiale dhe Metoda: Ky është një studim retrospektiv përshkrues mbi aktivitetin e teknikëve të anestezisë në një periudhë 12 - mujore (maj 2024 – maj 2025), në një strukturë kirurgjikale me profil të larmishëm. Janë analizuar 1325 ndërhyrje kirurgjikale të ndara sipas specialitetit: estetike, abdominale, endoskopike, urologjike dhe gjinekologjike. Vlerësimi është bazuar në dokumentimin intraoperativ, rastet me komplikacione të menaxhuara dhe observimin e drejtpërdrejtë të bashkëpunimit teknik–mjek.
Rezultate: Teknikët e anestezisë kanë kontribuar në çdo fazë të procesit anesteziologjik: përgatitjen e monitorimit, aparaturave dhe barnave, asistencën gjatë induksionit, si dhe reagimin në kohë ndaj komplikacioneve (hipotension, bronkospazëm, vështirësi në intubim). Në 7% të rasteve, prania aktive e teknikëve ishte kyçe në menaxhimin e episodeve të paparashikuara intraoperative, duke përfshirë mbështetjen në ndryshimin e parametrave ventilatorë apo furnizimin urgjent me medikamente. Koordinimi i mirë me anestezistin ka reduktuar ndjeshëm kohët e përgjigjes dhe ka ndikuar pozitivisht në sigurinë e pacientit.
Konkluzione: Tekniku i anestezisë është një hallkë kritike e ekipit kirurgjikal. Roli i tij shkon përtej funksioneve teknike dhe përfshin reagimin klinik, mbështetjen operative dhe garancinë për standardin e sigurisë së pacientit gjatë gjithë ndërhyrjes.

Rekomandime: Rekomandohet investimi në formimin e vazhdueshëm profesional të teknikëve të anestezisë, përfshirja e tyre në protokollet klinike dhe njohja institucionale e kontributit të tyre real në sigurinë dhe efikasitetin e procedurave kirurgjikale.

Fjalë kyçe: hipotension, anestezi, ndërhyrje kirurgjikale, monitorim, teknikë.

SINDROMA E VJEDHJES SI DISAVANTAZH I ZGJEDHJES SË FISTULËS ARTERIOVENOZE TEK PACIENTËT KRONIK NË HEMODIALIZË: PREZANTIMI I NJË RASTI KLINIK DHE REFLEKTIM MBI VENDIMMARRJEN MULTIDISIPLINARE.

Kristiana Caushaj

Abstrakt

Hyrje: Fistula arteriovenoze (AVF) mbetet zgjedhja e preferuar për aksesin vaskular afatgjatë tek pacientët në hemodializë, për shkak të jetëgjatësisë dhe rrezikut të reduktuar të infeksioneve. Megjithatë, ky akses nuk është pa disavantazhe, dhe në raste të caktuara mund të çojë në komplikacione të rëndësishme hemodinamike siç është sindroma e vjedhjes (steal syndrome), e cila mund të kompromentojë perfuzionin distal dhe të rezultojë në ishemi të rëndë të ekstremiteteve.

Prezantim i rastit: Ky punim paraqet një rast klinik të një pacienti me insuficiencë renale terminale, në hemodializë prej katër vitesh, me histori të dy fistulave të mëparshme të dështuara për shkak të fluksit të ulët dhe trombozave. AVF - ja brakio - bazilike dexter funksionale për 16 muaj, rezultoi në zhvillimin e një sindrome të rëndë vjedhjeje që çoi në ishemi kritike të digitit të dytë të dorës së djathtë. Situata përshkallëzoi drejt një rreziku të lartë për amputim, i cili u evitua falë ndërhyrjes së koordinuar të një ekipi multidisiplinar të përbërë nga nefrologu, angio - kirurgu dhe ortopedi.

Diskutime: Ky rast nënvizon nevojën për një vlerësim të kujdesshëm dhe të individualizuar të opsioneve të aksesit vaskular, duke marrë në konsideratë faktorët komorbidë, gjendjen vaskulare periferike, historikun e aksesit të mëparshëm si dhe parametrat klinikë dhe laboratorikë të pacientit. Megjithëse AVF mbetet standardi i artë, ajo nuk përbën zgjidhje universale për çdo pacient. Prania e faktorëve të rrezikut për komplikacione vaskulare duhet të orientojë vendimmarrjen drejt alternativave të tjera, siç është vendosja e një kateteri të tunelizuar permanent, sidomos kur indikacionet klinike dhe të dhënat objektive e justifikojnë këtë zgjedhje.

Konkluzione: Ky rast thekson rëndësinë e bashkëpunimit multidisiplinar në procesin e vendimmarrjes dhe nevojën për të pranuar se, në disa situata, refuzimi i krijimit të fistulës mund të jetë zgjedhja më e sigurt për pacientin.

Fjalë kyçe: Fistula arteriovenoze, aksesi vascular, hemodinamik, rast klinik.

ROLI I AUTOIMUNITETIT TIROID NË SHËNDETIN E KOCKAVE TË SHTYLLËS KURRIZORE.

Latif Bytyqi, MD

Abstrakt

Hyrje: Sëmundjet autoimune të tiroides, përfshirë tiroiditin Hashimoto dhe sëmundjen e Graves, janë ndër çrregullimet autoimune më të shpeshta, sidomos tek femrat. Hormonet tiroide luajnë rol të rëndësishëm në rregullimin e metabolizmit kockor, ndërsa autoimuniteti tiroid, përmes mekanizmave inflamatorë dhe ndryshimeve hormonale, mund të ndikojë në dendësinë minerale të kockave (BMD), sidomos në shtyllën kurrizore e pasur me kockë trabekulare.

Qëllimi: Të vlerësohet ndikimi i autoimunitetit tiroid në shëndetin e kockave të shtyllës kurrizore, përmes analizimit të lidhjes së tij me densitetin mineral kockor (BMD), rrezikun e frakturave vertebrale dhe ndryshimet e markerëve të metabolizmit kockor.

Metodologjia: U realizua një rishikim narrativ i literaturës duke përdorur bazat e të dhënave PubMed, Scopus dhe Web of Science për vitet 2015–2025. U përfshinë studime klinike, kohorte, përmbledhje sistematike dhe meta - analiza mbi lidhjen midis autoimunitetit tiroid dhe shëndetit kockor (BMD spinale, frakturat vertebrale dhe markerët e metabolizmit kockor).

Rezultate: Të dhënat tregojnë se individët me autoantitrupa tiroidalë (anti - TPO, anti - Tg), edhe kur janë në gjendje eutiroide, paraqesin BMD më të ulët në shpinë dhe prevalencë më të lartë të frakturave vertebrale krahasuar me kontrollin. Në Hashimoto, menaxhimi jo i saktë i dozës së levotiroksinës (mbi - supresion i TSH) përshpejton humbjen kockore. Në Graves, hipertiroidizmi aktiv rrit ndjeshëm rrezikun e osteoporozës dhe frakturave, ndërsa trajtimi përmirëson metabolizmin kockor. Mekanizmat imunologjikë, përfshirë rrugën RANKL / OPG dhe citokinat pro - inflamatore (IL - 6, TNF - α), kontribuojnë në dëmtimin e kockës përtej efektit hormonal.
Përfundime: Autoimuniteti tiroid ndikon në shëndetin e kockave të shtyllës kurrizore si nëpërmjet çrregullimeve hormonale, ashtu edhe përmes inflamacionit kronik autoimun. Vlerësimi i statusit të antitrupave tiroidalë tek individët në eutiroidi mund të shërbejë si tregues shtesë i rrezikut për osteoporozë dhe fraktura vertebrale.
Rekomandime: 1. Mbajtjen e TSH në intervalin normal, duke shmangur mbi - terapinë; 2. Vlerësimin e densitetit kockor tek pacientët me antitrupa pozitivë, veçanërisht tek gratë postmenopauzale; 3. Studime të mëtejshme afatgjata për të qartësuar ndikimin e inflamacionit autoimun mbi mikroarkitekturën kockore.

Fjalë kyçe: autoimuniteti tiroid, Hashimoto, Graves, densiteti mineral kockor, shtylla kurrizore, fraktura vertebrale, osteoporozë.

INCIDENCA DHE TRAJTIMI I PACIENTËVE ME MENINGJIT PURULENT NË KLINIKËN INFEKTIVE NË VITIN 2020 - 2023.

Laur Gega

Abstrakt
Hyrje: Meningjiti purulent është infeksion bakterial i hapësirës subarahnoidale që konsiston në një emergjencë diagnostike dhe terapeutike. Infeksioni mund të merret në komunitet ose të jetë nozokomial dhe mund të vijë si shkak i invazionit hematogjen të baktereve në meningje nga bakteremia ose si rezultat i infeksionit direkt prej ndonjë vatre të infeksionit lokal.
Qëllimi: Qëllimi i punimit është të paraqesë dhe të krahsaojë incidencën e rasteve me meningjit purulent në Klinikën Infektive gjatë viteve 2020 deri 2023 dhe të kemi një pasqyrë të ecurisë dhe suksesit të mjekimit të këtyre pacientëve brenda kësaj periudhe.
Metodologjia: Ky është një studim i tipit kohort retrospektiv, ndërsektorial. Të gjitha të dhënat për pacientët e shtruar dhe ecurinë e tyre duke përfshirë suksesin e mjekimit dhe kohëzgjatjen e tij janë mbledhur në menyrë retrospektive nga 186 pacientë te hospitalizuar në Klinikën Infektive në Prishtinë me meningjit purulent gjatë periudhës 2020 - 2023.
Rezultate: Numri i pacientëve me meningjit purulent të shtruar në Klinikën Infektive në periudhën Janar 2020 - Dhjetor 2023 ka qenë 186. Numri më i lartë ka qenë në vitin 2023 me gjithsej 91 pacientë (49%), pasuar nga viti 2022 me 75 pacientë (40, 3%), pastaj viti 2021 me 19 pacientë (10, 2%) dhe në fund në vitin 2020 ka marrë trajtim vetëm 1 pacient (0, 5%). Sa i përket përfundimit të sëmundjes vërejmë se në total prej 186 rasteve në periudhën kohore Janar 2020 - Dhjetor 2023, 163 pacientë (87, 6%) kanë pasur ecuri të mirë të sëmundjes pa përfundim letal, kurse 23 pacientë (12, 3%) kanë përfunduar me exitus (vdekje).
Përfundime: Numri i rasteve në vitin 2020 me vetëm 1 pacient ishte shumë herë më i vogël se në vitet në vazhdim duke u rritur për secilin vit çdoherë e më shumë deri në vitin 2023 ku arrin numrin më të lartë me 91 raste.

Fjalë kyçe: incidencë, meningjit purulent, pacientë.

DOMOSDOSHMËRIA E PROMOVIMIT TË DHURIMIT TË GJAKUT PËR TË KOMPENSUAR NDIKIMIN E EMIGRACIONIT DHE PLAKJEN E POPULLSISË SHQIPTARE.

Laura Selimaj

Abstrakt

Hyrje: Në kushtet e një emigracioni të vazhdueshëm dhe plakjes së popullsisë promovimi i gjakut po kthehet në një domosdoshmëri për sigurimin e tij. Sipas ligjit Nr. 9739, datë 21. 5. 2007 për çdo ndërhyrje kirurgjikale pacienti duhet të sigurojë vetë gjakun me anë të familjarëve të tij. Sipas Censusit të vitit 2023 të INSTAT popullsia e Shqipërise ka rënë nga 2. 8 milion në vitin 2011 në 2. 4 milion në vitin 2023. Në këtë 14. 5 % te popullsisë së emigruar pjesa më e madhe janë grupmosha të reja. Kjo sjell vështirësi të zbatimit të skedës maksimale kirurgjikale dhe sigurimit të gjakut vullnetar.

Objektiva: Ky studim synon të analizojë impaktin e largimit të grupmoshave të reja dhe ndryshimeve demografike në dhurimin e gjakut. Domosdoshmëria tashmë për një qasje tjetër të promovimit të gjakut për të pasur një furnizim të qëndrueshëm me gjak.

Metodologjia: Analiza e literaturës mbi emigracionin dhe propozime për një qasje ndryshe që mund të rrisë pjesëmarrjen e popullsisë rezidente. Analiza e të dhënave të sakta dhe nxjerrja e konkluzioneve praktike. Rezultatet e pritshme: Promovimi i pandalshëm i grupmoshave të reja; përdorimi i medias dhe rrjeteve sociale për sensibilizimin e dhurimit; përdorimi i informacionit të dhuruesve për herë të parë në databazë aktuale dhe rekrutimi i tyre në dhurues vullnetar.

Përfundimi: Gjaku është një resurs kombëtar, si i tillë duhet trajtuar me një vizion dhe largpamësi në mënyrë që të parandalojmë një krizë dhe rënie të numrit të dhurimeve. Me anë të sensibilizimit të vazhdueshëm, ndryshimin e mentalitetit dhe praktikave të promovimit në mund të arrijmë qëndrueshmëri dhe krijimin e një numri të konsiderueshëm vullnetar të rregullt.

Fjalë kyçe: demografike, grupmosha, vullnetarë, dhurim gjaku, INSTAT.

DIABETI MELITUS TIP 1 NË FËMIJËT DHE ADOLESHENTËT; DIAGNOZA, TRAJTIMI DHE MONITORIMI.

PhD. Laurant Kollçaku, [1] Ass. Prof Agim Gjikopulli, Ass Prof. Virtut Velmishi, PhD. Afërdita Tako, Dr. Era Kurti

Shërbimi i Specialiteteve, Klinika e Endokrinologjisë dhe Diabetologjisë, Qëndëra Spitalore Universitare''Nënë Tereza'', Tiranë. Departamenti i Pediatrisë, Fakulteti i Mjekësisë.

Abstrakt

Diabeti mellitus tipi 1 (DMT1) është sëmundja endokrine dhe metabolike kronike më e zakonshme në fëmijët dhe adoleshentët, i cili ndodh për shkak të defiçitit asolut të insulinës nga shkatërrimi selektiv i qelizave beta insulin prodhuese, në personat gjenetikisht të predispozuar me ndërmjetësi autoimune, si rezultat i ndërveprimit kompleks i faktorëve gjenetikë dhe mjedisorë. DMT1 është një sëmundje me shumë ndikim tek fëmija i prekur, familja e tij, sistemi shëndetësor dhe gjithë shoqërinë, duke përfshirë pasojat në cilësinë e jetës, pasojat social - ekonomike. Shoqërimi i DMT1 me një sërë komplikacionesh e bën edhe më të rëndësishme diagnostikimin e hershëm dhe menaxhimin e përshtatshëm të tij. Konsiderimi i manifestimeve jo klasike para shfaqjes së shenjave klasike siguron një diagnozë të hershme para se të instalohet ketoacidoza diabetike (KAD). Fatkeqësisht në studimin e rasteve të paraqitura në QSUNT, 67. 8% e fëmijëve diagnostikohen për herë të parë me KAD, një shpeshtësi shumë e lartë krahasuar me vendet e zhvilluara. Rritja e njohurive mbi fiziologjinë e qelizës beta, përmirësimi i teknologjisë i prodhimit të insulinave sa më fiziologjike dhe teknologjisë së dhënies së insilinoterapisë, terapi nutricionale bazuar në raportin karbohidrate: insulin shoqëruar me aktivitet fizik të strukturuar ka përmirësuar ndjeshëm kontrollin glicemik të fëmijëve diabetik. Monitorimi i fëmijëve me DMT1 është i rëndësishëm për shkak të rriskut të rritur të shoqërimit me sëmundje të tjera autoimune dhe komplikacione. Njohja dhe trajtimi i sëmundjeve autoimune shoqëruese është mjaft i rëndësishëm pasi ndikojnë drejtpërdrejt në kontrollin metabolik dhe në mirëqenien e përgjithshme dhe cilësinë e jetës. DMT1 është një patologji i cili shoqërohet me komplikacione afat - shkurtra dhe afat - gjata nëse nuk menaxhohet mirë duke u bërë shkak për prishjen e cilësisë së jetës dhe familjes së tij, barrë ekonomike për familjen, sistemin shëndetësor dhe gjithë shoqërinë.

Fjalët kyçe: diabet mellitus tip 1, HbA1c, insulinë, karbohidrate, aktivitet fizik.

STRESI NË PUNË, DHE BALANCË MODELI I PSIKOTERAPISË POZITIVE.

Msc. Laureta Roshi,
Psikologe ligjore, psikoterapiste PP & Emdr.

Abstrakt

Hyrje: Ne zgjohemi dru që kërkojmë drurë të tjerë, për të fëshfërirë në pyllin e jetës në harmoni me natyrën dhe emocionet tona. Lëviz përsëri, jeto përsëri duke mundësuar një balacë mes energjisë sëinvestuar dhe ndjesive. Objekt i studimit është si ndikon stresi në punën e përditshme dhe sa balacë modeli Studimi i kryer në profesionet e rënda, vecanërisht në sektorin e hidrokarbureve sjell të dhëna sesi puna e një personi mund të ndikojë në shëndetin e tij mendor dhe anasjelltas. Si dhe ndërhyrja me Psikoterapinë positive dhe teknikat e relaksimit, balancë modelin sjellin një ekuilibër itë shëndetshëm midis punës dhe jetës. E rëndërishmerezultoi nga studimi mbështetja e punëdhënësit që mund të ndihmojnë në nxitjen e shëndetit të mirë mendor tek punonjësit. Gajtë trajnimeve të punonjësve u përqëndrova në katër fusha të shëndetit, shpërndarjes së energjisë dhe reagimit ndaj konflikteve " Modeli i ekuilibrit" i Nossrat Peseschkian njihet si " zemra" e psikoterapisë pozitive dhe përdoret në mjedise të ndryshme. Ai njihet gjithashtu si " modeli i diamantit" , " katër cilësitë e jetës" , " katër mënyrat e menaxhimit të konflikteve" ose " katër mënyrat ose mediat e aftësisë njohëse&quot. Modeli i ekuilibrit bazohet në pikëpamjen se në thelb ekzistojnë katër fusha të mëdha të jetës në të cilat njerëzit jetojnë dhe punojnë. Këto fusha ndikojnë në kënaqësinë e tij me jetën, vetëvlerësimin e tij, trajtimin e konflikteve dhe sfidave dhe formësojnë personalitetin e tij këtu dhe tani. Modeli bazohet në pikëpamjen holistike të njeriut të psikoterapisë pozitive. Në këtë kontekst flasim për sferat dhe aftësitë biologjike - fizike, racionale - intelektuale, socio - emocionale dhe shpirtërore - shpirtërore të njerëzve. Edhe pse potenciali për të katër aftësitë është i natyrshëm në të gjithë, arsimi, mjedisi dhe socializimi theksojnë disa dhe neglizhojnë të tjerat. Nossrat Peseschkian e sheh një ekuilibër të energjisë jetësore, të ndarë në katër fusha trup - performancë - kontakt - ndjenjë, si një kusht të favorshëm për shëndetin dhe qëndrueshmërinë.

Fjalë kyçe: stresi, balancë, model, psikoterapisë pozitive etj.

SHËNJUESIT MIOEPITELIALË NË IMUNOHISTOKIMINË E GJIRIT: HISTORI, PERFORMANCË DIAGNOSTIKE, PËRDORIM I KOMBINUAR DHE MODELE NË PROLIFERIMET PAPILARE–TUBULARE.

Prof. Asoc. Leart Berdica [1, 2, 3, 4], Prof. Asoc. Teona Bushati[1, 2, 3, 4], Dr. Erion Sukaj [2, 3, 4], Dr. Albina Ndoja[2, 3, 4]
[1]*Universiteti Mjekësisë Tiranë,*
[2] *Universiteti WBU,*
[3] *Cambridge Clinical Laboratories,*
[4]*Spitali Amerikan.*

Abstrakt

Qelizat mioepiteliale (QME) janë thelbësore në patologjinë diagnostike të gjirit: prania e tyre zakonisht mbështet sëmundjen in situ, ndërsa mungesa e tyre favorizon pushtimin, me përjashtime të rëndësishme te kanceri papilar i kapsuluar dhe ai papilar solid. Kjo paraqitje sintetizon evolucionin historik, biologjinë dhe zbatimin praktik të imunohistokimisë (IHK) së QME - ve, me theks te performanca e shënjuesve, strategjitë e kombinuara dhe modelet karakteristike në proliferimet papilare–tubulare. Shënjuesit e hershëm “mioidë” (SMA, desmina, S - 100, 34βE12) ofruan ndjeshmëri, por mungesë specifikiteti për shkak të reaktivitetit të kryqëzuar me stromën / myofibroblastet. Përdorimi pasues i heavy chain të miozinës së muskujve të lëmuar (SMMHC) dhe kalponinës përmirësoi përkatësisht specifikitetin dhe ndjeshmërinë, megjithatë ruajti kurthe në kontekste sklerozuese. Futja e shënjuesit bërthamor p63 rreth vitit 2000 mundësoi ngjyrosje të qartë dhe specifike të QME - ve dhe u bë gur themeli për vlerësimin e pushtimit; p40 (ΔNp63) ofron specifikitet shtesë në situata të caktuara. Praktika bashkëkohore më e mirë përdor të paktën dy shënjues komplementarë—një bërthamor (p63 ose p40) dhe një citoplazmatik (SMMHC ± kalponinë)—të interpretuar krahas morfologjisë në H&E. Ndihmësit (D2 - 40, CD10)

dhe citokeratinat bazale (CK5 / 6, CK14, 34βE12) ndihmojnë në diferencime specifike, por nuk janë zëvendësues të pavarur për QME - të. Rishikohen modelet kyçe diagnostike: hiperplazia duktale e zakonshme (UDH) dhe papilomat paraqesin QME të paprekura periferikisht dhe përgjatë thelbeve fibro - vaskulare; DCIS papilar zakonisht humb QME përgjatë thelbeve, por ruan një brez periferik; kanceri papilar i kapsuluar (EPC) dhe ai papilar solid (SPC) shpesh nuk kanë shtresë të demonstrueshme QME, por trajtohen si in situ kur janë të kufizuara; adenozat sklerozuese / lezionet komplekse sklerozuese ruajnë QME të zbehta mes myofibroblasteve; kanceri tubular nuk shfaq QME; adenozë mikroglandulare mungesë QME - sh, por me membranë bazale të paprekur. Kurthet e zakonshme përfshijnë interpretimin e gabuar të myofibroblasteve pozitive për kalponinë / SMA si QME, ngjyrosjen me njolla në QME të zbehta, pozitivitetin e qelizave tumorale për p63 në kanceret metaplastike / bazal - like dhe artefaktet para - analitike të fiksimit. Ne propozojmë panele dhe algoritme pragmatike për skenarë të shpeshtë (in situ kundrejt pushtimit, papiloma kundrejt DCIS papilar, imitime sklerozuese, EPC / SPC), duke theksuar kërkesën për një brez mioepitelial periferik të vazhdueshëm për të konfirmuar sëmundjen in situ dhe përdorimin e kujdesshëm të ngjyrosjeve të dyfishta. Të mbështetura në studime primare dhe referenca standarde, këto rekomandime synojnë të përmirësojnë saktësinë diagnostike, të reduktojnë mbivlerësimin ose nënvlerësimin e pushtimit dhe të harmonizojnë interpretimin patologjik me menaxhimin e pacientit.

Fjalë kyçe: papiloma, adenozë, QME, papilare, solide, miofibroblaste.

QELIZAT STAMINALE: POTENCIALI RIGJENERUES MBI INFARKTIN E MIOKARDIT.

Gelda Rrushi, Anisa Seferi, Briselda Lleshi, Jugera Kurteshi, Prof. Asoc. Leart Bërdica
[1]*Universiteti i Mjekësisë Tiranë*
[2]*Western Balkan University*
[3]*QSUT, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë*
[4]*Spitali Amerikan*

Abstrakt
Hyrje: Kapaciteti i kufizuar rigjenerues i zemrës përbën arsyen kryesore pse sëmundjet kardiovaskulare mbeten ndër shkaktarët kryesorë të vdekshmërisë, me infarktin e miokardit si një nga kontribuesit kryesorë. Ndonëse terapitë konvencionale ndihmojnë në ngadalësimin e progresit të sëmundjes, ato nuk arrijnë të rikthejnë funksionin miokardial të zonës se prekur. Duke pasur parasysh përparimin e shpejtë në kërkimet mbi qelizat staminale, aftësia e tyre për rigjenerim ofron një qasje premtuese për menaxhimin efektiv të sëmundjes.
Objektiva: Kjo përmbledhje synon të ofrojë një pasqyrë të studimeve klinike te kryera mbi terapinë me qeliza staminale në menaxhimin e infarktit te miokardit. Përmes një analize krahasuese, ne synojmë të sintetizojmë bazat e rolit rigjenerues të qelizave staminale në rikuperimin kardiak, duke theksuar arritjet dhe sfidat e vazhdueshme ne vendosjen e strategjive premtuese.
Metoda: Nje kërkim i gjerë bibliografik është kryer duke përdorur bazat kryesore të të dhënave si PubMed, Cochrane Library. Termat e kërkimit përfshinin: infarkti i miokardit (IM), infarkt akut i miokardit, IAM, qeliza staminale, qeliza staminale mezenkimale, qeliza progenitore kardiake, qeliza staminale pluripotente të indukuara, qeliza staminale embrionale, sëmundje ishemike të zemrës, rigjenerim, histopatologji.
Përfundime: Studimet e kryera kanë thelluar kuptimin mbi potencialin terapeutik të qelizave staminale në rigjenerimin e miokardit pas infarktit. Pavarësisht ndryshimeve në llojin e qelizave apo mënyrën e administrimit, ekziston një qëndrim i përbashkët për sigurinë dhe efektet e tyre të para pozitive, kryesisht përmes mekanizmave indirekt si **sinjalizimi parakrin**. Pavaresisht përparimeve, mbeten sfida lidhur me **mbijetesën e qelizave, efikasitetin e rrugëve të administrimit**, dhe **sigurinë afatgjatë**. Nevojiten **studime më gjithëpërfshirëse, të fazës III** për të konfirmuar përfitimet funksionale dhe për të mundësuar përdorimin klinik të këtyre terapive.

Fjalë kyçe: tortuoziteti i arteries bazilare, pasojat.

SËMUNDJA DUAR - KËMBË - GOJË.
Laerta Blakaj

Abstrakti
Hyrje: HFMD paraqet një sëmundje virale të lehtë mjaft të perhapur, e shkaktuar më së shpeshti nga virusi Coxsackie A16, dhe enterovirusi 71. Ka një shkallë të lartë të përhapjes, është shumë ngjitëse. Prek më shumë moshat nën 5 vjeç, por çdo moshë mund të preket. Karakterizohet me ndryshime eritematoze qe prekin duart, këmbët dhe ulçeroze në mukozën e gojës, por shoqërohet edhe me ethe, temperaturë, ënjtje të fytit etj. Bartet kryesisht me anë të dropleteve ajrore, pështymës, kollitjes, tështimave, dhe zakonisht zgjat 7 - 10 ditë.
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të kuptohen shkaqet e saj, mënyra e bartjes, mënyrat për parandalimin si dhe ndikimi i përgjithshëm i saj mbi shëndetin publik (sa është prezente, cilat mosha atakohen më shumë, dhe cili eshte ndikimi social dhe ekonomik i saj), diagnostikimi dhe trajtimi i HFMD.
Metodologjia: Ky punim është realizuar përmes metodës rishikim i literaturës, ku informacionet janë mbledhur nga artikuj shkencorë të publikuar nëpër revista mjekësore dhe institucione shëndetesore nderkombëtare të besueshme, WHO (Organizata Botërore e Shëndetësisë), CDC (Qëndra për kontrollimin e sëmundjeve dhe parandalimin) dhe te tjera si PubMed, Health Harvard Publishing, etj.
Rezultate: Prej rishikimit të literaturës, vlen të theksojmë që HFMD paraqet një sëmundje virale të lehtë, më e pranishme në periudhën pranverë - verë, që lehtë përhapet sidomos në ambientet e shkollës, çerdhes, ambienteve të mbyllura, përmes rrugëve respiratore, moshat më të prekura janë ato deri në 5 vjeç. Shkaktohet prej viruseve Cocsackie 16 A16 dhe entervovirus 71, por mund të prek çdo moshë. Si masa parandaluese konsiderohen mbajtja e higjenës personale, larje e shpeshtë e duarve, dezinfektimi i sipërfaqeve që mbajmë më shpesh kontakt me to, siç janë bankat, tavolinat apo lodrat e fëmijëve. Shoqërohet me ndryshime eritematoze dhe ulceroze të dhimbshme, në gojë, duar edhe në këmbë. Pastaj mund të ketë ethe, temperaturë. Zakonisht zgjat 7 deri në 10 ditë. Komplikime të mundshme janë meningiti, encefaliti.
Diskutime: Nga rishikimet e realizuara për këtë sëmundje, rezultojmë që HFMD është një sëmundje virale, shumë ngjitëse, më e shpeshtë te moshat e reja nën 5 vjeç. Përhapet më lehtë në ambiente që janë më të izoluara dhe më të frekuentuara siç janë ambientet e shkollës dhe çerdheve. Shkaku më i shpeshtë është virusi Cocsackie A16, enterovirus 71. Edhe pse shumica e kalojnë lehtë, mund të ketë raste të rralla me komplikime neurologjike si meningitet dhe encefalitet. E rëndesishme për të parandaluar shfaqjen e komplikimeve dhe përhapjes është mbajtja e higjenës personale dhe dezinfektimi i sipërfaqeve.

Fjalë kyçe: HFMD, infeksion viral, cocsackie A16, enterovirus, përhapja dhe parandalimi, eritematoze dhe ulceroze, duar - këmbë dhe gojë, rishikim.

KUR ALLOPURINOLI PËRKEQËSON DHIMBJEN: RAST I ARTRITIT GUTOZ ME NORMOURICEMI TEK NJË 19 - VJEÇAR, SFIDAT DIAGNOSTIKE DHE TERAPEUTIKE - CASE REPORT.
Dr. Laerta Goga
Reumatologe - Spitali Amerikan

Abstrakt
Hyrje: Artriti gutoz është një sëmundje inflamatore e shkaktuar nga depozitimi në artikulacione i kristaleve të uratit monosodik, zakonisht e lidhur me hiperuricemi. Megjithatë, raste me normouricemi janë të dokumentuara dhe mund të paraqesin sfida diagnostike.
Raportim rasti: Paraqesim një paciente femër, 19 vjeç, me histori 2 - vjeçare të artritit monoartikular recidivant në gjurin e majtë. Analiza e lëngut sinovial zbuloi kristale urate, duke konfirmuar diagnozën e gutës pavarësisht normouricemisë. Pacientja trajtohej fillimisht me AINS dhe glukokortikoide, por pas nisjes së allopurinolit u shfaq përkeqësim i simptomave, fenomen i njohur gjatë fillimit të terapisë ulëse të acidit urik. Futja e kolkicinës si mbrojtje solli stabilitet klinik dhe kontroll të simptomave, duke lejuar vijimin e terapisë me allopurinol.
Diskutime: Ky rast thekson rëndësinë e analizës së lëngut sinovial si standardi i artë për diagnostikimin e gutës, sidomos në raste me normouricemi. Përkeqësimi pas nisjes së allopurinolit nënvizon nevojën për përdorimin e profilaksisë me kolkicinë ose AINS në fazën fillestare të trajtimit.
Rekomandime: Në pacientët me artrit monoartikular, veçanërisht të rinj, duhet të mendohet për gutën edhe kur acidi uriku është normal. Aspirimi dhe analiza e lëngut sinovial mbeten bazë për konfirmimin e diagnozës.

Allopurinoli duhet të shoqërohet me kolkicinë në fazën fillestare për të parandaluar përkeqësimin e simptomave. Trajtimi duhet të jetë i individualizuar, duke balancuar reduktimin e uricemisë me kontrollin e simptomave klinike. Nevoja për ndjekje afatgjatë është thelbësore për të monitoruar aktivitetin, efektet anësore dhe për të vlerësuar funksionin artikular.

Fjalë kyce: Guta, normouricemi, likid sinovial, kolcicin, allopurinol.

EPILEPSIA PEDIATRIKE: FAKTORËT E RREZIKUT DHE MENAXHIMI HERSHËM.

Dr. Learta Nika[1], Dr. Fatbardh Halitaj[1], Kosovare Morina[1]
[1]Fakulteti i mjekësisë, Universiteti i Prishtinës

Abstrakt
Hyrje: Epilepsia pediatrike është një nga çrregullimet më të shpeshta neurologjike tek fëmijët, me prevalencë globale 4–10 për 1000 fëmijë. Ajo karakterizohet nga kriza të përsëritura të shkaktuara nga aktiviteti elektrik jonormal i trurit. Manifestimet klinike tek fëmijët janë të ndryshme dhe shpesh vështirë të dallohen nga çrregullime të tjera neurologjike ose zhvillimore. Diagnostikimi dhe menaxhimi i hershëm janë vendimtarë për parandalimin e dëmtimeve njohëse dhe për përmirësimin e cilësisë së jetës.
Qëllimi: Ky punim synon identifikimin dhe analizimin e faktorëve të rrezikut të epilepsisë pediatrike, përfshirë ndikimet gjenetike, prenatal, perinatal dhe mjedisore, si dhe shqyrtimin e qasjeve bashkëkohore të diagnostikimit dhe menaxhimit.
Metodologjia: Studimi është një rishikim përshkrues i literaturës ndërkombëtare (PubMed, Google Scholar), ku janë përfshire publikime me të dhëna epidemiologjike dhe klinike. Rezultatet janë sintetizuar sipas tre tematikave kryesore: faktorët e rrezikut, diagnostikimi i hershëm dhe menaxhimi.
Rezultatet: Faktorët e rrezikut: Epilepsia pediatrike është multifaktoriale. Bazat gjenetike lidhen me mbi 70% të rasteve idiopatike. Faktorët prenatalë dhe perinatalë (lindja e parakohshme, infeksionet prenatale, asfiksia) përbëjnë rreth 20–25% të rasteve simptomatike. Faktorët neurologjikë dhe strukturorë si malformacionet kortikale dhe traumat neonatale kontribuojnë në 15–20% të rasteve. Faktorët mjedisorë (duhanpirja, mungesa e folatit, ekspozimi ndaj ndotësve) lidhen me një rritje të rrezikut prej 30–40%. Diagnostikimi i hershëm: Diagnostikimi i bazuar në anamnezë klinike, video - EEG, MRI dhe testime gjenetike / metabolike mundëson identifikimin e saktë në mbi 80% të rasteve. Vonimi i diagnozës pas krizës së dytë lidhet me përkeqësim njohës në rreth 35% të fëmijëve. Menaxhimi: Ilaçet antiepileptike kontrollojnë krizat në rreth 50–60% të rasteve; 20–30% e fëmijëve kanë epilepsi rezistente ndaj trajtimit. Kujdesi multidisiplinar (neurologjik, psikologjik, rehabilitues) përmirëson cilësinë e jetës në mbi 70% të pacientëve dhe redukton recidivat me rreth 40%.
Përfundime: Diagnostikimi i hershëm dhe menaxhimi i personalizuar, përfshirë trajtimin farmakologjik, dietën ketogjenike dhe mbështetjen psikologjike, përbëjnë qasjen më efektive. Testet gjenetike ndihmojnë në përcaktimin e etiologjisë dhe udhëzimin e terapive të reja.

Fjalë kyçe: Epilepsia pediatrike, faktorët e rrezikut, diagnostikimi i hershëm, menaxhimi farmakologjik, dieta ketogjenike, kujdes multidisiplinar.

SINDROMA E VEZORES POLICISTIKE (PCOS) – LIDHJA MIDIS STILIT TË JETËS DHE DISBALANCËS HORMONALE.

Kosovare Morina[1], Dr. Learta Nika[1]
[1]Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës

Abstrakt:
Hyrje: Sindroma e vezores policistike (PCOS) është një çrregullim endokrin i zakonshëm tek gratë në moshë riprodhuese, me prevalencë globale rreth 6–13% (WHO). Ajo karakterizohet nga cikle menstruale të çrregullta, hiperandrogjenizëm dhe vezore policistike, dhe shoqërohet shpesh me obezitet, rezistencë ndaj insulinës dhe rritje të rrezikut për diabet dhe sëmundje kardiovaskulare. Roli i stilit të jetesës – dieta, aktiviteti fizik dhe faktorët psikologjikë – është thelbësor në modulimin e disbalancës hormonale dhe manifestimeve klinike të PCOS.

Metodologjia: Ky punim bazohet në një rishikim sistematik të literaturës ndërkombëtare (2015–2025) nga PubMed dhe Google Scholar, përfshirë studime klinike, RCT dhe metaanaliza, për të analizuar ndikimin e ndryshimeve në stilin e jetesës mbi parametrat hormonalë dhe metabolikë te gratë me PCOS.
Rezultate: Evidencat tregojnë se dieta me indeks glicemik të ulët përmirëson ndjeshmërinë ndaj insulinës me 25–35%, ndërsa dieta mesdhetare ul nivelet e androgjenëve me 20–25% dhe rregullon ciklin menstrual në 60–70% të rasteve. Dieta ketogjenike redukton BMI - në me rreth 10% dhe përmirëson ovulacionin në 50% të grave me PCOS. Aktiviteti aerobik dhe rezistues ndihmon në humbjen e peshës me 5–10% dhe rrit ndjeshmërinë ndaj insulinës deri në 30%**.** Mbështetja edukative dhe psikologjike përmirëson aderencën ndaj trajtimit në 80% dhe cilësinë e jetës në 70% të rasteve.
Përfundime: Studimi nënvizon rëndësinë e një qasjeje multidisiplinare që integron dietën, ushtrimet dhe mbështetjen psikologjike si trajtimin fillestar të PCOS. Ndërhyrjet jo - farmakologjike janë efektive për reduktimin e simptomave dhe parandalimin e komplikimeve afatgjata metabolike dhe kardiovaskulare.
Modifikimi i stilit të jetesës përbën themelin e menaxhimit të PCOS, duke përmirësuar parametrat hormonalë dhe metabolikë, rikthimin e ovulacionit dhe cilësinë e jetës së pacientëve. Trajtimet farmacologjike mund të konsiderohen vetëm nëse ndërhyrjet jofarmakologjike nuk janë të mjaftueshme.

Fjalë kyçe: Sindroma e vezores policistike (PCOS), disbalanca hormonale, stili i jetesës, dieta me indeks glicemik të ulët, aktiviteti fizik, rezistenca ndaj insulinës, hiperandrogjenizmi, fertiliteti, mbështetja psikologjike, menaxhimi multidisiplinar.

VLERËSIMI I FAKTORËVE TË AKTIVITETIT FIZIK NË PACIENTËT ME INSUFICIENCË KARDIAKE NË NJË SPITAL TË TIRANËS.

Ledi Neçaj
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë.

Abstrakt
Qëllimi: Ky studim synon të vlerësojë shkallën në të cilën pacientët me insuficiencë kardiake (HF) përfshihen në ushtrime fizike, të karakterizojë parametrat që lidhen me një aktivitet të tillë dhe të hetojë pengesat dhe motivimet e mundshme për një aktivitet të tillë.
Materiali dhe Metoda. Tipi i Studimit: kros - seksional**.** Vendi dhe Kohëzgjatja: Nga korriku 2024 deri në shkurt 2025, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" në Tiranë, Shqipëri.
Në këtë studim u përfshinë gjithsej 90 pacientë të dy gjinive me insuficiencë kardiake. Mosha, gjinia, BMI e pacientëve, niveli arsimor, kohëzgjatja e sëmundjes së zemrës dhe prania e sëmundjeve shoqëruese u dokumentuan pas marrjes së pëlqimit me shkrim të informuar. Pacientëve me insuficiencë kardiake iu dha një anketë që përfshinte pyetje mbi nivelet e aktivitetit të tyre fizik (përshtatur nga Pyetësori i Shkurtër - International Physical Activity Questionnare), si dhe çdo pengesë që mund të kishin dhe çdo stimul pozitiv që mund të kishin. Të dhënat u analizuan duke përdorur SPSS 25. 0.
Rezultate: Mosha mesatare e pacientëve ishte 67, 9±20, 96 vjeç dhe kishin BMI mesatare 26, 1±4, 49 kg / m2. Shumica ishin meshkuj 65 (62. 04%) dhe 25 (37. 96%) raste ishin femra. Sëmundjet bashkëshoqëruese më të zakonshme, ishin hipertensioni i gjetur në 47 raste, i ndjekur nga Diabeti Mellitus në 22 raste dhe sëmundja e veshkave në 11 raste. Pacientet meshkuj 54 (59, 9%) ishin të arsimuar dhe 36 (40, 1%) ishin me nivel te ulet arsimor. Nga të gjithë, 26 (29. 2%) pacientë kishin nivel të ulët të aktivitetit fizik, 42 (46. 7%) raste kishin nivel mesatar dhe 22 (22. 6%) raste kishin nivel të lartë të aktivitetit fizik. Kishte një korrelacion të fortë midis niveleve të rritura të ushtrimeve dhe niveleve të edukimit, vetë - efikasitetit dhe motivimit në të gjitha rastet. Më shumë se gjysma (59. 4%) e të anketuarve përmendën faktorët psikologjikë si shtysë kryesore për aktivitetin e rregullt fizik, ndërsa vetëm 31. 4% përmendën faktorët fizik dhe 23. 4% përmendën faktorët social.
Përfundime: Ky studim zbuloi se 35% e pacientëve me insuficiense kardiake (HF) nuk kryenin asnjë lloj aktiviteti fizik në baza ditore. Njohuritë e pacientit, vetëvlerësimi i ushtrimeve dhe motivimi janë më të rëndësishme se sa ashpërsia e sëmundjes ose simptomave kur kështillohet një pacient me insuficiencë kardiake për aktivitetin fizik. Mosha, BMI dhe simptomat e shqetësimit parashikuan të gjithë parametrat e rëndësishëm të aktivitetit fizik në pacientet me insuficiencë kardiake.

Fjalët kyçe: insuficienca kardiake, aktiviteti fizik, parashikuesit, sëmundjet shoqëruese, mosha.

REZULTATET FUNKSIONALE DHE RADIOLOGJIKE PAS SHTIFTIMIT INTRAMEDULAR TË FRAKTURAVE TROKANTERIKE: NJË STUDIM KLINIK PROSPEKTIV.

Op. Ledian Fezollari, Prof. Asc. Vilson Ruci, Prof. Asc. Edvin Selmani, PhD Artan Distafa, Gezim Biba, Alfred Gega
Spitali Universitar i Traumës, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Frakturat trokanterike të femurit janë ndër dëmtimet më të shpeshta tek pacientët e moshuar me osteoporozë. Fiksimi dhe mobilizimi i hershëm kirurgjikal janë thelbësorë për të zvogëluar morbiditetin dhe vdekshmërinë.
Objektiva: Të vlerësohen rezultatet funksionale dhe radiologjike të frakturave trokanterike të trajtuara me shtift intramedular duke përdorur implante Gamma Nail, PFNA ose PFN.
Metoda: Një studim prospektiv u krye në 136 pacientë të njëpasnjëshëm me fraktura trokanterike të trajtuara kirurgjikalisht midis viteve 2023 dhe 2024. Pacientët u ndoqën për një vit. Rezultati funksional u vlerësua duke përdorur Harris Hip Score (HHS) dhe konsolidimi radiologjik u vlerësua në intervale të rregullta.
Rezultate: Nga 136 pacientë, 90 u trajtuan me një Gamma nail, 10 me PFNA dhe 36 me PFN. Koha mesatare deri në konsolidimin radiologjik ishte 12 javë. Bazuar në HHS, shumica arritën rezultate të mira deri në shumë të mira në një vit. Dymbëdhjetë pacientë (8. 8%) vdiqën gjatë ndjekjes, kryesisht për shkak të komorbiditeteve mjekësore që nuk lidhen me kirurgjinë. Komplikimet përfshinin konsolidimin varus në 3 raste (2. 2%) dhe dalja e vidës në 3 raste (2. 2%).
Përfundime: Shtiftimi intramedular është një metodë efektive dhe e besueshme për trajtimin e frakturave trokanterike tek pacientët e moshuar me osteoporozë, duke siguruar fiksim të qëndrueshëm, ecje të hershme dhe rikuperim funksional të favorshëm.

Fjalë kyçe: fraktura trokanterike, femur, implante, radiologji.

SFIDAT NË SHTIFTIMIN E FRAKTURAVE KOMPLEKSE FEMORALE PERTROKANTERIKE DHE SUBTROKANTERIKE: NJË STUDIM RETROSPEKTIV (2020–2024).

Op. Ledian Fezollari, Prof. Asc. Vilson Ruci, Prof. Asc. Edvin Selmani, PhD. Artan Distafa, Gezim Biba, Alfred Gega, Roxhers Mucaj, Elton Lepuri.
Trauma University Hospital, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Frakturat pertrokanterike dhe subtrokanterike të femurit mbeten një sfidë e madhe për shkak të anatomisë komplekse dhe streseve të larta mekanike. Shtiftimi intramedular, duke përfshirë Gamma nail i shkurter dhe shtifti i gjatë, është trajtimi i preferuar, por shpesh paraqet vështirësi teknike. Ky studim retrospektiv shqyrton rezultatet dhe sfidat e shtiftimit në raste komplekse të menaxhuara midis viteve 2020 dhe 2024.
Metoda: Tridhjetë e tetë pacientë me fraktura pertrokanterike dhe subtrokanterike të trajtuara me Gamma nail i shkurtër ose i gjatë u analizuan në mënyrë retrospektive. Parametrat e studiuar përfshinin lehtësimin e dhimbjes, shkallën e bashkimit, komplikimet dhe rikuperimin funksional.
Rezultate: Shumica e pacientëve arritën konsolidim dhe lehtësim të kënaqshëm të dhimbjes. Vështirësitë teknike lidheshin kryesisht me reponimin, identifikimin e pikës së hyrjes dhe ruajtjen e aksit. Komplikimet përfshinin konsolidim të vonuar në 3 raste, infeksion sipërfaqësor në 2 dhe dështim të implantit në 1. Shumica arritën rikuperim të mirë funksional brenda 6 muajve.
Përfundimi: Menaxhimi i suksesshëm i këtyre frakturave varet nga reponimi i saktë, përzgjedhja e saktë e shtiftit dhe vigjilenca intraoperative. Pavarësisht sfidave teknike të natyrshme, shtiftimi intramedular mbetet një opsion efektiv dhe i besueshëm për këto lëndime.

Fjalë kyçe: frakturë pertrokanterike, frakturë subtrokanterike, gama nail, shtift i gjatë, fiksim intramedular, kirurgji ortopedike.

SHNDËRRIMI I EVIDENCËS NË PRAKTIKË: NJË PËRMBLEDHJE E UDHËZIMEVE TË ACR - SË TË VITIT 2022 PËR MENAXHIMIN E GUTËS.

Dr. Ledio Collaku[1], Pandush Pojani[1], Adela Allko[1], Eneida Hoxha[1],
Klinika e Mjekësisë Interne dhe Hipertensionit, QSUNT, Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Kolegji Amerikan i Reumatologjisë (ACR) publikoi një udhëzim të përditësuar të bazuar në evidenca në vitin 2022 për të adresuar diskutimet e vazhdueshme në lidhje me cilësinë e kujdesit për Gutën. Ky abstrakt përmbledh rekomandimet kryesore për të ndihmuar në zbatimin e tyre nga klinicistët.

Metodologjia: Udhëzimi i ACR - së në 2022 u zhvillua duke përdorur metodologjinë GRADE (Grading of Recommendations Assessment, Development and Evaluation). Një panel multidisiplinar votues, që përfshinte edhe pacientë, mori në konsideratë preferencat e pacientëve, përfitimet dhe dëmet klinike, si dhe përdorimin e burimeve për të formuluar rekomandime të kushtëzuara dhe të forta.

Rezultate: Udhëzimi thekson një parim thelbësor: **Terapinë për Uljen e Urateve (ULT)** për të gjithë pacientët me kriza të shpeshta, tofe, artrit të kronik gutoz, ose dëmtim radiografik. Objektivi për acidin urik serik (AUs) mbetet <6. 0 mg / dL, me një rekomandim më të fortë për një objektiv <5. 0 mg / dL në pacientët me Gutë të rëndë (tofe, shpërthime të shpeshta). Rekomandimet kryesore përfshijnë: **Fillimi & Dozimi i ULT:** ULT rekomandohet gjatë një shpërthimi akut me kusht që të administrohet njëkohësisht edhe profilaksi anti - inflamatore. Alopurinoli rekomandohet fort si terapi e rendit të parë, duke filluar me një dozë të ulët (≤100 mg në ditë, më e ulët për sëmundje kronike të veshkave) dhe duke e rritur çdo 2 - 5 javë deri sa të arrihet objektivi i AUs. **Profilaksa:** Profilaksa njëkohësisht me anti - inflamatore (Kolkicina, NSAID, ose prednizon) rekomandohet fort për të paktën 3 - 6 muaj kur niset ose rritet ULT, duke vazhduar për 3 muaj pasi të arrihet objektivi i sUA (me kusht) ose 6 muaj nëse janë të pranishme tofe. **Menaxhimi i Shpërthimeve Akute:** Kolkicina, NSAID, ose glukokortikoide (orale, intra - articulare, ose intramuskulare) rekomandohen fort si terapi të rendit të parë. **Stili i Jetesës & Ushqimi:** Udhëzimi thekson se vetëm modifikimet dietike janë të pamjaftueshme për shumicën e pacientëve, por rekomandon kufizimin e alkoolit, të sirupeve me fruktozë të lartë, dhe të organeve të brendshme.

Përfundimi: Udhëzimi i ACR - së të 2022 ofron një kornizë të qartë për menaxhimin efektiv të Gutës. Shtyllat e saj qendrore janë një strategji "treat - to - target" me synim për një profilaksi të përshtatshme, një preferencë për Alopurinol dhe Febuxostate me titrim agresiv të dozës, dhe një zhvlerësim të kufizimeve dietike joefikase. Adaptimi i gjerë i këtyre rekomandimeve është thelbësor për përmirësimin e rezultateve afatgjata të pacientëve.

Fjalë kyçe: Guta, profilaksia, ULT.

INTELIGJENCA ARTIFICIALE (AI) NË IVF, SOT DHE NESËR.

Ledja Toro, MD, OB GYN, Fertility Expert.
Spitali Amerikan II, Albania,

Abstrakt

Hyrje: AI po luan një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në fushën e fertilizimit in vitro, duke ndihmuar në përmirësimin e rezultateve, uljen e kostove dhe personalizimin e trajtimit për çiftet që vuajnë infertilitetin.

Qëllimi: Të identifikojë platformat specifike që përdorin AI në IVF, dhe zbatimin praktik të tyre, të krahasojë rezultatet e IVF para dhe pas aplikimit të AI, të kryejë një panoramë fotografike të situatës në Shqipëri.

Materiale dhe Metoda: Analizë e artikujve shkencorë të publikuar së fundmi – si *Fertility and Sterility, Lancet, IEEE Transactions on Medical Imaging*, raporte dhe dokumente klinikash, analiza krahasuese, platforma dhe aplikacione komerciale.

Metoda: *Systematic review*, analizë krahasuese, analizë statistikore, analizë etiko - ligjore.

Rezultate: Përfitimet klinike të AI në IVF, kanë sjellë përmirësim të performancës së IVF, në drejtim të efikasitetit, personalizimit, dhe probabilitetit të suksesit.

Konkluzione: Përzgjedhja më e saktë e embrionit, trajtimi më i sigurtë dhe efektiv, rritja e efikasitetit të laboratorit, vlerë parashikuese në rezultatet e IVF, përmirësim i përvojës së pacientit, përdorim më i mirë i të dhënave mjekësore, redukton kostot afatgjata.

Rekomandime: Integrimi i kujdesshëm në praktikën klinike si mjet ndihmës jo si zëvendësues i ekspertizës mjekësore, trajnimi i stafit mjekësor, përdorimi i algoritmeve të validuara klinikisht, cilësia e të dhënave, monitorimi i performancës në kohë reale, transparenca dhe mbrojtja e privatësisë së pacientëve, nevoja për studime afatgjata me bashkëpunim ndërdisiplinor dhe standardizim ndërkombëtar.

Fjalë kyçe: inteligjenca artificiale, IVF, embrion.

PSIKIATRIA KONSULTATIVE - NDËRLIDHËSE DHE ÇRREGULLIMET NEUROPSIKIATRIKE NË SËMUNDJET KRONIKE TË VESHKAVE.

L. Sinani[1], I. Seitaj[1], A. Saliu[1].
[1]*Departamenti i Psikiatrisë, QSUT Nënë Tereza, Tiranë, Shqipëri.*

Abstrakt
Hyrje: Gjendjet neuropsikiatrike duke përfshirë depresionin, çrregullimet e ankthit dhe dëmtimet njohëse janë të përhapura te pacientët me sëmundje kronike të veshkave (SKV). Disa hipoteza janë përpjekur të shpjegojnë lidhjen midis SKV dhe çrregullimeve neuropsikiatrike.
Objektivi: Të ofrohet një përmbledhje e punës së një psikiatrie ndërlidhëse në një njësi spitalore të mjekësisë renale dhe të përmblidhen provat klinike dhe mekanizmat e mundshëm që lidhin SKV me çrregullimet e trurit, veçanërisht në lidhje me dëmtimin kognitiv, ankthin dhe depresionin.
Metoda: Rishikim sistematik i të dhënave të disponueshme për Psikiatrinë Konsultative - Liaison dhe gjendjet neuropsikiatrike në pacientët me sëmundje kronike të veshkave.
Rezultate: Ekziston një prevalencë e lartë e sëmundjeve psikiatrike tek pacientët që jetojnë me sëmundje kronike të veshkave, por pavarësisht kësaj, sëmundja psikiatrike shoqëruese shpesh nëndiagnostifikohet dhe nëntrajtohet, duke çuar në një rritje të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë. Bashkëpunimi ndërmjet psikiatërve dhe klinicistëve të tjerë mund të ndihmojë në njohjen dhe menaxhimin e kushteve psikiatrike shoqëruese te pacientët me SKV.
Konkluzione: Niveli i lartë i komorbiditetit kompleks fizik / psikiatrik, sugjeron që menaxhimi i pacientëve në një njësi spitalore të mjekësisë renale kërkon një bashkëpunim dhe dedikim të një ekipi të psikiatrisë ndërlidhëse, multidisiplinare, të udhëhequr nga konsulenti psikiatër, i cili është i trajnuar mirë në çështjet psikodinamike dhe kompleksitetin e çështjeve biologjike që lindin.

Fjalë kyçe: sëmundje kronike të veshkave, çrregullime neuropsikiatrike, njohje, sëmundje cerebrovaskulare, ankth, depression

APLIKIMI I BARNAVE I ASISTUAT NGA LAZERI (LADD) NË TRAJTIMIN E SHENJAVE POST - KIRURGJIKALE: NJË QASJE E RE MES DERMATOLOGJISË DHE KIRURGJISË PLASTIKE.

Dr. Lejla Zeka, Dr. Bujar Gashi
Qendra Klinike Universitare e Kosovës

Abstrakti
Shenjat hipertrofike dhe keloidet paraqiten si problem i shpeshtë pas ndërhyrjeve kirurgjikale. Trajtimet standarde përfshirë injektimet intralezionale dhe kremat me silikon, shpesh japin rezultate të pjesshme. Një nga arsyet kryesore është penetrimi i kufizuar i barnave topikale për shkak të barrierës së fortë të lëkurës.
Qëllimi: Ky punim synon të paraqesë potencialin e Laser - Assisted Drug Delivery (LADD) si metodë inovative që mund të përmirësojë menaxhimin e shenjave post - kirurgjikale duke kombinuar qasjen e dermatologjisë me kirurgjinë plastike.
Materiali dhe Metodat: Teknika bazohet në përdorimin e lazerit fraksional ablativ (CO_2 ose Er: YAG), i cili krijon mikro - kanale në epidermë dhe dermë. Këto hapësira të vogla lehtësojnë depërtimin e barnave. Trajtimi u realizua me seanca planifikuara në intervale te caktuara kohore. Vlerësimi i ndryshimeve u bë sipas shkallës së Vancouver Scar Scale (VSS) dhe dokumentimeve fotografike.

Rezultate: Raportet preliminare tregojnë se LADD zakonisht përmirëson parametrat e shenjave: ul trashësinë, përmirëson ngjyrën dhe strukturën e tyre, si dhe redukton simptomat si dhimbja dhe kruarja. Përveç te tjerash, pacientët raportojnë një nivel më të lartë kënaqësie estetike.
Përfundime: Laser - Assisted Drug Delivery përfaqëson një qasje premtuese në menaxhimin e shenjave post - kirurgjike. Kjo metodë, që bashkon teknologjinë dermatologjike me kirurgjinë rikonstruktive ka potencial të ulë nevojën për ndërhyrje të përsëritura dhe të ofrojë rezultate më të mira afatgjata për pacientët. Studimet kryesore klinike tregojnë se: "Hypertrophic Scar Outcomes in Fractional Laser - Assisted Topical Corticosteroid Delivery vs Fractional Laser Monotherapy" (2021): LADD dha përmirësim në shenja dhe efekte anësore minimale. "Laser - Assisted Drug Delivery in the Treatment of Hypertrophic Scars and Keloids: A Systematic Review" (2024): LADD përmirësoi rezultatet krahas kremave topikal të vetëm dhe shpesh është e krahasueshme me injeksionet intralesionale.

Fjalë kyçe: Laser - Assisted Drug Delivery (LADD), Shenjat hipertrofike, keloidet, fractional carbon dioxide laser (CO_2), mikro - kanale, barna, injeksionet intralesionale.

EFEKTET E SUPLEMENTEVE TË SELENIT DHE ZINKUT NË PARAMETRAT LABORATORIKË TË PACIENTËVE ME TIROIDIT HASHIMOTO.

Dr. Leon Hajdari[1], Besë Morina[1], Dr. Vlerë Morina[1]
Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës

Abstrakt
Hyrje: Tiroiditi Hashimoto është sëmundja autoimune më e shpeshtë që çon në hipotiroidizëm në vendet me suficiencë të jodit. Suplementet si seleni dhe zinku, për shkak të vetive antioksidante dhe imunomoduluese, janë studiuar për rolin e tyre në përmirësimin e funksionit tiroidal dhe reduktimin e proceseve inflamatore.
Qëllimi: Të vlerësohen efektet e suplementimit me selen dhe zink në nivelet e antitrupave antitiroid (anti - TPO, anti - TG) dhe në funksionin tiroidal (TSH, FT3, FT4).
Metodologjia: U analizuan të dhënat nga tre studime të kontrolluara: një RCT me 68 gra me tiroidit Hashimoto të ndara në katër grupe (zink, selen, Zn+Se dhe placebo); një RCT me 90 pacientë që morën selenomethioninë (200 µg / ditë për 6 muaj); dhe një meta - analizë e 35 RCT - ve me 2, 358 pacientë. U vlerësuan ndryshimet në TSH, FT3, FT4, anti - TPO dhe stresi oksidativ (MDA).
Rezultate: Suplementimi me zink dhe selen (Zn+Se) rezultoi në përmirësim të dukshëm të parametrave laboratorik si rritje të FT3 dhe FT4 dhe rënie të TSH; ($p<0.05$), ndërsa zinku i vetëm ndikoi kryesisht në rritjen e FT3. Seleni si monoterapi nuk pati ndikim të rëndësishëm në hormonët e lira. Në studimin me 2, 358 pacientë, seleni (200 µg / ditë) reduktoi në mënyrë sinjifikante antitrupat anti - TPO dhe TSH (në pacientët pa terapi hormonale), si dhe stresin oksidativ. Një tjetër studim tregoi ulje të anti - TPO, anti - TG dhe TSH pas 6 muajve suplementimi me selenomethioninë, së bashku me rritje të qelizave T - regulatore.
Përfundime: Suplementet e selenit dhe / ose zinkut kanë potencial të rëndësishëm për modulimin e funksionit tiroidal dhe përgjigjes autoimune në pacientët me tiroidit Hashimoto. Zinku ndikon në rritjen e hormonit FT3, ndërsa kombinimi Zn+Se përmirëson profilin laboratorik (FT4, TSH). Seleni veçmas kontribuon në uljen e antitrupave autoimunë (anti - TPO dhe anti - TG) dhe të TSH, veçanërisht te pacientët që nuk marrin terapi hormonale zëvendësuese. Mekanizmat përfshijnë reduktimin e stresit oksidativ që tregohet përmes uljes së nivelit të malondialdehyde (MDA) në serum dhe aktivizimin e qelizave T - regulatore.

Fjalë kyçe: Hashimoto, seleni, zinku, anti - TPO, tiroiditi autoimun

MENAXHIMI I TERAPISË ANTITROMBOTIKE TE PACIENTËT ME RREZIK TË LARTË PËR HEMORRAGJI QË I NËNSHTROHEN NDËRHYRJES PERKUTANE KORONARE (PCI).

Prof. Assoc. Leonard Simoni, Dr. Kristi Ziu, Dr. Ilva Gogo, Dr. Trugela Gega, Prof. Alban Dibra
Klinika e Kardiologjisë, QSUT "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Ndërhyrja Perkutane Koronare (PCI) është një strategji themelore e rivaskularizimit për individët me sëmundje të arterieve koronare (SAK). Terapia e dyfishtë antiagreegante (DAPT), e përbërë nga aspirina dhe një frenues i receptorit P2Y12, është thelbësore në reduktimin e komplikacioneve trombotike, veçanërisht trombozën e stentit dhe infarktin e miokardit pas PCI. Objektivi kryesor klinik i DAPT është minimizimi i këtyre ngjarjeve ishemike kritike, të cilat mund të kompromet ojnë rëndë rezultatet e pacientit.
Megjithatë, administrimi i DAPT shoqërohet në mënyrë të qenësishme me një rrezik të lartë hemorragjie, një shqetësim që ka fituar rëndësi në rritje në praktikën klinike. Ngjarjet madhore të hemorragjisë nuk janë thjesht komplikacione procedurale; ato janë të lidhura në mënyrë të pavarur me rritjen e morbiditetit dhe mortalitetit, shpesh duke ushtruar një ndikim prognostik po aq dëmtues sa vetë ngjarjet ishemike të përsëritura. Në këto kushte kërkohet një barazpeshim të kujdesshëm dhe shpesh sfidues për mjekët. Historikisht, fokusi mbizotërues në terapinë antiagregante pas PCI ishte kryesisht në parandalimin e ngjarjeve ishemike, me hemorragjinë shpesh të parë si një pasojë e pashmangshme, megjithëse e padëshirueshme. Megjithatë, të dhënat bashkëkohore theksojnë vazhdimisht se komplikacionet madhore të hemorragjisë kanë një lidhje të pavarur dhe thelbësore me rritjen e vdekshmërisë dhe morbiditetit, duke ndikuar shpesh në prognozë me një rrezik të krahasueshëm, ose edhe më të madh, se ajo e ngjarjeve të caktuara ishemike të përsëritura. Ky rivlerësim i rrezikut riformulon thelbësisht prioritetet terapeutike. Kjo qasje ka bërë të ndryshohet ndër vite koncepti "sa më shumë, aq më mirë" ndaj terapisë antiagregante, ku intensiteti dhe kohëzgjatja e trajtimit drejtoheshin kryesisht nga reduktimi i rrezikut ishemik. Regjimet antitrombotike të zgjatura ose tepër të fuqishme, ndërsa potencialisht ofrojnë përfitime ishemike margjinale, mund të shkaktojnë drejtpërdrejt ngjarje madhore hemorragjie. Këto ngjarje hemorragjie, nga ana tjetër, mund të shkaktojnë një kaskadë rezultatesh të pafavorshme, duke përfshirë nevojën kritike për të ndërprerë terapinë antitrombotike shpëtimtare, duke rritur kështu cenueshmërinë ndaj ngjarjeve ishemike të mëvonshme dhe duke kontribuar përfundimisht në vdekshmëri më të lartë. Prandaj nevojitet një qasje me të individualizuar ndaj DAPT, se sa një strategji uniforme për të gjithë.

Fjalë kyçe: ishemi, PCI, DAPT, terapi antiagregante, hemorragji.

DIAGNOZA DHE TRAJTIMI I ANEMISË AUTOIMUNE HEMOLITIKE NË PACIENTËT PEDIATRIKË.

Leonita Miftaraj

Abstrakt
Anemia hemolitike autoimune (AIHA) është sëmundje e shkaktuar nga sulmi i antitrupave të vet, autoantitrupave, ndaj antigjeneve të eritrociteve.
Qëllimi: Qëllimi i punimit është analizimi i pacientëve pediatrikë me AIHA, diagnostifikimi i tyre me theks të veçantë në Coombsin direkt dhe Coomssin indirekt, dhe mënyra e trajtimit të tyre. Gjithashtu, rrjedha e shërimit dhe përmirësimi i gjendjes shëndetësore pas trajtimit të pacientëve pediatrik ishte qëllimi dytësor.
Materjali dhe Metoda: Një studim retrospektiv i kryer në Qendrën Klinike Univesritare të Kosovës (QKUK), klinika e pediatrisë përfshiu të gjithë fëmijët 1 - 15 vjeç të diagnostikuar me AIHA të cilët kishin një test pozitiv antiglobulin (DAT+) në periudhën nga 1 Janari 2019 deri më 30 Nëntor 2023. Mostra për qëllimet e këtij punimi ka përfshi 19 subjekte të moshës 1 - 15 vjeç (6 femijë të gjinisë femërore dhe 13 femijë të gjinisë mashkullore) të prekur nga anemia autoimmune hemolitike në 5 vitet e fundit (2019 - 2023) në klinikën e pediatrisë të QKUK - së ku edhe është marr pëlqimi nga menaxhmenti i repartit. Subjektet e përfshira në punim kanë qenë të prekur nga këto lloje të anemive të gjakut: Anemia hemolitike, Anemia hemolitike hereditara, Anemia hemolitike spherocytosis dhe Anemia autoimune hemolitike.
Rezultate: Rezultatet e fituara në parametrat hematologjik të gjakut tregojnë se ka dallime të rëndësishme në mesataret aritmetikore në mes rezultateteve para dhe pas trajtimit me kortikosteroid dhe antibiotik si në vijim: Eritrocitet (RBC) Mean diff. = -. 959x10^3 / uL; t = - 2. 872; sig = 0. 011 (p< 0. 05), Hemoglobina (HGB) Mean diff. = - 3. 289x10^3 / uL; t = - 4. 745; sig = 0. 000 (p< 0. 05), Hematokritit (HCT) Mean diff. = - 8.

594x10ˆ3 / uL; t = - 3. 320; sig = 0. 004 (p< 0. 05), Leukocite (WBC) Mean diff. = 5. 450x10ˆ3 / uL; t = 2. 133; sig = 0. 047 (p< 0. 05) dhe Granulocite Mean diff. = - 5. 736 3 / uL; t = - 2. 269; sig = 0. 036 (p< 0. 05).
Përfundime: Pacientët me AIHA kishin Coombsin indirect pozitiv në 37% të rasteve dhe CD pozitiv në në 32% të rasteve. Trajtimi me kortikosteroide, antibiotikë dhe terapi transfuzive I pacientëve me AIHA është treguar i suksesshëm.

Fjalë kyçe: anemi hemolitike autoimune, kortikosteroide, Coombsi indirekt, antibiotik.

ROLI I ORTEZAVE KORRIGJUESE NË TRAJTIMIN E PARALIZËS OBSTETRIKE TË PLEXUS BRACHIALIS.

Dr. Shk. Lindita Vata
Reparti i Fizioterapisë Pediatrike, Q. S. U. Nënë Tereza – Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Paraliza Obstetrike e Pleksusit Brachial (POPB) është dëmtim nervor i tufës brachiale. Ndodh përgjithësisht tek lindjet e vështira dhe të zgjatura ose për shkak të traumave të gjymtyrëve të sipërme, qafës ose klavikulës. Në 1764 paraliza obstetrike e plexusit brachial (POPB) u përshkrua nga Smellie. Në 1872 Erb Duchenne paralizën obstetrike brachiale e klasifikon si dëmtim të pjesës së sipërme të paralizës (C5 – C7). Në 1885 Augusto Klumpke ishte i pari që përshkroi mënyrën klinike të dëmtimit të nervave të poshtëm të pleksusit brakial (C7 – T1).
Qëllimi: Prezantimi i eksperiencës time në repartin e fizioterapisë pediatrike në Q. S. U. T në trajtimin e pacientëve me paralizë obstetrike të plexusit brachial (POPB) dhe roli i ortezave korrigjuese në rezultatin e trajtimit.
Metodologjia: Studim i rasteve në seri (*Case series study*). Nga viti 2009 – 2025 kemi trajtuar 72 raste me paralizë obstetrike të plexus brachialis (POPB). Bilaterale nuk ka. 44 raste janë me paralizë Erb Duchenne, 21 raste me paralizë Klumpke dhe 7 raste me paralizë të plotë të plexus brachialis (C5 - T1). Rastet janë të ndara edhe sipas gjinisë dhe grupmoshave. 39 nga 72 raste (54%) kanë përdorur orteza korrigjuese, nga këto 18 pacientë me Erb Duchenne, 14 pacientë me Klumpke dhe 6 pacientë me paralizë totale brachiale.
Rezultate: Nga 72 raste me POPB, 39 kanë përdorur ortezë korrigjuese. Me shkallën e Erb Duchenne, 18 pacientë kanë përdorur orteza korrigjuese dhe kanë përfituar 100% funksion dhe 90% estetikë. Me shkallën Klumpke, 14 pacientë kanë përdorur ortezat; 6 nga pacientët kanë përdorur të dyja ortezat dhe kanë përfituar 100% funksion dhe 90% estetikë në kyç, 90% funksion dhe 80% estetikë në artikulacionin scapulotorakal, 80% funksion të dorës dhe krahut. 8 pacientë që kanë përdorur ortezën e kyçit dhe dorës kanë përfituar 100% funksion dhe 90% estetikë të kësaj pjese. Nga 7 pacientët me paralizë totale, 6 pacientë kanë përdorur të dyja ortezat. Kanë përfituar 70% funksion dhe 60% estetikë.
Konkluzione: Në të gjitha këto raste kanë ndikuar 4D: Shkalla e Dëmtimit, Koha e Duhur, Bashkëpunimi i Duhur dhe Mbajtja e Ortezës së Duhur.

Fjalë kyçe: POPB, Erb - Duchenne, Klumpke, trajtim fizioterapeutik, orteza korrigjuese, *case series study*, funksion, estetikë.

ROLI I PET - CT DHE PET - MRI NË DIAGNOSTIKIMIN E KANCERIT TË GJIRIT.

Liona Mala

Abstrakt
Hyrja: Kanceri i gjirit paraqet një ndër kanceret më të shpeshta dhe shkakun primar të mortalitetit të vajzave nga kanceri në nivel global. Rol themelor në mbijetësën dhe rritjen e kualitetit të jetës te këta pacientë luan diagnostikimi i hershëm, prandaj një rëndësi e veçantë i duhet kushtuar promovimit shëndetësor dhe qasjes adekuate me anë të metodave imazherike efektive për zbulim të hershëm të kancerit të gjirit.
Qëllimi: Qëllimi i këtij rishikimi është të qartësohen roli i PET / CT dhe PET / MRI për diagnostikimin e kancerit të gjirit, informata të cilat do të kenë ndikim në qasjen adekuate ndaj tyre.

Metodologjia: Ky punim është rishikim i literaturës botërore kryesisht të 5 viteve të fundit. Mënyra e përpunimit të të dhënave ka përfshirë kërkimin e punimeve shkencore në databaza kredibile, kategorizimin, filtrimin e të dhënave jo - relevante dhe krahasimin ndërmjet punimeve të ndryshme për përfitimin e rezultateve krahasuese sa i përket sensitivitetit dhe specificitetit të këtyre metodave diagnostike.
Rezultate: Për diagnostikim e tumoreve primare të gjirit rol të rëndësishëm luan mamografia, ultrazëri, rezonanca magnetike. Për detektimin e metastazave në nyjet regjionale aksillare si metodë standarde përdoret SNB, ndërsa PET / CT dhe PET / MRI kanë sensitivitet më të ulët, kurse për metastazat regjionale jashtë - aksillare PET / CT ka sensitivitet të lartë. Për detektimin e metastazave të largëta rol më të rëndësishëm ka PET / MRI sidomos në detektimin e metastazave në kocka dhe mëlçi, ndërsa për detektimin e metastazave në mushkëri përdoret CT. Rekurrencat e kancerit të gjirit diagnostikohen me PET / CT e cila ka sensitivitet relativisht të lartë.
Diskutime dhe përfundime: Sipas rezultateve nga ky studim, mund të konkludojmë se përdorimi i metodave imazherike PET, PET / CT dhe PET / MRI ka efektivitetin më të lartë në detektimin e metastazave sistemike dhe ka rol sinjifikant në detektimin e metastazave regjionale aksillare dhe jashtë - aksillare.

Fjalë kyçe: PET, PET / CT, PET / MRI, sensitivitet, specificitet.

ASTMA, ALERGJITË DHE SËMUNDJA E RRUGËVE TË FRYMËMARRJES E PËRKEQËSUAR NGA ASPIRINA (AERD).

Dr. Lirinda Vata

Abstrakt
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të paraqitet një pasqyrë e përgjithshme dhe e përditësuar mbi lidhjen mes astmës, alergjive dhe sëmundjes së rrugëve të frymëmarrjes së përkeqësuar nga aspirina (AERD), duke theksuar mekanizmat patofiziologjikë, rëndësinë klinike, dhe qasjet bashkëkohore në diagnostikim e trajtim. Fokus i veçantë i studimit është ndërthurja midis procesit inflamator alergjik dhe reagimit joimun ndaj inhibitorëve të COX - 1.
Metodologjia: Është realizuar një rishikim i literaturës përmes bazave të të dhënave shkencore PubMed, ScienceDirect dhe WHO Library, për periudhën 2015–2024. Janë analizuar publikimet që trajtojnë epidemiologjinë e astmës dhe AERD, mekanizmat imunologjikë (përfshirë rolin e leukotrieneve dhe eozinofileve), qasjet diagnostike (spirometri, testet alergologjike dhe provat provokuese me aspirinë) dhe opsionet terapeutike moderne, duke përfshirë përdorimin e biologjikëve (anti - IgE, anti - IL5, anti - IL4R).
Rezultate: Të dhënat tregojnë se AERD prek afërsisht 7–10% të pacientëve me astmë, dhe deri në 20% të atyre me astmë të rëndë. Sindroma karakterizohet nga triada klasike: astmë, polipe nazale dhe intolerancë ndaj aspirinës / NSAID - ve. Mekanizmi patofiziologjik dominohet nga prodhimi i shtuar i leukotrieneve dhe inflamacioni kronik eozinofilik i rrugëve të frymëmarrjes. Zbatimi i terapive të synuara (leukotriene modifiers dhe biologjikë) ka përmirësuar ndjeshëm kontrollin e simptomave dhe cilësinë e jetës te pacientët.
Përfundimi: AERD paraqet një nënfenotip klinik të veçantë të astmës dhe alergjisë respiratore, me sfida të mëdha diagnostike e terapeutike. Njohja e hershme e triadës karakteristike dhe individualizimi i trajtimit janë thelbësore për menaxhimin efektiv. Përfshirja e biologjikëve dhe qasjet multidisiplinare (pneumolog, alergolog, ORL) përbëjnë drejtimin modern në trajtimin e AERD, duke reduktuar ndjeshëm përkeqësimet dhe nevojën për ndërhyrje kirurgjikale.

Fjalë kyçe: Astma, alergjitë, AERD, leukotriene, polipe nazale, biologjikë.

HIPEREMESIS GRAVIDARUM BASHKËSHOQËRUAR ME KOLECISTIT AKUT JOKALKULOZ DHE KOLECISTEKTOMI NË TREMESTRIN E PARË.

Lorela Hysi[1], Genci Hyska[2]
[1]*Obstetër - Gjinekologe, Spitali Rajonal Vlorë*
[2]*Anestezist - Reanimator, Drejtues SUOGJ "Koço Gliozheni", Tiranë*

Abstrakt
Hyrje: Hiperemesis gravidarum është një diagnozë klinike që nuk ka kritere uniforme, që prek afërsisht 0. 3 deri në 3% të shtatzënive dhe është një shkak kryesor i shtrimit në spital gjatë shtatzënisë në fazat e hershme. Simptomat zakonisht shfaqen në javën e katërt deri në dhjetë të shtatzënisë. Diagnoza mund të vendoset tek shtatzënat me të vjella të vazhdueshme, humbje peshe më të madhe se pesë përqind të peshës trupore para shtatzënisë çrregullime të elektrolitëve dhe ketonuri që fillon në tremujorin e parë, si dhe përjashtimin e shkaqeve të tjera për këto simptoma.
Rasti: Pacientja 26 vjeçe G2P0A1 e cila kishte në anamnezë një nderpreje te vullnetshme të shtatzanisë për shakak të hyperemesis gravidarium, u paraqit për herë të parë 10 javë dhe u hospitalizua për simptoma të hyperemesis gravidarum. Pas trajtimit doli në gjendje të përmirësuar. Gjatë javës së 12 - të pacientja shtrohet në repartin e gastrohepatologjisë dhe më pas në atë kirurgjisë ku diagnostikohet me Kolecistit akut jokalkuloz dhe i nënshtrohet kolecistektomisë laparoskopike. Pas kolecistektomisë pacientja është hospitalizuar disa herë në pavionin e Patologjisë së Shatzanisë me të njëjtat ankesa dhe diagnozë, Hyperemesis Gravidarium. Në të gjitha rastet pacientja u paraqit me nauze, të vjella, ketonuri dhe disbalance elektrolitesh dhe u trajtua për këtë nozologji. Lindja përfundoi me Sectio Cesarea në moshën e barrës 38 jave +5 ditë. Në vlerësimin e foshnjës pas lindjes rezultoi: Apgari 1' - 9, 5' - 9 dhe Hgb - 9. 0 g / dl HCT 26. 4% dhe u rekomandua ndjekje nga mjeku hematolog pediatër. Nëna u paraqit 5 jave pas lindjes me simtoma të gjendjes febrile, pas trajtimit doli ne gjendje të mirë.
Konkluzion: Hyperemesis gravidarum është një gjendje e zakonshme në tremujorin e parë të shtatzënisë që zakonisht ka një rezultat të favorshëm. Megjithatë, është e rëndësishme të merret në konsideratë ekzistenca e rasteve me dekurs më të gjatë dhe pasojat e kësaj gjendjeje për nënën dhe fetusin. Nga ana tjetër, në rast të çrregullimeve të mëdha të testeve të funksionit të heparit dhe kolecistës, nuk duhet të neglizhohet vlerësimi për patologji të sferës gastro - hepatologjike e kirurgjikale dhe trajtimi i tyre.

Fjalë kyçe: Hyperemesis gravidarum, tremujori i parë, shtatzëni, kolecistit akut jokalkuloz.

KARCINOMA BAZOCELULARE MULTIPLE.

Loreta Kuneshka[1], Numila Maliqari[2],
[1]*Dermatologe në QSNUT*
[2]*Kardiopediatre në shërbimin e pediatrisë së përgjithshme.*

Abstrakt
Hyrje: Karcinoma e qelizave bazale është një papulë ose nyjë sipërfaqësore, me rritje të ngadaltë që rrjedh nga disa qeliza epidermale. Karcinomat e qelizave bazale lindin nga keratinocitet pranë shtresës bazale, të cilat nganjëherë quhen keratinocitet bazaloide. Metastazat janë të rralla, por rritja lokale mund të jetë shumë shkatërruese. Diagnoza bëhet me biopsi. Trajtimi varet nga karakteristikat e tumorit dhe mund të përfshijë heqje kirurgjikale, kriokirurgji, kimioterapi topikale ose, herë pas here, terapi me rrezatim ose medikamente.
Raportim rasti: Pacientja D. M e moshës 57 vjeç u paraqit pranë klinikës së dermatologjisë për disa plagë dhe erozione që i kishte të shpërndara pothuajse në të gjithë sipërfaqen e lëkurës së fytyrës. Kishte mbi 2 vjet me këto lezione po nuk ishte paraqitur tek mjeku për shkak të jetesës në një fshat të thellë të veriut. Kishte përdorur vetëm disa pomada popullore por pa rezultat (se nuk dinte as diagnozën). U pa me dermatoskop dhe u vunë re: Forma nodulare: nyje të vogla, me shkëlqim, të forta, pothuajse të tejdukshme deri në rozë me telangjiektaza. Sipërfaqësore: të kuqe ose rozë, papula ose pllaka të holla, të margjinuara, zakonisht në trung, që mund të jenë të ngjashme me psoriazën ose dermatitin e lokalizuar. Biopsia pas heqjes totale të njërit element rezultoi Ca bazocelular, por e hequr në kufij të shëndoshë. Në MRI total body dhe atë të kokës nuk rezultoi me metastaza. Heqja e të gjithë elementeve me rrugë kirurgjikale ishte e pamundur për shkak të sasisë së madhe. Disa iu hoqën me kirurgji plastike, të tjerat po mjekohen me imiquimod 5% cream. Në vendet që i ka të infektuara përdoret dhe ung. me antibiotik.

Konkluzione: Mos neglizhoni çdo shenjë të re, erozion, ulçeracion që ju shfaqet në lëkurë. Bëni kontrolle të vazhdueshme të çdo shenje që ju del në lëkurë se vetëm kështu mund të parandaloni një patologji që mund t'ju rrezikojë dhe jetën. Vizita tek dermatologu dhe dermatoskopia nuk janë procedura invazive dhe as të dhimbshme.

Fjalë kyçe: Ca bazocelular, kirurgji, imiquimod 5% cream.

OBEZITETI DHE KEQUSHQYERJA: RËNDËSIA E IDENTIFIKIMIT TË HERSËHM NË KUJDESIN PARËSOR.

Lorika Abazi

Abstrakt

Hyrje: Aktualisht ka mbi 1. 9 miliardë njerëz që janë obezë ose mbipeshë, duke çuar në një rritje të ndërlikimeve shëndetësore të lidhura me to. Obeziteti është njëra anë e barrës së dyfishtë të kequshqyerjes. Specialisti i mjekësisë familjare dhe doktori i mjekësisë janë shpesh linja e parë e trajtimit të obezitetit në mjediset e kujdesit parësor shëndetësor. Kjo ofron mundësi ndërhyrjeje të hershme për të parandaluar dhe / ose trajtuar mbipeshën dhe / ose obezitetin. Për të diagnostikuar obezitetin, një profesionist i kujdesit shëndetësor mund të kryejë një ekzaminim fizik dhe të rekomandojë disa të cilat përfshijnë: anamnezën, një ekzaminim të përgjithshëm fizik, llogaritjen e BMI - së (një BMI prej 30 ose më i lartë konsiderohet obezitet), matjen e madhësisë së belit; kontrollin për probleme të tjera shëndetësore si presioni i lartë i gjakut, kolesteroli i lartë, tiroide joaktive, problemet e mëlçisë dhe diabeti; testet klinike rutinë të cilat përfshijnë elektrolitet e serumit, azotin e uresë në gjak (BUN), kreatininën, nivelet e glukozës në gjak, profilin e lipideve, enzimat e mëlçisë dhe numërimin e plotë të gjakut; proteinat viscerale: si albumina, prealbumina, transferrina dhe proteina që lidh retinolin mund të ndihmojnë në vlerësimin e statusit ushqyes; nivelet e mikronutrientëve kur dyshohet për mangësi specifike të mikronutrientëve, mund të maten nivelet e vitaminave B, vitaminave A, C, D, E dhe K, hekurit, zinkut, selenit, homocisteinës, etj. Qëllimet e përgjithshme të trajtimit janë ulja e peshës trupore, ruajtja e një peshë më të ulët trupore në planin afatgjatë, parandalimi i shtimit të mëtejshëm në peshë dhe kontrolli i faktorëve të rrezikut të sëmundjeve shoqëruese.

Metodologjia: Ky punim është rishikim i literaturës. Për këtë punim është shfrytëzuar materiali i marrë nga burimet e ndryshme të njohura dhe të besueshëm, siç janë: PubMed, Medline, National Health Library, Google Scholar si dhe libra të ndryshëm.

Rezultate: Për shkak të vështirësisë në ruajtjen e humbjes së peshës me kalimin e kohës, parandalimi vazhdon të jetë opsioni më i zbatueshëm për kontrollin e mbipeshës. Mjekët kanë një rol të rëndësishëm në ndihmën e pacientëve për të parandaluar zhvillimin e obezitetit përmes identifikimit dhe diagnostikimit sa më të hershëm duke i njoftuar ata për rreziqet e shtimit të papërshtatshëm në peshë dhe duke mbështetur stilet e jetesës që promovojnë një peshë më të shëndetshme.

Diskutime: Identifikimi i hershëm nuk është vetëm një çështje klinike, por është edhe strategji kosto - efektive për sistemin shëndetësor, që shmang trajtimin e komplikimeve afatgjata të obezitetit dhe kequshqyerjes pasi qe këto të fundit janë probleme gjithnjë e në rritje me pasoja të mëdha për shëndetin publik.

Përfundime: Klinikat e kujdesit parësor dhe mjekët e kujdesit parësor luajnë një rol vendimtar në diagnostikimin dhe trajtimin e pacientëve me obezitet, duke ofruar një mundësi unike për të zbuluar pacientët në fazat e hershme të obezitetit. Mjekët e kujdesit parësor jo vetëm që duhet ta pranojnë obezitetin si një sëmundje kronike dhe pasojat e mundshme afatgjata që mund të shkaktojë, por edhe të ofrojnë ndërhyrje gjithëpërfshirëse dhe shumëkomponente që përfshijnë ndryshime në stilin e jetës, medikamente dhe referime të përshtatshme për kirurgji bariatrike kur është e nevojshme.

Fjalë kyçe: obezitet, kujdes parësor, teste laboratorike, stil jete, medikamente.

SIGURIA NË PUNË DHE STRESI QË PËRBALLOJNË PUNONJËSIT E SHËNDETËSISË.

Msc. Luiza Lushi[1], Msc. File Bracja[2], Dr. Shk. Svetllana Bitincka [3]
[1]*Fakulteti Shkencave Mjekësore, Universiteti Europian i Tiranës*
[2]*Fakulteti Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti Mjekësisë Tiranë*
[3]*Mjeke Infeksioniste, Lektore, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University.*

Abstrakt
Hyrje: Siguria në punë dhe menaxhimi i stresit përbëjnë një aspekt thelbësor në sektorin shëndetësor, ku punonjësit shpesh përballen me kushte pune të vështira dhe situata të paparashikueshme. Shkalla e lartë e përgjegjësisë, ekspozimi i vazhdueshëm ndaj rreziqeve biologjike dhe fizike, mungesa e burimeve njerëzore, si dhe presioni për ofrimin e kujdesit cilësor ndikojnë ndjeshëm në gjendjen e tyre psikologjike dhe fizike. Këta faktorë çojnë shpesh në shfaqjen e burnout - it, ndjenjës së pasigurisë dhe uljen e motivimit profesional.
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të identifikojë dhe analizojë faktorët kryesorë që kontribuojnë në përjetimin e stresit dhe pasigurisë në punë nga ana e punonjësve shëndetësorë, si dhe të propozojë masa të përshtatshme për përmirësimin e kushteve të punës dhe mbështetjen e mirëqenies së tyre.
Metodologjia: Studimi është zhvilluar mbi një kampion prej 85 profesionistësh të kujdesit shëndetësor, ku të dhënat janë mbledhur përmes një pyetësori të strukturuar që trajtonte faktorët e stresit, ndjenjën e sigurisë, përjetimin e dhunës në punë dhe kushtet ergonomike. Përveç të dhënave empirike, analiza është mbështetur edhe në literaturën bashkëkohore shkencore mbi sigurinë dhe mirëqenien në ambientet shëndetësore.
Rezultate: Të dhënat treguan se ngarkesa e lartë e punës, mungesa e stafit, oraret e gjata dhe intensiteti i përgjegjësive janë burimet kryesore të stresit. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve raportuan simptoma të burnout - it, lodhje të vazhdueshme dhe ulje të performancës në punë. Përveç stresit të lidhur me ngarkesën e punës, u evidentua edhe prania e dhunës verbale dhe fizike ndaj personelit, si dhe mungesa e kushteve ergonomike, të cilat ndikojnë negativisht në sigurinë dhe motivimin e tyre.
Përfundime: Studimi nxjerr në pah domosdoshmërinë e ndërhyrjeve institucionale për reduktimin e stresit dhe rritjen e sigurisë në punë. Këto masa duhet të përfshijnë: rritjen e numrit të stafit, planifikimin më të drejtë të orareve, krijimin e një mjedisi pune të sigurt dhe ergonomik, si dhe ofrimin e mbështetjes psikologjike e trajnimeve të vazhdueshme për menaxhimin e stresit. Përmirësimi i këtyre aspekteve është i lidhur ngushtë me rritjen e cilësisë së kujdesit shëndetësor dhe me mbrojtjen e mirëqenies së punonjësve.

Fjalë kyçe: stresi në punë, burnout, dhuna në vendin e punës, ergonomi, punonjës shëndetsorë, mirëqenie, siguri.

GJENET "KEEPER" DHE BAZAT MOLEKULARE TË KANCEROGJENEZËS: NJË RISHIKIM I LITERATURËS MBI ROLIN E TYRE NË RUAJTJEN E FENOTIPIT TUMORAL.

Lumbardh Qoti

Abstrakt
Hyrje: Kancerogjeneza përfshin një sërë ndryshimesh gjenetike, epigjenetike dhe qelizore që transformojnë qelizat normale në qeliza malinje. Ndërsa konceptet e driver dhe passenger genes janë mirë të njohura, studimet e fundit kanë propozuar një kategori të tretë "cancer - keeper genes (CKGs)" që nuk nxisin drejtpërdrejt transformimin qelizor, por janë thelbësore për ruajtjen e fenotipit tumoral. Ky rishikim synon të analizojë rolin e CKG - ve në mekanizmat themelorë të kancerogjenezës dhe potencialin e tyre si targete terapeutike.
Metoda: U krye një rishikim sistematik i literaturës në bazat PubMed, Scopus dhe Web of Science për periudhën 2015–2025, me termat "cancer - keeper genes", "non - oncogene addiction", "tumor maintenance" dhe "molecular carcinogenesis". Janë përfshirë studimet eksperimentale dhe ato bioinformatike që lidhnin CKG - t me rrugët klasike onkogjenike si p53, RAS, PI3K / AKT, Wnt dhe EMT.
Rezultate: U identifikuan disa gjene që veprojnë si "nyje ruajtëse" të rrjetit tumoral, përfshirë HSP90, YBX1, ELAVL1 dhe HNRNPK. Këto gjene mbështesin stabilitetin e onkoproteinave, mbrojnë qelizën nga stresi oksidativ, dhe rregullojnë proceset post - transkripcionale, duke siguruar mbijetesën e fenotipit malinj edhe në mungesë të stimulit fillestar onkogjenik.
Përfundime: Gjenet "keeper" përfaqësojnë një paradigmë të re në biologjinë e kancerit, duke lidhur bazat molekulare të kancerogjenezës me mekanizmat e qëndrueshmërisë tumorale. Targetimi i këtyre gjeneve mund të ofrojë një strategji terapeutike inovative që shënjestron "dobësitë stabilizuese" të qelizave kancerogjene, duke reduktuar rrezikun e rikthimit dhe rezistencës ndaj trajtimit.

Fjalë kyçe: cancer - keeper genes, kancerogjenezë, HSP90, YBX1, ruajtja e fenotipit tumoral, terapi molekulare.

FREKUENCA E PËRFSHIRJES SË THONJVE DHE ARTRITIT PSORIATIK NË PACIENTËT ME PSORIASIS VULGARIS.

Majla Mani [1], Prof. Ermira Vasili [1], Diana Muja [2].
[1]*Qendra Spitalore Univeristare Nënë Tereza, Tiranë, Shqipëri*
[2]*Poliklinika e Specialiteteve Nr. 2, Tiranë, Shqipëri.*

Abstrkt
Hyrje: Psoriaza është një dermatozë inflamatore kronike që shtrihet përtej përfshirjes së lëkurës dhe njihet si një sëmundje sistemike. Shpesh shoqërohet me manifestime ekstrakutane, duke përfshirë psoriazën e thonjve dhe artritin psoriatik. Këto karakteristika ekstrakutane shpesh nënvlerësohen në praktikën klinike. Prandaj, vlerësimi i shpeshtësisë së tyre në pacientët me psoriasis vulgaris është shumë i rëndësishëm për diagnostikimin e saktë, ndjekjen dhe menaxhimin e duhur të sëmundjes.
Objektivi: Ky studim synon të vlerësojë shpeshtësinë e prekjes së thonjve dhe praninë e artritit psoriatik në pacientët e diagnostikuar me psoriasis vulgaris, si dhe të hetojë lidhjen e mundshme midis këtyre dy manifestimeve klinike.
Metodologjia: Ky studim përfaqëson një studim prospektiv, rast - kontroll të kryer midis Janarit 2025 dhe Korrikut 2025. Studimi përfshin të dhëna të mbledhura sistematikisht nga pacientët që u ndoqën prospektivisht në një institucion të kujdesit terciar - konkretisht QSUT "Nënë Tereza" në Tiranë. Mbledhja e të dhënave u krye duke përdorur një qasje të kombinuar, duke përfshirë informacionin nga të dhënat klinike, historitë e strukturuara mjekësore dhe dokumentacionin fotografik të përfshirjes së thonjve. Të gjitha të dhënat u përpunuan në mënyrë anonime dhe u trajtuan me konfidencialitet të rreptë.
Rezultate: Ky studim përfshiu 40 pacientë të diagnostikuar me psoriasis vulgaris. Mosha mesatare e pjesëmarrësve ishte 48, 4 + / - 13, 3 vjeç. Prekja e thonjve u vu re në 97. 5% të pacientëve (39 nga 40), ndërsa artriti psoriatik ishte i pranishëm në 27. 5% (11 nga 40). Mes pacientëve me prekje të thonjve, numri mesatar i thonjve të prekur ishte 5, 49 + / - 2, 28, që tregon një shpërndarje të gjerë të dëmtimit të thonjve në shumicën e rasteve. Ndër manifestimet klinike të vëzhguara të thonjve, vrima ishte më e përhapura (46. 2%), e ndjekur nga hemorragjia e ndarë (38. 5%) dhe onikoliza (33. 3%). Për të analizuar statistikisht lidhjen midis prekjes së thonjve dhe pranisë së artritit psoriatik, u aplikua testi i Fisher. Ndërsa gjetjet klinike sugjeruan një korrelacion të fortë, testi nuk dha rezultate statistikisht domethënëse. Kjo mungesë rëndësie mund t'i atribuohet madhësisë së vogël të kampionit dhe, në veçanti, frekuencës shumë të lartë të përfshirjes së thonjve midis pjesëmarrësve në studim.
Përfundime: Ky studim tregon se prekja e thonjve është një manifestim i zakonshëm në pacientët me psoriasis vulgaris, ndërkohë që artriti psoriatik u shfaq gjithashtu si një komorbiditet i shpeshtë. U vu re një lidhje e fortë klinike midis këtyre dy manifestimeve, duke nxjerrë në pah rëndësinë e vlerësimit sistematik të të dyjave, thonjve dhe kyçeve te pacientët me psoriasis vulgaris.

Fjalë kyçe: Psoriaza, dermatozë, lëkurë, sëmundje sistemike, manifestime ekstrakutane.

MENAXHIMI I AKSIDENTEVE VASKULARE CEREBRALE NË KUJDESIN PARËSOR.
Majlinda Murati

Abstrakt:
Hyrje: Aksidentet vaskulare cerebrale (AVC) janë një nga shkaqet kryesore të vdekshmërisë dhe invaliditetit në të gjithë botën. Menaxhimi efikas i AVC - ve në kujdesin mjekësor parësor është thelbësor për minimizimin e pasojave afatgjata dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientëve.
Qëllimet e Menaxhimit: Identifikimi i Shpejtë: Njohja e shenjave dhe simptomave të AVC - ve për të siguruar trajtim të menjëhershëm. Trajtimi i Menjëhershëm: Përdorimi i terapive që reduktojnë dëmtimin cerebral dhe promovojnë rikuperimin**.**
Rehabilitimi: Planifikimi i një strategjie të rehabilitimit për të ndihmuar pacientët të rikthehen në aktivitetet e përditshme. Qasje të Koordinuara të Trajtimit: Trajtimi Farmakologjik: Përdorimi i antikoagulantëve dhe agjentëve të tjerë sipas nevojës. Terapitë Fizike e Okupacionale: Për ndihmuar në rikuperimin e funksioneve të dëmtuara. Edukimi dhe Mbështetje: Ofrimi i informacionit dhe mbështetjes për pacientët dhe familjet.
Metodologjia: Prezantimi i një rasti klinik, me të dhënat nga kartelat, që nxit pyetje dhe diskutime nga paneli për protokollin që duhet ndjekur për AVC.
Konkluzione: Në disa aspekte kërkohet përfshirja e profesionistëve të shëndetit parësor dhe atyre sekondar, për të krijuar një protokoll të unifikuar, përsa i përket ballafaqimit të dy shërbimeve. Një vlerësim i plotë mjekësor dhe multidisiplinar duhet të merret në konsideratë në gjithë pacientët me stroke akut, për të përcaktuar natyrën e ndodhjes, nevojën për investigime, menaxhimin e mëtejshëm dhe nevojën për rehabilitim. Menaxhimi i urgjencave të aksidenteve cerebrale në kujdesin parësor është një proces kompleks që kërkon njohuri të thella, aftësi diagnostikuese dhe një qasje të koordinuar.
Fjalë kyçe: Menaxhim, Faktorë rreziku, KSHP, Stroke, Protokolle, Rehabilitim.

VAPORIZATORËT NË ANESTEZI.
Prof. Asc. Majlinda Naço[1] [2], Prof. Asc. Haxhire Gani[2], Prof. Asc. Alma Cani[1], Prof. Krenar Lilaj[1] [2] Dr Ernest Caka[2].
[1]Departamenti i Kirurgjisë së Përgjithshme, Shërbimi i Anestezi e reanimacion, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri.
[2]Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt
Hyrje: Vaporizatori i nje agjenti anestezik është pajisje shpërndarëse e avullit që e transformon një agjent anestezik nga gjendja e lëngshme në avull dhe siguron një sasi të kontrolluar të avullit në rrjedhën e gazit të freskët. Avulli është faza e gaztë e një substance. Për të arritur këtë fazë, substanca duhet të arrijë një temperaturë nën temperaturën e saj kritike, e cila ndryshon për çdo inhalator. Funksionimi i avulluesve është i ndërlikuar dhe kërkon njohuri të termodinamikës, gazeve dhe fizikës. Përdorimi i vaporizatoreve është i domosdoshëm në çdo anestezi inhalatore.
Ekzistojnë disa mënyra për klasifikimin e vaporizatoreve: 1. mekanizmi për shtimin e avullit anestezik në rrjedhën e gazit të freskët: a. bypass variabël apo b. rrjedhje e matur; 2. rezistenca e brendshme e avulluesit: a. e lartë: avullues plenum apo b. e ulët: draw - over; 3. kompensimi i temperaturës: a. përçueshmëri e lartë termike dhe kapacitet i lartë nxehtësie i mbështjellësit apo b. rregullim automatik i raportit të ndarjes: 1. shirit bimetalik, 2. fryrje (bellows), 3. kontroll elektronik. Avulluesit mund të jenë të vendosur brenda ose jashtë qarkut. Të gjithë avulluesit bashkëkohorë përdoren jashtë qarkut pasi ofrojnë rezistencë të lartë ndaj rrjedhës së gazit. Sipas ASTM, avulluesit duhet të: 1. jenë në gjendje të pranojnë 15 L / min dhe të japin përqindje të parashikueshme avulli; 2. kenë manual përdorimi të qartë dhe 3. kenë të përcaktuar ndikimin e temperaturës dhe shpejtësisë së rrjedhjes. 4. kenë sistem izolimi midis avulluesve; 5. kenë kontroll për të kufizuar daljen e avullit nga dhoma; 6. knobët duhet të rrotullohen në drejtim kundër orës për të rritur përqindjen; 7. të kenë tregues niveli të lëngut të dukshëm nga përpara; 8. të mos mund të mbushen tepër. Modelet e avulluesve janë: seria TEC, e prezantuar nga kompania Cyprane në vitin 1956. Tech 1 – për halothane; Tech 2 – version i përmirësuar për halothane; Tech 3 – për isoflurane; Tech 4 – version i ridizenjuar i Tech 3; Tech 5 – për të gjithë agjentët specifikë; Tech 6 – avullues për desflurane, i ngrohur dhe me presion për ta avulluar; Tech 7 – jep halothane, isoflurane dhe sevoflurane. Avulluesit Aladin janë: 1. sisteme me kontroll elektronik të integruar në makinat e anestezisë dhe 2. kaseta portative që përmbajnë agjentin.

Fjalë kyçe: Anestetik inhalator, vaporizator Aladin, vaporizator Tech.

MENAXHIMI I AKSIDENTEVE VASKULARE CEREBRALE NË KUJDESIN PARËSOR.
Majlinda Murati

Abstrakt:
Hyrje: Aksidentet vaskulare cerebrale (AVC) janë një nga shkaqet kryesore të vdekshmërisë dhe invaliditetit në të gjithë botën. Menaxhimi efikas i AVC - ve në kujdesin mjekësor parësor është thelbësor për minimizimin e pasojave afatgjata dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientëve.
Qëllimet e Menaxhimit: Identifikimi i Shpejtë: Njohja e shenjave dhe simptomave të AVC - ve për të siguruar trajtim të menjëhershëm. Trajtimi i Menjëhershëm: Përdorimi i terapive që reduktojnë dëmtimin cerebral dhe promovojnë rikuperimin**. Rehabilitimi:** Planifikimi i një strategjie të rehabilitimit për të ndihmuar pacientët të rikthehen në aktivitetet e përditshme. Qasje të Koordinuara të Trajtimit: Trajtimi Farmakologjik: Përdorimi i antikoagulantëve dhe agjentëve të tjerë sipas nevojës. Terapitë Fizike e Okupacionale: Për ndihmuar në rikuperimin e funksioneve të dëmtuara. Edukimi dhe Mbështetje: Ofrimi i informacionit dhe mbështetjes për pacientët dhe familjet.
Metodologjia: Prezantimi i një rasti klinik, me të dhënat nga kartelat, që nxit pyetje dhe diskutime nga paneli për protokollin që duhet ndjekur për AVC.
Konkluzione: Në disa aspekte kërkohet përfshirja e profesionistëve të shëndetit parësor dhe atyre sekondar, për të krijuar një protokoll të unifikuar, përsa i përket ballafaqimit të dy shërbimeve. Një vlerësim i plotë mjekësor dhe multidisiplinar duhet të merret në konsideratë në gjithë pacientët me stroke akut, për të përcaktuar natyrën e ndodhjes, nevojën për investigime, menaxhimin e mëtejshëm dhe nevojën për rehabilitim. Menaxhimi i urgjencave të aksidenteve cerebrale në kujdesin parësor është një proces kompleks që kërkon njohuri të thella, aftësi diagnostikuese dhe një qasje të koordinuar.

Fjalë kyçe: Menaxhim, Faktorë rreziku, KSHP, Stroke, Protokolle, Rehabilitim.

VAPORIZATORËT NË ANESTEZI.
Prof. Asc. Majlinda Naço[1], [2], Prof. Asc. Haxhire Gani[2], Prof. Asc. Alma Cani[1], Prof. Krenar Lilaj[1], [2] Dr Ernest Caka[2].
[1]Departamenti i Kirurgjisë së Përgjithshme, Shërbimi i Anestezi e reanimacion, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri.
[2]Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt
Hyrje: Vaporizatori i nje agjenti anestezik është pajisje shpërndarëse e avullit që e transformon një agjent anestezik nga gjendja e lëngshme në avull dhe siguron një sasi të kontrolluar të avullit në rrjedhën e gazit të freskët. Avulli është faza e gaztë e një substance. Për të arritur këtë fazë, substanca duhet të arrijë një temperaturë nën temperaturën e saj kritike, e cila ndryshon për çdo inhalator. Funksionimi i avulluesve është i ndërlikuar dhe kërkon njohuri të termodinamikës, gazeve dhe fizikës. Përdorimi i vaporizatoreve është i domosdoshëm në çdo anestezi inhalatore.
Ekzistojnë disa mënyra për klasifikimin e vaporizatoreve: 1. mekanizmi për shtimin e avullit anestezik në rrjedhën e gazit të freskët: a. bypass variabël apo b. rrjedhje e matur; 2. rezistenca e brendshme e avulluesit: a. e lartë: avullues plenum apo b. e ulët: draw - over; 3. kompensimi i temperaturës: a. përçueshmëri e lartë termike dhe kapacitet i lartë nxehtësie i mbështjellësit apo b. rregullim automatik i raportit të ndarjes: 1. shirit bimetalik, 2. fryrje (bellows), 3. kontroll elektronik. Avulluesit mund të jenë të vendosur brenda ose jashtë qarkut. Të gjithë avulluesit bashkëkohorë përdoren jashtë qarkut pasi ofrojnë rezistencë të lartë ndaj rrjedhës së gazit. Sipas ASTM, avulluesit duhet të: 1. jenë në gjendje të pranojnë 15 L / min dhe të japin përqindje të parashikueshme avulli; 2. kenë manual përdorimi të qartë dhe 3. kenë të përcaktuar ndikimin e temperaturës dhe shpejtësisë së rrjedhjes. 4. kenë sistem izolimi midis avulluesve; 5. kenë kontroll për të kufizuar daljen e avullit nga dhoma; 6. knobët duhet të rrotullohen në drejtim kundër orës për të rritur përqindjen; 7. të kenë tregues niveli të lëngut të dukshëm nga përpara; 8. të mos mund të mbushen tepër. Modelet e avulluesve janë: seria TEC, e prezantuar

nga kompania Cyprane në vitin 1956. Tech 1 – për halothane; Tech 2 – version i përmirësuar për halothane; Tech 3 – për isoflurane; Tech 4 – version i ridizenjuar i Tech 3; Tech 5 – për të gjithë agjentët specifikë; Tech 6 – avullues për desflurane, i ngrohur dhe me presion për ta avulluar; Tech 7 – jep halothane, isoflurane dhe sevoflurane. Avulluesit Aladin janë: 1. sisteme me kontroll elektronik të integruar në makinat e anestezisë dhe 2. kaseta portative që përmbajnë agjentin.

Fjalë kyçe: Anestetik inhalator, vaporizator Aladin, vaporizator Tech.

VLERËSIMI I EFEKTIT ANTIMIKROBIAL TË VAJIT TË TRUMZËS NDAJ STAPHYLOCOCCUS AUREUS.

Dr. ÇUEDARI M. [1], JUKAJ F. [1], GJIKA E. [1]
[1]Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

Abstrakt
Hyrje: Staphylococcus Aureus (STA) po shndërrohet dita ditës në një shqetësim për shëndetin publik në botë, duke fituar rezistencë përherë e më shumë ndaj antibiotikëve. Rritja e antibiotiko - rezistencës ose dalja jashtë loje e tyre, ka bërë të rikthehen edhe njëherë sytë drejt metodave alternative, siç janë bimët medicinale.
Qëllimi i studimit: Evidentimi dhe analizimi e rasteve me STA dhe antibiotiko - rezistencës. Vlerësimi i efektivitetit të vajit të Trumzës kundër STA dhe ulja e përdorimit të antibiotikëve ndaj tij, duke përdorur trajtime alternative (vajin e trumzës).
Metodologjia: Është bërë evidentimi i rasteve pozitive me STA gjatë periudhës Janar – Maj 2018 në 15 individ të rastësishëm. Metodologjia e ndjekur është bazuar në metodën e difuzionit të disqeve Kirby - Bauer, e cila mundëson zhvillimin e diametrave të zonave të inhibimit, duke treguar veprimin sinergjik të dy produkteve me veti antibakteriale. U përdorën për çdo individ 4 mbjellje në terrene M. Hinton. Terrenet përmbanin të tretur vajin e Trumzës në hollimet me përqëndrim 0. 5 %, 1 %, 2% dhe pa hollime. U përdorën 10 antibiotikët më efektiv në antibiogramat e pacientëve.
Rezultate: Bazuar në rezultatet mund të themi se veprimi i vajit të trumzës me antibiotikët rezultoi me efektivitet maksimal (ndjeshmëri të plotë) në 86. 7% të mostrave me përqëndrim më të lartë të vajit. Veprimi antibakterial i vajit të Trumzës vetëm rezultoi efektiv duke vrarë plotësisht STA në 41. 7% te mostrave.
Konkluzione: Rezultatet tregojnë se është e mundur që nëpërmjet përdorimit të metodave alternative, duke përdorur bimë siç është vaji i Trumzës, bëjmë të mundur luftimin e këtij shtami patogen duke shmangur antibiotiko - rezistencen.

Fjalë kyçe: trumzë, vaj, antibiotiko - rezistenca, STA, bimë medicinale.

NEURALGJIA TRIGEMINALE – RISITË KIRURGJIKALE ME NEUROENDOSKOP DHE MINI - KRANIOTOMI NË BLLOKUN OPERATOR TË NEUROKIRURGJISË.

MSc. Manjola Pjetri, Prof. Asc. Valbona Bilali, Klea Kazari, Anita Lleshi, Dava Deda

Abstrakt
Hyrje: Neuralgjia trigeminale është një patologji e rrallë, por me impakt të lartë në cilësinë e jetës së pacientëve, e karakterizuar nga dhimbje të forta dhe të përsëritura në territorin e nervit trigeminal. Trajtimi kirurgjikal i saj ka njohur zhvillime të rëndësishme në vitet e fundit, duke u fokusuar në ndërhyrje minimale invazive me efikasitet të lartë.
Qëllimi: Të prezantohen risitë kirurgjikale të aplikuara në shërbimin e neurokirurgjisë, ku kombinimi i teknikës së neuroendoskopisë me mini - kraniotomi dhe përdorimi i teflonit për ndarjen e arterieve dhe venave nga nervi trigeminal siguron dekompresion të sigurt pa dëmtuar strukturat përreth.
Metodologjia: Analizë klinike e pacientëve të trajtuar për neuralgji trigeminale në bllokun operator të neurokirurgjisë, ku u aplikuan teknikat endoskopike dhe mikro - kirurgjikale. U vlerësuan parametrat klinikë, siguria e procedurës, komplikacionet dhe përmirësimi simptomatik postoperativ.
Rezultate: Përdorimi i neuroendoskopisë dhe mini - kraniotomisë ofron vizualizim superior, akses minimal invaziv dhe reduktim të riskut intraoperativ. Përdorimi i teflonit për ndarjen vaskulo - nervore rezulton në lehtësim të dhimbjes, ulje të recidivave dhe përmirësim të cilësisë së jetës së pacientëve.

Përfundime: Teknikat moderne minimalisht invazive si neuroendoskopia dhe mini - kraniotomia, të kombinuara me përdorimin e materialeve mbrojtëse si tefloni, përfaqësojnë një hap të rëndësishëm përpara në trajtimin kirurgjikal të neuralgjisë trigeminale, duke rritur sigurinë dhe efikasitetin terapeutik.

Fjalë kyçe: neuralgi, trigeminale, dhimbje, neurokirugji, arterie, kraniotomi.

VLERA DIAGNOSTIKE E AUTOANTITRUPAVE ME IMUNOFLUORESHENCË INDIREKTE NË DIAGNOZËN DIFERENCIALE TË DERMATOZAVE BULLOZE.

Margarita Kurti[1 2], Erion Kurti[2]
[1]Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
[2]Qendra Diagnostike Optimus

Abstrakt
Hyrje: Dermatozat bulloze janë sëmundje të rralla me flluska në lëkurë dhe në membrana mukoze. Ato karakterizohen nga prania e autoantitrupave të drejtuar ndaj strukturave të ndryshme, funksioni i të cilave është lidhja qelizë - qelizë në epidermë ose lidhja e epitelit skuamoz me dermën. Sëmundjet autoimune bulloze klasifikohen si sëmundje pemfigus, sëmundje pemfigoide, epidermolisis bullosa acquisita, dermatitis herpetiformis. Sëmundjet pemfigus karakterizohen nga flluska epidermale të shkaktuara nga një ndërprerje intraepiteliale e lidhjeve ndërqelizore në epidermën e lëkurës dhe në membranat mukoze. Në Imunofluoreshencën Indirekte, lokalizimi i komplekseve imune rezulton në një karakter fluoreshence ndërqelizore. Sëmundjet pemfigoide karakterizohen nga formimi i flluskave subepidermale. Autoantitrupat drejtohen ndaj komponentëve të hemidezmosomeve dhe filamenteve strukturore. Në Imunofluoresencën Indirekte, komplekset imune depozitohen në membranën bazale ne indin e ezofagut. Këto patologji shoqërohen me komplikacione të rënda, mortalitet të konsiderueshëm dhe ulje të cilësisë së jetës.
Qëllimi: Vlerësimi i pozitivitetit të autoantitrupave në dermatoza bulloze të ndryshme dhe vlerësimi i korelacionit të diagnozave klinike të dërguara me karakteret fluoreshente.
Materiale dhe metoda: Studimi është realizuar në një periudhë 14 - vjeçare, nga shkurti 2011 deri në gusht 2025. Të gjithë pacientët me lezione vezikulo - bulloze janë dërguar nga Shërbimi i Dermatologjisë. Për të gjithë pacientët u kërkua përcaktimi i autoantitrupave në serum. Përcaktimi dhe interpretimi u realizua me Imunofluoreshencë Indirekte.
Rezultate: Në studim u përfshinë 208 pacientë me interval moshe 21 - 89 vjeç, 58. 2% ishin femra. Çrregullimi më i zakonshëm rezultoi pemfigus vulgaris, 40. 4% të rasteve. Rreth 25% e pacientëve rezultuan me pemfigoid buloz. Pemfigoidi mukozal u gjet në 3. 8% të rasteve. Një rast rezultoi pozitivë për pemfigoid gestacional dhe katër raste rezultuan pozitivë për Epidermolisis bullosa acquisita. Nga 208 raste të dyshuara me çrregullime vezikulo - bulloze autoimune, vetëm 149 (71. 6%) raste korreluan klinikisht me karakteret fluoreshente.
Përfundime: Studimi ynë vërtetoi se Imunofluoreshenca Indirekte nuk shërben vetëm për diagnozë diferenciale, por është dhe konfirmuese për rastet e dyshuara klinike. Kështu që, identifikimi i autoantitrupave të ndryshëm mund të ndihmojë në diagnozën diferenciale të hershme të dermatozave bulloze duke ndikuar në uljen e komplikacioneve, uljen e mortalitetit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

Fjalë kyçe: dermatozat bulloze, imunofluoreshenca indirekte, autoantitrupa, epidermolisis bullosa acquisita, dermatitis herpetiformis.

SHOKU KARDIOGJENIK - ANALIZA E GJETJEVE ELEKTROKARDIOGRAFIKE TEK PACIENTËT ME SHOK KARDIOGJENIK PAS INFARKTIT AKUT TË MIOKARDIT: NDIKIMI NË MBIJETESË.

Dr. Margaritë Gjoka

Abstrakt
Hyrje: Shoku kardiogjen është komplikacioni më i rëndë i sindromës akute koronare (SAK) dhe mbetet shkaku kryesor i vdekjes pas infarktit akut të miokardit. Karakterizohet nga hipotension, hipoperfuzion i organeve vitale dhe mortalitet i lartë. Diagnoza vendoset me shenja klinike dhe parametra hemodinamikë. Trajtimi përfshin

oksigjenimin, inotropët, vazopresorët dhe reperfuzionin e hershëm koronar; në raste rezistente përdoret suporti mekanik i qarkullimit. Njohja dhe ndërhyrja e hërshme janë kyçe për përmirësimin e prognozës.
Qëllimi: Të përshkruhet rëndësia klinike e shokut kardiogjen dhe të analizohet lidhja midis parametrave elektrokardiografikë (EKG) dhe mbijetesës tek pacientët me SAK.
Metodologjia: Ky ishte një studim prospektiv, kross - seksional, i zhvilluar në Klinikën e Kardiologjisë gjatë periudhës mars–tetor 2024. Në studim u përfshinë 1, 166 pacientë të shtruar me SAK, prej të cilëve 86 (7. 4%) zhvilluan shok kardiogjen. Pacientët u ndanë në dy grupe sipas mbijetesës dhe u krahasuan parametrat EKG.
Rezultatet: Shkalla e përgjithshme e vdekshmërisë pas SAK ishte 3. 8%. Nga pacientët me shok kardiogjen, 83. 7% kishin STEMI dhe 16. 3% kishin NSTEMI (p<0. 0001). Pacientët me infarkt të murit inferior kishin më shumë gjasa të mbijetonin në fazën e hershme pas infarktit (p=0. 002). Parametrat e tjerë EKG nuk treguan dallime të rëndësishme statistikisht mes grupeve.
Përfundime: Rreth 7% e pacientëve me SAK zhvillojnë shok kardiogjen dhe afërsisht gjysma e tyre përfundojnë me vdekje. STEMI lidhet më shpesh me zhvillimin e kësaj gjendjeje sesa NSTEMI, ndërsa infarkti i murit inferior paraqet një probabilitet më të madh mbijetese. Trajtimi i hershëm dhe reperfuzioni emergjent janë vendimtarë për përmirësimin e prognozës.

Fjalë kyçe: shok, muri inferior, mbijetesë, SAK, EKG.

ALERGJIA USHQIMORE DHE LIDHJA E SAJ ME DERMATITI ATOPIK.

Maria Zoto, MD, MSc[1]; Anxhela Qirko, Assoc. Prof. [2]
[1]*Alergologe, Spitali Hygeia, Tiranë*
[2]*Alergologe, Klinika e Alergologjisë, Qendra Universitare "Nënë Tereza", Tiranë*

Abstrakt
Hyrje: Alergjia ushqimore e ndërmjetësuar nga IgE (AU) përbën një problem shëndetësor në rritje, veçanërisht në moshat pediatrike, ku shpesh gjendet e lidhur me dermatitin atopik (DA).
Objektiva: Të prezantojmë evidencat më të fundit mbi AU dhe lidhjen e saj me DA.
Materiale dhe Metoda: U analizuan udhëzues ndërkombëtarë, studime shkencore dhe artikuj të publikuar për të vlerësuar ndikimin e dietave eliminuese ushqimore në menaxhimin e DA.
Rezultate: DA është një sëmundje inflamatore kronike, e karakterizuar nga dëmtimi i barrierës mbrojtëse të lëkurës. Lidhja midis DA dhe AU është diskutuar për shumë vite. Fillimisht, disa ushqime janë konsideruar si faktorë agravues të ekzemës dhe shpesh janë rekomanduar dieta me eliminim të tyre. Megjithatë, në vitet e fundit, qëndrimi ndaj kësaj lidhjeje ka ndryshuar. Kjo sepse, tek fëmijët me DA, shpesh gjenden sensibilizime asimptomatike ndaj ushqimeve, dhe eliminimi i paarsyeshëm i tyre mund të shkaktojë më shumë dëm sesa përfitim. Nga ana tjetër, është vërejtur se fëmijët me DA me shfaqje të hershme dhe me formë të rëndë janë më të rrezikuar për të zhvilluar alergji ushqimore.
Përfundime: Testimi për alergenë ushqimorë tek fëmijët me DA nuk rekomandohet si pjesë e ekzaminimeve rutinë, pasi mund të çojë në dieta eliminuese të panevojshme. Ky testim duhet të kryhet vetëm në rastet me një histori klinike të dyshimtë për alergji ushqimore, ose në rastet e DA - së së rëndë që nuk i përgjigjet trajtimit standard.
Rekomandime: Ndër strategjitë më të fundit për parandalimin e shfaqjes së AU tek fëmijët me DA përfshihen: përdorimi i hershëm dhe i vazhdueshëm i emolientëve dhe trajtimeve lokale anti - inflamatore, si dhe prezantimi i hershme i ushqimeve potencialisht alergjike.

Fjalë kyçe: alergjia ushqimore, dermatiti atopik, dieta eleminuese.

NERVI OKULOMOTOR DHE ANATOMIA KLINIKE E TIJ.

Marigona Sejdiu Sadiku

Abstrakt
Hyrje: Nervi okulomotor është nervi i III kranial i cili së bashku me 11 nervat e tjerë të kokës dhe me nervat e qafës e ndërtojnë sistemin nervor periferik. Ndonëse është kryesisht nerv motorik ka edhe fije parasimpatetike,

apo fije visceromotorike të përgjithshme. Ai me fije motorike inervon m. levator palpebrae, m. rectus superior, m. rectus inferior, m. rectus medialis dhe m. obliquus inferior, kurse me fije parasimpatike m. sphincter pupillae dhe m. ciliaris.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të elaborohet dhe të paraqitet teorikisht nervi okulomotorius edhe anatomia klinike e tij, patologjitë e nervit okulomotor (paralizat okulomotore), shkaktarët më të shpeshtë të paralizave okulomotore, faktorët e rrezikut të paralizës okulomotore si dhe incidenca e paralizës okulomotore sipas moshës dhe gjinisë.
Metodologjia: Metodologjia e punës së përdorur karakterizohet në metodat e rishikimit të literaturës nga autorë të ndryshëm, ku janë përmbledhur dhe analizuar studime klinike të deritanishme, të cilat tregojnë për patologjitë e n. okulomotorius. Për këtë qëllim janë shfrytëzuar studime klinike të publikuara në revistat shkencore me qasje online si PubMed, MedLine, Science Direct dhe literaturë nga libra të ndryshëm mjekësorë. Kemi vlerësuar se ky punim do të jetë rifreskim i njohurive për studentët si dhe për profesionistët shëndetësorë.
Rezultate: Nga rezultatet vërehet se shkaktari më i shpeshtë i paralizës së n. okulomotor është shkaktari idiopatik. Prevalenca më e lartë është përshkruar 30. 2%, pastaj sëmundjet iskemike mikrovaskulare, traumat dhe aneurizmat. Paraliza e nervit okulomotor ka një incidencë më të lartë te meshkujt me 22 raste (63%) sesa femrat me 13 raste (37%). Grupmosha më e atakuar është 40 vjeçare me 20 raste ose 50%, ndërsa me një shkallë më të ulët grupmoshat 61–70 si dhe mbi 71 vjeçare me tre raste ose 7. 5%.
Përfundime: Pas shqyrtimit të rezultateve të fituara në këtë punim vërejmë se shkaktari më i shpeshtë i paralizave okulomotore është ai idiopatik, incidencë më të lartë te meshkujt, grupmosha më e atakuar nga paraliza e nervit okulomotor është 40 vjeçare, ndërsa sëmundjet si diabeti, hipertensioni, hiperkolesterolemia, sëmundja e arterieve koronare, infarkti i miokardit, dhe pirja e duhanit e rrisin rrezikun e paraqitjes së paralizës së nervit okulomotor.

Fjalë kyçe: Anatomia e nervit okulomotor, kompleksi bërthamor okulomotor, paraliza e CN III.

EVIDENTIMI DHE ANALIZIMI I AFTËSIVE DIGJITALE TE STUDENTËT E INFERMIERISË DHE IMPAKTI I ZHVILLIMIT TË INTELIGJENCËS ARTIFICIALE DHE TEKNOLOGJISË NË PËRMIRËSIMIN E NJOHURIVE TEORIKE DHE PRAKTIKE MJEKËSORE.

Msc. Marina Hida
Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë.

Abstrakt
Zhvillimi i teknologjisë së informacionit me hapa të shpejtë ka revolucionalizuar fushën mjekësore jo vetëm në zhvillimin e aparaturave dhe metodave të diagnostikimit dhe trajtimit, por duke kërkuar dhe aftësi të thella digjitale te studentët që i përkasin fushës mjekësore siç janë infermierët. Tashmë në drejtimin paralel të këtij progresi kërkohet që profesionistët mjekësorë të përfitojnë jo vetëm aftësi teorike dhe praktike mjekësore dhe në kujdesin shëndetësore, por edhe aftësi të mira digjitale. Ky studim ka si qëllim të indentifikojë dhe analizojë aftësitë digjitale në studentët e fushës së infermierisë, ndikimin e inteligjencës artificiale në shërbim të procesit të të studiuarit dhe aftësive të zgjidhjes së problemeve klinike dhe zhvillimi i aftësive në menaxhimin e informacionit shëndetësor.

Fjalë kyçe: njohuri, aparatura, digjitale, infermierë.

MATJA E LIPOPROTEINËS A SI ROL I PAVARUR RREZIKU PËR SËMUNDJET KARDIOVASKULARE.

Marina Parllaku, Dr. Rudina Pasho
Spitali Continental

Abstrakt
Hyrje: Lipoproteina A [Lp(a)] është një grimcë lipoproteinike e ngjashme me LDL - në, e përbërë nga një pjesë LDL dhe një proteinë të quajtur apolipoproteina(a). Ndryshe nga lipidet e tjera, niveli i Lp(a) përcaktohet pothuajse tërësisht nga gjenet dhe ndryshon shumë pak gjatë jetës, duke e bërë atë një biomarker të qëndrueshëm

për rrezikun kardiovaskular. Matja laboratorike: Matja e Lp(a) kryhet me metoda imunoturbidimetrike, të standardizuara ndaj referencave ndërkombëtare për të llogaritur përbërjen heterogjene të apolipoproteinës(a). Matja rekomandohet të bëhet të paktën një herë gjatë jetës tek të rriturit, veçanërisht nëse ekziston histori familjare e sëmundjeve kardiovaskulare të hershme ose nivele të larta të kolesterolit pa shkak të dukshëm. Konteksti gjenetik dhe lidhjet familjare: Nivelet e Lp(a) përcaktohen nga gjenet që kodojnë gjenin LPA dhe trashëgohen në mënyrë autosomale dominante. Individët që kanë një prind me Lp(a) të lartë kanë probabilitet të lartë ta trashëgojnë atë. Kjo e bën të nevojshme testimin edhe të anëtarëve të tjerë të familjes në rast të rezultateve të larta. Mekanizmi i ndikimit në aterosklerozë: Lipoproteina(a) kontribuon në formimin e pllakave aterosklerotike përmes disa mekanizmave biologjikë: depozitim i kolesterolit në murin arterial, ngjashëm me LDL - në; pengim i fibrinolizës, pasi apolipoproteina(a) është homologe me plazminogjenin dhe konkurron me të, duke favorizuar trombozën; inflamacion kronik i murit vaskular dhe stimulim i proliferimit të qelizave të muskujve të lëmuar; oksidimi i grimcave Lp(a) që rrit reaktivitetin e tyre ndaj endotelit. Rreziqet dhe ndikimi klinik: Nivelet e larta të Lp(a) (>50 mg / dL) janë të lidhura me rritje të ndjeshme të rrezikut për: sëmundje koronare të zemrës, infarkt miokardi dhe stenozë të aortës, ishemi cerebrale, aterosklerozë të përshpejtuar në pacientë me diabet ose dislipidemi të tjera. Në kombinim me LDL të lartë ose hipertension, prania e Lp(a) së lartë shumëfishon rrezikun total kardiovaskular.
Përfundime: Matja e lipoproteinës(a) është një mjet thelbësor për vlerësimin e rrezikut të fshehur aterosklerotik, sidomos në rastet me predispozitë familjare ose sëmundje të hershme kardiovaskulare. Duke qenë se trajtimet specifike për uljen e saj janë ende në zhvillim (si Antisense oligonucleotides ndaj LPA), identifikimi i hershëm dhe menaxhimi agresiv i faktorëve të tjerë të rrezikut mbetet strategjia më e rëndësishme klinike.

Fjalë kyçe: apolipoproteina, aterosklerotik, predispozitë gjenetike, inflamacion, SAK.

MAMIA MIDIS INSTIKTIT DHE EVIDENCËS: NJË EPOKË E RE NË PARANDALIMIN E LINDJEVE PARAKOHE.

MSc. Marinela Sema
Mami pranë SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë"

Abstrakt
Hyrje: Lindjet parakohe (para përfundimit të javës së 37 - të të shtatzënisë) mbeten një sfidë kryesore për shëndetin perinatal në mbarë botën. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (2023), rreth 15 milion lindje parakohe ndodhin çdo vit, duke kontribuar ndjeshëm në morbiditetin dhe mortalitetin neonatal. Në këtë kontekst, roli i mamisë është thelbësor jo vetëm në kujdesin klinik, por edhe në zbatimin e strategjive parandaluese të bazuara në evidencë.
Qëllimi: Të shqyrtojë rolin e mamive në parandalimin e lindjeve parakohe bazuar në evidencat më të fundit (2020–2025) dhe të analizojë mënyrën se si intuita klinike dhe praktika e bazuar në evidencë mund të integrohen në një model të unifikuar kujdesi.
Metodologjia: U krye një rishikim narrativ i literaturës ndërkombëtare aktuale, duke përfshirë udhëzimet e FIGO, ACOG dhe WHO, si dhe meta - analiza dhe studime të publikuara në PubMed, Cochrane dhe JAMA. Janë analizuar praktikat e mamive në vlerësimin e riskut, menaxhimin e qafës së mitrës, përdorimin e progesteronit dhe adoptimin e teknologjive digjitale në kujdesin prenatal.
Rezultate: Evidencat e reja tregojnë se modelet e kujdesit të udhëhequra nga mamitë reduktojnë incidencën e lindjeve parakohe deri në 30%. Integrimi i mjeteve digjitale dhe telemonitorimit përmirëson komunikimin, edukimin dhe mbështetjen e vazhdueshme për gratë shtatzëna me rrezik të lartë. Protokollet standardizuara klinike dhe zhvillimi profesional i vazhdueshëm i mamive kanë treguar përmirësime të matshme në rezultatet perinatale.
Konkluzione: Parandalimi efektiv i lindjeve parakohe kërkon një qasje të integruar ku intuita klinike e mamisë harmonizohet me evidencën shkencore bashkëkohore. Mamitë qëndrojnë në qendër të këtij transformimi – si ofruese kujdesi, edukatore dhe inovatore në teknologjinë digjitale për kujdesin perinatal. Fuqizimi i autonomisë profesionale të mamive dhe zbatimi i protokolleve të bazuara në evidencë përfaqëson hapa thelbësorë drejt një epoke të re të shkëlqyeshme të kujdesit perinatal.

Fjalë kyçe: Lindje parakohe, mamia, parandalim, kujdes i bazuar në evidencë, kujdes i vazhdueshëm, teknologji digjitale, FIGO, ACOG.

VLERA PARASHIKUESE E RAPORTIT BUN / KREATININËS DHE RAPORTIT NEUTROFIL / LIMFOCIT PËR MORTALITETIN TE PACIENTËT E RRITUR QË PARAQITEN NË URGJENCË ME RREZIK TË MODERUAR DERI TË LARTË PËR BAKTEREMI.

Marisa Marku[1], Prof. Dr. Lütfiye Mülazımoğlu Durmuşoğlu[1, 2], Prof. Dr. Nadiye Pınar Ay[1, 3], Dr. Kaan Çakan[1, 4]
[1]*Universiteti i Marmarës, Spitali i Trajnimit dhe Kërkimeve Pendik, Stamboll, Turqi, 2025*
[2]*Këshilltar*
[3]*Këshilltar Ndihmës*
[4]*Konsulent Statistikor*

Abstrakt

Qëllimi: Sepsis mbetet një nga shkaqet më të zakonshme të vdekjes në mbarë botën dhe incidenca e saj po rritet vazhdimisht. Vlerat klinike ose parametrat laboratorikë të përdorura më vete nuk janë gjithmonë të mjaftueshëm për të parashikuar saktë rezultatet; për këtë arsye, ky studim kishte për qëllim të vlerësonte faktorët e lidhur me mortalitetin 28 - ditor te pacientët me rrezik të moderuar deri të lartë për bakteremi që u pranuan në urgjencë, të përcaktonte vlerën parashikuese të raportit BUN / Kreatininë (BCR) dhe raportit Neutrofil / Limfocit (NLR) për mortalitetin, dhe të shqyrtonte nëse kombinimi i këtyre treguesve me vlerat klinike mund të ofronte një model më të besueshëm parashikues.

Materiale dhe Metoda: Ky studim, i dizajnuar si një kohort retrospektiv dhe i kryer në një qendër të vetme (Spitali i Trajnimit dhe Kërkimeve Pendik, Universiteti i Marmarës, Stamboll), përfshiu pacientë me rrezik të moderuar deri të lartë për bakteremi që u vlerësuan nga një specialist i sëmundjeve infektive dhe të cilëve u morën kultura gjaku brenda 48 orëve të pranimit. Të dhënat demografike, shenjat vitale në momentin e pranimit, rezultatet fillestare laboratorike, informacioni klinik dhe vlera e mortalitetit u regjistruan. Faktorët që ndikojnë në mortalitet u analizuan duke përdorur metoda univariat dhe multivariat. Analiza statistikore u krye me softuerin SPSS (versioni 26. 0) dhe u konsiderua i rëndësishëm niveli i $p < 0.005$.

Rezultate: Nga 500 pacientë të përfshirë, 27% (n=134) vdiqën brenda 28 ditëve. Analiza Kaplan–Meier tregoi se mortaliteti ishte më i lartë gjatë 10 ditëve të para. Analiza univariat zbuloi se komorbiditetet, nivelet e ulëta të albuminës, qSOFA ≥2, NEWS ≥5 dhe BCR ≥27. 3 ishin të lidhura në mënyrë të ndjeshme me rritjen e mortalitetit, ndërsa NLR, SIRS ≥2 dhe kulturat pozitive të gjakut nuk ishin parashikues të rëndësishëm. Analiza multivariat tregoi se BCR ≥27. 3 dhe qSOFA ≥2 ishin të pavarura të lidhura me një rrezik më të lartë vdekjeje. Prania e të dy vlerave të larta rriti rrezikun e mortalitetit 12. 33 herë ($p<0.001$). Kur u kombinua me NEWS, BCR ≥27. 3 dhe NEWS ≥5 rritën rrezikun 14. 74 herë. Analiza e kurbës ROC përcaktoi një prag BCR prej 24. 5 me sensivitet 64. 92% dhe specifikë 77. 33%. Përveç kësaj, analiza univariat tregoi se nuk kishte lidhje të ndjeshme midis BCR dhe bakteremisë, ndërsa u vërejt një lidhje midis NLR dhe bakteremisë.

Përfundimi: Ky studim shqyrtoi vlerën parashikuese të BCR dhe NLR si tregues për mortalitet te pacientët me rrezik të moderuar deri të lartë për bakteremi. Gjetjet sugjerojnë se BCR mund të jetë një tregues i rëndësishëm për parashikimin e mortalitetit 28 - ditor. Për më tepër, kur përdoret në kombinim me vlerat klinike si qSOFA dhe NEWS, këta tregues ofrojnë rezultate më të besueshme prognostike. Këto rezultate tregojnë se ndërhyrja e hershme në menaxhimin e sepsis mund të përmirësohet duke integruar këta tregues.

Fjalë kyçe: Bakteremi, BUN, Kreatininë, Mortalitet, Sepsis.

SIGURIA DHE EFIKASITETI I KARDIOPLEGJISË DEL NIDO NË KIRURGJINË KARDIAKE TË TË RRITURVE: NJË STUDIM PROSPEKTIV NË NJË QENDËR TË VETME DHE PËRVOJA FILLESTARE NË SHQIPËRI.

M. Bilaj (Miraka)[1], A. Gongo[3], R. Deveja[2], K. Menkshi[2], N. Rushiti[1], M. Belba[4]
[1]Departamenti i Anestezisë dhe Reanimacionit, Qendra Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi", Tiranë, Shqipëri
[2]Departamenti i Kirurgjisë Kardiake, Qendra Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi", Tiranë, Shqipëri
[3]Departamenti i Anestezisë dhe Reanimacionit, Spitali Universitar i Traumës, Tiranë, Shqipëri
[4]Departamenti i Lëndëve Biomjekësore dhe Eksperimentale, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Hyrje: Mbrojtja optimale e miokardit gjatë kirurgjisë kardiake është një komponent thelbësor i suksesit kirurgjikal. Kardioplegjia konsiderohet metoda standarde e artë për mbrojtjen e miokardit në kirurgjinë kardiake. DNC, e zhvilluar në vitet 1990 dhe fillimisht e dizajnuar për kirurgjinë kardiake pediatrike, ka fituar popullaritet gjithnjë e më të madh në ndërhyrjet kardiake tek të rriturit gjatë dy dekadave të fundit.
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi eshte të paraqesë sigurinë dhe efikasitetin e Kardioplegjisë Del Nido (DNC) në kirurgjinë kardiake të të rriturve si një alternativë ndaj kardioplegjisë tradicionale me gjak.
Hyrje: Mbrojtja optimale e miokardit gjatë kirurgjisë kardiake është një komponent thelbësor i suksesit kirurgjikal. Kardioplegjia konsiderohet metoda standarde e artë për mbrojtjen e miokardit në kirurgjinë kardiake. DNC, e zhvilluar në vitet 1990 dhe fillimisht e dizajnuar për kirurgjinë kardiake pediatrike, ka fituar popullaritet gjithnjë e më të madh në ndërhyrjet kardiake tek të rriturit gjatë dy dekadave të fundit.
Metoda: Ky studim prospektiv përfshiu të dhëna nga 25 pacientë që iu nënshtruan kirurgjisë kardiake në Qendrën Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi", Tiranë, në periudhën nga 20 nëntor 2024 deri më 21 mars 2025. Të gjithë pacientët ishin planifikuar për ndërhyrje elektive pas miratimit të konsentit anestetik dhe ndërhyrjeve kirurgjikale. Shpërndarja e pacientëve ishte si vijon: 11 meshkuj dhe 14 femra, të moshës 47–83 vjeç. Lloji i ndërhyrjeve kirurgjikale: CABG (6 pacientë), MVR minimalisht invazive (10 pacientë), AVR minimalisht invazive (3 pacientë), TVR minimalisht invazive (1 pacient), MVR + TVR minimalisht invazive (2 pacientë) dhe mbyllja minimalisht invazive e ASD (3 pacientë). Koha mesatare e bypass - it kardiopulmonar (CPB) ishte 144 minuta (intervali: 73–218), ndërsa koha mesatare e klemës aortale (ACC) ishte 87. 4 minuta (intervali: 38–143). DNC u administrua sipas protokollit për dozë të vetme ose të përsëritur, në varësi të kohëzgjatjes së ndërhyrjes.
Rezultate: Ritmi spontan u rivendos në fund të CPB - së tek shumica e pacientëve. Rreth 6% e pacientëve kërkuan defibrilim, dhe asnjë pacient nuk kishte nevojë për pejsim të përhershëm kardiak. Inotropët dhe vazopresorët u përdorën në 50% të pacientëve. Mortaliteti ishte 0%. Transfuzionet e gjakut dhe FFP u përdorën në 20% të pacientëve. Koha mesatare e ventilimit pas operacionit në Njësinë e Kujdesit Intensiv (ICU) ishte 6 orë (intervali: 3–8), qëndrimi në ICU ishte 48 orë, dhe qëndrimi total spitalor ishte afërsisht një javë.
Përfundime: Ky studim konfirmon sigurinë dhe efikasitetin mbrojtës të miokardit nga DNC në ndërhyrjet e ndryshme kardiake tek të rriturit. Me një reduktim të dukshëm të incidencës së fibrilacionit ventrikular, DNC demonstroi gjithashtu efektivitet afatgjatë përmes uljes së kohës së ACC, kohës së CPB dhe sasisë së kërkuar të solucionit kardioplegjik. Gjithashtu, pacientët përjetuan kohë më të shkurtër ventilimi dhe qëndrim më të shkurtër në ICU. Në përgjithësi, ky studim mbështet përdorimin e DNC si një strategji efektive dhe e sigurt për mbrojtjen e miokardit në kirurgjinë kardiake të të rriturve.

Fjalë kyçe: Kardioplegjia Del Nido, kirurgji kardiake, bypass kardiopulmonar, mbrojtje e miokardit, ICU.

QASJE METABOLIKE NË MENAXHIMIN E STEATOHEPATITIT JOALKOOLIK (NASH).

Marjeta Kermaj

Abstrakt
Hyrje: Steatohepatiti joalkoolik (NASH) është një formë progresive e sëmundjes së heparit të lidhur me disfunksionin metabolik dhe përbën një barrë gjithnjë në rritje për shëndetin global. Patogjeneza e tij lidhet ngushtësisht me rezistencën ndaj insulinës, obezitetin, dislipideminë dhe ndryshimet në mikrobiomën intestinale. Diagnoza e hershme dhe menaxhimi i duhur janë thelbësorë për të parandaluar progresionin e fibrozës dhe komplikimet afatgjata hepatike dhe kardiometabolike.

Metodologjia: Ky punim sintetizon provat e fundit nga udhëzimet klinike, rishikimet sistematike dhe studimet e mëdha kohorte që kanë vlerësuar strategjitë diagnostike dhe qasjet terapeutike në NASH. Literatura është përzgjedhur për të evidentuar përparimet në diagnozën joinvazive, ndërhyrjet e stilit të jetesës, terapitë farmakologjike dhe modelet e menaxhimit multidisiplinar.
Rezultate: Qasjet diagnostike po zhvendosen drejt metodave joinvazive, përfshirë elastografinë dhe panelet e biomarkerave, që mundësojnë stratifikim efektiv të rrezikut për fibrozë. Modifikimi i stilit të jetesës mbetet themeli i terapisë: humbja e peshës ≥7–10% përmirëson histologjinë, ndërsa optimizimi i dietës dhe aktiviteti fizik aerobik ose rezistenca përmirësojnë parametrat hepatikë dhe metabolikë edhe në mungesë të reduktimit të peshës. Abstinenca totale nga alkooli rekomandohet për pacientët me fibrozë të avancuar. Opsionet farmakologjike janë ndihmëse dhe të individualizuara: pioglitazoni dhe agonistët e receptorit GLP - 1 tregojnë përfitime histologjike tek pacientët me diabet ose obezitet, vitamina E mund të merret në konsideratë për pacientë të përzgjedhur pa diabet, ndërsa inhibitorët SGLT2 dhe agonistët e rinj dual / triple janë premtues në prova klinike. Kirurgjia bariatike është shumë efektive tek pacientët e përshtatshëm, duke ofruar regresion të NASH dhe mbijetesë më të mirë. Pacientët tipikisht janë të moshës së mesme deri të vjetër me obezitet, diabet, hipertension dhe dislipidemi, megjithatë fenotipe jo obeze po raportohen gjithnjë e më shpesh në popullatat aziatike.
Përfundime: NASH është në thelb një sëmundje metabolike që kërkon një qasje të personalizuar dhe multidisiplinare. Integrimi i ndryshimeve të stilit të jetesës, terapisë farmakologjike dhe ndërhyrjeve kirurgjikale, së bashku me stratifikimin periodik të rrezikut, ofron potencialin më të madh për përmirësimin e rezultateve hepatike dhe kardiometabolike afatgjata.

Fjalë kyçe: NASH, metabolike, joinvazive, aktivitet, aerobi, dietë.

RMN DHE CT NË PANKREATITIN AKUT: KUR DHE PSE?

Dr. Marjeta Tanka; Dr. Ermela Celaj; Prof. Dr. Ilirjana Bakalli; Prof. Dr. Ermira Kola; Dr. Fjorda Tuka.
Spitali Universitar "Nënë Tereza", Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Pankreatiti akut është një sëmundje e shpeshtë dhe potencialisht kërcënuese për jetën, e karakterizuar nga inflamacioni i pankreasit. Diagnoza e pankreatit akut bazohet në të dhënat klinike dhe laboratorike, por imazheria luan një rol vendimtar në konfirmimin e diagnozës, vlerësimin e gradës, zbulimin e komplikacioneve dhe planifikimin terapeutik.
Objektiva: Vleresimi i indikacioneve, kohës së kryerjes dhe vlerat diagnostikuese të Tomografisë së Kompjuterizuar dhe Rezonancës Magnetike në pankreatitin akut.
Metodologjia: Rishikim i literaturës aktuale dhe udhëzimeve klinike për të analizuar rolet e CT dhe MRI në faza të ndryshme të pankreatitit akut. Vëmendje të veçantë ne i kushtuam indikacioneve për egzaminimet imazherike, avantazheve dhe disavantazheve të secilit modalitet, dhe kontributi i tyre ne pankreatitin akut. CT përdoret gjerësisht për sensibilitetin e lartë në zbulimin e nekrozës, në vleresimin e koleksione likuidiene dhe komplikacioneve lokale, veçanërisht pas 72 orësh nga fillimi i simptomave. MRI, pavarësisht që është një egzaminim më pak i aksesueshëm, ofron rezolucion shumë të mirë të indeve të buta dhe është veçanërisht e përdorur tek pacientët me kundërindikacione për lëndet e kontrastit të CT dhe në vlerësimin e shkaqeve biliare. Të dyja modalitetet janë të rëndësishme për konfirmimin e pankreatitit akut dhe planifikimin terapeutik.
Përfundime: CT dhe MRI janë teknika imazherike të rëndësishme në pankreatitin akut. CT mbetet egzaminimi i linjës së parë në shumicën e rasteve për shkak të shpejtësisë dhe aksesueshmërisë së saj, ndërsa MRI ofron informacion të rëndësishme në raste komplekse ose të paqarta. Koha dhe përzgjedhja e duhur e egzaminimit imazherik janë të rëndësishme për të optimizuar rezultatet e pacientit dhe për të shmangur ekspozimin e panevojshëm ndaj rrezatimit.

Fjalë kyçe: pankreatit, CT, MRI, komplikacione, lëndë kontrasti.

TRAJTIMI KIRURGJIKAL I FUZIONIMIT TË PARAKOHSHËM TË SUTURAVE TË KALVARIAS.

Dr. Keisi Gjyli[1], Prof. Dr. Artur Xhumari[2], Dr Marjon Sako[3], Dr. Spiro Silla[4], Dr. Estela Muho[4], Prof. Elmira Kola[5], Dr. Durim Sala[5]
[1]Specializant Neurokirurgji, QSU "Nënë Tereza", Tiranë
[2]Neurokirurg, QSU "Nënë Tereza", Tiranë
[3]Kirurg Maksilo - Facial, SUT, Tiranë
[4]Anestezist - Reanimator, QSU "Nënë Tereza" Tiranë
[5]Pediatër Reanimator, QSU "Nënë Tereza" Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Kraniosinostoza është fuzionimi i parakohshëm i suturave të kalvarias. Në varësi të suturës apo suturave që fuzionohen, shfaqen deformime të ndryshme të kalvarias e masivit facial: Skafocefalia - sinostozë e suturës sagitale; Trigonocefalia - sinostozë e suturës metopike; Plagiocefalia - sinostozë unilaterale e suturës koronale; Brachicefalia - sinostozë bilaterale e suturës coronale; Oxicefalia - sinostozë premature e suturës coronale dhe sagitale.
Metoda: Një seri rastesh prospektive, jo krahasuese, e pacientëve që iu nënshtruan interventit kirurgjikal për kraniosinostozë në Departamentin e Neurokirurgjisë, UHC "Nënë Tereza", në periudhën shtator 2020 - 2025. Simptomat dhe shenjat e pacientëve u vlerësuan në periudhën e hershme preoperative si dhe në atë postoperative.
Rezultatet: Studimi përfshin gjashtëmbëdhjetë pacientë. Shfaqja klinike përfshin asimetri faciale, exoorbitizëm, hipertelorizëm, micrognati. Trajtim kirurgjikal konsistoi në rimodelimin kalvarial me apo jo avancim të bandosë fronto - orbitale.
Përfundime: Ekipi i specializuar multidisiplinar është i nevojshëm për të menaxhuar të gjitha aspektet e lidhura me trajtimin tek fëmijët me kraniosinostozë. Shumë lloje të kraniosinostozave kërkojnë trajtim kirurgjikal. Procedura kirurgjikale ka si qëllim të normalizojë presionin intracranial si dhe të permirësojë estetikisht formën e kalvarias e fytyrës. Interventi kryhet në moshën 6 - 8 muajshe. Fëmijët me kraniosinostozë shumë të lehtë mund të mos kenë nevojë për kirurgji. Helmetet mjekësore mund të përdoren për të ndihmuar në modelimin e kalvariumit.

Fjalë kyçe: Kraniosinostozë, sutur, CT, trajtim kirurgjikal.

SA EFEKTIVE ËSHTË TERAPIA ME RREZE X NË LEZIONET KUTANE MALINJE? EKSPERIENCA NJËVJECARE ME APARATIN E RI TË ORTOVOLTAZHIT.

Phd candidate Marsela Prendi, Prof. Asc Dr. Sander Kola, Phd Dr. Orges Spahiu, Phd candidate Dr. Daniela Bega.
Punonjës në Shërbimin Imazheri dhe Radioterapi në QSUNT.

Abstrakt
Hyrje: Terapia me rreze X është një ndër trajtimet e zgjedhura jo invazive për trajtimin e lezioneve kutane kancerogjene. Në shërbimin Onkologjik në QSUNT prej më shume se një vit kjo radioterapi ofrohet përmes aparatit të ri të kompjuterizuar të Ortovoltazhit.
Metodologjia: Në periudhën Gusht 2024 - Gusht 2025 janë trajtuar në total 336 pacient me diagnoza që përfshijnë BCC, SCC, Morbus Kaposi, kryesisht në stadin e II - III. Trajtimet janë bërë kryesisht me terapi të hiperfraksionuar. Përmes një plani trajtimi të zgjedhur nga mjekët radioterapeut dhe një mbrojtjeje të mirë në cdo seancë trajtimi janë marrë rezultate shumë të mira gjatë trajtimit dhe pas përfundimit të radioterapisë.
Rezultate: Rezultatet më të mira dhe më të shpejta janë marrë te pacientët që kanë filluar trajtimin në stad të hershëm të sëmundjes dhe me gjendje të përgjithshme të mirë shëndetësore. Efektet janë të kënaqshme që në tre mujorin e parë nga fillimi i trajtimit. Shkalla e mortalitetit dhe e recidivave gjatë kësaj periudhe ka qenë mjaft e ulet.
Konkluzione: Terapia me ortovoltazh është shumë e suksesshme sidomos në lezionet kutane në stad të hershëm falë personalizimit të mirë të planit të trajtimit nga stafi mjekësor dhe përdorimit të një aparati të kompjuterizuar dhe të mirëkalibruar.

Fjale kyce: rreze X, terapi e hiperfraksionuar, stad I hershem, plan trajtimi, mbrojtje, terapi e suksesshme.

VARIACIONET SEZONALE NË INCIDENCËN E HEMORAGJISË NGA VARICET EZOFAGEALE NË SHQIPËRI: NJË ANALIZË RETROSPEKTIVE.

Marsela Sina, Klevis Vrapi, Sara Hoxha, Skerdi Prifti
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Shërbimi i Gastrohepatologjisë, Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt

Hyrje: Hemorragjia nga variçet ezofageale (EVB) është një ndërlikim kërcënues për jetën i hipertensionit portal. Studimet e mëparshme sugjerojnë se, përveç faktorëve kryesorë të rrezikut si madhësia e variçeve, shenjat e ngjyrës së kuqe dhe ashpërsia e sëmundjes hepatike, variacionet sezonale mund të kontribuojnë gjithashtu në incidencën e hemorragjisë nga variçet ezofageale.

Qëllimi: Qëllimi ynë ishte të identifikonim variacionet sezonale në incidencën e EVB dhe ndikimin e tyre në kohëzgjatjen e qëndrimit spitalor.

Materiale dhe metoda: U krye një studim retrospektiv duke përdorur bazën e të dhënave të spitalit tonë, nga janari 2023 deri në dhjetor 2023. Kodet ICD - 9 u përdorën për të identifikuar pacientët e shtruar me diagnozën e hemorragjisë nga variçet ezofageale. Të dhënat u analizuan duke përdorur programin SPSS. Testet Chi - katror dhe Anova u përdorën për të llogaritur vlerat p.

Rezultate: Në studim u përfshinë gjithsej gjashtëdhjetë e pesë pacientë të shtruar me hemorragji nga variçet ezofageale; 60 pacientë (92. 3%) ishin meshkuj dhe 5 (7. 7%) femra; mosha mesatare 55. 5 vjeç. Incidenca e EVB sipas muajit është paraqitur në Figurën 1. Pika maksimale e incidencës u vu re në shkurt, dhe më e ulëta në qershor (16. 9% kundrejt 1. 5%, p=0. 009). Incidenca më e lartë e gjakderdhjes u vërejt gjatë dimrit dhe pranverës, duke u ulur në vjeshtë dhe verë (37%, 33. 8%, 20% dhe 9. 2% përkatësisht, p=0. 005). Megjithëse mesatarja e kohëzgjatjes së qëndrimit spitalor ishte më e lartë në vjeshtë sesa në verë (14. 25 ditë kundrejt 10. 00 ditë, p=0. 855), nuk u gjet asnjë ndryshim domethënës në kohëzgjatjen e qëndrimit spitalor ndërmjet muajve (p=0. 408).

Përfundime: Ekziston një variacion i qartë sezonal në incidencën e EVB në Shqipëri, i cili nuk ndikoi në kohëzgjatjen e qëndrimit spitalor. Ky model është i ngjashëm me studimet e mëparshme nga rajone të tjera, me kulme gjatë muajve të ftohtë dhe ulje gjatë muajve të ngrohtë, duke sugjeruar se faktorët mjedisorë mund të luajnë një rol në nxitjen e episodeve të EVB. Megjithatë, baza themelore e këtij variacioni mbetet ende e paqartë dhe kërkon kërkime të mëtejshme.

Fjalë kyçe: Hemorragji variçeale; incidencë; variacione sezonale.

RAPORTI BUN / KREATININË NË DIFERENCIIMIN E HEMORAGJISË SË SIPËRME DHE TË POSHTME TË TRAKTIT GASTROINTESTINAL: STUDIM RETROSPEKTIV I NJË QENDRE TË VETME.

Marsela Sina[1], Klevis Vrapi[1], Skerdi Prifti[1]
[1]Klinika Universitare e Gastroenterologjisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Hyrje: Vlerat e larta të BUN në gjak janë të zakonshme te pacientët me hemorragji të traktit të sipërm gastrointestinal (UGIB), për shkak të katabolizmit dhe përthithjes së proteinave të gjakut në zorrën e hollë, si dhe ekskretimit të reduktuar të ure - së për shkak të hipovolemisë dhe perfuzionit të ulur renal. Për rrjedhojë, raporti BUN / kreatininë (BUN / Cr) mund të shërbejë si një mjet i thjeshtë dhe me kosto të ulët për të diferencuar hemorragjinë e traktit të sipërm nga ajo e traktit të poshtëm gastrointestinal (LGIB), sidomos në rastet me burim të pasigurt të gjakderdhjes.

Qëllimi: Të vlerësohet roli i raportit BUN / Cr në diferencimin e hemorragjisë së sipërme nga ajo e poshtme e traktit gastrointestinal.

Materiale dhe Metoda: U realizua një studim retrospektiv te pacientët e shtruar për hemorragji gastrointestinale në QSUT "Nënë Tereza", gjatë periudhës Qershor 2024 – Gusht 2025. Raporti BUN / Cr u përllogarit për çdo pacient në momentin e pranimit. Të dhënat u analizuan me testin t të Studentit, me nivel domethënieje statistikore $p < 0.05$.

Rezultate: Në total, u përfshinë 84 pacientë: 49 meshkuj (58. 3%) dhe 35 femra (41. 7%), me moshë mesatare 65. 7 vjeç. 70 pacientë u paraqitën me hemorragji të traktit të sipërm gastrointestinal (etiologjitë më të shpeshta: ulçera peptike, kanceri gastrik, gastriti eroziv dhe ezofagiti). 14 pacientë me hemorragji të traktit të poshtëm

(etiologji: hemorroide, divertikulozë, kancer kolorektal). Raporti mesatar BUN / Cr ishte dukshëm më i lartë te pacientët me UGIB (mesatare = 69. 34) krahasuar me ata me LGIB (mesatare = 39. 56) (t = 4. 83; p < 0. 001). U gjet gjithashtu korelacion pozitiv mes raportit BUN / Cr dhe moshës te pacientët me UGIB (r = 0. 32; p = 0. 007).
Përfundime: Raporti BUN / kreatininë përfaqëson një marker të besueshëm për diferencimin e hemorragjisë së traktit të sipërm nga ajo e traktit të poshtëm gastrointestinal, duke ndihmuar në vendimmarrjen e hershme klinike. Janë të nevojshme kërkime të mëtejshme për të përcaktuar pragun optimal të raportit BUN / Cr për diferencim më të saktë, si dhe për të vlerësuar ndikimin e tij në parashikimin e rezultateve klinike.

Fjalë kyçe: Hemorragji gastrointestinale; raporti BUN / Kreatininë; UGIB; LGIB

CILËSIA E JETËS NË PACIENTËT ME SËMUNDJE INFLAMATORE TË ZORRËS TË TRAJTUAR ME TERAPI BIOLOGJIKE.

Marsela Sina[1], Rubin Mullaj[1], Sara Hoxha[1], Xhulia Bega[1], Skerdi Prifti[1]
[1]Shërbimi i gastrohepatologjisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"

Abstrakt
Hyrje: Sëmundja inflamatore e zorrës (SIZ), që përfshin kolitin ulceroz (KU) dhe Morbus Crohn (MC), është një sëmundje kronike që ndikon ndjeshëm në cilësinë e jetës së pacientëve.
Qëllimi: Vlerësimi i cilësisë së jetës tek pacientët me SIZ që marrin terapi biologjike në Shërbimin e Gastroenterologjisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza".
Metodologjia: Cilësia e jetës u vlerësua përmes pyetësorit "Short Inflammatory Bowel Disease Questionnaire" (SIBDQ), ku rezultatet nën 60 tregonin dëmtim klinikisht të rëndësishëm të cilësisë së jetës. Të dhënat demografike, klinike dhe laboratorike u morën nga kartelat e pacientëve. Aktiviteti i sëmundjes u vlerësua me "Mayo Score" (MS) dhe "Simple Clinical Colitis Activity Index" (SCCAI) për KU, dhe me "Crohn's Disease Activity Index" (CDAI) për MC. Niveli i sinjifikancës statistikore u përcaktua, p < 0. 05.
Rezultate: Në studim u përfshinë 34 pacientë, 23 meshkuj (68%) dhe 11 femra (32%), me moshë mesatare 38 ± 17. 2 vjeç. 28 pacientë (82%) kishin KU dhe 6 (18%) MC. Në momentin e vlerësimit, 24 pacientë (71%) ishin në remision. Rezultati mesatar i SIBDQ ishte 51. 8 ± 9. 8, me 27 pacientë (79%) që paraqisnin dëmtim klinikisht të rëndësishëm të cilësisë së jetës. Mosha më e re në momentin e diagnostikimit ishte e lidhur me rezultate më të ulëta të SIBDQ (p = 0. 006). Tek pacientët me KU, ata me dëmtim të rëndësishëm të cilësisë së jetës kishin vlera më të larta të MS (p = 0. 005) dhe SCCAI (p = 0. 001). Pacientët me pankolit apo kolit të majtë raportuan dëmtim klinikisht të rëndësishëm, ndërsa ata me proktit raportuan dëmtim të vogël ose të papërfillshëm (p = 0. 02). Tek pacientët me MC, ata me cilësi jete të dëmtuar kishin tendencë drejt vlerave më të larta të CDAI, por diferenca nuk ishte statistikisht sinjifikante (p = 0. 2).
Përfundimi: Cilësia e jetës është e dëmtuar tek pacientët me SIZ, veçanërisht tek ata më të rinj dhe me aktivitet më të lartë të sëmundjes. Është e nevojshme një qasje multidisiplinare për të adresuar si menaxhimin klinik, ashtu edhe mirëqenien e pacientëve.

Fjalë kyçe: sëmundja inflamatore e zorrës, koliti ulceroz, morbus chron, cilësia e jetës, sibdq, terapia biologjike.

ANKTHI TEK PACIENTËT ME SËMUNDJE INFLAMATORE TË ZORRËS NË SHQIPËRI: PREVALENCA, KORRELIMET KLINIKE DHE NDIKIMI NË CILËSINË E JETËS.

Marsela Sina[1], Sara Hoxha[1], Rubin Mullaj[1], Xhulia Bega[1], Skerdi Prifti[1]
[1]Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Shërbimi i Gastrohepatologjisë, Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt
Hyrje: Sëmundja inflamatore e zorrës (SIZ) është sëmundje kronike që shpesh shoqërohet me çrregullime psikologjike, veçanërisht ankth, i cili mund të ndikojë negativisht në cilësinë e jetës dhe në ecurinë klinike të pacientëve. Ky studim ka si qëllim të vlerësojë prevalencën e ankthit tek pacientët me SIZ dhe të eksplorojë lidhjen e tij me faktorë klinikë, demografikë, si dhe me cilësinë e jetës në këtë grup pacientësh.

Metodologjia: Ky studim i tipit përshkrues përfshiu 43 pacientë me SIZ (79. 1% me Kolit Ulceroz [KU] dhe 20. 9% me Morbus Crohn [MC]), të ndjekur në shërbimin e Gastrohepatologjisë në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri. U vlerësuan të dhënat demografike, klinike, të trajtimit si dhe biomarkerët laboratorikë (hemoglobina, albumina, proteina C - reaktive [PCR], kalprotektina fekale). Aktiviteti i sëmundjes u vlerësua me indeksin SCCAI dhe me Mayo Score për KU, dhe me indeksin CDAI për MC. Ankthi u vlerësua me anë të pyetësorit GAD - 7 (Generalized Anxiety Disorder 7), dhe pikët ≥10 u konsideruan tregues për ankth klinikisht të rëndësishëm. Cilësia e jetës u vlerësua me pyetësorin SIBDQ (Short Inflammatory Bowel Disease Questionnaire), i cili kategorizohet në tre nivele: dëmtim i lehtë (60–70 pikë), i moderuar (45–60 pikë) dhe i rëndë (10–45 pikë) i cilësisë së jetës. Analiza statistikore u krye me SPSS versioni 29. 0. 2. 0.
Rezultate: Mosha mesatare e pacientëve ishte 36. 3 ± 14. 9 vjeç, mosha mesatare në momentin e diagnozës 30. 6 ± 11. 2 vjeç dhe kohëzgjatja mesatare e sëmundjes ishte 5. 7 ± 7. 0 vjet. Shumica e pacientëve ishin meshkuj (65. 1%). Në periudhën e marrë në studim, 30 pacientë (69. 8%) ishin në remision dhe 13 (30. 2%) kishin sëmundje aktive, ndërsa 34 pacientë (79. 1%) ishin nën trajtim me bar biologjik. Ankthi ishte i pranishëm në 12 pacientë (27. 9%, 95% CI: 14. 5–41. 3%). Ai ishte më i shpeshtë tek femrat krahasuar me meshkujt (46. 7% kundrejt 17. 9%, p = 0. 045) dhe tek pacientët që ishin diagnostikuar në një moshë më të madhe (55. 6% kundrejt 20. 6%, p = 0. 038). Nuk u gjetën lidhje të rëndësishme statistikore me llojin e sëmundjes, shtrirjen, aktivitetin, terapinë apo biomarkerët laboratorikë. Pacientët me ankth kishin tendencë për kohëzgjatje më të gjatë të sëmundjes si dhe nivele më të ulëta të hemoglobinës dhe albuminës.
Cilësia e jetës ishte më e ulët tek pacientët me ankth krahasuar me ata pa ankth (45. 3 ± 14. 1 kundrejt 52. 8 ± 8. 8, p = 0. 057). Ankthi ishte më i shpeshtë tek pacientët me dëmtim të rëndë të cilësisë së jetës (50. 0% kundrejt 16. 7%), megjithëse kjo diferencë nuk arriti rëndësi statistikore (p= 0. 218).
Përfundime: Ankthi ishte i pranishëm në gati një të tretën e pacientëve me SIZ dhe ishte më i zakonshëm tek femrat dhe tek ata të diagnostikuar në moshë më të madhe. Edhe pse nuk u gjetën lidhje të rëndësishme me aktivitetin e sëmundjes, biomarkerët apo trajtimin, ankthi ishte i lidhur me një tendencë drejt përkeqësimit të cilësisë së jetës. Këto gjetje nënvizojnë rëndësinë e përfshirjes së vlerësimit psikologjik në menaxhimin rutinë të SIZ. Studime me përmasa më të mëdha janë të nevojshme për të konfirmuar këto lidhje.

Fjalë kyçe: Sëmundja Inflamatore e Zorrës, ankthi, cilësia e jetës, GAD - 7, Shqipëri.

TROMBOZAT VENOZE NË SHTATËZANI: DIAGNOSTIKIMI I HERSHËM, MENAXHIMI MULTIDISIPLINAR DHE SFIDAT E TRAJTIMIT.

Marsela Sopiqoti[1], Sokol Xhepa [1], Julinda Koci[1]
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"

Abstrakt
Hyrje: Trombozat venoze (DVT dhe Embolia Pulmonare) përbëjnë një nga komplikacionet më serioze të shtatzënisë dhe periudhës postpartum, duke kontribuar ndjeshëm në morbiditetin dhe mortalitetin maternal. Ndryshimet fiziologjike të koagulimit gjatë shtatzënisë krijojnë një gjendje prokoagulative, e cila në prani të faktorëve të tjerë të rrezikut si trombofilia, imobilizimi apo ndërhyrjet kirurgjikale, rrit ndjeshëm probabilitetin e zhvillimit të trombozës venoze.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të evidentojë rëndësinë e diagnostikimit të hershëm të trombozës venoze gjatë shtatzënisë, të vlerësojë rolin e bashkëpunimit multidisiplinar midis kirurgut vaskular, obstetrit dhe hematologut, si dhe të diskutojë sfidat kryesore në trajtimin me antikoagulantë gjatë kësaj periudhe.
Materiale dhe metoda: U analizuan të dhënat klinike të pacienteve shtatzëna të trajtuara për tromboza të venave të thella dhe / ose emboli pulmonare në periudhën 2022–2024 në Shërbimin e Kirurgjisë Vaskulare në QSUT. Janë vlerësuar faktorët e rrezikut, modalitetet diagnostike (Eko Doppler, D - dimer, Angio CT kur e lejon situata klinike), llojet e trajtimit me antikoagulantë dhe ndjekja post - partum.
Rezultate: U vu re se në shumicën e rasteve, diagnoza vonohej për shkak të mbivendosjes së simptomave me ato fiziologjike të shtatzënisë. Përdorimi i Doppler - it rezultoi metoda më e sigurt diagnostike. Trajtimi me heparinë me peshë molekulare të ulët ishte metoda standarde, me rezultate të mira klinike dhe pa efekte anësore serioze tek fetusi. Rëndësi të veçantë iu dha monitorimit afatgjatë dhe profilaksisë në periudhën post - partum.
Përfundime: Trombozat venoze gjatë shtatzënisë mbeten një sfidë klinike që kërkon vigjilencë të lartë, bashkëpunim të ngushtë multidisiplinar dhe individualizim në trajtim. Edukimi i personelit shëndetësor dhe skriningu i hershëm në grupet me risk mund të reduktojë ndjeshëm komplikacionet tromboembolike.

Fjalë kyçe: Tromboza venoze, shtatzëni, antikoagulantë, diagnostikim i hershëm, profilaksia, bashkëpunim multidisiplinar.

DHIMBJA ABDOMINALE TEK FËMIJËT: SFIDAT DIAGNOSTIKE DHE RËNDËSIA E KOMUNIKIMIT NDËRMJET KUJDESIT PARËSOR DHE SPITALOR.

Marsida Kurti, Sokol Buba, Eltona Malo, Enesa Hysenaj, Nilsa Shahini, Grielda Toci, Ada Pema, Mikel Koti

Abstrakt

Hyrje: Dhimbja abdominale përbën një nga shkaqet më të shpeshta të paraqitjes së fëmijëve në urgjence dhe sfidë diagnostike sidomos në spitalet e rretheve. Një analizë retrospektive e rasteve urgjente dhe të referuara mund të ofrojë të dhëna të vlefshme për përmirësimin e menaxhimit klinik edhe nga mjeket e shërbimit parësor.

Qëllimi: Ky studim ka për qëllim të analizojë incidencën, shpërndarjen dhe menaxhimin e dhimbjes abdominale në nje spital bashkiak gjatë periudhës 2020–2024, përfshirë edhe rastet e paraqitura tek mjeku i familjes duke evidentuar rëndësinë e informimit te shërbimit parësor shëndetësor mbi diagnozat.

Metodologji: Studimi është retrospektiv dhe përfshin të gjitha rastet pediatrike të paraqitura gjatë periudhës së viteve 2020 - 2024 (n=10, 776). Grupmosha e studiuar është 0 - 14 vjeç. Të dhënat janë analizuar sipas mënyrës të paraqitjes (urgjencë apo referim nga mjeku i familjes), moshës, gjinisë, vendbanimit, hospitalizimit dhe diagnozës përfundimtare. Të dhënat janë marrë nga regjistrat e urgjencës së përgjithshme dhe pediatrisë si dhe kartelave të shtrimeve të rregullta / ditore.

Rezultate: Gjatë viteve 2020 - 2024 janë paraqitur gjithsej 10, 776 fëmijë, nga të cilat 8, 004 raste (74. 2%) u paraqitën në urgjencë dhe 2, 772 raste (25. 8%) të referuar nga mjeku i familjes. Në total 302 raste (2. 8%) u paraqitën si dhimbje abdominale, ku 266 raste (88. 1%) janë paraqitur në urgjencën e përgjithshme dhe 36 raste (11. 9%) të referuar nga shërbimi parësor. Nga rastet e referuara nga mjeku familjes 24 raste (66. 7%) u referuan në Tiranë. Këto përfshijnë 7 (19. 4%) raste hernie inguinale (0–2 vjeç), 2 (5, 6%) raste hidrocelë, 11(30. 6%) raste dhimbje abdominale të padeterminuara dhe 4 (11. 1) raste patologji tumorale. 12 raste u mjekuan ambulatorisht ndër të cilat 5 (13. 9%) raste ishin parazitoza intestinale, 4 (11. 1%) raste infeksione të rrugëve urinare, 2 (5. 6%) raste gastroenterite dhe 1 (2. 8%) rast dhimbje menstruale. Nga 266 raste të paraqitura në urgjencë si dhimbje abdominale, 66 raste (24. 8%) u shtruan në pediatri, të cilat përbëjnë 4. 2% të shtrimeve totale (n=1, 561) pediatrike, 37 raste (13. 9%) u transferuan në pavionin e kirurgjisë dhe 154 raste (57. 9%) u trajtuan ambulatorisht. 9 raste (3. 4%) u derguan ne Tiranë për diagnozë dhe trajtim me të specializuar. Shpërndarja sipas viteve e shtrimeve si dhimbje abdominale tregon një trend më të lartë në vitin 2021 me 29 raste (43. 9%), ndërsa vitet 2020, 2022, 2023 dhe 2024 kanë pasur përkatësisht 4 raste (6. 1%), 16 raste (24. 2%), 2 raste (3. 0%) dhe 15 raste (22. 7%). Grupmosha me numrin më të madh të rasteve me diagnozë dhimbje abdominale është 0– 5 vjeç 40 raste (60. 6%), ndjekur nga grupmosha 6–10 vjeç me 22 raste (33. 3%) dhe 11–15 vjeç me 4 raste (6. 1%). Sipas gjinisë rezulton se 38 raste (57. 6%) ishin meshkuj dhe 28 raste (42. 4%) femra, ndërsa sipas vendbanimit, 39 raste (59. 1%) vinin nga zona rurale dhe 27 raste (40. 9%) nga zonat urbane. Në lidhje me diagnozat përfundimtare të kolikave abdominale të shtruara, dominon gastroenteriti / enteriti me 20 raste (30. 3%) më i shpeshtë në grupmoshën 2 - 5 vjeç, ndjekur nga dhimbja abdominale e padeterminuar (20 raste, 30. 3%) dhe intoksikacionet alimentare 3 raste (4. 5%) më e shpeshtë në grupmoshën 11 - 14 vjeç; infeksioni urinar (IVU) 11 raste (16. 7%) dhe parazitoza intestinale 6 raste (9. 1%) më i shpeshtë në grupmoshën 6 - 10 vjeç, kolika infantile 4 raste (6. 1%) më i shpeshtë në grupmoshën 0 - 1 vjeç dhe patologji kirurgjikale susp. appendicitis acuta 2 raste (3. 0%).

Konkluzione: Rezultatet e studimit tregojnë se dhimbja abdominale është një ndër shkaqet më të zakonshme të paraqitjes së fëmijëve në urgjencë, por shpesh mbeten të paqarta në fazat e para të vlerësimit. Forcimi i rolit të kujdesit parësor në identifikimin e hershëm dhe në menaxhimin fillestar të këtyre rasteve është thelbësor për të reduktuar referimet e panevojshme. Përmirësimi i komunikimit dhe trajnimi i vazhdueshëm i mjekëve të kujdesit parësor në diagnozën diferenciale të dhimbjes abdominale do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së shërbimit pediatrik në nivel komunitar.

Fjalë kyçe: dhimbje, abdominale, diagnozë diferenciale, shërbim parësor.

INCIDENCA DHE MENAXHIMI I PATOLOGJIVE KIRURGJIKALE NË SPITALET BASHKIAKE: NJË STUDIM RETROSPEKTIV.

Marsida Kurti, Sokol Buba, Eltona Malo, Nilsa Shahini, Ada Pema, Mikel Koti, Griselda Toçi, Enesa Hysenaj

Abstrakt

Hyrje: Patologjitë kirurgjikale pediatrike përbëjnë një pjesë të rëndësishme të rasteve të paraqitura në shërbimin e urgjencës së përgjithshme në spitalet e rretheve, duke kërkuar vlerësim të kujdesshëm diagnostik dhe bashkëpunim të ngushtë midis shërbimit kirurgjikal dhe atij pediatrik për menaxhimin e duhur të pacientëve.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të analizojë incidencën, shpërndarjen demografike dhe menaxhimin e patologjive kirurgjikale pediatrike në një spital bashkiak, si dhe t'i krahasojë me të dhënat e raportuara në literaturën ndërkombëtare.

Metodologjia: Studimi është retrospektiv dhe përfshin të dhënat e 8004 fëmijëve të paraqitur në shërbimin e urgjencës së përgjithshme të një spitali bashkiak gjatë periudhës 2020–2024. Grupmosha e studiuar është 0–14 vjeç. Të dhënat u morën nga regjistrat e shërbimit të urgjencës së përgjithshme, regjistrat dhe kartelat e shtrimeve të rasteve pediatrike në shërbimin e kirurgjisë. Këto të dhëna u analizuan sipas diagnozës hyrëse dhe dalëse, grupmoshës, gjinisë dhe vendbanimit (qytet / fshat), ditëqëndrimit mesatar dhe trajtimit.

Rezultate: Gjatë kësaj kohe, 8, 004 fëmijë u paraqitën në urgjencë, prej të cilëve 266 raste (3. 3%) u paraqitën me dhimbje abdominale. Nga këto, 73 raste (27. 4%) u diagnostikuan me patologji kirurgjikale, duke përbërë 0. 9% të të gjitha paraqitjeve pediatrike në urgjencë. 70 raste (95. 9%) u dyshuan për appendicitis acuta, ndërsa 3 raste (4. 1%) ishin hernie inguinale inkarcerata. Asnjë rast i dyshuar për appendicit nuk u referua nga mjekët e shërbimit parësor, ndërsa 12 raste me hernie inguinale (80%) u referuan me letër rekomandimi dhe 20% u paraqitën drejtpërdrejt në urgjencë. Në 70 raste të dyshuara si appendicitis, 40 raste (57. 1%) iu nënshtruan ndërhyrjes kirurgjikale, ndërsa 22 raste (31. 4%) u trajtuan me terapi empirike. Në 22 raste, 15 fëmijë u diagnostikuan si appendicitis acuta dhe njëkohësisht me infeksion parazitar shoqërues nga Enterobius vermicularis dhe G. Lamblia intestinalis, të cilët u përmirësuan pas mjekimit; infeksion i rrugëve urinare 2 raste (9. 1%) dhe gastroenterit viral 5 raste (22. 7%). Pas ndërhyrjes kirurgjikale, nga 40 raste apendektomie të realizuara, 34 raste (85%) rezultuan me apendicit gangrenoze, 5 raste (12. 5%) flegmonoze dhe 1 rast (2. 5%) katarale. Grupi i moshës më i prekur nga apendiciti ishte 10–14 vjeç (43 raste, 61. 4%), i ndjekur nga grupmosha 5–9 vjeç me 18 raste (25. 7%) dhe më pak në grupmoshën 0–4 vjeç me 9 raste (12. 9%). Sipas gjinisë rezultuan 55 meshkuj (78. 3%) dhe 15 femra (21. 7%). Përsa i përket vendbanimit, 31 raste janë nga fshati (44. 3%) dhe 39 nga qyteti (55. 7%). Numri më i madh i rasteve me apendicit akut ka qenë në muajin prill (13 raste, 18. 6%), pasuar nga maji dhe korriku (9 raste secili, 12. 9%) dhe më pak në muajt dhjetor dhe janar. Ditëqëndrimi mesatar ishte 5 ditë për apendicitet katarale, 6 ditë për flegmonozet, 7 ditë për gangrenozet dhe 4 ditë për kolikat abdominale të trajtuara në mënyrë empirike. 15 (100%) rastet e hernies inguinale ishin nga zonat rurale, 10 meshkuj (66. 7%) dhe 5 femra (33. 3%), dhe grupmosha me numrin më të lartë të rasteve ishte 4–10 vjeç (66. 7%). Të gjitha rastet iu nënshtruan ndërhyrjes kirurgjikale. Ditëqëndrimi mesatar ishte 4 ditë për herniet jo të komplikuara dhe 6 ditë për rastet inkarcerata.

Konkluzion: Patologjitë kirurgjikale zënë një numër relativisht të vogël në raport me patologjitë e tjera pediatrike të rasteve të paraqitura në urgjencë. Pjesa më e madhe e urgjencave kirurgjikale janë apendicitet akute të cilët në një numër të konsiderueshëm të rasteve janë trajtuar në mënyrë empirike duke shmangur ndërhyrjen e parakohshme dhe shpeshherë të panevojshme. Pavarësisht mungesës së kapaciteteve të avancuara diagnostikuese, rastet kanë përfunduar kryesisht pa komplikacione serioze.

Fjalë kyçe: patologji, urgjencë, komplikacione, apendicite akute, trajtim empirik.

INTEGRIMI I SISTEMEVE ELEKTRONIKE DHE MODELIT TË PAGESËS BAZUAR NË PERFORMANCË PËR MJEKËT E FAMILJES: NJË QASJE TEORIKE.

Marsida Mulaj, Ervin Toçi

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim trajton në mënyrë teorike mundësinë e integrimit të sistemeve elektronike të menaxhimit të informacionit shëndetësor me modelet e pagesës bazuar në performancë për mjekët e familjes, si një strategji për përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të kujdesit shëndetësor primar. Objektivi kryesor është të analizohen

përfitimet dhe sfidat që paraqet kjo qasje në kontekstin e sistemeve moderne shëndetësore. Modelet e pagesës të lidhura me performancën synojnë të nxisin ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të përqendruara te pacienti, duke e lidhur kompensimin financiar të mjekëve me rezultatet shëndetësore të arritura. Nga ana tjetër, teknologjitë e informacionit shëndetësor, si regjistri elektronik i banorëve (AHIS) dhe sistemet e vlerësimit të performancës (sistemi e vizita), mundësojnë monitorim të vazhdueshëm, analizë të të dhënave dhe vendimmarrje të bazuar në evidencë. Integrimi i këtyre dy komponentëve ofron potencial për të rritur transparencën, për të përmirësuar shpërndarjen e burimeve dhe për të ndihmuar në matjen objektive të performancës mjekësore. Punimi gjithashtu shqyrton faktorët institucionalë, teknologjikë dhe etikë që ndikojnë në zbatimin e kësaj qasjeje në praktikat e kujdesit parësor.
Ky diskutim synon të kontribuojë në ndërtimin e një kornize konceptuale për zhvillimin e politikave të qëndrueshme shëndetësore që mbështesin inovacionin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në sistemet e kujdesit shëndetësor.

Fjalë kyçe: Integrimi i sistemeve elektronike, model pagesa bazuar në performancë, mjekë të familjes, cilësia e kujdesit shëndetësor, regjistri elektronik i banorëve (AHIS), vlerësimi i performancës (sistemi evizita), menaxhimi i informacionit shëndetësor, politikë shëndetësore, inovacion shëndetësor, kujdes shëndetësor parësor.

PA AKSES, PA DHURUES, PA KOHË: DIALIZA PERITONEALE URGJENTE SI TERAPI SHPËTUESE TEK NJË PACIENT ME HEMODIALIZË AFATGJATË.

Matilda Imeraj[1], Evis Gjorga[2], Kristela Çupi[2], Ermira Imeraj[3]
[1]Shërbimi Nefrologjisë, QSUNT "Nënë Teresa", Tiranë, Shqipëri.
[2]Fakulteti i Mjekësisë, Universiti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri.
[3]FSDKSH, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Hyrje: Dështimi i aksesit vaskular përbën një komplikacion të zakonshëm dhe serioz tek pacientët që trajtohen me hemodializë afatgjatë. Kur të gjitha akseset vaskulare janë ezauruar dhe transplanti renal nuk është i mundshëm, mjekët përballen me një situatë urgjente që kërkon identifikimin dhe zbatimin e menjëhershëm të një modaliteti alternativ të terapisë renale zëvendësuese për të parandaluar komplikacionet potencialisht fatale.
Prezantimi i rastit: Një pacient mashkull, 65 vjeç, me insuficiencë renale kronike terminale, në trajtim me hemodializë për tetë vjet, u paraqit në gjendje kritike me hiperkalemi të rëndë dhe nivele të rritura ndjeshëm të uresë dhe kreatininës në serum. Të gjitha vendet e aksesit vaskular ishin ezauruar, ndërsa transplanti renal nuk ishte i mundur për shkak të mungesës së dhuruesve, si të gjallë ashtu edhe të vdekur. Pacienti kërkonte ndërhyrje të menjëhershme për të korrigjuar çrregullimet e rënda metabolike që rrezikonin jetën. Në kushtet e mungesës së aksesit për hemodializë dhe urgjencës metabolike, u vendos një kateter emergjent për dializë peritoneale. U iniciua dializa peritoneale manuale me tretësirë dializate me bazë glukoze 1. 36% (Dianeal), e cila çoi në përmirësim të shpejtë të parametrave biokimikë dhe stabilizim klinik të pacientit.
Konkluzion: Ky rast nënvizon rëndësinë e dializës peritoneale me fillim urgjent si një alternativë efektive dhe shpëtuese për pacientët me insuficiencë renale terminale, të cilët kanë humbur të gjitha mundësitë për hemodializë dhe transplant. Njohja e hershme e kësaj strategjie dhe koordinimi i shpejtë ndërdisiplinor janë thelbësorë për menaxhimin e krizave akute ureminike në situata kritike.

Fjalë kyçe: Dializë peritoneale, dështim i aksesit vaskular, menaxhim ndërdisiplinor.

PËRDORIMI I ATROPINËS ME DOZË TË ULËT PËR MENAXHIMIN E MIOPISË TEK FËMIJËT ME RETINOPATI TË PREMATURITETIT.

Matilda Islamaj Phd - C. [1], Ali Tonuzi Assoc. Prof. [1], Alketa Tandili Assoc. Prof. [1], Eglantina Bulica Phd - C. [2]
[1]Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri.
[2] Oftamologjist, Poliklinika e Specialiteteve, Nr. 1, Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt

Hyrja: Miopia është një nga pasojat më të shpeshta afatgjata tek foshnjat e prekur nga retinopatia e prematuritetit (ROP), veçanërisht tek ata që kanë kaluar trajtime për ablacion retine ose injeksione intravitreale me anti - VEGF. Ndryshimet strukturore në segmenin anterior dhe posterior të syrit kontribuojnë në zhvillimin progresiv të defekteve refraktive, duke ndikuar negativisht në zhvillimin vizual. Studime të fundit sugjerojnë se përdorimi i atropinës së holluar mund të ngadalësojë përparimin e miopisë tek këta pacientë me rrezik të lartë.
Qëllimi: Të shqyrtohen provat aktuale dhe të dhënat klinike mbi përdorimin e atropinës së holluar për menaxhimin e miopisë tek fëmijët me histori të ROP.
Metoda: U shqyrtua literaturë mbi miopinë pas ROP dhe trajtimin me atropinë. U analizuan parametrat që lidhen me dozat (0. 01–0. 05%), kohëzgjatjen e trajtimit, efikasitetin, efektet anësore dhe sigurinë tek foshnjat e parakohshme dhe pacientët e trajtuar për ROP. Gjithashtu u vlerësua dhe praktikë e përditshme klinike e trajtimit me atropinë të holluar të rasteve me miopi.
Rezultate: Atropina me dozë të ulët ka treguar ulje të ndjeshme të përparimit të miopisë tek fëmijët e moshës shkollore, megjithëse të dhënat specifike për miopinë pas ROP mbeten të kufizuara. Rezultatet paraprake sugjerojnë se atropina 0. 01%–0. 025% mund të jetë e sigurt dhe relativisht efektive në kontrollin e zgjatjes aksiale pa shkaktuar fotofobi të theksuar, turbullim në shikimin afër apo efekte rikthimi. Megjithatë, ndryshimet strukturore në syrin e pacientëve me ROP si trashja e thjerrëzës dhe harkimi më i theksuar i kornesë kërkojnë përshtatje individuale të dozës dhe ndjekje të afërt klinike.
Përfundime: Atropina e holluar paraqet një qasje premtuese ndihmëse në menaxhimin e miopisë tek fëmijët me ROP. Edhe pse të dhënat fillestare mbështesin sigurinë dhe efektivitetin e saj, nevojiten studime të kontrolluara për të përcaktuar protokollet optimale dhe rezultatet afatgjata. Integrimi i terapisë me atropinë në programet e ndjekjes pas ROP mund të përmirësojë prognozën vizuale dhe cilësinë e jetës së fëmijëve të prekur.

Fjalë kyçe: retinopatia e prematuritetit, miopia, atropina me dozë të ulët, defekte refraktive, oftalmologjia pediatrike, zhvillimi vizual.

TERAPIA ME ANTIDOTË NË MBIDOZAT ME OPIATE DHE BENZODIAZEPINA: PRESPEKTIVA E TOKSIKOLOGJISË KLINIKE MBI PËRDORIMIN E NALOKSONIT DHE FLUMAZENILIT.

MD Matilda Kambo[1], Prof. Asc Filadelfo Coniglione[2],
[1]Departamenti i Toksikologjisë Klinike dhe Varësisë Alkoolike, Qendra Universitare "Nënë Tereza"
[2]Profesor - Universiteti "Zoja e Këshillit të Mirë"

Abstrakt

Hyrje: Mbidozimet me opiate dhe benzodiazepina përbëjnë një emergjencë toksikologjike globale, të cilat karakterizohen nga depresioni respirator, alterimi i vetëdijes dhe rreziku i arrestit kardiopulmonar. Përdorimi i antidotëve specifikë, si naloksoni dhe flumazenili, mbetet thelbësor në rivendosjen e funksioneve vitale dhe në reduktimin e mortalitetit akut. Ky rishikim i literaturës synon të analizojë strategjitë toksikologjike në klinikë në racionalizimin e përdorimit të këtyre antidotëve në emergjenca.
Metodologjia: U realizua një përmbledhje narrative e literaturës për periudhën 2010–2024, duke përfshirë udhëzime ndërkombëtare të toksikologjisë klinike, rishikime sistematike dhe studime retrospektive mbi përdorimin e naloksonit dhe flumazenilit në intoksikacione të izoluara dhe të përziera. Burimet kryesore ishin PubMed, Scopus dhe WHO Drug Information Database.
Rezultate: Evidenca tregojnë se naloksoni vlerësohet, si antagonisti kompetitiv i receptorëve μ - opioidë, mbetet standarti më efektiv për rivendosjen e funksionit e respirator të shkaktuar nga opiatet. Dozat e titruara intravenoze (0. 04–0. 4 mg çdo 2–3minuta) dhe format intranazale 4 mg rezultojnë të sigurta dhe efikase, është i domosdoshëm monitorimi për ri - dhënien e dozave për shkak se ka gjysëmjetë më të shkurtër se opioidi. Sipas nje studimi të publikuar në PubMed "Naloxone Administration and Survival in Overdose Involving Opioids and Stimulans": Pennsylvania Overdose Information Network 72. 2% e overdozve kishin përdorur Naloxon.

Flumazenili, antagonist selektiv i receptorit GABA - A, është efektiv në rikthimin e vetëdijes në intoksikacione benzodiazepinike të izoluara, por përdorimi i tij është i kufizuar nga rreziku i konvulsioneve dhe sindromës së tërheqjes te pacientët me varësi kronike ose në mbidoza të përziera me depresantë të tjerë të sistemit nervor qendror. Menaxhimi klinik kërkon mbështetje të funksioneve vitale, titrim të kujdesshëm të dozës së antidotit dhe vlerësim të plotë toksikologjik përpara administrimit të flumazenilit. Në një studim retrospektiv në Mbretërine e Bashkuar "UK National Poisons Information Service (NPIS)" 1. 8% e rasteve u trajtuan me flumacenil.
Përfundime: Naloksoni mbetet standardi i artë në terapinë antidotike të mbidozës opioidike, ndërsa flumazenili duhet të përdoret në mënyrë selektive, vetëm në raste të kontrolluara dhe të monitoruara. Përdorimi i kombinuar i këtyre antidotëve kërkon kujdes të veçantë në intoksikacionet e përziera, ku menaxhimi toksikologjik duhet të orientohet drejt sigurisë respiratore dhe parandalimit të komplikacioneve neurologjike.

Fjalë kyçe: nalokson, flumazenil, mbidozë, toksikologji klinike, antidot, opiate, benzodiazepina, depresion respirator.

NDIKIMI I FAKTORËVE MJEDISORË NË SËMUNDJET AUTOIMUNE TË TIROIDES: PËRMBLEDHJE E LITERATURËS.

Megi Lekbello, Dorina Ylli, Matjeta Kermaj, Violeta Hoxha, Klodiana Poshi

Abstrakt
Sëmundjet autoimune të tiroides (AITD) përfaqësojnë sëmundjet organ - specifike autoimune më të përhapura, me një prevalencë që varion nga 2 deri në 5% në popullatën e përgjithshme, duke prekur më shpesh gratë (5–15%) sesa burrat. Ndër sëmundjet më të shpeshta renditen Sëmundja e Graves (GD) dhe Tiroiditi Hashimoto (TH). Etiopatogjeneza e AITD mbetet ende e paqartë, megjithëse përveç faktorëve gjenetikë dhe epigjenetikë, një sërë faktorësh mjedisorë janë të njohur për rolin e tyre në nxitjen e përgjigjes autoimune. Ndërkohë që ekzistojnë studime të shumta mbi predispozitën gjenetike, të dhënat mbi ndikimin e faktorëve mjedisorë janë më të kufizuara. Qëllimi i këtij punimi është të shqyrtojë dhe analizojë literaturën ekzistuese në lidhje me ndikimin e faktorëve mjedisorë në zhvillimin e AITD. Faktori më i mirë - studiuar është marrja e tepruar e jodit, e cila është e lidhur ngushtë me shfaqjen e tiroiditit autoimun tek individët me predispozitë gjenetike. Gjithashtu, në literaturë evidentohen si faktorë të rëndësishëm mungesa e vitaminës D dhe selenit, infeksionet virale dhe bakteriale (p. sh. EBV, HHV - 6, H. pylori), çrregullimet e mikrobiomës, disa medikamente (interferon - alfa, frenues të kinazës tirozinë), si dhe faktorë të tjerë si stresi, klima dhe pirja e duhanit. Ekspozimi ndaj kimikateve sintetike dhe pesticideve është gjithashtu i lidhur me rritjen e rrezikut për zhvillimin e autoimunitetit tiroid. Ndërgjegjësimi mbi faktorët mjedisorë që ndikojnë në shfaqjen e AITD është thelbësor për parandalimin dhe menaxhimin më efektiv të sëmundjes. Modifikimi i faktorëve të rrezikut përmes ndryshimeve në stilin e jetesës dhe ushqyerje mund të ulë incidencën dhe të lehtësojë ecurinë klinike të sëmundjeve autoimune të tiroides.

Fjalë kyçe: Sëmundjet autoimune të tiroides (AITD), sëmundja e graves (GD), tiroiditi hashimoto (TH).

SARCOPTES SCABIEI NË PREZANTIME KLINIKE ATIPIKE: VËSHTRIMI LABORATORIK.

Msc. Melissa Tabaku[1, 2], Dr. Shk. Najada Gjylameti[2] Dr. Shk. Erjona Shehu
[1]*Qendra Diagnostike Alfa*
[2]*Laboratori i Mikrobiologjisë QSUT*

Abstrakt
Hyrje: Sarcoptes scabiei është një parazit epidermal që shkakton sëmundjen e njohur Skabie. Shenjat klinike karakteristike janë eritema, papula dhe prurit. Disa pacientë paraqesin variante klinike atipike, ku diagnostikimi i bazuar vetëm në shenjat klinike mund të jetë i vështirë.
Qëllimi i studimit: Roli i laboratorit Mikrobiologjik në identifikimin e S. scabiei në rastet atipike, përmes ekzaminimit mikroskopik të mostrave të lëkurës dhe identifikimit të formave: mite, vezë dhe larva për të konfirmuar praninë e parazitit.

Materiali dhe metoda: Studimi është retrospektiv. Analizuam të dhënat e pacientëve të paraqitur pranë Qendrës Diagnostike Alfa gjatë vitit 2025. Pacientët janë rekomanduar nga mjekë Dermatologë për të konfirmuar diagnozën e infeksionit nga S. scabiei në bazë të shenjave klinike. Ekzaminimi përfshin marrjen e materialit (lëkurë) nga vatrat e dyshuara në trup dhe ekzaminimi mikroskopik direkt me KOH (20%).
Rezultate: Analizuam të dhënat e 36 pacientëve. Mosha mesatare e pacientëve rezultoi 35. 8 vjeç. U vu re një shpërndarje e larmishme sipas grupmoshave, nga 7 muaj - 80 vjeç. 52% (19) e pacientëve ishin femra dhe 48% (17) meshkuj. Në 36 pacientë, 63% (23) e tyre rezultuan pozitive me S. scabiei, e konfirmuar mikroskopikisht me të paktën një nga stadet e parazitit (mite, vezë, larva, nymph dhe parazit matur). Në 23 pacientë që rezultuan pozitive, vetëm 5 (21%) raste kishin pamje klinike atipike.
Përfundime: Gjetjet tona theksojnë rëndësinë e mikroskopisë si një metodë diagnostike të besueshme në rastet ku dyshimi klinik është i ulët, duke kontribuar në diagnostikimin e hershëm dhe trajtimin efektiv të skabies.

Fjalë kyçe: Sarcoptes scabiei, nymph, parazit, mikroskopi.

RETINA, DRITARJA E TRURIT: PËRDORIMI I IMAZHERISË RETINALE PËR DIAGNOSTIKIMIN E SËMUNDJEVE NEURODEGJENERATIVE.

Dr. Vlera Haxhishabani [1], Dr. Memli Haxhishabani [2], Dr. Vjollca Gojani[3]
[1]*QKMF, Gjakovë*
[2]*Spitali Rajonal Gjakovë, Reparti i Neurologjisë*
[3]*Qendra Diagnostike e Syrit Dr. Vjollca Gojani, Gjakovë*

Abstrakt
Hyrje: Retina është një strukturë nervore unike që pasqyron gjendjen e sistemit nervor qendror dhe ka aftësinë të shfaqë ndryshime mikroskopike para shfaqjes së simptomave klinike. Studimet e fundit kanë sugjeruar se analiza e retinës mund të shërbejë si biomarker i hershëm për sëmundjet neurodegjenerative, përfshirë Alzheimer - in dhe Parkinson - in. Ndryshimet vaskulare dhe strukturale në retina mund të lidhen me humbje kognitive dhe progresion të sëmundjeve neurodegjenerative.
Qëllimi: Ky prezantim synon të shqyrtojë përdorimin e imazherisë retinale, përfshirë Optical Coherence Tomography (OCT) dhe imazherinë fluoreskuese, si mjet jo - invaziv për diagnostikimin e hershëm dhe monitorimin e sëmundjeve neurodegjenerative.
Metodologjia: Analizohen studime klinike dhe longitudinale të publikuara midis viteve 2015–2025, duke përfshirë pacientë me diagnostikim të hershëm të Alzheimer - it dhe Parkinson - it. Vlerësohet lidhja midis reduktimit të retinal nerve fiber layer (RNFL), ndryshimeve vaskulare dhe progresionit të sëmundjeve.
Rezultatet: Evidenca tregon se reduktimi i RNFL dhe ndryshimet vaskulare lidhen ngushtë me humbjen kognitive dhe progresionin e sëmundjeve. Imazheria retinale ka potencial si biomarker i hershëm, i përsëritshëm dhe jo - invaziv, që mund të plotësojë diagnostikimin klinik dhe neuroimazherinë konvencionale.
Diskutime: Integrimi i imazherisë retinale në praktikën klinike mund të përmirësojë diagnostikimin e hershëm, të mundësojë monitorim longitudinal dhe të lehtësojë ndërhyrjet terapeutike të shpejta. Sfida mbetet standardizimi i protokolleve dhe interpretimi i rezultateve në nivel global.
Përfundime: Retina mund të shërbejë si "dritare" diagnostikuese e trurit, duke ofruar një qasje të avancuar, jo - invazive dhe të personalizuar për identifikimin e sëmundjeve neurodegjenerative.

Fjalë kyçe: Retina, neurodegjenerim, OCT, biomarker, alzheimer, parkinson, imazheri vaskulare, RNFL.

VLERËSIMI DHE KRAHASIMI I INJEKTIMEVE KORTIKOSTEROIDE DHE FIZIOTERAPISË NË MENAXHIMIN E DHIMBJES DHE REHABILITIMIN NË BURSITIN SUBACROMIAL.

Menada Curri Turdiu [1], Klarita Hoxhallari[2]
[1]Fizioterapiste Pediatrike Qëndra Spitalore Universitare Nënë Tereza
[1]Universiteti i Sporteve, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit
[2]Farmaciste, Drejtuese teknike "Bioplus"

Abstrakt

Hyrje: Bursiti Subacromial është çrregullimi më i zakonshëm i shpatullës, duke përbërë diku midis 44% dhe 65% të të gjitha ankesave të dhimbjes së shpatullës, me incidencën që rritet me moshën. Incidenca maksimale ndodh gjatë dekadës së gjashtë të jetës.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është krahasimi dhe vlerësimi i efektshmërisë së injektimeve kortikosteroide dhe fizioterapisë.

Metodologjia: Ky studim është një rishikim literature që u krye në 3 baza të dhënash elektronike (PubMed, ScienceDirect, Cochrane Library). Nga kërkimi elektronik u përzgjodhën vetëm 6 studime të shtrira në intervalin kohor nga viti 1998 (1 studim) deri në vitin 2023 (5 studime). Numri i pacientëve të përfshirë në 6 studimet e përzgjedhura ishte 631. Studimet duhet të përmbushnin kriteret e përfshirjes dhe të gjitha ishin në gjuhën angleze. Shkalla PEDro u përdor për vlerësimin e studimeve të marra.

Rezultate: Në rishikim tonë të literaturës hasëm limitime se në çfarë përfshinte trajtimi fizioterapeutik (llojin, frekuencën, fizoterapi e kryer nga fizioterapiste apo ushtrime te kryera në shtëpi. Popullata e marrë në shqyrtim nuk kishte të përcaktuar severitetin apo se në cilën fazë ishin akute apo kronike. Pikë e fortë e studimeve të marra në shqyrtim ishte fakti që ishin studime të randonizuara me grup kontrolli.

Konkluzione: Konkluzionet afatshkurtër (4 - 8 javë) - Injeksionet kortikosteroide (shoqëruar ose jo me fizioterapi) prodhojnë efekt më të shpejtë në uljen e dhimbjes dhe rritje të funksionalitetit sesa vëtëm trajtimi fizioterapeutik. Konklzionet afatgjatë (3 - 6 muaj) - Trajtimi fizioterapeutik sjell përmirësim funksionaliteti dhe rritje të cilësise së jetës. Terapia e kombinuar shfaq rezultate më të mira në ulje të dhimbjes më shpejt dhe mirëmbajtje me të mirë të Rom artikular afatgjatë.

Fjalë kyçe: bursiti subacromial, fizioterapi, injeksione kortikosteroide.

VLERËSIMI I INCIDENCËS SË INFEKSIONEVE TË LIDHURA ME KUJDESIN SPITALOR DHE NDIKIMI I TYRE NË PROGNOZËN DHE ECURINË E RASTEVE TË NDJEKURA PRANË SHËRBIMIT TË KUJDESIT INTENSIV PEDIATRIK NË QSUT, 1996–2024.

Dr. Mereme Sela[1], Prof. Arjan Harxhi[2], Prof. Asoc. Sokol Buba[2], Prof. Besim Boci[2], Ali Sela[4], Era Gjoka[4], Dr. Andrin Tahiri[3], Dr. Shk. Besim Ymaj[3], Zyra Ymaj[5], Prof. Entela Haloci[2]
[1]Sektori i Kontrollit të Infeksioneve Spitalore, QSUT "Nënë Tereza"
[2]Fakulteti i Mjekësisë, UMT
[3]PAI Neuroshkenca, Universiteti LUARASI
[4]Shërbimi i Toksikologjisë, QSUT "Nënë Tereza"
[5]Universiteti Aldent, Mjekësia Ligjore

Abstrakt

Nëpërmjet një projekti të Bankës Botërore në vitin 1996, u ngrit struktura e Njësisë së Infeksioneve Spitalore (SKIS) pranë QSUT - së. Kjo strukturë filloi punën me tre vetë: një mjek dhe dy infermiere, të cilët u dërguan për specializim në Spitalin Cantonal të Gjenevës. SKIS u caktua në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT - së. Gjatë dy dekadave të fundit, ky sektor ka pësuar një rritje të numrit të personelit dhe është trajnuar për të zhvilluar fushatat e vaksinimit të personelit me vaksinën e Hepatitit B, ka kryer studime për prevalencën e infeksioneve nozokomiale në klinikat kirurgjikale të QSUT - së, etj. Në vitet 2014–2024, SKIS është përfshirë gjerësisht në fushatat e vaksinimit kundër gripit, DDD, fushatën kundër përdorimit të duhanit, parandalimin e infeksioneve nozokomiale duke trajnuar personelin mjekësor për larjen e duarve, regjistrimin e detajuar të aksidenteve në punë, si dhe studime të detajuara. Disa prej këtyre studimeve përfshijnë: "Incidenca e Infeksioneve Spitalore te Plagët Operatore në tre Klinikat Kirurgjikale", studimi i "Prevalencës Pikësore në Reanimacionin Qendror dhe Reanimacionin e Diegie Plastikes", dhe botimi i monografisë "Kontrolli dhe Parandalimi i Infeksioneve Spitalore". SKIS ka qenë pjesë e bashkëpunimit me Spitalin Mater Dei të Maltës në

projektin për "Fuqizimin e kontrollit të Infeksioneve Spitalore", i cili u finalizua me marrjen e mostrave MRSA dhe KARBAPENEMAZE rezistente (rezultatet e të cilave janë botuar tashmë). Në vitin 2018, në të gjitha blloqet operatorë, reanimacionet dhe dhomat e mjekimit janë marrë gjithsej 1, 390 mostra për analizat bakterologjike. Nga këto, 1, 132 (81. 4%) mostra kanë rezultuar negative dhe 258 (18. 6%) josterile. Rezultati sipas njësive ka variuar nga 3. 6% deri në 46. 2%. Nga rastet e dyshuara për infeksion spitalor, janë marrë për analiza bakterologjike në laboratorin e QSUT - së gjashtë kultura nga plagët operatorë. Nga këto, dy (33. 3%) mostra kanë rezultuar me E. coli, dy (33. 3%) mostra me Staphylococcus (një aureus dhe një spp), një (16. 7%) mostër me Acinetobacter, dhe një (16. 7%) me Proteus Mirabilis. Vetëm për PAI Neuroshkencë, gjatë periudhës tetor 2023 – gusht 2024, janë evidentuar 9 raste vetëm në një pavion (të Neurokirurgjisë). SKIS mbetet një nga sektorët më të rëndësishëm të QSUT - së, suksesi i të cilit kontribuon në performancën më të mirë spitalore.

Fjalë kyçe: SKIS, infeksione nozokomiale, parandalim.

DERMATITI ATOPIK – SFIDAT DHE MUNDËSITË E REJA TË TRAJTIMIT.

Meri Komoni Nagavci

Abstrakt

Hyrja: Dermatiti atopik është një sëmundje kronike inflamatore e lëkures që shfaqet më shpesh te fëmijët por mund të vazhdoj edhe në moshë të rritur. Meqenëse dëmtohet barriera e lëkurës, ajo bëhet më e ndjeshme ndaj irrituesve dhe alergjenëve. Shkaktarët akoma nuk dihen, por besohet që ka të bëj me predispozitën gjenetike. Faktorët që e përkeqsojnë janë: alergenët, djersitja, stresi, ushqimet e ndryshme, klima e thatë, etj.

Qëllimi: Ky rishikim i literaturës përmban informacione të viteve të fundit në lidhje me dermatitin atopik. Qëllimi është që të njihen mënyrat e reja të mjekimit për këtë sëmundje shumë të përhapur që akoma nuk ka një terapi adekuate. Qëllimi kryesor në këto raste është që sëmundja të diagnostifikohet dhe të filloj të trajtohet sa më parë.

Metodologjia: Ky punim i tipit rishikim i literaturës është i bazuar në të dhëna të marrura nga databaza të ndryshme shkencore si PUBMED, Web of Science dhe Ebsco.

Janë analizuar në detaje disa punime të tipit rishikim literaturë të periudhës kohore (2021 - 2025) dhe është siguruar një pasqyrë e detajuar në lidhje me zbulimet e fundit për dermatitin atopik. Si përfundim do të shohim rezultatet nga metodat më të reja të diagnostifikimit dhe trajtimit të dermatitit atopik në botë.

Rezultate dhe diskutime: 1. Përparimet e fundit në trajtimin e dermatitit atopik**:** ky studim fokusohet kryesisht te ilaçet e reja në treg. Ilaçet që janë në fazë studimi dhe ato që janë miratuar si të sigurta për përdorim. Përmenden kremra të rinjë lokalë që bllokojnë fosfodiesterazën 4 dhe JAK –inhibitorët topik. Gjithashtu shikohet potenciali i trajtimeve që synojnë mikrobiomën; 2. sfidat dhe trendet e reja në trajtimin e dermatit atopik**:** trajtimi për dermatitin atopik duhet të jetë i personalizuar. Kjo ndodh sepse dermatiti atopik vjen nga shkaktarë të ndryshëm dhe trajtimi varet nga përgjigjja imune e organizmit; 3. biomarkerat si metodë klasifikimi te dermatiti atopik: meqenëse vitet e fundit trajtimi po kalon nga ai klasik (trajtimi i njejtë për të gjithë) në trajtimin e personalizuar, nevojiten metoda të klasifikohen pacientët. Një nga këto metoda është që të identifikohen biomarkerat që kanë lidhje me dermatitin atopik. Në këto formë pacientët stadifikohen dhe trajtohen në mënyrë të përsonalizuar; 4. dieta si faktor që ndikon në shfaqjen ose keqësimin e dermatitit atopik. Mënyra e të ushqyerit ka rol të madh. Ushqyerja ekskluzive me gji për 3 deri në 4 muaj, një dietë e pasur me fruta dhe perime dhe probiotikët mund të kenë një efekt të dobishëm; 5. komplikimet e dermatitit atopik me infeksione**:** meqenëse te dermatiti atopik kemi prishje të barrierës së lëkurës, rritet mundësia që të zvillohet infeksion. Megjithatë, përdorimi i antibiotikëve në këto raste mbetet i diskutueshëm. Trajtimet e reja preferojnë më shumë përmisimin e barrierës së lëkurës dhe përdorimin e terapisë antiinflamatore.

Përfundime: Dermatiti atopik është një nga dermatozat më të shpeshta kronike. Akoma nuk ka një kurë definitive prandaj paraqet një temë të rëndësishme për tu shtjelluar. Sipas studimeve të reja pacientët me dermatit atopik duhet të klasifikohen dhe të marrin trajtim të personalizuar.

Fjalë kyçe: dermatiti atopik, dermatoza, stadifikim, trajtim i personalizuar.

BMI NË SËMUNDJET NEURODEGJENERATIVE.

MD. PhD. Candidate. Meri Papajani
Shërbimi Universitar i Neurologjisë, QSUNT, Shqipëri
Universiteti I Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Hyrje: Indeksi i Masës Trupore (BMI) po konsiderohet gjithnjë e më shumë si një tregues klinik i vlefshëm në sëmundjet neurodegjenerative, me të dhëna që sugjerojnë një lidhje midis ndryshimeve në peshë trupore dhe progresionit të sëmundjes.

Qëllimi: Të vlerësohet lidhja mes vlerave të BMI - së dhe ecurisë klinike të disa sëmundjeve neurodegjenerative, të tilla si sëmundja e Alzheimerit (AD), sëmundja e Parkinsonit (PD) e patologjive të tjera neurodegjenerative.

Materiale dhe Metoda: U analizuan të dhënat e BMI - së nga pacientë të diagnostikuar me AD, PD, ALS etj. gjatë një periudhe të përcaktuar. U vlerësua marrëdhënia midis ndryshimeve të BMI - së dhe treguesve klinikë të ecurisë së sëmundjes, duke u marrë parasysh faktorët si mosha, gjinia dhe komorbiditetet.

Rezultate dhe Diskutime: BMI i ulët rezultoi i lidhur me përkeqësim më të shpejtë të funksioneve njohëse në AD dhe me humbje më të theksuar funksionale në ALS. Pacientët me PD treguan ndryshime të ndryshme në BMI, të ndikuara nga simptomat motorike dhe trajtimi farmakologjik. Në të gjitha grupet, vlerat jonormale të BMI - së lidhen me cilësi më të ulët jete dhe ngarkesë më të madhe për kujdestarët.

Konkluzione: BMI është një tregues i thjeshtë dhe jo - invaziv që mund të japë informacion të vlefshëm mbi rrjedhën e sëmundjeve neurodegjenerative. Monitorimi i rregullt i BMI - së mund të ndihmojë në ndërhyrje të hershme dhe planifikim më të mirë të kujdesit multidisiplinar.

Rekomandime: Ndjekja e një stili sa më të shëndetshëm jetese, konsulta të rregullta e trajtim I hershëm i patologjive do të ndikonte në ngadalësimin e zhvillimit të sëmundjeve neurodegjenerative.

Fjalë kyçe: BMI, tregues klinik, monitorim, sëmundjeve neurodegjenerative.

HEMORAGJIA INTRACEREBRALE SI EMERGJENCË NEUROLOGJIKE AKUTE.

Merita Gërguri[1], Abdurrahim Gërguri[2], Egzona Sadiku[3], Endrita Tora[4]
[1]*QKUK, Klinika e Neurologjisë, Prishtinë*
[2]*Kolegji AAB, Prishtinë*
[3]*QKMF - Mitrovicë*
[4]*QKMF - Prishtinë*

Abstrakt

Hemoragjia intracerebrale është një formë e hemoragjisë intrakraniale që ndodh brenda masës cerebrale, duke përfaqësuar një emergjencë neurologjike me një morbiditet dhe mortalitet të lartë. Shkaqet më të shpeshta janë: shtypja e lartë e gjakut, malformacionet arteriovenoze dhe traumat e kokës. Simptomat varen nga vendndodhja dhe madhësia e përfshirjes së hemoragjisë, por kryesisht përfshin: dhimbje të paparitur të kokës, dobësi apo paralizë të njëanëshme (hemiparezë), çrregullime të të folurit (afazi), probleme vizuale ose shqisore, alterim të vetëdijes ose në rastet më të rënda edhe komë. Diagnostikimi i kësaj emergjence neurologjike fillon prej anamnezës së sëmundjes, ekzaminimit fizik dhe statusit neurologjik posaçërisht poentimi i GCS (Glasgow Coma Scale) i cili jep të dhëna për prognozën e sëmundjes, biokimia e gjakut dhe urinës. Neuroimazheria luan një rol krucial në diagnostikimin e kësaj patologjie. Angiografia duhet të bëhet tek pacientët me hemoragji intracerebrale të cilët konsiderohen kandidatë për intervenim kirurgjikal, tumore, malformacione arteriovenoze apo aneurizma. Trajtimi inicial i hemoragjisë intracerebrale është i drejtuar në dhënien e ndihmës së parë dhe oksigjenimin, intubimi indikohet vetëm në rastet kur pO2<60mmHg. Trajtimi vazhdon varësisht nga simptomatologjia me analgjetikë dhe antikonvulzivë nëse kemi kriza konvulzive. Profilaksa e trombozës venoze bëhet me heparinë me doza të ulëta pas stabilizimit të gjakderdhjes. Për të evituar komplikimet metabolike dhe infeksionet eventuale bëhet monitorimi i glukozës dhe temperaturës trupore. Trajtimi kirurgjikal tek hemoragjia intracerebrale është i rrallë. Rehabilitimi i hershëm ndikon në uljen e komplikime duke përmirësuar cilësinë e jetës tek këta pacientë.

Fjalë kyçe: Hemoragjia intracerebrale, diagnostikimi, trajtimi.

PROFILIZIMI I RREZIKUT NË TRAUMË: NXITËSIT E HERSHËM HEMODINAMIKË DHE FARMAKOLOGJIKË TË DEMTIMIT AKUT RENAL DHE MORTALITETIT NË KËTË POPULLATË.

Marsida Kasa[1], Merita Rroji[2, 3]
[1]*Departamenti i Mjekësisë së Brendshme, Spitali Universitar i Traumës, Tiranë, Shqipëri*
[2]*Departamenti i Nefrologjisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri*
[3]*Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri*

Abstrakt
Hyrja: Dëmtimi akut i veshkave (DRA) është një ndërlikim i shpeshtë dhe i rëndë në kujdesin intensiv të traumës, që pasqyron paqëndrueshmërinë hemodinamike të hershme dhe stresin terapeutik. Shpesh shfaqet brenda 48 orëve të para, sinjalizon përkeqësim sistemik dhe parashikon rezultate të dobëta. Identifikimi i parashikuesve hemodinamikë dhe farmakologjikë të hershëm është thelbësor për të udhëhequr resusitimin e synuar dhe përmirësuar mbijetesën në këtë popullatë me rrezik të lartë.
Metodologjia: Kohort prospektiv në studim në vazhdim (2024–2025) në Spitalin Universitar të Traumës, Tiranë. DRA u përcaktua sipas kritereve KDIGO. U përdor regresioni logjistik për të vlerësuar parashikuesit e DRA - së dhe vdekshmërisë. U analizuan shënues të hershëm (teprica bazike [base excess], laktati, përdorimi i inotropëve, natriumi urinar, ekskretimi fraksionar i kaliumit—FEK) si dhe rezultati SOFA, ngarkesa transfuzionale dhe ekspozimet ndaj barnave.
Rezultate: Ndër 153 pacientë (mosha mesatare 56 vjeç; 84% meshkuj), 53. 6% zhvilluan DRA. Parashikues të hershëm përfshinin përdorimin e inotropëve brenda 24 orëve (OR 9. 6, p=0. 005) dhe BE me negative. Natriumi urinar <40 mmol / L parashikoi DRA të qëndrueshme (specifikësi 92%); FEK i rritur (>30–40%) pasqyroi stres mikrocirkulator të hershëm. Çdo rritje me 1 pikë në SOFA shtoi rrezikun për AKI me 30% (p=0. 0003). Shumica e DRA - së ndodhën ≤48 orë; Dita 2 ishte më e shpeshta (13. 1%); Ditët 1–3 përbënin gati një të tretën e të gjithë pacientëve. DRA i hershëm lidhej me laktatet më të lartë (3. 3 [2. 8–5. 3] kundrejt 2. 1 [1. 7–3. 0] mmol / L, p<0. 001), prirje për MAP (presioni mesatar arterial) më të ulët (82 [65–97. 5] kundrejt 90 [80–104. 5] mmHg, p=0. 05), CK (kreatin - kinaza) më të lartë (500 [240–1895] kundrejt 303 [148–906] U / L, p=0. 056) dhe prirje për bikarbonate më të ulëta (21 [18–24] kundrejt 22 [20–25] mmol / L, p=0. 08). Inotropët (~21%) dhe barnat nefrotoksike ishin më të shpeshta te DRA i hershem. Në analizën multivariabël (AUC = 0. 70), laktati mbeti parashikuesi më i fortë (p<0. 001); MAP i ulët, inotropët dhe ekspozimi nefrotoksik shtuan efekte kufitare. Incidenca e ekspozimit nefrotoksik: aminoglikozide 42%, karbapeneme 54%, kolistin 50%, vankomicinë 75%, vankomicinë–imipenem 100%. AINS (anti - inflamatorë josteroidalë) trefishuan rrezikun e DRA - se; manitoli dhe transfuzionet e rritën atë (~15% për njësi, p<0. 05). Vdekshmëria totale në ICU ishte 54% (83 / 153), duke u rritur nga 34% te pacientët pa DRA në 74% me DRA dhe duke arritur 100% në Stadin III. Pas korrigjimit, edhe Stadi I e dyfishoi rrezikun e vdekjes (OR 3. 57, p=0. 017).
Përfundime: DRA në traumë është një shënues dhe një ndërmjetësues i hershëm, i ndërvepruesheëm, i disfunksionit multiorganik. Laktati i rritur, MAP i ulët, nevoja për inotropë, BE negativ, ekspozimet nefrotoksike (veçanërisht vankomicinë–imipenem), manitoli dhe transfuzionet identifikojnë rrezik të lartë per DRA. Integrimi i strategjive reno - protektive në terapia e mire mund të ulë rriskun per DRA dhe vdekshmërinë.

Fjalë kyçe: DRA, trauma, inotrop, transfuzione, nefrotoksik, laktak.

FREKUENCA E ZEMRËS NË QETËSI DHE TENSIONI ARTERIAL NË LIDHSHMËRI ME AKTIVITETIN FIZIK TEK ADOLESHENTËT.

Meriton Bytyqi

Abstrakt
Hyrje: Frekuenca e zemrës është pasqyra e punës së zemrës në arteriet periferike, është numri i herëve që zemra juaj rreh në minutë. Matet me prekje në ato vende që kanë bazën e fortë, ashtin. Frekuenca e çdo kujt është e ndryshme dhe ndryshon me moshën, si dhe nga aktiviteti fizik, ndjenjat e sigurisë dhe emocionet. Tensioni arterial është presioni që gjaku ushtron tek muret e enëve të gjakut, dhe varet nga ritmi dhe nga forca e tkurrjes së zemrës, nga volumi i gjakut dhe nga rezistenca e enëve të gjakut që kundërshtojnë fluksin e gjakut.

Qëllimi: Qëllimi i këtij hulumtimi klinik është që të bëhet përcaktimi i frekuencës së zemrës në qetësi dhe tensionit arterial në lidhmëri me aktivitetin fizik tek adoleshentët, poashtu dhe vlerësimi i ndikimit të faktorëve si mosha, pesha trupore, lartësia trupore, BMI dhe aktiviteti fizik në frekuencën e zemrës dhe tensionin arterial.
Metodologjia: Punimi është i tipit prospektiv, kohort transversal me komponente descriptive dhe analitike. Në punim janë të përfshirë nxënësit e shkollës së mesme të Mjekësisë në Prizren përkatësisht nxënës të klasave X dhe XI të grupmoshës 15 - 17 vjeç.
Rezultate: Mosha mesatare e nxënësve ishte 16 vjeç. Mesatarja e peshës trupore, lartësisë trupore dhe BMI - së ishin më të mëdha tek djemtë se tek vajzat. Pesha trupore, BMI - ja dhe aktiviteti fizik kishin ndikim të dukshëm në frekuencën e zemrës në qetësi dhe tensionin arterial. Ndikimi i BMI - së në FZQ: r=0. 56 dhe në TA: r=0. 62, ishte i moderuar. Ndikimi i AF në FZQ: r= - 0. 31 dhe në TA: r= - 0. 85, ishte negativ. Ndërsa vlera mesatare e rrahjeve të zemrës në qetësi ishte më e shpejtë për katër rrahje në minutë tek vajzat. Vlerat mesatare të TAS dhe TAD ishin pothuajse të njëjta në të dy gjinitë pa ndonjë dallim signifikant.
Përfundime: Gjinia, pesha trupore, BMI - ja dhe aktiviteti fizik kanë ndikim në frekuencën e zemrës në qetësi dhe në tensionin arterial. BMI e lartë që përkon me moshë dhe aktiviteti fizik i ulët ndikojnë në rritjen e FZQ dhe TA. Ndërsa BMI normale dhe aktiviteti fizik i duhur tregojnë ndikim në mundësinë për një jetë më të shëndetshme.

Fjalë kyçe: Frekuenca e zemrës, tension arterial, aktivitet fizik.

VARIKOCELA DHE KUJDESI INFERMIEROR.

Mexhit Marku

Abstrakt
Qëllimi: Varikocela është një patologji me incidence dhe prevalencë të madhe në popullatë, e cila haset kryesisht në grupmoshën e adoleshencës dhe tek të rinjtë. Ajo ndikon negativisht në funksionin e sistemit riprodhues (funksionin e testikujve). Si sëmundje, ajo studiohet nga dy shkenca të mjekësisë: urologjia dhe gjinekologjia, sepse ekziston një debat i konsiderueshëm mbi efektet e mostrajtimit të saj dhe ndikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë në fertilitetin e ardhshëm. Varikocela është një lezion vaskular që karakterizohet nga zgjerimi dhe rrotullimi i venave spermatike. Rreth 15% e meshkujve të rritur kanë varikocele, por incidenca mund të shkojë deri në 40% tek pacientët që shkojnë në klinikat e infertilitetit dhe në 80% tek ata me infertilitet dytësor.
Metodologjia: Metoda kërkimore u bazua në rishikimin përshkrues të literaturës, si vendase ashtu edhe të huaj, si dhe në përvojat tona në punën e përditshme.
Qëllimi: Është analizimi dhe përmbledhja e informacionit të detajuar, duke nxjerrë në pah të rejat më të fundit, me qëllim rritjen e edukimit shëndetësor në popullatë, si dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit mjekësor për diagnostikimin dhe trajtimin e patologjive të tilla (varikocelës).
Konkluzione: Personeli shëndetësor përgjegjës është një element i rëndësishëm dhe luan një rol kyç për të siguruar një kujdes sa më cilësor dhe edukim shëndetësor për pacientët me risk të lartë për zhvillimin e kësaj sëmundjeje. Kujdesi shëndetësor dhe kryesisht ai infermieror, mbetet një prioritet për përmirësimin e shëndetit fizik dhe psikologjik të tyre. Nga evidentimi gjatë trajtimeve të këtyre patologjive (varikocelave) shihet se informacioni mbi diagnostikimin dhe prevalencën nuk është i mjaftueshëm. Konkluzionet në këto raste kanë të bëjnë me shtimin e informacionit për përgatitjen, këshillimin, trajtimin dhe mbështetjen emocionale të pacientëve.

Fjalë kyçe: Varikocele, infertilitet, edukim shëndetësor

KUJDESI INFERMIEROR PËR NJË PACIENT ME KOLECISTOLITIAZË TË TRAJTUAR ME KIRURGJI LAPAROSKOPIKE - STUDIM RASTI.

Lecturer. Mr. sc. Phd. can. Mexhit Mustafa[1], Mirlinda Mustafa[2]
[1]*Alma Mater Europaea Campus College "Rezonanca", Kosovo;*
[2]*Nurse in the surgical ward Spitali Sheikh Zayed - Vushtrri*

Abstrakt

Hyrje: Kolecistiti emfizematoz është një gjendje e rrallë, e shkaktuar nga ishemia e murit të kolecistës dhe nga proliferimi dytësor i bakterëve që prodhojnë gaz. Patofiziologjia dhe epidemiologjia e kësaj sëmundjeje dallojnë nga ato të kolecistitit akut të lidhur me gurët e tëmthit. Ky raport paraqet një rast të kolecistitit emfizematoz, i cili është trajtuar me sukses përmes kirurgjisë laparoskopike.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të evidentojë dhe analizojë problemet infermierore të një pacienti të diagnostikuar me kolecistolitiazë dhe të trajtuar me ndërhyrje kirurgjikale laparoskopike.

Metodat dhe materiale: Studimi është realizuar si hulumtim i rastit individual, duke përdorur metoda kërkimore si vëzhgimi, intervista infermierore, analiza e dokumentacionit dhe matja. Instrumentet e tjera të përdorura në studim përfshijnë: Historinë dhe Kontroll listën e Kujdesit Infermieror Individual, Shkallën Vizuale Analoge (VAS) për vlerësimin e dhimbjes dhe Pikëzimin Apfel për vlerësimin e rrezikut nga të përzierat dhe të vjellat postoperatore.

Rezultate: U krye me sukses një kolecistektomi laparoskopike emergjente, gjatë së cilës u vu re praninë e flluskave gazi në murin e fshikëzës së tëmthit. Kolangiografia intraoperative nuk tregoi gurë ose bllokim të kanaleve biliare. Pacienti pati një rikuperim të qetë dhe pa komplikime postoperatore, pa nevojë për kujdes intensiv. Analiza histopatologjike tregoi nekrozë infarktive të plotë të murit të fshikëzës së tëmthit, ndërsa kultura bakteriale identifikoi Clostridium perfringens.

Përfundime: Ky rast përfaqëson një shembull tipik të kolecistitit emfizematoz, të trajtuar me sukses përmes qasjes laparoskopike. Rezultatet mbështesin gjetjet e studimeve të tjera, të cilat sugjerojnë se kjo gjendje mund të menaxhohet në mënyrë të sigurt dhe efektive me kirurgji laparoskopike.

Fjalë kyçe: kujdes infermieror, kirurgji laparoskopike, dhimbje postoperatore, kolecistolitiazë.

PEELING KIMIK SI METODË EFIKASE NË TRAJTIMIN E AKNEVE AKTIVE DHE SHENJAVE POST AKNE.

Migena Gega

Abstrakt

Hyrje: Peeling kimik është një procedurë e përdorur gjerësisht në trajtimin e akneve dhe shenjave post tyre. Ai shkakton zhveshje të kontrolluar të një pjese apo të gjithë epidermës, me ose pa dermën, duke çuar në eksfoliacion dhe heqje të lezioneve sipërfaqësore, duke dhënë më pas rigjenerimin e indit të ri epidermal dhe dermal. Agjentët më të përdorshëm në peeling kimik janë acidi salicilik, glikolik, laktik, mandelik, piruvik, solucioni Jessner, acidi trikloroacetik dhe fenoli. Përzgjedhja e një peeling kimik bëhet në bazë të tipit të lëkurës së pacientit, fazës së aktivitetit të akneve dhe tipit të cikatriceve dhe shenjave post akne. Në shenjat post akne, peeling kimik mund të kombinohet edhe me procedura të tjera për të arritur rezultate sa më optimale.

Qëllimi: Në këtë review do të bëhet një analizë bashkëkohore e llojeve të ndryshme të peeling kimik të përshtatshme për përdorim dermatologjik.

Metoda: Në këtë review krahasuese u përdorën kërkime nga Cochrane Library, PubMed, dhe MEDLINE për të identifikuar literaturën relevante të agjentëve më të përdorshëm për peeling kimik.

Rezultate dhe konkluzione: Të gjithë agjentët e përdorur për peeling kimik, kur përdoren për indikacionin e duhur dhe me teknikën e përshtatshme, kanë treguar efikasitet të kënaqshëm dhe mbeten metoda me kosto efektive në praktikën e përditshme dermatologjike.

Fjalë kyçe: Peeling kimik, trikloroacetik peel, glikolik peel, photoageing, wrinkles, lentigo, melasma.

JACCOUD'S SYNDROME: NJË ARTROPATI DEFORMUESE JO EROZIVE NË SËMUNDJET SISTEMIKE REUMATIKE.

Migena Kacbufi, Dr. Sh. M. Ervin Rapushi, Anastasio Kolaci, Florid Zenelaj
Shërbimi i Reumatologjisë, QSUT

Abstrakt

Hyrje: Jaccoud's Syndrome është një artropati e rrallë, kronike dhe deformuese, por jo erozive, që rezulton nga inflamacioni i përsëritur periartikular i cili shkakton laksitet te aparatit ligamentar mbi të cilat veprojnë forcat mekanike nga imbalanca muskulo - tendinoze. E përshkruar fillimisht pas etheve reumatizmale, sot ajo vërehet më shpesh në lupus eritematoz sistemik (LES) dhe në sëmundje të tjera të indit lidhor. Karakteristikë dalluese është deformimi i theksuar i artikulacioneve në mungesë të erozioneve, shpesh duke imituar artritin reumatoid.

Qëllimi: Të përshkruhen mekanizmat patofiziologjik themelor dhe të përmblidhen sëmundjet sistemike me të cilat shoqërohet, duke theksuar rëndësinë diagnostike dhe terapeutike.

Metoda dhe Rezultate: Rishikimi i literaturës aktuale dhe vëzhgimet klinike theksojnë një mekanizëm të veçantë patofiziologjik: inflamacioni i indit lidhor periartikular në terren te patologjisë sistemike dobëson tendinet, ligamentet dhe kapsulën artikulare të artikulacioneve pa shkaktuar sinovit destruktiv tipik të artritit reumatoid. Citokinat dhe metaloproteinazat e MEC nxisin degradimin e kolagjenit, duke çuar në laksitet kapsular me ritme të ulta te rigjenerimit. Pasi vendoset laksiteti ligamentar dhe tendinoz, veprimi i forcave mekanike e mban në vazhdimësi deformimin edhe pas qetësimit të inflamacionit. Ky çekuilibër shkakton devijimin ulnar të tendinave ekstensorë në MCP, pamjaftueshmërinë e pllakës volare që çon në deformime "swan neck" dhe "boutonnière". Klinikisht, deformimet prekin kryesisht duart, por mund të përfshijnë edhe këmbët apo artikulacione të tjera, duke reflektuar paternin sistemik. Diagnostikimi bazohet në gjetjet klinike dhe imazherike që tregon deformime te reduktueshme pa prani te erozione, ruajtje të hapësirave artikulare në radiografi, ndërsa ekografia po fiton një rol në identifikimin e hershëm të inflamacionit tendinoz dhe ndryshimeve të indeve të buta. Trajtimi përqendrohet në kontrollin e sëmundjes bazë sistemike, lehtësimin simptomatik, fizioterapinë dhe përdorimin e mbajtëseve ortopedike, ndërsa ndërhyrja kirurgjikale rezervuar për deformimet fikse ose të avancuara.

Përfundime: Jaccoud's Syndrome përfaqëson ndërveprimin mes aktivizimit te sisemit imunitar sistemik dhe ç'ekuilibrit mekanik lokal. Njohja e natyrës së saj jo erozive është thelbësore për ta dalluar nga artriti reumatoid, për të shmangur trajtime agresive të panevojshme dhe për të orientuar terapinë drejt ruajtjes së funksionit artikular dhe menaxhimit të sëmundjes bazë.

Fjalë kyçe: Jaccoud's Syndrome, artropati jo erozive, laksitet ligamentar, inflamacion periartikular, sëmundje të indit lidhor, LES.

LIDHJA KOMPLEKSE MIDIS AUTISMIT DHE GJENIT MTHFR.

Migena Kika
Et Al - Kids Health Clinic

Abstrakt

Hyrje: Evidencat tregojnë një lidhje të ngushtë mes mutacioneve në gjenin MTHFR dhe një rreziku të rritur për Çrregullime Të Spektrit të Autismit. Mutacionet në gjenin MTHFR mund të çojnë në një aktivitet të reduktuar enzimatik që ndikojnë në metabolizmin e folateve. Methylenetetrahydrofolate reductase është një enzimë e rëndësishme që lidhet me shumë çrregullime neuropsikiatrike komplekse.

Metodologjia: Në literaturë mjekësore mund të gjenden nëpërmjet motorëve të kërkimit rreth 20 artikuj që lidhin mutacionet e gjenit MTHFR dhe CSA.

Rezultate: Një pjesë e studimeve sugjerojnë një prevalencë më të lartë të polimorfizmave të MTHFR në individët me autisëm, si psh C677T dhe A1298C. Këto variacione gjenetike çojnë në aktivitet të reduktuar të enzimës MTHFR, duke ndikuar në proceset metiluese në organizëm. Dëmtimi i procesit të metilimit si pasojë e varianteve të MTHFR mund të jete faktor kontribues në sfidat që shihen në individet me autisëm. Procesi disfunksional i metilimit ndikon në ekspresionin e ADN gjatë zhvillimit neurologjik. Ndikim ka gjithashtu në sintezën e neurotransmetuesve si serotonina dhe dopamina, të cilat ndikojnë në sjellje dhe aftësitë konjtive në individët me autisëm. Dëmtimi i procesit të metilimit kontribuon në rritjen e inflamacionit në tru.

Përfundime: Pjesa më e madhe e evidencave sugjeron një lidhje mes variacioneve të MTHFR dhe autismit, por jo lidhje direkte shkakësore. Sido nuk përjashtohet si një faktor kontribues potencial i klinikës në disa individë. Janë të nevojshme studime të tjera për të sqaruar mekanizmat e sakta të ndikimit në autisëm si dhe nëse ka indikacione në përdorimin e leukovorinës.

Fjalë kyçe: autismi, MTHFR, leukovorina.

MENINGITI BAKTERIAL, NJË KOMPLIKACION NEUROLOGJIK I RËNDESISHËM I PACIENTËVE TË HEMODIALIZUAR.

M. Qato, N. Como, E. Qyra, E. Puca, E. Meta, A. Yzeiraj

Abstrakt

Hyrje: Komplikacionet neurologjike hasen shpesh tek pacientët e hemodializuar. Këto komplikacione në pjesën më të madhe të rasteve rezultojnë për shkak të ndryshimeve metabolike, duke manifestuar të ashtuquajturën encefalopati uremike. Manifestime të tjera të rëndësishme janë ateroskleroza, aksidentet cerebrovaskulare si dhe neuropatia periferike, komplikacione këto të cilat rrisin ndjeshëm morbiditetin dhe vdekshmërinë. Gjithsesi, rritja e jetëgjatësisë së pacientëve të hemodializuar sot na jep mundësinë të shohim edhe një spektër klinik tërësisht ndryshe, sikurse janë neuroinfeksionet, me meningitet bakterial si përfaqësuesin më prevalent.

Paraqitje rasti: Pacientja F. M. , subjekt femër, 79 vjeç, hospitalizohet në Shërbimin e Sëmundjeve Infektive në datë 05 / 09 / 2025 me diagnozë klinike: Meningit akut bakterial në subjekt të hemodializuar. Në shtrim referohet një histori 3 - ditore me temperaturë deri 39 gradë, vështirësi në artikulimin e fjalëve, vështirësi në frymëmarrje, dobësi e theksuar trupore. Në antecedentët e pacientes evidentohen si sëmundje bashkëshoqëruese: HTA; DMellitus tip 2, SRK nën hemodializë prej 2 muajsh. Realizohen konsultat e para nga mjeku neurolog dhe infektolog dhe ekzaminimet e para imazherike evidentojnë: Atrofi kortikale cerebrale, pa likuid të freskët intrakranial. Ndryshime hipoksike kronike. Pa të dhëna për TEP central. Raport kardio - torakal i rritur. Aorta ascendente me diametër 8 mm. Likuid minimal perikardial. Likuid pleural dexter me trashësi 28 mm me atelektazë shoqëruese. Pa lezione evidente akute në prerjet abdominale të përftuara. Ndërkohë, gjatë ekzaminimit objektiv evidentohet hemorragji gastrointestinal në trajtën e melenave, duke evokuar konsultën me gastrohepatologun dhe terapinë pasuese ndihmëse. Pas hospitalizimit në Spitalin Infektiv, realizohet punksioni lumbar i cili rezulton me 720 qeliza. Fillon trajtimi i neuroinfeksionit sipas protokollit duke asistuar pacienten ndërkohë me seancë hemodialize sipas rekomandimeve të nefrologut. Ecuria e pacientes rezultoi efikase në trajtimin e neuroinfeksionit, duke evidentuar përmirësime të ekzaminimeve laboratorike sa i përket gjakut periferik, markuesve inflamatorë, kulturave mikrobiologjike. Ekzaminimi i likuorit cerebrospinal pas 10 ditësh terapi evidentoi 63 qeliza.

Konkluzione: Meningiti bakterial është një komplikacion që meriton vëmendje të veçantë, përpos paraqitjes jo gjithmonë klasike në subjektet e hemodializuar. Për këtë arsye, çdo rast i shoqëruar me bakteremi meriton vlerësimin e duhur edhe të sistemit nervor qendror dhe evokon terapinë antimikrobike empirike në mënyrë që të përmirësohet prognoza klinike.

Fjalë kyçe: meningit, bakterial, komplikacione, neurologjike, lezione.

ENDOKARDITI BIVALVULAR (PARAQITJE RASTI).

Migena Qato, Esta Kokla

Shërbimi i Sëmundjeve Infektive, QSU "Nënë Tereza"

Abstrakt

Hyrje: Endokarditi infektiv është një patologji e cila persiston të jetë shkak i konsiderueshëm morbiditeti dhe mortaliteti, pavarësisht avantazheve të reja në menaxhim dhe profilaksi. Përpos ndryshimeve dinamike që paraqet organizmi infektues, si dhe mekanizmave mbrojtës të hostit, diagnoza vazhdon të jetë e vështirë gjatë fazave të hershme të sëmundjes dhe shpesh vonohet derisa të jetë i pranishëm një infeksion serioz.

Paraqitje rasti: Një subjekt femër 73 - vjeçare u paraqit në urgjencë më 14. 07. 2025 me ankesat: lodhje, dobësi trupore, temperaturë deri 38. 5 gradë. Referon se prej 4 javësh nga hospitalizimi paraqitej me këto simptoma. Në datë 16. 07. 2025, si pjesë e protokollit të investigimit të sindromit febril akut, realizohet Eko Kardiake, ku evidentohet formacion në v. Ao me sipërfaqe 1. 3 cm^2 dhe prolaps i fl. anterior të valvulës mitrale. Në datë 17. 07. 2025, konsulta me mjekun kardiokirurg vendosi vazhdimin e antibiotikoterapisë sipas protokollit të Endokarditit Infektiv deri në stabilizimin e shenjave klinike dhe markuesve inflamatorë. Antibiotikoterapia filloi si empirike e më pas u targetua bazuar në hemokulturën pozitive dhe antibiogramën shoqëruese. Si pasojë e kësaj terapie u evidentua një përmirësim i ndjeshëm klinik i pacientes, si dhe një reduktim i parametrave inflamatorë. Në këto kushte realizohet një eko rikontrolli transezofageale në dt. 24. 07. 2025, në të cilën evidentohet vegjetacion 1 cm në valvulën aortale; v. mitrale miksomatoze me prolaps të lehtë të fletëve, si dhe vegjetacion me dimension 1 cm në fletën anteriore të v. trikuspidale. Në këto kushte, pacientja i nënshtrohet një rivlerësimi të mjekut kardiokirurg, duke paraqitur një urgjencë tanimë të mirëfilltë kirurgjikale. Në datë 05. 08. 2025, pacientja transferohet në Shërbimin e Kardiologjisë dhe një ditë më pas i nënshtrohet interventit: ZVA me protezë biologjike nr. 21, plastike e valvulës mitrale me unazë Edwards nr. 28, dhe rezekim i masës në valvulën trikuspidale më datë 08. 08. 2025. Ecuria postoperatore evidentoi prognozë të rezervuar.
Konkluzione: Endokarditet multivalvulare përfaqësojnë një entitet klinik me rëndësi të veçantë. Ecuria e tyre dhe prognoza përfaqësojnë një sfidë përpos diagnostikimit dhe trajtimit në kohë. Duhet të theksohet dhe nënvizohet roli i ekipit ndërprofesional në menaxhimin e pacientëve për të arritur rezultate sa më optimale.

Fjalë kyçe: Endokarditi bivalvular**,** infektiv, morbiditet, mortalitet.

UDHËZUESIT BASHKËKOHORË EUROPIANË NË TRAJTIMIN E DERMATITIT ATOPIK NË MOSHAT PEDIATRIKE.

Migena Vargu[1], Sabina Dedej[2], Petrit Vargu[2], Anxhela Nisi[1], Samuele Vargu[2]
[1]*Shërbimi i Dermatologjisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri*
[2]*Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri*

Abstrakt
Hyrje: Dermatiti atopik është një sëmundje inflamatore kronike, e karakterizuar nga kruarja, inflamacioni dhe përkeqësime të përsëritura. Menaxhimi i saj kërkon një qasje të integruar që përfshin si terapinë lokale, ashtu edhe sistemike, në varësi të ashpërsisë së sëmundjes. Qëllimi ynë është të bëjmë të njohur qasjet më të fundit nga Udhëzimi EuroGuiDerm, i zhvilluar nga ekspertë evropianë të dermatologjisë, i cili synon të standardizojë trajtimin bazuar në evidencë shkencore dhe konsensus klinik.
Materiale dhe metoda: Në këtë prezantim analizojmë të dhënat nga studimi më i fundit nga Shoqata Evopiane e Dermatologjisë sipas një procesi që përfshin studime të randomizuara e meta - analiza, si dhe paraqesim raste nga përvoja jonë klinike.
Rezultate: Në trajtimin lokal, baza mbetet përdorimi i emolientëve për rikthimin e barrierës epidermale dhe kortikosteroideve topike për kontrollin e inflamacionit. Inhibitorët topikë të kalcineurinës (tacrolimus, pimecrolimus) rekomandohen për zonat e ndjeshme ose përdorim afatgjatë pa rrezik atrofie. Për rastet e moderuara dhe të rënda që nuk përgjigjen ndaj trajtimit lokal, rekomandohen terapitë sistemike: ciklosporina si zgjedhja e parë, e ndjekur nga metotreksati, azatioprina dhe mykofenolati për përdorim afatgjatë. Terapitë e reja, si dupilumabi, tralokinumabi dhe inhibitorët e JAK (baricitinib, abrocitinib, upadacitinib), kanë treguar përmirësim të shpejtë të simptomave dhe reduktim të relapsit, me një profil sigurie të mirë të monitoruar.
Konkluzione: Trajtimi i dermatitit atopik mbështetet në rëndësinë e kombinimit racional të trajtimeve lokale dhe sistemike, bazuar në shkallën e sëmundjes dhe përgjigjen individuale. Qasja e personalizuar, mbështetur nga monitorim i rregullt klinik, siguron kontroll të qëndrueshëm të simptomave, ulje të përdorimit të kortikosteroideve sistemike dhe përmirësim të ndjeshëm të cilësisë së jetës së pacientëve me dermatit atopik.

Fjalë kyçe: Dermatiti atopik, sëmundje inflamatore kronike, mosha pediatrike.

SINDROMA SAPHO – RAPORT RASTI.

Anxhela Nisi[2], Migena Vargu[2], Petrit Vargu[3], Stesi Bani[4], Sabina Dedej[4], Samuele Vargu[5]
[1]*Rezidente, Klinika e Dermatologjisë, QSUT "Nënë Tereza"*
[2]*Dermatologe–Venereologe, Spitali Universitar "Nënë Tereza"*
[3]*Mjek urgjence, Lektor, Departamenti i Kirurgjisë, Spitali Universitar "Nënë Tereza"*
[4]*Rezidente, Klinika e Dermatologjisë, QSUT "Nënë Tereza"*
[5]*Dermatologe*

Abstrakt
Hyrje: Sindroma SAPHO (Sinoviti, Akne, Pustulozë, Hiperostozë, Osteit) është një çrregullim autoinflamator i rrallë që kombinon manifestime osteoartikulare dhe dermatologjike. Prezantimi i ndryshëm klinik shpesh e vonon diagnostikimin.
Paraqitja e rastit: Raportohet rasti i një pacienteje 19 - vjeçare që paraqitej me dhimbje kronike në pjesën e përparme të kraharorit, lezione të lëkurës me formë aknesh dhe dhimbje në pjesën lumbosakrale. Imazheria tregoi hiperostozë dhe osteit të artikulacionit sternoklavikular.
Menaxhimi dhe rezultate: Pacientja u trajtua fillimisht me antiinflamatorë josteroidë (NSAIDs), izotretinoin dhe antibiotikë, duke arritur lehtësim të pjesshëm të simptomave. Për shkak të dhimbjeve të vazhdueshme dhe shpërthimeve të lëkurës, u fillua terapi me metotreksat, që solli përmirësim të dukshëm klinik.
Përfundime: Ky rast thekson vështirësitë diagnostikuese të sindromës SAPHO dhe nënvizon rëndësinë e njohjes së hershme dhe të strategjive të trajtimit të personalizuara për përmirësimin e ecurisë së pacientit.

Fjalë kyçe: Sindroma SAPHO, çrregullim autoinflamator, manifestime osteoartikulare, manifestime dermatologjike.

PËRDORIMI I SUBSTANCAVE NË BURGJET E KOSOVËS: NJË ANALIZË KRAHASUESE ME POPULLATËN E PËRGJITHSHME NË KOSOVË DHE SHQIPËRI.

Prof Asoc. Dr. Milazim Gjocaj, MD, MSc, PhD[1, 2], Dr. Shqipe Ukelli, MSc[1, 2], Dr. Argjira Veseli[1], Prof. Asoc. Dr. Shefqet Mrasori, DD, MSc, PhD[1], Mr. Granit Shatri[2], Dr. Hedije Maloku[2], Mrs. Adelina Rexhepi[2], Mrs. Nora Salihaj[2], Mr. Ph Vala Prekazi[2], Mr. Ph Astrit Rexhaj[2], Mrs. Shukrane Novobërdaliu[2].
[1]*Alma Mater Europa Campus College "Rezonanca" në Prishtinë*
[2]*Ministria e Shëndetësisë në Kosovë*

Abstrakt
Hyrje: Përdorimi i substancave në burgje paraqet një sfidë të ndërlikuar për sistemet shëndetësore dhe të drejtësisë penale, veçanërisht në shoqëritë në tranzicion si Kosova. Me gjithë shqetësimet në rritje, të dhënat për përdorimin e drogës, alkoolit dhe duhanit te të burgosurit në Ballkanin Perëndimor janë të kufizuara.
Qëllimi: Të vlerësohet prevalenca dhe modelet e përdorimit të drogës, alkoolit dhe duhanit në mesin e të burgosurve në Kosovë, dhe të krahasohen gjetjet me popullatat e përgjithshme të Kosovës dhe Shqipërisë.
Metodologjia: U realizua një studim përshkrues me pyetësorë të strukturuar, të administruar në një kampion përfaqësues të të burgosurve në institucionet korrektuese të Kosovës. Të dhënat u krahasuan me sondazhe kombëtare të shëndetit dhe raporte për përdorimin e substancave në popullatën e përgjithshme në Kosovë dhe Shqipëri.
Rezultate: Të burgosurit raportuan norma dukshëm më të larta të përdorimit të drogës (sidomos kanabisit, heroinës dhe substancave sintetike) dhe duhanit krahasuar me popullatën e përgjithshme. Përdorimi i alkoolit ishte më i ulët në burg, kryesisht për shkak të kufizimeve institucionale. Krahasimet me Shqipërinë zbuluan ngjashmëri rajonale në përdorimin e duhanit, por dallime në preferencat dhe modelet e përdorimit të drogës, të ndikuara nga faktorë kulturorë dhe të ndryshimeve të rëndit shoqëror.. Kosova dhe Shqipëria kanë norma të larta përdorimi të duhanit tek të rriturit (~25. 7% dhe 22. 5%), afër mesatares evropiane, me konsum më të madh te burrat. Përdorimi i duhanit tek adoleshentët është më i lartë në Shqipëri (~15. 3%) sesa në Kosovë (~10. 4%). Në Kosovë, shumica e duhanpirësve janë përdorues ditorë, duke treguar varësi të lartë. Përdorimi i drogave është i konsiderueshëm në Kosovë (~40, 000 përdorues), me kanabisin si substancë kryesore, ndërsa në Shqipëri është më i përhapur përdorimi i kokainës. Konsumi i alkoolit është i moderuar në të dy vendet dhe më i ulët se mesatarja evropiane, ndikuar nga faktorët kulturorë. Këto tendenca tregojnë nevojën për ndërhyrje të synuara në shëndetin publik. Përcjellja e indikatorëve në burgjet e Kosovës gjatë periudhës 2014–2024, bazuar në

hulumtimin e kryer gjatë vizitës së parë mjekësore në momentin e pranimit të të burgosurve, tregon këto rezultate: Pirja e duhanit është e pranishme te deri në 69% e të burgosurve, me një trend linear në rritje. Përdorimi i alkoolit shënon një përqindje prej 7%, duke treguar një trend të lehtë në rënie. Ndërsa përdorimi i drogave arrin në 15%, me një trend të vazhdueshëm rritës gjatë periudhës së analizuar.
Përfundime: Nivelet e larta të përdorimit të substancave në burgjet e Kosovës ngrenë nevojën urgjente për ndërhyrje të koordinuara, duke përfshirë programet e reduktimit të dëmit dhe trajtimit të varësisë nga droga, pasi kjo pasqyron situatën reale në vend. Integrimi i shërbimeve shëndetësore të burgjeve me sistemin shëndetësor publik, përmes politikave, strategjive dhe aktiviteteve të përbashkëta, është thelbësor për adresimin efektiv të dëmeve të lidhura me substancat gjatë periudhës së burgimit dhe pas lirimit.

Fjalë kyçe: Duhani, alkooli, droga, burgu, trendi, varësia.

FAKTORËT PARASHIKUES DHE REZULTATET KLINIKE TË TRANSPLANTIT TË LËKURËS SË SHTRESËZUAR (MESHED) TEK PACIENTËT ME DJEGIE KRITIKE.

Milosao Bazo, Gjergji Belba
Universiteti i Mjekësisë, Fakulteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri
Departamenti i Kirurgjisë, Shërbimi i Djegieve dhe Kirurgjisë Plastike

Abstrakt
Hyrje: Transplantet e lëkurës së pjesshme (STSG) të përshkuara (meshed) përdoren gjerësisht në menaxhimin e djegieve të mëdha dhe plagëve traumatike komplekse, veçanërisht kur zonat dhuruese janë të kufizuara. Në sisteme shëndetësore me burime të kufizuara, vendimmarrja klinike duhet të balancojë kohën kirurgjikale, stabilitetin e pacientit dhe teknikën e graftimit për të optimizuar rezultatet. Kjo studim analizon indikacionet klinike, rezultatet dhe faktorët parashikues për përdorimin e graftit të përshkuar në një njësi të terapisë intensive për djegiet.
Metodologjia: Është kryer një rishikim retrospektiv mbi 435 pacientë të shtruar në Njësinë e Kujdesit Intensiv të Shërbimit të Djegieve në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" në Tiranë, Shqipëri, gjatë periudhës 2021–2023. Janë mbledhur të dhëna demografike të pacientëve, karakteristikat e dëmtimit dhe të dhënat kirurgjikale. Analizat statistikore përfshinë vlerësimin me kurbën ROC dhe regresionin logjistik për të identifikuar parashikuesit e aplikimit të STSG të përshkuar.
Rezultate: Nga 435 pacientët, 228 (52. 4%) iu nënshtruan ndërhyrjes kirurgjikale, nga të cilët 45 (20%) morën STSG të përshkuar. Këta pacientë ishin dukshëm më të moshuar, kishin përqindje më të lartë të sipërfaqes trupore të djegur (TBSA), më shumë dëmtime të trashësisë së plotë, dhe qëndrime më të gjata spitalore. Vlerësimet ABSI ishin ndjeshëm më të larta në grupin me graft të përshkuar (mesatarja 8. 04 krahasuar me 5. 77, p<0. 001). Një vlerë ABSI >7. 5 u identifikua si prag parashikues për përdorimin e graftit të përshkuar (AUC=0. 753, p<0. 000). Septicemia dhe mosha rezultuan si faktorë të pavarur parashikues në analizën multifaktoriale.
Përfundime: Transplanti i përshkuar i lëkurës është një teknikë kirurgjikale thelbësore për pacientët me djegie të rënda dhe zona të kufizuara dhuruese, veçanërisht në prani të djegieve me trashësi të plotë, sepsis ose përfshirje të madhe të TBSA. Pikëzimi ABSI mund të udhëheqë planifikimin kirurgjikal, sidomos në ambientet me burime të kufizuara, ku qasja në zëvendësimin e lëkurës është e limituar. Përdorimi strategjik i eskarotomisë i ndjekur nga transplante të etapizuara kontribuon në mbijetesë të përmirësuar tek pacientët me rrezik të lartë.

Fjalë kyçe: STSG, NJKI, dëmtim, TBSA, djegie.

IMPAKTI I TRAUMËS PSIKOLOGJIKE TEK PACIENTET ME SËMUNDJE MALINJE DHE FAMILJARËT E TYRE.

Mimoza Dosti
Psikologe në fushën e shëndetit mendor

Abstrakt
Një nga interpretimet e Traumës psikologjike është "plagë e shpirtit", diçka që thyen dhe ndërhyn në jetën e një personi duke tronditur dhe mënyrën e të perjetuarit. Ekzistojnë forma të ndryshme të eksperiencave traumatike.

Në rastin e njohjes dhe diagnostifikimit me kancerin, individi dhe familjarët e tij përjetojnë një eksperiencë traumatike të madhe "T". Situata në të cilë ndodhet individi paraqitet e bashkëshoqëruar me një diagnozë e cila kërcë on integritetin fizik, psikologjik dhe social të personit. Njëkohësisht kjo diagnozë prek drejtpërsëdrejti në aspektin psiko - emocional dhe familjarët, të cilët bëhen njëkohësisht mbështetës të familjarit të tyre por dhe bashkëvuajtës jo në aspektin e vuajtjes fizike, por të asaj psiko - traumatike si pasojë e gjëndjes shëndetësore ku ndodhet familjari i tyre. Përjetimi I procesit traumatik duhet theksuar që është individual dhe merr forma të ndryshme përjetimi nga persona të ndryshëm. Në bazë të përjetimit të traumës lënë gjurmë dhe pasojat e saj, të cilat mund të jenë të lehta, mesatare dhe të rënda, me shtrirje në kohë përkatesisht afat shkurtër, afat mesme, afatgjatë. Njohja dhe pranimi i kësaj diagnoze është një nga fazat më të vështira për individin. Nën efektin e traumës ndodh që individi tashmë (pacient) të mos e pranojë këtë diagnozë. Mohimi është një nga fazat e përpunimit të traumës. Kjo fazë kthehet në një problematikë serioze për pacientin, sa më e gjatë të jetë periudha e mohimit të diagnozës akoma më e vështirë bëhet marrja e trajtimit të nevojshëm për pacientin. Kjo diagnozë sjell jo vetëm problematika fizike por dhe problematika psiko - traumatike të cilat i ndryshojnë rrjedhën e jetës individit. Kjo lloj traume e çorienton individin në drejtim të menduarit, të përjetuarit dhe të sjellurit. Ky përjetim nuk e ndihmon aspak situatën shëndetësore ku ndodhet personi. Përveç këtyre ajo çka i mundon më së shumti personat e traumatizuar nga sëmundja e kancerit është dhe pyetja "PSE", e cila ka të bëjë me përpunimin e ngjarjes traumatike, me mos gadishmërinë si dhe me paaftësinë e personit për ta pranuar atë që po i ndodh. Ky proçes vështirësohet si pasojë e mos integrimit të diagnozës brenda historisë së vet. Personi në mënyr të pavetëdishme e ngadalson këtë proçes dhe favorizon shfaqen e disa fazave të tjera si faza e stresit akut, faza e stresit post traumatik. Në situata të tilla individi tashmë pacient duhet të ndihmohet jo vetëm në drejtim te mirëqënies së shëndetit fizik por dhe në drejtim te mirqënies së shëndetit psikologjik. Në këto kushte pacientit i vijnë në ndihmë mjekët të cilët përmes protokolleve mjekësore kujdesen për shëndetin fizik të pacientit. Gjithashtu figurë e rëndesishme janë edhe psikologët, psikoterapeutët që ju ofrojnë ndihmë për të pranuar dhe për punuar përjetimin e këtij momenti të vecantë. Kjo realizohet duke treguar përkujdesjen e tyre profesionale në mbështetjen, këshillimin individual dhe familjar. Suporti që i ofrohet këtyre personave është vetë përpunimi i traumës. Ky bashkpunim dhe kjo përkujdesje ndihmon që rrjedha e përpunimit të traumës të jetë sa më e përshtatëshme për personin. Duke qënë e tillë dhe pritshmëria për një shëndet sa më të qëndrueshem fizik dhe psikologjik do të ishte sa më e lartë. Pacienti pa konflikt psikologjik dhe në gjendje paqeje me diagnozën përcjell tek të afërmit besimin dhe shpresën për të ardhmen.

Fjalë kyçe: pacient, sëmundje malinje, diagnose, kancer.

NDIKIMI I MENOPAUZËS NË PROFILIN LIPIDIK DHE RREZIKUN KARDIOVASKULAR TEK GRATË NË MOSHËN MBI 45 VJEÇ NË RRETHIN E ELBASANIT.

Mimoza Kuçi
Biolog Molekular ne Laboratorin Mjekesor "ALFA" Elbasan

Abstrakt
Qëllimi: Të vlerësohet ndikimi i menopauzës në ndryshimet e profilit lipidik dhe lidhja e tyre me rrezikun për sëmundje kardiovaskulare tek gratë e moshës mbi 45 vjeç.
Metodologjia: Në këtë studim u përfshinë 250 gra të moshës 45–64 vjeç, të ndara në dy grupe: premenopauzë (n=142; 45–52 vjeç) dhe postmenopauzë (n=108; 53–64 vjeç). Kjo ndarje u bazua në kriteret klinike të tranzicionit menopauzal, ku periudha 45–52 vjeç përfaqëson fazën pre - ose perimenopauzale, me prani të aktivitetit ovarian dhe niveleve ende të konsiderueshme të estrogjenit, ndërsa mbi moshën 53 vjeç shumica e grave janë në fazën postmenopauzale me më shumë se një vit amenorre dhe defiçit të qëndrueshëm të estrogjenit (WHO, 1996). Të gjitha pjesëmarrëset dhanë pëlqimin e informuar, plotësuan një pyetësor mbi faktorët e rrezikut dhe iu nënshtruan ekzaminimit të profilit lipidik në Laboratorin "Alfa". U kërkua dietë pa yndyrna për 16 orë para ekzaminimit dhe të qenurit esëll në ditën e marrjes së kampionit. Për vlerësimin sipas BMI, 22. 5% kishin peshë normale, 49. 4% ishin mbipeshë dhe 29. 1% obezë. Nga të dhënat e marra nga pyetësori i plotësuar rezultoi se 38. 8% kishin trashëgimi për sëmundje kardiovaskulare.
Rezultate: Gratë në postmenopauzë paraqitën nivele dukshëm më të larta të kolesterolit total (245 ± 83. 6 mg / dL), LDL - kolesterolit (164 ± 27. 8 mg / dL) dhe triglicerideve (189 ± 74. 3 mg / dL) krahasuar me grupin premenopauzë. Ulja e estrogjenit pas menopauzës ndikon në reduktimin e aktivitetit të receptorëve LDL në mëlçi, duke rritur qarkullimin e lipideve atherogjene (Carr, 2003). Analiza statistikore me SPSS tregoi një

ndikim të rëndësishëm të menopauzës në rritjen e kolesterolit total dhe LDL - kolesterolit (p< 0. 001). . **Përfundime**: Menopauza shoqërohet me rritje të ndjeshme të niveleve të profilit lipidik sidomos të kolesterolit total dhe HDL (kolesterolit te mire), kryesisht për shkak të defiçitit të estrogjenit, duke rritur rrezikun atherosklerotik dhe predispozitën për sëmundje kardiovaskulare (Rosano et al. , 2007). Identifikimi i hershëm dhe ndërhyrja me ndryshime të stilit të jetesës, dietë të shëndetshme dhe masa parandaluese mund të reduktojnë këtë rrezik në popullatën e studiuar.

Fjalë kyçe: menopauza, estrogjeni, profil lipidik, LDL, kolesterol, sëmundje kardiovaskulare.

NXEHTËSIA EKSTREME DHE SHËNDETI KARDIOVASKULAR.

Prof. Dr. Mimoza Lezha FESC[1], Dr. Gentjan Mehmeti[2]
[1]*UMT, Fakulteti i Mjekësise, Departamenti i Sëmundjeve të Zemrës dhe Enëve të Gjakut QSUNT. Shërbimi i Kardiologjisë*
[2]*QSUNT. Shërbimi i Kardiologjisë*

Abstrakt
Nxehtësia ekstreme është një kërcënim serioz, planetar për shëndetin njerëzor. Numri i njerëzve që ekspozohen ndaj nxehtësisë ekstreme po rritet në mënyrë eksponenciale pasojë e ndryshimeve klimaterike në të gjithë regjionet e botës. Nxehtësia ekstreme përkufizohet si një periudhë e një nxehtësie dhe lagështirë të lartë, ku temperatura është mbi 90°F, ose mbi 30–40°C për së paku 2–3 ditë. Pragjet e temperaturave që konsiderohen ekstreme nga perspektiva shëndetësore njerëzore janë 35, 37 dhe 40°C. Nëqoftëse trendi i rritjes së ngrohjes globale do të vazhdojë, atëherë numri i njerëzve me sëmundje kardiovaskulare të shkaktuara nga nxehtësia parashikohet të dyfishohet nga mesi i shekullit. WHO deklaron që nëse nuk merren masa, atëherë nga vitet 2030 parashikohet që çdo vit të vdesin rreth 250, 000 persona nga nxehtësia. Fiziologjikisht ekspozimi ndaj nxehtësisë nxit përgjigjet termorregullatore, vazodilatacionin kutan dhe djersitjen për të shpërndarë nxehtësinë e trupit. Këto përgjigje ndikojnë në sistemin kardiovaskular duke rritur Fc dhe debitin kardiak për të ruajtur presionin arterial i cili ka tendencë për t'u ulur. Dehidrimi nga djersitja mund të theksojë më tej tendencën për hipotension si pasojë e reduktimit të volumit plazmatik. Nxehtësia mund të rrisë kërkesat e zemrës për oksigjen, nxit dehidratimin, mpiksjen e gjakut, çrregullimin e elektroliteve që mund të kontribuojnë në sëmundjen kardiovaskulare. Kjo mund të përkeqësojë insuficiencën kardiake dhe të precipitojë sindromë koronare akute, infarkt miokardi, aritmi dhe insult cerebral që ndikojnë në vdekshmërinë nga këto shkaqe. Mekanizmat me të cilat shpjegohen eventet kardiovaskulare që ndodhin në terren të nxehtësisë përfshijnë: rritja e kërkesave të miokardit për oksigjen së bashku me hipovoleminë potenciale dhe vazodilatacionin koronar të dëmtuar në pacientët me sëmundje kardiovaskulare mund të çojë në një mospërputhje të furnizimit me kërkesën për oksigjen duke çuar në ishemi miokardiale. Për më tepër, ekspozimi ndaj nxehtësisë mund të çojë në dehidrim dhe çrregullim elektrolitesh, të cilat mund të nxisin aritmitë. Ka disa popullata të cilat janë më të predispozuara për t'u ndikuar nga efektet negative të saj. Të moshuarit kanë një aftësi të ulët për t'u djersitur dhe për të rregulluar temperaturën e trupit. Infantët dhe fëmijët e vegjël kanë sistemet termorregullatore të pazhvilluara mirë pra, tek të moshuarit veçanërisht dhe tek ata me sëmundje kardiovaskulare, përgjigjet adaptive ndaj të nxehtit shpesh janë të topitura dhe për pasojë kjo popullatë është më vulnerabël ndaj të nxehtit. Më të rrezikuar janë gjithashtu edhe punëtorët që punojnë jashtë, siç janë ata që punojnë në bujqësi, ndërtim dhe shërbimet e emergjencës si zjarrfikësit. Pacientët me sëmundje kardiovaskulare, sëmundje respiratore dhe diabet janë veçanërisht vulnerabël, sikurse edhe ata që marrin disa medikamente si: betabllokues, ACE inhibitorë, ARB, calcibllokues e diuretikë të cilët mund të ekzagjerojnë përgjigjen e trupit ndaj nxehtësisë. Gratë shtatzëna janë në rrezik më të lartë kur ekspozohen ndaj nxehtësisë ekstreme pasi ato mund të ndërlikohen me lindje të parakohshme dhe lindje me peshë të ulët. Krijimi i hapësirave të gjelbra, parqeve, mbjellja e pemëve, ose çatitë e gjelbra është provuar që ulin temperaturën 0, 9°C, prandaj strategjia e ftohjes qendrore publike ose individuale merr rëndësi të veçantë.

Fjalë kyçe: temperaturë, ACEI, ARB, sëmundje kardiovaskulare, djersitje, nxehtësi.

FIBRILACIONI ATRIAL: EPIDEMIOLOGJIA, MENAXHIMI KLINIK DHE PERSPEKTIVA E SË ARDHMES.

Mimoza Luzati
Kardiologe QSH 9

Abstrakt

Fibrilacioni atrial është çrregullimi më i shpeshte i ritmit i lidhur me sëmundjet kardiovaskulare. Prevalenca e tij është 2 - 4% e popullatës dhe rritet ndjeshëm me moshën si dhe është e lidhur ngushtë me faktorë si hipertensioni arterial, sëmundjet koronare, insuficienca kardiake, diabeti dhe obeziteti. FA përbën një faktor të rëndësishëm rreziku për komplikacione të rënda si tromboembolizmi sistemik dhe në veçanti aksidentet cerebro vaskulare.

Menaxhimi i FA përfshin 3 shtylla kryesore; kontrollin e ritmit dhe kontrollin e frekuencës kardiake, parandalimin e trombozave nëpërmjet antikoagulimit dhe trajtimin e sëmundjeve bashkëshoqëruese. Terapitë për kontrollin e ritmit përfshijnë kardioversionin nëpërmjet elektroshokut, konvertimin farmakologjik nëpërmjet antiaritmikëve dhe procedurat e ablacionit. Vlerësim i riskut tromboembolik bëhet nëpërmjet shkallës CHA2DS2VASc score.

Për shkak të prevalencës në rritje dhe barrës së lartë socio - ekonomike FA përfaqëson një sfidë të rëndësishme klinike që kërkon një qasje multidisiplinare për diagnostikimin, trajtimin dhe parandalimin e komplikacioneve.

Fjalë kyçe: fibrilacion atrial, sëmundje kardiovaskulare, diagnostikim.

GJENETIKA NË SËMUNDJET MITOKONDRIALE - NGA MEKANIZMAT MOLEKULARË NË QASJET TERAPEUTIKE.

Mimoza Mollanji

Abstrakt

Hyrje: Sëmundjet mitokondriale janë një grup sëmundjesh të rralla gjenetike të shkaktuara nga një mosfunksionim i mitokondrive, struktura brenda qelizave që prodhojnë energji. Kur mitokondritë nuk funksionojnë siç duhet, qelizat marrin më pak energji dhe kjo mund të dëmtojë funksionimin e disa organeve. Për shkak se mitokondritë janë të pranishme në pothuajse çdo qelizë të trupit, këto sëmundje mund të prekin organe të shumta në të njëjtën kohë. Ato që përfshihen më shumë janë ato që kanë nevojë për shumë energji për të funksionuar, si truri, nervat, zemra, muskujt, shikimi, dëgjimi, mëlçia, veshkat dhe pankreasi

Qëllimi: Të njohim sëmundjet mitokondriale.

Diskutime: Mosfunksionimi mitokondrial prek të gjitha nivelet e trupit, dhe shpesh është faza fillestare e sëmundjes. Mitokondri jo vetëm që regullon prodhimin e energjisë dhe riparimin strukturor, por gjithashtu vendos, bazuar në sinjalet kimike që mer, nëse qeliza duhet te vetëshkatërohet, nëpërmjet apoptozës. Ky mekanizëm qëndron në themel të mbrojtjes bazë nga kanceri. Sëmundjet mitokondriale e kanë origjinën nga mutacionet gjenetike që prekin gjenet e përfshira në prodhimin e energjisë. Një pjesë e këtyre gjeneve gjendet në ADN - në mitokondriale, e cila trashëgohet vetëm nga nëna. Edhe pse përmban vetëm 37 gjene, mutacionet në këtë pjesë të vogël të ADN - së mund të shkaktojnë sëmundje të transmetueshme nga nëna. Gjene të tjera gjenden në ADN - në bërthamore, të cilat ne i trashëgojmë nga të dy prindërit. Edhe këtu, mund të ndodhin mutacione që mund të komprometojnë funksionimin e mitokondrive. Sëmundjet mitokondriale konsiderohen multisistemike dhe klinikisht shumë të ndryshueshme. Kjo do të thotë se: Çdo person mund të shfaqë simptoma të ndryshme, madje edhe me të njëjtën diagnozë. Simptomat mund të shfaqen në çdo moshë, nga fëmijëria deri në moshën madhore. Ecuria e sëmundjes është shpesh e paparashikueshme: ajo mund të mbetet e qëndrueshme për vite ose të përkeqësohet më shpejt. Ky kompleksitet e bën të vështirë diagnozën dhe kërkon vlerësim të kujdesshëm nga specialistë. Sa të përhapura janë? Sëmundjet mitokondriale prekin afërsisht 1 në 4300 njerëz. Ato konsiderohen si sëmundje të rralla, por në fakt janë më të zakonshme se shumë sëmundje të tjera gjenetike. Falë përparimeve në gjenetikën molekulare dhe ndërgjegjësimit më të madh të mjekëve, këto sëmundje po diagnostikohen gjithnjë e më shpesh, megjithëse mbeten ende të vështira për t'u njohur.

Rezultatie: Diagnoza e sëmundjeve mitokondriale është komplekse dhe kërkon një qasje multidisiplinare, me përfshirjen e specialistëve të ndryshëm. Përdoren mjete të avancuara diagnostikuese, duke përfshirë: analizat e gjakut dhe urinës, rezonancë magnetike, testim gjenetik, biopsi të muskujve (vetëm në disa raste specifike). Deri më sot, nuk ka një kurë përfundimtare, por ka trajtime që ndihmojnë në menaxhimin e simptomave dhe

përmirësimin e cilësisë së jetës. Këto përfshijnë: strategji të personalizuara ushqimore, terapi farmakologjike, kurse të rehabilitimit motorik dhe oksigjeno terapi. Oksigjeni është një nga përbërësit më të rëndësishëm në prodhimin e energjisë së përdorshme (ATP), transporti i oksigjenit. Çdo plan trajtimi është i përshtatur për nevojat specifike të personit.
Konkluzione: Studimet kostatojnë se anomalitë mitokondriale, stresi oksidativ, inflamacioni, sëmundjet kardiovaskulare dhe kanceri janë të lidhura ngushtë me njëra - tjetrën.

Fjalë kyçe: anomali mitokondriale, biopsi, stresi oksidativ, mutacione gjenetike, diagnozë.

ANEMIA HEMOLITIKE AUTOIMUNE NË MOSHËN PEDIATRIKE - SFIDAT NË DIAGNOSTIKIM, RISHIKIM LITERATURE, RASTE KLINIKE.

Mirela Xhafa[1], Denada Paja[2], Mirzana Kapllanaj[1], Enkeleda Duka[1], Donjeta Bali[1]
[1]Depatamenti i Pediatrisë, Shërbimi i Onkohematologjisë, QSU "Nënë Tereza", Tirana, Albania
[2]Specializante Departamenti i Pediatrisë, QSU "Nënë Tereza", Tirana, Albania

Abstrakt
Hyrje: Anemia Hemolitike Autoimune është një formë e fituar e anemisë hemolitike, ku antitrupat targetojnë dhe sulmojnë antigjenet në membranën eritrocitare, duke shkaktuar kështu lizë qelizore. Fillimisht kjo hemolizë e gjeneralizuar shkakton rritje të nivelit të EPO duke dhëne një rritje kompensatore të eritrociteve, por kjo përgjigje shpesh nuk është e mjaftueshme për të mbajtur nivelin e hemoglobinës në normë. Anemia Hemolitike Autoimine konsierohet "ekstrinseke" pasi në ndryshim nga shumë anemi të tjera hemoltike, në këtë rast eritrociti është normal. Në shumicën e studimeve Anemia Hemolitike konsiderohet autoimune kur kemi Test Coombs Direkt pozitiv si dhe përjashtim të hollësishëm të diagnozave të tjera diferenciale.
Qëllimi: Rëndësia e përfshirjes së Anemisë Hemolitike Autoimune në diagnozën diferenciale të anemive hemolitike në fëmije. Vlera e diagnostikimit të duhur dhe në kohë në mjekimin dhe trajtimin afatgjatë të sëmundjes.
Raste Klinike: Paraqesim shkurtimisht raste klinike të diagnostikuara dhe trajtuara nga shërbimi ynë, duke demonstruar algoritmin e vendosjes së diagnozës, trajtimin si dhe follow - up.
Konkluzione: Anemia Hemolitike Autoimune përbën një sfidë diagnostikuese në vëndin tonë. Është e rëndësishme të kuptohen mekanizmat në nivel qelizor të kësaj sëmundje si dhe të kuptohet vlera e testeve Coombs për të vënë një diagnozë sa më korrekte dhe qëndrim terapeutik bashkëkohor.

Fjalë kyçe: Anemi hemolitike, sëmundje autoimune, test Coombs direkt e indirekt, Hemolizë, hematologji pediatrike.

KORRELIMI I NJË RASTI TË DYSHUAR PËR TUMOR KOCKOR ME CELIAKINË. RISHIKIM LITERATURE.

Mirela Xhafa[1], Flora Draçi[2], Gladiola Hoxha[3], Mirzana Kapllanaj[1], Enkeleda Duka[1], Donjeta Bali[1]
[1]Sherbimi i Onko - Hematologjisë Pediatrike, QSUNT, Tiranë
[2]Specializante, Departamenti i Pediatrisë, QSUNT, Tiranë
[3]Sherbimi i Gastrohepalogjise Pediatrike, QSUNT, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Celiakia është një enteropati autoimune e shkaktuar nga intoleranca ndaj glutenit tek individë me predispozitë gjenetike. Studimet tregojnë se 56% e pacientëve të sapodiagnostikuar me celiaki paraqesin osteopeni, ndërsa 29. 2% kanë osteoporozë, çka shpjegon rrezikun e shtuar për fraktura. Frakturat e përsëritura në mungesë të traumës mund të jenë manifestimi fillestar i sëmundjes dhe shpesh çojnë në vlerësim për patologji onkohematologjike.
Qëllimi: Të prezantohet rasti klinik i një fëmije i referuar për vlerësim onkohematologjik për shkak të frakturave të përsëritura dhe dyshimit për tumor kockor, diagnostikohet me Celiaki. Rasti thekson rëndësinë e një vlerësimi multidisiplinar dhe rolin e pavionit të Onkohematologjisë pediatrike në zbulimin e sëmundjeve sistemike me prezantim atipik.

Prezantimi i rastit: Femija E. F. paraqitet në Sherbimin e Onko - Hematologjisë pediatrike për dhimbje të përsëritura në krahun e djathtë dhe historisë së frakturave të humerusit dexter në të njëjtin vend. Janë dokumentuar gjithsej katër fraktura, me histori të paqartë ndjekjeje ortopedike dhe ndërhyrje kirurgjikale, për të cilën nëna nuk kishte informacion të plotë. Ekzaminimi radiologjik i skapulës nuk tregoi lezione aktive, ndërsa i humerusit evidentoi një lezion periostal. Nga konsultat ortopedike rezultoi se pacienti ishte trajtuar për një cist kockor dhe ishte rekomanduar ndjekje vjetore. Për shkak të përsëritjes së frakturave, moskoherencës në historikun klinik dhe dyshimit për patologji sistemike, u zgjerua vlerësimi, përfshirë analizat për sëmundje metabolike dhe autoimune. Serologjia për sëmundje celiake rezultoi pozitive. Pacienti u referua për vlerësim në Shërbimin e Gastrohepatologjisë dhe u konfirmua diagnoza.
Konkluzion: Celiakia duhet të konsiderohet tek fëmijët me fraktura të përsëritura. Prezantimet atipike të celiakisë mund të çojnë në hetime të panevojshme onkologjike në mungesë të një vlerësimi të integruar klinik. Rasti nënvizon rëndësinë e bashkëpunimit multidisiplinar dhe rolin e Shërbimit të Onko - Hematologjisë në identifikimin e patologjive sistemike me prezantim atipik.

Fjalë kyçe: celiakia; fraktura të përsëritura; tumor kockor; vlerësim onkohematologjik; prezantim atipik.

TIRZEPATIDE PËR TRAJTIMIN E TË RRITURVE ME DIABET TIP 2: ANALIZË NGA NJË GRUP NË PRAKTIKËN KLINIKE TË PËRDITSHME.

Dr. Mirjeta Guni[1], Dr. Juliana Karanxha[2], Dr. Monika Dede[2], Prof. Florian Toti[3]
[1]Spitali Amerikan Nr. 3, Tiranë, Shqipëri
[2]Spitali Amerikan Nr. 2, Tiranë, Shqipëri
[3]Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Hyrje: Diabeti mellitus tip 2 (DM2) është një gjendje kronike e karakterizuar nga hiperglicemia e vazhdueshme dhe shpesh shoqërohet me mbipeshë ose obezitet, faktorë që kontribuojnë në rritjen e rrezikut kardiovaskular dhe metabolik. Në vitet e fundit, janë zhvilluar terapi të reja që përmirësojnë ndjeshëm kontrollin glikemik dhe nxisin humbje të konsiderueshme në peshë. Tirzepatide është një agonist dual i receptorëve GIP dhe GLP - 1, i cili administrohet një herë në javë dhe ka treguar ulje domethënëse të HbA1c dhe të peshës trupore në studime të kontrolluara me përzgjedhje të rastësishme.
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi ishte të vlerësonte efektivitetin e tirzepatide në kushte reale klinike, jashtë mjedisit të kontrolluar të studimeve klinike.
Metodologjia: U realizua një analizë vëzhguese në 50 të rritur me diabet tip 2 që filluan trajtim me tirzepatide. U përfshinë vetëm pacientët që kishin të dhëna në momentin fillestar dhe në ndjekje. U mblodhën të dhëna për këto variabla: Parametrat glicemikë: HbA1c dhe glicemia esëll (FPG). Parametrat antropometrikë: pesha trupore dhe indeksi i masës trupore (BMI). Treguesit kardiometabolikë: tensioni arterial dhe profili lipidik. U llogaritën gjithashtu përqindjet e pacientëve që arritën objektiva klinikisht të rëndësishëm: HbA1c <7. 0% dhe <6. 5%, humbje peshe prej ≥5%, ≥10% dhe ≥15%. U shqyrtua lidhja ndërmjet humbjes në peshë dhe përmirësimit të HbA1c duke përdorur analiza me p - vlera nga permutimi.
Rezultate: Karakteristikat e grupit: 50 pacientë me DM2 u përfshinë në analizë. Rezultatet për peshën trupore: Pesha në fillim: 111. 40 ± 19. 07 kg Pesha në ndjekje: 95. 34 ± 19. 33 kg. Ndryshim mesatar: –16. 06 kg (CI 95%: –17. 79 deri –14. 34; p=0. 0001) Përqindja e pacientëve që arritën objektiva për humbje peshe: ≥5% humbje peshe: 94. 0%, ≥10%: 82. 0%, ≥15%:, 50. 0%. Treguesit e tjerë klinikë: Pacientët gjithashtu shfaqën përmirësime në parametrat glikemikë dhe disa tregues të tjerë kardiometabolikë. Edhe pse këto të dhëna nuk ishin të plota për të gjithë pacientët, drejtimi i ndryshimeve ishte pozitiv dhe në përputhje me të dhënat nga studimet klinike.
Përfundime: Në këtë studim vëzhgues të praktikës klinike të përditshme, trajtimi me tirzepatide rezultoi në: Humbje të theksuar në peshë, mesatarisht mbi 16 kg për pacientë. Shkallë të lartë të humbjes klinikisht të rëndësishme të peshës, me gjysmën e pacientëve që humbën ≥15% të peshës trupore. Përmirësim të dukshëm të glicemisë dhe të disa treguesve të tjerë kardiometabolikë. Këto rezultate përforcojnë potencialin e tirzepatide si një terapi efektive për pacientët me diabet tip 2, duke ofruar përfitime të njëkohshme në menaxhimin e glukozës dhe reduktimin e peshës në praktikën klinike të përditshme.

Fjalë kyçe: Diabeti mellitus, DM2, hiperglicemia, mbipeshë, obezitet.

KARAKTERISTIKAT EPIDEMIOLOGJIKE TË SËMURËVE ME PLEKSUS BRACHIAL OBSTETRIC.

Mirush Gjocaj

Abstrakt

Hyrje: Paraliza e pleksusit brachial është paraliza e dobët e krahut në lindje që prek nerva të ndryshëm të pleksusit brachial të furnizuar nga C5 në T1. Në Kosovë, incidenca e dëmtimit të plexusit brachial varion nga 0. 8 deri në 3. 1 për 1000 të porsalindur, dhe është e ngjashme me incidencën e paralizës së pleksusit brachial në vendet e zhvilluara, ku raportohet se prek 0. 5 deri në 5. 1 për 1000 foshnja. Ka shumë lloje shkaqesh për këtë lezion, por më i shpeshti është një tërheqje anësore e kokës, qafës ose krahut të foshnjës gjatë lindjes. Manifestimet klinike varen nga shtrirja dhe vendndodhja e dëmtimit dhe mund të shfaqen si parezë ose paralizë, ose si dobësi ose ulje e forcës muskulare të krahut të prekur. Ky lloj dëmtimi kërkon rehabilitim të gjatë dhe të vazhdueshëm

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi ishte analizimi i shpeshtësisë së paralizës brakiale sipas gjinisë, llojit, anës.

Materiale dhe metoda: Foshnjat e porsalindura me paralizë brakiale janë studiuar në mënyrë retrospektive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Sëmundjet janëkonfirmuar me ekzaminim fizik, ekzaminim neurologjik dhe radiografi.

Rezultate: Shumica e të porsalindurve të përfshirë në këtë studim ishinme paralizë brachiale të tipit Erb - Duchene. Një numër më i madh i foshnjave të porsalindura (66%) kishin pësuar
lëndime në anën e djathtë.

Perfundime: Duke u bazuar në rezultatet e hulumtimit erdha në konkludim se: Shumica e të poralindurve me këtë dëmtim ishin djem, dominon tipi Erb - Duschenne c5 - c6, ana më e prekur është ana e djathtë, shumica e rasteve kanë ndodhur në shtatëzëninë e parë, ndërsa sipas faktorëve të rrezikut dominojnë dystocite e shpatullave dhe makrosomite.

Fjalë kyçe: Epidemiologji, paralizë e pleksusit brachial, të sapolindur.

ROLI I IMUNOFENOTIPIZIMIT NË LEUKEMITË AKUTE PEDIATRIKE ME KLINIKË ATIPIKE DHE NË DETEKTIMIN E HERSHËM TË RECIDIVËS PA SHËNJA HEMATOLOGJIKE.

Mirzana Kapllanaj[1], Rovena Aliaj[2], Valentina Semanaj[3], Sindi Dizdari, Enkeleda Duka[1], Mirela Xhafa[1], Anila Godo[1], Elona Gjika[4], Donjeta Bali[1]

[1]Shërbimi i Onkohematologjisë Pediatrike, Departamenti i Pediatrisë – QSUT

[2]Specializant pranë Shërbimit të Pediatrisë – QSUT

[3]Biologe molekulare

[4]Mjeke e laboratorit

Abstrakt

Hyrje: Leukemitë akute përbëjnë neoplazitë më të shpeshta malinje në moshën pediatrike, të karakterizuara nga proliferimi i pakontrolluar i qelizave hematopoetike të pamaturuara në palcën kockore. Diagnoza e hershme dhe e saktë mbetet faktor përcaktues për mbijetesën dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

Objektiva: Të evidentojmë rolin thelbësor të imunofenotipizimit jo vetëm në diagnostikimin fillestar të rasteve me prezantim klinik atipik, por edhe në zbulimin e hershëm të recidivës në mungesë të ndryshimeve të hemogramës dhe me manifestime jo karakteristike.

Metodologjia: Analizë retrospektive e disa rasteve klinike të ndjekura në Shërbimin e Onkohematologjisë Pediatrike, QSUT, ku imunofenotipizimi i gjakut periferik dhe i palcës kockore ka qenë përcaktues për konfirmimin e diagnozës dhe për monitorimin në vijim.

Rezultate: Pacientë të paraqitur me simptoma jo tipike si dhimbje kockore, çrregullime të ecjes ose insuficiencë renale akute, në mungesë të alterimeve laboratorike sugjestive, nuk u orientuan drejt diagnozës së hemopative malinje deri në kryerjen e imunofenotipizimit. Në një prej rasteve, imunofenotipizimi mundësoi identifikimin e recidivës shumë herët, pavarësisht hemogramës normale dhe shenjave klinike atipike, duke lejuar ndërhyrje terapeutike të menjëhershme.

Konkluzione: Imunofenotipizimi paraqitet si "gold standard" në diagnostikimin e leukemive akute pediatrike, duke ofruar avantazhe të dukshme në rastet me klinikë atipike. Për më tepër, ai shërben si metodë e

pakontestueshme për detektimin e hershëm të recidivës dhe monitorimin e sëmundjes minimale reziduale (MRD), duke kontribuar në përmirësimin e mbijetesës dhe reduktimin e komplikacioneve.

Fjalë kyçe: Leukemi akute, fëmijë, imunofenotipizëm, recidivë, MRD.

MENAXHIMI MULTIDISIPLINAR I NJË MASE RETROPERITONEALE TË RRALLË NË MOSHËN PEDIATRIKE: RAST ME GANGLIONEUROMË.

Sindi Dizdari[2], Mirzana Kapllanaj[1], Rovena Aliaj[2], Dritan Alushani[3], Eltona Malo[4], Mirela Xhafa[1], Enkeleda Duka[1], Donjeta Bali[1]
[1]Shërbimi i Onko - Hematologjisë Pediatrike, Departamenti i Pediatrisë – QSUT
[2]Specializant pranë Shërbimit të Pediatrisë – QSUT
[3]Shërbimi i Kirurgjisë Infantile, Departamenti i Pediatrisë - QSUT
[4]Shërbimi i Imazherisë, Departamenti i Pediatrisë - QSUT

Abstrakt
Hyrje: Tumoret retroperitoneale në fëmijë janë entitete të rralla dhe shpesh paraqiten si masa abdominale incidentale ose simptomatike për shkak të kompresionit të strukturave ngjitur.
Menaxhimi kërkon bashkëpunim multidisiplinar midis pediatrit, onko - hematologut, kirurgut pediatrik, radiologut dhe patologut.
Prezantimi i rastit: Një fëmijë 4 - vjeçar u paraqit me temperaturë të përsëritur dhe kollë të thatë. Gjatë ekzaminimit fizik u identifikua një masë abdominale suprapubike me përmasa të konsiderueshme (10–15 cm), që motivoi kryerjen e ekzaminimeve të mëtejshme. Ekografia abdominale dhe CT evidentuan një formacion retrovezikal me dimensione 15 × 14 × 10 cm, me karakteristika heterogjene, që zhvendoste strukturat fqinje dhe shoqërohej me dilatim të ureterit të majtë. Nuk u evidentuan limfonoduj patologjikë ose metastaza të largëta.
Pas transferimit në shërbimin e kirurgjisë pediatrike u realizua biopsi e masës, ku profili histopatologjik dhe imunohistokimik rezultoi në përputhje me ganglioneuromë, tumor beninj me origjinë nga qelizat ganglionare të sistemit nervor simpatik. U rekomandua ekscizion kirurgjikal i plotë. Menaxhimi dhe ecuria: Pas ndërhyrjes kirurgjikale, fëmija zhvilloi deficit motor periferik të këmbës së djathtë (ecje "stepante"), për të cilin u përfshi ekipi i rehabilitimit dhe fizioterapisë. Ndjekja post - operatore përfshiu monitorim klinik, laboratorik dhe imazherik për recidiv ose komplikacione.
Diskutime: Ky rast ilustron rëndësinë e qasjes së integruar multidisiplinare në diagnostikimin dhe menaxhimin e masave abdominale pediatrike. Diferenciali përfshin tumore të ndryshme retroperitoneale (neuroblastomë, wilms tumor, limfomë), ndaj biopsia dhe profili IHC janë vendimtarë për diagnozën përfundimtare. Kirurgjia mbetet trajtimi i zgjedhur, ndërsa rehabilitimi post - operativ është thelbësor për rikuperimin funksional.
Përfundime: Ganglioneuroma, megjithëse tumor beninj dhe i rrallë në fëmijë, mund të paraqitet si masë abdominale e madhe me impakt klinik të rëndësishëm. Menaxhimi i suksesshëm kërkon bashkëpunim të ngushtë multidisiplinar nga diagnostikimi deri në rehabilitim, duke siguruar prognozë të favorshme dhe cilësi optimale jete për pacientin pediatrik.

Fjalë kyçe: Ganglioneuroma, moshë pediatrike, diagnostikim, trajtim.

ECURIA SPITALORE E COVID - 19: NJË ANALIZË RETROSPEKTIVE.

Dr. Monika Dede[1], As. Prof Entela Kolovani[2], Dr. Gentian Huti[1], Dr. Mirjeta Guni[1], Dr. Juliana Karanxha[1], Dr. Artemis Ibra[1], Dr. Artan Simaku[3], Dr. Shk Elda Qyra[2], Dr. Shk Ermira Muco[2], As. Prof Edmond Puca[2], Prof. Dr Arjan Harxhi[2], Prof. Dr Najada Como[2]
[1]Spitali Amerikan
[2]Spitali Infektiv QSUT
[3]ISHP

Abstrakt
Hyrje: COVID - 19 përfaqëson një sfidë të paprecedentë për sistemet shëndetësore në mbarë botën, veçanërisht në vendet me burime të kufizuara. Në këtë kontekst, përvoja spitalore lokale ofron informacion të vlefshëm për vlerësimin e strategjive klinike të aplikuara gjatë pandemisë.

Qëllimi: Të përshkruajë karakteristikat demografike, ecurinë klinike, trajtimin dhe rezultatet spitalore të pacientëve të shtruar me COVID - 19, duke evidentuar faktorët që mund të kenë ndikuar në prognozë dhe nevojën për ndërhyrje intensive.
Metodologjia: U realizua një analizë retrospektive e 186 pacientëve të shtruar me diagnozë COVID - 19 gjatë viteve 2021–2022 ne Spitalin American 3. Të dhënat u përftuan nga një regjistër i detajuar që përfshinte të dhëna demografike, simptomat në paraqitje, terapinë e administruar (antikoagulim, oksigjenoterapi, prone position), si dhe ecurinë përfundimtare të hospitalizimit (dalje nga spitali, intubim, exitus).
Rezultate: Grupi i analizuar përfshinte 186 pacientë, prej të cilëve 52. 2% ishin meshkuj, 29% femra. Mosha mesatare e pacientëve ishte 59. 8 vjeç, që varionte nga 24 deri në 94 vjeç. Temperatura subfebrile ose febrile u raportua në 76. 3% të rasteve, ndërsa 23. 7% e pacientëve mbetën afebrilë gjatë qëndrimit spitalor. Oksigjenoterapia dhe antikoagulimi u administruan në 99. 5% të rasteve, ndërsa pozicionimi prone u përdor në 51. 6% të pacientëve. Nga ky grup, 4 paciente (2. 1%) u intubuan dhe vetëm 2 pacientë (1. 1%) rezultuan exitus. Qëndrimi mesatar spitalor ishte 6. 8 ditë. Analiza multivariate zbuloi se mosha mbi 70 vjeç ishte e lidhur me një rrezik të shtuar për ecuri të zgjatur ose përfundim negativ (OR=2. 9; 95% CI: 1. 2–7. 1; p=0. 018). Gjithashtu, prania e sëmundjeve bashkëshoqëruese rezultoi një faktor i rëndësishëm (OR=3. 6; 95% CI: 1. 5–8. 4; p=0. 004), ndërsa paraqitja në spital pas ditës së 10 - të të sëmundjes shoqërohej me rritje të rrezikut për ndërlikime (OR=2. 4; 95% CI: 1. 1–5. 2; p=0. 030). Në të kundërt, përdorimi i hershëm i oksigjenoterapisë dhe antikoagulimit lidhej me një ulje të ndjeshme të rrezikut për terapi intensive (OR=0. 42; 95% CI: 0. 19–0. 89; p=0. 023).
Përfundime: Menaxhimi spitalor i pacientëve me COVID - 19 mund të jetë efektiv duke u bazuar në oksigjenoterapi, antikoagulim dhe monitorim të afërt klinik, ndërhyrje që ulin gjasat për intubim. Rezultatet e analizës multivariate theksojnë rolin prognostik të moshës, komorbiditeteve dhe kohës së vonuar të paraqitjes në spital.

Fjalë kyçe: COVID - 19, oksigjenoterapi, antikoagulim, prone position, spitalizim, exitus, intubim, Shqipëri, trajtim jo - invaziv.

ERYSIPELA – DIAGNOSTIKIMI DHE TRAJTIMI NË KUJDESIN PARËSOR SHËNDETËSOR.

Muhamet Jashari

Abstrakt
Hyrje: Erysipela është një infeksion akut bakterial i lëkurës dhe enëve limfatike, më shpesh i shkaktuar nga streptokokët beta - hemolitikë të grupit A. Diagnostikimi i hershëm në kujdesin parësor është vendimtar për trajtimin efektiv dhe parandalimin e komplikimeve. Kjo përmbledhje synon të ofrojë një pasqyrë të praktikave aktuale për diagnostikimin, trajtimin dhe kriteret e referimit.
Materiale dhe metoda: U krye një rishikim narrativ i literaturës në bazat e të dhënave PubMed, Cochrane Library, Web of Science dhe në udhëzimet klinike të NICE dhe UpToDate, për periudhën 2015–2024. U përfshinë artikuj rishikimi, udhëzime klinike dhe studime relevante mbi diagnostikimin dhe trajtimin e erysipelës në nivel të kujdesit parësor.
Rezultate: Diagnoza është kryesisht klinike, e bazuar në eritemë të ndritshme me kufij të qartë, dhimbje, ethe dhe limfadenopati. Analizat laboratorike janë jospesifike, ndërsa hemokulturat rekomandohen vetëm në rastet e komplikuara. Penicilina mbetet terapia e parë, me kohëzgjatje trajtimi prej 5 ditësh, e cila rezulton jo - inferiore ndaj kurave më të gjata. Alternativa për pacientët alergjikë përfshijnë cefalosporinat e gjeneratës së parë ose klindamicinën. Referimi në spital rekomandohet në prani të shenjave sistemike, dështimit të terapisë orale ose dyshimit për infeksion më të thellë. Evidenca e fundit mbështet edhe përdorimin e profilaksisë me penicilinë në rastet e përsëritura.
Përfundime: Në praktikën e kujdesit parësor, diagnostikimi i hershëm dhe fillimi i menjëhershëm i trajtimit me antibiotikë me spektër të ngushtë janë thelbësore për suksesin klinik. Udhëzimet ndërkombëtare ofrojnë protokolle të qarta për menaxhimin ambulator dhe përcaktimin e rasteve që kërkojnë referim. Zbatimi i këtyre standardeve përmirëson prognozën dhe redukton rikthimin e sëmundjes.

Fjalë kyçe: Erysipela, kujdes parësor, penicilinë, trajtim ambulator, rikthim, profilaksi.

MENAXHIMI I DHIMBJES PAS LINDJES ME PRERJE CEZARIANE, FAKTORËT E RREZIKUT.

Prof. Asc. Dr. Mustafa Bajraktari[1, 2], Rinard Kortoci[2] Md, Roland Kaza[2] Md
[1]*Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri*
[2]*Spitali Amerikan 2, Tiranë, Shqipëri*

Abstrakt
Modalitetet më të njohura të menaxhimit të dhimbjes tek gratë që kryejnë lindje me prerje Cesareane janë administrimi sistemik dhe intratekal i opioideve, analgjezia e kontrolluar nga pacienti (PCA), ilaçet anti - inflamatore josteroide dhe bllokimet nervore rajonale. Analgjezia optimale postoperative ka një ndikim të rëndësishëm në rikuperimin dhe rezultatet e pacientes pas lindjes cezariane. Analgjezia multimodale është parimi kryesor për lindjen cezariane dhe menaxhimin e dhimbjes. Për një regjim standard analgjezik, rekomandohet përdorimi i opioideve neuroaksiale me veprim të gjatë (p. sh. , morfina) dhe ilaçeve ndihmëse, siç janë acetaminofeni i planifikuar dhe ilaçet anti - inflamatore josteroide, përveç nëse janë të kundërindikuara. Opioidet orale ose intravenoze duhet të rezervohen për dhimbjen e shpejtë. Përveç përdorimit të lartpërmendur të analgjezisë multimodale, vlerësimi paraoperativ është kritik për të individualizuar regjimin analgjezik sipas kërkesave të pacientit. Faktorët e rrezikut për dhimbje të forta postoperative ose efektet anësore të lidhura me analgjezinë do të kërkojnë modifikime në regjimin standard analgjezik. Gratë në lindje që kishin ankth para operacionit, histori të CS të mëparshme, prerje Pfannenstiel dhe ato që nuk morën analgjezi rajonale kanë vuajtur ndjeshëm nga dhimbje postoperative të moderuara deri në të rënda. Ashpërsia e dhimbjes duhet të vlerësohet dhe dokumentohet duke përdorur shkallë vlerësimi të dhimbjes dhe duhet të ketë qasje ndërdisiplinore për të siguruar menaxhim adekuat të dhimbjes.

Fjalë kyçe: Dhimbja pas lindjes Cezariane, analgjezia, faktorët e rrezikut.

PËRDORIMI I CEFTRIAXONIT NË MJEKËSINË FAMILJARE: STUDIM VLERËSUES MBI TRANSFORMIMIN E PRAKTIKAVE KLINIKE NË QKMF FUSHË KOSOVË PËRMES QASJES RACIONALE DHE STANDARDIZIMIT TERAPEUTIK (2024).

Dr. Mustafa Gashi, Dr Fitnete Ferizi, Dr Remzi Shala, Valbone syla, Aferdita Berisha, Rrezarta Kelani, Naile Qehaja
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ''Dr Fatmir Krasniqi'' Fushë Kosovë

Abstrakt
Hyrje: Përdorimi racional i antibiotikëve në Kujdesin Parësor mbetet një sfidë kritike për sistemet shëndetësore, veçanërisht në kontekstin e rritjes së rezistencës bakteriale dhe nevojës për përputhje me udhëzuesit terapeutikë. Ky studim vlerësues, i zhvilluar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Fushë Kosovë gjatë vitit 2024, synon të analizojë përdorimin e Ceftriaxon nga 39 mjekë familjarë, duke e krahasuar me standardet klinike të miratuara dhe duke vlerësuar ndikimin e ndërhyrjeve edukative në përmirësimin e praktikave të përshkrimit.
Metodologjia: Studimi u bazua në një analizë retrospektive të 211, 930 vizitave mjekësore të realizuara gjatë periudhës janar–dhjetor 2024. Nga të gjitha vizitat mjekësore të realizuara nga 39 mjekë u identifikuan 590 trajtime me antibiotikun Ceftriaxon, të cilat u analizuan në raport me udhëzuesit terapeutikë dhe dokumentimin e diagnozave. Instrumentet e përdorura përfshinë auditimin e të dhënave nga librat e regjistrit të pacientëve.
Rezultate: Auditi Klinik tregoi se përdorimi i Ceftriaxon ishte selektiv dhe i orientuar nga indikacione të qarta klinike. Rezultatet tregojnë një transformim të theksuar në qasjen terapeutike, të shoqëruar me avancim të dukshëm të praktikave klinike, si rezultat i ndërhyrjeve edukative dhe rritjes së përgjegjësisë profesionale. Gjatë periudhës janar–dhjetor 2024, janë realizuar gjithsej 211, 390 vizita mjekësore nga 39 mjekë të QKMF - së, ndërsa Ceftriaxoni është ordinuar në 590 raste, që përbën vetëm 0. 27% të vizitave, me një mesatare prej 15 trajtimesh për mjek në vit. Megjithatë, u identifikuan boshllëqe në dokumentimin e diagnozave, duke sugjeruar nevojën për përforcim të mekanizmave të monitorimit dhe përmirësim të vazhdueshëm të praktikave klinike.
Konkluzione: Ky studim reflekton angazhimin disavjeçar të QKMF Fushë Kosovë për përmirësimin e cilësisë së Kujdesit Parësor përmes vlerësimit të praktikave klinike dhe orientimit drejt standardizimit. Përdorimi i kujdesshëm i Ceftriaxon, i mbështetur nga ndërhyrje edukative dhe auditim të strukturuar, ka kontribuar në rritjen e sigurisë terapeutike dhe në parandalimin e përdorimeve të panevojshme të antibiotikëve. Rezultatet nënvizojnë rëndësinë e vazhdimit të monitorimit profesional dhe integrimit të protokolleve klinike në praktikën e përditshme.
Fjalë kyçe: ceftriaxon, mjekësia familjare, antibiotikët, audit klinik, përdorim racional, udhëzues klinikë.

TRAJTIMI KIRURGJIKAL I KANCERIT KOLOREKTAL.

Myzafer Kaci, Arvin Dibra, Xheladin Dracini, Marsid Sinani, Drini Shehi, Erjon Stojku, Ilir Skenduli, Armand Hoxha, Ylli Kercani

Abstrakt

Hyrje: Kanceri kolorektal është një ndër patologjitë malinje më të shpeshta të traktit digjestiv. Gjithashtu, ky kancer është dhe një ndër shkaqet më të shpeshta të vdekjeve në botë. Kanceri kolorektal është një sëmundje multidisiplinare, ku modaliteti kryesor i trajtimit të tij është trajtimi kirurgjikal.

Qëllimi: Evidentimi i llojit të teknikave kirurgjikale më të shpeshta të realizuara për trajtimin e kancerit kolorektal.

Materiale dhe metoda: Ky është një studim retrospektiv, ku janë analizuar të dhënat e grumbulluara të rasteve me kancer kolo - rektal të trajtuara në Klinikën e Parë të Kirurgjisë së Përgjithshme në QSUT, gjatë periudhës janar – dhjetor 2023. Në të gjitha rastet janë analizuar mosha, gjinia, lokalizimi i tumorit, teknikat operatore, nëntipi histologjik i biopsie.

Rezultate: Janë analizuar 177 raste, nga të cilat 54% kanë qenë meshkuj. Mosha mesatare ka qenë 54 vjeç. 32% e rasteve i përkasin kancerit të rektumit. 9% e rasteve janë trajtuar në shërbimin e urgjencës, pasi kanë ardhur si okluzione intestinale. Predominon stadi i II - të dhe IIII - të i sëmundjes me 54% dhe 42% respektivisht. Interventet e realizuara si tipologji kanë qenë APR, LAR, hemikolektomi dhe kolektomi totale.

Konkluzione: Kirurgjia e kancerit kolorektal mbetet një shtyllë e rëndësishme në trajtimin e kësaj sëmundjeje. Një teknikë kirurgjikale agresive ndaj sëmundjes, e shoqëruar me një kyrazh të mirë të limfonodulave, rrit mbijetesën e këtyre të sëmurëve dhe suksesin e trajtimit pasues nëse do të jetë i nevojshëm.

Fjalë kyçe: Kancer kolorektal, patologji malinje, trakt digjestiv.

INFEKSIONET NOSOKOMIALE NË PACIENTËT POST - OPERATORË.

N. Como, M. Qato

Shërbimi i Sëmundjeve Infektive, QSU "Nënë Tereza"

Abstrakt

Hyrje: Infeksionet nosokomiale janë infeksione që zhvillohen 48 orë pas pranimit ose brenda 30 ditëve pas daljes nga një strukturë shëndetësore. Rreth 1. 7% deri në 46% e pacientëve të shtruar në strukturat shëndetësore zhvillojnë infeksione nozokomiale. Infeksionet nosokomiale shoqërohen me një rritje të morbiditetit, mortalitetit dhe, përveç kësaj, infeksionet nosokomiale shpesh shoqërohen me mbivendosjen e organizmave rezistentë.

Qëllimi: Të evidentojmë pacientët postoperator si një grup risku veçanërisht i prekshëm ndaj infeksioneve nosokomiale dhe i asociuar me një ndikim të lartë në morbiditet dhe mortalitet.

Materiale dhe metoda: Rishikuam literaturën përkatëse bashkëkohore të lidhur me infeksionet nosokomiale post - operatore dhe evidentuam të dhënat përkatëse epidemiologjike, faktorët predispozues dhe rezultatet mikrobiologjike.

Rezultatet: Pjesa më e madhe e infeksioneve nosokomiale shkaktohen nga bakteret, kërpudhat, viruset dhe parazitët, por është fakt që bakteret janë përgjegjëse në më shumë se 95% të infeksioneve. Bakteret që përfshihen zakonisht janë E. faecium, S. aureus, K. pneumoniae, P. aeruginosa, A. baumanni dhe speciet Enterococcus, të cilat janë të ashtuquajturat patogjenë ESKAPE. Më pak se 5% e infeksioneve nosokomiale shkaktohen nga speciet Candida. Bakteret Gram - negative aktualisht përbëjnë më shumë se 60% të infeksioneve nosokomiale. Infeksionet më të zakonshme nosokomiale tek pacientët postoperatorë përfshijnë infeksionin e vatrës operatore, infeksione të lidhura me kateterin venoz, infeksionin e traktit të poshtëm respirator, infeksionin e traktit urinar dhe infeksionet e traktit gastrointestinal. Shumica e studimeve dëshmojnë se pjesa më e madhe e pacientëve janë meshkuj dhe grupmosha më e prekur përfshin 41 - 50 dhe 51 - 60 vjeç.

Përfundime: Infeksionet nosokomiale shoqërohen me një rritje të morbiditetit, mortalitetit dhe së fundmi, por jo më pak e rëndësishmja, me rritje të kostos së përgjithshme të kujdesit shëndetësor. Vlen të theksohet që

infeksionet nosokomiale shpesh shoqërohen me shfaqjen e organizmave rezistente, të cilat përfaqësojnë një sfidë të rëndësishme terapeutike.

Fjalë kyçe: Infeksionet nosokominale, pacientë post - operatorë.

PËRDITËSIME NË TRAJTIMIN E DISLIPIDEMIVE.

Dr. Shk. Naltin Shuka, Dr. Anastasa Keri, Dr. Besjan Shehu, Dr. Kevi Carkanji
QSUNT, Shërbimi i Kardiologjisë

Abstrakt
Sëmundjet kardiovaskulare të shkaktuara nga ateroskleroza mbeten shkaku kryesor i mortalitetit në Evropë dhe globalisht. Kontrolli i dislipidemisë, veçanërisht i LDL - kolesterolit, ka treguar ulje të ndjeshme të riskut kardiovaskular. Udhëzimet ESC / EAS 2019 rekomanduan objektiva shumë të rrepta të LDL - C, përdorimin e statinave me intensitet të lartë si trajtim fillestar dhe shtimin e ezetimibit apo inhibitorëve të PCSK9 kur objektivat nuk arrihen. Udhëzimet e vitit 2025 të Shoqatës Evropiane të Kardiologjisë (ESC) dhe Shoqatës Evropiane të Aterosklerozës (EAS) për menaxhimin e dislipidemive sjellin disa përditësime të rëndësishme krahasuar me rekomandimet e vitit 2019. Ndërsa objektivat e LDL - C sipas kategorive të riskut kardiovaskular mbeten të pandryshuara (<55 mg / dL për risk shumë të lartë, <70 mg / dL për risk të lartë, <100 mg / dL për risk të moderuar dhe <116 mg / dL për risk të ulët), udhëzimet e reja mbështeten tek SCORE2 dhe SCORE2 - OP dhe kalciumit koronar. Udhëzimet e vitit 2025 përfshijnë bempedoic acid (për pacientët që nuk tolerojnë statinat ose si terapi shtesë) dhe evinacumab për hiperkolesteroleminë familjare homozigote duke u shtrirë përtej statinave, ezetimibit dhe inhibitorëve PCSK9 duke. Në sindromin koronar akut rekomandohet terapia e kombinuar më herët: statinës me intensitet të lartë plus ezetimibe, ndërsa inhibitorët PCSK9 merren në konsideratë më herët tek pacientët me risk të lartë. Për hipertrigliceridemi, icosapent ethyl rekomandohet tek pacientët me risk të lartë ose shumë të lartë dhe me trigliceride 135–499 mg / dL që marrin statina, ndërsa volanesorsen prezantohet për chylomicronaeminë familjare për të reduktuar riskun e pankreatitit. Udhëzimet gjithashtu theksojnë se lipoproteina(a) >50 mg / dL është një faktor universal që rrit riskun, duke zgjeruar fokusin e vitit 2019 mbi nivelet ekstreme të Lp(a). Popullata të veçanta: HIV: Tek të rriturit ≥40 vjeç me HIV, rekomandohet statinë pavarësisht riskut të llogaritur dhe LDL - C (I - B); Kardio - onkologjia: Tek pacientët me risk të lartë / shumë të lartë nga antraciklinat, statinat duhen marrë në konsideratë për reduktim të disfunksionit kardiak (IIa - B). Nuk ishte në 2019. Më në fund, udhëzimet e vitit 2025 deklarojnë qartë se suplementet dietike dhe nutraceutikët e pa provuar nuk rekomandohen për parandalimin e sëmundjes aterosklerotike kardiovaskulare (ASCVD).

Fjalë kyçe: ESC, dislipidemi, LDL - C, ezetimib, PCSK9, udhëzime 2025.

MASTOPEKSIA ME AUGMENTIM – INDIKACIONET DHE TEKNIKAT KIRURGJIKALE.

Dr. Nardi Kola, Dr. Albiona Saliaj, Dr. Genti Zikaj, Dr. Armand Basha

Abstrakt
Hyrje: Mastopeksia me augmentim (Breast Augmentation Mastopexy) është një ndërhyrje kirurgjikale e kombinuar që ka për qëllim ngritjen e gjirit në një pozicion më të lartë në murin torakal, ndërkohë që përmirëson formën dhe shton vëllimin e tij nëpërmjet vendosjes së protezave. Kjo procedurë është veçanërisht e përshtatshme për pacientet që përveç ptozës së gjirit, kërkojnë dhe një augmentim estetik të tij.
Teknikat dhe Prerjet më të Përdorura: Mastopeksia me model "Wise Pattern" (T e përmbysur): Një nga teknikat më të përdorura që përfshin një prerje rreth areolës, zgjatet vertikalisht poshtë gjirit dhe vijon horizontalisht përgjatë palës inframamare. Ofron akses të shkëlqyer për heqjen e lëkurës së tepërt dhe formësimin e indit gjëndror. Mastopeksia Vertikale: Kjo teknikë përfshin një prerje rreth areolës që zgjatet drejt vijës inframamare, pa përfshirë prerjen horizontale. Mastopeksia Cirkumareolare dhe "Crescent": Teknika më të thjeshta, me prerje të kufizuara në nivelin e areolës, të cilat mund të kombinohen me vendosjen e implanteve për një rezultat më estetik.

Vendosja e Implanteve: Teknika "Dual - Plane". Implanti vendoset nën muskujt pektorale dhe pjesërisht brenda indit gjëndror të gjirit. Kjo metodë ndihmon në rikuperimin e mbushjes në polin e sipërm të gjirit dhe siguron një mbështetje më të mirë strukturore. Vendosje Subglandulare: Implanti vendoset drejtpërdrejt pas indit gjëndror, por përpara muskulit pektoralis. E përdorshme në raste të zgjedhura.
Përvoja Klinike (Rastet tona): Gjatë periudhës 2024–2025, kemi kryer 15 raste të mastopeksive me augmentim. 7 raste ishin zëvendësime të protezave me implantë silikoni, të shoqëruara me ndryshim të planit të vendosjes dhe mastopeksi. 4 raste u trajtuan me mastopeksi cirkumareolare, ndërsa rastet e tjera me mastopeksi të tipit "T e përmbysur". Rezultatet ishin shumë të mira, pa komplikacione madhore. Shqetësimi kryesor i pacienteve mbeti cilësia e cikatrices (shenjës kirurgjikale). Në një rast u evidencua një asimetri e dukshme e trajtuar me lipofilling pas 6 muajsh.
Përfundim: Mastopeksia me augmentim paraqet një ndërhyrje të kombinuar që kërkon përzgjedhje të kujdesshme të teknikës në bazë të karakteristikave anatomike të pacientit dhe pritshmërive estetike. Përdorimi i teknikave të avancuara dhe personalizimi i planit kirurgjikal garantojnë rezultate të qëndrueshme me risk të ulët komplikacionesh.

Fjalë kyçe: Mastopeksi, augmentim gjiri, proteza silikoni, cicatricë, lipofilling, teknikë dual - plane, kirurgji estetike e gjirit.

RINDËRTIMI I DEFEKTEVE TË HUNDËS.

Dr. Nasian Mosku
Kirurgji e Përgjithshme, Plastike dhe Rikonstruktive
Spitali Rajonal Korçë

Abstrakt
Prezantimi flet mbi rindërtimin e defekteve të hundës që mund të krijohet nga eksizioni i tumoreve apo nga traumat. Hunda, është jo vetëm një organ i dukshëm, por është edhe përcaktues për tiparet e fytyrës duke i dhënë veçantinë çdo njeriu. Rindërtimi i saj është i rëndësishëm, si për të pasur normale funksionin e frymëmarrjes dhe fryмënxjerrjes, ashtu edhe për t'i dhënë vetëbesim pacientit për të funksionuar normalisht në shoqëri dhe për të mos mbetur i gjymtuar. Në këtë prezantim do të shqyrtohen metodat e ndryshme të rindërtimit të hundës si zëvendësimi me kërc nga organe të tjera, transplanti i lëkurës si dhe lëmbot e thjeshta dhe ato të pedunkuluara. Prezantimi shoqërohet me foto dhe raste konkrete të autorit, nga puna e tij 2. 5 vjeçare si kirurg rikonstruktiv dhe kirurg i përgjithshëm në spitalin rajonal të Korçës.

Fjalë kyçe: Rindërtimi i defekteve, hundë, kirurgji.

ROLI I IMAZHERISË NË SPONDILODISCITET INFEKTIVE - RISHIKIM I LITERATURËS.

Hoxha N[1], Como N[2], Muco E[2]
[1]Pavioni i Sëmundjeve Infektive, Spitali Rajonal Dibër, Shqipëri
[2]Shërbimi i Sëmundjeve Infektive, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Hyrje: Spondilodisciti infektiv është një infeksion i disqeve intervertebrale dhe trupave vertebralë, shpesh me simptoma jo - specifike. Diagnostikimi i hershëm është sfidues, ndërsa dallimi nga patologji të tjera vertebrale si ato degjenerative apo tumoret është thelbësor për trajtim të suksesshëm. Imazheria luan një rol kyç për identifikimin, diagnozën diferenciale dhe monitorimin e sëmundjes.
Qëllimi: Të përshkruhet roli i imazherisë si MRI, CT dhe PET / CT në diagnostikimin e spondilodisciteve dhe në diferencimin e tyre nga pathologjitë e tjera vertebrale.
Materiale dhe metoda: Ne shqyrtuam literaturën shkencore, rishikime restrospektive dhe raporte rastesh për diagnozën imazherike të spondilodisciteve infektive. U analizuan senistiviteti, specificiteti dhe përdorimi klinik i RM, CT dhe PET / CT në diagnostikimin dhe menaxhimin e infeksioneve vertebrale, si dhe për diagnozën diferenciale nga patologji të tjera vertebrale.

Përfundime: Imazheria është thelbësore në diagnostikimin e hershëm dhe monitorimin e spondilodisciteve infektive. MRI ofron informacion të detajuar mbi strukturat e buta dhe ndihmon në dallimin nga degjenerimet dhe tumoret vertebrale. CT siguron vlerësim të strukturave kockore, ndërsa PET / CT identifikon infeksionet aktive dhe ndihmon në dallimin nga proceset malinje. Integrimi i këtyre teknikave të imazherisë me vlerësimin klinik dhe laboratorik përmirëson saktësinë diagnostike dhe ndihmon në përcaktimin e trajtimit të pacientëve.

Fjalë kyçe: Spondilodisciti infektiv, imazheri, rezonancë magnetike, CT, PET / CT, diagnozë diferenciale.

NSTEMI I SHKAKTUAR NGA GJAKDERDHJA GASTROINTESTINALE PAS CABG: RAPORT RASTI.

Dr. Nehar Spahiu
Klinika e Kardiologjisë, Qendra Klinike Universitare e Kosovës Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës, Kosovë

Abstrakt
Hyrje: Infarkti i miokardit pa ngritje të segmentit ST (NSTEMI) përfaqëson një nëngrup të rëndësishëm të sindromave koronare akute dhe zakonisht shkaktohet nga okluzioni i pjesshëm i arterieve koronare, që çon në dëmtim të miokardit. Gjakderdhja gastrointestinale (GIB) është një urgjencë e shpeshtë mjekësore që mund të komplikojë trajtimin e pacientëve me sëmundje kardiovaskulare, veçanërisht atyre që janë në terapi antitrombocitare ose antikoagulante. Ky raport rasti paraqet një kombinim të rrallë, por të rëndësishëm, midis NSTEMI - t dhe GIB tek një pacient pas CABG, duke theksuar dilemat diagnostike dhe terapeutike. Përmbledhje: Një mashkull 65 - vjeçar me histori të hipertensionit dhe ndërhyrje kirurgjikale për bypass të arteries koronare (CABG) para 8 vitesh, u paraqit me hematemezë dhe melena. Analizat laboratorike treguan anemi dhe rritje të biomarkerëve kardiak. EKG tregoi depresione të segmentit ST në derivacionet laterale. Pas stabilizimit me transfuzion, dhimbja e gjoksit dhe ndryshimet ishemike në EKG u zhdukën. Ky rast thekson sfidën klinike në menaxhimin e NSTEMI - t të shkaktuar nga gjakderdhja gastrointestinale tek pacientët pas CABG, duke nënvizuar nevojën për balancim të kujdesshëm midis antikoagulimit dhe hemostazës.
Paraqitja e rasti: Një pacientë mashkull 65 - vjeçar nga Kamenica u pranua në spital me të vjella me gjak dhe feçe të zeza (melena), të shoqëruara me dhimbje gjoksi, lodhje dhe përgjumje. Historia mjekësore përfshinte hipertension dhe ndërhyrje kirurgjikale CABG të kryer para 8 vitesh. Në momentin e pranimit, tensioni arterial ishte 100 / 70 mmHg dhe pulsi 114 rrahje / min. Analizat laboratorike treguan anemi, ure dhe glukozë të rritur, si dhe enzima kardiake të larta (Troponin T 3085 pg / mL, CK - MB 2790 U / L, LDH 1091 U / L). EKG tregoi depresione të segmentit ST në derivacionet V3–V6. Ekokardiografia tregoi dilatim të të dy atriumeve dhe barkushes së djathtë, me funksion të ruajtur të barkushes së majtë. Endoskopia e sipërme zbuloi ulçerë gastrike (Forrest IIc) pa gjakderdhje aktive. Pas transfuzionit të gjakut dhe plazmës, gjendja e pacientit u stabilizua dhe ndryshimet ishemike në EKG u zhdukën.
Diskutime: Bashkëekzistenca e NSTEMI - t dhe gjakderdhjes gastrointestinale paraqet një sfidë të madhe terapeutike për shkak të qëllimeve të kundërta të trajtimit. Terapia antitrombotike, e domosdoshme për menaxhimin e ishemisë miokardike, mund të përkeqësojë gjakderdhjen, ndërsa ndërprerja e saj rrit rrezikun e ishemisë. Në këtë rast, mekanizmi më i mundshëm ishte ulja e furnizimit me oksigjen si pasojë e anemisë dhe hipovolemisë, duke shkaktuar ishemi të tipit 2 tek një miokard i ndjeshëm pas CABG. Udhëzimet e ESC (2020) theksojnë rëndësinë e vlerësimit të balancuar të rrezikut ishemik kundrejt atij hemorragjik, duke theksuar bashkëpunimin e ngushtë midis ekipeve të kardiologjisë dhe gastroenterologjisë.
Përfundime: Ky rast nënvizon rëndësinë e njohjes së gjakderdhjes gastrointestinale si një shkak potencial për shkaktimin e ishemisë miokardike tek pacientët me histori CABG. Menaxhimi optimal kërkon vlerësim individual të rrezikut, strategji të kujdesshme transfuzioni dhe bashkëpunim ndërdisiplinar për të arritur ekuilibrin midis hemostazës dhe parandalimit të ishemisë.

Fjalë kyçe: Nstemi, gjakderdhja gastrointestinale, CABG.

TROMBOFILIA HEREDITARE NË RASTET E ABORTIT REKURENT: UDHËZIME DHE REKOMANDIME.

Nensi A. Dilo[1, 2], Bianka Agaraj[1, 3], Evis Nushi[1], Majlinda Toska[1]
[1]*Labor Dr. Limbach Albania, Tiranë, Shqipëri.*
[2]*Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koço Gliozheni"*
[3]*Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza, Departamenti i Antomisë Patologjike*

Abstrakt

Hyrje: Aborti rekurent përkufizohet si 2 ose më shumë aborte të njëpasnjëshme llogaritur nga periudha e koncepsionit deri në javën e 24 - të të gestacionit. Ndër shkaqet multifaktoriale, trombofilitë e trashëguara mbeten mjaft të rëndësishme, megjithatë rëndësia klinike e shumë testeve gjenetikë mbetet e diskutueshme. Udhëzimet ndërkombëtare theksojnë një qasje të kufizuar dhe të bazuar në evidencë për testimin tek gratë me aborte të përsëritura.

Objektiva: Të ofrojë rekomandime të bazuara në udhëzime për testimin e trombofilisë hereditare në pacientet me aborte rekurente, me fokus tek testet klinikisht të rëndësishme dhe shmangien e depistimeve gjenetike të panevojshme.

Materiale dhe metoda: Rishikim literature dhe protokolleve ndërkombëtare, i kombinuar me analizim të praktikave aktuale të testimit në Shqipëri.

Rezultate: Teste e linjës së parë që japin informacion të vlefshëm për stratifikimin e riskut dhe mundësojnë udhëzimin e tromboprofilaksisë në shtatzënitë pasuese janë: Mutacioni i Faktorit të V - të të Leidenit (G1691A), mutacioni i Protrombinës (G20210A), aktiviteti i Antitrombinës, aktiviteti i Proteinës C, aktiviteti i Proteinës S, testi i rezistencës ndaj APC - së, aktiviteti i Faktorit VIII, testimi i Sindromit Antifosfolipidik obstetrikal. Testimi i mutacioneve gjenetike të përfshira në panele trombofilike si MTHFR C677T, A1298C, PAI - 1 4G / 5G, nivelet e homocysteinës nuk tregojnë evidencë sinjifikante në rastet me aborte rekurente. Testimi i tyre shton kosto dhe në pjesën më të madhe të pacienteve nuk ka përfitim klinik.

Përfundime: Testimi për trombofili të trashëguara në abortin rekurent duhet të jetë selektiv dhe i orientuar nga rëndësia klinike. Mjekët duhet të ndjekin rekomandimet ndërkombëtare duke u fokusuar tek Faktori V Leiden, mutacioni i protrombinës G20210A, së bashku me depistimin për antitrupa antifosfolipidik. Kryerja e testeve korrekte është thelbësore për trajtimin dhe ndjekjen obstetrikale të grave.

Fjalë kyçe: Abort rekurent, trombofili hereditare, Faktori V Leiden, protrombina G20210A, antitrombina, proteina C, proteina S, antitrupat antifosfolipidik.

NIVELI I EDUKIMIT SHËNDETËSOR TË POPULLATËS SHQIPTARE MBI SHËNDETIN DHE SËMUNDJET RENALE.

Nereida Spahia

Abstrakt

Hyrje: Prevalenca globale e sëmundjes kronike të veshkave (SKV) po rritet ndjeshëm, ndërsa incidenca kombëtare është afruar në rreth 130 raste për një milion banorë. Në përputhje me tendencat rajonale dhe evropiane, diabeti mellitus dhe hipertensioni arterial përbëjnë shkaktarët kryesorë etiologjikë. Ndërgjegjësimi publik për SKV luan një rol kyç në parandalim, diagnostikim të hershëm dhe trajtim efektiv.

Qëllimi: Të vlerësohet niveli i njohurive dhe perceptimit të popullatës së përgjithshme në lidhje me sëmundjet e veshkave.

Materiale dhe metoda: U krye një studim i tipit cross - sectional me përfshirjen e individëve nga zona urbane dhe rurale, pa histori të njohur të ndonjë sëmundje renale, diabet apo hipertension. Pjesëmarrësit plotësuan një pyetësor të strukturuar që përmbante pesë pyetje të përgjithshme dhe tetë të veçanta, të përgatitura për të vlerësuar ndërgjegjësimin, perceptimin e rrezikut dhe njohuritë mbi SKV.

Rezultate: Studimi përfshiu 1844 pjesëmarrës me moshë mesatare 44 ± 18 vjeç; 57. 1% ishin femra, 86. 6% banonin në zona urbane, 54. 4% kishin arsim universitar dhe 9. 6% ishin të papunë. Në total, 20. 6% raportuan se njihnin një person me sëmundje të veshkave, ndërsa 12. 9% nuk kishin kryer asnjëherë test urinar " urine komplet". Lidhja ndërmjet diabetit dhe SKV njihej nga 52. 8% e pjesëmarrësve; 29. 21% e mohuan dhe 18. 01% nuk kishin informacion. Ndërkohë, 75. 69% pranuan lidhjen midis hipertensionit dhe SKV, por vetëm 47. 2% njohën marrëdhënien dykaheshe shkak - pasojë. Sëmundjet më të përmendura ishin gurët në veshka (40.

19%) dhe infeksionet e traktit urinar (36. 2%). Vetëm 13. 6% dhanë përgjigje plotësisht të sakta. Niveli i njohurive ishte dukshëm më i lartë te personat që kishin një të afert me sëmundje renale (p = 0. 01) dhe tek banorët urbanë (p = 0. 039). Nuk u vërejtën dallime statistikisht të rëndësishme sipas arsimit, gjinisë, moshës apo statusit të punësimit.
Përfundime: Rezultatet e këtij studimi tregojnë mungesë të konsiderueshme informacioni mbi SKV, veçanërisht lidhur me marrëdhënien e saj me diabetin dhe hipertensionin. Nevojiten programe edukative të strukturuara që të zgjerojnë njohuritë përtej koncepteve të kufizuara si nefrolitiaza apo infeksionet urinare, duke theksuar rëndësinë e faktorëve metabolikë dhe vaskularë në zhvillimin e sëmundjes kronike të veshkave.

Fjalë kyçe: Sëmundje, veshka, edukim i popullatës.

MONITORIMI AMBULATOR I PRESIONIT ARTERIAL TEK PACIENTËT E TRANSPLANTUAR: METODË E SAKTË PËR VLERËSIMIN E HIPERTENSIONIT.

N. Pasko, A. Strakosha, A. Imeraj, V. Cadri, I. Nasufi
Shërbimi i Nefrologjisë, Qendra Spitalore Universitare, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Hipertensioni është një nga ndërlikimet më të shpeshta dhe klinikisht të rëndësishme pas transplantit të veshkave. Ai prek deri në 80% të pacientëve të transplantuar dhe është një faktorë kryesor i humbjes së organit të transplantuar dhe morbiditetit kardiovaskular. Matjet konvencionale të matjes se presionit arterial (PA) shpesh nuk evidentojne vlerat e larta të PA, duke çuar në nëndiagnozë dhe kontroll jo optimal. Përmbledhje e evidencave: Monitorimi ambulator i presionit arterial (MAPA) ofron një profil të PA 24 - orësh, duke ofruar saktësi me te mire diagnostikuese krahasuar me matjet individuale te PA. MAPA identifikon hipertensionin e fshehtë, efektin e bluzës së bardhë dhe modelet anormale cirkadiane. Studimet tregojnë se hipertensioni gjatë natës lidhet me uljen e funksionit te graftit, rritjen e proteinurinë dhe hipertrofinë e ventrikulit të majtë. MAPA gjithashtu identifikon pacientët me hipertension që mund të duken normotensivë në klinikë, duke mundësuar trajtim adekuat. Për më tepër, vlerat e MAPA - s, duke përfshirë vleren e PA gjatë natës dhe PA sistolike mesatar ne 24 - orë, janë shoqëruar në mënyrë të pavarur si me mbijetesën e graftit ashtu edhe me atë të pacientit. Implikimet Klinike: Integrimi i MAPA në ndjekjen post transplant ofron një kontroll më të mirë të PA. MAPA ndihmon në optimizimin e regjimeve antihipertensive, vlerësimin e efikasitetit të barnave dhe uljen e rreziqeve afatgjata kardiovaskulare dhe renale. MAPA gjithashtu ndihmon në diferencimin e hipertensionit të vërtetë rezistent nga fenomeni i bluzës së bardhë, duke ulur trajtimin e panevojshëm. Pavarësisht vlerës në përdorimin klinik te MAPA - s, ai mbetet një ekzaminim që nuk përdoret gjerësisht në klinikë për shkak të kufizimeve kohore dhe ndërgjegjësimit të kufizuar midis klinicistëve.
Përfundime: MAPA është një metodë e vlefshme por pak e përdorur ne vlerësimin e saktë të hipertensionit tek pacientët e transplantuar. Udhëzimet e fundit të KDIGO dhe ESH rekomandojnë përdorimin e MAPA si një ekzaminim plotësues për monitorimin e PA në zyrë dhe në shtëpi në pacientet e transplantuar. Standardizimi i protokolleve të MAPA dhe strategjive të aplikimit mund të lehtësojë perdorimin më të gjerë në praktikën rutinë të nefrologjisë. Vlera e tij për të zbuluar hipertensionin e maskuar dhe të natës ofron një vlerësim më të mirë kardiovaskular dhe të graftit. Përdorimi rutinë i MAPA duhet të inkurajohet për të përmirësuar menaxhimin e personalizuar dhe për të përmirësuar rezultatet afatgjata.

Fjalë kyçe: Monitorimi ambulator, presion arterial, pacientët e transplantuar.

SPEKTRI ETIOLOGJIK I NEUROPATITE INFEKTIVE.

N. Kryemadhi[1], E. Ramosaco[1], E. Petoshati[1], M. Kokici[2], D. Kolldani[1], V. Mano[2], N. Como[1]
Shërbimi Infektiv, QSUT[1]
Shërbimi i Laboratoreve, QSUT[2]

Abstrakt

Hyrje: Evidentimi i hershëm i shkaktarit mikrobik të Neuropative Infektive (NI) është mjaft i rëndësishëm në trajtimin etiologjik si hallka më e rëndësishme e trajtimit kompleks të NI, duke ulur kështu mortalitetin dhe riskun për sekela neurologjike irreversibile.

Qëllimi: Analizim i aspekteve epidemiologjike, etiologjike, terapeutike dhe prognostike të Neuropative të shkaktuara nga patogjenët mikrobikë.

Materiale: Përfshin 35 raste me Neuropati Infektive, të hospitalizuar në Shërbimin Infektiv gjatë viteve 2020 - 2024.

Metoda: Studim i tipit analitiko - deskriptiv, retrospektiv. Kemi grupuar rastet sipas shkaktarëve etiologjikë si dhe i klasifikuam ato sipas fenotipeve klinike neurologjike. Kërkuam korrelacionin e mundshëm midis shkaktarëve etiologjikë me prognozën si dhe përcaktuam mortalitetin. Të dhënat janë marrë nga kartelat, regjistrat dhe databaza i Shërbimit Infektiv, QSUT.

Rezultate: Sipas shkaktarëve mikrobikë: Baktere 9 (S. aureus 2, S. hemoliticus 1, E. fecalis 1, P. aeruginosa 1, Brucela spp. 1, Corynebacterium afermentans 1, M. tuberculosis 2); Viruse 24 (H. zoster 12, H. simplex 1, WNV 7; SARS - COV - 2 3, HIV 1 rast); Pa etiologji 2. Sipas fenotipit klinik neurologjik: Sindroma Guillain - Barré 3 raste; Polineuropatia demielinizuese 1; Miokloni periferik (spinal) 2; Parkinsonizëm akut 4; Plexit brakial 1; Radikulopati kraniale 4 (vestibulit 1, neurit i nervit okulomotor 1, neurit i nervit facial 2); Neurit i nervit frenik 1; Neuralgjia post - herpetike 6; Parestezia tranzitore 3; Inkontinenca urinare 1; Radikulopati kompresive 7 (lumbare 4; sakrale 2; torakale 1); Mortaliteti 1 / 35.

Përfundime: Si shkaktarë mikrobikë më të shpeshtë të neuropative në pacientët tanë mbizotëruan viruset me 68. 75%, WNV në 31. 81% të tyre. Evidentuam 11 forma klinike, që variuan nga format e lehta të parestezisë e deri tek tetraplegjia e plotë.

Fjalë kyçe: neuropati infektive, spektri etiologjik, mortalitet, fenotip.

SEKSUALITETI TE ADOLESHENTËT ME AUTIZËM.

Msc. Nevila Toska

Abstrakt

Hyrje: Në këtë ministudim është trajtuar seksualiteti tek adoleshentët me autizëm. Kjo çështje është shumë pak e trajtuar në Shqipëri dhe një pjesë e konsiderueshme e njerëzve kanë pak njohuri rreth jetës seksuale të adoleshentëve me autizëm.

Qëllimi: Eksplorimi i sjelljeve seksuale të adoleshentëve me autizëm.

Metodologjia: Një kampion prej 5 adoleshentësh të diagnostikuar me autizëm janë përfshirë në proçesin e vëzhgimit dhe u realizuan 10 intervista me mësueset e shkollës speciale "Luigj Gurakuqi". Duke u nisur nga përvoja në institucionet e kujdesit për personat me aftësi të veçanta dhe opinionet e ndryshme të stafit të këtyre insitucioneve rreth sjelljeve të adoleshentëve me autizëm, kanë shërbyer si një nga nismat kryesore për të realizuar këtë studim. Një pjesë e madhe e stafit të këtyre insitucioneve i konsideronin si aseksual adoleshentët me autizëm. Ajo që është kërkuar të arrihet në këtë ministudim është eksplorimi kryesisht i interesit seksual dhe llojeve të sjelljeve që shfaq adoleshenti me autizëm. Nga të dhënat e mbledhura, analiza e tyre, është arritur në përfundimin që: subjektet e përfshirë në këtë studim shfaqnin sjellje të ndryshme seksuale. Parafilitë, kontakti fizik, të puthurit, të përqafuarit, prekja e pjesëve intime të trupit të tyre dhe të personave të tjerë u shfaqën tek të gjithë subjektet. Adoleshetët masturbonin në klasë gjatë orës së mësimit duke përdorur mjete të ndryshme rrethanore duke përfshirë këtu edhe mjetë që përbënin rrezik për shëndetin e tyre. Disa nga mjetet më të përdorshme ishin karriget, kaloriferi, mjete prerëse, lodra të ndryshme. Vetëm një pjesë e subjekteve jargoseshin kur përqafonin apo ishin në kontakt me perosna të tjerë. Adoleshenti me autizëm shfaq sjellje dhe interes seksual.

Fjalë kyçe: Autizëm, seksualitet, seksualiteti tek adoleshentët, masturbim.

ZAKONET E PËRDORIMIT TË ÇANTAVE, BESIMET DHE QËNDRIMET LIDHUR ME DHIMBJEN E SHPINËS TEK STUDENTËT E UNIVERSITETIT.

Pt. Nida Qono

Abstrakt

Hetimi i Zakoneve, Besimeve dhe Qëndrimeve të Përdorimit të Çantave Lidhur me Dhimbjen e Shpinës tek Studentët e Universitetit. Universiteti Marmara, Fakulteti i Shkencave të Shëndetit, Departamenti i Fizioterapisë dhe Rehabilitimit, Tezë Universitare, Stamboll 2023. Qëllimi i këtij studimi ishte të hetonte qëndrimet dhe besimet në lidhje me dhimbjen e shpinës në mesin e studentëve të universitetit bazuar në modelet dhe zakonet e tyre të përdorimit të çantave. Studimi përfshinte 127 studentë universiteti me një moshë mesatare prej 18+ / - 17 vjeç, pa probleme të njohura mjekësore dhe që përdornin çanta shpine, çanta laptopi zyre, çanta me rripa të gjatë, çanta beli dhe çanta të vogla gjatë viteve të tyre të shkollës. Pas marrjes së pëlqimit të informuar, u përdor Shkalla e Qëndrimeve ndaj Dhimbjes së Shpinës. U mblodhën informacione demografike dhe u vlerësua stili i mbajtjes së çantave të shpinës: me një rrip të vetëm, me dy rripa, për t'u mbajtur në dorë, për t'u mbajtur në shpatull, njëanshme, dypalëshe dhe për të mbajtur në të gjithë trupin. Mbajtja unilaterale e çantave të shpinës, krahasuar me mbajtjen bilaterale, është raportuar të shkaktojë lëkundje posturale, anim të pasmë të legenit, çrregullime të ecjes, kinetikë dhe kinematikë të ndryshuar të ecjes, anim të përparmë të kokës, qëndrim të përkulur dhe dhimbje mekanike të shpinës së poshtme. Përdorimi i gjerë i çantave të shpinës jo vetëm që shkakton dhimbje të shpinës së poshtme dhe çrregullime posturale, por edhe hernie diskale lumbare. Faktorët biopsikosocialë konsiderohen gjithashtu se ndikojnë në dhimbjen e shpinës së poshtme. Metodat dhe llojet e mbajtjes së çantave u vlerësuan në parametra të ndryshëm, dhe llojet më të përdorura të çantave ishin çantat e shpinës dhe çantat me rripa të gjatë. Nuk u gjet asnjë ndryshim statistikisht i rëndësishëm (p>0. 05) në vlerat mesatare VAS në vlerësimin e dhimbjes në qetësi dhe nivele aktiviteti. Përveç kësaj, çanta e laptopit të zyrës u ekzaminua sipas katër parametrave, varësisht nga mënyra se si u përdor: në dorë, me një rrip në shpatull, ndonjëherë në dorë, ndonjëherë me një rrip dhe jo në përdorim. Duke marrë parasysh vlerat VAS në nivelet e qetësi dhe aktivitetit, nuk u gjet asnjë ndryshim statistikisht i rëndësishëm, pasi vlera p për të dy grupet dhe të katër parametrat ishte më e madhe se 0. 05 (p>0. 05).

Fjalë kyçe: Dhimbja e shpinës, postura, çanta.

ANEMITË E RËNDA NË PERIUDHËN NEONATALE: KËNDVËSHTRIM I PLOTË I SHKAQEVE.

Niketa Koliçi[1], E. Gjylbegu[1], A. Jonuzi[1], V. Lekgjika[1], L. Marku [2,] E. Koliçi [3]
[1]*Shërbimi i Neonatologjisë, Spitali Amerikan 3, Tiranë*
[2]*Shërbimi i Laboratorit, Spitali Amerikan 3, Tiranë*
[3]*Fakultetii Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*

Abstrakt

Hyrje: Anemia neonatale është një shkak i rëndësishëm i sëmundshërisë të të porsalindurve. Shkaqet e saj ndahen në tre kategori: humbje gjaku, rritje e shkatërrimit të RBC - ve ose ulje të prodhimit të RBC - ve. Diagnostikimi i shpejtë dhe trajtimi i menjëhershëm janë thelbësore për rezultate të mira. Gjetja e shkaqeve të mundshme është gjithashtu thelbësor për të parandaluar ndërlikime të mëtejshme për të porsalindurin dhe nënën e tij. Anemia përcaktohet si përqendrim i hematokritit (Hct) ose hemoglobinës (Hgb) >2 SD nën mesataren për moshën. Ndikimi kryesor fiziologjik i anemisë është ulje e furnizimit me oksigjen në inde, duke rezultuar në përgjigje kompensuese dhe pasoja akute ose kronike, duke përfshirë ulje të ritmeve të rritjes. Anemia përkufizohet si Hct <45% tek një foshnjë në term.

Objektivi: Të identifikohen të porsalindurit me "anemi të rëndë në lindje", të përcaktuar nga një hemoglobinë / hematokrit brenda gjashtë orëve të para pas lindjes që paraqitej nën percentilin e 1 - rë sipas moshës gestacionale. U bë një analizë retrospektive e të dhënave të të porsalindurve në spitalin Amerikan 3 për periudhen nga janarit 2017 deri në qershor 2025, të cilët kishin një hemoglobinë ose hematokrit, të matur brenda gjashtë orëve të para pas lindjes, nën intervalin e referencës më të ulët të percentilit të 1 - rë (hematokriti ∼35% tek të porsalindurit > 35 javë. Në shumicën e rasteve anemia u diagnostikua gjatë 24 orëve të para. Anemia kishte më shumë gjasa të regjistrohej si problem (85%) nëse hemoglobina ishte 2 g / dL ose më shumë nën percentilin e 1 - rë (P<0. 001). Vlerat më të ulëta të hemoglobinës ndodhën tek ata ku hemorragjia ishte shkaku

i mundshëm (P<0. 013 kundrejt hemolizës dhe P<0. 001 kundrejt hipoprodhimit, shkaqeve të kombinuara ose të papërcaktuar). Trajtimi iu dha 39. 5%. Rishikimi retrospektiv sugjeroi që mekanizmat e përzier, veçanërisht hemorragjike plus hemolitike, ndodhnin më shpesh. Nje rol të rëndësishëm duket se luajnë edhe shkaqet infektive, kryesisht Parvovirus 19.
Përfundime: Anemia e rëndë në lindje është një shkak i rëndësishëm i sëmundshmërisë të të porsalindurve. Ne supozojmë se njohja më e hershme dhe diagnozat më të sakta do të lehtësoheshin nga një njohje më e plotë e historikut të lindjes dhe një nomogram i moshës gestacionale të hemoglobinës / hematokritit.

Fjalë kyçe: Neonatologjia, anemia neonatorale, transfuzioni fetomaternal.

NDIKIMI I STËRLODHJES NË OBSTETRIKË - GJINEKOLOGJI.

Dr. Odeta Hoxhaj, Dr. Eneida Dede
SUOGJ "Mbreteresha Geraldinë"

Abstrakt
Hyrje: Stërlodhja është një përgjigje psikologjike ndaj stresit të punës që karakterizohet nga rraskapitja emocionale, depersonalizimi dhe reduktim i ndjenjës së arritjeve personale. Obstetrika dhe Gjinekologjia është një fushë me stres të lartë profesional, që çon në numër të konsiderueshëm stërlodhjeje. Studimet kanë treguar se 43% e specialistëve Obstetër - Gjinekologë në shkallë botërore kanë përjetuar stërlodhje, krahasuar me 20 - 24% të specialiteteve të tjera. Në një reportim të vitit 2017 të ACOG, vlerësohej se 40 - 75% e Obstetër - Gjinekologëve kishin përjetuar stërlodhje (humbje kontrolli, mospërfundim i detyrave në kohë dhe zvogëlim i ndjenjës së arritjeve profesionale). Simptomat variojnë nga ndjenja të nënvlerësimit dhe lodhjes së patrajtuar, në cinizëm, depresion, simptoma fizike dhe sëmundje. Stërlodhja është e lidhur me kënaqësi të pakët profesionale, vënien në diskutim të zgjedhjeve profesionale dhe largim nga profesioni, duke ndikuar kështu në shqetësimet për forcën e punës dhe kërkesat e pacientëve. Ndërgjegjësimi për simptomat dhe disa teknika të thjeshta për uljen e lodhjes dhe stesit, kanë ulur rrezikun e të qënit të stërlodhur dhe mosdaljes nga kjo spirale. Ndërhyrjet e suksesshme variojnë nga shtimi i orëve të gjumit, në kalim kohe jashtë spitalit dhe pushime, deri në ndërhyrje profesionale të specializuara. Ndoshta duhet marrë parasysh edhe reduktimi i orëve të punës.

Fjalë kyçe: Strëlodhje, obstetër - gjinekolog, stres, ndërhyrje.

ROLI I TRIKOSKOPISË NË DIAGNOZËN DIFERENCIALE TË ALOPECIA AREATA DHE TRICHOTILLOMANIA ME PREKJE TË VETULLAVE DHE QERPIKËVE - KRAHASIM I DY RASTEVE PEDIATRIKE.

Oljeda Kaçani[1], Monika Fida[2], Arbnore Tafica[3]
[1]*Klinika Dermatologjike A Derma, Tiranë, Shqipëri*
[2]*Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri*
[3]*Spitali Hygeia Tiranë, Shqipëri*

Abstrakt
Hyrje: Humbja e vetullave dhe qerpikëve te fëmijët mund të jetë shqetësuese si për pacientët ashtu edhe për prindërit. Ky fenomen mund të ketë shkaqe të ndryshme, përfshirë ato autoimmune, endokrinologjike, virale, gjenetike, neoplastike dhe traumatike. Tek fëmijët, alopecia areata dhe trichotillomania përbëjnë ndër shkaqet më të zakonshme, megjithatë dallimi midis tyre shpesh paraqet vështirësi diagnostike.
Prezantim i rasteve: Rasti 1: Një djalë 14 - vjeçar u paraqit me humbje të vetullave dhe qerpikëve prej një viti. Në ekzaminim u vu re rënie difuze dhe e parregullt e flokëve në të dy vetullat dhe qerpikët, pa prekje të skalpit. Testi i tërheqjes së flokëve (*hair pull test*) ishte negativ. Trikosopia tregoi flokë të këputura në nivele të ndryshme, pika të zeza (*black dots*), flokë në formë grepi (*hook hairs*), flokë në formë tulipani (*tulip hairs*) dhe flokë në formë flake (*flame hairs*), gjetje që mbështetën diagnozën e **trichotillomania.** Rasti 2: Një vajzë 12 - vjeçare paraqiti humbje të vetullave dhe qerpikëve prej tre muajsh. Në ekzaminim u vunë re vatra të mirëkufizuara pa flokë, pa prekje të skalpit. Testi i tërheqjes së flokëve ishte pozitiv. Në trikoskopi u identifikuan

folikuj bosh, pika të zeza (*black dots*) dhe flokë në formë pikëçuditëse (*exclamation mark hairs*), duke konfirmuar **alopecia areata.**
Përfundime: Trikosopia është një mjet diagnostik thelbësor për të diferencuar **trichotillomania** nga **alopecia areata.** Edhe pse e raportuar rrallë në literaturë, trichotillomania duhet marrë në konsideratë si një shkak i mundshëm i humbjes bilaterale të vetullave dhe qerpikëve tek fëmijët.

Fjalë kyçe: Trikoskopi, trichotillomania, alopecia areata.

NDIKIMI I GJUMIT TË PAMJAFTUESHËM NË HORMONET LEPTINË DHE GHRELINË DHE RREZIKUN PËR OBEZITET.

Olta Meroveci

Abstrakt
Hyrje: Gjumi është një komponent thelbësor i shëndetit fiziologjik dhe mendor, i cili ndikon në proceset hormonale, metabolike dhe njohëse të organizmit. Në dekadat e fundit, gjumi i pamjaftueshëm është shndërruar në një problem global të shëndetit publik, i lidhur ngushtë me shtimin në peshë, obezitetin dhe çrregullimet metabolike. Hormonet leptinë dhe ghrelinë luajnë rol kyç në rregullimin e oreksit dhe ekuilibrit energjetik: leptina, e prodhuar nga indi dhjamor, sinjalizon ndjesinë e ngopjes, ndërsa ghrelina, e prodhuar nga stomaku, nxit urinë. Privimi i gjumit ndryshon ndjeshëm balancën midis këtyre hormoneve, duke ulur leptinën dhe rritur ghrelinën, çka çon në konsum të shtuar kalorik dhe akumulim të yndyrës trupore. Këto ndryshime kontribuojnë në zhvillimin e obezitetit dhe rrisin ndjeshëm rrezikun për diabet mellitus tip 2 dhe sindromë metabolike.
Qëllimi: Ky rishikim synon të përmbledhë dhe analizojë provat shkencore mbi ndikimin e gjumit të pamjaftueshëm në nivelet hormonale të leptinës dhe ghrelinës, si dhe të vlerësojë efektet e tyre në rrezikun për obezitet dhe çrregullimet metabolike që e shoqërojnë atë. Gjithashtu, synohet të vlerësohen faktorët biologjikë dhe të sjelljes që ndërmjetësojnë këtë lidhje, me qëllim identifikimin e strategjive parandaluese efektive në praktikën klinike.
Metodologjia: U realizua një rishikim sistematik i literaturës përmes bazave të të dhënave PubMed, ResearchGate dhe PLOS Medicine. Përzgjedhja përfshiu studime origjinale, vëzhguese dhe eksperimentale, si dhe meta - analiza të publikuara midis viteve 2004–2024, që shqyrtonin lidhjen midis reduktimit të gjumit dhe ndryshimeve në nivelet e leptinës, ghrelinës, insulinës dhe parametrave metabolikë. Janë analizuar gjithashtu studime të kohortave afatgjata që vlerësojnë ndikimin e privimit të gjumit në shtimin e peshës trupore dhe zhvillimin e obezitetit tek fëmijët dhe të rriturit.
Rezultate: Të dhënat nga studimet ndërkombëtare tregojnë qartë se kufizimi i gjumit ndikon ndjeshëm në homeostazën hormonale. Në një studim eksperimental dy - ditor, kufizimi i gjumit në 4 orë për natë shkaktoi ulje me 18% të leptinës dhe rritje me 28% të ghrelinës, duke shoqëruar këtë ndryshim me shtim të ndjeshëm të urisë për ushqime të pasura me karbohidrate dhe yndyrë. Metanalizat që përfshijnë mbi 600, 000 pjesëmarrës kanë treguar se individët që flenë më pak se 6 orë në natë kanë një rrezik 15–40% më të lartë për obezitet, krahasuar me ata që flenë 7–8 orë. Studimet afatgjata tek fëmijët tregojnë se privimi kronik i gjumit gjatë moshës 5–9 vjeç dyfishon rrezikun për obezitet në krahasim me fëmijët që flenë mjaftueshëm. Gjithashtu, privimi nga gjumi është lidhur me ulje të ndjeshmërisë ndaj insulinës, rritje të kortizolit dhe çrregullim të ritmit cirkadian, faktorë që përshpejtojnë zhvillimin e sindromës metabolike dhe diabetit tip 2. Mekanizmat e propozuar përfshijnë ndryshime neuroendokrine, sjellje kompensuese të ngrënies dhe reduktim të aktivitetit fizik si rezultat i lodhjes dhe qëndrimit të zgjatur zgjuar.
Përfundime: Gjumi i pamjaftueshëm përbën një determinant të rëndësishëm dhe shpesh të nënvlerësuar në zhvillimin e obezitetit. Evidencat sugjerojnë se rregullimi i gjumit, përmirësimi i cilësisë së tij dhe ndërgjegjësimi publik për rolin e tij metabolik duhet të bëhen pjesë integrale e strategjive parandaluese të obezitetit dhe diabetit. Praktikat klinike duhet të përfshijnë vlerësimin rutinë të higjienës së gjumit, ndërsa programet komunitare duhet të nxisin ndërhyrje të kombinuara që përfshijnë edukimin shëndetësor, aktivitetin fizik dhe menaxhimin e stresit. Promovimi i gjumit të shëndetshëm mund të përfaqësojë një strategji efektive, me kosto të ulët dhe ndikim të madh në shëndetin publik.

Fjalë kyçe: Gjumi, leptina, ghrelina, obeziteti, metabolizmi, sindroma metabolike, kortizoli, diabeti tip 2, shëndeti publik.

AKI DHE HYPERURICEMIA.

Qurku. O[1], Idrizi. A[2]
[1]Nefrologe pranë shërbimit të mjekësisë interne, spitali rajonal Gjirokastër
[2]Nefrologe pranë shërbimit të nefrologjisë, transplantit dhe dializës, QSUT "Nënë Tereza"

Abstrakt

Hyrje: Dëmtimi renal akut karakterizohet nga një ulje e menjëhershme e filtracionit glomerular që çon në ulje të eleminimit të duhur të toksinave uremike dhe produkteve të fundit të metabolizmit. Ky dëmtim akut renal klasifikohet në disa stade bazuar në magnitudën e rritjes së kreatininës serike dhe uljes së diurezës e cila mund të ndodh brenda disa orësh deri në 7 ditë. Në pacientët e hospitalizuar shkaku më i shpeshtë i këtij dëmtimi akut renal është çrregullimi hemodinamik renal që vjen si rezultat i uljes së perfuzionit arterial renal, kongjestionit venoz renal dhe nga medikamentet të cilat ndikojnë në hemodinamikën glomerulare. Uljen e perfuzionit arterial renal e gjejmë kryesisht te pacientët që paraqiten me diarre, të vjella profuse, hemorragji akute, nga aplikimi i dozave të larta të diuretikëve dhe në rast sekuestrimi në hapësirat e treta. Në të gjitha këto raste kemi një reduktim total të volumit qarkullues. Pacientët që konsiderohen euvolemik gjithashtu mund të paraqiten me ulje të perfuzionit arterial renal në rastet kur presioni arterial është i ulët si në kushtet e shokut distributiv apo nga ulja e tonit vasomotor arterial në kushtet e mbidozimit me preparate antihipertensive. Pacientët me insuficiencë kardiake severe me ulje të fraksionit të ejeksionit ose ata me sëmundje hepatike të dekompesuar mund të paraqiten me dëmtim renal akut nga hipoperfuzioni edhe pse janë hipervolemik. Kështu, në dëmtimin renal akut me shkaqe pre - renale, vihet re një ulje e presionit në nivel të kapilarëve glomerular por me ruajtje të funksionit tubular i cili mundëson riabsorbimin e natriumit dhe ujit. Kështu sistemi i autorregullimit i cili mundëson në këto raste presionin filtrues glomerular dhe GFR realizohet përmes dy mekanizmave: vasodilatacionit të arterioles afferente dhe vasokonstriksionit të arterioles eferente. Medikamentet apo agjentët e tjerë që dëmtojnë këto mekanizma kompensatore përkatësisht AIJS, ACE - inhibitorët dhe ARB mund ta precipitojnë edhe më tej dëmtimin renal. Min Woo Kang & co treguan në studimin e tyre se pacientët e hospitalizuar dhe që paraqiten vlera të larta të acidit urik në gjak prezantuan një risk më të lartë për dëmtim renal akut se pacientët e tjerë. Gjithashtu nivelet e larta të acidit urik u shoqëruan me një risk të lartë për të mos rikuperuar nga dëmtimi renal akut. Meqenëse dëmtimi renal akut është një faktor risku për mortalitet, u sugjerua monitorimi i acidit urik te pacientët e hospitalizuar. Një studim i fundit i realizuar nga Xunliang Li & colleagues tregoi të njëjtin konkluzion si më lart rreth nivelit të lartë të acidit urik dhe mortalitetit në pacientët me dëmtim renal akut.

Metodologjia dhe rezultate: Në spitalin rajonal Gjirokastër gjatë periudhës Shkurt - Dhjetor 2024 ishin hospitalizuar 735 paciente. Në studimin tonë u përfshinë vetëm ata pacientë të cilët ishin vlerësuar për nivelin serik të acidit urik, përkatësisht 132 paciente. Më pas i kategorizuam pacientët të cilët kishin bërë ose jo dëmtim akut renal dhe i vlerësuam njëkohësisht sipas nivelit serik të acidit urik, profilit lipidik, kalcemisë, fosforemisë, albuminës, nivelit të HgB, sëmundjeve bashkëshoqëruese dhe medikamenteve në përdorim të cilat njihen si shkaktarë të hiperuricemisë. Mosha mesatare e të gjithë pacienteve ishte 68, 3 vjeç (70, 4 për meshkujt dhe 67, 6 për femrat). 38, 6% e pacienteve ishin diagnostikuar me dëmtim renal akut, 72, 5% e të cilëve kishin vlera të larta të acidit urik. Pra, pacientët e diagnostikuar me AKI treguan të kishin vlera më të larta të acidit urik krahasuar me ata me funksion renal normal. Gjithashtu, ata kishin prezantuar edhe faktorë të tjerë risku si IKK, SIZ dhe HTA. Përshkrimi i medikamenteve ARB nuk tregoi të ishte faktor risku ndryshe nga diuretikët. Asnjë sinjifikancë nuk u gjet midis dëmtimit renal akut dhe të dhënave të tjera laboratorike.

Konkluzione: Niveli i lartë serik i acidit urik është i shoqëruar me risk të lartë për dëmtim renal akut në pacientët e hospitalizuar, duke sugjeruar kështu nevojën për monitorim të këtij niveli në të gjithë pacientët e hospitalizuar dhe ndjekje të tij edhe pas rikuperimit nga një dëmtim akut renal.

Fjalë kyçe: dëmtim renal akut, acid urik, AKI, HgB.

TË REJAT NË IDENTIFIKIM DHE OPTIMIZIMIN E PROCEDURAVE PARA - TRAJTUESE NË INFEKSIONET PERIPROSTETIKE.

Oltiana Petri[1, 2], Fabiana Giarritiello[3], Arjana Marku[1], Esmeralda Angjeli[1], Dhimitrulla Skuri[1]
[1]*Laboratori i Mikrobiologjisë, Cambridge Clinical Laboratories, Tiranë, Shqipëri*
[2]*Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit, Universiteti i Sporteve të Tiranës, Shqipëri*
[3]*Department of Medicine and Health Sciences "V. Tiberio", University of Molise, 86100 Campobasso, Italy*

Abstrakt
Hyrje: Ky studim përqendrohet në analizën e infeksioneve periprostetike (PJI), përmes një kërkimi të thelluar të rrjedhës klinike të PJI pas operacionit, me vëmendje të veçantë ndaj implikimeve të tyre për kirurgjinë e përsëritur. Objektivi kryesor është të adresohen PJI - të, të njohura si një nga ndërlikimet më të rëndësishme në fushën kirurgjikale. Kjo temë është veçanërisht e rëndësishme për vendet ku praktikat diagnostikuese mikrobiologjike janë ende në zhvillim e sipër, siç është Shqipëria, ku terapitë empirike me antibiotikë me spektër të gjerë ende përdoren zakonisht, me rreziqet e shoqëruara të efikasitetit të reduktuar dhe rezistencës së rritur antimikrobike.
Materiale dhe metoda: Ne hetuam mënyra të ndryshme të fillimit të infeksionit, duke përfshirë kontaminimin direkt, përhapjen hematogjene dhe infeksionet e përsëritura. Prania e trupave të huaj, siç janë implantet, rrit rrezikun e infeksionit, kryesisht për shkak të formimit të biofilmit. Për ta parandaluar këtë, ne eksploruam metodat e para - trajtimit kimik duke përdorur ditiotreitol (DTT), një teknikë laboratorike e validuar dhe e riprodhueshme e rekomanduar nga udhëzimet italiane të AMCLI (Shoqata e Mikrobiologëve Klinikë Italianë). DTT shbërbën në mënyrë efektive biofilmin bakterial, duke bërë të mundur rritjen e patogjenëve në kultura dhe duke zvogëluar gabimet diagnostike (pozitive dhe negative të rreme).
Rezultate: Përdorimi i trajtimit paraprak me DTT përmirëson ndjeshëm saktësinë e identifikimit të patogjenëve tek PJI. Kjo u lejon mjekëve të përshkruajne target terapi antimikrobike, në kontrast me përdorimin empirik të antibiotikëve me spektër të gjerë që dobësojnë imunitetin dhe përshpejtojnë rezistencën antimikrobike. Rritja e spensitivitetit dhe specificitetit diagnostik përmes shpërbërjes të biofilmit ofron një mjet praktik dhe efektiv për laboratorët e mikrobiologjisë.
Konkluzione: Studimi ynë nxjerr në pah një përparim të rëndësishëm në menaxhimin e PJI përmes aplikimit të trajtimit paraprak kimik me DTT. Kjo qasje mundëson identifikimin e saktë të patogjenëve dhe mbështet terapinë me antibiotikun specifik, duke përfaqësuar një hap vendimtar në luftën kundër rezistencës antimikrobike. Promovimi i përdorimit të këtyre strategjive diagnostikuese në laboratorët e mikrobiologjisë mund të luajë një rol thelbësor në përmirësimin e rezultateve të pacientëve dhe përhapjen e një metode inovative të menaxhimit të infeksioneve.

Fjalë kyçe: Infeksione periprostetike, strategji diagnostikuese, laborator.

SPOK NJE SËMUNDJE INFLAMATORE SISTEMIKE.

Dr. Shk. Olvis Petre, Prof. Dr. Silvana Bala, Prof. Dr. Hasan Hafizi

Abstrakt
Hyrje: Sëmundja pulmonare obstruktive kronike (SPOK) është një sëmundje inflamatore pulmonare që karakterizohet nga inflamacioni i rrugëve ajrore, parenkimës dhe sistemit vaskular, por jo vetëm. Ajo konsiderohet sot si sëmundje inflamatore sistemike dhe shpesh është e shoqëruar me sëmundje të tjera në ecurinë e saj. Sëmundjet shoqëruese mendohet që luajnë një rol në ashpersinë e sëmundjes dhe mortalitetin e saj. Lidhur me këtë, një rol gjithnjë e më tepër i atribuohet inflamacionit sistemik.
Qëllimi i studimit: Të evindentojë inflamacionin sistemik të SPOK dhe impaktin e tij në sëmundjet shoqëruese.
Materiali dhe metodologjia: Ky është një studim i tipit rast - seri, i cili konsistoi në rekrutimin e një numri (serie) rastesh klinike, përkatësisht 190 raste, të trajtuar pranë Spitalit Universitar "Shefqet Ndroqi" në Tiranë, i cili u realizua gjatë periudhës kohore 2017 - 2019. U realizua sipas skedës individuale, mbledhja e të dhënave demografike, social - ekonomike, antropometrike, për stilin e jetesës, klinike, imazherike, laboratorike, funksionale, sëmundjet e tjera shoqëruese. Këto të fundit u vlerësuan sipas raportimit të subjekteve dhe ekzaminimi klinik e konfirmimit nga mjeku.
Rezultate: Pjesa më e madhe e të sëmurëve me SPOK kishte proteinë C reaktive të lartë (PCR), e shpërndarë në të gjitha stadet e obstruksionit bronkial. (p=0, 01) Vlerat mesatare të PaO2 sipas vlerave të PCR dhe fibrinogjenit, ishin në mënyrë konsistente më të ulura midis pacientëve të cilët kishin të çrregulluara këto faktorë

(përkatësisht p= 0, 02 dhe p=0, 01). D - dimer nuk paraqiti lidhje sinjifikante statistikore me vlerën mesatare të PaO2 (p=0, 110). Vlerat mesatare të PaCO2 sipas vlerave të PCR, D - dimer dhe fibrinogjenit, ishin në mënyrë konsistente më të larta midis pacientëve të cilët kishin çrregullim të këtyre faktorëve, por D - dimer nuk paraqiti lidhje sinjifikante statistikore me vlerën mesatare të PaCO2(p=0, 158) PCR mbi vlerat normale është në mënyrë konsistente e pranishme pothuajse në të gjithë pacientët me sëmundje shoqëruese, krahasuar me pacientët të cilët nuk kanë këto bashkëshoqërime. Vlera mesatare e leukociteve tek pacientët me bronkektazi dhe PCR në vlera mbi normë, është në mënyrë sinjifikante më e lartë krahasuar me pacientët e tjerë (p<0. 001).
Konkluzione: SPOK është një sëmundje inflamatore sistemike heterogjene e cila rrallë gjendet si sëmundje e izoluar, ajo është pjesë e një patologjie komplekse multimorbiditeti dhe duhet trajtuar si e tillë. Spiromeria vërteton obstruksionin bronkial, por i sëmuri me SPOK ka nevojë për një sërë ekzaminimesh laboratorike, imazherike dhe ekografike për ndjekjen e tij afatgjatë. SPOK - u është një sëmundje inflamatore sistemike, inflamacion i cili luan rol në rëndimin e tij dhe në shfaqjen apo thellimin e insuficiencës respiratore.

Fjalë kyçe: SPOK, sëmundje shoqëruese, inflamacion sistemik, inflamacion dhe obstruksion bronkial, faktor risku.

FISTULAT ARTERIOVENOZE SPINALE: RISHIKIM I LITERATURËS. PËRVOJA JONË ME TRAJTIMIN ENDOVASKULAR DHE NDJEKJEN AFATSHKURTËR.

Oneda Çibuku
Mjeke Neurologe, Shërbimi Neurovaskular Stroke dhe Post Stroke, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Fistulat arteriovenoze spinale (SAVF) përfaqësojnë malformacione vaskulare të rralla që krijojnë një lidhje jonormale ndërmjet sistemit arterial dhe atij venoz të medullës spinale. Kjo çon në hipertension venoz progresiv, kongjestion dhe dëmtim të qarkullimit venoz medullar, që gradualisht përkthehet klinikisht në deficite neurologjike. Klinikisht, pacientët paraqiten shpesh me dobësi progresive të anësive inferiore, parestezi, çrregullime të urinimit që imitojnë mielopatitë inflamatore apo pathologjitë demielinizante. Në dekadat e fundit, trajtimi endovaskular ka fituar rëndësi të veçantë si alternativë minimalisht invazive ndaj ndërhyrjes mikrokirurgjikale, duke ofruar mundësinë e mbylljes selektive të fistulës përmes agjentëve embolizues të lëngshëm si Onyx apo nBCA. Qëllimi i këtij studimi ishte vlerësimi i rezultateve klinike dhe radiologjike pas trajtimit endovaskular të pacientëve me SAVF.
Metodologjia: Ky studim retrospektiv përfshiu 9 pacientë (6 meshkuj dhe 3 femra) të diagnostikuar me SAVF gjatë periudhës 2022–2025 në një qendër referimi neurovaskular. Mosha mesatare e pacientëve ishte 56. 8 vjeç. Diagnoza u vendos në bazë të rezonancës magnetike (MRI) të shtyllës kurrizore, që tregoi përforcim të palcës dhe vena të dilatuara perimedullare, dhe u konfirmua me angiografi selektive spinale (DSA). Të gjithë pacientët iu nënshtruan embolizimit endovaskular dhe vlerësimi klinik u krye përpara dhe pas ndërhyrjes duke përdorur shkallën e modifikuar Rankin (mRS) dhe Aminoff Logue. Kontrolli imazherik pasues me MRI u krye në intervale 6–12 mujore për të vlerësuar mbylljen e plotë të fistulës dhe përjashtimin e rikthimit të saj.
Rezultate: Rezultatet angiografike treguan mbyllje të plotë të fistulës në 7 nga 9 pacientë (77. 7%), ndërsa dy pacientë (22. 2%) kishin reduktim të ndjeshëm të drenazhit venoz, pa shenja të rrjedhjes reziduale simptomatike. Në ndjekjen mesatare 12 - mujore, 6 pacientë (66. 6%) përmirësuan gjendjen klinike me të paktën 1 pikë në shkallën mRS, ndërsa 3 pacientë mbetën stabilë pa përkeqësim neurologjik. Nuk u raportuan komplikacione madhore gjatë ose pas procedurës, përveç një rasti me rikthim angiografik pas 9 muajsh, i cili u trajtua me sukses kirurgjikalisht. Pacientët që përfituan më shumë ishin ata me fistula dorsale me anatomi të favorshme dhe me deficit motorik në fazat e hershme. Rastet me mielopati të avancuar kishin përmirësim më të kufizuar, duke theksuar rëndësinë e diagnozës së hershme dhe ndërhyrjes në kohë.
Përfundime: Embolizimi endovaskular i fistulave arteriovenoze spinale rezulton një metodë e sigurt dhe efektive, me përqindje të lartë mbylljeje të fistulës dhe me përmirësim të dukshëm të gjendjes funksionale tek shumica e pacientëve. Monitorimi i rregullt me MRI është thelbësor për të identifikuar rikthimet e mundshme, pasi disa fistula mund të rikanalizohen me kalimin e kohës.
Të dhënat tona mbështesin përdorimin e terapisë endovaskulare si qasje të parë në menaxhimin e SAVF, veçanërisht në rastet ku anatomia vaskulare është e përshtatshme dhe rreziku kirurgjikal është i lartë. Në përfundim, menaxhimi multidisiplinar që përfshin neuroradiologët ndërhyrës, neurokirurgët dhe neurologët

mbetet kyç për diagnostikimin e hershëm, trajtimin efektiv dhe ndjekjen afatgjatë të këtyre patologjive komplekse vaskulare.

Fjalë kyçe: Fistulat arteriovenoze spinale (SAVF), embolizimi endovaskular, shkalla Aminoff Logue.

EFEKTI I STËRVITJES AKUTE TË REZISTENCËS ME INTENSITET TË LARTË DHE TË ULËT NË NIVELET E BDNF TE MESHKUJT E MOSHUAR TË SHËNDETSHËM.

Orgesa Qipo[1, 4, 5], Wouter A. J. Vints MD[1, 2, 3], Simona Kušleikienė MD[1], Lina Mickevičienė[1], Ivan Bautmans[4, 5], Vida J. Česnaitienė PhD[1], Mati Pääsuke PhD[6], Oron Levin PhD[1, 7], Nerijus Masiulis PhD[1]

[1]Departamenti i Promovimit të Shëndetit dhe Rehabilitimit, Universiteti i Sporteve të Lituanisë, Kaunas, Lituani

[2]Departamenti i Mjekësisë Rehabilituese, Shkolla Kërkimore CAPHRI, Universiteti i Maastricht - it, Maastricht, Holandë

[3]Qendra e Ekspertizës së Rehabilitimit dhe Audiologjisë, Adelante Zorggroep, Hoensbroek, Holandë

[4]Departamenti i Gerontologjisë, Universiteti Vrije, Bruksel (VUB), Laarbeeklaan 103, B - 1090 Bruksel, Belgjikë

[5]Departamenti Kërkimor "Frailty in Ageing – FRIA", Universiteti Vrije, Bruksel (VUB), Laarbeeklaan 103, B - 1090 Bruksel, Belgjikë

[6]Instituti i Shkencave të Sportit dhe Fizioterapisë, Universiteti i Tartu - t, Tartu, Estoni

[7]Grupi Kërkimor për Kontrollin Motorik dhe Neuroplasticitetin, Grupi i Shkencave Biomedikale, Universiteti Katolik i Leuven - it, Leuven, Belgjikë.

Abstrakt

Plakja shoqërohet me rënie të funksionit neuromuskular dhe konjitiv, pjesërisht të lidhura me uljen e faktorëve neurotrofikë qarkullues si faktori neurotrofik i derivuar nga truri (BDNF). Stërvitja me rezistencë është propozuar si një strategji jofarmakologjike për të përmirësuar neuroplasticitetin, por efektet akute të modaliteteve të ndryshme mbeten të paqarta. Ky studim i kontrolluar i rastësishëm shqyrtoi ndikimin e stërvitjes me kufizim të rrjedhjes së gjakut (BFRT) dhe stërvitjes me rezistencë të lartë (HIRT) mbi nivelet plazmatike të BDNF tek meshkuj të moshuar të shëndetshëm. Gjashtëdhjetë e tre pjesëmarrës (60–75 vjeç) u ndanë në grupe BFRT, HIRT ose kontroll dhe kryen një seancë të vetme ushtrimesh. Mostrat e gjakut u morën para dhe pas stërvitjes për të vlerësuar përgjigjet akute të BDNF dhe laktatit. Nuk u vunë re dallime domethënëse në bazë mes grupeve. Megjithatë, u gjet një ndërveprim i rëndësishëm kohë × grup (F (2, 50) = 4. 454, p =. 017, η^2_p =. 151), ku BFRT shkaktoi një rritje të theksuar të BDNF, ndërsa në grupin kontroll nivelet ranë. Të dyja modalitetet e stërvitjes (BFRT dhe HIRT) shkaktuan rritje më të mëdha të laktatit krahasuar me kontrollin, dhe ndryshimet në laktat korrelonin në mënyrë të moderuar me ndryshimet në BDNF (ρ = 0. 435, p =. 001). Këto gjetje sugjerojnë se BFRT, pavarësisht ngarkesës së ulët mekanike, është efektive në rritjen akute të BDNF qarkullues, ndoshta nëpërmjet mekanizmave të stresit metabolik. BFRT mund të përfaqësojë një strategji praktike dhe neuro - mbrojtëse për të moshuarit që nuk janë në gjendje të kryejnë stërvitje me ngarkesa të larta.

Fjalë kyçe: Plakja, stërvitje, BDNF, BFRT.

KOMUNIKIMI NDËRPERSONAL (PERSONEL MJEKËSOR - PACIENT) SI FAKTORË KYÇ NË SIGURIMIN E KUJDESIT SHËNDETËSOR GJITHËPËRFSHIRËS.

MP. Oriada Lazaj[1], Dr. Juventina Ngjela[2], Cand. Dr. Erind Thartori[2]

[1]Infermiere Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koço Gliozheni"

[2]Pedagog, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, FSHM, Albanian University.

Abstrakt

Hyrje: Komunikimi ndërpersonal midis personelit mjekësor dhe pacientit përbën një element thelbësor në sigurimin e kujdesit shëndetësor cilësor dhe gjithëpërfshirës. Ai nuk kufizohet vetëm në shkëmbimin e informacionit klinik, por përfshin ndërtimin e besimit, empatinë dhe respektin e ndërsjellë. Një komunikim efektiv ndihmon pacientët të kuptojnë më qartë procesin e trajtimit, të ndihen të përfshirë në vendimmarrje dhe të përjetojnë më pak stres e pasiguri gjatë ndërveprimit me profesionistët e shëndetit. Studimet kanë treguar se

komunikimi empatik dhe etik është i lidhur ngushtë me rritjen e kënaqësisë së pacientëve, përmirësimin e sigurisë klinike dhe arritjen e rezultateve më të mira shëndetësore.
Qëllimi: Ky punim synon të analizojë rolin e komunikimit ndërpersonal midis personelit mjekësor dhe pacientëve si një faktor përcaktues në sigurimin e kujdesit shëndetësor gjithëpërfshirës. Objektivat kryesore janë të evidentohen praktikat pozitive të komunikimit, të identifikohen pengesat që ndikojnë në efektivitetin e tij, si dhe të formulohen rekomandime për përmirësimin e ndërveprimit profesional - pacientë. Punimi gjithashtu synon të theksojë rëndësinë e trajnimit të vazhdueshëm të personelit në aftësi komunikative dhe etike, për të rritur cilësinë e përvojës së pacientëve.
Metodologjia: Studimi është bazuar në metodën e kërkimit sasior, përmes administrimit të pyetësorëve të strukturuar në formë elektronike (Google Forms). Kampioni përfshiu pacientë të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme nga institucione të ndryshme shëndetësore në Republikën e Shqipërisë. Të dhënat u analizuan për të vlerësuar perceptimet e pacientëve mbi komunikimin me stafin mjekësor dhe ndikimin e tij në cilësinë e kujdesit të marrë.
Konkluzione: Rezultatet e punimit evidentuan rëndësinë e trajnimeve të stafit shëndetësor përsa i përket rëndësisë së komunikimit, gjë e cila ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së kujdesit për pacientët. Një komunikim i përmirësuar midis stafit mjekësor dhe pacientëve kontribuon në një shërbim më të efektshëm dhe më të besueshëm, që ka ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë e pacientëve dhe përmirësimin e rezultateve klinike.

Fjalë kyçe: Komunikimi ndërpersonal, personel mjekësor, pacientë, cilësia e kujdesit, empatia, kujdesi gjithëpërfshirës.

TOFUS GUTOZ, SI IMITUES I CALCINOSIS CUTIS. LËKURA SI TREGUES I PATOLOGJIVE SISTEMIKE: RAPORTIM RASTI.

Ornela Cela[1], Prof Ermira Vasili[1], Driada Preza[2], Valbona Zenelaj[3]
[1]*Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë, Shqipëri*
[2]*Poliklinika e Specialiteteve Nr. 3, Tiranë, Shqipëri.*
[3]*Spitali Universitar i Traumës*

Abstrakt
Hyrje: Tofi i podagrës mund të imitojë kalcinozën e lëkurës, veçanërisht podagrën e përhapur të lëkurës, një gjendje e rrallë ku tofi të përhapur formohen nën lëkurë. Të dyja janë nyje të lëkurës, por tofi janë depozita kristalesh të buta, të shkumësuara, të uratit monosodium, ndërsa kalcinoza e lëkurës përfshin depozita më të forta të kalciumit. Eshte e rendesishme diferencimi i tyre, pasi trajtimet ndryshojnë ndjeshëm,
Objektivi: Të paraqitet një rast klinik me tofi të podagrës, duke theksuar rëndësinë e lëkurës në diagnostikimin e sëmundjeve sistemike.
Raportim Rasti: Pacienti 75 - vjeçar me diabet u paraqit në departamentin ambulator të dermatologjisë me nyje të mëdha, të kuqe, të fryra dhe të dhimbshme në gjymtyrët e sipërme dhe të poshtme. Dhimbja dhe ënjtja e nyjeve kishin filluar 2 vjet më parë. Ekzaminimi dermatologjik zbuloi nyje të bardha në artikulacione. Pas një vlerësimi klinik, radiografik dhe biokimik, u arrit në përfundimin se kemi të bëjmë me TOPHUS GOUTOZ.
Konkluzione: Podagra është artropatia inflamatore më e zakonshme dhe shkaktohet nga depozitat e uratit monosodium në nyje dhe inde të buta. Kjo patologji është quajtur si "imituesi i madh" për shkak të shumë prezantimeve klinike që mund të ketë, duke e bërë diagnozën një sfidë për ekipin mjekësor.

Fjalë kyçe: Tofus gutoz, calcinosis cutis, lëkura.

MODELET KAPILAROSKOPIKE TEK PACIENTËT POZITIVË PËR SCL - 70 DHE U1 - RNP: NJË ANALIZË KRAHASUESE.

Ornela Gelaj MD, MSc

Abstrakt

Hyrje: Kapilaroskopia e rrudhave të thonjve është një mjet jo - invaziv diagnostikues që përdoret për të vlerësuar përfshirjen mikrovaskulare në sëmundjet e indit lidhor, veçanërisht në sklerodermën sistemike (SSc) dhe sëmundjen e përzier të indit lidhor (MCTD). Autoantitrupat si anti - SCL - 70 dhe anti - U1 - RNP shoqërohen me fenotipe të ndryshme të sëmundjes dhe karakteristika të veçanta kapilaroskopike.

Qëllimi: Të analizohen dhe krahasohen modelet kapilaroskopike të vërejtura tek pacientët pozitivë për autoantitrupat SCL - 70 dhe U1 - RNP.

Materiale dhe metoda: U krye një shqyrtim i të dhënave klinike dhe imazheve kapilaroskopike nga pacientët seropozitivë për SCL - 70 ose U1 - RNP. Modelet kapilaroskopike u klasifikuan sipas standardit të përdorur për sklerodermën: modeli i hershëm, aktiv dhe i vonshëm. U dokumentuan gjithashtu tipare shtesë si kapilarë gjigantë, hemorragji, humbje kapilarësh, neoangiogjenezë dhe çrregullim i arkitekturës vaskulare.

Rezultate: Pacientët me pozitivitet për SCL - 70, zakonisht të lidhur me sklerodermën sistemike difuze, shfaqën mikropatologji të avancuar. Kapilaroskopia në këtë grup tregoi një model të vonshëm të sklerodermës, me humbje të dukshme të kapilarëve, çrregullim të theksuar vaskular dhe kapilarë të deguar që tregojnë neoangiogjenezë. Ndërsa pacientët pozitivë për U1 - RNP, të lidhur më shpesh me MCTD ose sindroma mbivendosëse, paraqitën ndryshime më të lehta mikrovaskulare. Gjetjet kapilaroskopike tek ky grup korresponduan më së shpeshti me një model të hershëm ose jospesifik, të karakterizuar nga kapilarë të mëdhenj të rrallë dhe mikrohemorragji, pa humbje të madhe të kapilarëve apo çrregullim të strukturës vaskulare.

Përfundime: Profilet autoantitrupore SCL - 70 dhe U1 - RNP lidhen me modele të ndryshme kapilaroskopike, që pasqyrojnë ndryshime të ndryshme në patologjinë themelore. Njohja e këtyre modeleve mund të ndihmojë në klasifikimin e sëmundjes dhe monitorimin e progresit mikrovaskular në sëmundjet e indit lidhor.

Fjalë kyçe: Kapilaroskopia e rrudhave të thonjve, SSc, MCTD.

PREZANTIMI I FISTULËS TRAKEOEZOFAGEALE NË DY ADOLESHENTE. DIAGNOZË E VONUAR…?!

Ornela Nuredini MD, PhD, Ilir Peposhi MD, PhD

Shërbimi Pneumologjisë, Kabineti Bronkoskopisë QSRT "Sh. Ndroqi" Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Fistula trakeoezofageale (TEF) rezulton nga dështimi i ndarjes laterale në traktin digjestiv dhe respirator përgjatë zhvillimit embrionik. TEF zakonisht diagnostikohet në fëmijëri, sepse >98% e pacienteve me TEF shoqërohen me atrezi të ezofagut që mund të cojë në komplikacione serioze jetë kërcënuese. Fistula e izoluar pa atrezi ezofageale, e quajtur si tipi H, përbën rreth 4% të malformacioneve trakeoezofageale. Diagnoza e hershme e tipit H të TEF mund të jetë e vështirë sepse simptomat janë jospecifike. Infeksionet e përsëritura të traktit respirator dhe kollat kronike me etiologji të pashpjegueshme duhet t'i bëjnë më të vëmendshëm mjekët drejt kësaj diagnoze.

Raportime rastesh: Rasti 1. Një paciente 17 - vjeçare referonte për infeksione të shpeshta pulmonare dhe bronkoektazi bibazale. Në ekzaminim fizik kishte rale krepitante bilaterale dhe ronke në zonat e poshtme torakale. Radiografia e toraksit tregonte infiltrim bronkial bilateral. CT toraksit tregonte infiltrim bronkial bilateral të zonave bazale dhe konfirmoi diagnozën bronkoaktazia bilaterale. Bronkoskopia fleksibile konfirmoi diagnozën TEF. Rasti 2. Një paciente 15 - vjeçare referonte për kollë kronike dhe pneumoni rekurente. Në ekzaminim fizik kishte rale krepitante dhe ronke në zonat e poshtme të pulmonit dexter. RTG pulmonic tregonte konsolidim në të njëjtën zonë të pulmonit dexter. CT toraksi vihet re fistulë në nivel të vertebrave një dhe dy torakale. Bronkoskopia rikonfirmoi fistulën 2 cm të lokalizuar proksimalisht karinës trakeale. Testet për TBC ishin negative dhe kultura e sputumit ishte sterile. Testet funksionale respiratore dhe ekokardiografia ishin normale. Në të dyja rastet fistula u përcaktua nëpërmjet eksplorimit bronkoskopik dhe u riparua me sukses nëpërmjet kirurgjisë.

Diskutime: TEFi është një anomali e shpeshtë kongenitale e traktit respirator, me një incidencë rreth 1 në 3000 deri 4500 lindje. Shoqërohet me anomali vertebrale, kardiovaskulare dhe renale si vazhdim i atrezisë anale dhe difekteve të limb, të njohura si VACTERL, që ndodh në 30 e 50% të rasteve. Anomalitë e izoluara të trakese dhe ezofagut si trakeomalacia dhe stenoza trakeale dhe ajo ezofageale janë gjithashtu të pranishme. TEF mund të shkatërrojë zhvillimin fiziologjik të pleksit mioenterek të ezofagut në uterus dhe të shkaktojë çrregullim të peristaltikës si dhe dëmtim të funksionit të sfinkterit të ezofagut të poshtëm. Vendi më i shpeshtë i lokalizimit të TEF - it kongenital është afër hyrjes për në toraks. TEF u përshkrua për herë të parë në 1929 nga Negus si një gjetje rastësore post mortum te një pacient adult i cili vdiq nga kanceri pulmonar. TEF rrallë është kongenital te pacientët adultë, ndërkohë që është i shpeshtë me pacientët me malignance, me trauma ekstreme ose kirurgjikale (iatrogjene) me tub nazogastrik, si dhe mbifryrje të tubit endotrakeal. TEF pa atrezi, i njohur ndryshe si tipi H, është forma më pak severe. Nëse defekti është i madh pacientët mund të paraqiten në periudhën neonatale me distension abdominal dhe simptoma respiratore direkt pas ushqimit. Koha e diagnozës së hershme përfshin 26 ditë deri 4 vite. Diagnoza e vonuar është prezantuar rreth moshës 15 vjeç deri në 63 vjeç te paciente asimptomatikë. Kontraksioni i muskujve të murit të fistulës ose lokalizimi oblik i fistulës ndërmjet trakese dhe ezofagut mund t'i mbrojë rrugët e ajrit nga aspirimi gjatë gëlltitjes. Dhe madhësia e vogël e fistulës mund të cojë në prezantim të vonshëm. Një dyshim i fortë klinik duhet të cojë në vendosjen e diagnozës. Diagnoza e një TEFi të izoluar është sfiduese. Fistula mund të demonstrohet dhe nga kryerja e testit të gëlltitjes së bariumit në pozicionin shtrirë. CT scan i toraksit rekomandohet për të parë dëmtimin e parenkimës pulmonare dhe identifikimin e lokalizimit të saktë të fistulës. Bronkoskopia lejon observimin direkt të fistulës, dokumenton prezencën e trakeomalacisë, identifikon lokalizimin korrekt të origjinës së saj, duke ndihmuar kështu në përcaktimin e planit kirurgjikal. Duke përmbledhur çka thamë më sipër, tipi H i TEF - it është i rrallë tek adoleshentët, por mund të paraqitet me sëmundjen kronike pulmonare si pasojë e aspirimeve të përsëritura. Këto case reporte duhet të na tërheqin vëmendjen dhe duhet të na bëjnë që të marrim në konsideratë këtë diagnozë në çdo grupmoshë me kollë dhe infeksione pulmonare rekurente.

Fjalë kyçe: Fistulës trakeoezofageale, adoleshentë, bronkoskopia.

SINDROMI HEMOLITIK UREMIK NË FËMIJË: 10 VITE EKSPERIENCË.

Ornela Xhango[1], Diamant Shtiza[1], Elisa Baca[2], Dorisa Saliasi[2], Andueca Geca[2], Aurora Arolli[2] [1]QSU "Nënë Tereza", Shërbimi Nefrologji Dializë Pediatrike, Tiranë [2] Specializant Departamenti i Pediatrisë.

Abstrakt:

Hyrje: Sindromi hemolitik uremik (SHU) është një nga patologjitë më të shpeshta që çon në dëmtim renal akut në moshën pediatrike. Ai mund të jetë potencialisht jetëkërcënues, por gjithashtu mund të shkaktojë dëme të përhershme renale, për rrjedhojë sëmundje renale kronike (SRK).

Qëllimi: Të studiohen parametrat demografikë, kliniko - laboratorikë dhe ecuria afatshkurtër dhe afatgjatë e fëmijëve me SHU gjatë një periudhe 10 - vjeçare.

Materiali dhe metoda: Një studim retrospektiv observues është zhvilluar në Spitalin Pediatrik (QSUT). Janë marrë në studim fëmijët e shtruar gjatë periudhës janar 2015 – shtator 2025 me diagnozë SHU. Për të gjithë pacientët e përfshirë në studim janë analizuar të dhënat demografike, klinike, laboratorike, komplikacionet dhe ecuria e tyre në fazën akute. Është studiuar gjithashtu ecuria afatgjatë në pacientët që kanë kryer **follow - up** gjatë periudhës së marrë në studim.

Rezultate: Në studim u përfshinë 61 pacientë: 33 femra dhe 28 meshkuj. Mosha 1–3 vjeç ishte më e prekur. Nga të gjitha rastet, u konstatua vetëm një SHU atipik i konfirmuar gjenetikisht. Në rastet e studiuara, 49 raste paraqitnin prodromë diarreike. 40 raste u paraqitën me oligoanuri; hipertensioni ishte prezent në 29 raste. Komplikacione në fazën akute, si konvulsione dhe koma, probleme kardiake, etj u panë në 14 raste. 35 raste patën nevojë për terapi renale zëvendësuese (TRZ). Ditëqendrimi mesatar ishte 2–3 javë. Në lidhje me ecurinë, në fund të studimit kishim këtë panoramë: 39 raste të shëruara plotësisht, 7 **exitus**, 10 me sekela (proteinuri, HTA, SRK) dhe 5 raste të humbura gjatë **follow - up.**

Konkluzione: SHU, pavarësisht përmirësimit të trajtimit pas futjes së TRZ gjatë 15 viteve të fundit, vazhdon të mbetet një rrezik serioz për jetën dhe për dëmtimin e përhershëm të veshkave. Diagnoza e shpejtë dhe trajtimi i menjëhershëm adekuat, si edhe ndjekja e mëtejshme dinamike, minimizojnë këtë rrezik.

Fjalë kyçe: SHU, dëmtim renal, TRZ, oligoanuri, HTA.

SFIDAT DHE QASJET TERAPEUTIKE NË INSUFICIENCËN KARDIAKE ME FRAKSION EJEKSIONI TË ULËT.

Pandush Pojani
Shërbimi i Mjekësisë Interne & HTA, QSU "Nënë Tereza", Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Insuficienca kardiake me fraksion ejeksioni të ulët (HFrEF) mbetet një nga sfidat më të rëndësishme në kardiologjinë bashkëkohore, me prevalencë në rritje dhe ndikim të madh në mortalitet e cilësinë e jetës së pacientëve. Nga të dhënat spitalore 50% e insuficiencave kardiake janë me fraksion ejeksioni të ulur.

Objektiva: Insuficienca kardiake me fraksion ejeksioni të ulur është një sindrom klinik kompleks dhe progresiv. Strategjitë bazë të trajtimit përfshijnë diuretikët për lehtësimin e simptomave dhe përdorimin e terapisë së katërfishtë (bllokuesit e receptorëve të angiotenzinës / frenuesit e neprilizinës, beta - bllokuesit, antagonistët e receptorëve mineralokortikoidë dhe frenuesit e bashkëtransportuesit të natriumit - glukozë 2) për reduktimin e mortalitetit. Medikamente të tjera si hekuri intravenoz, ivabradina, hydralazina / nitratet dhe vericiguat mund të kenë gjithashtu një rol në nëngrupe të caktuara. Grupe të veçanta pacientësh mund të jenë gjithashtu kandidatë për terapi me pajisje, si defibrilator kardiak të implantuar, terapi risinkronizimi kardiak.

Metodologjia: Ndërtimi i temës është bazuar në literaturë të marrë kryesisht nga publikimet e viteve të fundit, në revista prestigjoze, si dhe në udhërrefyesit e Shoqatës Europiane të Kardiologjisë.

Rezultate: Ky rishikim ofron një përmbledhje gjithëpërfshirëse të qasjeve të menaxhimit të barnave dhe pajisjeve, rekomandime për fillimin dhe titrimin e terapive dhe sfidat që lidhen me terapinë mjekësore të drejtuar nga udhëzimet në menaxhimin e këtyre pacientëve.

Konkluzioni: Pavarësisht përparimeve të dukshme në diagnostikë dhe terapi, menaxhimi i këtyre pacientëve kërkon një qasje të integruar që përfshin identifikimin e hershëm të shenjave të dekompensimit, optimizimin e terapisë farmakologjike dhe përdorimin e strategjive të personalizuara trajtuese**.**

Fjalë kyçe: Insuficienca kardiake, fraksioni i ejeksionit, trajtimi.

SHQYRTIMI I ÇRREGULLIMEVE TË GJUMIT TE PACIENTËT E HEMODIALIZËS: RISHIKIM LITERATURE DHE PERSPEKTIVA SHQIPTARE.

Paola Pina[1] Elona Prifti[1] Xhoela Shtëmbari[2] Senada Idrizi[3] Kristian Jongari[4]
[1]*Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, Shqipëri*
[2]*Poliklinika Nr. 1, Lushnje, Shqipëri*
[3]*Spitali Rajonal Shkodër, Shkodër, Shqipëri*
[4]*Spitali Bashkiak Divjakë, Divjakë, Shqipëri*

Abstrakt

Hyrje: Çrregullimet e gjumit janë komplikacione të shpeshta, shpesh të nënvlerësuara te pacientët në hemodializë (HD), që dëmtojnë cilësinë e jetës dhe kontribuojnë në morbiditetin kardiovaskular, konjitiv dhe psikosocial.

Objektiva: Përmbledhja e të dhënave mbi çrregullimet e gjumit te pacientët e HD, vlerësimi i mjeteve dhe terapive të aplikuara në këtë popullatë dhe kontekstualizimi me realitetin shqiptar.

Metodologjia: U realizua një rishikim narrativ i literaturës përmes databazave të PubMed, Scopus, Web of Science dhe Google Scholar për periudhën kohore 2010 - 2025, me fokus çrregullimet e gjumit te pacientët adultë në hemodializë. Studimi përfshiu një analizë të epidemiologjisë, faktorëve të rriskut, mjeteve të diagnostikimit dhe menaxhimit. Rezultatet janë interpretuar gjithashtu në funksion të kontekstit specifik shqiptar të shërbimit të HD.

Rezultate: Meta - analizat konfirmojnë se pagjumësia, Apnea Obstruktive e Gjumit (OSA), Restless Legs Syndrome (RLS) dhe përgjumja e tepërt gjatë ditës (ESD) janë çrregullimet më të shpeshta te pacientët e HD, me prevalenca deri në 46%, 40%, 36% dhe 35% respektivisht. Faktorët kryesorë kontribues përfshijnë mbingarkesën volumore, pruritin, dhimbjen, çrregullimet e humorit, aneminë / mungesën e hekurit, toksinat uremike, kohën e seancave të dializës dhe medikamentet. OSA shpesh mbetet e padiagnostikuar, ku një qasje praktike mbetet depistimi rutinë. Menaxhimi përfshin Continuous Positive Airway Pressure (CPAP) për OSA; Terapinë Kognitive - Biheviorale, ushtrimet e strukturuara, relaksimin / akupunkturën dhe higjienën e gjumit

për pagjumësinë; marrjen e suplementeve të hekurit, përdorim të kujdesshëm të gabapentinoideve / agjentëve dopaminergjikë për RLS dhe një bazë të menaxhimit optimal të mbingarkesës volumore dhe simptomave të përgjithshme. Në Shqipëri, konsumimi i lartë i kripës, mungesa e edukimit të strukturuar dhe diagnostikimit të problematikave të gjumit përkeqësojnë më tej situatën.
Përfundime: Çrregullimet e gjumit në HD janë të shpeshta, me pasoja të rëndësishme, por shpesh të modifikueshme. Realizimi i një programi të depistimit, të përshtatur me kontekstin shqiptar, është i domosdoshëm dhe i realizueshëm. Arritja e këtij objektivi, megjithatë, kërkon prioritizimin e hulumtimit lokal, validimin e protokolleve të thjeshtuara dhe pilotimin e ndërhyrjeve multidisiplinare për të optimizuar rezultatet klinike të fokusuara te pacienti.

Fjalë kyçe: Hemodializa, çrregullimet e gjumit, Shqipëri.

LIDHJA MIDIS PËRDORIMIT TË MARIHUANËS DHE ÇRREGULLIMEVE PSIKOTIKE.

Pasho Maksuti
Doktor në neuroshkencë, psikiatër pranë Shërbimit Psikiatrik të QSU" Nënë Tereza", Tiranë

Abstrakt
Qëllimi: Gjatë konsultave në klinikën e adiksionit shpesh hasim çrregullime të përdorimit të marihuanës. Për këtë arësye mendoj të shtjelloj faktet shkencore mbi problematikat dhe ndërlidhjet e përdorimit të marihuanës dhe të çrregullimeve psikiatrike.
Metoda: Shtjellimi i literaturës shkencore mjekësore.
Rezultate: Edhe se shumë shtete tani lejojnë shpërndarjen e marihuanës për qëllime mjekësore dhe ka prova anekdotike në rritje për efikasitetin e përbërjeve që rrjedhin nga marihuana, FDA nuk e ka miratuar "marihuanën mjekësore". Nëse konsumimi i marijuanës ka përfitime terapeutike që tejkalojnë rreziqet e saj shëndetësore, është ende një pyetje e hapur që shkenca nuk e ka zgjidhur. Marihuana dëmton kujtesën dhe gjykimin afatshkurtër dhe shtrembëron perceptimin si edhe mund të dëmtojë performancën në shkollë ose në punë. Marihuana ndikon gjithashtu në sistemet e trurit që janë ende duke u zhvilluar, kështu që përdorimi i rregullt nga adoleshentët mund të ketë efekte negative afatgjata në zhvillimin e aftësive njohëse. Përdorimi i marihuanës gjatë adoleshencës, më pas mund të shkaktojë forma problematike të varësisë. Hulumtimet e fundit sugjerojnë se konsumimi çdo ditë i marihuanës me fuqi të lartë, mund të rrisë shanset e zhvillimit të psikozës me gati pesë herë në krahasim me njerëzit që nuk kanë përdorur kurrë marihuanë. Sasia e drogës së përdorur, mosha e përdorimit të parë dhe predispozita gjenetike, kanë treguar se ndikojnë në manifestimin e psikozave apo çrregullimeve tjera psikiatrike nga marihuana.
Përfundime: Përdorimi i marihuanës mund të çojë në zhvillimin e përdorimit problematik, i njohur si çrregullim i përdorimit të marihuanës, që merr formën e varësisë apo psikozës në raste të rënda. Të dhënat e fundit sugjerojnë se 30% e atyre që përdorin marihuanë mund të kenë njëfarë çrregullimi të përdorimit të marihuanës ndërsa përdorimi i marihuanës para moshës 18 vjeçare kanë katër deri në shtatë herë më shumë gjasa të zhvillojnë një çrregullim të përdorimit të marihuanës sesa të rriturit.

Fjalë kyçe: marihuana, çrregullimeve psikiatrike, përfitime terapeutike.

OTITIS MEDIA AKUTA TEK FËMIJËT DHE KOMPLIKIMET EKSTRAKRANIALE.

Dr. Pëllumb Sermaxhaj, Aurela Salihu
Doktor i Mjekësisë
Studente e Stomatologjisë, viti i pestë

Abstrakt
Hyrje: Otitis media akuta (OMA) është një infeksion i dhimbshëm i veshit të mesëm që më së shpeshti rezulton nga një superinfeksion bakterial me Streptococcus pneumoniae, Haemophilus influenzae ose Moraxella catarrhalis pas një infeksioni viral të traktit të sipërm respirator. Otitis media akut është një infeksion i zakonshëm tek fëmijët nën moshën 2 vjeç dhe karakterizohet nga një fillim akut i simptomave (p. sh. , otalgji, ethe, anoreksi) me shenja të inflamacionit të veshit të mesëm (p. sh. , membrana timpanike e fryrë, eritemë).

Infeksionet e lehta unilaterale mund të menaxhohen pa antibiotikë, pasi ato shpesh janë vetë - kufizuese. Infeksionet tek fëmijët nën 6 muaj, Otitis media bilateral ose simptomat e rënda zakonisht trajtohen me antibiotikë oralë. Shumica e fëmijëve do të përjetojnë të paktën një episod para moshës pesë vjeç, tek fëmijët me OMA të përsëritur që shkakton simptoma të shpeshta, mund të merret në konsideratë miringotomia dhe vendosja e tubave - timpanostomi. Komplikacioni më i zakonshëm është mastoiditi akut, por mund të ndodhin edhe paraliza faciale, labirintiti dhe në raste të rralla, madje edhe abscese intrakraniale.
Qëllimi: Qëllimi i kësaj teme është të shqyrtojë në mënyrë të detajuar incidencën, shenjat klinike, diagnostikimin dhe trajtimin e komplikimeve ekstrakraniale që lindin si pasojë e otitit media akuta te fëmijët, me fokus të veçantë në rëndësinë e diagnostikimit të hershëm dhe ndërhyrjes adekuate për të parandaluar pasoja të rënda shëndetësore. Gjithashtu, synohet të theksohet nevoja për bashkëpunim multidisiplinar në menaxhimin e rasteve të komplikuara dhe rritjen e ndërgjegjësimit klinik për këto ndërlikime të mundshme në praktikën pediatrike të përditshme.

Fjalë kyçe: Otitis media akuta, komplikime ekstrakraniale, mastoiditis, paraliza e nervit facial, abscesi bezold, infeksionet e indeve të buta, diagnostikim i hershëm, menaxhim pediatrik, parandalimi i komplikimeve.

LIMFOMAT MALINJE.
Petrit Borovci

Abstrakt
Hyrja: Limfoma është një grup i sëmundjeve malinje të gjakut që zhvillohen nga limfocitet (një lloj i qelizave të bardha të gjakut). Emri shpesh i referohet vetëm versioneve kanceroze dhe jo të gjithë tumoreve të tillë. Limfoma është një grup neoplazish malinje të limfociteve me më shumë se 90 nëntipe. Tradicionalisht klasifikohet gjerësisht si limfoma jo - Hodgkin ose Hodgkin.
Qëllimi i punimit: Qëllimi i këtij punimi është që të përshkruhen Limfomat Malinje, te pershkruhen llojet e limfomave, incidence e tyre, prevalence, mundesite e rekurrencave te pershkruhet shenjat klinike si dhe metodat diagnostike.
Materiali dhe metoda: Ky punim paraqet një rishikim të literaturës dhe vlerësim të ndryshimeve potenciale nga të dhëna të ndryshme. Një kërkim fillestar literature është kryer për studimet si raportimet e rasteve qe nga viti 1986 deri te hulumtimet më të fundit të vitit 2021 duke përdorur bazat e të dhënave (Medline, PubMed) dhe motor kërkimin 'Google Scholar'. Artikuj të gjuhës angleze dhe botime abstrakte janë identifikuar duke përdorur fjalë kyçe dhe filtra.
Rezultate dhe konkludime: Si fëmijët ashtu edhe të rriturit mund të zhvillojnë limfomën Hodgkin, por është më e zakonshme në moshën madhore të hershme (veçanërisht në të 20 - at e një personi). Rreziku i limfomës Hodgkin rritet përsëri në moshën madhore të vonë (pas moshës 55 vjeç). Në përgjithësi, mosha mesatare e njerëzve kur diagnostikohen është 39 vjeç. Limfoma Hodgkin është e rrallë tek fëmijët më të vegjël se 5 vjeç. Por është kanceri më i zakonshëm i diagnostikuar tek adoleshentët e moshës 15 deri në 19 vjeç. Shkalla e mbijetesës është përmirësuar në dekadat e fundit, kryesisht për shkak të përparimeve në trajtim. Shkalla e mbijetesës relative 5 - vjeçare për të gjithë pacientët e diagnostikuar me limfomën Hodgkin tani është rreth 87%. Disa faktorë të tillë si stadi (shtrirja) e limfomës Hodgkin dhe mosha e një personi ndikojnë në këto ritme.

Fjalë kyçe: malignant lymphomas, NHG lymphoma, Tumor diagnostics, Hodgkin lymphoma.

KOMPLIKIMET E NUTRICIONIT TOTAL PARENTERAL TE PACIENTËT NË PERIUDHËN POST - OPERATIVE.
Dr. Plaurat Krasniqi
Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

Abstrakt
Hyrje: Nutricioni total parenteral (NTP) është një mbështetje jetike për pacientët që, pas operacioneve të mëdha, nuk mund të ushqehen në mënyrë enterale. Megjithatë, përfitimet e tij shpesh shoqërohen me sfida klinike që mund të ndikojnë në ecurinë postoperative dhe shërimin e pacientit**.**

Qëllimi: Ky punim synon të vlerësojë komplikimet më të shpeshta të NTP - së te pacientët në periudhën postoperative dhe të theksojë rëndësinë e kujdesit të vazhdueshëm dhe monitorimit multidisiplinar.
Metodologjia: Janë shqyrtuar të dhënat e literaturës bashkëkohore dhe përvoja klinike e pacientëve që kanë marrë NTP pas ndërhyrjeve kirurgjikale abdominale. U analizuan komplikimet më të zakonshme metabolike, infektive dhe mekanike.
Rezultate: Hiperglicemia, infeksionet e lidhura me kateterin qendror dhe çrregullimet elektrolitike përbëjnë komplikimet më të shpeshta. Faktorët kryesorë të rrezikut lidhen me gjendjen e përgjithshme të pacientit, mungesën e asepsisë dhe përdorimin afatgjatë të NTP - së. Monitorimi i rregullt laboratorik dhe bashkëpunimi i ngushtë i ekipit mjekësor reduktojnë ndjeshëm këto rreziqe.
Përfundime: NTP mbetet një ndërhyrje thelbësore në kujdesin postoperative, por kërkon vëmendje të vazhdueshme, qasje të individualizuar dhe komunikim të mirë midis profesionistëve shëndetësorë. Parandalimi dhe trajtimi në kohë i komplikimeve ndihmon në përmirësimin e rezultateve klinike dhe cilësisë së jetës së pacientëve**.**

Fjalë kyçe: Nutricioni total parenteral, periudha post - operative, komplikime, kujdes multidisiplinar, monitorim.

KOMPLIKIMET DHE MJEKIMI I OBEZITETIT.
Poemë Rexhepi MD[1], Andi Aliu MD
Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë Kosovë

Abstrakt
Hyrja: Obeziteti mund të përkufizohet si një tepricë e yndyrës në trup. Obeziteti nuk është vetëm një shqetësim kozmetik, është një problem mjekësor që rrit rrezikun e sëmundjeve dhe problemeve të tjera shëndetësore.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi ka qenë të bëhet matja e peshës dhe gjatësisë truporetëpersonave të anketuardhe nëpërmjet këtyre parametrave të bëhet llogaritja e BMI, gjithashtu të vlerësohet shkalla e obezitetit, mënyra e qasjes së tyre në ushtrime, dieta si dhe konsultat me nutricionistë apo dietologë. Gjithashtu të vlerësohet edhe konsumimi i ushqimit te personat e caktuar, komplikimet e mundshme dhe trajtimet e marrura.
Metodologjia: Rastet janë marrë duke u bazuar në anketimin e 80 personave në platformën online. Në studim janë përfshirë dhënat e personave të cilët i janë përgjigjur pyetjeve të formuluara në pyetësor. Pyetësori është formuluar me platformën Google Forms. Analiza statistikore e të dhënave është bërë me programin SPSS. Rezultatet janë të paraqitura në formë të grafikoneve të cilat janë punuar me Excel.
Rezultate: Nga gjithsej 80 persona të anketuar dhe disa prej tyre të trajtuar, nga llogaritja online e BMI rezultuan që 22 persona të jenë me peshënormale, 23 të tjerë mbipeshë dhe 35 persona obezë. Nga gjithsej të anketuar janë: 44 persona të moshës 20 – 45 vjeç (57%), 17 persona mbi 45 vjeç (21, 3%) dhe 19 persona të moshës nën 20 vjeç (23, 8%). Gjithashtu nga komplikimet të cilat iu shfaqën të anketuarve ishin: 36 persona nuk kishin asnjë komplikim (46%), 4 persona– depresion (5%), 18 persona – problem me gjumin (23%), 2 persona – sëmundje të zemrës (2%), 9 persona – hipertension (11%), 8 persona – diabet (9%), 3 persona – infertilitet (4%). Ndërsa nga trajtimet e marrura rezultoi që: 39 persona nuk ishin trajtuar ndonjëherë (49%), 14 persona vetëm aktivitet fizik (17%), 17 persona me dietë (21%), 7 persona me barna (9%) dhe 3 persona – ndërhyrje kirurgjike (4%).

Fjalë kyçe: Obezitet, BMI, yndyrna, komplikacione.

FRAKTURAT E QAFËS SË FEMURIT DHE TRAJTIMI OPERATIV I SAJ.
Qendrim Daci

Abstrakt
Hyrja: Frakturat e qafës së femurit përbëjnë një emergjencë ortopedike me prevalencë të lartë në popullatën geriatrike. Faktorët si osteoporoza dhe trauma të lehta janë ndër shkaktarët kryesorë. Trajtimi kirurgjikal me protezë është bërë metoda e preferuar për shkak të rezultateve të qëndrueshme dhe rikthimit më të shpejtë të funksionit të hipit.

Qëllimi: Ky hulumtim synon të përmbledhë njohuritë ekzistuese mbi llojet e frakturave, shkaqet dhe rëndësinë e vendosjes së protezës për rikthimin e aftësisë funksionale të pacientëve.
Metodologjia: Hulumtimi është realizuar me metodologji teorike, duke u bazuar në analiza të literaturës shkencore, artikujve mjekësorë dhe librave ortopedikë të besueshëm. Burimet janë shqyrtuar në mënyrë përshkruese dhe krahasuese për të nxjerrë përfundime mbi trajtimin dhe rezultatet e protezës.
Rezultate: Literatura tregon se vendosja e protezës ndihmon në rikthimin e lëvizshmërisë dhe pavarësisë funksionale, redukton dhimbjen dhe përmirëson cilësinë e jetës. Përzgjedhja e tipit të protezës dhe teknikës kirurgjikale është kyçe për rezultate optimale dhe për minimizimin e komplikacioneve.
Diskutime: Hulumtimi tregon për rëndësinë e përdorimit të protezës në trajtimin e frakturave të qafës së femurit dhe nevojën për praktika të bazuara në literaturë për rezultate të qëndrueshme klinike.

Fjalë kyçe: Fraktura e qafës së femurit, proteza, trajtim kirurgjikal, ortopedi.

NDRYSHIMET OKULARE TE PACIENTËT ME SËMUNDJE ENDOKRINE JO TË ZAKONSHME: AKROMEGALIA, SINDROMA E CUSHING DHE HIPERPARATIROIDIZMI.

Eglantina Loci, Qendrim Daci

Abstrakt
Hyrje: Sëmundjet endokrine ndikojnë në shumë sisteme të trupit, veçanërisht prekin edhe sistemin vizual. Ndër patologjitë më të shpeshta endokrine që manifestohen me ndryshime okulare janë Akromegalia, Sindroma e Cushing dhe Hiperparatiroidizmi. Njohja dhe kuptimi i këtyre ndryshimeve është bazë për diagnostikim të hershëm dhe menaxhim të duhur të pacientëve.
Qëllimi i studimit: Qëllimi i këtij punimi është të shqyrtojë dhe analizojë ndryshimet okulare që ndodhin te pacientët me sëmundje endokrine si Akromegalia, Sindroma e Cushing dhe Hiperparatiroidizmi, si dhe rolin e oftalmologut në diagnostikim dhe trajtim të hershëm.
Metodologjia: Ky studim është një rishikim literture, i cili është i bazuar në artikuj shkencorë të publikuar në ScienceDirect, Medline, ResearchGate dhe PubMed. Është bërë përmbledhje e literaturës në 5 vitet e fundit, si dhe analizimi i disa prej rasteve klinike.
Rezultate: Akromegalia: rritje e presionit intraokular, shfaqje e neuropatisë optike për shkak të rritjes së tumorit hipofizar (adenoma), rritje e dimensioneve orbitale Sindroma e Cushing: retinopati hypertensive, edemë makulare, glaukoma sekondare për shkak të përdorimit afatgjatë të kortikosteroideve. Hiperparatiroidizmi: Dëmtimet okulare përfshijnë kalcifikime në segmentin e përparmë të syrit (si kornea dhe lenteja), kataraktë, dhe në disa raste kalcifikime të retinës.
Diskutime: Pasi e gjithë vëmendja klinike përqendrohet në simptomat sistemike, manifestimet okulare që shfaqen nga këto sëmundje endokrine janë të nënvlerësuara, gjë që çon në diagnostikim të vonshëm. Gjithmonë rekomandohet ekzaminimi okulistik për sëmundje të cilat dyshohet se kanë çrregullim endokrin. Zbulimi i hershëm ndihmon në ruajtjen e funksioneve vizuale dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientit.

Fjalë kyçe: Akromegali, sindroma e cushing, hiperparatiroidizëm, ndryshime okulare, sëmundje endokrine, oftalmologji, retinopati, glaukoma, kalcifikime okulare.

MORBUS PAGET – ASPEKTET KLINIKE, DIAGNOSTIKE DHE TERAPEUTIKE NË BAZË TË LITERATURËS BASHKËKOHORE.

[1]Gresa Selmanaj, [2]Dr. Qendrim Daci
[1]Studente e Mjekësisë
[2]Doktor i Mjekësisë

Abstrakt
Hyrja: Morbus Paget, ose sëmundja e Paget - it e kockës, është një çrregullim kronik i metabolizmit kockor që karakterizohet nga rishpërbërje e çrregullt e indit kockor. Kjo gjendje shkakton formim të kockave të zmadhuara dhe më pak rezistente, duke çuar në deformime dhe rritje të rrezikut për fraktura patologjike. Etiologjia është multifaktoriale, me ndikim të faktorëve gjenetikë, veçanërisht mutacioneve në gjenin SQSTM1, dhe mundësisht

agjentëve viralë që ndikojnë në aktivitetin e osteoklasteve. Sëmundja haset kryesisht tek individët në moshë të avancuar dhe shpesh diagnostikohet rastësisht.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të përmbledhë njohuritë më të fundit nga literatura ndërkombëtare mbi patogjenezën, manifestimet klinike, metodat diagnostike dhe qasjet terapeutike të Morbus Paget, si dhe të theksojë rëndësinë e diagnostikimit të hershëm.
Metodologjia: U krye një rishikim sistematik i literaturës në bazat e të dhënave Medscape, PubMed, Frontiers dhe MSD Manuals, duke përfshirë publikimet e viteve të fundit. Janë analizuar artikuj rishikues dhe studime klinike që trajtonin aspektet patofiziologjike, klinike, diagnostike dhe terapike të Morbus Paget.
Rezultate: Rishikimi i literaturës tregoi se Morbus Paget është një sëmundje me zhvillim të ngadalshëm që prek kryesisht kockat me aktivitet të lartë metabolik si pelvisi, femuri, kafka dhe shtylla kurrizore. Manifestimet klinike variojnë nga asimptomatike deri te dhimbja kockore dhe deformimet skeletore. Diagnostikimi mbështetet në analizat laboratorike dhe imazherike, ndërsa trajtimi standard mbetet terapia me bisfosfonate, e cila redukton aktivitetin osteoklastik dhe përmirëson simptomat.
Diskutim: Sipas literaturës bashkëkohore, Morbus Paget mbetet një patologji me rëndësi klinike për shkak të komplikacioneve ortopedike, neurologjike dhe onkologjike që mund të zhvillohen. Diagnoza e hershme dhe monitorimi i vazhdueshëm laboratorik dhe radiologjik janë thelbësore për menaxhim efektiv. Terapia me bisfosfonate ka përmirësuar dukshëm prognozën dhe cilësinë e jetës së pacientëve.

Fjalë kyçe: Morbus Paget, metabolizmi kockor, fosfataza alkaline, bisfosfonatet, diagnoza radiologjike, terapi antirezorptive.

KOMPLIKACIONET E TRAJTIMEVE TË VENAVE VARIKOZE: RISHIKIM SISTEMATIK DHE META - ANALIZË KRAHASUESE MIDIS TRAJTIMEVE KIRURGJIKALE, ENDOVASKULARE DHE KONSERVATIVE.
Kreshnik Daci,Qendrim Daci

Abstrakt
Hyrje: Venat varikoze paraqesin një nga patologjitë e shpeshta në kirurgjinë vaskulare. Shpesh shoqërohen me probleme estetike dhe klinike. Komplikacionet e tyre mund të jenë të ndryshme, duke filluar nga simptomat e thjeshta si dhimbja dhe edema, e deri te gjendjet më serioze si tromboflebiti sipërfaqësor, ulçerat venoze kronike dhe ndonjëherë me trombozë venoze të thellë.
Qëllimi: Ky punim ka qëllim të analizojë komplikacionet më të shpeshta të venave varikoze dhe të krahasojë efektivitetin e trajtimit kirurgjikal me atë konservativ.
Metodologjia: Është kryer një përmbledhje këndvështruese për literaturën e publikuar në bazat shkencore si: PubMed, Cochrane Library, ESVS Guidelines. Janë shqyrtuar studimet dhe udhëzimet që trajtojnë komplikacionet e venave varikoze, si dhe rezultatet e metodave të ndryshme terapeutike: kirurgjinë tradicionale, endovaskulare dhe ato konservative me kompresion.
Rezultate: Literatura na tregon që trajtimi konservativ ka rol të rëndësishëm në kontrollimin e simptomave dhe parandalimin e përkeqësimeve, por nuk adreson në mënyrë definitive refluksin venoz. Ndërsa ai kirurgjikal dhe endovaskular redukton në mënyrë më të qëndrueshme simptomat dhe komplikacionet afatgjata, por megjithatë shoqërohet me rrezik të komplikacioneve perioperative.
Përfundimi: Venat varikoze trajtohen në mënyrë të individualizuar, në bazë të gjendjes klinike të pacientit, prirjes për komplikacione dhe preferencave personale. Kirurgjia dhe procedurat endovaskulare ofrojnë përfitime afatgjata në reduktimin e rikthimit dhe ulçerimit, kurse trajtimi konservativ është një mundësi e vlefshme trajtimi për pacientët me kundërindikacione kirurgjikale dhe tek ata që janë në fazat e hershme të sëmundjes.

Fjalë kyçe: vena, varikoze, komplikacione, perioperative, kirurgji.

SHPËRNDARJA E GRUPEVE TË GJAKUT DHE RH - D FAKTORIT INKOMPATIBILITETI I TYRE TEK ÇIFTET BASHKËSHORTORE NË POPULLATËN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS.

Qëndrim Sylejmani
Poliklinika Ginekos, Prizren Kosovë

Abstrakt
Grupet e gjakut u përshkruan për herë të parë në vitin 1901 nga Karl Landsteiner, zbulim që u nderua me Çmimin Nobel në mjekësi më 1930. Ato përcaktohen nga antigjenet në membranën e eritrociteve, ku janë identifikuar mbi 600 antigjene të radhitura në 26 sisteme. Klinikisht, më të rëndësishmit janë sistemi ABO dhe sistemi Rhesus, ku antigjeni Rh - D ka rëndësinë kryesore në transfuzion dhe obstetrikë. Qëllimi i këtij studimi ishte të paraqesë shpërndarjen e grupeve të gjakut dhe faktorit Rh - D në popullatën e Republikës së Kosovës dhe të vlerësojë shkallën e inkompatibilitetit të tyre te çiftet bashkëshortore. Janë analizuar të dhënat e 16970 individëve (4841 çifte bashkëshortore), të përpunuara me programin "Win Acta Medicus" në Poliklinikën GINEKOS, Prizren, dhe analizuar me SPSS 10. Inkompatibiliteti Rh - D u identifikua në 598 çifte ose 12, 35% (P>0. 05). Te burrat dominonte grupi A Rh - D pozitiv me 1569 ose 37% raste, dhe 0 Rh - D pozitiv me 1542 ose 36, 37% raste (P>0. 05). Kurse te gratë dominonte A Rh - D pozitiv me 6310 ose 37, 18% raste dhe 0 Rh - D pozitiv me 5869 ose 34, 58% raste (P>0, 05). Në popullatën e përgjithshme, grupi A ishte më i shpeshti me 7011 ose 41, 31% raste, i ndjekur nga 0 me 6737 ose 39, 69% raste. Faktori Rh - D pozitiv u gjet në 15027 ose 88, 55% të rasteve, ndërsa Rh - D negativ në 1943 ose 11, 44% të rasteve (P<0, 01). Shkalla e inkompatibilitetit Rh - D te çiftet bashkëshortore në Kosovë rezulton moderate. Për parandalimin e sëmundjes hemolitike të fetusit dhe të porsalindurit, rekomandohet përcaktimi i grupit të gjakut dhe faktorit Rh - D të të dy bashkëshortëve para ose në fillim të shtatzënisë. Në rastet me inkompatibilitet, duhet të aplikohet profilaksia me imunoglobulinë humane anti - D sipas udhëzimeve obstetrike.

Fjalë kyçe: Grupet e gjakut, faktori Rh - D, inkompatibilitet bashkëshortor, Republika e Kosovës.

TRAJTIMI I DHIMBJEVE ME REZONANCË MIKROVALORE (RMV).

[1]Prof. Dr. Rabit Sadiku PhD, [2]Peon Sadiku
[1, 2]Aku Center, Gjilan, Kosovë
[2]Student i Mjekësisë

Abstrakt
Kërkimet e filluara në vitet 1960, të bazuara në teorinë e ekscitimeve koherente në sistemet biologjike, çuan në zhvillimin e terapisë me Rezonancë Mikrovalore (RMV). Kjo metodë përdor valë elektromagnetike me frekuencë 30–300 GHz, gjatësi valore 1–10 mm dhe intensitet subtermal për qëllime terapeutike dhe profilaktike. Studimet e shkencëtarëve Sitko dhe Horkov në vitet 1980 dëshmuan se sistemi i akupunkturës është një strukturë dinamike që reagon ndaj fushave elektromagnetike mikrovalore, duke mundësuar stimulimin jo invaziv të mekanizmave vetërregullues të organizmit. RMV karakterizohet nga veprimi jo medikamentoz, pa kontakt dhe pa efekte anësore, duke ofruar mundësi të gjerë përdorimi si monoterapi apo në kombinim me metodat tradicionale e konvencionale. Ajo kontribuon në përmirësimin e funksioneve biologjike, reduktimin e dhimbjes dhe përshpejtimin e procesit të rikuperimit deri në dy herë krahasuar me metodat klasike. Në këtë studim janë përfshirë 50 pacientë me dhimbje të ndryshme kronike. Terapia është aplikuar dy herë në javë në cikle prej gjashtë seancash, me kohëzgjatje 5–10 minuta për pikë akupunkture. Pas trajtimit, 60% e pacientëve raportuan zhdukje të plotë të dhimbjeve, 28% përmirësim të dukshëm, ndërsa vetëm 12% kërkuan më shumë se tre trajtime. Pas gjashtë muajsh, te 60% e pacientëve nuk është shënuar rikthim i simptomave. Këto rezultate konfirmojnë se terapia me Rezonancë Mikrovalore është një metodë efektive, e sigurt dhe moderne për menaxhimin e dhimbjeve, e cila po gjen gjithnjë e më shumë zbatim në Kosovë dhe pritet të zgjerohet edhe në Shqipëri.

Fjalë kyçe: Rezonanca mikrovalore, akupunkturë, dhimbje, terapia jo invazive, biofizikë mjekësore.

PËRDITËSIMI I PROTOKOLLIT INFERMIEROR NË ONKOLOGJI.

Msc Raimonda Lalaj[1]; Msc Erald Cocka
[1]Kryeinfermiere Shërbimi Onkologjik QSUNT, Anëtare e BSH KSHI, Pedagoge Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë.

Abstrakt
Hyrje: Onkologjia është një shërbim sa sfidues aq edhe interesant, sa i mbushur me shumë sfida të vështira aq edhe dinamik dhe i shumëllojshëm sidomos në aspektin e veprimtarisë profesionale të personelit infermieror. E në fakt tërësia e këtyre manipulimeve e bën komplekse dhënien e kujdesit infermieror në këtë specialitet. Që të realizohet një shërbim sa më adekuat, patjetër që duhet domosdoshmërisht krijimi i disa standarteve (protokolleve) dhe zbatimi i tyre.
Objektiva: Standartizimi i serisë së manipulimeve infermierore, përshtatja e protokolleve ndërkombëtare dhe homogjenizimi i tyre me standartet e kërkuara edhe për në sistemin tonë shëndetësor. Nëpërmjet këtij punimi shkencor është në objektivat tona edhe nxitja e kolegëve që punojnë në onkologji për përditësim të vazhdueshëm të standarteve, sepse edhe shkenca mjekësore në vazhdim hera herës sjell vërtetime shkencore që mund të bien ndesh me ato 'te parat'. Rëndësi ka sensibilizimi, parandalimi në përditësimin e protokollit.
Metodologjia: Eksperienca mbi 40 vjecare si Infermiere dhe Kryeinfermiere në këtë shërbim më jep një qasje reale dhe konstruktive sa i përket protokolleve infermierore në onkologji. Në këtë material shkencor janë të përmbledhura edhe të gjitha shënimet e mia që kam mbajtur me shkrim për thuajse 40 vjet.
Konkluzione: Në disa periudha kohore është parë e nevojshme përditësimi i protokolleve të veprimtarisë infermierore si një domosdoshmëri për të qënë koherent me zhvillimet shkencore në mjekësi. Vlen shummë për tu theksuar gjithashtu, që materialet e reja janë përvetësuar mirë nga personeli, gjë që është reflektuar në një shërbim shumë më cilësor dhe adekuat, në një feedback pozitiv karshi pacientit.

Fjalë kyce: Onkologji, infermier, protokolle, edukim, standarte, sensibilizim, parandalim.

PËRDITËSIMI I PROTOKOLLIT INFERMIEROR NË ONKOLOGJI.

Msc Raimonda Lalaj[1]; Msc Erald Cocka
[1]Kryeinfermiere Shërbimi Onkologjik QSUNT, Anëtare e BSH KSHI, Pedagoge Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë.

Abstrakt
Hyrje: Onkologjia është një shërbim sa sfidues aq edhe interesant, sa i mbushur me shumë sfida të vështira aq edhe dinamik dhe i shumëllojshëm sidomos në aspektin e veprimtarisë profesionale të personelit infermieror. E në fakt tërësia e këtyre manipulimeve e bën komplekse dhënien e kujdesit infermieror në këtë specialitet. Që të realizohet një shërbim sa më adekuat, patjetër që duhet domosdoshmërisht krijimi i disa standarteve (protokolleve) dhe zbatimi i tyre.
Objektiva: Standartizimi i serisë së manipulimeve infermierore, përshtatja e protokolleve ndërkombëtare dhe homogjenizimi i tyre me standartet e kërkuara edhe për në sistemin tonë shëndetësor. Nëpërmjet këtij punimi shkencor është në objektivat tona edhe nxitja e kolegëve që punojnë në onkologji për përditësim të vazhdueshëm të standarteve, sepse edhe shkenca mjekësore në vazhdim hera herës sjell vërtetime shkencore që mund të bien ndesh me ato 'te parat'. Rëndësi ka sensibilizimi, parandalimi në përditësimin e protokollit.
Metodologjia: Eksperienca mbi 40 vjecare si Infermiere dhe Kryeinfermiere në këtë shërbim më jep një qasje reale dhe konstruktive sa i përket protokolleve infermierore në onkologji. Në këtë material shkencor janë të përmbledhura edhe të gjitha shënimet e mia që kam mbajtur me shkrim për thuajse 40 vjet.
Konkluzione: Në disa periudha kohore është parë e nevojshme përditësimi i protokolleve të veprimtarisë infermierore si një domosdoshmëri për të qënë koherent me zhvillimet shkencore në mjekësi. Vlen shummë për tu theksuar gjithashtu, që materialet e reja janë përvetësuar mirë nga personeli, gjë që është reflektuar në një shërbim shumë më cilësor dhe adekuat, në një feedback pozitiv karshi pacientit.

Fjalë kyce: Onkologji, infermier, protokolle, edukim, standarte, sensibilizim, parandalim.

ROLI DHE RËNDËSIA E DIAGNOSTIFIKIMIT TË BAKTERIURISË ASIMPTOMATIKE NË SHTATZËNI.

Ramadan Dacaj, Dren Tolaj[2]
[1] *Departamenti i Obstetrikës dhe Gjinekologjisë, Spitali Rajonal, Pejë, Republika e Kosovës.*
[2]*QKMF - Junk*

Abstrakt
Hyrje: Të dhënat në literaturën bashkëkohore tregojnë se bakteriuria asimptomatike e rëndësishme sinjifikante paraqitet me ndërlikime fetale dhe të nënës gjatë shtatzënisë.
Qëllimi i punimi: Qëllimi i këtij punimi është të analizojë rolin dhe rëndësinë e bakteriurisë asimptomatike sinjifikante në shfaqjen e komplikacioneve fetale tek nëna gjatë shtatzënisë dhe të përcaktojë incidencën e bakteriurisë asimptomatike sinjifikante, gjatë shtatzënisë sipas llojit të bakterit në popullatën tonë.
Materiali dhe metoda: Studimi përfshiu 110 shtatzëni, të cilat u përzgjodhën sipas metodës rastësore. Gratë shtatzëna u ekzaminuan në formë klinike, laboratorike dhe me ultratinguj, duke përfshirë shtatzënitë nga java e 13 - të e shtatzënisë deri në javën e 40 - të. Këto shtatzëni u diagnostifikuan me urinokulturë dhe rezultatet e traktit urinar u grupuan në grupin e pacienteve me urinokulturë sterile, me bakteriuri asimptomatike sinjifikante dhe bakteriuri asimptomatike jo - sinjifikante.
Rezultate: Nëpërmjet rezultateve të marra kemi konstatuar se; lindja e parakohshme, aborti spontan, vdekja e fetusit in utero, rritja e kufizimit të rritjes intrauterine (IUGR), preeklampsia dhe anemia janë raportuar me incidencë më të lartë tek pacientet me baktere të rëndësishme asimptomatike krahasuar me pacientët me urinokulture sterile. Pielonefriti, glomerulonefriti dhe cistiti paraqiten vetëm në rastet me bakteriuri asimptomatike sinjifikante.
Përfundime: Komplikacionet fetale - amtare; lindja e parakohshme, aborti spontan, vdekja e fetusit in utero, IUGR, preeklampsia dhe anemia janë raportuar me incidencë më të lartë të pacientet me bakteriuri asimptomatike snjifikante në krahasim me pacientët me urinokulture sterile.

Fjalë kyçe: Bakteriuri, asimptomatike, sinjifikante, urinokulturë sterile, shtatzëni, ndërlikime fetale - amtare.

ZMADHIMI I GJOKSIT PERIAREOLAR.

Redi Kapllani

Abstrakt
Hyrje: Zmadhimi i gjoksit periareolar është një procedurë kirurgjikale estetike që synon rritjen e volumit të gjirit përmes një prerjeje të vogël përgjatë kufirit të areolës. Kjo teknikë lejon vendosjen e implantit me ekspozim të kufizuar të indeve dhe me një shenjë që maskohet natyrshëm në vijën areolare. Përparësitë kryesore përfshijnë qasje të mirë kirurgjikale, rezultat estetik të natyrshëm dhe shenja minimale. Megjithatë, ndër komplikacionet e mundshme përfshihen ndryshimet në ndjeshmërinë e areolës, rreziku i infeksionit dhe mundësia e asimetrisë. Përzgjedhja e kujdesshme e pacientit, planifikimi i saktë i teknikës dhe komunikimi i hapur ndërmjet kirurgut dhe pacientes janë thelbësore për arritjen e rezultateve të suksesshme.
Qëllimi: Qëllimi i kësaj pune është të paraqesë avantazhet, indikacionet dhe kufizimet e teknikës së zmadhimit të gjoksit periareolar, si një alternativë estetike dhe funksionale ndaj metodave tradicionale. Kjo teknikë ka fituar popullaritet për shkak të shenjës së fshehur dhe rikuperimit më të shpejtë, duke ofruar rezultate të natyrshme për pacientet që kërkojnë përmirësim të formës dhe volumit të gjirit.
Metodologjia: Studimi mbështetet në analizën e literaturës bashkëkohore mbi teknikat e zmadhimit të gjoksit, me fokus në prerjen periareolare. Janë shqyrtuar faktorët që ndikojnë në zgjedhjen e kësaj metode, përfshirë morfologjinë e gjirit, diametrin e areolës, tipin e implantit dhe pritshmëritë estetike të pacientit. Gjithashtu, janë përfshirë të dhëna mbi procesin kirurgjikal, menaxhimin post - operativ dhe vlerësimin e rezultateve klinike.
Përfundime: Zmadhimi i gjoksit periareolar përbën një teknikë të sigurt dhe efektive për pacientët që kërkojnë rezultate estetike të natyrshme me shenja minimale. Suksesi i procedurës varet nga përzgjedhja e kujdesshme e pacientit, përvoja e kirurgut dhe respektimi i protokolleve të sterilitetit e sigurisë. Komunikimi i hapur kirurg–pacient mbetet faktor kyç për kënaqësinë estetike dhe psikologjike të rezultateve.

Fjalë kyçe: zmadhimi i gjoksit, prerje përiareolare, implant gjiri, kirurgji estetike, rezultat estetik, komplikacione.

ROLI I EKOGRAFISË KUNDREJT MRCP NË VLERËSIMIN E TRAKTIT BILIAR.

Msc Redon Trungu
Teknike Imazherie

Abstrakt
Vlerësimi i traktit biliar kërkon metoda imazherike që garantojnë saktësi të lartë diagnostike dhe imazhe të besueshme. Ekografia abdominale, si modalitet i parë, mbetet një mjet praktik dhe i aksesueshëm, por shpesh kufizohet nga faktorë anatomikë, teknikë dhe nga varësia ndaj operatorit. Në kontrast, kolangiopankreatografia magnetike (MRCP) ofron një vizualizim më të detajuar të rrugëve biliare dhe pankreatike, duke demonstruar ndjeshmëri dhe specifitet më të lartë në rastet ku ekografia rezulton jo - konkluzive. Rezultatet e këtij studimi treguan se MRCP jo vetëm zbulohet patologji të humbura nga ekografia, por edhe redukton ndjeshëm artefaktet që komprometojnë cilësinë e imazhit. Megjithatë, ekografia ruan avantazhin e thjeshtësisë dhe tolerancës më të lartë nga pacientët, ndërsa MRCP mund të kufizohet nga faktorë si klaustrofobia dhe nevoja për qëndrueshmëri të gjatë. Në përfundim, MRCP përforcohet si metoda superiore për diagnostikim të saktë të traktit biliar, ndërkohë që ekografia mbetet një ekzaminim i parë i domosdoshëm dhe praktik.

Fjalë kyçe: MRCP, ekografia abdominale, trakti biliar, ndjeshmëri diagnostike, artefakte, saktësi diagnostike.

MARKUES INFLAMATORE NË SPOK.

DrSc. Regina Hasa, Dr. Sc. Roland Hasa, Dr. Donika Bardhi Prof. Anyla Bulo

Abstrakt
Hyrje: SPOK paraqet një sindromë klinike në bazë të të cilit qëndron obstruksioni bronkial i përhapur, jo plotësisht i kthyeshëm, shenjë klinike karakterizuese e të cilit është dispnea. Diagnoza, parandalimi dhe etiologjia e acarimeve të SPOK është tashmë një sfidë që vazhdon të bëhet objekt hulumtimi jo vetëm klinikisht, por edhe me gamë të gjerë biomarkuesish.
Qëllimi: Hetimi dhe vlerësimi i sjelljes dhe ndryshimeve të niveleve të CRP dhe IL6 në të sëmurët me SPOK në gjendje të acaruar dhe në gjendjen pas trajtimit të acarimit.
Materiali: Janë rekrutuar 118 pacientë me SPOK. 10 raste në stadin II, 24 raste stadi III dhe SPOK stadi IV 84 raste. Diagnoza dhe stadifikimi i SPOK u bazua në kriteret e GOLD. 113 meshkuj dhe 5 femra me moshë mesatare përkatësisht 69±9 vjeç dhe 70±8 vjeç. 22 joduhanpirës (JD) dhe 96 duhanpirës (D).
Metoda: Përveç të dhënave klinike, spirometrisë dhe imazherisë, u kryen teste biokimike të rutinës, markues të inflamacionit si IL6, CRP, fibrinogjen, hemogazanalizë dhe hemogramën e plotë. Analiza Statistike u realizua me programin statistikor SPSS 16 dhe 21.
Rezultate: Në grupin me SPOK Stadi II mesatare e FEV1(%) 74. 5+ / - 11, mesatare e FEV1 / FVC (%) 67+ / - 16. Në SPOK stadi III mesatare e FEV1 (%) 47. 5+ / - 10, mesatare e FEV1 / FVC(%) 56. 2+ / - 11. Stadi IV me mesatare FEV1(%) 30. 9+ / - 10, mesatare e FEV1 / FVC(%) 47+ / - 11. Të gjitha p<0. 05. CRP rezultoi me vlera mesatare me ndryshime domethënëse midis grupeve. Stadi II CRP 10. 2+ / - 9 mg / l, Stadi III CRP 42. 6+ / - 45 dhe Stadi IV CRP 69. 2+ / - 84 (p=0. 0001). Vlerat e IL6 rriten në mënyrë domethënëse sidomos në stadin IV 30. 3+ / - 49. Në periudhën e acarimit të SPOK, me kurbën ROC, CRP rezultoi më e ndjeshme se IL6 për të diskriminuar pacientët me SPOK nga grupi i kontrollit. CRP SE: AUC 0. 871, 95% CI(0. 815 - 0. 926), P=0. 0001 ndërsa IL6 SE: AUC 0. 85, 95% CI(0. 79 - 0. 909), P= 0. 0001. Në gjendje stabël të SPOK, IL6 tregoi ndjeshmëri më të rritur se CRP për të dalluar pacientët me SPOK nga grupi i kontrollit. IL6 SE: AUC 0. 671, 95% CI (0. 571 - 0. 772), ndërsa CRP SE: AUC 0. 359, 95% CI(0. 255 - 0. 463). Në pacientët me insuficiencë respiratore mesataret e CRP dhe IL6 ishin përkatësisht 73. 6+ / - 83 mg / dl dhe 36. 4+ / - 54. 6 pg / ml (p=0. 0001) ndërsa në pacientët pa insuficiencë respiratore, CRP dhe IL6 ishin përkatësisht 9. 6+ / - 11. 8 mg / l dhe 8. 59+ / - 9 pg / ml (p=0. 0001). CRP rezultoi me ndjeshmëri më të rritur sinjifikante për të dalluar pacientët me insuficiencë respiratore nga pacientët pa insuficiencë respiratore. CRP SE: AUC 0. 820, CI 95% (0. 723 - 0. 928), P=0. 0001; IL6 SE: AUC 0. 809, CI 95% (0. 703 - 0. 914), P=0. 0001. Në rastet me IL6<7 pg / ml ditqëndrimi mesatar 6. 6+ / - 2. 2 (p=0. 018), kur IL6>7 pg / ml, ditqëndrimi mesatar 9+ / - 3. 4, p=0. 004. Në rastet me CRP<15 mg / L, ditqëndrimi mesatar është 7. 4+ / - 2. 9, p=0. 018 ndërsa në rastet me CRP>15 mg / L, ditëqëndrimi mesatar 9. 4+ / - 3. 4, p=0. 015 (T - test). CRP dhe IL6 kanë lidhje korrelative pozitive domethënëse me numrin e ditëqëndrimit; përkatësisht Rp=0. 338 p=0. 007 dhe Rp=0. 377 p=0. 002. Vlera mesatare e IL6 në grupin e duhanpirësve ishin më të rritura se tek joduhanpirësit vetëm në matjen e realizuar në

periudhën e acarimit (p=0. 025). IL6 (në matjen në gjendje stabël) rezultoi me korrelacion pozitiv domethënës me numrin e Paketë / vite (sasinë e duhanit) ku koeficienti i korrelacionit Pearson Rp= 0. 243, p= 0. 035. CRP nuk korreloi me asnjë nga karakteristikat e duhanpirjes në gjendje të stabilizuar. Vlerat e CRP të matura në acarim dhe në gjendje stabël nuk ndryshonin në mënyrë domethënëse mes grupit duhanpirës dhe joduhanpirës dhe nuk korrelonin me karakteristikat e duhanpirjes.
Përfundime: Vlerat e CRP, IL6 dhe markuesve inflamatorë të rutinës janë më të rritura në stadet më të rënda të SPOK. IL6 jep më tepër informacion për inflamacionin subakut dhe atë të lidhur me dëmtimet të indit pulmonar nga duhani në gjendje stabël. CRP dhe markuesit e rutinës janë ndihmës në përcaktimin e rëndesës dhe trajtimin e SPOK në periudhën e acarimit. CRP dhe IL6 reflektojnë acarim meqenëse vlerat e tyre janë më të rritura në pacientët me insuficiencë respiratore dhe në pacientë me qëndrim më të zgjatur në spital.

Fjalë kyçe: markues, SPOK, diagnoza, CRP.

QASJET MODERNE NË MENAXHIMIN E HIPERTENSIONIT DHE HIPERLIPIDEMISË.

Gzim Abrashi[1], Remzi Rrahmani
[1]*Student, Universiteti i Prishtinës*

Abstrakt
Hyrje: Hipertensioni dhe hiperlipidemia mbeten ndër faktorët më të rëndësishëm të rrezikut për sëmundjet kardiovaskulare, të cilat vazhdojnë të jenë shkaku kryesor i vdekjeve në mbarë botën. Përparimet në farmakoterapi dhe mjekësinë digjitale kanë transformuar qasjet terapeutike, duke mundësuar strategji më të personalizuara, efektive dhe të sigurta të menaxhimit.
Metoda dhe rezultate: Është kryer një rishikim narrativ i literaturës së publikuar midis viteve 2015 dhe 2025 duke përdorur bazat e të dhënave PubMed, Scopus dhe Google Scholar. Sipas udhëzimeve të ACC / AHA, terapia e kombinuar me ARB (bllokues të receptorëve të angiotenzinës II) dhe CCB (bllokues të kanaleve të kalciumit) ka treguar kontroll më të mirë të presionit të gjakut krahasuar me monoterapinë. Në menaxhimin e lipideve, inhibitorët e PCSK9 kanë reduktuar ndjeshëm nivelet e kolesterolit LDL dhe rrezikun kardiovaskular te pacientët me dislipidemi të rëndë. Për më tepër, përdorimi i terapive digjitale dhe telemonitorimit—duke përfshirë platformat mobile, kujtuesit elektronikë dhe programet e menaxhimit në distancë është lidhur me përmirësimin e aderencës së pacientëve ndaj terapisë dhe rezultate më të mira klinike tek pacientët me hipertension.
Përfundime: Menaxhimi modern i hipertensionit dhe hiperlipidemisë po zhvendoset drejt një paradigme të personalizuar dhe të bazuar në prova shkencore. Kombinimi i terapive farmakologjike të avancuara me mjetet e shëndetit digjital përmirëson kontrollin e faktorëve të rrezikut kardiovaskular dhe redukton barrën e përgjithshme të sëmundjeve kardiovaskulare. Zbatimi i këtyre qasjeve inovative përfaqëson një hap të madh drejt menaxhimit më efektiv dhe të qëndrueshëm të sëmundjeve kronike.

Fjalë kyçe: hipertensioni, hyperlipidemia, sëmundje kardiovaskulare,

RETINOPATIA DIABETIKE: SËMUNDJA E HESHTUR QË KËRCËNON SHIKIMIN.

Dr. Renis Qamo[1], Prof Asc. Vilma Mema, Ditmira Muça[2]
[1]*Okulist*
[2] *Infermiere*

Abstrakt
Hyrje: Retinopatia diabetike është një ndërlikim i zakonshëm i diabetit mellitus që prek syrin, duke shkaktuar dëmtime progresive të enëve të gjakut në retinë dhe makulë. Kjo patologji mund të çojë në humbje të konsiderueshme ose të plotë të shikimit nëse nuk diagnostikohet dhe trajtohet në kohë.
Qëllimi: Ky studim ka për qëllim të analizojë faktorët kryesorë të rrezikut, mekanizmat patologjikë dhe opsionet bashkëkohore të trajtimit për retinopatinë diabetike, si dhe të theksojë rëndësinë e diagnostikimit të hershëm dhe monitorimit të vazhdueshëm oftalmologjik.

Metodologjia: Studimi u bazua në të dhëna klinike dhe përgjigje të pacientëve për të vlerësuar prevalencën dhe qasjet e trajtimit të retinopatisë diabetike. Metodat diagnostike të përdorura përfshinë angiografinë me fluoresceinë dhe tomografinë e koherencës optike (OCT), të cilat u vlerësuan si mjete thelbësore për identifikimin e sëmundjes në fazat e saj fillestare. Të dhënat u analizuan sipas parametrave demografikë, gjinorë, grupmoshave, tipit të diabetit dhe metodës së trajtimit.
Rezultate dhe Konkluzione: Prevalenca e retinopatisë diabetike rezultoi më e lartë në zonat urbane sesa në ato rurale. Meshkujt u prekën më shpesh nga kjo patologji sesa femrat. Grupi i moshës më i prekur ishte 51–80 vjeç, ndërsa grupi 30–40 vjeç regjistroi numrin më të ulët të rasteve. Forma më e shpeshtë ishte retinopatia diabetike jo - proliferative me edemë makulare.
Një pjesë e konsiderueshme e pacientëve iu nënshtrua injeksioneve intravitreale anti - VEGF, duke reflektuar rritjen e kërkesës për trajtime moderne. Terapitë aktuale, si anti - VEGF dhe fotokoagulimi me lazer, kanë treguar efikasitet në ngadalësimin ose parandalimin e humbjes së shikimit. Studimi nënvizon rëndësinë e monitorimit të rregullt oftalmologjik dhe integrimit të strategjive të reja terapeutike për përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientëve me diabet.

Fjalë kyçe: Retinopatia diabetike, diabeti, angiografia me fluoresceinë, trajtimi anti - VEGF, monitorimi oftalmologjik.

ROLI I TERAPISË TARGET DHE IMUNOTERAPISË NË ÇRREGULLIMET LIMFOPROLIFERATIVE.

Resmije Tozharaku
Spitali Hygeia, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Çrregullimet limfoproliferative (LPD) përfshijnë një spektër të gjerë të maligniteteve të qelizave B dhe T. Me avancimin e terapive të synuara dhe imunoterapisë, është shënuar një ndryshim thelbësor në qasjen terapeutike ndaj këtyre patologjive, duke ofruar kontroll më të mirë të sëmundjes dhe përmirësim të dukshëm të mbijetesës së pacientëve.
Qëllimi i studimit: Ky prezantim ka për qëllim të shqyrtojë rolin klinik dhe ndikimin terapeutik të katër agjentëve kyç—Obinutuzumab, Polatuzumab Vedotin, Brentuximab Vedotin, dhe Rituximab subkutan (MabThera SC)—në menaxhimin e çrregullimeve limfoproliferative, në bazë të të dhënave të marra nga studimet klinike kyçe dhe evidenca të bazuara në përvojën reale (real - world data).
Përfundime: Agjentët e synuar dhe imunoterapitë kanë sjellë përmirësime domethënëse në trajtimin e LPD - ve. Polatuzumab dhe Brentuximab kanë zgjeruar ndjeshëm opsionet terapeutike për pacientët me sëmundje të rikthyer ose rezistente ndaj trajtimit (relaps / rekurrente dhe refraktare), ndërkohë që Obinutuzumab dhe Rituximab SC kanë përmirësuar lehtësinë dhe efikasitetin e terapisë fillestare dhe asaj mirëmbajtëse. Integrimi i këtyre molekulave në strategjitë e personalizuara të trajtimit është thelbësor për optimizimin e mbijetesës dhe cilësisë së jetës së pacientëve me neoplazi limfoide.

Fjalë kyçe: Linfoma, imunoterapi, terapi e synuar, Obinutuzumab, Polatuzumab, Brentuximab, Rituximab subkutan, DLBCL, LLC, linfoma Hodgkin.

KANJULA INTRAVENOZE PERIFERIKE.

Revelino Tali

Abstrakt
Ky punim është realizuar me qëllim për të treguar, shpjeguar, ilustruar dhe demonstruar çdo gjë rreth kanjulimit intravenoz. Duke filluar nga shpjegimi i konceptit "kanjule intravenoze'', llojet e kanjulave, teknikat e inserimit, regjionet më të përdorshme për të realizuar këtë procedurë, arsyet pse është i domosdoshëm të kryhet kanjulimi intravenoz, komplikacionet nga mosrealizimi me sukses i kanjulimit intravenoz për arsye nga më të ndryshmet etj. Së fundmi, këshilla dhe metoda sesi të realizojmë me sukses kanjulimin intravenoz saktë dhe pa komplikacione për pacientin. E ndiej dëshirë për të informuar dhe mësuar sidomos studentët e infermierisë

vendosjen e kanjulës intravenoze, prandaj vendosa ta zgjedh si temë leksioni për referim teorik dhe praktik. Për të mësuar në mënyrë që kolegët dhe studentët që do bëhen infermierë të ardhshëm të jenë të aftë ta realizojnë procedurën saktë, pa dhimbje e pa i shkaktuar komplikacione pacientit.

Fjalë kyçe: Kanjule intravenoze, madhësia: 14G, 16G, 18G, 20G, 22G, 24G, 26G, vena cefalike, vena bazilike, vena mediale cubittis, vena mediale antebrachialis, vena metacarpale, vena dorsale, vena e madhe safena, vena e harkut dorsal të pedis, leukoplast, zhgut, pambuk, alkool 70%, hematoma, flebitis, infiltrim.

INHIBUESIT DHE STIMULUESIT E APOPTOZËS SË ERITROCITEVE.

Rexhep Sahatciu

Abstrakt

Eritrocitet krijohen prej qelizave hematopoetike. Funksioni kryesor i eritrociteve është transportimi i oksigjenit dhe dioksidit të karbonit mes mushkërive dhe indeve në trupin tonë. Ato prodhohen në palcën kockore përmes një procesi të quajtur eritropoezë. Eritrocitet karakterizohen me një formë bikonkave dhe janë të pavarura nga oksigjeni, fenomen ky i cili mundëson transportimin e plotë të oksigjenit në inde. Ndonëse pa bërthamë, struktura e veçantë e membranës së tyre, iu mundëson eritrociteve të përshtaten në mjedisin në të cilin veprojnë gjatë ciklit jetësor i cili shquhet të jetë 100 - 120 ditor. Indet normale posedojnë një balancë fiziologjike mes zhvillimit të qelizave dhe vdekjes së atyre, e cila arrihet përmes apoptozës, fenomen ky i cili prek edhe eritrocitet. Ky fenomen te eritrocitet njihet si eriptozë dhe ka mundësi të ndodhë edhe nën ndikimin e kushteve patofiziologjike që çojnë në shkatërrimin e eritrociteve edhe para arritjes së jetëgjatësisë së tyre të plotë 120 ditë. Eriptoza karakterizohet me tkurrje qelizore dhe ekspozim të fosdatidilserinës në sipërfaqen qelizore. Mekanizmat qelizorë të cilët i paraprijnë këtij procesi stimulohen nga substanca të ndryshme si: kadmiumi, acidi alfa lipoik, kostunolidi, anti - A igG antitrupat etj. , ndërsa edhe inhibohen nga substanca, si: eritropoetina, katekolaminat, adenozina, etj.

Fjalë kyçe: eritrocitet, eriptoza, stimuluesit, inhibuesit, mekanizmat molekularë, sëmundjet.

PERFORACIONI I SEPTUMIT NASAL: NJË RAST STUDIMOR I LIDHUR ME SËMUNDJET AUTOIMUNE.

Dr. Rexhina Rama
Poliklinika e Specialiteteve nr. 2

Abstrakt

Hyrje: Dëmtimet inflamatore të mukozës së hundës janë një karakteristikë e dëmtimit vaskular. Disa çrregullime autoimune janë të lidhura me perforacionin e septumit nazal. Ky rast studimor paraqet një grua 60 vjeçare me histori të perforacionit të septumit nazal në muajt e fundit dhe me një kompleks patologjish që shpjegojnë natyrën autoimune të të gjitha simptomave.

Metoda: Diagnostikimi me endoskopi i një perforacioni të madh anterior të septumit në muajt e fundit, pa klinikë. Rishikim me literaturen e 5 viteve te fundit.

Rezultate: Nuk evidentohen shkaqe kryesore që çojnë në perforacionin septal. Hulumtohet në drejtim të sëmundjeve autoimune multisistemike. Rreth 140 raste jane raportuar me perforacion te septumit nazal ne terren te sëmundjeve autoimune sistemike.

Diskutime: Shumë raste të sëmundjeve autoimune diagnostikohen vonë ose mbeten pa diagnozë. Konfirmimi i këtyre patologjive me teste laboratorike shpjegon natyrën autoimune të dëmtimit kartilagenoz.

Konkluzione: Roli kryesor i mjekëve ORL në detektimin e hershëm të sëmundjeve autoimune multisistemike gjatë diagnostikimit të perforacionit të septumit nazal, veçanërisht në situatën e simptomave të tjera të pashpjeguara.

Fjalë kyçe: Perforacion i septumit nazal, ANA, ANCA, Wegener granulomatosis, COVID.

KRAHASIMI I REZULTATEVE TË LITOTRIPSISË PNEUMATIKE ENDO - URETERALE DHE ESWL NË TRAJTIMIN E GURËVE URETERALË – PËRVOJA E SHËRBIMIT UNIVERSITAR TË UROLOGJISË, QSUT "NËNË TEREZA".

Dr. Sh. K. Rezart Xhani
Shërbimi i Urologjisë, QSUT "Nënë Tereza", Tiranë

Abstrakt

Qëllimi: Të vlerësohen dhe krahasohen rezultatet klinike të litotripsisë pneumatike endo - ureterale (LP) me ato të litotripsisë ekstrakorporale me valë goditëse (ESWL) në trajtimin e gurëve ureteralë në popullatën adulte.
Materiale dhe metoda: Studimi përfshiu 60 pacientë (40 meshkuj dhe 20 femra), të moshës 18–65 vjeç, të trajtuar në Shërbimin Universitar të Urologjisë, QSUT "Nënë Tereza". Pacientët u ndanë në dy grupe të barabarta: Grupi I (n = 30) – trajtuar me ESWL; Grupi II (n = 30) – trajtuar me litotripsi pneumatike endo - ureterale. Parametrat e vlerësuar përfshinin madhësinë dhe lokalizimin e gurit, kohëzgjatjen e ndërhyrjes, numrin e seancave të nevojshme, shkallën e pastrimit (stone - free rate), komplikacionet dhe kohëzgjatjen e hospitalizimit.
Rezultate: Pastrimi i plotë i ureterit u arrit në 83 % të pacientëve me ESWL dhe 96 % të atyre me litotripsi pneumatike. Numri mesatar i seancave ishte 1. 8 për ESWL dhe 1. 1 për LP. Komplikacionet ishin të lehta (hematuri kalimtare, kolikë renale post - procedurale) dhe u regjistruan në 13 % të pacientëve me ESWL kundrejt 10 % në grupin LP. Koha mesatare e qëndrimit spitalor ishte 1. 2 ditë për grupin LP dhe 0. 3 ditë për ESWL. Diferenca në shkallën e pastrimit ishte statistikisht e rëndësishme ($p < 0. 05$).
Përfundime: Të dy metodat janë të sigurta dhe efektive për trajtimin e gurëve ureteralë. ESWL mbetet metodë jo - invazive me avantazhin e trajtimit ambulator, ndërsa litotripsia pneumatike endo - ureterale ofron shkallë më të lartë pastrimi dhe më pak nevojë për trajtime të përsëritura, duke qenë një alternativë shumë e vlefshme sidomos për gurët e mesëm dhe të poshtëm të ureterit.

Fjalë kyçe: Litotripsi pneumatike endo - ureterale, ESWL, gurë ureteralë.

VLERËSIMI I CILËSISË SË KUJDESIT INFERMIEROR TE PACIENTËT ME SËMUNDJEN E PARKINSONIT: NJË STUDIM MBI PËRVOJAT E PACIENTËVE.

Joana Hodaj, Engjell Hoxholli, Rezarta Tota, Mirela Tushe, Xhejni Kurti, Alma Imami Lelçaj
Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt

Hyrje: Sëmundja e Parkinsonit është një çrregullim neurodegjenerativ që prek sistemin nervor dhe ka një ndikim të madh në jetën e pacientëve, duke shkaktuar humbje të aftësive motorike, vështirësi në komunikim dhe përkeqësim të funksionit të përditshëm. Kjo sëmundje gjithashtu përshpejton varësinë e pacientëve nga kujdesi infermieror, duke e bërë atë një faktor kyç në përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre.
Materiale dhe metoda: Ky studim përdor një qasje kualitative dhe përfshin intervista të thelluara me pacientët e prekur nga Parkinsoni dhe infermierët që ofrojnë kujdesin e tyre. Ky pyetësor është hartuar për të mbledhur të dhëna nga pacientët me sëmundjen e Parkinsonit që marrin trajtim në Spitalin Neurologjik të QSUT, me qëllim vlerësimin e cilësisë së kujdesit infermieror që ata marrin. Në studim moren pjese 28 pacientë që janë trajtuar në periudhën mes 17 shkurt - 21 mars 2025. Synimi është të identifikohen faktorët që ndikojnë në cilësinë e kujdesit infermieror dhe të kuptohet më mirë si pacientët përjetojnë këtë kujdes në përditshmërinë e tyre.
Rezultate dhe diskutime: Nga 28 pacientë të anketuar, 60. 7% janë kënaqur me përgjigjen e infermierëve, ndërsa një pjesë e vogël ka shprehur mendime më të përmbajtura për cilësinë e kujdesit. Ky rezultat tregon se, përgjithësisht infermierët ofrojnë një kujdes të mirë, por ka ende mundësi për përmirësim në disa aspekte të kujdesit të ofruar.
Përfundime: Në përfundim, ky studim nxorri në pah se sëmundja e Parkinsonit është një çrregullim që ka një ndikim të madh në jetën e pacientëve, dhe është e nevojshme një qasje e integruar për trajtimin dhe mbështetje të pacientëvenë mënyrë që të sigurohet një cilësi më e mirë jete për pacientët.

Fjalë kyçe: Parkinson, pacientë, infermier.

QASJA BASHKËKOHORE NË MENAXHIMIN E OBEZITETIT PEDIATRIK: PREJ NDRYSHIMIT TË STILIT TË JETESËS E DERI TE KIRURGJIA BARIATRIKE.

Rina Skeraj, Ardit Bislimaj,
[1]*PhDc, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë*

Abstrakt
Hyrje: Obeziteti pediatrik tashmë paraqet një sfidë shëndetësore madhore globale, që lidhet me shumë komplikime afatgjate, për çfarë edhe trajtimi i hershëm i tij është me interes të veçantë. Përveç ndryshimit të stilit të jetesës i cili është gurthemel i trajtimit, farmakoterapia dhe kirurgjia bariatrike tashmë paraqesin komponenta integrale në trajtimin e obesitetit te adultët. Megjithatë, përdorimi i tyre te moshat pediatrike ende ka kufizime dhe kërkon një vlerësim të detajuar dhe të individualizuar për të balancuar përfitimet dhe rreziqet potenciale. Me anë të këtij punimi jemi përpjekur të analizojmë dhe të përmbledhim të dhënat më të reja sa i përket trajtimit të obezitetit pediatrik.
Metodologjia: Ky punim përbën një rishqyrtim literature, për të cilin janë marrë të dhëna nga databazat e mëdha ndërkombëtare, si Pubmed, Cochrane, Embase dhe Scopus. Kërkimi është kufizuar në punimet e publikuara në 5 vitet e fundit, me fokus specifik në metodat e reja të trajtimit të obezitetit pediatrik.
Rezultate: Programet multidisiplinare që përfshijnë ndryshimin e stilit të jetesës, aktivitetin fizik dhe ndryshimet në sjellje mbeten linja e parë e trajtimit dhe rekomandohen për fëmijët e të gjitha moshave. Ndërkaq, farmakoterapia vjen në konsideratë zakonisht për moshat ≥ 12 vjeç, atëherë kur terapia iniciale nuk ka treguar mjaftueshëm sukses ose ekziston shqetësimi për komorbiditetet shoqëruese. GLP - 1 agonistët si liraglutidi, semaglutidi, eksenatidi dhe setmelanotidi, pastaj orlistati dhe fentermina / topiramati, dhe biguanidet si metformina, paraqesin vetëm disa nga opsionet farmakologjike. Pas një vlerësimi multidiciplinar, në rastet e obezitetit të rëndë mund të shqyrtohet edhe kirurgjia bariatrike me "sleeve gastrectomy" ose "Reux en Y bypass".
Përfundime: Në vitet e fundit, trajtimi i obezitetit pediatrik po fillon të zgjerohet si fushë, me rekomandimet e para drejt trajtimit farmakologjik dhe kirurgjik. Modifikimi i stilit të jetesës ende mbetet baza e trajtimit, mirëpo qasjet e reja duken premtuese.

Fjalë kyçe: Obeziteti pediatrik, farmakoterapia, kirurgjia bariatrike, stili i jetesës.

PNEUMONIA ASPIRATIVE NË PACIENT ME SINDROMË CORNELIA DE LANGE (CdLS), VLERËSIM NË RETROSPEKTIVË.

R. Kortoci, R. Kaza, M. Bajraktari, U. Dushku, E. Abazi
Shërbimi Anestezi – Reanimacion
Spitali Amerikan 2, Tiranë.

Abstrakt
Hyrje: CdLS është çrregullim gjenetik shumë i rrallë që karakterizohet nga ndryshime të dallueshme në fytyrë, deficite në zhvillim dhe anomali të tjera shoqëruese.
Kjo sindromë është e lidhur me probleme të tjera shëndetësore, përfshirë ato respiratore. Ndërsa pneumonia aspirative nuk është e rrallë në personat me CdLS (sidomos në fëmijë), menaxhimi dhe trajtimi është sfidë unike për shkak të anomalive anatomike dhe fiziologjike.
Incidenca është e paqartë për shkak të prezantimit të larmishëm (nga forma të lehta që nuk evidentohen → forma të rënda që dallohen edhe intrauterine). Në SHBA 1: 10 000–50 000 të porsalindur.
Objektiva: Ky vlerësim do të na ndihmojë të zbulojmë: incidencën e CdLS, menaxhimin klinik, faktorët e rrezikut si edhe rëndësinë e zbulimit dhe ndërhyrjes së shpejtë në pneumoni aspirative. Në rastin tonë, roli dhe

bashkëpunimi me laboratorin ishte themelor. 28 vjeçe, F, prezantohet në urgjencë me: takipne, kollë, të vjella, temperaturë 39°C dhe SpO_2 të ulët.
Ne analizuam faktorët kontribues në pneumoni aspirative si: disfagia, refluksi GE dhe dëmtimet neurologjike. Ecuria klinike si edhe plani i trajtimit janë të dokumentuara.
Rezultate: Prevalenca e pneumonisë aspirative është disa herë më e lartë në CdLS sesa në popullsinë e përgjithshme. Faktorët kyç përfshijnë: vështirësitë në ushqim, aspirime të herëpashershme dhe anamnezë për pneumoni të përsëritura. Menaxhimi klinik varion, disa raste kërkojnë modifikimin e teknikës së ushqimit si p. sh. : gastrostomi ushqyese.
Pikë kyçe në rastin tonë ishin: plani i menaxhimit respirator (O_2 - terapi, NIV dhe MV) dhe strategjia e trajtimit të infeksioneve (identifikimi dhe antimikrobikët)
Konkluzione. Pneumonia aspirative është komplikacion i shpeshtë dhe sfidë në trajtim te pacientët me CdLS. Aftësia për të qenë alert dhe gjithmonë proaktive për të bërë të mundur trajtimin adekuat në çdo stad të ecurisë së pneumonisë aspirative. Identifikimi i hershëm i faktorëve të rrezikut dhe trajtimi multidisiplinar janë përcaktues në ecurinë e pacientëve. Studime më të thelluara janë të domosdoshme për të standardizuar protokolle për parandalimin dhe trajtimin e komplikacioneve respiratore te personat me CdLS.

Fjalë kyçe: Sindroma Cornelia de Lange, pneumonia aspirative, disfagia, strategji e menaxhimit.

REZISTENCA NDAJ ANTIBIOTIKËVE: KËRCËNIM I HESHTUR PËR SHËNDETIN PUBLIK GLOBAL.

Rinor Canaj, Festona Qamili
Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

Abstrakt
Hyrja: Rezistenca antimikrobike (AMR) është një sfidë globale që shpesh quhet "pandemia e heshtur" për shkak të mënyrës se si fshihet, kalon pa u vënë re dhe pa u diskutuar, ndërkohë që bën dëm të madh dhe merr jetë. Rezistenca ndaj antibiotikëve është një proces natyror që ndodh me kalimin e kohës. Për të mbijetuar, bakteret mund të krijojnë mekanizma mbrojtës kundër antibiotikëve. Kjo ndodh përmes ndryshimeve gjenetike në baktere. Këto baktere rezistente mbijetojnë, rriten dhe përhapen.
Qëllimi: Ky punim ka për qëllim të rishikojë dhe analizojë rezistencën e antibiotikëve në nivel global duke rishikuar literaturën më të fundit që diskuton rreth pasojave që lë rezistenca ndaj antibiotikëve në shëndetin e njeriut.
Metodologjia: Ky punim i përket llojit të hulumtimeve "rishikim i literaturës ekzistuese", këtu përfshihen libra dhe punime shkencore të publikuara në faqe mjekësore të licencuara dhe të mirënjohura si Pubmed, Medline, Scopus, Google Scholar etj.
Rezultate: Rezistenca ndaj antibiotikëve ka shkaktuar të paktën një milion vdekje çdo vit që nga viti 1990. Aktualisht, në nivel global, rreth 1. 3 milion njerëz humbin jetën çdo vit si pasojë e infeksioneve bakteriale të shkaktuara nga AMR. Infeksionet rezistente po rriten me shpejtësi dhe, nëse nuk ndërmerren masa politike, parashikohet se më shumë se 39 milionë jetë mund të humbasin deri në vitin 2050. Kjo është ekuivalente me 3 vdekje për minutë.
Përfundime: Këto gjetje theksojnë se AMR ka qenë një kërcënim serioz për shëndetin global për dekada dhe se ky rrezik është në rritje. Kjo nxjerr në pah një nevojë jetike për ndërhyrje që përfshijnë parandalimin e infeksionit, vaksinimin, minimizimin e përdorimit të papërshtatshëm të antibiotikëve dhe kërkimin në antibiotikë të rinj për të ulur numrin e vdekjeve nga AMR që parashikohen për vitin 2050. Konsiderohet si një nga dhjetë kërcënimet kryesore globale të shëndetit publik për njerëzimin në shekullin e 21 - të.

Fjalë kyçe: Rezistenca antimikrobike, pandemi e heshtur, parandalimi, vaksinimi.

PATOLOGJITË E ARTIKULACIONIT RADIOCARPAL DHE ROLI I IMAZHERISË NË DETEKTIMIN E TYRE.

Rinor Maliqi, MD
QKMF - Junik

Abstrakt

Hyrje: Kyçi është një artikulacion kompleks i përbërë nga tre artikulacione të tjera: artikulacioni radiokarpal, artikulacioni ulnokarpal dhe artikulacioni radioulnar. Nyja radiokarpale është një nyje synoviale e formuar nga artikulimi midis radiusit distal dhe skafoidit, lunatit dhe triketrumit si dhe strukturave të indeve të buta që mbajnë bashkimin së bashku.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të përshkruhen karakteristikat e përgjithshme te patologjive te artikulacionit radiokarpal, etiologjia e tyre, ndarjet, dallimet, epidemiologjia, prezantimet klinike, trajtimi dhe prognoza e tyre si dhe në veçanti të vlerësohet roli i imazherisë diagnostike në detektimin e tyre.

Materiale dhe metoda: Ky punim paraqet një rishikim të literaturës ekzistuese. Kërkimi i literaturës është kryer duke shfrytëzuar bazat e të dhënave si Medscape, PubMed, Radiopedia dhe Google Schoolar. Artikuj të gjuhës angleze dhe botime abstrakte janë identifikuar duke përdorur fjalë kyqe dhe filtra.

Rezultate: Në hulumtimet shkencore të analizuara përmes të cilave jemi munduar që të arrijmë deri te konkludimet adekuate për rolin e imazherisë diagnostike në diagnostikimin e patologjive të artikulacionit radiokarpal.

Fjalë kyçe: Frakturë, artikulacioni radiokarpal, imazheri.

TRAUMAT E SHTYLLËS KURRIZORE NË NGJARJET AKSIDENTALE, NJË HULUMTIM SHKENCOR, RETROSPEKTIV.

Riona Bytyci

Abstrakt

Ky punim është hulumtim shkencor, retrospektiv, i cili vlerëson traumat e boshtit kurrizor në ngjarjet aksidentale të evidentuara në Klinikën e Ortopedisë, në Prishtinë përgjatë vitit 2024. Pjesa e parë e studimit përqendrohet në analizimin e shkaktarëve të ndryshëm të këtyre traumave, ndikimin e dëmtimeve tek pacientët dhe klasifikimin e tyre në këndvështrimin mjeko - ligjor. Pasqyrimi i plotë i karakteristikave demografike të pjesëmarrësve, duke përfshirë gjininë, moshën, dhe muajt e ndodhive të ngjarjeve, si dhe identifikimin e faktorëve etiologjikë dhe diagnostikë. Ky studim synon të kontribuojë në përmirësimin e trajtimit dhe rehabilitimit të pacientëve, duke ofruar rekomandime për politikat e menaxhimit të këtyre traumave. Gjithashtu dhe kategorizimi i lëndimeve: në lëndime të rënda dhe lëndime të lehta, bazuar në Kodin Penal të Kosovës.

Fjalë kyçe: Trauma, ngjarjet, aksidentet, dëmtimet, hulumtimi, mjeko - ligjor, defiçit neurologjik.

VLERËSIMI I RASTEVE ME CA PULMONI I AVANCUAR ME QELIZA TË VOGLA DHE ORIENTIMI DREJT FREKUENCËS SË STADIT TË SËMUNDJES BAZUAR NË TIPIN HISTOLOGJIK.

Dr. Riselda Tahiraj
Onkologe Kimioterapeute

Abstrakt

Hyrje: Vlerësimi i rasteve me ca pulmoni i avancuar me qeliza të vogla, dhe orientimi drejt frekuencës së stadit të sëmundjes bazuar në tipin histologjik.

Metodologjia: Në këtë studim të randomizuar janë marrë në shqyrtim 100 raste me ca pulmoni nga viti 2022, 2023, 2024 të diagnostikuara dhe të trajtuara në spitalin onkologjik QSUT. U analizua dhe u krahasua mosha, gjinia dhe stili i jetës, shpeshtësia e stadit në rastet me ca pulmoni, si ka ndryshuar mosha mesatare e diagnostikimit në këto vite, dhe si ka ndryshuar raportimi histopatologjik.

Rezultate: Nga studimi rezultoi se në 100 raste me ca pulmoni, 89% ishin me advanced non small cell lung carcinoma, kishte një shpeshtësi të rritur të gjinisë mashkullore; nga 100 pacientë, 91 janë meshkuj. Mosha mesatare varionte nga 55 - 75 vjeç, u vu re se në bazë të stilit të jetës, 83% e pacientëve përdorin duhan prej shumë vitesh. Në 100 pacientë të marrë në studim u vu re se 64% e rasteve ishin kapur në stadin e katërt të sëmundjes. Nga ekzaminimi rezultoi se në bazë të nën - tipit histopatologjik, 53% janë carcinoma e qelizave squamoze, 40% janë adenocarcinoma, 7% janë forma të tjera.
Konkluzione: Në studimin tonë u vu re se gjinia më e prekur në kancerin e pulmonit ishte mashkullore, dhe përdorues të duhanit prej disa vitesh. Stadi më i shpeshtë në të cilin ishin kapur pacientët me ca pulmoni me qeliza të vogla e avancuar, ishte stadi i katërt. Diagnozat më të shpeshta në bazë të nën - tipit histopatologjik ishin karcinoma e qelizave squamoze dhe adenokarcinoma.

Fjalë kyçe: ca pulmoni me qeliza të vogla, kancer, staad, histopatologji.

VAKSINIMI KUNDËR HPV PËRTEJ KANCERIT TË QAFËS SË MITRËS: ZGJERIMI I MBROJTJES SË SHËNDETIT TË GRUAS.

Rita Macula Rexha

Abstrakt
Hyrje: Infeksioni me HPV njihet gjerësisht si shkaktari i kancerit të qafës së mitrës por shtamet e tij onkogjene lidhen gjithashtu me kancerin e vulvës, vaginës, anusit dhe atij orofaringeal. Vaksinimi me vaksinën nëntë - valente kundër HPV ka zgjeruar mbrojtjen përtej shtameve HPV16 / 18, gjë që siguron mbrojtje të shumëfishtë kundër shtameve të tjera onkogjene. Studimet më të fundit sugjerojnë rol potencial të vaksinës kundër HPV në zvogëlimin e gjasave për relaps pas trajtimit të neoplazisë intraepiteliale cervikale (CIN).
Qëllimi: Ky punim ka për qëllim të vlerësojë të dhënat e fundit mbi rolin e vaksinimit kundër HPV në mbrojtjen ndaj kancereve jo - cervikale dhe të theksojë rëndësinë e tij në shëndetin e përgjithshëm të grave.
Metodologjia: Për kryerjen e këtij punimi është bërë rishikimi i studimeve klinike, studimeve epidemiologjike dhe të dhënave të hulumtimeve globale të publikuara në periudhën 2015 - 2025, me fokus te sëmundjet malinje të lidhura me infeksionin me HPV e të lokalizuara jashtë qafës së mitrës. Të dhënat u analizuan për efektivitetin e vaksinës, mbrojtjen afatgjatë dhe përfitimet në nivel popullate.
Rezultate: Të dhënat tregojnë se vaksinimi kundër HPV ofron deri në 90% mbrojtje ndaj shtameve me rrezik të lartë që shkaktojnë kacnerin e vulvës dhe vaginës. Hulumtime në zhvillim e sipër tregojnë që vaksinimi kundër HPV ul poashtu rrezikun për zhvillimin e lezioneve prekanceroze dhe atyre kanceroze anale dhe orofaringeale. Studimet sugjerojnë relaps të reduktuar të neoplazisë intracervikale (CIN) pas konizimit kur aplikohet vaksinimi adjuvant.
Përfundime: Trajtimi i vaksinimit kundër HPV si strategji përtej parandalimit të kancerit të qafës së mitrës rrit vlerën e tij në shëndetin e grave dhe mund të nxisë pranimin dhe shfrytëzimin e tij. Nëse vihet theksi te përfitimet e tij si mbrojtës ndaj shumë kancereve mund të përshpejtohen objektivat e OBSH për eliminimin e kancerit të qafës së mitrës dhe njëkohësisht të reduktohet incidenca e malinjiteteve të tjera të lidhura me HPV.

Fjalë kyçe: HPV, vaksinim, kancer i qafës së mitrës.

EKSOZOMET: APLIKIMET E MUNDSHME KLINIKE NË DERMATOLOGJI.

Ritjana Mala[1], Monika Fida[2]
Dermatologe - venerologe, Spitali Rajonal i Tiranës 'Shefqet Ndroqi'
Prof. asc, Shërbimi i Dermatologjisë, Spitali Universitar 'Nënë Tereza', Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Eksozomet janë vezikula të vogla jashtëqelizore (30–150 nm), të sekretuara nga një sërë qelizash, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në komunikimin ndërqelizor përmes transferimit të proteinave, lipideve dhe acideve nukleike. Në dermatologji, eksozomet kanë treguar potencial premtues si në aspektin terapeutik, ashtu edhe në atë diagnostik. Mekanizmat e tyre të veprimit përfshijnë modulimin e përgjigjes imune, reduktimin e stresit oksidativ, nxitjen e proliferimit të qelizave, rritjen e angiogjenezës dhe rregullimin e mjedisit

jashtëqelizore. Aplikimet eksperimentale përfshijnë trajtimin e plagëve kronike, reduktimin e formimit të keloidëve, menaxhimin e sëmundjeve inflamatore të lëkurës si dermatiti atopik, psoriaza, lupus eritematoz, sklerozën sistemike si dhe përmirësimin e shenjave të plakjes së lëkurës. Gjithashtu, ekzomet po studiohen për përdorim në alopeci dhe çrregullime pigmentare si vitiligo. Megjithatë, sfida të rëndësishme përfshijnë standardizimin e përgatitjes, përcaktimin e dozës efektive, sigurinë afatgjatë dhe zhvillimin e sistemeve efikase për dorëzimin në shtresat e synuara të lëkurës.
Konkluzion: Në përfundim, ekzomet përfaqësojnë një qasje të re premtuese në dermatologji, por kërkohet më shumë kërkim klinik për të konfirmuar efektshmërinë dhe sigurinë e tyre për përdorim të gjerë terapeutik.

Fjalë kyce: eksozome, sëmundje autoimune të lëkurës, sëmundje inflamatore të lëkurës, rigjenerimi i lëkurës.

TRAJTIMI I KONJUGUAR ME OKSIGJEN NORMOBARIK ME PRESION TË LARTË DHE ACID HIALURONIK PËR ATROFINE VULVO - VAGINALE.

Roland Lama[1], Xhensila Omeri[2]
[1]*Roland Lama, Gjinekolog në SUOGJ "Materniteti Mbretëresha Geraldinë", Klinika Gjinekologjike LINDI*
[2]*Xhensila Omeri, Gjinekologe, Klinika Gjinekologjike LINDI*

Abstrakt
Hyrje: Atrofia vulvo - vaginale është një gjendje e lidhur ngushtë me uljen e nivelit të estrogjenit, ku shkaku kryesor është menopauza. Thatësia vaginale është një simptomë jo e rrallë edhe për gratë gjatë gjidhënies, përdorimit të kontraceptivëve, antidepresantëve etj. Terapia lokalisht me krem me estrogjen përmirëson simptomat, por shpesh nuk preferohet nga pacientet. Vitet e fundit janë propozuar terapi alternative si: CO_2 lazer i fraksionuar ose Caress Flow, që është subjekt i këtij studimi. Ky studim ka si qëllim të vlerësojë efektivitetin e trajtimit të konjuguar topikal të oksigjenit me presion të lartë dhe acidit hialuronik.
Materiale dhe metoda: Në këtë studim janë përfshirë pacientet me gradë të rëndë të atrofisë vulvo - vaginale nga nëntor 2022 – qershor 2025, që janë ndjekur në Klinikën Gjinekologjike LINDI. 58 paciente i janë nënshtruar terapisë me oksigjen dhe acid hialuronik që përfshin 5 seanca çdo dy javë. Është vlerësuar intensiteti i simptomave të pacientes, në fillim dhe pas çdo seance të terapisë (dispareunia, sekrecionet vaginale, kruarje vulvo - vaginale, djegia vulvo - vaginale) sipas një vlerësimi të shkallëzuar nga 1 tek 6, ndërsa elasticiteti i vaginës dhe pamja e epitelit të vaginës janë vlerësuar në mënyrë analoge të shkallëzuar nga 1 tek 5 në vlerësim kolposkopik. Janë vlerësuar ndryshimet në parametra në fillim dhe pas përfundimit të terapisë.
Rezultate: Tek 58 pacientet që iu nënshtruan terapisë, kishin përmirësim në mirëqenien e përgjithshme (0. 3 vs 4. 9, p<0. 001), në djegien vaginale (0. 2 vs 4. 9, p<0. 001), në prezencën e sekrecioneve (0. 5 vs 5. 1, p<0. 001), në pamjen e epitelit të vaginës (1. 5 vs 4. 6), në elasticitetin e vaginës (1. 2 vs 3. 5, p<0. 001). Këto ndryshime u konstatuan 10 ditë pas mbarimit të 5 seancave, në krahasim me gjendjen fillestare të pacienteve. Gjithashtu pacientet referuan për përmirësim të marrëdhënies seksuale.
Konkluzione: Terapia Caress Flow që kombinon acidin hialuronik me oksigjen me presion të lartë është një trajtim inovativ dhe efektiv në përmirësimin e atrofisë vulvo - vaginale.

Fjalë kyçe: Atrofia vulvo - vaginale, dispareunia, menopauza, sindromi genito - urinar.

RIKTHIMI I IDENTITETIT: NDIKIMI PSIKOLOGJIK DHE ESTETIK PAS TRAJTIMIT TË CIKATRICEVE POST - DJEGIE ME PROTOKOLL RIGJENERATIV TË KOMBINUAR.

Selenica R, Bazo. M

Abstrakt
Hyrje: Ky studim ka për qëllim të vlerësojë ndikimin estetik dhe psikologjik të një protokolli të kombinuar rigjenerativ në trajtimin e cikatriceve post - djegie, të lokalizuara në zona të ndryshme të trupit. Synimi kryesor është të vlerësohet përmirësimi i cilësisë së lëkurës dhe ndikimi që këto ndryshime sjellin në perceptimin e vetë - imazhit dhe rikthimin e identitetit personal pas traumës.
Metodologjia: Në studim u përfshinë 10 pacientë (6 femra dhe 4 meshkuj), të moshës 19–46 vjeç, me cikatrice të qëndrueshme nga djegiet. Protokolli përfshinte trajtimin me: Nanofat grafting, për stimulim qelizor dhe

përmirësim të strukturës së indit; PRP autolog, për rritje të sintezës së kolagjenit dhe rigjenerim dermal; Acid hialuronik të kryqëzuar (cross - linked HA), për elasticitet dhe mbështetje strukturore. Laser CO_2 fraksional, për përmirësimin e sipërfaqes dhe ngjyrës së lëkurës. Trajtimi u krye në tre seanca me intervale mujore. Rezultatet u vlerësuan duke përdorur: POSAS për ndryshimet estetike, BDI - II dhe BIQLI për gjendjen psikologjike si dhe intervista subjektive mbi perceptimin personal të rezultatit.
Rezultate: Të gjithë pacientët raportuan përmirësim të dukshëm në teksturë, elasticitet dhe ngjyrë të lëkurës. Sipas vlerësimit klinik, u arrit: 45% përmirësim mesatar në POSAS, 37% reduktim të simptomave depresive në BDI - II, dhe rritje të dukshme të vetëvlerësimit në BIQLI. Shumica e pacientëve e përshkruan trajtimin si një proces që i ndihmoi "të ndiheshin vetvetja përsëri". Nuk u raportuan efekte anësore serioze.
Përfundime: Kombinimi i Nanofat, PRP, acidit hialuronik të kryqëzuar dhe Laser - it CO_2 ofron rezultate të qëndrueshme si në aspektin estetik ashtu edhe në atë emocional. Rikthimi i identitetit pas traumës post - djegie përbën një proces të ndërlidhur mes rigjenerimit biologjik dhe shërimit psikologjik, duke theksuar rëndësinë e qasjeve multidisiplinare në trajtimin modern të cikatriceve.

Fjalë kyçe: cikatrice post - djegie, nanofat, PRP, acid hialuronik i kryqëzuar, Laser CO_2, vetëvlerësim, identitet psikologjik, rigjenerim estetik.

TRAJTIMI I CISTITIT NË KUJDESIN PARËSOR: RISHIKIM I LITERATURËS KLINIKE DHE UDHËZIMEVE BASHKËKOHORE.

Dr. Ronesa Derguti, Dr. Blerte Bibaj, Dr. Besim Durguti

Abstrakt
Hyrje: Ky punim qe eshte rishikim literature përmbledh njohuritë mbi cistitin, duke u fokusuar në vlerësimin dhe trajtimin e tij në kujdesin parësor, bazuar në literaturën klinike dhe udhëzimet bashkëkohore, si dhe rolin e ekipit ndërprofesional në menaxhimin e pacientëve. Cistiti është një infeksion që prek traktin urinar të poshtëm, gjegjësisht fshikëzën urinare. Ai ndahet në dy kategori kryesore: i pakomplikuar dhe i komplikuar. Gratë janë më të rrezikuara për shkak të anatomisë së tyre — uretra është më e shkurtër dhe më pranë anusit, gjë që favorizon përhapjen e bakterieve. Në kujdesin parësor, trajtimi i cistitit ka një rol shumë të rëndësishëm për të parandaluar komplikimet e mundshme dhe për të shmangur përdorimin e tepërt të antibiotikëve. Ky rishikim synon të japë një pasqyrë të qartë mbi mënyrat e vlerësimit dhe menaxhimit të cistitit në këtë nivel të kujdesit, duke u mbështetur në literaturën më të fundit klinike dhe në udhëzimet moderne.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të rishikojë literaturën më të fundit mbi trajtimin e cistitit ne kujdesin primar, që është një sfidë e përditshme për klinicistët. Ky punim synon të ofrojë një përmbledhje krahasuese të të dhënave duke theksuar rëndësinë e diagnostikimit të saktë, trajtimit adekuat dhe rolit të ekipit ndërprofesional në menaxhimin efektiv të pacientëve me cistit.
Metodologjia: Ky punim është rishikim i literaturës. Për realizimin e këtij punimi janë marrë të dhënat më të reja duke shfrytëzuar literaturën elektronike si PubMed, Scopus, Medscape dhe literaturën nga librat e botuar të fokusuar në trajtimin e cistitit në kujdesin parësor.
Përfundimi: Trajtimi i cistitit në kujdesin parësor ka një rol shumë të rëndësishëm për shërim të shpejtë dhe në parandalimin e komplikacioneve serioze që mund të ndodhin nëse infeksioni nuk trajtohet. Njohja dhe përdorimi i udhëzimeve mjekësore moderne ndihmojnë që trajtimi të jetë i saktë dhe i përshtatshëm, duke shmangur përdorimin e antibiotikëve dhe rritjen e rezistencës bakteriale. Vlerësimi i kujdesshëm i çdo pacienti në bazë të simptomave dhe rreziqeve individuale është thelbësor për të përcaktuar trajtimin më të mirë. Roli i ekipit ndërprofesional në kujdesin parësor është po ashtu kyç, pasi bashkëpunimi midis mjekëve, infermierëve dhe profesionistëve të tjerë shëndetësor siguron një qasje gjithëpërfshirëse dhe mbështetje të vazhdueshme për pacientët.

Fjalë kyçe: Cistit, infeksion i traktit urinar, trajtimi i cistitit, kujdes parësor, antibiotikë, diagnostikimi.

NDIKIMI I LINDJES PRETERM NË CILËSINË E JETËS SË PRINDËRVE (NDIKIM EKONOMIK, SOCIAL, PSIKOLOGJIK).

R. Tafxhafa[1], E. Gjata[2], V. Kasapi[3]
[1]Spitali Universiteti Obstetrikë Gjinekologji "Koco Gliozheni", Tiranë
[2]Univeristeti i Mjekësisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Tiranë
[3]Universiteti Aldent, Tiranë

Abstrakt

Qëllimi: Lindja e parakohshme (PTB), e përcaktuar si lindje para javës së 37 - të të shtatzënisë, mbetet shkaku kryesor i morbiditetit dhe mortalitetit neonatal në mbarë botën. Përveç pasojave neonatale, lindja preterm ndikon ndjeshëm në cilësinë e jetës (QoL) së nënës dhe familjes.

Metodologjia: U zhvillua një studim kohort në 100 nëna të hospitalizuara për lindje të parakohshme në maternitetin "Koço Gliozheni" gjatë periudhës 2023–2025. Të dhënat u mblodhën përmes intervistave të strukturuara dhe pyetësorit standardizuar. Analiza statistikore u realizua me programin SPSS v26, duke përdorur testin χ^2 dhe regresionin logjistik për të identifikuar lidhjet ndërmjet faktorëve maternë, rezultateve neonatale dhe cilësisë së jetës.

Rezultatet: Prevalenca e lindjeve të parakohshme ishte **18%.** Nënat e foshnjave preterm raportuan cilësi më të ulët të jetës psikologjike dhe sociale, veçanërisht gjatë qëndrimit në njësinë e kujdesit intensiv neonatal (NICU). Qëndrimi i zgjatur në NICU (≥14 ditë) lidhej me barrë emocionale dhe ekonomike më të lartë për familjet.

Përfundime: Lindja e parakohshme mbetet një sfidë madhore shëndetësore dhe sociale. Identifikimi i hershëm i faktorëve të rrezikut dhe kujdesi i vazhdueshëm para lindjes janë thelbësorë për reduktimin e saj. Po aq e rëndësishme është ofrimi i mbështetjes psikologjike dhe sociale për nënat dhe familjet e fëmijëve preterm.

Fjalë kyçe: Lindja e parakohshme, cilësia e jetës, faktorë ekonomik, social, psikologjik NICU.

PANENCEFALITI SUBAKUT SKLEROTIZANT NGA FRUTHI: PREZANTIM RASTI.

Rovena Aliaj[1], Aferdita Tako[2], Sindi Dizdari[1], Armand Shehu[2], Xheni Doka[2], Aida Bushati[3]
[1]Specializante e Pediatrisë, Shërbimi i Pediatrisë, Spitali Universitar "Nënë Tereza", Tiranë
[2]Mjeke Neuropediatre, Shërbimi i Neuropediatrisë, Spitali Universitar "Nënë Tereza", Tiranë
[3]Shefe e Shërbimit të Neuropediatrisë, Spitali Universitar "Nënë Tereza", Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Panencefaliti subakut sklerotizant (PSS) është një sëmundje neurodegjenerative kronike dhe progresive që lind si pasojë e persistencës së virusit mutant të fruthit në sistemin nervor qendror. Zakonisht shfaqet disa vite pas infeksionit fillestar, kryesisht tek fëmijët që e kanë kaluar fruthin në moshë të hershme, dhe manifestohet me regres psikomotor, kriza epileptike dhe çrregullime ekstrapiramidale.

Prezantim rasti: Një fëmijë u paraqit me histori njëvjeçare të përkeqësimit neurologjik progresiv, të shoqëruar me konvulsione të përsëritura, spazma dhe regres psikomotor. Në moshën 2 - muajshe kishte kaluar fruth në formë të rëndë. Fillimisht u dyshua për encefalit autoimun, por pavarësisht trajtimit me antiepileptikë (levetiracetam, clonotril), ribavirin dhe fizioterapi, simptomat përparuan. EEG tregoi valë periodike të ngadalta, MRI evidentoi demielinizim difuz, dhe LCS rezultoi pozitiv për IgG anti - measles, duke konfirmuar diagnozën e PSS.

Diskutime: Ky rast ilustron tiparet klinike dhe diagnostike karakteristike të panencefalitit subakut sklerotizant (PSS), një sëmundje që shpesh paraqitet me shenja fillestare të paqarta dhe mund të ngatërrohet me encefalitin autoimun apo encefalopatitë epileptike progresive. Triada diagnostike e PSS përfshin: EEG me valë periodike të ngadalta, MRI me ndryshime demielinizuese difuze të substancës së bardhë, dhe pozitivitet të antitrupave IgG anti - measles në LCS. Pavarësisht trajtimeve me ribavirin, interferon - alfa dhe antiepileptikë, përgjigjja terapeutike është e kufizuar dhe ecuria zakonisht përfundon me degjenerim të plotë neurologjik. Rëndësia e këtij rasti qëndron në evidentimin e rëndësisë së diagnozës së hershme dhe në përfshirjen e PSS në diagnozën diferenciale të encefaliteve progresive tek fëmijët me histori fruthi.

Përfundime: Panencefaliti subakut sklerotizant është një encefalopati e rrallë, progresive dhe fatale, që kërkon diagnozë të hershme dhe qasje multidisiplinare për menaxhim optimal. Në mungesë të terapisë kurative, vaksinimi universal kundër fruthit mbetet masa më efikase dhe thelbësore për parandalimin e kësaj patologjie neurodegjenerative.

Fjalë kyçe: Panencefaliti subakut sklerotizant, fruthi, encefalit autoimun, antitrupa anti - measles (IgG).

LIDHJA NDËRMJET GAMAPATISË MONOKLONALE ME SIGNIFIKANCË TË PAPËRCAKTUAR (MGUS) DHE ARTRITIT REUMATOID (AR).

Dr. Rovena Lico
Poliklinika e Specialiteteve Nr 1, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Gamapatia monoklonale me signifikancë të papërcaktuar (MGUS) përfaqëson një gjendje asimptomatike hematologjike, e cila karakterizohet nga prania në qarkullim e një imunoglobuline monoklonale (proteina M), në mungesë të shenjave klinike ose laboratorike të mielomës multiple apo të neoplazive të tjera të qelizave plazmatike. Sëmundjet autoimune reumatizmale, veçanërisht artriti reumatoid, janë të lidhura me një incidencë të shtuar të MGUS. Aktivizimi imun i vazhdueshëm dhe inflamacioni kronik që karakterizojnë këto patologji shoqërohen me prodhim të shtuar të citokinave proinflamatore, të cilat kontribuojnë në proliferimin e qelizave plazmatike dhe në sintezën e proteinës M. Të dhënat epidemiologjike tregojnë se pacientët me artrit reumatoid paraqesin një prevalencë dukshëm më të lartë të MGUS sesa popullata e përgjithshme. Megjithatë, roli i artritit reumatoid në rrezikun e progresionit të MGUS drejt mielomës multiple mbetet ende i paqartë dhe kërkon studime të mëtejshme për vlerësim të plotë. Në nivel popullate, MGUS prek rreth 3. 2% të individëve mbi moshën 50 vjeç, ndërsa rreziku i transformimit malign vlerësohet mesatarisht në 1% në vit.
Përfundime: Marrëdhënia ndërmjet MGUS dhe artritit reumatoid nënvizon domosdoshmërinë e monitorimit afatgjatë dhe sistematik të pacientëve, me qëllim identifikimin e hershëm të transformimit drejt patologjive malinje. Një sfidë e hapur mbetet hartimi i protokolleve të standardizuara klinike, të cilat do të mundësonin një menaxhim më të unifikuar dhe efikas të kësaj kategorie pacientësh.

Fjalë kyçe: Gamapatia monoklonale, MGUS, sëmundje autoimune reumatizmale.

PAPULAT URTIKARIALE PRURIGINOZË TË GRAVIDANCËS.

Dr. Rovena Stroni, Prof. Asoc. Monika Fida, Dr. Esmeralda Meta, Dr. Eris Mesonjesi, Dr. Marina Parllaku
Spital Continental, QSUT, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: PUPPP karakterizohen nga papula pruriginoze rreth barkut, vitheve, gjoksit dhe krahëve. Hipoteza më e përhapur është se gjatë shtatzënisë barku zmadhohet aq shpejt sa qelizat e lëkurës nuk mund të përballojnë ritmin, ku shfaqen shenjat e strijave. Shtrirja dëmton indin lidhor të lëkurës dhe shkakton inflamacion. Kjo çon në formimin e një skuqjeje mepapula në lëkurë. Disa faktorë predispozues të njohur për PUPPP janë javët e fundit të shtatzënisë ose menjëherë pas lindjes, gratë e bardha, fetusi mashkull, shtatzënia e parë, gravidancë binjake ose trinjake.
Raportim rasti: Pacientja jonë gjatë 32 javëve të shtatzënisë zhvilloi urtikarie. Në fillim në të dy këmbët, më vonë rreth barkut, gjoksit dhe krahëve. Ajo ankohej për kruajtje. Elementet papular po i shtoheshin në madhësi dhe konfluencë kryesisht në extremitetet e poshtme. Në anamnezë nuk referonte për alergji të vecantë. Në analiza evidentohej WBC 21000 mm3, neutrofile 87%, VES 23mm / h, AST 12U. L dhe ALT 23 U / L, Bilirubina 1. 0 mg / dl, Acidet biliare - normale, fece parazit - negative, HBsAg dhe anti HCV negativ, HIV negative. Rasti u konsultua me alergologe, Infeksioniste dhe Dermatologe. Çka konkludoi PUPPP - U përdor kortizon dhe pomada lokale qetësuese. Planifikua për lindje të parakohshme. Në javën e 4 filluan të reduktohen gradualisht elementet. Pacientja ishte primipare, fetusi ishte i gjinisë mashkull. Meqenëse situata klinike u stabilizua gravidanca shkoi në term dhe u realizua lindja jo cezariane.
Konkluzione: Urtikariet gravidanre janë diagnoza që hasen jo shpesh, duhen njohur faktorët predispozues, mosha gravidancës, diferencimi nga etiologji të tjera si dhe kërkojë monitorim të ngushtë për një qëndrim sa më adekuat për të vendosur mbi momentin e lindjes dhe procedurës adekuate të saj.

Fjalë kyçe: Papulat urtikariale, gravidancë, PUPPP.

DETEKTIMI I ÇRREGULLIMEVE TË RITMIT ME ANË TË HOLTER MONITORINGUT TEK PACIENTËT PEDIATRIK.

Dr. Rozafa Elezi
Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës

Abstrakt

Hyrja: Zemra është organi kryesor i sistemit tonë kardiovaskular, një rrjet i eneve të gjakut që pompon gjakun në të gjithë trupin. Ajo gjithashtu punon me sisteme të tjera të trupit për të kontrolluar rrahjet e zemrës dhe presionin e gjakut. Historia familjare, anamneza e jetës dhe mënyra e jetesës të gjitha ndikojnë se sa mirë funksionon zemra.

Qëllimi: Qëllimi i punimit është që përmes këtij hulumtimi të percaktojmë rolin e Holterit në diagnostikimin e disritmive si dhe shpërndarjen demografike dhe gjinore të Holterit, llojet e disritmive dhe shpërndarjen gjinore të tyre, shoqërimin e tyre me sëmundjet kongjenitale të zemrës dhe sëmundjet e tjera jokardiake.

Metodologjia: Studimi në vazhdim është studim retrospektiv kohort. Në këtë studim është përdorur dokumentacioni mjekësor i pacientëve, që janë nënshtruar Holter monitoringut në Klinikën e Pediatrisë, në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK

Rezultate: Në bazë të dokumentacionit mjekësor të analizuar, mostra e këtij studimi ka anuar më shumë kah gjinia mashkullore në krahasim me gjininë femërore. Pacientët që i janë nënshtruar Holter monitoringut mosha mesatare është 12. 6 vjeç.

Diskutime: Teknologjia dhe përdorimi klinik i regjistrimeve Holter janë zgjeruar me shpejtësi gjatë 20 viteve të fundit. Kjo ka çuar në zhvillimin e magnetofonëve portativë të vegjël (50 g), të cilët janë në gjendje të ruajnë > 24 orë të dhëna elektrokardiografike, pra më shumë se 100000 rrahje. Kjo mund të krahasohet me EKG - të rutinë, të cilat do të konsumonin pothuajse një milje letre EKG gjatë një periudhe të ngjashme. Krahas kësaj, mund të përdoret gjithashtu për të vlerësuar efikasitetin terapeutik të agjentëve anti - aritmikë dhe për të vlerësuar sigurinë dhe efikasitetin e një programi rehabilitimi kardiak. Së fundi, mund të jetë mjeti i vetëm për të vlerësuar keqfunksionimet e stimuluesve kardiak.

Përfundime: Nga të dhënat e analizuar në klinikën e pediatrisë shohim se Holterit i janë nënshtruar më shumë pacientët e gjinisë mashkullore sesa femërore. Grupmosha më e shpeshtë është 11 - 15 vjeç. Pacientët me disritmi të shoqëruar me sëmundje tjera shoqëruese jokardiake janë në mënyre signifikante më te pakët sesa ata pa sëmundje tjera shoqëruese jokardiake. Disritmitë më së shpeshti janë paraqitur tek meshkujt sesa tek femrat.

Rekomadime: Përdorimi më i shpeshtë i Holterit te pacientët me probleme kardiake dyshuese për cregullime të ritmit.

Fjalë kyçe: Zemra, pediatrik, disritmi, Holter monitoring.

AVANCIMI I OZHQ 3: FORCIMI I SHËNDETIT GLOBAL PËRMES ULJES SË VDEKSHMËRISË SË FËMIJËVE, KONTROLLIT TË SËMUNDJEVE NGJITËSE DHE MBULIMIN UNIVERSAL SHËNDETËSOR.

Rozarta Nezaj[1, 2] Artan Bitri[3], Vjollca Kamberi[4], Mirela Cela[5], Telma Aliaj[5]
[1]*Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, UMT,*
[2]*Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit, UBT*
[3]*Mjek Familjar në Qendrën Shëndetësore Nr. 9 në Tiranë*
[4]*Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, Kolegji Universitar Logos, 5Fakulteti i Mjekësisë, UMT*

Abstrakt

Gjatë dekadës së fundit, shëndetësia globale ka përjetuar përmirësime të rëndësishme, sidomos në reduktimin e vdekshmërisë foshnjore dhe luftën kundër sëmundjeve ngjitëse. Deri në vitin 2023, 133 vende kanë arritur objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) për vdekshmërinë tek fëmijët nën moshën pesë vjeç, ndërsa vdekjet globale të lidhura me AIDS janë përgjysmuar që nga viti 2010 për shkak të zgjerimit të aksesit në trajtime efektive. Deri në fund të vitit 2025, të paktën një sëmundje tropikale e lënë pas dore do të jetë eliminuar në 54 vende, duke dëshmuar mundësinë për arritje të suksesshme përmes bashkëpunimit global.

Megjithatë, mbeten ende sfidat e mëdha. Pabarazitë në qasjen ndaj kujdesit shëndetësor janë të dukshme, ndërsa pandemia COVID - 19 ka penguar progresin në shumë tregues kyç shëndetësorë. Shkalla e imunizimit të fëmijëve ka rënë dhe rastet e tuberkulozit dhe malaries janë rritur në disa rajone, duke kërcënuar realizimin e

objektivave të OZHQ 3. Ky objektiv synon të përfundojë epidemitë e sëmundjeve kryesore ngjitëse, të zvogëlojë vdekshmërinë nga sëmundjet jo - ngjitëse, të sigurojë mbulim shëndetësor universal dhe të promovojë shëndetin mendor dhe mirëqenien deri në vitin 2030. Ky punim nxjerr në pah si progresin e bërë, ashtu edhe nevojën urgjente për angazhim dhe investime të përtërira për të përmbushur objektivat gjithëpërfshirëse të përcaktuara në OZHQ 3. Arritja e këtyre objektivave kërkon një qasje shumësektoriale, duke theksuar kujdesin parandalues, edukimin shëndetësor, aksesin e barabartë në barnat dhe vaksinat thelbësore, si dhe financimin e fuqishëm të shëndetësisë, veçanërisht në vendet me burime të kufizuara. Forcimi i sistemeve shëndetësore, investimi në fuqinë punëtore të kujdesit shëndetësor dhe përmirësimi i sistemeve të paralajmërimit të hershëm dhe menaxhimit të riskut janë të domosdoshme për t'u mbrojtur nga kërcënimet e ardhshme globale shëndetësore.

Fjalë kyçe: Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ 3), shëndeti global, vdekshmëria foshnjore, sëmundjet ngjitëse, mbulimi universal shëndetësor, politika e shëndetit publik.

ANIZOKORIA TE LËNDIMET E KOKËS.

Dr. Rrezarta Berbati, Prof. Mentor, Prof. Ass. Dr. Agon Mekaj
Universiteti i Prishtinë, Fakulteti i Mjekësisë
Klinika e Neurokirurgjisë - QKUK

Abstrakt
Lëndimet kraniocerebrale (LKC) përbëjnë një ndër sfidat më të mëdha në neurokirurgji dhe mjekësinë emergjente, duke qenë shkak i rëndësishëm i morbiditetit dhe mortalitetit në të gjitha grupmoshat. Një nga treguesit më të hershëm dhe më sensitivë të përkeqësimit neurologjik në pacientët me trauma kraniale është anizokoria – ndryshimi në madhësinë e bebëzave – e cila pasqyron drejtpërdrejt rritjen e presionit intracranial dhe kompresionin e nervit okulomotor. Ky studim retrospektiv deskriptiv, i realizuar në Klinikën e Neurokirurgjisë në QKUK gjatë viteve 2015–2025, ka analizuar pacientët me LKC të shoqëruara me anizokori dhe midriazë pupilare. Të dhënat janë mbledhur nga protokollet klinike dhe janë analizuar me programin SPSS, duke u paraqitur në forma tabelare dhe grafike. Rezultatet treguan se prevalenca e anizokorisë ishte e konsiderueshme, me dominim të formës bilaterale (53. 4%), ndërsa meshkujt përbënin shumicën dërrmuese të rasteve (76. 8%). Grupmoshat më të shpeshta ishin 20–40 vjeç (36. 8%) dhe 41–64 vjeç (35. 4%). Hematoma subdurale doli të ishte më e shpeshta (63. 6%), shpesh në bashkëshoqërim me hematomë subaraknoidale. U vu re se hematomat e mëdha kishin lidhje të drejtpërdrejtë me incidencë më të lartë të rritjes së presionit intracranial dhe me rezultate klinike më të rënda. Gjetjet e këtij studimi konfirmojnë se anizokoria mbetet një tregues i rëndësishëm prognostik në traumat kraniocerebrale, ku zbulimi i hershëm, sidomos i formave unilaterale, duhet të nxisë reagim të menjëhershëm diagnostik dhe terapeutik për të parandaluar herniimin dhe për të përmirësuar mbijetesën dhe funksionalitetin pas traumës.

Fjalë kyçe: Anizokoria, lëndimet e kokës**, LKC, hematoma.**

EVOLUCIONI I TRAJTIMIT TË PSORIAZËS: NGA TERAPITË KONVENCIONALE TE TERAPITË BIOLOGJIKE.

Jon Kotori[1], Rrezarta Muqa[1], Merita Kotori[1, 2, 3]
[1]*Department of Dentistry, Alma Mater Europaea Campus College Rezonanca, Prishtina, Kosovo.*
[2]*Department of Dermatology, Alma Mater Europaea Campus College Rezonanca, Prishtina, Kosovo.*
[3]*Clinic center QKUK Dermatology Pristina*

Abstrakt
Hyrje: Psoriasis vulgaris është një sëmundje kronike që shpesh shfaqet dhe zhduket në mënyrë të përsëritur. Kjo gjendje shkaktohet për shkak të krijimit të shpejtë të qelizave në sipërfaqen e lëkurës. Ashpërsia e psoriazës mund të variojë nga njolla të vogla deri në mbulimin e plotë të trupit. Faktorët të cilët mund të përkeqësojnë psoriazën përfshijnë stresin, tërheqjen e kortikosteroideve sistemike, konsumimin e tepruar të alkoolit dhe duhanit. Ka shumë trajtime në dispozicion, por për shkak të natyrës kronike, psoriaza është një sfidë për t'u trajtuar. Shkaku i psoriazës ende nuk dihet plotësisht, por besohet se ka një komponent gjenetik. Faktorët të cilët

mund të përkeqësojnë psoriazën përfshijnë stresin, tërheqjen e kortikosteroideve sistemike, konsumimin e tepruar të alkoolit dhe duhanit. Ka shumë trajtime në dispozicion, por për shkak të natyrës kronike, psoriaza është një sfidë për t'u trajtuar.
Qëllimi: Të njihemi me disa raste të trajtimit modern të të sëmurëve psoriatikë dhe ndjekjen (follow up) si pjesë e praktikës së përditshme te mjeku dermatolog dhe mjeku stomatolog.
Materiale dhe Metoda: Raste të diagnostikuara dhe të trajtuara të pacientëve me Psoriasis vulgaris. Terapia biologjike e administruar te këta pacientë, protokollet e trajtimit. Terapitë sistemike tradicionale (metotreksati, ciklosporina dhe acitretina) dhe fototerapia (UVB 311nm dhe PUVA) janë linja e parë e trajtimit për psoriazën e moderuar deri në të rëndë.
Rezultate: Për shkak të zhvillimit të farmaceutikës, ne mund të trajtojmë në mënyrë efektive psoriazën, duke arritur remisionin klinik, pra lëkurë të pastër. Ideja e dermatologjisë moderne është kontrolli i procesit të psoriazës, pra kryerja e trajtimit në mënyrë të tillë që pacienti të qëndrojë pa ndryshime të lëkurës për aq kohë sa të jetë e mundur. Trajtimi biologjik bazohet në përdorimin e antitrupave monoklonalë kundër proteinave kyçe të përfshira në procesin patogjenetik të psoriazës, p. sh. TNF - alfa, IL - 12 / IL - 23. Tani e dimë mekanizmin e tyre të veprimit dhe profilin e sigurisë, prandaj i konsiderojmë jashtëzakonisht efektive dhe të sigurta për pacientët. Një revolucion i madh në trajtimin e këtyre pacientëve.
Konkluzione: Psoriaza si sëmundje kronike ka arritur që terapitë biologjike të japin shpresa te pacientët të cilët jo vetëm që vuajnë prej ndryshimeve të lëkurës, por këta pacientë ishin edhe psikologjikisht të prekur. Ky revolucion i terapisë biologjike ka arritur trajtim efikas dhe kohëzgjatje të remisioneve të sëmundjes**.**

Fjalë kyçe: Psoriasis, terapia biologjike, stresi**.**

KORRIGJIMI I ANEMISË PËR PËRMIRËSIMIN E OKSIGJENIMIT CEREBRAL.

Prof. Rudin Domi

Abstrakt
Hyrje: Anemia gjatë periudhës perioperative lidhet me rritje të komplikacioneve dhe dëmtim të furnizimit të indeve me oksigjen, çka mund të ndikojë negativisht në rezultatet e pacientit. Në kontekstin neurokirurgjik dhe kujdesit neurokritik, menaxhimi është veçanërisht kritik pasi truri është shumë i ndjeshëm ndaj hipoksisë, duke konsumuar rreth 25% të oksigjenit total të trupit pavarësisht masës së vogël që ka. Edhe uljet modeste të hemoglobinës mund të ndikojnë ndjeshëm në metabolizmin cerebral, funksionin neuronal dhe rikuperimin pas operacionit apo dëmtimit të trurit. Faktorë si mosha e avancuar, komorbiditetet, dobësia, kequshqyerja, terapia kronike me antikoagulantë ose antiplateletikë, dhe natyra e procedurave neurokirurgjike ndikojnë në prevalencën dhe ashpërsinë e anemisë perioperative.
Materiale dhe Metoda: U aplikua një qasje multimodale dhe specifike për pacientin në korrigjimin e anemisë, e udhëhequr nga parimet e Menaxhimit të Gjakut të Pacientit (Patient Blood Management – PBM). Ndërhyrjet përfshinin suplementim të synuar me hekur, administrim të eritropoietinës, përdorim të kujdesshëm të transfuzioneve të gjakut dhe menaxhim të çrregullimeve të koagulimit me agjentë si acidi traneksamik. U implementua monitorimi i oksigjenimit cerebral për të përshtatur pragjet e transfuzionit dhe strategjitë hemodinamike. Qasja u aplikua në pacientë neurokirurgjikë kritikë, përfshirë ata me stroke, dëmtim traumatic të trurit dhe procedura operative komplekse.
Rezultate: Zbatimi i strategjive PBM mundësoi korrigjimin efektiv të anemisë dhe optimizimin e oksigjenimit cerebral. Monitorimi individual i lejoj ndërhyrje në kohë dhe minimizoi transfuzionet e panevojshme. Pacientët demonstruan stabilitet më të mirë perioperator dhe u reduktuan efektet anësore potenciale të lidhura me hipoksinë ose transfuzionin e tepruar. Megjithëse metrikat standarde të rezultateve janë të kufizuara, përvoja e hershme sugjeron se një qasje e strukturuar dhe multimodale përmirëson kujdesin specifik për pacientin.
Diskutim: Anemia perioperative te pacientët neurokirurgjikë mbetet një sfidë komplekse dhe jo mirë standardizuar. Kuadri i PBM ofron një qasje premtuese dhe të bazuar në prova duke kombinuar korrigjimin e synuar të anemisë, menaxhimin e koagulimit dhe monitorimin individual të oksigjenimit cerebral. Përdorimi i protokolleve të strukturuara mund të përmirësojë rezultatet neurologjike, të minimizojë rreziqet e transfuzionit dhe të sigurojë një strategji specifike për pacientin në menaxhimin e anemisë perioperative. Kërkime të mëtejshme janë të nevojshme për të verifikuar protokollet standarde PBM dhe për të saktësuar ndikimin e tyre në rikuperimin neurologjik afatgjatë.

Përfundime: Një qasje e strukturuar dhe multimodale ndaj anemisë perioperative, e përfaqësuar nga kuadri i Menaxhimit të Gjakut të Pacientit, është thelbësore në ambientet neurokirurgjike dhe neurokritike. Ndërhyrjet e synuara, monitorimi individual dhe praktikat e kujdesshme të transfuzionit mund të optimizojnë oksigjenimin cerebral, të ulin komplikacionet dhe të përmirësojnë potencialisht rezultatet neurologjike. Standardizimi dhe përhapja më e gjerë e strategjive PBM mund të përbëjë rrugën më efektive për përmirësimin e kujdesit specifik për pacientët në këtë popullatë me rrezik të lartë.

Fjalë kyçe: anemia, oksigjenimi cerebral, protokolle.

MENAXHIMI I PROBLEMET SHËNDETËSORE TË MOSHAVE TE TRETA.

Rudina Pirushi[1], Valbona Alliu[1], Denisa Veseli (Bego)[1], Elida Peka[1], Zamira Imeraj[1], Fransi Pirushi[2,] Elona Barjami[3]
[1]Lektore, Fakulteti i Shkencave Teknike Mjekësore, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
[2]Student Fizioterapie, Fakulteti i Shkencave Teknike Mjekësore, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
[3]Pediatria, Spitali Rajonal i Beratit

Abstrakt
Qëllimi: Qëllimi kryesor i këtij studimi është të vlerësojë shëndetin e përgjithshëm të të moshuarve, të identifikojë patologjitë më të zakonshme dhe të përshkruajë rolin dhe përgjegjësitë e infermierit tek të moshuarit me sëmundje kardiovaskulare, neurologjike dhe ortopedike, tek të gjithë pacientët në Klinikat Geriatrike. Problemet shëndetësore të të moshuarve, përveç atyre thjesht mjekësore, përbëjnë një problem kompleks, social, ekonomik, psikologjik dhe shpirtëror, i cili po rritet në mënyrë të pandalshme kudo në botë.
Materiale dhe metoda: Metoda e përdorur gjatë këtij studimi u krye nëpërmjet një pyetësori të të moshuarve në qendrat geriatrike. Punimi përfshin të dhëna mbi pacientët gjatë periudhës Shkut - Maj, 2025.
Rezultate: Të dhënat u vëzhguan tek 300 persona të moshuar, nga të cilët 100 persona ose 33% ishin femra dhe 200 persona ose 67% ishin meshkuj. Mosha mesatare e pacientëve ishte 90 ± 65 vjeç. Këtyre të moshuarve iu dhanë informacione rreth kushteve të jetesës, problemeve sociale, sëmundjeve që kishin, etj. Patologjitë më të zakonshme të këtyre të moshuarve të studiuara ishin Problemet Kardiovaskulare 25%, Problemet Ortopedike 31% dhe Problemet Neurologjike 43%.
Përfundime: Nga të dhënat e mësipërme vihet re se pothuajse të gjithë të moshuarit kanë një sëmundje shoqëruese. Roli i infermierit duhet të jetë të përqendrohet në monitorimin e përditshëm të gjendjes së pacientit, të identifikojë në kohë rreziqet e mundshme, t'i shpjegojë pacientit se si ta marrë terapinë, sa kohë duhet marrë terapia, cilat mund të jenë efektet anësore dhe si duhet të kombinohen medikamentet.

Fjalë kyçe: Kujdes, menxhim, klinika geriatrike, probleme sociale, sëmundje, të moshuar, etj.

KARCINOMA PULMONALE, EFUZIONET REKURENTE DHE CILËSIA E JETËS NË KËTË GRUPIM NË BAZË TË TREGUESIT QLQ - LC13.

Ruzhdi Rexhepi[1, 2], Selma Arifi[1, 3], Merita Rexhepi[4], Semra Arifi[1], Avdi Nazifi[5]
[1]Spitali Klinik Tetove, Republika e Maqedonisë së Veriut
[2]Fakulteti I Shkencave Mjekësore, Universiteti Goce Delcev Shtip, Republika e Maqedonisë së Veriut
[3]ISHP Omega Medika, Tetovë, Republika e Maqedonisë së Veriut
[4]Shkolla e Mesme Mjekësore Nikolla Shtejn, Tetovë, Republika e Maqedonisë së Veriut
[5]Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës, Republika e Maqedonisë së Veriut

Abstrakt
Hyrje: Kanceri i mushkërive është shkaktari kryesor i vdekjes tek sëmundjet malinje, edhe pse ekzistojnë metoda të avancuara për detektimin e hershëm të sëmundjes. Pirja e duhanit mbetet faktori mbizotërues i rrezikut për kancerin e mushkërive. Kanceret e mushkërive kategorizohen si karcinoma me qeliza të vogla ose karcinoma jo - me qeliza të vogla (p. sh. , adenokarcinoma, karcinoma me qeliza skuamoze, karcinoma me qeliza të mëdha). Këto kategori përdoren për vendimet e trajtimit dhe përcaktimin e prognozës. Shenjat dhe simptomat mund të ndryshojnë në varësi të llojit të tumorit dhe shkallës së metastazave. Karcinoma pulonale që shoqërohet me

efuyzion pleural konsiderohet të ketë prognozë të keqe. Kanceri i mushkërive shoqërohet me një barrë më të madhe simptomash sesa kanceret e tjera, megjithatë dihet pak rreth prevalencës së problemeve emocionale dhe se si problemet emocionale mund të lidhen me barrën fizike të simptomave dhe cilësinë e jetës tek pacientët e diagnostikuar rishtazi me kancer të mushkërive.
Materiale dhe metoda: Në studim janë përfshirë gjithsej 70 pacientë në Spitalin Klinik Tetovë, Departamenti për Sëmundje të Brendshme. Kriter inkluziv ishte karcinoma pulmonale e diagnostifikuar. Pacientët janë ndjekur për një periudhë 4 mujore nga muaji Prill 2025 deri në Gusht 2025. Nga gjithsej 70 pacientë, 45 ishin meshkuj dhe 25 femra. Numri më i madh ishin duhanpirës 50 pacientë dhe 20 joduhanpirës.
Rezultate: Në bazë të pyetësorit QLQ - LC13 rezultatet janë si vijon: 15, 5 % e pacientëve nuk kanë simptoma dhe vështirësi me cilësinë e jetës, 25, 7% kanë simptoma të lehta dhe vështirësi me kualitetin e jetës. Simptoma mesatare dhe probleme me kualitetin e jetës kanë 35, 0% dhe 23, 8% kanë simptoma të rënda dhe probleme me kualitetin e jetës.
Konkluzione: Në bazë të rezultateve mund të konkludojmë se dedektimi i hershëm i karcinomës pulmonale dhe menaxhimi i duhur ka ndikim madhor në ruajtjen e kualitetit të jetës tek pacintët që janë në luftë me sëmundjet malinje.

Fjalë kyçe: Efuzioni pleural, karcinoma pulmonale, kualiteti i jetës.

ROLI I DERMATOSKOPISË ME FLUORESHENCË TË INDUKTUAR NGA RREZET UV NË PATOLOGJITË DERMATOLOGJIKE.

Sabina Dedej
Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Hyrje: Dermatoskopia me fluoreshencë të induktuar nga rrezet UV është një zhvillim i ri, i rëndësishëm në fushën e imazherisë jo invazive dermatologjike, e cila shfrytëzon dritën në diapazonin 320–400 nm për të analizuar reflektimin, absorbimin dhe fluorescencën e strukturave kutane. Kjo teknologji lejon identifikimin e ndryshimeve biokimike dhe morfologjike që nuk janë të dukshme në dermatoskopinë klasike.
Materiale dhe metoda: Në këtë prezantim do të shpjegojmë parimet e dermatoskopisë UVF që bazohen në ndërveprimin diferencial të dritës ultraviolet me komponentët e lëkurës, duke prodhuar fluoreshencë karakteristike. Do të prezantojmë raste klinike të pacientëve tanë dhe raportime nga literatura rreth aplikimit në lezionet pigmentare, inflamatore, infektive dhe tumorale.
Rezultate dhe Diskutime: Në praktikën klinike, UVF dermatoskopia tregon vlera të larta diagnostike në identifikimin e infeksioneve fungale përmes fluorescencës jeshile të porfirinave, në lokalizimin dhe shpërndarjen e lezioneve bakteriale e parazitare, në vlerësimin e fotodëmtimeve përmes reflektimit blu të keratinociteve të dëmtuara. Në fushën e tumoreve kutane ndihmon në diferencimin e lezioneve melanocitare beninje e malinje midis tyre dhe në përcaktimin e kufijve kirurgjikalë. Në dermatozat inflamatore identifikon aktivitetin dhe thellësinë e procesit inflamator. Gjithashtu, përdoret me sukses për të monitoruar përgjigjen terapeutike. Aplikimi i saj përfshin çdo fashë moshore dhe të gjitha strukturat dermatologjike: lëkurë, mukoza, thonj dhe flokë.
Përfundime: UVF dermatoskopia kontribuon në diagnozë më të hershme, diferencim më të saktë të patologjive, menaxhim më të personalizuar dhe ndjekje objektive të terapisë. Integrimi i saj në praktikën klinike i jep dermatologëve një mjet të avancuar për diagnozë dhe menaxhim efikas.

Fjalë kyçe: Patologjitë dermatologjike, dermatoskopi, fluoreshencë e induktuar, rrezet UV.

PARAQITJA E NJË TUMORI GERMINAL ME METASTAZA INTRAKARDIAKE: RAST KLINIK.

Sabjan Memishaj M. D[1], Raif Cavolli Md, Shkelzen Muriqi MD,
[1]*Qendra Klinike Universirtare E Kosovës, Departamenti Kardiokirurgjisë, nPrishtinë, Kosovë.*
Spitali I Zemrës "Roland Xhaxho", Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Metastazat kardiake të tumoreve malinje germinale joseminomatoze janë tepër të rralla. Tumoret metastatike mund të përfshijnë zemrën përmes invazionit direkt, përhapjes hematogjene ose përhapjes limfatike. Më poshtë do paraqesim një rast shumë te rrallë që u paraqit me gjendje sinkopale. Tomografia kompjuterike (CT) e kraharorit tregoi një masë në atriumin e djathtë dhe adenopati mediastinale. Tumori germinal metastatik përfshinte atriumin dhe ventrikulin e djathtë duke shkaktuar pengesë simptomatike të qarkullimit të gjakut. Pacienti u trajtua me sukses me kimioterapi të bazuar në platinium dhe kirurgji.

Rast klinik: Një 23 - vjeçar me sindromën Down u paraqit në urgjencë pas katër episodeve sinkopale gjatë 10 ditëve të fundit; pacienti kishte histori ortopneje, e cila lehtësohej nga oksigjeni i dhënë me kanulë nazale. Ai raportoi dhimbje gjoksi dhe një humbje peshe prej 16 kg gjatë katër muajve të fundit. Analizat laboratorike treguan hemoglobinë 10. 3 g / dl, numër leukocitesh 10, 900 / ml dhe trombocite 21, 000 / ml. Për shkak të gjetjeve, u dyshua për tumor të qelizave germinale. Pacienti filloi trajtim me enoksaparinë (Sanofi, Paris, Francë) për reduktimin e ngjarjeve tromboembolike. Për shkak se etiologjia e trombocitopenisë nuk ishte e qartë, iu dha deksametazon (Merck Sharp & Dohme Limited, Hertford Road, MB), e ndjekur nga imunoglobulinë në dozë të lartë (BAXTER, SHBA), por pa përmirësim domethënës të numrit të trombociteve. Diagnoza e tumorit jo - seminomatoz të qelizave germinale (NSGCT) u vendos mbi bazën e paraqitjes klinike, moshës, gjetjeve radiologjike dhe markerëve tumoralë. Pacienti u klasifikua me sëmundje të stadit 3 për shkak të përhapjes supradiafragmatike dhe u trajtua me dozë të plotë etopozid, ifosfamid dhe cisplatin. Numri i trombociteve ra në 15, 000 / ml në ditën e 6 - të të ciklit të parë. U ndërmor rezeksion elektiv i tumorit intrakardiak në ditën e 20 të ciklit 2. Numri i trombociteve ishte 69, 000 / ml pas transfuzionit dhe hemoglobina 8. 8 g / dl para operacionit. U krye sternotomi mediane standarde, u hap perikardi dhe u palpua masa që mbushte atriumin e djathtë dhe shtrihej në venën kava inferiore dhe ventrikulin e djathtë. Paraqitja e tumoreve malinje jo - seminomatoze të qelizave germinale me sinkopë është shumë e rrallë. Në këtë rast, sinkopa ishte pasojë e obstruksionit të outflow - ut pulmonar nga tumori intrakardiak. Prania e një zhurmë kardiake ose simptomash kardiake duhet të ngrejë dyshimin për një rast të tillë. Kimioterapia sistemike u nis pa diagnozë histologjike për shkak të obstruksionit kardiak. Ekokardiografia ishte shumë e vlefshme për zbulimin e masës intrakardiake. CT konfirmoi diagnozën dhe stratifikimin e riskut. Shndërrimi i NSGCT malinj në teratomë të matur pas kimioterapisë është i zakonshëm. Në këtë rast, mekanizmi i propozuar i trombocitopenisë ishte stresi i lartë i forcuar nga rrjedhja turbulente e gjakut dhe DIC kronik i shkaktuar nga NSGCT metastatik. Në përputhje me këtë mekanizëm, hemograma e pacientit u përmirësua brenda orëve pas heqjes së tumorit. Prognoza afatgjatë pas kimioterapisë dhe kirurgjisë varet nga tipi histologjik dhe plotësia e rezeksionit. Pacientët me NSGCT kërkojnë ndjekje të rregullt për të zbuluar dhe trajtuar përsëritjen e sëmundjes si me kimioterapi ashtu edhe me kirurgji.

Fjalë kyçe: Sinkop, masë kardiake intra - atriale, tumor testikular. :

EPIZIOTOMIA - KUR ËSHTË OPSIONI MË I SIGURTË PËR NËNËN DHE FËMIJËN?

Saimir Cenameri MD, PhD[1], Arnolda Cani
Spitali Universitar Obstetrik - Gjinekologjik 'Mbretëresha Geraldinë', Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt

Hyrje: Epiziotomia është një incision që kryhet në indet midis introitusit vaginal dhe anusit gjatë lindjes. Kjo zonë quhet perineum. Megjithëse epiziotomia ishte dikur pjesë rutinë e lindjes, sot nuk ndodh më kështu. Për vite, epiziotomia mendohej të ndihmonte parandalimin e lacerimeve më të mëdha vaginale gjatë lindjes. Ekspertët besonin se një incision do të shërohej më mirë se një lacerim natyral. Kjo procedurë mendohej gjithashtu se mbronte muskujt dhe indin lidhor që mbështet dyshemenë pelvike. Sot, megjithatë, kërkimet sugjerojnë se epiziotomitë rutinë nuk i parandalojnë këto problematika. ndërlikimet që mund të ndodhin gjatë një epiziotomie përfshijnë: hemorragjinë; infeksionin; dispareunia; dëmtim i sfinkterit anal dhe rektumit; cikatrice; inkontinenca urinare; kohë e zgjatur rekuperimi.

Materiale & Metoda: Ky është një studim kros - seksional. Ne kemi analizuar në mënyrë retrospektive procedurën e epziotomisë, sipas diagnozës në SUOGJ 'Mbretëresha Geraldinë' gjatë vitit 2023. Të dhënat u nxorrën nga sistemi informativ i shërbimit të statistikës të spitalit tonë.
Rezultate: Studimi ynë tregon që dy diagnozat kryesore janë (ICD O83) Tjetër lindje e thjeshtë e asistuar - Epiziotomi me 64% të rasteve dhe (ICD O42) Ruptura premature e membranave me 29% të rasteve.
Përfundime: Në situata të caktuara, një epiziotomi ndihmon për të reduktuar riskun e një laceracioni natyral. Nëse është bërë lindje me epiziotomi, ka qenë opsioni më i mirë për nënën ose foshnjen. Episiotomia rutinë nuk rekomandohet më sepse: a. Rekuperimi nga episiotomia është jo i rehatshëm. Ndonjëherë incisioni është më i gjerë se ç'do të kishte qenë një lacerim natyral. Mund të ndodhë një infeksion. Për disa, episiotomia mund të shkaktojë dhimbje gjatë marrëdhënieve seksuale në muajt pas lindjes. b. Një episiotomi mediane e vendos gruan në rrezik për laceracion vaginal të gradës së katërt. Ky tip laceracioni shtrihet përmes sfinkterit anal dhe në membranat e mukozes së rektumit. Mund të ndodhë inkontinenca fekale.

Fjalë kyçe: epiziotomi, perineum, lindje, laceracion etj.

ANCA - VASKULITET: GARA E NEFROLOGUT KUNDËR KOHËS.

Saimir Seferi, Suela Mumajesi, Merita Selmani
Shërbimi i Nefrologji - Dializë - Transplant, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"

Abstrakt
Vaskulitet e shoqëruara me ANCA (AAV) janë një grup vaskulitesh të rralla, primare, sistemike nekrotizuese të enëve të vogla. Granulomatoza me poliangit dhe poliangiti mikroskopik përbëjnë ~80 - 90% të të gjithë AAV. Ekspozimi ndaj pluhurit të silicës, të marrurit me bujqësi dhe bartja kronike e Staphylococcus aureus nazal shoqërohen me rrezik në rritje të zhvillimit të AAV. Kur dyshohet për një diagnozë të AAV, si tek pacientët me insuficencë multiorganore apo ata me karakteristika të tilla si rinosinusiti kronik recidivues, noduset kavitale të mushkërive, purpura e prekshme ose dëmtimi akut i veshkave, atëherë nevojiten hetime të mëtejshme të përshtatshme, duke përfshirë testimin ANCA. Në këtë skenar, duhet të kryhet një vlerësim klinik i strukturuar, duke vlerësuar të gjitha organet e mundshme të përfshira, dhe biopsia e indeve mund të jetë e nevojshme për konfirmimin e diagnozës. Algoritmet terapeutike ndryshojnë në bazë të ashpërsisë së AAV, diagnozës klinike / specifikitetit të ANCA dhe moshës, peshës, sëmundjeve komorbide dhe prognozës së pacientit. Të dhënat e fundit favorizojnë rituximab si një opsion të preferueshëm si për induksionin ashtu edhe për mbajtjen e remisonit. Përveç kësaj, regjimet me më pak glukokortikoide janë po aq efektive dhe më të sigurta në induktimin e remisonit krahasuar me regjimet konvencionale, dhe avakopani është një opsion efektiv që kursen glukokortikoide. Në të kundërt, nuk ka prova bindëse për të mbështetur përdorimin rutinor të plasmaexchange përveç terapisë standarde të induksionit të remisonit në AAV. ANCA dhe biomarkues të tjerë mund të jenë të dobishëm në lidhje me vlerësimin klinik për të udhëhequr diagnozën dhe vendimet e trajtimit. Pacientët duhet të vlerësohen shpesh gjatë ndjekjes për rikthime të mundshme të sëmundjes ose morbiditet të lidhur me trajtimin, dhe për monitorimin e dëmit të shtuar, veçanërisht dëmtimin metabolik dhe kardiovaskular.

Fjalë kyçe: Vaskuliti i shoqëruar me ANCA, avakopan, granulomatoza me poliangit, induksioni i remisionit, poliangit mikroskopik, rituximab.

NDRYSHIMET NË NIVELIN E ANKTHIT DHE DEPRESIONIT GJATË TRAJTIMIT MULTIDISIPLINAR TEK PACIENTËT ME ÇRREGULLIME NGA PËRDORIMI I SUBSTANCAVE PSIKOAKTIVE.

Sami Hajrullahu
Psikolog Klinik Dhe Forenzik
Spitali për trajtimin e Varësive "Rezonanca 3", Prishtinë

Abstrakt
Hyrje: Pacientët me çrregullime nga përdorimi i substancave zakonisht shfaqin nivele të larta të ankthit dhe depresionit në fillim të trajtimit. Monitorimi i këtyre simptomave gjatë procesit terapeutik është thelbësor për të vlerësuar efektivitetin e ndërhyrjeve multidisiplinare.
Qëllimi: Të vlerësohen ndryshimet në nivelet e ankthit dhe depresionit tek pacientët gjatë trajtimit spitalor multidisiplinar.
Materiale dhe metoda: Nivelet e ankthit, depresionit dhe përdorimit të substancave u matën me instrumente standarde: BDI, BAI, HADS, GAD - 7, PHQ - 9, SCL - 90 - R, AUDIT, DUDIT dhe SOCRATES. Matjet u kryen në pranimin fillestar, pas dy javësh dhe në daljen nga spitali.
Rezultate: Gjetjet tregojnë reduktim të ndjeshëm të ankthit dhe depresionit brenda dy javëve të para dhe përmirësim të vazhdueshëm deri në përfundim të programit, duke evidentuar efektivitetin e qasjes multidisiplinare.
Përfundime: Trajtimi spitalor multidisiplinar kontribuon pozitivisht në uljen e simptomave të ankthit dhe depresionit tek pacientët me çrregullime nga përdorimi i substancave, duke theksuar nevojën për protokolle klinike të standardizuara.

Fjalë kyçe: Varësia, ankthi, depresioni, trajtimi multidisiplinar, protokollet klinike.

EFEKTIVITETI I FIZIOTERAPISË NË MENAXHIMIN E FIBROZËS KISTIKE TEK FEMIJËT.

Sara Bashalliu
Fizioterapiste, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"

Hyrje: Fibroza kistike është një patologji gjenetike kronike që prek organet e frymëmarrjes dhe sistemin tretës, kryesisht mushkëritë dhe pankreasin. Fizioterapia është pjesë thelbësore e trajtimit të fibrozës kistike, duke ndihmuar në pastrimin e sekrecioneve të trasha nga mushkëritë, duke përmirësuar frymëmarrjen dhe duke ulur riskun e infeksioneve.
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të zbulojë efikasitetin e fizioterapisë në menaxhimin e simptomave të fibrozës kistike te fëmijët.
Metodologjia: Ky studim është një rishikim literature. Burimi kryesor i informacionit janë bazat e të dhënave elektronike të besueshme si PubMed, Medline, Google Scholar. 13 studime nga 27 plotësuan kriteret e përfshirjes dhe u morën në konsideratë për realizimin e këtij studimi.
Rezultate: Rishikimi i literaturës tregoi se fëmijët të cilëve iu aplikuan teknikat respiratore të kombinuara me ushtrimet fizike patën më shumë përmirësim sesa ata që janë ndjekur vetëm me trajtim medikamentoz.
Konkluzione: Studimet e shumta tregojnë se fizioterapia respiratore, duke përfshirë drenazhin postural, perkusionin dhe vibrimin, teknikat ACBT, së bashku me pajisjet për pastrimin e rrugëve të frymëmarrjes, kanë efikasitet në menaxhimin e simptomave, por nuk ka evidenca për superioritetin e një teknike ndaj një tjetër.

Fjalë kyçe: Fizioterapi, fibrozë kistike, fëmijë, teknikë respiratore.

NEUROPLASTICITETI DHE FIZIOTERAPIA: SI "RIPROGRAMOHET" TRURI PËRMES USHTRIMEVE TERAPEUTIKE (REVIEW 2020–2025).

Sara Zeka
Departamenti i Fizioterapisë
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Truri njerëzor ka një aftësi të jashtëzakonshme për t'u përshtatur dhe për t'u rindërtuar përmes përvojës, dëmtimit dhe trajtimit terapeutik. Ky proces dinamik, i njohur si neuroplasticitet, përbën bazën biologjike të rikuperimit funksional në patologjitë neurologjike. Fizioterapia moderne nuk kufizohet më në stërvitjen e lëvizjeve, por përdoret si një mekanizëm aktiv i "riprogramimit" të trurit, duke stimuluar rrjete të reja neuronale që zëvendësojnë ato të dëmtuara. Kjo e ka kthyer konceptin e rehabilitimit nga një proces pasiv në një proces adaptiv, të bazuar në shkencë.
Metodologjia: Ky studim përfaqëson një rishikim narrativ me elemente sistematike, zhvilluar sipas udhëzimeve PRISMA 2020. U krye një kërkim i thelluar në bazat e të dhënave PubMed, Scopus dhe Web of Science, duke përdorur termat: neuroplasticity, physiotherapy, rehabilitation, motor recovery, dhe therapeutic exercise. Artikujt pa komponent terapeutik fizik ose me fokus farmakologjik u përjashtuan. Pas filtrimit, pesë studime u përzgjodhën për analizë përfundimtare, duke përfshirë pacientë me goditje cerebrale, dëmtime të palcës kurrizore dhe sëmundje Parkinson. Të dhënat u analizuan në mënyrë krahasuese sipas tipit, intensitetit dhe efektit të ndërhyrjes.
Rezultate: Nga pesë studimet e përfshira, të gjitha raportuan ndryshime neuroplastike të rëndësishme pas programeve terapeutike. Stërvitja aerobike dhe trajnimi i ekuilibrit përmirësuan lidhjet funksionale kortikale dhe performancën motorike te pacientët me Parkinson; kombinimi i neuromodulimit me ushtrime motorike tregoi efekte të dukshme në reorganizimin e rrjeteve nervore pas dëmtimit të palcës kurrizore; ndërsa terapi inovative si ekzergaming - u rriti aktivizimin kortikal dhe funksionin e ekuilibrit. Evidencat sugjerojnë se intensiteti, përsëritja dhe fillimi i hershëm i rehabilitimit janë faktorë kyç në nxitjen e neuroplasticitetit**.**
Konkluzione: Neuroplasticiteti përbën bazën biologjike mbi të cilën fizioterapia "riprogramon" trurin për të rikthyer funksionet e humbura. Ushtrimet e përsëritura, të fokusuara dhe të personalizuara stimulojnë rikrijimin e lidhjeve neuronale dhe përmirësojnë performancën motorike dhe kognitive. Integrimi i metodave të reja si neuromodulimi, trajnimi virtual dhe stërvitja aerobike intensive mund të rrisin ndjeshëm potencialin rehabilitues. Nevojiten studime të mëtejshme për të standardizuar protokollet dhe për të përcaktuar kombinimin më efektiv të ndërhyrjeve.

Fjalë kyçe: Neuroplasticitet, fizioterapi, rehabilitim motor, rikuperim neurologjik, ushtrime terapeutike, neuromodulim.

KOORDINIMI DHE ROLI I MJEKUT FAMILJAR NË MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE SHËNDETËSORE GJATË FATKQËSIVE NATYRORE.

Selim Ibrahimi
Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë, Mjek familje, QSH Berzhitë, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Fatkeqësitë natyrore, duke përfshirë tërmetet, përmbytjet dhe stuhitë e forta, paraqesin sfida të konsiderueshme për sistemet shëndetësore në mbarë botën dhe theksojnë rolin thelbësor të mjekut familjar në mbrojtjen e shëndetit të komunitetit. Në Shqipëri, ngjarje të fundit si tërmeti i vitit 2019 dhe përmbytjet e përsëritura në disa zona kanë nxjerrë në pah mangësi në përgatitje dhe nevojën për ndërhyrje efektive në kujdesin parësor. Ky studim ka për qëllim të analizojë koordinimin, përgjegjësitë dhe kontributet praktike të mjekëve familjarë në menaxhimin e emergjencave shëndetësore gjatë fatkeqësive natyrore.
Metodologjia: Përfshiu një rishikim të gjerë të literaturës ndërkombëtare dhe kombëtare mbi menaxhimin e fatkeqësive dhe kujdesin shëndetësor parësor, së bashku me analiza të përvojave praktike nga Shqipëria. Vëmendje e veçantë iu kushtua masave të përgjigjes gjatë tërmetit të vitit 2019 dhe ngjarjeve të përmbytjeve të shpeshta, duke përfshirë organizimin e kujdesit emergjent, komunikimin me strukturat e mbrojtjes civile dhe ndjekjen e pacientëve me sëmundje kronike në kushte sfiduese.

Rezultate: Tregojnë se mjeku familjar është një aktor kyç në katër faza kryesore të menaxhimit të fatkeqësive. Faza e parë është parandalimi dhe edukimi i komunitetit, ku mjekët familjarë luajnë një rol qendror në rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet shëndetësore të mundshme, promovimin e sjelljeve mbrojtëse dhe informimin e publikut për sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe masat e përgatitjes. Faza e dytë është menaxhimi akut i emergjencave, duke përfshirë triazhin, ofrimin e ndihmës së parë, trajtimin e rasteve urgjente dhe kujdesin e vazhdueshëm për pacientët me sëmundje kronike në kushte sfiduese. Mjekët familjarë shpesh veprojnë si pika e parë e kontaktit dhe sigurojnë vlerësim dhe stabilizim të shpejtë të pacientëve. Faza e tretë përfshin koordinimin me strukturat e mbrojtjes civile, autoritetet lokale dhe institucionet e tjera shëndetësore, duke siguruar vazhdimësinë e kujdesit dhe shpërndarjen efektive të burimeve. Kjo përfshin referimin në spitale të specializuara, bashkëpunimin me ekipe mjekësore mobile dhe integrimin në strategjitë më të gjera të menaxhimit të emergjencave. Faza e katërt fokusohet në menaxhimin e pasojave afatgjata, veçanërisht mbështetjen e shëndetit mendor për të mbijetuarit, monitorimin e popullsive të cenueshme si fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, dhe organizimin e ndjekjes së kujdesit për ata të prekur nga lëndimet ose zhvendosjet. Megjithëse roli i mjekëve familjarë është thelbësor, sfida të konsiderueshme mbeten, duke përfshirë mungesën e trajnimeve të rregullta mbi përgjigjen ndaj fatkeqësive, burime të pamjaftueshme, mungesën e protokolleve standarde emergjente në nivelin e kujdesit parësor dhe nevojën për një integrim më të fortë në planet kombëtare të emergjencave. Studimi përfundon se forcimi i kapaciteteve dhe roli i mjekëve familjarë në përgatitjen dhe përgjigjen ndaj fatkeqësive është jetik për reziliencën e komunitetit. Rekomandimet përfshijnë trajnime periodike mbi menaxhimin e emergjencave, përfshirjen e mjekëve familjarë në planet lokale dhe kombëtare të emergjencave, zhvillimin e udhëzimeve praktike për kujdesin parësor gjatë fatkeqësive dhe promovimin e bashkëpunimit multidisiplinar me mbrojtjen civile dhe agjencitë e shëndetit publik. Përmes përmirësimit të përgatitjes dhe koordinimit, mjekët familjarë mund të ulin ndjeshëm morbiditetin dhe mortalitetin, të sigurojnë vazhdimësinë e kujdesit dhe të mbështesin reziliencën e përgjithshme të komuniteteve gjatë dhe pas fatkeqësive natyrore.

Fjalë kyçe: Mjek familjar, kujdes parësor, menaxhimi i emergjencave, përgatitja ndaj fatkeqësive, tërmete, përmbytje, shëndeti i komunitetit.

TROMBOZA E HERSHME E PROTEZAVE BIOLOGJIKE TË VALVULËS AORTALE: PSE ZGJEDHJA E PROTEZËS NUK DUHET NËNVLERËSUAR.

Selman Dumani[1, 2], Alessia Mehmeti[1], Saimir Kuci[1, 2], Verona Beka[2], Fjoralba Qejvani[1], Ali Refatllari[1, 2]
[1]*Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, Shqipëri*
[2]*German Hospital International, Tiranë, Shqiperi*

Abstrakt
Tromboza e protezave biologjike aortale (TPB) po njihet gjithnjë e më shumë si një shkak i hershëm i disfunksionit të protezave të valvulës së aortës, shpesh e nëndiagnostikuar pa përdorimin e imazherisë së avancuar. Ne po ju prezantojmë rastin e një pacienti mashkull, 72 vjeç, i cili zhvilloi stenozë të rëndësishme të protezës biologjike të valvulës aortale St. Jude Medical (SJM) Epic™ brenda shtatë muajve pas implantimit, si pasojë e formimit të një trombi të organizuar. Ai u prezantua me edemë pulmonare akute dhe iu nënshtrua zëvendësimit të protezës biologjike aortale (SAVR) me një protezë valvulare mekanike SJM Regent™. Gjetjet intraoperative konfirmuan praninë e trombit që përfshinte të tre fletët e protezës biologjike të valvulës së aortës të implantuar herën e parë. Ky rast nënvizon rëndësinë e njohjes së hershme të TPB, shqyrtimin e kujdesshëm të antikoagulimit pas operacionit dhe përzgjedhjen e kujdesshme të protezës valvulare. Rishikimi i literaturës trajton incidencën, faktorët e rrezikut, strategjitë diagnostike dhe rrugët e menaxhimit për TPB, duke iu referuar metaanalizave të fundit dhe rekomandimeve të udhëzuesve klinikë.
Konkluzione: Zgjedhja e protezës për zëvendësimin e valvulës aortale mbetet një çështje me rëndësi të veçantë, që përfshin vlerësimin e faktorëve të lidhur si me pacientin ashtu edhe me protezën. Vendimi bazohet në rekomandimet e udhëzuesve, gjykimin e ekipit kirurgjikal dhe preferencat e pacientit, pas një shpjegimi të detajuar mbi përfitimet dhe rreziqet që lidhen me secilin lloj proteze.

Fjalë kyçe: kirurgjia e valvulës aortale, valvula aortale, protezë mekanike, protezë bioprostetike, tromboza e protezës biologjike të valvulës aortale.

BIOPSIA TRANSBRONKIALE NË DIAGNOSTIKIMIN E PROTEINOZËS ALVEOLARE PULMONARE: NJË RAST KLINIK.

Serxho Golgota, Kristi Reveli, Eritjan Tashi, Marsel Broqi, Viola Selmani
Qendra Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi" Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Proteinoza alveolare pulmonare (PAP) është një sëmundje e rrallë e mushkërive, e karakterizuar nga akumulimi jonormal i surfaktantit brenda alveolave. Diagnostikimi shpesh është sfidues për shkak të simptomave jospecifike dhe incidencës së ulët të sëmundjes.

Paraqitja e rastit: Raportojmë një rast të një femre 52 - vjeçare, e cila u paraqit me një histori një mujore të kollës së thatë dhe vështirësisë në frymëmarrje. Tomografia e kompjuterizuar me rezolucion të lartë (HRCT) e toraksit tregoi një pamje karakteristike "crazy paving" – opacitet me xham të turbullt të shoqëruara me trashje të septave interlobulare – sugjestive për PAP. U krye bronkoskopi diagnostike me biopsi transbronkiale pulmonare (TBLB), e cila konfirmoi diagnozën nëpërmjet gjetjeve histopatologjike të materialit proteinik brenda alveolave, pozitiv me ngjyrimin PAS.

Diskutime: Ky rast nënvizon rëndësinë e TBLB si një metodë minimale invazive dhe efektive për diagnostikimin e PAP, veçanërisht kur të dhënat klinike dhe radiologjike ngjallin dyshime për këtë sëmundje të rrallë. Diagnoza e hershme është thelbësore për menaxhimin optimal, i cili mund të përfshijë lavazh pulmonar të përgjithshëm ose terapi me GM - CSF në varësi të nënllojit.

Përfundime: Në pacientë me simptoma respiratore jospecifike dhe gjetje imazherike karakteristike, TBLB mund të luajë një rol kyç në diagnostikimin e sëmundjeve të rralla si proteinoza alveolare pulmonare, duke shmangur nevojën për ndërhyrje më invazive kirurgjikale.

Fjalë kyçe: biopsi, transbronkiale, proteinoz alveolare etj.

NGA DIAGNOSTIKA TEK TERAPIA: EVOLUCIONI I UDHËZIMEVE PËR SËMUNDJET DIFUZE PULMONARE.

Serxho Golgota, Ina Pojani, Kristi Reveli, Doris Orgocka, Loreta Karaulli, Sidita Shpuza, Anxhela Papa, Elga Bardho, Eritjan Tashi, Marsel Broqi, Ilir Peposhi, Alma Teferici, Emira Hysa, Kloedina Bratja
Mjekësia Pulmonare, Qendra Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi", Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Sëmundjet difuze pulmonare (SDP) si fibroza pulmonare idiopatike (FPI), fibroza pulmonare progresive (FPP), sëmundjet intersticiale pulmonare të lidhura me patologjitë e indit lidhor (ILD - SIL), pneumoniti i hipersensitivitetit (PH), sarkoidoza dhe pneumonitë eozinofilike, përbëjnë një shkak të rëndësishëm të morbiditetit dhe mortalitetit. Këto patologji karakterizohen nga deformimi i arkitekturës pulmonare, me prani të lezioneve fibrotike dhe / ose inflamatore. Udhëzimet ndërkombëtare të viteve të fundit theksojnë unifikimin e kritereve diagnostike për FPP dhe aplikimin e qasjeve terapeutike të individualizuara (1, 4) ku terapitë antifibrotike, imunomoduluese dhe mbështetëse integrohen në menaxhimin klinik.

Materiale dhe metoda: Është kryer një rishikim narrativ i udhëzimeve ndërkombëtare (ATS, ERS, JRS, ALAT) dhe përmbledhjeve sistematike të botuara gjatë periudhës 2020 - 2024 (5). Ky studim është fokusuar tek algoritmat diagnostike, terapitë farmakologjike dhe kujdesin suportiv.

Rezultate: Rekomandimet e përditësuara fokusohen në përdorimin e agjentëve antifibrotikë (nintedanib, pirfenidone) tek FPI dhe të gjitha format e FPP, pavarësisht etiologjisë(1, 3, 5). Diagnostikimi i pneumonitit të hipersensitivitetit mbështetet tek vlerësimi i ekspozimit, HRCT dhe limfocitoza e BAL, ndërsa biopsia indikohet vetëm tek rastet e diskutueshme (2). Kortikosteroidet mbeten trajtimi standard për sarkoidozën, ndërkohë që metotreksati ose terapitë biologjike rekomandohen në format refraktare apo me prekje të rëndë organore. Kujdesi suportiv përfshin rehabilitimin pulmonar, oksigjenoterapinë, vaksinimin dhe monitorimin e strukturuar dhe është i domosdoshëm për të gjitha SDP - të (5). Evidencat aktuale sugjeronjnë rëndësinë e fenotipizimit të saktë, fillimit të hershëm të trajtimit dhe vendimmarrjes multidisiplinare për përmirësimin e rezultateve klinike.

Përfundime: Studimet e fundit mbështesin fenotipizimin e saktë, nisjen e hershme të trajtimit antifibrotik dhe imunomodulues si dhe përfshirjen e vendimmarrjes multidisiplinare. Zbatimi i këtyre qasjeve përmirëson ndjeshëm menaxhimin klinik dhe prognozën e pacientëve me SDM.

Fjalë kyçe: Sëmundjet difuze pulmonare, fibroza pulmonare idiopatike (FPI), fibroza pulmonare progresive (FPP).

PËRDORIMI I TERAPIVE BIOLOGJIKE PËR TRAJTIMIN E ARTRITIT REUMATOID.

Shend Kryeziu[1], Fatlinda Berisha[1], Elton Bahtiri[2], Avni Kryeziu
[1]*Doktor i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, Kosovë, 10000*
[2]*Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Klinika e Endokrinologjisë, Prishtinë, Kosovë, 10000*
[3]*Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Klinika e Reumatologjisë, Prishtinë, Kosovë, 10000*

Abstrakt
Hyrje: Artriti reumatoid (RA) është një sëmundje autoimune kronike që prek kryesisht nyjet, por mund të përfshijë edhe inde ekstraartikulare. Terapia biologjike, e prezantuar në vitet 1990, përdoret zakonisht pas dështimit të DMARD - ve konvencionalë. Këta agjentë biologjikë janë më specifik dhe më efektiv, por shoqërohen me një rrezik më të lartë për efekte anësore. Ekzistojnë pesë klasë të medikamente biologjike, të ndara sipas mekanizmit të tyre veprues.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është shqyrtimi i literaturës mbi terapinë biologjike në RA, duke vlerësuar përdorimin, efektet klinike në varësi të kohëzgjatjes së trajtimit, dhe rezultatet e kombinimit bDMARDs + csDMARDs krahasuar me monoterapinë.
Metodologjia: Ky punim bazohet në një rishikim të literaturës shkencore mbi përdorimin e terapisë biologjike në RA, duke analizuar studime të përzgjedhura nga burime si PubMed, Google Scholar, MedlinePlus dhe institucione të njohura mjekësore. Kërkimi u kufizua për periudhën 2015–2025 dhe u krye me fjalë kyçe specifike për temën. Në analizë u përfshinë pesë studime kryesore, të cilat u krahasuan me nëntë studime të tjera mbështetëse.
Rezultate: Sipas katër studimeve të para, barnat biologjike më të shfrytëzuara kundër RA - së ishin etanercepti dhe adalimumabi. Bazuar në studimin 3, kohëzgjatja e përdorimit të terapisë biologjike >12 muaj rezultoi të ketë efekte të dëshiruara klinike te shumica e pacientëve krahasuar me kohëzgjatjen <12 muaj. Rezultatet e studimit 4 dhe 5 e nxorën terapinë e kombinuar si superiore krahasuar me monoterapinë.
Përfundime: TNF - inhibitorët, kryesisht etanercepti dhe adalimumabi, janë terapitë më të përdorura, ndërsa agjentët jo - TNFi kanë treguar efikasitet dhe qëndrueshmëri më të lartë. Terapia biologjike afatgjatë përmirëson kontrollin e sëmundjes, ndërsa kombinimi bDMARD + csDMARD është më efektiv dhe i qëndrueshëm sesa monoterapia, qoftë me bDMARD, ose me metotreksat.

Fjalë kyçe: Artriti reumatoid, terapia biologjike, bDMARDs.

PREVALENCA E SINDROMËS METABOLIKE.

Dr. Shkelqesa Tahiraj

Abstrakt
Hyrje: Sindroma metabolike është çrregullim i cili përbëhet nga obeziteti i formës viscerale (qendrore), rezistenca insulinike, hiperinsulinemia, hiperlipidemia, çrregullimet endoteliale, hipertensioni arterial dhe sëmundjet koronoare.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është që përmes rishikimit të literaturës dhe interpretimeve të ndryshme të spjegojmë identifikimin e sindromës metabolike dhe prevalencën e saj. Prandaj janë paraparë këto qëllime: Identifikimi i pacientëve me sindromë metabolike, hulumtimi i komponenteve të sindromës metabolike te pacientet obez, hulumtimi për të vërtetuar gjininë dhe racën ose grupin etnik më të prekur me sindromë metabolike dhe hulumtimi për të vërtetuar grup - moshën më të prekur.
Metodologjia: Ky është një rishikim i literaturës mbi sindromën metabolike dhe prevalencën e saj. Literatura ku bazohet punimi është grumbulluar nga një numër i konsiderueshëm punimesh shkencore ndërkombëtare më bashkëkohore. Këtu përfshihen libra nga autorë të ndryshëm ndërkombëtar dhe punime të publikuara në revista të njohura ndërkombëtare.
Prezantimi i parametrave statistikore është bërë në mënyrë tabelare dhe me grafikore. **Rezultate dhe Diskutime:** Në shumicën e punimeve të analizuara hasen të dhëna përmes të cilave mund të identifikojmë

pacientët me SM dhe rezultate përmes të cilave arrijmë në përfundime të besueshme për komponentët e SM, gjininë, racën ose grupet etnike dhe grup - moshën. Në këto rezultate kemi hasur në komponentet kryesore të SM te pacientët obez ku pjesa më e madhe e pacientëve obez ishin në numër më të madh me hipertension. Prevalenca më e lartë e SM është e shprehur te gjinia femërore, ndërsa raca / grupi etnik me prevalencën më të lartë është e shprehur te jo - hispanikët e bardhë por në studime të tjera vërejmë luhatje të prevalencës në bazë të racës / grupit etnik. Vërehet një rritje e prevalencës së SM me rritjen e moshës. Prevalenca më e lartë është në grup - moshën 50 - 59 vjeçare.

Përfundime: Ekzistojnë disa kritere për identifikimin e pacientëve me SM: niveli i rritur i TG, niveli i rritur i glukozës në gjendje esëll, nivelin i reduktuar i HDL - C, presioni i rritur i gjakut dhe obeziteti. Rol të rëndësishëm parandaluese kanë ndryshimet e stilit të jetesës, kryesisht humbja e peshës, dieta dhe stërvitjet, ndërsa trajtimi përfshinë përdorimin e duhur të agjentëve farmakologjikë për të reduktuar faktorët e caktuar të rrezikut.

Fjalë kyçe: Sindroma metabolike, prevalenca, obeziteti.

ZHVILLIMI PROFESIONAL I MJEKUT NË EPOKËN E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE DHE AUTOMATIZIMIT: BASHKËJETESË APO ZËVENDËSIM?

Dr. Shkumbin Dreshaj

Abstrakt

Inteligjenca artificiale (IA) po sjell përparime të mëdha në sistemet shëndetësore moderne, duke rritur saktësinë diagnostike, efikasitetin e vendimmarrjes klinike dhe menaxhimin e të dhënave. Në vendet e BE - së dhe OECD - së, përdorimi i IA - së në radiologji ka treguar përmirësime të matshme: një meta - analizë e vitit 2024 tregon AUC = 0. 95 për detektimin e metastazave kanceroze, me ndjeshmëri 0. 88 dhe specifitet 0. 89, të krahasueshme me radiologët me përvojë (Liu et al. , 2024). Në neuroimazheri, ndjeshmëria e IA - së për lezione cerebrovaskulare kapërcen 90%, ndërsa përdorimi si "reader i dytë" e rrit ndjeshmërinë për nodulat pulmonarë me 14% (Kermany et al. , 2022). Në kardiologji, një RCT tregoi se interpretimi i EKG - ve nga IA uli kohën "door - to - balloon" nga 96 në 82 minuta për pacientët me STEMI (p=0. 002) (Zhang et al. , 2021). Në laboratorët klinikë, IA ka përmirësuar standardet e kontrollit cilësor dhe ka reduktuar kohën e analizës deri në 40% (Gupta et al. , 2024). Në Kosovë, sfidat janë të shumta: mungon një sistem elektronik i integruar për të dhënat e pacientëve, trajnimet për teknologji janë sporadike dhe jo të akredituara, dhe mungon një strategji kombëtare për përfshirjen e IA - së në shëndetësi. Megjithëse disa pajisje për interpretimin e EKG - ve me IA janë në përdorim, besimi klinik mbetet i ulët dhe IA shihet vetëm si referencë. Përfitimet e integrimit të IA - së në programet e Zhvillimit të Vazhdushëm Profesional (ZVP) janë të mëdha: reduktimi i gabimeve mjekësore, identifikimi më i hershëm i ndërlikimeve klinike dhe përmirësimi i shpërndarjes së burimeve në urgjenca. Për shembull, algoritmet e IA kanë ulur gabimet false - negative në radiologji me 20 - 30% (Liu et al. , 2024), si dhe kanë ndihmuar në aktivizimin më të shpejtë të laboratorëve kateterizues në raste kardiake urgjente (Lee et al. , 2022). Për të përfituar nga ky potencial, Kosova duhet të ndërtojë një kornizë të re ZVP - je që përfshin: Module të detyrueshme dhe të akredituara për përdorimin praktik të IA - së, të strukturuara sipas fushave (mjekësi familjare, urgjencë, laborator, imazheri, etj.); Bashkëpunim ndërinstitucional mes Fakultetit të Mjekësisë, Odës së Mjekëve dhe partnerëve ndërkombëtarë si WHO dhe ERASMUS+; Trajnime hibride (online + praktike) për profesionistët në zonat urbane dhe rurale; Vlerësim periodik të ndikimit të IA - së përmes auditimit klinik dhe feedback - ut të pjesëmarrësve. Në këtë drejtim, vizioni për të ardhmen e mjekësisë në Kosovë përfshin një sistem ku IA është komponentë bazë e ZVP - së, e integruar në mjekësi familjare, onkologji dhe emergjenca, me strategji të mirëfillta publike për edukimin digjital në shëndetësi (OECD, 2021; WHO, 2022; European Commission, 2023).

Fjalë kyçe: Zhvillimi profesional, epokë e inteligjencës artificiale, Kosovë

DHUNA, ALKOOLI DHE DROGA NË SHQIPËRI: ANALIZË MBI ASOCIACIONET KYÇE DHE NDIKIMIN RAJONAL.

Shpëtim Doksani

Abstrakt

Dhuna në shoqërinë shqiptare mbetet një fenomen kompleks me pasoja të thella në planin individual, familjar dhe komunitar. Ky studim synon të analizojë lidhjen ndërmjet dhunës dhe përdorimit të substancave psikoaktive, me fokus të veçantë tek alkooli dhe drogat, si faktorë bazë ("derived key factors") që ndikojnë në intensitetin dhe shpërndarjen rajonale të dhunës. Nëpërmjet analizës së të dhënave kombëtare, raporteve të INSTAT, Policisë së Shtetit dhe organizatave të shoqërisë civile (2022–2024), vërehet se rreth 40% e rasteve të dhunës në familje lidhen drejtpërdrejt me abuzimin me alkool, ndërsapërdorimi i drogës (veçanërisht kanabisit, heroinës dhe kokainës) është në rritje në zonat urbane dhe periurbane si Tiranë, Durrës dhe Elbasan. Në rajonet jugore (Vlorë, Gjirokastër, Tepelenë) dhe veriore (Shkodër, Lezhë, Kukës), lidhja ndërmjet varfërisë, papunësisë dhe përdorimit të substancavereflektohet në shtimin e rasteve të dhunës komunitare dhe familjare. Ndërkohë, në zonat rurale, fenomeni shpesh mbetet i nën - raportuar për shkak të mungesës së mekanizmave të raportimit dhe stigmat sociale. Metodologjia e përdorur përfshin analizë të të dhënave sekondare, krahasim rajonal dhe interpretim përmes një qasjeje socio - ekonomike. Rezultatet tregojnë se përdorimi i alkoolit dhe drogës është variabël i ndërmjetëm ndërmjet faktorëve socio - ekonomikë (papunësia, migracioni, arsimi i ulët) dhe manifestimeve të dhunës. Studimi përfundon se parandalimi i dhunës në Shqipëri kërkon një strategji të integruar që përfshin kontrollin e përdorimit të substancave, forcimin e shërbimeve sociale dhe ndërgjegjësimin e komunitetit. Për më tepër, nevojitet një qasje rajonale e diferencuar, pasi intensiteti dhe format e dhunës ndryshojnë ndjeshëm nga një qark në tjetrin.

Fjalë kyçe: Dhuna, alkooli, droga, Shqipëria, faktorët socialë, asociacionet kyçe, rajonet, parandalimi, varfëria, papunësia, shëndeti publik.

PITYRIASIS ROSEA: TRAJTIM, OBSERVIM APO ASGJË? EVIDENCAT PËR TRAJTIM, RREZIKUN E PËRSËRITJES DHE SFIDAT AKTUALE KLINIKE.

Dr. Shqiponjë Morina, Dr. Idriz Trolli

Abstrakt

Hyrje: Pityriasis Rosea është sëmundje beninje, vetë - kufizuese që karakterizohet me erupsionin e ekzantemës papuloskuamoze. Në shumicën e rasteve 2 javë para erupsionit shfaqet shenja patognomonike që duket sikur medalion, që quhet "Herald Patch". Ky është një lezion 2 - 10 cm që shfaqet zakonisht në gjoks, qafë, ose shpinë, ndërsa efloreshencat e fazës së erupsionit janë më të vogla, 0. 5 - 1 cm dhe shpërndahen në pjesët proksimale të ekstremiteteve dhe në trungun e trupit duke ndjekur vijat Langer të lëkurës, me ç'rast formohet figura karakteristike e "pemës së Krishtlindjes". Simptoma më problematike është kruarja e cila mund të jetë intensive, por ekzistojnë edhe simptomat prodromale si: dhimbje fyti, ethe, artralgji, shqetësime gastrointestinale. Etiologjia nuk është saktësisht e përcaktuar, por hipoteza më e fuqishme është se shkaktohet nga infeksioni apo edhe riaktivizimi i HHV - 6 dhe HHV - 7.

Qëllimi: Të analizohet etiologjia, natyra e sëmundjes, të evidentohet shkalla e përsëritjes së erupsionit si dhe strategjia më e mirë e menaxhimit të kësaj sëmundje.

Metodologjia: Për realizimin e këtij punimi janë rishikuar dhe analizuar punime shkencore të ndryshme në databazat shkencore si PubMed, Science Direct, Google Scholar, dhe publikime në burime dermatologjike të specializuara si; DermNet, AAD (American Academy of Dermatology).

Rezultate: Shumë studime mbështesin faktin se shkaku më i shpeshtë mendohet të jetë infeksioni me HHV - 6 dhe HHV - 7 mirëpo janë evidentuar lidhshmëri në paraqitjen e Pityriasis Rosea (P. R.) pas infeksionit me SARS - CoV - 2 dhe / apo pas vaksinës kundër COVID - 19. Në një studim me 154 pacientë, Pityriasis Rosea u raportua në 102 raste (66. 2%) pas vaksinimit kundër COVID - 19, ndërsa në 52 raste (33. 8%) në lidhje me infeksionin me SARS - CoV - 2 – përkatësisht, në 22 pacientë gjatë infeksionit dhe në 30 pacientë pas tij. Pityriasis Rosea është vërtetuar se prek më shumë gratë shtatzëna dhe madje paraqet rrezikshmëri për këtë grup të popullatës. Në një studim tjetër është evidentuar se nga 61 gra shtatzëna me P. R. 22 prej tyre (36%) patën rezultate të pafavorshme ndërsa 8 të tjera (13%) abortuan. Rreziku për abort është më i madh kur infeksioni ndodh në 15 javët e para të gestacionit. Për sa i perket relapsit të P. R. prej studimeve më të hershme është menduar se relapset

janë relativisht të rralla, diku 3%, mirëpo një studim i viteve më të fundit ka evidentuar se shkalla e përsëritjes është në fakt më e lartë sesa kemi menduar. Sipas këtij studimi të kryer në Turqi, janë përcjellur për 4 vite 212 pacientë me P. R. ku 55 prej tyre patën relaps, pra shkalla e përsëritjes ishte 25. 9%.
Përfundime: Pityriasis Rosea në shikim të parë duket se është një sëmundje jo - problematike, ku shqetësimi më potent i pacientëve është kruarja intensive dhe ndikimi psikologjik dhe emocional për shkak të dukjes së lëkurës nga skuqja dhe efloreshencat, por në disa raste mund të kërkojë vëmendje të veçantë, sidomos te gratë shtatzëna. Është një sëmundje beninje dhe vetëkufizuese që shërohet edhe vetvetiu brenda 2 - 3 muajsh, rrallë përsëritet, dhe kur ndodh zgjat më pak dhe ka më pak ndryshime lëkurore. Lidhshmëria me viruset HHV - 6 / 7, rrezikshmëria e komplikimeve në gratë shtatzëna me P. R. si dhe rritja e raportuar e relapsit, theksojnë nevojën për qasje individuale në menaxhim dhe për hulumtime të mëtejshme.

Fjalë kyçe: Pityriasis rosea, herald patch, HHV - 6, HHV - 7, Covid - 19, shtatzëna.

PËRDORIMI KLINIK I [18F] FDG PET / CT NË PACIENTËT ME KANCER TË GJIRIT TREFISH NEGATIV TË TRAJTUAR ME KIMIOTERAPI NEOADJUVANTE ME OSE PA IMUNOTERAPI.

Shqiponjë Plakaj, Ramë Miftari

Abstrakt
Hyrje: Kanceri i gjirit trefish negativ paraqet një grup heterogjen sëmundjesh me profile gjenetike, histologjike dhe imunologjike të ndryshme, të agreguara në këtë term për shkak të mungesës së receptorëve të estrogjenit, progesteronit dhe HER - 2. Ky punim ka për qëllim mbledhjen e sistematizuar të dëshmive nga literatura e recensuar mjekësore dhe studimet e ndryshme shkencore të viteve të fundit për perdorimin klinik të [^{18}F] FDG PET / CT në pacientët me kancer të gjirit trefish negativ te trajtuar me kimioterapi neoadjuvante me ose pa imunoterapi Ky punim është rishikim i sistematizuar i literatuës. Metodologjia është e bazuar në rekomandimet për udhëheqjen e rishikimit të literaturës që përbëhet nga 5 hapa: kërkimi i literaturës, përzgjedhja e literaturës, evaluimi i literaturës, mbledhja dhe sinteza e të dhënave.
Rezultate: Të dhënat nga punimet shkencore të 10 viteve të fundit sugjerojnë se ndryshimet metabolike dhe të perfuzionit nga [^{18}F] FDG PET / CT janë të lidhura ngusht me përgjigjen patologjike dhe prognozën te pacientët me kancer të gjirit trefish negativ të trajtuar me kimioterapi neoadjuvante (NAC), me ose pa imunoterapi. Një reduktim më i madh i vlerës maksimale të përthithjes së standardizuar (SUVmax) pas dy cikleve NAC u vu re te pacientët që arritën përgjigje të plotë patologjike (pCR) (−72% kundrejt −42%, $p < 0.0001$, ulja mbi 42% e SUVmax pas dy cikleve NAC lidhet me rrezik më të ulët të rikthimit. ΔSUVmax
≥81. 3% korrelonte me pCR, ndërsa një ΔSUVmax <15. 9% parashikonte mbijetesë pa sëmundje më të ulët ($p = 0.0078$). Ndryshimet e hershme në perfuzionin tumoral (ΔBF) parashikuan gjithashtu mbijetesën 3 - vjeçare (87% kundrejt 48%). Saktësia e PET / CT ndryshonte në varësi të regjimit të kimioterapisë, dhe në modelet preklinike, si [^{18}F] FDG ashtu edhe [^{18}F] FLT PET identifikuan në mënyrë efektive përgjigjen ndaj paclitaxelit. SUVmax i lartë dhe TMTV i ulët u shfaqën si parashikues të pavarur të pCR në të dy grupet NAC dhe NACI.
Përfundime: Imazheria me [^{18}F] FDG PET / CT para dhe gjatë NAC ofron një mjet të rëndësishëm klinik për përcaktimin e përgjigjes së TNBC, duke mundësuar personalizimin e strategjive terapeutike, veçanërisht në kontekstin e kimioterapisë me ose pa imunoterapi. Nevojiten studime të mëtejshme për të integruar këto biomarkerë në praktikën klinike.

Fjalë kyçe: ^{18}F - FDG PET / CT, TNBC, kimioterapi neoadjuvante, imunoterapi.

GLOMERULONEFRITI AKUT.

Shqipron Goxhuli

Abstrakt
Glomerulonefriti akut është një sëmundje inflamatore e glomerulave të veshkave, që shfaqet papritur dhe shpesh pason një infeksion bakterial, veçanërisht atë streptokokal. Ky proces patologjik shkaktohet kryesisht nga reaksione imunologjike ku komplekset imune depozitohen në glomerula, duke çuar në dëmtim të funksionit filtrues të veshkave. Manifestimet klinike përfshijnë hematurinë, proteinurinë, edemën dhe hipertensionin

arterial, ndërsa diagnoza vendoset përmes analizave laboratorike, ekzaminimit të urinës dhe ndonjëherë biopsive renale. Trajtimi është kryesisht mbështetës dhe synon kontrollin e simptomave dhe parandalimin e komplikimeve të mundshme, si dështimi akut i veshkave. Njohja e hershme e simptomave dhe ndërhyrja e shpejtë janë thelbësore për përmirësimin e prognozës. Ky punim synon të paraqesë një pasqyrë të plotë mbi etiologjinë, patogjenezën, diagnostikimin dhe menaxhimin klinik të glomerulonefritit akut, duke u mbështetur në literaturë bashkëkohore dhe burime klasike të nefrologjisë.

Fjalë kyçe: Glomerulonefriti akut, sëmundje inflamatore, glomerula.

ÇRREGULLIMI I EKUILIBRIT HEMOSTATIK NË DREJTIM TË NJË GJENDJEJE PROKOAGULANTE TE PACIENTËT ME LUPUS ERITEMATOZ SISTEMIK PA ANTITRUPA ANTIFOSFOLIPIDIKË.

Silda Caushaj, Ervin Rapushi, Artur Zoto, Teuta Backa, Anastasio Kolaci, Florid Zenelaj, Stela Janko
Shërbimi i Reumatologjisë, QSUNT

Abstrakt
Ky rishikim literature synon të analizojë çrregullimin e ekuilibrit hemostatik në drejtim të një gjendjeje prokoagulante te pacientët me lupus eritematoz sistemik (LES) pa antitrupa antifosfolipidikë, duke përmbledhur provat aktuale mbi mekanizmat që nxisin hiperkoagulimin në këtë grup pacientësh. Studimet e fundit kanë treguar se, edhe në mungesë të sindromës antifosfolipidike, pacientët me LES paraqesin shenja të aktivizimit endotelial, rritje të gjenerimit të trombinës, përmbajtje të shtuar të faktorit të indit në mikropjesëzat qarkulluese dhe aktivizim të trombociteve, të cilat kontribuojnë në një profil të theksuar prokoagulant. Gjithashtu, rrjetat jashtëqelizore të neutrofileve (NETs) dhe rritja e niveleve të PAI - 1 përforcojnë këtë disbalancë duke penguar fibrinolizën dhe duke favorizuar formimin e trombit. Këto gjetje nënvizojnë se inflamacioni sistemik dhe dëmtimi vaskular i lidhur me LES mund të jenë faktorë kyç në çrregullimin e hemostazës, duke e bërë të domosdoshme përdorimin e testeve globale të koagulimit për vlerësimin e hershëm të riskut trombotik dhe për zhvillimin e strategjive parandaluese te këta pacientë.

Fjalë kyçe: Lupus eritematoz sistemik, gjendje prokoagulante, ekuilibër hemostatik, inflamacion sistemik, risk trombotik.

PROJEKTI DRAIGON: DIAGNOZË "AFËR - PACIENTIT" PËR REZISTENCËN ANTIMIKROBIKE ME AI DHE SEKUENCIM GJENOMIK.

Silva Tafaj[1], Silvana Bala[2], Hasan Hafizi[2]
[1]*Laboratori Kombëtar i Referencës për Tuberkulozin, Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës "Shefqet Ndroqi", Tiranë.*
[2]*Shërbimi i Pneumologjisë, Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës "Shefqet Ndroqi", Tiranë.*

Abstrakt
Hyrje: Konteksti dhe nevoja: Rezistenca ndaj antimikrobikëve (AMR) përbën sot një nga kërcënimet më të rrezikshme për shëndetin publik, si në Evropë ashtu dhe në mbarë botën. Vetëm në vitin 2019, AMR kontribuoi në 4. 95 milionë vdekje globale, prej të cilave 1. 27 milionë të shkaktuara drejtpërdrejt. Në BE, Parlamenti Evropian në vitin 2023 e renditi AMR si një nga tre prioritetet kryesore të shëndetit. Metodat tradicionale diagnostike janë shpesh të ngadalta dhe jo gjithmonë të sakta, duke vënë në rrezik trajtimin efektiv dhe kontrollin e përhapjes së infeksioneve të shumta (MDR).
Qëllimi i projektit DRAIGON: Projekti (Diagnosing Infections with Multi - Drug Resistant Microorganisms using AI - powered Genomic Antibiotic Susceptibility Prediction from Long - Read Sequencing Data) synon të zhvillojë një pajisje in vitro (IVD) inovative që integron inteligjencën artificiale dhe sekuencimin e gjeneratave të reja (WGS), për diagnostikim të
shpejtë dhe të saktë "afër pacientit". Qëllimi është të mundësohet identifikim i saktë i
patogjenit dhe profil i plotë i rezistencës / ndjeshmërisë në vetëm një analizë.

Zbatimi klinik: DRAIGON do të vlerësohet në kushte reale klinike për infeksionet në: Infeksione të gjakut (bloodstream infections, BSI), infeksione të lidhura me protezat ortopedike (prosthetic joint infections, PJI) Analizat do të zhvillohen në 5 vende, duke përfshirë Shqipërinë, një vend me të ardhura mesatare dhe me barrë të lartë AMR dhe infrastrukturë të kufizuar laboratorike. Avantazhet teknike dhe mjekësore: Duke përdorur edhe analizën me AI bazuar në cloud DRAIGON synon diagnozë "near patient", që do të thotë rapide, të sakta dhe të implementueshme direkt aty ku është pacienti, duke përshpejtuar vendimmarrjen klinike dhe përmirësuar rezultatin për pacientët. Pajisja do të ofrojë informacion për: identifikimin e patogjenit, profilin e ndjeshmërisë ndaj antibiotikëve dhe tipizimin e kloneve / shpërthimeve në një analizë të vetme. Potenciali transformues: Kjo qasje diagnostike, që kombinon WGS me AI, do të forcojë luftën globale kundër AMR duke mbështetur parimin: "antibiotiku i duhur, në dozën e duhur, për pacientin e duhur dhe në kohën e duhur".

Fjalë kyçe: Rezistencë antimikrobike (AMR), diagnozë rapide "near patient", inteligjenca artificiale (ai), sekuencimi i gjeneratave të reja / whole genome sequencing (wgs), infeksione të gjakut (BSI) dhe infeksione te protezave ortopedike (PJI), Horizon Europe, Horizon - IA, IVD diagnostikë.

EPIDEMIOLOGJIA GJENOMIKE E PATOGJENËVE ESKAPE NË SHQIPËRI: IDENTIFIKIMI I KLONEVE ME RREZIK TË LARTË DHE MULTIREZISTENTE NGA STUDIMI TWIW 2020.

Silva Tafaj[1,2], Basil Britto Xavier[3], Silvana Bala[4], Hasan Hafizi[4], Entela Ramosacaj[5], Gentian Kasmi[2], Fatmir Caushi[6], Arjan Harxhi[7], Anurag Kumar Bari[3], Maria João Cardoso[3], Tim T. Severs[3,8], Sofia Berdalli[9], Frank Møller Aarestrup[10], Bhanu Sinha[3], John W. A. Rossen[3,8,11]

[1]Departamenti i Mikrobiologjisë, Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës "Shefqet Ndroqi", Tiranë, Shqipëri;
[2]Departamenti i Laboratorëve, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri;
[3]Departamenti i Mikrobiologjisë Mjekësore dhe Parandalimit të Infeksioneve, Qendra Mjekësore Universitare e Groningen - it, Universiteti i Groningen - it, Holandë;
[4]Klinika e Pneumologjisë, Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës "Shefqet Ndroqi", Tiranë, Shqipëri;
[5]Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Tiranë, Shqipëri;
[6]Departamenti i Kirurgjisë Torakale, QSRT "Shefqet Ndroqi", Tiranë, Shqipëri;
[7]Departamenti i Sëmundjeve Infektive, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri;
[8]Laboratori i Mikrobiologjisë Mjekësore dhe Sëmundjeve Infektive & Isala Academy, Spitali Isala, Zwolle, Holandë;
[9]Laboratori Michael Ogon për Kërkime Ortopedike, Spitali Ortopedik Vienna Speising, Vjenë, Austri;
[10]Universiteti Teknik i Danimarkës, Instituti Kombëtar i Ushqimit, Laboratori Referencë i BE - së për Rezistencën Antimikrobike, Qendra Bashkëpunuese e OBSH për Rezistencën Antimikrobike në Patogjenët që Transmetohen nga Ushqimi dhe Gjenomikën, Laboratori Referencë i FAO - s për Rezistencën Antimikrobike, Kgs. Lyngby, Danimarkë;
[11]Departamenti i Patologjisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Utah, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Abstrakt

Objektivat: Të paraqitet një panoramë gjenomike e rezistencës antimikrobike (AMR) ndërmjet patogjenëve bakterialë klinikë kryesorë të grupit ESKAPE, të izoluar nga Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës "Shefqet Ndroqi" (QSRT), me fokus në profilin e rezistencës, identifikimin e kloneve me rrezik të lartë dhe implikimet e tyre në praktikën klinike dhe shëndetin publik.

Materiale dhe metoda: Izolatet klinike të mbledhura gjatë studimit TWIW 2020 iu nënshtruan sekuencimit të plotë gjenomik dhe analizës së thelluar bioinformatike. Të dhënat e marra nga sekuencimi ju nënshtruan procesit të kontrollit të cilësisë, të "trimming" dhe "assembly"; u eleminuan kontaminimet dhe gjenomat u anotuan duke përdorur "pipeline" - t standarde. Identifikimi i llojeve dhe tipizimi multilokus (MLST) u kryen me databaza specifike për çdo lloj. Analizat e gjenomës core MLST dhe marrëdhëniet filogjenetike u realizuan me *chewBBACA* dhe *GrapeTree.* Determinantët e rezistencës antimikrobike u identifikuan me *AMRFinderPlus* për të karakterizuar diversitetin e shtameve, mekanizmat e rezistencës dhe shpërndarjen e elementeve gjenetike të lëvizshme.

Rezultate: U konstatua një prevalencë e lartë e rezistencës së fituar ndër patogjenët ESKAPE. Klonet me rrezik të lartë përfshinin *Pseudomonas aeruginosa* ST235 që bart *blaNDM - 1, Acinetobacter baumannii* ST425 / 2 me karbapenemazën *OXA - 23, Klebsiella pneumoniae* ST15 që mbart *NDM - 1* dhe yersiniabaktin, si dhe *Escherichia coli* ST131 që prodhon *CTX - M - 15.* Këto linja shfaqën rezistencë të gjerë ndaj antibiotikëve

dhe shpesh lidheshin me transmetim spitalor. U identifikuan elemente të shumta gjenetike të lëvizshme dhe mekanizma të ndryshëm rezistence, të cilët kufizojnë ndjeshëm opsionet terapeutike.
Përfundime: Zbulimi dhe qarkullimi endemik i kloneve ESKAPE multirezistente, të njohura globalisht, , paraqet një sfidë të mëdha për trajtimin klinik dhe kontrollin e infeksioneve. Këto gjetje theksojnë nevojën urgjente për forcimin e programeve të parandalimit të infeksioneve, përdorimin racional të antibiotikëve dhe zbatimin e mbikëqyrjes së vazhdueshme gjenomike për të frenuar përhapjen e AMR dhe për të mbrojtur shëndetin publik.

Fjalë kyçe: Sekuencimi i plotë i gjenomit, patogjenët ESKAPE, rezistenca antimikrobike, klone, rrezik i lartë.

MASA MULTIDISIPLINARE PËR PARANDALIMIN EFEKTIV TË PNEUMONIVE TË LIDHURA ME VENTILATORIN (VAP) NË REANIMACION.

Dr. Silvana Leka[1], Prof. Hektor Sula[2]
[1]Anestezi - Rean Spitali Universitar i Traumës, Fakulteti i Mjekësisë
[2]Zv. Rektor Universiteti i Mjekësisë

Abstrakt
Hyrje: Pneumonitë e lidhura me ventilatorin (VAP) është një ndër infeksionet nozokomiale më serioze në të sëmurët në gjendje të rëndë në reanimacion, duke cuar në mortalitet të rritur, zgjatje të periudhës së qëndrimit në respirator, qëndrimit në reanimacion dhe rritje sinjifikante të kostove spitalore. Për këto arsye, parandalimi VAP është një prioritet kritik për sigurinë e pacientit dhe përmirësimin e cilësisë në Reanimacion. Në studimin që do të kryhet ka për qëllim të vlerësohet efektiviteti ne implementimin e një sërë masash për të ulur icidencën e VAP.
Materiale dhe metoda: Në qendrën tonë terciare janë mbledhur të dhëna për incidencën e VAP për një periudhë 12 mujore dhe vlerësohet një incidencë e rritur në krahasim me reanimacione në qendra spitalore europiane. Në studim do të përfshihen për një periudhë 6 mujore të gjithë të sëmurët e intubuar me qëndrim mbi 48 h nën ventilim mekanik dhe mbi 18 vjeç, të cilët do ti nënshtrohen masave parandaluese në mënyrë rigoroze: ngritja e kokës së krevatit 30 - 45 gradë, pastrim ditor i gojës me furca të përshtatshme për të sëmurë të intubuar me klorheksidine, përdorim vetëm i kateterëve të mbyllur të aspirimit, përpjekje për ekstubim të hershëm, përdorimi i një antibiotiku si cefalosporinë e gjeneratës së tretë ose kinolon për parandalim. Një përpjekje do bëhet për ritrajnim të stafit infermieror dhe plotësimin e nje checkliste të standardizuar për çdo të semurë.
Rezultate: Do të vlerësohet incidenca e VAP me kriteret përkatëse dhe do të krahasohet nëse masat parandaluese kanë qenë efikase pë uljen e incidencës së VAP
Konkluzione: Mendohet që masat do të ulin incidencën e VAP, ditëqendrimin në respirator të të sëmurit, ulje të mortalitetit dhe ulje të kostos spitalore. Mendohet që ky protokoll të standartizohet e të jetë pjesë e protokollit tonë spitalor.

Fjalë kyçe: VAP, infeksionet nozokomiale, reanimacion.

KARAKTERISTIKAT KLINIKE DHE EFIKASITETI I TERAPISË ME ANTI - TNFA TEK PACIENTËT ME SËMUNDJEN INFLAMATORE TË ZORRËS: EKSPERIENCA JONË.

Marsela Sina[1], Xhensila Pemaj[1], Skerdi Prifti[1]
[1]Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza, Shërbimi i Mjekësisë së Brendshme, Gastroenterologji, Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt
Hyrje: Fillimi i përdorimit të terapive me barna biologjik anti TNFα (tumor necrosis factor α) ka qenë një moment i rëndësishëm në menaxhimin e sëmundjes inflamatore të zorrës (SIZ), që perfshine Kolitin Ulceroz (KU) dhe Sëmundjen e Crohn - it (CD). Pavarësisht zhvillimit të terapive të reja biologjike dhe terapive me molekula të vogla, agjentët anti - TNFα vazhdojnë të luajnë një rol thelbësor në trajtim. Në disa vende, këta agjentë mbeten të rimbursueshëm si terapi e linjës së parë, pas dështimit ose intolerancës ndaj terapive

konvencionale. Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i efektivitetit të terapisë me anti - TNFα në induktimin dhe ruajtjen e remisionit klinike dhe endoskopike tek pacientët me SIZ.
Metoda: Ky është një studim prospektiv në Klinikën Universitare të Gastroenterologjisë, në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë, Shqipëri (2016–2025). U përfshinë të gjithë pacientët adult të diganostikuar me KU ose CD, të trajtuar me infliksimab (IFX) ose adalimumab (ADA). U analizuan të dhënat demografike, karakteristikat klinike dhe detajet e trajtimit. Përgjigjja klinike u vlerësua në javën e 8 - të, ndërsa remisioni kliniko dhe endoskopik në javën e 52 - të.
Rezultate: Në studim u përfshinë 106 pacientë, me moshë mesatare 46. 3 ± 14. 4 vjeç (19–79); 52 (49. 1%) ishin meshkuj. KU ishte diagnoza mbizotëruese (84%), ndërsa 16% kishin CD. Kohëzgjatja mesatare e sëmundjes ishte 8. 9 ± 5. 7 vite. IFX u përshkrua në 55. 7% të rasteve, ndërsa 44. 3% morën ADA. Ndër pacientët me KU, 46. 1% kishin pankolit, 47. 2% kolit të majtë dhe 6. 7% proktit. Për CD, 35. 3% kishin ileit të izoluar, 11. 8% kolit dhe 52. 9% ileokolit. Përgjigjja klinike afatshkurtër u arrit në 60. 4% të pacientëve (64% KU, 58. 3% CD; p=0. 7), pa dallim te rendesieshme mes KU dhe CD. Në vlerësimin e javës së 52 - të, remisioni klinike u arrit në 57% të pacientëve, me rezultate të krahasueshme midis KU dhe CD (53. 7% kundrejt 72. 7%; p = 0. 246). Remisioni endoskopike u arrit në 46. 6% të gjithë pacienteve, pa dallime statistikisht domethënëse midis CD dhe KU (33. 3% kundrejt 47. 3%; p = 0. 637) apo midis pacientëve të trajtuar me IFX dhe ADA (37. 5% kundrejt 56. 7%; p = 0. 125).
Konkluzione: Përvoja jonë tregon se terapia me anti - TNFα (IFX dhe ADA) është efektive në induktimin dhe ruajtjen e remisionit klinike tek pacientët me SIZ, me rezultate të krahasueshme midis nën - grupeve KU dhe CD.

Fjalë kyçe: anti - TNFα, terapi, pacient, efikasitet etj

PROFILI KLINIKO - DEMOGRAFIK I PACIENTËVE ME VDEKSHMËRI TË HERSHME NGA COVID - 19 PA INSUFICIENCË RESPIRATORE DHE PA KOMORBIDITETE TË SHUMTA: NJË ANALIZË RETROSPEKTIVE E RASTEVE FATALE TË HOSPITALIZUARA GJATË PRIUDHËS PANDEMIKE.

Sofiela Telo[1], Elizana Petrela[2], Jonida Tula[1], Nerida Dhigoi[1], Borana Galanxhi[1], Arba Ismalaja[1]
[1]*Qendra Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi", Tiranë*
[2]*Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë*

Abstrakt
Hyrje: Shumica e rasteve fatale nga COVID - 19 përfshijnë pacientë të moshuar, me insuficiencë respiratore dhe sëmundje shoqëruese të shumta. Megjithatë, një nëngrup i vogël pacientësh kanë humbur jetën në mënyrë të hershme, pavarësisht mungesës së faktorëve klasikë të rrezikut. Kuptimi i karakteristikave të këtij grupi është thelbësor për përmirësimin e vlerësimit të hershëm të rrezikut dhe përcaktimin e strategjive më efektive të ndërhyrjes.
Qëllimi: Të përshkruajë profilin klinik dhe demografik të pacientëve që ndërruan jetë herët nga COVID - 19, pa insuficiencë respiratore në momentin e shtrimit, me një ose asnjë sëmundje shoqëruese dhe me kohë qëndrimi spitalor ≤10 ditë. Gjithashtu, të identifikojë faktorë të mundshëm që lidhen me përkeqësimin e shpejtë klinik.
Metodologjia: Ky është një studim retrospektiv përshkrues mbi 1572 raste fatale të pacientëve të hospitalizuar me COVID - 19 në Qendrën Spitalore Universitare "Shefqet Ndroqi", gjatë periudhës Prill 2020 – 2021. Vdekshmëria e hershme u përcaktua si vdekje në pacientë nën 60 vjeç, pa insuficiencë respiratore në momentin e shtrimit, me kohë qëndrimi <10 ditë dhe me një ose asnjë sëmundje shoqëruese.
Rezultate dhe Diskutime: Nga 1572 raste, 42 pacientë (2. 7%) plotësuan kriteret për vdekshmëri të hershme. Mosha mesatare ishte 50. 2 ± 9. 1 vjeç, ndjeshëm më e ulët krahasuar me pacientët e tjerë (69. 4 ± 10. 5 vjeç, p < 0. 001). Koha mesatare e qëndrimit në spital ishte 5. 2 ± 2. 8 ditë (vs. 9. 2 ± 7. 5 ditë; p < 0. 001). Asnjë pacient nuk kishte insuficiencë respiratore në momentin e pranimit, ndërsa hipertensioni ishte komorbiditeti më i shpeshtë (28. 6%). Në 16. 8% të rasteve, vdekja ndodhi brenda 48 orëve nga shtrimi, duke reflektuar një përkeqësim të shpejtë klinik.
Përfundime: Vdekshmëria e hershme në pacientë të rinj, pa komorbiditete të shumta dhe pa insuficiencë respiratore në momentin e shtrimit, përfaqëson një nëngrup të veçantë me rëndësi të lartë klinike. Rezultatet theksojnë nevojën për rishikim të protokolleve të vlerësimit të rrezikut dhe për implementimin e ndërhyrjeve të hershme edhe në pacientë që në dukje paraqiten me rrezik të ulët.

Fjalë kyçe: COVID - 19, komorbiditete, vdekshmëri e hershme, insuficencë respiratore.

TRAM FLAP NË REKONSTRUKSIONIN AUTOLOG TË GJIRIT.

Prof. Asoc. Isaraj S, Dr. Drinjak HJ

Abstrakt

Hyrje: Rekonstruksioni autolog i gjirit me lembo TRAM (Transverse Rectus Abdominis Myocutaneous) është një teknikë kirurgjikale që përdor indet e pacientes për të rikrijuar gjirin pas mastektomisë. Anatomikisht, TRAM bazohet në muskulin rectus abdominis dhe lëkurën e barkut, të furnizuar nga arteria epigastrive inferiore. Fiziologjikisht, kjo metodë siguron një gji me pamje dhe ndjesi natyrale, duke shmangur implantet. Teknika përfshin transferimin e indit abdominal në zonën e gjirit, me ose pa ruajtjen e furnizimit vaskular (lembo e pedunkuluar ose e lirë), duke kërkuar njohuri të mira kirurgjikale për të minimizuar komplikimet.

Metodologjia: Dy paciente me rekonstruksion unilateral të gjirit u përfshinë në studim. Të dyja kishin kryer mastektomi për karcinomë të gjirit dhe iu nënshtruan rindërtimit me TRAM. Procedura u krye duke përdorur teknikën e lembos së pedunkuluar, me transferimin e indit nga barku në zonën e gjirit, duke ruajtur furnizimin vaskular. Pacientet u përzgjodhën bazuar në gjendjen e përgjithshme dhe disponueshmërinë e indit abdominal të mjaftueshëm.

Rezultate: Të dyja pacientet patën rezultate estetike të kënaqshme, me gji që imitonin pamjen natyrale. Nuk u raportuan komplikime të mëdha. Megjithatë, një paciente pati nekrozë distale ne rreth 5 - 10% të sipërfaqes së lëmbos. Koha mesatare e rikuperimit ishte 6 javë, me kënaqësi të lartë të raportuar nga pacientet për rezultatin estetik dhe funksional.

Përfundime: Flapa TRAM është një metodë efektive për rindërtimin autolog të gjirit, duke ofruar rezultate natyrale dhe kënaqësi të lartë estetike. Përzgjedhja e kujdesshme e pacientes dhe teknika e saktë kirurgjikale janë thelbësore për të minimizuar komplikimet dhe për të siguruar sukses. Studime të mëtejshme me kampionë më të mëdhenj nevojiten për të vlerësuar efikasitetin afatgjatë të kësaj teknike.

Fjalë kyçe: TRAM flap, rekonstruksion i gjirit, teknikë kirurgjikale.

INSUFICIENCA KARDIAKE TERMINALE DHE PREKJET ORGANORE.

Somida Kuka, Eneida Hoxha, Margarita (Gjata) Resuli
Departamenti i Mjekësisë Interne dhe Hipertensionit, "Nënë Tereza" Qendra Universitare Spitalore, Tiranë.

Abstrakt

Hyrje: Insuficienca kardiake (IKK) është një patologji me ecuri të keqe dhe vdekshmëri të lartë. Në situatat end stage ajo përfshin në çrregullime edhe sistemet e tjera të organizmit, duke shfaqur klinikë që simulojnë patologji të tjera. Analizat laboratorike mund të alterohen gjithashtu. Alterimet shoqëruese futin organizmin në një vorbull që vështirëson mjekimin. Gjithashtu, kjo situatë kthehet në një rreth vicioz që përkeqëson gjendjen dhe e çon organizmin drejt vdekjes. Alterimet organore kryesore janë: dëmtimet trunore, alterimet renale, alterimet hepatike, alterimet hematologjike, alterimet elektrolitike, çrregullimet e traktit intestinal, ulcerat trofike, etj.

Objektiva: Të njihen këto ndryshime sekondare në IKK dhe të bëhet diagnoza diferenciale me patologjitë specifike, duke qenë se dhe mjekimi i tyre është i ndryshëm.

Materiale dhe metoda: Të dhënat janë materiale dhe informacione të marra nga artikujt dhe botimet e fundit. Informacionet e grumbulluara nga informacionet e viteve të fundit tregojnë elemente të rëndësishëm mbi dallimin e IKK me patologjitë e tjera.

Diskutime: Komplikacionet organore në terren të IKK janë të shumta, me shtrirje të dëmtimeve në shkallë të ndryshme, nga prekjet e lehta deri në insuficiencat organore: renale, hepatike, etj. Për diagnozën diferenciale me dëmtimet organore primare, pra jo në terren të IKK, na orienton sfondi ku zhvillohen këto alterime dhe ekzaminimet shoqëruese përkatëse. Shpesh kjo diagnozë diferenciale bëhet e vështirë, atëherë dhe trajtimi i tyre është gjithashtu i vështirë.

Konkluzione: Komplikacionet e rënda dhe dëmtimet që shtrihen në të gjithë organizmin te IKK duhet të njihen dhe të trajtohen. Ato vështirësojnë trajtimin efektiv të IKK, prishin cilësinë e jetës dhe afrojnë vdekjen. Duke

ditur këtë ecuri të keqe të IKK, është e rëndësishme diagnostikimi i hershëm i saj dhe trajtimi në fazat e hershme, kur është edhe më efektiv.

Fjalë kyçe: Insuficiencë kardiake, dëmtime organore, çrregullime metabolike.

SËMUNDJET HIPERTENSIVE GJATË SHTATZËNISË.

Prof. Asc. Sonila Bele
Departamenti i Semiologjisë Imazherike dhe Klinike, Fakulteti i Mjekësisë,
Universiteti Mjekësor i Tiranës

Abstrakt
Hipertensioni në shtatzëni komplikon rreth 5 - 10% të shtatzënave duke u vlerësuar si një nga shkaqet madhore të sëmundshmërisë dhe mortalitetit fetal dhe amëtar. Hipertensioni në shtatzëni megjithëse një sëmundje unike për shtatzëninë është evidentuar që ka pasoja të rëndësishme në shëndetin e grave sidomos në sistemin kardiovaskular. Hipertension në shtatzëni konsiderohet kur TA≥140 / 90 mm Hg. Sëmundjet hipertensive gjatë shtatzënisë janë klasifikuar në këto kategori: Hipertensioni kronik, Hipertensioni i shtatzënisë, Preeklampsia. Diagnoza e hipertensionit gjatë shtatzënisë e matur me Holter Tensioni është më superiore krahasuar me matjet e tensionit në dhomen e mjekut apo monitorim e tensionit nga vetë pacientet në shtëpi. Në ditët e sotme me rritjen e moshës së shtatzënisë dhe prevalences obezitetit numri i grave dhe i bebeve që vuajnë pasojat e hipertensionit tenton vazhdimisht të shtohet. Hipertensioni gjatë shtatzënisë konsiderohet një faktor i rëndësishëm risku për ngjarje të pafavorshme kardiovaskulare në jetën e një gruaje. Sëmundshmëria dhe vdekshmëria nga shkaqe kardiovaskulare te gratë është më rritur tek ato që gjatë shtatzënive të tyre janë ndërlikuar nga hipertensioni shtatzënisë.
Konkluzion. Menaxhimi i hipertensionit gjatë shtatzënisë sigurisht që kërkon hulumutime të mëtejshme për zbulimim e plotë të shkaqeve, vlerësim dhe diagnostikim të kujdesëshëm për të patur sa më pak pasoja nëna dhe fetusi.

Fjalë kyçe: Hipertensioni, shtatzëni, Hipertensioni i shtatzënisë, Preeklampsia.

SHPËRTHIMI I RASTEVE ME PERTUSSIS NË SHQIPËRI: JANAR - QERSHOR 2024.

D. Sh. M. Sonila Borici[1, 2], Dr. Brunilda Hyseni[3], Dr. Ilir Akshija[4], Dr. Iris Mali[2]
[1]*Shërbimi i Pneumologjisë dhe Alergologjisë Pediatrike, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", 1001 Tiranë, Shqipëri*
[2]*Departamenti i Pediatrisë, Universiteti i Mjekësisë, 1001 Tiranë, Shqipëri*
[3]*"Laboratori Luarmedr", Universiteti i Mjekësisë, 1001 Tiranë, Shqipëri*
[4]*Shërbimi i Statistikes, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", 1001 Tiranë, Shqipëri*

Abstrakt
Që nga Janari 2024, në Shqipëri, kemi vërejtur një numër në rritje të vizitave për shkak të Bordetella pertussis që prek të gjitha grupmoshat. Numrat në rritje pasqyrojnë rritjen e qarkullimit të Bordetella pertussis në Shqipëri. Rritje e numrit te rasteve me Bordetella pertussis vërehen në vende të ndryshme evropiane (Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve. Rritja e rasteve të pertussis në BE / EEA. 2024.), dhe shfaqja e saj përfaqëson një problem të shëndetit publik që duhet të adresohet në mënyrë korrekte, siç është futja e dozës përforcuese të vaksinës Bordetella pertussis në parashkollor, adoleshentë dhe shtatzëni, identifikimi i kontakteve dhe fillimi i hershëm i profilaksisë pas ekspozimit janë shumë të rëndësishme për parandalimin e barrës së Bordetella pertussis dhe vdekjeve të saj. Përhapja e shpejtë e infeksionit mund të lidhet edhe me uljen e mbulimit vaksinor në disa zona, si dhe me imunitetin e dobësuar me kalimin e kohës. Kjo nënvizon rëndësinë e strategjive të rishikuara të vaksinimit dhe edukimit shëndetësor për popullatën. Gjithashtu, mbikëqyrja epidemiologjike aktive dhe përmirësimi i kapaciteteve diagnostike janë thelbësore për të ndjekur në kohë reale evolucionin e situatës. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe informimi i vazhdueshëm i profesionistëve të kujdesit shëndetësor ndihmon në menaxhimin efikas të rasteve dhe parandalimin e shpërthimeve të mëtejshme.

Fjalë kyçe: Bordetella pertussis, fëmijë, vaksinim.

KARAKTERISTIKAT E PACIENTËVE ME KRIZË ASTME TË SHTRUAR NË SHËRBIMIN E PNEUMOLOGJISË PEDIATRIKE.

D. Sh. M. Sonila Borici, Dr. Laura Qamili, Dr. Ema Allajbej
[1]*Service of Pediatric Pulmonology and Allergy, University Hospital Center "Mother Tereza", Tirana, Albania*
[2]*Hospital of Gjirokastra, Albania*
[3]*Pediatric Department, University Hospital Center "Mother Tereza", Tirana, Albania*

Abstrakt
Hyrje: Astma pediatrike përfaqëson një nga shkaqet kryesore të shtrimeve spitalore tek fëmijët dhe karakterizohet nga një profil heterogjen inflamator. Identifikimi i biomarkerëve hematologjikë dhe laboratorikë si neutrofilet, eozinofilet dhe PCR, si dhe vlerësimi i praktikave terapeutike, janë thelbësorë për kuptimin e fenotipeve dhe menaxhimin optimal të krizave.
Qëllimi: Të analizojë karakteristikat klinike, laboratorike dhe terapeutike të fëmijëve të hospitalizuar me krizë astmatike.
Metodologjia: Studimi është retrospektiv dhe përfshiu 84 pacientë pediatrikë (1–14 vjeç) të shtruar në pavionin e Pneumologjisë Pediatrike, QSUNT, gjatë periudhës Shtator 2024 – Prill 2025. Të dhënat u morën nga kartelat mjekësore dhe u analizuan me Microsoft Excel dhe SPSS. Variablat e studiuar përfshinë treguesit demografikë, klinikë (simptomat, saturimi O_2), laboratorikë (Hb, leukocite, neutrofile, eozinofile, PCR) dhe terapeutikë. Analizat përfshinë statistika përshkruese (mesatare ± SD, minimum, maksimum) dhe shpërndarje përqindore.
Rezultate: Mosha mesatare e pacientëve ishte 5. 7 ± 3. 2 vjeç, me dominancë mashkullore (54. 8%). Shumica vinin nga zona urbane (94%), me incidencë më të lartë gjatë muajit Shtator (20. 2%) dhe Mars - Prill. Saturimi mesatar i oksigjenit ishte 93. 3%, duke sugjeruar kriza të moderuara. Vlera mesatare e neutrofileve absolute ishte 10. 33 ± 4. 76 x10^9 / L, me 67% të pacientëve mbi kufijtë normalë, veçanërisht në grupmoshën 6–10 vjeç (88. 5%). Eozinofilia ≥0. 5 x10^9 / L u identifikua në 10. 7%, duke sugjeruar fenotipin alergjik. PCR mesatar ishte 1. 49 ± 2. 04 mg / dL (max 13. 8 mg / dL), me 63. 1% të pacientëve mbi pragun 0. 5 mg / dL. Antibiotikoterapia u aplikua në 100% të rasteve, kryesisht Cefazolin (45. 2%), Cefuroxim (38. 1%) dhe Ceftriaxon (16. 7%). Të gjithë pacientët morën kortikosteroide dhe bronkodilatatorë, ndërsa $MgSO_4$ u përdor në 25%.
Përfundime: Studimi tregon një prevalencë të lartë të neutrofilisë dhe rritje të PCR - së te fëmijët me krizë astmatike, duke sugjeruar rol të komponentit infektiv dhe fenotipit neutrofilik. Përdorimi universal i antibiotikëve ngre shqetësime mbi mbipërdorimin, megjithëse mund të justifikohet nga konteksti klinik.

Fjalë kyçe: Astma pediatrike, shërbimi i pneumologjisë pediatrike.

SHËNDETI MENDOR NË MOSHËN E TRETË: NJË RISHIKIM I LITERATURËS NDËRKOMBËTARE MBI SFIDAT, NDËRHYRJET DHE PRECEPTIMET NDAJ TRAJTIMIT.

Msc. Sonja Brahaj
Departamenti Psikologjisë, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Albanian University, Tiranë

Abstrakt
Plakja e popullsisë po transformon shoqëritë moderne dhe po rrit nevojën për politika dhe ndërhyrje të reja shëndetësore. Shëndeti mendor i të moshuarve është një dimension thelbësor i mirëqenies dhe cilësisë së jetës, por shpesh mbetet i nënvlerësuar dhe i padiagnostikuar. Depresioni, ankthi, vetmia dhe izolimi social përbëjnë çrregullimet dhe sfidat më të zakonshme në këtë grupmoshë, duke ndikuar negativisht jo vetëm në gjendjen emocionale, por edhe në shëndetin fizik dhe funksionimin e përditshëm. Rishikim i literaturës ndërkombëtare synon të analizojë në mënyrë të integruar prevalencën e problemeve të shëndetit mendor në pleqëri, faktorët pengues të kërkimit të ndihmës dhe perceptimet e të moshuarve mbi trajtimet farmakologjike dhe psikoterapeutike. Analiza tregon se stigma ndaj çrregullimeve mendore dhe frika nga efektet anësore të barnave psikotrope janë pengesa kryesore për aderencën ndaj trajtimit. Për më tepër, mungesa e informacionit dhe njohurive mbi shëndetin mendor te të moshuarit dhe kujdestarët e tyre e përkeqëson problemin, duke çuar në

vonesa në diagnostikim dhe trajtim. Nga ana tjetër, ndërhyrjet edukative dhe psikoedukative të dizajnuara për të moshuarit, familjarët dhe profesionistët e kujdesit parësor kanë treguar rezultate premtuese në reduktimin e stigmatizimit, rritjen e pranueshmërisë së trajtimit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës. Ky rishikim thekson rëndësinë e zhvillimit të politikave kombëtare dhe programeve komunitare të bazuara në evidencë, veçanërisht në vendet me burime të kufizuara si Shqipëria, ku shërbimet psikosociale janë ende të fragmentuara. Integrimi i kujdesit psikosocial në shëndetin parësor, trajnimi i profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe përdorimi i teknologjisë për edukim mund të ofrojnë një qasje të qëndrueshme dhe me kosto të ulët për të përmirësuar shëndetin mendor në moshën e tretë.

Fjalë kyce: Shëndeti mendor, mosha e tretë, depresioni geriartik, ankthi, stigma, aderenca e trajtimit, kujdesi parësor.

PNEUMOTORAKSI SPONTAN NË TERAPI INTENSIVE NEONATALE: RASTE KLINIKE.

Sosiana Baja
Mjeke Pediatër Neonatolog, SUOGJ "Koço Gliozheni"

Abstrakt
Hyrje: Pneumotoraksi spontan përfaqëson një emergjencë respiratore në periudhën neonatale dhe mund të ndodhë si për arsye idiopatike, ashtu edhe si ndërlikim i sëmundjeve pulmonare apo i terapisë respiratore. Shfaqja e tij mund të përkeqësojë ndjeshëm gjendjen klinike të foshnjes, si dhe të rrisë nevojën për ndërhyrje të menjëhershme.
Qëllimi: Të paraqiten dhe analizohen disa raste të pneumotoraksit spontan të diagnostikuar në repartin e terapisë intensive neonatale të maternitetit "Koço Gliozheni", duke vlerësuar faktorët predispozues, manifestimet klinike, menaxhimin terapeutik dhe ecurinë pas trajtimit.
Materiale dhe metoda: Janë përfshirë disa raste klinike të neonatëve me pneumotoraks spontan, të identifikuar gjatë trajtimit për detres respirator. Të dhënat janë mbledhur retrospektivisht, duke analizuar parametrat klinikë, përdorimin e ventilimit (invaziv ose jo invaziv), gjetjet radiologjike dhe rezultatin klinik.
Rezultate: Pneumotoraksi u konfirmua me radiografi torakale dhe në disa raste kërkoi drenazh pleural urgjent. Shumica e neonatëve treguan përmirësim të shpejtë pas ndërhyrjes dhe rregullimit të parametrave të ventilimit. U identifikuan si faktorë rreziku prematuriteti, faktorë që lidhen me funksionin pulmonar, si dhe faktorë që lidhen me ventilimin.
Përfundime: Pneumotoraksi spontan mbetet një ndërlikim i rëndësishëm në kujdesin neonatal intensiv. Njohja e hershme e simptomave, diagnostikimi i shpejtë me imazheri dhe ndërhyrja e menjëhershme janë thelbësore për uljen e mortalitetit dhe komplikacioneve. Përcaktimi i parametrave të sigurt të ventilimit dhe monitorimi i vazhdueshëm klinik ndihmojnë në parandalimin e këtij komplikacioni.

Fjalë kyçe: Pneumotoraks spontan, detres respirator, terapi intensive, ventilim jo invaziv.

REANIMACIONI NEONATAL JASHTË SALLËS SË LINDJES: PARIME, SFIDAT DHE STRATEGJITË PRAKTIKE.

Spiro Dama PhD[1], Vilma Mema Assoc. Prof[2], Alketa Tandili Assoc. Prof[2], Ilir Arapi Assoc. Prof[2], Eglantina Bulica Phd - C. [3], Amarilda Hysenshahaj Msc[4]
[1]Neonatolog, SUOGJ"Mbreteresha Geraldinë", Tiranë, Shqipëri
[2]QSUT "Nene Tereza", Tirane, Shqipëri
[3]Okulist, Poliklinika e Specialiteteve, Nr. 1, Tiranë, Shqipëri
[4]Staticien, ISHP, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Hyrja: Reanimimi neonatal zakonisht kryhet në sallën e lindjes, megjithatë foshnjat mund të kenë nevojë për ndërhyrje reanimuese edhe në mjedise të tjera spitalore si njësitë e kujdesit intensiv neonatal, repartet e lindjes, urgjencat apo gjatë transportit. Edhe pse mjedisi ndryshon, parimet fiziologjike dhe hapat bazë të Programit të Reanimacionit Neonatal (NRP) mbeten të njëjta gjatë gjithë periudhës neonatale.

Qëllimi: Të përmblidhen parimet thelbësore, sfidat dhe strategjitë për reanimacionin e foshnjave jashtë sallës së lindjes, me fokus në ventilimin, menaxhimin e temperaturës dhe përgatitjen e ekipit mjekësor.
Materiale dhe metoda: U shqyrtua nje informacion përmbledhës i literaturës dhe udhëzimeve bashkëkohore mbi reanimimin neonatal, duke theksuar përshtatjen e protokolleve standarde për mjedise jashtë sallës së lindjes dhe menaxhimin e sfidave klinike dhe logjistike përkatëse.
Rezultate: Ventilimi i mushkërive mbetet hapi fillestar dhe më i rëndësishëm në reanimimin neonatal. Ventilimi me presion pozitiv (PPV) indikohet kur foshnja është apneike, merr frymë me vështirësi ose ka frekuencë kardiake <100 rrahje / min pas stimulimit fillestar. Nëse PPV nuk është efektiv, duhet zbatuar menjëherë hapat korrektues sipas sekuencës **MRSOPA (**rregullimi i maskës, ripozicionimi i rrugëve të frymëmarrjes, aspirimi i gojës dhe hundës, hapja e gojës, rritja e presionit, alternativa e rrugëve të frymëmarrjes). Menaxhimi i temperaturës është thelbësor, pasi hipotermia përkeqëson ndjeshëm prognozën; masat përfshijnë përdorimin e sipërfaqeve të ngrohura, batanijeve termike dhe gazrave të lagështuar. Nëse frekuenca kardiake mbetet <60 rrahje / min pavarësisht ventilimit efektiv, rekomandohet nisja e kompresioneve torakale në raport 3: 1 me ventilimet.
Përfundime: Reanimimi neonatal jashtë sallës së lindjes paraqet sfida të veçanta që lidhen me ambientin, pajisjet dhe përgatitjen e ekipit. Megjithatë, respektimi i parimeve bazë të NRP, ventilimi efektiv, kontrolli termik dhe ndërhyrja në kohë me kompresione torakalevmbetet thelbësor për përmirësimin e mbijetesës neonatale. Trajnimi i vazhdueshëm, simulimet dhe protokollet e gatishmërisë janë thelbësore për sigurimin e një reanimacioni cilësor në çdo mjedis kujdesi neonatal.

Fjalë kyçe: Reanimimi neonatal, ventilimi me presion pozitiv, MRSOPA, kompresione torakale, menaxhimi i temperaturës, reanimacion jashtë sallës së lindjes.

MONITORIMI ME NIRS (NEAR - INFRARED SPECTROSCOPY) NË ENDARTEKTOMINË KAROTIDE, NJË STANDART QË MUND TË JETË I ARTË.

Llazo, Stavri[1], Zllami Brunilda[2], Basha Entela[3], Kuçi Sajmir [4], Ibrahimi Alfred[5], Bejko Ervin[6], Koçi Julinda[7], Xhepa Sokol[8]
[1, 4, 5, 6]*Departamenti i Anestezisë pranë kirurgjisë Kardiake dhe Vaskulare, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë*
[2]*Departmenti i Neurologjisë, Spitali Amerikan 1, Tiranë*
[3]*Departmenti Neurologjisë, Uniteti i Stroke, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"*
[7, 8]*Departmento i Kirurgjisë vaskulare, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë*

Abstrakt
Aplikimi i NIRS (near - infrared spectroscopy) sjell një informacion të hollësishëm përsa i përket balancës së nevojës dhe furnizimit me oksigjen të trurit dhe kështu ka potencialin të kthehet në një standart të artë në monitorimin e endarterektomisë karotide (CEA). NIRS është relativisht jo i kushtueshëm, i lehtë për t'u përdorur dhe lejon që të ketë monitorim të vazhdueshëm dhe në kohë reale të oksigjenimit cerebral. Endarterektomia karotide (CEA), në vetvete është standarti i artë për të trajtuar stenozat karotide simptomatike dhe jo simptomatike, me një risk potencial të stroke perioperativ gjatë kirurgjisë që varion nga 1. 2% - 3%. Për shkak të shkallës së gjërë nga pacienti në pacient të vlerave bazë të rSO(2), tek çdo pacient, duhet përcaktuar një bazë përpara induktimit të anestezisë së përgjithshme. Është vënë re se ishemia cerebrale është më e varur nga ndryshimet në këtë bazë, sesa në vlerën absolute: Një reduktim me 20% nga vlera bazë zakonisht pranohet si vlerë indikuese e ishemisë cerebrale. Vlera kryesore që synohet të arrihet me këtë studim dhe përqasjes së të literaturës është e lidhur me saktësinë intraoperative të NIRS, krahasuar dhe me mjetet e tjera diagnostike e monitoruese të përdorura për të vlerësuar komplikacionet neurologjike, më së shumti isheminë cerebrale hemodinamike te pacientët që i nënshtrohen endarterektomisë në anestezinë gjenerale.
Objektiva: Ky studim është disenjuar për të përcaktuar vlerën e (near - infrared spectroscopy) në monitorimin e endarterektomisë karotide (CEA).
Materiale dhe metoda: Është një studim prospektiv, i realizuar në QSUT, Shërbimi i Kirurgjisë kardiake dhe Vaskulare, në periudhën Dhjetor 2022 - Shtator 2025. Në pacientët e marrë në studim, 436 janë monitoruar me teknikat rutinë, ndërsa 230 janë monitoruar dhe me NIRS.
Rezultate: Në 697 pacientë që iu nënshtruar endartektomisë karotide (CEA), 230 prej tyre janë monitoruar me NIRS. Në këtë studim 539 të pacientëve ishin meshkuj, 158 femra, në moshën mes 60 - 80 vjeç. Nga këta

pacientë 277 kishin Diabet Mellitus dhe 687 Hipertension arterial. 27 pacientë patën indikacion për vendosjen e shuntit.
Kirurgjitë janë kryer mes ditës së dytë dhe 14 pas AVC në rastet simptomatike (128 pacientë) dhe nga dita 14 - 30 pas AVC - së (59 pacientë). Shfaqën komplikacione neurologjike, encefalopati 57 pacientë (brenda 4 orëve të para pas kirurgjisë), defiçit të ri neurologjik (8 pacientë) dhe kishte 4 vdekje në dekursin post operator (një nga komplikacione neurologjike).
Gjatë monitorimit me NIRS janë ruajtur vlera më të ulëta të tensioneve arteriale, ka pasur më pak komplikacione neurologjike (AVC), më pak shenja të encefalopatisë dhe kohëqëndrim më të pakët në shërbimin intensiv dhe në spital.
Konkluzione: Studimi ynë ka demostruar që NIRS mund të shërbejë si një mjet monitorues i efektshëm gjatë endarterektomisë cerebrale. Përdorimi i rSO (2) në monitorimin e pacientëve që i nënshtrohen endarterektomisë, mund të shërbejë si një mënyrë për planifikimin e anestezisë, mbajtjen e vlerave të përshtatshme të tensionit arterial, reduktim të komplikacioneve neurologjike, prognozë më të favorshme në përgjithësi dhe ulje të kohëqëndrimit në spital.

Fjalë kyçe: Endarterektomia karotide (CEA), komplikacionet neurologjike të endarterektomisë karotide, NIRS (near - infrared spectroscopy).

URTIKARIET AUTOIMUNE SI SHENJË E HERSHME NË SËMUNDJET REUMATOLOGJIKE.

Stela Janko, Artur Zoto, Ervin Rapushi, Teuta Backa, Anastasio Kolaci, Xhoi Doko, Florid Zenelaj, Silda Çaushi
Shërbimi Reumatologjisë, QSUNT.

Abstrakt
Hyrje: Urtikaria kronike shpesh konsiderohet thjesht si një manifestim alergjik, por një pjesë e saj ka bazë autoimune dhe mund të shfaqet si shenjë e hershme e sëmundjeve reumatologjike. Urtikaria autoimune përfshin forma spontane, rezistente ndaj antihistaminikëve, dhe urtikaria vaskulitike, e cila karakterizohet nga lezione që zgjasin më shumë se 24 orë dhe shpesh shoqërohen me manifestime sistemike. Këto forma mund të lidhen me sëmundje si lupus eritematoz sistemik (LES), artrit reumatoid, sindromën Sjögren dhe vaskulitet e enëve të vogla, duke e bërë vlerësimin imunologjik dhe matjen e komplementit të domosdoshëm për identifikimin e sfondit autoimun. Analizat laboratorike përfshijnë ANA, anti - dsDNA, anti - Ro / SSA, anti - La / SSB, faktor reumatoid, anti - CCP, C3, C4, C1q dhe anti - C1q, sipas kontekstit klinik. Në këtë punim prezantohet një rast klinik i një pacienteje me urtikarie kronike rezistente ndaj antihistaminikëve, pa histori alergjie, me ANA të rritur, anti - dsDNA lehtësisht pozitiv dhe nivele të ulëta të C4 dhe C1q, që çuan drejt diagnozës së hershme të LES. Ky rast ilustron se urtikaria autoimune mund të jetë manifestimi i parë i një sëmundjeje reumatologjike dhe nënvizon rëndësinë e bashkëpunimit multidisiplinar midis dermatologëve, alergologëve dhe reumatologëve për diagnostikimin e hershëm dhe menaxhimin adekuat të pacientëve. Njohja dhe vlerësimi i kujdesshëm i urtikarive kronike të rezistente ndaj trajtimit standard është thelbësor për identifikimin e hershëm të sëmundjeve autoimune sistemike, përmirësimin e prognozës dhe shmangien e komplikacioneve.

Fjalë kyçe: urtikaria autoimune, urtikaria vaskulitike, lupus eritematoz sistemik (LES), sëmundjet reumatologjike, nivelet e komplementit (C3, C4, C1q), autoantitrupat (ANA, anti - dsDNA, anti - Ro / SSA, anti - La / SSB), manifestim i hershëm, diagnostikim multidisiplinar.

TERAPIA BIOLOGJIKE NË KOLITIN ULÇEROZ ME TOKSICITET NGA AZATIOPRINA DHE INFEKSION ME C. DIFFICILE.

Taçi S. , Kola F. , Beqja E.
Q*endra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Departamenti i Gastro - Hepatologjisë*

Abstrakt
Hyrje: Koliti ulçeroz përfaqëson një formë të sëmundjes inflamatore kronike të zorrës, trajtimi i së cilës në format e moderuara dhe të rënda konsiston në përdorimin e medikamenteve imunosupresivë. Përdorimi i tyre shoqërohet me risk të konsiderueshëm për efekte anësore të rënda duke përfshirë mielotoksicitetin. Në vijim

paraqitet një rast klinik i komplikuar nga infeksioni me *Clostridium difficile* dhe pancitopenia e shkaktuar nga azatioprina, që kërkoi rishikim të menjëhershëm të strategjisë terapeutike.
Prezantimi i rastit: Një pacient mashkull 56 vjeç, me histori njëvjeçare të kolitit ulçeroz nën trajtim me kortikosteroide (prednizon 50 mg / ditë) dhe mesalazinë 4 g / ditë, u shtrua në spital për përkeqësim te gjendjes klinike. Kolonoskopia tregoi pancolitis, analizat laboratorike konfirmuan infeksion me *Clostridium difficile* (pozitiv për toksinat A dhe B), ndaj u nis trajtimi me vankomicinë orale 125 mg katër herë në ditë për 10 ditë, dhe azatioprina (100 mg / ditë) si terapi alternative në kolit ulceroz kortikosteroid dependent. Dy javë më pas, pacienti zhvilloi pancitopeni febrile: WBC: 0. 5×10^3 / μL, RBC: 2. 20×10^6 / μL, Hemoglobina: 7. 6 g / dL, Trombocitet: 58×10^3 / μL. Azatioprina u ndërpre menjëherë. Mielograma dhe imunofenotipizimi përjashtuan malinjitetet hematologjike. U aplikua terapia suportuese hematologjike me filgrastim dhe transfuzione gjaku. Pas rikuperimit hematologjik, u nis adalimumabi, një agjent biologjik, inhibitor i TNF - α, që solli përmirësim të dukshëm klinik dhe laboratorik, me zbutje të simptomave bazë të sëmundjes dhe normalizim të parametrave hematologjikë.
Përfundim: Ky rast thekson rëndësinë e individualizimit të strategjive terapeutike në rastet komplekse të kolitit ulçeroz me infeksione të mbivendosura dhe toksicitet nga medikamentet. Zhvillimi i pancitopenisë febrile të rëndë menjëherë pas fillimit të azatioprinës nënvizon nevojën për monitorim të kujdesshëm hematologjik. Pas rikuperimit hematologjik, fillimi i adalimumabit solli përmirësim të theksuar klinik, duke treguar potencialin e tij si një alternativë e sigurt dhe efektive te pacientët që nuk tolerojnë terapitë imunosupresore konvencionalë.

Fjalë kyçe: kolitit, ulçeroz, adalimumabi, azatioprina, agjent biologjik.

TRENDI POST PANDEMIK I INFEKSIONEVE TE TRAKTIT RESPIRATOR.
Suada Sulaj, Esta Kokla, Migena Cenaj, Migena Qato, Najada Como
Shërbimi i Sëmundjeve Infektive, QSU "Nënë Tereza"

Abstrakt
Hyrje: Me rihapjen graduale dhe uljen e masave kufizuese, u rritën në mënyrë eksponenciale jo vetëm rastet e konfirmuara të COVID - 19, por edhe incidenca e sëmundjeve të tjera infektive të cilat prekin traktin respirator. Agjentë infektivë si virusi i influenzës, virusi sincicial respirator, rinoviruset, adenoviruset dhe metapneumovirusi human spikaten me se shumti në këtë panoramë epidemiologjike. Përveç kësaj, disa vende raportuan edhe raste në rritje të sëmundjeve bakteriale invazive respiratore ku dominoi kryesisht pneumokoku.
Qëllimi: Nxjerrja në pah e ndikimit të pandemisë në trendet epidemiologjike të Infeksioneve Respiratore.
Metoda: Ne rishikuam të dhënat e literaturës në lidhje me këtë fenomen dhe evidentuam sëmundjet e veçanta virale dhe bakteriale që prekën kryesisht traktin respirator.
Rezultate: Rritja e rasteve të gripit në periudhën pas pandemisë COVID - 19 pasqyron ndryshimet në sëmundjet infektive të traktit respirator, para dhe pas heqjes së politikave të kontrollit të pandemisë COVID - 19. Rastet e infektimit nga viruset influenziale perfaqsojne rreth 60 - 65% te patologjive te traktit respirator, virusi sincicial respirator evidentoi nje prekje 10 - 15 % me predominim ne moshat pediatrike dhe adenovirozat se bashku me rhinovirozat 10%. Nderkohe , infeksioni invaziv nga pneumokoku u evidentua ne shifra te rendesishme si patologji e izoluar por edhe si koninfeksion.
Konkluzion: Peiudha post pandemike diktoi një trend mjaft variable të Infeksioneve të Traktit Respirator, jo vetëm në shifra por edhe në kuader te entiteteve klinike. Rastet e shtuara me nozologjite e siperpermendura ishin pasoje e uljes se vigjilences se popullates ne drejtim te kontagiozitetit por edhe pasojave reale te infeksionit nga SARS COV2, pasi inflamacioni kronik i lidhur me te prekte ne menyre te rendesishme mbrojtjen imunitare.
Fjalë kyçe: trend, post pandemik, infeksion etj.

STRATEGJITË E KUJDESIT GJITHËPËRFSHIRËS NË PACIENTËT E MOSHUAR NËN TRAJTIM ME HEMODIALIZË.
Dr. ShK. M. Suela Mumajesi, Dr. ShK. M. Saimir Seferi, Spec. Elena Gjecka, Kryeinf. Elida Luri, Ass. Prof. Ariana Strakosha.
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri, Shërbimi Nefrologji - Dializë - Transplant

Abstrakt
Hyrje: Popullsia globale po rritet me ritme të shpejta dhe ky ndryshim demografik po shoqërohet me rritje të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë. Në fushën e nefrologjisë, ky trend rritës po reflektohet me shtimin gjithnjë e më shumë të pacientëve të moshuar që kanë nevojë për terapi zëvendësuese renale – hemodializë. Menaxhimi i dializës tek të moshuarit paraqet sfida të veçanta të cilat ndryshojnë ndjeshëm nga udhërrëfyesit tradicionale nefrologjik.
Në praktikën e përditshme klinike, udhërrëfyesit zakonisht ofrojnë protokolle të përshtatura kryesisht për pacientë të rinj në moshë me ose pa sëmundje bashkë - shoqëruese, duke mos reflektuar në mënyrë specifike nevojat e pacientëve të cilët përjetojnë sindroma si: dobësi të përgjithshme trupor, humbje muskulature (sarkopeni), dëmtime të funksionit konjitiv (njohës) dhe depresion. Të gjitha këto, së bashku me sëmundjen kronike të veshkave, e bëjnë menaxhimin e kësaj grup popullate më të ndërlikuar, prandaj, lindi nevoja për strategji më të personalizuara ndaj trajtimit të tyre. Pacientët e moshuar, zakonisht kanë metabolizëm më të ulët, oreks dhe etje për ujë më të reduktuar, po ashtu dhe masa e tyre muskulore është më e ulët. Kjo plakje biologjike ndikon në uljen e prodhimit të toksinave uremike dhe mbingarkesës me lëngje, duke sugjeruar se regjimi dialitik konvecional (tre herë në javë) mund të jetë më shumë i lodhshëm sesa realisht i nevojshëm në këta pacient. Ndërkohë, dializa e përshkallëzuar, si formë fillestare e terapisë renale zëvendësuese, është propozuar si një alternativë pragmatike që mund të ndihmojë si në ruajtjen e funksionit të mbetur të veshkave, reduktimin e lodhjes pas seancave të dializës dhe në përmirësimin e funksionit konjitiv. Po ashtu, dieta ushqimore është shumë e rëndësishme, pasi kufizimet e rrepta dietike shpesh - herë cojnë në kequshqyerje dhe sarkopeni tek këta pacientë. Vendimmarrja për aksesin vaskular shton më tej kompleksitetin tek këta pacient, ndërkohë që fistulat arteriovenoze konsiderohen standardi i artë në hemodializë, patologjitë e avancuara vaskulare, jetëgjatësia e kufizuar dhe komplikacionet kardiake shpesh e bëjnë përdorimin e kateterëve si zgjedhja më e arsyeshme për pacientët e moshuar. Si përfundim, dializa për të moshuarit nuk duhet të udhëhiqet vetëm nga udhërrëfyesit e pandryshueshëm, por duhet të integrohen dhe parimet e geriatrisë. Të realizohet një vendimmarrje e përbashkët midis mjekut dhe pacientit, dhe, kur është e përshtatshme, trajtimi paliativ mund të ofrojë një strategji më etike dhe efektive për menaxhimin e kësaj grup popullate.

Fjalë kyçe: hemodializë, terapi, pacient etj.

ÇRREGULLIMET KONJITIVE DHE ATO NEURO PSIKIATRIKE NË PATHOLOGJITË NEURODEGJENERATIVE DHE KONTRIBUTI I "DTLA –ALB".

Suzana Gjeci[1], Eni Reka[2], Sandrinne Basaglia[3], Majlinda Shyti[2]
[1]*Universiteti i Mjekësisë, Fakulteti i Mjekësisë Tiranë, Shqipëri*
[2]*Departmenti Neurologjisë, Spitali rajonal Elbasan, Shqipëri*
[3]*Service de Psychologie Cognitive et Neuropsychologie, Université de Mons*

Abstrakt
Hyrje: Rritja demografike e popullatës pas moshës 60 vjeç shoqërohet me një shtim të rëndësishëm të prevalencës së pathologjive degjenerative, të cilat karakterizohen nga alterime neurokonjitive ku asociohen kryesisht perturbacione të sjelljes, simptoma apo shenja psikiatrike & neuro psikiatrike, të cilat përbëjnë manifestime primare të një dysfunksionimi cerebral. Diagnostikimi i hershëm i demencave mbështetet në tipe të ndryshme vlerësimi ku rol të rëndësishëm luan edhe depistimi i çrregullimeve të të folurit nisur nga fakti se keto paraqiten në formë heterogjene. Parametri i të folurit rezulton të jetë më resistent ne këtë deklinacion që shoqeron avancimin në moshë.
Qëllimi: Studimi synon implantimin e DTLA aktualisht funksionues në botë, në shqip, ku qëllimi mbetet në funksionim nëshërbimet e Neurologjisë e psikiatrisë për depistimin e hershëm të demencave e më tej.
Materiale dhe metoda: Tre studime distinkte do të realizohen: 1. Adaptimi DTLA në shqip. 2. Kollektim i të dhënave në 120 pacientë për ndërtimin e të dhënave normative te DTLA - Alb në funksion të moshës e të nivelit edukativ. 3. Vlerësimi i veçorive psikometrikete DTLA - Alb duke krahasuar 15 persona të shëndetsshëm, ndaj 15 pacientëve AD e duke examinuar fidelitetin "inter – juge".
Rezultate dhe diskutime: Në prezencë të patologjive komplekse si APP klinicistët administrojnë mjete klinike deteksioni MMSE, MoCA: vlerësimi centrohet ne çrregullimet e kujtesës karakteristike në AD, por domene te tjera konjitive perfshirëse nuk njihen ose konsiderohen sa duhet. Nevoja e një testi depistues të çrregullimeve të të folurit do të përmbushë këtë mungesë. Në proçes.

Konkluzione: Rezultatet e studimit do të kenë implikacione të rendësishme në depistimin e hershëm te çrregullimeve neurokonjitive mazhore.
Rekomandime: Validimi i testit DTLA në gjuhën shqipe do t'u vijë në ndihmë klinicistëve neurologë, psikiatër, neuropsikologë e më gjerë në rutinën e përditshme për t'u ardhur në ndihmë pacientëve.

Fjalë kyçe: DTLA, çrregullimet konjitive, pathologjitë neurodegjenerative.

SHËNDETI I GRUAS SI E DREJTË ABSOLUTE E SAJ DHE DETYRIM PËR T'U GARANTUAR NGA QEVERIA.

Dr. Tatjana Milo, Dr, Atea Milo, Dr. Nadire Zeneli, Dr. Violeta Imeraj, Dr. Kongres Imeraj

Abstrakt
Shëndeti i gruas është një e drejtë absolute dhe themelore. Është njëkohësisht detyrim institucional i shtetit për të garantuar një shërbim shëndetësor të kualifikuar obstetrik - gjinekologjik, të shtrirë gjerësisht në të gjithë vendin, duke ofruar asistencë mjekësore moderne dhe të bazuar në evidenca. Vlerësimi i shëndetit fizik, mendor dhe riprodhues përfaqëson një standard dhe protokoll mjekësor të përcaktuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), i cili synon të unifikohet në të gjitha vendet. Ky prezantim do të ofrojë një përmbledhje të praktikave aktuale në Shqipëri dhe do të sjellë një seri rekomandimesh për përmirësimin e sistemit obstetrik - gjinekologjik në të ardhmen.
Metodologjia: Ky studim është realizuar nëpërmjet një analize deskriptive dhe krahasimore të të dhënave kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me shëndetin e gruas. Janë analizuar: Politikat dhe protokollet aktuale të ndjekura në vendin tonë, Udhëzimet e OBSH - së dhe standardet ndërkombëtare, Raporte të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit të Shëndetit Publik, Publikime shkencore dhe studime të kryera në fushën e shëndetit të gruas nga databaza si PubMed, Google Scholar dhe WHO Library. Gjithashtu, janë shqyrtuar intervista me profesionistë shëndetësorë dhe raportime nga shërbimet obstetrike në nivel primar dhe terciar në Shqipëri.
Rezultate: U vu re se ekziston mungesë e njëtrajtshmërie në ofrimin e shërbimeve obstetrik - gjinekologjike, sidomos në zonat rurale. Ndërgjegjësimi për shërbimet e shëndetit riprodhues mbetet i ulët në disa grupe të popullatës, sidomos tek gratë në moshë riprodhuese që jetojnë në zona me akses të kufizuar. Programet e skriningut për kancerin e qafës së mitrës dhe të gjirit nuk janë të zbatuara në mënyrë të barabartë në të gjithë vendin. U identifikua një mospërputhje midis praktikave klinike dhe protokolleve ndërkombëtare, për shkak të mungesës së trajnimeve të vazhdueshme për personelin mjekësor. Vlerësohet nevoja për forcimin e komponentit të shëndetit mendor, sidomos në kontekstin e shtatzënisë dhe periudhës pas lindjes.
Fjalë kyçe: shëndet riprodhues, Pap - Test, HPV.

HAIRY CELL LEUKEMIA NË SHQIPËRI NË 10 VJET.

Tatjana Caja, Megi Mihasi, Borana Kapexhiu, Jada Caja
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Hairy Cell Leukemia – HCL është një neoplazi limfoproliferative, e karakterizuar nga prania e limfociteve jo normale B me projeksione zgjatimesh citoplazmatike – prej nga vjen edhe termi "flokë". Përbën rreth 2% të të gjitha llojeve të leuçemive, prek kryesisht të rriturit në moshë të mesme ose të moshuarit, me predominim tek meshkujt me raport meshkuj / femra afërsisht 4: 1.
Qëllimi: Qëllimi kryesor i këtij studimi është të vlerësojë incidencën, modalitetet e trajtimit, mbijetesen dhe rezultatet klinike të HCL në Shqipëri gjatë dekadës së fundit përmes një analize retrospektive të të dhënave të pacientëve. Në mënyrë më të detajuar, studimi synon: 1. Te përcaktojë shkallën e incidencës së HCL në Shqipëri gjatë periudhës së studimit, duke analizuar tendencat në kohë dhe shpërndarjen gjeografike të sëmundjes në nivel kombëtar. 2. Te karakterizojë profilin demografik dhe klinik të pacientëve të diagnostikuar me HCL, duke përfshirë moshën, gjininë, paraqitjen klinike, vendbanimin etj. 3. Të identifikojë protokollet e trajtimit që u janë administruar pacientëve, me fokus të veçantë në përdorimin e analogeve të purinës si kladribina dhe pentostatina, si dhe çdo terapi alternative.

Materiale dhe metoda: U morën në studim 88 pacientë në total të diagnostikuar dhe trajtuar me HCL gjatë viteve 2014 - 2024, të Shërbimit të Hematologjisë QSUT. Prej tyre, vetëm për 66 pacientë kishte të dhëna të mjaftueshme për tu marrë në konsideratë në studim. Është kryer një rishikim i gjerë i literaturës së huaj, studimeve klinike dhe protokolleve të trajtimit të HCL. Të dhënat u përpunuan ne Microsoft Excel dhe aplikacione të ndryshme statistikore si JASP dhe DataTab për të krijuar grafikë dhe tabela të nevojshme për studimin.
Rezultate: Incidenca e HCL - së në Shqipëri u gjet të ishte 0. 299 për 100. 000 banorë, e përafërt me incidencën botërore prej 0. 3. Vlera mesatare e moshës në diagnozë rezultoi të ishte 57. 3 vjeç, më një predominim të theksuar në gjininë mashkullore. Trajtimi u vërejt të varionte në bazë të gjendjes së pacientit dhe pranisë apo mungesës së agjentëve kimioterapeutikë. 34. 85% e rasteve mbeten nën observim gjatë gjithë ecurisë së sëmundjes. Vetëm 10. 3% prej tyre morën Kladribin si terapi. Rreth 33. 3% patën rituximabin si bazë mjekimi ne kombinim me kimioterapi. Mbijetesa në 2 - 3 vitete e para rezultoi e larte me 80 - 90% probabilitet, dhe vijoi duke u ulur në vitet në vazhdim deri në 50% rreth vitit të 9 - të.
Konkluzione: Të dhënat epidemiologjike të HCL - së në Shqipëri rezultojnë të jenë të ngjashme me vendet e tjera, që tregon për faktorë të përbashkët që ndikojnë në fizpatologjinë e sëmundjes në popullata të ndryshmë. Protokollet e përdorura në këtë studim nuk janë standarti i artë i trajtimit, por megjithatë po bëhen përpjekje vitet e fundit për tu zhvendosur drejt PNA si linjë e parë terapeutike, pasi shoqërohet me shkallë më të lartë remisioni dhe ulje të numrit të relapseve. Ky studimi për herë të parë krijoji një panoramë të plotë kombëtare mbi HCL në Shqipëri, duke kontribuar në përmirësimin e praktikës klinike, politikave shëndetësore dhe nxitjen e kërkimeve të mëtejshme në fushën e malinjiteteve hematologjike.

Fjalë kyçe: Hairy Cell Leukemia, incidenca, trajtimi, mbijetesa.

RIKUPERIM I PLOTË I NJË PACIENTI TË INTUBUAR PAS INTOKSIKIMIT AKUT NGA MONOKSIDI I KARBONIT, I TRAJTUAR ME TERAPI HIPERBARIKE ME OKSIGJEN (HBOT).

Dr. Tauland Qyrdedi, MD
Spitali Universitar i Traumës (SUT), Tiranë

Abstrakt
Qëllimi: Të paraqitet një rast klinik me rikuperim të plotë të një pacienti të intubuar pas intoksikimit akut nga monoksidi i karbonit (CO), i trajtuar me sukses me Terapinë Hiperbarike me Oksigjen (HBOT).
Materiale dhe metoda: Një pacientë mashkull u pranua në spital në gjendje të intubuar pas një intoksikimi akut me CO. Trajtimi fillestar me 100% oksigjen normobarik nuk solli përmirësim klinik, ndaj pacienti u referua për terapi HBOT. U krye vlerësimi klinik dhe monitorimi i gjendjes së përgjithshme të pacientit përpara, gjatë dhe pas terapisë.
Rezultate: Në momentin e pranimit, pacienti kishte një GCS prej 3E. Ai gjithashtu paraqiste pneumoni nga aspirimi, pneumoni të dyshuar nga COVID - 19 dhe insuficiencë kardiake me një EF prej 18%. Terapia HBOT filloi 36 orë pas ekspozimit, në një dhomë hiperbarike të modelit spitalor Hypertech Zyron 10+2, me presion 2. 8 ATA (Tabela 6 e HBOT). Pas 4 seancash u vu re përmirësim neurologjik (GCS: 15). Në total u realizuan 18 seanca. Kontrolli pasues nuk tregoi sekelave neurologjike.
Përfundime: Ky rast mbështet efikasitetin e HBOT në rikthimin e funksioneve neurologjike të dëmtuara rëndë nga intoksikimi me CO, edhe në pacientë kompleksë, të intubuar dhe me komplikacione. Referimi në kohë dhe ndërhyrja e hershme me HBOT mund të jenë vendimtare për shpëtimin e jetës.

Fjalë kyçe: Monoksidi i karbonit, terapia hiperbarike me oksigjen, intoksikimi nga monoksidi i karbonit.

MARKERËT BIOKIMIKË TË INFLAMACIONIT NË SINDROMËN KORONARE AKUTE.

Taulant Gishto, Edlira Ruci, Naltin Shuka, Silvia Methoxha
Shërbimi i Kardiologjisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt

Hyrje: Të vlerësohen ndryshimet në parametrat laboratorikë inflamatorë dhe metabolikë midis pacientëve të diagnostikuar me Sindromë Koronare Akute (SKA), me qëllim identifikimin e profileve biologjike që shoqërojnë ngjarjet ishemike akute në kontekstin e faktorëve jokonvencionalë të rrezikut.

Material dhe metoda: U realizua një studim rast - kontroll me përfshirjen e 150 pacientëve me SKA me faktorë jokonvencionalë dhe 150 individëve të grupit kontroll, të ndjekur në Shërbimin e Kardiologjisë të QSUT gjatë vitit 2025. U analizuan parametrat laboratorikë: acidi urik, proteina C - reaktive (PCR), fibrinogjeni, numri total i leukociteve (WBC) dhe neutrofilet.

Rezultate: Pacientët me SKA dhe faktorë jokonvencionalë paraqitën vlera ndjeshëm më të larta të **acidit urik** (8. 14 ± 4. 22 mg / dL) krahasuar me grupin kontroll (4. 97 ± 1. 92 mg / dL; p < 0. 001), sugjerues për stres oksidativ të shtuar. Po ashtu, **fibrinogjeni** (416. 0 ± 107. 0 vs 330. 9 ± 79. 0; p < 0. 001), **WBC** (9. 90 ± 3. 23 vs 7. 97 ± 4. 09; p < 0. 001) dhe **neutrofilet** (11. 96 ± 17. 89 vs 5. 06 ± 5. 01; p < 0. 001) ishin të gjitha të rritura ndjeshëm në grupin e rasteve. Edhe **proteina C - reaktive** rezultoi më e lartë te pacientët me SKA (6. 40 ± 32. 9) krahasuar me kontrollet (1. 58 ± 3. 91; p = 0. 043), duke reflektuar përfshirje të qartë të inflamacionit subklinik.

Përfundime: Gjetjet laboratorike sugjerojnë një profil të theksuar inflamator dhe trombotik tek pacientët me SKA që nuk paraqesin faktorë klasikë, duke mbështetur rolin e faktorëve jokonvencionalë në patogjenezën e sëmundjeve koronare akute. Vlerësimi rutinë i këtyre parametrave mund të kontribuojë në stratifikim më të saktë të rrezikut dhe personalizim të vendimmarrjes klinike.

Fjalë kyçe: sindroma koronare akute, faktorë jokonvencionalë, markerë inflamatorë.

ZËVENDËSIMI HORMONAL ADEKUAT PAS KIRURGJISË HIPOFIZARE: SFIDAT DHE QASJET KLINIKE.

Tea Shehu Kolnikaj[1], Ardita Muja[2]
[1]*Endokrinologe, Spitali Amerikan 3.*
[2]*Endokrinologe, Spitali Universitar i Traumës.*

Abstrakt

Kirurgjia hipofizare mbetet trajtimi kryesor për shumicën e tumoreve të hipofizës, por shpesh shoqërohet me defiçit të një ose më shumë akseve hormonale. Zëvendësimi hormonal adekuat është thelbësor për të garantuar homeostazën metabolike, funksionin riprodhues dhe cilësinë e jetës së pacientëve pas operacionit. Vlerësimi i hershëm postoperativ përfshin monitorimin e kortizolit, hormoneve tiroidiane, gonadotropëve, hormonit të rritjes dhe vazopresinës, me qëllim përcaktimin e mungesave akute dhe kronike. Terapia zëvendësuese duhet të individualizohet, duke marrë parasysh jo vetëm normat biokimike, por edhe nevojat klinike të pacientit, rrezikun kardiometabolik dhe moshën. Administrimi korrekt i glukokortikoideve, levotiroksinës, hormonit të rritjes, gonadotropinave apo preparateve të estrogjenit / testosteronit siguron stabilitet hemodinamik, ul rrezikun e komplikimeve dhe përmirëson prognozën afatgjatë. Për më tepër, ndjekja e rregullt endokrinologjike është e domosdoshme për të rregulluar dozat dhe për të identifikuar shenjat e rikthimit të funksionit hormonal ose të recidivës së tumorit.

Fjalë kyçe: kirurgjia hipofizare, zëvendësimi hormonal, panhipopituitarizëm, pas - operacionit, prognozë.

SFIDAT DHE MUNDËSITË E REJA NË TRAJTIMIN E KARCINOMËS HEPATOCELULARE (HCC).

Teona Bushati[2, 3, 4], Leart Berdica[1, 2, 3], Albina Ndoja[3, 4], Erjon Sukaj[3, 4]
[1]*Shef i Departamentit të Patologjisë, Rrjeti Spitalor Amerikan,*
[2]*Lektor i Patologjisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti Mjekësor i Tiranës.*
[3]*Lektor i Histologjisë & Patologjisë, Universiteti Western Balkans.*
[4]*Patolog, Departamenti i Patologjisë, Spitali Amerikan.*

Abstrakt
Karcinoma hepatocelulare (HCC) mbetet një nga shkaqet kryesore të vdekjeve të lidhura me kancerin në mbarë botën, kryesisht për shkak të diagnostikimit të vonshëm, pranisë së sëmundjeve kronike hepatike dhe mungesës së opsioneve efektive kurative. Pavarësisht përparimeve në survejancë dhe imazheri, diagnostikimi i hershëm mbetet i kufizuar, veçanërisht tek pacientët pa cirozë. Nga pikëpamja histopatologjike, diagnoza shpesh vështirësohet nga ngjashmëria morfologjike me kolangiokarcinomën intrahepatike dhe metastazat adenokarcinomatoze, çka kërkon përdorimin e paneleve të rafinuara imunohistokimike dhe profilizim molekular. Markerët si Arginase - 1, Glypican - 3 dhe HepPar - 1 mbeten thelbësorë për konfirmimin e origjinës hepatocitare, ndërsa teknikat e sekuencimit të gjeneratës së re (NGS) mundësojnë identifikimin e targeteve molekulare të trajtueshme si mutacionet e TERT, TP53, CTNNB1 dhe amplifikimet e FGF19. E ardhmja e menaxhimit të HCC qëndron në integrimin e diagnostikës molekulare, profilizimit imunogjenomik dhe biopsive të lëngshme për zbulim më të hershëm, terapi të personalizuar dhe monitorim dinamik të përgjigjes terapeutike.

Fjalë kyçe: karcinoma hepatocelulare, imunoterapi, profilizim molekular, terapi të targetuara, sfida diagnostike.

VASCULITI ME IGA (HENOCH–SCHÖNLEIN PURPURA): NJË UPDATE PËR TRAJTIMIN.

Teuta Backa, Ervin Rapushi
Shërbimi i Reumatologjisë, QSUNT.

Abstrakt:
Hyrje: Vaskuliti IgA (IgAV), i quajtur edhe si purpura Henoch - Schönlein, është vaskuliti sistemik më i shpeshtë tek fëmijët. Tek të rriturit, IgAV është më pak i zakonshëm edhe pse shoqërohet me sëmundje më të rëndë. Në fakt, frekuenca e glomerulonefritit (i referuar si nefriti IgAV) tek të rriturit është më e lartë se tek fëmijët dhe tenton të paraqitet më rëndë, me rreth 10 - 30% të të prekurve që përfundimisht përparojnë në SRK end - stage. Në këtë përmbledhje, ne përshkruajmë fiziopatologjinë, tiparet kryesore klinike, diagnozën e sëmundjes dhe të dhënat më të fundit klinike në lidhje me terapinë IgAV.
Metodologjia: U rishikua literatura, kryesisht e bazuar në artikuj të botuar në PubMed. Përveç diskutimit të aspekteve kryesore të glukokortikoideve dhe barnave konvencionale që modifikojnë sëmundjen të përdorura në menaxhimin e IgAV, qëllimi ishte të përqendrohet në informacionin më të fundit të raportuar në lidhje me biologjikët dhe terapitë e mundshme në të ardhmen.
Rezultate: Glukokortikoidet janë terapia e linjës së parë për IgAV, veçanërisht tek të rriturit me manifestime të rënda. Kolkicina, dapsoni dhe metotreksati mund të jenë të dobishëm për kontrollin e manifestimeve të vogla. Disa agjentë imunomodulues, siç janë ciklosporina A, takrolimusi dhe mikofenolat mofetil, kanë treguar rezultate të favorshme si agjentë që kursejnë glukokortikoidet. Leflunomidi ka treguar rezultate premtuese, por kërkon studime të mëtejshme. Përdorimi i rituksimabit ka treguar efikasitet në uljen e frekuencës së rikthimit, uljen e ngarkesës kumulative të glukokortikoideve dhe arritjen e remisionit të sëmundjes tek fëmijët dhe të rriturit me IgAV. Imunoglobulinat dhe plazmofereza mund të jenë gjithashtu të dobishme në situata të vështira dhe kërcënuese për jetën. Terapi të tjera të mundshme me rezultate inkurajuese përfshijnë TRF - budesonidin, terapinë e drejtuar nga qelizat B, agjentët që pakësojnë qelizat B, frenuesit e kotransporterit - 2 të natriumit - glukozës, antagonistët e receptorëve të endotelinës dhe frenuesit e rrugës së komplementit.
Përfundime: Glukokortikoidet janë terapia e linjës së parë për IgAV, veçanërisht tek të rriturit me manifestime të rënda. Roli i terapive të ndryshme imunomoduluese, siç janë frenuesit e kalcineurinës dhe mikofenolat mofetil, mbetet premtues, ndërsa rituksimabi zvogëlon efektet anësore afatgjata të glukokortikoideve dhe mund të ndihmojë në arritjen e remisionit të sëmundjes. Terapi të tjera të mundshme me rezultate inkurajuese kërkojnë kërkime të mëtejshme.

Fjalë kyçe: glukokortikoide, TRF - budesonid, leflunomide, plazmofereza, qeliza B.

PARASHIKIMI I LINDJES PREMATURE PËRMES CERVIKOMETRISË, PROVAT KLINIKE DHE PRAKTIKAT BASHKËKOHORE.

Teuta BARE[1], Elvana Toska[2]
[1]DSHM OB / GYN, SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë"
[2]DR. OB / GYN, SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë"

Abstrakt
Lindja Premature (LP) vazhdon të ngelet një nga sfidat më të mëdha në obstetrikën moderne, pasi ngelet shkaku kryesor i morbiditetit dhe mortalitetit neonatal në mbarë botën. Parashikimi i hershëm i rrezikut për LP është i rëndësishëm për marrjen e masave për përmirësimin e rezultateve perinatale. Një ndër metodat më të besueshme në këtë drejtim është cervikometria, matja e gjatësisë së qafës së mitrës me ekzaminimin endovaginal ekografik. Studimet klinike kanë treguar se një qafë mitre e shkurtuar <25 mm në tremujorin e dytë të shtatzënisë lidhet ngushtë me probabilitet të shtuar për LP. Përveç cervikometrisë, kombinimi me provat klinike si testi i fibronektinës fetale, vlerësimi i historisë obstetrikale dhe përdorimi i ndërhyrjeve parandaluese (progesterone vaginal, cerklazhi ose pesar vaginal) ka treguar rezultate të favorshme në reduktimin e incidencës së LP. Praktikat bashkëkohore synojnë integrimin e qasjeve shumëdisiplinare që përfshijnë vlerësim ekografik, analiza biokimike dhe algoritmet e personalizuara të rrezikut. Synojmë të analizojmë rëndësinë e cervikometrisë si mjet parashikues, të shqyrtojmë provat klinike kryesore dhe të përmbledhim zhvillimet më të fundit në menaxhimin dhe parandalimin e LP.

Fjalë kyçe: Lindje Parakohe, cervikometri, ekografi transvaginale, progesterone, parandalim obstetrikal.

KIRURGJIA REFRAKTIVE NË KERATOKONUS (ABLACION I PERSONALIZUAR ME RAY TRACING NË SYTË ME EKTAZI KORNEALE).

Dr. Shk. Teuta Haveri, Dr. Mimoza Meco, Giusseppe D'ippolito
Kirurge oftalmologe, Hygeia Eye Center, Hygeia Hospital, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Keratokonusi, një formë e ektazisë korneale, është tashmë një patologji mjaft e shpeshtë në vendin tonë, që prek kryesisht popullatën e re midis moshave 12–28 vjeç, por nuk përjashtohen edhe moshat mbi 30. Paraqitet me ulje graduale të shikimit; pacienti ndërron shpesh syzet, por cilësia e shikimit vazhdon të përkeqësohet. Kur semundja zbulohet herët, trajtimi medikal dhe mini - invaziv i rekomanduar në këto stade është mjaft efikas. Procedura e Cross - linking mbetet trajtimi i vetëm që mund të frenojë ecurinë progresive të keratokonusit. Pas frenimit të sëmundjes, pacientët, gjithnjë e më të rinj në moshë, kanë nevojë për rehabilitim të shikimit. Opsionet e deritanishme kanë qenë lentet e kontaktit të forta dhe / ose syzet. Opsionet e kirurgjisë refraktive (për eliminimin e numrit) nuk kanë qenë të mundshme deri më sot, për shkak të rrezikut të riaktivizimit të sëmundjes pas ablacionit dhe hollimit të trashësisë korneale. Vitin e fundit, teknologjia Cipta® Web application, duke ofruar një modelim të "butë" të kornesë, ofron mundësinë unike për eliminimin e numrit, pa ndikuar dhe pa nxitur evolucionin e keratokonusit. Kjo teknologji e re mundëson eliminimin e syzeve te pacientët me keratokonus.
Metoda: Fuqia refraktive efektive e syrit të njeriut mund të përcaktohet në mënyrë unike përmes analizës me ray - tracing. Ray - tracing analizon refraktimin e një rreze të dendur drite, paralele me boshtin optik, përmes sipërfaqeve refraktive të syrit. Aplikacioni Cipta® Web nga iVis Technologies përcakton në mënyrë unike formën Ideale të kornesë, duke u bazuar në teknologjinë ray - tracing - in për të optimizuar cilësinë e shikimit nëpërmjet ablacionit minimal selektiv. Forma ideale e kornesë përcaktohet nga aplikacioni Cipta®, duke përcaktuar: Zonën Refraktive, bazuar ne sipërfaqen e pasme te kornese dhe harten epiteliale. Zonën transitore, perms një algoritmi specific që garanton stabilitetin e trajtimit. Validimi i formave korneale për qëllime kirurgjikale kryhet automatikisht nga tomografi Precisio®, duke kontrolluar që ndryshimet morfologjike dhe refraktive midis dy ekzaminimeve të pavarura të jenë brenda kufijve të tolerancës së paracaktuar. Forma Ideale përshtat zonën refraktive sipas nevojave reale të pacientit, duke u mbeshtetur ne algoritmin

pMetrics® Pupilen Ideale, e cila mbulon kushtet e zakonshme të ndriçimit që pacienti përjeton gjatë jetës së përditshme, bazuar ne dinamikën e pupilës, stilin e jetës dhe profesionin. Zona tranzitore luan një rol kyç në garantimin e stabilitetit te trajtimit, cilësinë e shikimit dhe shërimin e duhur, duke ofruar një trajtim të personalizuar dhe te sigurte ne terma afatgjate.
Konkluzione: Keratokonusi, sëmundje e syve të rinj me një incidencë në rritje vitet e fundit, nëse lihet e patrajtuar mund të ketë pasoja serioze për shikimin. Duke qenë se prek popullatën e re dhe aktive për punë, ka ndikim të ndjeshëm edhe në shëndetin publik. Cross - linking është metodë jo invazive që frenon ecurinë progresive të sëmundjes.

Fjalë kyçe: keratoconus, syri, cross - linking.

PËRDORIMI I EKOGRAFISË PËR BLLOK NERVOR.
Dr. Thoma Kalefi, Msc. Manjola Pjetri**,** Msc. Klea Kazazi

Abstrakt
Hyrje: Ekografia (ultrasonografia) është një metodë moderne imazherike që përdor valë zanore për të vizualizuar strukturat anatomike të trupit në kohë reale. Në fushën e anestezisë, përdorimi i ekografisë për bllok nervor ka revolucionarizuar mënyrën e administrimit të anestezisë rajonale, duke rritur saktësinë, efikasitetin dhe sigurinë e procedurës. Falë ekografisë, anestezisti dhe infermierja asistuese mund të identifikojnë nervin, enët e gjakut dhe indet përreth, duke mundësuar injektimin e saktë të anestetikut pranë nervit të synuar.
Qëllimi: Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të ekografisë në realizimin e bllokut nervor. Të përshkruajë rolin e infermierit në përgatitjen dhe asistimin e procedurës. Të evidentojë përfitimet dhe sigurinë që ofron ekografia krahasuar me metodat tradicionale (p. sh. me palpim ose stimulim elektrik). Përcaktimi i bllokut nervor: Blloku nervor është një teknikë anestezie rajonale, ku injektohet një substancë anestetike pranë një nervi ose grupi nervash për të bllokuar ndjeshmërinë dhe dhimbjen në një zonë të caktuar të trupit (p. sh. krah, këmbë, bark). Kjo metodë përdoret në ndërhyrje kirurgjikale, dhimbje akute apo kronike, si dhe në procedura ortopedike.
Përdorimi i ekografisë në bllokun nervor: Ekografia i mundëson operatorit të: Shikojë në kohë reale strukturat anatomike (nervin, enët e gjakut, muskujt, fasciet). Drejtojë gjilpërën e bllokut me saktësi deri në pozicionin e dëshiruar. Kontrollon shpërndarjen e anestetikut gjatë injektimit. Ulë rrezikun e komplikacioneve si dëmtimi i nervit, injektimi intravaskular apo hematomat. Roli i infermierit: Roli i infermierit në përdorimin e ekografisë për bllok nervor është thelbësor dhe përfshin disa detyra të rëndësishme: Përgatitja e pacientit: Informon pacientin për qëllimin e procedurës dhe siguron pëlqimin e informuar. Vlerëson alergjitë, historinë mjekësore dhe terapitë aktuale. Kontrollon shenjat vitale para ndërhyrjes. Vendos pacientin në pozicionin e duhur për vizualizim optimal të zonës. Asistimi gjatë procedures: Përgatit aparatin e ekografisë dhe ndihmon në zgjedhjen e sondës së duhur. Sterilizon sondën dhe sipërfaqen e punës. Përgatit mjetet sterile, gjilpërën e bllokut dhe solucione anestetike. Ndihmon mjekun gjatë orientimit të sondës dhe ndjekjes së gjilpërës në ekran. Mbikëqyr reagimin e pacientit gjatë injektimit. Kujdesi pas procedures: Monitoron pacientin për efektet e anestezisë dhe shenjat e ndërlikimeve. Dokumenton kohën, llojin e bllokut, ilaçin e përdorur dhe reagimet e pacientit. Jep këshilla për kujdesin pas ndërhyrjes (p. sh. shmangia e lëvizjeve në zonën e bllokuar). Përfitimet e përdorimit të ekografisë: Saktësi më e lartë në vendosjen e anestetikut. Kohë më e shkurtër e procedurës. Më pak komplikacione (hemorragji, dëmtime nervore). Efekt më i mirë analgjezik dhe rikuperim më i shpejtë. Rrit sigurinë dhe komoditetin e pacientit.
Përfundime: Përdorimi i ekografisë në bllokun nervor përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt anestezisë moderne të sigurt dhe të personalizuar. Roli i infermierit është i domosdoshëm për suksesin e procedurës, përmes përgatitjes, asistimit aktiv dhe monitorimit të pacientit. Integrimi i ekografisë në praktikën e përditshme përmirëson cilësinë e kujdesit shëndetësor dhe sigurinë e pacientit.

Fjalë kyçe: Ekografia, metodë moderne imazherike, valë zanore.

NUTRICIONI NE KIRURGJI, LLOJET E NUTRICIONIT, INDIKACIONET DHE KOMPLIKIMET.
Dr. Tokjona Ndreca

Abstrakt
Hyrje: Nutricioni në kirurgji përfaqëson një komponent të domosdoshëm të trajtimit të pacientëve që i nënshtrohen ndërhyrjeve kirurgjikale, veçanërisht atyre me rrezik të lartë për malnutricion. Statusi ushqimor ndikon ndjeshëm në ecurinë klinike post - operatore, duke përfshirë shërimin e plagëve, rikuperimin funksional si dhe shkallën e komplikimeve dhe mortalitetit. Ky punim shqyrton rëndësinë e nutricionit në kirurgji, llojet kryesore të mbështetjes ushqimore (oral, enteral dhe parenteral), indikacionet klinike për secilin prej tyre dhe komplikimet potenciale që mund të shfaqen gjatë ose pas administrimit të tyre. Bazuar në rishikimin e literaturës së zgjedhur shkencore, janë analizuar praktikat bashkëkohore në përdorimin e terapive ushqimore perioperatore dhe rëndësia e qasjes së hershme multidisiplinare në parandalimin dhe menaxhimin e malnutricionit kirurgjikal. Gjithashtu, janë vlerësuar udhëzimet më të fundit ndërkombëtare nga ESPEN dhe ASPEN për të përcaktuar qasjet ideale në kujdesin nutricional të pacientëve kirurgjikalë.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të analizojë rëndësinë e nutricionit tek pacientët kirurgjikalë, të identifikojë llojet e mbështetjes ushqimore të përdorura në praktikën klinike, indikacionet për përdorimin e tyre dhe komplikimet e mundshme që mund të shfaqen gjatë trajtimit. Nëpërmjet rishikimit të literaturës bashkëkohore dhe udhëzimeve ndërkombëtare, synohet të theksohet rëndësia e ndërhyrjes së hershme nutricionale dhe të sugjerohen strategji për përmirësimin e menaxhimit të ushqimit në pacientët kirurgjikalë.
Metodologjia: Punimi i diplomës i përket llojit të hulumtimeve "rishikim i literaturës ekzistuese", e cila bazohet në literaturën angleze dhe punime shkencore të publikuara nga institutet e licencuara.
Poashtu duke u bazuar në fjalët kyqe "nutricioni ne kirurgji", "nutricioni parenteral", "nutricioni enteral", "nutricioni perioperative", është siguruar një numër i madh i informacioneve shkencore nga webfaqet medicinale si Pubmed, Medline, Scopus, Google Scholar etj. Poashtu jane shfrytëzuar udhëzimet zyrtare të shoqatave ndërkombetare për nutricionin klinik si ESPEN dhe ASPEN. Këto materiale kanë shërbyer si bazë e literaturës për shtjellimin e temës. Punimet ku bazohet hulumtimi janë bashkëkohore, të vërtetuara dhe të autorizuara për publikim. Janë zgjedhur me përpikmëri vetëm ato punime që janë të lidhura me temën dhe që ndihmojnë në nxjerrjen e një përfundimi real.

Fjalë kyçe: Nutricioni kirurgjikal, nutricion enteral, nutricion parenteral, malnutricion, kirurgji, komplikime post - operatore.

PREVALENCA E HIV, HEPATITIT B, HEPATITIT C DHE SYPHILISIT NË GRATË SHTATZËNA GJATË VITIT 2024 NË TIRANË.
Tone Sokoli - Imeraj[1], Fiona Konomi[1], Shpetim Qyra[2], Ela Ali[2], Dhurata Torba[2]
[1]Departamenti i Laboratorëve, Shërbimi i Epidemiologjisë OSHKSH Tiranë
[2]Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Infeksionet seksualisht të transmetueshme (IST) janë një nga problemet më të mëdha të shëndetit në mbarë botën. Edhe në Shqipëri, nga ndryshimet demografike, ekonomike dhe sociale, këto infeksione kanë ardhur në rritje, problem madhor për shëndetin publik, veçanërisht për gratë shtatzëna..
Qëllimi: Prevalenca e HIV, Hepatitit B, Hepatitit C dhe Syphilisit në gratë shtatzana gjatë vitit 2024, në Tiranë.
Materiale dhe metoda: U ekzaminuan mostrat e gjakut(serum) të grave shtatzana, periudha janar - dhjetor 2024, në Tiranë. Është përdorur metoda imunokromatografike për detektimin kualitativ: te antitrupave te virusit HIV tip 1 & 2; të antigenit sipërfaqësor te virusit të hepatitit B(HbsAg); të antitrupave të virusit të hepatitit C dhe antitrupave të Treponema Pallidum në serumin human. Për konfirmimin e rasteve pozitive është përdorur metoda ELISA dhe Western blot (HIV).
Rezultate: Nga ekzaminimet e serumeve të grave shtatzana rezultoi se: 0, 1% e tyre ishin positive për HIV - 1 ose HIV 1 & 2; 2, 3% ishin positive për HBsAg; 0, 1% ishin positive për anti HCV. Nga ekzaminimet e serumeve të individeve në total (femra dhe meshkuj) rezultoi se: 0, 2% e tyre ishin positive për HIV - 1 ose HIV 1 & 2; 4, 5% ishin positive për HBsAg; 1% ishin positive për anti HCV dhe 0. 6% ishin positive për Syphilis.
Konkluzione: Rezultatet treguan se infeksioni HIV / AIDS, Hepatiti B, Hepatiti C, si dhe Sifilisi janë problem madhor i shëndetit publik ne Tiranë, si për popullatën në tërësi, ashtu edhe për gratë shtatzana. Në grupmoshen

25 - 45 vjeç rezultoi përqindja më e lartë e pozitivitetit për IST e lartpërmendura (P<0. 01). Është i nevojshme një menaxhim i mirë nga mjekët e familjes dhe mjekët e konsultores së gruas, veçanarisht për këtë grupmoshë.

Fjalë kyçe: HIV virus tip 1&2, Hepatiti B, Hepatiti C, syphilis, gra shtatzëna, seroprevalencë, serum, IST.

IMUNOTERAPIA NË KANCERIN E GJIRIT TRIPLE NEGATIVE: NJË STANDARD I RI TRAJTIMI SIPAS REKOMANDIMEVE KLINIKE NGA ASCO, ESMO, NCCN.

Dr. Trendafile Korri
Mjeke onkologe

Abstrakt
Hyrje: Kanceri i gjirit triple negativ (TNBC) është një formë mjaft agresive e kancerit të gjirit me një prognozë jo të mirë, e cila karakterizohet nga pikëpamja imunoistologjike nga mungesa e receptorëve për hormonet estrogjen, progesteron dhe HER2, duke kufizuar specialistët onkologë në zgjedhjen e protokolleve standarde të trajtimit. Kjo formë e kancerit të gjirit përbën rreth 15–20% të të gjitha rasteve të diagnostikuara me këtë formë në botë dhe rreth 10–15% në Shqipëri. Në vitet e fundit, përdorimi i imunoterapisë ka shënuar një ndryshim të rëndësishëm në trajtimin e kancerit të gjirit triple negativ, duke përmirësuar jetesën e pacientëve. Udhëzimet klinike më të fundit nga organizatat ndërkombëtare të onkologjisë si ASCO, ESMO, NCCN rekomanduan përdorimin e inhibitorëve të checkpointeve imunologjikë si pembrolizumab, në kombinim me kimioterapinë, duke e rekomanduar si trajtim standard në kancerin e gjirit triple negativ. Indikimet praktike të miratuara tashmë në botë dhe në Shqipëri prej shkurtit 2025, bazohen në 2 studimet e mëdha të randomizuara: KEYNOTE - 522 (2024), sipas të cilit rekomandohet përdorimi i pembrolizumab në kombinim me kimioterapinë neoadjuvante, e ndjekur nga pembrolizumab adjuvant në pacientë me TNBC stad II–III. Studimi tjetër është KEYNOTE - 355, i cili rekomandon përdorimin në praktikën klinike të pembrolizumab + kimioterapi për pacientët PD - L1 pozitiv me kancer gjiri triple negativ metastatik, si linjë e parë trajtimi.
Përfundime: Aplikimi i imunoterapisë në trajtimin e kancerit të gjirit triple negativ përfaqëson një zhvillim rrënjësor në trajtimin e këtij kanceri, si në stade të hershme ashtu edhe në ato metastatike. Duke qenë një standard i ri trajtimi, ofron shpresë për rritjen e jetëgjatësisë dhe prognozë më të mirë.

Fjalë kyçe: Kanceri i gjirit, triple negative, imunoterapi, rekomandime klinike.

MENAXHIMI BAZIK I REFLUKSIT GASTROEZOFAGEAL (GERD).

Trimor Aliu

Abstrakt
Hyrje: Refluksi gastroezofageal (GERD) përbën një nga çrregullimet më të zakonshme gastrointestinale në praktikën klinike moderne, duke ndikuar në mënyrë të ndjeshme mirëqenien fizike dhe psikologjike të pacientëve. Kjo gjendje kronike shkaktohet nga mosfunksionimi i sfinkterit të poshtëm ezofageal, i cili lejon kthimin e përmbajtjes acide të stomakut në lumenin e ezofagut. Ekspozimi i përsëritur i mukozës ezofageale ndaj acidit gastrik rezulton në inflamacion kronik, irritim dhe dëmtim të strukturës së saj. Simptomat më të zakonshme përfshijnë djegien retrosternale (urën e zemrës), regurgitimin acid, ndjesinë e shijes së hidhur në gojë, dhimbjen pas ushqimit dhe, në disa raste, vështirësi në gëlltitje (disfagi). Përveç manifestimeve tipike, GERD mund të paraqitet edhe me simptoma ekstraezofageale si kollë kronike, laringit, astmë e përkeqësuar ose dhimbje torakale jo - kardiake, duke e bërë diagnostikimin më kompleks. Për shkak të natyrës së saj kronike dhe ndikimit në jetën e përditshme, GERD konsiderohet një problem shëndetësor publik në rritje.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të shqyrtojë strategjitë bazë të diagnostikimit dhe menaxhimit të refluksit gastroezofageal, me theks të veçantë në ndërhyrjet jo - farmakologjike dhe trajtimin farmakologjik me inhibitorë të pompës protonike (PPI).
Materiale dhe metoda: Është realizuar një rishikim i literaturës bashkëkohore në bazat e të dhënave mjekësore (PubMed, Medline, Cochrane Library), duke analizuar studime që vlerësojnë efektivitetin e PPI dhe ndërhyrjeve në stilin e jetës në menaxhimin e simptomave të GERD.

Rezultate: Të dhënat e mbledhura nga literatura ndërkombëtare dhe studimet klinike tregojnë qartë se kombinimi i ndërhyrjeve në stilin e jetës me trajtimin farmakologjik jep rezultate dukshëm më të mira në menaxhimin e refluksit gastroezofageal (GERD). Ndryshimet në stilin e jetës – përfshirë reduktimin e peshës trupore, shmangien e ushqimeve që nxisin sekrecionin acid (si çokollata, kafeja, pijet me gaz dhe ushqimet e yndyrshme), ndalimin e duhanit dhe ngritjen e kokës së shtratit gjatë gjumit – janë treguar se reduktojnë frekuencën e episodeve të refluksit dhe përmirësojnë ndjeshëm simptomat subjektive të pacientëve. Në të njëjtën kohë, përdorimi i inhibitorëve të pompës protonike (PPI) ka rezultuar në ulje të dukshme të ekspozimit të ezofagut ndaj acidit gastrik dhe në përmirësim të lezioneve mukozale të konfirmuara endoskopikisht. Studimet e kontrolluara kanë treguar se pacientët që marrin PPI në mënyrë të rregullt raportojnë përmirësim të simptomave brenda 2–4 javëve të trajtimit dhe një reduktim të ndjeshëm të recidivave në periudhën afatgjatë. Krahasuar me terapitë alternative, PPI - të kanë treguar efikasitet më të lartë në shërimin e ezofagitit eroziv dhe në parandalimin e komplikacioneve si strikturat ose metaplazia intestinale (ezofagu i Barrett - it). Ndërkohë, pacientët që kanë ndjekur me përpikëri rekomandimet jo - farmakologjike kanë pasur nevojë për doza më të ulëta të barnave dhe periudha më të gjata remisjeje. Analiza e përgjithshme tregon se një qasje e integruar, që kombinon modifikimet e stilit të jetës, trajtim farmakologjik racional dhe monitorim periodik, është më efektive në kontrollin afatgjatë të GERD, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e jetës dhe duke ulur rrezikun e komplikacioneve kronike të ezofagut.
Përfundime: Njohja e hershme e simptomave dhe zbatimi i strategjive të përshtatshme terapeutike janë thelbësore për parandalimin e dëmtimeve kronike të ezofagut dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientëve me GERD. Menaxhimi bazik, që përfshin qasjen jo - farmakologjike dhe përdorimin racional të PPI, mbetet themeli i trajtimit efektiv.

Fjalë kyçe: Refluksi gastroezofageal (GERD), çrregullime gastrointestinale, gjendje kronike.

NDJEKJA E NJË PACIENTI ME KANCER GJIRI, ÇFARË DUHET TË DIJË MJEKU I FAMILJES.
Dr. Valbona Çejku, Fjoralba Çejku

Abstrakt
Hyrje: Kanceri i gjirit përbën një nga patologjitë më të shpeshta malinje te gratë në mbarë botën dhe në Shqipëri, duke përfaqësuar një sfidë të vazhdueshme për sistemin shëndetësor. Përmirësimi i mbijetesës falë diagnostikimit të hershëm dhe terapive moderne ka rritur numrin e pacienteve që kërkojnë ndjekje afatgjatë në nivel parësor. Mjeku i familjes luan një rol kyç në koordinimin e kujdesit, monitorimin e komplikimeve, mbështetjen psikosociale dhe edukimin shëndetësor, duke siguruar një vazhdimësi të trajtimit pas përfundimit të terapisë spitalore. Për të garantuar një kujdes cilësor dhe në kohë, është e domosdoshme që mjeku i familjes të zotërojë njohuri të detajuara mbi stadifikimin, terapitë kryesore, efektet anësore dhe protokollet e ndjekjes së pacientëve me kancer gjiri.
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të evidentojë rolin praktik dhe teorik të mjekut të familjes në ndjekjen e pacienteve me kancer gjiri, të përcaktojë ndërhyrjet kryesore klinike dhe edukative, si dhe të theksojë rëndësinë e bashkëpunimit ndërdisiplinar në sistemin shëndetësor.
Metodologjia: Studimi bazohet në një analizë narrative të literaturës kombëtare dhe ndërkombëtare, udhëzimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, shoqatave profesionale onkologjike si ESMO dhe NCCN, si dhe protokolleve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë. Janë shqyrtuar praktikat më të mira në ndjekjen post - trajtim të pacienteve me kancer gjiri, me fokus në rolin klinik dhe edukativ të mjekut të familjes.
Rezultate dhe konkluzione: Mjeku i familjes është një hallkë kyçe në kujdesin afatgjatë të pacienteve me kancer gjiri. Integrimi i njohurive klinike, ndjekja sipas udhëzimeve të standardizuara dhe bashkëpunimi i ngushtë me shërbimet onkologjike e kthen atë në një faktor vendimtar për menaxhimin efektiv të kësaj patologjie. Përmirësimi i programeve të edukimit profesional dhe fuqizimi i rolit të mjekut të familjes në sistemin shëndetësor do të ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e mbijetesës dhe cilësisë së jetës së pacienteve.

Fjalë kyçe: Kancer gjiri, mjek familjeje, ndjekje klinike, kujdes afatgjatë, stadifikim, terapi onkologjike, monitorim, komplikime, mbështetje psikosociale, kujdes parësor, bashkëpunim multidisiplinar, sistem shëndetësor.

RAPORTI I FAKTORIT RHEUMATOID DHE ANTI - CCP NË AKTIVITETIN E ARTRITIT RHEUMATOID.

Bora Kavaja, Valbona Duraj

Abstrakt

Hyrje: Artriti rheumatoid është një sëmundje autoimmune kronike sistemike inflamatore me një prevalencë 1% në popullatën në botë. Diagnoza dhe ecuria e sëmundjes bazohen në ekzaminimin klinik, ekzaminimet imazherike dhe laboratorike, ku rëndësi te vecantë marrin FR dhe anti - CCP, dhe DAS - 28.

Qëllimi: Ky studim shqyrton lidhjen ndërmjet vlerave të testeve serologjike si faktori rheumatoid (FR) dhe antitrupat anti - citrulinë (anti - CCP) me aktivitetin e sëmundjes tek pacientët me artrit rheumatoid (AR).

Materiale dhe Metoda: Ky është një studim retrospektiv, I mbështetur në të dhënat e pacientëve të paraqitur në Qendrën Spitalore "Nënë Tereza" gjatë vitit 2024. Në këtë studim u përfshinë 75 pacientë të diagnostikuar me artrit rheumatoid seropozitiv, të cilët gjatë periudhës së hospitalizimit iu nënshtruan ekzaminimeve laboratorike dhe vlerësimit klinik përmes indeksit DAS - 28. Treguesit laboratorikë të analizuar në këtë studim ishin faktori rheumatoid, antitrupat anti - citrulinë, proteina C - reaktive dhe Eritrosedimenti.

Rezultate: Nga 75 pacientë të marrë në studim, 62 ishin femra (82, 67%) dhe 13 meshkuj, ku mosha mesatare ishtë 57, 01. FR u gjet pozitiv në 74 nga 75 pacientë, ndërsa anti - CCP pozitiv në 54 nga 75 pacientë në total. 45 pacientë me vlera positive të FR dhe anti - CCP kishin të pranishme sëmundje bashkëshoqëruese (60%). Indeksi DAS - 28 korrelonte mirë me aktivitetin e sëmundjes dhe testet serologjike. Rezultatet e studimit tonë treguan se vlerat e larta të anti - CCP dhe FR, ishin të lidhura ngushtë me aktivitetin e lartë të sëmundjes.

Konkluzione: Nga përfundimi i studimit rezultoi se testet imunologjike si FR dhe anti - CCP janë të rëndësishme në prognozën e AR. Një element I rëndësishem në vlerësimin e aktivitetit të sëmundjes janë dhe treguesit e fazës akute të inflamacionit të implementuara në indeksin DAS - 28. Shfaqja e sëmundjeve bashkëshoqëruese ishte e shpeshtë në pacientët me FR dhe anti - CCP positive.

Fjalë kyçe: artriti rheumatoid, faktori rheumatoid, anti - CCP, DAS - 28, testet e fazës akute të inflamacionit, aktiviteti i sëmundjes, sëmundje bashkëshoqëruese.

SINDROMA E NGJASHME ME MONONUKLEOZËN ZBULON INFEKSIONIN E HERSHËM TË HIV / SIFILIZ TE NJË PACIENT I RI.

Valbona Gashi

Abstrakt

Paraqesim një rast diagnostikisht kompleks, mashkull 25 - vjeç i hospitalizuar me një histori 10 - ditore me temperaturë, dhimbje të fytit, limfadenopati cervikale, dhimbje koke, lodhje, anoreksi dhe një rash makulopapular pas administrimit të cefuroksimës. Dyshimi fillestar klinik ishte mononukleoza infektive. Gjetjet laboratorike treguan një test Mono - spot pozitiv, pozitivitet CMV dhe EBV - VCA IgG me IgM negative, transaminaza të larta (AST / ALT) dhe leukopeni. Testimet serologjike të mëtejshme zbuluan sifiliz aktiv (RPR, VDRL dhe TPHA pozitiv). Vlen të theksohet se pacienti kishte kryer testin për HIV gjashtë javë më parë, i cili rezultoi negativ. Megjithatë, testi aktual i shpejtë për HIV 1+2 ishte reaktiv, dhe kuantifikimi i RNA - së së HIV - it tregoi një ngarkesë virale shumë të lartë, ndërsa testi Western Blot mbeti negativ—gjë që sugjeron një infeksion akut HIV gjatë dritares së serokonvertimit (periudha dritare). Ky rast ilustron sfidat diagnostikuese që shfaqen ne sindromat Mononukleosis - like, veçanërisht kur bashkekzistojne me infeksione seksualisht të transmetueshme dhe infeksionin e hershëm të HIV - it. Prania e një skuqjeje të shkaktuar nga ilaçet e komplikuar më tej pamjen klinike. Kombinimi i simptomave sistemike virale, funksioneve të mëlçisë jo normale dhe gjetjeve hematologjike shtyu një hetim më të gjerë infektiv, duke zbuluar në fund bashkë - infeksione që kërkonin ndërhyrje urgjente. Menaxhimi përfshinte kujdes mbështetës, fillimin e trajtimit për sifilis, dhe koordinimin me specialistët e sëmundjeve infektive në Spitalin Publik për trajtimin dhe ndjekjen e HIV - it. Ky rast thekson rëndësinë e konsiderimit të infeksionit akut HIV tek pacientët me simptoma të ngjashme me mononukleozën dhe ekspozim të fundit me rrezik të lartë, edhe në prani të një testi të fundit negativ për HIV. Ai gjithashtu nxjerr në pah përdorimin e testimit HIV - RNA për diagnostikimin e hershëm dhe kufizimet e analizave bazuar në antitrupa gjatë serokonvertimit. Përmes kësaj prezantimi, ne synojmë të theksojmë nevojën për strategji gjithëpërfshirëse diagnostikuese dhe bashkëpunim multidisiplinar në vlerësimin e sëmundjeve febrile me karakteristika jo të zakonshme tek të rinjtë.

Fjalë kyçe: HIV, sifiliz, EBV - VCA, IgM negative, Western Blot, AST, ALT.

FIBROMIALGJIA, E MBIVLERËSUAR, E NËNDIAGNOSTIKUAR APO E KEQMENAXHUAR?

Valbona Salko, Prof. Asc. Artur Zoto, Prof. Dr. Teuta Backa, PhD. Ervin Rapushi, Dr. Florenc Spaho
QSUNT, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Hyrje: Fibromialgjia karakterizohet nga një spektër kompleks simptomash dhe gjetjesh që e bëjnë sfiduese vendosjen e saktë të diagnozës. Në vitet e fundit koncepti i fibromialgjisë dhe tendenca për të vendosur këtë diagnozë është shtuar. Duke qënë një diagnozë e vendosur kryesisht në perceptimin e pacientit, pa të dhëna objektive të detektueshme apo parametra të matshëm, shpesh herë vihet re nevoja e rishikimit të kritereve të kësaj diagnoze në mënyrë që të shmangen gabimet në diagnostikimin e pacientëve.

Objektiva dhe Qëllime: Rishikimi i kritereve diagnostike të fibromialgjisë për të shmangur keqdiagnostikimin apo menaxhimin jo - adekuat të këtyre pacientëve.

Materiale dhe Metoda: Kriteret e American College of Rheumatology (ACR) 1990, kriteret e modifikuara të diagnozës së propozuara në 2011 nga ACR (2011ModCr) dhe përditësimet më të vonshme të kësaj diagnoze në vitin 2016. U rishikuan 14 studime të rëndësishme që krahasonin kriteret e ACR 2010 / 2011(të modifikuara) dhe klasifikimin e ACR 1990 duke përfshirë kriteret klinike gjithashtu dhe epidemiologjinë, ekzaminimin objektiv, të dhënat laboratorike etj. Bazuar në diferencat definicionale ndërmjet kritereve të 1990 dhe 2010 / 2011, u dakortesua që sensitiviteti i kritereve në masën 85% dhe specifiteti 90% ishin një tregues i shkëlqyer i vendosjes së diagnozës.

Rezultate dhe Diskutime: Kriteret e viteve 2010 / 2011 çuan në klasifikim të gabuar kur u aplikuan në sindromat e lokalizuara të dhimbjes, por kur u shtua një kriter i modifikuar i dhimbjes së përhapur, klasifikimi i gabuar u minimizua. Bazuar në të dhënat e mësipërme dhe të dhënat e përdorimit klinik, u zhvillua një rishikim (2016) i kritereve të fibromialgjisë të viteve 2010 / 2011. Fibromialgjia tani mund të diagnostikohet tek të rriturit kur plotësohen të gjitha kriteret e përcaktuara.

Konkluzione: Kriteret aktuale të fibromialgjisë kanë sensitivitet dhe specifitet të lartë. Ky rishikim kombinon kriteret e mjekut dhe të pyetësorit, minimizon klasifikimin e gabuar dhe eliminon rekomandimin e mëparshëm konfuz në lidhje me përjashtimet diagnostike. Sfida kryesore pas vendosjes së diagnozës është menaxhimi i sëmundjes, i cili shpesh paraqitet i vështirë dhe kërkon një gërshetim multidisiplinar të planeve të trajtimit.

Fjalë kyçe: fibromialgji, diagnozë, sindromë.

SËMUNDJA E BLOUNT - IT.

Valmir Prenaj

Abstrakt

Sëmundja e Blount - it infantile është një deformim patologjik progresiv i genu varum që prek tibian te fëmijët nga 2 deri në 5 vjeç. Diagnostikimi behet duke u bazuar në praninë e deformimeve të genu varum - it, fleksionit dhe rotacionit të brendshëm, dhe konfirmohet radiografikisht me nje kënd të rritur metafizë - diafizë. Trajtimi mund të përfshijë orteza, ose kirurgji, në varësi të moshës së pacientit dhe ashpërsisë së deformimit. Forma e adoleshencës është një deformim patologjik progresiv i genu varum që prek tibian te fëmijët mbi 10 vjeç. Pacientët me formën e adoleshencës shpesh janë obezë dhe zakonisht paraqiten me deformim progresiv varus të këmbës, me ose pa dhimbje në gju. Çrregullimi mund të jetë unilateral, bilateral ose asimetrik. Diagnostikimi bëhet klinikisht në prani të deformimit të genu varum dhe konfirmohet radiografikisht. Te forma e adoleshencës trajtimet konservative (fizioterapi, gips, orteza, etj.) kanë treguar kryesisht se janë të pasuksesshme, prandaj preferohet trajtimi kirurgjikal.

Fjalë kyçe: Blount, infantile, genu varum, trajtim kirurgjikal, deformime.

MENAXHIMI I PACIENTËVE ME HIPERTENSION REZISTENT.
Valmire Kuqi

Abstrakt
Hyrje: Hipertensioni persistent përbën një nga sfidat më të mëdha në mjekësinë bashkëkohore, pasi pacientët nuk arrijnë të mbajnë nën kontroll vlerat e presionit arterial pavarësisht trajtimit me kombinime të shumta barnash. Ai lidhet me rrezik të lartë për komplikacione kardiovaskulare dhe renale, duke kërkuar një menaxhim të kujdesshëm dhe individualizuar.
Qëllimi: Ky studim synon të analizojë strategjitë aktuale të menaxhimit të pacientëve me hipertension persistent, të identifikojë faktorët që kontribuojnë në rezistencën ndaj trajtimit dhe të propozojë masa për përmirësimin e kontrollit të presionit arterial.
Metodologjia: Punimi është bazuar në një rishikim të literaturës shkencore ndërkombëtare dhe analizën e udhëzimeve klinike bashkëkohore për trajtimin e hipertensionit rezistent. Janë shqyrtuar strategjitë farmakologjike, roli i aderencës ndaj trajtimit dhe ndikimi i ndërhyrjeve në stilin e jetesës.
Rezultate: Studimet tregojnë se kontrolli më i mirë i presionit arterial arrihet përmes kombinimit të barnave nga klasa të ndryshme dhe përmirësimit të stilit të jetesës. Përdorimi i spironolaktonit ka rezultuar efektiv në shumë raste, ndërsa mungesa e disiplinës në marrjen e terapisë është faktor i shpeshtë i dështimit terapeutik.
Përfundime: Menaxhimi i hipertensionit persistent kërkon një qasje të balancuar mes trajtimit farmakologjik dhe masave jo - medikamentoze. Përfshirja aktive e pacientit dhe ndjekja e vazhdueshme mjekësore janë kyçe për arritjen e rezultateve të qëndrueshme dhe uljen e rrezikut për komplikacione.

Fjalë kyçe: hipertensioni, presion arterial, barna, terapi, aderencë.

INFARKTI I MIOKARDIT NE RAPORT ME FAKTORËT E FITUAR TË RREZIKUT KARDIOVASKULAR PËR PERIUDHËN JANAR - QERSHOR 2025.
Berisha Valon, Asani Saud

Abstrakt
Hyrje: Infarkti i miokardit (IM), si një nga format klinike të sëmundjes iskemike të zemrës, shfaqet kur qarkullimi koronar i gjakut zvogëlohet papritmas pas okluzionit trombotik të arteries koronare, e cila paraprakisht është e ngushtuar nga ateroskleroza. Personat që janë në rrezik të rritur për shfaqje të IM janë ata tek të cilët është vërejtur prania e faktorëve të rrezikut kardiovaskular.
Qëllimi: Objektiv i këtij punimi ishte hulumtimi i pranisë së faktorëve të fituar të rrezikut kardiovaskularë (hipertonia arteriale, hiperkolesterolemia, diabeti, përdorimi i duhanit dhe obesiteti) te pacientët e hospitalizuar për shkak të infarktit akut të miokardit.
Metodologjia: Hulumtimi është kohort retrospektiv me komponenten deskriptive. Është analizuar prania e faktorëve të rrezikut te 56 pacientë me IAM për periudhën 6 mujore (janar - qershor), të hospitalizuar në Njësinë Koronare të Spitalit Regjional - Mitrovicë. Të dhënat janë marrë nga historitë e pacientëve të hospitalizuar, dhe janë përpunuar me programin e Microsoft Excel. Janë prezentuar përmes tabelave dhe grafikeve.
Rezultate: Nga 56 pacientët me infarkt akut të miokardit, te 42 prej tyre (75%) u vërejt prania e 1 apo më shumë faktorëve të analizuar të rrezikut. Këto rezultate janë të përafërta me hulumtimet e shumta të autorëve të ndryshëm lidhur me efektin e faktorëve të rrezikut kardiovaskular te infarkti i miokardit.
Përfundime: Rezultatet e fituara tregojnë qartë se në rrezik të rritur për shfaqje të IM janë, në përqindje më të lartë, personat me prani të faktorëve të rrezikut kardiovaskularë (në këtë rast të faktorëve të fituar), e sidomos ata me prani të shumëfisht të tyre. Nga faktorët kardiovaskular të rrezikut më i pranishmi ishte presioni arterial me 39% ndërsa më pak i pranishmi ishte obeziteti me 16%. Në rastet e raportuara të IAM dominoi grupmosha mbi 60 vjeçare me 36%, kurse më pak e prekur ishte grupmosha deri në 20 vjet me 2%. Nga të gjitha rastet e raportuara më e prekur ishte gjinia mashkullore me 57%.

Fjalë kyçe: Infarkti i miokardit, ateroskleroza, faktorët e fituar të rrezikut kardiovaskular.

PET - CT NË DIAGNOSTIKIMIN E LEZIONEVE NEOPLAZIKE NË MËLÇI.
Valon Bujupaj

Abstrakt
Mëlçia është organi më i madh i brendshëm viceral dhe gjëndrra më e madhe në organizmin e njeriut. Është organi visceral më i vaskularizuar. Ka anatomi dhe ndërtim histologjik mjaft të ndërlikuar dhe poashtu i kryen rreth 500 funksione të ndryshme, që disa prej tyre janë vitale për organizmin. Mëlçia poashtu, është njëri ndër organet më të shpeshta në organizmin e njeriut, në të cilin zhvillohen proceset neoplazike. Neoplazmat në përgjithësi, e ato hepatike në veçanti janë ndër sëmundjet më të shpeshta të kohërave moderne, të cilat kanë incidencë të lartë por edhe shkallë të lartë të mortalitetit. Ky punim ka për qëllim kryesor të përshkruajë rolin e PET - CT në diagnostikimin e neoplazmave hepatike beninje, malinje, primare dhe sekondare. Ndërsa qëllime dytësore janë edhe përshkrimi i rolit të PET - CT në shkallëzimin, përcaktimin e terapisë, detektimin e rekurrencave dhe prognozën e këtyre neoplazmave. Ky punim është një rishikim literature. Në këtë punim është bërë një analizë e disa punimeve shkencore. Gjatë rishikimit të literaturës janë përfituar rezultate të ndryshme të rolit të PET - CT në diagnostikimin e neoplazmave të ndryshme hepatike. Te hemangiomat PET - CT nuk konsiderohet si metodë e besueshme diagnostike. PET - CT konsiderohet e rëndësishme për dallimin e hiperplazionit nodular fokal nga adenoma hepatoqelizore, e poashtu mund të përdoret për diagnostikimin e adenomave hepatike të llojit H1FNA. Te karcinoma hepatoqelizore përdoren një numër i madh i radiofarmakëve, ndërsa besueshmëria e diagnostikimit rritet me kombinimin e tyre. Te kolangiokarcinoma, PET - CT ka besueshmëri më të madhe në diagnostikimin e formës intrahepatike. PET - CT konsiderohet si metoda më sensitive jo - invazive në diagnostikimin e metastazave hepatike e poashtu luan rol të rëndësishëm në dallimin e limfomave hepatike nga karcinomat hepatoqelizore. Poashtu, kjo metodë shpesh përdoret për diagnostikimin e lezionit primar të një metastaze hepatike. Gjatë rishikimit të literaturës mund të konstatohet se PET - CT për disa lloje të caktuara të tumoreve dhe gjatë përdorimit të disa radiofarmakëve të caktuar ka rol të rëndësishëm në diagnozë, shkallëzim dhe prognozë. Por poashtu, te disa lloje të tjera të tumoreve mund të konstatohet se PET - CT nuk konsiderohet si teknikë e rendit të parë për diagnostikim.

Fjalë kyçe: PET / CT, lezione neoplazike, mëlçi.

FARMAKOTERAPIA E ANGINËS PEKTORALE.
Vanesa Dragaqina, Prof Asoc. Dr Elton Bahtiri
Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti Mjekësi e Përgjithëshme, Prishtinë, Kosovë

Abstrakt
Hyrje: Angina pektorale është një manifestim klinik i sëmundjes koronare të zemrës që karakterizohet nga dhimbje apo ndjesi presioni në gjoks, e shkaktuar nga furnizimi i pamjaftueshëm me oksigjen të miokardit. Menaxhimi i saj përfshin ndërhyrje farmakologjike me qëllim të kontrollit të simptomave dhe parandalimit të ngjarjeve kardiovaskulare. Udhëzimet ndërkombëtare, si ato të NICE dhe ESC, japin rekomandime të qarta për përzgjedhjen dhe kombinimin e barnave.
Qëllimi: Ky punim synon të analizojë dhe përmbledhë qasjet farmakoterapeutike në trajtimin e anginës pektorale bazuar në udhëzimet më të fundit ndërkombëtare dhe në literaturën shkencore relevante, me fokus në efikasitetin dhe sigurinë e barnave antianginoze.
Materiale dhe metoda: Ky punim është një rishikim i literaturës mbi farmakoterapinë e anginës pektorale, i cili synon të përmbledhë dhe të analizojë të dhënat ekzistuese shkencore për trajtimet farmakologjike të kësaj gjendje. Është punuar duke mbledhur, analizuar, krahasuar e vlerësuar baza të dhënash të njohura ndërkombëtare.
Rezultate dhe diskutime: U konstatua se trajtimi farmakologjik i anginës pektorale duhet të përshtatet sipas profilit të pacientit. Beta - bllokuesit dhe CCB - të përbëjnë terapinë e linjës së parë, ndërsa nitrate me veprim të gjatë, ivabradina dhe ranolazina shërbejnë si terapi shtesë në raste të përzgjedhura. Rekomandimet e NICE dhe ESC përkojnë në disa pika, por dallojnë në renditjen e preferencës së disa barnave. Trajtimi duhet të synojë kontrollin simptomatik dhe parandalimin e ngjarjeve kardiake, duke minimizuar efektet anësore.
Përfundime: Farmakoterapia e anginës pektorale mbetet një shtyllë e rëndësishme në menaxhimin e sëmundjes koronare. Zgjedhja e barnave duhet të individualizohet dhe të bazohet në udhëzime klinike dhe prova shkencore.

Rishikimi tregon rëndësinë e qasjes së integruar dhe multidisiplinare për përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientëve.

Fjalë kyçe: Angina pectoris, sëmundja koronare e zemrës, farmakoterapia, beta - bllokues, CCB, nitrate, udhëzime ESC, udhëzime NICE.

LUPUS – LYELL SYNDROME.

Vasilika Gjika MD, Prof. Asc. Dorina Ruci, Prof. Dr. Teuta Backa
Shërbimi i Reumatologjisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Lupusi eritematoz sistemik LES është një sëmundje autoimune sistemike jo organ specifike, e cila karakterizohet nga prania e autoantitrupave që shkaktojnë dëmtim indor në shumë organe. Organi i dytë më i prekur nga LES është lëkura. Prekja kutane nga lupusi klasifikohet në: akute, subakute dhe kronike. Ekzistojnë gjithashtu edhe forma të tjera të manifestimeve kutane, të cilat klasifikohen si jo - lupus specifike. Një prej manifestimeve të veçanta kutane të lupusit është edhe sindroma Lupus – Lyell. Lupus – Lyell ose e njohur ndryshe si nekroliza toksike epidermoide e lidhur me lupusin (TEN) është një entitet i veçantë, mjaft i ngjashëm me sindromën Lyell të induktuar nga medikamentet. Karakterizohet nga shkatërrimi i shtresës sipërfaqësore të lëkurës dhe membranave mukozale. Është një manifestim hiperakut dhe mjaft i rëndë me prognozë të rezervuar dhe mortalitet të lartë.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është një rishikim i literaturës dhe të japë informacion mbi këtë formë të rëndë të shfaqjes së lupusit, mënyrat e manifestimit klinik, sfidat e diagnostikimit ku fokusi vendoset te diferencimi midis një prekje kutane të rëndë të lupusit dhe një reaksioni medikamentoz autentik, format e menaxhimit adekuat si dhe ecurinë dhe prognozën e pacientëve.
Konkluzione: Lupus – Lyell syndrome është një nga manifestimet më të rënda dhe më të rralla kutane të LES që paraqet sfidë si për diagnostikim edhe për menaxhimin dhe trajtimin e pacientëve. Studimi i rasteve të pakta të dokumentuara si dhe analizimi i të gjithë elementeve të kësaj patologjie mund të ndihmojë në zbulimin dhe menaxhimin e hershëm dhe sa më të mirë të rasteve në mënyrë që të përmirësohet prognoza dhe niveli i mortalitetit.

Fjalë kyçe: Lupus eritematoz sistemik, Lyell syndrome, prekje kutane, TEN.

VAKSINIMI PAS - COVID - 19 DHE SHTATZËNIA: SIGURIA, REZULTATET DHE MITET NJË PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE NGA STUDIME TË MËDHA DHE REKOMANDIME TË BAZUARA NË PROVA SHKENCORE.

Vera Beca[1, 2], PhDc; Mirela Rista[1], Prof. Dr; Daniela Nakuci[1] PhDc;Eliona Demaliaj[1], Prof. Dr;
[1]Spitali Universitar i Obstetrikë - Gjinekologjisë "Mbretëresha Geraldinë", Tiranë, Shqipëri
[2]Shefe e Shërbimit të Kontrollit të Infeksioneve Spitalore S. U. O. GJ 'Mbretëresha Geraldinë' Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Hyrje: Fillimi i vaksinimit kundër COVID - 19 ngjalli shqetësime në lidhje me sigurinë gjatë shtatzënisë, fertilitetin dhe ndikimet e mundshme mbi zhvillimin fetal. Megjithatë, një numër gjithnjë në rritje studimesh shkencore ka treguar se vaksinimi është i sigurt dhe sjell përfitime të dukshme si për nënën, ashtu edhe për foshnjën.
Materiale dhe Metoda: Ky studim përmbledh të dhëna nga analiza të mëdha retrospektive, studime popullatash dhe meta - analiza të publikuara midis viteve 2021–2024, të cilat kanë vlerësuar efektet e vaksinimit gjatë shtatzënisë. Janë analizuar parametrat obstetrikë dhe neonatologjikë, përfshirë lindjen e parakohshme, vdekshmërinë intrauterine, abortet spontane, peshën e ulët në lindje dhe shtrimet në kujdesin intensiv neonatal.
Rezultate: Të dhënat e përbashkëta nga shume studime retrospektive, por dhe ne dinamikë, treguan se vaksinimi nuk lidhet me rritje të rrezikut për komplikacione obstetrike apo neonatale. Përkundrazi, tek gratë e vaksinuara u vu re një incidencë më e ulët e lindjeve të parakohshme, vdekshmërisë fetale dhe peshës së ulët në lindje. Nuk

u vërejtën rritje të rrezikut për abort, anomalitë kongjenitale apo probleme fertiliteti. Për më tepër, u konstatua transferim transplacentar i antitrupave, duke ofruar mbrojtje të hershme për neonatin.
Përfundime: Vaksinimi kundër COVID - 19 gjatë shtatzënisë është i sigurt dhe ndihmon në përmirësimin e rezultateve perinatale. Mitet që lidhen me infertilitetin, abortin apo dëmtimet fetale nuk mbështeten nga prova shkencore. Mjekët dhe profesionistët e shëndetit kanë rol kyç në promovimin e informacionit të saktë dhe në rritjen e besimit të grave shtatzëna ndaj vaksinimit.

Fjalë kyçe: Vaksinimi COVID - 19; shtatzënia; siguria; rezultatet perinatale.

PROGNOZA GJUHËSORE DHE FUNKSIONALE TE NJË FËMIJË ME SINDROMËN PRADER WILLI, STUDIM RASTI 7 - VJEÇAR.
Msc. Verona Gjergji, Phd. Cand. Antigoni Bullari

Abstrakt
Hyrje: Sindroma Prader–Willi është një kondicion gjenetik i rrallë që shoqërohet me vonesa në zhvillimin motorik, gjuhësor dhe konjitiv, si dhe me sfida të vazhdueshme në aftësitë sociale. Ndërhyrja e hershme logopedike luan një rol kyç në përmirësimin e komunikimit dhe integrimit akademik e social.
Qëllimi: Paraqitja e prognozës gjuhësore dhe funksionale të një fëmije femër, e diagnostikuar me sindromen Prader–Willi në moshën 2 vjeç, e cila ka ndjekur terapi logopedike për një periudhë 7 - vjeçare.
Metodologjia: U krye një ndjekje longitudinale e fëmijës nga mosha 2 deri në 9 vjeç. Të dhënat përfshijnë vlerësime të zhvillimit gjuhësor, aftësitë pragmatike dhe përfshirjen akademike. Terapia logopedike është zhvilluar rregullisht duke përdorur metoda interaktive, për prodhimin e të folurit, kuptimin e gjuhës, zgjerimin e komunikimit, si dhe teknika për zhvillimin e komunikimit social.
Rezultate: Pas 7 viteve ndërhyrje logopedike, fëmija ka arritur të ketë një zhvillim të mirë të gjuhës së kuptuar dhe të folur, të ndjekë shkollën më mbështetje, të zvilloje aftësi në lexim dhe shkrim. Ecuria pozitive sugjeron një prognozë të mirë të Sindromës Prader Willi kur ndërhyrja logopedike fillon herët dhe bëhet në mënyrë të qëndrueshme.

Fjalë kyçe: Sindroma Prader–Willi, terapia logopedike, zhvillimi gjuhësor, prognoza, studim rasti.

INFEKSIONET BAKTERIALE TË LEKURËS.
Vesa Hasani

Abstrakt
Hyrje: Normat shoqërore kanë një ndikim të rëndësishëm në sjelljen njerëzore, 1 - 4 dhe mund të kategorizohen në dy fusha të dallueshme. Normat përshkruese i referohen perceptimeve të një personi mbi mënyrën se si sillen të tjerët (p. sh. , sa e zakonshme është pirja e duhanit), ndërsa normat udhëzuese i referohen perceptimeve të një personi mbi atë se si mendojnë të tjerët se duhet të sillen njerëzit (p. sh. , aprovimi i pirjes së duhanit). Në mënyrë të zgjeruar, denormalizimi është procesi i ndryshimit të perceptimit të një personi për një sjellje nga më e zakonshme dhe / ose e pranuar në më pak të zakonshme dhe / ose të pranuar; ndërsa renormalizimi është e kundërta. Ndërprerja e pirjes së duhanit nga duhanpirësit aktualë zvogëlon rrezikun e tyre për sëmundje të zemrës, kancer, goditje në tru dhe sëmundje respiratore.
Materiale dhe metoda: Hulumtimi i këtij punimi është "rishikim i literaturës ekzistuese" me bazë në libra të ndryshëm ndërkombëtarë shkencoro - mjekësorë dhe informata shkencore marrë nga uebfaqe të ndryshme. Të gjitha burimet informative janë të cituara në pjesën e referencave. Punimet ku bazohet hulumtimi janë më bashkëkohoret dhe më të përditësuarat. Ato janë të publikuara në revista të indeksuara në databaza prestigjioze si Web of Science, Scopus, Pubmed, Medline, Google Schoolar etj.
Rezultate: Duhanpirja vazhdon të përbëjë një shqetësim të madh shëndetësor, veçanërisht kur analizojmë dallimet mes gjinive. Të dhënat tregojnë se përhapja e këtij zakoni të dëmshëm është ndjeshëm më e lartë tek meshkujt sesa tek femrat. Më konkretisht, 37. 4% e burrave raportojnë se pijnë duhan, ndërsa kjo përqindje bie në 19. 7% tek gratë. Ky hendek i madh gjinor nuk është i kufizuar vetëm në një grupmoshë të caktuar – përkundrazi, ai është i pranishëm dhe i qëndrueshëm në të gjitha grupmoshat, gjë që tregon për një tendencë të

thellë kulturore dhe shoqërore që lidhet me perceptimin dhe praktikat rreth duhanit. Kur analizojmë më në detaje përhapjen e duhanpirjes sipas moshës, vihet re një model mjaft i qartë dhe domethënës. Tek të rinjtë e moshës 15 deri në 24 vjeç, rreth 16. 0% e individëve janë përdorues të rregullt të duhanit.
Diskutime: Ky studim tregon se Kosova ka një prevalencë të lartë të duhanpirjes, me 31. 7% të të rriturve të moshës 25 - 64 vjeç që janë duhanpirës aktualë. Duhanpirja është më e përhapur tek meshkujt sesa tek femrat (41. 6% kundrejt 21. 9%; P<0. 001). Gjithashtu, përhapja e duhanpirjes tek fëmijët e shkollës është e konsiderueshme, me 37% të nxënësve të moshës 13 - 15 vjeç që raportojnë përdorimin e duhanit.
Përfundime: Përhapja e duhanpirjes në Kosovë është e lartë në krahasim me shumë vende të tjera të Evropës Lindore. Nëse nuk merren masa të duhura, në dekadat në vijim vendi rrezikon të përballet me një barrë të rëndë të sëmundjeve të lidhura me përdorimin e duhanit. Prandaj, është thelbësore që t'i kushtohet vëmendje e veçantë ndërhyrjeve të mirëkoordinuara, si nga institucionet shtetërore ashtu edhe nga komuniteti. Këto ndërhyrje duhet të mbështeten në udhëzimet për kontrollin e duhanit të ratifikuara nga Konventa Kuadër e OBSH - së për Kontrollin e Duhanit (WHO FCTC), si dhe në masa të provuara që kanë treguar efektivitet në reduktimin e duhanpirjes dhe në uljen e sëmundjeve dhe vdekjeve që lidhen me të. Ky model tregon nevojën urgjente për strategji më efikase të parandalimit dhe ndihmës për lënien e duhanit, për të reduktuar rreziqet afatgjata për shëndetin që lidhen me përdorimin e duhanit.

Fjalë kyçe: Pirja e duhanit, faktorët demografikë, edukimi shëndetësor, Kosova, politikat e kontrollit të duhanit.

MOS NEGLIZHO FUNKSIONIN KOGNITIV NË KUJDESIN RENAL: SKRININGU I HERSHËM KOGNITIV NË CKD NDRYSHON ECURINË KLINIKE.

Vilma Cadri[1], Amantia Imeraj[1], Eralda Dervishi[1], Brikena Allkoja[2], Ariana Strakosha[1]
[1] Departamenti i Nefrologjisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri
[2] Shërbimi i Psikiatrisë, Qendra e Kujdesit Shëndetësor Nr. 1, Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt
Hyrje: Dëmtimi kognitiv (CI)—që prek vëmendjen, funksionin ekzekutiv dhe kujtesën—është i zakonshëm, por shpesh i nënvlerësuar në sëmundjen kronike të veshkave (CKD). Uremia, anemia, sëmundja cerebrovaskulare e eneve të vogla, polifarmacia (veçanërisht ngarkesa antikolinergjike), dhe çrregullimet e humorit janë kontribuues të shpeshtë dhe të modifikueshëm. Instrumente të shkurtëra si **Vlerësimi Kognitiv i Montrealit (MoCA)** mundësojnë zbulimin e hershëm dhe ndërhyrjen e synuar.
Raportim rasti: Një pacient mashkull 64 - vjeçar me CKD stad 4 (eGFR 24 mL / min / 1. 73 m²), hipertension dhe diabet mellitus tip 2 paraqitej me harresë progresive, ngadalësim të përpunimit mendor dhe përqendrim të dobët. Rezultati në MoCA ishte 20 / 30, duke treguar deficite ekzekutive dhe të vëmendjes. Analizat laboratorike treguan Hb 9. 8 g / dL, shënues uremikë të rritur, vitaminë B12 në kufijtë e poshtëm normalë, ferritin të ulët - mesatar, ndërsa TSH rezultoi normal. MRI e trurit demonstroi sëmundje të eneve të vogla. Rishikimi i medikamenteve zbuloi ngarkesë të lartë antikolinergjike dhe sedative. Skriningu për depresion rezultoi lehtësisht pozitiv. U realizua **depreskriptimi** i barnave antikolinergjike / sedative, u optimizua kontrolli i presionit të gjakut (<130 / 80 mmHg) dhe i glikemisë, u trajtua anemia (me hekur ± ESA sipas udhëzimeve) dhe u suplementua vitamina B12. Pacienti filloi **rehabilitim kognitiv të strukturuar** dhe edukim familjar për strategjitë kompensuese. Monitorimi me MoCA u planifikua çdo 3–6 muaj.
Rezultate: Pas 3 muajsh, rezultati në MoCA u përmirësua në 24 / 30, me më pak ankesa subjektive dhe funksionim më të mirë në aktivitetet e përditshme; nuk u shfaq delirium. Ndiqej në mënyrë të vazhdueshme nga një ekip multidisiplinar (nefrologji, neurologji, psikologji klinike).
Përfundime: Në CKD, rënia kognitive **nuk është e pashmangshme**. Skriningu i hershëm me MoCA dhe korrigjimi sistematik i faktorëve të modifikueshëm—si anemia, ngarkesa medikamentoze, faktorët hemodinamikë e metabolikë, mungesat ushqyese dhe çrregullimet e humorit—mund të përmirësojnë performancën kognitive dhe cilësinë e jetës. Skriningu kognitiv duhet të integrohet në kujdesin rutinë të pacientëve me CKD, me rivlerësim periodik dhe plan trajtimi të personalizuar.

Fjalë kyçe: sëmundje kronike e veshkave; dëmtim kognitiv; MoCA; anemia; sëmundje e eneve të vogla; depreskriptim; rehabilitim kognitiv.

RETINOPATIA E PREMATURITETIT NE SHQIPERI (ROP): PROGRAMI I PARE KOMBETAR I DEPISTIMIT.

Vilma Mema Assoc. Prof. [1], Eglantina Bulica Phd - C. [2], Alketa Tandili Assoc. Prof. [1], Ilir Arapi Assoc. Prof. [1], Spiro Dama Phd[3], Amarilda Hysenshahaj Msc[4]
[1]Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri
[2]Okuliste, Poliklinika e Specialiteteve, Nr. 1, Tiranë, Shqipëri
[3]Neonatolog, Spitali Obstetrik Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë", Tiranë, Shqipëri
[4]Staticiene, Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt
Hyrja: Retinopatia e prematuritetit (ROP) mbetet një nga shkaqet kryesore të verbërisë së parandalueshme në fëmijëri. Deri kohët e fundit, Shqipëria nuk kishte një program të strukturuar për depistim sistematik apo të dhëna kombëtare mbi incidencën e ROP.
Qëllimi: Të përshkruhet ngritja e programit të parë kombëtar të depistimit dhe menaxhimit të ROP në Shqipëri dhe të paraqiten gjetjet paraprake nga zbatimi fillestar i tij.
Metodologjia: U iniciua një program prospektiv në të gjitha njësitë e kujdesit intensiv neonatal (NICU) në Shqipëri. Foshnjat me moshë gestacionale ≤32 javë dhe / ose peshë në lindje ≤1500 g u përfshinë sipas udhëzimeve ndërkombëtare të depistimit. Ekzaminimet oftalmologjike u kryen me oftalmoskopi indirekte. U mblodhën të dhëna mbi parametrat demografikë, faktorët perinatalë të rrezikut, stadifikimin e ROP dhe nevojën për trajtim.
Rezultate: Gjatë vitit të parë të zbatimit, programi mundësoi depistimin kombëtar të foshnjave të parakohshme dhe krijimin e të dhënave të para epidemiologjike mbi ROP në Shqipëri. Rreth një e treta e foshnjave zhvilluan një shkallë caktuar të ROP, ndërsa një përqindje më e vogël përparoi në stade të avancuara që kërkonin ndërhyrje. U krijua një bazë të dhënash kombëtare që lejon monitorimin sistematik të incidencës, faktorëve të rrezikut dhe rezultateve terapeutike.
Përfundime: Nisja e programit të parë për ROP në Shqipëri përfaqëson një hap të rëndësishëm në përmirësimin e kujdesit neonatal dhe oftalmologjik. Gjetjet tregojnë një barrë të konsiderueshme të sëmundjes dhe theksojnë nevojën urgjente për depistim të standardizuar, trajtim në kohë dhe ndjekje afatgjatë. Kjo nismë ofron një model për përmirësimin e rezultateve në nivel lokal dhe kontribuon me të dhëna të vlefshme në përpjekjet ndërkombëtare për parandalimin e dëmtimeve vizuale të lidhura me ROP.

Fjalë kyçe: Neonatal, retinopatia e prematuritetit, program, depistim, bazë të dhënash.

OSTEOTOMIA SUPRACETABULARE CHIARI NË MOSHAT E REJA.

Vilson Ruçi, Edvin Selmani, Ledian Fezollari, Daniel Pina

Abstrakt
Osteotomia pelvike Chiari (OPC) ose osteotomia pelvike me zhvendosje mediale është një procedurë kirurgjikale për të krijuar një strehë kongruente acetabulare mbi artikulacionin kokso - femoral intakt, duke përdorur kockën spongioze iliake bashkë me interpozimin kapsular për të mbajtur kokën femorale dhe për të mbajtur peshën. OPC zakonisht konsiderohet si procedurë shpëtimi e indikuar në pacientët me acetabul displazik si pjesë e displazisë zhvillimore kokso - femorale. Kryhet gjerësisht për disa dekada, por që prej vitit 1990 numri i procedurave të OPC është ulur për shkak të përdorimit të osteotomive të tjera pelvike, protezave totale kokso - femorale dhe depistimit me ekografi, të cilat e kanë ngushtuar indikacionin për këtë procedurë. Megjithatë, OPC nuk është procedurë historike e të kaluarës, por ka indikacione të zbatueshme në kirurgjinë ortopedike moderne, veçanërisht në pacientët që preferojnë kirurgjinë me ruajtjen e artikulacionit ose në situata kur nuk është e mundur të kryhet proteza totale kokso - femorale. Për më tepër, ruajtja e artikulacionit kokso - femoral nativ sa më shumë të jetë e mundur është preferencë e ortopedisë moderne. Osteotomia Chiari mund të sjellë rezultate të shkëlqyera në pacientët me indikacione të duhura dhe kur procedurat e tjera nuk janë të mundura. Nga ana tjetër, ka disa disavantazhe të kësaj procedure si ngushtimi i baçinit, shkurtimi i anësisë dhe rreziku i paralizës së nervit shiatik. Në një analizë të thellë të literaturës, diskutojmë indikacionet e OPC, teknikën kirurgjikale, konvertimin në protezë totale kokso - femorale pas procedurës Chiari, intervalin nga OPC në protezë totale dhe mbijetesën e OPC.

Fjalë kyçe: osteotomi pelvike, procedurë ruajtëse e kyçit, procedurë shpëtuese, displazia zhvillimore kokso - femorale.

DIGJITALIZIMI I KUJDESIT PËR DIABETIN.

Viola Sopa
Doktor i Mjekësisë

Abstrakt
Hyrje: Diabeti mellitus tip 2 është sfidë globale e shëndetit publik, i karakterizuar nga nivele të larta të glukozës në gjak dhe komplikacione serioze shëndetësore. Përhapja në rritje e kësaj sëmundje kërkon metoda më efikase për menaxhimin dhe parandalimin e komplikacioneve.
Qëllimi: Qëllimi i punimit është të shqyrtojë ndikimin e digjitalizimit në kujdesin për diabetin, duke u fokusuar në teknologjinë moderne si sensorët për monitirimin e vazhdueshëm të glukozës, pompat intelegjente të insulinës dhe aplikacionet digjitale për vetëmenaxhim.
Metodologjia: Në këtë punim është përdorur një metodologji analitike që përfshin studimin e literaturës ndërkombëtare, përvojave praktike në vende të ndryshme, si dhe situatën aktuale në Shqipëri dhe Kosovë, duke vlerësuar përfitimet dhe sfidat e implementimit të këtyre teknologjive.
Rezultate: Analizat tregojnë se përdorimi i këtyre teknologjive përmirëson ndjeshëm menaxhimin e diabetit. Në Shqipëri dhe Kosovë, prevalenca diabetit arrin rreth 11. 1 - 11. 5% të të rriturve, megjithatë përdorimi i këtyre teknologjive mbetet i kufizuar për shkak të kostove dhe mungesës së edukimit. Studime ndërkombëtare tregojnë se deri në 80% e pacientëve me Diabet tip 1 që përdorin pompa të avancuara të insulinës kanë përmirësuar jetëgjatësinë dhe reduktuar komplikacionet. Megjithatë në Shqipëri dhe Kosovë, vetëm një pjesë e vogël e pacientëve kanë akses në këto paisje, duke theksuar nevojën për politika mbështetëse.
Përfundime: Për të shfytëzuar plotësisht potencialin e digjitalizimit në menaxhimin e diabetit, janë të nevojshme politika mbështetëse, trajnime për përdoruesit dhe integrimi i teknologjive në sistemet shëndetësore kombëtare. Bashkëpunimi ndërdisiplinor dhe angazhimi institucional janë kyç për një kujdes më efektiv dhe të personalizuar.

Fjalë kyçe: Diabet mellitus tip 2, digjitalizimi, monitorimi i vazhdueshëm i glukozës, menaxhimi i diabetit, teknologjia.

SARKOIDOZA KUTANE ATIPIKE, STUDIM RASTI.

Dr. Shk. Violeta Dajçi, Lorena Bixhaku[1], Erisa Alia[1],
Shërbimi i Dermatologjisë, QSUT
[1]Specializante QSUT

Abstrakt
Hyrje: Sarkoidoza është një sëmundje inflamatore kronike multisistemike me etiologji idiopatike që karakterizohet nga grumbullimi i limfociteve T, fagociteve mononukleare dhe formimit të granulomave jo - kazeoze në indet e prekura. Prekja pulmonare ose e nyjeve limfatike ndodh në rreth 90% të pacientëve me sarkoidozë, ndërsa rreth 50% e pacientëve kanë manifestime extrapulmonare në prezantim duke përfshirë dhe sarkoidozën kutane. Gjetjet kutane mund të jenë specifike, kur granulomat sarkoidale infiltrojnë lëkurën, ose jo specifike, kur lezionet paraqiten si proces inflamator pa granuloma tipike. Sarkoidoza kutane mund të jetë shenja e parë prezantuese ose mund te zhvillohet më vonë pergjatë dekursit të sëmundjes. Sarkoidoza kutane, ndryshe e njohur si imituese e sëmundjeve të tjera për shkak të polimorfizmit të saj, e bën kështu vendosjen e diagnozës një sfidë. Diagnoza bazohet në kombinimin e faktorëve të shumtë duke përfshirë të dhënat klinike, ekzaminimin fizik, të dhënat imazherike dhe gjetjet histopatologjike të granulomave jo - kazeoze. Menaxhimi efektiv i sarkoidozës mund të jetë sfidues përsa i përket vetë dekursit të sëmundjes dhe të efekteve anësore medikamentoze.
Raportim rasti: Pacientja Dh. R. , 58 vjeçe, paraqitet me ankesa të shfaqjes të lezioneve në fytyrë dhe, në masë më të vogël, në ekstremitete. Këto elemente patologjike janë vërejtur për herë të parë para një viti, të cilat nuk i

kanë provokuar shqetësime. Në ekzaminimin objektiv, vërehet një proces patologjik i lokalizuar kryesisht në regjionin facial dhe më pak në ekstremitete, i karakterizuar nga pllaka eritematoze atipike me kufij të qartë, disa me skuamë të lehtë dhe të tjera me shkëlqim në sipërfaqe. Pacientja u plotësua me ekzaminimet e nevojshme, nga ku biopsia kutane evidentoi praninë e granulomave jo - kazeoze, në përputhje me diagnozën e sarkoidozës kutane. Biopsia limfonodulare konfirmoi diagnozën e sarkoidozës.
Qëllimi: Të paraqitet një rast i sarkoidozës kutane me manifestime klinike tipike, për të theksuar rëndësinë e biopsisë si mjet konfirmues diagnostik dhe sfidat që paraqet kjo patologji në diferencim nga dermatozat e tjera granulomatoze.

Fjalë kyçe: Sarkoidozë kutane, granuloma jo - kazeoze, sëmundje granulomatoze, diagnozë histopatologjike, lezionet e lëkurës.

TUMORET NEUROENDOKRINE TË HIPOFIZËS QË SEKRETOJNË PROLAKTINË DHE MENAXHIMI I TYRE KLINIK NË KONTEKSTIN SHQIPTAR.

Violeta Hoxha, Seimir Laqja

Abstrakt
Hyrje: Tumoret neuroendokrine të hipofizës që sekretojnë prolaktinë (PRL - PitNETs), të njohura si prolaktinoma, përbëjnë llojin më të shpeshtë të adenomave funksionale të hipofizës, duke zënë rreth 30–60% të të gjitha tumoreve hipofizare. Ato burojnë nga qelizat laktotrope të hipofizës së përparme dhe variojnë nga mikroadenoma beninje deri te makroadenoma invazive. Rëndësia klinike lidhet me efektet e hiperprolaktinemisë (çrregullime menstruale, galaktorre, infertilitet, hipogonadizëm) dhe me efektet masive të tumorit (cefale, deficite vizuale për shkak të kompresionit të kiazmës optike). Prevalenca globale është rreth 50 raste për 100, 000 banorë, më e lartë tek gratë në moshë riprodhuese. Në Shqipëri, të dhënat klinike nga QSUT dhe qendrat universitare tregojnë një shpërndarje të ngjashme me vendet e Evropës Jugore. Mikroprolaktinomat janë më të shpeshta tek gratë, ndërsa makroprolaktinomat — më të mëdha dhe më agresive — prekin më shpesh meshkujt.
Metodologjia: Studimi është përshkrues - analitik dhe bazohet në të dhëna të literaturës ndërkombëtare (përfshirë studimin e Mele et al. , Frontiers in Endocrinology, 2025) dhe në përvojën klinike të qendrave shqiptare të endokrinologjisë dhe neurokirurgjisë. Janë analizuar praktikat diagnostike dhe terapeutike ekzistuese në raport me standardet evropiane. Diagnostikimi bazohet në matjen e prolaktinës në gjak esëll, përjashtimin e shkaqeve sekondare (medikamente, hipotiroidizëm) dhe kryerjen e rezonancës magnetike të hipofizës (MRI) me kontrast. Vështirësitë kryesore përfshijnë mungesën e aksesit të rregullt në MRI me rezolucion të lartë dhe mungesën e testimit për makroprolaktinemi në disa laboratorë rajonalë.
Rezultate: Terapia me agonistë të dopaminës (DA), veçanërisht kabergolinën, përbën trajtimin e vijës së parë për prolaktinomat në Shqipëri, me doza tipike 0. 5–1. 0 mg / javë. Studimi i Mele et al. (2025) vërteton se normalizimi i hershëm i prolaktinës është treguesi më i mirë i kontrollit hormonal afatgjatë, me 74% sukses brenda dy viteve. Përvoja shqiptare përputhet me këto gjetje, megjithëse mungojnë të dhëna të centralizuara. Sfida kryesore mbeten përkushtimi i pacientëve për shkak të kostos së barnave dhe mungesës së konsultave endokrinologjike jashtë Tiranës. MRI e ndjekjes zakonisht kryhet çdo 12–24 muaj, me vlerësim të madhësisë tumorale bazuar në diametër. Kirurgjia transsfenoidale mbetet opsion për rastet rezistente ose intolerante ndaj DA; këto ndërhyrje realizohen kryesisht në QSUT me përdorimin në rritje të teknikave endoskopike.
Përfundime: Menaxhimi klinik i prolaktinomave në Shqipëri është në përputhje me udhëzimet ndërkombëtare, por kërkon mbledhje sistematike të të dhënave, regjistër kombëtar endokrinologjik dhe protokolle të standardizuara ndjekjeje për të optimizuar rezultatet afatgjata. Prioritetet përfshijnë përmirësimin e aksesit në MRI, trajnimin e radiologëve për vlerësim volumetrik, ndjekjen hormonale çdo 3–6 muaj dhe sigurimin e programeve me kosto të ulët për terapinë me agonistë dopaminikë. Integrimi i provave ndërkombëtare, si ato të Mele et al. (2025), në udhëzimet vendore pritet të përmirësojë ndjeshëm prognozën e pacientëve me tumore prolaktinë - sekretuese në Shqipëri.

Fjalë kyçe: prolaktinoma, tumore neuroendokrine të hipofizës, hiperprolaktinemi, kabergolinë, agonistë të dopaminës, MRI, rezistencë ndaj DA, menaxhim klinik, Shqipëri.

INHIBITORËT E SGLT2 DHE AGONISTËT E RECEPTORËVE GLP - 1 NË SINDROMËN KARDIO - RENO - METABOLIKE: NJË RISHIKIM LITERATURE.

Violeta Hoxha, Seimir Laqja

Abstrakt

Hyrje: Sindroma kardio - renale - metabolike (CRMS) i referohet patofiziologjisë së ndërlidhur të Diabeti mellitus tip 2 (T2DM), sëmundjes kardiovaskulare (CVD), sëmundjes kronike të veshkave (CKD) dhe sëmundjes metabolike të mëlçisë me yndyrë (MAFLD), e njohur më parë si NAFLD. Këto gjendje ndajnë mekanizma të përbashkët si rezistenca ndaj insulinës, inflamacioni kronik, stres oksidativ dhe disfunksion endoteli, me pasoja të konsiderueshme për sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë globale.

Qëllimi: është shqyrtimi dhe sintetizimi i literaturës aktuale mbi rolin e inhibitorëve të kotransportuesit natrium - glukozë tip 2 (SGLT2) dhe agonistëve të receptorit të peptidit - 1 të tipit glukagon (GLP - 1) në menaxhimin e CRMS - së, me theks të veçantë në efektet e tyre mbi steatozën hepatike.

Metoda: Zbatim i një kërkimi gjithëpërfshirës në bazat e të dhënave PubMed, Scopus dhe Cochrane Library për studime të publikuara midis 2015 - 2025. Fjalë-kyçe përfshinin: cardio - renal - metabolic syndrome, SGLT2 inhibitors, GLP - 1 receptor agonists, hepatic steatosis, MAFLD, NAFLD. U përfshinë studime të rastësishme (RCT), studime observuese dhe meta - analiza relevante dhe u bë përmbledhje dhe sintetizim cilësor.

Rezultate: Të dy klasat terapeutike — SGLT2 - inhibitorët dhe GLP - 1 agonistët — demonstrojnë efekte të rëndësishme mbrojtëse kardiovaskulare dhe renale tek pacientët me T2DM dhe sindromë metabolike. Përveç efekteve të tyre glukozore dhe reduktimit të peshës trupore, evidenca në rritje sugjeron një ndikim të favorshëm edhe mbi steatozën hepatike. Agonistët e receptorit GLP - 1 kanë treguar reduktime të përmbajtjes së yndyrës në mëlçi, inflamacionit hepatik dhe shenjave të fibrozes. SGLT2 - inhibitorët gjithashtu shfaqin potencial në përmirësimin e parametrave të mëlçisë përmes humbjes së peshës, përmirësimit të ndjeshmërisë ndaj insulinës dhe reduktimit të adipozitetit visceral.

Konkluzion: SGLT2 - inhibitorët dhe agonistët e receptorit GLP - 1 përfaqësojnë një ndryshim paradigme në menaxhimin e CRMS - së. Efektet e tyre pleiotropike shtrihen përtej kontrollit të glukozës duke përfshirë përfitime kardiake, renale dhe hepatike. Përfshirja e këtyre agjentëve në strategjitë klinike mund të ofrojë një qasje gjithëpërfshirëse për trajtimin e barrës multifaktoriale të CRMS - së, përfshirë edhe steatozën hepatike. Nevojiten studime të mëtejshme afatgjata dhe head - to - head për të konfirmuar efikasitetin krahasues në MAFLD.

Fjalë kyçe: sindroma kardio - renale - metabolike, inhibitorë të SGLT2, agonistë të receptorit GLP - 1, steatozë hepatike, MAFLD, NAFLD, diabeti mellitus tip 2, sindroma metabolike, yndyra hepatike.

TEKNIKAT KIRURGJIKALE NË IMPLANTIMIN E GJIRIT. VENDOSJA SUBFACIALE VS SUBMUSKULARE E IMPLANTIT.

Virxhinia Çuka, Gentian Zikaj, Rezarta Kapaj, Alba Naska

Abstrakt

Hyrje: Zgjedhja e planit të vendosjes së implantit është një nga faktorët kryesorë që përcakton rezultatet estetike, funksionale dhe incidencën e komplikacioneve në augmentimin e gjirit. Ky punim synon të krahasojë rezultatet klinike dhe estetike të teknikave subfaciale dhe submuskulare të vendosjes së implantit, duke theksuar avantazhet, kufizimet dhe kriteret e përzgjedhjes së pacientit për secilën qasje. Janë vlerësuar parametrat si dhimbja post - operative, forma përfundimtare e gjirit, palpimi i implantit, incidenca e animacioneve muskulare, si dhe kënaqësia e përgjithshme e pacientëve.

Rezultate: Rezultatet tregojnë se vendosja submuskulare siguron mbulim më të mirë të implantit dhe redukton rrezikun e palpimit dhe riprezantimit të skajeve të implantit, por shoqërohet me dhimbje më të madhe post - operative dhe rrezik të animacionit të muskujve. Nga ana tjetër, teknika subfaciale ofron rikuperim më të shpejtë, dhimbje më të ulët dhe ruajtje më natyrale të lëvizjes, por kërkon përzgjedhje të kujdesshme të pacienteve me ind adekuat të gjirit.

Përfundime: Të dy teknikat kanë avantazhet dhe kufizimet e tyre. Zgjedhja optimale duhet të individualizohet bazuar në morfologjinë e gjoksit, trashësinë e indeve, stilin e jetesës dhe pritshmëritë estetike të pacientes. Kombinimi i vlerësimit klinik me eksperiencën kirurgjikale mbetet çelësi për rezultate të qëndrueshme dhe harmonike.

Fjalë kyçe: Implantim gjiri, subfacial, submuskular, teknika kirurgjikale, rezultate estetike.

METASTAZAT NË TRU: EPIDEMIOLOGJIA, MODALITETET E TRAJTIMIT DHE REZULTATET NË KLINIKËN E NEUROKIRURGJISË TË QKUK (2015 - 2019).

Dr Visar Zhubi
Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës
Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Klinika e Neurokirurgjisë

Abstrakt
Hyrje: Metastazat në tru përbëjnë një sfidë të rëndësishme në onkologji, duke ndikuar ndjeshëm në mbijetesën dhe cilësinë e jetës së pacientëve. Kompleksiteti i trajtimit dhe përparimet e
vazhdueshme në teknologjitë diagnostike dhe terapeutike theksojnë nevojën për studime të vazhdueshme në këtë fushë.
Qëllimi: Ky studim synon të analizojë incidencën dhe menaxhimin e metastazave në tru në Klinikën e Neurokirurgjisë, QKUK, gjatë periudhës 2015 - 2019. Krahas paraqitjes së të dhënave epidemiologjike, studimi ofron një krahasim me të dhënat e qendrave neurokirurgjike në vende të tjera dhe eksploron modalitetet alternative të trajtimit përtej kirurgjisë.
Metodologjia: Ky është një studim retrospektiv i bazuar në të dhënat klinike të pacientëve me metastaza në tru të trajtuar në QKUK. Të dhënat u mblodhën nga protokollet klinike për periudhën 2015 - 2019, pas aprovimit etik dhe nën mbikëqyrjen e stafit përgjegjës. Analiza statistikore u krye duke përdorur programin SPSS dhe rezultatet u vizualizuan me tabela dhe grafikë.
Rezultate: Studimi identifikoi se metastazat më të zakonshme në tru vinin nga kanceri pulmonar (33. 2%), i gjirit (22. 2%) dhe melanoma malinje (19. 4%). Shpërndarja gjinore ishte pothuajse e barabartë, me 44. 4% femra dhe 55. 6% meshkuj. Grupmosha më e prekur ishte 41 - 64 vjeç (47. 2%), e ndjekur nga pacientët mbi 65 vjeç (41. 6%), duke sugjeruar një rritje të incidencës me moshën.
Konkluzione: Përparimet teknologjike dhe qasjet multidisiplinare po ofrojnë mundësi të reja në menaxhimin e metastazave në tru. Diagnostikimi i hershëm dhe trajtimet e personalizuara mund të përmirësojnë ndjeshëm prognozën e pacientëve. Studime të mëtejshme janë të nevojshme për të adresuar sfidat aktuale dhe për të optimizuar modalitetet terapeutike.

Fjalë kyçe: metastaza në tru, trajtim multidisiplinar, radioterapi, kimioterapi, neurokirurgji.

NJË EPIDEMI E FSHEHUR: DEPRESIONI POST - COVID NË PRAKTIKËN KLINIKE.

Vjollca Ibrahimi

Abstrakt
Hyrje: Pandemia COVID - 19 ka lënë pas jo vetëm pasoja fizike, por edhe ndikime të rëndësishme në shëndetin mendor. Ndër to, depresioni post - COVID është shfaqur si një epidemi e fshehur, shpesh e nënvlerësuar në praktikën e përditshme klinike.
Objektiva: Të theksohet prevalenca, faktorët e rrezikut dhe rëndësia klinike e depresionit post - COVID në mjeksinë familjare, ku zbulimi i hershëm dhe kujdesi i vazhdueshëm janë thelbësorë.
Metodologjia: U krye një rishikim narrativ i studimeve të fundit dhe përvojave klinike, me fokus tek pacientët në kujdesin parësor që zhvilluan simptoma depresive pas rikuperimit nga COVID - 19.
Rezultate: Depresioni post - COVID lidhet me izolimin e zgjatur, inflamacionin, lodhjen kronike dhe stresorët socialë. Mjekët familjarë kanë një rol unik për të identifikuar këto simptoma herët përmes ndjekjes së rregullt, instrumenteve të skriningut dhe komunikimit empatik.

Fjalë kyçe: pandemi, pasoja fizike, COVID - 19, depression, inflamacion.

MBIPESHA DHE OBEZITETI TEK ADOLESHENTËT E RINJ DHE MARRËDHËNIA ME ZAKONET E TË USHQYERIT DHE AKTIVITETIN FIZIK TË TYRE.

Vjollca Shpata[1], Xhensila Frashëri - Prendushi[2], Klejda Tani[1], Alma Nurçe[2], Manika Kreka[3], Alma Soxhuku - Isufi[3], Ariana Hajro[1]
[1]Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit, Universiteti i Sporteve të Tiranës
[2]Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
[3]Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Obeziteti është një sëmundje kronike, multifaktoriale, e cila rezulton nga ndërveprimi i faktorëve mjedisorë obezogjenë, psikosocialë dhe gjenetikë. Ai karakterizohet nga akumulim i tepruar i indit dhjamor, duke rritur ndjeshëm rrezikun për komplikacione dhe sëmundje shoqëruese. Gjatë dekadave të fundit, prevalenca globale e obezitetit tek fëmijët dhe adoleshentët 5–19 vjeç është rritur në mënyrë eksponenciale, duke u katërfishuar nga 2% në 8%, dhe kjo tendencë vijon të shfaqet edhe në moshën e rritur.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë prevalencën e mbipeshës dhe obezitetit tek fëmijët dhe adoleshentët 10–15 vjeç në zonat urbane të Tiranës, si dhe të analizojë lidhjen e tyre me zakonet e të ushqyerit dhe nivelin e aktivitetit fizik.

Matedologjia: U realizua një studim kros - seksional me përfshirjen e nxënësve të moshës 10–15 vjeç, që frekuentonin nëntë shkolla publike në Tiranë. Klasifikimi antropometrik u krye sipas indeksit të masës trupore (BMI) për moshë dhe gjini, bazuar në kurbat e rritjes të OBSH - së për grupmoshën 5–19 vjeç: mbipeshë (percentilet 85–95), obezitet (≥ percentile 95) dhe obezitet i rëndë (≥120% e percentilit 95 ose ≥35 kg / m²).

Rezultate: Ndërmjet 2020 pjesëmarrësve (48. 9% vajza), prevalenca e obezitetit rezultoi 16. 1%, ndërsa e mbipeshës 20. 9%. Shkalla më e lartë e obezitetit u evidentua në grupmoshën 11 vjeç (18. 70%), e ndjekur nga grupmoshat 10 (18. 35%) dhe 12 vjeç (18. 21%), ndërsa ajo më e ulët u regjistrua tek grupmoshat 14–15 vjeç (7. 85%). Krahasuar me bashkëmoshatarët me peshë normale, nxënësit mbipeshë dhe obez raportuan konsum më të rrallë të mëngjesit dhe më pak se tre porcione frutash / perimesh në ditë. Për më tepër, këta individë shfaqën konsum më të lartë të pijeve të ëmbëlsuara dhe pjesëmarrje të reduktuar në sport dhe aktivitete fizike.

Përfundime: Prevalenca e mbipeshës dhe obezitetit tek nxënësit 10–15 vjeç në zonat urbane të Tiranës arrin në 37%. Adoleshentët mbipeshë dhe obezë karakterizohen nga një stil jetese obezogjen, i cili kontribuon në përkeqësimin e statusit të tyre shëndetësor. Nevojitet zbatimi i masave urgjente për nxitjen e sjelljeve të shëndetshme përmes një diete të ekuilibruar, aktivitetit fizik të rregullt dhe ndërhyrjeve mjedisore që i mbështetësin këto zakone për uljen e barrës së obezitetit në këtë grupmoshë.

Fjalë kyçe: obezitet, mbipeshë, adoleshentë, stil jetese, zakone ushqimore, aktivitet fizik.

BRAZILIAN BUTT LIFT SI METODË BASHKËKOHORE E RIMODELIMIT TRUPOR: BALANCA MIDIS ESTETIKËS DHE SIGURISË KIRURGJIKALE.

Prof. Assoc. Vladimir Filaj[1]; Dr. Ester Tabaku [2]
[1]Shërbimi i Djegie - Plastikës, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë
[2]Klinika Estetike Champ Élysée.

Abstrakt

Hyrje: Brazilian Butt Lift (BBL) është një procedurë kirurgjikale estetike që kombinon liposuksionin dhe lipotransferimin, duke përdorur dhjamin e vetëpacientit për të riformuar dhe përmirësuar përmasat e gluteve. Kjo teknikë bazohet në konceptin e transferimit të dhjamit autolog, ku dhjami i marrë nga zona donatore (si barku, ijet, apo pjesa e brendshme e kofshëve) përpunohet dhe injektohet mbi muskulin gluteal. Ky studim analizon gjithashtu procesin e vlerësimit para ndërhyrjes, kriteret për përzgjedhjen e pacienteve, faktorët që ndikojnë në vendimmarrje, komunikimin e rreziqeve dhe përfitimeve, si dhe komplikimet e mundshme të hasura gjatë dhe pas procedurës.

Metodologjia: Nëpërmjet këtij studimi synojmë të analizojmë ndikimin e përgjithshëm të procedurës Brazilian Butt Lift (BBL) në Klinikën Champ Élysée gjatë periudhës shtator 2021 – gusht 2025, duke nxjerrë në pah

përfitimet estetike, funksionale dhe psikologjike të saj, si dhe raportin rrezik–përfitim. Ky është një studim retrospektiv që përfshin gjithsej 153 paciente femra, me moshë nga 25 deri në 56 vjeç, të cilat iu nënshtruan procedurës BBL gjatë kësaj periudhe.
Dhjami u mor kryesisht nga zona e barkut (në 67% të rasteve), ndërsa në rastet e tjera nga pjesa e brendshme ose e jashtme e kofshëve, në varësi të morfologjisë trupore dhe nevojës për volum në glute. Pas aspirimit me liposuksion, yndyra u përpunua dhe më pas u injektua mbi muskulin gluteal (plan suprafascial) dhe pjesërisht në shtresën subkutane, për të arritur shpërndarje të njëtrajtshme dhe rezultat natyral. Sasia e injektuar për secilën anë varionte nga 70 cc deri në 500 cc, në varësi të strukturës trupore dhe objektivit estetik të pacientit.
Rezultate: Gjatë periudhës së studimit u analizuan 153 raste të pacienteve femra të moshës 25–56 vjeç që iu nënshtruan procedurës së BBL. Rezultatet treguan një nivel të lartë kënaqësie për sa i përket përmirësimit të formës trupore dhe harmonisë së përmasave, me rikuperim mesatar prej 3–4 javësh. Komplikimet e lehta (si seroma, asimetri e vogël apo ënjtje e zgjatur) u evidentuan në rreth 6% të rasteve, ndërsa nuk u shënuan emboli dhjamore apo komplikime të rënda sistemike. Kjo u arrit falë respektimit strikt të protokolleve të sigurisë, përfshirë: injektimin vetëm në planin suprafacial dhe subkutan, duke shmangur plotësisht vendosjen intramuskulare të dhjamit; përdorimin e kanjulave të mëdha me majë të rrumbullakët, për të minimizuar rrezikun e dëmtimeve vaskulare; teknikën e injektimit retrograd me lëvizje të vazhdueshme, që shmang grumbullimin e yndyrës dhe depërtimin në enë gjaku; monitorimin intraoperativ të presionit dhe sasisë së injektuar për çdo anë.
Përfundime: Brazilian Butt Lift (BBL) përfaqëson një procedurë efektive dhe të sigurt për rimodelimin trupor, kur respektohen kriteret e përzgjedhjes së pacienteve dhe udhëzimet teknike të sigurisë. Në përfundim, BBL jo vetëm përmirëson estetikën trupore, por edhe ndikon pozitivisht në vetëvlerësimin dhe mirëqenien psikologjike të pacienteve, duke e bërë atë një ndërhyrje me rrezik minimal dhe përfitim të lartë, kur kryhet në kushte të kontrolluara dhe me respektim të standardeve të praktikës kirurgjikale.

Fjalë kyçe: BBL, Brazilian Butt Lift, lipotransfer, dhjam autolog, rimodelim gluteal, injektim suprafascial, liposuksion, siguri kirurgjikale, emboli dhjamore, vetëvlerësim, kontur trupor, rezultate estetike.

IDENTIFIKIMI DHE MENAXHIMI I EMERGJENCAVE KARDIAKE: NJË UDHËZUES I AVANCUAR PËR MJEKËT E RINJ DHE PRAKTIKANTËT KLINIKË.

Dr. Vlera Haxhishabani[1], Dr. Luan Pazhari[2]
[1]*QKMF Gjakovë*
[2]*Spitali Rajonal Isa Grezda Gjakovë, Reparti i Njësisë Koronare*

Abstrakt
Hyrje: Emergencat kardiake, duke përfshirë iskeminë akute dhe arrestin kardiak, përbëjnë situata të kërcënuara për jetën që kërkojnë reagim të menjëhershëm dhe vendimmarrje të saktë. Për mjekët e rinj dhe praktikantët klinikë, njohja e shenjave klinike dhe diferencimi i saktë midis këtyre gjendjeve janë vendimtarë për diagnostikim efektiv dhe trajtim adekuat.
Qëllimi: Ky prezantim synon të ofrojë një udhëzues të avancuar mbi identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e urgjencave kardiake, duke theksuar instrumentet diagnostike dhe algoritmet klinike që ndihmojnë mjekët e rinj dhe praktikantët klinikë në praktikën emergjente.
Metodologjia: Bazuar në udhëzimet aktuale (ESC, AHA, ACC, 2015–2025) dhe studime klinike, analizohen protokollet për vlerësimin e dhimbjes së gjoksit, përdorimin e EKG - së, biomarkerëve kardiakë, imazherisë urgjente dhe skoringut të rrezikut. Fokus është mbi aplikimin praktik të këtyre mjeteve në ambientet emergjente për profesionistët në fillim të karrierës.
Rezultate: Dhimbja e gjoksit me karakter të papritur, shtrirje në qafë, nofull, shpatull ose krah të majtë, e shoqëruar me djersitje, nauze dhe dispne, është tregues i iskemisë akute. Arresti kardiak shfaqet me humbje të menjëhershme të vetëdijes, mungesë pulsi dhe ndalim të frymëmarrjes, duke kërkuar ndërhyrje urgjente CPR dhe defibrilim. Algoritmet klinike dhe protokollet e standardizuara ndihmojnë në vendimmarrjen e shpejtë dhe të sigurt.
Diskutime: Edukimi praktik mbi shenjat alarmuese, simulimet klinike dhe përdorimi i protokolleve standarde rrisin sigurinë dhe reduktojnë kohën e reagimit, duke optimizuar shpëtimin e jetës.
Përfundime: Identifikimi dhe menaxhimi i emergjencave kardiake kërkon njohuri të specializuara, vlerësim klinik të shpejtë dhe përdorim të protokolleve të bazuara në evidencë, duke fuqizuar mjekët e rinj dhe praktikantët klinikë për vendimmarrje efektive dhe shpëtim të pacientëve.

Fjalë kyçe: Emergjencë kardiake, ishemia kardiake, arrest kardiak, EKG, biomarkera, CPR, protokolle klinike, mjekë të rinj, praktikantë klinikë.

PNEUMONITË BAKTERIALE TE FËMIJËT: SFIDAT DIAGNOSTIKE, MENAXHIMI TERAPEUTIK DHE STRATEGJITË PARANDALUESE NË EPOKËN E REZISTENCËS ANTIMIKROBIKE.

Vlerë Jashari
Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, Kosovë

Abstrakt
Hyrje: Pneumonia bakteriale mbetet një nga shkaqet kryesore të morbiditetit dhe mortalitetit te fëmijët nën pesë vjeç në nivel global, pavarësisht përparimeve të rëndësishme në mjekësi. Menaxhimi efektiv i saj komplikohet nga vështirësitë në diferencimin nga pneumonia virale, rritja alarmante e rezistencës antimikrobike dhe variacionet në qasjet terapeutike. Ky punim argumenton se një strategji e integruar, e cila kombinon diagnozën e saktë dhe të hershme, përdorimin racional të antibiotikëve dhe zbatimin rigoroz të programeve të vaksinimit, është thelbësore për të përmirësuar rezultatet klinike dhe për të frenuar përhapjen e rezistencës.
Metodologjia: Ky punim bazohet në një rishikim gjithëpërfshirës të literaturës shkencore aktuale, duke përfshirë udhëzues klinikë nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) dhe akademitë pediatrike ndërkombëtare, studime klinike të rastësishme, meta - analiza dhe artikuj kërkimorë të publikuar në revista të njohura mjekësore gjatë dekadës së fundit. Gjetjet Kryesore: Analiza thekson se mbështetja vetëm në shenjat klinike është e pamjaftueshme për një diagnozë etiologjike të saktë. Përdorimi i biomarkerëve si proteina C - reaktive (CRP) dhe prokalcitonina (PCT), së bashku me vlerësimin klinik, mund të përmirësojë vendimmarrjen. Terapia empirike me amoksicilinë mbetet zgjedhja e parë për rastet e pakomplikuara, por rritja e rezistencës, veçanërisht nga Streptococcus pneumoniae, kërkon një mbikëqyrje të vazhdueshme epidemiologjike. Më tej, theksohet roli transformues i vaksinave të konjuguara pneumokoksike (PCV) dhe Haemophilus influenzae tipi b (Hib) si ndërhyrjet më kosto - efektive parandaluese.
Konkluzione: Menaxhimi i suksesshëm i pneumonisë bakteriale te fëmijët nuk është më vetëm një çështje e përshkrimit të antibiotikut të duhur. Ai kërkon një qasje holistike që fillon me parandalimin përmes vaksinimit, vazhdon me një proces diagnostik të sofistikuar për të shmangur përdorimin e panevojshëm të antibiotikëve dhe kulmon me një terapi të udhëhequr nga parimet e administrimit antimikrobik (antibiotic stewardship). Investimi në këto tre shtylla është investimi më i sigurt për shëndetin e brezit të ardhshëm.

Fjalë kyçe: Pneumoni pediatrike, pneumoni bakteriale, rezistencë antimikrobike, diagnozë, vaksinim, streptococcus pneumoniae, menaxhim klinik.

KUR ALGORITMET SHOHIN MË THELLË SE SYRI I NJERIUT: INTELIGJENCA ARTIFICIALE NË ZBULIMIN E HERSHËM TË KANCERIT TË GJIRIT.

Ass. Dr. Vloriana Arifaj Shala

Abstrakt
Hyrje: Kanceri i gjirit mbetet një nga shkaqet kryesore të mortalitetit tek gratë në mbarë botën. Diagnostikimi i hershëm dhe vlerësimi i saktë i rrezikut janë elemente thelbësore për përmirësimin e mbijetesës dhe efikasitetit të trajtimit. Zhvillimet e fundit në inteligjencën artificiale (IA) kanë hapur mundësi të reja për analizimin e imazheve dhe të dhënave klinike, duke mundësuar parashikime më të sakta dhe më të personalizuara të rrezikut për zhvillimin e kancerit të gjirit.
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë performancën e modeleve të inteligjencës artificiale në parashikimin e rrezikut për zhvillimin e kancerit të gjirit dhe ta krahasojë atë me metodat tradicionale të vlerësimit, si modeli Gail, faktorët klinikë dhe imazheria standarde.
Materiale dhe metoda: Ky është një studim retrospektiv që përfshin të dhëna nga paciente të cilat kanë kryer mamografi, ultratinguj dhe / ose biopsi gjiri në dy spitale kryesore të Kosovës. Të dhënat do të përfshijnë karakteristika demografike, histori familjare, densitet të gjirit, shenja radiologjike dhe biomarkues përkatës. Do

të zhvillohet dhe testohet një model i IA duke përdorur rrjete neurale konvolucionale dhe metodologjinë e *transfer learning*. Performanca e modelit do të vlerësohet përmes treguesve si saktësia, ndjeshmëria, specifikësia dhe AUC e kurbës ROC, duke u krahasuar me interpretimin radiologjik dhe vlerësimet klinike të rrezikut.
Rezultate: Parashikohet që modeli i IA të tejkalojë metodat tradicionale në identifikimin e pacienteve me rrezik të lartë përpara shfaqjes së simptomave, të reduktojë gabimet *false negative* dhe të kontribuojë në diagnostikimin më të hershëm të sëmundjes.
Përfundime: Integrimi i inteligjencës artificiale në procesin diagnostik mund të përmirësojë identifikimin e hershëm të kancerit të gjirit, të optimizojë përdorimin e burimeve spitalore dhe të mundësojë personalizimin e skemave të monitorimit për gratë me rrezik të lartë. Megjithatë, kërkohen studime prospektive dhe validime të mëtejshme lokale për të konfirmuar efikasitetin dhe zbatueshmërinë klinike të këtij modeli.

Fjalë kyçe: Kancer gjiri, inteligjencë artificiale, paciente.

TË DHËNAT KLINIKO - IMAZHERIKE TË FISTULAVE KAROTIDO - KAVERNOZE: RISHIKIM LITERATURE DHE PARAQITJE E RASTEVE.

Vojsava Leka[1], Oneda Cibuku[2], Eris Ranxha[2], Arben Rroji[2], Eugen Enesi[2], Mentor Petrela[1]
[1]Spitali Amerikan, Tiranë, Shqipëri
[2]Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Hyrje: Fistulat karotido - kavernoze (FKK) paraqesin komunikime arteriovenoze jonormale midis sistemit karotid dhe sinusit kavernoz. Ato mund të shfaqen spontanisht, më shpesh si pasojë e këputjes së një aneurizme në segmentin kavernoz të arteries karotide të brendshme, ose të ndodhin pas traume kraniofaciale apo ndërhyrjes iatrogjene. Spektri klinik dhe imazherik është shumë i ndryshueshëm, në varësi të shpejtësisë së fluksit, modelit të drenazhit venoz dhe etiologjisë.
Qëllimi: Të rishikohet literatura bashkëkohore dhe të ilustrohen karakteristikat kryesore klinike dhe radiologjike të fistulave karotido - kavernoze përmes paraqitjes së rasteve përfaqësuese, duke theksuar qasjet diagnostike dhe strategjitë terapeutike.
Metodologjia: U krye një rishikim literature në bazat e të dhënave PubMed dhe ato kryesore neurokirurgjikale e neuroradiologjike, duke u fokusuar në raportet dhe seritë e rasteve të publikuara gjatë dekadës së fundit. U analizuan të dhënat mbi paraqitjen klinike, modalitetet e imazherisë, gjetjet angiografike, klasifikimin (direkte kundrejt indirekte) dhe rezultatet pas trajtimit endovaskular apo kirurgjikal. U përfshinë gjithashtu raste ilustruese nga përvoja institucionale jonë.
Rezultate: Manifestimet tipike klinike përfshijnë ekzoftalmi pulsatile, kemozë, zhurmë orbitale, diplopi dhe paraliza të nervave kranialë si pasojë e hipertensionit venoz në sinusin kavernoz. Angiografia me subtraksion digjital (DSA) mbetet standardi i artë diagnostik, duke ofruar klasifikim të saktë dhe planifikim të trajtimit. MRI / MRA dhe CT / CTA ndihmojnë në zbulimin joinvaziv, shpesh duke treguar zgjerim të venës oftalmike superiore dhe rritje asimetrike të kontrastit në sinusin kavernoz. Embolizimi endovaskular me koile ose agjentë të lëngshëm përbën trajtimin e zgjedhur, me normë të lartë mbylljeje dhe morbiditet të ulët. Mbyllja spontane mund të ndodhë në fistulat indirekte me fluks të ulët.
Përfundime: Fistulat karotido - kavernoze paraqesin një sfidë diagnostike për shkak të spektrit të gjerë kliniko - imazherik. Imazheria multimodale është thelbësore për klasifikimin dhe planifikimin e trajtimit. Terapia endovaskulare mbetet gur themeli i menaxhimit, me rezultate anatomike dhe funksionale shumë të mira kur realizohet në kohë.

Fjalë kyçe: Fistulë karotido - kavernoze, sinus kavernoz, trajtim endovaskular, angiografi me subtraksion digjital, oftalmoplegji, kemozë, raportim rasti, rishikim literature.

APLIKIMI I TEKNIKËS LAPAROSKOPIKE NË SHËRBIMIN E UROLOGJISË NË QSU "NËNË TEREZA".

Dr. Sh. M. Xh. Keshi, Dr. Sh. M. B. Hoxha, Ass. Prof. H. Gani, Dr. F. Bedalli, Dr. Z. Hyseni, A. Keshi

Abstrakt

Qëllimi: Vlerësimi i efektivitetit të teknikës laparoskopike në trajtimin e të sëmurëve urologjikë në shërbimin tonë dhe krahasimi i përfitimeve të pacientëve në raport me trajtimin tradicional me kirurgji të hapur.

Metodologjia: U analizuan të dhënat e të sëmurëve të operuar me teknikën laparoskopike gjatë periudhës janar–shtator 2025, në mënyrë konsekutive. Koha operatore u përllogarit nga momenti i prerjes së lëkurës deri në përfundim të qepjes së plagës operatore. Nuk u bë përjashtim selektiv rastesh. Të dhënat u analizuan në mënyrë statistikore. Operacionet u realizuan nga i njëjti ekip kirurgjikal.

Rezultate: Gjatë periudhës janar–shtator 2025 u trajtuan me laparoskopi 33 pacientë. Nga këta, 20 me diagnozë *tumorë renale*, 3 me *tumorë të gjendrës mbiveshkore,* 4 me patologji të *SPU* dhe 5 raste me *pielonefrit* ose *kalkulozë renale.* Mosha mesatare ishte 53. 6 vjeç. Koha mesatare operatore ishte 140 minuta (nga lëkura në lëkurë). Qëndrimi mesatar spitalor ishte 5. 6 ditë. Sasia e hemorragjisë intraoperatore varionte nga 0 ml (kur nuk është përdorur aspiratori) deri në 100 ml.

Konkluzione: Teknika laparoskopike në trajtimin e të sëmurëve në Shërbimin e Urologjisë tashmë është drejt konsolidimit, me shtrirje në diagnoza të ndryshme. Dekursi postoperator i pacientëve është shumë i kënaqshëm dhe rehabilitimi i tyre është i shpejtë dhe efikas.

Rekomandime: Përmirësimi i teknologjisë do të favorizonte një shtrirje më të gjerë të metodës dhe një efikasitet më të lartë në trajtimet kirurgjikale urologjike.

Fjalë kyçe: urologji, kirurgji e hapur, teknologji, dekurs postoperator.

LIDHJA MIDIS NIVELE TË VITAMINËS D NË SERUM DHE TREGUESVE TË FUNKSIONIT IMUNITAR: KORRELACIONI ME PCR, LIMFOCITET DHE INFEKSIONET.

Xhensila Beqari, Shqiponja Simitçiu, Grejsi Çekrezi

MsC, Teknik Laboratori, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Vitamina D nuk ka vetëm funksion në ruajtjen e ekuilibrit të kalciumit, por vepron edhe si një hormon i fuqishëm imunomodulues. Mungesa e saj është lidhur me rritjen e rrezikut për infeksione, sëmundje autoimune dhe çrregullime të përgjigjes imunitare. Megjithatë, lidhja midis niveleve të vitaminës D në serum dhe treguesve inflamator të sistemit imunitar tek popullata e përgjithshme mbeten ende te paqarta.

Qëllimi: Të vlerësohet lidhja midis niveleve të 25 - hidroksi - vitaminës D në serum dhe treguesve të funksionit imunitar, duke përfshirë PCR - në, leukocitet, sidomos përqindjen e limfociteve dhe historinë e fundit të infeksioneve tek te rriturit.

Metodologjia: U krye një studim i tipit përshkrues (cross - sectional) me 150 të rritur të moshës 18–75 vjeç, të cilët i ishin nënshtruar analizave rutinë laboratorike. Nivelet e 25 - hidroksi - vitaminës D, proteinës C - reaktive (PCR) dhe numrit total të qelizave të bardha të gjakut (WBC) u analizuan duke përdorur sisteme automatike kimilumineshente dhe hematologjike. Pjesëmarrësit u ndanë në 3 grupe: me mungesë të vitaminës D (<20 ng / mL), pamjaftueshmëri (20–30 ng / mL) dhe mjaftueshmëri (>30 ng / mL). Analizat statistikore u kryen duke përdorur ANOVA dhe korrelacionin e Pearson - it, $p < 0.05$ u konsiderua me domethënie signifikante.

Rezultate: Nga 150 pjesëmarrës, 33% kishin mungesë të vitaminës D, 40% kishin nivel të pamjaftueshëm, dhe 27% kishin nivel të mjaftueshëm. Personat me mungesë të vitaminës D kishin në mënyrë domethënëse nivele më të larta të proteinës C - reaktive (PCR) dhe numër më të ulët limfocitesh në krahasim me individët me nivele të mjaftueshme të vitaminës D ($p < 0.01$). Historia e infeksioneve ishte më e zakonshme te personat me mungesë të vitaminës D (68%) krahasuar me personat qe kishin nivel të mjaftueshëm (22%) ($p < 0.001$). U vu re një korrelacion negativ mes vitaminës D dhe PCR - së ($r = –0.44$, $p < 0.01$), si dhe një korrelacion pozitiv midis vitaminës D dhe përqindjes së limfociteve ($r = 0.31$, $p < 0.05$).

Përfundime: Nivelet e ulëta të vitaminës D janë të lidhura ngushtë me rritjen e inflamacionit dhe uljen e aktivitetit të leukociteve, duke çuar në një ndjeshmëri më të lartë ndaj infeksioneve. Mbajtja e përqendrimeve serike të 25(OH)D mbi 30 ng / mL mund të ndihmojë në ruajtjen e qëndrueshmërisë optimale imunitare dhe në uljen e rrezikut për infeksion.

Fjalë kyçe: Vitamina D, imuniteti, PCR, limfocite, infeksion.

EFEKTET E HEMATOMËS SUBKORIONIKE NË ECURINË E SHTATZËNISË TEK PACIENTET ME ABORT INCIPIENT.

Xhensila Omeri[1], Roland Lama [2], Gerta Semini [3]
[1]*Gjinekologe, Klinika gjinekologjike Lindi*
[2]*Gjinekolog, SUOGJ Materniteti "Mbretëresha Geraldinë"*
[3]*Gjinekologe, Klinika Alushani.*

Abstrakt
Hyrje: Hematoma subkorionike (SCH) është patologjia më e shpeshtë e detektueshme ekografikisht tek gratë me abort incipient. Hematoma subkorionike është një gjendje patologjike specifike, që ndodh zakonisht në tremujorin e parë të shtatzënisë dhe zhvillohet si rezultat i shkëputjes së pjesshme të membranës korionike nga decidua, duke u manifestuar si hemorragji dhe grumbullim gjaku (hematomë) në hapësirën retrokoriale. Efektet e hematomës dhe impakti klinik në ecurinë e shtatzënisë janë ende të diskutueshme dhe të paqarta.
Objektiva: Qëllimi i studimit është të vlerësojë efektet dhe impaktin klinik të hematomës subkorionike në ecurinë e shtatzënisë tek pacientet me hemorragji vaginale gjatë 20 javëve të para të shtatzënisë.
Materiali dhe metoda: Ky është një studim retrospektiv kohort, që përfshin pacientet e shtruara në pavionin e Patologjisë së Barrës në maternitetin SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë", gjatë periudhës janar 2018 – dhjetor 2019, me diagnozën *abort incipient.* Grupi i studimit përbëhet nga 103 paciente me hematomë subkorionike, të evidentuar në ekzaminimin ekografik, ndërsa grupi i kontrollit përbëhet nga 214 paciente pa hematomë. Ecuria e shtatzënisë është krahasuar midis grupit të kontrollit dhe grupit studimor.
Rezultate: Nuk u vunë re ndryshime statistikisht të rëndësishme midis dy grupeve në lidhje me parametrat demografikë, përfshirë moshën, paritetin, numrin e aborteve të mëparshme, moshën gestacionale në episodin e parë të hemorragjisë dhe statusin pas lindjes me prerje cezariane. 12. 6% e pacienteve me hematomë përfunduan në abort spontan të shtatzënisë, kundrejt 7. 4% të pacienteve pa hematomë (p = 0. 010). Mosha gestacionale në momentin e abortit dhe koha e kaluar nga episodi i parë i hemorragjisë deri në abortimin e shtatzënisë ishin të ngjashme midis dy grupeve. Rezultatet e shtatzënisë tek pacientet shtatzënia e të cilave vazhdoi deri në lindje – si mosha gestacionale në lindje, lindjet e parakohshme, PPROM, pesha e foshnjës, mënyra e lindjes, IUGR, preeklampsia, HISH, shkëputja manuale e placentës dhe distako placenta – ishin gjithashtu të ngjashme midis dy grupeve.
Konkluzione: Hematoma subkorionike e zbuluar ekografikisht rrit rrezikun për abort spontan të shtatzënisë tek pacientet me hemorragji vaginale dhe abort incipient gjatë 20 javëve të para të shtatzënisë. Megjithatë, ajo nuk ndikon në rezultatet e shtatzënisë tek pacientet shtatzënia e të cilave vazhdon deri në lindje.

Fjalë kyçe: abort incipient, abort spontan, hematoma subkorionike.

NDIKIMI I FAKTORËVE TË MODIFIKUESHËM TË RISKUT NË PROGRESIONIN E SËMUNDJES RENALE KRONIKE, FOKUSI NË HIPERURICEMINË.

Dr. Xhensila Ujka, Prof. Dr. Alma Idrizi, Dr. Marina Parllaku Babali
Shërbimi Nefrologjisë, Sherbimi Laboratorit, QSUT, Spital Continental, Tiranë.

Abstrakt
Hyrje: Sëmundja renale kronike është e lidhur me një risk të rritur për semundje kardiovaskulare dhe lidhet gjithashtu me rritjen e acidit urik, që po cilësohet si faktor risku kardiovaskular jo tradicional. Acidi urik rritet zakonisht në pacient me SRK për shkak ekskretimit të demtuar si pasojë e uljes së funksionit renal. Gjithashtu ka evidenca dhe studime që tregojnë për rolin e acidit urik në kaskadën e inflamacionit dhe në demtimin endotelial në subjekt me funksion renal në normë dhe me funksion renal të dëmtuar. Duke luajtur rol kështu në hipertension, sindromin metabolik dhe në SRK. Prandaj në studim vlerësohet acidi urik i lartë si faktor risku për sëmundje kardiovaskulare dhe për efektin e tij në funksionin renal.

Qëllimi: Ky studim ka si qëllim të vlerësojë si ndikon trajtimi me Allopurinol dhe Febuxostat në pacient me Hiperuricemi dhe SRK në progresion e semundjes renale kronike në periudhat kohore 6 muaj, 1 vit dhe 2 vite.
Metodologjia: Ky studim eshte observues retrospektiv dhe u përfshinë 55 paciente me Hiperuricemi dhe Sëmundje renale kronike në stadet 3 - 5, nga të cilet 13 ishin me terapi renale zëvendesuese (hemodialize). Pacientët trajtoheshin me Allopurinol dhe Febuxostat për periudha 6muaj, 1 vit, dhe 2 vjeçare.
Rezultate: Mosha mesatare e pacientëve të përfshire në studim ishte 66. 9 dhe përqindjen më të madhe e përbënin meshkujt me vlerën mesatare më të larte të acidit urik. Rezulton ulje sinjifikante të vlerave të acidit urik në të gjitha periudhat kohore të trajtimit, dhe për të dyja llojet e trajtimit. Gjatë trajtimit me Febuxostat ka diferenca sinjifikante ndërmjet periudhave përsa i perket vlerave mesatare te GFR dhe azotemisë, nuk rezultojnë diferenca sinjifikante gjatë trajtimit me Allopurinol. Në periudhën 1 vit trajtimi me Febuxostat ka rezultuar me efikas në uljen e vlerave të acidit urik sesa trajtimi me Allopurinol, duke parë dhe një trend rritje më të pakët dhe më graduale të vlerave të kreatinines dhe rënie më të pakët të GFR.
Konkluzione: Në studimin tonë numrin më të lartë të pacientëve e përbën grupmosha 65 - 74 vjeç (41. 8%). Meshkujt kanë vlera më të larta të acidit urik sesa femrat. Në pacientët që zhvillojnë evente kardiovaskulare acidi urik është më i lartë. Në pacientët me SRK, Hiperuricemi dhe DM e ndryshojnë stadin një përqindje më e lartë se në ata pa DM. Në pacientet që nuk e ndryshojnë stadin vihet re një ulje më sinjifikante e acidit urik pas trajtimit. Për periudhen kohore 1 vit, rezulton që trajtimi me Febuxostat e ul më shume acidin urik se trajimi me Allopurinol, dhe vihet re një rënie me e paket e GFR se në periudhen e trajtimit 6 muaj.

Fjalë kyce: Sëmundje renale kronike, hiperuricemia, dislipidemia, sëmundje kardiovaskulare, Allopurinol, Febuxostat.

ÇRREGULLIMET E LËVIZJES, NJË PËRQASJE DIAGNOSTIKE KLINIKE NË MOSHAT PEDIATRIKE.

Xhentila Doka[1], Aida Bushati[1] Armand Shehu[1], Afërdita Tako[1]
[1]Shërbimi i Neurologjisë Pediatrike, QSU "Nënë Tereza", Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Çrregullimet e lëvizjes në moshat pediatrike përmbledhin një grup të gjërë çrregullimesh. Gjetja e shkaktarit etiologjik shpesh është e vështirë me një sërë diagnozash diferenciale dhe komplekse. Aplikimi i një algoritmi i përbërë nga disa hapa, do ndihmoj klinicistin në vlerësimin korrekt të pacientit. Hapi i parë është fenotipi / paterni klinik. Në këtë pikë duhet të diferencojmë nëse është lëvizje normale, patern i zhvillimit motor normal apo çrregullim patologjik. Hapi i dytë konsiston në klasifikimin e çregullimit të lëvizjes dhe cili çrregullim është më prominent (hiperkinetik, hipokinetik dhe ataksia). Hapi i tretë është konsiderimi i çrregullimit si çrregullim funksional. Në rastet e çrregullimeve të lëvizjes, pjesa funksionale nuk është përjashtuese, por konsiderohet që në fillim në bazë të paternit / të klinikës, historisë dhe ekzaminimit të pacientit. Hapi i katërt është të përcaktojmë sindromin klinik. Nga mbledhja e të dhënave të mësipërme, mundet të vihet diagnoza e një sindromi, në raste të tjera kjo mund të jetë më e vështirë. Sipas fenotipit të shfaqur kemi tiket, distoninë, chorea, miokloninë, stereotipitë, tremor, parkinsonizëm, ataxia. Qëllimi i këtij prezantimi do ketë fokus klinikën e këtyre crregullimeve të lëvizjes. Hapi i pestë ka të bëjë me mundësinë që ky çrregullim të ketë një shkaktar etiologjik të fituar. Hapi i gjashtë identifikimi i një sëmundje metabolike të lindur (IEM). Në fëmijët me më shumë se një çrregullim të lëvizjes, me prekje të disa organeve me / pa crregullime konjitive, shkaku etiologjik mund të jetë IEM. Njohja e shpejtë e një sëmundje IEM të trajtueshme është elementi kyç për të nisur sa më shpejtë terapinë e për të shmangur dëmtime të mëtejshme. Hapi i shtatë është testimi gjenetik. Në rastet me gjenotip - fenotip të qartë që korelon me një diagnozë, me një histori familjare pozitive ka vlerë testimi sekuencues Sanger (testim gjenetik i drejtuar në një gjen të vetëm). Në rastet ku korrelimi gjenotip - fenotip është jo i qartë, testimi i hibridizimit komparativ gjenomik do ishte alternativa më e zgjedhur. Në rastet ku diagnoza diferenciale gjenetike është midis disa sëmundjeve, është më e volitshme NGS sesa analiza e gjeneve specifike (si për shkak të kostos ashtu si dhe marrjes së shpejtë të përgjigjes së analizës). Hapi i tetë dhe i fundit është fenotipi post - NGS. Në disa raste edhe pas bërjes së analizës mund të kemi përgjigje si VUS ose mutacione heterozigote të gjeneve, në sëmundjet recesive. Në rast se çrregullimi i lëvizjes korelon me fenotipin e sëmundjes nevojiten investigime të mëtejshme për të përcaktuar nëse varjanti i gjetur shpjegon fenotipin e pacientit.

Objektiva: Prezantimi i një përqasje diagnostikuese klinike që të ndihmojë çdo klinicist që haset me çrregullimet e lëvizjes në moshat pediatrike. Kjo përqasje bazohet në 8 hapa që përfshijnë njohjen e çrregullimit të lëvizjes / paternit klinik, identifikimin e sindromit klinik, konsiderimin e një shkaku të fituar, testimi gjenetik, interpretimin e të dhënave dhe fenotipi post sekuencimit gjenetik.
Diskutime: Çrregullimet e lëvizjes përfshijnë një grup të madh çrregullimesh, ku tabloja klinike përfshin gjetje klinike neurologjike dhe jo neurologjike. Të dhënat që testimet gjenetike sidomos NGS japin, kanë bërë të mundur që shumë testime të tjera të jenë të panevojshme në këto raste. Gjithashtu, për një pjesë të rasteve trajtimet e hershëm pas përgjigjes gjenetike kanë bërë të mundur përmirësimin klinik të pacientëve.
Konkluzione: Ky algoritëm diagnostik mund të shërbejë si një përqasje fillestare ideale për cdo pacient pediatrik me çrregullime të lëvizjes.

Fjalë kyçe: mosha pediatrike, çrregullime, lëvizje, tablo klinike, klinicist.

SINDROMA EHLERS - DANLOS.
Xhoi Doko, Artur Zoto, Ervin Rapushi, Teuta Backa, Stela Janko, Florid Zenelaj, Anastasio Kolaci, Silda Çaushi
*Shërbimi i Reumatologjis*ë, *QSUNT.*

Abstrakt
Sindroma Ehlers - Danlos (EDS), është një grup çrregullimesh gjenetike heterogjene që përfshijnë indin lidhës, konkretisht përfshijnë një defekt gjenetik në sintezën dhe strukturën e kolagjenit dhe proteinave të matricës jashtëqelizore të indit lidhës. Kolagjeni i prekur nga këto defekte është pjesë integrale e çdo sistemi të trupit, për këtë arsye EDS prek çdo sistem organesh, por kryesisht lëkurën, artikulacionet dhe enët e gjakut. Manifestohet klinikisht me hipermobilitet të artikulacioneve, me hiperelasticitet të lëkurës dhe brishtësi të indit lidhës. Anomali të kolagjenit janë identifikuar në të paktën 6 lloje kryesore të EDS, të cilat janë: forma klasike, hipermobile, vaskulare, kifoskoliotike, artrokalazë dhe dermatosparaksis. Në vitin 2017, u propozua një klasifikim i ri ndërkombëtar i EDS me 13 variante të ndryshme, ku defekti i kolagjenit është i ndryshëm për secilin variant. Patofiziologjia e shumicës së nëntipeve të sindromës Ehlers - Danlos përfshin mutacione të trashëgueshme autosomale dominante ose recesive, në sintezën dhe përpunimin e kolagjenit. Patologjia biokimike e kolagjenit është e pranishme që në lindje, megjithatë, manifestimet klinike bëhen të dukshme më vonë. Karakteristikat klinike më të zakonshme muskuloskeletore përfshijnë: hipermobilitet të artikulacioneve, që çon në subluksacion e luksacione dhe rrjedhimisht në osteoartrit të hershëm, fraktura dhe dhimbje kronike, dobësi muskulore, pacientët kanë tendencë të rrëzohen dhe vështirësi në ecje. Manifestimet kutane më të zakonshmet janë hiperelasticitet i lëkurës, tekstura e lëmuar dhe e brishtë, shërimi i vonuar i plagëve dhe shenja atrofike pas shërimit të plagëve. Disa forma të EDS mund të çojnë në: rupturë arteriale, perforim spontan dhe traumatik visceral, hernie, prolaps të valvulave kardiake, periodontit, anomali të kornesë. Diagnostikohet kryesisht klinikisht, megjithëse identifikimi i gjenit që kodon kolagjenin ose proteinat që bashkëveprojnë me të është i nevojshëm për të identifikuar llojin e EDS. Trajtimi dhe menaxhimi i pacientëve me EDS duhet të përdorë një qasje multidisiplinare që përqendrohet në parandalimin e përparimit të sëmundjes dhe ndërlikimeve pasuese, pasi nuk ka kurë specifike për sëmundjen. Parandalimi është aspekti më i rëndësishëm i menaxhimit mjekësor, pasi çdo dëmtim rrit mundësinë e ndërlikimeve.
Fjalë kyçe: hipermobilitet, indi lidhës, deficit i kolagjenit, diagnozë gjenetike.

JETËGJATËSIA DHE SHËNDETI NË MOSHË TË MADHE.
Ylber Visha

Abstrakt
Hyrje: Jetëgjatësia mesatare në botë është rritur ndjeshëm gjatë dekadave të fundit, duke ngritur pyetjen nëse njerëzit jetojnë më gjatë në kushte më të mira apo më të këqija shëndetësore. Kuptimi i marrëdhënies midis jetëgjatësisë dhe shëndetit është thelbësor për planifikimin e politikave shëndetësore, financave publike dhe sistemeve të kujdesit afatgjatë.
Qëllimi: Ky prezantim synon të shqyrtojë teoritë kryesore mbi lidhjen midis jetëgjatësisë dhe shëndetit, mënyrat e matjes së shëndetit dhe paaftësisë, si dhe implikimet për politikat shëndetësore dhe shoqërore.

Metodologjia: Bazuar në literaturën shkencore dhe indikatorë të ndryshëm si ADL, IADL, YLD, DALYs, HALE dhe HLY, analizohet mënyra se si shëndeti i popullatës së moshuar matet dhe interpretohet në kuadër të tre skenarëve kryesorë: zgjerimi i morbiditetit, kompresimi i morbiditetit dhe ekuilibri dinamik.
Rezultate: Tre teori ofrojnë perspektiva të ndryshme mbi kohëzgjatjen e jetës në shëndet të mirë apo keq, si dhe ndikimin në shpenzimet dhe nevojat shëndetësore. Matjet e shëndetit të bazuara në funksionalitet janë më të përshtatshme për vlerësimin e cilësisë së jetës së të moshuarve sesa vetëm diagnozat e sëmundjeve kronike. Skenari i ekuilibrit dinamik sugjeron se pavarësisht nga rritja e sëmundshmërisë, ashpërsia e sëmundjeve mund të ulet, duke ulur kështu koston e kujdesit.
Konkluzione: Kuptimi i ndryshimeve në jetegjatësi dhe shëndetësi është kyç për zhvillimin e politikave efektive shëndetësore dhe sociale që mbështesin një jetë më të gjatë dhe më të shëndetshme. Matjet funksionale dhe një qasje e kombinuar e indikatorëve ofrojnë një pasqyrë më të plotë të shëndetit të popullsisë së moshuar.

Fjalë kyçe: jetegjatësi, shëndetësi, politika, të moshuar, indikatorë.

ENDOMETRIOZA DHE HIPOTIREOZA AUTOIMUNE NË FEMRAT FERTILE.

Prof. Asoc. Yllka Themeli [1, 2], Armela Bara[3]
Lektore, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë
Endokrinologe, Qendra diagnostike "DIAMED"
Universiteti "Barleti" Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Hyrje: Endometrioza është një gjendje kronike inflamatore me etiologji ende të paqartë. Studimet e fundit sugjerojnë se autoimuniteti i tiroides mund të shoqërohet me endometriozë në femrat fertile, duke luajtur potencialisht një rol të rëndësishëm në zhvillimin e saj.
Objektiva: Qëllimi i këtij studimi ishte të krahasonte nivelet e hormonit stimulues të tiroides (TSH) dhe antitrupave antitiroidienë tek femrat me dhe pa endometriozë, dhe të vlerësonte nëse ka një ndryshim në incidencën e çrregullimeve të tiroides midis këtyre grupeve.
Metodologjia: Në këtë studim prospektiv të tipit krahasues u përfshinë 60 femra fertile, që kishin kryer ndërhyrje kirurgjikale për probleme gjinekologjike brenda pesë viteve të fundit. Pjesëmarrëset u ndanë në dy grupe: një grup studimi me endometriozë (n=30) dhe një grup kontrolli pa endometriozë (n=30). Në të dy grupet u matën nivelet serike të TSH, tiroksinës së lirë (FT4), antitrupave anti - peroksidazë (anti - TPO) dhe antitrupave anti - tiroglobulinë (anti - Tg).
Rezultate: Niveli mesatar i TSH rezultoi dukshëm më i lartë në grupin me endometriozë (3. 29±1. 01 IU / mL) krahasuar me grupin e kontrollit (1. 38±0. 37 IU / mL). Niveli mesatar i FT4 ishte dukshëm më i ulët në grupin me endometriozë (0. 64±0. 23 ng / dL) sesa në grupin e kontrollit (1. 08±0. 21 ng / dL) (p=0. 002; p<0. 05). Midis pacientëve me endometriozë bilaterale, niveli mesatar i anti - TPO (82. 21±252. 29 IU / mL) ishte dukshëm më i lartë sesa tek ata me endometriozë unilaterale. Megjithatë, nuk u gjet asnjë ndryshim statistikisht i rëndësishëm midis grupeve me endometriozë dhe atyre të kontrollit në lidhje me nivelet e anti - TPO dhe anti - Tg në përgjithësi. Një korrelacion pozitiv dhe statistikisht i rëndësishëm u vu re midis madhësisë së lezioneve endometriotike dhe niveleve të anti - TPO (p=0. 011; p<0. 05).
Konkluzioni: Ky studim nxjerr në pah ndikimin e rëndësishëm të endometriozës bilaterale në nivelet e TSH, FT4 dhe anti - TPO, duke sugjeruar autoimunitetin si një komponent të mundshëm në patofiziologjinë e endometriozës.

Fjalë kyçe: Tiroiditi Hashimoto, endometrioza, TSH, anti - TPO, anti - Tg.

PLAGËT POST OPERATORE DHE PROBLEMI I INFEKSIONEVE SPITALORE.

Dr. Shk. Zahide Sulejmani[1], Ersi Kampula[2], Arjel Prenga[2], Elja Sulejmani[2], Alvarita Sina[2], Dr. Arenc Brahimi[1]
[1]*Instituti i Shëndetit Publik*
[2]*Fakulteti i Mjekësisë.*

Abstrakt

Hyrje: Problematika e epidemiologjisë së infeksioneve post operatore përfshihet në kategorinë e infeksioneve nozokomiale, të cilat mund të zhvillohen brenda spitalit ose shkaktohen nga patogjenë që përfitohen gjatë hospitalizimit. Në botë, çdo vit mesatarisht 25 - 28% e të operuarve në klinikat e kirurgjisë marrin infeksion spitalor. Në SHBA, infektimi i plagëve operatore luhatej nga 15%, në Itali 15%, në Shqipëri infektimi i plagëve operatore arrin shifrat 12 - 15%.

Qëllimi: Informimi dhe njëkohësisht sensibilizimi i personelit mjekësor për të ndjekur rigorozisht standardet dhe protokollet e sigurisë gjatë manipulimit me pacientin, sidomos gjatë mjekimeve të plagëve post operatore, duke parandaluar kështu mundësinë për t'u infektuar.

Metodologjia: Metodologjia e përdorur është marrja e mostrave në plagët postkirurgjikale në vite të ndryshme për të parë zbatimin e programit kombëtar të parandalimit të infeksioneve spitalore.

Rezultatet: Infeksionet e plagëve postkirurgjikale ndryshojnë nga shumë faktorë. Në vitin 2014 janë marrë 49 kampione të plagëve post operatore, janë përfshirë klinika e I - rë dhe klinika e III - të e Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza". Një total prej 49 mostrash për vitin 2014. Mosha e pacientëve nga 22 - 70 vjeç, 39 meshkuj dhe 9 femra. Nga 49 mostra u izoluan dhe identifikuan 24 shtame mikrobike = 48. 8%, prej të cilëve u izoluan: 3 shtame E. coli = 12. 5%, 4 shtame Staphylococcus aureus = 16. 6%, 12 shtame Staphylococcus epidermidis = 50%, 3 shtame Pseudomonas = 12. 5%, 2 shtame Klebsiella = 8. 3%. Në vitin 2025, në monitorimin e kryer janë marrë 34 mostra të plagëve post operatore të klinikës Nr. 3. Nga totali i 34 mostrave të marra për ekzaminim mikrobiologjik, vetëm 2 plagë rezultuan të kontaminuara me Pseudomonas aeruginosa.

Rekomandime: Zbatimi i Programit Kombëtar të Parandalimit të Infeksioneve Spitalore. Zbatimi me përpikmëri i protokolleve dhe procedurave standarde operative të parandalimit të infeksioneve spitalore, profilaksia para interventit, dezinfektimi dhe sterilizimi i mjediseve ku ofrohet kujdes shëndetësor.

Fjalë kyçe: Infeksion i plagëve kirurgjikale, mikroorganizmat patogjenë, parandalim, dezinfektim, sterilizem.

DISPLAZIA ZHVILLIMORE KONGENITALE – DIAGNOZA E HERSHME.

Zamir Demiraj

Abstrakt

Anomalitë kongenitale të aparatit lokomotor, për sa i përket frekuencës, zënë vendin e tretë pas anomalive kardiovaskulare dhe neurologjike. Displasia zhvillimore koks - femorale është patologjia osteoartikularë kongenitale më e shpeshtë. Kjo patologji prek kryesisht popullatën kaukaziane, duke shfaqur variabla gjeografike dhe shpesh me përhapje endemike. Një incidencë e lartë e saj është vërejtur në vendet mesdhetare, përfshirë edhe vendin tonë, ku kjo incidencë luhatet në 10–14 raste për 1000 lindje të gjalla. Diagnoza e hershme është çelësi i trajtimit të suksesshëm dhe i parandalimit të komplikacioneve reziduale. Ideale do të ishte të arrihej diagnostikimi i kësaj patologjie gjatë 6 muajve të parë të jetës, për arsye se strukturat osteomuskulare janë ende të pazhvilluara mirë dhe fëmija nuk ka filluar të ecë. Ekzaminimi klinik luan një rol kyç me teste të tilla si testi i Ortolanit, testi i Barlow dhe testi i kufizimit të abduksionit. Metodat imazherike si ekografia dhe radiografia gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm, por secila prej tyre ka kufizimet e veta. Në varësi të moshës së diagnostikimit të displazisë zhvillimore koks - femorale, aplikohen metoda të ndryshme për trajtimin e saj dhe për parandalimin e komplikacioneve.

Fjalë kyçe: displasia zhvillimore koks - femorale, anomalitë kongenitale, diagnoza e hershme, testi Ortolani, testi Barlow, ekografi, radiografi, prognoza.

MENAXHIMI I HEMORAGJISË DHE TRANSFUZIONEVE NË PERIUDHËN KIRURGJIKALE – ROLI I INFERMIERIT NË SIGURINË E PACIENTIT. SFIDAT DHE PRAKTIKAT MË TË MIRA.

Zamira Imeraj, Anisa Kishta
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i MjekësisëTiranë

Abstrakt

Hyrje: Hemoragjia gjatë ndërhyrjeve kirurgjikale përbën një nga komplikacionet më të shpeshta dhe më serioze që rrezikon jetën e pacientit. Menaxhimi i saktë i humbjes së gjakut dhe transfuzioneve të gjakut është një proces kompleks që kërkon bashkëpunimin e ngushtë të ekipit multidisiplinar, ku infermierët luajnë një rol kyç në monitorimin, identifikimin e hershëm të komplikacioneve dhe zbatimin e protokolleve të sigurisë.

Qëllimi: Të theksohet rëndësia e rolit të infermierit në menaxhimin e hemoragjisë intra - dhe post - operatore, si dhe në administrimin e transfuzioneve të sigurta për të reduktuar morbiditetin dhe mortalitetin.

Metodologjia: Ky abstrakt bazohet në rishikimin e literaturës shkencore të 10 viteve të fundit, udhëzimet ndërkombëtare (WHO, AABB, ESAIC) dhe protokollet spitalore që lidhen me menaxhimin e hemoragjisë kirurgjikale dhe transfuzioneve të gjakut.

Rezultate: - Infermierët janë përgjegjës për vlerësimin e shenjave vitale dhe dokumentimin e sasisë së humbjes së gjakut. Zbatimi i protokolleve të transfuzionit ul incidencën e reaksioneve hemolitike dhe komplikacioneve imunologjike. Edukimi i stafit infermieror dhe përdorimi i "checklist" - ave për sigurinë e transfuzionit kanë treguar rritje të efikasitetit dhe reduktim të gabimeve. Menaxhimi aktiv i gjakderdhjes pas operacionit përmes monitorimit të drenazheve kirurgjikale, hemoglobinës dhe shenjave klinike është thelbësor për detektimin e hershëm të komplikacioneve.

Përfundime: Roli i infermierit në menaxhimin e hemoragjisë dhe transfuzioneve gjatë periudhës kirurgjikale është i pazëvendësueshëm. Implementimi i protokolleve të standardizuara, edukimi i vazhdueshëm dhe monitorimi i kujdesshëm i pacientit janë faktorë kyç për të rritur sigurinë dhe për të përmirësuar rezultatet klinike.

Fjalë kyçe: hemoragji kirurgjikale, transfuzion gjaku, infermieria kirurgjikale, siguria e pacientit, menaxhim perioperativ.

SINDROMA E VEZOREVE POLICISTIKE, SFIDAT DIAGNOSTIKUESE BASHKËKOHORE DHE QASJET TERAPEUTIKE.

Zamira Bexheti[1], Gazmend Zulbeari[2], Bashkim Isamili[3], Isan Emini[1]
[1]*South East European Iniversity - Tetova R. North Macedonia*
[2]*Faculty of Medical Sciences, Goce Delcev University, Stip, North Macedonia*
[3]*I. P. SH Specialized Hospital for Obstetics and Gynecology "MOTHER TERESA" – ÇAIR, Skopje*

Abstrakt

Hyrje: Sindroma e Vezoreve Policistike (PCOS) është çrregullimi më i zakonshëm endokrin që prek gratë në moshë riprodhuese, me një prevalencë globale që varion nga 5% në 15% në varësi të kritereve diagnostikuese të aplikuara. Karakterizohet nga anovulimi kronik, hiperandrogjenizmi klinik ose biokimik dhe morfologjia e vezoreve policistike. Pavarësisht dekadave të kërkimit, mbeten polemikat në lidhje me pragjet diagnostikuese, ndryshueshmërinë fenotipike dhe strategjitë afatgjata të menaxhimit. Ky rishikim nxjerr në pah kriteret më të fundit diagnostikuese, heterogjenitetin e manifestimeve klinike dhe përparimet e fundit në qasjet terapeutike, duke përfshirë ndërhyrjet farmakologjike dhe të stilit të jetës. Një plan trajtimi multidisiplinar dhe i individualizuar mbetet thelbësor për të përmirësuar rezultatet riprodhuese, metabolike dhe psikologjike tek gratë me PCOS. Sindroma e Ovareve Policistike (PCOS) është një çrregullim kompleks dhe heterogjen me implikime riprodhuese, endokrine dhe metabolike. U përshkrua për herë të parë në vitin 1935 nga Stein dhe Leventhal si një shoqërim i amenorresë, hirsutizmit, obezitetit dhe vezoreve policistike të zmadhuara. Që atëherë, PCOS është njohur si një gjendje multifaktoriale e ndikuar nga faktorë gjenetikë, epigjenetikë dhe mjedisorë. PCOS është një shkak kryesor i infertilitetit anovulues dhe është i lidhur fort me rezistencën ndaj insulinës, obezitetin dhe sindromën metabolike. Përtej manifestimeve fizike, PCOS ka edhe pasoja të thella psikosociale, duke përfshirë ankthin, depresionin dhe cilësinë e ulët të jetës. Pavarësisht rëndësisë së saj klinike, diagnoza dhe menaxhimi mbeten sfiduese për shkak të ndryshueshmërisë në prezantim dhe mungesës së kritereve diagnostikuese të pranuara universalisht.

Materiale dhe metoda: Ky rishikim u krye përmes një kërkimi gjithëpërfshirës në bazat e të dhënave PubMed, Scopus dhe Web of Science midis viteve 2010 dhe 2025. U përdorën fjalët kyçe të mëposhtme: PCOS, diagnozë, kriteret e Roterdamit, hiperandrogjenizëm, infertilitet, rezistencë ndaj insulinës, menaxhim. Prioritet iu dha rishikimeve sistematike me cilësi të lartë, provave të kontrolluara të rastësishme dhe udhëzimeve të fundit të praktikës klinike.
Rezultate: Kriteret Diagnostikuese. Kriteret e Shoqërisë AE - PCOS (2006). Manifestimet Klinike Karakteristikat riprodhuese: Oligo / amenorre, infertilitet, humbje e përsëritur e shtatzënisë. Karakteristikat androgjenike: Hirsutizëm, akne, alopeci androgjenike. Karakteristikat metabolike. Komplikacionet afatgjata. Patofiziologjia**.** Qasje Terapeutike.
Diskutime: Pavarësisht progresit në kuptimin e PCOS, sfidat vazhdojnë në harmonizimin e kritereve diagnostikuese. Mbidiagnoza tek adoleshentët dhe nëndiagnoza tek gratë me prezantime atipike janë probleme të shpeshta. Për më tepër, trajtimi duhet të shtrihet përtej shqetësimeve të fertilitetit për të përfshirë shëndetin kardiometabolik afatgjatë dhe mirëqenien psikologjike. Kujdesi multidisiplinar - duke kombinuar gjinekologjinë, endokrinologjinë, të ushqyerit dhe shëndetin mendor - është thelbësor. Në rajonet me të ardhura të ulëta dhe të mesme, përfshirë Ballkanin, mungesa e ndërgjegjësimit dhe qasja e kufizuar në burimet diagnostikuese e ndërlikojnë më tej menaxhimin. Hulumtimet e ardhshme duhet të përqendrohen në qasjet e mjekësisë precize, identifikimin e biomarkuesve për diagnozë të hershme dhe personalizimin e strategjive terapeutike.
Përfundime: PCOS është një çrregullim shumëplanësh me implikime riprodhuese, metabolike dhe psikologjike. Diagnoza mbetet e diskutueshme, por kriteret e Roterdamit mbeten më të aplikuara gjerësisht. Trajtimi kërkon një qasje të individualizuar dhe multidisiplinare që adreson si shqetësimet e menjëhershme riprodhuese ashtu edhe rreziqet afatgjata shëndetësore. Terapitë në zhvillim janë premtuese, por modifikimi i stilit të jetës mbetet gurthemeli i menaxhimit.

Fjalë kyçe: Sindroma e ovareve policistike, hiperandrogjenizëm, infertilitet, rezistencë ndaj insulinës, shëndeti riprodhues, kriteret e roterdamit.

ENZIMAT TE OBSTRUKSIONI I RRUGËVE BILIARE.

Dr. Zana Braha
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti i Mjekësisë, Mjekësi e Përgjithshme.

Abstrakt
Obstruksioni biliar është një gjendje klinike që karakterizohet nga bllokimi i kanaleve biliare, i cili mund të rezultojë nga etiologji të ndryshme duke përfshirë këtu gurët në kolecistë, tumoret, strikturat dhe pankreatitin. Ky obstruksion çon në grumbullim të likidit në kolecistë, duke shkaktuar ikter, kolestazë dhe dëmtim të mundshëm të heparit. Diagnoza zakonisht gjendet me anë të teknikave imazherike si ultratingull, CT ose MRCP, të cilat ndihmojnë në identifikimin e vendndodhjes dhe shkakut të obstruksionit. Opsionet e trajtimit variojnë në bazë të shkaktarit themelor dhe përfshijnë procedura endoskopike, ndërhyrje perkutane ose qasje kirurgjikale. Diagnoza dhe ndërhyrja e hershme janë thelbësore për të parandaluar komplikimet sic janë infeksionet, insuficienca hepatike dhe rritja e morbiditetit. Enzimat hepatike, kryesisht alaninë aminotransferaza (ALT), aspartat aminotransferaza (AST), fosfataza alkaline (ALP) dhe gama - glutamil transferaza (GGT), luajnë një rol vendimtar në vlerësimin e funksionit hepatik dhe diagnostikimin e sëmundjeve hepatike. Rritjet në këto enzima mund të tregojnë një sërë gjendjesh klinike, nga dëmtimi akut i heaprit dhe hepatiti kronik deri te obstruksioni biliar dhe cirroza hepatike. Interpretimi i niveleve të enzimave të heparit kërkon shqyrtim të kujdesshëm të kontekstit klinik, pasi ngritja e tyre mund të rezultojë edhe nga faktorë jo hepatikë. Për shembull, ALT është më specifike për dëmtimin e heparit, ndërsa AST mund të rritet në kushtet që prekin indet e tjera. Për më tepër, raporti AST / ALT mund të sigurojë njohuri mbi patologjitë specifike të heparit, siç është sëmundja alkoolike e heparit(ALD). Monitorimi i rregullt i enzimave hepatike është thelbësor për zbulimin e hershëm të mosfunksionimit të heparit, orientimin e vendimeve për trajtimin dhe vlerësimin e përgjigjes ndaj terapisë. Ky abstrakt nënvizon rëndësinë e një qasjeje multidisiplinare në menaxhimin e obstruksionit biliar për të optimizuar rezultatet e pacientit dhe rëndësinë e enzimave hepatike si biomarkues jetik në hepatologji, duke lehtësuar diagnostikimin e hershëm dhe menaxhimin e çrregullimeve të lidhura me heparin.

Fjalë kyçe: obstruksion biliar, sistemi biliar, rrjedhje e çrregulluar e bilës, enzimat hepatike, biomarkerë.

TRAJTIMI I SYRIT TË THATË: PËRDORIMI I TERAPIVE AKTUALE DHE SFIDAT E MENAXHIMIT TË SËMUNDJES.

Zana Sulejmani

Abstrakt

Hyrje: Syri i thatë është një problem klinik i zakonshëm që haset nga oftalmologët në mbarë botën. Sëmundja është ciklike me shpërthime simptomash dhe periudha joaktive që karakterizohet nga paqëndrueshmëria e shtresës së lotit, hiperosmolariteti dhe inflamacioni i sipërfaqes së syrit. Simptomat përfshijnë ankesat e dhimbjes, që karakterizohen si ndjenjë e thatësisë por edhe dhimbëse, ndjesi e trupit të huaj dhe irritim.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është prezentimi i literaturës lidhur me trajtimin e syrit të thatë përkatësisht përdorimi i terapive aktuale dhe sfidat e menaxhimit, të gjetura nga kërkimi i databazës elektronike Pubmed.

Metodologjia: Ky punim është rishikim i sistematizuar i literaturës. Metodologjia është bazuar në rekomandimet për udhëheqjen e rishikimit sistematik të literaturës që përbehet nga 5 hapa: kërkimi i literaturës, përzgjedhja e literaturës, evaluimi i literaturës, mbledhja dhe sinteza e të dhënave.

Rezultate: Të dhënat nga ky rishikim sugjerojnë se: trajtimi i sëmundjes së syrit të thatë kërkon një qasje gjithëpërfshirëse dhe të individualizuar që adreson si simptomat ashtu edhe mekanizmat patofiziologjik; terapitë duhet të përshtaten sipas nëntipit specifik dhe ashpërsisë së sëmundjes; trajtimet aktuale kanë dhënë rezultate të përmirësimit ndjeshëm ndër pacient, por shpesh ofrojnë kontrroll të simptomave në vend të shërimit si dhe trajtimet më të reja tregojnë premtime, por kërkojnë studime më të thelluara.

Përfundime: Të dhënat nga studimet e përfshira që janë botuar në 2 vitet e fundit tregojnë se trajtimi i ST mbetet një sfidë komplekse për shkak të natyrës multifaktoriale, variabilitetit në përgjigjen ndaj trajtimit dhe mungesës së një qasje të standardizuar që të jetë efektive për të gjithë pacientët.

Fjalë kyçe: Syri i thatë, terapi, menaxhim.

IMPAKTI I USHQYERJES TEK FËMIJËT ME ÇRREGULLIM TË SPEKTRIT TË AUTIZMIT. TERAPIA E USHQIMIT NJË DOMOSDOSHMËRI.

Zvjetllana Skorovoti[1, 3], Alba Themeli[3], Marsela Manasterliu[4], Jetmira Kerxhaliu[5], Marjon Zoga[3, 6], Rigers Vatoci[6], Enver Halili[2]

[1]*Psikiatre për fëmijë dhe adoleshentë, Spitali Rajonal Durrës*

[2]*Neurolog, Spitali Rajonal Fier.*

[3]*Qendra e trajnimit Mjekësor "Santa Maria"*

[4]*Pediatre, Spitali Rajonal Durrës*

[5]*Neurokirurge, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë*

[6]*Student mjekësie, UNIZKM.*

Abstrakt

Hyrje: Të ushqyerit në mënyrë të shëndetshme luan një rol vendimtar në mbështetjen e rritjes fizike, konjitive dhe emocionale të fëmijëve. Truri në zhvillim kërkon një furnizim të qëndrueshëm të lëndëve ushqyese thelbësore, duke përfshirë vitaminat, mineralet, proteinat dhe yndyrnat e shëndetshme. Këto lëndë ushqyese mbështesin rritjen dhe lidhjen e qelizave të trurit, duke ndihmuar në zhvillimin e aftësive njohëse si vëmendja, kujtesa, zgjidhja e problemeve dhe aftësitë gjuhësore. Femijët me CSA karakterizohen nga selektiviteti ushqimor dhe priren të kenë më shumë inflamacion në mukozën e zorrëve dhe një çekuilibër të baktereve të mira dhe të këqija të saj. Ata shfaqin crregullim të tretjes së karboidrateve.

Qëllimi: Të hartohen dieta specifike për fëmijët me CSA të cilat zvogëlojnë inflamacionin dhe ndryshojnë metabolizmin e trurit. Të hartohen programe specifike në terapinë e zhvillimit për ushqyerjen e shëndetshme.

Materiale dhe metoda: Një rishikim i thellësishëm i literaturës që trajton lidhjen e dietës ushqimore me rritjen e funksionalitetit tek fëmijët me CSA.

Konkluzione: Dieta ketogjenike mund të përmirësojë problematikat me sjelljen dhe funksionimin social tek fëmijët me CSA duke përmirësuar funksionimin mitokondrial, reduktuar inflamacionin, rritur prodhimin e GABA - s, ulur nivelin e glutamatit dhe përmirësimin e sinjalizimit midis neuroneve. Futja e kësaj diete dhe në

seancat e tarapive që fëmijët me CSA ndjekin është një domosdoshmëri për përmirësimin e funksionimit global tek këta fëmijë.

Fjalë kyçe: Dietë e ekulibruar, dietë ketogjenike, çrregullim i spektrit të autizmit, CSA, terapia e ushqimit.

ABSTRAKTET E DENTISTRISË

ABSTRACT OF DENTISTRY

NËNTOR 2025 | NOVEMBER 2025

ZERO BONE DISTANCE …THE WHOLE STORY.

Dr. Ahmed Abdelwahed Shaaban BDS, MDSc, DDSc, PhD
Professor of Prosthodontics, Future University in Egypt
Founder and president of the Egyptian Association of Prosthetic and Restorative Dentistry (EAPRD)
President of Egyptian dental union (EDU)

Abstract
Subperiosteal implants have re - emerged as a viable and advanced treatment modality for patients with severe alveolar bone resorption where conventional endosseous implants are contraindicated. This lecture explores the indications, design, surgical protocol, and long - term outcomes of subperiosteal implants, with a focus on digital workflow innovations that have significantly improved their precision and predictability. Through clinical case studies and evidence - based discussion, we will highlight how subperiosteal implants offer a less invasive alternative to extensive bone grafting procedures, enabling fixed prosthetic rehabilitation even in the most challenging anatomical conditions. Participants will gain a comprehensive understanding of when and how to incorporate this approach into their practice, ultimately expanding treatment options for compromised cases. Recent advancements in 3D printing technology and computer - guided surgery have revolutionized the fabrication and adaptation of subperiosteal frameworks, ensuring a perfect fit and minimizing intraoperative adjustments. The integration of CBCT imaging with CAD / CAM design has further enhanced diagnostic accuracy and treatment planning efficiency. Emphasis will also be placed on postoperative maintenance, complication management, and patient - specific customization to achieve optimal esthetic and functional outcomes. By the end of this session, attendees will appreciate the evolution of subperiosteal implantology as a modern, evidence - based solution that bridges the gap between prosthetic needs and anatomical limitations.

Keywords: Subperiosteal implant, CAD / CAM workflow, 3D printing.

IMPLANTI PA DISTANCË NGA KOCKA … E GJITHË HISTORIA.

Dr. Ahmed Abdelwahed Shaaban BDS, MDSc, DDSc, PhD
Profesor i Protetikës Dentare, Future University in Egypt
Themelues dhe President i Shoqatës Egjiptiane të Protetikës dhe Stomatologjisë Restauruese (EAPRD)
President i Unionit Dentar Egjiptian (EDU)

Abstrakt
Implantet subperiostale janë rishfaqur si një mundësi e vlefshme dhe e avancuar trajtimi për pacientët me resorbim të theksuar të kockës alveolare, ku implantet endoosale konvencionale janë të kundërindikuara. Ky leksion shqyrton indikacionet, dizajnin, protokollin kirurgjikal dhe rezultatet afatgjata të implanteve subperiostale, me fokus në inovacionet e fluksit digjital të punës, të cilat kanë përmirësuar ndjeshëm saktësinë dhe parashikueshmërinë e tyre. Nëpërmjet studimeve klinike dhe diskutimeve të bazuara në evidencë, do të theksojmë se si implantet subperiostale ofrojnë një alternativë më pak invazive ndaj procedurave të gjera të transplantimit të kockës, duke mundësuar rehabilitim protetik fiks edhe në kushtet anatomike më sfiduese. Pjesëmarrësit do të fitojnë një kuptim të plotë mbi momentin dhe mënyrën e duhur për të integruar këtë qasje në praktikën e tyre, duke zgjeruar në fund mundësitë e trajtimit për rastet e kompromentuara. Përparimet e fundit në teknologjinë e printimit 3D dhe kirurgjinë e udhëhequr nga kompjuteri kanë revolucionarizuar procesin e prodhimit dhe përshtatjes së strukturave subperiostale, duke siguruar një përshtatje perfekte dhe duke minimizuar rregullimet gjatë operacionit. Integrimi i imazherisë CBCT me dizajnin CAD / CAM ka përmirësuar më tej saktësinë diagnostike dhe efikasitetin në planifikimin e trajtimit. Gjithashtu, do të theksohet rëndësia e mirëmbajtjes pas operacionit, menaxhimit të komplikimeve dhe personalizimit të trajtimit për çdo pacient, me qëllim arritjen e rezultateve optimale estetike dhe funksionale. Në përfundim të këtij sesioni, pjesëmarrësit do të vlerësojnë evolucionin e implantologjisë subperiostale si një zgjidhje moderne, të bazuar në evidencë, që lidh nevojat protetike me kufizimet anatomike.

Fjalë kyçe: Subperiostal implant, resorbim kockor, CAD / CAM, printim 3D.

EVALUATION OF HEALING TIME AND POSTOPERATIVE MORBIDITY AFTER IMPLANT UNCOVERING WITH VESTIBULARY REPOSITIONED FLAP ASSOCIATED WITH PRF.

Alessio Frisone[1], Giuseppe Balice[1, 2], Matteo Serroni[1], Beatrice Femminella[1], Bruna Sinjari[1, 2], Sergio Caputi[1, 2], Michele Paoloantonio[1].

[1]Department of Innovative Technologies in Medicine and Dentistry, University "G. d'Annunzio" Chieti - Pescara, 66100 Chieti, Italy

[2]Hi tech Dental Materials Laboratory, University "G. d'Annunzio" Chieti - Pescara, 66100 Chieti, Italy

Abstract

Introduction: The aim of this study was to evaluate healing time and postoperative morbidity following implant uncovering performed with a vestibularly repositioned flap (VRF) in combination with platelet - rich fibrin (PRF). This prospective, randomized, controlled clinical trial assessed soft tissue healing and postoperative morbidity after implant uncovering in the maxillary arch using a vestibularly repositioned flap technique. Patients were assigned to two groups: a test group, in which the surgical wound was treated with PRF, and a control group, in which the wound was allowed to heal by secondary intention without any hemostatic dressing. After patient selection, the study protocol included the surgical procedure, weekly evaluation of peri - implant wound healing over four weeks, and assessment of postoperative morbidity. The application of PRF was hypothesized to promote faster soft tissue healing and reduce postoperative discomfort compared with secondary intention healing. Within the limitations of this study, PRF appears to have a positive influence on soft tissue healing and may decrease postoperative morbidity in vestibularly repositioned flap procedures during implant uncovering. Clinicians are encouraged to adopt surgical techniques that preserve or increase the width of peri - implant keratinized mucosa, as this factor contributes to long - term implant stability and favorable esthetic outcomes.

Keywords: healing time, morbidity, PRF etc.

VLERËSIMI I KOHËS SË SHËRIMIT DHE MORBIDITETIT POST - OPERATIV PAS ZBULIMIT TË IMPLANTIT ME FLAP TË RIPOZICIONUAR VESTIBULAR TË SHOQËRUAR ME PRF.

Alessio Frisone[1], Giuseppe Balice[12], Matteo Serroni[1], Beatrice Femminella[1], Bruna Sinjari[12], Sergio Caputi[12], Michele Paoloantonio[1]

[1]Departamenti i Teknologjive Inovative në Mjekësi dhe Stomatologji, Universiteti "G. d'Annunzio" Chieti - Pescara, Itali

[2]Laboratori i Materialeve Dentare Hi - Tech, Universiteti "G. d'Annunzio" Chieti - Pescara

Abstrakt

Hyrje: Qëllimi i këtij studimi ishte të vlerësonte kohën e shërimit dhe morbiditetin post - operativ pas zbulimit të implantit të kryer me teknikën e flap - it të ripozicionuar vestibular (VRF) në kombinim me fibrinën e pasur me trombocite (PRF). Ky studim klinik, prospektiv, i randomizuar dhe i kontrolluar, vlerësoi shërimin e indeve të buta dhe morbiditetin post - operativ pas zbulimit të implantit në harkun maksilar, duke përdorur teknikën e VRF - së.

Materiale dhe Metoda: Pacientët u ndanë në dy grupe: grupi testues, te i cili plaga kirurgjikale u trajtua me PRF, dhe grupi kontroll, ku plaga u lejua të shërohej me qëllim të dytë (healing by secondary intention), pa ndonjë veshje hemostatike. Pas përzgjedhjes së pacientëve, protokolli i studimit përfshinte procedurën kirurgjikale, vlerësimin javor të shërimit të plagës peri - implante për katër javë dhe vlerësimin e morbiditetit post - operativ. U hipotetizua se aplikimi i PRF - së do të nxitë një shërim më të shpejtë të indeve të buta dhe do të reduktojë diskomfortin post - operativ në krahasim me shërimin me qëllim të dytë.

Përfundime: Brenda kufizimeve të këtij studimi, PRF - ja duket se ka një ndikim pozitiv në shërimin e indeve të buta dhe mund të ulë morbiditetin post - operativ në procedurat me flap të ripozicionuar vestibular gjatë zbulimit të implantit. Klinicistët inkurajohen të aplikojnë teknika kirurgjikale që ruajnë ose rrisin gjerësinë e mukozës keratinizuese përreth implantit, pasi kjo ndikon në qëndrueshmërinë afatgjatë të implantit dhe rezultate të favorshme estetike.

Fjalë kyçe: koha e shërimit, morbiditeti post - operativ, PRF, flap i ripozicionuar vestibular, mukozë peri - implante.

ROOT CANAL SHAPING.
Andrea Galentino

Abstract
Root canal shaping represents a critical phase in endodontic treatment, as it directly affects the cleaning, disinfection, and eventual sealing of the root canal system. In recent years, the introduction of nickel - titanium (Ni - Ti) alloy instruments has significantly transformed clinical endodontics, making the shaping process faster, safer, and more predictable, while preserving more dentinal structure. In this presentation, the speaker will explore the fundamental biomechanical principles that guide effective root canal preparation and will highlight the ongoing shift towards **minimally invasive endodontics.** Special focus will be given to the role of advanced metallurgy (controlled memory Ni - Ti, enhanced flexibility), the prevention of procedural errors such as ledges, transportation or instrument fracture, and the importance of respecting the natural canal anatomy to improve long - term prognosis. By comparing traditional shaping techniques with modern rotary and reciprocating systems, the presentation aims to illustrate how contemporary endodontic technologies contribute to safer treatments and better clinical outcomes.

Keywords: Conservative endodontics, Ni - Ti instruments, root canal shaping, minimally invasive treatment, controlled memory, biomechanics, long - term tooth preservation.

FORMIMI I KANALEVE TË RRËNJËS.
Andrea Galentino

Abstrakt
Formësimi i kanaleve rrënjësore përbën një hap thelbësor në trajtimin endodontik, duke ndikuar drejtpërdrejt në pastrimin, dezinfektimin dhe mbushjen e suksesshme të sistemit të kanalit. Gjatë dekadës së fundit, përdorimi i instrumenteve të prodhuara nga aliazh nikeli - titani (Ni - Ti) ka transformuar praktikën klinike, duke e bërë procedurën më efikase, më të sigurt dhe më pak invazive për strukturat dentare. Ligjëruesi në këtë relacion do të analizojë parimet biomekanike që duhet të respektohen gjatë formësimit të kanaleve, si dhe do të diskutojë evolucionin teknologjik që ka mundësuar një qasje më konservative dhe më anatomike ndaj trajtimit endodontik. Do të shqyrtohen gjithashtu konceptet moderne të **minimal invasive endodontics**, menaxhimi i riskut të devijimeve apo frakturave të instrumenteve, dhe rëndësia e ruajtjes së strukturës dentare për jetëgjatësinë e dhëmbit. Përmes krahasimeve ndërmjet teknikave tradicionale dhe sistemeve të reja me përkulshmëri të lartë dhe memorje të modifikuar, do të theksohet roli që teknologjia luan në përmirësimin e standardeve klinike dhe rezultateve afatgjata.

Fjalë kyçe: Endodoncia konservative, instrumente Ni - Ti, formësim kanalor, trajtim minimisht invaziv, memorje e kontrolluar, biomekanikë, jetëgjatësi dentare.

ROOT CANAL IRRIGATION.
Andrea Galentino

Abstract
The chemical cleaning phase represents an essential and non - negotiable step for the success of endodontic therapy. In modern clinical practice, there are techniques and tools that allow this process to be performed quickly and safely, significantly increasing the success rate of treatment. Chemical irrigation is necessary to remove organic debris, bacteria, biofilm, and the smear layer factors that contribute to treatment failure if not adequately addressed (Siqueira & Rôças, 2008). Although mechanical instrumentation plays a critical role in

shaping the canal, it has limitations in terms of disinfection, with only 35–50% of the canal wall being effectively contacted by instruments. The use of irrigants such as **sodium hypochlorite (NaOCl)** for its tissue - dissolving and strong antimicrobial properties and **EDTA (ethylenediaminetetraacetic acid)** for the removal of inorganic components of the smear layer is considered standard. **Chlorhexidine** is also used for its long - lasting antibacterial activity, although it lacks tissue - dissolving ability. To improve the effectiveness of irrigation, various **irrigant activation techniques** have been introduced, including **ultrasonic activation (Passive Ultrasonic Irrigation – PUI), sonic activation** (e. g. , EndoActivator), **negative pressure systems** (e. g. , EndoVac), and more recently, **laser - assisted activation** using Er: YAG and Nd: YAG lasers. These techniques allow deeper penetration of irrigants into complex anatomical areas such as lateral canals, isthmuses, and dentinal tubules. The implementation of these advanced technologies has shown significant improvement in reducing microbial load, eliminating smear layer, and enhancing the long - term outcomes of endodontic therapy. This report emphasizes the critical role of irrigation in root canal therapy and supports the integration of evidence - based protocols and modern techniques to achieve optimal therapeutic results.

Keywords: endodontic irrigation, chemical cleaning, sodium hypochlorite, EDTA, ultrasonic activation, bacterial biofilm, smear layer, laser, therapeutic success.

IRRIGIMI I KANALEVE TË RRËNJËVE.

Andrea Galentino

Abstrakt

Faza e detersionit kimik përfaqëson një moment të domosdoshëm për suksesin e terapisë endodontike: në panoramën klinike moderne ka teknika dhe instrumente që na lejojnë ta bëjmë atë të shpejtë dhe të sigurt, duke rritur përqindjen e suksesit të trajtimit. Pastrimi kimik është i domosdoshëm për të eliminuar mbetjet organike, bakteriet, biofilmin dhe smear layer - in, të gjitha këto janë faktorë që kontribuojnë në dështimin e trajtimeve nëse nuk trajtohen në mënyrë efektive (Siqueira & Rôças, 2008). Megjithëse instrumentimi mekanik është i rëndësishëm për formësimin e kanalit, ai ka kufizime në sterilizim, dhe vetëm 35–50% e sipërfaqeve të kanalit preken realisht nga instrumentet. Përdorimi i irriguesve **si hipokloriti i natriumit (NaOCl),** për shkak të vetive të tij tretëse të indeve dhe efektit të fortë antimikrobial, është më i përhapuri. **EDTA (acid etilendiamintetraacetik)** është i domosdoshëm për heqjen e komponentëve inorganikë të smear layer - it, ndërsa **klorheksidina** përdoret për vetitë e saj të qëndrueshme antibakteriale, edhe pse nuk tret inde të gjalla. Për të rritur efikasitetin e irrigimit, përdoren teknika të **aktivizimit të irriguesve:** aktivizimi **ultrasonik (Passive Ultrasonic Irrigation – PUI), aktivizimi sonik), sistemet me presion negativ** dhe më së fundmi, përdorimi i **laserëve** si Er: YAG dhe Nd: YAG për aktivizim fotonik. Këto metoda ndihmojnë në depërtimin më të mirë të irriguesve në strukturat më të thella të sistemit të kanaleve dhe në kanalet laterale. Implementimi i këtyre teknologjive moderne ka treguar përmirësim të ndjeshëm në reduktimin e ngarkesës bakteriale, eliminimin e smear layer - it dhe përmirësimin e rezultateve afatgjata të terapisë endodontike. Ky raport thekson rëndësinë kritike të fazës së irrigimit në terapinë endodontike dhe mbështet përdorimin e protokolleve të avancuara për të arritur sukses terapeutik maksimal.

Fjalë kyçe: irrigim endodontik, pastrim kimik, hipoklorit natriumi, EDTA, aktivizim ultrasonik, biofilm bakterial, smear layer, lazer, sukses terapeutik.

CUSTOMIZED IMPLANTS IN NO BONE PATIENTS.

Angelo Cardarelli

Abstract

Introduction: In cases of severe maxillary atrophy, the absence of adequate bone volume renders conventional implant therapy unfeasible. Customized subperiosteal implants, digitally designed and 3D - fabricated, offer a viable solution for functional and aesthetic oral rehabilitation in such challenging clinical scenarios.

Methodology: This lecture presents an innovative workflow for planning and placing customized subperiosteal implants by integrating: Computerized tomography (CT) scans for precise anatomical assessment. CAD

(Computer - Aided Design) for customized implant modeling. CAM (Computer - Aided Manufacturing) with 3D printing for titanium frameworks. Advanced surgical protocols to ensure safe and predictable placement.
Results: Clinical experience indicates high success rates in oral rehabilitation of patients with complete bone loss. Customized implants demonstrate long - term stability, improved masticatory function, and high patient satisfaction while minimizing the need for bone grafting procedures.

Keywords: customized implants, subperiosteal implants, maxillary atrophy, 3D printing, oral surgery, bone - free rehabilitation.

IMPLANTET E PERSONALIZUARA TE PACIENTËT PA KOCKË.
Angelo Cardarelli

Abstrakt
Hyrje: Në rastet e atrofisë së avancuar maksilare, mungesa e masës kockore e bën të pamundur aplikimin e implanteve konvencionale. Në këto situata sfiduese, implantet subperiostale të personalizuara, të dizajnuara dhe prodhuara përmes teknologjisë së avancuar digjitale, ofrojnë një alternativë të vlefshme për rikthimin funksional dhe estetik të pacientëve.
Metodologjia: Në këtë punim prezantohet qasja moderne në dizajnimin dhe vendosjen e implanteve subperiostale përmes përdorimit të: Tomografisë së kompjuterizuar (CT scan) për vlerësimin e anatomisë ekzistuese. Dizajnimit kompjuterik (CAD) të implanteve të personalizuara. Prodhimit me printim 3D (CAM) të strukturave metalike. Teknikave kirurgjikale të avancuara për vendosje të sigurt dhe të parashikueshme.
Rezultate: Përvoja klinike tregon një shkallë të lartë suksesi në restaurimin oral të pacientëve me mungesë të plotë të kockës alveolare. Implantet e personalizuara kanë demonstruar stabilitet të qëndrueshëm, përmirësim të funksionit oral, dhe kënaqësi të lartë të pacientëve, duke reduktuar nevojën për ndërhyrje shtesë si graftet kockore.

Fjalë kyçe: implante të personalizuara, implant subperiostal, atrofia maksilare, printim 3D, kirurgji orale, rehabilitim oral pa kockë.

MIXED GRAFTS OF DEMINERALIZED DENTIN AND XENOGENEIC MATERIALS IN SOCKET PRESERVATION.
Angelo Michele Inchingolo; Alessio Danilo Inchingolo

Abstract
Tooth extractions are procedures that may cause dramatic dimensional changes of the alveolar ridge contour, resulting in a bone loss up to 60% with respect to the baseline level. Socket preservation is a technique aimed at preventing bone resorption after tooth extraction by the means of bone grafting materials. When it comes to bone grafting materials in regenerative dentistry, most of the biomaterials commonly placed in bone defects are xenogeneic grafts widely available in the market that act solely as scaffolds and do not induce osteogenesis. Demineralized dentin is characterized by osteoinductive properties as well as osteoconductivity, but there might limited availability of it due to the suboptimal condition of the extracted tooth. Therefore, by merging the advantages of both materials, dentin grafts mixed with xenogeneic grafts might lead to a new dimension in socket preservation.

Keywords: extractions, demineralized, dentin, tooth, grafts, resorption.

TRANSPLANTE TË KOMBINUARA TË DENTINËS SË DEMINERALIZUAR DHE MATERIALEVE KSENOGJENIKE NË RUAJTJEN E ALVEOLËS DENTARE.

Angelo Michele Inchingolo; Alessio Danilo Inchingolo

Abstrakt

Ekstraksionet dentare janë procedura që mund të shkaktojnë ndryshime të mëdha dimensionale në konturin e kreshtës alveolare, duke rezultuar në një humbje kockore deri në 60% në krahasim me nivelin bazal. Ruajta e alveolës (socket preservation) është një teknikë që synon parandalimin e resorbimit kockor pas ekstraksionit dentar, përmes përdorimit të materialeve për graftim kockor. Kur bëhet fjalë për materiale graftimi në stomatologjinë rigjenerative, shumica e biomaterialeve që përdoren zakonisht në defekte kockore janë graftet xenogjenike, të cilat janë gjerësisht të disponueshme në treg dhe veprojnë vetëm si skelë (scaffold), pa nxitur osteogjenezën. Dentina e demineralizuar karakterizohet nga veti osteoinduktive si dhe osteokonduktive, por mund të ketë disponueshmëri të kufizuar për shkak të gjendjes jo optimale të dhëmbit të nxjerrë. Prandaj, duke bashkuar përparësitë e të dy materialeve, graftet me dentinë të demineralizuar të përziera me graftet xenogjenike mund të çojnë në një dimension të ri në ruajtjen e alveolës.

Fjalë kyçe: ekstraksione, demineralizuar, dentinë, dhëmb, graft, resorbim.

MAXILLARY ATROPHY: CLASSIFICATION, CLINICAL MANAGEMENT OF THE SINUSES, AND ANALYSIS OF COMPLICATIONS.

Antonela Squillacioti

Abstract

Maxillary atrophy presents significant challenges in clinical and surgical practice. Its proper classification and management require a comprehensive understanding of sinus anatomy and associated complications. **Surgical Anatomy:** Detection of the infraorbital nerve emergence is essential. The second branch of cranial nerve V (N. Jaw) — the maxillary nerve — runs along the infraorbital groove as the infraorbital nerve. It emerges from the homonymous foramen, located approximately 7–8 mm from the orbital floor, and divides into the following branches: lower eyelids, external nasals, internal nasals and pper lips. Median and anterior upper alveolar branches, which descend inside the wall of the maxillary sinus between the bone and mucous tunic and resolve into thin dental and gingival branches. These branches anastomose with each other to create the superior dental plexus. This structure represents a distribution pathway for sympathetic, parasympathetic, and sensory fibers, similar to other branches of the trigeminal nerve, and carries sensory impulses from the lower eyelid, ala of the nose, upper lip (skin and mucosa), and gums. **Complications of Sinusitis: Bone:** Osteomyelitis of the anterior wall of the frontal sinus. **Orbital:** CORB, phlegmon, abscess, Altario, dacryocystitis **Endocranial:** Frontal cerebral abscess, Thrombophlebitis of the superior sagittal sinus, Cavernous sinus thrombophlebitis.

Keyword: Maxillary atrophy, infraorbital nerve, maxillary sinus, surgical anatomy, sinusitis complications, osteomyelitis, orbital cellulitis, cerebral abscess, thrombophlebitis.

ATROFIA MAKSILARE: KLASIFIKIMI, MENAXHIMI KLINIK I SINUSEVE DHE ANALIZA E KOMPLIKIMEVE.

Antonela Squillacioti

Abstrakt

Hyrje: Atrofia maksilare paraqet sfida të rëndësishme në praktikën klinike dhe kirurgjikale. Klasifikimi dhe menaxhimi i duhur kërkojnë një kuptim të plotë të anatomisë së sinusit dhe komplikimeve të lidhura. **Anatomia Kirurgjikale:** Identifikimi i daljes së nervit infraorbital është thelbësor. Dega e dytë e nervit kranial V (nervi i nofullës) nervi maksilar, kalon përgjatë groove infraorbital si nervi infraorbital. Ai del nga foramenti homonim, i vendosur rreth 7–8 mm nga dyshemeja orbitale, dhe ndahet në degët e mëposhtme: qepallat e poshtme, degët e jashtme të hundës, degët e brendshme të hundës, dhe buzët e sipërme.

Degët alveolare mediane dhe anteriorë të sipërm zbresin brenda murit të sinusit maksilar midis kockës dhe tonikës mukozale dhe përfundojnë në degë të holla dentare dhe gingivale. Këto degë anastomozohen për të krijuar plexusin dentar superior. Kjo strukturë përfaqëson një rrugë shpërndarjeje për fibra simpatike, parasimpatike dhe sensorike, si degët e tjera të nervit trigeminal, dhe bart impulset sensoriale nga qepalla e poshtme, krahina e hundës, buza e sipërme (lëkura dhe mukozë) dhe mishrat e dhëmbëve. **Komplikimet e Sinusit: kockat:** Osteomieliti i murit anterior të sinusit frontal, **Orbita:** CORB, flegmon, absces, Altario, dakriocistiti. **Endokraniale:** Absces cerebral frontal, tromboflebiti i sinusit sagital superior, tromboflebiti i sinusit kavernos.

Fjalë kyçe: atrofia maksilare, nervi infraorbital, sinusi maksilar, anatomia kirurgjikale, komplikimet e sinusit, osteomieliti, celuliti orbital, absces cerebral, tromboflebiti.

ENVIRONMENTAL IMPACT OF ORTHODONTICS: A LITERATURE REVIEW OF TRADITIONAL MULTIBRACKETS APPLIANCES AND CLEAR ALIGNERS.

Antonino Peluso[1 - 3], Giovanna Murmura[1], Bruna Sinjari[2], Michele D'Attilio[1]
[1]*Department of Innovative Technologies in Medicine & Dentistry, University "G. d'Annunzio" Chieti - Pescara, Chieti, Italy.*
[2]*High - Tech Dental Materials Laboratory, Department of Innovative Technologies in Medicine and Dentistry, University "G. d'Annunzio" Chieti - Pescara, Chieti, Italy.*
[3]*Department of Human Sciences, Law, and Economics, Telematic University Leonardo da Vinci, UNIDAV, Torrevecchia Teatina, 66100 Chieti, Italy.*

Abstract
Climate change has led to a growing interest in environmental sustainability in the healthcare sector, including orthodontics. This review aims to analyze and compare the environmental footprint of traditional multibrackets appliances (TMA) and clear aligners (CA) focusing on 5 aspects: manufacturing process, pollution from raw materials, clinical management and recycling potential. A comprehensive literature search was conducted on different databases: Pubmed, Scopus, Web of Science, Google Scholar and ScienceDirect. In addition, a manual and grey literature search was performed. The articles included in the review were then divided into the following categories: manufacturing processes, environmental impact of production, clinical management and waste generation with recycling potential. A total of 34 studies published between 2003 and 2004 along with academic books and technical / informational sources were analyzed. The production of TMA materials relies mainly on stainless - steel and alumina, while CA use thermoplastic polymers such as polyethylene terephthalate (PET), glycol - modified polyethylene terephthalate (PET - G) and polyurethane (PU). Although stainless - steel production generates higher CO2 emissions, it offer better recyclability. In contrast, CA materials production require more energy and generate larger amount of non - recyclable plastic waste. The environmental impact is also influenced by the clinical management of these therapies such as time and frequency of visits. Both systems contribute to environmental pollution. TMA appear more sustainable due to their recyclability and reduced waste generation. Future research should focus on improving recyclable polymers, sustainable production methods and optimized clinical workflows.

Keywords: orthodontics, environmental sustainability, clear aligners, multibracket appliances, carbon footprint.

NDIKIMI MJEDISOR I ORTODONCISË: NJË RISHIKIM I LITERATURËS MBI APARATET ORTODONTIKE TRADICIONALE ME BRAKETA DHE ALIGNERS TRANSPARENTË.

Antonino Peluso[1 - 3], Giovanna Murmura[1], Bruna Sinjari[2], Michele D'Attilio[1]
[1]*Department of Innovative Technologies in Medicine & Dentistry, University "G. d'Annunzio" Chieti - Pescara, Chieti, Italy.*
[2]*High - Tech Dental Materials Laboratory, Department of Innovative Technologies in Medicine and Dentistry, University "G. d'Annunzio" Chieti - Pescara, Chieti, Italy.*
[3]*Department of Human Sciences, Law, and Economics, Telematic University Leonardo da Vinci, UNIDAV, Torrevecchia Teatina, 66100 Chieti, Italy.*

Abstrakt
Ndryshimet klimatike kanë çuar në një interes të shtuar për qëndrueshmërinë mjedisore edhe në sektorin e kujdesit shëndetësor, përfshirë ortodoncinë. Ky rishikim ka për qëllim të analizojë dhe krahasojë ndikimin mjedisor të aparateve tradicionale me braketa (TMA) dhe trajtimeve me aligner - a transparentë (CA), duke u fokusuar në pesë aspekte: procesin e prodhimit, ndotjen nga lëndët e para, menaxhimin klinik dhe potencialin për riciklim. Është kryer një kërkim i gjerë në literaturë në bazat e të dhënave: PubMed, Scopus, Web of Science, Google Scholar dhe ScienceDirect. Përveç kësaj, u realizua edhe një kërkim manual dhe në literaturën gri. Artikujt e përfshirë në rishikim u ndanë në kategoritë: proceset e prodhimit, ndikimi mjedisor i prodhimit, menaxhimi klinik, prodhimi i mbetjeve dhe potenciali për riciklim. Në total, u analizuan 34 studime të publikuara midis viteve 2003 dhe 2004, së bashku me libra akademikë dhe burime teknike / informative. Prodhimi i materialeve për TMA bazohet kryesisht në çelik inox dhe aluminë, ndërsa CA përdorin polimere termoplastike si polietileni tereftalat (PET), PET i modifikuar me glikol (PET - G) dhe poliuretani (PU). Edhe pse prodhimi i çelikut gjeneron më shumë emisione CO_2, ai ofron një mundësi më të mirë për riciklim. Në të kundërt, prodhimi i materialeve për aligner - a kërkon më shumë energji dhe gjeneron një sasi më të madhe mbetjesh plastike që nuk riciklohen. Ndikimi mjedisor ndikohet gjithashtu nga mënyra e menaxhimit klinik të këtyre terapive, si koha dhe frekuenca e vizitave. Të dyja sistemet kontribuojnë në ndotjen mjedisore, por TMA shfaqen si më të qëndrueshme për shkak të mundësive për riciklim dhe prodhimit më të ulët të mbetjeve. Kërkimet e ardhshme duhet të fokusohen në zhvillimin e polimereve të riciklueshëm, metoda të qëndrueshme të prodhimit dhe optimizimin e praktikave klinike.

Fjalë kyçe: Ortodoncia, qëndrueshmëri mjedisore, aparate me braketa tradicionale, aligners transparentë, ndikim mjedisor, riciklim, polimere termoplastike, mbetje plastike, menaxhim klinik.

STATE OF THE ART IN ELASTODONTICS.

Antonio D'astore

Abstract
Introduction: Elastodontics is an emerging field within orthodontics that uses elastic functional appliances, typically preformed and made from soft, biocompatible materials such as medical - grade silicone. These devices are designed to guide craniofacial growth, correct dysfunctional habits, and improve occlusion. Their action is based on stimulating harmonious skeletal development, promoting neuromuscular reprogramming, enhancing tongue posture, and supporting respiratory and phonatory function.
Methodology: This review analyzes the latest scientific literature, clinical protocols, and technological advancements in elastodontic therapy. A systematic comparison of elastodontic devices, their indications, materials, and modes of action was conducted. The study also considers multidisciplinary contributions from gnathology, posturology, and myofunctional therapy, to better understand the holistic approach of elastodontics in treating malocclusions and functional disorders.
Results: Elastodontic therapy has shown promising results, especially in growing patients, by facilitating orthopedic and functional correction without invasive procedures. Clinical outcomes include improved dental arch development, reduction of oral dysfunctions (e. g. , mouth breathing, atypical swallowing), correction of class II and III tendencies, and postural balance enhancement. The non - invasive nature and ease of use make elastodontic devices highly accepted by patients, especially children.

Keywords: elastodontics, functional orthodontics, myofunctional therapy, craniofacial development, neuromuscular reprogramming, tongue posture, interceptive orthodontics.

GJENDJA AKTUALE NË ORTODONCINË FUNKSIONALE ELASTIKE.
Antonio D'astore

Hyrje: Elastodontia është një fushë në zhvillim brenda ortodoncisë, e cila përdor pajisje funksionale elastike, zakonisht të paraformuara dhe të prodhuara nga materiale të buta biokompatibile, si silikoni mjekësor. Këto pajisje synojnë të udhëheqin rritjen kranio - faciale, të korrigjojnë zakone orale të dëmshme dhe të përmirësojnë okluzionin. Veprimi i tyre bazohet në stimulimin e zhvillimit harmonik të strukturave skeletore, riprogramimin neuromuskular, përmirësimin e qëndrimit të gjuhës dhe mbështetjen e funksioneve respiratore dhe artikuluese.
Metodologjia: Ky punim paraqet një analizë të literaturës më të fundit shkencore, protokolleve klinike dhe zhvillimeve teknologjike në terapinë elastodoncike. Është kryer një krahasim sistematik i pajisjeve elastodontike, indikacioneve të tyre, materialeve dhe mënyrës së veprimit. Gjithashtu, janë marrë parasysh kontributet ndërdisiplinore nga gnatologjia, posturologjia dhe terapia miofunksionale, për të kuptuar më mirë qasjen holistike të elastodoncisë në trajtimin e malokluzioneve dhe çrregullimeve funksionale.
Rezultate: Terapia elastodontike ka treguar rezultate premtuese, veçanërisht tek pacientët në rritje, duke mundësuar korrigjime ortopedike dhe funksionale pa procedura invazive. Rezultatet klinike përfshijnë zhvillim të përmirësuar të harkut dentar, reduktim të disfunksioneve orale (si frymëmarrja me gojë, gëlltitja atipike), korrigjim të prirjeve të klasës II dhe III, si dhe përmirësim të ekuilibrit postural. Natyra jo - invazive dhe lehtësia në përdorim i bëjnë këto pajisje shumë të pranueshme, sidomos tek fëmijët.

Fjalë kyçe: elastodonti, ortodonci funksionale, terapi miofunksionale, zhvillimi kranio - facial, riprogramim neuromuskular, qëndrimi i gjuhës, ortodonci interceptive.

CONOMETRIC PROSTHESIS ON IMPLANTS: AN INNOVATION COMING FROM THE PAST.
Dr. Antonio DI CIAULA

Abstract
Introduction: The splinting with bars has raised concerns among researchers due to the possible interference of the rigid connection system of prosthetic bases on the elastic deformations of the mandible during function. The conometric prosthesis on implants allows for more periodontally correct reconstructions, as it facilitates the patient's plaque control. Other advantages include: the possibility of removal, making cleaning easier both for the prosthesis and the implants; absence of subgingival cement; excellent aesthetics because there are no channels or screws to cover; tissue support; and total passivation.
Objectives: The main objective of this research was to conduct a literature review concerning implant - supported overdentures compared to fixed prosthetic solutions. Specific objectives focus on identifying the positive advantages of the conometric prosthesis on implants versus bar - type or Toronto - type solutions.
Materials and Methods: The method used to create conometric prostheses on implants consists of the following steps: Removal of healing caps and taking an impression of the implant positions or oral scanning. Diagnostic fitting of the prosthesis in the mouth. Selection of angled titanium abutments. Milling of the abutments at a 2° angle. Fabrication of BioHPP caps on the abutments. Creation of a tertiary metal framework that is incorporated into the resin prosthesis designed. Fixing the BioHPP caps in the patient's mouth using a dual resin cement applied inside the prosthesis. After polymerization, removal of the prosthesis, removal of excess resin around the caps, and finishing. Delivery of the prosthesis to the patient.
Results: The one - year research results show an ideal situation: patients are very satisfied, the prosthesis is in excellent condition, and the peri - implant tissues are biologically healthy and stable. In light of the follow - up, it is clear that this procedure guarantees highly precise work with minimal use of machinery. After a 40 - month usage period, no clinical reduction in prosthesis retention was observed. The primary and tertiary cones are made of economical alloys free of noble metals. The tertiary structure is made in a single casting, thus avoiding the use of joining techniques between the connector and the tertiary element.

Conclusions: This new type of conometric overdenture offers the possibility of a removable restoration with comfort and functionality similar to fixed prostheses. A conometric - overdenture connection allows efficient retention through the use of an easy - to - manage and cost - effective BioHPP cap. This results in a highly valid solution that clinicians can consider when offering rehabilitation options that cannot be achieved with fixed prostheses. Undoubtedly, the most striking aspect of this technique is its practicality, along with the advantages for both clinician and patient in terms of cost, time for maintenance, and long - term success of implant rehabilitations.

Keywords: total edentulism, conometric overdenture, BioHPP caps.

PROTEZË KONOMETRIKE MBI IMPLANTE: NJË INOVACION ME RRËNJË NGA E KALUARA.

Dr. Antonio Di Ciaula

Abstrakt

Hyrje: Përdorimi i lidhjes me bara në protetikën mbi implante ka ngritur shqetësime te klinicistët dhe kërkuesit për shkak të interferencës së mundshme të sistemeve rigide të lidhjes me deformimet elastike fiziologjike të mandibulës gjatë funksionit. Proteza konometrike mbi implante ofron një rikonstruksion më të favorshëm periodontal duke lehtësuar kontrollin e pllakës bakteriale tek pacienti. Përfitime të tjera përfshijnë mundësinë e heqjes së lehtë për higjienë më të mirë të protelzës dhe implanteve, mungesën e cementit subgingival, estetikë superiore për shkak të mungesës së kanaleve apo vidave për mbulim, mbështetje të indeve të buta dhe pasivizim total të përshtatjes.

Qëllimi: Qëllimi kryesor i këtij studimi ishte realizimi i një rishikimi bibliografik mbi overdenture - t e mbështetura në implante krahasuar me zgjidhjet protetike fikse. Objektivat specifike ishin identifikimi i përfitimeve klinike dhe funksionale të protezës konometrike në krahasim me protetikën me bara ose ura të tipit Toronto.

Materialet dhe Metoda: Protokolli klinik për realizimin e protezave konometrike mbi implante përbëhet nga këto hapa: Heqja e kapakëve të shërimit dhe marrja e gjurmëve të pozicionit të implanteve ose skanimi dixhital intraoral. Provimi diagnostik i protezës në gojë. Zgjedhja e abutmenteve të titanit me kënd të përshtatshëm. Fresimi preciz i abutmenteve me një kënd prej 2°. Prodhimi i kapakëve BioHPP mbi abutmente. Ndërtimi i një strukture të tretë metalike e cila inkorporohet në protezën e projektuar me rezinë. Fiksimi i kapakëve BioHPP në gojën e pacientit me përdorimin e cementit resinor dikuar me polimerizim dy - fazor. Pas polimerizimit, heqja e protezës, heqja e resinës së tepërt rreth kapakëve dhe përfundimet përkatëse. Dorëzimi i protezës tek pacienti.

Rezultate: Në një vlerësim pas 1 viti, rezultatet tregojnë një situatë ideale klinike: pacientët janë shumë të kënaqur, proteza është në gjendje të shkëlqyer dhe indet peri - implantare janë biologjikisht të shëndetshme dhe të qëndrueshme. Protokolli siguron punë me saktësi të lartë dhe me përdorim minimal të pajisjeve laboratorike. Pas një periudhe përdorimi prej 40 muajsh, nuk u vu re asnjë humbje klinike e kapjes së protezës. Konet primar dhe terciar janë prodhuar nga aliazhe ekonomike pa metale të çmuara. Struktura terciar prodhohet me hedhje të vetme, duke shmangur teknikën e bashkimit midis lidhësit dhe elementit terciar.

Konkluzione: Overdenture - t konometrike paraqesin një alternativë të re për restaurim të heqshëm me rehati dhe funksionalitet të ngjashëm me protezat fikse mbi implante. Lidhja konometrike siguron mbajtje efikase përmes përdorimit të kapakëve BioHPP të lehtë për menaxhim dhe me kosto të ulët. Kjo teknikë ofron një zgjidhje të vlefshme që klinicistët mund ta konsiderojnë në rastet ku protetika fikse nuk është e mundur ose e përshtatshme. Avantazhi kryesor i kësaj metode qëndron në praktikën e saj, si dhe përfitimet në kosto, kohë të mirëmbajtjes dhe sukses afatgjatë të rehabilitimeve implantare për mjekun dhe pacientin.

Fjalë kyçe: edentulia totale, overdenture konometrike, kapakë BioHPP, protetikë implanti, restaurime të heqshme.

SUCCESS IN IMPLANT THERAPY: CLINICAL AND SURGICAL CONSIDERATIONS.
Antonio Lanza

Abstract
Dental implant therapy has become a well - established and predictable treatment option for the functional and aesthetic rehabilitation of partially or fully edentulous patients. Implant success, however, extends beyond osseointegration and must consider multiple parameters, including long - term implant stability, absence of peri - implant diseases (such as mucositis and peri - implantitis), preservation of peri - implant hard and soft tissues, and overall patient satisfaction. The surgical technique plays a pivotal role in achieving favorable outcomes. Alongside the conventional two - stage placement, modern approaches such as immediate implant placement post - extraction, immediate or early loading, flapless surgery, and computer - guided implant placement offer significant clinical advantages when properly indicated. These techniques can reduce invasiveness, shorten treatment times, and enhance patient comfort and esthetic outcomes. The choice of technique must be based on a comprehensive evaluation of anatomical, functional, and prosthetic factors. Ultimately, long - term success in implant therapy relies on accurate treatment planning, a personalized and multidisciplinary approach, and adherence to evidence - based surgical protocols. Regular maintenance and monitoring further contribute to the longevity and stability of implant - supported restorations.

Keywords: Dental implant therapy, implant success, osseointegration, peri - implant diseases, surgical techniques.

SUKSESI NË TERAPINË ME IMPLANTE: KONSIDERATA KLINIKE DHE KIRURGJIKALE.
Antonio Lanza

Abstrakt
Terapia me implante dentare është bërë një opsion trajtimi i mirëvendosur dhe i parashikueshëm për rehabilitimin funksional dhe estetik të pacientëve me pjesërisht ose plotësisht humbje të dhëmbëve. Suksesi i implantit, megjithatë, shkon përtej osseointegrimit dhe duhet të marrë parasysh disa parametra, përfshirë stabilitetin afatgjatë të implantit, mungesën e sëmundjeve peri - implantuese (si mucoziti dhe peri - implantiti), ruajtjen e indeve të forta dhe të buta përreth implantit, si dhe kënaqësinë e përgjithshme të pacientit. Teknikat kirurgjikale kanë një rol kyç në arritjen e rezultateve të favorshme. Përveç teknikës konvencionale të vendosjes në dy etapa, qasjet moderne si vendosja e menjëhershme e implantit pas nxjerrjes së dhëmbit, ngarkimi i menjëhershëm ose i hershëm, kirurgjia pa flap (flapless surgery) dhe vendosja e implantit me asistencë kompjuterike ofrojnë përparësi klinike të rëndësishme kur janë të indikacionit të duhur. Këto teknika mund të reduktojnë invazivitetin, të shkurtrojnë kohën e trajtimit dhe të përmirësojnë komoditetin e pacientit dhe rezultatin estetik. Zgjedhja e teknikës duhet të bazohet në një vlerësim gjithëpërfshirës të faktorëve anatomikë, funksionalë dhe protetikë. Në fund të fundit, suksesi afatgjatë në terapinë me implante mbështetet në planifikimin e saktë të trajtimit, qasjen e personalizuar dhe multidisiplinare, si dhe në zbatimin e protokolleve kirurgjikale bazuar në evidencë shkencore. Kujdesi dhe monitorimi i rregullt kontribuojnë gjithashtu në qëndrueshmërinë dhe jetegjatësinë e rehabilitimeve të mbështetura në implante.

Fjalë kyçe: Terapia me implante dentare, sukses i implantit, osseointegrimi, sëmundjet peri - implantuese, teknika kirurgjikale.

IMMEDIATE LOADING IN IMPLANT DENTISTRY: CURRENT SURGICAL AND PROSTHETIC APPROACHES.
Antonio Lanza

Abstract
Immediate loading has become a well - established therapeutic strategy in implant dentistry, aiming to reduce treatment time and enhance patient experience without compromising clinical predictability. Successful application of this protocol requires strict adherence to biological and clinical criteria, both surgically and

prosthetically. From a surgical perspective, achieving primary stability (≥35 Ncm) and ensuring sufficient bone quality and volume are essential prerequisites. Current evidence supports the use of implants with macro - designs optimized for immediate loading, often placed in post - extraction sites or using flapless techniques to reduce invasiveness and preserve peri - implant tissues. On the prosthetic side, screw - retained provisional restorations with controlled occlusal contacts and reduced functional loading are preferred, in order to minimize micromovement and promote successful osseointegration. A fully digital workflow allows for integrated surgical and prosthetic planning, improving accuracy and predictability. One of the most relevant aspects of immediate loading is the optimization of treatment timing, particularly concerning the delivery of the provisional restoration. In this context, the recently introduced DIL (Digital Immediate Loading) technique significantly enhances clinical efficiency through the application of an integrated digital protocol, enabling rapid and precise fabrication and placement of provisional prostheses. In conclusion, immediate loading, when properly indicated and executed, offers a predictable solution aligned with the functional and aesthetic demands of modern patients. The adoption of evidence - based protocols and a multidisciplinary approach is essential to ensure long - term success.

Keywords: Immediate loading, implant dentistry, digital workflow, primary stability.

NGARKESA E MENJËHERSHME NË IMPLANTOLOGJI DENTARE: QASJET KIRURGJIKALE DHE PROTETIKE AKTUALE.

Antonio Lanza

Abstrakt

Ngarkesa e menjëhershme është bërë një strategji terapeutike e mirëpërcaktuar në implantologjinë dentare, me qëllim të shkurtimit të kohës së trajtimit dhe përmirësimit të përvojës së pacientit, pa kompromentuar parashikueshmërinë klinike. Zbatimi i suksesshëm i këtij protokolli kërkon respektim të rreptë të kritereve biologjike dhe klinike, si në aspektin kirurgjikal ashtu edhe në atë protetik. Nga pikëpamja kirurgjikale, arritja e stabilitetit fillestar (≥ 35 Ncm) dhe sigurimi i cilësisë dhe vëllimit të mjaftueshëm të kockës janë parakushte thelbësore. Evidenca aktuale mbështet përdorimin e implanteve me dizajn makro të optimizuar për ngarkesë të menjëhershme, të cilat shpesh vendosen në vende post - eksktraksioni ose përmes teknikave pa ngritje të flap - it (flapless), me qëllim të reduktimit të invazivitetit dhe ruajtjes së indeve rreth implantit. Në aspektin protetik, preferohen restaurimet provizore të fiksuara me vidë, me kontakte të kontrolluara okluzale dhe ngarkesë funksionale të reduktuar, në mënyrë që të minimizohet mikrolëvizja dhe të promovohet osteointegrimi i suksesshëm. Një rrjedhë pune plotësisht digjitale mundëson planifikim të integruar kirurgjikal dhe protetik, duke përmirësuar saktësinë dhe parashikueshmërinë. Një nga aspektet më të rëndësishme të ngarkesës së menjëhershme është optimizimi i kohës së trajtimit, veçanërisht në lidhje me dorëzimin e restaurimit provizor. Në këtë kontekst, teknika e sapo prezantuar DIL (Digital Immediate Loading) përmirëson ndjeshëm efikasitetin klinik përmes aplikimit të një protokolli të integruar digjital, duke mundësuar prodhimin dhe vendosjen e shpejtë dhe precize të protezave provizore. Në përfundim, ngarkesa e menjëhershme, kur është e treguar dhe zbatuar siç duhet, ofron një zgjidhje të parashikueshme që përputhet me kërkesat funksionale dhe estetike të pacientëve modernë. Zbatimi i protokolleve të bazuara në evidencë dhe një qasje multidisiplinare janë thelbësore për të siguruar sukses afatgjatë.

Fjalë kyçe: ngarkesë e menjëhershme, implantologji dentare, rrjedhë pune digjitale, stabilitet fillestar.

ATYPICAL SWALLOWING AND MYOFUNCTIONAL THERAPY: FROM DIAGNOSIS TO RE - EDUCATION.

Antonio Rizzo, Lucia Pia Zaminga

Abstract

Atypical swallowing is a common condition that can affect not only the development of dental occlusion, but also tongue posture, breathing, and the balance of the orofacial musculature. It often arises during childhood as a result of prolonged oral habits such as thumb sucking, pacifier use, or mouth breathing, which interfere with

the normal maturation of swallowing patterns. If left untreated, this condition may contribute to dental malocclusions, altered craniofacial growth, and speech difficulties. Early recognition is essential to prevent long - term complications and the persistence of dysfunctional habits, which can become deeply ingrained over time. Myofunctional therapy has emerged as an effective rehabilitative tool, capable of restoring correct swallowing through targeted exercises aimed at improving muscle tone, coordination, and neuromuscular control of the orofacial region. When applied consistently, these therapeutic protocols can promote more stable orthodontic outcomes and enhance overall oral function. This presentation aims to illustrate the most common clinical features of atypical swallowing, its potential long - term consequences, and the benefits achievable through the application of myofunctional protocols, while emphasizing the importance of an interdisciplinary approach involving speech therapists, dentists, orthodontists, and other health professionals in achieving optimal and lasting results.

Keywords: myofunctional, therapy, dentists, muscle, tone, coordination.

GËLLTITJA ATIPIKE DHE TERAPIA MIOFUNKSIONALE: NGA DIAGNOZA DERI TE RIEDUKIMI FUNKSIONAL.

Antonio Rizzo, Lucia Pia Zaminga

Abstrakt

The use of new technologies in full - arch rehabilitations on implants plays an increasingly important role in the treatment of totally edentulous patients. The factors that determine success in digital workflows (I. O. S. , scanbody, 3D printers) must be carefully analyzed and the materials that must be used to obtain a predictable and long - lasting result must also be known. Even more important is the possibility of planning integrated treatment plans (Ortho - perio - implant - restorative) on digital platforms that allow the use of all the data available using digital tools. Monolithic full - arch restorations, particularly those made from high - strength zirconia, have become the preferred choice due to their durability and biocompatibility. Their one - piece design reduces the risk of mechanical failure compared to layered prosthetics. Digital impressions, when captured accurately, eliminate the need for conventional materials and reduce patient discomfort. The accuracy of scan body positioning is critical, as even minor misalignments can lead to prosthetic misfit. Advanced CAD software allows the clinician and dental technician to design restorations with precise occlusion, esthetics, and phonetics. The digital workflow also improves communication between the clinical and laboratory teams. 3D printing facilitates the creation of surgical guides, temporary prostheses, and verification jigs with high accuracy. Milling centers can produce monolithic restorations within shorter timeframes, improving overall efficiency. Through facial scanning and digital smile design, esthetic outcomes can be previewed and adjusted before finalization. This workflow also enables clinicians to simulate implant positioning relative to anatomical limitations. With CBCT integration, bone quality and nerve proximity can be assessed digitally. Guided surgery based on digital planning enhances surgical precision and reduces chair time. The reduction in appointments is beneficial for elderly or medically compromised patients. Additionally, digital archiving of cases allows for easy duplication or repair if needed in the future. Material selection, such as choosing between zirconia, PMMA, or hybrid composites, must be based on biomechanical needs and patient - specific factors. Monolithic restorations provide excellent resistance to wear and staining. Patient satisfaction is typically higher due to faster delivery times and improved esthetics. Load distribution in monolithic arches must be carefully planned to avoid overloading implants. The passive fit of the prosthesis is more achievable with digital workflows than with

analog techniques. Overall, the fully digital workflow reduces manual errors, enhances predictability, and streamlines the treatment process for both clinicians and patients.

Keywords: Arch implant, restorations, digital platforms.

RESTAURIMET MONOLITIKE TË HARKUT TË PLOTË MBI IMPLANTE (NË KUADËR TË PUNËS SË PLOTË DIGJITALE).

Prof. Piero Venezia

Abstrakt

Përdorimi i teknologjive të reja në rehabilitimet e harkut të plotë mbi implante luan një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në trajtimin e pacientëve plotësisht edentulë. Faktorët që përcaktojnë suksesin në rrjedhat e punës digjitale (skanerët intraoralë - I. O. S. , elementët e skanimit – scanbodies, printerët 3D) duhet të analizohen me kujdes, po ashtu edhe njohja e materialeve që duhen përdorur për të arritur një rezultat të parashikueshëm dhe afatgjatë është thelbësore. Edhe më i rëndësishëm është potenciali për të planifikuar trajtime të integruara multidisiplinare (ortodontike, periodontale, implanto - protetike dhe restauruese) në platforma digjitale që lejojnë përdorimin e të gjithë të dhënave të disponueshme përmes mjeteve digjitale. Restaurimet monolitike të harkut të plotë, veçanërisht ato të realizuara me zirkon të forcës së lartë, janë bërë zgjedhja e preferuar për shkak të qëndrueshmërisë së tyre mekanike dhe biokompatibilitetit. Struktura e tyre një pjesë redukton rrezikun e dështimeve mekanike në krahasim me restaurimet e shtresuara. Marrja e masave digjitale, kur kryhet me saktësi, eliminon nevojën për materialet konvencionale dhe redukton ndjeshëm parehatinë për pacientin. Pozicionimi i saktë i scanbody - ve është kritik, pasi edhe devijimet më të vogla mund të çojnë në përshtatje të pasaktë të punës protetike. Softuerët CAD të avancuar i mundësojnë mjekut stomatolog dhe teknikut dentar të projektojnë restaurime me saktësi në okluzion, estetikë dhe fonetikë. Rrjedha digjitale e punës përmirëson gjithashtu komunikimin midis ekipit klinik dhe laboratorik. Printimi 3D lehtëson krijimin e udhëzuesve kirurgjikalë, protezave provizore dhe elementëve të kontrollit të saktësisë me një nivel të lartë precizioni. Qendrat e frezimit mund të prodhojnë restaurime monolitike brenda afateve më të shkurtra kohore, duke rritur efikasitetin e përgjithshëm. Përmes skanimit facial dhe dizajnit digjital të buzëqeshjes, rezultatet estetike mund të parashikohen dhe të rregullohen përpara dorëzimit final. Kjo mënyrë pune i lejon klinicistëve të simulojnë pozicionimin e implantit në përputhje me kufizimet anatomike. Me integrimin e imazherisë CBCT, cilësia e kockës dhe afërsia me strukturat nervore mund të vlerësohen në mënyrë digjitale. Kirurgjia e udhëzuar mbi bazën e planifikimit digjital përmirëson saktësinë kirurgjikale dhe redukton kohën në poltronet dentare. Reduktimi i numrit të seancave është veçanërisht i favorshëm për pacientët e moshuar ose ata me gjendje shëndetësore të kompromentuar. Gjithashtu, arkivimi digjital i rasteve lejon riprodhimin ose riparimin e punimeve në të ardhmen në mënyrë të thjeshtuar. Zgjedhja e materialit, si p. sh. ndërmjet zirkonit, PMMA - së apo kompoziteve hibride, duhet të bazohet në nevojat biomekanike dhe faktorët individualë të pacientit. Restaurimet monolitike ofrojnë rezistencë të shkëlqyer ndaj konsumit dhe njollosjes. Kënaqësia e pacientëve është zakonisht më e lartë falë kohës më të shkurtër të dorëzimit dhe rezultateve më estetike. Shpërndarja e ngarkesave okluzale në restaurimet monolitike duhet të planifikohet me kujdes për të shmangur mbingarkimin e implanteve. Përshtatja pasive e protezës është më lehtësisht e arritshme përmes punës digjitale sesa teknikave analoge. Në përmbledhje, puna e plotë digjitale redukton gabimet manuale, rrit parashikueshmërinë dhe optimizon të gjithë procesin terapeutik, si për klinicistët ashtu edhe për pacientët.

Fjalë kyçe: Hark implanti, restaurim, platforma digjitale.

MINIMALLY INVASIVE MANAGEMENT OF TEMPOROMANDIBULAR DISORDERS: FUNDAMENTAL STRATEGIES.

Reha S. Kisnisci

Abstract

Current direction of management of surgical diseases continues to narrow down for open and rather invasive surgical options. This reflects a broader trend toward patient - centered care, emphasizing faster recovery,

reduced complications, and shorter hospital stays. Among minimally invasive approaches, is noteworthy of gained acceptance for the management of various temporomandibular joint problems. These approaches are becoming increasingly preferred due to their effectiveness in treating both acute and chronic TMJ conditions with minimal trauma. Basically 2 modalities may be utilized to reverse and manage some temporomandibular disorders. Both methods aim to restore joint function, alleviate pain, and prevent long - term degenerative changes. Arthrocentesis and arthroscopy are that former being comparably less technique sensitive than the latter which requires a steep learning curve. While arthrocentesis is often performed under local anesthesia in outpatient settings, arthroscopy allows for more detailed visualization and intervention within the joint. The purpose of the lecture will be to discuss the fundamental background of both minimally invasive interventions. Emphasis will be placed on indications, clinical outcomes, procedural nuances, and recent advances in technology supporting these treatments.

Keywords: Temporomandibular joint, minimally invasive, arthroscopy, arthrocentesis.

MENAXHIMI INVAZIV MINIMALIST I ÇRREGULLIMEVE TË ARTIKULACIONIT TEMPOROMANDIBULAR: STRATEGJITË THEMELORE.

Reha S. Kisnisci

Abstrakt

Drejtimi aktual i menaxhimit të sëmundjeve kirurgjikale po shkon gjithnjë e më shumë drejt kufizimit të opsioneve të hapura sesa ndërhyrjet invazive kirurgjikale. Kjo pasqyron një tendencë më të gjerë drejt kujdesit të përqendruar te pacienti, duke theksuar rikuperimin më të shpejtë, komplikacionet e reduktuara dhe qëndrimet më të shkurtra në spital. Ndër qasjet minimale invazive, vlen të përmendet pranimi në rritje për trajtimin e problemeve të ndryshme të artikulacionit temporomandibular. Këto qasje po preferohen gjithnjë e më shumë për shkak të efektivitetit të tyre në trajtimin e gjendjeve të ATM - së si akute ashtu edhe kronike, me trauma minimale. Në thelb, dy modalitete mund të përdoren për të evituar dhe menaxhuar disa çrregullime temporomandibulare. Të dyja metodat synojnë të rivendosin funksionin e artikulacionit, të lehtësojnë dhimbjen dhe të parandalojnë ndryshimet degjenerative afatgjata. Artrocenteza dhe artroskopia janë ato modalitete, ku e para është më pak e ndjeshme ndaj teknikës në krahasim me të dytën, e cila kërkon një kurbë të mprehtë të të nxënit. Ndërkohë që artrocenteza shpesh kryhet nën anestezi lokale në kushte ambulatore, artroskopia ofron vizualizim dhe ndërhyrje më të detajuar brenda artikulacionit. Qëllimi i leksionit do të jetë diskutimi i sfondit bazë të të dy ndërhyrjeve minimale invazive. Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet indikacioneve, rezultateve klinike, hollësive procedurale dhe zhvillimeve të fundit teknologjike që mbështesin këto trajtime.

Fjalë kyçe: Artikulacioni temporomandibular, minimal invaz, artroskopi, artrocentëzë.

THE INTERPLAY BETWEEN MYOFUNCTIONAL THERAPY AND ORTHODONTICS: ADVANCING GROWTH AND FUNCTIONAL OUTCOMES.

Sabina Saccomanno

Abstract

Myofunctional therapy has gained increasing attention as a complementary approach in orthodontics, particularly in growing patients. Orofacial dysfunctions—such as atypical swallowing, mouth breathing, and altered tongue posture—may compromise craniofacial development, stability of orthodontic outcomes, and overall functional balance. Orthodontic treatment alone often addresses dental alignment and occlusal relationships, but without correcting the underlying muscular patterns, relapse and functional limitations may persist. This lecture will explore the synergistic role of myofunctional therapy and orthodontics in achieving stable, long - term results. Clinical evidence and case presentations will highlight how integrating myofunctional re - education into orthodontic protocols can enhance skeletal growth, improve airway function, and optimize neuromuscular coordination. Emphasis will be placed on early diagnosis, timing of intervention, and interdisciplinary collaboration among orthodontists, speech therapists, and other specialists. The session aims to provide clinicians with practical strategies to incorporate myofunctional therapy into everyday orthodontic practice, ensuring both esthetic and functional success for patients in growth and beyond.

Keywords: myofunctional, orofacial, dysfunctions, re - education, evidence.

NDËRVEPRIMI MIDIS TERAPISË MYOFUNKSIONALE DHE ORTODONCISË: PËRPARIMI I RRITJES DHE I REZULTATEVE FUNKSIONALE.

Sabina Saccomanno

Abstrakt

Terapia miofunksionale ka fituar gjithnjë e më shumë vëmendje si një qasje plotësuese në ortodonci, veçanërisht tek pacientët në rritje. Disfunksionet orofaciale — si gëlltitja atipike, frymëmarrja me gojë dhe qëndrimi i ndryshuar i gjuhës — mund të kompromet ojnë zhvillimin kraniofacial, stabilitetin e rezultateve ortodontike dhe ekuilibrin funksional të përgjithshëm. Trajtimi ortodontik në vetvete shpesh adreson vetëm rreshtimin dentar dhe marrëdhëniet okluzale, por pa korrigjuar modelet muskulare themelore, rikthimi i anomalive dhe kufizimet funksionale mund të vazhdojnë. Kjo ligjëratë do të eksplorojë rolin sinergjik të terapisë miofunksionale dhe ortodoncisë në arritjen e rezultateve të qëndrueshme dhe afatgjata. Evidenca klinike dhe paraqitjet e rasteve do të theksojnë se si integrimi i riedukimit miofunksional në protokollet ortodontike mund të përmirësojë rritjen skeletore, funksionin e rrugëve të frymëmarrjes dhe të optimizojë koordinimin neuromuskular. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet diagnostikimit të hershëm, kohës së ndërhyrjes dhe bashkëpunimit ndërdisiplinor midis ortodontëve, logopedëve dhe specialistëve të tjerë. Sesioni synon t'u ofrojë klinicistëve strategji praktike për të integruar terapinë miofunksionale në praktikën e përditshme ortodontike, duke siguruar sukses si estetik ashtu edhe funksional për pacientët në fazë rritjeje dhe më tej.

Fjalë kyçe: miofunksionale, orofaciale, disfunksione, riedukim, evidencë.

FROM OCCLUSION TO POSTURE: THE MANDIBLE AS A NEUROMUSCULAR INTERFACE IN THE CRANIO - CERVICO - MANDIBULAR SYSTEM.

Sara Savastano

Abstract

Dental occlusion represents much more than a simple relationship between dental arches: it is the peripheral expression of a dynamic and integrated equilibrium involving the mandible, the hyoid bone, the tongue, the cranial base, the cervical spine, and the plantar support. In this holistic view, the mandible emerges as a strategic neuromuscular interface, capable of influencing the entire body's organization through fascial, proprioceptive, and receptor - based connections. According to the theories of Pedro Planas, Jeffrey Okeson, Rodolfo Stefanelli, Jean - Pierre Meersseman, and Mariano Rocabado, occlusal balance cannot be separated from postural and neuromotor balance. The occlusal plane conditions the position and function of the mandible, influencing the structure of the cranio - cervico - mandibular system and overall posture. Occlusal disharmony can act as a destabilizing factor, triggering a chain of compensatory adaptations throughout the body. However, when compensatory mechanisms are no longer sufficient to maintain adaptation, compromising the system's tensegrity, a "breaking point" is reached, leading to the emergence of neuromuscular, articular, and neurological dysfunctions: headaches, neck pain, temporomandibular disorders, vertigo, tinnitus, neuralgias, and alterations in plantar support. This work presents clinical cases of dysfunctional patients treated with neuromuscular appliances and mandibular motor reprogramming, through an approach centered on restoring the global equilibrium of the human system.

Keywords: dental, arches, mandible, cranial base, plantar, system.

NGA OKLUZIONI TE QËNDRIMI TRUPOR: MANDIBULA SI NDËRLIDHJE NEUROMUSKULARE NË SISTEMIN KRANIO - CERVIKO - MANDIBULAR.
Sara Savastano

Abstrakt
Okluzioni dentar përfaqëson shumë më tepër sesa një marrëdhënie të thjeshtë midis harqeve dentare: ai është shprehja periferike e një ekuilibri dinamik dhe të integruar që përfshin mandibulën, kockën hioide, gjuhën, bazën kraniale, shtyllën kurrizore cervikale dhe mbështetjen plantare. Në këtë këndvështrim holistik, mandibula shfaqet si një ndërfaqe strategjike neuromuskulare, e aftë të ndikojë në organizimin e të gjithë trupit përmes lidhjeve fasciale, propioceptive dhe receptoriale. Sipas teorive të Pedro Planas, Jeffrey Okeson, Rodolfo Stefanelli, Jean - Pierre Meersseman dhe Mariano Rocabado, ekuilibri okluzal nuk mund të ndahet nga ekuilibri postural dhe ai neuromotor. Plani okluzal përcakton pozicionin dhe funksionin e mandibulës, duke ndikuar në strukturën e sistemit kranio - cerviko - mandibular dhe në qëndrimin e përgjithshëm trupor. Dis - harmonia okluzale mund të veprojë si faktor destabilizues, duke shkaktuar një zinxhir adaptimesh kompensuese në të gjithë trupin. Megjithatë, kur mekanizmat kompensues nuk janë më të mjaftueshëm për të ruajtur përshtatjen, duke kompromentuar tensegritetin e sistemit, arrihet një "pikë thyerjeje", e cila çon në shfaqjen e çrregullimeve neuromuskulare, artikulare dhe neurologjike: dhimbje koke, dhimbje cervikale, çrregullime temporomandibulare, marramendje, zhurma në veshë, neuralgji dhe ndryshime në mbështetjen plantare. Ky punim paraqet raste klinike të pacientëve me disfunksione, të trajtuar me pajisje neuromuskulare dhe riedukim motorik mandibular, përmes një qasjeje të përqendruar në rikthimin e ekuilibrit global të sistemit njerëzor.
Fjalë kyçe: dentar, harqe, mandibulë, bazë kraniale, plantare, sistem.

QASJA KLINIKE NË TRAJTIMIN E DHËMBËVE TË IMPAKTUAR SI PASOJË E PERSISTENCËS SË DHËMBËVE TË QUMËSHTIT.
Prof. Dr. Abdyl Izairi, Anda Izairi, Vebi. E, Ardi. I
IPSH Dental Lux, Tetovë

Abstrakt
Hyrje: Terapia e kaninëve të impaktuar paraqet një problem serioz specifik nga aspekti i zgjedhjes së ndërhyrjes terapeutike - kirurgjike, për secilin rast në veçanti por në të shumtën e rasteve kërkon një bashkëpunim të ngushtë interdisciplinar me ortodontin.
Qëllimi: Qëllimi i trajtimit është eruptimi i detyruar i kaninëve duke perdorur metoda ortodontiko kirurgjike. Qëllimi i dytë është sjellja e tyre në okluzion. Terapia: Terapia e ndërhyrjes kirurgjike të kaninëve maksilar varësisht nga mosha e pacientëve mund të jetë: ortodontiko - kirurgjike, kirurgjiko - ortodontike, kirurgjike dhe metoda e observimit. Në materialin tonë janë paraqitur disa raste të moshave të ndryshme me diagnozë dhëmb i impaktuar (dens impacta).
Rezultatet: Rezultatet tregojnë se impakcionet e kaninëve maksilar janë më të shpeshtë se ato mandibular. Impakcionet e kaninëve maksillar janë më të shpeshtë te gjinia femërore.
Konkluzione: Parashikimi i vështirësisë së eruptimit të kaninëve të impaktuar maksilar, duke u bazuar në opinionin e ortodontistëve me eksperiencë, faktori moshë, angulacioni, distanca vertikale nga rrafshi okluzal janë shumë të rëndësishme.

Fjalë kyçe: impaktimi, kaninët, bimaksilar.

EFEKTI I PRF - SË KRAHASUAR ME MATERIALET E TJERA RIGJENERUESE NË TERAPINË PERIODONTALE.
Adea Karakashi

Abstrakt
Rigjenerimi periodontal vazhdon të jetë një sfidë kryesore në periodontologji, me një gamë të gjerë materialesh që përdoren për të përmirësuar shërimin dhe rigjenerimin e indeve. Ky rishikim sistematik ka për qëllim të krahasojë efektivitetin klinik të Fibrinës së Pasur me Trombocite (PRF) me materiale të tjera rigjeneruese të

zakonshme – si membranat për rigjenerim të të indeve, graftet kockore në terapinë periodontale. Një kërkim në literaturë nga viti 2015 deri në 2025 identifikoi 38 studime klinike që vlerësuan parametra si niveli i ngjitjes së gingivës, reduktimi i thellësisë së xhepit periodontal (PD) dhe shpenzimi radiografik i kockës. Rezultatet treguan se PRF promovon në mënyrë të qëndrueshme shërimin e indeve të buta dhe të forta, shpesh duke qenë e barabartë ose më e efektshme sesa materialet tradicionale rigjeneruese, sidomos kur përdoret në terapi të kombinuara. Avantazhet e PRF përfshijnë natyrën autologe, koston e ulët, përdorimin e lehtë dhe mungesën e reaksioneve imune. Megjithatë, heterogjeniteti në dizajnet e studimeve dhe kohëzgjatjet e ndjekjes kufizojnë krahasimet direkte. Nevojiten më shumë studime të kontrolluara dhe të standardizuara për të vendosur protokolle të qarta klinike.

Fjalë kyçe: Fibrina e pasur me trombocite, rigjenerim periodontal, materiale rigjeneruese, graft kockor, efektivitet klinik, rishikim sistematik.

INTELIGJENCA ARTIFICIALE NË DIAGNOSTIKIMIN RADIOGRAFIK DENTAR: NJË RISHIKIM SISTEMATIK MBI SAKTËSINË DIAGNOSTIKE DHE APLIKUESHMËRINË KLINIKE.

Adea Karadeshi, Leke Karakashi

Abstrakt

Sëmundjet orale janë ndër sëmundjet joinfektive më të zakonshme që prekin fëmijët dhe adoleshentët në mbarë botën. Edukimi i hershëm dhe kujdesi parandalues janë thelbësorë për të reduktuar pasojat afatgjata shëndetësore. Ky rishikim sistematik shqyrton rolin e inteligjencës artificiale (IA) në promovimin e ndërgjegjësimit për shëndetin oral dhe në mbështetjen e stomatologjisë parandaluese tek individët e moshës 5–18 vjeç. Një kërkim gjithëpërfshirës në bazat e të dhënave për periudhën 2010–2025 identifikoi 42 studime përkatëse që përdorin mjete të IA - së si aplikacione mobile, platforma të gamifikuara, chatbot - e dhe mjete diagnostikuese me imazhe. Këto ndërhyrje treguan rezultate pozitive në përmirësimin e sjelljeve të higjienës orale, ruajtjen e njohurive dhe zbulimin e hershëm të problemeve dentare. Megjithatë, ndryshimet në cilësinë e studimeve, mungesa e ndjekjes afatgjatë dhe mungesa e fokusit në barazinë dixhitale dhe privatësinë e të dhënave përbëjnë kufizime të rëndësishme. Ndërsa IA paraqet potencial të konsiderueshëm, nevojiten kërkime më të thelluara, afatgjata dhe etike për të vlerësuar efektivitetin dhe shkallëzueshmërinë e saj.

Fjalë kyçe: Inteligjenca artificiale, stomatologji parandaluese, shëndeti oral, fëmijët, adoleshentët, shëndet dixhital, edukim.

KEQINFORMIMI NË RRJETE SOCIALE LIDHUR ME PRAKTIKAT E KUJDESIT DENTAR DHE TRAJTIMEVE PROFESIONALE.

Adora Shpati[1], Adela Alushi[1, 2], Alba Kamberi[1]
[1]*Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri*
[2]*Universita degli Studi "G. d'Annunzio" Chieti, Itali*

Abstrakt

Hyrje: Aksesi i gjerë në internet dhe mungsa e filtrave dhe kontrolli të përmbajtjeve të ngarkuara, vë përdoruesit në kontakt me video informative lidhur me kujdesin dentar, të cilat përmbajnë informacione të gabuara dhe të pabazuara në fakte, duke sjellë dyshime dhe hezitime tek pacientët që vijnë në klinikën dentare për të kryer trajtime.

Qëllimi: Evidentimi i disa prej teorive më të përhapura keqinformuese lidhur me trajtimet dentare dhe shqetësimet lidhur me to që pacientët referojnë tek dentisti.

Materiale dhe metoda: Kërkimi në rrjete sociale në hashtags me fjalë kyce si dentist naturopath, oil pulling, natural dental treatment,

Rezultate: Teoritë më të zakonshme të shpërndara në rrjetet sociale lidhen me mundësine e trajtimit të kariesit pa ndërhyrje nga dentisti, oil pulling, frika për trajtime endodontike pas shpërndarjes së disa teorive lidhur me korrelacionin midis trajtimit endodontik dhe kancerit të gjirit, por më së shumti përqëndrohen në përmbajtjen e

fluorit në pastat apo produktet e tjera dentare dhe e konsiderojnë shkaktar të disa problemeve lokale dhe sistemike.
Konkluzione: Keqinformimi ka sjellë hezitime tek pacientët, të cilët behën gjithnjë e më shumë dyshues lidhur me trajtimet dentare, duke rënduar situatën nga mosmarrja e trajtimit të duhur dhe përkeqësimi i situatës së shëndetit oral.

Fjalë kyce: keqinformim, dentist naturopat, mjekësi alternative.

METODAT MODERNE PËR DIAGNOSTIKIM TË KARIESIT TË DHËMBËVE.
Agaton Xërxa
Dentika Dent

Abstrakt
Hyrje: Diagnostikimi i saktë dhe trajtimi i kariesit në fazat më të hershme, ku ende nuk janë shfaqur simptomat e saj është i rëndësishëm. Prania për punë klinike e metodave të reja diagnostikuese të sofistikuara dhe ato në zhvillim, zgjeron mundësinë e diagnostikimit të hershëm të kariesit të dhëmbëve, dhe mundëson një hap të madh në avansim të diagnostikës si proces dhe trajtimit të sëmundjes së kariesit të dhëmbëve. Të gjitha metodat diagnostike kanë për qëllim të përbashkët diagnostikimin e sëmundjes së kariesit në fazat e hershme të saj. Viteve të fundit teknologjitë e avancuara diagnostike janë duke zënë vend shumë të rëndësishëm në këtë proces. Por, edhe pse janë studiuar dhe prezantuar këto metoda ende nuk janë studiuar në mënyrë të detajuar për të vendosur konkluzion definitiv mbi efektshmërinë e saktë të tyre. Disa prej tyre principet e punës ende i kanë të vendosura në baza hipotetike. Poashtu këto metoda nuk janë të afta të bëjnë diagnostikimin e lezioneve kariotike si të vetme, por gjithmonë duhet të kombinohen me metodat konvencionale. Prandaj këto mangësi të tyre, ende po studiohen dhe po eleminohen duke mundësuar që në të ardhmen çdo ndryshim minimal në strukturën e dhëmbit të detektohet duke bërë një kthesë për modernizimin e procesit të diagnostikimit dhe menaxhimit të sëmundjes së kariesit.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi ka qenë që duke shqyrtuar literaturën aktuale të publikuar mbi metodat moderne për diagnostikimin e kariesit të dhëmbëve, të bëjmë përditësimin e njohurive mbi teknikat dhe metodat më të reja diagnostikuese, rëndësinë e diagnostikimit të kariesit në fazat më të hershme të tij, rëndësinë dhe efikasitetin e metodave të reja gjatë punës klinike.
Metodologjia: Punimi është realizuar në trajtën e "rishikimit të literaturës" mbi metodat moderne për diagnostikimin e kariesit të dhëmbëve. Të dhënat për punim janë mbledhur nga tekstet mësimore universitare dhe nga publikimet më të reja botërore në platformat si Web of Science, Scopus, Pubmed, Medline, Google Scholar dhe Medscape. Publikimet e pranueshme janë zgjedhur pas rishikimit të titujve, abstrakteve, rezultateve, përfundimeve dhe referencave.
Rezultate: Metodat konvencionale diagnostike përdoren më shpesh gjatë punës së përditshme klinike dhe janë më të lira ndërsa metodat e avancuara janë më të afta se metodat konvencionale për detektimin e kariesit të dhëmbit. Metodat fluoreshente për diagnostikimin e kariesit në sipërfaqet okluzale kanë ndjeshmëri, specifitet dhe saktësi në vlera (86. 9, 88. 9 dhe 87. 8) më të larta se inspeksioni vizual dhe radiografia. SROC – "summary receiver operating characteristic" sipas performancës të parat i rendit metodat fluoreshente, inspeksionin dhe pastaj radiografinë. Në detektimin e kariesit të sipërfaqeve aproksimale fluoreshenca prap për nga sensitiviteti dhe saktësia renditet e para. Radiografia renditet e fundit për nga sensitiviteti dhe saktësia por e para për nga specifiteti. Është gjetur që për kariesin në përgjithësi inspeksioni ka ndjeshmëri të lartë. Radiografia retrokoronare ka ndjeshmëri më të vogël krahasuar me metodat laserike fluoreshente dhe ACIS. Në ndjeshmërinë për kariesin dentinor, fluoreshenca laserike dhe ACIS tregojnë ndjeshmëri më të lartë se inspeksioni vizual dhe radiografia retrokoronare. Në ndjeshmërinë për kariesin dentinor, fluoreshenca laserike dhe ACIS tregojnë ndjeshmëri më të lartë se inspeksioni vizual dhe radiografia retrokoronare. Në ndjeshmërinë për kariesin e smaltit vlera më të mëdha tregon inspeksioni vizual. Shkalla e saktësisë së inspeksionit vizual është 65. 6%, 69. 8%, e radiografisë retrokoronare, 53. 1% e fluoreshencës laserike dhe 74. 0% e ACIS.

Fjalë kyçe: Diagnostikimi, kariesi, metodat, dhëmbëve.

ROLI I ERBIUM LASERËVE NË EFIKASITETIN E TRAJTIMIT ENDODONTIK.
Dr. sc. Agime Dragidella, Asst.

Abstrakt
Teknologjia laserike ka avancuar terapinë endodontike, duke mundësuar kështu ndërhyrje më precize, efikasitet më të lartë të pastrimit dhe dezinfektimit, si dhe ruajtjen e strukturës biologjike të dhëmbit. Ndër laserët që kanë gjetur aplikim klinik në endodonci, Erbium: YAG (Er: YAG) dhe Er, Cr: YSGG përfaqësojnë klasën më premtuese, për shkak të aftësisë së tyre për të vepruar në përbërjen ujore dhe hidroksiapatitin – komponentë kryesorë të dentinës dhe strukturave të dhëmbit. Në fazën e përpunimit të kanalit të rrënjës, energjia e Erbium laserit mundëson ablacion të kontrolluar të dentinës përmes proceseve fotomekanike dhe fototermike, duke krijuar kanale me mure të lëmuara dhe konicitet të përmirësuar. Kjo redukton rrezikun e devijimeve, transportimeve dhe ruan më mirë konfiguracionin natyror të kanalit, krahasuar me instrumentet konvencionale mekanike. Në aspektin **baktericid**, Erbium laserët kanë demonstruar efikasitet të lartë kundër mikroorganizmave rezistentë, si *Enterococcus faecalis* dhe *Candida albicans*, për shkak të efektit të kombinuar termik dhe fotomekanik shpërthyes, që çon në dëmtimin e membranave bakteriale dhe shkatërrimin e biofilmit. Ky veprim i dyfishtë kontribuon ndjeshëm në reduktimin e mikroorganizmave edhe në pjesët më të thella të tubuleve të dentinës. Një tjetër aspekt thelbësor është roli i Erbium laserëve në aktivizimin e irrigimit. Teknikat moderne si Photon - Induced Photoacoustic Streaming (PIPS) dhe Shock Wave Enhanced Emission Photoacoustic Streaming (SWEEPS) bazohen në impulsin e shpejtë të energjisë së laserit për të prodhuar mikro - kavitete vibrime brenda irriguesit, duke mundësuar depërtim më të thellë të NaOCl dhe EDTA - së në tubulat e dentinës. Po ashtu, Erbium laserët luajnë një rol kyç në largimin e shtresës smear, duke krijuar sipërfaqe të pastra dhe homogjene që përmirësojnë lidhjen dhe sigurimin e mbushjes hermetike obturuese të kanalit të rrënjës së dhëmbit. Në këtë ligjëratë plenare do të trajtohen në mënyrë të detajuar parimet biologjike dhe fizike të veprimit të Erbium laserëve, aplikimet e tyre klinike në formësim dhe irrigim, efektet antimikrobiale, si dhe potenciali i tyre në përmirësimin e suksesit afatgjatë të trajtimit endodontik.

Fjalë kyçe: Teknologjia laserike, terapi endodontike, efikasitet.

AUTOPLASTIKA LOKO - REGJIONALE E INDEVE TE BUTA NE REGJIONIN ORO - MAKSILO - FACIAL.
Alba Bimo
Kirurge maxilo - faciale

Abstrakt
Qëllimi: Me anë të këtij punimi bëhet një analizë statistikore e ndërhyrjeve kirurgjikale më të shpeshta në QSUT përgjatë 5 viteve, 2019 - 2024, në regjionin oro - maksilo - facial të indeve të buta si dhe vecoritë e tyre shoqëruar nga raste klinike.
Materiale dhe Metoda: Autoplastika loko - regjionale në regjionin oro - maksilo - facial përfaqëson një nga teknikat më të rëndësishme dhe të avancuara të kirurgjisë rekonstruktive, e cila bazohet në përdorimin e indeve autologe nga zona përreth për të rikonstruktuar defekte të lindura, post - traumatike apo pas rezeksioneve tumorale. Ky regjion anatomik ka një kompleksitet të lartë funksional dhe estetik, ndaj edhe kërkon qasje të kujdesshme kirurgjikale, të përshtatur për çdo pacient. Në këtë punim analizohen në mënyrë sistematike teknikat kryesore të autoplastikës, si transplantimi i indeve të lëkurës, mukozës, muskujve apo strukturave të kombinuara, të cilat përdoren për të rikthyer integritetin morfologjik dhe funksional të gojës, nofullës dhe strukturave përreth. Theksohet rëndësia e ruajtjes së vaskularizimit të indeve të përdorura, adaptimi anatomik, si dhe menaxhimi post - operator për të minimizuar komplikacionet dhe për të përmirësuar rezultatin final. Gjithashtu, punimi përfshin një vlerësim të përparësive që ofron autoplastika krahasuar me teknikat alloplastike, si biokompatibiliteti, shmangia e refuzimit të transplantit dhe rezultatet më të mira afatgjata.
Konkluzione: Në përfundim, autoplastika loko - regjionale paraqitet jo vetëm si një zgjedhje efektive, por edhe si një strategji kirurgjikale që respekton biologjinë natyrore të pacientit, duke ofruar rikuperim më të shpejtë dhe rezultate të qëndrueshme në një nga regjionet më delikate të trupit të njeriut.

Fjalë kyçe: autoplastika loko - regjionale, rikonstruksion kirurgjikal, integritet morfologjik, kompleksitet funksional, estetikë.

ROLI I HIGJIENISTIT DENTAR TE PACIENTI ME IMPLANT.
Alba Ceka

Abstrakt
Higjienisti dentar ka një rol themelor në ruajtjen e shëndetit të implanteve dentare. Detyra e tij kryesore është parandalimi i komplikimeve si mukoziti dhe peri - implantiti, duke siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të implantit. Gjatë seancave të mirëmbajtjes, higjienisti kontrollon gjendjen e indeve peri - implantarë, heq pllakën bakteriale dhe gurëzat me instrumente specifike që nuk dëmtojnë sipërfaqet e implantit, dhe vlerëson çdo shenjë të mundshme inflamacioni. Vlerësimi i saktë i thellësisë së xhepit periodontal, gjakrrjedhjes gjatë sondimit dhe gjendjes së indeve të buta mundëson identifikimin e hershëm të sëmundjeve peri - implantarë. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është edukimi i pacientit: higjienisti mëson teknikat e duhura të higjienës orale në kushte shtëpie dhe e motivon pacientin të ruajë një pastërti të mirë ditore dhe të respektojë kontrollet periodike. Protokollet e mirëmbajtjes përshtaten individualisht në bazë të statusit oral të pacientit, tipit të restaurimit protetik dhe faktorëve të rrezikut si duhanpirja ose kontrolli i pamjaftueshëm i pllakës bakteriale. Në fund, higjienisti bashkëpunon me stomatologun dhe periodontologun për monitorimin afatgjatë, duke kontribuar në mënyrë vendimtare në suksesin dhe stabilitetin e implantit. Kjo qasje multidisiplinare siguron zbulimin e hershëm të ndryshimeve patologjike dhe promovon jetëgjatësinë e restaurimeve të mbështetura mbi implante.

Fjalë kyçe: shëndet, dentar, implante, inflamacion.

LEZIONET E BARDHA TË MUKOZAVE ORALE DIAGNOZA DIFERENCIALE.
Albenita Buzhala

Abstrakt
Ky punim trajton lezionet e bardha të mukozave orale dhe rëndësinë e diagnozës diferenciale për përcaktimin e saktë të natyrës dhe shkakut të tyre. Lezionet e bardha orale mund të jenë kongenitale ose të fituara, të cilat karakterizohen nga ndryshime patologjike si trashja e keratinës, hiperplazia epiteliale, edema ndërqelizore dhe zvogëlimi i vaskularitetit. Në bazë të pamjes klinike dhe mundësisë së heqjes me garzë, ato ndahen në katër grupe kryesore: Lezionet kongenitale, Lezionet e fituara që mund të gërvishten, Lezionet e fituara që nuk mund të gërvishten me model specifik, Lezionet e fituara që nuk mund të gërvishten me model jospecifik. Diagnoza e saktë kërkon anamnezë të plotë, ekzaminim klinik, si dhe analiza laboratorike (patohistologjike, mikrobiologjike dhe hematologjike). Qëllimi i punimit është të rishikojë literaturën bashkëkohore mbi këto entitete dhe të ndihmojë mjekët stomatologë në identifikimin e hershëm dhe diferencimin e tyre nga patologjitë e tjera me pamje të ngjashme. Konkludohet se një qasje sistematike dhe progresive në diagnozën diferenciale zvogëlon rrezikun e trajtimeve të panevojshme dhe përmirëson kujdesin ndaj pacientit.

Fjalë kyçe: Lezionet e bardha orale, diagnoza diferenciale, stomatologji, mukozë orale, lezione kongenitale, lezione të fituara.

IMPLANTET MONOFAZIKE PËRKUNDREJT IMPLANTEVE BIFAZIKE DHE NGARKIMI PROTETIK I TYRE.
Dr. Albert Syla

Abstrakt
Implantologjia i referohet degës së stomatologjisë e cila merret me zëvendësimin e dhëmbëve nëpërmjet futjes së vidave implantare brenda indeve të forta kockore si mukoza, periosteumi ose direkt kocka. Ky zëvendësim mund të jetë i plotë ose i pjesshëm, pavarësisht nga niveli I edentulizmit që gjendet tek pacienti. Implantologjia orale, e cila përdor implantet e osteointegruara të përdorura si mbështetje për rehabilitimin e protezës fikse ose të lëvizshme, njihet botërisht si një metodologji e sigurt klinike e aftë për të garantuar rezultate të qëndrueshme në rehabilitimin oral. Synimi i kësaj teze është fillimisht të shpjegojë dhe më pas të krahasojë dy teknika: atë tradicionale bifazike dhe teknikës monofazike si teknika rehabilitimi. Implanti dentar monofazik e ka marrë emrin nga teknika të cilës i referohet: sistemi njëfazor. Implanti dentar monofazik është një implant me një

pjesë, vidë që futet në kockë. Ajo që ndodh në praktikë është se një implant monofazik, pasi të futet në kockë, do të dalë menjëherë nga gingivat. Me futjen e një implanti monofazik, blloku i implantit është në kontakt të drejtpërdrejtë me kockën dhe gingivat. Pasi të ketë kaluar periudha e osteointegrimit, vazhdohet menjëherë me vendosjen përfundimtare të kurorës. Implanti dentar bifazik, ndryshe nga ai monofazik, përbëhet nga disa pjesë që mund të montohen së bashku në kohë të ndryshme. Implanti futet në kockën mandibulare dhe mbulohet nga gingivat. Prandaj sistemi është i zhytur, i mbrojtur nga stresi mekanik dhe çdo infeksion bakterial. Pas përfundimit të fazës së osteointegrimit, gingiva rihapet, futet kapaku dhe pritet faza e shërimit të gingivave, përpara vendosjes së punimit protetik përfundimtar. Pra ngarkimi protetik mund të jetë i menjëhershëm apo i vonshëm post - integrim. Pozicionimi i një implanti post ekstraksionit kërkon kushte të veçanta sepse jo të gjithë pacientët janë kandidatë për këtë teknikë kirurgjikale. Ka kundërindikacione absolute, të cilat mjeku duhet t'i marrë parasysh. Nëse kjo procedurë menaxhohet siç duhet, ajo është në gjendje të prodhojë një rezultat të dëshiruar implant - protetik që garanton kënaqësinë dhe rehatinë e pacientit.

Fjalë kyçe: implante monofazike, implante bifazike, kockë, ekstraksion.

KRAHASIMI I EFIKASITETIT TË DEZINFEKTIMIT TË KANALEVE TË INFEKTUARA ME NJË SEANCË DHE ME SHUMË SEANCA. NJË STUDIM RASTI NË QENDRËN KLINIKE UNIVERSITARE STOMATOLOGJIKE TË KOSOVËS GJATË PERIUDHËS JANAR 2023 – JANAR 2024.

Albion Krasniqi

Abstrakt
Trajtimi endodontik konvencional mund të kryhet në disa vizita, megjithatë disa klinicistë sugjerojnë se trajtimi endodontik me një vizitë të vetme ka një shkallë më të lartë suksesi. Të dyja metodat, trajtimi me një seancë dhe trajtimi me shumë seanca kanë avantazhet dhe disavantazhet e tyre. Ky punim synon të krahasojë dezinfektimin e kanaleve të rrënjës së infektuar në një seancë kundrejt disa seancave, bazuar në të dhënat e mbledhura në Qendrën Klinike Universitare Stomatologjike të Kosovës gjatë periudhës janar 2023 – janar 2024. Gjithashtu, do të përshkruhet trendi i metodës së trajtimit në zonat rurale dhe urbane, sipas grupmoshave dhe komplikimeve pas operacionit.

Fjalë kyçe: trajtim endodontik, dezinfektimi i kanaleve të rrënjës, shkalla e shërimit në endodonti, endodoncia me një seancë, endodoncia me shumë seanca.

MBIVENDOSJA E INFLAMACIONEVE SEKONDARE NË PATOLOGJITË KRONIKE DHE TRAJTIMI I TYRE.

Dr. Aldo Vangjeli (PhD), Dr. Nasira Kopliku
Kirurg O. M. F, Lektor, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University

Abstrakt
Inflamacionet sekondare shfaqen shpesh mbi patologjitë kistike, jo vetëm për shkak të karakteristikave klinike të heshtura të këtyre formacioneve, por edhe si pasojë e mos trajtimit për një kohë të gjatë të ndryshimeve periapikale, të diagnostikuara ose jo. Kjo çon në rritjen e përmasave të tyre dhe ndërlikon trajtimin në shumë raste. Arsyetimi klinik në raste të tilla drejton drejt eliminimit të patologjive inflamatore sekondare fillimisht me terapi medikamentoze të përgjithshme dhe lokale (si hapje endodontike minimale për dekongjestion). Megjithatë, në prani të inflamacionit purulent të pa drenuar intra ose ekstrakapsular, shpesh i përhapur edhe në indet e buta për shkak të mungesës së fistulës, trajtimi duhet të jetë jo vetëm medikamentoz, por edhe kirurgjikal. Në këto raste, ndërhyrja incizion–drenim e kombinuar me antibioterapi, vitaminoterapi dhe stabilizimin e gjendjes së pacientit duhet të paraprijë trajtimin përfundimtar të patologjisë kistike. Kjo shmang përsëritjen e ndërhyrjes dhe humbjen e kohës terapeutike. Në material do të paraqiten raste klinike të komplikuara me inflamacion sekondar purulent, të trajtuara me një seancë kirurgjikale duke siguruar shërim per primam, pa rikthim të fenomeneve inflamatore.

Qëllimi: Ky punim synon të ilustrojë, me raste klinike, trajtimin kirurgjikal me një seancë të patologjive kistike me inflamacion sekondar purulent. Gjithashtu, të theksojë rreziqet dhe komplikacionet e mundshme, por edhe përfitimet e qarta që ky trajtim ofron.
Materiale dhe metoda: Të gjitha rastet janë trajtuar në kushte ambulatore, me anestezi lokale infiltrative ose trunkale
Diskutim: Raste të tilla janë të shumta në praktikën klinike. Ndërhyrjet mbi kistet ku është mbivendosur një patologji e dytë kanë rezultuar të suksesshme. Inflamacionet shpesh shoqërohen me sekrecione purulente, të cilat në shumë raste bëhen shkak për zbulimin e vetë patologjisë. Në një farë mënyre, kjo përbën të vetmen anë pozitive të tyre.
Konkluzione: Trajtimi kirurgjikal me një seancë i patologjive kistike të komplikuara nga inflamacioni sekondar purulente: nuk e përjashton nevojën e terapisë paraprake të përgjithshme dhe lokale; redukton përdorimin e zgjatur dhe shpesh të pa kriter të antibiotikëve dhe medikamenteve të tjera; shmang ndërhyrjet e përsëritura dhe traumat e panevojshme për pacientin; përmirëson gjendjen e përgjithshme të pacientit në kohë të shkurtër; lejon trajtimin në kushte ambulatore dhe ul kostot financiare. Ky lloj trajtimi kërkon mjekë të specializuar, vendimmarrje të shpejtë dhe të saktë, si dhe përgjegjësi profesionale të lartë.

Fjalë kyçe: kist, inflamacion sekondar, sekrecione purulente, sticky bone, membranë APRF, trajtim kirurgjikal.

GUIDA KIRURGJIKALE NË IMPLANTOLOGJI: SAKTËSI, SIGURI DHE EFIKASITET KLINIK.

Algen Isufi[1 2 3] DMD PhD, Irina Isufi[2 3] DMD PhD
[1]*Shërbimi i Kirurgjisë OMF, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri*
[2]*Universiteti Aldent, Tiranë Shqipëri*
[3]*Isufi Dental Clinic, Tiranë Shqipëri*

Abstrakt
Hyrje: Kirurgjia implantare e guiduar ka revolucionarizuar praktikën klinike duke ofruar një qasje të planifikuar paraprakisht, me qëllim rritjen e saktësisë së vendosjes së implanteve dhe minimizimin e komplikacioneve. Përdorimi i teknologjisë së imazherisë 3D dhe softuerëve të specializuar lejon një transferim të besueshëm të planit protetik në realitetin kirurgjikal.
Materiale dhe metoda: Në këtë prezantim paraqitet përdorimi i guidave kirurgjikale të personalizuara, të bazuara në skanime CBCT dhe modele dixhitale të kavitetit oral. Rastet klinike u planifikuan nëpërmjet softuerëve CAD / CAM, duke mundësuar pozicionim optimal të implanteve në raport me strukturat anatomike kritike dhe rezultatet protetike të parashikuara.
Rezultate: Përdorimi i guidës kirurgjikale demonstroi rritje të saktësisë në pozicionimin tridimensional të implanteve, reduktim të kohës së ndërhyrjes dhe ulje të diskomfortit post - operator tek pacientët. Gjithashtu, u evidentua një shkallë më e lartë sigurie klinike, duke shmangur dëmtimin e strukturave anatomike vitale.
Konkluzione: Kirurgjia implantare e guiduar përfaqëson një metodë të avancuar që kombinon teknologjinë dixhitale me praktikat kirurgjikale bashkëkohore. Ajo siguron saktësi, siguri dhe efikasitet klinik, duke kontribuar në rezultate më të qëndrueshme dhe të parashikueshme në rehabilitimin oral.

Fjalë kyçe: implantologji, guida kirurgjikale, kirurgji e guiduar, CAD / CAM, rehabilitim oral.

MASA TERCIARE NË PROTEZAT TOTALE: NJË RISHIKIM NARRATIV MBI MATERIALET.

Alketa Qafmolla, Sara Vasku, Edit Xhajanka, Neada Hysenaj, Endrit Paparisto, Tedi Verçani, Blerta Lila, Belisa Kaleci.
Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
Klinika Stomatologjike Universitare, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Përveç masës primare dhe sekondare, masa terciare ose masa piezografike përfaqëson regjistrimin e sipërfaqes së jashtme të protezës si dhe regjistron zonën ku duhet të rreshtohen dhëmbët artificial, në mënyrë që të kemi një ekuilibrim të forcave. Zona neutrale përfaqëson ekuilibrin dinamik midis forcave të muskujve të

gjuhës, faqeve dhe buzëve, dhe materiali i përdorur duhet të jetë në gjendje të riprodhojë këtë zonë pa e deformuar atë. Evolucioni i materialeve dentare ka sjellë një gamë të gjerë opsionesh me veti të ndryshme.
Qëllimi: Ky studim synon të përmbledhë dhe analizojë në mënyrë kritike evidencat aktuale mbi materialet e përdorura për regjistrimin e zonës neutrale në protezat totale të lëvizshme, duke vlerësuar vetitë fiziko - mekanike, biokompatibilitetin dhe performancën klinike të secilit material.
Metoda: U realizua një kërkim bibliografik në bazat **PubMed, Scopus** dhe **Google Scholar** për periudhën **2000–2025**, duke përdorur fjalët kyçe: *neutral zone, piezography, complete denture, functional impression materials, tissue conditioner, polyether, polyvinyl siloxane, impression compound, elastic resin* dhe *prosthodontics.*
Konkluzione: Dylli Kerr siguron përshtatje të mirë muko - kompresive, ndërsa zink oksid–eugenol (ZOE) ofron riprodhim të detajeve, por është i brishtë dhe potencialisht irritues, ndërsa kushtëzuesit indor kanë rrjedhshmëri të lartë. Elastomerët si polivinil siloksanet (VPS), silikonet light dhe polieteret paraqesin biokompatibilitet dhe stabilitet. Rezinat elastike shfaqin veti viskoelastike, që lejojnë riprodhim të qëndrueshëm të zonës neutrale. Së fundmi, teknikat digjitale kanë revolucionarizuar konceptin e masës terciare: regjistrimet piezografike, skanimi intraoral dhe integrimi në sistemet CAD / CAM lejojnë rikonstruksione të përshtatshme dhe riprodhueshmëri më të lartë. Nevojiten kërkime të reja për të përcaktuar protokollet optimale dhe për të matur në mënyrë objektive ndikimin e tyre në cilësinë e jetës së pacientëve.

Fjalë kyçe: Masa terciare, piezografi, protezë totale, elastomerë, zink - oksid eugenol, silikon, polieter.

DIAGNOZA DIFERENCIALE E DISFUNKSIONIT TË ATM - SË ME PATOLOGJITË OTORINOLARINGOLOGJIKE.

Prof. Ass Alketa Qafmolla[1], Ph. D Orjeta Tonuzi[2], Aurora Mema[1]
[1]*F. M. D*
[2]*QSUT*

Abstrakt
Artikulacioni temporo - mandibular preket nga patologji të ndryshme të shumta dhe të shumëllojshme, por patologjia më e shpeshtë që haset në praktikën e përgjithshme është çrregullimi disfunksional i saj. Në aparatin stomatognatik shfaqen patologji të ndryshme, pasojat e të cilit reflektohen në ATM. Një ndër patologjitë më të shprehura që reflektohet në zonën përreth artikulacionit është dhimbja e veshit. Aërsia anatomike e veshit me artikulacionin temporo - mandibular mund të ngatërrojnë shpesh të lokalizojnë dhimbjen. Dhimbja e veshit perceptohet më posteriorisht se sa dhimbja në artikulacion. Kjo shpjegohet me faktin se vetëm një zonë, lamina e hollë e kockës temporale ndan artikulacionin temporo - mandibular nga meatus akustikus ekstern dhe media (veshi i mesëm dhe i jashtëm). Kjo aërsi anatomike me të njëjtën trashëgimi filogjenetike dhe inervim nervi, mund të ngatërrojë aftësinë e pacientit për të lokalizuar dhimbjen. Ankesa kryesore e disfunksionit të artikulacionit temporo - mandibular është dhimbja gjatë lëvizjes së mandibulës, vështirësi në hapjen e gojës dhe shpesh kërcitje në artikulacion. Ndërsa në patologjitë e veshit që shoqërohen me ankesa të tilla si: ulja e dëgjimit, zhurmë në vesh, marrje mendsh, nistagmus etj. Ajo që e diferencon patologjinë e veshit me atë të artikulacionit temporo - mandibular është se këto simptoma pacienti i referon edhe në gjendje qetësie. Është pikërisht agravimi i dhimbjes gjatë lëvizjes së mandibulës, s imptoma që bën diferencimin e dhimbjes edhe në qetësi të veshit. Diferencimin e patologjisë disfunksionale të ATM - së me sëmundjet otorinolaringologjike e kryen nëpërmjet studimit të dy grupe pacientësh. Grupi i parë përbëhej nga 60 pacientë me patologji të veshit dhe grupi i dytë përbëhet nga 211 pacientë me çrregullime disfunksionale të ATM - së.
Rezultate: Rezultatet e studimit treguan se nga 60 pacientë të trajtuar me patologji të veshit 60% (36) e rasteve ishin me dhimbje të theksuar në këtë regjion. Rezultatet e studimit treguan se dhimbja në vesh shfaqet në çdo moshë, nga 6 - 78 vjeç pasi nuk ekziston një lidhje statikisht midis dhimbjes në vesh dhe moshës pasi p=0, 813. Ndërsa në rastin e disfunksionit të ATM, dhimbja ka lidhje me lëvizjen e nofullës dhe tregon për një lidhje statistikisht të rëndësishme pasi vlera e p<0. 001.
Konkluzione: Konkluzioni i këtij studimi është që shfaqja e dhimbjes dhe vështirësisë së hapjes së gojës janë simptomat që diferencojnë patologjinë disfunksionale të ATM - së me atë të veshit, në të cilën ato janë të shprehura edhe në qetësi.

Fjalë kyçe: Artikulacioni temporo - mandibular, disfunksion i ATM - së, dhimbje në vesh.

DIGJITALIZIMI NË PROTETIKËN TOTALE: A ËSHTË FUNDI I METODAVE TRADICIONALE?

Brisa Lala[1], Alketa Qafmolla[2], Prof. Asc. Edit Xhajanka[2].
1Studente, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tirane.
2Prof. Asc në Fakultetin e Mjekësisë Dentare, Departamenti i Ortopedisë Stomatologjike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Abstrakt
Hyrja: Zhvillimet teknologjike të dekadës së fundit kanë transformuar ndjeshëm fushën e stomatologjisë, duke përfshirë edhe protetikën totale. Përdorimi i teknologjive CAD / CAM, skanimit intraoral dhe printerëve 3D ka mundësuar prodhimin më të shpejtë, më të saktë dhe më të personalizuar të protezave. Megjithatë, pyetja mbetet nëse këto inovacione mund të zëvendësojnë plotësisht metodat tradicionale, të cilat kanë siguruar për dekada rezultate të qëndrueshme dhe të parashikueshme klinikisht.
Qëllimi: Ky studim synon të analizojë ndikimin e digjitalizimit në procesin e realizimit të protezave totale, duke krahasuar saktësinë dhe efikasitetin tek pacientët mes metodave tradicionale dhe atyre digjitale. Objektivi kryesor është të vlerësohet nëse teknologjitë CAD / CAM mund të zëvendësojnë plotësisht metodat konvencionale në praktikën klinike të përditshme.
Metoda: U krye një rishikim sistematik i literaturës së publikuar gjatë viteve 2018–2025 dhe një analizë krahasuese mbi 40 raste klinike me proteza totale të realizuara në mënyrë tradicionale dhe digjitale. U vlerësuan parametrat e përshtatjes së bazës së protezës, stabiliteti, estetika, koha e përfundimit dhe komoditeti i raportuar nga pacientët, duke përdorur pyetësorë të standardizuar dhe matje objektive të adaptimit.
Rezultate: Teknologjitë digjitale ofruan përmirësime të dukshme në saktësi dimensionale, dhe reduktim të kohës së punës laboratorike me rreth 40%. Pacientët raportuan komoditet më të lartë dhe përshtatje më të mirë, veçanërisht në rastet e realizuara me skanime intraorale dhe frezim CAD / CAM. Megjithatë, në pacientët me resorbim të theksuar alveolar, metodat tradicionale dhanë rezultate funksionale më të mira.
Përfundime: Digjitalizimi po transformon rrënjësisht protetikën totale, duke ofruar efikasitet dhe cilësi të lartë. Sidoqoftë, metodat tradicionale ende mbajnë rëndësi të veçantë në rastet ku kërkohet përshtatje më e ndjeshme ndaj variacioneve anatomike. Prandaj, e ardhmja e protetikës totale qëndron në ndërthurjen e mençur të teknologjisë digjitale me ekspertizën tradicionale të klinicistit.

Fjalë kyçe: Protetikë totale, digjitalizim, CAD / CAM, proteza totale, metodë tradicionale, saktësi klinike.

KOMPLIKIMET E SINUSIT MAKSILAR NË PRAKTIKËN DENTARE.

Amet Demiri[1], Seha Demiri Mustafai[2 3], Armed Demiri[2].
[1]Klinika për Kirurgji Orale "Kirurgjia Estetike Orale" Tetovë
[2]Klinika Dentare "Vivadent", Tetovë
[3]Programi Studimor Stomatologji, Fakulteti i Shkencave Mjekësore,

Abstrakt
Hyrje: Proceset inflamatore odontogjene në sinuset maksilare janë një problem i zakonshëm në patologjinë orale. Përqindja e sinuseve maksilare me origjinë odontogjene krahasuar me sinuset me origjinë rinogjene, sipas autorëve të ndryshëm, është e ndryshme. Sipas Hepstad, nga 385 sinusite, 22. 55% ishin me origjinë dentogjene. Martenson në vitin 1952 pohoi se 12. 4% e rasteve i përkasin këtyre sinusiteve. Sipas autorëve të tjerë, ato janë nga 16 - 40%. Otorinolaringologët e zvogëlojnë atë në 6% të rasteve.
Qëllimi: Qëllimi i punimit është të paraqesë prevalencën e sinusit maksilar si një ndërlikim i zakonshëm në praktikën dentare, qoftë për shkak të marrëdhënieve anatomike - topografike midis rrënjëve të dhëmbëve dhe sinusit maksilar, ekzistencës së ndryshimeve kronike periapike, absceseve identoalveolare, osteomielitit pas nxjerrjes dhe për fat të keq, jo rrallë për shkak të ndërhyrjes së ashpër dhe joprofesionale.
Materiali dhe metoda: Mostra e hulumtimit përbëhet nga 42 pacientë për periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2023. Ata u trajtuan në varësi të diagnozës, pra infeksionit, madhësisë së lumenit të komunikimit oro - antral dhe pranisë së një trupi të huaj: konservatore, kirurgjikale (plastikë sinusale) ose radikale sipas Caldwell Luk.

Rezultate: Duke analizuar materialin ekzistues nga 42 pacientë për një periudhë prej 3 vitesh, arritëm në përfundimet e mëposhtme: nga një total prej 42 rastesh të sinus aperta, 22 ishin pas nxjerrjes së të parit, 15 raste ishin pas nxjerrjes së molarit të dytë, 3 raste pas nxjerrjes së premolarit të parë dhe nga një rast pas nxjerrjes së një qeni dhe një dhëmbi të pjekurisë.
Përfundime: Nëse dentisti nuk e vëren ose nuk e parashikon këtë ndërlikim, mund të formohet një komunikim që lidh zgavrat orale dhe antrale. Me kalimin e kohës, fistula e formuar çon në shfaqjen e sinusit akut dhe më pas kronik. Prandaj, diagnostikimi i hershëm i sinus aperta është shumë i rëndësishëm. E gjithë kjo kërkon një diagnozë në kohë me një ekzaminim objektiv, radiografi (ortopantomografi) dhe nëse është e nevojshme, ndërhyrje kirurgjikale.

Fjalë kyçe: sinusit maksilar, komunikimit oro - antral, Caldwell Luk.

EFIKASITETI I TRAJTIMIT TERIODONTAL JO - KIRURGJIKAL ME DHE PA PËRDORIMIN E ANTIBIOTIKËVE SISTEMIKË: NJË METAANALIZË.
Ana Bytyci

Abstrakt
Qëllimi: Të vlerësohet efektiviteti i trajtimit periodontal jo - kirurgjikal vetëm me scaling dhe root planing (SRP), krahasuar me kombinimin SRP + antibiotikë sistemikë, në përmirësimin e parametrave klinikë te pacientët me periodontit.
Metodologjia: U realizua një rishikim sistematik dhe metaanalizë bazuar në literaturën e publikuar në databaza ndërkombëtare (PubMed, Scopus, Cochrane, Embase). U përfshinë studime të kontrolluara të rastësishme (RCTs) që krahasojnë SRP vetëm dhe SRP me shtim të antibiotikëve sistemikë. U analizuan ndryshimet në thellësinë e xhepave periodontale (PPD), fitimi i ngjitjes klinike (CAL) dhe reduktimi i gjakderdhjes në sondim (BOP). Vlerësimi i cilësisë së studimeve u bë me mjetin Cochrane RoB.
Rezultate: Nga 738 artikuj të identifikuar, u përfshinë 15 studime me gjithsej 982 pacientë. Kombinimi i SRP me antibiotikë sistemikë (kryesisht amoksicilinë + metronidazol) tregoi përmirësime statistikisht të rëndësishme në reduktimin e PPD (mesatarisht 0. 4 mm më shumë se SRP vetëm) dhe rritje të CAL (mesatarisht 0. 3 mm). Efekti ishte më i theksuar në pacientë me periodontit të avancuar. Nuk u raportuan efekte anësore serioze, megjithatë përdorimi empirik i antibiotikëve mbetet i diskutueshëm.
Përfundime: Antibiotikët sistemikë mund të rrisin efektivitetin e trajtimit periodontal jo - kirurgjikal në raste të avancuara. Megjithatë, përdorimi i tyre duhet të bazohet në vlerësim të kujdesshëm klinik, për të shmangur përdorimin e panevojshëm dhe për të parandaluar rezistencën ndaj antibiotikëve.

Fjalë kyçe: Trajtimi teriodontal jo - kirurgjikal, antibiotikët sistemikë, trajtim.

TRAJTIMI I INSTRUMENTEVE TË THYER INTRAKANALAR: SFIDË APO MUNDËSI.
Ana Halipaj

Abstrakt
Hyrje: Trajtimi endodontik është një nga procedurat më të rëndësishme dhe të ndërlikuara në praktikën stomatologjike, duke kërkuar saktësi dhe ekspertizë të lartë. Një nga sfidat kryesore gjatë këtij trajtimi është thyerja e instrumenteve brenda kanalit të rrënjës, një komplikacion që jo vetëm mund të rrisë kompleksitetin e trajtimit, por gjithashtu të ndikojë në suksesin afatgjatë të tij. Instrumentet e thyer brenda kanalit të rrënjës përfshijnë zakonisht instrumentet manualë dhe ata rotativë me nikël - titan (NiTi), të cilët janë të ndjeshëm ndaj lodhjes ciklike dhe deformimeve torsionale. Faktori kryesor që ndikon në thyerjen e instrumenteve është anatomi komplekse e kanalit të rrënjës, si p. sh. , kthesat e mprehta, gjerësia e kanalit apo sekuestrimi i mbetjeve të dentinës dhe pulpës gjatë përpunimit të kanalit. Për më tepër, përdorimi i gabuar i instrumenteve, si presioni i tepërt dhe mungesa e mirëmbajtjes së duhur, mund të kontribuojnë në këtë komplikacion.
Qëllimi: Ky studim synon të shqyrtojë: Shkaqet kryesore të thyerjes së instrumenteve brenda kanalit të rrënjës. Protokollet klinike për parandalimin dhe menaxhimin e këtij problemi. Rëndësinë e teknologjive moderne, si mikroskopët dentarë dhe pajisjet me ultratinguj, për nxjerrjen e fragmenteve të thyer.

Materiale dhe Metoda: Ky studim përfshin pacientë të paraqitur në Klinikën "Dental Turk" gjatë periudhës: janar 2022 – gusht 2025 të cilët kanë kryer trajtime dhe ritrajtime endodontike në dhëmbë me instrumente të thyer brenda kanaleve radikulare, të cilat janë menaxhuar dhe ndjekur klinikisht per ecurine e trajtimit. Janë përfshirë pacientë të grupmoshave 18–65 vjeç, të dy gjinive. Pacientët duhet të kishin: a) Dhëmbë me histori trajtimi endodontik të mëparshëm, ku gjatë trajtimit ishte raportuar thyerje instrumenti, dhe tani kërkonin ritrajtim. b) Dhëmbë në të cilët instrumenti ishte thyer gjatë trajtimit aktual, dhe u menaxhua menjëherë. Janë përjashtuar rastet me rezorbime të gjera, fraktura vertikale ose mungesë të të dhënave pasuese. Ndjekja klinike: pacientët u kontrolluan pas 6 muajsh, 12 muajsh dhe 24 muajsh për të vlerësuar shërimin periapikal, mungesën e simptomave dhe funksionalitetin e dhëmbit.
Përfundime: Thyerja e instrumenteve brenda kanalit të rrënjës mbetet një sfidë e rëndësishme në praktikën endodontike. Përmes teknologjive të avancuara dhe protokolleve të standardizuara, stomatologët mund të minimizojnë rrezikun e këtij komplikacioni dhe të përmirësojnë rezultatet klinike. Kjo temë është thelbësore për një mjek stomatolog që dëshiron të kontribuojë në përmirësimin e praktikave klinike dhe të trajtojë me sukses rastet e ndërlikuara në endodonci duke theksuar rëndësine e ruajtjes sa më gjatë të dhëmbit natyral të njeriut.

Fjalë kyçe: Thyerja e instrumenteve, endodonci, kanal i rrënjës.

PERIIMPLANTITI DHE NDIHMA E PIEZOKIRURGJISË.

Andi Shqerra, Renato Isufi

Abstrakt
Objektivat: Kjo përmbledhje narrative ofron një pasqyrë të bazuar në prova mbi peri - implantitin për seminarin botëror të vitit 2017 mbi klasifikimin e sëmundjeve dhe gjendjeve periodontale dhe peri - implantare.
Metodat: U krye një rishikim i literaturës që trajtoi temat e mëposhtme: përkufizimi i peri - implantitit, konvertimi nga mukoziti peri - implantar në peri - implantit, fillimi dhe modeli i përparimit të sëmundjes, karakteristikat e peri - implantitit, faktorët / treguesit e rrezikut për peri - implantitin dhe humbja progresive e kockave krestale në mungesë të inflamacionit të indeve të buta.
Përfundime: Peri - implantiti është një gjendje patologjike që ndodh në indet përreth implanteve dentare, e karakterizuar nga inflamacion në indin lidhës peri - implantar dhe humbje progresive e kockës mbështetëse. Kushtet histopatologjike dhe klinike që çojnë në konvertimin nga mukoziti peri - implantar në peri - implantit nuk janë kuptuar plotësisht. Fillimi i peri - implantitit mund të ndodhë herët gjatë ndjekjes dhe sëmundja përparon në një model jo - linear dhe përshpejtues. Vendet e peri - implantitit shfaqin shenja klinike të inflamacionit dhe thellësi të rritura të sondimit krahasuar me matjet bazë. Në nivelin histologjik, krahasuar me vendet e periodontitit, vendet e peri - implantitit shpesh kanë lezione më të mëdha inflamatore. Hyrja kirurgjikale në vendet e peri - implantitit shpesh zbulon një model rrethor të humbjes së kockave. Ka prova të forta se ekziston një rrezik në rritje i zhvillimit të peri - implantitit tek pacientët që kanë një histori të periodontitit kronik, aftësi të dobëta të kontrollit të pllakës dhe mungesë kujdesi të rregullt mirëmbajtjeje pas terapisë me implante. Të dhënat që identifikojnë "pirjen e duhanit" dhe "diabetin" si faktorë / tregues të mundshëm rreziku për peri - implantit janë të paqarta. Ekzistojnë disa prova të kufizuara që lidhin peri - implantitin me faktorë të tjerë, siç janë: prania e çimentos submukozale pas restaurimit, mungesa e mukozës së keratinizuar peri - implantare dhe pozicionimi i implanteve që e bëjnë të vështirë kryerjen e higjienës orale dhe mirëmbajtjen. Provat sugjerojnë që humbja progresive e kockës krestale rreth implanteve në mungesë të shenjave klinike të inflamacionit të indeve të buta është një ngjarje e rrallë.

Fjalë kyçe: diagnozë; implantologji; peri - implantit; rishikime sistematike dhe mjekësi e bazuar në prova.

TRAJTIMI I HERSHËM ORTODONTIK: KUR, SI DHE PSE?

Dr. Andia Kusta, Dr. Artela Cankja, Dr. Afërdita Kusta

Abstrakt

Hyrja: Trajtimi ortodontik i hershëm luan një rol thelbësor në drejtimin e zhvillimit të duhur dento - skeletik gjatë fëmijërisë. Kjo qasje lejon korrigjimin e hershëm të çrregullimeve funksionale dhe parandalon përkeqësimin e anomalive që mund të kërkojnë trajtime më të ndërlikuara në moshat e mëvonshme. Përcaktimi i momentit të duhur të ndërhyrjes dhe i metodës më të përshtatshme mbetet një ndër sfidat kryesore për ortodontët.

Qëllimi: Të vlerësohet rëndësia e trajtimit ortodontik të hershëm përmes analizës së kohës optimale të fillimit, arsyes biologjike dhe funksionale të ndërhyrjes, si dhe metodave që garantojnë rezultate të qëndrueshme në zhvillimin harmonik kraniofacial.

Materialet dhe Metodat: Në këtë punim u realizua një rishikim i literaturës së viteve të fundit dhe u analizuan disa raste klinike të pacientëve të moshës 6–10 vjeç, të trajtuar me aparate funksionale dhe interceptive. Janë vlerësuar faktorët etiologjikë që ndikojnë në zhvillimin dento - skeletik, prania e zakoneve orale, mënyra e frymëmarrjes dhe bashkëpunimi i pacientit gjatë trajtimit.

Diskutimi: Rezultatet treguan se trajtimi i hershëm ndihmon në krijimin e një ekuilibri më të mirë funksional dhe estetik, duke ndikuar pozitivisht në zhvillimin e kockave maksilare dhe mandibulare. Ndërhyrjet në fazat e hershme reduktojnë nevojën për trajtime fikse më vonë dhe lehtësojnë korrigjimin e problemeve si respirimi oral, shtyrja e gjuhës apo zakonet e dëmshme. Pavarësisht avantazheve, suksesi i terapisë varet nga diagnostikimi i saktë, motivimi i pacientit dhe ndjekja e vazhdueshme klinike.

Rezultate: Në pjesën më të madhe të rasteve të analizuara u arrit përmirësim i dukshëm i funksionit dhe estetikës faciale. Ndërhyrja në kohë rezultoi në reduktim të rasteve me klasë skeletike II dhe në përmirësim të profilit të fytyrës. Raste të trajtuara në moshë më të vonë kërkuan kohëzgjatje më të madhe dhe procedura më të avancuara ortodontike.

Konkluzione: Trajtimi ortodontik i hershëm përbën një fazë kyçe të kujdesit dentar te fëmijët, pasi ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin harmonik të sistemit stomatognatik. Njohja e faktorëve që përcaktojnë kur, pse dhe si duhet ndërhyrë është thelbësore për arritjen e rezultateve afatgjata dhe stabile. Qasja interceptive duhet konsideruar si investim parandalues që ul nevojën për trajtime komplekse në të ardhmen dhe përmirëson funksionin, estetikën dhe mirëqenien e pacientit.

Fjalë kyçe: Ortodoncia interceptive, trajtim i hershëm, zhvillim kraniofacial, zakone orale, parandalim ortodontik.

TUMORET E WARTHIN - IT TË GJËNDRAVE PAROTIDE – RISHIKIM I LITERATURËS DHE RAPORTIM I RRALLË RASTI ME PREKJE BILATERALE.

Dr. Shk. Andis Qendro[1], Dr. Gresa Baboçi[1], Dr. Lediona Mere[2]

[1]Lektor, Fakulteti i Mjekësisë Dentare / Kirurg Oral dhe Maksilofacial, QSUT "Nënë Tereza"

[2]Kirurg Oral dhe Maksilofacial – Praktikë private.

Abstrakt

Hyrje: Tumori i Warthinit është neoplazia e dytë më e shpeshtë beninje e gjëndrave të pështymës pas adenomës pleomorfike, duke përfaqësuar deri në 10% të të gjithë tumoreve të gjëndrës parotide. Pothuajse të gjitha rastet shfaqen brenda gjëndrës parotide ose në nyjet limfatike periparotide. Multifokaliteti ndodh në rreth 20% të rasteve, ndërsa përfshirja bilaterale në rreth 6%. Zakonisht prek pacientë në dekadën e gjashtë të jetës, është dy herë më i shpeshtë tek meshkujt dhe tregon një lidhje të fortë me duhanpirjen. Këta tumore shpesh paraqiten me pamje heterogjene në ekzaminimet imazherike, duke përfshirë shpesh komponentë cistike. Transformimi malinj është jashtëzakonisht i rrallë (~1%). Ekzicioni kirurgjikal, zakonisht me parotidektomi sipërfaqësore, përbën trajtimin e zgjedhur, me një normë të ulët rikthimi, kryesisht të lidhur me multifokalitetin.

Rast klinik: Një pacient mashkull 71 - vjeçar, duhanpirës kronik, u paraqit me zmadhime bilaterale të gjëndrave parotide — një në anën e djathtë, e pranishme për 10 vjet, dhe një tjetër në anën e majtë për 6 vjet. Tomografia e kompjuterizuar (CT) tregoi lezionin e mirëpërcaktuar me përforcim pas kontrasti, karakteristike për tumore bilaterale të Warthinit. Citologjia me aspirim me gjilpërë të hollë (FNAC) konfirmoi diagnozën. Pacienti iu

nënshtrua ekscizionit kirurgjikal në dy faza të të dy lezioneve. Ekzaminimi histopatologjik i çdo mostre verifikoi diagnozën e tumorit të Warthinit.
Diskutime: Tumoret bilaterale të Warthinit të gjëndrave parotide janë të rralla dhe paraqesin sfida të veçanta diagnostikuese dhe kirurgjikale për shkak të marrëdhënies së tyre të ngushtë me nervin facial. Kombinimi i ekzaminimit imazherik me FNAC ofron një diagnozë të saktë preoperative. Ekscizioni kirurgjikal mbetet metoda e preferuar e trajtimit, dhe një qasje me dy faza rekomandohet për të minimizuar komplikacionet postoperatore.
Përfundime: Edhe pse të rralla, tumoret bilaterale të Warthinit duhet të merren parasysh tek meshkujt e moshuar duhanpirës me zmadhime bilaterale të gjëndrës parotide. Diagnoza e saktë përmes imazherisë dhe citologjisë, e ndjekur nga trajtimi kirurgjikal i planifikuar në faza, siguron rezultate optimale dhe minimizon rrezikun.

Fjalë kyçe: tumori i Warthinit, gjendra parotide, tumor beninj, tumor bilateral, multifokalitet, duhanpirje, parotidektomi, citologji me aspirim me gjilpërë të hollë (FNAC), diagnozë imazherike, nervi facial, transformim malinj, histopatologji, trajtim kirurgjikal.

SHFAQJA DHE PËRKEQËSIMI I SËMUNDJEVE KARDIOVASKULARE DHE DENTARE SI PASOJË E NDOTJES SË AJRIT: RISHIKIM I LITERATURËS SË FUNDIT.

Dr. Andri Cabeli, Dr. Edlira Mulo, Dr. Egi Mulo, Prof. Xhina Mulo

Abstrakt
Hyrje: Ndotja e ajrit është një ndër faktorët më të rëndësishëm mjedisor që kontribuon në sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë globale. Gjatë dekadës së fundit, evidenca në rritje sugjeron një lidhje të drejtpërdrejtë mes ekspozimit ndaj ndotësve atmosferikë dhe incidencës apo përkeqësimit të sëmundjeve kardiovaskulare (SKV), përfshirë infarktin e miokardit, hipertensionin, aritmitë dhe insuficiencën kardiake. Gjithashtu, ka lidhje edhe me shtimin e rasteve të pacientëve bruksues.
Qëllimi: Ky punim synon të paraqesë një përmbledhje të literaturës më të fundit mbi efektet e ndotjes së ajrit në sistemin kardiovaskular, duke analizuar mekanizmat fiziopatologjikë, grupet më të rrezikuara dhe impaktin klinik. Po keshtu, edhe rastet me pacientët bruksues.
Materiale dhe Metoda: Është realizuar një rishikim sistematik i literaturës shkencore të publikuar gjatë 5 viteve të fundit në databaza të njohura si PubMed dhe Scopus, me fokus në studimet observacionale, meta - analizat dhe udhëzimet e organizatave ndërkombëtare.
Rezultate: Disa ndotës si PM2. 5, NO2 dhe O3 janë të lidhur me rritje të ndjeshme të rrezikut për ngjarje akute kardiake. Mekanizmat përfshijnë stresin oksidativ, inflamacionin sistemik, disfunksionin endotelial dhe ndryshimet në autonominë kardiake. Popullatat më të ndjeshme janë të moshuarit, pacientët me sëmundje të mëparshme kardiake dhe ata që jetojnë në zona urbane të ndotura. Ndërkohë nuk është gjetur lidhje signifikante me rritjen e edhe rasteve me pacientët bruksues.
Konkluzione: Ndotja e ajrit përfaqëson një faktor rreziku të rëndësishëm, por shpesh të nënvlerësuar në shëndetin kardiovaskular. Evidenca aktuale mbështet përfshirjen e ekspozimit mjedisor në vlerësimet e rrezikut për SKV.
Rekomandime: Rekomandohet rritja e ndërgjegjësimit mjekësor dhe publik, integrimi i monitorimit të ndotjes në praktikën kardiologjike dhe promovimi i politikave të shëndetit publik për uljen e ndotjes ambientale.

Fjalë kyçe: ndotja e ajrit, sistem kardiovaskular, infarkt, ndotës.

VLERËSIMI I EFEKTIT ANTIBAKTERIAL TË NANOGRIMCAVE TË ARGJENDIT NDAJ ENTEROCOCCUS FAECALIS.

Anila Kamberi – Çuni
Kandidate në PhD në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës, Kosovë.

Abstrakt
Hyrje: Suksesi i trajtimit endodontik bazohet në eliminimin e mikroorganizmave nga kanali i rrënjës së dhëmbit. Arsyeja më e shpeshtë e dështimit të terapisë së kanalit të rrënjës është mbijetesa e mikroorganizmave

brenda këtij sistemi. Një gamë e gjerë agjentësh antimikrobikë përdoret për eliminimin e mikroorganizmave në kanalin e infektuar; megjithatë, për shkak të shfaqjes së mikroorganizmave persistentë ndaj medikamenteve, kërkimi për alternativa të tjera dhe të sigurta biologjikisht mbetet një sfidë e vazhdueshme. Nanoteknologjia ka përparuar ndjeshëm gjatë dekadave të fundit, duke sjellë një sërë aplikimesh të mundshme në fusha të ndryshme biomjekësore. Në veçanti, përdorimi i nanogrimcave të argjendit në endodonci ka nxitur interes të madh për shkak të karakteristikave të tyre unike. Kjo ka nxitur kërkimin mbi përdorimin e irrigantëve dhe medikamenteve intrakanalore me bazë nanogrimcash antibakteriale, të cilat mund të përmirësojnë eliminimin e infeksioneve endodontike, veçanërisht të E. faecalis.

Qëllimi: Të krahasohet aktiviteti antimikrobik i nanogrimcave të argjendit (Ag - NPs) me atë të hidroksidit të kalciumit ndaj Enterococcus faecalis.

Materiali dhe metoda: Në këtë studim in vitro u testuan 70 dhëmbë të përparmë të nofullës së sipërme dhe të poshtme, të nxjerrë për shkaqe periodontale. Dhëmbët u ndanë në katër grupe: Grupi I (n=25): nanogrimca argjendi - xhel, 32 ppm; Grupi II (n=25): $Ca(OH)_2$; Grupi III (n=10): grup kontroll pozitiv, ku në kanalet e rrënjëve u inokulua Enterococcus faecalis, por nuk u aplikua trajtim; Grupi IV (n=10): grup kontroll negativ, ku u konfirmua mungesa e rritjes bakteriale në kanalet e rrënjëve. Medikamentet u testuan kundër Enterococcus faecalis (ATCC 29212). Numri i njësive formuese të kolonive (CFU / mL) u llogarit sipas formulës: (numri i kolonive × vëllimi i bujonit të infektuar [BHI] × faktori i hollimit). Përveç numërimit të kolonive, u aplikua edhe metoda kolorimetrike për detektimin e baktereve VITEK MS (MALDI - TOF MS).

Rezultate: Grupi me nanogrimca të argjendit - xhel 32 ppm tregoi aktivitet antimikrobik më të lartë ndaj Enterococcus faecalis krahasuar me $Ca(OH)_2$.

Përfundime: Xheli me nanogrimca argjendi 32 ppm ka potencial të përdoret si medikament intrakanalar në trajtimin e kanalit të rrënjës së infektuar.

Fjalë kyçe: nanogrimca, Ag - NPs, endodonci, kanali i infektuar.

ROLI I FRENULUMEVE TË GJUHËS DHE BUZËS NË FUNKSIONET ORALE: RËNDËSIA KLINIKE DHE OPSIONET TERAPEUTIKE.

Anisa Demrozi, Ardita Konomi, Adnand Demrozi

Abstrakt:

Hyrje: Frenulumet orale, megjithëse struktura të vogla anatomike, kanë një rol të rëndësishëm në funksionet bazë të kavitetit oral. Frenulumi lingual dhe ai labial ndikojnë në proceset e thithjes, gëlltitjes, artikulimit dhe në shëndetin periodontal. Variacionet anatomike apo pozicionimi jonormal i tyre mund të sjellin pasoja funksionale dhe estetike, duke ndikuar që në fazat e hershme të zhvillimit të individit.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të evidentojë rëndësinë klinike të frenulumeve të gjuhës dhe të buzëve, të analizojë problematikat që lidhen me to dhe të shqyrtojë mundësitë diagnostike e terapeutike që sigurojnë një menaxhim efektiv.

Diskutimi: Variacionet e frenulumit lingual mund të shfaqen si ankiloglosia, e cila shpeshherë lidhet me vështirësi në gjidhënie tek neonatët dhe me probleme në artikulim tek fëmijët. Frenulumi labial i zgjatur ose i trashë, nga ana tjetër, mund të shkaktojë diastemë interincizive, të pengojë higjienën orale ose të ndikojë negativisht në stabilitetin e protezave. Vlerësimi klinik realizohet përmes ekzaminimit funksional dhe klasifikimeve sipas gradës së kufizimit të lëvizjes. Opsionet terapeutike variojnë nga monitorimi dhe terapia mbështetëse logopedike, deri tek ndërhyrjet kirurgjikale. Trajtimi shpesh kërkon një qasje multidisiplinare.

Përfundime: Diagnoza dhe menaxhimi i hershëm i frenulumeve janë thelbësore për të parandaluar komplikacionet afatgjata funksionale dhe estetike. Një qasje integruese, që kombinon ekspertizën e profesionistëve të ndryshëm, siguron përmirësim të ndjeshëm të funksioneve orale, duke kontribuar në cilësinë e jetës së pacientit.

Fjalë kyçe: Frenulumet orale, struktura anatomike, nkiloglosia.

REHABILITIMI I NOFULLËS ATROFIKE ME KONCEPTIN "ALL - ON - 4" DHE ATERNATIVAT E TJERA: RAST KLINIK.

Dr. Arbnor Bujupi, Prof. Assoc. Dr. Erda Qorri
Albanian University, Tirana, Albania.

Abstrakt

Hyrje: Atrofia e avancuar e kreshtës alveolare në maksillë dhe mandibulë paraqet një sfidë të rëndësishme për vendosjen e implanteve dentare, sidomos në segmentet e pasme kur përdoren teknikat konvencionale.

Qëllimi: Ky studim synon të prezantojë rehabilitimin e nofullës atrofike me konceptin "All - on - 4" dhe të diskutojë alternativat e tjera të mundshme për trajtimin e pacientëve me edentulizëm total.

Metodologjia: Prezantimi i një rasti klinik ku është aplikuar koncepti "All - on - 4" për rehabilitimin e nofullës atrofike, duke analizuar procedurat, kohëzgjatjen dhe rezultatet funksionale. Krahasim me metoda të tjera të augmentimit kockor dhe vendosjes së implanteve.

Përfundime: Koncepti "All - on - 4" ofron një zgjidhje efektive dhe të shpejtë për pacientët me edentulizëm total dhe atrofi të avancuar të kreshtës alveolare, duke reduktuar nevojën për procedura të gjera augmentimi kockor dhe duke siguruar një rehabilitim funksional dhe estetik.

Fjalë kyçe: atrofi alveolare, All - on - 4, implant dentar, edentulizëm total, rehabilitim, augmentim kockor.

PËRDORIMI I TERAPISË ME LAZER NË MENAXHIMIN E ÇRREGULLIMEVE TEMPOROMANDIBULARE: NJË RISHIKIM I LITERATURËS.

Dr. Ardit Hetemaj
Dental Clinic Enzo, Prishtina, Kosovo Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti i Mjekësisë

Abstrakt

Hyrje: Çrregullimet temporomandibulare (TMD) paraqesin një gjendje klinike të shpeshtë, e karakterizuar nga dhimbje, tinguj artikularë dhe kufizim i lëvizjes mandibulare. Strategjitë konvencionale të trajtimit përfshijnë terapinë farmakologjike, shinat okluzale dhe fizioterapinë. Vitet e fundit, terapia me lazer ka fituar vëmendje si një trajtim ndihmës minimalisht invaziv, falë efekteve analgjezike, anti - inflamatore dhe biostimuluese.

Qëllimi: Ky rishikim synon të vlerësojë evidencën aktuale mbi efektivitetin e terapisë me lazer në menaxhimin e TMD - ve, me fokus në reduktimin e dhimbjes dhe përmirësimin e funksionit mandibular.

Metodologjia: U krye një rishikim narrativ i literaturës, duke përfshirë prova të kontrolluara të rastësishme, studime klinike dhe rishikime sistematike të publikuara në 10 vitet e fundit. Përzgjedhja e studimeve u bazua në përdorimin e lazerit me nivel të ulët (LLLT) dhe lazerëve të tjerë terapeutikë në pacientët me TMD.

Rezultate: Shumica e studimeve raportojnë reduktim të dhimbjes orofaciale, përmirësim të hapjes maksimale të gojës dhe ulje të shenjave klinike të inflamacionit pas trajtimit me lazer. Përfitimet vërehen kryesisht me lazerin me nivel të ulët, megjithatë ekziston heterogjenitet i madh në parametrat e përdorimit, që vështirëson standardizimin e protokolleve klinike.

Përfundime: Terapia me lazer paraqet një alternativë premtuese dhe minimalisht invazive për menaxhimin e çrregullimeve temporomandibulare, duke ofruar reduktim të simptomave dhe përmirësim të funksionit mandibular. Megjithatë, nevojiten studime të mëtejshme me metodologji të fortë për të përcaktuar protokollet optimale dhe për të konfirmuar efektet afatgjata.

Fjalë kyçe: çrregullime temporomandibulare (TMD), terapia me lazer, lazer me nivel të ulët (LLLT), dhimbje orofaciale, funksioni mandibular, terapi minimalisht invasive.

INFLAMACIONI ORAL DHE ALZHEIMERI: NJË LIDHJE E MUNDSHME PATOLOGJIKE.

Besara Dardhanjori, Dr. Ardita Koçi, PhD, Dr. Alba Koshovari, Dr. Amela Muca
Western Balkans University, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Departamenti i Stomatologjisë.

Abstrakt

Hyrje: Periodontiti është një sëmundje inflamatore kronike që prek indet mbështetëse të dhëmbëve. Sëmundja e Alzheimerit (SA) është forma më e zakonshme e demences, e karakterizuar nga neurodegjenerimi progresiv. Dëshmitë në rritje tregojnë për një lidhje ndërmjet këtyre dy gjendjeve përmes inflamacionit sistemik kronik.

Qëllimi: Qëllimi i këtij kërkimi është të shqyrtojë lidhjen ndërmjet periodontitit dhe sëmundjes së Alzheimerit, duke analizuar mekanizmat inflamatorë që mund të ndërmjetësojnë këtë marrëdhënie. Studimi synon të theksojë rëndësinë e shëndetit oral si faktor i mundshëm rreziku për dëmtimin njohës dhe të vlerësojë nëse ndërhyrjet dentare mund të kontribuojnë në parandalimin ose ngadalësimin e progresionit të neurodegjenerimit.

Materiale dhe metoda: Janë shqyrtuar meta - analiza të fundit, studime të tipit kohort dhe modele eksperimentale. Janë vlerësuar biomarkuesit kryesorë inflamatorë (IL - 1β, IL - 6, TNF - α) dhe agjentët mikrobialë (p. sh. Porphyromonas gingivalis) për rolin e tyre në inflamacionin sistemik dhe atë nervor.

Rezultate: Studimet tregojnë se pacientët me periodontit kanë një rrezik më të lartë për zhvillimin e rënies njohëse. Bakteret periodontale dhe citokinat inflamatore mund të hyjnë në qarkullimin sistemik, të kalojnë barrierën gjak - tru, të aktivizojnë mikrogliat dhe të kontribuojnë në formimin e pllakave amiloide dhe ngatërrimeve tau. Nga ana tjetër, rënia e funksioneve njohëse përkeqëson higjienën orale, duke krijuar një cikël të dyanshëm. Provat klinike sugjerojnë se terapia periodontale mund të reduktojë atrofinë e trurit dhe të ngadalësojë rënien e funksioneve njohëse.

Diskutime: Lidhja gojë–tru e ndërmjetësuar nga inflamacioni thekson rëndësinë e shëndetit oral për rezultatet neurologjike. Infeksionet periodontale mund të veprojnë si faktorë të rrezikut të modifikueshëm për demences. Bashkëpunimi ndërdisiplinor mes stomatologjisë dhe mjekësisë është thelbësor për ndërhyrje të hershme, veçanërisht në popullatat në plakje.

Përfundime: Periodontiti mund të jetë një kontribuues i rëndësishëm dhe i parandalueshëm ndaj sëmundjes së Alzheimerit përmes rrugëve inflamatore. Ruajtja e shëndetit oral mund të luajë rol në ruajtjen e funksionit njohës dhe uljen e rrezikut për dementie.

Fjalë kyçe: Periodontiti, sëmundja e Alzheimerit, inflamacioni, neurodegjenerimi, lidhja oral - sistemike.

LIDHJA MIDIS SHËNDETIT ORAL DHE SHËNDETIT SISTEMIK: ROLI I PERIODONTITIT NË PATOLOGJITË KRONIKE.

Erida Çela, Dr. Ardita Koçi, PhD, Dr. Alba Koshovari, Dr. Amela Muca.
Western Balkans University, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Departamenti Stomatologjisë

Abstrakt

Hyrje: Sëmundja periodontale nuk shihet më vetëm si një gjendje e lokalizuar orale, por si një gjendje inflamatore kronike me pasoja të gjera sistemike. Evidencat e reja theksojnë marrëdhënie komplekse dypalëshe midis shëndetit periodontal dhe sëmundjeve sistemike, duke nënvizuar rolin e zgavrës orale si kontribuese kryesore në shëndetin e përgjithshëm.

Qëllimi: Ky studim synon të shqyrtojë ndikimin e periodontitit në shëndetin sistemik, duke analizuar mekanizmat biologjikë që e lidhin me sëmundje kronike jo - transmetuese dhe duke theksuar rëndësinë e parandalimit dhe menaxhimit multidisiplinar.

Materiale dhe Metoda: Ky rishikim sintetizon literaturën e tanishme nga *Periodontology 2000 (2021)* dhe jo vetëm, që eksploron lidhjet multimodale midis sëmundjes periodontale dhe shëndetit sistemik në popullata të veçanta. Materiali përfshin të dhëna klinike, epidemiologjike dhe molekulare, duke theksuar mekanizmat mikrobialë, gjenetikë, imunologjikë dhe mjedisorë.

Rezultate: Sëmundja periodontale ka treguar lidhje të forta me pothuajse të gjitha gjendjet sistemike. Mekanizmat kyç përfshijnë disbiozën mikrobiale, inflamacionin sistemik, predispozitën gjenetike, stresin (përfshirë COVID - 19) dhe çrregullimet imune.

Mikrobioma orale përfshirë bakteret, viruset dhe kërpudhat shfaqet si një faktor thelbësor në ndërmjetësimin e këtyre lidhjeve. Ky studim prezanton gjithashtu konceptin e boshteve funksionale të veçanta si boshtiet: oral - tru, oral - mëlçi dhe oral - veshkë, duke forcuar ndikimin sistemik të patologjisë orale.

Diskutimi: Këto gjetje kërkojnë një ndryshim në edukimin dhe praktikën dentare, me dentistët që marrin një rol më integrues në diagnostikimin dhe ndihmën për parandalimin e sëmundjeve sistemike. Popullatat vulnerabël, si gratë shtatzëna, të moshuarit ose pacientët me rënie kognitive, kërkojnë menaxhim të veçantë periodontal.
Përfundime: Shëndeti oral është një tregues dhe ndikues i fuqishëm i mirëqenies sistemike. Njohja dhe adresimi i sëmundjes periodontale si kontribuese multisistemike është thelbësore për kujdesin holistik të pacientit dhe përparimin e shëndetit publik.

Fjalë kyçe: Lidhja oral - sistemike, sëmundja periodontale, mikrobioma orale, inflamacioni, popullatat e veçanta.

BIZHUTERITË DHE PIRSING ORAL.
Ardita Konomi, Anisa Demrozi

Abstrakt
Hyrje: Bizhuteritë dhe pirsingët oralë janë bërë një trend gjithnjë e më i përhapur, sidomos tek të rinjtë, si formë e shprehjes individuale dhe identitare. Megjithatë, prania e tyre në kavitetin oral shoqërohet me rreziqe të shumta për shëndetin dentar dhe atë të përgjithshëm.
Qëllimi: Ky studim synon të analizojë ndikimin e pirsingëve dhe bizhuterive orale në strukturat e gojës, duke identifikuar komplikacionet më të shpeshta, faktorët riskues dhe rëndësinë e ndërhyrjes së hershme profesionale.
Metoda: Është kryer një shqyrtim i literaturës bashkëkohore dhe i rasteve klinike të raportuara, me fokus te komplikacionet më të zakonshme dhe menaxhimi i tyre.
Rezultate: Të dhënat tregojnë se pirsingët oralë lidhen me një incidencë të lartë të infeksioneve bakteriale, inflamacionit të mukozës, dëmtimeve mekanike të smaltit dhe resorbimit të gingivave. Në disa raste, ato ndërhyjnë edhe në funksionin normal të të folurit, përtypjes dhe gëlltitjes. Kujdesi i pamjaftueshëm pas vendosjes së pirsingut dhe mungesa e vizitave të rregullta dentare përbëjnë faktorë kryesorë risku.
Përfundime: Bizhuteritë dhe pirsingët në gojë, pavarësisht dimensionit estetik dhe kulturor, përbëjnë një sfidë për shëndetin oral. Informimi i pacientëve, edukimi mbi higjienën, si dhe diagnostikimi dhe trajtimi i hershëm i komplikacioneve janë thelbësorë për minimizimin e rreziqeve.

Fjalë kyçe: Pirsing oral, bizhuteri, shëndeti oral, komplikacione, infeksion.

ROLI I TOMOGRAFISË SË KOMPJUTERIZUAR ME RREZE KONIKE (CBCT) NË KIRURGJINË ORALE.
Ariana Ademaj

Abstrakti
Tomografia e kompjuterizuar me rreze konike (CBCT) përfaqëson një nga zhvillimet më të rëndësishme të dekadës së fundit në stomatologji dhe kirurgji orale. Ky modalitet imazherik ofron vizualizim tredimensional të strukturave dentare dhe maksilofaciale me një dozë më të ulët të rrezatimit sesa tomografia e kompjuterizuar konvencionale, duke mundësuar një diagnostikim më të saktë dhe planifikim më të sigurt kirurgjikal. Në kirurgjinë orale, CBCT ka gjetur përdorim të gjerë në: vlerësimin e raporteve anatomike gjatë planifikimit të nxjerrjes së dhëmbëve të impaktuar, veçanërisht të molarit të tretë mandibular, diagnostikimin e patologjive cistike dhe tumoriale të nofullave, planifikimin para - implantar dhe vlerësimin e volumit kockor, menaxhimin e traumave maksilofaciale dhe frakturave të strukturave kraniofaciale. Gjithashtu, CBCT ndihmon në parashikimin e rreziqeve intraoperative duke lehtësuar identifikimin e strukturave anatomike të ndjeshme si nervi alveolar inferior dhe sinusi maksilar, gjë që ndikon drejtpërdrejt në reduktimin e komplikacioneve dhe në zgjedhjen e teknikave më të sigurta kirurgjikale. Përdorimi i saj është i lidhur ngushtë me përmirësimin e komunikimit ndërdisiplinar si dhe me një qasje më të personalizuar ndaj pacientit. Përdorimi rutinë i CBCT - së në kirurgjinë orale nuk përfaqëson vetëm një ndihmesë teknologjike, por edhe një standard të ri të kujdesit klinik, duke kombinuar saktësinë diagnostike me efikasitetin terapeutik. Kjo teknologji kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë, uljen e rrezikut të komplikacioneve dhe optimizimin e rezultateve afatgjata në trajtimin kirurgjikal oral.

Fjalë kyçe: CBCT, kirurgji orale, imazheri 3D, planifikim kirurgjikal.

TRAJTIMI ENDODONTIK PËRMES EKSTRAKTEVE BIMORE: POTENCIALI, EFIKASITETI DHE PERSPEKTIVAT KLINIKE.

Ass. Dr. sc. Ariana Kameri Murseli
Departamenti i Sëmundjeve të Dhëmbit me Endodoncion, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës

Abstrakt
Infeksionet me origjinë endodontike janë të lidhura ngushtë me praninë e mikroorganizmave, kryesisht baktere anaerobe dhe fakultative, të cilat në mungesë të trajtimit adekuat përkeqësohen me inflamacion periradikular, absces dhe celulit. Qëllimi thelbësor i trajtimit endodontik është eliminimi i mikroflorës patogjene përmes metodave mekanike, kimike dhe gjithnjë e më shumë edhe biologjike. Në këtë kontekst, aplikimi i ekstrakteve bimore paraqet një risi premtuese, duke ofruar alternativa natyrale dhe efektive për dezinfektimin e sistemit të kanaleve të rrënjës së dhëmbit. Kërkimet shkencore që nga viti 2003 e në vazhdim, kanë treguar se shumë bimë mjekësore si Thymus serpyllum, Tanacetum vulgare, Azadirachta indica (Neem), Matricaria chamomilla, Ocimum sanctum (Tulsi), Glycyrrhiza glabra, si dhe vajrat esenciale të agrumeve, posedojnë veti të fuqishme antibakteriale, anti - inflamatore dhe antifungale me efikasitet të krahasueshëm me substancat konvencionale si hipokloriti i natriumit (NaOCl) dhe klorheksidina (CHX). Po ashtu, disa ekstrakte bimore janë treguar efektive në largimin e pllakut dentar dhe smear shtresës, si dhe në zbutjen e gutaperkës gjatë procedurave të ritrajtimit. Me zhvillimin teknologjik dhe orientimit të ri drejt terapive më të sigurta dhe më pak toksike, përdorimi i ekstrakteve bimore në endodonci po fiton gjithnjë e më shumë vëmendje në praktikën klinike dhe në industrinë stomatologjike. Ato shfaqin potencial të lartë jo vetëm për efikasitetin terapeutik, por edhe për ndikimin e tyre pozitiv në qëndrueshmërinë afatgjate të trajtimeve endodontike. Ky prezentim synon të ofrojë një pasqyrë të gjerë mbi aplikimin aktual dhe perspektivat e ardhshme të ekstrakteve bimore në endodonci, duke u bazuar në evidencë shkencore dhe përvoja klinike, me theks të veçantë në përdorimin e Tanacetum vulgare, Matricaria chamomilla, të cilat janë bimë autoktone me vlera të veçanta terapeutike në rajonin tonë.

Fjalë kyçe: infeksionet me origjinë endodontike, mikroflora patogjene, tanacetum vulgare etj.

FUNKSIONET MASTIKATORE DHE PUNIMET PROTETIKORE.

Arlind Ramadani

Abstrakt
Hyrje: Funksionet mastikatore janë procese thelbësore për tretjen dhe mirëqenien e përgjithshme të individit. Humbja e dhëmbëve dhe çrregullimet në sistemin stomatognatik ndikojnë drejtpërdrejt në përtypje, gëlltitje dhe të folur. Protetika stomatologjike ka për qëllim rikthimin e këtyre funksioneve përmes punimeve fikse, mobile ose implanteve dentare, duke ruajtur estetikën dhe funksionalitetin oral.
Metodologjia: Ky punim është realizuar përmes një rishikimi të literaturës shkencore ndërkombëtare të publikuar në bazat e të dhënave PubMed, MedLine dhe Sci - Hub, duke përdorur fjalë kyçe si "Masticatory muscles", "Dental prosthetics", "Fixed and removable dentures" dhe "Implant - supported prostheses". Janë analizuar studime klinike dhe eksperimentale që trajtojnë lidhjen midis funksioneve mastikatore dhe punimeve protetikore.
Rezultate: Nga analizimi i literaturës del se pacientët pa dhëmbë kanë nevojë për një forcë përtypëse shtatë herë më të madhe krahasuar me ata me dhëmbë natyralë. Punimet fikse kanë jetëgjatësi mesatare prej 10. 3 vjetësh, ndërsa protezat e mbështetura mbi implante tregojnë efikasitet më të lartë funksional dhe adaptim më të mirë muskulor. Implantet gjithashtu parandalojnë atrofine e muskujve mastikatorë dhe ruajnë dimensionin vertikal të fytyrës.
Diskutime: Muskujt mastikatorë, artikulacioni temporomandibular dhe dhëmbët veprojnë në sinkronizim për të mundësuar përtypjen dhe gëlltitjen. Pas humbjes së dhëmbëve, funksionet neuroreflektore ndryshojnë dhe

përtypja bëhet më pak efikase. Punimet protetikore, veçanërisht ato të bazuara në implante, rikthejnë ekuilibrin funksional dhe estetik.
Përfundime: Punimet protetikore janë thelbësore për rikthimin e funksioneve fiziologjike dhe përmirësimin e cilësisë së jetës. Implantet dentare përfaqësojnë standardin modern të rehabilitimit oral, duke ofruar rezultate të qëndrueshme dhe efikasitet të lartë funksional.

Fjalë kyçe: Funksionet mastikatore, punimet protetikore, muskujt mastikatorë, protezat fikse, protezat mobile, implantet dentare, sistemi stomatognatik.

APLIKIMI I KURORAVE ESTETIKE REZINOZE NË DENTISTRINË PEDIATRIKE DHE NDIKIMI I TYRE NË MIRËQENIEN PSIKOLOGJIKE TË FËMIJËS.

Arlinda Karaj[1, 2], Eva Habazaj[3], Elsena Mataj[1, 4], Martin Metushi[5]
[1]*Doktorante në Mjekësi Dentare, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë Tiranë.*
[2]*Pedagoge, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Luarasi.*
[3]*Klinika Stomatologjike Universitare, QSUT*
[4] *Pedagoge, Western Balkans University*
[5] *Teknik Dentar*

Abstrakt
Hyrje: Kujdesi dentar në moshën pediatrike është me rëndësi jo vetëm në aspektin fizik, por edhe në mirëqenien psikologjike të fëmijës. Një buzëqeshje jo vetëm e shëndetshme, por edhe estetike ndikon në vetëbesimin, vetëvlerësimin, raportet sociale dhe zhvillimin emocional të tij. Shqetësimet dentare te fëmijët ndikojnë në cilësinë e jetës së tyre, si edhe në shëndetin mendor.
Qëllimi: Aplikimi i kurorave estetike me rezinë të parafabrikuar të përgatitura me CAD / CAM për të rikthyer estetikën te pacientët e moshës pediatrike. Ndikimi i estetikës dentare në mirëqenien psikologjike të fëmijës.
Përshkrimi i rastit: Prindi paraqitet në klinikën dentare me vajzën (3 vjeç), shqetësimi kryesor i të cilit ishte mirëqenia psikologjike e fëmijës. Në ekzaminimin klinik u konstatua prezenca e kariesit në stadin e dytë, prekje e smaltit - njolla kafe, të lokalizuar kryesisht te 4 dhëmbët frontal lart. Nisur nga mosha e fëmijës dhe mundësitë e bashkëpunimit, u mendua si zgjidhje më e përshtatshme aplikimi i kurorave rezinoze të përgatitura në laborator.
Konkluzione: Përdorimi i kurorave estetike rezinoze të përgatitura me CAD / CAM, ishte një zgjidhje me anë të së cilës mundëm të rikthejmë estetikën e fëmijës, dhe cfarë është më e rëndësishme arritëm të kemi një ndikim jo te vogël në aspektin emocional dhe vetëbesimin e femijës duke e bërë atë të ndjehej e lumtur me buzëqeshjen e re.

Fjalë kyçe: kurora estetike, dentistri pediatrike, mirëqenia psikologjike, vetëbesimi i femijëve.

"BUZËQESHJA GINGIVARE": RIPOZICIONIMI I BUZËS, TEKNIKA KIRURGJIKALE PËR TË TRAJTUAR BUZËQESHJEN GINGIVARE.

DDS DDM MSc Arnold Mboqe

Abstrakt
Buzëqeshja gingivare (Gummy Smile) karakterizohet nga ekspozimi i tepërt i indeve gingivare gjatë buzëqeshjes, duke ndikuar jo vetëm në estetikën e fytyrës, por edhe në mirëqenien psikologjike të pacientit. Etiologjia e buzëqeshjes gingivare është multifaktoriale dhe përfshin faktorë si gjatësia e ekzagjeruar e buzës së sipërme, hipermobiliteti i buzës, mbinxjerrja vertikale e dhëmbëve ose e skeletit maxilofacial, si dhe anomalitë në zhvillimin dento - facial. Këta faktorë shpesh bashkëveprojnë, duke bërë të domosdoshëm një vlerësim klinik të detajuar për të përcaktuar etiologjinë specifike dhe përzgjedhjen e trajtimit adekuat. Në rastet kur buzëqeshja gingivare shkaktohet kryesisht nga hipermobiliteti i buzës së sipërme, duke rezultuar në ekspozim gingivar të lehtë deri mesatar (4 - 8 mm), kirurgjia e ripozicionimit të buzës paraqitet si një opsion efektiv dhe më pak invaziv krahasuar me ndërhyrjet ortognatike më komplekse. Procedura kirurgjikale konsiston në heqjen e një shiriti me trashësi të pjesshme nga mukoza vestibulare bukale e maksilës, dhe më pas qepjen e mukozës së buzës

në vijën mukogingivale, me qëllim reduktimin e lëvizjes së tepërt të buzës dhe minimizimin e ekspozimit të gingivës gjatë buzëqeshjes. Nga një perspektivë mjekësore, kjo teknikë është e sigurtë, me një profil komplikacionesh minimale, dhe sjell përfitime të konsiderueshme estetike dhe funksionale. Për më tepër, ripozicionimi i buzës lehtëson menaxhimin e pacientëve, redukton nevojën për trajtime më invazive dhe ofron një kohë të shkurtër rikuperimi, duke rritur kënaqësinë e tyre dhe cilësinë e jetës. Vlerësimi paraoperativ i kujdesshëm dhe përcaktimi i indikacioneve të sakta janë thelbësore për suksesin e ndërhyrjes dhe për të shmangur komplikacionet. Ripozicionimi kirurgjik i buzës është një alternativë terapeutike e rëndësishme për trajtimin e buzëqeshjes gingivare të shkaktuar nga hipermobiliteti i buzës së sipërme, duke siguruar rezultate të qëndrueshme, estetike dhe funksionale, si dhe përmirësim të mirëqenies psikologjike të pacientëve.

Fjalë kyçe: Buzëqeshje gingivare, buza e sipërme, ekspozim, dhëmbë.

HIPERPLAZIONET GINGIVALE TË SHOQËRUARA ME MEDIKAMENTE - RISHIKIM LITERATURE.

Dr. Artan Quni, Prof. Ass. Dr. Zana Sllamniku - Dalipi
Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë, Drejtimi Stomatologji.

Abstrakt
Qëllimi: Ky punim ka si qëllim analizimin e ndikimit të medikamenteve në zhvillimin e hiperplazioneve gingivale, pasojat që ato shkaktojnë në strukturat e kockës alveolare dhe trajtimin efektiv të këtyre gjendjeve patologjike.
Materiale dhe metoda: Ky studim është një rishikim sistematik i literaturës shkencore të publikuar në vitet e fundit, ku janë shqyrtuar ndryshimet që shkaktohen në gingiva nga medikamentet e përdorura për trajtimin e kushteve të ndryshme mjekësore. Një vëmendje e veçantë iu kushtua medikamenteve antikonvulsante, antihipertensive dhe imunosupresive, të cilat janë të lidhura ngushtë me zhvillimin e hiperplazionit gingival. Një kërkim i literaturës në bazën e të dhënave MEDLINE / PubMed u krye për të identifikuar mekanizmat e përfshirë në procesin e rritjes së tepërt të gingivave të shkaktuar nga medikamentet. Janë shqyrtuar 106 artikuj në këtë rishikim prej të cilave 30 janë punime shkencore.
Rezultate: Sipas analizave të fundit, medikamentet që shkaktojnë më shpesh hiperplazion gingival janë fenitoina (me prevalencë deri në 70% të rasteve), dhe më pas, medikamentet e tjera antikonvulsante që kanë një përqindje prej 30%. Përdorimi i nifedipinës dhe diltiazemit është gjithashtu i lidhur me një rrezik 30% për zhvillimin e hiperplazioneve gingivale, ndërsa verapamili ka një prevalencë prej 20%. Ciklosporina, një medikament imunosupresiv, shkakton hiperplazion në një përqindje të konsiderueshme prej 50 - 80% të rasteve.
Përfundime: Tërheqja nga përdorimi i medikamenteve shkaktuese dhe zëvendësimi i tyre me alternativa më të sigurta, së bashku me përmirësimin e higjienës orale, ka rezultuar të jetë një strategji efektive në trajtimin e hiperplazionit gingival të shkaktuar nga medikamentet. Përfundimet e studimit theksojnë rëndësinë e ndërhyrjeve të hershme terapeutike dhe menaxhimit proaktiv të trajtimit, për të reduktuar komplikimet potenciale në shëndetin parodontal të pacientëve.

Fjalë kyçe: Hiperplazioni i gingivave, rritja e tepërt e gingivave, semundjet e gingivave.

PËRDORIMI I INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË DIAGNOZËN DHE PLANIFIKIMIN E TRAJTIMIT ORTODONTIK: NJË SHQYRTIM I LITERATURËS.

Artana Kajtazi[1], Leutrim Etemi[2]
[1]*Dentiste, Klinika Specialistike Dentare "Dani", Ferizaj, Kosovë*
[2]*Dentist, Klinika Specialistike Dentare "Dini Dent", Prishtina, Kosovë*

Abstrakt
Hyrje: Ky rishikim synon të paraqesë një pasqyrë të përgjithshme mbi aplikimet e inteligjencës artificiale (IA) në diagnostikimin dhe planifikimin e trajtimit ortodontik, si dhe të vlerësojë nëse përdorimi i saj përmirëson saktësinë, qëndrueshmërinë dhe efikasitetin kohor krahasuar me qasjet manuale të bazuara në ekspertizën klinike, duke evidentuar njëkohësisht kufizimet aktuale.

Materiale dhe metoda: Një kërkim sistematik elektronik u krye në bazat e të dhënave PubMed, Web of Science dhe Google Scholar. Pas aplikimit të kritereve të përzgjedhjes, në rishikim u përfshinë gjithsej 59 artikuj shkencorë. Fushat kryesore të kërkimit u kategorizuan në tre domene kryesore sipas qëllimit të përdorimit të IA - së: diagnostikimi (n = 21), identifikimi i pikave kraniometrike (n = 25) dhe planifikimi i trajtimit (n = 13).
Përfundime: Ky rishikim përmbledhës tregon se inteligjenca artificiale ka potencial të konsiderueshëm në fushën e ortodoncisë, veçanërisht në identifikimin e pikave anatomike, i cili mbetet domeni më i studiuar. Ndërsa IA ka treguar aftësi në rritjen e efikasitetit kohor dhe reduktimin e variabilitetit ndër - operator, saktësia dhe besueshmëria e saj ende nuk e kanë tejkaluar nivelin e klinicistëve ekspertë. Mbikëqyrja njerëzore mbetet e domosdoshme në çdo fazë. Nevojiten zhvillime dhe optimizime të mëtejshme për të arritur drejt planifikimit tërësisht të personalizuar dhe të automatizuar të trajtimit. Përdorimi i inteligjencës artificiale në ortodonci përfaqëson një mjet premtues mbështetës në procesin e vendimmarrjes klinike, duke kontribuar në përmirësimin e efikasitetit të diagnostikimit dhe planifikimit terapeutik ortodontik.

Fjalë kyçe: Inteligjenca artificiale, ortodoncia, diagnostikimi, planifikimi i trajtimit.

ANALIZA CEFALOMTRIKE NE MALOKLUZION DENTOSKELETAL KLASE III.

Aurora Isufi, Dr. Renato Isufi, Prof. Dr Virgjini Mulo, Prof. Dr. Lidija Kanurkova

Abstrakt
Hyrje: Grafia cefalometrike laterale është një grafi standarte që përdoret në radhë të pare për diagnozën dhe planin e trajtimit në ortodonci. Është një e dhënë e rëndësishme përpara trajtimit dhe mund të përdoret gjithashtu edhe gjatë trajtimit për të ndjekur progresin. Përdoret për të vlerësuar variacionet e rritjes dhe zhvillimit, etiologjinë e maloluzionit, për të percaktuar nëse maloluzioni është skeletal, dentar apo i lidhur me të dyja. Malokluzioni i Klases së III mund të jetë pasojë e prognatizmit mandibular, retrognatizmit maksilar apo një kombinim i të dyjave, por më i shpeshtë është nga rritja ekscesive e mandibulës.
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është rishikimi i literaturës shkencore dhe vlerësimi i provave egzistuese për saktësinë e grafisë cefalometrike laterale në ortodonci. Gjithashtu nëpërmjet këtij rishikimi literature ne studiojmë saktësinë dhe përshtatshmërinë e grafisë laterale dhe analizës cefalometrike.
Materiali dhe metoda: Përshtatja e studimeve të përzgjedhura është përcaktuar nga leximi i abstrakteve të artikujve të identifikuar në cdo databazë. Të gjithë artikujt që përmbushin kriteret përfshirëse janë përzgjedhur dhe grumbulluar. Strategjia kërkimore ka rezultuar në 120 artikuj. Pas përzgjedhjes sipas kritereve pranuese, 34 artikuj janë kualifikuar për analizën finale.
Konkluzione: Ky kërkim shkencor është i rëndësishëm për specialistët, sepse kur përdor analiza të ndryshme në të njëjtin pacient, konfuzioni krijohet nga diferenca në rezultate, ky studim kërkon që ta reduktojë këtë konfuzion. Si rrjedhojë, të dhënat e marra nga ky studim kontribojnë në njohuritë e përgjithshme të diagnozës në ortodonci. Mund të themi që është thelbësore analiza cefalometrike në lidhje me metoda të tjera për të vendosur diagnozën ortodontike dhe për një plan trajtimi të saktë.

Fjalë kyçe: saktësia e analizës cefalometrike, Malokluzion Klasa III, rishikim literature.

FAKTORËT ETIOLOGJIKË TË ALVEOLITIT.

Dr. Basri Oruqaj
Ordinanca Stomatologjike Dentline, Prishtinë

Abstrakt
Hyrje: Alveoliti, i njohur edhe si “dry socket”, është një nga komplikacionet më të zakonshme pas nxjerrjes së dhëmbëve, veçanërisht të molarëve të tretë mandibularë. Kjo gjendje karakterizohet nga dhimbje intensive, erë e pakëndshme dhe shpërbërje e koagulit të gjakut brenda alveolës.
Qëllimi: Ky studim ka për qëllim të analizojë faktorët shkaktarë të alveolitit pas nxjerrjes së dhëmbëve.
Materiale dhe metoda: Duke u bazuar në një rishikim sistematik të literaturës së 20 viteve të fundit në bazat e të dhënave PubMed, Scopus dhe Google Scholar.

Rezultatet: Alveoliti është rezultat i një kombinimi faktorësh lokalë dhe sistemikë. Trauma kirurgjikale dhe prania e infeksionit janë faktorët primarë, ndërsa duhanpirja dhe hormonet ndikojnë në prishjen e stabilitetit të koagulit. Faktorët tjerë që lidhen me incidencën e alveolitit janë përdorimi i kontraceptivëve oralë, mosha dhe gjinia e pacientit, si dhe mungesa e kujdesit adekuat post - operativ. Evidencat mbështesin se përdorimi i antiseptikëve si klorheksidina dhe ndjekja e teknikave atraumatike gjatë kirurgjisë ulin ndjeshëm rrezikun e zhvillimit të alveolitit.
Konkluzionet: Faktorët lokalë si trauma kirurgjikale dhe infeksioni janë shkaktarët kryesorë, ndërsa faktorët sistemikë si nikotina dhe estrogjeni ndikojnë në destabilizimin e koagulit. Parandalimi i alveolitit kërkon një qasje të integruar që përfshin edukimin e pacientit dhe teknika kirurgjikale të përshtatshme, ndërsa menaxhimi i tij bazohet në trajtimin e dhimbjes dhe përmirësimin e shërimit të indeve.

Fjalë kyçe: alveolit, nxjerrja e dhëmbëve, faktorë rreziku, dry socket, kontraceptivë oralë, duhanpirje, parandalim.

MENAXHIMI DENTAR I PACIENTIT ME ANGINË PEKTORALE TË QËNDRUESHME GJATË NXJERRJES SË DHËMBIT: RAPORT RASTI.

Dr. Baton Binaku
Klinika Dentare Private "Denta Care", Prishtinë, Kosovë

Abstrakt
Ky përshkrim rasti paraqet menaxhimin dentar të një pacienti mashkull 50 - vjeçar me anginë pektorale të qëndrueshme, hipertension dhe dislipidemi, të cilit iu desh të kryhej nxjerrja e premolarit të dytë të majtë maksilar (dhëmbi 25) që nuk mund të restaurohej. Procedura u krye nën anestezi lokale me epinefrinë, duke ndjekur protokollet për reduktimin e stresit dhe pa ndërprerë terapinë antiplaketare. Hemostaza u arrit duke përdorur gazë me celulozë të oksiduar dhe sutura. Pacienti nuk pësoi asnjë komplikim gjatë apo pas procedurës.
Hyrje: Sëmundjet kardiovaskulare, përfshirë anginën pektoris, kërkojnë menaxhim të kujdesshëm stomatologjik për shkak të rrezikut të shtuar për ngjarje kardiake gjatë trajtimit. Udhëzimet aktuale klinike mbështesin kryerjen e procedurave dentare të vogla pa ndërprerjen e terapisë antiagreguese, me kusht që anestetikët lokalë me epinefrinë të administrohen me kujdes dhe të zbatohen protokollet e reduktimit të stresit. Sipas Shoqatës Amerikane të Zemrës (AHA) dhe Shoqatës Evropiane të Kardiologjisë (ESC), pacientët me anginë stabile mund t'i nënshtrohen në mënyrë të sigurt procedurave dentare rutinë, kur sigurohet vlerësimi i rrezikut, strategjitë për reduktimin e stresit dhe monitorimi kardiovaskular.
Diskutime: Ky rast tregon menaxhim të sigurt dhe efektiv të një pacienti me gjendje mjekësore të kompromet uar. Literatura mbështet vazhdimin e terapive antiplatelet, me studime që konfirmojnë rrezik të ulët të komplikacioneve hemorragjike kur ato menaxhohen me masa lokale, si celuloza e oksiduar. Anestetikët që përmbajnë epinefrinë gjithashtu konsiderohen të sigurt në doza të kontrolluara. Inspektimi vizual dhe protokollet e menaxhimit të stresit janë thelbësore. Nitroglicerina profilaktike nuk është gjithmonë e nevojshme, siç ishte rasti këtu. Ky rast ilustron rëndësinë e aplikimit të gjykimit klinik të strukturuar dhe protokolleve të bazuara në prova te pacientët me sëmundje iskemike të zemrës. Hemostaza në këtë rast u arrit duke përdorur gazë me celulozë të oksiduar të kombinuar me qepje, që është një qasje e zakonshme dhe efektive. Sidoqoftë, vëzhgimet klinike të fundit sugjerojnë se te disa pacientë, veçanërisht ata me kohë të zgjatur të gjakderdhjes ose mekanizma koagulimi të kompromet uar, përdorimi i celulozës së oksiduar mund të vonojë shërimin dhe të rrisë parehatinë post - operatore. Prandaj, te shumica e pacientëve, thjesht kompresimi me gazë dhe mbajtja e presionit për 30 minuta mund të jetë e mjaftueshme për hemostazë, madje edhe në prani të terapive antiplatelet. Procedurat kirurgjikale orale te pacientët me sëmundje kardiovaskulare kërkojnë planifikim të individualizuar dhe koordinim të ngushtë me mjekët për të minimizuar rrezikun.
Përfundime: Me planifikim adekuat paraoperativ dhe menaxhim në përputhje me udhëzimet klinike, nxjerrjet dentare te pacientët me angina stabile mund të kryhen në mënyrë të sigurt. Ky rast thekson rëndësinë e vlerësimit individual të rrezikut dhe respektimit të protokolleve bazuar në dëshmi. Për më tepër, kombinimi i planifikimit paraoperativ të kujdesshëm, vlerësimit kardiovaskular dhe zbatimit të protokolleve të bazuara në dëshmi siguron një menaxhim të sigurt të nxjerrjeve dentare tek pacientët me angina pektoris stabile. Ky rast thekson rëndësinë e bashkëpunimit ndërdisiplinor, vlerësimit të personalizuar të rrezikut dhe zgjedhjes së teknikave të përshtatshme hemostatike. Integrimi i metodave jo - farmakologjike për reduktimin e stresit, së bashku me përdorimin korrekt të agjentëve hemostatikë, është thelbësor për përmirësimin e shërimit, parandalimin e

komplikacioneve si “dry socket” dhe arritjen e rezultateve dentare të favorshme te pacientët me gjendje të kompromet uar shëndetësore. Pajtim i shkruar i informuar u mor nga pacienti për publikimin e këtij rasti dhe për përdorimin e të gjitha imazheve klinike të lidhura.

Fjalë kyçe: Angina pektorale, nxjerrja e dhëmbit, menaxhimi dentar, sëmundje kardiovaskulare, terapi antiplaketare, anestezi lokale.

PLANIFIKIMI KIRURGJIKAL DHE PROTETIK I IMPLANTEVE DENTARE TEKE NË MAKSILË DHE MANDIBUL, RËNDËSIA E MENAXHIMIT TË INDEVE TË BUTA.

Benarda Beqaraj[1,2], Armend Topalli[3]
[1] Fakulteti i Stomatologjisë, Universiteti Aldent, Tiranë, Shqipëri
[2] Smile Dental Studio, Tiranë, Shqipëri
[3] AT Group Dental Lab, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Hyrje: Trajtimi me implante teke paraqet sfida të shumta jo vetëm për shkak të anatomisë komplekse dhe densitetit të kufizuar kockor, por edhe për menaxhimin e protetikës dhe indeve të buta përreth implantit. Stabiliteti biologjik dhe estetik i implantit varet nga një integrim harmonik midis planifikimit kirurgjikal dhe atij protetik.
Objektiva: Të vlerësohet ndikimi i planifikimit protetik të hershëm në pozicionimin e implantit, si dhe roli i menaxhimit të indeve të buta (gingivës dhe mukozës peri - implantare) në suksesin afatgjatë funksional dhe estetik.
Metoda: U përfshinë 50 pacientë me mungesa distale (25 maksilë, 25 mandibulë), ku planifikimi kirurgjikal u integrua me dizajnin protetik të parashikuar. U përdor CBCT për planifikimin kirurgjikal 3D, teknika të augmentimit kockor kur nevojitej, si dhe procedura për ruajtjen dhe formësimin e indeve të buta (abutmente të përkohshme, profile emergjence të personalizuara. Analizat u fokusuan mbi stabilitetin e indeve të buta dhe rezultatet protetike.
Rezultate: Pas 12 muajsh ndjekjeje, shkalla e mbijetesës së implanteve ishte 97%. Menaxhimi aktiv i indeve të buta solli një stabilitet më të mirë gingival dhe reduktoi recesionin mukozal (mesatarisht 0. 4 mm kundrejt 1. 2 mm në rastet pa ndërhyrje specifike, $p < 0.05$). Nga ana protetike, profili emergjent i personalizuar përmirësoi integrimin estetik dhe funksional të punimeve fikse, duke rritur nivelin e kënaqësisë së pacientëve.
Përfundime: Suksesi afatgjatë i implanteve në zonat distale nuk varet vetëm nga vendosja kirurgjikale, por edhe nga planifikimi protetik i hershëm dhe menaxhimi i kujdesshëm i indeve të buta. Një qasje e integruar kirurgji–protetikë është thelbësore për të garantuar stabilitet biologjik dhe rezultate estetike të qëndrueshme.

Fjalë kyçe: implante dentare, planifikim kirurgjikal, planifikim protetik, inde të buta, maksilë, mandibulë, CBCT.

ROLI I MJEKUT ORTODONT NË MENAXHIMIN DHE TRAJTIMIN E SINDROMIT TË APNESË SË GJUMIT TEK FËMIJËT: RISHIKIM LITERATURE.

Berna Stojani

Abstrakt
Hyrje: Apnea e gjumit (OSA) është një problem shëndetësor i rëndë që prek shumë fëmijë. Me miratimin e ADA në 2017 për përfshirjen e fushës ortodontike në menaxhimin e apnesë së gjumit, një frymë e re inovative u integrua në protokollin e trajtimit të OSA si tek fëmijët ashtu dhe tek adultët. Duke u mbështetur në një analizë të hollësishme të literaturës bashkëkohore, ky studim synon të shpalos ndikimin e kritereve ortodontike në identifikimin dhe trajtimin e apnesë së gjumit te fëmijët dhe të eksplorojë rolin dhe kontributin e mjekut ortodont në menaxhimin e këtij sindromi.
Materiale dhe metoda: U shqyrtuan 130 artikuj duke u përqëndruar në informacione dhe të dhëna me qëllim sjellen e qasjeve dhe diskutimeve më bashkëkohore dhe të vlefshme përsa i përket këtij studimi. Periudha kohore e informacioneve të përzgjedhura ishte e pakufizuar.

Hulumtimi përfshiu burime të marra nga literatura, PubMed, Medline, Cochrane, EMBASE, ResearchGate në gjuhën angleze me afat kohor të papërcaktuar.
Rezultate: U vu re një përmirësim i konsiderueshëm i parametrave polisomnografikë: rënie e niveleve të indeksit, AHI nga 8±3. 4 në 2. 2±1. 9, dhe rritje e SpO2 nga 91. 36±7. 5 në 96. 76±0. 9 pas trajtimit me ekspanduesin maksilar. Edhe me avancimin e mandibulës gjithashtu u vu re rënie e indeksit AHI nga 6. 29 ± 4. 5 në 2. 17 ± 0. 7 dhe rritje e nivelit të saturimit të oksigjenit nga 89. 4 në 94. 48. Konstatohet reduktim i rezistencës nazale duke e lehtësuar kështu frymëmarrjen nazale dhe përmirësim i cilësisë së gjumit dhe jetës në tërësi.
Konkluzione: Roli i mjekut ortodont në sindromin e apnesë së gjumit është më shumë i tipit interceptiv me fokus në reduktimin e indeksit AHI. Diagnostikimi i hershëm, trajtimi i personalizuar, i përshtatur me karakteristikat individuale të secilit pacient, ndihmon në përmirësimin e rrugëve ajrore gjatë gjumit dhe parandalimin e komplikacioneve të mundshme të kësaj gjendjeje. Ndërhyrja ortodontike, në bashkëpunim me ekipin multidisiplinor shëndetësor, mund të konsiderohen hallka të lidhura fort me njëra tjetrën, gërshetimi i të cilave mund të jetë çelësi për shërimin e OSA.

Fjalë kyçe: Apnea e gjumit tek fëmijët, aparate ortodontike, RME, avancimi mandibular, cefalometri, AHI.

PËRDORIMI I EKSTRAKTEVE BIMORE NË ENDODONCI.

Dr. Besëjona Januzi, Dr. Rina Selmani
Qendra Stomatologjike Klinike Universitare e Kosovës

Abstrakt
Hyrje: Fitoterapia studion përdorimin e ekstrakteve me origjinë bimore si medikamente ose si agjentë që kontribuojnë në përmirësimin e shëndetit. Në fushën e endodoncisë, përdorimi i substancave bimore ka marrë rëndësi në rritje për shkak të efekteve citotoksike të disa irriguesve tradicionalë dhe rritjes së rezistencës bakteriale ndaj antibiotikëve. Ekstraktet bimore njihen për rolin e tyre në pastrimin dhe dezinfektimin e kanaleve të rrënjëve, përdorimin ndërmjet seancave dhe ndikimin në procesin e reparimit të dentinës dhe pulpës dentare, duke treguar potencial të madh terapeutik në trajtimet endodontike.
Qëllimi: Ky punim synon të rishikojë literaturën bashkëkohore mbi përdorimin e ekstrakteve bimore në endodonci, me qëllim përditësimin e njohurive lidhur me efikasitetin, përdorimin, avantazhet dhe kufizimet e tyre sipas qëndrimeve të autorëve të ndryshëm.
Metodologjia: Punimi është realizuar në formën e një rishikimi të literaturës. Janë analizuar artikuj dhe studime shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare, që trajtojnë përdorimin e ekstrakteve bimore në trajtimet endodontike. Fokusi është vendosur në substanca si Morinda citrifolia, Curcuma longa (turmeriku), Glycyrrhiza glabra (likoricia), Propolis, Triphala, Melaleuca alternifolia (tea tree oil), Azadirachta indica (neem), Thymus vulgaris, Tanacetum vulgare dhe Aloe vera.
Rezultate dhe diskutime: Rezultatet nga literatura tregojnë se përbërjet bioaktive të këtyre bimëve – përfshirë alkaloidet, kumarinat, saponinat dhe flavonoidet – manifestojnë veti antibakteriale, antiinflamatore dhe rigjeneruese të pulpës dentare. Megjithatë, shumica e studimeve ekzistuese janë kryer in vitro ose ex vivo, duke kufizuar vlefshmërinë e tyre klinike.
Konkluzione: Ekstraktet bimore paraqesin një potencial të konsiderueshëm si alternativa biokompatibile në trajtimet endodontike, duke ofruar më pak efekte anësore dhe një qasje më natyrale ndaj shëndetit oral. Për vlerësim të plotë të efikasitetit dhe sigurisë së tyre, nevojiten studime të mëtejshme in vivo në modele shtazore dhe njerëzore.

Fjalë kyçe: Fitoterapia, ekstrakte bimore, endodonci, antibakterial, biokompatibilit.

ANKTHI PËRPARA EKSTRAKSIONIT KIRURGJIKAL TË MOLARIT TË TRETË.
Dr. Bisela Asllanaj, Prof. Suzana Gjeci

Abstrakt:
Hyrje: Ekstraksioni kirurgjikal i molarit të tretë është një nga procedurat më të shpeshta që realizohet në klinikën dentare dhe shpesh shoqërohet me nivel të lartë të ankthit në fazën preoperative. Percepsioni paraprakë i pacientëve mbi dhimbjen, frika nga komplikacionet që e shoqërojnë vet procedurën dentare dhe vështirësia e vet interventit ndikojnë në bashkepunimin mjek pacient dhe përjetimin e dhimbjes gjatë dhe pas ndërhyrjes.
Objektiva: Qëllimi ishte vlerësimi i prevalencës dhe shkallës së ankthit preoperative tek pacientët që do I nënshtroheshin procedurës së ekstraksionit të molarit të tretë. Ne synuam të identifikojm faktorët kryesorë kontribues në rritjen e ankthit tek këta pacient.
Materialet dhe metodat: Studimi që zgjodhëm ishte cross - sectional tek pacientët adult të paraqitur në klinik për ekstraksionin kirurgjikal të molarit të tretë. Një pyetësorë specifik mbi ankthin ju bashkangjitë anamnezës në kartelën personale të pacientëve dhe niveli i ankthit u vlerësua me shkallën e modifikuar të ankthit dentarë (MDSA). Programi spss u përdor për të parë lidhjet statistikore midis ankthit dhe faktorëve psikologjik dhe klinik.
Rezultate: Më tepër se 50% e pacientëve paraqitën ankth para dhe gjatë injeksionit të anestezisë, veshjes kirurgjikale të stafit, pamjes së instrumenteve të paketuara mbi tavolinë, zhurma e frezës. Por komunikimi I vazhdueshëm empatik, shpjegimi I qartë paraprakisht I procedurës dukshëm ulte stresin dhe ankthin.
Konkluzione: Ankthi para ekstraksionit të molarit të tretë dukshëm ndikon në suksesin e procedurës dhe rikuperimin postoperatorë të pacientit. Komunikimi I mirë, sqarimi I detajuar I procedurës, pregatitja profesionale dhe eksperienca e mjekut kirurgë, metodologjia bashkëkohore e paisjeve dentare përmirëson dhe redukton ankthin tek pacienti, rrit shpejtësinë e interventit dhe rikuperimin post operatorë.

Fjalët kyçe: ankthi, anestezia, komunikimi, darët, zhurma, tronditja.

MARRËDHËNIA NË MES TË SËMUNDJEVE PARODONTALE DHE SËMUNDJEVE ISHEMIKE TË ZEMRËS.
Dr. Blend Gashi, Prof. Ass. Dr. Zana Sllamniku Dalipi

Abstrakt
Hyrja: Sëmundjet periodontale dhe sëmundjet ishemike të zemrës janë patologji kronike me prevalencë të lartë globale dhe faktorë të përbashkët rreziku. Marrëdhënia midis sëmundjeve periodontale dhe sëmundjeve ishemike të zemrës, paraqet një marrëdhënie komplekse, e cila shpjegohet përmes mekanizmave të inflamacionit sistemik, diseminimit bakterial dhe stresit oksidativ. Këto mekanizma çojnë në ndryshime klinike të dukshme, si thellësi të shtuar të xhepit parodontal, humbje të lidhjes klinike dhe gjakderdhje gjatë sondimit, të cilat janë të lidhura me nivele të larta të markerëve sistemik të inflamacionit, si proteina C - reaktive dhe interleukin - 6. Trajtimi parodontal, si në formën jo - kirurgjike ashtu edhe kirurgjike, ka treguar efekte pozitive në menaxhimin e këtyre pacientëve, duke reduktuar inflamacionin lokal dhe sistemik.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të hulumtoj marrëdhënien midis sëmundjeve parodontale dhe sëmundjeve ishemike të zemrës. Ky hulumtim synon të shqyrtojë se si sëmundja parodontale mund të kontriboj në rrezikun kardiovaskular dhe nëse trajtimi ose parandalimi i sëmundjes parodontale mund të reduktojë mundësinë e komplikimeve kardiovaskulare.
Metodologjia: Është bërë një rishikim sistematik i literaturës, përmes punimeve të publikuara viteve të fundit, me anë të së cilave janë vlerësuar mekanizmat e ndërlidhjes, ndryshimet klinike parodontale tek pacientët me sëmundje ishemike të zemrës dhe trajtimi jo - kirurgjikal dhe kirurgjikal periodontal.
Rezultate: Pacientët me sëmundje ishemike të zemrës shpesh shfaqin ndryshime parodontale të dukshme, si thellësi të shtuar të xhepit, resorbim më të shprehur kockor, gjakderdhje gjatë sondimit. Trajtimi parodontal, si ai jo - kirurgjikal ashtu edhe kirurgjikal, ka treguar ndikime pozitive në reduktimin e inflamacionit sistemik dhe përmirësimin e shëndetit paroodontal.
Përfundime: Trajtimi i sëmundjes parodontale, si me formën jo - kirurgjike ashtu edhe kirurgjike, së bashku me menaxhimin e faktorëve të rrezikut kardiovaskular, ka treguar rezultate të suksesshme në uljen e inflamacionit lokal dhe sistemik tek pacientët me sëmundje iskemike të zemrës.

Fjalë kyçe: sëmundje ishemike**,** inflamacion lokal, ndryshime paradontale, hemorragji.

KËSHILLIMI I PACIENTIT PERIODONTAL PËR PARANDALIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E PROGNOZËS SË TRAJTIMIT TË SËMUNDJEVE INFLAMATORE PERIODONTALE.

Blerina Zeza, Erdita Cenameri
Departamenti i Stomatologjisë
Katedra e Periodontologjisë
Albanian University, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Qëllimi: Sëmundjet periodontale mbeten të përhapura globalisht pavarësisht përparimeve në nivel trajtimi dhe parandalimi. Qëllimi i këtij punimi është të vëzhgojë evidencën mbi faktorët që mund të ndikojnë në këtë gjendje.
Metoda: Kërkim sistematik i literaturës klasike dhe të fundit në përputhje me qëllimin.
Rezultate: Sëmundjet periodontale njihen për natyrën komplekse në të cilën pllaka bakteriale specifike njihet si faktor kryesor etiologjik por që nuk arrin të shkaktojë shfaqjen klinike të sëmundjes nëse nuk janë të pranishëm faktorët që ndryshojnë nivelin e përgjigjes inflamatore dhe imune të organizmit. Ndër këto faktorë, pavarësisht se të përmendur, shpesh të neglizhuar në praktikën e përditshme qëndrojnë aspekti emocional dhe mental i pacientit, dieta, aktiviteti fizik etj.
Përfundime: Për parandalimin si parësor edhe dytësor të periodontitit shërben një orientim individual në harmoni me kërkesat e brendshme të çdo pacienti, ku të përfshihet këshillimi mbi higjienën orale, ushqyerjen, aktivitetin fizik dhe menaxhimin emocional dhe mental.

Fjalë kyçe: periodontit, sëmundje periodontale, parandalim parësor, parandalim dytësor, stresi.

MANIFESTIMET ORALE NË PACIENTËT ME DIABET MELLITUS, MENAXHIMI I TYRE.

Blerta Rumano[1], Eva Habazaj[1], Belisa Kaleci[1], Gerta Kaçani[2], Eralda Lleshi[1].
[1]*Klinika Stomatologjike Universitare*
[2]*Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*

Abstrakt
Diabeti Mellitus (DM) është një sëmundje kronike dhe shfaqet kur pankreasi nuk prodhon insulinën ose prodhon një sasi të pakët insuline. Referuar të dhënave të IDF (International Diabetes Federation) 537 milion të rritur (të grupmoshës 20 - 79 vjeç) janë të prekur nga diabeti. Punimi ka si qëllim rritjen e njohurive mbi manifestimet orale te pacientët diabetik, komplikimet që lidhen me këtë sëmundje dhe menaxhimin e tyre. Për të gjetur literaturë me interes për këtë punim u realizua një kërkim në database të ndryshme elektronike (Pubmed Medline, Google Schoolar) duke përdorur terma të përshtatshëm kërkimi. Të dhënat u mblodhën dhe rezultatet u deklaruan. Kjo sëmundje mund të ketë shumë komplikime të ndryshme sistemike duke përfshirë dhe zgavrën e gojës. Komplikimet sistemike të DM përfshijnë zemrën, dëmtime të veshkave, dëmtime të syve dhe dëmtime të nervave. Manifestimet dhe komplikimet e rëndësishme orale përfshijnë kserostominë, kariesin dentar, gingivitin, sëmundjen periodontale, tendencën e shtuar për infeksione orale, djegien e gojës, shqetësimin e shijes dhe vështirësi në shërimin e plagëve. Ndryshimi në stilin e jetesës, kontrollet e rregullta dentare me theks vlerësimin periodontal dhe përforcimi i udhëzimeve të shëndetit oral mund të parandalojnë në mënyrë efektive komplikacionet orale të DM.

Fjalë kyçe: Diabeti mellitus, manifestimet orale, komplikimet orale, menaxhim.

RUAJTJA E FUNKSIONIT DHE FORMËS GJATË RIKONSTRUKSIONIT TË BUZËS SË POSHTME: REZULTATET E MENJËHERSHME TË RIKONSTRUKSIONIT ME LAMBO KARAPANDZIC NË KARCINOMËN SKUAMOCELULARE TË BUZËS SË POSHTME.

Blerta Rusinovci[1, 2], Sinan Rusinovci[2, 3], Enis Beka[2]
[1]*Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti i Mjekësisë – Studime të Doktoratës, Departamenti i Mjekësisë Paraklinike*
[2]*Klinike Stomatologjike dhe Kirurgjike "SiDent", Prishtinë*
[3]*Kolegji UBT – Higher Education Institution, Profesor i Kirurgjisë Maksilofaciale, Prishtinë*

Abstrakt
Kanceri i zgavres së gojës është një tumor malinj, kërcenues për jetën të cilin e shkaktojnë faktorë te jashtëm si pirja e duhanit, alkoolit, virusi Human Papilloma dhe faktorë të brendshëm si p. sh alterimet gjenetike. Më shumë se 90% e kancerit oral ka origjinë nga qelizat skuamoze dhe për këtë njihet edhe me emrin Karcinoma Skuamocelulare, e cila përfshin mukozen bukale, dyshemenë e gojës, pjesën anteriore të gjuhës, kreshtat alveolare, regjionin e trigonumit retromolar, qiellzën e fortë dhe mukozën e buzëve. Shumica e tumoreve malinje orale diagnostikohen vonë, duke rezultuar në një shkallë të lartë të vdekshmërisë. Prandaj, diagnoza e hershme, jo vetëm që ndihmon në parandalimin e komplikimeve të sëmundjes, por edhe në sigurimin e një jete të shëndetshme për pacientin. Kirurgjia mbetet trajtimi kryesor për karcinomën qelizore skuamoze (OCSC), si në fazë të herëshme ashtu dhe në atë të avancuar. Defektet e buzës së poshtme pas heqjeve të karcinomës qelizore skuamoze (SCC) rikonstruktohen me disa teknika kirurgjikale. Megjithatë, rikonstruktimi i defekteve me përfshirje më të madhe të mbetet një sfidë terapeutike. Zgjedhja e teknikes operative varet nga madhësia e defektit. Defektet më të mëdha, që arrijnë një të tretën deri në dy të tretat e gjerësisë së buzës së poshtme mund të mbyllen me teknikat Karapandzic, Abbe, Estlander etj. Në këtë punim, ne prezantojmë një rast të suksesshëm ku kemi përdorur teknikën Karapandzic për rikonstruktimin e plotë të buzës së poshtme, pasi karcinoma skuamoqelizore ka përfshirë pjesën më të madhe të saj. Teknika me përdorimin e lambos Karapandzic është një metodë e preferuar për rikonstruktimin e buzëve, veçanërisht tek ato raste kur kemi ind të mjaftueshëm bukal për mobilizim dhe kur nuk kërkohet marrja e indit shtesë nga buzët. Nga pamja dhe rezulteti i menjëhershëm post - operativ, mund të sugjerohet se kjo teknikë dhe përdorimi i kësaj lamboje ka potencial të lartë për të ruajtur lëvizshmërinë e buzëve, funksionin artikulues dhe, në përgjithësi, integritetin e zgavrës së gojës.

Fjalë kyçe: Kanceri oral, karcinoma skuamocelulare, buza e poshtme, rikonstruksioni kirurgjikal, lambo karapandzic.

ZIRKONIA VS EMAX: FORCË, ESTETIKË DHE PERFORMANCË KLINIKE – RISHQYRTIM I LITERATURËS.

Blerta Vehapi, Elza Vehapi, Rronë Kryeziu

Abstrakt
Hyrje: Rritja e kërkesës për restaurime dentare pa metal ka nxitur përdorimin e materialeve tërësisht qeramike, ku zirkonia dhe disilikati i litiumit (e. max) përfaqësojnë sistemet më të besueshme në stomatologjinë moderne. Të dy materialet ofrojnë kombinim të vetive mekanike, estetike dhe biologjike, por ndryshojnë dukshëm në përbërje, strukturë dhe sjellje klinike. Përzgjedhja e saktë midis tyre është thelbësore për arritjen e suksesit afatgjatë të restaurimeve.
Metodologjia: Ky studim synon të krahasojë në mënyrë gjithëpërfshirëse kurorat prej zirkoni dhe e. max në aspektin e përbërjes kimike, vetive estetike, qëndrueshmërisë mekanike, mekanizmave të ngjitjes dhe performancës klinike. Për këtë qëllim, u analizuan publikime të periudhës 2010–2025 të përfshira në bazat e të dhënave PubMed, Scopus dhe ScienceDirect, duke përfshirë studime in vitro, prova klinike të kontrolluara dhe rishikime sistematike.
Rezultate: Zirkonia, e përbërë nga kristale tetragonale të stabilizuara me yttrium (Y - TZP), paraqiti forcë të lartë mekanike (900–1200 MPa), qëndrueshmëri ndaj frakturës dhe rezistencë të lartë ndaj konsumimit, gjë që e bën ideale për restaurime posteriore dhe restaurime të mbështetura në implante. Megjithatë, transparenca e kufizuar dhe protokollet komplekse të ngjitjes kufizojnë përdorimin e saj në zonat me kërkesa të larta estetike. Nga ana tjetër, disilikati i litiumit (e. max) — një qeramikë qelqore — ofron transparencë dhe përshtatje ngjyrash

të shkëlqyer, si dhe potencial të lartë për ngjitje adhezive. Edhe pse forca e saj e përkuljes (350–450 MPa) është më e ulët se ajo e zirkonit, performanca estetike është dukshëm më e lartë.
Përfundime: Të dy materialet kanë treguar biokompatibilitet të lartë dhe norma qëndrueshmerie mbi 90% në ndjekje afatgjata (5–10 vjet). Zirkoni mbetet zgjedhja më e përshtatshme për zona me ngarkesë të lartë funksionale, ndërsa e. max preferohet për restaurime anteriore ku estetika është prioritet. Përzgjedhja e materialit duhet të udhëhiqet nga kërkesat funksionale, aspektet estetike dhe protokolli i ngjitjes. Zhvillimi i zirkonit me transparencë të përmirësuar dhe studimet klinike afatgjata të tij mbeten prioritet për kërkimet e ardhshme shkencore.

Fjalë kyçe: Zirkonia, disilikat litiumi, e. max, restaurime qeramike, estetikë dentare, forcë mekanike, adhezion, CAD / CAM.

PËRDORIMI I INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË DIAGNOZËN DHE PLANIN E TRAJTIMIN NË ORTODONCINË KLINIKE SI DHE ROLI I SAJ NË PËRMIRËSIMIN E KOMUNIKIMIT MJEK - PACIENT NËN TRAJTIM ORTODONTIK, NJË RISHIKIM I LITERATURËS.

Borana Vrapi[1], Adora Shpati[1], Adela Alushi[2]
[1]*Fakulteti i Shkencave Dentare, Universiteti Aldent, Tirana, Shqipëri*
[2]*Universita degli Studi "G. d'Annunzio" Chieti - Pescara, Itali*

Abstrakt
Hyrje: Inteligjenca artificiale (IA) po integrohet gjithnjë e më shumë në fushën e Stomatologjisë, duke përfshirë zhvillimet e rëndësishme në ortodonci. Në vitet e fundit është vënë re një rritje e konsiderueshme e softuerëve që përdorin IA për vlerësimin e rastit dhe planifikimin e trajtimit ortodontik. Studime të shumta kanë treguar përdorimin e gjerë të IA në praktikën klinike, me nivele të larta saktësie dhe suksesi. Sot, IA po tejkalon përdorimin vetëm nga specialistët dhe po shndërrohet në një sistem mbështetës informimi edhe për pacientët në trajtim ortodontik.
Qëllimi: Ky rishikim i literaturës synon të vlerësojë rolin softuerëve të bazuar në IA në përmirësimin e cilësisë së trajtimit ortodontik dhe mundësitë konkrete të aplikimit të tyre në klinikat dentare në vendin tonë.
Materiale dhe Metoda: Është kryer një rishikim sistematik i literaturës për periudhën 2020–2025, duke përdorur databaza online si PubMed, Google Scholar, ResearchGate dhe Web of Science. Janë përfshirë studime in vitro dhe in vivo që trajtojnë aplikimin e IA në diagnozën, planifikimin dhe komunikimin në ortodonci.
Rezultatet: Studimet konfirmojnë nivele të larta saktësie në analizën e rasteve dhe planifikimin e trajtimit përmes IA. Gjithashtu, IA ndihmon në orientimin e praktikës klinike në procedura të ndryshme, si pozicionimi i braketave dhe monitorimi i përparimit të trajtimit. Roli i saj në përmirësimin e komunikimit mjek - pacient është gjithashtu evidentuar.
Konkluzione: Integrimi i inteligjencës artificiale në klinikat dentare sjell përfitime të rëndësishme për klinicistët dhe pacientët. Për të maksimizuar këto përfitime, është e nevojshme që profesionistët të kenë akses në programet IA dhe të ofrohen trajnime të specializuara për përdorimin e tyre në ortodonci.

Fjalë kyçe: Inteligjenca artificiale, ortodonci, diagnozë, planifikim trajtimi, komunikim mjek - pacient.

TRAUMAT E REGJIONIT MAKSILLOFACIAL DHE ORAL NGA KËNDVËSHTRIMI MJEKO - LIGJOR.

Dea Llapashtica

Abstrakt
Hyrje: Trauma maksillofaciale përfshin çdo dëmtim fizik në regjionin e fytyrës dhe përfaqëson një entitet klinik të shpeshtë në praktikën e kirurgjisë maksillofaciale, shpesh e shoqëruar me një shkallë të lartë morbiditeti. Qëllimi i këtij studimi është të hulumtoj të gjitha traumat e regjionit maksilofacial, duke u fokusuar në klasifikimin e tyre në aspektin mjekoligjor, bazuar në të dhënat e mbledhura në Klinikën e Kirurgjisë Maksilofaciale në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Të dhënat në studim janë regjistruar gjatë një periudhe njëvjeçare, përgjatë vitit 2024. Ky studim është retrospektiv, krahasues dhe analizues. Në ndarjen e

tyre në bazë të shkaktarit të traumës rezultoi se numri më i madh i traumave është si rezultat i aksidenteve në komunikacion me dominim të pacientëve dhe me përfshirje me rreth 38%, në vendin e dytë janë rrëzimet me një përqindje prej 29%, të pasuar nga përleshja fizike me 13%, rënie nga lartësia me 6%, lëndim gjatë punës me 7%, dhe lëndim sportiv me 7%. Ndarja në lëndime trupore të lehta dhe të rënda sipas gjinisë rezultoi se përqindja e meshkujve me lëndime të rënda trupore dominon rreth 69. 33% kurse femrat me 13. 33%, meshkujt dominojnë edhe në lëndime të lehta trupore me rreth 13. 33% ndërsa femrat me 4%. Ndarë sipas gjinisë, shihet pjesëmarrja më e madhe e meshkujve me gjithsej 84%, dhe pjesëmarrja e femrave me gjithsej 16%. Shkaktarët dhe karakteristikat e traumave maksilofaciale ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme midis vendeve të ndryshme, duke u ndikuar nga faktorë të shumtë social, ekonomikë, kulturorë dhe infrastrukturorë. Traumat maksilofaciale zakonisht shoqërohen edhe me prishje të aspektit estetik (shëmtimi), atëherë nga këndvështrimi juridiko - civil është e rëndësishme që të bëhet kjo analizë dhe vlerësimi i tij si pjesë e rëndësishme mjeko - ligjore.

Fjalë kyçe: mjekësi ligjore, trauma, regjioni maksillofacial, shëmtimi, fraktura.

RASTE KLINIKE: PIEZOKIRURGJIA NË KIRURGJINË ENDODONTIKE.

Dr. Denis Kadaifciu[1], Dr. Eriselda Simoni[1], Dr. Renato Isufi[1], Dr. Shk. Belisa Kaleci[1], Dr. Shk. Xhanina Gavrazi[1], Prof. As. Silvana Bara[2]
[1]*Klinika Stomatologjike Universitare, Tiranë*
[2]*Fakulteti i Mjekësise Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*

Abstrakt
Hyrje: Kirurgjia endodontike synon të trajtojë patologjitë e plulpës dhe lezionet shoqëruese periapikale. Metodat kirurgjikale tradicionale përfshijnë përdorimin e instrumentave rotator dhe manual, të cilët mund të cojnë në komplikacione si dëmtimi i indeve të buta përreth, me shume hemorragji në fushën operatore dhe dhimbje gjatë dhe post operatore më të madhe. Piezokirurgjia u prezantua në fillimin e viteve 2000, ajo shfrytëzon valët ultrasonike për të prerë indet e forta me precision shumë të lartë.
Rasti klinik: Pacienti mashkull, 45 vjeç u paraqit në Shërbimin e Kirurgjisë pranë Klinikës Stomatologjike Universitare me diagnozën e granulomës periapikale tek dhembi 12. Meqënëse pacienti kishte punim protetik urë fikse porcelani trajtimi i zgjedhur ishte kirurgjia endodontike. Meqënëse pacienti vuante nga HTA dhe ankth u vendos që kirurgjia endodontike të realizohej me pajisjen e piezos për shkak të hemorragjisë dhe traumës minimale që ajo ofton në fushën operatore.
Konkluzione: Aplikimi i piezokirurgjisë në procedurat endodontike ka rritur precizionin, ka reduktuar hemorragjinë dhe traumën dhe ka përmirësuar rezultatet postoperatore, duke e bërë atë një mjet të domosdoshëm për endodontinë moderne.

Fjalë kyçe: Piezokirurgji, kirurgji endodontike, instrumenta rrotatore.

NEUROBIOLOGJIA E BRUKSIZMIT: NJË ÇRREGULLIM I LIDHUR ME STRESIN APO ME SISTEMIN EKSTRAPIRAMIDAL? RISHIKIM LITERATURE.

Dr. Denisa Musaj, Dr. Adrian Qypi.

Abstrakt
Hyrje: Bruksizmi përbën një çrregullim motorik orofacial, i karakterizuar nga shtrëngimi ose kërcitja e pavullnetshme e dhëmbëve, që mund të ndodhë si gjatë gjumit por në disa raste dhe kur pacienti është zgjuar. Prevalenca e lartë dhe ndikimi i tij në shëndetin oral dhe mirëqënien e përgjithshme kanë nxitur kërkime të shumta mbi etiologjinë dhe patofiziologjinë e tij. Tradicionalisht, bruksizmi është lidhur kryesisht me stresin apo me faktorë të tjerë psikologjikë, të cilët kanë ndikim duke aktivizuar dhe boshtin hipotalamo - hipofizo - adrenal duke çrregulluar kështu ekuilibrin neurokimik të sistemit nervor qëndror. Megjithatë, evidencat e reja tregojnë se bruksizmi mund të ketë gjithashtu një bazë etiologjike neurobiologjike e lidhur me sistemin ekstrapiramidal. Disregullimi i neurotransmetuesve dopaminergjikë dhe funksioni i ganglioneve bazale të cilat luajnë rol në kontrollin e levizjeve të pavullnetshme dhe mund të ndikojnë në shfaqjen e këtij aktiviteti motorik. Ndërveprimi midis stresit dhe mekanizmave dopaminergjikë sugjeron se bruksizmi është rezultat i

bashkëveprimit midis proçeseve neurobiologjike dhe psikologjike, më shumë sesa i një shkaku të vetëm. Kjo e vendos bruksizmin në kufirin midis një reagimi ndaj stresit dhe një çrregullimi të modulimit motorik ekstrapiramidal, duke hapur rrugë për qasje më të integruara në diagnostikim dhe trajtim.

Fjalë kyçe: neurobiologji, stres, bruksizëm, neurotransmetues dopaminergjikë, boshti HPA.

INTELIGJENCA ARTIFICIALE NË STOMATOLOGJI: ZBULIMI I HERSHËM DHE DIAGNOSTIKIMI MULTIMODAL.

Diella Uka
Eral Dent, Fushë Kosovë

Abstrakt
Inteligjenca artificiale (IA) me shpejtësi po bëhet pjesë e pandashme e praktikës dentare, me rreth një të tretën e dentistëve në mbarë botën që tashmë e përdorin atë, dhe shumica raportojnë përmirësime të dukshme në rezultatet klinike. Roli më i konsoliduar i saj është në zbulimin e hershëm të sëmundjeve orale, një fushë ku edhe klinicistët më me përvojë përballen me kufizime të ndjeshme diagnostike. Në zbulimin e kariesit, studimet tregojnë se dentistët, kur përdorin inteligjencën artificiale, identifikojnë deri në 40 - 43% më shumë lezione sesa gjatë interpretimit të radiografive pa asistencë. Sistemet e të mësuarit të thellë (deep learning), të trajnuara me imazhe intraorale, kanë arritur një saktësi diagnostikuese mbi 90%, duke mundësuar identifikimin më të hershëm të kariesit që shpesh mbetet i pazbuluar gjatë ekzaminimeve rutinë. Në sëmundjet periodontale, IA mund të matë automatikisht nivelet e kockës alveolare me saktësi rreth 0. 3 mm, duke ofruar shpejtësi dhe konsistencë që rrallë arrihen manualisht. Ndërkohë, në kancerin oral, modelet e rrezikut klinik të bazuara në IA kanë arritur rreth 94% saktësi në parashikimin e transformimeve malinje, duke ndihmuar dentistët të identifikojnë në kohë pacientët që kërkojnë ndërhyrje urgjente. Përveç diagnostikimit të patologjive individuale, IA po përparon drejt diagnostikimit multimodal, duke integruar të dhëna nga radiografitë, CBCT, skanimet intraorale, fotografitë dhe biomarkerët e pështymës, për të ndërtuar një panoramë më të plotë të shëndetit oral. Kjo qasje lejon zbulim më të hershëm, parashikim më të saktë të rrezikut dhe planifikim më të personalizuar të trajtimit. Ky punim shqyrton provat shkencore ndërkombëtare, evidenton mundësitë dhe sfidat e zbatimit të IA në stomatologji, dhe thekson se IA duhet të shihet si një mjet mbështetës - një "mendim i dytë" që fuqizon ekspertizën e dentistit - ndërsa gjykimi klinik, etik dhe profesional mbeten thelbësisht njerëzore.

Fjalë kyçe: inteligjenca artificiale, stomatologji, diagnostikim, sëmundje orale.

PACIENTËT GERIATRIK, TRAJTIMI DHE KUJDESI NDAJ TYRE.

Dionika Jahiri

Abstrakt
Ky studim ofron një analizë të thellë mbi konceptin e geriatrisë dhe plakjes së shëndetshme, duke evidencuar rolin e saj kryesor në sigurimin e cilësisë së lartë të jetës së të moshuarve në kontekstin global. Trajton aspekte multidisiplinare të kujdesit ndaj plakjes, duke përfshirë dimensionet fiziologjike, psikologjike dhe sociale, me fokus të veçantë në shëndetin oral si pasqyrë e shëndetit sistemik. Theksi vihet në rëndësinë e ruajtjes së funksionalitetit, parandalimit të sëmundjeve kronike dhe përmirësimit të qasjes së kujdesit shëndetësor të integruar për pacientët geriatric. Përmes një analize të shkaqeve, sfidave dhe avancimeve teknologjike, punimi demonstron evolucionin e praktikës stomatologjike geriatrike, duke theksuar rolin strategjik të protokolleve të specializuara, bashkëpunimit multidisiplinar dhe përpjekjeve për edukimin dhe ndërgjegjësimin publik. Përmirësimi i shërbimeve dhe politikat publike, së bashku me përdorimin e teknologjisë së avancuar, janë thelbësore për arritjen e plakjes së shëndetshme në moshën e tretë, duke synuar parandalimin e komplikacioneve shëndetësore dhe shtimin e mirëqenies së përgjithshme të popullatës së plakur.

Fjalë kyçe: Geriatria, plakja e shëndetshme, kujdes multidisiplinar, shëndeti oral, pacientët e moshuar, parandalimi i sëmundjeve kronike.

EKSELENCA NË ORTODONCI ME RASTE IMPAKSIONI - MIT APO REALITET?

Dr. Diturije Bytyqi, Dr. Agron Bytyqi
Poliklinika orofaciale"Ada - dent"

Abstrakt

Hyrje: Dhëmbët e impaktuar përbëjnë një nga sfidat më të mëdha klinike në fushën e ortodonciës dhe kirurgjisë orale, për shkak të kompleksitetit anatomik të nofullave, kufizimeve biologjike dhe hapësinore në proceset alveolare, si dhe variacioneve në pozicionin dhe boshtin e dhëmbëve të impaktuar. Këto anomali kërkojnë një qasje të integruar multidisiplinare, ku bashkëveprojnë ortodonti, kirurgjia orale dhe imazheria dentare. Në epokën digjitale, koncepti i ekselencës në ortodonci po transformohet nga një ideal teorik në një realitet të arritshëm klinik, falë planifikimit të avancuar dixhital dhe përdorimit të teknologjive bashkëkohore.

Qëllimi: Të paraqiten disa raste klinike të dhëmbëve të impaktuar të trajtuara me qasje multidisiplinare dhe të mbështetura në teknologji të avancuar digjitale, si demonstrim i faktit se ekselenca në trajtim është e mundshme përmes planifikimit të kujdesshëm dhe kontrollit biomekanik të forcave ortodontike.

Materiale dhe Metoda: Në studim janë përfshirë tre raste klinike me tipe të ndryshme impaksioni: Impaksion i dhëmbëve 13 dhe 23, Impaksion i dhëmbëve 15 dhe 25, Impaksion i kombinuar i dhëmbëve 13 dhe 15, i shoqëruar me resorbim të rrënjës së dhëmbit 12 si pasojë e presionit nga kurora e dhëmbit 13. Diagnostikimi është bazuar në imazheri digjitale 2D dhe 3D, përfshirë teleradiografinë dhe ekzaminimin klinik të detajuar. Plani i trajtimit ka përfshirë aparat ortodontik fiks, me aplikim të forcave të lehta dhe të kontrolluara drejtimisht, me qëllim minimizimin e resorbimit të rrënjëve dhe ruajtjen e integritetit periodontik.

Rezultate: Të tre rastet klinike përfunduan me erupsion të suksesshëm të dhëmbëve të impaktuar, stabilitet okluzal të mirë, dhe rezultate estetike optimale. Gjatë periudhës së ndjekjes nuk u evidentua resorbim i rëndësishëm radikular dhe as humbje e mbështetjes periodontale. Integrimi i imazherisë digjitale me kontroll biomekanik ka rezultuar efektiv në drejtimin e dhëmbëve të impaktuar dhe në ruajtjen e shëndetit të indeve përreth.

Përfundimi: Çelësi i suksesit në trajtimin e dhëmbëve të impaktuar qëndron në individualizimin e planit terapeutik, bashkëpunimin multidisiplinar dhe përdorimin racional të teknologjive të avancuara digjitale. Përzgjedhja e aparaturës adekuate dhe aplikimi i forcave të kontrolluara biologjikisht janë thelbësore për rezultate të qëndrueshme funksionale dhe estetike. Në përfundim, ekselenca në trajtimin e dhëmbëve të impaktuar nuk është më një mit, por një realitet klinik, i bazuar në planifikim të saktë, teknologji moderne dhe qasje të koordinuar ndërdisiplinare.

Fjalë kyçe: impaksion dentar, resorbim radikular, imazheri digjitale, ortodonci, ekselencë klinike, planifikim multidisiplinar.

IRRIGIMI NË ENDODONCI: PARIMET, PROTOKOLLET DHE PËPARËSITË.

Donat Reshiti

Abstrakt

Hyrje: Ky punim paraqet një rishikim të literaturës mbi irigimin në trajtimin endodontik, bazuar në burime autoritative si Cohen's Pathways of the Pulp dhe Ingle's Endodontics, dhe në të dhëna shkencore të njohura të publikuara në databaza si PubMed, Google Scholar dhe Medline.

Qëllimi: është të përmbledhë parimet biologjike të irigimit, të analizojë protokollet klinike të përdorura më shpesh, të evidentojë kufizimet e irigantëve ekzistues dhe të diskutojë perspektivat e reja në këtë fushë. Irigimi i kanaleve rrënjësore përfaqëson një komponent thelbësor, pasi vetëm instrumentimi mekanik nuk është i mjaftueshëm për të eliminuar ngarkesën mikrobiale dhe për të pastruar anatomitë komplekse si istmuset, kanalet laterale dhe delta apikale. Hipokloriti i natriumit (NaOCl) dhe EDTA mbeten standardi i artë, duke ofruar përkatësisht tretjen e indeve organike dhe heqjen e smear layer - it. Megjithatë, asnjë irigant nuk i përmbush të gjitha vetitë ideale dhe përdorimi i tyre paraqet kufizime si citotoksiciteti, inkompatibiliteti kimik dhe depërtimi i kufizuar në zonën apikale. Aktivizimi i irrigantëve përmes metodave ultrasonike, sonike, presionit negativ ose ngrohjes së NaOCl përmirëson ndjeshëm efikasitetin klinik. Aspektet e sigurisë janë thelbësore për të shmangur komplikime si ekstrudimi apik i irigantit. Përparimet e fundit, përfshirë nanopartikujt, dezinfektimin fotoaktiv

dhe irigantët bimore, tregojnë potencial premtues për biokompatibilitet më të lartë dhe rezultate më të qëndrueshme.
Përfundime: Irigimi mbetet një gur themeli i suksesit afatgjatë në endodonci, si pjesë e triadës së pastrimit, formësimit dhe obturimit.

Fjalë kyçe: irrigimi endodontik, hipoklorit natriumi (NaOCl), EDTA, aktivizimi i irrigantëve.

MENAXHIMI I MBETURINAVE BIOMJEKËSORE NË ORDINANCË STOMATOLOGJIKE.
Dr. Driada Ukshini

Abstrakt
Hyrje: Mbeturinat biomjekësore të krijuara në ordinancat stomatologjike përbëjnë një rrezik serioz për shëndetin publik dhe mjedisin, nëse nuk menaxhohen siç duhet. Ato përfshijnë materiale të ndotura me gjak, pështymë, kimikate, metale të rënda si merkur, plumb e argjend, si dhe instrumente të mprehta që mund të shkaktojnë lëndime dhe përhapje infeksionesh si HIV, Hepatit B dhe C. Menaxhimi i duhur i këtyre mbetjeve është thelbësor për ruajtjen e higjienës, sigurisë profesionale dhe mbrojtjes së mjedisit.
Qëllim: Qëllimi i këtij punimi është të analizojë rëndësinë e menaxhimit të duhur të mbeturinave biomjekësore në ordinancat stomatologjike, të identifikojë praktikat ekzistuese dhe sfidat në trajtimin e tyre, si dhe të propozojë masa për përmirësim në përputhje me standardet ndërkombëtare të OBSH - së dhe udhëzimet e institucioneve mjedisore.
Përfundime: Menaxhimi efikas i mbeturinave biomjekësore kërkon ndarjen, etiketimin, transportin dhe trajtimin e tyre sipas kategorive dhe rregulloreve përkatëse. Trajnimi i stafit, përdorimi i mjeteve mbrojtëse personale, aplikimi i metodave të sigurta si autoklavimi dhe incenerimi, si dhe bashkëpunimi me institucionet kompetente janë elemente kyçe për garantimin e një mjedisi të shëndetshëm dhe të sigurt. Zbatimi i këtyre praktikave kontribuon në mbrojtjen e shëndetit publik dhe reduktimin e ndotjes ekologjike.

Fjalë kyçe: Mbetje biomjekësore, menaxhim, ordinancë stomatologjike, autoklavim, sterilizim, mjedis, siguri profesionale, kontroll infeksionesh.

NDRYSHIMET NË HIGJIENËN ORALE DHE GJENDJEN GINGIVALE GJATË TRAJTIMIT ORTODONTIK: NJË RISHIKIM I LITERATURËS.
Drita Ndou
Klinikë Dentare "Prizreni Dental Aesthetic"

Abstrakt
Ky rishikim ka qëllim të analizojë evidencat ekzistuese mbi ndryshimet që ndodhin në higjienën orale dhe gjendjen gingivale tek pacientët gjatë trajtimit ortodontik. U krye një kërkim sistematik në PubMed dhe u shqyrtuan studime të publikuara në vitet e fundit që vlerësonin statusin e higjienës orale dhe shenjat e inflamacionit gingival tek individë që i nënshtrohen trajtimit ortodontik. Shumica e studimeve tregojnë një rritje të akumulimit të pllakës dentare dhe inflamacionit gingival në fazat e hershme të trajtimit ortodontik. Megjithatë, me kalimin e kohës dhe me përmirësimin e rutinës së higjienës orale, shenjat e inflamacionit priren të reduktohen. Faktorët që ndikojnë përfshijnë llojin e pajisjes ortodontike, teknikat e pastrimit të dhëmbëve dhe frekuencën e kontrollit profesional. Vlerësimi oral i pacientëve para, gjatë dhe pas trajtimit është i nevojshëm, si dhe udhëzimet dhe motivimi për higjienën orale Trajtimi ortodontik ndikon në mënyrë të konsiderueshme në higjienën orale dhe shëndetin gingival. Edukimi dhe mbështetja e vazhdueshme e pacientëve në ruajtjen e higjienës orale janë thelbësore për të parandaluar zhvillimin e gingivitit dhe komplikacioneve periodontale gjatë trajtimit.

Fjalë kyçe: higjiena, gingivit, aparatat ortodontik, risk, rishikim, literature.

KRAHASIMI I MASËS DIGJITALE PËRKUNDJET MASËS KONVENCIONALE NË PROTETIKËN FIKSE DHE TË LËVIZSHME.

Prof. Edit Xhajanka, Dr. Endrit Paparisto, Dr. Neada Hysenaj, Dr. Tedi Verçani, Prof. Asoc. Alketa Qafmolla.
Fakulteti Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Abstrakt

Hyrje: Përparimet e mëdha në fushën e protetikës dentare kanë arritur kulmin me futjen e metodave dixhitale në pjesën e përgatitjes laboratorike, si edhe në pjesën e procedurave klinike. Kjo është shoqëruar me prodhimin e shumë skanerave intraoralë me parime pune të ndryshme, të përdorur për marrjen e masës dixhitale dhe transferimin e saj direkt në laborator, në mënyrë digjitale. Këto metoda kanë shkurtuar ndjeshëm kohën e punës dhe paraqesin një sërë përparësish në shumë drejtime.

Qëllimi: është krahasimi ndërmjet masës digjitale me skaner intraoral dhe masës tradicionale në punimet fikse protetike, në protezat parciale të lëvizshme dhe në protezat totale, bazuar në kriteret kryesore që përdoren në praktikën stomatologjike dhe në literaturën shkencore.

Materiali dhe metoda: Janë studiuar 200 burime literature të viteve pas 2010, duke analizuar rezultate të studimeve të ndryshme bashkëkohore mbi precizionin dhe efikasitetin e masës digjitale krahasuar me masën analoge. Literatura e studiuar është ndarë për degët specifike të protetikës; protetikën fikse, protetikën parciale të lëvizshme dhe protetikën totale.

Rezultate: Masa analoge kërkon kohë, materiale dhe pajisje specifike, ndërsa masa digjitale nuk ka nevojë për material fizik apo përgatitje të modelit të gipsit. Në punimet fikse masa tradicionale është ende e vlefshme në raste të veçanta (p. sh. zona të vështira për skanim, kosto e ulët fillestare). Masa digjitale me skaner intraoral ofron saktësi më të lartë, komoditet më të madh, efikasitet kohor, dhe është standard i ri në punimet fikse moderne (kurora, ura, inlay / onlay, faseta). Në protezat parciale të lëvizshme: Masa dixhitale po arrin një nivel precizioni të krahasueshëm me masën tradicionale në pjesët dentare të PPL. Masa tradicionale ende mbetet më e përshtatshme për indet e buta dhe zonat pa dhëmbë. Kombinimi i të dyjave (teknika hibride) ofron balancën më të mirë ndërmjet precizionit dhe efikasitetit klinik. Me zhvillimin e skanerave të rinj me optikë të avancuar dhe softuer të inteligjencës artificiale, pritet që masa digjitale të bëhet standardi i artë edhe për protezat parciale të lëvizshme në të ardhmen e afërt. Në protezat totale: masa tradicionale është ende më e saktë në riprodhimin e kufijve mukozalë. Në literaturë mbështetet ideja se kombinimi i skanimit digjital me masën tradicionale (teknika hibride) ofron precizionin më të lartë dhe kursim kohe laboratorike.

Përfundime: Masa digjitale është mjaft precize në punimet fikse. Masa tradicionale mbetet standardi i artë për protezat totale të lëvizshme, sidomos për zonat pa dhëmbë. Masa digjitale po përparon me shpejtësi, me rezultate shumë premtuese në protezat hibride dhe të mbështetura mbi implante. Zgjidhja më e mirë aktualisht është kombinimi i teknikave, ku saktësia e masës tradicionale plotësohet me efikasitetin e teknologjisë digjitale.

Fjalë kyçe: masa digjitale, punime fikse, kufinj mukozalë, proteza, hibride, skaner intraoral.

NDIKIMI I PROJEKTIT ERASMUS+ BIOSINT NË NDËRKOMBËTARIZIMIN E FAKULTETIT TË MJEKËSISË DENTARE, UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË.

Prof. Edit Xhajanka, Dr. Neada Hysenaj, M. Sc. Marsela Fagu, Sara Vasku, Inva Idrizi, Aurora Mema
Fakulteti Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
Klinika Stomatologjike Universitare

Abstrakt

Hyrje: Ky leksion përqendrohet në ndikimin e projektit Erasmus+ BIOSINT ("Strengthening Capacities and Digital Competences in Biomedical Education through Internationalization at Home") në procesin e ndërkombëtarizimit në Fakultetin e Mjekësisë Dentare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (UMT). Në kuadër të projektit, u realizuan anketa me studentë, staf akademik dhe Dekanin, për të vlerësuar gjendjen fillestare dhe progresin pas zbatimit të strategjisë. Rezultatet treguan rritje të dukshme në treguesin e ndërkombëtarizimit. Ky progres vjen si rezultat i hartimit dhe miratimit të strategjisë për ndërkombëtarizimin, ndërkombëtarizimin e kurrikulës ekzistuese, krijimin e një klase virtuale, implementimin e tre lëndëve të reja të përbashkëta: Terapia Nutricionale Mjekësore, Mjekësia e Personalizuar dhe Menaxhimi Shëndetësor në Krizë, krijimit të sistemit "Buddy", udhëzuesi për stafin dhe studentët ndërkombëtarë, si dhe protokolli për sigurinë. Studentët e Fakultetit të Mjekësisë Dentare shfaqën motivim të lartë për mobilitet ndërkombëtar dhe e vlerësuan njohjen e anglishtes

si faktorë kyç për karrierën profesionale. Stafi akademik shfaqi gatishmëri për të dhënë mësim në gjuhën angleze dhe interes të lartë për trajnime shtesë.
Konkluzione: Rezultatet tregojnë një përmirësim të dukshëm në proçesin e ndërkombëtarizimit në Fakultetin e Mjekësisë Dentare të UMT. Megjithatë, nevojiten hapa të mëtejshëm për të siguruar që këto përfitime të bëhen pjesë e qëndrueshme e jetës akademike dhe mësimdhënies në fakultet.

Fjalë kyçe: Erasmus+ BIOSINT, proces ndërkombëtarizimi, Fakulteti i Mjekësisë Dentare.

ANOMALITË VERTIKALE TË SHOQËRUARA ME FRYMËMARRJEN ORALE.
Dr. Edlira Mulo, Dr. Andri Çabeli, Dr. Egi Mulo, Prof. Xhina Mulo

Abstrakt
Hyrje: Frymëmarrja orale është një gjendje e zakonshme, veçanërisht tek fëmijët dhe shoqërohet me ndryshime të rëndësishme në zhvillimin kraniofacial, anomalitë dentomaksilare dhe shëndetin e përgjithshëm. Pavarësisht kërkimeve të gjera, roli i frymëmarrjes orale në zhvillimin e malokluzionit mbetet i diskutueshëm, me debate nëse është një faktor shkaktar apo një përshtatje dytësore ndaj problemeve ekzistuese kraniofaciale.
Metoda: Përpos paraqitjes së rasteve tona klinike, ky është edhe nje rishikim literature që sintetizon studime të publikuara në 15 vitet e fundit, duke u përqëndruar në ndikimin e frymëmarrjes orale në zhvillimin dentofacial dhe qëndrimin mandibular. Studimet u përfshinë nëse ato përqëndroheshin në efektet e frymëmarrjes orale në morfologjinë kraniofaciale, malokluzionin dhe ndryshimet posturale tek fëmijët dhe adoleshentët e moshës 6 - 18 vjeç.
Rezultate: Rezultatet tregojnë një lidhje të fortë midis frymëmarrjes orale dhe ndryshimeve dentofaciale, siç janë facies adenoide, malokluzioni i Klasës II, kafshimi i kryqëzuar posterior dhe kafshimi i hapur anterior. Shkakton ndryshime në qëndrimin e kokës, veçanërisht rritje të përkuljes përpara të kokës, si një mekanizëm kompensues për të ruajtur kalimin e rrugëve të frymëmarrjes.
Përfundime: Frymëmarrja orale është një faktor rreziku për prognozën e malokluzionit, veçanërisht tek fëmijët në rritje. Ndryshimet dentofaciale tek ata që marrin frymë nga goja përfshijnë facies adenoide, profilin konveks të fytyrës dhe rritjen e lartësisë së poshtme të fytyrës. Frymëmarrja orale gjithashtu çon në ndryshime të rëndësishme në qëndrimin e kokës, shpesh të shoqëruara me ndryshime mandibulare, gjuhësore dhe palatinale.

Fjalë kyçe: frymëmarrje orale, frymëmarrje me gojë, zhvillim kraniofacial, qëndrim postural, malokluzion, ortodonci.

PROBLEMATIKAT E KANINIT MAKSILAR EKTOPIK.
Dr. Egi Mulo, Dr. Edlira Mulo, Dr. Andri Çabeli, Prof. Xhina Mulo

Abstrakt
Hyrje: Dhëmbët ektopikë i referohen dhëmbëve që nuk eruptojnë në pozicionin e tyre normal. Kur këto probleme prekin kaninët maksilarë, kjo mund të çojë në probleme estetike, si dhe probleme shëndetësore dentare. Ekzistojnë një sërë faktorësh që mund të çojnë në pozicion ektopik të kaninëve. Në përgjithësi, problemi kryesor është pozicioni i dhëmbëve të tjerë në gojë. Nëse dhëmbët nuk janë të vendosur mirë ose janë të dëndesuar, kjo mund të shkaktojë që kanini të dalë në një pozicion të ndryshëm. Gjenetika dhe historia familjare mund të rrisin mundësinë e shfaqjes së këtij problemi.
Metodologjia: Paraqitja rasteve tona klinike, para dhe mbas trajtimit ortodontik.
Rezultate dhe Përfundime: Kaninët maksilarë ektopikë mund të shkaktojnë një sërë problemesh shëndetësore dentare. Për shembull, pamja e buzëqeshjes mund të ndikohet negativisht nga kanini i pozicionuar sipër, duke cënuar vetëvlerësimin e pacientit. Përveç kësaj, kaninët maksilarë ektopikë mund të jenë pjesë e një problemi të përgjithshëm me malokluzion, ose pozicionim të keq rreshtuar të dhëmbëve. Kjo mund të kontribuojë në vështirësi në kafshim dhe përtypje, dhimbje gjatë ngrënies së ushqimeve të caktuara dhe kërcitje dhëmbësh (bruksizëm). Duke i drejtuar dhëmbët dhe duke përmirësuar pozicionimin e përgjithshëm të dhëmbëve, këto probleme estetike dhe shëndetësore mund të shmangen.

Fjalë kyçe: kaninët maksilarë ektopikë, malokluzion, ortodonci.

RUAJTJA E SHËNDETIT MENDOR TE STMATOLOGËT. STRATEGJI PËR PARANDALIM.
Dr. Shk. Mj. Eglantina Bejko, Dr. Edlira Mulo, Dea Bejko

Abstrakt
Stomatologjia eshtë ndër profesionet më të ekspozuara ndaj stresit kronik, perfeksionizmit dhe lodhjes emocionale, qe shpesh çojnë në depresion dhe sëmundje te tjera mentale për shkak të ngarkesës mendore. Shume stomatologë nuk jane te vetedijshem per kete risk, ndersa mungesa e strukturave mbeshtetese e perkeqeson situaten. Ky artikull synon te analizojë faktorët që kërcënojnë shëndetin mendor te stomatologëve dhe te propozoje strategji konkrete per parandalimin dhe ruajtjen e mireqenies psikike. Permes shqyrtimit te literatures nderkombetare dhe qasjeve bashkekohore si mindfulness, inteligjenca emocionale dhe vetekujdesi profesional, theksohet rëndësia e integrimit te mirëqenies mendore në edukimin dhe praktiken dentare. Ruajtja e shëndetit mendor te stomatologut nuk eshte vetëm nevojë personale, por edhe garanci për cilësine e kujdesit ndaj pacientit.

Fjalë kyçe: stomatolog, shëndet mendor, stres profesional, parandalim, miréqenie emocionale, burnout, vetekujdes, strategji psikologjike.

ZONA E VIBRIMIT DHE ROLI I SAJ NË STABILITETIN E PROTEZËS TOTALE TË SIPËRME. REGJISTRIMI FUNKSIONAL I SAJ.
Eglantina Bejko, Dea Bejko
Fakulteti i Mjekësisë Dentare.

Abstrakt
Hyrje: Zona e vibrimit ose zona e postdamit është zona që ndodhet në pjesën e pasme të qiellzës së fortë, ku ndërthuret në mënyrë graduale mukoza e qiellzës së fortë me mukozën e qiellzës së butë. Ajo përcakton kufirin posterior funksional të bazës së protezës dhe është thelbësore për krijimin e vakumit dhe mbajtjen e protezës në gojë. Si zonë që gjendet në kufirin ndërmjet qiellzës së fortë dhe të butë, pra aty ku ndodh ndryshimi i lëvizshmërisë së mukozës gjatë funksionit (gëlltitje, të folur, frymëmarrje), quhet "zona e tranzicionit muskulomukozal". Ekzistojnë dy linja të vibrimit që kufizojnë këtë zonë, gjerësia e së cilës është e ndryshme në persona të ndryshëm. Kjo zonë duhet të përfshihet nga kufiri i protezës dhe në të duhet të ushtrohet një shtypje e lehtë nga proteza për të siguruar efektin vakuum dhe qëndrueshmërinë e protezës.
Qëllimi: paraqitja e një metode për përcaktimin funksional të zonës së vibrimit dhe regjistrimin funksional të saj.
Materiale dhe metoda: në pacientët totalisht pa dhëmbë në maksilë, me zonë vibrimi të gjerë, kryesisht me gradë të tretë atrofie është përdorur një metodë e thjeshtë për të përcaktuar individualisht kufirin posterior të protezës së sipërme dhe për të regjistruar në mënyrë funksionale reziliencën e mukozës në këtë zonë. Në këtë mënyrë në kemi përcaktuar në mënyrë precize gjatësinë e kufirit posterior të protezës si dhe sa do të jetë ngjeshja në mukozë që do të ushtrojë pllaka e protezës në këtë zonë me rëndësi të lartë në protezim. Për këtë teknikë janë përdorur materiale të ndryshme si oksid zink eugenoli, silikone të adicionit light, dyllë, etj. Fillimisht merret masa funksionale me metodën e zakonshme. Më pas në pacientë shënohen në gojë me laps kopjativ, në mënyrë funksionale, dy linjat e vibrimit. Masa rivendoset në gojë duke e presuar lehtë; shenjat nga goja transferohen në masë. Në masë, në zonën ndërmjet dy vijave vendoset material i butë dhe masa rivendoset në gojë, duke i thënë pacientit të shqiptojë "Ah" të lehtë dhe të zgjatur. Materiali i ri regjistron në mënyrë funksionale sesa do të jetë shtypja që do të ushtrojë në zonën e postdamit kufiri posterior i protezës.
Rezultate: Me aplikimin e kësaj metode është konstatuar rritje e stabilitetit të protezës, mbyllje hermetike (seal) në pjesën posteriore të protezës, duke parandaluar hyrjen e ajrit, rritjen e efektit vakuum, duke rritur qëndrueshmërinë e protezës gjatë funksionit. Po kështu, është vënë re reduktim i lëvizjes së protezës kur forcat veprojnë në drejtim vertikal ose horizontal, si dhe kompensim i tkurrjes dhe deformimit të rezinës që ndodh në metodën tradicionale të polimerizimit.

Konkluzione: metoda e individualizimit dhe regjistrimit funksional të postdamit është një metodë e thjeshtë, ekonomike dhe efikase, që përdoret me sukses sidomos në situata klinike ku qëndrueshmëria e protezës së sipërme është e diskutueshme. Rezultatet pozitive më të shprehura janë në pacientë me zonë vibrimi të gjerë.

Fjalë kyçe: qiellzë, oksid zink eugenoli, dyllë, rezina, zona e vibrimit.

TRAJTIMI ORTODONTIK INTERCEPTIV DHE SHËNDETI PERIODONTAL TE FËMIJËT: RËNDËSIA E INDEKSIT BPE NË MONITORIMIN PERIODONTAL.

Ekrem Çitaku[1], Emire Çitaku [2*], Minovska A. 1, Renxhova V. [2], Apostolska S. [2]
[1]Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti "Goce Delcev", Shtip, Maqedoni e Veriut
[2]Fakulteti i Stomatologjisë, Universiteti "Ss. Cyril and Methodius", Shkup, Maqedoni e Veriut

Abstrakt
Hyrje: Qëllimi i këtij studimi ishte të vlerësojë ndryshimet në shëndetin periodontal te fëmijët, gjatë periudhës një vjeçare të trajtimit ortodontik interceptiv, duke përdorur indeksin Bazik të Ekzaminimit Periodontal (BPE). Përveç vlerësimeve klinike periodike, fëmijët dhe prindërit e tyre morën këshilla për higjenën orale. Në fillim u regjistrua një rritje e lehtë e vlerave BPE, që pasqyron sfidat e hershme të vendosjes së aparatit ortodontik. Më vonë, shumica e pjesëmarrësve treguan përmirësim të vazhdueshëm të shëndetit periodontal, sidomos ata që ndoqën udhëzimet për higjienën orale dhe kishin mbështetjen e prindërve. Rezultatet konfirmojnë se kombinimi i monitorimit të rregullt periodontal me këshillat për higjienën orale janë vendimtaer për të ruajtur shëndetin periodontal gjatë dhe pas trajtimit ortodontik te fëmijët.

Fjalë kyçe: terapi ortodontike interceptive, shëndet periodontal, ekzaminim periodontal bazik (BPE), këshilla për higjienën orale, fëmijët.

LIDHJA MIDIS USHQYERJES ME GJI, VESEVE TË FITUARA DHE MALOKLUZIONEVE, NJË RISHIKIM I LITERATURËS.

Doc. Elona Hasalla, Prof. Dr. Vergjini Muli, Phd. Ilda Taka, Msc. Brandi Fahriu, Msc. Elda Ruci, Msc. Irena Xhaferri, Msc. Blerta Hasalla, Dr. Sulejman Baha
Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani",
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Departamenti i Lëndëve Paraklinike,
Falukteti i Mjekësisë Dentare, Tiranë, Departamenti i Specialiteteve Mjekësore Teknike
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Tiranë, Universiteti i Firencës, Itali.

Abstrakt
Hyrje: Malokluzioni është një gjendje patologjike në të cilën dhëmbët e sipërm nuk artikulojnë në raportet e duhura me dhëmbët e poshtëm. Prania e kësaj patologjie ndikon shumë në funksionin e aparatit stomatognatik. Ai manifestohet me probleme neuromuskulare dhe orofaciale qe shprehen ne indet e buta dhe te forta të aparatit stomatognaitk. Kjo patologji mund te shfaqet qe në fëmijërinë e hershme si pasoje e ushqyerjes jo adekuate me gji ose veseve te tjera te fituara në këtë periudhë të jetës.
Objektiva: Qëllimi i studimit tonë është të përcaktojë lidhjen midis ushqyerjes jo adekuate me gji, veseve orale dhe malokluzioneve; të identifikojë problemet në gëlltitje, përtytje, artikulimin e fjalëve dhe frymëmarje që vijnë si pasojë e malokluzioneve; të edukojë nënat e reja mbi rëndësine e ushqyerjes adekuate me gji dhe elemimin sa më herët të veseve orale; të rrisë njohuritë e stomatologëve mbi rëndësinë e identifikimit të hershëm të këtyre problemve
Materiale dhe metoda e studimit: Studimi jonë është një rishikim literature (riview sistematike) e artikujve të publikuar në revista shkencore (pub med, google scholar, research gate, etj).
Ne morëm në studim rreth 100 artikuj të cilët studionin lidhjen midis ushqyrjes me gji, veseve orale dhe shfaqjes së malokluzionit. U morën në konsideratë vetëm ata artikuj që kishin metodologji të saktë dhe që kishin evidencë shkencore. U hoqën nga studimi artikuj që nuk paraqisnin metodologji të saktë dhe ato që paraqisnin vetëm opinione të ekspertëve. Artikujt ishin të gjithë në gjuhën angleze.

Rezultate: Në 50 % të rasteve u vu re një korelacion pozitiv midis mosushqyerjes me gji, veseve orale dhe shfaqjes së malokluzioneve. U vu re se femijët që janë ushqyer me qumësht gjiri 6 muaj ose më shumë kanë incidencë më të ulët të malokluzionit se fëmijët e tjerë. Përdorimi i biberonit dhe prania e veseve orale ndiokojnë në shfaqjen e malokluzioneve. Momenti dhe nevoja për të ndërhyrë është në varësi të moshës së fëmijës dhe zhvillimit të aparatit stomatognatik. Duke qënë se dhëmbët e fëmijës janë në zhvillim të vazhdueshëm, vizitat tek stomatologu duhet të behën në intervale të rregullta.
Konkluzione: Përdorimi i zgjatur i biberonit është shkaku më i zakonshëm i shfaqjes së malokluzioneve. Diagnostikimi sa më i hershëm i malokluzioneve në vendet në zhvillim dhe nje trajtim i thjeshtë ortodontik mund të minimizojë ose eleminojë trajtimet e kushtueshme në të ardhmen. Rëndësi të madhe ka edukimi i nënave për rëndësinë e ushqyerjes me gji dhe elemimin sa më të hershëm të veseve orale. Të gjithe stomatologët e përgjithshëm duhet të kënë njohuritë e nevojshme për diagnostikimin sa më të hershëm të këtyre problemeve. Rëndësi do të kishte depistimi në nivel kombëtar i malokluzioneve dhe ndërjyrja sa me e hershme e mundshme për përmirësimin e shëndetit të popullatës.

Fjalë kyçe: ushqyerje me gji, vese orale, malokluzion, nderhyrje ortodontike, diagnostikim.

GINGIVITI JUVENIL: PREZANTIM RASTI.

Elona Zahaj, Desara Zazaj, Eneida Prifti
Klinika Stomatologjike Universitare

Abstrakt
Hyrje: Gingiviti Juvenil është një gjendje inflamatore e gingivave, e lidhur kryesisht me praninë e pllakës bakteriale dhe me faktorë predispozues tek fëmijët dhe adoleshentët. Me shpesh ndodh gjatë pubertetit si pasojë e ndryshimeve hormonale. Ky punim paraqet një rast klinik të një pacienteje 15 - vjeçare, e cila u paraqit në Klinikën Universitare Stomatologjike me ankesa për dhimbje dhe gjakrrjedhje gjatë larjes së dhëmbëve. Ekzaminimi klinik evidentoi gingivë edematoze dhe eritematoze, me depozita të dukshme pllake dhe kalkuli. Pacientja kishte diagnozë të mëparshme me epilepsi. Pas pastrimit profesional të pllakës dhe gurëzave dentare, u aplikua lokalisht klorheksidinë 0. 2% dy herë në ditë për një javë. Në kontrollet pasuese (1 muaj dhe 1 vit më vonë), gjendja e gingivës rezultoi e përmirësuar ndjeshëm, pa shenja të inflamacioneve. Diskutimi evidenton se faktorët kryesorë që kontribuojnë në shfaqjen e gingivitit juvenil janë: higjiena orale e pamjaftueshme, ndryshimet hormonale gjatë pubertetit, pllaka bakteriale, përdorimi i medikamenteve dhe disa probleme shëndetësore, si dhe prania e aparateve ortodontike.
Përfundime: Rasti thekson rëndësinë e higjenës orale të rregullt, vizitave periodike tek dentisti dhe edukimit të pacientëve mbi mënyrat e duhura të kujdesit oral, si masa kryesore parandaluese ndaj gingivitit juvenil.

Fjalë kyçe: Gingiviti Juvenil, inflamacion, gingivat.

ROLI I STOMATOLOGUT – SFIDAT POST COVID SIPAS ADA DHE APA.

Elvane Krasniqi

Abstrakt
Hyrje: Pandemia e COVID - 19 ekspozoi sfida të mëdha në sektorin e kujdesit oral, duke prekur drejtpërdrejt praktikat stomatologjike në nivel global. Rritja e riskut të transmetimit të infeksionit në mjediset dentare, mungesa e burimeve njerëzore dhe ndikimet psikologjike si tek profesionistët, ashtu edhe tek pacientët, kanë nxjerrë nevojën për një analizë të thelluar të rolit të stomatologut në periudha post - pandemike dhe në përgatitje për emergjenca të ardhshme shëndetësore.
Qëllimi: Qëllimi i studimit është të shqyrtojë mënyrën se si stomatologët kanë adaptuar praktikën e tyre klinike në periudhën post - COVID, si dhe të identifikojë strategjitë që mund të përdoren për të rritur reziliencën e sistemit stomatologjik ndaj pandemive të ardhshme, duke u bazuar në rekomandimet dhe të dhënat e Shoqatës Amerikane të Stomatologjisë (ADA) dhe burimeve të tjera relevante.
Metodologjia: Metodologjia e përdorur është e natyrës cilësore, me një qasje përmbledhëse dhe analitike ndaj literaturës ekzistuese. Janë shqyrtuar raportet dhe publikimet e ADA - s dhe APA - s (American Psychological

Association), si dhe të dhënat empirike të botuara gjatë dhe pas pandemisë, me qëllim analizimin e ndikimit të COVID - 19 në shëndetin oral publik, sistemet klinike dhe mirëqenien e stafit dentar. Rezultatet tregojnë se, përveç sfidave logjistike dhe të sigurisë, një ndër aspektet më të rëndësishme ka qenë ndikimi psikologjik dhe social i pandemisë, si dhe nevoja për një qasje më gjithëpërfshirëse në edukimin, mbështetjen dhe organizimin e praktikës dentare. Në të njëjtën kohë, pandemia ka nxitur zhvillimin e teknologjive të reja si tele - stomatologjia dhe përmirësimin e protokolleve të kontrollit të infeksionit. Ky studim kontribuon në literaturën shkencore duke ofruar një pasqyrë të integruar mbi transformimin e profesionit të stomatologut në kushtet e pandemive, dhe rekomandon qasje konkrete për përmirësimin e infrastrukturës, trajnimit dhe mbrojtjes së personelit në të ardhmen.

Fjalë kyçe: Stomatologu, sfidat, Covid 19, ADA, APA.

RESORBIMI RRËNJËSOR I DHËMBËVE SI KOMPLIKACION I TRAJTIMIT ORTODONTIK: SHKAQET, PARANDALIMI DHE MENAXHIMI.

Elvira Ramovic, Ilvia Tabaku Alimehmeti
Klinikë Dentare Private "Elit Dent Ulqin"

Abstrakt
Resorbimi rrënjësor i dhëmbëve përbën një komplikacion që ndodh gjatë trajtimit ortodontik. Ai manifestohet me humbjen progresive të indeve të forta të rrënjës si pasojë e përgjigjes biologjike ndaj forcave mekanike të aplikuara për lëvizjen dentare. Ky rishikim literature synon të përmbledhë evidencën aktuale mbi shkaqet, mekanizmat patofiziologjikë, strategjitë parandaluese dhe menaxhimin klinik të resorbimit rrënjësor të shkaktuar nga trajtimi ortodontik. U krye një kërkim online në PubMed, Scopus dhe Google Scholar për studimet e publikuara gjatë dhjetë viteve të fundit që analizojnë faktorët etiologjikë dhe qasjet parandaluese ndaj resorbimit rrënjësor të dhëmbëve. Evidenca sugjeron se resorbimi rrënjësor është një fenomen multifaktorial, i ndikuar nga faktorë individual dhe faktorë të lidhur me trajtimin. Monitorimi periodik dhe përdorimi i forcave të moderuara janë ndër strategjitë më efektive për reduktimin e rrezikut. Resorbimi rrënjësor mbetet një sfidë klinike e rëndësishme për ortodontët. Studime të mëtejshme janë të nevojshme për të standardizuar metodat e diagnostikimit dhe për të përcaktuar udhëzime të qarta klinike në parandalimin e resorbimit rrënjësor gjatë trajtimit ortodontik.

Fjalë kyçe: Resorbimi, trajtim ortodontik, menaxhim, monitorim, rrënjë.

REDUKTIMI I MIKRORRJEDHJES APIKALE DHE KORONARE: RËNDËSIA E PROTOKOLEVE TË AKTIVIZUARA TË IRRIGIMIT.

Emire Çitaku [1], Ekrem Çitaku [2], Rendzova V. [1], Apostolska S. [1], Minovska A. [2]
[1] Fakulteti i stomatologjisë, Ss. Cyril and Methodius University, Shkupe, Maqedonia e Veriut
[2]Fakulteti i Shkencave Mjekesore, Goce Delcev University, Štip, Maqedonia e Veriut.

Abstrakt
Hyrje: Qëllimi i këtij studimi in vitro ishte të vlerësonte ndikimin e protokolleve të ndryshme të irrigimit të kanaleve të rrënjës në mikrorrjedhjen apikale dhe koronare. Kanaleve të rrënjës iu aplikuan irrigantë të ndryshëm, me ose pa aktivizim me ultrazë dhe më pas u obturuan duke përdorur teknikën e kondensimit vertikal të gutaperkës së ngrohtë. Mikrorrjedhja apikale dhe koronare u vlerësua me metodën e penetrimit të ngjyrës metilen blu nën mikroskop me dritë. Analiza statistikore ($p < 0.05$) konfirmoi dallime domethënëse mes grupeve. Kombinimi i NaOCl dhe EDTA me aktivizim me ultrazë tregoi nivelin më të ulët të mikrorrjedhjes, ndërsa grupi kontroll i trajtuar vetëm me tretje fiziologjike tregoi vlerat më të larta. Këto gjetje nënvizojnë rëndësinë e përzgjedhjes së një protokolli efektiv të irrigimit, me aktivizim me ultra zë, për të arritur pastrim superior të kanaleve, për të minimizuar mikrorrjedhjen apikale ashtu edhe atë koronare dhe për të siguruar sukses afatgjatë të trajtimit endodontik.

Fjalë kyçe: protokollet e irrigimit, aktivizim me ultra zë, mikrorrjedhje apikale, mikrorrjedhje koronare, kondensim vertikal, penetrimi i ngjyrës metilen blu.

APLIKIMI I PIEZOKIRURGJISË NË KIRURGJINË ORTOGNATIKE: NJË RISHIKIM I LITERATURËS.

Endri Murzaku[1], Renato Isufi[2], Belisa Kaleci[2]
[1]Departamenti i Kirurgjisë Orale dhe Maksilofaciale, Fakulteti i Mjekësisë Dentare
[2]Klinika Stomatologjike Universitare, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Piezokirurgjia është një paisje që përdoret në kirurgjinë orale e cila u shpik nga kirurgu italian Dr. Tomaso Vercellotti në vitin 1988. Ajo është përdorur me sukses në osteotominë Le Fort I, BSSO, osteotominë bimaxilare dhe zgjerimin e shpejtë të maxilës së asistuar me kirurgji (SARME).
Qëllimi i Studimit: Qëllimi i këtij rishikimi të literaturës është të evidentojë avantazhet e përdorimit të piezokirurgjisë krahasuar me osteotominë tradicionale në kirurgjinë ortognatike.
Materiali dhe Metoda: Për përgatitjen e këtij studimi u krye një kërkim i plotë i literaturës në PubMed dhe Google Scholar duke përdorur fjalë kyçe si "kirurgjia ortognatike" dhe "piezokirurgjia" për të identifikuar studime klinike, random clinical trials (RCT), review, systematic review dhe meta - analiza.
Rezultate: Nga 12 studimet e përzgjedhura për këtë rishikim, pesë ishin random clinical trials (RCT), gjashtë ishin non - random clinical trials (nRCT) dhe një ishte systematic review. Piezokirurgjia ofron reduktim të humbjes së gjakut gjatë operacionit dhe një fushë kirurgjikale pa gjak që përmirëson shikueshmërinë. Linjat e osteotomisë ishin më të sakta me piezokirurgjinë dhe u vunë re prerje të pastra krahasuar me skajet e çrregullta dhe jo uniforme të osteotomisë me frezë. Gjithashtu zvogëlohet rreziku i dëmtimit të nervave ose enëve të gjakut, megjithatë koha kirurgjikale zgjatet me piezokirurgjinë.
Konkluzione: Piezokirurgjia është një paisje e sigurt dhe efektive që ofron shumë avantazhe në kirurgjinë ortognatike. Megjithatë, duhen kryer studime të mëtejshme me një kampion më të madh për të krahasuar piezokirurgjinë me osteotominë tradicionale në lidhje me kohën e operimit, si dhe komplikacionet gjatë dhe pas operacionit në kirurgjinë ortognatike.

Fjalë kyçe: kirurgjia ortognatike, piezokirurgjia, osteotomia tradicionale.

PIEZOGRAFIA NË PROTEZAT TOTALE TË LËVIZSHME: NJË RISHIKIM I LITERATURËS.

Dr. Endrit Paparisto, Enriko Leka, Prof. Dr. Edit. Xhajanka, Dr. Neada Hysenaj, Dr. Tedi Verçani, Dr. Blerta Lila, Dr. Shk. Belisa Kaleci
Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
Klinika Stomatologjike Universitare, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Piezografia përfaqëson një masë funksionale që regjistron zonën neutrale përmes lëvizjeve dinamike të muskulaturës orale, si dhe sipërfaqen e jashtme të protezës. Ajo synon të përmirësojë stabilitetin, retensionin dhe komoditetin e protezës duke arritur ekuilibrin midis forcave muskulare. Gjatë viteve, disa studime kanë vlerësuar rëndësinë klinike e kësaj teknike.
Qëllimi: Ky rishikim përmbledh evidencat aktuale shkencore mbi përdorimin klinik, ndryshimet metodologjike dhe përparësitë e piezografisë në përgatitjen e protezave totale.
Materiale dhe metoda: U krye një kërkim elektronik në bazat e të dhënave PubMed, Scopus dhe Google Scholar për artikujt e publikuar midis viteve 2000–2025, duke përdorur fjalët kyçe: *piezography*, *neutral zone*, third impression, prostheses, removable *complete denture*.
Rezultate: Literatura tregon se piezografia përmirëson stabilitetin e protezës, veçanërisht tek pacientët me proçese alveolare të rezorbuara ose me kontroll neuromuskular të reduktuar. Krahasuar me metodat tradicionale, ajo ofron përshtatje më të individualizuar të sipërfaqes së jashtme të protezës dhe pozicionimit të dhëmbëve artificial brenda zonës neutrale.

Përfundime: Piezografia mbetet një teknikë me vlerë në protetikën moderne. Kërkimet e ardhshme duhet të fokusohen në vlerësimin e kënaqësisë së pacientit, zhvillimin e protokolleve për zbatim më të gjerë klinik dhe integrimin e teknologjive dixhitale (CAD / CAM) në proçesin piezografik.

Fjalë kyçe: Piezografi, zonë neutrale, protezë totale e lëvizshme.

KIRURGJIA E GUIDUAR IMPLANTARE: STATIKE VS DINAMIKE (RISHIKIM LITERATURE).

MSc. Phd Enea Haxhiraj, MSc. DDS Ira Bollo

Abstrakt

Hyrje: Qëllimi i këtij studimi ishte të bëjë një vlerësim mbi saktësinë e planifikimit virtual të kirurgjisë së drejtuar nga kompjuteri bazuar në rezultatet aktuale të vendosjes klinike të implanteve dentare.

Materiale dhe metoda: Ky studim analizon publikime të ndryshme në Pubmed mbi kirurgjinë e guiduar implantare, atë statike dhe dinamike, si dhe krahasime mbi kritere të ndryshme ndërmjet këtyre dy teknikave kryesore. Analiza perfshin disa të dhëna si: avantazhet klinike, saktësinë, efikasitetin, faktorë të ndryshëm si mosha, gjinia apo numri i elementëve dentare, raportet kosto - benefite ndërmjet dy teknikave, si edhe komfortin e pacientit.

Rezultate: Përsa i përket gjinisë, nuk vihet re diferencë për shkallën e suksesit, por ajo që mund të vërehet është diferenca ndërmjet rasteve të edentulisë totale me atë parciale. Kirurgjia e guiduar flap - less është më e saktë se ajo me flap në rastin e guidave mbështetur në dhëmbë. Megjithatë, cilësia e dobët dhe mungesa e kockës mund të kufizojnë aplikimet e kirurgjisë së guiduar. Në këto raste, ajo dinamike është më e avantazhuara. Kirurgjia e guiduar, sidomos ajo dinamike është "e ardhmja" e kirurgjisë implantare, duke sjell më shumë komfort për pacientin, saktësi më të madhe nga planifikimi në aplikim.

Fjalë kyçe: implante, statike, edentuli, kocka, efikasitet.

MENAXHIMI I URGJENCAVE DENTARE NË PRAKTIKËN KLINIKE.

Dr. Eneida Prifti, Dr. Eni Jani, Dr. Elona Zahaj, Dr. Desara Zazaj
Klinika Stomatologjike Universitare, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Urgjencat dentare përfaqësojnë situata klinike që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme për të lehtësuar dhimbjen, për të parandaluar përhapjen e infeksionit dhe për të ruajtur funksionin oral.

Qëllimi: Qëllimi i këtij abstrakti është të paraqesë parimet kryesore që udhëheqin menaxhimin efektiv të urgjencave dentare në praktikën klinike, në përputhje me udhëzimet ndërkombëtare.

Materiale dhe metoda: U krye një përmbledhje narrative e literaturës ndërkombëtare (2010–2025), duke përfshirë udhëzimet e FDI (Federata Dentare Ndërkombëtare), ADA (American Dental Association) dhe EAPD (European Academy of Paediatric Dentistry). U analizuan protokollet klinike të menaxhimit të dhimbjes akute, infeksioneve orale dhe traumave dentare.

Rezultate: U identifikuan gjashtë parime bazë për trajtimin urgjent dentar: (1) vlerësimi i menjëhershëm i pacientit dhe gjendjes sistemike, (2) lehtësimi i simptomave akute, (3) kontrolli i infeksionit, (4) trajtimi specifik sipas llojit të urgjencës, (5) stabilizimi dhe ndjekja pas trajtimit, dhe (6) respektimi i masave të sigurisë dhe dokumentimit. Zbatimi i tyre redukton komplikacionet dhe përmirëson prognozën klinike.

Përfundime: Menaxhimi i strukturuar dhe në kohë i urgjencave dentare është thelbësor për sigurinë e pacientit dhe suksesin klinik. Zbatimi i protokolleve të standardizuara rrit efikasitetin e trajtimit, zvogëlon komplikacionet dhe mbështet vendimmarrjen klinike të bazuar në prova shkencore.

Fjalë kyçe: Urgjencë dentare, trajtim, menaxhim klinik, infeksion oral, FDI, praktikë stomatologjike.

NDËRLIDHJA MIDIS SËMUNDJES PERIODONTALE DHE DIABETIT.

MSc Eni Jani[1], Msc Eneida Prifti[1], PhD Belisa Kaleci[1], MSc Desara Zazaj[1], Spa Andi Xhaferri[2]
[1]*Klinika Stomatologjike Universitare*
[2]*Spitali Universitar i Traumës*

Abstrakt

Hyrje: Sëmundja periodontale dhe diabeti janë dy patologji kronike me ndikim të ndjeshëm në shëndetin publik. Studimet kanë treguar se ekziston një lidhje e fortë dypalëshe midis tyre: diabeti rrit rrezikun dhe ashpërsinë e sëmundjes periodontale, ndërsa inflamacioni i shkaktuar nga periodontiti ndikon negativisht në kontrollin e glicemisë, duke përkeqësuar diabetin. Megjithëse kjo ndërlidhje është mirëdokumentuar, ndërgjegjësimi mbi rëndësinë e kujdesit oral në menaxhimin e diabetit mbetet i ulët, si te pacientët ashtu edhe te profesionistët e shëndetësisë.

Objektiva: Ky prezantim synon të: sqarojë mekanizmat biologjikë që lidhin sëmundjen periodontale me diabetin; analizojë ndikimin e inflamacionit kronik në kontrollin e glicemisë; diskutojë praktikat më të mira për parandalimin dhe trajtimin e periodontitit te pacientët diabetikë; theksojë rëndësinë e një qasjeje të integruar midis dentistëve dhe mjekëve për një menaxhim më efektiv të këtyre sëmundjeve.

Metodologjia: Ky prezantim bazohet në një rishikim të literaturës më të fundit mbi lidhjen midis diabetit dhe sëmundjes periodontale, duke përfshirë studime klinike, meta - analiza dhe udhëzime nga organizatat shëndetësore ndërkombëtare. Do të analizohen mekanizmat kryesorë patologjikë dhe do të paraqiten raste klinike për të ilustruar ndikimin e trajtimit periodontal në përmirësimin e kontrollit të diabetit.

Rezultate: Ndikimi i diabetit në shëndetin periodontal: Hiperglicemia rrit nivelet e inflamacionit dhe dëmton mekanizmat e mbrojtjes imune, duke përshpejtuar përparimin e sëmundjes periodontale. Ndikimi i sëmundjes periodontale në diabet: Periodontiti shkakton një inflamacion sistemik të zgjatur, i cili ndikon negativisht në ndjeshmërinë ndaj insulinës dhe përkeqëson kontrollin glicemik. Menaxhimi klinik: Studimet tregojnë se trajtimi i periodontitit përmirëson nivelet e HbA1c, duke ndihmuar në stabilizimin e diabetit. Kujdesi oral i rregullt dhe strategjitë e parandalimit luajnë një rol kyç në reduktimin e komplikacioneve të të dyja sëmundjeve.

Përfundime: Duke qenë se lidhja midis diabetit dhe sëmundjes periodontale është dypalëshe dhe reciprokisht përkeqësuese, është thelbësore që menaxhimi i njërit prej këtyre çrregullimeve të përfshijë edhe trajtimin e tjetrit. Stomatologët duhet të jenë të vetëdijshëm për ndikimin e diabetit në shëndetin oral dhe të inkurajojnë pacientët për një kujdes më të mirë oral, ndërsa mjekët duhet të përfshijnë vlerësimin periodontal në protokollet e menaxhimit të diabetit. Një qasje multidisiplinare do të kontribuojë në përmirësimin e shëndetit të përgjithshëm dhe cilësisë së jetës te pacientët me diabet.

Fjalë kyçe: diabet, periodontal, hiperglicemia, HbA1c, kujdes oral, meta - analiza.

ZBULIMI I HERSHËM I KALCIFIKIMIT TË ARTERIES KAROTIDE NGA DENTISTI PËRMES ORTOPANTOMOGRAFISË.

Enis Veseli
Departamenti i Protetikës Stomatologjike, Drejtimi Stomatologji, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, Kosovë.

Abstrakt

Kalcifikimi i arteries karotide (CAC) është një tregues i rëndësishëm i sëmundjeve kardiovaskulare, duke ofruar njohuri për rrezikun e një pacienti për goditje në tru dhe komplikime të tjera serioze shëndetësore. Metodat tradicionale për vlerësimin e statusit të arterieve karotide shpesh përfshijnë procedura më invazive ose të kushtueshme, duke theksuar nevojën për të rivlerësuar teknikat e imazhit më të aksesueshëm. Ky artikull shqyrton rolin e dentistit në zbulimin e hershëm të CAC në radiografitë panoramike (ortopantomografë) gjatë kontrollave dentare. Të dhënat bazohen në artikuj kërkimorë nga PubMed dhe Google Scholar, duke u fokusuar në fjalë kyçe përkatëse që lidhen me temën. Gjetjet tregojnë se CAC mund të identifikohen nga dentisti me anë të radiografisë panoramike poshtë këndit mandibular dhe ngjitur me vertebrat cervikale në kryqëzimin ndërvertebror C3–C4. Kjo nënvizon përgjegjësinë shtesë për dentistët për të ekzaminuar këtë zonë shpesh të anashkaluar, por kritike, në imazhet panoramike. Ndërsa kalcifikimet nuk tregojnë domosdoshmërisht stenozë të konsiderueshme dhe jo të gjitha lezionet aterosklerotike janë të kalcifikuara, hipotetizohet se prania e

kalcifikimeve në radiografitë dentare mund të shoqërohet me sëmundje të rëndësishme latente karotide. Me trajnimin e duhur, dentistët mund të identifikojnë pllaka të tilla dhe t'i referojnë pacientët te mjekët për ndërhyrje mjekësore në kohë, duke nxitur kështu bashkëpunimin ndërdisiplinor dhe duke rritur kujdesin parandalues për sëmundjet që lidhen me CAC dhe duke shpëtuar shumë jetë.

Fjalë kyçe: kalcifikimi i arteries karotide, ortopantomografi, dentisti.

NDIKIMI I PIJEVE ENERGJIKE NË SHËNDETIN E DHËMBËVE.

Enkel Robaj
Klinika Private Stomatologjike "Elite Dental Care", Prishtinë, Kosovë

Abstrakt
Hyrje: Pijet energjike konsumohen gjerësisht për shkak të aftësisë së tyre për të rritur vigjilencën, përqendrimin dhe performancën fizike. Megjithatë, përbërja e tyre me pH shumë të ulët, sasi të lartë sheqernash dhe kafeinë i bën ato faktorë të rëndësishëm rreziku për shëndetin oral. Ato kontribuojnë në demineralizimin e smaltit, erozionin, zhvillimin e kariesit, ndjeshmëri dentare dhe ndryshime estetike në sipërfaqet restauruese.
Materiale dhe Metoda: Studimi u bazua në një rishikim të literaturës shkencore për të analizuar ndikimin e pijeve energjike tek dhëmbët. Kërkimi u krye në bazat e të dhënave Scopus, PubMed, Google Scholar dhe Web of Science, duke përdorur fjalë kyçe si "pije energjike", "dhëmbët", "aciditet" dhe "erozion". U përfshinë vetëm studime eksperimentale (in vivo dhe in vitro) të kryera tek njerëzit, të publikuara në gjuhën angleze dhe me akses të hapur (open access).
Rezultate: Fillimisht u identifikua një numër i madh artikujsh dhe publikimesh që trajtonin ndikimin e pijeve energjike në shëndetin oral. Pas eliminimit të studimeve me referenca të përafërta, numri i punimeve u reduktua ndjeshëm. Vetëm studimet më relevante dhe të bazuara në të dhëna shkencore u përfshinë në analizë, duke ofruar një pamje më të qartë mbi ndikimin real të këtyre pijeve në strukturat dentare.
Diskutime: Të dhënat tregojnë se dëmtimi i dhëmbëve varet nga pH - ja e pijes, përmbajtja minerale, frekuenca e konsumit, rrjedhja e pështymës dhe veset e të ushqyerit. Konsumimi i shpeshtë rrit ndjeshëm rrezikun e erozionit dhe kariesit, ndërsa masat parandaluese si përdorimi i fluorit, shmangia e ekspozimit të gjatë dhe zëvendësimi i pijeve me ujë janë thelbësore.
Konkluzioni: Pijet energjike paraqesin rrezik të konsiderueshëm për shëndetin oral, duke ndikuar negativisht në smalt, dentinë dhe materiale restauruese. Edukimi, ndërgjegjësimi dhe kontrollet e rregullta stomatologjike janë masa kryesore për parandalimin dhe menaxhimin e dëmtimeve të shkaktuara nga këto pije.

Fjalë kyçe: aciditet, dhëmbët, erozion, pije energjike.

MORFOLOGJIA E RRËNJËS.

Enkeleda Zhupa

Abstrakt
Hyrje: Morfologjia e rrënjëve dentare përfaqëson një komponent kyç të anatomisë orale, me rëndësi të veçantë në endodonti, kirurgji orale dhe trajtime protetike. Variacionet morfologjike, përfshirë numrin, formën dhe drejtimin e rrënjëve, janë të ndryshme sipas grupit të dhëmbëve: dhëmbët prerës dhe kaninët zakonisht kanë një rrënjë të vetme, premolarët mund të kenë një ose dy rrënjë, ndërsa molarët karakterizohen nga dy rrënjë në nofullën e poshtme dhe tre në atë të sipërme. Përveç kësaj, devijimet, harkimet dhe prania e shumë kanaleve endodontike brenda një rrënje të vetme përbëjnë sfida të rëndësishme klinike. Njohja e detajuar e këtyre karakteristikave është esenciale për suksesin e trajtimeve dentare konservative, procedurave endodontike dhe ndërhyrjeve kirurgjikale
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të analizojë dhe të përshkruajë variacionet morfologjike të rrënjëve dentare sipas llojit të dhëmbëve, duke përfshirë numrin, formën, drejtimin dhe praninë e kanaleve endodontike. Njohja e këtyre karakteristikave synon të përmirësojë suksesin e trajtimeve dentare, veçanërisht procedurat endodontike, kirurgjinë orale dhe trajtimet protetike.

Përfundime: Morfologjia e rrënjëve dentare tregon variacione të konsiderueshme sipas llojit të dhëmbit dhe karakteristikave individuale. Njohja e numrit, formës, drejtimit dhe kanaleve endodontike është thelbësore për planifikimin dhe suksesin e trajtimeve dentare, duke përfshirë endodontinë, kirurgjinë dhe procedurat protetike. Kuptimi i detajeve morfologjike ndihmon në parandalimin e komplikacioneve dhe përmirëson rezultatet klinike.

Fjalë kyçe: Morfologjia e rrënjëve dentare, anatomia orale, trajtim.

NDRYSHIMET ORALE TE ÇRREGULLIMET E FUNKSIONIT TË GJËNDRËS PARATIROIDE.

Era Domi, Era Stojkaj
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti i Mjekësisë, Stomatologji.

Abstrakt
Hyrja: Gjëndrat paratiroide gjenden në pjesën posteriore të gjëndrës tiroide në regjionin e qafës. Ato sekretojnë hormonin paratiroid (PTH) që luan rol të rëndësishëm në rregullimin e kalciumit dhe fosforit, si dhe krijimin e vitaminës D, respektivisht, në zhvillimin e eshtrave dhe të dhëmbëve. PTH - ja vepron mbi veshka, kocka dhe në aparatin tretës (kryesisht në zorrën e hollë). Çrregullimi i funksionit të paratiroides mund të çojë në hipersekretim ose hiposekretim të hormoneve, gjegjësisht hiperparatiroidizmi dhe hipoparatiroidizmi, gjë që rezulton në manifestime të ndryshme orale. Manifestimet e zakonshme orale te pacientët me hiperparatiroidizëm (HPT) janë tumori Brown, humbja e densitetit të kockave, kalcifikimi i indeve të buta dhe anomalitë dentare. Në hipoparatiroidizëm, anomalitë dentare janë një vonesë ose ndërprerje e rritjes dhe zhvillimit të dhëmbëve, hipoplazioni i smaltit, parestezi e gjuhës ose e buzëve dhe ndryshim i muskujve të fytyrës.
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është shqyrtimi i literaturës në lidhje me ndryshimet orale te çrregullimet e funksionit të gjëndrës paratiroide.
Materiali dhe metodologjia: Ky punim është realizuar në trajtën e "shqyrtimit të literaturës", duke shfrytëzuar literaturën më të re në temën: "Ndryshimet orale te çrregullimet e funksionit të gjëndrës paratiroide". Në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e këtij punimi, është realizuar studimi i literaturës bashkëkohore, ku përfshihen: Librat referent, Abstraktet e ndryshme, Artikujt shkencorë nga platforma të ndryshme si: PubMed, Google Scholar, Europe PMC.
Rezultate: Prej studimeve mbi ''Ndryshimet orale te çrregullimet e funksionit të gjëndrës paratiroide '' janë shqyrtuar 10 punime për realizimin e këtij punimi. Punimet e studiuara janë në trajtë të rishikimeve të literaturave bashkëkohore si dhe paraqitjes së rasteve klinike në lidhje me temën. Punimet e studiuara janë realizuar në periudha kohore të ndryshme, nga viti 2006 - 2020.

Fjalë kyçe: hiperparatiroidizmi, hipoparatiroidizmi, paratiroid hormoni, manifestimet orale.

TRAJTIMI ME DY FAZA I MALOKLUZIONIT TË KLASËS II TEK PACIENTËT NË RRITJE.

Dr. Eris Kotorri, Dr. Ela Margariti, Dr. Kristulla Kotorri

Abstrakt
Hyrje: Malokluzioni i klasës II përfaqëson një nga anomalitë më të shpeshta skeletore dhe dentare, që shpesh lidhet me retrognatinë mandibulare dhe disbalancën ndërmjet maxillës dhe mandibulës. Trajtimi i hershëm, gjatë periudhës aktive të rritjes, ofron mundësi të rëndësishme për ndërhyrje funksionale dhe modifikim skeletor. Ky punim paraqet një rast klinik të një pacienti në rritje, tek i cili u aplikua terapi ortodontike me dy faza. Në fazën e parë, u përdor pajisja funksionale Twin Block me qëllim stimulimin e rritjes mandibulare dhe korrigjimin e marrëdhënieve skeletore. Në fazën e dytë, trajtimi vazhdoi me aparat fiks ortodontik, për të rafinuar pozicionin e dhëmbëve, për të kompensuar çdo mospërputhje të mbetur dhe për të arritur një okluzion funksional e estetik të qëndrueshëm. Rezultatet treguan një përmirësim të dukshëm në profilin facial, avancim të mandibulës, dhe balancë okluzale të qëndrueshme, duke konfirmuar efektivitetin e trajtimit me dy faza në menaxhimin e malokluzioneve të klasës II tek pacientët në rritje.
Fjalë kyçe: malokluzion klasa II, retrognati mandibulare, pajisje funksionale, Twin Block, terapia me dy faza, ortopedi funksionale e nofullës.

MIKROBIOMA DHE MIKROBIOTA E GOJËS DHE ROLI I TYRE NË LIDHJE ME SHËNDETIN E PËRGJITHSHËM TË ORGANIZMIT.

Erisa Shameti, Tedi Verçani, Endrit Paparisto, Edlira Mulo

Abstrakt

Hyrje: Mikrobioma dhe mikrobiota orale ndërlidhen ngushtë me gjendjen e shumë sistemeve dhe organeve në organizmin e njeriut. Goja është një nga ekosistemet më komplekse të trupit të njeriut. Ajo përmban mbi 700 lloje mikroorganizmash, të cilët përfshijnë: baktere (streptokokë, aktinomicete, fusobaktere, porfironomade etj.), viruse, kërpudha (p. sh. Candida albicans), protozoarë etj. Këta mikroorganizma jetojnë së bashku në një ekuilibër dinamik dhe formojnë atë që quhet mikrobiota orale (grupi i mikrobeve që jetojnë në gojë) dhe mikrobioma orale (gjithë gjenet dhe funksionet e tyre biologjike). Rëndësia e mikrobiotës orale qëndron në disa drejtime: ajo mbron kundër kolonizimit të mikrobeve patogjene, ndihmon në tretjen fillestare të ushqimit dhe në metabolizmin e përbërësve të tij, si dhe stimulon e rregullon imunitetin lokal të mukozës së gojës. Kur prishet ekuilibri, gjendje që quhet disbioza orale, krijohen problematika të ndryshme në organizëm. Faktorë si higjiena e dobët orale, dieta e pasur me sheqerna, përdorimi i antibiotikëve me spektër të gjerë ose sëmundjet sistemike (p. sh. diabeti) mund të çojnë në disbiozë, duke favorizuar rritjen e bakstereve patogjene. Disbioza shkakton karies dentar, gingivit, periodontit, dhe në këto raste mikrobet prodhojnë toksina, enzima dhe molekula inflamatore që mund të hyjnë në qarkullimin e gjakut.

Qëllimi: Është të tregojë lidhjen e mikrobiomës orale me sëmundjet e përgjithshme të organizmit. Është bërë studimi i literaturës bashkëkohore për të treguar lidhjen direkte të sëmundjeve të përgjithshme me mikrobiomën dhe mikrobiotën orale. Studimet moderne tregojnë se mikrobioma orale nuk ndikon vetëm në shëndetin e gojës, por lidhet ngushtë me: Sëmundjet kardiovaskulare - bakteret periodontale (p. sh. Porphyromonas gingivalis) kontribuojnë në inflamacionin sistemik dhe rrezikun për aterosklerozë, infarkt e goditje cerebrale. Diabetin Mellitus - ekziston marrëdhënie dypalëshe: diabeti rrit rrezikun për periodontit, ndërsa periodontiti përkeqëson kontrollin e glukozës. Sëmundjet e frymëmarrjes - mikrobe nga goja mund të thithen në mushkëri, duke shkaktuar pneumoni ose duke përkeqësuar COPD. Sëmundjet gastrointestinale - disa baktere orale lidhen me gastritin nga Helicobacter pylori dhe me çrregullime të mikrobiomës intestinale. Shëndetin riprodhues - infeksionet periodontale janë lidhur me lindje ë parakohshme dhe peshë të ulët të foshnjës. Sëmundjet neurodegjenerative - janë gjetur shenja të bakstereve orale në tru, të lidhura me Alzheimer dhe Parkinson, duke sugjeruar rol të inflamacionit kronik.

Konkluzione: Mikrobioma orale është një element kyç i shëndetit të përgjithshëm. Ekuilibri i saj ndihmon në mirëqenien e gojës dhe trupit në tërësi, ndërsa çrregullimet lidhen me sëmundje inflamatore, metabolike, kardiovaskulare dhe neurodegjenerative. Kujdesi për higjienën orale dhe mbajtja e një mikrobiome të shëndetshme kanë ndikim shumë më të gjerë sesa vetëm tek dhëmbët.

Fjalë kyçe: mikrobioma, mikrobiota, shëndet i gojës, organizëm etj.

PIEZOKIRURGJIA DHE TEKNIKAT ROTATORE NË KIRURGJINË ENDODONTIKE.

Eriselda Simoni (Malushi)[1], Renato Isufi[1], Denis Kadaifciu[1], Dr. Shk. Belisa Kaleci[1], Dr. Shk. Xhanina Gavrazi[1], Prof. Asc. Silvana Bara[2]

[1]*Klinika Stomatologjike Universitare*

[2]*Fakulteti i Mjekësisë Dentare*

Abstrakt

Sfondi dhe Qëllimi: Rezeksioni apikal në kirurgjinë endodontike shpesh shoqërohet me ngjarje të padëshiruara. Teknika të ndryshme kirurgjikale janë përdorur për këtë lloj kirurgjie. Terapia endodontike përfshin: trajtimin primar, sekondar dhe kirurgjinë periradikulare, e cila zakonisht përdoret kur dhëmbët mund të ruhen. Kirurgjia periapike konsiderohet trajtimi i zgjedhur për të shpëtuar një dhëmb me patologji apikale që nuk mund të menaxhohet me endodonci konvencionale, jo - kirurgjikale.

Në studimin tonë, synojmë të paraqesim një pasqyrë të menaxhimit kirurgjikal të patologjive periapike të përsëritura të shoqëruara me një dhëmb jo - jetal me piezosurgeri dhe të hetojmë ndryshimet në rezultatet operative dhe postoperative tek pacientët që i nënshtrohen piezosurgerisë dhe teknikave rrotulluese konvencionale.

Materiale dhe Metoda: 140 pacientë u përfshinë në studim. 70 pacientë iu nënshtruan teknikës piezokirurgji (grupi 1), dhe 70 pacientë iu nënshtruan teknikës rrotulluese konvencionale (grupi 2) për rezeksionin apikal në kirurgjinë endodontike. Në secilin grup studiuam dhe krahasuam gjatë ndërhyrjes: hemorragjinë gjatë kohës së operacionit; dhe disa elementë postoperativë si dhimbja me luspat dhe analgjezikët e përdorur, ditët me edemë, hemorragjia postoperative dhe infeksioni.
Rezultate: Krahasuar me teknikën rrotulluese konvencionale, teknika e piezokirurgjisë u gjet se kishte më pak reaksione postoperative në lidhje me pikëzimin e dhimbjes, analgjezikët e përdorur, ditët me edemë, hemorragjinë dhe infeksionin. Ndërkohë, teknika konvencionale rrotulluese kishte një kohë më të shkurtër operacioni krahasuar me piezokirurgjinë.
Konkluzione: Rezeksioni apikal në kirurgjinë endodontike me teknikën piezosurgery mund të ketë disa avantazhe në rezultatet postoperative krahasuar me teknikën rrotulluese konvencionale.

Fjalë kyçe: Rezeksion apikal, kirurgji endodontike, piezosurgery, teknikë rrotulluese konvencionale.

AVANTAZHET E PIEZOKIRURGJISE NE INTERVENTET ENDODONTIKE.

Eriselda Simoni[1], Laureta Flaga[2], Endrit Paparisto[3], Silvana Bara[4]
[1]*Klinika Stomatologjike Universitare,*
[2]*Qendra Shëndetësore Nr. 5.*
[3]*Klinika Dentare "Paparisto".*

Abstrakt
Hyrje: Pajisja e piezokirurgjisë u zhvillua për prerje të kockes ne mënyrë atraumatike duke përdorur vibrime ultrasonike. Ne ditët e sotme sa vjen e më tepër po rritet përdorimi i saj në dentistri dhe kirurgji vecanërisht në kirurgjinë endodontike, në osteotomi, rezeksionin e majës së rrënjës dhe preparimin e fundit të rrënjës.
Qëllimi: Kjo përmbledhje literature ka për qëllim të nënvizojë përdorimet klinike të piezokirurgjisë në dentistri vecanërisht rolin e saj në kirurgjinë endodontike.
Materiali dhe metoda: U realizua një kërkim në Pubmed në anglisht me fjalë kyce piezokirurgjia në kirurgjinë endodontike në 5 vitet e fundit. Një total prej 120 artikujsh plotësonin kriteret tona të kërkimit.
Përfundime: Piezokirurgjia është një teknikë premtuese e së ardhmes me disa përdorime në dentistri, kirurgji dhe kirurgji endodontike duke permirësuar cilësinë e ndëryrjeve dhe rezultatin final, por më tepër studime duhet të realizohen në të ardhmen që të nxjerrin në pah përparësitë e piezokirurgjisë në rezeksionin e apeksit të rrënjës dhe përpunimin e tij.

Fjalë kyçe: piezokirurgji, kocka, atraumatike, endodonci, dentistri.

INTERVENIMET KIRURGJIKE ENDODONTIKE.

Erleta Mucaj[14ABCDE] Elza Mucaj[13ABDE] Leart Kuci[2ADE] Elita Bekteshi[1ABE] Rinesa Kolshi[1AE]
[1]*Alma Mater Europaea, Kolegji "Rezonanca", Prishtinë, Kosovë.*
[2]*Fakulteti i Stomatologjisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Prishtinë, Kosovë.*
[3]*Universiteti "Cyril dhe Methodius", Shkup, Maqedonia e Veriut, kandidat për doktoraturë.*
[4]*Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Prishtinë, Kosovë, kandidat për doktoraturë – Kirurgji Orale.*
[A]*Dizajni / planifikimi i studimit*
[B]*Mbledhja / regjistrimi i të dhënave*
[C]*Interpretimi i të dhënave*
[D]*Përgatitja e punimit*
[E]*Analizë / kërkim i literaturës*

Abstrakt
Hyrje: Kirurgjia endodontike përbën një nga qasjet më të avancuara në trajtimin e lezioneve periradikulare, veçanërisht në rastet kur trajtimi konvencional i kanalit të rrënjës nuk ka rezultuar i suksesshëm. Ajo ofron një alternativë të vlefshme për ruajtjen e dhëmbit natyral në kavitetin oral përmes ndërhyrjeve mikro - kirurgjikale të sakta. Zhvillimet teknologjike dhe përmirësimi i teknikave operative kanë rritur ndjeshëm efikasitetin dhe

shkallën e suksesit të këtyre procedurave, duke e pozicionuar kirurgjinë endodontike si një komponent të rëndësishëm të terapive moderne endodontike.
Qëllimi i punimit: Ky punim synon të analizojë në mënyrë të detajuar konceptin e mikrokirurgjisë endodontike, me fokus në indikacionet klinike, përfitimet dhe kufizimet e saj, si dhe përshkrimin e instrumenteve dhe materialeve të përdorura gjatë procedurës. Gjithashtu, theksohen dallimet mes kirurgjisë endodontike dhe kirurgjisë orale tradicionale.
Metodologjia: Punimi është realizuar përmes një rishikimi sistematik të literaturës shkencore nga databaza të njohura si Web of Science, Scopus, Pubmed, Medline, Ebsco dhe Google Scholar. Përzgjedhja e materialeve është bërë bazuar në cilësinë e evidencës shkencore dhe rëndësinë klinike të përmbajtjes.
Rezultate: Të dhënat nga literatura tregojnë se mikrokirurgjia endodontike ka një shkallë të lartë suksesi, sidomos në trajtimin e lezioneve periapikale të cilat nuk i janë përgjigjur trajtimit konvencional. Efektiviteti i kësaj metode rritet ndjeshëm kur respektohen protokollet standarde operative, përdoren materiale biokompatibile dhe aplikohet vizualizimi përmes mikroskopit kirurgjikal.
Përfundime: Kirurgjia endodontike përfaqëson një avancim të rëndësishëm në menaxhimin e komplikimeve endodontike. Ajo nuk duhet të shihet si alternativë e parë pas dështimit të trajtimit klasik, por si një mundësi e vlefshme në rastet ku ritrajtimi nuk është i mundur ose ka dështuar. Aplikimi i drejtë i kësaj metode kontribuon në ruajtjen afatgjatë të dhëmbëve natyralë dhe në përmirësimin e cilësisë së trajtimit endodontik në përgjithësi. Ky studim thekson rëndësinë e integrimit të teknikave mikrokirurgjikale në praktikën e përditshme endodontike, me qëllim përmirësimin e rezultateve afatgjata të trajtimit.

Fjalë kyçe: kirurgjia endodontike, mikrokirurgjia, trajtimi i rrënjës, llambo, infeksioni periapikal, rrënjë dentare.

KIRURGJIA ORTOGNATIKE KONVENCIONALE VS. E GUIDUAR: QASJE KRAHASUESE PËR STUDIMIN E RASTEVE DHE APLIKIMIN E TRAJTIMIT.

Ermal Pashaj, Gianluca Nicolai, Mattia Todaro, Elio Sinani, Edona Mbole, Dea Osmanaj, Sandro Pelo
Departamenti i Kirurgjisë, Kirurgjia Maksilo - Faciale, Qendra Spitalore Universitare "Zoja e Këshillit të Mirë"

Abstrakt
Kirurgjia ortognatike synon të rikthejë funksionin dhe ekuilibrin facial te pacientët me deformime odonto–faciale. Planifikimi konvencional, i ndërtuar mbi radiografi 2D, modele dentare të artikuluara dhe fotografi klinike, mbetet themeli i kësaj disipline, por me rritjen e kompleksitetit të rasteve, arritja e rezultateve të dëshiruara bëhet më e vështirë. Të dhënat e nevojshme për studimin, diagnostikimin dhe planifikimin e trajtimit të këtyre pacientëve ekzistojnë në formate të ndryshme, gjë që i detyron klinicistët të kombinojnë modele, radiografi, fotografi dhe lëvizje të planifikuara të nofullave për t'i transferuar më pas në sallën operatore. Çdo hap manual, duke filluar nga montimi i modeleve në artikulator përmes harkut facial, planifikimi i lëvizjeve në modele dhe prodhimi i splinteve kirurgjikalë, shton varianca të vogla dhe e bën procesin e rishikimit të vështirë, duke rritur kështu edhe probabilitetin e gabimit. Komunikimi në ekip po ashtu vështirësohet kur plani nuk mund të shihet dhe testohet në një mjedis të unifikuar. Krijimi i një modeli 3D të unifikuar të pacientit, duke kombinuar CBCT / CT, skanime dentare dixhitale dhe skanimin e fytyrës, mundëson krijimin e një "binjaku dixhital" të pacientit. **Planifikimi virtual** lejon vizualizim të qartë të marrëdhënieve skeletike, testim të shpejtë të alternativave dhe transferim të thjeshtuar drejt kirurgjisë përmes guidave të dizenjuara në mënyrë dixhitale ose pllakave të fiksimit të personalizuara. Studimet krahasuese tregojnë se të dyja qasjet – konvencionale dhe dixhitale – mund të japin rezultate skeletike të qëndrueshme. Megjithatë, planifikimi i udhëhequr nga kompjuteri priret të përmirësojë komunikimin me pacientin, qartësinë e planit të trajtimit, koordinimin e ekipit dhe përputhjen midis planit dhe ekzekutimit, duke e thjeshtuar kalimin nga simulimi 3D në sallën operatore. Rezultatet në indet e buta ilustrojnë një ndryshim në parashikueshmëri: kirurgjia konvencionale mund të arrijë rezultate të krahasueshme, por planifikimi 3D ofron parashikime më të besueshme dhe specifike për rastin, lidhur me ndryshimet e pritshme të indeve të buta, si dhe ndihmon në përafrimin e lëvizjeve me objektivat funksionalë përpara ndërhyrjes kirurgjikale. **Evolucioni dixhital** duket se ka shndërruar kirurgjinë ortognatike nga një art empirik në një disiplinë inxhinierike. Literatura dhe rezultatet në praktikën e përditshme favorizojnë planifikimin e udhëhequr nga kompjuteri si zgjedhjen moderne për rastet komplekse.

Fjalë kyçe: kirurgjia ortognatike, deformime odonto - faciale, planifikim konvencional, planifikim dixhital,

binjak dixhital, CBCT, skanim dentar dixhital, skanim i fytyrës, planifikim virtual, splinte kirurgjikale, modele 3D, navigim kirurgjikal.

TRAJTIMI I KARIESIT DENTAR ME TEKNIKA MINIMALE INVASIVE.

Erna Zeqiri, Krenar Gashi
Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

Abstrakt

Hyrje: Trajtimi i kariesit dentar mbetet një nga sfidat kryesore në stomatologji, duke kërkuar qasje efektive dhe njëkohësisht sa më pak invazive për pacientin. Ky studim ka për qëllim të analizojë dhe vlerësojë teknikat minimale invazive në menaxhimin e kariesit dentar, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së indit dentar të shëndoshë dhe përmirësimit të përvojës së pacientit. Rëndësia akademike dhe praktike e këtij hulumtimi qëndron në faktin se qasjet minimale invazive po bëhen standard i ri në stomatologjinë moderne, duke kontribuar në trajtime më të qëndrueshme dhe të personalizuara. Metodologjia e përdorur përfshin një shqyrtim të literaturës shkencore ndërkombëtare dhe një analizë krahasuese të efikasitetit klinik të këtyre teknikave kundrejt trajtimeve tradicionale. Gjetjet sugjerojnë se përdorimi i teknikave si remineralizimi, infiltrimi i resinës, trajtimi atraumatik restaurues dhe përdorimi i materialeve bioaktive çon në ruajtje më të madhe të strukturës natyrore dhe rezultate afatgjata më të qëndrueshme. Ky studim përfundon duke theksuar kontributin e madh që qasjet minimale invazive kanë në mbushjen e boshllëqeve të ekzistuara në informacion dhe praktikë, duke rekomanduar një integrim më të gjerë të këtyre metodave në stomatologjinë bashkëkohore.

Fjalë kyçe: karies dentar, teknika minimale invazive, remineralizim, resin infiltrimi, trajtim atraumatik.

AUTOTRANSPLANTIMI I DHËMBËVE SI ALTERNATIVË FUNKSIONALE DHE BIOLOGJIKE NDAJ IMPLANTOLOGJISË MODERN.

Dr. Ernest Llaka, PhD

Abstrakt

Autotransplantimi i dhëmbëve përfaqëson një procedurë kirurgjikale të bazuar në transferimin e një dhëmbi të shëndetshëm nga një vend në një tjetër brenda të njëjtit individ, duke ruajtur potencialin biologjik dhe aftësinë rigjeneruese të ligamentit periodontal. Ky trajtim ka marrë një vëmendje të shtuar vitet e fundit si një alternativë valide ndaj implantologjisë dentare, sidomos tek pacientët e rinj ku zhvillimi i kockës ende vazhdon. Qëllimi i këtij punimi është të paraqesë avantazhet, kufizimet dhe perspektivat klinike të autotransplantimit të dhëmbëve në stomatologjinë moderne. Në fokus vendosen faktorët prognostikë që ndikojnë në suksesin afatgjatë të procedurës, si p. sh. mosha e pacientit, gjendja e rrënjës së dhëmbit dhurues, teknika kirurgjikale dhe periudha e revascularizimit. Studimet klinike të raportuara në literaturë tregojnë një shkallë mbijetese prej mbi 80–90% në ndjekje afatgjata, me integrim funksional dhe estetik të krahasueshëm ose superior ndaj alternativave protetike dhe implantologjike. Për më tepër, autotransplantimi ruan arkitekturën alveolare, stimulon rigjenerimin e indit periodontal dhe përfaqëson një opsion ekonomikisht të leverdishëm për pacientin. Konkluzioni është se autotransplantimi i dhëmbëve duhet të konsiderohet një procedurë me potencial të lartë klinik, veçanërisht në raste të përzgjedhura me kujdes dhe të realizuar nga profesionistë të trajnuar.

Fjalë kyçe: autotransplantimi, kirurgjikale, revaskularizim, estetike, indi periodont.

NANOTEKNOLOGJIA NË STOMATOLOGJINË RESTAURATIVE DHE NË ENDODONCION.

Dr. Errita Bokshi
Ordinanca private stomatologjike "3Dent", Gjakovë, Kosovë.

Abstrakt

Hyrje: Nanoteknologjia si disiplinë është zgjeruar me shpejtësi në të gjitha fushat e shkencës pasi ofron mënyra alternative të rëndësishme për të zgjidhur çështjet dhe problemet shkencore dhe mjekësore. Nanoteknologjia është një degë e teknologjisë që punon në përmasa më të vogla se 100 nm. Duke pasur parasysh pengesat në shkencë, bioteknologji dhe zhvillimet në materialet dentare, ekziston një nevojë për zhvillim për teknologji më të avancuar në epokën aktuale. Nanoteknologjitë po krijojnë materiale më të mira dentare dhe metoda të përmirësuara diagnostikuese të lidhura me shëndetin oral.

Qëllime: Qëllimi i këtij punimi është që përmes shqyrtimit të literaturës aktuale të publikuar mbi Nanoteknologjinë në Stomatologji, të përshkruhet koncepti bazë i nanomaterialeve, si dhe të interpretohen aplikimet e përditësuara të materialeve të reja të zhvilluara në treg, rëndësinë klinike dhe efikasiteti e materialeve të tilla në krahasim me ato që përdoren aktualisht në praktikën klinike.

Materiale dhe Metoda: Rishikim i literaturës, duke u mbështetur në literaturën më të fundit shkencore të publikuar në burime të indeksuara si: PubMed, National Library of Medicine, Journal of Dentistry, Google Scholar.

Rezultate: Nanoteknologjia si inxhinieri artistike në madhësi më të vogël se 100 nm ka mundësuar të arritet dizajni, funksionet dhe performanca e dëshiruar e produkteve përfundimtare. Parashikohet që në të ardhmen e afërt, Nano - Dentistria do të zëvendësojë metodat konvencionale të trajtimit.

Përfundime: Nuk ka dyshim se kërkesa për biomateriale dentare është në rritje të shpejtë dhe nuk ka materiale dentare të disponueshme me veti ideale për çdo aplikim dentar. Shkenca dhe aplikimet e Nanoteknologjisë janë vazhdimisht në evolucion ndërsa ne jemi dëshmitarë të produkteve të reja që futen në treg. Pritet që Nanoteknologjia të vazhdojë të rritet dhe të gjejë më shumë aplikime në fushën e shkencës shëndetësore. Ky parashikim bazohet në përfitimet e mundshme dhe efektivitetin e kostos; avantazhet socio - mjedisore, publike dhe profesionale. Me kalimin e kohës, studiuesit po eksplorojnë gjithnjë e më shumë dimensione të reja të shkencës nano - stomatologjike, ndërsa punojnë për të kapërcyer kufizimet e saj.

Fjalë kyçe: Nanoteknologji, Stomatologji Restaurative, Endodoncion, Materiale dentare.

PËRDORIMI I FLUORIT NË DENTISTRINË PEDIATRIKE: ROLI DHE PËRFITIMET NË PARANDALIMIN E KARIESIT.

Eva Habazaj[1], Blerta Rumano[1], Nineta Manastirliu[1], Belisa Kaleci[1], Arlinda Karaj[2], Ilvia Tabaku[3], Eralda Lleshi [1]

[1]Klinika Stomatologjike Universitare Tiranë [2]Fakulteti i Mjekësisë Dentare [3]Klinikë Dentare Private

Abstrakt

Hyrje: Parandalimi i kariesit dentar tek fëmijët përbën një prioritet në dentistrinë pediatrike moderne. Fluori është një mineral esencial me rol të rëndësishëm në ruajtjen e shëndetit oral dhe në forcimin e smaltit përmes procesit të remineralizimit.

Qëllimi: Të vlerësohet roli dhe efektiviteti i fluorit në parandalimin e kariesit dentar tek fëmijët, duke theksuar mënyrat e aplikimit dhe rëndësinë e përdorimit të kontrolluar në praktikën klinike.

Materiale dhe Metoda: Ky punim është bazuar në rishikimin e literaturës shkencore që trajton përdorimin e fluorit në dentistrinë pediatrike. Janë analizuar format e ndryshme të aplikimit të tij, përfshirë pastat e dhëmbëve me fluor, trajtimet profesionale dhe suplementet fluoruese si dhe efektet e tyre në reduktimin e incidencës së kariesit.

Rezultate: Fluori ndihmon në procesin e rimineralizimit të smaltit dhe në uljen e aktivitetit bakterial që lidhet me zhvillimin e kariesit. Përdorimi i rregullt dhe i mbikëqyrur i fluorit në fazën posteruptive tregon efikasitet të lartë në zvogëlimin e kariesit, veçanërisht tek individët me risk të lartë. Megjithatë, përdorimi i tepërt pa mbikëqyrje mund të çojë në shfaqjen e fluorozes dentare.

Përfundime: Fluori mbetet një komponent thelbësor në strategjitë parandaluese të kariesit dentar në dentistrinë pediatrike. Përdorimi i tij duhet të jetë i sigurt, i dozuar dhe i kontrolluar për të maksimizuar përfitimet dhe për të parandaluar efektet anësore duke kontribuar në përmirësimin e shëndetit oral tek fëmijët.

Fjalë kyçe: fluor, parandalim, karies dentar, dentistri pediatrike etj.

TRAJTIMI KIRURGJIKAL I TUMOREVE BENINJE DHE MALINJE TË GJENDRAVE TË MËDHA TË PËSHTYMËS.

Everest Dede

Abstrakt

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i neoplazive beninje dhe malinje të gjëndrave të mëdha të pështymës nga aspekti klinik, imazherik dhe anatomopatologjik si dhe trajtimi i tyre kirurgjikal dhe komplikacionet post operatore.

Materiale dhe metoda: Në këtë studim u analizuan në mënyrë retrospektive të dhënat për 57 pacientë me tumore të gjëndrave parotis, submandibulare dhe sublinguale, të cilët iu nënshtruan ndërhyrjeve kirurgjikale, nga periudha janar 2018 deri në 11 prill 2023. Pacientët e përfshirë në studim janë të gjitha raste të realizuara në Shërbimin e Kirurgjisë Maksilofaciale, Spitali Francez, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë. Të dhënat e studimit janë marrë nga arkivat e shërbimit të statistikës për departamentin e Kirurgjisë Maksilofaciale për pacientët e paraqitur në QSUT. U analizuan manifestimet e ndryshme klinike të tumoreve të gjëndrave të pështymës. Gjithashtu u studiuan mosha, gjinia, të dhënat histopatologjike të tumoreve si dhe ditët e qëndrimit në spital. U analizua trajtimi kirurgjikal i përdorur dhe komplikacionet post operatore. Analiza statistikore: Ky studim është një studim i tipit Cross - Sectional, statistikor - klinik. U krijua një databazë me të dhënat e pacientëve në Microsoft Excel. Gjithashtu tabelat dhe grafikët u ndërtuan në Microsoft Excel. Një tabelë bazë me të dhënat përshkruese u ndërtua për të treguar karakteristikat kryesore të pacientëve. Rezultatet u prezantuan në numra dhe përqindje.

Konkluzione: Pjesa më e madhe e pacientëve të hospitalizuar dhe trajtuar ishin banues në qytetin e Tiranës (50. 88%), ndjekur nga qyteti i Korçës (8. 77%) dhe Vlorës (8. 77) si dhe qyteti i Shkodrës (7. 02%). Nga 57 raste që u morën në studim, 61. 4% e tyre i përkisnin gjinisë mashkullore, ndërsa 38. 6% gjinisë femërore. Mosha e rasteve varionte nga 17 vjeç deri në 89 vjeç dhe shënon një moshë mesatare 59 vjeç me një shmangie standarde (SD 18. 04). Nga të dhënat e studimit lokalizimi më i shpeshtë i tumoreve beninje dhe malinje ishte në gjëndrën parotis (68%), e ndjekur nga gjëndra submandibulare (23%) dhe ajo sublinguale (9%). Nga të dhënat evidentohet se teknika operatore më e përdorur ishte parotidectomia parcialë me 82. 05% e ndjekur nga parotidectomia subtotalë me 10. 26% dhe ajo totalë 7. 69%. Për gjëndrën submandibulare dhe sublinguale përdorej një teknikë e vetme operatore, që ishte ekscizioni total i gjëndrës. Sipas të dhënave rezultoi se 7 pacientë (17. 95%) të operuar për tumore të gjëndrës parotis kanë shfaqur komplikacionein e paralizës së përkohshme dhe 2 pacientë (5. 13%) kanë shfaqur paralizë të përhershme. Koha e rikuperimit varionte nga 4 ditë deri në 6 muaj. Në rastin e gjëndrës submandibulare evidentohet se 2 raste (15. 38%) me hematomë nga bllokimi i drent. Për gjëndrën sublinguale nuk evidentohet asnjë komplikacion postoperator.

Fjalë kyçe: neoplazi, beninje, malinje, gjëndra të mëdha të pështymës etj.

KONFIGURIMI RRËNJËSOR I MOLARIT TË DYTË MANDIBULAR: RAST KLINIK DHE KRAHASIM ME LITERATURËN.

Dr. Fatijon Gashi

Elite Dental Care, Prishtinë, Republika e Kosovës

Abstrakt

Hyrje: Të kuptuarit e morfologjisë së kanaleve të dhëmbëve është thelbësor për suksesin e trajtimit endodontik. Sistemi i klasifikimit sipas Vertucci - t përshkruan variacionet e anatomisë së kanaleve, ku tipi III është relativisht i rrallë te molarët e dytë mandibularë. Dështimi për të njohur dhe trajtuar siç duhet këto variacione mund të çojë në infeksione të vazhdueshme dhe dështim të trajtimit endodontik. Ky prezantim rasti paraqet

trajtimin endodontik të molarit të dytë mandibular që shfaq një anatomi të rrallë të kanalit të tipit III sipas klasifikimit të Vertucci - t, i karakterizuar nga një kanal i vetëm që del nga dhoma pulpare, ndahet në dy në të tretën e mesme dhe ribashkohet në një kanal të vetëm në të tretën apikale. Diagnostikimi i saktë dhe menaxhimi i një anatomie kaq komplekse janë thelbësore për suksesin e trajtimit. Ky prezantim përshkruan qasjen klinike, sfidat e hasura dhe menaxhimin e suksesshëm të rastit, i mbështetur me prova radiografike.

Fjalë kyçe: Anatomia e kanalit, molar i dytë mandibular, Tipi III, kondensimi lateral.

PËRDORIMI I SKANERËVE INTRAORALË DHE NDIKIMI I TYRE NË CILËSINË E MODELEVE DIGJITALE.

Feisi Gjolena
Teknik i lartë Dentar
Lektore, Albanian University.

Abstrakt
Hyrje: Zhvillimet e fundit në teknologjinë digjitale dentare kanë transformuar mënyrën e marrjes së masave dhe krijimit të modeleve protetike. Skanerët intraoralë ofrojnë një alternativë moderne ndaj metodave tradicionale me materiale elastike, duke mundësuar krijimin e modeleve tredimensionale me saktësi të lartë. Ky studim synon të vlerësojë ndikimin e përdorimit të skanerëve intraoralë në cilësinë, saktësinë dhe përsëritshmërinë e modeleve digjitale, në krahasim me metodat konvencionale.
Metodologjia: U përfshinë 20 modele të harkut dentar të përftuara nga 10 pacientë. Për secilin pacient u morën dy lloje masash: njëra me metodën tradicionale (material silikonik) dhe tjetra me skaner intraoral (teknologji CAD / CAM). Modelet digjitale u analizuan me softuer metrologjik 3D për të krahasuar devijimet dimensionale në raport me modelet referuese. U vlerësuan gjithashtu koha e procesit, komoditeti për pacientin dhe përsëritshmëria e rezultateve.
Rezultate: Analizat treguan se modelet e përftuara nga skanimi intraoral kishin një devijim mesatar më të ulët në përmasat lineare krahasuar me modelet konvencionale. Diferencat më të mëdha u vunë re në rajonet molare, ku lagështia dhe aksesueshmëria ndikojnë në cilësinë e skanimit. Përdorimi i skanerëve digjitalë uli kohën mesatare të marrjes së masës me rreth 35%, duke përmirësuar gjithashtu përvojën e pacientit. Megjithatë, aftësia e operatorit rezultoi një faktor kyç për saktësinë e matjeve.
Përfundime: Skanerët intraoralë përfaqësojnë një hap të rëndësishëm drejt dixhitalizimit të praktikës dentare dhe laboratorike. Ata ofrojnë përfitime në saktësi, komoditet dhe efikasitet, megjithëse kërkojnë trajnim të duhur profesional për të maksimizuar cilësinë e rezultateve. Integrimi i teknologjisë së skanimit me sistemet CAD / CAM përmirëson ndjeshëm cilësinë e punimeve protetike dhe redukton mundësinë e gabimeve njerëzore.

Fjalë kyçe: skaner intraoral, modele digjitale, CAD / CAM, saktësi dimensionale, teknologji dentare.

MASAT DIGJITALE DHE PËRPUNIMI DIGJITAL I RESTAURIMEVE PROTETIKE.

Fitore Bytyqi[1], Prof. Assoc. Dr. Teuta Pustina Krasniqi[2]
[1]*Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Stomatologjisë, Prishtinë, Kosovë.*

Abstrakt
Sistemi digjital i dizajnimit / prodhimit me ndihmën e kompjuterit (CAD / CAM) përmes përdorimit të laserëve dhe makinerive të tjera skanuese, ofron disa përfitime në krahasim me teknikën konvencionale. Marrja e masës në mënyrë digjitale paraqet një metodë novatore që na mundëson të krijojmë një kopje virtuale të indeve të buta dhe të forta të zgavrës së gojës. Evolucioni i teknologjisë digjitale dhe sistemit CAD / CAM ka krijuar mundësi për përmirësimin e stomatologjisë restauruese. Sistemet digjitale tani ofrojnë mundësinë, për të shmangur marrjen e masës me metodën konvencionale duke përfshirë materialet e zakonshme për marrjen e masës, kohën dhe kufizimet e trajtimit që lidhen me to. Skanerët intraoral kanë potencialin të ofrojnë saktësi të shkëlqyeshme dhe një përvojë më komode për pacientin dhe rrjedhë më efikase të punës.

Fjalë kyçe: CAD / CAM, masa digjitale, skanerët intraoral, restaurimet.

PËRSHKRIMI I ANTIBIOTIKËVE NË STOMATOLOGJINË E PËRDITSHME (PËRDORIMI DHE KEQPËRDORIMI).

Dr. Florentina Sadiku[1], Dr. Abdullah Maxhuni
[1]*Departamenti i stomatologjisë.*

Abstrakt
Meqense antibiotikët përdoren zakonisht në stomatologji, është thelbësore të kuptohet përdorimi i duhur për të parandaluar zhvillimin e baktereve rezistente ndaj antibiotikëve. Nga ana tjetër, keqpërdorimi i antibiotikëve mund të ketë pasoja serioze, duke përfshirë reaksione negative ndaj ilaçeve dhe rritjen e baktereve rezistente ndaj antibiotikëve. Prandaj, është thelbësore të përdoren antibiotikët me përgjegjësi dhe vetëm kur është e nevojshme në stomatologjinë e përditshme. Kariesi dentar, nekroza pulpare, trauma dhe çrregullimet periodontale mund të shkaktojnë infeksione dentare, të cilat mund të kenë efekte serioze si për indet e buta ashtu edhe për ato të forta të zgavrës orale. Infeksionet dentare mund të shkaktojnë dhimbje, ethe dhe edemë. Trajtimet kirurgjikale dhe endodontike përdoren për të trajtuar së pari dhëmbët e infektuar, të ndjekura nga antibiotikët. Kur kryhen operacione dentare, antibiotikët përdoren zakonisht për të trajtuar infeksionet profilaktike, lokale, fokale dhe jo - odontogjene. Është vërejtur se vetëm afërsisht 12% e dentistëve përshkruajnë saktë dhe në mënyrë të mjaftueshme antibiotikët, duke theksuar rëndësinë e rekomandimeve të hollësishme. Antibiotikët e pershkruar mund të kenë efekte anësore të pafavorshme, duke përfshirë alergji dhe gjendje dermatologjike, si dhe reaksione të mbindjeshmërisë. Për të parandaluar vështirësitë e përshkrimeve të panevojshme të antibiotikëve, veçanërisht rezistencën bakteriale, duhet të zhvillohen rekomandime të hollësishme. Qëllimi i këtij studimi është të përshkruajë indikacionet për terapinë me antibiotikë në stomatologji dhe të shqyrtojë format më të përhapura të antibiotikëve të përdorur në praktikën stomatologjike, të organizuara sipas klasës farmakologjike. Për më tepër, diskutohen llojet e antibiotikëve që konsiderohen të sigurt gjatë shtatzënisë dhe fëmijërisë.

Fjalë kyçe: Antibiotikë, rezistencë bakteriale, profilaksi, stomatologji.

INOVACIONI KLINIK NË IMPLANTOLOGJI: NGARKESA E MENJËHERSHME NË REHABILITIN ALL - ON - SIX.

Dr. MDSc. Genc Zenunaj[1, 2, 3], Prof. Asocc. Dr. Erda Qorri[1], Dr. Egzona Hasani[3], Dr. Arif Metaj[3]
[1] *Albanian University, Tiranë, Shqipëri*
[2] *LUMC – Qendra Mjekësore Universitare e Leidenit, Leiden, Holandë*
[3] *Dental Clinic, Istog, Kosovë.*

Abstrakt
Sfondi: Protokollet e ngarkesës së menjëhershme në implantologji mundësojnë rehabilitim funksional dhe estetik brenda një kohe të shkurtër, duke rritur ndjeshëm kënaqësinë e pacientit. Ato përfaqësojnë një alternativë të rëndësishme ndaj ngarkesës së vonuar tradicionale, veçanërisht në rastet me atrofi të rëndë, pasi reduktojnë kohën e trajtimit dhe rikthejnë menjëherë cilësinë e jetës.
Paraqitja e rastit: Pacienti me atrofi të rëndë dhe denticion të kompromentuar paraqitet me dhimbje, lëvizshmëri dhe vështirësi funksionale. U ekstraktuan dhjetë dhëmbë dhe u realizua planifikimi digjital mbi bazën e CBCT. U vendosën gjashtë implante (NucleOSS T6 TRQ 3510): pesë të drejta dhe një i pjerrët me 30° në mes 34–35. Implanti i pjerrët u angulua për të anashkaluar foramen mentale, e cila u ekspozua me kujdes në të dy anët për të siguruar vizualizim të saktë dhe vendosje të sigurt. Të gjitha implantet arritën stabilitet primar të shkëlqyer, duke mundësuar dorëzimin e një ure provizore PMMA të fiksuar me vidhë brenda 48 orëve. Pas dy muajsh shërimi pa komplikime, u vendos ura përfundimtare prej zirkoni, duke rikthyer funksionin, fonetikën dhe estetikën me stabilitet të lartë dhe kënaqësi maksimale të pacientit.
Përfundim: Ky rast demonstron parashikueshmërinë dhe potencialin afatgjatë të ngarkesës së menjëhershme në rehabilitimin e plotë me konceptin All - on - Six. Ekspozimi i kujdesshëm i foramen mentale dhe angulimi i implantit distal ofruan një teknikë të sigurt dhe të riprodhueshme për optimizimin e pozicionimit të implanteve. Planifikimi digjital modern, i kombinuar me ekzekutim kirurgjikal të saktë, siguroi stabilitet optimal, funksion të hershëm dhe rezultate estetike të shkëlqyera, duke dëshmuar se përparimet teknologjike përkthehen drejtpërdrejt në kujdes të përmirësuar për pacientin.

Fjalë kyçe: implantologji, atrofi, implante, All - on - six, foramen mentale.

SI TË KUJDESEMI PËR IMPLANTET DENTARE DHE PËRDORIMI I PIEZOKIRURGJISË.

Gerelda Doraci, Renato Isufi
University Dental Clinic

Abstrakt
Hyrje: Duke qënë se implantet dentare janë bërë pjesë e zakonshme e trajtimit të mungesave të dhëmbëve lind nevoja për një protokoll të mirëmbajtjes të zonës peri - implantare. Nëse më parë suksesi i implanteve dentare fokusohej vetëm në fazën kirurgjikale për të arritur një stabilitet të mirë primar, me kalimin e kohës u vu re se mirëmbajtja e zonës peri - implantare rrit jetëgjatësinë e implantit. Në këtë artikull do të shqyrtojmë anatominë e indeve peri - implantare, etiologjinë dhe faktorët e rrezikut të sëmundjeve peri - implantare si dhe trajtimin kirurgjikal dhe jokirurgjikal të këtyre sëmundjeve. Do të diskutohen protokollet e disponueshme dhe hapat klinik që duhen ndjekur për të ruajtur ose rikuperuar shëndetin peri - implantar.

Fjalë kyçe: implant dentar, mirëmbajtje, kirurgji etj.

TRAJTIMI PERIODONTAL JO KIRURGJIKAL DHE KLASIFIKIMI I RI I PERIODONTITIT.

PhD. Gerila Tafaj

Abstrakt
Trajtimi periodontal jo kirurgjikal (TPJK) është linja e parë terapeutike në menaxhimin e periodontitit, pavarësisht nga stadet dhe gradat e tij sipas klasifikimit të ri të sëmundjeve periodontale dhe periimplantare nga Federata Evropiane e Periodontologjisë (EFP) dhe Akademia Amerikane e Periodontologjisë (AAP) të vitit 2018. Kjo qasje përfshin eliminimin e pllakës bakteriale dhe gurëzave subgingivale nëpërmjet pastrimit dhe lëmimit të rrënjës, të shoqëruar me kontrollin e pllakës nga pacienti dhe modifikimin e faktorëve të rrezikut si duhanpirja dhe diabeti. Klasifikimi i ri i periodontitit bazohet në një sistem të stadave dhe gradimeve te ndryshe. Stadet (I - IV) pasqyrojnë ashpërsinë e dëmtimit periodontal dhe kompleksitetin e trajtimit, ndërsa Gradat (A - C) tregojnë shpejtësinë e progresionit dhe faktorët e rrezikut sistemik. TPJK është veçanërisht efektiv në stadet fillestare dhe të moderuara (I - III), duke përmirësuar thellësinë e sondimit dhe inserimin klinik. Megjithëse TPJK është thelbësor për kontrollin e sëmundjes, në rastet e avancuara (stad i IV) mund të kërkohet trajtim kirurgjikal plotësues. Personalizimi i trajtimit sipas klasifikimit aktual mundëson një qasje më precize dhe të parashikueshme për stabilitetin periodontal afatgjatë.

Fjalë kyçe: periodontit, klasifikimi, trajtim jo - kirurgjikal etj.

MENAXHIMI ORTODONTIK NE BORDERLINE.

Gilda Saveta
GE - Dental Klinik, Lushnjë, Shqipëri

Abstrakt
Hyrje: Raste të quajtura"Kufi" janë raste ku pacientët të ekzaminimeve ortodontike paraqesin diskrepance së harkut dentar, dimensione transversale në papërputhshmëri me harkun e kundërt, apo diskrepanca skeletale që e bëjnë edhe më të vështirë trajtimin. Në këtë punim janë paraqitur pacientë të cilët janë me diagnoza të diskutueshme pasi zgjidhjet dhe trajtimet e tyre i kalojnë vlerat anatomike ortodontike sipas guidave të njohura me ekstraksione ose elemente funksionale. Si kërkesë e shtuar në Ortodoncinë e avancuar, vendosja e diagnozave përtej protokolleve në Ortodoncinë tradicionale është domosdoshmëri për të kuptuar zgjedhjen e trajtimeve ortodontike mbi bazën e njohurive dhe zgjidhjes që secili mjek ortodont sheh të arsyeshme duke patur arsye të parë shëndetin oral, funksional dhe estetikën si kërkesë gjithmonë e në rritjen nga ana e pacientit.

Qëllimi: Nëpërmjet rasteve klinike, qëllimi është të pranojmë dhe të diskutojmë ide të ndryshme të zgjidhjes së një rasti ortodontik në mënyra të ndryshme por me qëllime të njëjta lidhur me dëshirat dhe kujdesin dentar të pacientit. Në ortodonci zgjidhjet mund të jenë me metoda dhe aplikime të ndryshme por me përfundim arritjen sa më të saktë të rezultatit.
Rezultate: Vlerësimi i materialeve diagnostike dhe rezultatet e trajtimeve na ndihmojnë disa analiza trajtimesh për të njëjtin rast, ku secili mjek analizon dhe paraqet një model të gjykimit të tij duke dhënë rezultatet e dëshiruara si nga ana e mjekut dhe e pacientit.
Konkluzione: Në përfundim është vënë re nuk ka asnjë ndryshim statistikor nëse pacienti është trajtuar me ekstraksione apo me aparate për të aplikuar forca funksionale apo biomekanike për sa kohë arrihet një rezultat korrekt dhe i kënaqshëm për pacientin dhe mjekun. Në këto raste "borderline" është e rëndësishme një dakortësi midis personave pjesëmarrës.
Rekomandime: Për të arritur në një përfundim sa më pranë kërkesave të pacientit dhe punimit ortodontik, rekomandohet analiza e kujdesshme e modeleve, cefalometrike, e indeve periorale dhe funksionale të pacientit, duke u koreluar me guidat dhe studimet të mëparshme lidhur me raste në diskutim.

Fjalë kyçe: aparate funksionale, pendulum, zgjerues i shpejtë, ortodonci fikse, hark lingual panoramex, cefalometri, analiza modelesh.

KOMPLIKACIONET E INFEKSIONEVE TË RËNDA ODONTOGJENE.

Dr. Gresa Baboçi, Dr. Shk. Andis Qendro
Kirurgë Oralë dhe Maksilofacialë – QSUT "Nënë Tereza", Tiranë
Pedagogë – Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Abstrakt
Termi infeksion odontogjen i referohet një infeksioni që merr origjinën nga dhëmbi ose në indet rrethuese. Infeksioni i përmendur më pas përparon përgjatë periodontiumit deri në apeks, duke përfshirë kockën periapike dhe nga kjo zonë, më pas përhapet përmes kockës dhe periosteumit drejt strukturave të afërta ose në distancë. Rëndësia e këtij lloj infeksioni qëndron në atë se mund të shkaktojë infeksione që dëmtojnë strukturat më të largëta nëpërmjet përhapjes direkte dhe përhapjes në distancë. Faktorët që ndikojnë në përhapjen e infeksionit varen nga ekuilibri midis kushteve që lidhen me pacientin dhe karakteristikave që lidhen me mikroorganizmat. Gjendjet që lidhen me pacientin përfshijnë disa faktorë sistemikë që përcaktojnë rezistencën dhe përgjigjen imunitare, e cila mund të dëmtohet në situata të tilla si sindroma e imunodeficiencës ose në diabetin mellitus, si dhe faktorë lokalë që gjithashtu do të ushtrojnë ndikimin e tyre në përhapjen e infeksionit. Infeksionet kërcënuese për jetën me origjinë odontogjene ose të rrugëve të sipërme të frymëmarrjes mund të shtrihen në hapësirat e formuara nga planet e fascieve të zonës së poshtme të kokës dhe të sipërme të qafës. Komplikacionet e rënda përfshijnë bllokimin e rrugëve të frymëmarrjes, mediastinitin, fascitin nekrotizant, trombozën e sinusit kavernoz, sepsis, abscesin orbital, osteomielitin, etj. Incidenca e këtyre infeksioneve është ulur shumë nga terapia moderne me antibiotikë. Megjithatë, edhe pse të rralla, këto infeksione mund të hasen ndaj duhen menaxhuar me prioritetin de qasjet e duhura.

Fjalë kyçe: infeksione odontogjene, komplikacione cervikofaciale, obstruksion i rrugëve të frymëmarrjes, mediastinit, trombozë e sinusit kavernoz, sepsis, kirurgji maksilofaciale emergjente.

PROTETIKA FIKSE DHE SHËNDETI PERIODONTAL.

Grisela Fico[1], Marjeta Fico.
Klinikë Dentare"FICO Dental", Tiranë.
Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Abstrakt
Hyrje: Protetika fikse është ndër disiplinat më dominante të protetikës. Me rritjen e standarteve te jetesës, kulturës dhe informimit shëndetësor të pacientëve tanë, të shumtë jane ata që i drejtohen mjekut stomatolog me kërkesë protezimi fiks.

Objektivi: Sot protezimi fiks gjen përdorim të shpeshtë jo me vetëm për të zëvendësuar dhëmbët që mungojnë, por me pritshmëri te shtuar për një rehabiltim estetik të denticionit. Kjo na motivon të jemi gjithmonë në kërkim / studim të mini / invazivitetit procedurial, ruajtjes së integritetit te indeve të shëndetshme, dhe biokompatibilitetit të materialeve përdorur në protetikën fikse.
Materiale dhe Metoda: Rishikim sistematik i korrelacionit protezim / periodont.
Konkluzioni: Protetika fikse ka ndikim në ruajtjen apo cënimin e integritetit periodontal, vecanërisht me rëndesi mënyra e preparimit dhe lokalizimi i skajit marginal.

Fjalë kyçe: protetikë, kurorë fikse, periodont.

PREVALENCA E KARIESIT TË MOLARËVE TË PARË TË PËRHERSHËM TEK FËMIJËT E MOSHËS 6 - 7 VJEC.

Msc. Griselda Blloshmi

Abstrakt
Hyrje: Kariesi dentar është një sëmundje infektive më e përhapur sidomos në fëmijët e moshës 6 - 7 vjeçare e cila lidhet me shumë faktorë, vecantërisht me shfaqjen në kavitetin oral të bakterit streptokok**.**
Qëllimi: Qëllimi i punimit është të përcaktohet prevalenca e kariesit të molarëve të përhershëm tek fëmijët e moshës 6 - 7 vjec**.**
Materiali dhe metoda: Materiali është marrë direkt nga ekzaminimi klinik i 102 fëmijëve dhe është analizuar sipas gjinisë, erupsionit të dhëmbëve, kariesit dhe ekstraksioneve**.**
Metoda e analizës është në mënyrë retrospektive.
Rezultate: Nga të gjithë molarët e parë permanent të ekzaminuar të eruptuar te vajzat 75, 95% dhe te djemtë 72, 76%. Indexi i prevalencës 30, 43% për vajzat dhe 48, 21% për djemtë. DMFT për vajzat është 60% dhe për djemtë 78%. DMFS për vajzat është 69% dhe për djemtë 89%.
Konkluzione: Në 102 femijë 2 / 3 e të gjithë molarëve të parë permanent kanë eruptuar. Mbi 90% e femijëve të moshës 6 - 7 vjecare kanë të paktën 1 molar të përhershëm me karies**.**

Fjalë kyçe: Kariesi, molar permanent**.**

MARRËDHËNIA MIDIS ORTODONCISË DHE PERIODONTOLOGJISË: NJË QASJE NDËRDISIPLINORE PËR REZULTATE OPTIMALE TË TRAJTIMIT.

Phd. Dds. Ms. Fiadfe. Gurien Demiraqi, Phd. Dds. Edlira Baruti, Ms. Eriola Noçka, Dr. Ervin Sulaj

Abstrakt
Hyrje: Ortodoncia dhe periodontologjia janë dy komponentë thelbësorë të stomatologjisë bashkëkohore që kërkojnë angazhim bashkëpunues për të siguruar suksesin afatgjatë të procedurave dentare. Ky prezantim synon të shqyrtojë lidhjet funksionale dhe biologjike midis këtyre dy fushave, duke u përqendruar në ndikimin e ndërhyrjeve ortodontike në indet periodontale dhe rolin kritik të shëndetit periodontal në planifikimin e trajtimit ortodontik. Gjatë gjithë leksionit, ne do të vlerësojmë faktorët kryesorë të rrezikut që lidhen me lëvizjen ortodontike tek pacientët me probleme periodontale, strategjitë për menaxhimin e inflamacionit dhe rëndësinë e ruajtjes së higjienës së duhur orale. Ne gjithashtu do të nënvizojmë rëndësinë e një partneriteti të ngushtë midis ortodontëve dhe periodontologëve gjatë fazave diagnostikuese, planifikimit dhe ndjekjes klinike për të shmangur komplikime të tilla si rezorbimi alveolar, recesioni gingival dhe migrimi patologjik i dhëmbëve. Duke përdorur raste klinike ilustruese dhe kërkimet më të fundit shkencore, ky leksion synon të ofrojë një qasje holistike që përmirëson jo vetëm rezultatet estetike dhe efikasitetin funksional, por gjithashtu ruan integritetin biologjik të strukturave mbështetëse dentare.

Fjalë kyçe: ortodont, periodont, stomatologji, higjenë dentare etj.

MALOKLUZIONI I KLASËS II, KOHA E TRAJTIMIT.

Ilda Gribizi, Elona Kongo, Beatrice Manes Gravina
Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Specializimi Afatgjatë në Ortognatodonci Albanian University, Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Malokluzioni i klasës II është një nga anomalitë ortodontike më të shpeshta, i karakterizuar nga një mospërputhje skeletore në drejtimin anteroposterior që mund të ndikojë negativisht në estetikën e fytyrës, funksionin okluzal dhe stabilitetin afatgjatë. Megjithëse ekzistojnë disa modalitete trajtimi, përcaktimi i kohës optimale të ndërhyrjes mbetet çështje debati, veçanërisht në lidhje me përfitimet skeletore krahasuar me kompensimin dentar.

Objektivi: Qëllimi i këtij studimi ishte vlerësimi i ndikimit të kohës së trajtimit mbi rezultatet skeletore dhe dentoalveolare te pacientët me malokluzion të klasës II, të trajtuar në faza të ndryshme të rritjes kraniofaciale.

Materiale dhe Metoda: U realizua një vlerësim krahasues mbi pacientët me malokluzion të klasës II të konfirmuar, të cilët iu nënshtruan trajtimit gjatë tre fazave të rritjes: denticion i përzier i hershëm (7–9 vjeç), denticion i përzier i vonshëm (10–12 vjeç) dhe denticion i përhershëm (13–16 vjeç). Modalitetet e trajtimit përfshinin aparate funksionale dhe aparatura fikse ortodontike si edhe clear aligners. Ndryshimet skeletore dhe dentare u vlerësuan përmes grafive laterale, modeleve të studimit dhe regjistrimeve klinike të standardizuara. Rezultatet u analizuan në lidhje me korrigjimin sagital, ndryshimet në dimensionin vertikal dhe stabilitetin afatgjatë.

Rezultate: Trajtimi në denticionin e përzier të hershëm favorizoi ndryshime skeletore domethënëse, veçanërisht avancimin mandibular dhe kufizimin e rritjes së maksilës. Ndërhyrjet gjatë denticionit të përzier të vonshëm ofruan balancën më të mirë midis modifikimeve skeletore dhe korrigjimeve dentare, me parashikueshmëri më të lartë dhe shkallë më të ulët të ritrajtimeve. Trajtimi i nisur në denticionin e përhershëm tregoi kryesisht kompensim dentoalveolar, me potencial të kufizuar për përmirësim skeletor. Në të gjitha grupet, pajtueshmëria e pacientit me aparate të heqshme dhe potenciali i mbetur i rritjes u identifikuan si faktorë kyç për efektivitetin e trajtimit.

Përfundime: Koha e trajtimit të malokluzionit të klasës II ndikon ndjeshëm në rezultatet terapeutike. Ndërhyrja e hershme mund të shfrytëzojë rritjen për korrigjim skeletor, por shoqërohet me rrezik më të madh të trajtimeve të dyta dhe stabilitet të ndryshueshëm. Denticioni i përzier i vonshëm paraqet një dritare optimale terapeutike, duke kombinuar adaptueshmërinë skeletore me shkallë më të ulët të ritrajtimeve. Trajtimi në denticionin e përhershëm mbetet i efektshëm për kamuflazh dentar, por i kufizuar në korrigjimin skeletor. Diagnoza e individualizuar, vlerësimi i rritjes dhe pajtueshmëria e pacientit duhet të udhëheqin zgjedhjen e kohës së trajtimit për rezultate afatgjata optimale.

Fjalë kyçe: malokluzioni i klasës II, koha e trajtimit, aparate funksionale, denticion i përzier, denticion i përhershëm, stabiliteti ortodontik.

NDIKIMI I SËMUNDJEVE AUTOIMUNE NË SHËNDETIN ORAL.

Dr. Ilir Muqaku

Abstrakt

Hyrja: Sëmundjet autoimune përbëjnë një grup patologjish kronike ku sistemi imunitar i organizmit sulmon indet e veta, duke shkaktuar dëmtime sistemike dhe lokale. Ndikimi i tyre në shëndetin oral është i rëndësishëm, pasi shumë prej këtyre sëmundjeve shfaqen me manifestime në mukozën orale, gjëndrat e pështymës dhe indet përreth dhëmbëve. Ndër to përfshihen Lupusi Eritematoz Sistemik, Sindroma Sjögren, Lichen planus oral dhe Pemfigusi, të cilat mund të çojnë në ulceracione, kserostomi, inflamacion gingival dhe çrregullime në shërimin e plagëve.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të analizojë ndikimin e sëmundjeve autoimune në shëndetin oral, të identifikojë manifestimet klinike më të shpeshta dhe të theksojë rëndësinë e diagnostikimit të hershëm dhe menaxhimit të duhur stomatologjik tek këta pacientë.

Metodologjia: Punimi bazohet në rishikimin e literaturës shkencore të publikuar në vitet e fundit, si dhe në analizën e rasteve klinike të vëzhguara gjatë praktikës profesionale. Janë shqyrtuar burime të besueshme

shkencore që trajtojnë lidhjen midis patologjive autoimune dhe manifestimeve orale, me fokus në simptomat, ndryshimet histopatologjike dhe qasjet terapeutike.
Rezultate: Nga analizimi i literaturës rezulton se sëmundjet autoimune kanë ndikim të konsiderueshëm në shëndetin oral. Manifestimet më të zakonshme përfshijnë gojën e thatë (kserostominë), ulceracionet mukozale, eritemën dhe ndjeshmërinë gingivale. Këto ndryshime ndikojnë negativisht në cilësinë e jetës së pacientëve dhe kërkojnë kujdes të posaçëm në trajtimin dentar. Vlerësohet se bashkëpunimi ndërmjet stomatologëve dhe mjekëve specialistë është thelbësor për diagnostikimin dhe menaxhimin efektiv të pacientëve me sëmundje autoimune.
Përfundime: Sëmundjet autoimune paraqesin sfida të rëndësishme në praktikën stomatologjike, për shkak të kompleksitetit të manifestimeve dhe nevojës për trajtim të kujdesshëm. Njohja e hershme e shenjave orale dhe komunikimi i vazhdueshëm ndërdisiplinar janë çelësi për përmirësimin e shëndetit oral dhe të përgjithshëm të pacientëve. Edukimi i vazhdueshëm i profesionistëve shëndetësorë mbetet thelbësor për menaxhimin e duhur të këtyre patologjive.

Fjalë kyçe: semundje autoimune, eritematoz sistemik, sindroma Sjögren, Lichen planus oral dhe pemfigusi.

DIAGNOSTIKIMI ME INTELIGJENCË ARTIFICIALE PËR PATOLOGJITË ENDODONTIKE DHE PERIODONTALE.

Ilma Robo[1], Saimir Heta[2], Doris Mingomataj[3], Nebra Xhixha[3], Vera Ostreni[2]
[1] Universiteti i Mjekësisë, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Tiranë, Shqipëri
[2]Universiteti i Mjekësisë, Fakulteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri
[3] Albanian University, Fakulteti i Shkencave Dentare, Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt
Hyrje: Aplikimi i inteligjencës artificiale në stomatologji nuk është një e dhënë e paditur tashmë, parë edhe nga këndvështrimi që në disa prej specialiteteve të stomatologjisë janë kryer edhe ndërhyrje robotike për trajtimin e patologjive të ndryshme endo - periodontale. Duke qenë në përballje më këtë situatë, ky studim paraqet një tablo të përgjithshme mbi të dhënat në literaturën e botuar rreth aplikimit të inteligjencës artificiale në diagnostikim të patologjive të ndryshme endo apo periodontale.
Metodologjia: Studimi është i llojit review mbi artikujt e përzgjedhur në faqen PubMed, brenda fashës së tre viteve të fundit të botimit mbi aplikimin e inteligjencës artificiale në rastin e patologjive endo dhe periodontale. Nga totali i artikujve të përzgjedhur vihen re të dhëna interesante rreth indikacioneve të aplikimit të inteligjencës artificiale, rreth problematikave dhe arsyes së dëshirës së shtuar profesionale në aplikimin e inteligjencës artificiale kryesisht në fushën e diagnostikimit të patologjive të ndryshme endo edhe periodontale. Përballja e këtyre shifrave me sfidat e hasuara gjatë aplikimit aktual të inteligjencës artificiale kryesisht në diagnsotikim dhe relativisht pak në trajtim apo terapi mbështetëse, është një tjetër qëllim i këtit studimi, bashkëshoqërues i qëllimit primar të ditur të faktit se deri ku ka rezultuar e sukseshme inteligjenca arificiale me epërsitë e mjeteve të përdorura në reduktimin e kohës së diagnostikimit, në dedektimin e hershëm të patologjive orale, në reduktimin e gabimeve humane në diagnostikim apo në standartizimin si në diagnostikim, ashtu edhe në trajtim të patologjive endo dhe periodontale.
Konkluzione: Artikujt e përzgjedhur tregojnë vlera të ndryshme të saktësisë së aplikimi të inteligjencës artificiale në diagnostikimin e patologjive specifike si periodontit, karies, periodontit apikal, peri - implantit apo gingivit. Parë në këndvështrimin e ngjashmërive dhe ndasive në natyrën e sjelljes së këtyre patologjive dhe në mjetet e ndryshme të diagnostikimit të këtyre patologjive, vihet re shifra të ndryshme të saktësisë së aplikimit të inteligjencës artificiale në diagnostikimin e patologjive orale endo dhe periodontale.

Fjalë kyçe: Inteligjenca artificiale, dentistri, periodontit, karies, gingivit, periodontit apikal, standartizim, sfida klinike.

MIKROBIOTA ORALE DHE KARAKTERISTIKAT E SAJ.

Irida Cenolli[1], Sidrit Hoxha[2]
[1]Klinika Dentare Bluetooth [2]Klinika Dentare"Sident"

Abstrakt

Hyrje: Mikrobiotë orale quhet tërësia e mikroorganizmave që jetojnë, shumohen dhe vdesin në kavitetin oral. Janë rreth 20 bilion baktere që jetojnë në atë që e quajnë mjedisin e tyre, kavitetin oral. Ky është një komunitet që ndahet në bakteret bashkëshoqëruese (ose komensale), simbiotike (ose sinergjike) dhe patogjenike. Kjo mikrobiotë gjendet e lokalizuar kryesisht në sipërfaqen e gjuhës, gingivave, dhëmbëve dhe në biofilm që është një shtresë e përbërë nga polisaharide ku bakteret mbijetojnë në një gjendje të "mpirë" të rritjes së ngadaltë. Mikrobiota orale është përgjegjëse për të ruajtur homeostazën, mbrojtjen dhe parandalimin e sëmudjeve. Të gjithë njerëzit kanë të përbashkët mikrobiotën "bazë" dhe ajo që i bën të ndryshëm është mikobiota "variable" e cila është e ndryshme sipas fenotipit, genotipit te personit apo dhe mënyrës së jetesës. Janë mbi 700 lloje të ndryshme specie bakteresh duke përfshirë këtu dhe ato jobakteriale si dhe qelizat arkea, viruset, mykrat, protozoarët.

Objektiva: A dimë mjaftueshëm për mikrobiotën orale dhe çfarë përfaqëson ajo në vetvete? Si mund te ruajmë balancat e duhura që të kemi një shëndet jo vetëm oral por dhe sistemik?

Metodologjia: Janë zgjedhur artikuj të ndryshëm shkencorë në PubMed dhe Google Scholar që hedhin dritë mbi popullatën e mikroorganizmave që jetojnë në kavitetin oral.

Rezultate: Mikrobiota orale është një bashkësi mikroorganizmash që jetojnë në balancë në kushte të një higjene të mirë orale. Shëndeti i mikrobiotës orale është shumë i rëndësishm për shëndetin sistemik në tërësi. Mënyra e ushqyerjes dhe cilësia e ushqimit ndikojmë direkt në tipin dhe sasinë e baktereve që kolonizojnë gojën. Njohuritë në këtë fushë mund të nxisin pacientët që të bëhen më të përgjegjshëm për shëndetin e tyre jo vetëm oral.

Fjalë kyçe: mikrobiotë, baktere, kavitet oral, balancë, mykra.

TRAJTIMI MULTIDISIPLINAR I MALOKLUZIONEVE SKELETALE: INTEGRIMI I KIRURGJISË ORTOGNATIKE DHE ORTODONCISË.

Irina Isufi [1, 2] DMD MsC PhD, Algen Isufi [1, 2, 3] DMD PhD
[1]Universiteti Aldent, Tiranë Shqipëri
[2]Isufi Dental Clinic, Tiranë, Shqiperi
[3]Shërbimi i Kirurgjisë OMF, Qëndra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri

Abstrakti

Hyrje: Malokluzionet skeletale të moderuara dhe të rënda përbëjnë një problem kompleks funksional dhe estetik, që shpesh nuk mund të korrigjohet vetëm me trajtim ortodontik konvencional. Trajtimi ortodontik - kirurgjikal përfaqëson standardin e artë në menaxhimin e këtyre rasteve, duke integruar planifikimin tredimensional, kirurgjinë ortognatike dhe fazat ortodontike para dhe pas operacionit.

Materiale dhe Metoda: Ky është një studim kliniko - statistikor me natyrë përshkruese. U analizuan të dhëna klinike nga pacientë me malokluzione skeletale të diagnostikuar në saj të ekzaminimeve ortodontik, ekstra dhe intraorale, ekzaminimet radiologjike dhe analizat suplementare si ato cefalometrike, analizat e modeleve të studimit etj. Planifikimi i trajtimit u krye në saj të konsultës ndërdisiplinare, duke përcaktuar lëvizjet ortodontike dhe ato kirurgjikale optimale (osteotomi Le Fort I, BSSO dhe procedura të kombinuara bimaxilare). Ortodoncia preoperatore u fokusua në dekompensimin dentar, ndërsa ortodoncia post - kirurgjikale siguroi okluzionin final funksional dhe stabilitetin.

Rezultate: Trajtimi multidisiplinare solli përmirësime të ndjeshme në parametrat cefalometrikë (SNA, SNB, ANB, Wits,), estetikën faciale dhe funksionin stomatognatik. Pacientët raportuan përmirësim të ndjeshëm të cilësisë së jetës dhe funksionit mastikator. Vlerësimi i ndjekjes afatshkurtër dhe afatgjatë demonstroi stabilitet të kënaqshëm post - kirurgjikal, me recidiv minimal skeletal.

Konkluzione: Trajtimi ortodontik - kirurgjikal mbetet një qasje e bazuar në evidencë për menaxhimin e malokluzioneve skeletale. Ky bashkëpunim multidisiplinar është thelbësor për të arritur rezultate funksionale dhe estetike afatgjata.

Fjalë kyçe: malokluzion skeletal, kirurgji ortognatike, ortodonci kirurgjikale, planifikim digital, stabilitet post - kirurgjikal.

NDIKIMI I MODELEVE TË BASHKIMIT KONOMETRIK DHE CONE MORSE NË RUAJTJEN E KOCKËS PERI - IMPLANTARE.

Iris Alla

Abstrakt

Sfondi / Qëllimet: Lidhja midis implantit dhe abutmentit është propozuar për të rritur qëndrueshmërinë e lidhjes dhe për të reduktuar problemet biologjike dhe protetike. Qëllimi i këtij studimi ishte të vlerësohej ndikimi i këndit konik të bashkimit implant–abutment në humbjen kockore marginale dhe në komplikacionet mekanike.

Metodologjia: U krye një shqyrtim sistematik i literaturës duke përdorur bazat e të dhënave *PubMed / MEDLINE*, *EMBASE* dhe *Google Scholar*. Procesi i përzgjedhjes u zhvillua për të realizuar një sintezë përshkruese dhe për të kryer meta - analiza. Për krahasime u konsideruan kategoritë e mëposhtme: hekzagon i jashtëm (EI), hekzagon i brendshëm (HI), Cone Morse (CM) (<8° kënd kontakti) dhe bashkimi konometrik (>8° kënd kontakti). Për sintezën përshkruese të të dhënave u morën parasysh: madhësia e mostrës, prodhuesi i implantit, tipi i lidhjes protetike, komplikacionet protetike, humbja kockore marginale dhe rezultatet e studimit.

Rezultate: Nga gjithsej 4457 artikuj të shqyrtuar, 133 studime u përfshinë në sintezën përshkruese dhe 12 artikuj në analizën statistikore. Nuk u gjetën ndryshime të rëndësishme në humbjen kockore marginale kur u krahasua një kënd konik <8° me një kënd konik >8°.

Përfundime: Brenda kufijve të këtij studimi, ndërfaqja konike duket se prodhon humbje më të vogël kockore marginale krahasuar me lidhjen hekzagonale të jashtme dhe të brendshme. Nuk u gjetën ndryshime domethënëse midis këndit konik <8° dhe >8°.

Fjalë kyçe: humbje kockore marginale, implant dentar, abutment, komplikacione mekanike.

ZHVILLIMET NË MENAXHIMIN E DHIMBJES POSTOPERATORE NË KIRURGJINË ORALE: PROVAT KLINIKE.

Jakup Ahmeti[1], Rrona Huruglica[2]

[1]Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Departamenti i Stomatologjisë, Tetovë, Maqedonia e Veriut

[2]Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Stomatologjisë, Prishtinë, Kosovë

Abstrakt

Dhimbja pas operacionit është një pasojë e pashmangshme e procedurave kirurgjikale orale, duke ndikuar në rehati, rikuperim dhe kënaqësi të përgjithshme të pacientit. Historikisht, analgjezikët opioidë kanë dominuar strategjitë e menaxhimit të dhimbjes, gjë që ka shkaktuar shqetësime për efektet anësore, keqpërdorimin dhe krizën më të gjerë të opioidëve. Ky punim shqyrton peizazhin në zhvillim të menaxhimit të dhimbjes postoperatore në kirurgjinë orale, me fokus në tendencat bazuar në prova shkencore që synojnë optimizimin e kontrollit të dhimbjes duke minimizuar rreziqet. Tendencat kryesore përfshijnë përdorimin e gjerë të analgjezisë multimodale, integrimin e teknikave që zvogëlojnë përdorimin e opioidëve, përdorimin e agjentëve farmacologjikë të rinj si anestetikët lokal me veprim të zgjatur, dhe theksin në qasje parandalimi dhe të orientuara tek pacienti. Evidenca klinike mbështet fuqishëm këto ndryshime, duke treguar përmirësim të rezultateve të dhimbjes, konsum më të ulët të opioidëve, më pak efekte anësore dhe përvojë më të mirë të pacientit. Drejtimet e ardhshme nënvizojnë potencialin e menaxhimit të personalizuar të dhimbjes, teknikave të avancuara të anestezisë rajonale dhe ndërhyrjeve të shëndetit digjital për të përmirësuar më tej kujdesin postoperativ në kirurgjinë orale.

Fjalë kyçe: dhimbja postoperatore, kirurgjia orale, analgjezia multimodale, zvogëlimi i përdorimit të opioidëve, bupivacaine liposomal, anestezia rajonale, evidenca klinike.

DEKOMPRIMIMI, METODË MINIINVAIVE PËR TRAJTIMIN E KISTEVE.
Jakup Vrioni

Abstrakt
Kistet odontogjene ose jo, janë patologji të shpeshta të regjionit oro - maksilo - facial. Nisur nga madhësia, lokalizimi dhe agresiviteti, janë zgjedhur si mënyra trajtimi: kyretimi, enukleimi, rezeksioni dhe dekomprimimi. Sot kirugjia synon aplikimin e metodave minimale invasive. Dekomprimimi si e tillë, synon zvogëlimin e volumit të lezionit kistik duke shmangur frakturat që mund të ndodhin gjatë ndërhyrjes dhe duke ruajtur strukturat anatomike fqinje. Kjo metodë mund të çojë deri në regres të plotë të lezionit kistik. Nëse jo, enukleimi sekondar kryhet në kushte të përmirësuara: volum i reduktuar kistik, epitel më i trashë për të shkolitur, risk më i vogël për të dëmtuar strukturat anatomike fqinje dhe risk më i ulur për rekurencën e lezionit. Megjithatë follow - up - et duhet të jenë të rregullta. Më poshtë paraqitet rasti i një kisti menaxhuar përmes dekomprimimit.

Fjalë kyçe: kiste, odontogjene, regjioni oro - maksilo - facia, lezione, epitel, rezeksion.

MENAXHIMI KIRURGJIKAL I NJË RANULE - MUKOCELË E LABISË SË POSHTME TE NJË PACIENTE SHTATZËNË.
Bunjamin Xhaferi[1, 4], Jeton Neziri[1, 3], Ruhide Azemi Neziri[2, 3], Xhejlane Xhaferi[1], Betim Abdurahmani[3]
[1]Departamenti i Kirurgisë Orale, Fakulteti i Stomatologjisë, Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" - Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
[2]Klinika Universitare për Gjinekologji dhe Obstetrikë, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
[3]Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Republika e Maqedonisë së Veriut
[4]Universiteti MIT, Fakulteti i Stomatologjisë, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Abstrakt
Ranula, e quajtur edhe si mukocelë e buzës së poshtme paraqitet si një lezion i madh, i mbushur me mukus dhe zakonisht rezulton nga lëndimi traumatik ose bllokimi i gjëndrave të vogla të pështymës. Në këtë raport rasti, ne kemi përshkruar menaxhimin klinik të një pacienteje njëzet e një vjeçare, shtatzënë për herë të parë, e cila zhvilloi një mukocele labiale të poshtme, të shkaktuar nga një dëmtim traumatik i lokalizuar dhe i përkeqësuar nga statusi hormonal gjatë shtatzënisë. Pacientja gëzonte shëndet të plotë dhe nuk kishte marrë ilaçe gjatë shtatzënisë. Gjatë ekzaminimit klinik, u vu re një lezion i mukozës së buzës së poshtme, fluktuant në palpim dhe transparent në dukje. Trajtimi përfshiu termokauterizimin si dhe heqjen e plotë të indit cistik dhe elementëve gjëndrorë shoqërues. Vendimi për trajtim kirurgjikal u mor për shkak të madhësisë së lezionit, rekurencës dhe simptomeve. Procedura u realizua me anestezi lokale. Pas operacionit, u administrua profilaksë me antibiotikë fenoksimetilpenicilinë. Përveç kësaj, u rekomandua xhel gingival NBF për shërimin dhe minimizimin e inflamacionit të mukozës. Ky rast klinik thekson rolin vendimtar të një trajtimi gjithëpërfshirës kirurgjikal të mukoceleve, veçanërisht tek gratë shtatzëna, ku ndryshimet hormonale mund të përshpejtojnë zhvillimin e lezionit. Për shërim të plotë, trajtimi përfshin teknikën e kombinuar, e cila ka rezultuar të jetë efektive dhe e sigurtë.

Fjalë kyçe: ranula, trajtim kirurgjik, paciente shtatzënë, trauma, hormone.

PERFORMANCA KLINIKE E TRAJTIMEVE ORTODONTIKE ME SISTEMIN SELF - LIGATING.
Jolanda Taga
Ortodonte

Abstrakt
Hyrje: Në këtë punim paraqiten disa raste klinike që janë trajtuar me sistemin e fërkimit të reduktuar në ortodonci. Synimi kryesor është arritja e një rezultati sa më estetik dhe funksional, pa pasur nevojë për ekstraksione të dhëmbëve të përhershëm. Kjo arrihet përmes shkurtimit të kohës së trajtimit, reduktimit të vizitave në kabinetin dentar dhe përmirësimit të efikasitetit të përgjithshëm të trajtimit ortodontik.

Metoda: Janë analizuar disa raste të trajtuara me sistemin self - ligating, i cili mundëson korrigjimin e anomalive dentare në një periudhë më të shkurtër kohore, me më pak diskomfort për pacientin dhe me produktivitet më të lartë. Ky sistem përdor braketa vetëlidhëse, të cilat eliminojnë nevojën për lidhje elastike apo metalike, duke ulur ndjeshëm fërkimin dhe përmirësuar efikasitetin e lëvizjes dentare. Kjo metodë kontribuon gjithashtu në ruajtjen e estetikës së fytyrës dhe shmang shpesh nevojën për zgjerues ose ekstraksione.
Rezultate: Eliminimi i lidhjeve elastike ndihmon në uljen e mbledhjes së pllakës bakteriale dhe e bën më të lehtë mirëmbajtjen e higjienës orale gjatë trajtimit. Përdorimi i braketave vetëlidhëse ka treguar rezultate shumë të mira estetike dhe funksionale, me më pak shqetësime për pacientin dhe me kohë trajtimi dukshëm më të shkurtër.
Përfundime: Sistemi self - ligating përfaqëson një hap përpara në ortodoncinë bashkëkohore. Edhe pse teknikat klasike vazhdojnë të përdoren gjerësisht për shkak të kostos më të ulët dhe përvojës më të madhe të ortodontëve, avantazhet e sistemit self - ligating — si efikasiteti i lartë, higjiena më e mirë dhe komoditeti i shtuar — e bëjnë këtë metodë një nga opsionet më të avancuara dhe efektive në trajtimet ortodontike moderne.

Fjalë kyçe: trajtim, pacient, ortodont.

EFEKTI I ER: YAG LASERIT ME DY MODALITETE TË PULSIT NË FORCËN E LIDHJES SË BRAKETAVE ORTODONTIKE.

Kaltrina Aliu[1]*, Tine Malgaj[2], Miranda Stavileci[1], Fisnik Aliu[1]
[1] Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti i Mjekësisë, Prishtinë, Kosovë
[2] Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Ljubljanës, Sloveni.

Abstrakt
Demineralizimi i smaltit të dhëmbëve me Er: YAG është studiuar si një metodë e re dhe alternative ndaj brejtjsë konvencionale me acid. Qëllimi i këtij studimi in vitro është krahasimi i forcës së lidhjes (SBS) së breketave ortodontike me smaltin e dhëmbëve të demineralizuar me acid dhe me Er: YAG laser me dy modalitete të pulsit. Janë testuar paramolarë human (n=30) të ekstraktuar për shkaqe ortodontike. Mostrat janë ndarë në mënyrë rastësore në 5 grupe sipas mënyrës së demineralizimit. Në grupin 1 është bërë brejtja e smaltit me acid fosforik 37% për 30 s, në grupin 2 me Er: YAG laser (SSP, 90 µs) për 15 s, grupin 3 me Er: YAG laser (SSP, 90 µs) për 10 s + acid fosforik 37% për 30 s, grupin 4 me Er: YAG laser në modalitet QSP (600 µs), për 15 s dhe grupin 5 me Er: YAG laser në modalitet QSP (600 µs) për 10 s, + acid fosforik 37% për 30 s. Të gjitha mostrat i janë nënshtruar 12000 cikleve të termociklimit. Për vlerësimin e forcës së lidhjes në mes të braketës dhe smaltit është përdorur makina testuese - Quasar 2, 5. Nga grupet eksperimentale, grupi 3 tregoi forcë lidhëse mesatare më të lartë (12. 85 ± 6. 97 MPa) krahasuar me grupin kontrolllues (11. 74 ± 3. 53 MPa). Rezultatet e ANOVA njëanësore treguan se nuk ka dallim statistikor sinjifikant ndërmjet grupeve (F = 0. 305, p = 0. 872).

Fjalë kyçe: Breketa, brejtja me acid, Er: YAG Laser, forca e lidhjes.

LAMBOT DHE PËRDORIMI I TYRE NË STOMATOLOGJI DHE KIRURGJINË MAKSILOFACIALE.

Kanita Hoxha, Erik Musliu, Dea Likaj
Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca", Fakulteti i Stomatologjisë, Prishtinë, Kosovë.

Abstrakt
Hyrje: Lambot (flap - et kirurgjikale) përfaqësojnë një komponent thelbësor në kirurgjinë orale, periodontale dhe maksilofaciale, duke mundësuar qasje të kontrolluar në strukturat nënmukozale për trajtim, rigjenerim ose heqje të indeve patologjike. Qëllimi i këtij punimi është të paraqesë llojet kryesore të lambove, indikacionet e tyre, si dhe rëndësinë klinike në procedurat stomatologjike dhe rekonstruktive.
Metodologjia: Metodat përfshijnë rishikimin e literaturës mbi lambot mukoperiostale dhe modifikimet e tyre në kirurgjinë endodontike, periodontale, implantologjike dhe maksilofaciale, me fokus të veçantë në përdorimin e lambove pas heqjes së karcinomave të fytyrës.

Rezultate: Rezultatet tregojnë se zgjedhja e duhur e llojit dhe dizajnit të lambos është vendimtare për rigjenerimin e suksesshëm të indeve, reduktimin e komplikimeve post - operatore dhe ruajtjen e funksionit e estetikës së fytyrës. Në rastet onkologjike, lambot lokale dhe rajonale ofrojnë mbulim të menjëhershëm të defekteve, duke përmirësuar cilësinë e jetës së pacientit.
Përfundime: Në përfundim, përdorimi i lambove në stomatologji dhe kirurgjinë maksilofaciale përbën një element të pazëvendësueshëm të praktikës moderne, ku kombinimi i njohurive anatomike dhe aftësive kirurgjikale përcakton suksesin terapeutik dhe estetik.

Fjalë kyçe: lambot, kirurgji orale, periodontologji, implantologji, karcinoma, kirurgji maksilofaciale.

SHKALLA E EKSPOZIMIT TË HERSHËM DHE EKSPOZIMI VERTIKAL I KOCKËS ME RRJETË TITANIUM "MESH" NË RIGJENERIMIN E KOCKËS MAKSILARE: RISHIKIM SISTEMATIK DHE META - ANALIZË.

Dr. Klea Gjergji
Mjeke Ordinatore Ksu

Abstrakt
Qëllimi: Ky studim synon të vlerësojë efektivitetin e rrjetës së titanit në rigjenerimin e kockës maksilare, duke u fokusuar në shkallën e ekspozimit të hershëm dhe ekspozimin vertikal të kockës (VBG). Objektivi kryesor është të krahasohen rezultatet e teknikave me rrjetë titani me metodat e tjera të rigjenerimit të drejtuar të kockës (GBR) dhe të identifikohen strategjitë më efikase për reduktimin e incidencës së ekspozimit të hershëm.
Materiale dhe Metoda: U krye një rishikim sistematik dhe meta - analizë në përputhje me udhëzimet PRISMA. U kërkuan studime relevante në bazat e të dhënave PubMed / MEDLINE, EMBASE dhe Google Scholar. Në analizë u përfshinë vetëm studime klinike që raportonin vlerat e fitimit vertikal të kockës dhe shkallën e ekspozimit të rrjetës së titanit. Nga çdo studim u ekstraktuan të dhënat mbi dizajnin, teknikën rigjenerative, madhësinë e mostrës, gjetjet klinike dhe periudhën e ndjekjes. Analizat statistikore u përdorën për të krahasuar VBG dhe normat e ekspozimit midis teknikave të ndryshme kirurgjikale.
Rezultate: Rezultatet treguan se përdorimi i rrjetës së titanit siguron fitim të lartë vertikal të kockës pas periudhës së shërimit. Nuk u vërejtën dallime domethënëse midis rrjetës së titanit dhe metodave të tjera GBR në aspektin e fitimit të kockës, por përdorimi i flapit lingual të avancuar koronalisht reduktoi ndjeshëm shkallën e ekspozimit të hershëm në krahasim me grupet e kontrollit. Këto gjetje mbështesin përdorimin e rrjetës së titanit si një zgjidhje të qëndrueshme dhe efektive për rigjenerimin vertikal të kockës, veçanërisht kur menaxhimi i flapit kirurgjikal kryhet me kujdes optimal.
Përfundime: Rrjeta e titanit përbën një metodë të efektshme për rigjenerimin e kockës maksilare, duke ofruar fitim të konsiderueshëm vertikal të kockës. Megjithatë, shkalla e ekspozimit të hershëm mund të minimizohet përmes teknikave të përsosura të menaxhimit pasiv të flapit. Nevojiten studime klinike shtesë për të standardizuar protokollet kirurgjikale dhe për të përmirësuar suksesin afatgjatë të trajtimit.

Fjalë kyçe: rigjenerim kockor, rrjetë titani, defekte të nofullës, rigjenerim vertikal i kockës.

HEMOSTATIKËT LOKAL BIOLOGJIK, LLOJET DHE INDIKACIONET PËR PËRDORIMIN E TYRE.

Krenar Gashi, Erna Zeqiri
Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

Abstrakt
Hemostaza paraqet një proces thelbësor fiziologjik që ruan ekuilibrin midis rrjedhjes së lirshme të gjakut dhe aftësisë për të parandaluar hemorragjinë përmes formimit të koagulumit. Ky punim ka për qëllim të analizojë përdorimin e hemostatikëve lokal biologjik si metoda efektive në menaxhimin e gjakderdhjeve intraorale dhe kirurgjikale, duke theksuar avantazhet, kufizimet dhe indikacionet e tyre kryesore. Rëndësia e studimit qëndron në faktin se këto preparate, të bazuara në komponentë natyralë si trombina dhe fibrina, jo vetëm që kontribuojnë në kontrollin e gjakderdhjes por edhe reduktojnë komplikimet postoperative. Metodologjia e punimit është e

bazuar në rishikimin e literaturës ndërkombëtare dhe analizimin e rasteve klinike mbi përdorimin e preparateve biologjike. Gjetjet sugjerojnë se hemostatikët lokal biologjik sigurojnë një koagulim më të shpejtë dhe stabël, janë të lehtë për aplikim dhe të përshtatshëm për pacientë me çrregullime të koagulimit, megjithëse përdorimi i tyre kufizohet nga çmimi i lartë, jetëgjatësia e shkurtër dhe rreziku potencial i bartjes së infeksioneve. Studimi përfundon duke nënvizuar rëndësinë e integrimit të hemostatikëve biologjikë në stomatologjinë kirurgjikale moderne si pjesë e protokolleve standarde për menaxhimin e gjakderdhjeve. Rekomandohet përdorimi i tyre në mënyrë të targetuar, në bazë të indikacioneve specifike klinike, si dhe zhvillimi i mëtejshëm i alternativave biosintetike që reduktojnë rreziqet e bartjes së sëmundjeve.

Fjalë kyçe: Hemostaza, gjakderdhja, hemostatikët lokal biologjik, trombina, fibrina.

FENOMENI I ALERGJISË NGA REZINA DHE NGACMIMET MUKOZALE NË TË PROTEZUARIT ME PROTEZA TË LËVIZSHME.

Laura Alili, Endrit Paparisto, Tedi Vercani, Edlira Mulo
Universiteti Mjekësisë Tiranë, Fakulteti i Mjekësisë Dentare.

Abstrakt
Hyrje: Alergjia nga rezina e protezave është një fenomen që krijon problematika gjatë proetzimit të pacientëve me proteza të lëvizshme. Alergjia lidhet me hipersensibilitetin ndaj materialit akrilik të bazës së protezës. Shkaku është reaksioni imunologjik ndaj një komponenti të rezinës (zakonisht monomeri i metil - metakrilatit, por edhe pigmentet apo substancat ndihmëse). Mund të ndodhë edhe kur rezina është polimerizuar mirë, tek individët me ndjeshmëri të lartë.
Qëllimi: Studimi dhe krahasimi ndërmjet alergjisë dhe ngacmimeve të mukozës në pacientë me proetza të lëvizshme.
Materiali dhe metoda: Është bërë studimi llojit te reagimit, i cili është një reaksion alergjik i tipit IV (hipersensibilitet i vonuar), i ngjashëm me dermatitin e kontaktit. Shenjat klinike janë eritemë (skuqje) difuze e mukozës nën protezë, djegie, kruarje, ndjesi pickimi, mukozë e thatë dhe me çarje. Në raste më të rënda: ulcera të vogla ose edemë. Diagnostikimi bëhet me test patch (test alergjik i lëkurës) ndaj monomerëve akrilikë. Përjashtohen shkaqe të tjera (trauma mekanike, higjienë e dobët, kandidiaza). Trajtimi: konsiston në heqje të përkohshme të protezës, zëvendësim me rezina hipoalergjike (p. sh. akrilate të polimerizuara nën presion të lartë ose rezina termoplastike pa monomer të lirë), përdorim i kortikosteroideve lokale në rastet e rënda. Ngacmimi (iritacioni) nga monomeri i rezinës ka si shkak monomerin e papolimerizuar që mbetet në protezë për shkak të polimerizimit jo të plotë (temperaturë, kohë ose përzierje e gabuar). Pra, nuk është reagim alergjik, por efekt toksik kimik lokal. Lloji i reagimit është reaksion toksi - irritativ, jo imunologjik. Shenjat klinike janë djegie e menjëhershme në momentin që proteza vendoset, eritemë e kufizuar në zonat e kontaktit të drejtpërdrejtë, nuk ka kruarje të fortë si te alergjia. Simptomat qetësohen shpejt pasi proteza hiqet ose lahet mirë. Diagnostikimi: bazuar në kohën e shfaqjes (menjëherë pas vendosjes së protezës së re), Përmirësim i menjëhershëm pas ripolimerizimit ose larjes së gjatë të protezës në ujë të ngrohtë. Trajtimi: Ripolimerizim ose ribazim bazës së protezës, lënie e protezës në ujë për 24 - 48 orë për të nxjerrë monomerin e mbetur, edukimi i laboratorit për ciklin e saktë të polimerizimit.
Konkluzione: Alergjia nga rezina e protezës është shumë e rrallë dhe shkaktohet nga ngjyruesi i rezinës. Përgatitja e protezave duke respektuar rigorozisht kërkesat teknologjike të polimerizimit është domosdoshmëri dhe parandalon lindjen e alergjisë ose irritimit nga monomeri në shumicën e pacientëve edhe patch - test pozitiv.

Fjalë kyçe: rezinë, prurit, reaksion alergjik, hipersensibilitet, monomer, proteza.

TEKNIKA E PËRGATITJES E ORIENTUAR BIOLOGJIKISHT (BOPT): RINDËRTIMI I MARRËDHËNIES MIDIS PËRGATITJES SË DHËMBIT, INDEVE MBËSHTETËSE DHE ESTETIKËS SË BUZËQESHJES.

Msc, Spec. Laureta Peposhi; Prof. Dr. Edit Xhajanka

Abstrakt

Biologically Oriented Preparation Technique (BOPT) paraqet një koncept të avancuar në protetike dhe periodontologji, duke tejkaluar kufizimet e përgatitjeve tradicionale me vijë përfundimi. Përgatitja vertikale, e kombinuar me menaxhimin e kontrolluar të provizorëve, krijon kushte optimale për modulimin e indeve marginale dhe stabilizimin afatgjatë të arkitekturës gingivale. Ky proces nuk synon vetëm rikonstruksionin protetik funksional, por mbi të gjitha garantimin e një rezultati estetik të qëndrueshëm. Element kyç i qasjes BOPT është koncepti i "gjerësisë biologjike horizontale", i cili, së bashku me përcaktimin dhe modulimin e profilit të emergjencës, mundëson transformimin e biotipit gingival dhe parandalimin e recesionit peri - restaurues. Përgatitja ekstrakoronale e dhëmbit i jep klinicistit fleksibilitet të plotë volumetrik, duke shmangur kufizimet statike të përgatitjeve intrakoronale. Evidenca klinike afatgjatë demonstron se kjo metodologji siguron stabilitet peri - restaurues, simetri të konturеve gingivale dhe një integrim estetik superior në krahasim me teknikat tradicionale. BOPT duhet konsideruar si një qasje fondamentale për rehabilitimin modern protetik dhe implantologjik, duke rikonfiguruar marrëdhënien midis përgatitjes dentare, indeve suportive dhe estetikës së buzëqeshjes.

Fjalë kyçe: BOPT, përgatitje vertikale, gjerësi biologjike horizontale, profil emergjence, stabilitet peri - restaurues, estetika protetike, periodontologji.

NDIKIMI I FAKTORËVE PROTETIKË NË SUKSESIN AFATGJATË TË IMPLANTEVE DENTARE.

Lediona Mere

Abstrakt

Hyrje: Zëvendësimi i dhëmbëve të munguar me proteza fikse ose të lëvizshme të mbështetura në implante paraqet një nga zgjidhjet më të suksesshme në rehabilitimin oral. Vendimmarrja klinike ndërmjet këtyre dy llojeve të restaurimeve varet nga faktorë të shumtë, duke përfshirë kushtet anatomike, kërkesat estetike, faktorët ekonomikë dhe preferencat individuale të pacientit. Dështimet protetike jo vetëm që cënojnë funksionalitetin dhe estetikën, por mund të çojnë edhe në humbjen e implantit dhe dështimin e të gjithë rehabilitimit. Studimet e deritanishme kanë identifikuar disa faktorë rreziku që ndikojnë negativisht në ecurinë e implanteve, përfshirë cilësinë dhe sasinë e kockës alveolare, pozicionin dhe dimensionet e implantit, si dhe procedurat e augmentimit. Gjithashtu, kushte sistemike si diabeti mellitus dhe faktorë të jashtëm si pirja e duhanit janë lidhur me rritjen e incidencës së komplikimeve (Bornstein, Cionca, & Mombelli, 2009; Palma - Carrió et al. , 2011).

Metodologjia: U realizua një rishikim i literaturës bashkëkohore në lidhje me ndërlikimet protetike të lidhura me implantet dentare, duke analizuar ndikimin e tyre në funksionalitetin dhe jetëgjatësinë e rehabilitimit. Për më tepër, u prezantuan dhe analizuan raste klinike që ilustrojnë komplikacionet më të shpeshta dhe arsyet etiologjike përkatëse.

Përfundime: Rishikimi i të dhënave ekzistuese tregon se ndërlikimet teknike dhe biologjike janë të pranishme si në protezat fikse, ashtu edhe në ato të lëvizshme të mbështetura në implante. Këto komplikime mund të ndikojnë ndjeshëm në rezultatet afatgjata të trajtimit dhe, në raste të rënda, të çojnë në dështim të plotë të rehabilitimit protetik (Sailer et al. , 2022). Zgjedhja e llojit optimal të protezës dhe përbërësve protetikë, në përputhje me kushtet individuale të pacientit, mbetet thelbësore për arritjen e rezultateve të qëndrueshme klinike.

Fjalë kyçe: Implantologji, rehabilitim protetik, komplikime teknike, proteza fikse, proteza të lëvizshme, materiale dentare.

DEKORTIKIMI I DHËMBIT NË PROTETIKËN FIKSE: PARIME, TEKNIKAT DHE ZBATIMET KLINIKE.

Leutrim Etemi[1], Artana Kajtazi[2]
[1]Klinika Specialistike Dentare "Dini Dent", Prishtina, Kosovë
[2]Dentiste, Klinika Specialistike Dentare "Dani", Ferizaj, Kosovë

Abstrakt
Qëllimi: Qëllimi i këtij artikulli është të paraqesë parimet themelore të dekortikimit të dhëmbëve (përgatitjes për kurorë) në protetikën fikse, duke krahasuar teknikat dhe kërkesat për lloje të ndryshme kurorash: Zirkon, Faseta (Veneer), kurorat prej porcelani dhe metal - porcelani.
Materiali dhe Metodat: Ky është një artikull rishikues, i bazuar në literaturën përkatëse ne PubMed, Web Of Science, Google Scholar dhe në përmbledhjen e materialeve mësimore mbi dekortikimin. Janë analizuar aspektet teknike të reduktimit okluzal dhe aksial, konfigurimi i vijës së demarkacionit, këndet e pjerrësisë, instrumentet e përdorura dhe pasojat klinike të dekortikimit jo të saktë.
Përfundime: Dekortikimi i saktë është thelbësor për suksesin afatgjatë të restaurimeve fikse. Çdo kurorë kërkon qasje specifike për të siguruar ekuilibrin midis stabilitetit mekanik, ruajtjes së indeve biologjike dhe kërkesave estetike. Një planifikim i kujdesshëm, respektimi i dimensioneve të reduktimit dhe formimit të vijës së demarkacionit, si dhe lëmimi final i sipërfaqeve, kontribuojnë në qëndrueshmëri dhe funksionalitet optimal të punimeve protetike.

Fjalë kyçe: dekortikimi, kurorat protetikore, kurorat e fasetuara, kurora metal - porcelan; protetikë fikse, vija e demarkacionit.

ROLI I MATERIALEVE OBTURUESE NË PREVENIMIN E RRJEDHJES APIKALE TË RRËNJËS SË DHËMBIT.

Lirak Vranovci

Abstrakt
Hyrje: Mikrorrjedhja përkufizohet si "difuzioni i baktereve, lëngjeve orale, joneve dhe molekulave në dhëmb dhe ndërmjet materialit mbushës, ose përcaktohet si kalimi klinikisht i pazbulueshëm i baktereve, lëngjeve, molekulave ose joneve midis dhëmbit dhe materialit restaurues ose mbushës". Rrjedhja apikale konsiderohet të jetë shkaku i zakonshëm i dështimit endodontik dhe ndikohet nga shumë variabla si teknikat e ndryshme të mbushjes, vetitë kimike dhe fizike të materialeve mbushëse të kanalit të rrënjës dhe prania ose mungesa e shtresës "smear".
Qëllimi i punimit: Qëllimi i këtij punimi është që përmes shqyrtimit të literaturës aktuale të publikuar mbi materialet obturuese të kanalit të rrënjës dhe vetive të tyre fizike, kimike dhe mbyllëse të interpretohet roli i tyre në parandalimin e rrjedhjes apikale të rrënjës së dhëmbit.
Metodologjia: Punimi është realizuar në trajtë të "rishikimit të literaturës", duke përdorur artikuj shkencorë dhe profesional të publikuar si dhe libra universitarë. Si burim i të dhënave janë shfrytëzuar: PubMed, National Library of Medicine, Google Scholar etj.
Përfundime: Pavarësisht faktit se vazhdimisht ka tendencë për zbulimin, testimin dhe përdorimin e materialeve të reja me qëllim të arritjes së një trajtimi endodontik sa më preciz dhe të sigurtë aktualisht nuk ka asnjë material mbushës të kanalit të rrënjës që mund të parandalojë rrjedhjen apikale. Bazuar nga literatura dhe publikimet e rishikuara dhe në rezultatet e tyre aftësia vulosëse e pastave me bazë bioqeramike është gjetur të jetë e kënaqshme falë lidhjes së tyre me dentinën dhe materialet tjera bazë obturuese dhe e krahasueshme me pastat obturuese tjera të disponueshme në treg.

Fjalë kyçe: materialet obturuese, rrjedhja apikale, smear shtresa.

DEKONTAMINIMI I HAPËSIRËS PUNUESE NË ORDINANCAT STOMATOLOGJIKE DHE LABORATORËT TEKNIKË DENTARË.

Dr. Lumbardh Halili

Abstrakt

Hyrje: Dekontaminimi i hapësirave punuese në ordinancat stomatologjike dhe laboratorët teknikë dentarë është një komponent thelbësor i kontrollit të infeksioneve në mjediset shëndetësore. Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj pështymës, gjakut dhe mikroorganizmave patogjenë rrit ndjeshëm rrezikun për infeksione të kryqëzuara, duke kërkuar zbatim rigoroz të protokolleve të dezinfektimit dhe sterilizimit.

Qëllime: Ky studim synon të analizojë rëndësinë e dekontaminimit të hapësirave dhe instrumenteve dentare, të vlerësojë metodat më efikase të dezinfektimit dhe sterilizimit, si dhe të theksojë përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare të sigurisë të përcaktuara nga OBSH dhe CDC.

Metodologjia: Punimi është bazuar në rishikimin e literaturës bashkëkohore shkencore, dokumenteve të institucioneve ndërkombëtare dhe praktikave standarde të aplikuara në klinikat dentare. Janë analizuar metodat tradicionale dhe moderne të dekontaminimit, përfshirë përdorimin e autoklavëve, plazmës së peroksidit të hidrogjenit, rrezatimit UV dhe sistemet HEPA.

Përfundime: Rezultatet tregojnë se dekontaminimi i rregullt dhe i standardizuar i sipërfaqeve, instrumenteve dhe mjedisit redukton ndjeshëm rrezikun e transmetimit të sëmundjeve infektive si hepatiti B, hepatiti C dhe HIV. Aplikimi i teknologjive të avancuara të sterilizimit përmirëson efikasitetin dhe sigurinë klinike. Zbatimi i protokolleve të bazuara në evidencë dhe trajnimi i vazhdueshëm i stafit janë elemente kyçe për garantimin e një mjedisi dentar të sigurt.

Fjalë kyçe: Dekontaminimi, sterilizimi, dezinfektimi, stomatologji, laborator dentar, kontroll i infeksioneve, autoklavë, higjiena dentare.

ORTODONCIA DIGJITALE DHE ALIGNERS – NJË EPOKË E RE PËR PACIENTËT ADULTË.

Manjola Gusho, Erjo shundi, Fatiola Blaceri
Albanian University, Fakulteti i Stomatologjisë
Klinika: "Manjola Gusho Ortodont"

Abstrakt

Hyrje: Në dekadat e fundit është vënë re një rritje e konsiderueshme e kërkesës për trajtim ortodontik nga pacientët adultë. Aparatet fikse tradicionale perceptohen nga pacientët si joestetike dhe trajtime që zgjasin shumë. Ortodoncia, ashtu si dhe shumë disiplina të tjera në stomatologji, ka përfituar nga inovacionet teknologjike. Trajtimi ortodontik me aligner është një nga këto inovacione dhe shpesh herë aligners janë zgjidhja e parë kur duam të trajtojmë një pacient adult, për shkak se pacientët adultë kanë kërkesa të larta për estetikë, kërkojnë trajtime komforte, të shkurtra dhe higjiena është më e lehtë për t'u mbajtur nën kontroll. Mundësia që u jepet këtyre pacientëve për të parë se si do të jetë rezultati pa e filluar ende trajtimin përbën një tjetër avantazh të kësaj metode. Në shumicën e rasteve, trajtimi ortodontik tek pacientët adultë është multidisiplinar duke përfshirë periodontologun, kirurgun, protezistin etj.

Qëllimi: Ky studim synon të evidentojë rolin e aligners në trajtimin ortodontik tek pacientët adultë, të vlerësohet spektri i anomalive që mund të trajtohen në mënyrë të suksesshme përmes sistemeve ortodontike të drejtuara nga teknologjia digjitale, duke theksuar avantazhet, kufizimet dhe kriteret e përzgjedhjes së këtyre pacientëve.

Materiale dhe Metoda: Nëpërmjet rasteve klinike do të nxjerrim në pah avantazhet e trajtimit me aligners në anomali siç janë: grumbullime dentare të lehta deri të moderuara, mbyllja e hapësirave, ekspansioni i harqeve, intruzioni dentar etj. Do të diskutohen avantazhet e aligners si dhe përzgjedhja e kujdesshme e pacientëve për këto trajtime.

Rezultate: Trajtimet ortodontike kanë qënë të suksesshme në rastet me malokluzione të lehta deri në mesatare si dhe në trajtimin e recidivave. Avantazhet kryesore përfshijnë estetikën, mbajtja më lehtë e higjienës dhe deri diku koha e trajtimit pak më e shkurtër në disa anomali. Kontrolli i forcave që ushtrohen mbi dhëmb përbën një tjetër avantazh të kësaj metode.

Konkluzione: Trajtimet me aligners paraqesin disa limite, siç janë: anomalitë skeletike, rrotacionet e mëdha etj, bashkëpunimi i pacientit, është thelbësor për të arritur rezultatin e dizenjuar në fillim të trajtimit. Kafshimi i hapur posterior ngelet një nga efektete e padëshiruara në këto trajtime.

Fjalë kyçe: Aligners, estetika, ortodoncia digjitalale, pacientë adultë, bashkëpunim, trajtim multidisiplinar.

PROTAPER DHE ISOTAPER: TEKNIKA TË NDRYSHME, QËLLIM I PËRBASHKËT! ANALIZË KRAHASUESE NDËRMJET SISTEMEVE TË INSTRUMENTAVE ENDODONTIK.

Marinela (Malci) Ferhati, Bujar Ferhati

Abstrakt

Hyrje: Çdo dhëmb meriton një mundësi të dytë! Për këtë arsye, një disiplinë si endodontia përfshin shumëllojshmëri procedurash dhe aftësish për të rritur jetëgjatësinë e dhëmbit në kavitetin oral. Suksesi i një terapie endodontike është i lidhur në mënyrë direkte me reduktimin mikrobial, përpunimin e kanalit të rrënjës dhe me obturimin e tij. Zhvillimi i sistemeve ProTaper dhe ISOtaper ka përmirësuar ndjeshëm efikasistetin e një përpunimi mekanik radikular.

Qëllimi: Të studiohen dhe të vlerësohen llojet e sistemeve të ndryshme rotatore, reciprokante. Të analizojmë teknikat, strategjinë e përdorimit, efikasitetin klinik dhe sigurinë gjatë punës ndërmjet sistemeve ProTaper dhe ISOtaper.

Objektiva: Të nxjerrim në pah avantazhet e secilës metodë gjatë trajtimeve endodontike dhe të bëjmë diferencën ndërmjet tyre; të studiohet efikasiteti i pastrimit të mbjetjeve nekrotike dhe dentinare në kanalet radikulare; të përcaktohet koha e instrumentimit; të përcaktohet metoda e cila ndihmon më shumë në formësimin e dëshiruar të kanalit; a vërehet ndryshim domethënës statistikor në zhvendosjen apikale, transportim të kanalit dhe humbje të dentinës gjatë instrumentimit; të evidentohet cili sistem rotator rezultoi më i sukseshëm gjatë studimeve.

Materiali dhe Metodologjia: Studimi është në formë "review" dhe përfshin analiza nga literatura të ndryshëm të cilët janë përzgjedhur në bazë të disa kritereve dhe si qëllim kanë krahasimin midis sistemeve rotatore gjatë trajtimeve endodontike.

Rezultate dhe Konkluzione: Metoda rotatore dhe reciprokante rezultoi në vlera të lartë statistikore krahasuar me metodën manuale në efikasitetin e pastrimit, formësimin e kanalit, kohën e instrumentimit, kualitetin e obturimit si dhe në suksesin klinik dhe radiologjik. Një disavantazh që u vërejt në metodën rotatore ishte fraktura e instrumentave. Sistemet rotatore ProTaper dhe ISOtaper rezultojnë efektive në përgatitjen mekanike të kanaleve radikulare, por me karakteristika dhe përparësi të ndryshme që i bëjnë më të përshtatshëm për situata të caktuara klinike. Sistemi ProTaper rezultoi nga më të preferuarit duke u rënditur si dhe më efikasi.

Fjalë kyçe: instrumente NiTi, sisteme rotatore, motorr endodontik, profile, protaper, preparim.

GJERËSIA BIOLOGJIKE E IMPLANTIT. KONCEPTI DHE IMPAKTI KLINIK NË SUKSESIN E TRAJTIMIT. RISHIKIM NARRATIV LITERATURE.

Marjola Davidhi
Klinikë private Administratore dhe Mjeke stomatologe Fier, Shqipëri.

Abstrakt

Hyrje: Raporti i konsoliduar dhe i shëndetshëm i Implantit dentar me indet e buta dhe të forta rreth tij janë çelësi i suksesit Implantar. Një barrierë e fuqishme e indeve të buta siguron kushtet për një Osteointegrim Implantar të suksesshëm. Shëndeti i indeve të buta periimplantare, stabiliteti i këtyre indeve të buta, niveli, dimensionet dhe aftësia rigjeneruese e tyre përbëjnë kriteret për vlerësimin e suksesit të Integrimit te indeve të buta rreth implantit, Analogjia midis strukturës indore rreth Dhëmbëve dhe Implantit, përbën një orientim për të kuptuar funksionalitetin e indeve të buta dhe rolin e tyre natyral.

Qëllimi: Ky artikull synon të analizojë gjerësine biologjike rreth Implantit në shumë aspekte për të ndihmuar klinicistin në zgjedhjen e strategjisë më të mirë implantare dhe evitimin maksimal të komplikacioneve. Diskutimi i konceptit të gjerësisë biologjike supra dhe subkrestale rreth Implantit të Osteointegruar shëndetshëm dhe rreth defekteve infrakockore, si dhe vlerësimi i dimensionit dhe funksionit të indeve të buta janë në fokusin e këtij studimi.

Metoda dhe materiale: Ky studim është një rishikim literature me natyrë narrative bazuar në shumë artikuj shkencorë Online të publikuar së fundmi në disa site mjekësore kryesore (Pub Med, Clinical research, Google scholar sites).

Fjalë kyçe: Gjerësi biologjike periimplantare, gjerësi biologjike supracrestale, gjerësi biologjike subcrestale, ind lidhor.

TEKNIKA E STRATIFIKIMIT TË KOMPOZITIT NË REGJIONIN ANTERIOR.

Dr. Mentor Smailaj
DDS, UFO - dental, st. Tirana. p. n. Prizren, Kosova.

Abstrakt
Në këtë prezantim do të shpjegohet metoda e stratifikimit të kompozitit në dhëmbët e përparmë në rastet e frakturave, kariesit dhe në rastet e veneers të drejtpërdrejta të kompozitit. Me këtë prezantim gjithashtu do të sqarojë se si të studiohet rasti paraprakisht përmes fotografisë dentare dhe si realizohet. Brenda prezantimit do të prezantohen raste klinike të cilat do të prezantojnë teknikën e shtresëzimit, imitim të morfologjisë dhe histologjisë së dhëmbit me kompozit, gjithashtu do të shpjegohen instrumentet që përdorim. Këtu qëllimi i këtij prezantimi është të sqarojë rëndësinë e teknikës së shtresimit, në mënyrë që restaurimet e kompozitit dentar në front të jenë të qëndrueshme, praktike, natyrale dhe të padukshme, restorime të fshehura. Në fokus të këtij prezantimi është jo vetëm aspekti estetik i restaurimeve, por edhe ai funksional, duke theksuar balancën mes artit dhe shkencës në restaurimin e dhëmbëve anteriorë. Teknikat e avancuara të shtresimit do të shpjegohen në kontekstin e imitimit të strukturave natyrale të smaltit dhe dentinës, me qëllim krijimin e një efekti tredimensional dhe dritë - transmetues, që reflekton karakteristikat e dhëmbit të vërtetë. Do të diskutohet rëndësia e analizës së hollësishme të ngjyrës, përzgjedhja e nuancave të kompozitit në përputhje me struktura të ndryshme të dhëmbit (opake, dentinë, smalt, efektesh të specializuara), si dhe roli i ndriçimit të duhur në identifikimin e karakteristikave të dhëmbit që do të restaurohet. Prezantimi do të përfshijë gjithashtu demonstrimin e teknikave të konturimit dhe lustruarit për të maksimizuar rezultatin estetik dhe për të minimizuar mundësinë e plakjes së parakohshme të restaurimit. Për më tepër, do të analizohet ndikimi i strategjive të ndryshme të shtresëzimit në qëndrueshmërinë biomekanike të restaurimeve, si dhe faktorët që ndikojnë në kohezionin mes shtresave dhe në lidhjen e tyre me strukturën dentare natyrale. Do të paraqiten gjithashtu gabimet më të zakonshme klinike gjatë këtij procesi dhe mënyrat për t'i shmangur ato, duke përfshirë menaxhimin e kufijve, kontrollin e kontaktit interproximal dhe ruajtjen e integritetit gingival. Qasja e prezantuar synon jo vetëm një estetikë të avancuar dhe të personalizuar, por edhe ruajtjen e strukturës dentare përmes një filozofie minimale invazive. Kjo metodë ofron një alternativë efikase ndaj restaurimeve indirekte, duke reduktuar kostot, kohën e trajtimit dhe duke rritur përfshirjen e drejtpërdrejtë të profesionistit në krijimin e një restaurimi tërësisht të kontrolluar në çdo fazë të tij.
Fjalë kyçe: shtresëzim i kompozitit, Veneers, dhëmb, smalt, dentinë, kompozit.

LASER DIODË 980 NM: NJË MODALITET I MIRË PËR EKSPOZIMIN E DHËMBËVE TË PËRHERSHËM TË IMPAKTUAR.

Prof. Merita Bardhoshi, Dr. Shk. Esat Bardhoshi
Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Tiranë
Departamenti i Kirurgjisë OMF

Abstrakt
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të demonstrojë se si teknika me laser mund të ndihmojë pozitivisht në ekspozimin e dhëmbëve të impaktuar për arsye ortodontike.
Materiale dhe metoda: Ky studim përfshiu 30 pacientë të trajtuar për ekspozimin e dhëmbëve të impaktuar me laser diodë 980 nm, për arsye ortodontike. Trajtimi u krye nga maji 2013 deri në maj 2016 në Klinikën Universitare Stomatologjike në Tiranë. Periudha e ndjekjes ishte një javë, dy javë dhe gjashtë muaj për vlerësimin e rezultateve. Braketat u vendosën menjëherë pas operacionit, falë koagulimit të mirë.

Rezultate: Avantazhi intraoperativ i përdorimit të laserit diodë 980 nm ishte koha më e shkurtër në karrige dhe mungesa e plotë e hemorragjisë, gjë që dha mundësinë e vendosjes së menjëhershme të braketës në smalt të thatë. Asnjë nga pacientët nuk raportoi efekte anësore pas operacionit; nuk pati gjakderdhje, dhimbje, ënjtje apo shqetësime një deri në dy javë pas trajtimit. Laseri diodë është efektiv dhe i sigurt për indet e buta.
Përfundime: Laseri diodë 980 nm është një modalitet i mirë për ekspozimin e dhëmbëve të impaktuar për arsye ortodontike. Kjo metodë siguron rezultate të mira operative dhe post - operative pa efekte anësore.

Fjalë kyçe: Laser diodë 980 nm, ekspozimi i dhëmbëve, shërimi i plagëve.

NDIKIMI I PROTEZAVE TË LËVIZSHME TË KONSTRUKTUARA ME TEKNIKËN E PIEZOGRAFISË NË MIRËQENIEN PSIKOSOCIALE TË PACIENTËVE EDENTULOZË.

Neada Hysenaj, Edit Xhajanka, Sara Vasku, Endrit Paparisto, Edlira Mulo, Alketa Qafmolla, Belisa Kaleci, Blerta Lila
Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
Klinika Stomatologjike Universitare, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Edentulizmi përbën një sfidë të rëndësishme klinike dhe sociale, e cila ndikon ndjeshëm në aftësitë funksionale, komunikimin dhe perceptimin e vetvetes. Teknikat funksionale, si piezografia, mundësojnë regjistrimin e zonës neutrale përmes lëvizjeve funksionale të gjuhës, faqeve dhe buzëve.
Qëllimi: Qëllimi i studimit ishte të vlerësonte ndikimin e protezave të ndërtuara me teknikën e piezografisë në mirëqenien psikosociale të pacientëve edentulozë, në krahasim me protezat e realizuara me teknikat tradicionale.
Materiale dhe metoda: Në studim u përfshinë 122 pacientë edentulozë, të cilët u trajtuan në Klinikën Stomatologjike Universitare, të ndarë në dy grupe të barabarta sipas metodës së konstruktimit të protezës. Të gjitha procedurat u zhvilluan të njëjta me përjashtim të procedurës së piezografisë. Pas një periudhe adaptimi prej një muaji, pjesëmarrësit plotësuan pyetësorin OHIP - EDENT me 19 pyetje të ndara në 7 domene funksionale e psikosociale.
Rezultate: Grupi i trajtuar me teknikën e piezografisë raportoi ndryshime statistikisht domethënëse në **aspektin psikologjik** dhe **social**, duke reflektuar një ndikim pozitiv të teknikës në mirëqenien e përgjithshme të pacientëve.
Konkluzione: Protezat e ndërtuara me teknikën e piezografisë përfaqësojnë një qasje të avancuar, të orientuar drejt pacientit, që ofron përfitim në disa drejtime si: funksionale dhe psikosociale.

Fjalë kyçe: Piezografi, proteza të ndërtuara, pacientë.

TUMORET BENINJE TË ZGAVRËS SË GOJËS: DIAGNOSTIKIMI DHE MENAXHIMI KLINIK.

Dr. Njomza Dauti

Abstrakt
Hyrje: Tumoret beninje të zgavrës së gojës përfaqësojnë një grup të larmishëm lezionesh me origjinë epiteliale, mezenkimale, gjëndrore dhe odontogjene. Edhe pse janë neoplazi jo - malinje, ato mund të shkaktojnë shqetësime funksionale dhe estetike, sidomos kur janë të lokalizuara në zona kritike ose kanë përmasa të konsiderueshme.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të prezantojë karakteristikat klinike, histopatologjike dhe opsionet e menaxhimit për tumoret më të shpeshta beninje të zgavrës së gojës, si dhe të theksojë rëndësinë e diferencimit të tyre nga lezionet malinje ose para - malinje.
Metodologjia: Është kryer një rishikim retrospektiv i rasteve të tumoreve beninje të trajtuara në klinikën stomatologjike / orale gjatë 5 viteve të fundit. Të dhënat janë analizuar në bazë të tipit të tumorit, lokalizimit anatomik, simptomatikës, metodës së diagnostikimit dhe mënyrës së trajtimit. Gjithashtu, janë shqyrtuar dhe krahasuar literaturat bashkëkohore për të pasuruar analizën.
Përfundime: Tumoret beninje të zgavrës së gojës, ndonëse me natyrë jo - agresive, kërkojnë një vlerësim të kujdesshëm klinik dhe histopatologjik për të përjashtuar lezionet malinje. Diagnostikimi i hershëm dhe trajtimi

adekuat – shpesh kirurgjikal – sigurojnë një prognozë të mirë dhe reduktojnë rrezikun e rikthimit. Përdorimi i metodave moderne të imazherisë dhe analizave molekulare ka përmirësuar ndjeshëm saktësinë diagnostike dhe menaxhimin klinik të këtyre lezioneve.

Fjalë kyçe: Tumore, beninje, malinje, diagnostikim.

RAPORTI I ANATOMISË SË BRENDSHME TË DHËMBIT NDAJ PROCEDURAVE ENDODONTIKE.

Olta Kastrati

Abstrakt

Hyrje: Ky punim trajton lidhshmërinë ndërmjet anatomisë së brendshme të dhëmbit dhe procedurave endodontike. Pulpa dentare, si ind lidhor i shkrifët që ndodhet në pjesën e brendshme të dhëmbit, luan rol thelbësor në ruajtjen e vitalitetit dentar dhe në suksesin e trajtimeve endodontike. Variacionet anatomike të rrënjëve dhe kanaleve, të ndikuara nga mosha, gjinia, përkatësia etnike dhe faktorë zhvillimorë, shpesh paraqesin sfida klinike gjatë diagnostikimit dhe trajtimit të kanalit rrënjor.

Metodologjia: Punimi është bazuar në rishikim të literaturës shkencore të publikuar në databaza si PubMed, MedLine, Sci - Hub dhe ResearchGate. Janë analizuar artikuj dhe studime të përzgjedhura me fjalë kyçe si Root canal anatomy, Tooth morphology dhe Endodontic procedures, me qëllim identifikimin e faktorëve që ndikojnë në suksesin ose dështimin e trajtimit endodontik.

Rezultate: Analiza tregoi se njohja e konfiguracioneve të ndryshme të kanaleve rrënjë dhe aplikimi i metodave moderne të vizualizimit si CBCT, radiografia digjitale dhe mikroskopia dentare janë thelbësore për diagnostikim të saktë. Dështimet endodontike rezultojnë kryesisht nga kanalet e patrajtuara, dezinfektimi jo i plotë ose përzgjedhja e papërshtatshme e instrumenteve.

Diskutim: Studiues të shumtë kanë theksuar se anatomia e dhëmbit është unike për çdo individ dhe ndryshon madje edhe midis dhëmbëve të të njëjtit individ. Përdorimi i instrumenteve Ni - Ti ka përmirësuar fleksibilitetin dhe efikasitetin e përpunimit të kanaleve, duke reduktuar gabimet procedurale.

Përfundime: Njohja tredimensionale e anatomisë së dhëmbit është parakusht për një trajtim endodontik të suksesshëm. Për të arritur rezultate optimale, endodontisti duhet të zotërojë njohuri të hollësishme mbi morfologjinë e dhëmbit dhe të aplikojë teknikat bashkëkohore të pastrimit dhe obturimit të kanalit.

Fjalë kyçe: Anatomi dentare, kanali rrënjor, trajtim endodontik, CBCT, instrumente Ni - Ti, morfologji e dhëmbit.

AVANTAZHET KLINIKE TË IMPLANTEVE POST - EKSTRAKTIVE, KRAHASUAR ME PROTOKOLLET STANDARTE: NJË STUDIM KRAHASUES RETROSPEKTIV I SHKALLËS SË SUKSESIT DHE EFICENCËS NË TRAJTIM.

Oltjon Kaja[1], Alba Koshovari[2], Niki Isehiti[3], Laura Fejza[3]

Abstrakt

Hyrje: Protokolli i vendosjes së implanteve menjeherë pas ekstraksionit, ka marrë vëmendjen e kërkuesve dhe klinicistëve ditët e sotme, duke u fokusuar në avantazhet që ky protokoll ofron, lidhur me kohën e trajtimit dhe komfortin e pacientit gjatë trajtimit. Pavarësisht kësaj, ka një kontraditë presistente nëse ky protokoll ofron rezultate klinike të krahasueshme me protokollin standart / të vonuar të vendosjes së implanteve

Qëllimi: Ky studim kohort, retrospektiv, krahasoi shkallën e suksesit, humbjen e kockës marginale; dhe eficencën ne trajtim ndërmjet dy protokolleve.

Materiale dhe metoda: U analizuan të dhënat klinike dhe radiografike të **119 pacientëve** (52 femra, 67 meshkuj; mosha mesatare = 52. 71 ± 11. 57 vjeç, në intervalin = 21–80 vjeç) të trajtuar në dy klinika dentare private në Tiranë, Shqipëri, gjatë periudhës **Janar 2020 – Shtator 2024. 55 pacientë (46. 2%)** u trajtuan me implante post - ekstraktive dhe **64 pacientë (53. 8%)** me implante të vendosura sipas protokollit standart, me një ndjekje / follow - up minimal prej **12 muajsh.** Nivelet margjinale të kockës u matën në momentin bazë, pas 6 dhe 12 muajsh duke përdorur radiografi standarde periapikale të kalibruara në programin ImageJ®. Analiza

statistikore përfshiu testin *t* për mostra të pavarura, Chi - Square, Mann–Whitney U dhe regresionin logjik për shumë variabla, duke u përshtatur për moshën, gjininë dhe vendndodhjen e implantit.
Rezultate: Shkalla e përgjithshme e suksesit të implanteve ishte 94. 1%, pa dallime statistikisht domethënëse midis protokolleve (të menjëhershme = 96. 4%, të vonuara / standart = 92. 2%; $\chi^2 = 0.932$, $p = 0.334$). Humbja mesatare marginale e kockës pas 6 muajsh ishte −0. 219 ± 0. 196 mm dhe pas 12 muajsh −0. 816 ± 1. 764 mm, pa dallime domethënëse midis grupeve ($p = 0.813$ dhe 0. 717, përkatësisht). Regresioni logjik nuk tregoi asnjë lidhje statistikisht domethënëse midis suksesit të implantit dhe ndonjë prej variablave të shqyrtuar — përfshirë protokollin e vendosjes, moshën, gjininë, harkun maksilar / mandibular dhe rajonin e implantit ($p > 0.05$ për të gjitha). Për protokollin e vendosjes në veçanti, OR ishte 0. 805 (95% CI: 0. 13–4. 99; $p = 0.816$). Megjithatë, koha e trajtimit ishte dukshëm më e shkurtër për grupin me vendosje të menjëhershme, duke konfirmuar avantazhin e tij në efikasitetin e trajtimit.
Konkluzione: Vendosja e menjëhershme e implantit post - ekstraktiv tregoi shkallë suksesi dhe stabilitet margjinal të kockës të krahasueshme me protokollet e vendosjes së vonuar, duke reduktuar ndjeshëm kohën e përgjithshme të trajtimit. Këto gjetje mbështesin vlefshmërinë klinike të vendosjes së menjëhershme të implantit tek pacientët e përzgjedhur me kujdes. Rekomandohen studime multicentrike, prospektive dhe me ndjekje afatgjatë për të konfirmuar këto rezultate dhe për të eksploruar aspektet estetike dhe rezultatet e raportuara nga vetë pacientët.

Fjalë kyçe: Implante post - ekstraktive, protokoll, pacientë.

NGA FUNKSIONI TEK ESTETIKA: APLIKIMI I OCCLUSAL STAMP TECHNIQUE NË RESTAURIMET KOMPOZITE - RAPORT RASTI.

Oreli Esati[1], Lindihana Emini[2], Jetmire Alimani Jakupi[3], Zana Jusufi Osmani[4]
[1]*Doktor i Mjekësisë Dentare*
[2]*Profesor i Sëmundjes së Dhëmbit, Universiteti i Tetovës*
[3]*Profesor i Anatomisë Dentare, Universiteti i Tetovës*
[4]*Asistant i Anatomisë Dentare, Universiteti i Tetovës.*

Abstrakt
Hyrja: Ruajtja e anatomisë okluzale është thelbësore për funksionin përtypës dhe estetikën në restaurimet e dhëmbëve posteriorë. Occlusal Stamp Technique është një metodë që lejon rikthimin e formës natyrore të sipërfaqes përtypëse, duke ulur kohën klinike dhe duke siguruar kontakte okluzale fiziologjike. Kjo teknikë është e aplikueshme jo vetëm në karieset e cekëta apo të mesme, por gjithashtu në rastet me karies të thellë të kontrolluar dhe madje edhe pas trajtimit endodontik, kur është ruajtur struktura okluzale për t'u marrë stampimi. Ky rast paraqet përdorimin inovativ të Light - Curing Gingival Protection, zakonisht të destinuar për zbardhimin dentar, si material për stampim.
Paraqitje rasti: Pacienti A. K. , 27 vjeç, u paraqit në klinikë me dhimbje të lehtë gjatë përtypjes dhe ndjeshmëri ndaj të ftohtit dhe ushqimeve të ëmbla, pa dhimbje të natës. Ekzaminimi klinik dhe radiografik zbuloi një lezion kariesi të thellë por jo - profund, me pulpë të paafektuar. Para preparimit u mor masa e sipërfaqes okluzale duke përdorur Light - Curing Gingival Protection. Pas heqjes selektive të kariesit, dezinfektimit të kavitetit dhe vendosjes së bazës mbrojtëse, u aplikua sistemi adeziv dhe kompoziti në shtresa. Në shtresën përfundimtare u shtyp stampa okluzale, duke rikthyer relievin natyror; restaurimi u polimerizua, u rregullua okluzioni dhe u lustrua.
Diskutime: Teknika e stampës është e përshtatshme për një gamë të gjerë situatash klinike ku kërkohet rikthimi i anatominë natyrore, përfshirë lezione kariesi të kontrolluara dhe restaurime pas trajtimit endodontik. Përdorimi i barrierës gingivale si material stampimi ofron avantazhe praktike, megjithëse kërkon kujdes në përgatitjen dhe menaxhimin e kavitetit.
Përfundime: Occlusal Stamp Technique kombinon estetikën dhe funksionin duke siguruar rikthimin e relievit natyror të sipërfaqes përtypëse në restaurimet kompozite, duke u përshtatur për një gamë të gjerë indikacionesh klinike.

Fjalë kyçe: Occlusal Stamp Technique, ushqime të ëmbla, kariesi, kompozita, restaurim.

KOMPLIKACIONET POST - OPERATIVE NË KIRURGJINË ORALE: MENAXHIM DHE PARANDALIM.

Dr. Qëndrim Ajazaj
Stomatolog

Abstrakt

Hyrje: Komplikacionet post - operative në kirurgjinë orale, si dhimbja, ënjtja, infeksioni dhe gjakderdhja, janë të zakonshme por të parandalueshme me planifikim të kujdesshëm dhe teknikë të saktë kirurgjikale. Menaxhimi i hershëm dhe ndjekja post - operative e rregullt reduktojnë ndjeshëm rrezikun dhe përmirësojnë shërimin e pacientit.

Qëllimi: Ky punim ka për qëllim të analizojë komplikacionet më të zakonshme pas ndërhyrjeve kirurgjikale orale dhe të paraqesë strategjitë më efektive për menaxhimin dhe parandalimin e tyre.

Materiale dhe metoda: Është realizuar një rishikim i literaturës bashkëkohore nga vitet 2010–2024 përmes bazave të të dhënave PubMed, Scopus dhe Google Scholar. Janë përfshirë studime klinike dhe përmbledhje që trajtojnë komplikacionet postoperative si infeksioni, hemorragjia, dëmtimet nervore dhe komunikimi oro - antral.

Rezultate: Komplikacionet më të shpeshta përfshijnë dhimbjen, edemën, infeksionin alveolar dhe gjakderdhjen. Faktorët kryesorë që ndikojnë janë teknika kirurgjikale, higjiena orale dhe ndjekja e udhëzimeve postoperative. Strategjitë parandaluese përfshijnë përdorimin e teknikave atraumatike, kontrollin e asepsisë dhe edukimin e pacientit.

Konkluzione: Njohja dhe menaxhimi i hershëm i komplikacioneve postoperative janë thelbësore për suksesin klinik. Trajtimi multidisiplinar dhe ndjekja e kujdesshme post - operative reduktojnë ndjeshëm rrezikun e komplikacioneve dhe përmirësojnë rezultatet terapeutike.

Fjalë kyçe: Kirurgjia orale, komplikacionet post - operative, infeksioni, hemorragjia, parandalimi, menaxhimi.

OSTEODENSIFIKIMI DUKE PËRDORUR TEKNOLOGJINË E FREZAVE DENSAH™, NJË PARADIGMË E RE NË PËRGATITJEN E OSTEOTOMISË IMPLANTARE.

Redion Bejleri

Abstrakt

Qëllimi: Osteodensifikimi përfaqëson një teknikë të avancuar biomekanike për përgatitjen e osteotomisë implantare, e cila synon të ruajë sa më shumë masën kockore ekzistuese duke rritur njëkohësisht stabilitetin primar dhe sekondar të implantit. Ndryshe nga teknikat tradicionale të shpimit, të cilat largojnë materialin kockor gjatë krijimit të vendit për inserimin e implantit, osteodensifikimi lejon zhvendosjen dhe kompaktimin e kockës, duke përmirësuar cilësinë dhe densitetin e saj. Ky prezantim ka për qëllim të analizojë përfitimet e kësaj metode dhe ndikimin e saj në qëndrueshmërinë e implantit, procesin e osteointegrimit dhe përshpejtimin e shërimit post - operativ.

Materiale dhe metoda: Për vlerësimin e osteodensifikimit, u përdorën frezat Densah™, të cilat operojnë me një mekanizëm unik që rrotullohet në drejtim të kundërt të frezimit klasik, duke ngjeshur dhe zgjeruar kockën pa e dëmtuar atë. Eksperimentet u realizuan në mostra kockore dhe subjekte klinike për të krahasuar efekasitetin e kësaj teknike me metodat tradicionale të shpimit. Gjatë analizës, u matën parametra si koeficienti i stabilitetit të implantit (KSI), kontakti kockë - implant (KKI), dhe vlerat e inserimit të torque - it (VIT). Gjithashtu, u realizuan analiza histologjike për të vlerësuar ndryshimet strukturore të kockës dhe procesin e shërimit pas osteodensifikimit.

Rezultate: Të dhënat eksperimentale dhe klinike treguan se osteodensifikimi ndikon pozitivisht në përmirësimin e stabilitetit primar dhe sekondar të implantit, duke siguruar një kontakt më të madh midis implantit dhe kockës përreth. Në krahasim me teknikat tradicionale të shpimit, ku materiali kockor hiqet dhe shpesh çon në një densitet të reduktuar të kockës përreth implantit, osteodensifikimi ruajti dhe përforcoi strukturën kockore, duke ofruar një bazë më të fortë për osteointegrim. Analizat histologjike treguan një rritje të densitetit kockor dhe një vaskularizim të përmirësuar, duke reduktuar ndjeshëm kohën e nevojshme për shërimin dhe ngulitjen përfundimtare të implantit.

Përfundime: Osteodensifikimi me frezat Densah™ përfaqëson një qasje inovative dhe shumë premtuese në fushën e implantologjisë dentare. Kjo teknikë jo vetëm që ruan integritetin e kockës gjatë përgatitjes së osteotomisë, por gjithashtu përmirëson vetitë e saj biomekanike, duke siguruar një stabilitet më të madh të implantit që nga momenti i vendosjes. Përfitimet e kësaj metode, duke përfshirë një rigjenerim më të shpejtë të kockës dhe një reduktim të rrezikut të komplikacioneve, e bëjnë atë një alternativë të vlefshme për praktikën klinike. Bazuar në këto rezultate, osteodensifikimi mund të konsiderohet si një evolucion i rëndësishëm në teknikat e përgatitjes së kockës për implantim, me potencial për të përmirësuar në mënyrë domethënëse suksesin afatgjatë të implanteve dentare.

Fjalë kyçe: Freza Densah™, osteodensifikimi, material kockor.

PIEZOKIRURGJIA NË MOLARËT E TRETË TË IMPAKTUAR.

Dr. Renato Isufi, Dr. Aurora Isufi, Prof. Dr. Ramazan Isufi

Abstrakt

Hyrje: Pak studime kanë krahasuar efektet e piezokirurgjisë dhe kirurgjisë konvencionale për dhëmbët e impaktuar të pjekurise në cilësinë e jetës. Mes këtyre studimeve, parametrat e përfshirjes dhe metodat e vlerësimit kanë ndryshuar.

Materiale dhe metoda: Ky studim kishte për qëllim të krahasonte efektet e piezokirurgjisë dhe instrumenteve rrotulluese konvencionale në cilësinë e jetës duke përdorur një metodë të standardizuar. Pacientët me dhëmballe pjekurise të impaktuar mandibular u përfshinë në bazë të klasifikimit Winter dhe Pell - Gregory. Studimi është kryer ndërmjet Shtator 2023 dhe Tetor 2024 Protokolli i karteles klinike u regjistrua.

Rezultate: Ne regjistruam 20 pacientë (40 dhëmbë pjekurie) dhe zbuluam se heqja e dhëmbëve të prekur duke përdorur metodën e piezkirurgjisë ndikoi pozitivisht në cilësinë e jetës dhe përmirësoi ndjeshëm rezultatet e ënjtjes, trizmusit dhe dhimbjes. Megjithatë, piezokirurgjia mund të ndikojë në sëmundshmëritë postoperative, siç është rritja e kohës totale të operacionit.

Konkluzione: Piezokirurgjia duket se ka avantazhe në krahasim me kirurgjinë konvencionale për heqjen e dhëmballës së pjekurisë, me ndikim për sa i përket cilësisë së jetës dhe simptomave postoperative. Megjithatë, kërkimet e mëtejshme duhet të studjojne të metat e mundshme dhe të konfirmojnë këto gjetje.

Fjalë kyçe: Molari i tretë, piezokirurgjia, osteotomia, dhimbje, cilësia e jetës, ënjtje, trizmus.

ANTIKOAGULANTËT NË INTERVENTET KIRURGJIKALE VEÇANËRISHT NË KIRURGJINË ENDODONTIKE ME PIEZOKIRURGJI.

Renisa Mataj, Eriselda Simoni (Malushi)[1], Arlind Myftari[2], Renato Isufi[1], Denis Kadaifçiu[1], Dr. Shk. Belisa Kaleci[1], Dr. Shk. Xhanina Gavrazi[1], Prof. Asc. Silvana Bara[3], Laureta Malushi[4], Leonard Simoni[2]

[1]Klinika Stomatologjike Universitare
[2]Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"
[3]Fakulteti i Mjekësisë Dentare
[4]Qendra Shëndetësore Nr. 5

Abstrakt

Antikoagulantët janë një grup medikamentesh të përdorura për parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve tromboembolike dhe çrregullimeve të tjera kardiovaskulare. Përdorimi i këtyre medikamenteve është jetik për pacientët që vuajnë nga këto kushte. Ndërhyrjet dentare kirurgjikale te këta pacientë pa vlerësimin paraprak korrekt mund të shkaktojnë hemorragji të konsiderueshme, që mund të përbëjnë një rrezik të madh për pacientët që janë në trajtim me antikoagulantë. Ky prezantim do të trajtojë vlerësimin e ndërhyrjeve dentare kirurgjikale në pacientë që marrin antikoagulantë, vlerësimin e rrezikut të hemorragjive, si dhe protokollet e përdorura për menaxhimin e këtyre rasteve. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i këtij prezantimi është vlerësimi i bashkëpunimit ndërmjet mjekëve stomatologë dhe mjekëve specialistë për të siguruar një trajtim të sigurt për pacientët që përdorin antikoagulantë. Ky bashkëpunim është i nevojshëm për të aplikuar siç duhet protokollet e parapërgatitjes dhe menaxhimit të këtyre pacientëve për ndërhyrje dentare kirurgjikale. Pra, pacientët që

përdorin koagulantë kanë rrezikshmërinë e hemorragjive gjatë dhe pas procedurave dentare, duke e bërë të nevojshme një qasje të kujdesshme për të reduktuar komplikacionet e mundshme, përfshirë hemorragjitë perioperative dhe postoperatore. Këta pacientë mund të realizojnë procedura kirurgjikale dentare nëse zbatohet protokolli i trajtimit në mënyrë të saktë dhe mjekët të jenë të përgatitur për të menaxhuar komplikacionet që mund të hasen gjatë interventit kirurgjikal.

Fjalë kyçe: Atikoagulantë, protokoll, intervent kirurgjikal, hemostatikët, trajtim.

APLIKIMI SISTEMIK I BARNAVE ANTI - INFLAMATORE DHE ANTIMIKROBIALE NË TERAPINË ENDODONTIKE.

Rina Berisha

Abstrakt

Një problem me origjinë endodontike zgjidhet kryesisht duke pastruar dhe dezinfektuar sistemin kanalikular të rrënjës së dhëmbit. Megjithatë, përdorimi sistemik i barnave është një ndihmesë e madhe në luftimin e dhimbjes, inflamacionit dhe / ose infeksionit, duke e bërë këtë trajtim më të lehtë. Meqenëse dhimbja endodontike shoqërohet shpesh me inflamacion kronik, praninë e produkteve bakteriale dhe aktivizimin e rrjetit të citokinës dhe intermedierëve të tjerë inflamatorë, dhimbja mund të reduktohet nga administrimi i barnave anti - inflamatore steroide dhe jo steroide (NSAID). Aplikimi sistemik i barnave kortikosteroide shfrytëzohet kryesisht për menaxhimin e dhimbjes dhe inflamacionit pas trajtimit endodontik, sidomos në raste të dhimbjeve të forta ose edemës pas trajtimit. Antimikrobikët në endodonci nuk duhet të përdoren në rutinë, por vetëm në raste të caktuara kur janë të nevojshëm për kontrollin e infeksionit dhe parandalimin e komplikimeve sistemike. Penicilina V, e kombinuar me metronidazol për të mbuluar shtamet anaerobe, është efektive në shumicën e rasteve. Megjithatë, rekomandohet amoksicilina (vetëm ose së bashku me acidin klavulanik) për shkak të përthithjes më të mirë dhe rrezikut më të ulët të efekteve anësore. Në rast të alergjisë së konfirmuar ndaj penicilinës, linkozamidet si klindamicina janë bari i zgjedhjes.

Fjalë kyçe: Trajtim sistemik, terapi endodontike, anti - inflamatorë, antimikrobikë.

KERATOCISTA ODONTOGJENE – ETIOPATOGJENEZA, DIAGNOZA KLINIKE DHE TERAPIA.

Rina Selmani, Rinesa Hoti, Besejona Januzi

[1]Fakulteti i Mjekësisë, Dega e Stomatologjisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Prishtinë, Kosovë

Abstrakt

Hyrje: Keratocistet odontogjene janë ciste evolutive të nofullave që përfaqësojnë një entitet të veçantë klinik në kuadër të cisteve të nofullave. Veçantia e tyre qëndron në: rritjen e shpejtë dhe agresive me shkatërrim të sipërfaqeve të mëdha të kockës zakonisht pa simptoma subjektive; ndërtimin e veçantë histologjik me mbështjellës shumë të hollë; dhe prirjen e lartë për recidiv pas trajtimit kirurgjik. Keratocistet mund të jenë të shoqëruara me sindromën e Gorlin - Goltz (sindroma e nevuseve multiple me qeliza bazale). Trajtimi është kirurgjikal, duke përfshirë marsupializimin dhe enukleimin, ndërsa në raste të veçanta përdoren procedura më radikale si resekcioni segmental apo enblok. Për eliminimin e plotë të patologjisë dhe parandalimin e recidivit, trajtimi mund të kombinohet me metoda shtesë si aplikimi i solucionit të Carnoy - t apo osteotomia periferike.

Qëllimi: Qëllimi i punimit ishte përditësimi i njohurive mbi etiopatogjenezën, manifestimin klinik dhe trajtimin e keratocistës odontogjene përmes shqyrtimit të literaturës bashkëkohore, si dhe analiza e faktorëve që ndikojnë në zgjedhjen e metodës kirurgjikale më të përshtatshme.

Metodologjia: Punimi është realizuar në formë të rishikimit të literaturës.

Konkluzione: Keratocista odontogjene është një nga cistet më agresive odontogjene, me shkallë të lartë recidivimi. Për minimizimin e recidiveve janë shqyrtuar metoda të shumta kirurgjikale, përfshirë dekompresionin dhe enukleimin të kombinuara me teknika si ekscizioni i mukozës përreth, osteotomia periferike, krioterapia dhe aplikimi i solucionit të Carnoy - t. Trajtimi radikal përfshin resekcionin segmental dhe enblok, ndërsa përcjellja afatgjatë postoperative (5–10 vjet) është thelbësore për të shmangur recidivat.

Fjalë kyçe: Keratocistet odontogjene, sindroma Gorlin - Goltz.

PRESERVIMI I ALVEOLËS PAS EKSTRAKSIONIT TË DHËMBIT ME QASJE KIRURGJIKALE DHE JOKIRURGJIKALE.

Rinesa Hoti, Rina Selmani
Fakulteti i Mjekësisë, Dega Stomatologji, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

Abstrakt
Hyrje: Humbja e dhëmbit shoqërohet me ndryshime të shpejta dhe progresive në strukturën kockore të alveolës, përfshirë resorbimin horizontal dhe vertikal të kreshtës si dhe reduktimin e indit të butë përreth. Këto ndryshime ndodhin si pasojë e mungesës së ngarkesës funksionale dhe ndërprerjes së ushqyerjes vaskulare në zonën post-ekstraksionale, duke kompromet uar seriozisht vendosjen optimale të implanteve dentare dhe rezultatin final estetik dhe funksional. Rigjenerimi spontan i alveolës pas ekstraksionit shpeshherë nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur kërkesat funksionale dhe estetike të rehabilitimit të mëvonshëm protetik ose implantologjik. Në këtë kuadër, preservimi alveolar përfaqëson një ndërhyrje thelbësore parandaluese dhe restauruese, tashmë pjesë e protokolleve standarde të stomatologjisë bashkëkohore. Ajo realizohet përmes teknikave kirurgjikale dhe jokirurgjikale që stimulojnë osteogjenezën dhe ruajnë volumin alveolar.
Qëllimi: Të analizojë në mënyrë krahasuese dhe kritike qasjet kirurgjikale dhe jokirurgjikale në preservimin e alveolës pas ekstraksionit të dhëmbit, duke vlerësuar efektivitetin e tyre në ruajtjen e strukturës kockore dhe përgatitjen për trajtim të mëvonshëm me implante dentare.
Metodologjia: Punimi bazohet në rishikimin e literaturës shkencore dhe protokolleve klinike. Janë analizuar materialet më të përdorura për graftim kockor (autograft, allograft, xenograft, aloplast) dhe membranat mbrojtëse (resorbtive, joresorbtive, bioaktive), si dhe teknikat për ekstraksion atraumatik, stabilizimin e graftit dhe mbylljen e plagës.
Përfundime: Preservimi alveolar ndihmon në ruajtjen e strukturës kockore dhe përmirëson suksesin e rehabilitimit protetikor. Qasja kirurgjikale preferohet në rastet me deficite të mëdha kockore, ndërsa ajo jokirurgjikale në raste me strukturë të mirë alveolare. Zgjedhja bazohet në vlerësimin individual të rastit.

Fjalë kyçe: Preservimi alveolar, ekstraksion atraumatic, graft kockor, membranë mbrojtëse, qasje kirurgjikale, qasje jokirurgjikale, rigjenerim kockor, implant dentar.

SHËNDETI ORAL SI PASQYRË E SHËNDETIT TË PËRGJITHSHËM: RËNDËSIA E PARANDALIMIT.

Rineta Hyseni

Abstrakt
Qëllimi: Bazuar në faktin se goja nuk është një sistem i izoluar – ajo është një pasqyrë e rëndësishme dhe shpesh e hershme e shëndetit të përgjithshëm të organizmit, manifestimet e ndryshme që paraqiten në të nuk janë vetëm probleme lokale, mirëpo ato lidhen ngushtë me diabetin, sëmundjet kardiovaskulare, sëmundjet respiratore, komplikacionet gjatë shtatzënisë dhe madje edhe me çrregullime neurologjike dhe autoimune. Qëllimi i këtij punimi është të theksojë këtë marrëdhënie midis shëndetit oral dhe atij sistemik, duke vënë theks të veçantë te rëndësia e qasjes parandaluese në stomatologji.
Materiale dhe metoda: Ky punim është realizuar në trajtën e "rishikimit të literaturës", duke përdorur bazat e të dhënave në PubMed dhe Scopus, duke analizuar artikujt e botuar me fokus në këtë lidhje dypalëshe mes shëndetit oral, atij sistemik dhe strategjive parandaluese.
Rezultate: Literatura e shqyrtuar e konfirmon se shëndeti oral dhe ai sistemik janë thellësisht të ndërlidhur përmes mekanizmave inflamatorë dhe metabolikë. Gjetjet theksojnë se inflamacioni kronik oral, sidomos ai periodontal, nuk ndikon vetëm në indet lokale, mirëpo kontribuon në zhvillimin ose përkeqësimin e sëmundjeve sistemike egzistuese si diabeti ose sëmundje kardiovaskulare.
Përfundime: Lidhja mes shëndetit oral dhe shëndetit sistemik na sfidon të ndryshojmë mënyrën se si e perceptojmë dhe e menaxhojmë kujdesin shëndetësor. Një inflamacion i mishrave të dhëmbëve, një infeksion i pa trajtuar apo një shenjë e vogël në gojë, **mund të jenë tregues të hershëm të sëmundjeve sistemike që**

rrezikojnë jetën. Prandaj, **parandalimi, kontrollat e rregullta orale dhe bashkëpunimi ndërmjet profesionistëve shëndetësorë** janë çelës për të mbrojtur jo vetëm buzëqeshjen, por edhe zemrën, trurin, sistemin imunitar dhe jetën në tërësi.

Fjalë kyçe: Shëndeti oral, sëmundjet sistemike, parandalimi, periodontiti.

ROLI I INFERMIERIT NË STOMATOLOGJI: PËRFSHIRJA SI ASISTENTE DENTARE NË KIRURGJITË ORALE – PËRVOJA JONË ME MBI 1000 RASTE.

Rolanda Leka[1] Nderim Shefkiu[1], Krisli Serani MD[2]
[1]*Shërbimi i Stomatologjisë Plaza Dental*
[2]*Shërbimi i Anestezi Reanimacion, QSUT*

Abstrakt
Hyrje: Stomatologjia moderne ka njohur zhvillime të mëdha teknike dhe procedurale, duke rritur ndjeshëm nevojën për bashkëpunim multidisiplinar dhe mbështetje të specializuar në sallën dentare. Roli i infermierit, i trajnuar si asistent dentar, është bërë gjithnjë e më thelbësor jo vetëm në aspektin teknik, por edhe në garantimin e një procesi të sigurt, steril dhe të mirëorganizuar. Në praktikën kirurgjikale orale, ky bashkëpunim është kyç për realizimin me sukses të ndërhyrjeve, duke përfshirë nxjerrjet e dhëmbëve të komplikuar, implantologjinë, trajtimet me sedacion dhe kirurgjitë e indeve të buta apo të forta.
Qëllimi: Të evidentojmë rolin funksional dhe profesional të infermierëve të përfshirë si asistentë dentarë në kirurgjitë orale, bazuar në një eksperiencë konkrete me mbi 1000 raste në një periudhë 12 - mujore.
Materiale dhe metoda: U realizua një analizë retrospektive e 1080 ndërhyrjeve kirurgjikale orale të kryera në klinikën tonë nga maj 2024 deri në maj 2025, ku personeli infermieror ka luajtur rolin e asistentit dentar. U vlerësuan detyrat para, gjatë dhe pas ndërhyrjes, përfshirë përgatitjen e instrumenteve, asistencën intraoperative, kontrollin e sterilitetit, menaxhimin e materialeve të implantit dhe mbështetjen e pacientit gjatë periudhës postoperatorë.
Rezultate dhe Diskutime: Infermierët e trajnuar si asistentë dentarë kanë kontribuar në mënyrë aktive në çdo etapë të ndërhyrjes kirurgjikale. Ndihma në menaxhimin e urgjencave të vogla (hemorragji, ankth akut), optimizimi i kohës kirurgjikale, mbajtja e një ambienti të kontrolluar dhe komunikimi me pacientët rezultuan faktorë kyç që ndikuan në rrjedhën pozitive të procedurave. Përdorimi i protokolleve të standardizuara dhe bashkëpunimi efektiv me stomatologun rezultoi në efikasitet më të lartë dhe në reduktim të komplikacioneve pas ndërhyrjes.
Konkluzione: Përfshirja e infermierit si asistent dentar në kirurgjinë orale përmirëson ndjeshëm cilësinë e shërbimit, sigurinë e pacientit dhe organizimin e praktikës klinike. Ky rol kërkon trajnim të dedikuar, njohuri të procedurave orale dhe zotërim të protokolleve të sterilitetit dhe menaxhimit postoperator.
Rekomandime: Rekomandohet fuqimisht përfshirja e infermierëve të trajnuar në ekipet dentare, zhvillimi i trajnimeve të vazhdueshme në kirurgji orale dhe krijimi i standardeve kombëtare për rolin e asistencës infermierore në fushën e stomatologjisë.
Fjalë kyçe: Stomatologji, roli i infermierit, kirurgji orale.

EFEKTIVITETI I FURÇAVE ELEKTRIKE KUNDREJT ATYRE MANUALE NË KONTROLLIN E PLLAKËS DENTARE.

Rrona Huruglica[1], Jakup Ahmeti[2]
[1]*Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Stomatologjisë, Prishtinë, Kosovë*
[2]*Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Departamenti i Stomatologjisë, Tetovë, Maqedonia e Veriut*

Abstrakt
Kontrolli i pllakës dentare është thelbësor për ruajtjen e shëndetit optimal oral, duke parandaluar sëmundjet e zakonshme orale si kariesi dentar dhe sëmundjet periodontale. Larja e dhëmbëve është metoda primare për largimin mekanik të pllakës, me të dyja llojet e furçave – manuale dhe elektrike – që janë gjerësisht të disponueshme. Ky punim analitik rishikon dhe sintetizon në mënyrë sistematike literaturën shkencore aktuale

për të krahasuar efektivitetin e furçave elektrike kundrejt atyre manuale në kontrollin e pllakës dentare. Është kryer një kërkim i gjerë në disa baza të dhënash, duke u përqendruar në studime klinike, rishikime sistematike dhe meta - analiza të publikuara gjatë dy dekadave të fundit. Analiza tregon në mënyrë të qëndrueshme se furçat elektrike, veçanërisht ato me teknologji lëkundëse - rrotulluese dhe sonike, në përgjithësi tregojnë efikasitet më të lartë në largimin e pllakës dhe reduktimin e gingivitit në krahasim me furçat manuale. Kjo efektivitet më i lartë shpesh i atribuohet lëvizjeve të standardizuara të pastrimit, timerëve të integruar dhe sensorëve të presionit, të cilët reduktojnë variabilitetin që varet nga përdoruesi. Ndërsa teknika e duhur mbetet thelbësore për të dyja llojet e furçave, furçat elektrike mund të ofrojnë përparësi të veçanta për individët me kufizime motorike ose për ata që kanë vështirësi në larjen efektive manuale. Punimi përfundon me implikime për rekomandimet klinike dhe sugjerime për drejtimet e kërkimeve të ardhshme.

Fjalë kyçe: Furçë elektrike, furçë manuale, kontroll i pllakës, higjienë orale, gingivit, rishikim sistematik, meta - analizë.

LEZIONET ORALE TË SHKAKTUARA NGA PUNIMET PROTETIKE TË PËRDORURA.

Sherif Shaqri[1, 2], Kaltrina Beqiri[1], Edita Etemi[1]
[1]Klinika për protetikë stomatologjike "protetika ag" - tetovë
[2]Programi studimor për stomatologji, fakulteti i shkencave mjekësore, universiteti i tetovës

Abstrakt
Lezionet orale te mbajtësit e punimeve protetike përbëjnë një grup heterogjen ndryshimesh të indeve si në lidhje me patogjenezën, veçoritë klinike dhe histopatologjike, si dhe me komplikimet e mundshme. Punimet protetike mund të jenë shkaku i drejtpërdrejtë i këtyre gjendjeve, për shkak të ndryshimit të kushteve mjedisore të zgavrës së gojës dhe ngarkimit të indeve të buta dhe të forta të gojës. Gama e lezioneve orale në përgjithsi është e gjerë dhe e ranguar në grupe të caktuara duke filluar nga lezionet e bardha dhe ndjekur nga lezionet e kuqe, lezionet e zeza dhe ato braon, lezionet veziko buloze, lezionet ulcerative, lezionet papillare, zmadhimet e gingivës, tumoret dhe kistat e indeve të buta, ënjtjet ashtërore dhe të qafës, si dhe lezionet e buzëve. Lezionet orale të shkaktuara nga punimet protetike, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë janë temë shtjellimi i këtij prezentimi, ku në veçanti do t'i kushtohet kujdes etiologjisë, veçorive klinike dhe trajtimit të këtyre lezioneve, ndërsa diversiteti i këtyre lezioneve midis studimeve të ndryshme varet nga lloji, cilësia dhe materialet e protezave të bëra, teknikat e përdorura dhe metodat e miratuara për udhëzimet e pacientëve. Përdoruesit e punimeve protetike duhet të edukohen për rëndësinë e ekzaminimit periodik për shkak të ndryshimit të indeve mbështetëse dhe për zbulimin e lezioneve të hershme të mukozës, në mënyrë që të ruajnë higjenën e tyre orale dhe të protezave në një nivel optimal. Për më tepër, për të parandaluar ose minimizuar shtrirjen e lezioneve, shfrytëzuesit e punimeve protetike duhet rregullisht të paraqiten te mjeku stomatolog për ekzaminim të zgavrës së gojës dhe punimeve protetike.

Fjalë kyçe: Lezionet orale, pasojat, punimet protetike, përdorimi.

BRUKSIZMI.

Shkumbin Elezi, Erodita Kukaj

Abstrakt
Bruksizmi është mjaft i shpeshtë në praktikën e përditshme stomatologjike, andaj është shumë e rendësishme të kemi njohuri mbi mënyrën e trajtimit të tij. Në këtë punim, do të shtjellohen në mënyrë të detajuar çka është bruksizmi, llojet e tij, etiologjia, pasqyra klinike, diagnostifikimi dhe mënyrat e trajtimit. Brukasizmi është një shtrëngim i fortë, i pavetëdishëm i dhëmbëve në gjendje jofunksionale, që paraqitet si pasojë e faktorëve me natyrë psikogjene dhe okluzale. Klasifikohet në bazë të kohës së paraqitjes së tij. Për shkak të simptomatologjisë së tij, është shumë me rëndësi njohja e metodave bashkëkohore të parandalimit dhe trajtimit të tij, për të eliminuar pasojat që mund ti jep bruksizmi. Bruksizmi nuk është vetëm një problem stomatologjik, por mund të ndikojë edhe në cilësinë e jetës së pacientit, duke shkaktuar dhimbje koke, dhimbje në muskujt e nofullës dhe lodhje të përgjithshme. Faktorët psikologjikë si stresi, ankthi dhe tensioni emocional luajnë një rol të

rëndësishëm në shfaqjen dhe agravimin e bruksizmit. Për më tepër, faktorë të tjerë si çrregullimet e gjumit dhe disa medikamente mund të kontribuojnë gjithashtu në këtë gjendje. Ndaj, trajtimi i bruksizmit kërkon një qasje multidisiplinare që përfshin stomatologë, psikologë dhe specialistë të gjumit. Në këtë mënyrë, pacienti mund të përfitojë nga një diagnozë e saktë dhe një plan trajtimi i personalizuar, që do të ndihmojë në minimizimin e dëmtimeve dentare dhe përmirësimin e mirëqenies së përgjithshme.

Fjalë kyçe: Bruksizmi, problem stomatologjik, faktorë psikologjikë.

MALOKLUZIONET E KLASËS II ME ANKORIM SKELETIK.

Sidrit Beqiraj
Albanian University

Abstrakt
Malokluzionet e Klasës II në pacientët në rritje trajtohen me sukses me anë të aparateve funksionale të lëvizshme ose fikse. Aparatet fikse kanë treguar rezultate të mira edhe në pacientët pas pikut pubertal të rritjes. Megjithatë këto trajtime kanë edhe efekte të padëshiruara, siç janë vestibularizimi i incizivëve inferiorë, retroinklinimi i atyre posteriorë, gjë që mund të pengojë spostimin përpara të mandibulës. Mjetet e përkohshme të ankorimit te fiksuara direkt ne kockë, si miniplakat apo minividat të përdorura së bashku me aparatet funksionale fikse mund të zvogelojnë këto efekte anësore, duke përmirësuar profilin e pacientëve dhe adaptimin e indeve të buta. Këto gjetje janë mbështetur nga një numër studimesh klinike që evidentojnë përfitimet e kombinimit të teknikave të ndryshme ortodontike. Zgjedhja e metodës së trajtimit varet nga mosha skeletore e pacientit, shkalla e maloklucionit dhe objektivat terapeutike. Në praktikë klinike, një vlerësim i kujdesshëm i faktorëve individualë është thelbësor për të garantuar rezultate optimale dhe për të shmangur komplikimet afatgjata. Për më tepër, përfshirja e teknologjive të reja dhe protokolleve të personalizuara të trajtimit mund të rrisin efikasitetin dhe komoditetin gjatë procesit terapeutik.

Fjalë kyçe: Maloklucionet e klasës II, ankorim skeletik.

VLERËSIMI I RISKUT PROFESIONAL NDAJ HEPATITIT B NË KLINIKËN STOMATOLOGJIKE UNIVERSITARE, TIRANË.

Msc. Tanita Daci[1], Dr. Shk. Belisa Kaleci[2]
[1]*Doktorante në Shëndet Publik*
[2]*Epidemiologe, Klinika Stomatologjike Universitare, Tiranë*

Abstrakt
Hyrje: Hepatiti B përbën një nga sfidat më të mëdha të shëndetit publik, duke qënë një infeksion viral me rrezik të lartë për t'u transmetuar nëpërmjet gjakut dhe lëngjeve trupore. Personeli shëndetësor, vecanarisht ai stomatologjik, për shkak të natyrës së punës me ekspozim të shpeshtë ndaj gjakut dhe instrumenteve të mprehta, përbën një grup me risk të shtuar professional për infektim. Vlerësimi i nivelit të riskut dhe masave parandaluese të zbatuara është thelbësor për garantimin e sigurisë në praktikën klinike, si dhe përmirësimin e standardeve të kontrollit të infeksioneve në institucionet universitare.
Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë nivelin e riskut profesional ndaj infeksionit të hepatitit B tek personeli i Klinikës Stomatologjike Universitare në Tiranë, duke analizuar faktorët e ekspozimit, njohuritë mbi masat parandaluese, si edhe statusin e vaksinimit. Rezultatet synojnë të ofrojnë evidenca për forcimin e protokolleve të sigurisë dhe përmirësimin e strategjive të mbrojtjes së personelit shëndetësor.
Metodologjia: Studimi u realizua mbi bazën e një pyetësori të standartizuar, i cili u plotësua nga personeli (mjekësor dhe mbështetës) i Klinikës Stomatologjike Universitare, Tiranë. Pyetësori përmbante pyetje në lidhje me të dhënat demografike dhe profesionale të stafit (mosha, statusi civil, përvoja në vite pune në shëndetësi etj), të dhëna mbi ekspozimin e përditshëm ndaj mostrës së gjakut dhe instrumenteve prerëse, e po ashtu pyetje në lidhje me statusin e vaksinimit, dozat e vaksinave, dozën përforcuese, testimin ndaj sëmundjeve infektive etj. Të dhënat u përpunuan nëpërmjet programit SpSS, version 29.

Diskutime: Personeli mjekësor por jo vetëm, edhe ai mbështetës është i ekspozuar në mënyrë të vazhduar ndaj riskut për Hepatit B. Duhet theksuar se mbrojtja e pacientit fillon me mbrojtjen e personelit dhe se mbrotja më e mirë e personelit mbetet nëpërmjet vaksinimit sipas protokolleve në fuqi. Mosvaksinimi i stafit mbart pasoja të shumta, përtej riskut individual: ai cënon sigurinë e pacientit dhe shton ndjeshëm probabilitetin e përhapjes së infeksioneve në mjediset klinike.
Përfundime: 61 % e personelit mjekësor ishte e vaksinuar. Analiza cilësore e përgjigjeve evidentoi gjithashtu se personeli mbështetës kishte njohuri të kufizuara mbi mënyrat e transmetimit të Hepatitit B dhe mbi rëndësinë e vaksinimit si instrument parandalues. Kjo tregon për nevojën e menjëhershme për ndërhyrje edukative të strukturuara, si pjesë e trajnimeve të detyrueshme vjetore për të gjithë stafin.

Fjalë kyçe: Hepatitit b, vaksinim, infeksion viral me rrezik të lartë.

GABIMET GJATË PROCEDURAVE ENDODONTIKE.

Dr. Tauland Totaj

Abstrakt
Endodontia është një fushë e rëndësishme e stomatologjisë që fokusohet në trajtimin e infeksioneve dhe sëmundjeve të dhëmbëve, kryesisht duke trajtuar pulpën dhe kanalet radikulare. Pavarësisht avancimeve të mëdha teknologjike dhe teknikave të përmirësuara, gabimet gjatë procedurave endodontike mund të shkaktojnë komplikacione serioze dhe të ndikojnë negativisht në parashikimin e trajtimit. Ky abstrakt shqyrton disa nga gabimet më të zakonshme që ndodhin gjatë procedurave endodontike dhe pasojat e mundshme të tyre. Gabimet më të zakonshme përfshijnë gabime në përzgjedhjen e trajtimit të duhur, dështimin në pastrimin dhe dezenfektimin e duhur të kanaleve radikulare, gabimet në dimensionet dhe formën e kanaleve radikulare, dhe dështimin në mbushjen dhe sigurinë e kanalit radikular. Po ashtu, lëndimet e pulpës, perforimet e kanaleve dhe dështimet në përdorimin e materialeve të mbushjes janë gjithashtu shkaktarë të gabimeve që mund të ndikojnë në suksesin e trajtimit endodontik. Një nga gabimet më të rrezikshme është dështimi për të identifikuar dhe trajtuar kanale të dyta apo të pazbuluara, që mund të çojnë në rikthimin e infeksionit dhe kërkojnë trajtime të mëtejshme. Po ashtu, gabimet mekanike siç janë thyerjet e instrumenteve endodontike dhe përdorimi i teknologjive të pasakta mund të ndodhin, duke ndikuar në rezultatet e trajtimit. Në këtë punim, do të shqyrtojmë gjithashtu mënyrat për të minimizuar këto gabime, duke përfshirë përdorimin e teknologjive të avancuara siç janë radiografia digitale, mikroskopi endodontik dhe sistemet mekanike të pastrimit, dhe rëndësinë e një diagnostikimi të saktë dhe planifikimit të kujdesshëm të trajtimit. Shëndeti i pacientit dhe suksesiviteti i trajtimit endodontik varen nga zbatimi i teknikave të sakta dhe përdorimi i një qasjeje të kujdesshme dhe të qëndrueshme gjatë procedurave. Ky abstrakt synon të theksojë rëndësinë e edukimit dhe trajnimit të vazhdueshëm të profesionistëve të kujdesit dentar në evitimin e gabimeve dhe në rritjen e cilësisë së trajtimeve endodontike, duke kontribuar kështu në përmirësimin e rezultateve klinike dhe reduktimin e komplikacioneve.

Fjalë kyçe: Endodontia, trajtimi i infeksioneve, sëmundje e dhëmbëve, gabime.

RESTAURIMI I DHËMBËVE ANTERIORË TË TRAJTUAR NË MËNYRË ENDODONTIKE: INFLUENCA E GJATËSISË SË RINDËRTIMIT NË REZISTENCË NDAJ FRAKTURËS.

Tetore Olloni

Abstrakt
Objektiva: Ky studim synon të vlerësojë rezistencën ndaj frakturës së dhëmbëve anteriorë të trajtuar në mënyrë endodontike, të restauruar me rindërtime me gjatësi 5 mm dhe 10 mm.
Materiale dhe metoda: Dyzet e tetë incizivë intakt maksillarë u përzgjodhën për studim. Pas trajtimit endodontik, kurorat u prenë nën kufirin smalt - cement me efektin unazë, prej 2 mm. Rrënjët u ndanë rastësisht në katër grupe (n=4) sipas llojit dhe gjatësisë së rindertimit. Grupi 1 u restaurua me rindërtim fibër - post (10 mm), bërthamë kompoziti dhe një kurorë qeramike me mbulim të plotë; Grupi 2, me rindërtim fibër - post (5 mm), bërthamë kompozite dhe një kurorë qeramike me mbulim të plotë; Grupi 3, me rindërtim zirkonia (10 mm) dhe një kurorë qeramike me mbulim të plotë dhe Grupi 4, me rindërtim zirkonia (5 mm)dhe një kurorë

qeramike me mbulim të plotë. Çdo mostër u fut në një formë akrilike dhe iu nënshtrua testit të rezistencës ndaj frakturës duke përdorur makinën universale për testim nën ngarkesë kompresive me një shpejtësi prej 1. 0 mm / min deri në frakturë. Forca e nevojshme për frakturë tek çdo mostër u regjistrua dhe të dhënat e marra u analizuan ne aspektin statistikorë me ANOVA dhe chi - square testin. Mënyra e dështimit u përcaktua si frakturë e riparueshme ose e pariparueshme.
Rezultate: Vlerat më të larta të rezistencës ndaj frakturës ishin për dhëmbët e trajtuar në mënyrë endodontike të restauruar me rindërtime fibër - post. Kishte një ndryshim statistikisht të rëndësishëm midis rezistencës mesatare ndaj frakturës tek grupet e rindërtimeve të gjata dhe të shkurtëra (P> 0. 05) brenda llojit. Grupet e restauruara me rindërtime fiber - post paraqitën një numër më të lartë frakturash të riparueshme në krahasim me grupin tjetër.
Përfundime: Përdorimi i rindërtimeve të ndryshme do të përforcojë dhëmbin e kompromentuar, por lloji dhe gjatësia e rindërtimit do të ndikojnë në rezultatet përfundimtare. Rëndësia klinike edhe pse ky studim in vitro ka disa kufizime në lidhje me rëndësinë e tij klinike, restaurimi i dhëmbëve të përparmë të dëmtuar kryesisht me përdorimin e një rindërtimi të gjatë fibër - post mund të ketë avantazhe ndaj një rindërimi të shkurtër fibër - post.

Fjalë kyçe: Dhëmbë anteriorë, dhëmbë të trajtuar në mënyrë endodontike, rezistenca ndaj thyerjes.

VETITË OPTIKE TË QERAMIKAVE DENTARE.
Teuta Pustina

Abstrakt
Hyrje: Inovacioni i vazhdueshëm në materialet restauruese në sistemin CAD / CAM ka transformuar standardet estetike dhe funksionale të protetikës moderne.
Qëllimi: Ky studim In Vitro kishte për qëllim të vlerësonte vetitë optike të pesë sistemeve të qeramikave dentare CAD / CAM, duke matur dhe krahasuar vetitë e tyre në lidhje me transparencën dhe opaleshencën. Materialet e testuara përfshinë tre lloje të zirkoniumit monolitik me shkallë të ndryshme të transparencës, një qeramikë hibride të infiltruar me polimer dhe një qeramikë prej qelqi me litium disilikat, që u përdor si referencë.
Materiale dhe metoda: Në laborator teknik janë punuar gjithsej 100 mostra drejtkëndëshe (14 × 12 × 1 mm, ngjyra A2) dhe janë analizuar vetitë optike duke përdorur spektrofotometrin Vita Easyshade V në kushte të standardizuara, duke ndjekur sistemin e ngjyrave CIELAB (Commision International d'Eclaraige). Parametrat e transparencës (TP) dhe opaleshencës (OP) u krahasuan statistikisht duke përdorur ANOVA me një drejtim dhe testin post hoc të Bonferronit ($\alpha = 0.05$).
Rezultate: Treguan diferenca statistikisht të rëndësishme ($p < 0.05$) mes grupeve të testuara. Litium disilikati tregoi performancën optike më të mirë, i ndjekur nga qeramika hibride e infiltruar me polimer, ndërsa vetitë optike të zirkoniumit shfaqën vlera gjithnjë e më të ulëta të transparencës dhe opaleshencës në varësi të përbërjes dhe strukturës kristalore të tyre. Këto rezultate vërtetojnë se vetitë optike të materialeve qeramike varen nga organizimi i tyre mikroskopik dhe aftësia për të shpërndarë dritën. Klinikisht, kjo njohuri ofron udhëzime të vlefshme për zgjedhjen e materialeve në përputhje me kërkesat e materialeve restauruese.
Përfundime: Litium disilikati mbetet ideal për restaurimet në punimet protetike të sektorit interkanin, ku estetika është parësore; qeramikat hibride ofrojnë një kompromis të balancuar ndërmjet vetive optike dhe mekanike; ndërsa zirkoniumi, megjithëse më pak transparent, ofron forcë të pakrahasueshme për restaurimet në punimet protetike të sektorit postkanin. Studimi thekson rëndësinë e integrimit të shkencës optike në vendimmarrjen klinike për të arritur restaurime që harmonizojnë suksesin biologjik, mekanik dhe estetik.

Fjalë kyçe: CAD / CAM, litium disilikat, opaleshenca, qeramika hibride, transparencë, zirkoniumi.

PËRDORIMI I MIKROSKOPIT NË ENDODONCION - PËRPARËSITË DHE SFIDAT.

Dr. Ujvesa Bytyçi, Prof. Asoc. Dr. Donika Bajrami Shabani
Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë
QKSUK, Klinika e Sëmundjeve të Dhëmbit me Endodoncion

Abstrakt
Mikroskopi operator ka sjellë një revolucion të rëndësishëm në praktikën stomatologjike moderne, veçanërisht në fushën e endodoncisë. Përfitimet e shumta në aspektin klinik, diagnostik dhe terapeutik e bëjnë atë një mjet të domosdoshëm për të përmirësuar diagnostikimin dhe trajtimin e patologjive endodontike si: lokalizimi i kanaleve të fshehura, heqja e instrumenteve të thyera, menaxhimi i kalcifikimeve, perforimeve, ritrajtimet endodontike etj. Janë analizuar avantazhet teknike dhe klinike të mikroskopit, duke përfshirë zmadhimin, ndriçimin dhe mundësinë për dokumentim vizual në kohë reale. Krahasuar me instrumentet tradicionale, mikroskopi operator përmirëson cilësinë e trajtimit, duke lejuar ruajtjen maksimale të strukturave natyrale të dhëmbit. Po ashtu janë krahasuar dhe jane analizuar zbulumet e shumë shkencëtarëve, duke u marrë për bazë në përdorim. Një aspekt i rëndësishëm i mikroskopit është edhe ndikimi i tij në ergonomi, duke kontribuar në përmirësimin e pozicionit të stomatologëve gjatë punës dhe uljen e lodhjes muskulare në procedurat e zgjatura. Megjithatë, përfshinë disa sfida si kostoja e lartë dhe nevoja për një trajnim të dedikuar për përdorimin e duhur. Ky punim tregon rëndësinë gjithnjë në rritje të mikroskopit operator si një komponent thelbësor i stomatologjisë bashkëkohore, duke pasqyruar ndikimin e tij pozitiv në cilësinë e trajtimit, përmirësimin e rezultateve afatgjata dhe të përvojës së përgjithshme, si për pacientin ashtu edhe për mjekun stomatolog.

Fjalë kyçe: Mikroskopi operator, endodonci, diagnostikim, trajtim.

PËRDORIMI I KLORHEKSIDINËS NË STOMATOLOGJI.

Valbona Disha[1], Eni Disha[2]
[1]*Departamenti i Stomatologjisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University, 1001 Tiranë, Shqipëri*
[2]*Departamenti i Stomatologjisë, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, 1001 Tiranë, Shqipëri*

Abstrakt
Hyrje: Shpëlarësit orale përdoren gjerësisht në fushën e stomatologjisë për shkak të efekteve të tyre antiseptike. Disa prej tyre, veçanërisht ata që përmbajnë glukonat klorheksidine kanë treguar efekte të mira antibakteriale. Megjithatë, përdorimi i shpeshtë dhe i zgjatur i këtyre përbërësve, sidomos në stomatologji, mund të shoqërohet me efekte anësore të padëshiruara, si pigmentimi i dhëmbëve, ndryshimi i shijes dhe formimi i gurëzave subgingivale. Së fundmi, një shqetësim i rëndësishëm lidhet me zhvillimin e rezistencës mikrobiale.
Qëllimi: Të analizohen të dhënat më të fundit që lidhen me fenomenin e rezistencës mikrobiale, i cili përbën një sfidë të madhe në fushën e mjekësisë.
Metoda: Për këtë studim është kryer një kërkim literature me fjalët kyç klorheksidine, rezistenca bakteriale, avantazhet dhe disavantazhet e klorheksidinës. Në artikujt e zgjedhur përfshiheshin si studimet in vitro dhe in vivo.
Rezultate: Studime të shumta raportojnë një ulje të ndjeshmërisë ndaj klorheksidinës kur ajo përdoret në mënyrë të vazhdueshme, si dhe një rezistencë të kryqëzuar ndaj disa antibiotikëve. Nga efektet e tjera negative, ngjyrosja e dhëmbëve ishte më e shpeshta.
Konkluzione: Përdorimi i glukonatit te klorheksidinës është shoqëruar me një rritje të rezistencës ndaj disa klasave të antibiotikëve. Duke qenë se ky fenomen përbën një sfidë serioze për mjekësinë dhe stomatologjinë moderne, kërkohen studime të mëtejshme për të vërtetuar përfundimisht këto rezultate paraprake, ndërkohë rekomandohet kujdes në përdorimin e klorheksidinës.

Fjalë kyçe: Klorheksidina, rezistenca, ekspozimi, toleranca.

RESORBIMI FIZIOLOGJIK I RRËNJËVE TË DHËMBËVE TË PËRHERSHËM TEK NJË FËMIJË 10 - VJEÇAR ME DIABET MELLITUS TIPI 1.

Vesa Hoxhaj
Klinika Dentare 'Nardent" Prizren, Kosovë

Abstrakt
Resorbimi i rrënjëve të dhëmbëve të përhershëm është një fenomen shumë i rrallë në fëmijët para - adoleshentë dhe zakonisht lidhet me faktorë patologjikë lokalë ose sistemikë. Qëllimi i këtij punimi është të paraqesë një rast klinik të resorbimit fiziologjik të rrënjëve të molarëve të përhershëm tek një fëmijë 10 - vjeçar me diabet mellitus tipi 1 dhe të diskutojë ndikimin e diabetit në zhvillimin dhe ruajtjen e strukturave dentare. Pacientja, 10 vjeç, me histori mjekësore të diabetit mellitus tipi 1 të trajtuar me insulinë tri herë në ditë, u paraqit në klinikë për vlerësim stomatologjik. U realizua ekzaminim klinik dhe radiografik (ortopantomografi dhe bite - wing). U analizuan faktorët oralë dhe sistemikë që mund të kenë kontribuar në procesin e resorbimit të rrënjëve të molarëve të përhershëm. Ekzaminimi radiografik tregoi resorbim të dukshëm të rrënjëve të molarëve të përhershëm, sidomos në dhëmbët e poshtëm, të shoqëruar me karies të avancuar. Pacientja nuk paraqiste shenja inflamatore akute, por kishte histori të diabetit të pakontrolluar dhe higjienë orale të pamjaftueshme. Ky rast klinik tregon se diabeti mellitus tipi 1 mund të ndikojë në proceset fiziologjike të zhvillimit dentar, duke përshpejtuar resorbimin e rrënjëve përmes ndryshimeve metabolike, inflamacioneve kronike dhe dëmtimit të qarkullimit mikrovaskular. Ndjekja e rregullt stomatologjike dhe bashkëpunimi ndërmjet mjekut endokrinolog dhe stomatologut janë thelbësore për parandalimin e komplikimeve orale te fëmijët me diabet.

Fjalë kyçe: resorbimi i rrënjëve, dhëmbët e përhershëm, diabet mellitus tipi 1, fëmijë, karies dentar.

KRAHASIMI I INTENSITETIT TË DHIMBJES TEK PACIENTËT ME ÇRREGULLIM TË NYJES TEMPOROMANDIBULARE PAS TRAJTIMIT ME ARTROCENTEZË ME ACID HIALURONIK KUNDREJT ARTROCENTEZËS ME KORTIKOSTEROIDE.

Vesna Goshic Markovska

Abstrakt
Hyrje: Çrregullimi i nyjes temporomandibulare (TMJD) është një gjendje multifaktoriale që ndryshon funksionimin normal të nyjes temporomandibulare (TMJ), muskujve mastikë dhe indeve të buta përreth. Karakterizohet nga dhimbje të forta dhe lëvizje të kufizuara të mandibulës.
Objektivi: Të krahasohen nivelet e dhimbjes, të vlerësuara nëpërmjet Shkallës Analoge Vizuale (VAS), para trajtimit dhe gjatë një periudhe ndjekjeje 90 - ditore tek pacientët e trajtuar me artrocentezë të kombinuar me kortikosteroide kundrejt atyre të trajtuar me artrocentezë dhe acid hialuronik.
Materiale dhe metoda: Ky studim klinik prospektiv, gjatësor, përfshinte 60 pacientë të moshës 18 deri në 65 vjeç të diagnostikuar me TMJD. Pjesëmarrësit u caktuan rastësisht në dy grupe me nga 30 secili. Grupi i parë iu nënshtrua artrocentezës së TMJ - së e ndjekur nga aplikimi i kortikosteroideve (CS), ndërsa grupi i dytë iu nënshtrua artrocentezës me injeksion intra - artikular të acidit hialuronik (HA). Vlerësimet e dhimbjes u kryen para ndërhyrjes, pastaj 7 ditë, 30 ditë, 60 ditë dhe 90 ditë pas procedurës. Nivelet subjektive të dhimbjes u vlerësuan duke përdorur pyetësorin VAS.
Rezultate: Një ulje statistikisht e rëndësishme e dhimbjes u vu re si në ditën e 60 - të ashtu edhe në atë të 90 - të pas ndërhyrjes. Konkretisht, në 60 ditë, grupi i trajtuar me acid hialuronik tregoi nivele dhimbjeje dukshëm më të ulëta krahasuar me grupin e kortikosteroideve (Z = - 3. 014; p = 0. 003). Ky ndryshim ishte edhe më i theksuar në 90 ditë (Z = - 4. 137; p < 0. 0001).
Përfundime: Të dy grupet e trajtimit përjetuan një ulje statistikisht të rëndësishme të dhimbjes, me grupin e acidit hialuronik që tregoi rezultate superiore në 60 dhe 90 ditë pas trajtimit.

Fjalë kyçe: Çrregullim i nyjes temporomandibulare, artrocentezë, acid hialuronik, kortikosteroid.

SI NDIKON SHTATËZANIA DHE GJIDHËNIA NË SHËNDETIN ORAL. KUJDESI QË DUHET TË TREGOJMË.

Xheka Saliasi
Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Fakulteti i Mjekësisë Dentare.

Abstrakt

Hyrje: Dëgjojmë shumë shpesh në praktikën dentare që pacientet ankohen: *"Shtatzënia na shkatërroi dhëmbët. "* Problemet që vihen re më shpesh te pacientet shtatzëna janë problemet gingivare dhe kariesi dentar. Ka paciente që nuk e kuptojnë ndikimin që ka mbajtja e higjienës orale në agravimin e problemeve të shëndetit oral gjatë shtatzënisë dhe gjidhënies. Kjo më shtyu të trajtoj këtë temë, duke u munduar të informojmë pacientet në mënyrë që problemet dentare në këto grupe pacentesh të parandalohen ose të menaxhohen në kohën e duhur.

Objektiva: Njohja e përgjithshme me problematikat e shëndetit oral gjatë shtatzënisë dhe gjidhënies; njohja me faktorët që mund të shkaktojnë probleme të tilla; njohja me mënyrën se si mund t'i parandalojmë; njohja me masat që duhen marrë për trajtimin e këtyre problemeve dentare dhe gingivare në këto paciente.

Materiale dhe metoda: Gjatë këtij punimi janë përdorur të dhëna konkrete nga praktika e përditshme dentare, të dhëna nga studime rastesh, burime nga interneti, materiale nga leksionet e Dr. Adem Alushit, libri *"Dental Management of the Pregnant Patient"* nga Christos Skouteris*, "Pregnancy and Oral Health"* nga Sheila Wolf, dhe libri *"Dentistry and the Pregnant Patient"* nga Daniel Ninan.

Rezultate: Është vënë re që shumë paciente shtatzëna paraqiten me probleme gingivare dhe dentare në praktikën tonë dentare. Ka gjithashtu paciente që nuk arrijnë ta kuptojnë rëndësinë e higjienës orale në përkeqësimin e këtyre problemeve. Duhet realizuar edukimi i pacienteve shtatzëna apo në gjidhënie që të mos anashkalojnë ruajtjen e higjienës orale dhe konsultimin me dentistin që në fazat e para të shfaqjes së problemit gingivar apo dentar.

Fjalë kyçe: paciente, higjiena orale, dentar, gingiva, probleme, dentist.

KRAHASIMI I MATERIALEVE DENTARE RESTAURUESE NË PROTETIKËN FIKSE: QERAMIKA KUNDREJT ZIRKONIT.

Xhesjana Duli

Abstrakt

Zhvillimi i restaurimeve fikse dentare përfaqëson një ndër aspektet më delikate dhe më të rëndësishme të rehabilitimit oral, ku suksesi afatgjatë nuk varet vetëm nga aftësitë teknike të profesionistëve, por edhe nga zgjedhja e materialeve më të përshtatshme. Në vitet e fundit, teknologjitë dentare kanë avancuar ndjeshëm, duke sjellë në fokus materiale me performancë të lartë si zirkoni monolitik, që konkurrojnë me qeramikat tradicionale të përdorura prej dekadash. Ky punim ka lindur nga nevoja për të kuptuar më mirë ndryshimet dhe ngjashmëritë midis këtyre dy materialeve, jo vetëm në aspektin teorik, por edhe praktik, duke analizuar karakteristikat e tyre në përpunimin laboratorik, qëndrueshmërinë funksionale, estetikën klinike, biokompatibilitetin dhe pritshmëritë në kohë. Përmes një përqasjeje krahasuese, synohet të identifikohen avantazhet dhe kufizimet e secilit material, në mënyrë që zgjedhja restauruese të mos jetë vetëm rutinë teknike, por një vendim i informuar dhe i personalizuar sipas rastit klinik. Përmes këtij punimi, është dashur të vendos në qendër jo vetëm të dhëna të bazuara në literaturën shkencore dhe në përvojën laboratorike, por edhe mendimin e profesionistëve në praktikë, të cilët përballen çdo ditë me zgjedhje klinike që ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin, funksionalitetin dhe estetikën orale të pacientëve. Ky studim përbën një përpjekje për të ndihmuar në orientiminmë të saktë në përzgjedhjen e materialeve restauruese fikse duke kontribuar në përmirësimin e standardeve të punës në protetikën moderne.

Fjalë kyçe: restaurime, fikse, qeramika, estetika orale, materiale restauruese, protetika moderne.

NGA PREFERENCA TEK PERFORMANCA: NJË KRAHASIM ANALITIK I ZGJEDHJES SË PASTAVE TË DHËMBËVE NGA STUDENTËT DHE EFIKASITETIT TË ZBARDHIMIT DUKE PËRDORUR UDHËZUESIN E NGJYRAVE DENTARE.

Danjel Cani, Xhini Rizaj
Universiteti Western Balkans

Abstrakt

Hyrje: Preferencat e konsumatorëve për pastat e dhëmbëve shpesh ndikohen nga imazhi i markës, shija dhe pretendimet për zbardhueshmëri, më tepër sesa nga performanca e verifikuar klinikisht. Megjithëse shumë produkte reklamohen për efektin e tyre zbardhues, ekziston pak evidencë shkencore që lidh preferencat e përdoruesve me rezultatet reale klinike.

Qëllimi: Ky studim synon të krahasojë preferencat e studentëve për pastat e dhëmbëve me performancën e tyre reale të zbardhimit, të matur në mënyrë objektive me një udhëzues standard të nuancave dentare. U analizuan gjithashtu ndryshimet në sjellje dhe perceptim midis studentëve të stomatologjisë dhe atyre të degëve te tjera.

Metodologjia dhe materialet: Një pyetësor elektronik (Google Form) u shpërnda për 100 studentë universitarë (50 të stomatologjisë dhe 50 të degeve te tjera) në Western Balkans University, për të identifikuar tre markat më të preferuara të pastave të dhëmbëve. Gjashtë dhëmbë të ekstraktuar u vendosën me një tretësirë kafe–cola për shtatë ditë në 37 °C. Mostrat u ndanë në tre grupe (n = 2) dhe u pastruan dy herë në ditë për shtatë ditë me pastat e përzgjedhura. Ndryshimi i ngjyrës u vlerësua vizualisht me Udhëzuesin Klasik të Ngjyrave Dentare VITA, duke u dhënë vlerave numerike përkatëse. Përmirësimi i zbardhimit u shpreh si ndryshimi i njësisë së udhëzuesit të ngjyrave (ΔSGU = vlera fillestare – vlera përfundimtare).

Rezultate: Të gjitha pastat e testuara treguan efekt zbardhues, me vlera mesatare ΔSGU prej 7. 0 ± 0. 7 për Pastën A, 4. 8 ± 0. 8 për Pastën B, dhe 2. 8 ± 0. 7 për Pastën C ($p < 0.05$). Studentët e stomatologjisë theksuan më shumë përmbajtjen e fluorit dhe pretendimet klinike, ndërsa studentët e tjerë u udhëhoqën kryesisht nga shija dhe marka.

Fjalë kyçe: Pastë dhëmbësh; zbardhueshmëri; Udhëzues i Ngjyrave Dentare; studentë; sjellje konsumatori; heqje njollash.

ABSTRAKTET E FARMACISË

ABSTRACTS OF PHARMACY

NËNTOR 2025 | NOVEMBER 2025

NANOSISTEMET NË LËKURË: TRAJTIMI I AVANCUAR I DERMATITIT ATOPIK PËRMES NANOSISTEMEVE LIPIDIKE.

Blina Kastrati, Adhurim Bresa, Elira Berisha

Abstrakt

Dermatiti atopik është një sëmundje kronike inflamatore e lëkurës që karakterizohet nga barrierë epidermale e dëmtuar, inflamacion i përsëritur dhe kruarje e vazhdueshme. Terapitë tradicionale shpesh kufizohen nga biodisponibiliteti i ulët lokal dhe efektet anësore sistemike, ndaj kërkohen strategji më të avancuara terapeutike. Nanosistemet dermale kanë tërhequr vëmendje për aftësinë e tyre në rritjen e depërtimit transdermal, shpërndarjen e synuar dhe lirimin e kontrolluar të përbërësve aktivë. Midis tyre, liposomet, ethosomet, nanosferat polimerike dhe nanolipid carrier (NLC) paraqesin alternativa premtuese. NLC - të përfaqësojnë gjeneratën e avancuar të sistemeve lipidike, duke kombinuar lipide të ngurta dhe të lëngshme për të arritur ngarkesë më të lartë të substancave aktive, stabilitet më të mirë dhe efikasitet terapeutik të shtuar. Përdorimi i nanosistemeve ka treguar ndikim të rëndësishëm në përmirësimin e terapisë së dermatitit atopik, duke hapur mundësi të reja për aplikime më efektive dhe më të sigurta në dermatologji.

Fjalë kyçe: Dermatiti atopik, nanosistemet lipidike, depërtim transdermal, nanolipid carrier (NLC), efikasitet terapeutik.

VAKSINAT INTRANAZALE: POTENCIALI, PËRPARËSITË DHE SFIDAT NË IMUNIZIMIN MODERN.

Elira Berisha, Adhurim Bresa, Blina Kastrati

Abstrakt

Hyrje: Vaksinimi ka qenë një nga arritjet kryesore në kontrollin e sëmundjeve infektive. Vaksinat tradicionale, të administruara në menyrë parenterale, nxisin kryesisht imunitetin sistemik, por jo atë mukozal. Vaksinat intranazale synojnë mukozën respiratore dhe stimulojnë prodhimin e sIgA, antitrupi kryesor që neutralizon patogjenët në hyrje. Kjo formë vaksinimi ofron përparësi të shumta, përfshirë: lehtësinë e administrimit pa nevojë për gjilpëra, rritjen e përputhshmërisë së pacientëve, potencialin për shpërndarje masive në raste emergjente, dhe induktimin e një përgjigjeje imune të dyfishtë – si mukozale, ashtu edhe sistemike. Megjithatë, sfida të rëndësishme mbeten ende, si stabiliteti i vaksinës, nevoja për adjuvantë të përshtatshëm, dhe sigurimi i efikasitetit afatgjatë. Studimet e fundit mbi vaksinat intranazale për gripin, COVID - 19 dhe patogjenë të tjerë respiratorë kanë treguar rezultate premtuese, duke sugjeruar se kjo platformë mund të bëhet një shtyllë e rëndësishme në imunizimin global. Ky prezantim do të shqyrtojë avantazhet, kufizimet dhe perspektivat e ardhshme të vaksinave intranazale, me theks të veçantë në rolin e tyre për përmirësimin e strategjive të shëndetit publik.

Fjalë kyçe: vaksinat intranazale, imuniteti mukozal, sIgA, infeksionet respiratore, strategjitë e vaksinimit.

FARMAKOGJENETIKA E STATINEVE.

Agon Krasniqi

Abstarkt

Statinet janë barna të cilat përdoren për trajtimin dhe prevencionin e komplikimeve të cilat vijnë si pasojë e sëmundjes aterosklerotike. Sëmundja aterosklerotike kardiovaskulare karakterizohet nga formimi i pllakës aterosklerotike në enët e gjakut të zemrës, trurit, arteries renale, arteries popliteale. Kjo sëmundje paraqitet kur nivelet e LDL - C në gjak janë më të larta se vlera normale. Kur kemi rritje të nivelit të LDL - C në gjak dhe kur në arterie kemi dëmtimin endotelial, atëherë vjen deri te formimi i pllakës aterosklerotike. Kjo pllakë me kohë mund të destabilizohet dhe të shprehë efektin trombogjenik të saj, me ç'rast pason formimi i trombit e pastaj tromboembolia dhe paraqitja e eventeve kardiovaskulare. Statinet janë barna që parandalojnë këto evente duke inhibuar sintezën e kolesterolit në mëlçi. Vendi i veprimit të tyre është inhibimi i HMG - CoA reduktazës. Në disa pacientë janë vërejtur efekte të padëshiruara të statineve duke përfshirë miozitë apo edhe rabdomiolizë.

Përveç shkaqeve sekondare që ndikojnë në paraqitjen e tyre, roli kryesor i atribuohet farmakogjenetikës së statineve apo gjeneve të cilat janë përgjegjëse për kodimin e proteinave të cilat marrin pjesë në marrjen, metabolizmin apo eliminimin e statineve nga organizmi. Ato, madje, mund të jenë përgjegjëse edhe për efektet e padëshiruara të rralla të cilat janë hepatotoksiciteti dhe neurotoksiciteti.

Fjalë kyçe: Statinet, trajtim, sëmundje aterosklerotike kardiovaskulare.

PËRDORIMI RACIONAL I ANTIBIOTIKËVE.

Alma Shabani

Abstrakt

Përdorimi i antibiotikëve është një nga arritjet më të mëdha të mjekësisë moderne, por përdorimi i pakontrolluar dhe jo racional ka çuar në rritjen e rezistencës bakteriale dhe komplikimeve të tjera shëndetësore. Ky punim synon të shqyrtojë praktikat aktuale të përdorimit të antibiotikëve, faktorët që ndikojnë në përdorimin jo racional, dhe strategjitë për optimizimin e tyre në praktikën mjekësore. Metodologjia e punimit përfshin një rishikim të literaturës së fundit shkencore dhe udhëzimeve ndërkombëtare për përdorimin e antibiotikëve. Rezultatet tregojnë se ndërhyrjet edukative, protokollet klinike të standardizuara dhe monitorimi i rregullt i përdorimit të antibiotikëve janë faktorë kyç për reduktimin e rezistencës bakteriale dhe përmirësimin e efikasitetit të trajtimit. Përdorimi racional i antibiotikëve është i domosdoshëm për ruajtjen e efektivitetit të tyre dhe për parandalimin e krizave të shëndetit publik.

Fjalë kyçe: antibiotikë, përdorim racional, rezistencë bakteriale, shëndetësi, protokolle klinike.

SISTEMET E AVANCUARA TË SHPËRNDARJES NË FORMULIMET ORALE TË HEKURIT: ANALIZË KRAHASUESE E HEKURIT BISGLICINAT, HEKURIT SUKROSOMIAL DHE SULFATIT TË HEKURIT NË PRAKTIKËN KLINIKE.

Ani Tusha, Ledjan Malaj, Brunilda Myftari
Departamenti i Farmacisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Qëllimi: Të vlerësohet dhe të krahasohet efektiviteti klinik dhe tolerueshmëria e tre formulimeve orale të hekurit - hekuri bisglicinat, hekuri sukrosomial dhe sulfati i hekurit—në trajtimin e anemisë nga mungesa e hekurit, me fokus tek përparimet bioteknologjike të formulimit dhe rezultatet e pacientëve.

Metodologjia: Një studim pilot vëzhgues në kushte reale u krye, ku morën pjesë tre mjekë të përgjithshëm, secili duke monitoruar 10 pacientë të diagnostikuar me anemi nga mungesa e hekurit (n=30 gjithsej). Pacientët u caktuan të merrnin një nga tre formulimet e hekurit. Parametrat hematologjikë bazë dhe pas trajtimit—hemoglobina, ferritina serike, sideremia dhe TIBC—u matën duke përdorur aparaturë diagnostike Roche. Pacientët u ndoqën nën të njëjtat udhëzime dietike dhe gjatë të njëjtit interval trajtimi.

Rezultate: Hekuri sukrosomial tregoi tolerueshmërinë më të lartë dhe përmirësim të dukshëm të niveleve të ferritinës serike. Hekuri bisglicinat shfaqi efikasitet mesatar me më pak efekte anësore gastrointestinale, ndërsa sulfati i hekurit, edhe pse efektiv në rritjen e hemoglobinës, u shoqërua me një incidencë më të lartë të shqetësimeve gastrointestinale dhe ndërprerjes së trajtimit tek disa pacientë.

Përfundime: Formulimet e avancuara bioteknologjike si hekuri sukrosomial dhe hekuri bisglicinat ofrojnë alternativa premtuese ndaj kripërave tradicionale të hekurit, duke përmirësuar bashkëpunimin e pacientit dhe duke minimizuar efektet anësore. Janë të nevojshme studime të mëtejshme të rastësishme për të konfirmuar këto gjetje.

Fjalë kyçe: formulime orale, analizë krahasuese, hekur bisglicinat, hekur sukrosomial, sulfat hekuri.

STUDIM MBI TRAJTIMET E MANIFESTIMEVE DERMATOLOGJIKE NË PACIENTËT DIABETIKË.

hhhhBrunilda Myftari, Dea Gaçaj
Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Farmacisë.

Abstrakt

Hyrje: Diabeti mellitus është një nga sëmundjet kronike më të përhapura në nivel global, i shoqëruar jo vetëm me komplikacione metabolike dhe vaskulare, por edhe me manifestime kutane që shpesh paraqiten si shenja të hershme klinike. Identifikimi i ndryshimeve të lëkurës është thelbësor për diagnostikimin, menaxhimin dhe parandalimin e ndërlikimeve të avancuara.

Qëllimi: Ky studim ka qëllim të analizojë llojet më të shpeshta të manifestimeve kutane tek pacientët me diabet mellitus, lidhjen e tyre me faktorët klinikë dhe biokimikë të sëmundjes. Një pjesë e rëndësishme e punimit fokusohet tek opsionet terapeutike farmaceutike, duke analizuar si preparatet standarde të tregut, ashtu edhe mundësitë e personalizimit përmes formulimeve magjistrale.

Metodologjia: Është kryer një kërkim në literaturën shkencore vendase dhe të huaja duke përdorur motorët e kërkimit si MPDI, Research Gate, Pubmed, Google Scholar. Kriteret e përzgjedhjes ishin periudha kohore 2020 deri në 2025 dhe fjalë kyçe si Diabetus mellitus, manifestime kutane, trajtim, efikasitet, topik. Në bazë të këtyre kritereve janë përzgjedhur artikujt dhe botimet shkencore që janë analizuar në këtë mikrotezë. Ky punim vlerëson gjithashtu preparatet topike të përdorura në praktikën mjekësore për trajtimin e manifestimeve kutane tek pacientët me Diabet Mellitus.

Rezultate: Manifestimet dermatologjike tek pacientët me diabet mund të parandalohen duke mbajtur nën kontroll gliceminë. Për sa i përket efikasitetit të trajtimeve dermatologjike mund të thuhet se trajtimet topike, si mupirocina për infeksionet bakteriale dhe ciklopiroksina për infeksionet mykotike, tregojnë rezultate të mira në reduktimin e simptomave. Po kështu preparatet hidratuese me ure, lanolinë, vazelinë dhe vitamina janë efektive në menaxhimin e kserozës dhe parandalimin e plagëve.

Përfundime: Menaxhimi i pacientëve me diabet duhet të jetë multidisiplinar, duke përfshirë mjekun endokrinolog, dermatologun dhe farmacistin, ku farmacisti ka rolin kyç për afërsinë që ka me pacientin. Farmacisti mund të kontribuojë në monitorimin e hershëm dhe edukimin e pacientëve. Gjithashtu optimizimi i preparateve dermatologjike dhe bashkëpunimi i duhur mes tre hallkave mjek - pacient - farmacist mund të përmirësojnë ndjeshëm përmirësimin e gjendjes së lëkurës.

Fjalë kyçe: Diabetus mellitus, manifestime kutane, trajtim, efikasitet.

SHKAKTARËT INTESTINALË TË SËMUNDJEVE AUTOIMUNE: LIDHJA MIDIS ALERGENËVE USHQIMOR, MIKROBIOTËS DHE ÇRREGULLIMIT IMUN.

Dafinë Kastrati BajÇinca
Farmaciste Përgjegjëse, Farmacia Living Pharmacy
Universiteti i Zagrebit, Fakulteti i Farmacisë

Abstrakt

Trakti gastrointestinal funksionon si rregullator qendror i ekuilibrit imun, duke integruar ndërveprime komplekse midis antigjeneve ushqimore, mikrobiotës së zorrëve dhe barrierës intestinale. Çrregullimi i këtij ekuilibri lidhet gjithnjë e më shumë me zhvillimin e sëmundjeve autoimune, përfshirë sëmundjen celiake, diabetin tip 1, artritin reumatoid, sklerozën multiple dhe sëmundjet inflamatore të zorrëve. Evidencat aktuale tregojnë se mekanizma të tilla si modifikimi i nyjeve të ngushta të mediuara nga zonulina, ngjashmëria molekulare midis peptidëve mikrobal ose ushqimor dhe antigjeneve të trupit, si dhe çrregullimet në metabolizmin e acideve yndyrore me zinxhir të shkurtër, kontribuojnë në disregullimin imun. Zakone të ndryshme ushqimore luajnë një rol vendimtar: ndjekja e një diete mesdhetare, të pasur me fibra, mbështet diversitetin mikrobal dhe integritetin mukozal, ndërsa konsumimi i ushqimeve të përpunuara promovon disbiozën dhe inflamacionin sistemik. Ky studim eksploron gjithashtu strategjitë terapeutike të drejtuara nga mikrobioma përfshirë probiotikët, prebiotikët dhe molekulat bioaktive të vogla si derivatet 1, 4 - naftokinone (MNQ dhe Lawsone) të cilat tregojnë potencial në rikthimin e tolerancës imune dhe homeostazës intestinale. Të dhënat epidemiologjike rajonale nga Kosova tregojnë një rritje të prevalencës së sëmundjeve autoimune, duke theksuar rëndësinë e ndërhyrjeve parandaluese dhe të personalizuara, bazuar në dietë dhe modulimin e

mikrobiotës. Duke integruar faktorët ushqimorë, mikrobal dhe stilin e jetesës, ky studim propozon një kuadër translacional dhe individual për rregullimin imun, duke theksuar zorrët si një portë terapeutike për menaxhimin e sëmundjeve autoimune.

Fjalë kyçe: Mikrobiota e zorrëve, alergjitë ushqimore, sëmundjet autoimune, permeabiliteti intestinal, terapia ushqimore, modulim imun.

NDRYSHIMI I KLASIFIKIMIT TË BARNAVE NGA ME RECETË (RX) NË PA RECETË (OTC): NJË PERSPEKTIVË RREGULLATORE.

MSc. Dea Kristina Cenomeri[1], MSc. Orion Dido[2]
[1]*Specialiste, Sektori i Autorizimit për Tregtim dhe Çështjeve Rregullatore, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore*
[2]*Inspektor, Sektori i Inspektimit, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.*

Abstrakt
Hyrje: Rritja e ndërgjegjësimit të pacientëve dhe nxitja e vetëkujdesit kanë çuar në një rishikim global të mënyrës së klasifikimit të barnave. Kalimi i një bari nga statusi me recetë (Rx) në pa recetë (OTC) synon të lehtësojë qasjen e pacientëve ndaj trajtimeve për sëmundje të lehta, pa cënuar sigurinë e përdorimit. Ky proces, i udhëhequr nga autoritetet rregullatore, kërkon balancë midis aksesit publik dhe kontrollit profesional.
Qëllimi: Analizimi nga këndvështrimi rregullator i procesit të ndryshimit të klasifikimit të barnave nga me recetë në pa recetë, kriteret që merren në konsideratë gjatë vlerësimit, si dhe rëndësia e përditësimit të listave kombëtare për të reflektuar zhvillimet ndërkombëtare.
Materiale dhe Metoda: U realizua një analizë përshkruese e kritereve rregullatore të përdorura në vende të ndryshme për miratimin e kalimit të barnave në statusin OTC, përfshirë kriteret e sigurisë, efikasitetit, përvojës pas - marketingut dhe nivelit të vetëvlerësimit nga pacienti. U shqyrtua gjithashtu kuadri shqiptar për listën e barnave pa recetë.
Rezultate dhe Diskutime: Riklasifikimi i barnave kërkon të dhëna të besueshme mbi sigurinë dhe përdorimin racional në kushte reale. Autoritetet rregullatore ndërkombëtare shpesh vendosin kufizime në dozë, paketim ose indikacione për të ruajtur kontrollin profesional dhe sigurinë e pacientit. Në Shqipëri, lista aktuale e barnave OTC përbën një hap të rëndësishëm drejt përafrimit me praktikat europiane, por zhvillimet e fundit në tregjet ndërkombëtare, ku shumë barna janë riklasifikuar si OTC, tregojnë nevojën për një përditësim të saj, në mënyrë që të reflektojë ndryshimet e reja dhe të përmirësojë aksesin e qytetarëve në barna të sigurta.
Përfundime: Ndryshimi i klasifikimit të barnave është një proces dinamik që duhet të mbështetet në të dhëna shkencore dhe në monitorim të vazhdueshëm pas tregtimi. Për Shqipërinë, përditësimi periodik i listës së barnave OTC do të ndihmojë në harmonizimin me praktikat europiane, rritjen e aksesit të pacientëve dhe promovimin e përdorimit racional të barnave.

Fjalë kyçe: barnat OTC, perspektivë rregullatore, siguri e pacientit, përdorim racional, autorizim për tregtim.

EFEKTIVITETI I BARNAVE BIOLOGJIKE NË TRAJTIMIN E ARTRITIT REUMATOID: RISHIKIM LITERATURE.

Dorela Hasankolli[1], Mirela Miraci[1], Entela Haloçi[1], Teuta Backa[2], Marsida Mulaj[3], Fatjola Ferrollari[1]
[1]*Universiteti i Mjekësisë, Departamenti i Farmacisë, Tiranë, Albania*
[2]*Departamenti i Reumatologjisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tirane, Albania*
[3]*Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Tiranë, Albania*

Abstrakt
Artriti reumatoid (RA) është një sëmundje inflamatore kronike autoimune që shkakton dhimbje, ngurtësim dhe deformime të nyjeve, duke ndikuar ndjeshëm në cilësinë e jetës së pacientëve. Barnat biologjike kanë revolucionarizuar trajtimin e RA, veçanërisht tek pacientët që nuk përgjigjen ndaj terapive konvencionale. Ky rishikim literature synon të përmbledhë metodat dhe treguesit që përdoren për të matur efektivitetin e barnave biologjike në trajtimin e RA. Për këtë qëllim, u analizuan studime klinike, meta - analiza, rishikime sistematike

dhe artikuj të publikuar gjatë 10 viteve të fundit, të fokusuar në përdorimin e biologjikëve në RA. Literaturat përfshijnë të dhëna nga kohëzgjatja e trajtimit, ndryshimet në aktivitetin e sëmundjes, përgjigjen laboratorike dhe raportet e pacientëve mbi funksionin dhe cilësinë e jetës. Në literaturë, efektiviteti i barnave biologjike matet përmes indikatorëve klinikë, laboratorikë dhe përceptivë të pacientëve. Instrumentet klinike përfshijnë DAS28 (Disease Activity Score në 28 nyje), CDAI (Clinical Disease Activity Index) dhe SDAI (Simplified Disease Activity Index), të cilat vlerësojnë inflamacionin dhe aktivitetin e sëmundjes. Parametrat laboratorikë, si ESR (Erythrocyte Sedimentation Rate), CRP (C - reactive protein) dhe faktorët autoimunë (anti - CCP, RF), përdoren për të monitoruar përgjigjen inflamatore. Përceptimet e pacientëve matën përmes HAQ - DI (Health Assessment Questionnaire – Disability Index) dhe EQ - 5D - 5L, të cilat janë tregues të rëndësishëm të funksionit të përditshëm, aftësisë për të kryer aktivitete të përditshme dhe cilësisë së jetës. Pyetësorët përdoren gjithashtu në analizat e kosto - effektivitetit, pasi ofrojnë të dhëna mbi cilësinë e jetës dhe vitet e jetës të shëndetshme (QALYs), të cilat janë baza për të krahasuar koston dhe përfitimin e trajtimeve të ndryshme. Ky rishikim evidenton rëndësinë e kombinimit të treguesve objektivë dhe subjektivë për një vlerësim të plotë të efektivitetit, duke theksuar nevojën për monitorim të vazhdueshëm dhe personalizim të terapive. Analiza e literaturës sugjeron se zgjedhja e biologjikëve duhet të bazuar në profilin individual të pacientit dhe në faktorët prognostikë, me fokus të veçantë në përmirësimin e funksionit dhe cilësisë së jetës.

Fjalë kyçe: Artrit reumatoid, barnat biologjike, efektiviteti, DAS28, CDAI, HAQ - DI, EQ - 5D - 5L, CRP, ESR, QALY, kosto - effektivitet.

NDIKIMI I POLIMERIT PAABCH MBI STABILITETIN DHE PËRTHITHJEN TRANSDERMALE TË VITAMINËS D_3.

Doris Lacej[1]; Pietro Matricardi[2], Gentjan Mataj[1]; Ledjan Malaj[3]; Brunilda Myftari[3]; Eni Bushi[1, 3]
[1]*Profarma Sh. a*
[2]*Universiteti "La Sapienza", Romë*
[3]*Universiteti i Mjekësisë, Tiranë – Departamenti i Farmacisë.*

Abstrakt
Aplikimi dhe perthithja përmes lëkurës i vitaminës D_3 është i kufizuar për shkak të lipofilicitetit dhe paqëndrueshmërisë së saj. Ky studim vlerësoi ndikimin e polimerit inovativ të sintetizuar nga molekula e kolesterolit dhe acidi polylaktik, PAAbCH mbi përthithjen transdermale dhe stabilitetin e vitaminës D_3 duke përdorur lëkuren e njerëzve konkretisht zonën abdominale në qeliza difuzioni Franz. Membranat SCE u vendosën nën kushte okluzive dhe u trajtuan për 24 orë me vaj vitamine D_3, me ose pa PAAbCH. Mostrat përkatese të polimerit me vitaminë D dhe të vitaminës në vaj u analizuan me HPLC. Nuk pati ndryshime të konsiderueshme në përthithjen transdermale për të dyja formulimet. Në kontrast, nënprodukte të oksidimit të vitaminës D_3, të cilat mungonin në standardet e pastra, u zbuluan në mostrat kontroll, por ishin dukshëm më të ulëta tek formulimet me PAAbCH. Këto rezultate tregojnë se megjithëse PAAbCH nuk ndikon dukshëm ne përthithjen transdermale, ai ofron mbrojtje kundër degradimit oksidativ dhe mund të shërbejë si eksipient stabilizues në formulimet topike të vitaminës D_3.

Fjalë kyce: Vitaminë D_3, përthithje transdermale, polimer PAAbCH, eksipient stabilizues; degradim oksidativ, formulime topike, lëkurë njerëzore, qeliza difuzioni Franz.

HIDROKSIKLOROKINA BARI I PËRDORUR GJATË PANDEMISË COVID - 19.

Ejona Karagjozi[1], Adriana Manuka[2]
[1]*Farmaci 'IDIAL'*
[2]*Fakulteti i Farmacisë, Universiteti Katolik Zoja e Këshillit të Mirë, Tiranë*

Abstrakt
Hyrje: Në dhjetor të 2019, ndodhi shpërthimi i një pneumonie me origjinë të panjohur deri atëherë qe më vonë do të identifikohej si COVID - 19, raportuar në Wuhan, provinca Hubei, Kinë. Virusi SARS - CoV - 2, i përket te njëjtës familje virusesh që shkaktoi (SARS) sindromën e rëndë akute respiratore dhe sindromën respiratore e

së Lindjes së Mesme (MERS). Studimet e hershme të transmetimit raportuan një lidhje midis tregut lokal të peshkut dhe kafshëve të egra në Kinë, ku shumica e infeksioneve të hershme treguan një tranzicion të mundshëm të virusit nga kafshët te njerëzit. Që kurse OBSH e klasifikoi si pandemi në mars 2020, qeveritë, shkencëtarët dhe institucionet kanë punuar në zhvillimin e vaksinave të reja dhe ripërdorimin e barnave ekzistuese. Ripërdorimi i barnave ekzistuese ishte një zgjedhje mjaft e mirë: për të parë efektivitetin e tyre ndaj COVID - 19, për uljen e kostove, dhe përshpejtimin shpërndarjes së barnave, veçanërisht kur siguria e këtyre barnave është kryer nga studime paraklinike të mëparshme. Hidroksiklorokina (HCQ) është një bar imunomodulator përdorur për trajtimin jo vetëm të malarjes, por edhe në sëmundjet autoimunitare, si lupusi eritematoz sistemik dhe artriti inflamator. Përdorime e përfitime të reja të këtij bari vazhdojnë ende të shfaqen, duke përfshirë përdorimin e tij si terapi antikancerogjene ose në pacientët diabetikë. Në fillim të pandemisë në 2020, FDA dhe OBSH autorizuan përdorimin urgjent të hidroksiklorokinës (HCQ) dhe klorokinës për trajtimin e COVID - 19. Ky studim synon të vlerësojë dobitë e hidroksiklorokinës kundër COVID - 19.

Metodologjia: Ky rishikim sistematik u krye në përputhje me udhëzimet PRISMA. Bazat e të dhënave të përdorura për kërkimin e artikujve përfshinin Google Scholar, Scopus, PubMed, dhe Medrxiv. Fjalët kyçe të përdorura në anglisht përfshinin termat si hidroksiklorokina dhe covid - 19, hidroksiklorokina ose covid - 19. U gjetën më shumë se 700 artikuj. Fillimisht, 400 botime duke përfshirë recensione, abstrakte, komente dhe dublikata u hoqën. Studimet e mbetura u shqyrtuan bazuar në kriteret e mëposhtme të përjashtimit: (1) Artikuj që nuk kanë lidhje me hidroksiklorokinën dhe / ose COVID - 19; (2) Studime në gjuhën jo - angleze; (3) Studime që nuk kanë informacion ose të dhëna për temën që po trajtojmë; (4) Studimet mbi kafshë; (5) Studime të paarritshme. Nxjerrja e të dhënave nga studimet u bë gjithashtu në mënyrë të pavarur nga të gjithë studiuesit. Studimet e mbetura përfshinin prova klinike, meta - analyzes, raste studimore dhe artikuj shkencor, duke ngushtuar përzgjedhjen në 26 botime.

Rezultate: Disa nga studimet e përfshira në këtë rishikim, ishin shumë premtuese, duke sugjeruar përdorimin e hidroksiklorokines si agjent profilaktik dhe terapeutik. U rekomandua si terapi për COVID - 19 përdorimi i një doze fillestare prej 400 mg / 2x në ditë per nje dite, e ndjekur nga 200 mg / 2x në ditë për 4 ditët të vazhdim. Pacientët që merrnin klorokine fosfat kishin më pak përkeqësim të pneumonisë, një përmirësim të dukshëm në rezultatet e imazhit të mushkërive dhe një rrjedhë më të shkurtër të sëmundjes. In vitro klorokina rezultonte shumë efektive në kontrollin e COVID - 19 dhe te dhenat mbi sigurinë e saj e sugjeron që ajo duhet të merret ne konsiderate per perdorim tek personat e prekur nga koronavirusit të ri. Rikthimi i temperatures normale së trupit dhe sherimin i kollës ishin dukshëm më të shkurtra, si dhe një përqindje e lartë e pacientëve me pneumoni tregoi përmirësim. Në vendet ku ishte e aksesueshme hidroksiklorokina ndihmoi në uljen e numerit te vdekjeve nga COVID - 19. Trajtimi me hidroksiklorokinë shoqërohet me një ulje të vdekshmërisë në pacientët e sëmurë rëndë, duke ulur nivelet të citokinës inflamatore IL - 6.

Konkluzione: Megjithëse disa artikuj ishin mjaft interesantë, ky studimi nuk gjeti prova te mjaftueshme në botimet shkencore e kërkimore të zgjedhura, që hidroksiklorokina duhet të përdoret si një agjent profilaktik dhe terapeutik per COVID - 19.

Fjalë kyçe: Virusi SARS - CoV - 2, COVID - 19, Trajtim, hidroksiklorokina, klorokina.

PLANTAGO MAJOR: VETITË DHE RISITË E PËRDORIMIT, NË QYTETIN E TIRANËS, NË PERIUDHËN SHTATOR 2024 – SHTATOR 2025.

Msc. Elefteri Baba
Farmaci "Ungjillëzimi", Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Në të gjithë historinë njerëzore, bimët mjekësore janë përdorur për të kuruar sëmundjet. Një nga bimët potenciale që mund të përdoret në mjekësinë tradicionale është Plantago major, e cila ka veti të shumta si: dermatoprotektive, anti - inflamatore, analgjezike, antioksidante, antimikrobiale, imunomodulatore dhe me aktivitet anti – ulcerogenik. Qëllimi i këtij studimi është të japë një tablo aktuale mbi vetitë dhe përdorimin e suplementeve me ekstrakt të Plantago major në qytetin e Tiranës, në periudhën shtator 2024 – shtator 2025.

Materiale dhe metoda: Studimi është i llojit përshkrimor transversal. Ai u realizua duke marrë në shqyrtim 2200 receta, të përzgjedhura në mënyrë rastësore nga dy farmaci të qytetit të Tiranës, në periudhën shtator 2024 – shtator 2025. Të dhënat u përpunuan me metodën statistikore SPSS 23.

Rezultate: Rezultatet e studimit treguan se: nga 2200 receta të marra në studim, në 94 receta (4. 28 % e recetave në total) janë përshkruar suplemente me ekstrakt të Plantago major, të gjitha si pjesë e politerapisë; nga të cilat në 80 receta vihet re përdorimi i Plantago major si demulcent në pneumologji, në 10 receta përdorimi si laksativ në gastro - hepatologji për trajtimin e konstipacionit dhe në 4 receta përdorimi në nefrologji për trajtimin e urolithiasis.
Përfundime: Nga rezultatet e këtij studimi vërejmë se ka një përdorim të konsiderueshëm të suplementeve me ekstrakt të Plantago major, në periudhën shtator 2024 – shtator 2025, në qytetin e Tiranës, në specialitetin e pneumologjisë, për shkak të efikasitetit dhe tolerancës së lartë nga pacientët. Vihet re gjithashtu një përdorim i kufizuar në specialitetin e gastro - hepatologjisë dhe sidomos të nefrologjisë, vetëm me konsulta të specialistëve herbalistë. Për këtë arsye, duhet të bëhen studime të tjera klinike më të detajuara për Plantago major në Shqipëri, për t'u përdorur në të ardhmen edhe në shumë specialitete të tjera për shkak të potencialit të lartë kurues që ajo ka.

Fjalë kyçe: Plantago major, vetitë, risitë në përdorim, receta, Tiranë.

ROLI I FARMACISTIT NË TRAJTIMIN E PARANDALIMIN E ONIKOMIKOZËS.

Elton Myftari[1], Naziona Malkaj[2], Edjola Duraj[1], Brunilda Myftari [1]
[1]Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Farmacisë.
[2]Farmaci "Sauku", Rr. Elbasanit, Tiranë

Abstrakt
Hyrje: Onikomikoza është një infeksion i pllakës së thoit, matricës ose shtratit të thoit, i cili shkaktohet nga dermatofitet. Trajtimi është afatgjatë dhe bëhet në mënyrë lokale dhe sistemike me preparate antimykotike.
Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të sjellë një përditësim të të dhënave nga literatura shkencore botërore mbi onycomycosis si dhe një pasqyrë të situatës në rrethet Tiranë dhe Fier në lidhje me rolin e farmacistit në trajtimin e kësaj patologjie.
Metodologjia: U bazua në grumbullimin dhe përzgjedhjen e literaturës shkencore nga bota dhe vendi në lidhje me onikomikozën dhe trajtimet e ndryshme. Ky studim është kryer gjatë një periudhe 6 mujore, në stinët dimër e pranverëkur incidenca është edhe më e lartë. Në respect të privatësisë së pacientëve janë shqyrtuar kartelat mjekësore. Të dhënat e përftuara nga kartelat dhe recetat mjekësore të shqyrtuara nëpër farmaci të ndryshme, u përpunuan statistikisht me metodën Microsoft Excel.
Rezultate: Në studim janë përfshirë 102 raste, nga të cilët 63% janë femra, ndërsa 37% janë meshkuj. Rezulton se trajtimi i përzgjedhur është terbinafina 250 mg pasi është edhe në listën e barnave të rimbursueshme (LBR). Rezulton se më shumë preken persona të moshës mbi 51 vjeç në një frekuencë relative 54%. Gjithashtu duke kaluar nga muajt e dimrit drejt verës u vu re rritje e numrit të rasteve.
Diskutime: Onycomycosis është një sëmundje, e cila prek çdo moshë dhe në pjesën më të madhe të rasteve janë femrat, në një raport 2: 1 kundrejt meshkujve. Nuk gjendet pothuajse fare në periudhën para pubertetit. Në rrethet ku u zhvillua studimi, incidenca më e madhe ishte tek femrat dhe shkaqet kryesore ishin traumat, faktorët gjenetik, kushtet klimaterike, higjena e varfër dhe neglizhenca e mjekimit. Lagështia ishte faktori kryesor, i cili bënte kolonizimin e mykut. Në studimin tonë muajt Prill dhe Maj ishin ato me numrin më të lartë të pacientëve me onycomycosis.
Përfundime: Gjetjet e këtij studimi dëshmojnë se kushtet atmosferike ndihmojnë zhvillimin e mykut. Farmacisti ka një rol kyç në trajtimin e mykut të thonjve. Ai me njohuritë që ka mund të ndihmojë në parandalimin e këtyre rasteve apo të rishfaqjes së saj. Gjithashtu e rëndësishme është edhe mbështetja psikologjike që farmacisti i jep pacientit gjatë kohës së mjekimit, për të mos u dekurajuar dhe për ta përmbushur trajtimin deri në fund, pasi këto trajtime zgjasin në kohë.

Fjalë kyçe: Onikomikoza, antimykotik, trajtim, parandalim, farmacist, pacientë, aderencë.

ANTIBIOTIKËT NË COVD - 19.

Endrita Tora Arifi

Abstrakt

Hyrje: Coronavirus (CoV) rrjedh nga fjala 'corona' që do të thotë 'kurorë' në latinisht. Epidemia e COVID - 19 ka ndryshuar fokusin global të kujdesit shëndetësor. Në 80% të rasteve të diagnostikuara, simptomat janë të lehta deri në mesatare. Përafërsisht 20% e pacientëve janë të sëmurë rëndë dhe sëmundja është kritike në 6% të pacientëve të prekur. Roli i antibiotikëve në trajtimin e rasteve me COVID - 19 ende nuk është përcaktuar në mënyrë adekuate dhe nuk janë përcaktuar kritere për trajtimin, llojin dhe kohëzgjatjen e antibiotikëve.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të hulumtoj lidhur me përdorimin e antibiotikëve te pacientët e diagnostifikuar me COVID - 19 të cilat u trajtuan në kuadër të Klinikës Infektive në QKUK, në Prishtinë.

Metodologjia: Ky hulumtim është një studim kohor i realizuar në një qendër, observacional dhe retrospektiv i pacientëve të diagnostikuar me Covid - 19 në Klinikën e Infektivës në QKUK, në Prishtinë. Gjithsej 100 pacientë të hospitalizuar në klinikë për COVID - 19 u zgjodhën në mënyrë rastësore nga të dhënat mjekësore të pacientëve. Të dhënat janë marrë nga fletëlëshimet e pacientëve të diagnostifikuar, në periudhën kohore 3 mujore, në nëntor - janar 2020 / 2021. Të dhënat mbi përdorimin e antibiotikëve u mblodhën sipas një pyetësori të modifikuar të anketimit të Iniciativës Ndërkombëtare të Kërkimit për Sëmundjet Infektive (ID - IRI). Për grupimin, përpunimin dhe llogaritjen e parametrave statistikorë është përdorë SPSS dhe prezantimi i tyre është bërë në mënyrë tabelare dhe me grafikone.

Rezultate: Gjatë periudhës nëntor - janar 2020 / 2021 nga 100 pacientë të diagnostifikuar me Covid - 19 që u parqitën në Klinikën Infektive, 66% e këtyre pacientëve ishin meshkuj ndërkaq 34% ishin femra. Personi më i ri që iu është drejtuar Klinikës së Infektivës është i moshës 35 vjeç ndërkaq që personi më i moshuar i prekur me këtë sëmundje në bazë të të dhënave tona është 86 vjeç. Mosha mesatare e 100 të anketuarëve është 63 vjeç e 7 muaj me një devijim standard nga kjo mesatare për 12 vjeç e 2 muaj. Gjendja shoqëruese më e zakonshme ishte hipertensioni në 58 raste, i ndjekur nga diabeti mellitus 34 raste, sëmundje të zemrës 17 raste, sëmundje renale 2 raste, insuficienca respiratore 2 raste dhe hepatiti kronik 1 rastë. Ndër antibiotikët më të përdorur gjatë trajtimit të pacientëve në repartet e Klinikës Infektive ishin Ceftriaxone / Cefotaxime dhe Fluoroquinolone në 42 (43, 75%) raste. Ndër antibiotikët më të përdorur në ICU janë Fluoroquniolone 4 (100%), Meropenem 4 (100%) dhe Vankomycin 4 (100%).

Fjalë kyçe: COVID - 19, antibiotikët, rastet në repart / ICU.

VALIDIMI I PASTRIMIT: KRITERET PDE DHE RRITJA E KUFIJVE TË MBETJEVE.

Eni Bushi[1] [2]; Gentjan Mataj[1]; Ledjan Malaj[2]; Brunilda Myftari[2]; Erjon Troja[2]**; Doris Lacej**[1]
[1]*Profarma Sh. a*
[2]*Universiteti i Mjekësisë, Tiranë – Departamenti i Farmacisë*

Abstrakt

Hyrje: Në validimin e pastrimit farmaceutik, përcaktimi i kufijve të pranueshëm të mbetjeve është thelbësor për të garantuar që ndotjet e kryqëzuara midis produkteve të ndryshme të mbeten nën nivelet që mund të rrezikojnë sigurinë e pacientit. Historikisht, kriteri **10 ppm** ka qenë standardi më i përdorur, duke ofruar një qasje të thjeshtë dhe konservative. Megjithatë, futja e **kriterit bazuar në PDE (Permitted Daily Exposure)** ka ndryshuar ndjeshëm mënyrën e vlerësimit të rrezikut, duke synuar një qasje më shkencore dhe të personalizuar për secilën substancë aktive.

Qëllimi: Në këtë kuadër, u krye **validimi i pastrimit të linjës së prodhimit të perfuzioneve** në ambient steril. Nga analiza e riskut u identifikua **ciprofloksacina** si produkti më kritik ("worst case"), për shkak të dozës së ulët ditore dhe potencialit të lartë toksikologjik. U vlerësua **MACO (Maximum Allowable Carryover)** sipas tre kritereve: **PDE, 1 / 1000 e dozës terapeutike,** dhe **10 ppm.**

Rezultate: Rezultatet treguan se **kriteri 10 ppm** doli më strikt, duke siguruar kufijtë më konservativë për mbetjet e pranueshme. Mostrat e pastrimit u analizuan për **mbetjet e API - së** dhe **ngarkesën mikrobiale**, dhe të gjitha rezultatet u gjetën **brenda limiteve të lejuara**, duke konfirmuar **efektivitetin e procesit të pastrimit** dhe përshtatshmërinë e metodës së verifikimit.

Përfundime: Ky studim tregon se, megjithëse kriteri PDE përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt një vlerësimi shkencor të rrezikut, në disa raste, si në prodhimin e perfuzioneve, kriteri **10 ppm** mbetet **më i sigurt dhe më praktik** për të garantuar pastërtinë dhe sigurinë e produktit përfundimtar.

Fjalë kyçe: Validimi i pastrimit; PDE; 10 ppm; MACO; Ciprofloksacinë; perfuzione; qasje e bazuar në rrezik.

TERAPITË ZËVENDËSUESE ENZIMATIKE (ERT) DHE VEÇORITË SPECIFIKE TË TYRE, NË REALITETIN AKTUAL MJEKËSOR DHE FARMACEUTIK.

Erjon Troja[1], Karolina Paloka[1], Ina Pasho[2], Virtut Velmishi[3], Paskal Cullufi[3]
[1]*Universiteti i Mjekësisë, Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri*
[2]*Departmenti Mjekësor, Novartis Pharma, Shqipëri / Kosovë / Maqedoni e Veriut, Tiranë, Shqipëri*
[3]*Departamenti i Pediatrisë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri*

Abstrakt
Hyrje: Terapitë e zëvendësimit të enzimave (ERT) përbëjnë një qasje premtuese dhe realitet të pranishëm prej vitesh, lidhur me trajtimin e sëmundjeve të ruajtjes lizozomale (LSD), një grup çrregullimesh metabolike të trashëgueshme të karakterizuara nga funksionimi i dëmtuar i lizozomeve. Pavarësisht sfidave, si kostot e larta të trajtimit, rimbursimit të produkteve farmaceutike, nevojat për administrim të vazhdueshëm dhe kufizimet në trajtimin e manifestimeve neurologjike të sëmundjeve, ERT kanë potencial të lartë për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe për të dhënë rezultate afatgjata për pacientët me LSD.
Qëllimi: Qëllimi i këtij prezantimi është dhënia e një informacioni aktual, risi për audiencën e aktivitetit mbi këtë tematikë mjekësore, duke përfshirë të dhëna mbi rregjistrimin dhe menaxhimin e këtyre sëmundjeve globalisht dhe në Shqipëri, duke u fokusuar kryesisht në kujdesin ndaj pacientëve, alternativat terapeutike, aspektet ligjore, klinike dhe ekonomike, në dhjetëvjecarin e fundit. Një tjetër moment me interes është shprehja dhe prezantimi i eksperiencave pozitive individuale, mundësive dhe bashkëpunimit real të suksesshëm midis profesionistëve të kujdesit shëndetësor farmacist – mjek specialist, në funksion të mirëqënies së pacientëve dhe përparimit të përbashkët shkencor - profesional.

Fjalë kyçe: qeliza lizozomiale, sëmundje të rralla, enzyme replacement therapy (ERT), farmacist.

DIABETI GESTACIONAL BIOMARKERËT, DIAGNOSTIKIMI I HERSHËM DHE ASPEKTE ME INTERES KLINIK E FARMACEUTIK.

Aleksia Allajbej[1], Erjon Troja[1], Trendelina Sahatxhiu[2], Diana Gjergjindreaj[1]
[1]*Universiteti i Mjekësisë, Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri*
[2]*Farmacia "Ana", Berat, Shqipëri*

Abstrakt
Diabeti mellitus është një sëmundje kronike dhe e pashërueshme, por që mund të mbahet nën kontroll nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm dhe ndërhyrjeve të përshtatshme. Kjo gjendje karakterizohet nga nivele të larta të glukozës në gjak dhe klasifikohet kryesisht në dy forma: diabeti i tipit I, i cili zakonisht shfaqet në fëmijëri ose në moshë të re dhe lidhet me mungesën ose mungesën totale të insulinës; dhe diabeti i tipit II, që prek kryesisht të rriturit dhe individët me mbipeshë, si pasojë e prodhimit jo të mjaftueshëm të insulinës ose rezistencës ndaj saj. Një formë e tretë, e njohur si diabeti gestacional, shfaqet gjatë shtatzënisë dhe përfaqëson një formë të intolerancës ndaj karbohidrateve që rezulton në hiperglicemi me intensitet të ndryshueshëm. Diabeti gestacional mund të ketë pasoja serioze si për nënën, ashtu edhe për fetusin, veçanërisht nëse nuk diagnostikohet dhe menaxhohet në kohë. Në raste të diagnostikimit të hershëm, një regjim ushqimor i përshtatur dhe kujdesi mjekësor mund të ndihmojnë në mbajtjen e glukozës në nivel të kontrolluar, duke siguruar një shtatzëni normale. Ky prezantim synon të ofrojë një pasqyrë të thelluar mbi faktorët që kontribuojnë në zhvillimin e diabetit gjatë shtatzënisë, kohën e shfaqjes së tij, protokollet diagnostikuese – përfshirë testet laboratorike që përdoren – si dhe strategjitë më të përshtatshme për menaxhimin e kësaj gjendjeje, me në fokus rolin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor, në vecanti farmacistit pranë komunitetit.

Fjalë kyçe: diabeti gestacional, glukoza, niveli i sheqerit, insulina, testi i tolerancës së glukozës.

ANTITRUPAT MONOKLONALË DHE RISITË NË TRAJTIMIN E ARTRITIT REUMATOID.

Denada Dedaj[1], Erjon Troja[1], Albert Pjetri[1]
[1]*Universiteti i Mjekësisë, Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri.*

Abstrakt
Artriti reumatoid (AR) është një sëmundje autoimune multifaktoriale me etiologji të panjohur, që prek kryesisht artikulacionet, më pas mund të shfaqen dhe manifestime ekstra - artikulare. Për shkak të kompleksitetit të tij, i cili bazohet në një mekanizëm patofiziologjik të pazbuluar plotësisht, menaxhimi i mirë i AR - së kërkon një qasje multidisiplinare. Për trajtimin e kësaj patologjie, njihen disa klasa barnash, të cilat janë përdorur kryesisht për trajtimin simptomatik të AR - së, pa adresuar shkakun themelor të sëmundjes. Trajtimet tradicionale kanë disa të meta klinike, duke përfshirë mekanizma të paqartë farmakologjikë dhe efekte anësore serioze. Antitrupat monoklonalë (mAb) janë zhvilluar si një klasë revolucionare e agjentëve biologjikë që ofrojnë strategji terapeutike të drejtuara kundër ndërmjetësve kryesorë molekularë në AR. Këto antitrupa janë projektuar për t'u lidhur në mënyrë selektive me antigjene specifike, duke moduluar kështu rrugët imune me saktësi më të madhe dhe me më pak efekte anësore sistemike. Ky prezantim ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të antitrupave monoklonalë, eksploron aplikimet terapeutike të mAb - ve në AR, sfidat që lidhen me imunogjenicitetin dhe administrimin, si dhe teknologjitë në zhvillim siç janë antitrupat bispecifikë dhe konjugatet antitrup - bar. Vëmendje e veçantë i kushtohet përparimeve teknologjike dhe provave klinike që kanë formësuar peizazhin aktual të trajtimit biologjik në AR. Nëpërmjet një analize të thelluar të literaturës aktuale dhe të dhënave klinike, studimi nënvizon ndikimin transformues të antitrupave monoklonale në menaxhimin e AR - së, duke nxjerrë në pah risitë e vazhdueshme dhe perspektivat e ardhshme që synojnë optimizimin e efikasitetit, sigurisë dhe aksesit të këtyre terapive në mbarë botën.

Fjalë kyce: antitrupa, monoklonalë, artrit reumatoid, DMARD, inhibitorë të TNF - alfa, teknologjia hibridome.

STRATEGJITË E REJA TË ZHVILLIMIT DHE REALITETI I VAKSINAVE ANTI - TUMORALE: IMUNOTERAPIA E PERSONALIZUAR.

Xhersika Serjani[1], Erjon Troja[1], Rubina Dushku[1], Ranela Ceci[2], Delina Troja[3]
[1]*Universiteti i Mjekësisë, Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri*
[2]*Zyra e Përfaqësimit "Meda Pharmaceuticals Switzerland GmbH", Tiranë, Shqipëri*
[3]*Zyra e Përfaqësimit ''Hoffmann - La Roche'', Tiranë, Shqipëri.*

Abstrakt
Sëmundjet tumorale mund të konsiderohen sëmundjet e shekullit. Një problematikë komplekse e cila në saj të prognozës shfaqet në grada të ndryshme dhe shkakton rritje të rrezikshmërisë për jetën. Trajtimi i tyre po përjeton një transformim të thellë falë zhvillimeve në imunoterapi, me theks të veçantë mbi vaksinat me neoantigjene — një formë inovatore e imunoterapisë së personalizuar. Kjo qasje bazohet në identifikimin e mutacioneve unike të tumorit të secilit pacient, të cilat gjenerojnë antigjene të reja (neoantigjene), që nuk gjenden në indet e shëndetshme. Vaksinat kundër neoantigjeneve synojnë të stimulojnë një përgjigje të fuqishme dhe të saktë të sistemit imunitar kundër qelizave tumorale, duke reduktuar rrezikun e efekteve anësore dhe duke rritur efikasitetin terapeutik. Kjo temë trajton mekanizmat biologjikë dhe imunologjikë që qëndrojnë në bazë të kësaj forme terapie, teknologjitë e përdorura për identifikimin dhe përzgjedhjen e neoantigjeneve, si dhe evidencat klinike më të fundit që mbështesin përdorimin e tyre në disa lloje patologjish, përfshirë melanomën, kancerin pulmonar dhe atë gastrointestinal. Prezantimi synon të theksojë rëndësinë e vaksinave kundër neoantigjeneve si një drejtim premtues në zhvillimin e terapive të synuara dhe të personalizuara për pacientët onkologjikë.

Fjalë kyce: trajtim, sëmundje tumorale, vaksina, neoantigjen, terapi, imunoterapi e personalizuar.

ZHVILLIMI DHE VALIDIMI I NJË METODE HPLC - DAD PËR PËRCAKTIMIN SASIOR TË CLOBAZAMIT DHE PËRDORIMI I SAJ PËR VLERËSIMIN E PROFILEVE TË DISOLUCIONIT TË TABLETAVE QË PËRMBAJNË CLOBAZAM.

Eva Gavani, David Lekli, Luan Lekli, Leonard Deda

Abstrakt

Hyrje: Në këtë studim krahasuam profilet e disolucionit të tabletave që përmbajnë clobazam 10 mg - produkt referencë (i patentuar) dhe produkt gjenerik - duke përdorur një metodë të validuar HPLC. Metoda u optimizua dhe u verifikua për identifikim dhe përcaktim kvantitativ të clobazam te λ = 230 nm. U përdor kolona C18 (150 × 4. 6 mm, 5 µm) me fazë lëvizëse acetonitril: ujë (40: 60, v / v). Temperatura e kolonës ishte 25 °C dhe volumi i injektimit 25 µL. Metoda rezultoi lineare në një gamë të gjerë, me një koeficient korrelacioni $R^2 = 1$ dhe ekuacion regresioni y = 3280. 1·x + 0. 4462. Kufiri i detektimit (LOD) ishte 0. 02662 µg / mL dhe kufiri i përcaktimit (LOQ) 0. 087 µg / mL. Metoda është selektive për clobazam dhe dëshmoi gabime sistematike të papërfillshme, çka e bën të përshtatshme për krahasimin e profileve të disolucionit të dy produktet, të cilat kanë të njëjtën molekulë dhe të njëjtët eksipientë. Disolucioni u krye në tre media me pH të ndryshëm: HCl pH 1. 2, buffer acetat pH 4. 5 dhe buffer fosfat pH 6. 8. Matjet u morën në katër pika kohore: 5, 10, 15 dhe 30 minuta. Ngjashmëria e profileve u vlerësua duke përdorur faktorin e diferencës f1 dhe faktorin e ngjashmërisë f2. Për të njëjtat pika kohore dhe koncentrime, vlerat e f1 dhe f2 ishin brenda kufijve të pranueshëm: për pH 1. 2 f1 = 3. 25 dhe f2 = 77. 89; për pH 4. 5 f1 = 3. 18 dhe f2 = 75. 57; për pH 6. 8 f1 = 2. 35 dhe f2 = 83. 32. Të dy produktet (referenca dhe gjeneriku) treguan një shkallë shumë të shpejtë të disolucionit (≥ 85%) në më pak se 15 minuta dhe profile disolucioni të ngjashme në të gjitha kushtet e studimit.

Fjalë kyçe: validimi i metodës, HPLC, profil disolucioni, faktor f1, faktor f2, clobazam.

INSUFICIENCA RENALE KRONIKE.

Evis Karkanjozi

Abstrakt

Hyrje: Insuficienca renale kronike është një patologji e karakterizuar nga një reduktim gradual dhe i parikthyeshëm i funksionit të veshkave, (humbje e nefroneve funksionale), duke ndikuar në funksionet sekretuese dhe të homeostazës, në të cilat veshka është rregullatore. Substrakti anatomo - funksional i IRK përfaqësohet nga humbja progresive e nefroneve funksionale dhe si rrjedhojë reduktim i filtratit glomerular renal (FGS), i cili në kushte normale është 100–130 ml / min. Shkalla e dëmtimit renal është proporcionalisht e kundërt me numrin e mbetur të nefroneve funksionale, prandaj IRK e klasifikojmë në stadet që vijojnë: epidemiologjia, eciopatogjeneza, kuadri klinik, aparati kardiovaskular, sistemi kardiovaskular, sistemi emopoetik, sistemi nervor, aparati gastroenterik, sistemi kockor, alterime të metabolizmit, terapia dhe dializa.
Objektivi: IRK, dializa, terapia konservative dhe ajo zëvendësuese. Si ndikon IRK në homeostazën e veshkave, katabolitët, toksike të IRK terminale, roli i çelantëve të aluminit, ruajtja e raportit Ca / P, roli i ekskretimit, bilanci hidrik, FGR (filtrati glomerular), funksioni endokrin i nefronit, ekuilibri acido - bazë, veshka policistike, roli i PTH, funksioni i eritropoetinës në anemitë sekondare nga IRK, mekanizmi adaptiv i nefroneve të mbetura i cili ndikohet nga një sërë faktorësh si angiotensina, sistemi reninë - angiotensinë - aldosteron.

Fjalë kyçe: Insuficienca renale kronike, patologji, dializa, terapia conservative.

NJOHURITË DHE QASJET E PRINDËRVE NË MENAXHIMIN E TEMPERATURËS TEK FËMIJËT.

MSc. Fabiola Noga, MSc. Kasandra Cerri, Prof. Asoc. Ela Hoti
Departamenti i Farmacisë, Fakulteti Mjekësisë, Universiteti Mjekësisë Tiranë.

Abstrakt

Hyrja: Temperatura e lartë është një simptomë e zakonshme tek fëmijët, por shkakton shqetësim dhe ankth te prindërit. Ky është një tregues i qartë që prindërit mund ta konsiderojnë temperaturën si një sëmundje më vete dhe njohuritë dhe perceptimet e tyre lidhur me menaxhimin e saj mund të jenë të pasakta.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë njohuritë dhe qasjet e prindërve lidhur me menaxhimin e episodeve të temperaturës së lartë tek fëmijët e tyre.

Metodologjia: Për të realizuar këtë studim është përdorur një pyetësor i strukturuar në dy pjesë. Në pjesën e parë të pyetësorit është realizuar mbledhja e të dhënave demografike të prindërve, ndërsa në pjesën e dytë të pyetësorit janë përfshirë pyetje që synonin hetimin e njohurive të prindërve rreth temperaturës së lartë dhe mënyrën se si këta prindër menaxhojnë temperaturën e lartë te fëmijët e tyre. Pyetësori i strukturuar, u plotësua nëpërmjet intervistave me prindër me fëmijë nën moshën 12 vjeç në qytetin e Tiranës.

Rezultate: Në studim morën pjesë 74 prindër, me moshë mesatare 31. 02 ± 4. 5 vjet. Më shumë se gjysma e pjesëmarrësve konsideronin temperaturën në vlera mbi 39°C si temperaturë të lartë. Sipas përgjigjeve, 82% e prindërve raportuan se fillonin trajtimin me barna antipiretikë kur temperatura e fëmijës ishte midis vlerave 38°C dhe 38. 9°C. Rreth 26% e prindërve përdornin vetëm paracetamol, ndërsa pjesa tjetër alternonin paracetamol dhe ibuprofen duke e konsideruar si opsion më efikas për të menaxhuar episodet febrile të fëmijës së tyre. Për udhëzime mbi dozimin, shumica e prindërve (86. 5%) konsultoheshin me mjekun pediatër, ndërsa 33. 8% mbështeteshin tek rekomandimi i farmacistit. Sipas perceptimit të prindërve të intervistuar, temperatura e lartë mund të shkaktojë përkeqësimin e sëmundjes së fëmijës (51. 4%) dhe konvulsione (44. 6%).

Përfundime: Prindërit ndjekin një qasje të përshtatshme në menaxhimin e temperaturës së lartë te femijët e tyre, por shfaqin edhe perceptime të gabuara. Edukimi nga profesionistët e shëndetësisë është thelbësor për të adresuar këto perceptime dhe për të përmirësuar praktikat e prindërve.

Fjalë kyçe: prindër, temperaturë, fëmijë, pyetësor.

FARMAKOGJENETIKA DHE REAKSIONET E PADËSHIRUARA TË BARNAVE.

Fatos Kadesha

Abstrakt

Hyrje: Farmakogjenetika demonstron një gjendje gjenetike polimorfike duke zbuluar një përgjigje të saktë, të veçantë ndaj barit. Në vitin 1959 Vogël prezantoi termin farmakogjenetikë në mjekësinë klinike. Pasojat e variacionit farmakogjenetik në enzima mund të përfshijnë së pari ndryshimin e kinetikës dhe kohëzgjatjes së veprimit të barnave specifikë, dhe së dyti ndërveprimin medikamentoz si rezultat i kinetikës së ndryshuar dhe reaksionin e tretë idiosinkratik të padëshiruar të barit, i cili përfshin lidhjet kovalente të metabolitëve reaktiv ndaj proteinave të qelizave dhe ndikimi i tyre në pacientë të sëmurë. Tre klasa të fenotipeve për metabolizmin e barnave që tregojnë polimorfizëm gjenetik janë: Metabolizues të gjerë (Ems), metabolizues të dobët (PMs), të shoqëruar me akumulimin e barit ose metabolitit prind, i cili zakonisht është një tipar autosom recesiv që rezulton nga mutacioni ose fshirja në të dy alelet, dhe metabolizuesit ultraextensive (UEM), rrit metabolizmin e barnave dhe eshte tipar autosomik dominant që rezulton nga amplifikimi i gjeneve. Për të siguruar një kuptim më të mirë të fenomenit të farmakogjenetikës, në po paraqesim termat e shquar të përdorur: allelet, autosomal dominant, autosomal receziv, homozigotë, isoenzimë, fenotipe, polimorfizëm. Ekzistojnë gjithashtu disa shembuj të gjendjes farmakogjenetike me mangësitë e dukshme të enzimave, mënyrat e frekuencës së trashëgimisë dhe ndjeshmërinë ndaj barnave si: (Glucose 6 - phosphat Dehydrogjenaze) G6PD, Globin and Heme Metabolizing Enzymes, Catechol - 0 - Methyl Transferase (COMT), Thiopyrin Methyl Transferase (TPMT), Glycolytic Enzymes, Dehydropirimidin Dehydrogenaza (DPD) N - Acetyl Transferase Enzymes (NAT1 and NAT2,) Cholinesteraza, Chitochrom P - 450 Isoenzyme CYP2D6, Cytochrom P - 450 Isoenzyme CYP2C19, Microsomal Oxidation, Hypoxanthine - guanine phosphoribosyltransferase (HgPTASE), Receptor Enzyme, Alcohol Dehydrogenase, Binding proteins, SLCO1B1.

Konkluzione: Testimi për vetëm tre gjene (CYP2C19, CYP2D6 dhe SLCO1B1) mund të ndihmojë në parandalimin e një pjese të konsiderueshme, rreth 75% të efekteve anësore nga grupet e barnave psikiatrike dhe kardiovaskulare. Ky hulumtim farmakogjenomik analizoi mbi 1. 3 milion raporte të reaksioneve të padëshiruara të ilaçeve (ADR) dhe sugjeron që integrimi i testimit gjenetik në praktikën klinike mund të përmirësojë sigurinë dhe efektivitetin e ilaçeve duke u bazuar ne trajtimin e personalizuar.

Fjalë kyçe: farmakogjenetika, barna, mjekësi klinike etj.

ANTIBIOTIKO REZISTENCA – SFIDA DHE STRATEGJI PËR PËRBALLIMIN E NJË KËRCËNIMI GLOBAL.

Dr. Shk. Florjana Rustemi[1, 2]; Alesio Boçari[3]
[1]*Lektor, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Departamenti i Farmacisë, Albanian University*
[2]*Drejtor i Koordinimit të Informacionit dhe Studimit të Strategjive të Zhvillimit Shëndetësor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor*
[3]*Klinika Dentare "Nobel"*

Abstrakt
Antibiotiko rezistenca (AMR) është një kërcënim për shëndetin dhe zhvillimin global dhe vlerësohet se kontribuon me më shumë se pesë milionë vdekje në vit. AMR nxitet nga përdorimi i papërshtatshëm i antibiotikëve dhe parandalimi dhe kontrolli i ulët i infeksioneve tek njerëzit, kafshët, bimët dhe mjedisi. Rezistenca ndaj antibiotikëve ndikon negativisht në rezultatet klinike dhe terapeutike, me pasoja që variojnë nga dështimet e trajtimit dhe nevoja për barna alternative të shtrenjta dhe më të sigurta deri në rritje të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë, shtrimi më i gjatë në spital dhe kosto të larta të kujdesit shëndetësor.
Ky rishikim ka përmbledhur situatën, sfidat dhe strategjitë për menaxhimin e antibiotiko rezistencës. Dihet pak për modelet e përdorimit të antibiotikëve në Shqipëri, përfshirë vitet e pandemisë, ku u përballëm me një rritje të përdorimit të antibiotikëve për trajtimin e pacientëve me COVID - 19 dhe ndikimin e një popullsie në plakje. Shkaqet kryesore që mund të çojnë në keqpërdorim janë mbipërshkrimi, i nxitur nga përdorimi i gjerë empirik i antibiotikëve dhe dhënia e antibiotikëve pa recetë, megjithëse legjislacioni aktual nuk lejon dhënien pa recetë të antibiotikëve, kjo ende ndodh, ndikuar nga presioni i pacientëve mbi mjekët dhe farmacistët për të përshkruar dhe shpërndarë antibiotikë dhe problematikave të kontrollit.
Nëpërmjet Planit Global të Veprimit për AMR, OBSH po punon për të përmirësuar mbikëqyrjen e rezistencës antimikrobike dhe për të reduktuar konsumin e papërshtatshëm të antibiotikëve. Publikimi i AWaRe ofron udhëzime koncize dhe të bazuara në evidencë për zgjedhjen e antibiotikut, dozën, mënyrën e administrimit dhe kohëzgjatjen e trajtimit për më shumë se 30 nga infeksionet klinike më të zakonshme tek fëmijët dhe të rriturit si në kujdesin shëndetësor parësor ashtu edhe në mjediset spitalore. Imunizimi dhe antibiotikët e rinj janë dy risitë kryesore të nevojshme për të luftuar AMR. Vaksinat janë një mjet i domosdoshëm, duke vepruar përmes rrugëve të shumta për të parandaluar mekanizmat që nxisin rezistencën. Aktet ligjore luajnë një rol të rëndësishëm duke kufizuar përdorimin pa kriter të antibiotikëve. Ekziston një nevojë urgjente për të zhvilluar dhe zbatuar indikatorë të qartë, të pranuar globalisht, duke u mbështetur në sistemin AWaRe. Mbeten shumë sfida, duke përfshirë mënyrën se si të dhënat duhet të informojnë politikat lokale dhe si të ndryshojmë modelet e përdorimit të barnave, të formuara gjatë dekadave. Nevojiten programe promovimi mbi përdorimin e kujdesshëm të antibiotikëve në nivel kombëtar dhe global. Sistemet e mbështetjes së vendimmarrjes klinike për mjekët dhe përfshirja e Praktikave të përshkrimit të antibiotikëve për Mjekët e Përgjithshëm dhe të Familjes si një Indikator kombëtar në Kujdesit Shëndetësor Parësor. Inteligjenca artificiale mund të përdoret për t'ju përgjigjur pyetjeve si cilët pacientë do të vuajnë nga infeksione rezistente, për të parashikuar transmetimin e rezistencës dhe për të mbështetur vendimmarrjen klinike për të optimizuar përdorimin e antibiotikëve.

Fjalë kyçe: AMR, përdorim i përshtatshëm, përshkrim, sfida, strategji.

EVOLUCIONI I POLITIKAVE FARMACEUTIKE NË SHQIPËRI.

Dr. Msc. Gentiana Qendro[1], Dr. Proces. Joana Malo[2,] Kristina Gjeci[3]
[1]*Pharmalaw Regulatory Albania*
[2]*Universiteti Aldent*
[3]*Universiteti i Mjekesisë*

Abstrakt
Qëllimi: Qëllimi i këtij artikulli është të analizojë dhe të diskutojë procesin e transformimit të politikave farmaceutike në Shqipëri, duke i drejtuar ato drejt një përputhjeje më të mirë me standardet ndërkombëtare. Përmbajtja e studimit është orientuar drejt të kuptuarit se si ky transformim do të ndikojë në sistemin shëndetësor, industrinë farmaceutike dhe shëndetin e përgjithshëm të popullsisë.
Materiale dhe Metoda: Studimi eshte bazuar në aktet ligjore dhe nën ligjore të nxjera në vite për të kuptuar kontekstin dhe implikimet e politikave farmaceutike në Shqipëri. Këtu janë përfshirë intervista me ekspertë të fushës, diskutime me përfaqësues të sektorit të shëndetësisë dhe analiza të thella të dokumentacionit zyrtar. Kjo qasje kualitative siguron një kuptim më të thellë dhe më të hollësishëm të çështjeve që lidhen me transformimin e politikave farmaceutike në Shqipëri.
Rezultate: Për të vlerësuar rezultatet e këtij artikulli, është e rëndësishme të konsiderojmë ndikimin dhe përparimin e arritur nga procesi i transformimit të politikave farmaceutike në Shqipëri drejt një bashkëpunimi më të ngushtë ndërkombëtar. Këtu përfshihen, Përmirësimi i standardit të kujdesit shëndetësor, Rritja e besueshmërisë ndërkombëtare, Lehtësimi i qasjes në barna të cilësisë së lartë, Ndikimi në industrinë farmaceutike vendase, Ndikimi në politikën e shëndetit publik. Vlerësimi i këtyre rezultateve ka ndihmuar në kuptimin e ndryshimeve të realizuara dhe sfidave të mbetura në rrugën drejt transformimit të politikave farmaceutike në Shqipëri.
Perfundime: Janë identifikuar sfidat dhe mundësitë në rrugën drejt konformitetit me standardet ndërkombëtare. Ndërkohë, përpjekjet për të përmbushur këtë qëllim janë vlerësuar për potencialin e tyre për të rritur standardet e shërbimit farmaceutik, të lehtësuar qasjen në barna të cilësisë së lartë dhe për të rritur besueshmërinë ndërkombëtare të sistemit farmaceutik shqiptar.

Fjalë kyçe: politika farmaceutike, evulucion, standarte.

PERSPEKTIVA E ZHVILLIMEVE TË REJA NË FORMULIMET PA DIOKSID TITANI: QASJA SHKENCORE DHE RREGULLATORE.

Gentjan Mataj[1], Eni Bushi[1] [2], Ledjan Malaj[2], Brunilda Myftari[2], Erjon Troja[2], Doris Lacej[1]
[1]*Profarma Sh. a*
[2]*Universiteti i Mjekësisë, Tiranë – Departamenti i Farmacisë*

Abstrakt
Hyrje: Dioksidi i titanit (TiO_2) përdoret gjerësisht në format e ngurta orale farmaceutike si pigment i bardhë dhe opacifices, për shkak të indeksit të lartë të përthyerjes, inertetit kimik dhe aftësisë për të maskuar shijet dhe aromat e pakëndshme. Megjithatë, shqetësimet për sigurinë, veçanërisht për nano - grimcat, kanë nxitur disa masa rregullatore. Në vitin 2022, Komisioni Evropian ndaloi përdorimin e TiO_2 si aditiv ushqimor (E171), bazuar në përfundimin e Autoritetit Evropian për Sigurinë Ushqimore (EFSA) se shqetësimet për genotoksicitetin nuk mund të përjashtoheshin. Megjithëse përdorimi i tij në produktet mjekësore mbetet i lejuar nën dispozita kalimtare, kjo vendimmarrje ka nxitur kërkime të gjera për alternativa të pranueshme farmaceutike.
Qëllimi: Ky studim vlerëson zëvendësuesit në zhvillim të TiO_2 në veshjet e formave të ngurta farmaceutike, duke u fokusuar në ekuivalencën funksionale, profilin toksikologjik dhe përshtatshmërinë rregullatore.
Rezultate: Alternativat ideale duhet të tregojnë opacitet dhe bardhësi të krahasueshme, fotostabilitet dhe përputhshmëri me formulimin, duke mbetur njëkohësisht kimikisht dhe biologjikisht inerte. Kandidatët më të zakonshëm përfshijnë karbonatin e kalciumit, karbonatin e magnezit, oksidin e zinkut, talkun dhe derivatet e silicës. Ndër këta, karbonati i kalciumit dhe ai i magnezit janë identifikuar si opacifices premtues për shkak të sigurisë së tyre dhe pranueshmërisë së gjerë rregullatore. Megjithatë, indeksi më i ulët i përthyerjes zvogëlon aftësinë mbuluese, duke kërkuar shpesh rregullime në formulim. Prodhuesit farmaceutikë përballen me sfida teknike gjatë adoptimit të këtyre alternativave, përfshirë ndryshime në trashësinë e filmit, forcën mekanike dhe

mbrojtjen ndaj rrezeve UV. Për më tepër, barriera rregullatore mbetet e konsiderueshme: çdo ndryshim në përbërjen e eksipientëve në produktet e autorizuara kërkon paraqitjen e variacioneve dhe testime shtesë të stabilitetit. Agjencitë rregullatore, përfshirë EMA dhe autoritetet kombëtare kompetente, kanë publikuar udhëzime për zhvillimin e formulimeve pa TiO_2 dhe kërkojnë vlerësime të vazhdueshme të raportit rrezik - përfitim.
Përfundime: Kalimi drejt eliminimit të dioksidit të titanit në produktet farmaceutike është një proces kompleks, por gjithnjë e më i domosdoshëm. Asnjë alternativë e vetme nuk mund të riprodhojë plotësisht të gjitha funksionet e TiO_2; megjithatë, disa kombinime eksipientësh dhe teknologji veshjeje japin rezultate premtuese. Kërkimi i vazhdueshëm në shkencën e eksipientëve dhe bashkëpunimi transparent me autoritetet rregullatore do të jenë thelbësorë për të garantuar cilësinë e produktit dhe sigurinë e pacientëve në formulimet pa TiO_2.

Fjalë kyçe: zëvendësues të dioksidit të titanit, perspektiva rregullatore, industria farmaceutike.

ÇFARË JANË PROBIOTIKËT? RËNDËSIA E TYRE NË JETËN TONË.

Griselda Guri

Abstrakt
Hyrje: Probiotikët janë mikroorganizma të gjallë të pranishëm në trupin e njeriut që mbështesin shëndetin e zorrëve dhe përmirësojnë ekuilibrin mikrobik. Brenda trupit tuaj jeton një ekosistem kompleks, që strehon qindra lloje të ndryshme të baktereve të mira dhe të dëmshme. Kur ka më shumë baktere të këqija, ekuilibri prishet dhe kemi një infeksion ose probleme me tretjen. Në këtë moment kemi disbiozë. A mund të marr probiotikë nga ushqimet? Probiotikët, që gjenden në ushqime dhe suplemente, mund të sjellin baktere të mira për të rivendosur atë ekuilibër. Por probiotikët janë baktere të gjalla. Pra, probiotikët në ushqime nuk zëvendësojnë suplementet. Mund t'i përdorim të dyja në të njëjtën kohë. Efektet pozitive: përmirësojnë funksionin imunitar, përmirësojnë tretjen, përmirësojnë shëndetin e lëkurës**,** ndihmojnë në humbjen e peshës**,** zvogëlojnë rrezikun e disa sëmundjeve. Mos harroni, zgjedhja e probiotikëve duhet të përputhet me nevojat tuaja specifike shëndetësore. Dallimi midis probiotikëve dhe simbiotikëve? Probiotikët janë thjesht baktere, simbiotikët janë Pro+ Prebiotikë. Prebiotiku është ushqimi i këtyre baktereve. Klasifikimi i probiotikëve është: Lacobacillus: jeton përmes tretjes, gojës, në zorrën e trashë, në zonën e ndërmjetme. Bifidobacteria: jeton në zorrën e trashë, ku fermentohet në zorrë Disa lloje probiotikësh: Lactobacillus acidophilus për shëndetin vaginal, infeksionet mykotike, problemet e zorrëve dhe aknet. Ka qenë shumë i dobishëm për njerëzit me intolerancë ndaj laktozës dhe kancer të zorrës së trashë). Lactobacillus rhamnosus (për ekzemën dhe problemet e zorrëve që lidhen me antibiotikët). Lactobacillus plantarum (për inflamacion në traktin gastrointestinal (IBS), funksionimin e zemrës). Lactobacillus casei (për funksionin e trurit dhe tretjen). Lactobacillus paracasei (forcon sistemin imunitar, zvogëlon inflamacionin dhe ndihmon tretjen. Ndihmon në përmirësimin e simptomave të bllokimit të hundës, syve të fryrë dhe kruajtjes). Lactobacillus salivarius (për higjienën dentare, shëndetin e zorrëve dhe mbështetjen imunitare ndaj astmës, kancerit, dermatitit atopik). Lactobacillus Bulgaricus (për shëndetin e zorrëve dhe gjendje të tilla si rosacea, aknet dhe ekzema). Bifidobacterium lactis (një nga probiotikët më premtues për shëndetin tuaj imunitar). Bifidobacterium longum (për tretjen dhe shëndetin e trurit). Bifidobacterium breve (për anti - plakje dhe tretje). Në cilën orë të ditës duhet ta marr probiotikun tim? Probiotikët merren më mirë në mëngjes ose në mbrëmje me ujë dhe me stomak bosh. Kjo lejon që probiotiku të lëvizë më lehtë nëpër zorrë, më tej përmirësimin e shëndetit të zorrëve.
Konkluzione: Ekuilibri delikat i ekosistemit tuaj të zorrëve luan një rol jetësor në mirëqenien tuaj të përgjithshme, dhe probiotikët mund t'ju ndihmojnë ta arrini këtë. Kjo është arsyeja pse të kuptuarit e llojeve të ndryshme të probiotikëve është e rëndësishme, pasi mund t'ju ndihmojë të bëni zgjedhje që mbështesin një zorrë të shëndetshme, duke çuar në një jetë më të shëndetshme.

Fjalë kyçe: probiotik, prebiotic, inflamacion, sistem tretës etj.

PËRDORIMI I PIJEVE ENERGJIKE TEK FËMIJËT. NDIKIMET PSIKOFIZIKE DHE RREZIQET SHËNDETËSORE.

Mr. ph. Hamez Aliga
Farmacist

Abstrakt

Hyrje: Përdorimi i pijeve energjike është në rritje të vazhdueshme, jo vetëm tek të rriturit por gjithnjë e më shumë edhe tek fëmijët dhe adoleshentët. Ky punim ka për qëllim të shqyrtojë shkaqet që çojnë fëmijët drejt konsumit të pijeve energjetike, përbërësit kryesorë të këtyre pijeve dhe ndikimin e tyre në shëndetin fizik dhe mendor të fëmijëve. Nëpërmjet një analize të literaturës shkencore dhe të dhënave nga anketime të realizuara në shkolla fillore dhe të mesme, janë identifikuar shqetësime të shumta si rritja e rrahjeve të zemrës, çrregullimet e gjumit, nervozizmi, mungesa e përqendrimit dhe rritja e ankthit. Përveç ndikimeve shëndetësore, një tjetër faktor shqetësues është mungesa e kontrollit nga prindërit dhe mosinformimi mbi përmbajtjen dhe efektet afatgjata të këtyre pijeve. Punimi përfundon me rekomandime konkrete për ndërhyrje edukative, kufizime ligjore dhe përfshirjen e institucioneve shkollore dhe shëndetësore në informimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi me pije energjetike.

Fjalë kyçe: pije energjike, fëmijë, kafeinë, shëndeti mendor, edukim, rreziqe shëndetësore.

TRENDET E HOSPITALIZIMIT DHE TË PËRDORIMIT TË BARNAVE NË SËMUNDJEN PULMONARE OBSTRUKTIVE KRONIKE: NJË ANALIZË KRAHASUESE DHE PROPOZIM PËR KUJDESIN FARMACEUTIK NË KOSOVË.

Jeton Muçaj, Beti Djurdjic, Zorica Naumovska, Kristina Mladenovska, Maja Simonoska Crcarevska
Fakulteti i Farmacisë, Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Abstrakt

Sëmundja pulmonare obstruktive kronike (SPOK) është një çrregullim progresiv i mushkërive i karakterizuar nga simptoma të rrugëve të frymëmarrjes, të tilla si dispnea, kolla dhe sekretimi i gëlbazës, që vijnë si pasojë e anomalive të rrugëve të frymëmarrjes (bronkiti, bronkioliti) dhe / ose alveolare (emfizema) që shkaktojnë kufizim të rrjedhës së ajrit. OBSH e rendit SPOK si shkakun e tretë kryesor të vdekjeve në nivel global, kryesisht të lidhur me pirjen e duhanit dhe ndotjen e ajrit. Sipas Iniciativës Globale për SPOK, kjo sëmundje prek rreth 10% të individëve të moshës 40 vjeç e lart, me prevalencë që rritet me moshën. Të dhënat globale mbi frekuencën e hospitalizimit, shpërndarjen demografike dhe përdorimin e barnave janë mbledhur përmes një rishikimi të strukturuar të literaturës (PubMed, Scopus, Google Scholar, Web of Science, raportet e OBSH - së). Të dhënat lokale u morën nga Klinika e Pulmologjisë (QKUK - Prishtinë) me leje paraprake dhe me aprovim etik. Të gjitha të dhënat e pacientëve u anonimizuan në përputhje me standardet etike. Të dhënat e hospitalizimit nga Kosova në vitin 2022 zbuluan se SPOK mbetet një barrë e madhe shëndetësore, me 461 pacientë të hospitalizuar, 331 meshkuj dhe 130 femra, me mbizotërim të meshkujve(71. 67%) në kontrast me të dhënat globale (46. 2%), ku në nivel global femrat shtrohen më shpesh në spital (28. 12% në nivel lokal kundrejt 53. 8% në nivel global). Hospitalizimi midis pacientëve të moshuar (≥70 vjeç) ishte i krahasueshëm në nivel lokal dhe global (36% kundrejt 34. 7%), duke treguar tendenca të ngjashme në lidhje me moshën. Të dhënat lokale të konsumit të barnave (Kosovë, 2022), të marra nga distributorët farmaceutikë, treguan përdorim më të ulët të kortikosteroideve të inhaluara (ICS) krahasuar me nivelet globale (29% kundrejt 45. 7%), por përdorim më të lartë të agonistëve β_2 me veprim të shkurtër (SABA) (34% kundrejt 7. 9%). Terapitë e kombinuara (ICS / LABA) kishin shkallë të ngjashme përdorimi në të dy nivelet (23% kundrejt 27. 7%). Inhalatorët më të përdorur në nivel lokal ishin salbutamoli (34%), flutikazon / salmeterol (22. 5%) dhe budesonidi (17. 2%), duke sugjeruar një fokus në menaxhimin simptomatik sesa në atë afatgjatë të sëmundjes. Këto gjetje tregojnë përdorim të pamjaftueshëm të terapive mbajtëse dhe kontroll jo optimal të sëmundjes, duke kontribuar në shkallë të lartë të hospitalizimit dhe një barrë të vazhdueshme të SPOK në Kosovë. Globalisht, forcimi i kujdesit shëndetësor parësor me përfshirjen aktive të farmacistëve të komunitetit ka rezultuar thelbësor për rezultate më të mira përmes edukimit të pacientëve, forcimit të aderencës mjekësore, përdorimit të saktë të inhalatorëve dhe "skriningut" të hershëm duke ulur në fund të fundit hospitalizimin dhe kostot e kujdesit shëndetësor (Hudd, 2020). Bazuar në këtë këndvështrim, propozohet zbatimi i një plani gjithëpërfshirës të kujdesit farmaceutik për SPOK në farmacitë komunitare në Kosovë. Ai duhet të theksojë edukimin e pacientëve, përcjelljen e rregullt,

monitorimin e aderencës dhe bashkëpunimin farmacist - mjek për të përmirësuar rezultatet e pacientëve dhe për të ulur barrën e kujdesit shëndetësor.

Fjalë kyçe: Sëmundja pulmonare obstruktive kronike, konsumi i barnave, hospitalizimi, kujdesi farmaceutik, farmaci komunitare.

PRAKTIKAT MJEKËSORE TË PËRDORIMIT TË PROBIOTIKËVE NË RECETAT ME ANTIBIOTIKË.

Jonida Yzeiraj

Abstrakt

Hyrje: Përdorimi i antibiotikëve përbën një nga ndërhyrjet më të zakonshme në praktikën mjekësore moderne. Megjithatë, përdorimi i tyre shoqërohet shpesh me efekte anësore gastrointestinale, siç është diarreja e lidhur me antibiotikët, e cila lidhet me shkatërrimin e florës normale intestinale. Kjo gjendje, përveç shqetësimeve klinike, ndikon në uljen e cilësisë së jetës së pacientëve dhe rrit shpenzimet shëndetësore. Në vitet e fundit, probiotikët – mikroorganizma të gjallë që, kur merren në sasi të përshtatshme, ofrojnë përfitime shëndetësore – janë propozuar si një mjet efektiv për parandalimin e çrregullimeve gastrointestinale të shkaktuara nga antibiotikët. Evidencat shkencore tregojnë se disa shtame specifike, si Lactobacillus rhamnosus GG dhe Saccharomyces boulardii, mund të zvogëlojnë ndjeshëm incidencën e diarresë së lidhur me antibiotikët. Megjithatë, praktikat e përfshirjes së probiotikëve në recetat me antibiotikë ndryshojnë ndjeshëm në varësi të profesionistëve shëndetësorë, njohurive të tyre, llojit të antibiotikut dhe politikave të brendshme të institucioneve farmaceutike. Në këtë kontekst, analiza e recetave të përshkruara në një farmaci të rrjetit të hapur përfaqëson një mjet të vlefshëm për të kuptuar realisht se si zbatohet kjo praktikë në terren.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë praktikën aktuale të kombinimit të probiotikëve me antibiotikë dhe të identifikojë nëse ky kombinim zbatohet në mënyrë të qendrueshme dhe të bazuar në evidencë. Analiza e recetave të paraqitura gjatë vitit 2024 në një farmaci të rrjetit të hapur synon të ofrojë një panoramë reale të qasjes së profesionistëve të shëndetit ndaj parandalimit të efekteve anësore të antibiotikëve.

Metodologjia: Studimi është retrospektiv, deskriptiv dhe analitik, i bazuar në analizën e të gjitha recetave të paraqitura në një farmaci të rrjetit të hapur gjatë periudhës 1 janar - 31 Dhjetor 2024. Për cdo recetë janë regjistruar të dhëna bazë për pacientin (mosha, gjinia), informacion mbi antibiotikun dhe nëse në të njëjtën recetë është përshkruar ose jo një probiotik. Të dhënat janë hedhur manualisht dhe sistematikisht në një databazë të krijuar në programin Microsoft Ecxel. Të dhënat janë analizuar duke përdorur funksione statistikore në Excel.

Rezultate: Në studim u përfshinë në total 1813 receta në një farmaci të rrjetit të hapur për periudhën kohore 1 Janar - 31 Dhjetor. Popullata është rastësore, janë të gjithë pacientë të trajtuar me recetë nga mosha pediatrike deri në moshën geriartrike. Nga këto receta u vlerësuan ato me përshkrim antibiotikë (633), 89 nga të cilat kanë edhe një probiotik të shtuar. Recetat të cilat në përshkrim të antibiotikut kanë të shoqëruar një probiotik janë kryesisht të pacientëve pediatrikë. Konkretisht, 65 % e pacientëve të trajtuar me probiotikë janë pediatrike, 8. 01% janë pacientë nga mjekë familje, 5. 34% janë të tjerë (infeksionist, pneumolog) etj.

Fjalë kyçe: Antibiotik, Probiotik, flora bakteriale, recetë, farmaci.

RAPORTIMI I EFEKTEVE TË PADËSHIRUARA DHE VLERËSIMIT TË SINJALEVE NË FARMAKOVIGJILENCË.

Jovisa Marku

Abstrakt

Qëllimi: Raportimi i efekteve të padëshiruara në formatin ICSR (Individual Case Safety Report) sipas standartit ICH E2B dhe rëndësia e zbulimit, evidentimit dhe vlerësimit të efekteve të padëshiruara të sinjaleve në farmakovigjilencë. Qëllimi është të sigurohet që informacioni minimal i kërkuar për një raportim të jetë i plotë dhe i krahasueshëm mes autoriteteve rregullatore, kompanive farmaceutike dhe organizatave shëndetësore.

Metodologjia: Sinjalet në farmakovigjilencë janë informacion mbi një risk të mundshëm nga një bar që kërkon hetim të mëtejshëm. Konceptet bazë të "sinjalit" sipas OBSH, EMA dhe UMC, duke u fokusuar në burimet

kryesore të sinjaleve (raportimet spontane në VigiBase, literatura shkencore, autoritetet rregullatore, mediat) dhe faktorët që nxisin procesin e detektimit (efekte të padëshiruara të reja, raste fatale etj). Procesi i vlerësimit të sinjalit përfshin analizën e serive klinike dhe vlerësimin e shkakësisë (causality assessment). Raportimi i efekteve të padëshiruara në formatin ICSR përfshin: identifikimin e pacientit dhe raportuesit, barnat e dyshuara, përshkrimin klinik, narrativën e rastit, të dhëna mbi batch - in, dechallenge / rechallenge dhe vendin e ngjarjes. Një ICSR i vlefshëm duhet të përmbajë të paktën një raportues dhe pacient të identifikueshëm, një bar të dyshuar dhe një efekt të padëshiruar.
Përfundime: Përdorimi i gjerë pas autorizimit rrit nevojën për monitorim të vazhdueshëm. Integrimi i detektimit të sinjaleve dhe raportimit në ICSR siguron identifikimin e hershëm të risqeve dhe marrjen e masave për mbrojtjen e shëndetit publik.

Fjalë kyçe: risqe, farmakovigjilencë, efekte të padëshiruara, ICSR.

STUDIM MBI RISITË AKTUALE NË MENAXHIMIN E AKNE ROSACEA.

Klajda Serjanaj, Brunilda Myftari
Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt
Hyrje: Akne rosacea prek miliona njerëz në mbarë botën, duke ndikuar ndjeshëm në cilësinë e jetës. Trajtimet tradicionale përfshijnë antibiotikë topikalë dhe sistemikë, por këto nuk janë gjithmonë efektive dhe mund të kenë kufizime në lidhje me përdorimin afatgjatë. Hulumtimet e fundit kanë çuar në zhvillimin e terapive të reja që synojnë rrugë specifike të përfshira në patogjenezën e rosacea - s.
Metodologjia: U krye një rishikim gjithëpërfshirës i literaturës, duke shqyrtuar provat klinike, meta - analizat dhe udhëzimet e ekspertëve të botuara në pesë vitet e fundit. Inovacionet në modalitetet e trajtimit u kategorizuan në strategji farmakologjike, të bazuara në pajisje dhe strategji të reja.
Rezultate: Pacientët sot mund të përfitojnë nga risitë farmakologjike si Ivermektina topike: e cila sipas studimeve të fundit zvogëlon inflamacionin dhe eritemën e shoqëruar me rosacea përmes vetive të saj antiparazitare dhe anti - inflamatore; Brimonidina dhe Oksimetazolina: Këta agonistë alfa - adrenergjikë kanë treguar efikasitet në zvogëlimin e eritemës persistente të fytyrës duke shkaktuar vazokonstriksion të enëve të gjakut të zgjeruara; Terapitë me Lazer dhe Dritë: Dritë Intense e Pulsuar (IPL): Provat klinike mbështesin përdorimin e IPL në zvogëlimin e eritemës dhe telangiektazisë, duke përmirësuar pamjen e përgjithshme të lëkurës; Lazerët Vaskularë: Teknologji të tilla si lazeri me ngjyrë pulsuese (PDL) dhe lazeri Nd kanë treguar efektivitet në trajtimin e lezioneve vaskulare të shoqëruara me rosacea. Duhet përmendur Hulumtimi i Bioshënuesve: Hetimet mbi shënuesit gjenetikë dhe imunologjikë mund të lejojnë strategji trajtimi të përshtatura, duke synuar profile specifike të pacientëve bazuar në patofiziologjinë e tyre unike. Mjekësia e Personalizuar. Një rol kyç ka njohja në rritje e rolit të shkaktarëve të tillë si dieta dhe stresi, që ka çuar në rekomandime për modifikime individuale të stilit të jetesës, duke përfshirë ndryshimet në dietë dhe teknikat e menaxhimit të stresit.
Diskutime: Pamja e trajtimit të akneve rosacea është duke evoluar, me përparime të rëndësishme si në terapitë farmakologjike ashtu edhe në ato jo - farmakologjike. Inovacione të tilla si trajtimet topike me ivermectinë dhe lazer ofrojnë mundësi të reja për pacientët që nuk i përgjigjen terapive tradicionale. Theksi në mjekësinë e personalizuar mund të rrisë më tej efikasitetin e trajtimit dhe kënaqësinë e pacientit.
Përfundime: Trajtimet inovative për aknen rosacea vazhdojnë të shfaqen, duke adresuar natyrën shumëplanëshe të gjendjes. Një kombinim i terapive të synuara, teknologjive të përparuara të lazerit dhe strategjive të kujdesit individual premton përmirësimin e rezultateve tek pacientët me akne rosacea. Hulumtimi i vazhdueshëm është thelbësor për të përsosur më tej këto qasje dhe për të eksploruar rrugë të reja terapeutike.

Fjalë kyçe: akne rosacea, trajtim, barna, topike, jo - farmakologjike.

SISTEMET E ADMINISTRIMIT TË ADRENALINËS: EFIKASITETI, LEHTËSIA E PËRDORIMIT DHE DREJTIMET E ARDHSHME NË TRAJTIMIN E ANAFILAKSISË.

Klaudia Lekli, Amarilda Zyli
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Hyrje: Pajisjet për administrimin e adrenalinës janë të domosdoshme në trajtimin urgjent të anafilaksisë dhe reaksioneve të tjera të rënda alergjike. Administrimi i shpejtë dhe efektiv i adrenalinës mund të shpëtojë jetë, ndaj zgjedhja dhe dizenjimi i këtyre pajisjeve janë thelbësore.

Metoda: Ky rishikim vlerëson pajisje të ndryshme për administrimin e adrenalinës, duke përfshirë autoinjektorët intramuskularë dhe spërkatësit nazal, duke u fokusuar në farmacokinetikën, lehtësinë e përdorimit, sigurinë dhe aksesueshmërinë e tyre. Janë analizuar studime klinike dhe të dhëna mbi performancën e pajisjeve për të vlerësuar efektivitetin.

Rezultate: Autoinjektorët intramuskularë të adrenalinës mbeten standardi i artë për administrimin e shpejtë në raste anafilaksie, duke siguruar dozimin e saktë dhe lehtësinë e përdorimit në situata emergjente. Formulimet me spërkatës nazal janë shfaqur si një alternativë premtuese, duke ofruar administrim pa gjilpërë dhe duke përmirësuar aderimin dhe pranimin, veçanërisht te fëmijët dhe personat me frikë nga gjilpërat. Profilat farmacokinetikë ndryshojnë ndërmjet pajisjeve, duke ndikuar në kohën e fillimit të veprimit dhe bio - disponueshmërinë. Trajnimi dhe udhëzimet e qarta janë thelbësore për përdorimin e duhur të pajisjeve. Sfida përfshijnë kostot, disponueshmërinë dhe edukimin e pacientëve.

Konkluzione: Pajisjet për administrimin e adrenalinës janë mjete kyçe në menaxhimin e anafilaksisë, ku autoinjektorët dhe spërkatësit nazal ofrojnë përparësi të veçanta secili. Kërkimet dhe zhvillimet e ardhshme duhet të përqendrohen në optimizimin e dizajnit të pajisjeve, përmirësimin e aksesueshmërisë dhe ofrimin e trajnimeve të plota për pacientët dhe profesionistët shëndetësorë për të përmirësuar përgjigjen emergjente.

Fjalë kyçe: Pajisjet e adrenalinës, anafilaksia, drejtimet e ardhshme.

NDIKIMI I FTALATEVE NË SHËNDETIN E NJERIUT.
NJOHJA E SIMPTOMAVE TË RREZIKSHME NË BARNATORE.

Laureta Berisha Kosumi

Abstrakt

Hyrje: Janë të përditshme rastet e kërkesave të ndryshme nga pacientët që qasen në barnatoret komunitare për t'ju ofruar zgjidhje të shpejta rreth gjendjeve të ndryshme mjekësore, përfshirë edhe simptomat e rrezikshme, të cilat në pamje të parë mund të duken lehtë të zgjidhshme, por në fakt janë simptoma të cilat duhet trajtuar si emergjenca mjekësore duke i udhëzuar direkt te mjeku përkatës.

Qëllimi: Qëllimi im i trajtimit të kësaj teme është i lidhur me shqetësimin e ruajtjes së shëndetit të pacientit nga këto simptoma të cilat na duken të zgjidhshme nga dituria jonë si farmacistë, por në fakt duhet trajtim i mënjehershëm nga ana e mjekut. Shtuar kësaj, mundësinë e gabimeve të shumta që mund të ndodhin nga prezenca e personave jo kompetent në barnatore, me qëllimin e parë të zgjidhjes së problemit dhe idesë së gabuar që patjetër ti shitet diçka pacientit.

Materiale dhe metoda: Farmacistët të edukohen përmes ndjekjes së trajnimeve dhe seminareve të ndryshme për ti njohur simptomat e rrezikshme dhe të përgatiten për situata emergjente, duke e vënë në fokus ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të pacientit. Të përdoren protokolle standarde për konsultim me pacientët rreth simptomave të rrezikshme, si dhe të monitorohen këto simptoma. Poashtu, të përdoren udhëzime të qarta që ti referojmë pacientët te mjeku, atëherë kur simptomat janë të rrezikshme apo të komplikuara, gjithmonë duke e ruajtur qetësinë dhe duke mos e shqetësur pacientin. E në fund ura lidhëse farmacist - mjek, duhet të jetë hallkë e fortë profesionale, për të siguruar trajtimin e duhur për pacientët me simptoma të rrezikshme, duke çmuar dhe vlerësuar punën e njëri tjetrit, gjithmonë në të mirë të shëndetit të pacientit.

Rezultate: Si rezultate të këtij punimi do vë theksin në marrjen e njohurive nga farmacistët, e sidomos farmacistët e rinjë, rreth identifikimit të simptomave të rrezikshme, duke përfshirë një listë të simptomave të rrezikshme që mund të vijnë në kontakt me farmacistët në barnatore. Simptoma të tilla mund të jenë: vjellja, infeksionet mykotike, temperatura e lartë, shenjat e një ataku akut kardiak; e shumë të tjera që do i vë përgjatë prezantimit. Këtë punim do e plotësoj me shembuj praktik, në të cilët njohja e simptomave të rrezikshme ka

pasur një impakt të lartë pozitiv në kujdesin për pacientët në barnatore. Përdorimi i studimeve shkencore, literaturës së specializuar dhe udhëzimeve profesionale, con në mbështetje dhe përmirësimin e njohurive rreth simptomave të rrezikshme në barnatore, e më pas nga këto njohuri të aftësohen edhe farmacistë të rinjë dhe këso forme të ndërtohen hallka të rëndësishme në ruajtjen e shëndetit të pacientit, duke i ofruar zgjidhjen më profesonale.

Përfundime: Në përfundim do të theksohen përfitimet për farmacistët dhe pacientët në njohjen e këtyre simptomave të rrezikshme. Për farmacistët, kjo njohje do të rrisë kapacitetin e tyre për të ofruar këshilla dhe ndihmë të menjëhershme në rastet kur simptomat janë të rëndësishme dhe kërkojnë ndërhyrje të shpejtë. Kjo gjithashtu mund të përmirësojë reputacionin e barnatoreve si qendra të sigurta dhe të besueshme për kujdesin shëndetësor e jo vetëm për shitje të barnave. Në anën tjetër, për pacientët, njohja e simptomave të rrezikshme do të rrisë vetëdijen e tyre për shëndetin dhe do t'i ndihmojë ata të kërkojnë ndihmë mjekësore në kohë sa më të shpejtë dhe të shmangin komplikime të mundshme shëndetësore. Siç shihet, njohja e këtyre simptomave ka përfitime të konsiderueshme për të dyja palët, duke ndikuar në kualitetin dhe sigurinë e kujdesit shëndetësor në nivel të barnatoreve komunitare, gjithmonë në bashkëpunim të ngushtë me hallkat tjera të kujdesit shëndetësor.

Fjalë kyçe: parametrat antropometrik, IMT, SAK, indi dhjamor.

PËRGATESAT USHQYESE TË MOSHËS PEDIATRIKE, KËRKESAT TEKNOLOGJIKE DHE SFIDAT NË FORMULIM.

Ledjan Malaj, Adela Kallmeti
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Ushqimet e përdorura në pediatri përbëjnë një kategori thelbësore të ushqyerjes, të krijuara për të përmbushur nevojat fiziologjike dhe zhvillimore të foshnjave dhe fëmijëve të vegjël. Formulimi i tyre kërkon balancim të kujdesshëm midis përbërjes ushqyese, sigurisë mikrobiologjike dhe stabilitetit fiziko - kimik. Proceset teknologjike, si "spray drying", liofilizimi, mikroinkapsulimi, homogjenizimi dhe sterilizimi UHT janë vendimtare për cilësinë dhe sigurinë e produktit, ndërsa paketimi aseptik garanton ruajtjen optimale të tij.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të ofrojë një përshkrim analitik të teknologjive më të përdorura gjerësisht në prodhimin e produkteve ushqimore pediatrike dhe të eksplorojë sfidat e formulimit që lidhen me to. Ai gjithashtu synon të vlerësojë ndikimin e këtyre teknologjive në perceptimin e konsumatorit dhe në sigurinë e produktit përmes një analize krahasuese të tregut dhe të një pyetësori shkencor me fokus prindërit dhe farmacistët.

Metodologjia: Studimi është i ndarë kryesisht në dy pjesë. Pjesa teorike, e cila paraqet një qasje inovative nëpërmjet analizës së literaturës bashkëkohore mbi teknologjinë e prodhimit dhe sfidat e formulimit të ushqimeve pediatrike. Kjo pjesë mbështetet në burime shkencore të përzgjedhura në PubMed, ScienceDirect, Google Scholar dhe bazat e të dhënave të OBSH.

Pjesa hulumtuese, e cila realizohet përmes hartimit dhe plotësimit të një pyetësori shkencor, që synon të mbledhë të dhëna mbi perceptimin, njohuritë dhe qendrimet e prindërve dhe farmacistëve lidhur me cilësinë, sigurinë dhe teknologjitë e përdorura në produktet ushqimore pediatrike.

Rezultate: Studimi thekson rëndësinë e adoptimit të teknologjive moderne ushqimore në Shqipëri, forcimit të pajtueshmërisë rregullatore dhe përmirësimit të ndërgjegjësimit publik për cilësinë dhe sigurinë ushqyese. Duke kapërcyer hendekun midis perceptimit të konsumatorit dhe realitetit shkencor, ky studim kontribuon në diskutimet mbi politikat dhe praktikat e industrisë që synojnë përmirësimin e së ardhmes së ushqyerjes pediatrike në Shqipëri.

Fjalë kyçe: ushqime pediatrike, liofilizim, mikroinkapsulim, "spray drying", siguri ushqimore, kontroll cilësie, homogjenizim, paketim aseptik.

EPËRSITË DHE TË METAT E FORMULIMEVE FARMACEUTIKE QË PËRDOREN NË ZGAVRAT E ORGANIZMIT.

Ledjan Malaj, Brisilda Sela
Universiteti i Mjekësë, Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Administrimi i barnave nëpërmjet rrugës rektale dhe vaginale përbën një alternativë të rëndësishme ndaj administrimit oral dhe parenteral, duke ofruar përparësi si shmangia e metabolizmit të parë hepatik, veprim lokal, përthithje e shpejte dhe rritje e përputhshmërisë me pacientin. Formulimet farmaceutike të përdorura për këto rrugë përfshijnë supozitorët, ovulat, kremrat, xhelrat vaginale si dhe sistemet bioadezive, të cilat janë zhvilluar me qëllim rritjen e biodisponibilitetit dhe sigurimit të një veprimi terapeutik më të qëndrueshëm.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të ofrojë një analizë integruese rreth formulimeve farmaceutike që administrohen në rrugë vaginale dhe anale si dhe të paraqesi epërsitë dhe të metat e këtyre rrugëve.

Metodologjia: Ky është një studim kualitativ i realizuar përmes një rishikimi sistematik të literaturës (systematic literature revieë), me qëllim analizimin dhe sintetizimin e informacionit shkencor në lidhje me administriin e barnave në rrugë anale dhe vaginale. Përzgjedhja e literaturës është bërë përmes platformave shkencore PubMed dhe Google Scholar. Janë marrë gjithashtu parasysh informacionet e fituara gjatë studimeve universitare në fushën e Teknologjisë Farmaceutike. Janë përfshirë studime të botuara në gjuhën angleze dhe shqipe të tillë si: artikuj shkencorë, rishikime sistematike, raporte klinike dhe kapituj librash. Periudha e botimit të artikujve që u morën parasysh: 2015 - 2025. Janë përjashtuar: artikuj pa tekst të plotë, artikuj pa referenca të qarta. , studime që nuk trajtojnë drejtpërdrejtë temën kryesore, artikuj të përsëritur.

Rezultate: Ky studim thekson rëndësinë e këtyre formulimeve si pjesë e terapive moderne, duke kontribuar në zgjerimin e mundësive për trajtime më efektive dhe më të përshtatura ndaj nevojave të pacientëve.

Fjalë kyçe: administrim, rrugë rektale, rrugë vaginale, përgatitje farmaceutike, rëndësia terapeutike, teknologji farmaceutike.

RISITË NË ZHVILLIMIN E BARNAVE BIOLOGJIKË DHE ROLI I FARMACISTIT TË GJENERATËS SË ARDHSHME.

Ledjan Malaj, Jorgji Nica
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Abstrakt

Hyrje: Në këtë punim kam zgjedhur të trajtoj zhvillimet më të reja në barnat biologjikë dhe rolin e farmacistit të gjeneratës së ardhshme, një temë që përfaqëson ndërthurjen e bioteknologjisë moderne me kujdesin farmaceutik dhe vizionin për të ardhmen e mjekësisë. Barnat biologjikë kanë përmirësuar mënyrën se si trajtohen shumë sëmundje kronike dhe komplekse, duke sjellë një ndryshim të thellë në konceptin e terapisë: nga trajtimi simptomatik drejt një ndërhyrjeje të synuar në nivel molekular e qelizor. Gjatë kërkimit tim kam parë se risitë më të rëndësishme në këtë fushë fokusohen në rritjen e selektivitetit farmakologjik, uljen e toksicitetit sistemik dhe rritjen e qëndrueshmërisë së përgjigjes terapeutike. Një nga drejtimet më të rëndësishme të këtyre zhvillimeve është përdorimi i nanogrimcave, të cilat kanë sjellë një përparim të madh në mënyrën e shpërndarjes së barnave. Falë dimensioneve të tyre të vogla dhe mundësisë për t'u funksionalizuar, nanogrimcat mundësojnë çlirimin e kontrolluar dhe të synuar të molekulave biologjike, duke reduktuar efektet anësore dhe duke përmirësuar biodisponibilitetin e barnave. Një tjetër zhvillim është humanizimi i antitrupave monoklonalë, i cili ka mundësuar përdorimin më të sigurt të këtyre molekulave tek njeriu. Procesi i humanizimit ka eliminuar pjesërisht reaksionet imune që vinin nga përdorimi i antitrupave me origjinë jo - njerëzore, duke i bërë këto barna më të tolerueshme dhe më efikase. Kjo më ka bërë të kuptoj se çdo përmirësim teknologjik është i lidhur ngushtë me etikën, sigurinë dhe mirëqenien e pacientit, që janë vlera thelbësore dhe profesionale. Inxhinieria e antitrupave përfaqëson një nga arritjet më të larta të bioteknologjisë moderne. Nëpërmjet teknikave si manipulimi gjenetik dhe modelimi strukturor, sot mund të krijohen antitrupa me afinitet më të lartë për antigenin, qëndrueshmëri më të madhe në qarkullim dhe efikasitet më të lartë terapeutik. Kjo tregon se mjekësia po shkon drejt një epoke të re, ku terapitë biologjike do të jenë gjithnjë e më të personalizuara, të dizajnuara për çdo pacient sipas nevojave të tij. Teknologjitë e reja si CRISPR - Cas9, platformat e inxhinierisë së proteinave dhe nanoteknologjia po hapin horizonte të reja për zhvillimin e molekulave biologjike. Në këtë kuadër, roli i

farmacistit të gjeneratës së ardhshme bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Unë e shoh farmacistin e së ardhmes si një profesionist që nuk kufizohet vetëm në shpërndarjen e barnave, por që është pjesëmarrës aktiv në kërkimin shkencor, në zhvillimin e biosimilarëve, në vlerësimin e efekteve toksikologjike dhe në edukimin e pacientëve. Farmacisti modern duhet të kuptojë mekanizmat molekularë të barnave biologjike, të vlerësojë ndërveprimet dhe të ndihmojë në përdorimin racional e të sigurt të tyre.

Fjalë kyçe: risitë, barna biologjikë, rol, farmacist.

PROBIOTIKËT DHE TEKNOLOGJIA FARMACEUTIKE NË FUNKSION TË LËKURËS SË SHËNDETSHME: RISHIKIM LITERATURE.

Prof. Dr. Ledjan Malaj, Kriselda Krashi
Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekesisë, UMT.

Abstrakt

Hyrje: Lëkura është organi më i madh i trupit tonë. Mikrobiota e lëkurës luan një rol thelbësor në ruajtjen e ekuilibrit fiziologjik dhe në mbrojtjen kundër patogjenëve të jashtëm. Rritja e interesit për trajtime më natyrale dhe me më pak efekte anësore ka nxitur kërkimin e alternativave që synojnë jo vetëm simptomat, por edhe shkaqet biologjike të çrregullimeve të lëkurës. Probiotikët, të njohur tradicionalisht për efektet e tyre në shëndetin e traktit gastrointestinal, janë shfaqur si përbërës premtues në dermatologji falë aftësive të tyre imunomoduluese, antimikrobiale dhe riparuese të barrierës epidermale.

Qëllimi: Ky punim synon të realizojë një rishikim të thelluar të literaturës mbi përdorimin e probiotikëve në funksion të shëndetit të lëkurës dhe të analizojë rolin e teknologjisë farmaceutike në optimizimin e këtyre përbërësve në formulime dermatologjike.

Metodologjia: U realizua një analizë sistematike e literaturës shkencore në burime si PubMed, ScienceDirect, SpringerLink dhe Google Scholar, duke përfshirë artikuj kërkimorë dhe përmbledhje të publikuara gjatë dekadës së fundit, por kryesisht pesë viteve të fundit.

Rezultate: Probiotikët janë treguar efektivë në përmirësimin e gjendjes së lëkurës në patologji të ndryshme. Teknologjitë farmaceutike si mikrokapsulimi, liposomet, emulsionet e qëndrueshme dhe nanopartikalet janë thelbësore për ruajtjen e stabilitetit të shtameve probiotike dhe për shpërndarjen e kontrolluar në aplikime topike.

Fjalë kyç: Probiotikë, lëkura, mikrobiotë, teknologji farmaceutike, formulime topike, mikrokapsulimi, inflamacion, barrierë epidermale.

SISTEME NANO DHE MAKROSKOPIKE PËR ÇLIRIM TË LOKALIZUAR TË BARNAVE, TË NDJESHME NDAJ MJEDISEVE OKSIDO - REDUKTUESE DHE TË BAZUARA NË ACIDIN HIALURONIK. ZHVILLIMI DHE APLIKIMI NË IMUNOTERAPI.

Ledjan Malaj, Silvia Ndocaj, Roberta Censi
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
Universiteti i Camerino - s, Itali

Abstrakt

Hyrje: Imunoterapia përfaqëson një qasje premtuese në trajtimin e kancerit, duke synuar aktivizimin specifik të sistemit imunitar kundër qelizave tumorale. Megjithatë, terapitë konvencionale me antitrupa përballen me kufizime si stabilitet i ulët in vivo, toksicitet sistemik dhe depërtim i kufizuar në indet tumorale. Në këtë kontekst, zhvillimi i sistemeve të shpërndarjes së barnave që mundësojnë një çlirim të kontrolluar dhe të qëndrueshëm shënon një aspekt kyç në evolucionin e imunoterapisë bashkëkohore.

Metodologjia: U zhvilluan sisteme të bazuara në acidin hialuronik të tioluar (HA - SH) me dy shkallë zëvendësimi (DS30 dhe DS70) për çlirimin e kontrolluar të agjentëve imunoterapeutikë. Tiolimi i acidit hialuronik u realizua përmes reaksionit të amidimit të ndërmjetësuar nga EDC dhe lidhjet disulfide të formuara u reduktuan nga ditiotreitoli (DTT), ndërsa karakterizimi strukturor dhe morfologjik u realizua përmes FT - IR, Raman, ^{1}H - NMR dhe SEM. U formuluan hidroxhele dhe nanoxhele që përfshinin imunoglobulinën G (IgG) si

antitrup model dhe anti - PD1 (aPD1) si antitrup terapeutik. Nanoxhelet u karakterizuan për madhësinë e grimcave dhe indeksin e polidispersitetit (PDI) me anë të DLS.
Rezultate: Analizat konfirmuan modifikimin e suksesshëm të acidit hialuronik me grupe tiol. Hidroxhelet DS30 shfaqen një degradim më të shpejtë në mjedise reduktuese dhe çlirim të qëndrueshëm të antitrupit (85 ± 6% në 9 ditë), ndërsa DS70 shfaqën strukturë më të dendur dhe çlirim më të shpejtë (71 ± 7% në 5 ditë). Nanoxhelet e formuluara që përfshinin IgG dhe aPD1 paraqitën madhësi nanoskalare (220–249 nm) dhe PDI të ulët (0. 19–0. 43), duke treguar strukturë kompakte dhe të qëndrueshme, stabilitet të mirë koloidal dhe potencial të lartë terapeutik.
Përfundime: Sistemet me bazë HA - SH shfaqin potencial të lartë si platforma të personalizueshme për çlirim të synuar dhe të ndjeshëm ndaj mjedisit tumoral, duke kontribuar në rritjen e efikasitetit dhe sigurisë së imunoterapive moderne kundër kancerit.

Fjalë kyçe: imunoterapia, acidi hialuronik i tioluar, hidroxhele, nanoxhele; çlirim i kontrolluar; antitrupa; terapitë e personalizuara kundër kancerit.

NDIKIMI I KOMBINIMIT TË TERAPISË ME ANTIDEPRESIVË DHE ROSUVASTATIN NË FUNKSIONIN E HEPAR DHE VESHKËVE: RISHIKIM LITERATURE.

Lirika Kërhanaj
Universiteti i Tetovës

Abstrakt
Hyrje: Në dekadat e fundit, trajtimi farmakologjik për sëmundjet kardiovaskulare dhe sëmundjet e sistemit nervor është bërë një shtyllë kryesore e mjekësisë. Me rritjen e përdorimit të barnave për trajtimin e këtyre sëmundjeve është shtuar edhe rreziku për ndërveprime mes tyre. Një ndër kombinimet më të shpeshta paraqitet në rastet e kombinimit ndërmjet antidepresivëve dhe statinave, konkretisht rosuvastatinës. Këto dy grupe barnash metabolizohen pjesërisht në hepar dhe eleminohen përmes veshkve.
Qëllimi: Qëllimi kryesor i këtij punimi është të vlerësojë ndikimin që ka kombinimi i terapisë me antidepresivë dhe rosuvastatin në funksionin e hepar dhe të veshkëve, duke u bazuar në të dhënat e studimeve klinike dhe laboratorike ekzistuese, synohet analizimi i ndërveprimeve farmakologjike dhe identifikimi i ndryshimeve laboratorike në funksionin e parametrave biokimik renal (ALT dhe AST) dhe parametrave biokimik hepatik si dhe sigurinë klinike.
Metodologjia: Kërkimi u bazua në bazat e të dhënave PubMed, Scopus dhe Google Scholar, për periudhën 2005–2025. Nga 60 artikuj fillestarë, u përzgjodhën 15 që përmbanin të dhëna klinike ose eksperimentale mbi ndërveprimet midis rosuvastatinës dhe antidepresivëve.
Përfundime: Rosuvastatina mbetet një statinë e sigurtë në efikasitet dhe përdorim, por kur ajo përdoret në kombinim me terapi antidepresive kërkohet monitorim në dozim dhe i monitorim parametrave hepatik dhe renal, studimet tregojnë praninë e efekte anësore minore të rralla të cilat janë të kthyeshme.

Fjalë kyçe: rosuvastatin, antidepresivë, funksion i veshkëve, funksion i mëlçisë, interaksion mes barnave, parametra biokimik.

TABLETA TË VOGLA, IMPAKTE TË MËDHA: RIBOCICLIB 200MG.

Msc. Marsida Reli
Farmacia e Rimbursimit QSUNT

Abstrakt
Hyrje: Ky dokument eksploron fushën në zhvillim të inhibitorëve CDK4 / 6 duke e krahasuar atë me barnat konvencionale dhe duke u thelluar në përdorimin e tyre në rritje, kuadrin ligjor në Shqipëri, dhe përfshirjen e tyre në listen spitalore të barnave të rimbursuara në vend. Ribociclib 200 mg: Inovacion në klasën e inhibitorëve CDK4 / 6 dhe roli i farmacistit në terapinë onkologjike moderne. Ribociclib i përket klasës së inhibitorëve të kinazave të varura nga ciklina 4 / 6 (CDK4 / 6), të cilët kanë revolucionarizuar trajtimin e kancerit të gjirit HR+ / HER2 -. Ndryshe nga mjekësia konvencionale, e cila mbështetej kryesisht në terapi hormonale klasike ose

kimioterapi me toksicitet të lartë, ribociclib ka demonstruar përfitime të qëndrueshme në mbijetesë, duke u bërë pjesë standarde e trajtimit si në stadin metastatik, ashtu edhe si terapi adjuvante në pacientet me rrezik të lartë rikthimi. Tema paraqet rëndësinë e formulimit të Ribociclib 200mg, i cili ofron fleksibilitet në modifikimin e dozës, duke mbështetur personalizimin e trajtimit, përmirësimin e përputhshmërisë dhe përdorimin racional të barnave të kushtueshme në kuadër të Listës së Barnave të Rimbursueshme spitalore. Forma farmaceutike 200 mg lejon reduktime të dozës (600 → 400 → 200 mg) pa ndërprerje të terapisë, çka përmirëson vazhdimësinë e trajtimit dhe cilësinë e jetës së pacienteve. Krahasuar me trajtimet konvencionale, ribociclib si terapi orale është më i menaxhueshëm dhe integron konceptin e kujdesit onkologjik të personalizuar. Roli i farmacistit spitalor mbetet thelbësor në: monitorimin e ndërveprimeve farmakologjike (CYP3A4), këshillimin e pacienteve, mbikëqyrjen e parametrave laboratorikë, menaxhimin e stoqeve dhe sigurimin e qëndrueshmërisë ekonomike të rimbursimit.
Përfundime: Ribociclib 200 mg përfaqëson një risi të vogël farmaceutike me ndikim të madh klinik e farmakoekonomik. Si në përdorimin adjuvant ashtu edhe në terapinë e avancuar, ai mbështet kujdesin onkologjik të personalizuar, ndërsa farmacisti spitalor ka rol kyç në sigurimin e përdorimit racional dhe të sigurt të tij.

Fjalë kyçe: inhibitore te kinazave CDK4 / 6, barna konvencionale, legjislacioni shqiptar, barna të rimbursueshme, politika mjekësore, farmaci spitalore.

FORMULIMI E ZHVILLIMI I NJË PRODUKTI DERMATOLOGJIK KUNDËR PSORIAZËS: NGA KËRKIMI LABORATORIK DERI NË PËRDORIMIN KLINIK.

Migena Lika, Rexhina Bazaj, Ariola Todhe, Enver Mustafaj
Njësia R&D dhe Laboratori i Kontrollit të Cilësisë, Fabrika Florfarma

Abstrakt
Hyrje: Ky punim trajton një qasje të integruar teknologjike dhe farmakologjike në formulimin e zhvillimin e një pomade dermatologjike me veprim kundër psoriazës dhe ekzemës, e cila ka si bazë vazelinen e verdhë dhe parafinen e lehtë, ku inkorporohen lëndë vepruese si acidi salicilik, rezorcina, vaji i pemës së çajit (*Tee Trea oil*), oksidi i zinkut dhe iktioli.
Qëllimi: Ky punim ka si synim studimin dhe zhvillimin tërësor të të gjitha niveleve të prodhimit teknologjik të pomadës duke inkluduar të gjitha lëndët vepruese me efektet e tyre terapeutike dhe synuar prodhimin deri në nivel industrial, duke garantuar cilësi produkti, siguri, efikasitet, por dhe përmbushje të kërkesave të tregut.
Metodologjia: Zhvillimi i pomadës, si produkt farmaceutik është ndjekur përmes një metodologjie të strukturuar, e cila përfshin faza të qarta nga konceptimi fillestar deri te synimi për prodhim në shkallë industriale për tu finalizuar pastaj me studime klinike e të dhëna (feedback) të profesionistëve mjekësorë, të lidhura me sigurinë e barit dhe efektet e synuara terapeutike te pacientët. Aspektet teknologjike të punimit: në stadet e realizuara deri tani, është gjetur një bazë e përshtashme pomade me raporte optimale mes dy përbërësve vazelinë - parafinë e lehtë, e cila siguron viskozitetin e duhur për një shpërndarje sa më të mirë mbi lëkurë; mundëson inkorporimin (trupëzimin) e gjithë përbërësve të tjerë veprues edhe në raporte të ndryshuara mes tyre, përfshirë lëndë viskoze (iktioli), lëndë të ngurta (acidi salicilik, rezorcina e oksidi i zinkut) dhe lëngun vajor të pemës së çajit. Tek produkti në studim, po vazhdohet me ndjekjen e stabilitetit të formulimit ekzistues ndërkohë paralelisht po realizohet dhe optimizimi i parametrave të prodhimit industrial: përkatësisht shkallës dhe mënyrës së pluhurizimit të lëndëve të ngurta, rendit dhe mënyrës së inkorporimit të lëndëve vepruese në bazën e pomadës, temperaturës më të përshtatshme për operimin në reaktor (makineria ku realizohet përzierja, homogjenizimi, temperatura dhe vakumi, nëse do të jetë e nevojshme), kohëzgjatjes më të përshtatshme dhe numrit të rrotullimeve qoftë tek procesi i përzierjes apo homogjenizimit dhe gjetjes së parametrave optimal tek makineria e mbushje - dozimit. Në aspektin trajtimit farmakologjik: megjithëse njihet tashmë etiologjia autoimune e psoriazës, duke shkaktuar luspa, kruarje dhe inflamacion, sikurse dihet dhe pranohet se trajtimi më i zakonshëm i kësaj patologjie janë kortikosteroidet topike si betametazoni, fokusi ynë u orientua drejt formulimeve gjysmë të ngurta me përdorim lokal. Në përfundim, studimi i deritanishëm ku ndërthuren komponentët teknologjikë dhe farmakologjikë, i përgatitur deri në shkallen pilot, bazuar edhe në të dhënat e deritanishme nga klinicistë e farmacistë, rezulton i përshtatshëm për trajtimin simptomatik të formave të lehta deri të moderuara të psoriazës.

Fjalë kyçe: formulim dermatologjik, metodologji kërkimore, rezultate eksperimentale, risi teknologjike, tea tree oil, antipsoriazë, prodhim pilot dhe industrial, R&D farmaceutik.

NDËRVEPRIMET E BARNAVE ANTIKOAGULANTE DHE RËNDËSIA E KOMUNIKIMIT MULTIDISIPLINOR NË MENAXHIMIN E EFEKTEVE ANËSORE: NJË STUDIM PËRVOJASH NDËRMJET FARMACISTËVE DHE STOMATOLOGËVE.

Naziona Malka
Farmaciste – Farmaci Sauku

Abstrakt
Qëllimi: Terapia me antikoagulantë oralë përbën një nga ndërhyrjet më të ndjeshme në praktikën mjekësore, për shkak të dritares së ngushtë terapeutike dhe rrezikut të shtuar për hemorragji apo ndërveprime me barna dhe ushqime të tjera. Ky studim synon të eksplorojë rolin e farmacistit dhe stomatologut në identifikimin dhe menaxhimin e efekteve anësore që lidhen me përdorimin e antikoagulantëve, me fokus në ndërveprimet bar–bar dhe bar–ushqim, si dhe rëndësinë e komunikimit të koordinuar multidisiplinor për të shmangur ndërlikime të padëshiruara te pacientët që i nënshtrohen ndërhyrjeve dentare ose kirurgjikale.
Metodologjia: U realizua një pyetësor i strukturuar me 20 profesionistë të shëndetit (farmacistë dhe stomatologë), i cili përfshinte pyetje lidhur me njohuritë e tyre mbi ndërveprimet më të zakonshme të antikoagulantëve, rastet klinike të përjetuara, praktikat e bashkëpunimit me mjekët përshkrues, si dhe menaxhimin e pacientëve para dhe pas procedurave dentare.
Rezultate: Analiza e përgjigjeve tregoi se: Ndërveprimet bar–bar më të shpeshta përfshinin: NSAID (si ibuprofeni dhe diklofenaku), të cilët rrisin rrezikun për gjakderdhje gastrointestinale kur kombinohen me antikoagulantë. Antibiotikë si metronidazoli dhe makrolidet, që mund të ndikojnë në metabolizmin e acenokumarolit, duke rritur efektin e tij antikoagulues. Suplemente dietike si vitamina E dhe preparatet me vaj peshku, që kanë efekt shtesë antitrombocitar dhe mund të rrisin rrezikun për hemorragji. Antifungale (p. sh. flukonazoli), të cilat pengojnë metabolizmin e antikoagulantëve të varur nga enzima CYP450. Ndërveprimet bar–ushqim më të raportuara përfshinin: Marrjen e vitaminës K në sasi të mëdha (perime me gjethe jeshile, brokoli, lakra), që antagonizon veprimin e acenokumarolit. Konsumi i tepërt i alkoolit, që ndikon në nivelet plazmatike të barnave. Konsumi i qitros, i njohur për inhibimin e enzimës CYP3A4, çka çon në rritje të përqendrimit plazmatik të barnave si rivaroxabani dhe apixabani, duke rritur ndjeshëm rrezikun për gjakderdhje. Stomatologët raportuan dilema të shpeshta klinike lidhur me ndërprerjen e antikoagulantëve para ndërhyrjeve, duke theksuar rëndësinë e konsultës me mjekun përshkrues për çdo vendim mbi modifikimin e dozës ose ndërprerjen e përkohshme të terapisë. Farmacistët theksuan rolin e tyre në identifikimin e ndërveprimeve potencialisht të rrezikshme gjatë ekzekutimit të recetës, si dhe nevojën për edukimin e pacientit mbi mënyrën e administrimit të barnave dhe raportimin e çdo simptome të pazakontë. Komunikimi efektiv ndërmjet mjekut përshkrues, farmacistit dhe stomatologut u identifikua si faktor kyç në parandalimin e efekteve anësore serioze, veçanërisht te pacientët me histori hemorragjike ose me terapi të kombinuar (antitrombocitarë dhe antikoagulantë). Barnat më të përdorura nga pacientët, sipas raportimeve të pjesëmarrësve, ishin: aspirina 100 mg, rivaroxabani 20 mg, apixabani 5 mg dhe acenokumaroli 4 mg.
Përfundime: Ky studim nxjerr në pah kompleksitetin e menaxhimit të pacientëve që marrin terapi me antikoagulantë dhe rëndësinë e një qasjeje të integruar, të bazuar në bashkëpunim dhe komunikim të vazhdueshëm ndërmjet profesionistëve të shëndetit. Rritja e ndërgjegjësimit për ndërveprimet e mundshme, edukimi i pacientëve dhe vendimmarrja e përbashkët janë thelbësore për të siguruar një trajtim të sigurt dhe efektiv, duke shmangur ndërlikimet peri - dhe post - operatore. Edukimi i vazhdueshëm i profesionistëve dhe angazhimi aktiv në bashkëpunim ndërdisiplinor janë elementë kyç për reduktimin e efekteve anësore dhe përmirësimin e sigurisë së pacientit.

Fjalë kyçe: Terapi me antikoagulantë oralë, terapi, vitamina, analiza.

PËRDORIMI I PROBIOTIKËVE: NJË STUDIM EKSPERIMENTAL ME ANKETIM TE STUDENTËT E FARMACISË.

Amelia Ibrahimi[1], Olsi Caushi[2], Selim Ibrahimi[3]
[1]*Universiteti Barleti, Deparatamenti i Farmacisë.*
[2]*Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Farmacisë, Farmacist*
[3]*Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë, Mjek Familje*

Abstrakt
Hyrje: Probiotikët janë mikroorganizma të gjallë që, kur administrohen në sasi të mjaftueshme, sjellin përfitime shëndetësore për organizmin. Ky studim ka për qëllim të vlerësojë njohuritë, përdorimin dhe perceptimet e studentëve të shkencave mjeksore kryesisht te farmacisteve lidhur me suplementet probiotike. Metoda e përdorur është një anketim i thjeshtuar me 50 studentë. Rezultatet treguan se 72% e studentëve kishin përdorur probiotikë, kryesisht në raste të terapisë me antibiotikë. Diskutimi nxjerr në pah nevojën për edukim më të gjerë mbi përdorimin racional të probiotikëve.
Qëllimi: Ky studim ka për synim të vlerësojë njohuritë, përdorimin dhe perceptimet mbi suplementet probiotike te studentët e farmacinë.
Metodologjia: U realizua një anketim me 50 studentë, duke përdorur një pyetësor me 10 pyetje që matnin frekuencën e përdorimit, arsyet, burimin e informacionit dhe perceptimin mbi efikasitetin.
Rezultate: 72% e studentëve kishin përdorur probiotikë, kryesisht gjatë trajtimeve me antibiotikë (65%). Burimi kryesor i informacionit ishin profesionistët shëndetësorë (50%), por një pjesë e konsiderueshme e studentëve u informuan nga interneti (30%). Shumica (60%) raportuan përvoja pozitive me efektivitet të dukshëm.
Përfundimi: Përdorimi i probiotikëve është i përhapur mes studentëve të farmacinë, me rol të veçantë në reduktimin e efekteve anësore të antibiotikëve. Edukimi i strukturuar mbi përdorimin racional mbetet i nevojshëm për të garantuar praktikë farmaceutike të bazuar në evidencë.

Fjalë kyçe: probiotikë, studentë farmacie, përdorim, perceptim, antibiotikë.

PRAKTIKAT E RUAJTJES DHE SHPËRNDARJES SË MIRË TË BARNAVE SI STANDARD NDËRKOMBËTAR.

Orion Dido[1], Helena Hazizaj[2] Arjola Lata[1]
[1]*Inspektor, Sektori i Inspektimit, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore*
[2]*Përgjegjës Sektori Shpërdarjes së Barnave, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore*

Abstrakt
Hyrje: Praktikat e Ruajtjes dhe Shpërndarjes së barnave i referohen standardeve minimale që një shpërndarës i barnave duhet të përmbushë për të siguruar që cilësia dhe integriteti i barnave të ruhen gjatë gjithë zinxhirit të shpërndarjes. Rritja e tregut farmaceutik dhe nevoja për unifikim rregullator i kanë bërë Praktikat e Ruajtjes dhe Shpërndarjes së Mirë të Barnave një standard të domosdoshëm në nivel ndërkombëtar. Ky studim synon të shqyrtojë rëndësinë e praktikave të mira, ndikimin e tyre në sigurinë farmaceutike dhe sfidat e zbatimit në Shqipëri.
Objektiva: Të shqyrtojë situatën aktuale të Praktikave të Ruajtjes dhe Shpërndarjes së Mirë të Barnave në farmaci në Shqipëri si dhe të propozojë ndryshime dhe përmirësime në legjislacionin shqiptar për të siguruar përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare.
Materiale dhe metoda: Të dhënat për studimin u morën nga shpërndarja e një pyetësori online te farmacistët e komunitetit në Shqipëri. Ai u plotësua nga 136 farmacistë (91. 2 % nga zona urbane), nga ku 60. 3% të farmacistëve ishin me më shumë se 3 vite eksperiencë pune. Vetëm 39. 7% e farmacistëve pjesëmarrës në pyetësor kanë marë pjesë në trajnime mbi procedurat e ruajtjes, shpërndarjes dhe menaxhimit të barnave. Gjithashtu, 92. 6% e farmacistëve nuk i rregjistrojnë të dhënat e temperaturave të ambientit dhe frigoriferit në një databazë fizike / elektronike.
Rezultate: Rezultatet e studimit treguan që ka nevojë për disa ndryshime si në kuadrin ligjor apo edhe në rritjen e ndërgjegjësimit te farmacistët për të përmirësuar situatën aktuale.

Fjalë kyçe: Barna, farmaci, shpërndarje, standard ndërkombëtar.

POLIMERET ORGANIKE SI PLATFORMA TË AVANCUARA PËR CLIRIMIN E KONTROLLUAR TË MEDIKAMENTEVE: PERSPEKTIVA FARMACEUTIKE DHE EKSPERIENCA NDËRKOMBËTARE.

Partizan Malkaj[1]; Ledjan Malaj[2]
[1]*Departamenti i Inxhinierisë Fizike, Universiteti Politeknik i Tiranës, Departamenti i Farmacisë; Universiteti i Mjekësisë i Tiranës.*
[2]*Departamenti i Farmacisë, Universiteti Mjekësor i Tiranës.*

Abstrakt
Në dekadat e fundit, polimeret organike janë shfaqur si një klasë materialesh jashtëzakonisht premtuese për zhvillimin e sistemeve të leshimit të kontrolluar të medikamenteve. Këto materiale karakterizohen nga biokompatibiliteti, biodegradueshmëria dhe mundësia e modifikimit kimik, çka i bën ato të përshtatshme për një gamë të gjerë aplikimesh farmaceutike. Këto platforma bazohen në mekanizma të kontrolluar leshimi, të cilët lejojnë shpërndarjen graduale të përbërjes aktive në vendin e veprimit, duke reduktuar toksicitetin sistemik dhe duke përmirësuar efikasitetin terapeutik. Ndër polimerët sintetikë më të përdorur përfshihen polilaktidi (PLA), poliglikolidi (PGA) dhe kopolimeri i tyre PLGA, të cilët kanë treguar rezultate të shkëlqyera në formimin e nanogrimcave, mikrosferave dhe hidrogeleve me qëndrueshmëri të lartë dhe profil të qëndrueshëm clirimi. Nga ana tjetër, polimeret natyrale si kitozani, alginati dhe celuloza e modifikuar kimikisht po zënë një vend gjithnjë e më të rëndësishëm falë përputhshmërisë biologjike dhe aftësisë së tyre për të ndërvepruar me molekulat e barit përmes lidhjeve jonike ose hidrogjenore. Eksperienca ndërkombëtare tregon se sistemet e bazuara në polimere organike kanë gjetur zbatim të gjerë në terapitë onkologjike, në clirimin e peptideve dhe proteinave, si dhe në sistemet transdermale, okulare dhe gastrointestinale. Këto zhvillime përfaqësojnë një hap drejt personalizimit të terapisë farmaceutike dhe integrimit të nanoteknologjisë në zhvillimin e barnave me biodisponibilitet të optimizuar. Polimeret organike përfaqësojnë një platformë thelbësore në dizajnin e sistemeve inteligjente dhe të qëndrueshme të clirimit të kontrolluar, duke kontribuar në avancimin e farmacisë bashkëkohore drejt një terapie më efikase, të sigurt dhe të personalizuar për pacientin.

Fjalë kyçe: polimerë organikë; çlirim i kontrolluar i medikamenteve; nanoteknologji farmaceutike; biokompatibilitet; inovacion.

RËNDËSIA DHE ROLI I SUPLEMENTEVE E NUTRACEUTIKËVE GJATË DIETAVE PËR HUMBJE PESHE.

Dr. Patricia Daliu
Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University.

Abstrakt
Në ditët e sotshme po vihet re një qasje ndaj dietave ketogjenike apo detox. Këto dieta janë efektive për humbje të shpejt peshe, kontroll të sheqerit në gjak dhe përmirësim të metabolizmit. Por ato mund të nxisin trupin të nxjerrë më shumë ujë dhe elektrolite, mungesa të disa lëndeve ushqyese pasi kufizojnë ose përjashtojnë frutat, drithërat dhe bishtajoret, që janë burime të fibrave, vitaminave dhe mineraleve të cilat ndihmojnë në funksionimin e muskujve dhe energjinë, duke sjellë në disa raste efekte anësore. Ky punim ka si qëllim të realizojë një databazë të përsonalizuar për secilën dietë lidhur me nevojën specifike për nutraceutike dhe suplemente duke sjellë rekomandime, në dozim, mënyrën e marrjes, kohëzgjatje dhe zgjedhjen e duhur te këtyre shtesave ushqimore duke përfshirë vitaminën A, grupin e vitaminave B, C, E, K, magnez, fibra, acide yndyrore, prebiotikë e probiotikë, enzima tretëse dhe ekstrakteve bimore duke theksuar faktin që suplementet nuk zëvendësojnë një dietë të shëndetëshme.

Fjalë kyçe: Nutraceutike, suplemente, dieta ketogjenike, detox.

DERMATITI ATOPIK: PATOGJENEZA, FAKTORËT NXITËS DHE STRATEGJI TË REJA MENAXHIMI.

Rexhina Marku, Brunilda Myftari
Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt

Hyrje. Dermatiti atopik (DA) është një sëmundje inflamatore kronike e lëkurës që karakterizohet nga episodet e përsëritura të kruarjes dhe inflamacionit. Kjo sëmundje prek fëmijët dhe të rriturit në mënyrë të përhapur në mbarë botën dhe ka një ndikim të konsiderueshëm në cilësinë e jetës së pacientëve. Menaxhimi i sëmundjes është sfidues, duke kërkuar përdorimin e përgatitjeve farmaceutike si glukokortikoidët lokalë dhe imunomodulatorët, përfshirë takrolimusin dhe pimekrolimusin.

Qëllimi. Ky studim synon të sjellë një pasqyrë të terapive që rekomandohen në Shqipëri dhe t'i krahasojë me ato të ndjekura në vendet e Europës dhe Ballkanit.

Metodologjia. Janë grumbulluar dhe përzgjedhur artikuj shkencorë dhe materiale të tjera nga literatura përmes kërkimit në faqe të ndryshme si Pub Med, Google scholar, researchgate, etj përgjatë një periudhe 3 mujore. Paralelisht është përgatitur një pyetësor i strukturuar për të paraqitur situatën në kryesisht farmacitë e Tiranës. Të dhënat janë mbledhur edhe përmes takimeve me disa farmaci dhe përfshijnë analiza mbi recetat e përshkruara dhe preferencat e trajtimit.

Rezultate. Nga rezultatet e pyetësorit mund të thuhet se trajtimet farmaceutike më të përdorura në farmacitë shqiptare për menaxhimin e DA - së, janë glukokortikoidët lokalë dhe inhibitorët e kalcineurinës. Nga shqyrtimi i literaturës rezulton se si terapi inovative dhe me rezultate të mira edhe në raste të rënda mund të jenë barna si dupilumab. Studimet e venë theksin edhe tek trajtimet që shërbejnë për rigjenerimin e funksionit të barrierës kutane. Rekomandohen hidratues të avancuar dhe formulime të pasura në ceramide.

Përfundime: Panorama e trajtimit të dermatitit atopik po zhvillohet me shpejtësi, me një gamë gjithnjë e në rritje të opsioneve terapeutike inovative që përmirësojnë rezultatet dhe cilësinë e jetës së pacientëve. Hulumtimi i vazhdueshëm është thelbësor për të sqaruar më tej patofiziologjinë e AD - së dhe për të zhvilluar trajtime më efektive dhe të synuara.

Fjalë kyçe: Dermatit atopik, trajtim, farmaci, barna, rigjenerim.

APLIKIMI I INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË FUNKSION TË PËRMIRËSIMIT TË SIGURISË SË MJEKIMIT.

Dr. Rudina Prifti[1], Alda Todaj[1], Emona Vokshi[1], Daria Sinani[2]
[1]*Albanian Univerity*
[2]*Semmelweis University*

Abstrakt

Hyrje: Inteligjenca artificiale (IA) shfaqet si një teknologji transformuese që ka potencial të revolucionarizojë kujdesin shëndetësor në tërësi, pa lënë mënjanë edhe kujdesin farmaceutik. Programet e IA janë zhvilluar dhe aplikohen sot për diagnostikimin e patologjive, për zhvillimin e protokolleve të mjekimit, zbulimin e barnave, mjekësinë e personalizuar, kujdesin dhe monitorimin e pacientit.

Qëllimi: Ky punim synon të eksplorojë dhe analizojë zbatime të ndryshme të IA brenda fushës së kujdesit shëndetësor në tërësi e veçanërisht në kujdesin farmaceutik.

Materiale dhe metoda: Mbledhja dhe paraqitja e të dhënave të marra nga studime dhe botime shkencore publikuar në PubMed, Google Scholar etj në lidhje me IA, farmacinë klinike, menaxhimin e barnave, reaksionet e padëshiruara të barnave etj.

Rezultate: IA, duke përdorur algoritme të ndryshme, mund të aplikohet për zbulimin dhe parashikimin e reaksioneve të padëshiruara të barnave (ADRs) në praktikën e farmacisë. Studimet tregojnë zbatimin e suksesshëm të sistemeve të mbështetjes së vendimeve klinike të bazuara në IA për të rritur kujdesin ndaj pacientit dhe sigurinë e mjekimit. IA është përdorur për të automatizuar proceset e shpërndarjes, për të optimizuar dozimin e barnave, për të përmirësuar aderimin e pacientit dhe për të ofruar shërbime të personalizuara të mjekimit.

Diskutime: Përfshirja e IA në praktikën farmaceutike ofron përfitime të rëndësishme duke përfshirë vendime klinike më të sakta e të bazuara në prova, përmirësime të rezultateve të pacientit dhe përmirësim të

bashkëpunimit midis hallkave të kujdesit shëndetësor. Nevojiten studime të mëtejshme për të shfrytëzuar plotësisht potencialin e IA në kujdesin farmaceutik. Kërkimet duhet të fokusohen në zbatimin gjithëpërfshirës të shërbimeve të IA brenda sistemeve ekzistuese dhe në vlerësimin e ndikimit të tyre në përmirësimin e shëndetit të pacientëve, por edhe të kostove financiare.

Fjalë kyçe: Inteligjencë artificiale, farmaci, pacientë, siguri.

PËRDORIMI I TINZAPARINËS NË TROMBOEMBOLIZMIN PULMONAR: STUDIM RASTI.

Silvana Crroj[1], Silvana Mullhaj (Sadria)[2]
[1]*Farmaciste*
[2]*Mjeke Pneumologe Qëndra e Sëmundjeve të Mushkërive Dispanceria.*

Abstrakt
Hyrja: VTE - Trombozë e venave të thella (DVT) + Embolizëm Pulmonar (PE). Tromboza e venave të thella është një sëmundje e shpeshtë, ashpërsia e së cilës lidhet me fillimin e një embolizmi pulmonar e cila mund të jetë vdekjeprurese. Diagnoza e trombozës së venave të thella është një diagnozë e vështirë që duhet të marrë në konsideratë shenjat klinike, por edhe kontekstin klinik dhe praninë e faktorëve të rrezikut ndoshta të kthyeshëm. Një dozë emergjente e D - dimerit lejon të vendoset një strategji diagnostikuese. Komplikacioni kryesor i trombozës së venave të thella është Embolizmi Pulmonar (PE) pasi ai vë në lojë prognozën afatshkurtër "quoad vitam" dhe evolucionin e mundshëm te semundjeve pulmonale kronike në afat të mesëm dhe të gjatë. Zgjedhja e parë në nivel botëror bëhet me heparinat me peshë të ulët molekulare, rasti që do të trajtojmë është me Tinzaparinë 4500 ui.
Metodologjia: Ne do të paraqesim rastin e një mashkulli 77 vjec, i cili mbërriti në urgjencë me fillimin e një gjendjeje të papritur dhe të pashpjegueshme të agjitacionit psikomotor, të karakterizuar nga dridhje të përgjithësuara dhe mungesë frymemarrje. Në ekzaminimin fizik, gjendja e e tij e përgjithshme duket e mirë. Pacienti duket i qartë dhe i orientuar. Obezitet i moderuar. Takipnea (23 frymëmarrje / minutë) dhe takikardia (120 rrahje / minutë) janë të pranishme. Auskultimi i kraharorit zbulon kërcitje bibazilare që nuk lehtësohen nga kolla. Kjo gjëndje kishte vazhduar për gati 2 javë në shtëpi.
Qëllimi: Vlerësimi i përdorimit të Tinzaparinës në mjekimin afatgjatë në diagnoza si Tromboembolizmi Pulmonar (TEP) duket të jetë i realizueshëm në pacientët të cilët vlerësohen si kandidatë për terapi në shtëpi. Kjo për shkak se gjatësia e zinxhirit të Tinzaparinës (Innohep®) përkthehet në avantazhe klinikisht të rëndësishme, krahasuar me LMWH me zinxhirë më të shkurtër.
Rezultate: Tinzaparina u përdor së pari gjatë qëndrimit në spital dhe më pas në shtëpi për një periudhë 21ditore dhe deri në 6 muaj. Eficienca: Tinzaparina eshte efektive si faze e parë gjate hospitalizimit dhe ambulatore për TEP. Siguria: Me pak komplikime të lehta hemoragjike se VKA. Prakticiteti: Një doze fikse subkutane pa nevojë për monitorim të rregullt të PPT / INR. Kosto dhe qëndrueshmëri: Me e shkurter në Spital, kosto direkte te ngjashme ose me të uleta në krahasim me të tjerat.
Përfundime: Ky rast klinik përfaqëson një rast të rrallë të tromboembolizmit venoz me një të ashtuquajtur paraqitje atipike: Konsultimi psikiatrik ndihmoi në parandalimin e kësaj, duke lidhur ankthin me problemet themelore "organike"; një anamnezë më e thelluar, e kryer në një vend "të mbrojtur" (si një njësi kujdesi nën - intensiv) me qëllim marrjen e bashkëpunimit më të mirë të mundshëm nga pacienti, zbuloi sulme të dukshme paniku, të cilat e kishin goditur papritur për rreth 10 ditë, shoqëroheshin me dispne me djersitje të lehtë dhe një ndjesi subjektive të vertigos; simptoma të karakterizuara nga takikardi, takipne me ndryshime tipike të gazrave të gjakut (hipoksemi dhe hipokapni); dhe një rritje progresive të D - dimerit. Tinzaparina u përdor se pari gjatë qendrimit ne spital dhe më pas në shtëpi për një periudhë 21 ditore dhe deri në 6 muaj. Edhe pse imazhet në skanera CT nuk trëgojnë në menyrë direkte efektin e tinzaparinës, konfirmojnë diagnozën me TEP që çon në vendosjen e trajtimit me Tinzaparinë si LMWH standarte. Stabiliteti dhe shëndeti i pacientit përcaktojnë një plan trajtimi me kohëzgjatje deri në 6 muaj me Tinzaparinë.

Fjalë kyçe: Trombozë e venave të thella (DVT), embolizëm pulmonar (PE), tromboembolizëm pulmonar (TEP), tinzaparina, LMWH, përdorimi i tinzaparinës në tromboembolizmin pulmonar**.**

PËRDORIMI IRRACIONAL I ANTIBIOTIKËVE: PASOJAT E FSHEHURA DHE MËSIMET E NXJERA NGA EPOKA E COVID - 19.

Silvi Bozo
[1]*Departamenti i Teknologjive Kimiko - farmaceutike dhe Biomolekulare, Fakulteti i Farmacisë, Universiteti Katolik ''Zoja e Këshillit të Mirë'', Tiranë, Shqipëri*

Abstrakt

Qëllimi: Përdorimi irracional i antibiotikëve është një nga faktorët kryesorë që nxisin rezistencën antimikrobike (AMR), duke paraqitur sfida të konsiderueshme për shëndetin publik në mbarë botën. Pandemia COVID - 19 ka përkeqësuar përdorimin dhe përshkrimin irracional të antibiotikëve, duke zbuluar pasoja të fshehura për pacientët dhe sistemet shëndetësore. Ky studim synon të shqyrtojë trendet, pasojat dhe mësimet kryesore të nxjerra nga përdorimi irracional i antibiotikëve gjatë epokës COVID - 19.

Metoda: U krye një rishikim i literaturës mbi artikuj të publikuar midis viteve 2020 dhe 2025, në databazat PubMed, Google Scholar dhe Cochrane. U përfshinë studime që fokusohen në përdorimin e antibiotikëve, modelet e rezistencës dhe ndikimin e COVID - 19 në praktikat e përshkrimit të antibiotikëve.

Rezultate: Trende të ndryshme të përdorimit të antibiotikëve u vunë re në komunitet përkundrejt sektorit spitalor gjatë Covid - 19. Në komunitet, konsumi i përgjithshëm i antibiotikëve u ul; Rrjeti Europian për Monitorimin e Konsumit të Antimikrobikëve (ESAC - Net) raportoi një ulje prej 18. 3% në vendet e BE / EEA midis 2019 dhe 2020, ndërsa Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC) raportoi një rënie të ndjeshme të përdorimit ambulant në SHBA në 2020 krahasuar me 2019. Nga ana tjetër, në sektorin spitalor përdorimi i antibiotikëve mbeti i lartë pavarësisht prevalencës së ulët të infeksioneve bakteriale në pacientët COVID - 19. Këto trende mund të kenë kontribuar në rritjen e rezistencës. Megjithëse dëshmitë janë të kufizuara, të dhënat e disponueshme tregojnë se në spitale prevalenca e patogjenëve rezistentë është rritur. Rritjet më të theksuara përfshijnë Acinetobacter rezistent ndaj karbapenemëve (78%), Pseudomonas aeruginosa multirezistente (32%), Enterococcus rezistent ndaj vankomicinës (+4%) dhe Staphylococcus aureus rezistent ndaj meticilinës (13%).

Përfundime: Ka një nevojë urgjente për menaxhim proaktiv të antibiotikëve, përmirësim të edukimit publik dhe profesional, dhe integrim më të fortë të praktikave të bazuara në prova klinike gjatë krizave shëndetësore. Mësimet nga pandemia ofrojnë udhëzime të vlefshme për optimizimin e menaxhimit të antibiotikëve dhe parandalimin e keqpërdorimit të ardhshëm.

Fjalë kyçe: Përdorimi i antibiotikëve, rezistenca ndaj antimikrobikëve (AMR), COVID - 19, stewardship i antibiotikëve, përshkrim racional.

PËRCAKTIMI I NJËKOHSHËM ELEKTROKIMIK I KATEKOLIT DHE HIDROKINONIT DUKE PËRDORUR NJË ELEKTRODË TË MODIFIKUAR TË PASTËS SË KARBONIT.

Vlera Lipa[1], Endrita Kadriu[1], Astrid Ortner[2], Kurt Kalcher[2], Eda Mehmeti[1]
[1]*UBT – Institucion i Arsimit të Lartë, Fakulteti i Farmacisë, Lagjja Kalabria, 10000 p. n. , 10000 Prishtinë, Kosovë.*
[2]*Universiteti Karl - Franzens i Grazit, Instituti i Shkencave Farmaceutike (Kimi Farmaceutike), Schubertstrasse 1 / I, 8010 Graz, Austri.*

Abstrakt

Ky studim paraqet një teknikë të thjeshtë elektrokimike për analizën e njëkohshme të përbërjeve me strukturë të ngjashme, konkretisht 1, 2 - dhe 1, 4 - dihidroksibenzene, përkatësisht hidrokinonit (HQ) dhe katekolit (CC). Metoda përdor një elektrodë të pastës së karbonit (CPE) të modifikuar me dioksid mangani (MnO_2), duke aplikuar teknikën e voltametrisë me impuls diferencial (DPV). Përgjigja analitike optimale për HQ dhe CC, e vlerësuar në bazë të formës së pikut dhe intensitetit të rrymës, u arrit në një pH prej 10. 1, duke përdorur buferin e amoniakut. Pas optimizimit të sasisë së modifikuesit, u përcaktua se përfshirja e 5% MnO_2 përmirëson ndjeshëm vetitë elektrokimike të elektrodës. Elektroda e modifikuar, e quajtur MnO_2 / CPE 5%, tregoi sinjale të qarta redoks të lidhura me reaksionet elektrokimike të hidrokinonit dhe katekolit. Shtimi i MnO_2 në strukturën e elektrodës rriti diferencën e potencialit midis çifteve redoks të përbërjeve të synuara, duke çuar në rritjen e intensitetit të pikëve. Procesi i regjistruar nga elektroda e modifikuar ishte i kontrolluar nga difuzioni. Parametrat kryesorë të metodës u optimizuan dhe u ndërtuan lakoret e kalibrimit. U vu re se rryma e oksidimit ishte në

marrëdhënie lineare me përqendrimet e të dy analitëve në intervalin 50 deri në 190 μM, me kufirin e detektimit (3σ) për HQ dhe CC të barabartë me 30 μM dhe 37 μM, përkatësisht u shqyrtua ndikimi i përbërjeve potencialisht ndërhyrëse dhe metoda e zhvilluar u përdor me sukses për të matur sasinë e CC dhe HQ në mostra uji të rubinetit, duke përdorur teknikën DPV.

Fjalë kyçe: Hidrokinon, katekol, teknika e voltametrisë me impuls diferencial, sensor elektrokimik, elektrodë e modifikuar.

ROLI I FARMACISTIT NË SISTEMININ SHËNDETËSOR.

Zehadin Gashi[1], Drilon Gashi[2]
[1]Fakulteti i Farmacisë, AME Rezonanca, Prishtinë
[2]Barnatore Barkos, Prizren

Abstrakt
Farmacisti përbën një hallkë thelbësore në zinxhirin e kujdesit shëndetësor modern, duke shërbyer si urë lidhëse ndërmjet mjekut, pacientit dhe institucioneve të tjera të kujdesit shëndetësor. Roli i tij ka evoluar ndjeshëm gjatë dekadave të fundit, nga funksioni tradicional i shpërndarjes së barnave drejt një roli aktiv dhe bashkëpunues në kujdesin klinik, menaxhimin terapeutik dhe edukimin shëndetësor të popullatës. Përmes promovimit të përdorimit racional të barnave, këshillimit profesional, pjesëmarrjes në ekipet multidisiplinare dhe menaxhimit efikas të burimeve farmaceutike, farmacisti kontribuon drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor, sigurisë së pacientit dhe rezultateve klinike. Përfshirja e tij në vendimmarrjen klinike, optimizimin e terapisë medikamentoze dhe parandalimin e ndërveprimeve të padëshiruara është thelbësore për garantimin e trajtimit efektiv, të sigurt dhe ekonomikisht të qëndrueshëm. Megjithatë, në realitetin e sotëm, veçanërisht në sistemin shëndetësor të Kosovës dhe Shqipërisë, roli i farmacistit shpesh mbetet i kufizuar në shpërndarjen e barnave, pa përfshirje të plotë në proceset klinike. Kjo përbën një boshllëk të rëndësishëm në funksionimin e integruar të kujdesit shëndetësor, që kërkon ndërhyrje institucionale, ligjore dhe ekonomike. Institucionet profesionale si Urdhri i Farmacistëve dhe Urdhri i Mjekëve duhet të ndërmarrin hapa konkretë për institucionalizimin e rolit të farmacistit si pjesë integrale e ekipit mjekësor dhe të sistemit shëndetësor kombëtar. Vetëm përmes bashkëpunimit ndërprofesional mund të arrihet një kujdes shëndetësor gjithëpërfshirës, i sigurt dhe me kosto të përballueshme.

Fjalë kyçe: Farmacisti, kujdesi klinik, sistemi shëndetësor, ekip multidisiplinar, edukimi shëndetësor, përdorimi racional i barnave.